



Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Departamenti i Shkencës dhe i Teknologjisë

KUMTESAT I

NGA KONFERENCA VJETORE E SHKENCËS E SHKENCËS “JAVA E SHKENCËS” 2014

KUMTESAT I

Shkenca gjuhësore, kulturore
dhe historike

ISBN 978-9951-16-088-9



9 789951 160889

Prishtinë
2015

KUMTESAT I

Nga konferenca vjetore e shkencës 'Java e Shkencës 2014'

KUMTESATI

Nga konferenca vjetore e shkencës 'Java e Shkencës 2014'

Redaktor:

Dr. Murteza Osdautaj

Këshilli botues:

Prof. Dr. Myzafere Limani

Prof. Dr. Blerim Rexha

Prof. Dr. Lul Raka

Prof. Dr. Gazmend Qorra

Prof. Dr. Hysen Matoshi

Prof. Dr. Hysen Bytyqi

Kopertinën dhe përgatitjen kompjuterike
MOSDA[©]



Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Departamenti i Shkencës dhe i Teknologjisë

KUMTESAT I

Shkencat gjuhësore, kulturore dhe historike

Prishtinë,
2015



Parathënia e ministrit Prof. Dr. Arsim Bajrami

Të nderuar lexues,

Është kënaqësi e veçantë që para jush po paraqiten dy vëllimet e reja të kumtesave të paraqitura në konferencën kombëtare të shkencës “Java e Shkencës 2014”. Në këto vëllime paraqiten kontributet e punëtorëve shkencorë të Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë, Austrisë dhe disa vendeve të tjera evropiane nga të cilat kishte pjesëmarrës në konferencë.

Gjithsesi, “Java e Shkencës” për disa vite me radhë është bërë vend i takimit dhe i manifestimit të vlerave shkencore të hulumtuesve shqiptarë por edhe atyre joshqiptarë, të cilët dëshirojnë që rezultatet e tyre shkencore t’i bëjnë pjesë të kësaj konference.

Ne besojmë se kontributet shkencore të konferencës “Java e Shkencës” po e shënojnë një ngritje të vazhdueshme cilësore e cila po shënon rritje vit pas viti. Kjo është arritur me anë të ngritjes së mekanizmave recensuese dhe vlerësuese të konferencës por edhe me mekanizmin e recensimit të aplikuar për kumtesat në institucionet prej nga vijnë shkencëtarët pjesëmarrës të konferencës.

Për disa vite në konferencë është shënuar rritje e vazhdueshme e pjesëmarrjes së punëtorëve shkencorë. Në vitin 2014 kishte rreth 500 autorë dhe bashkautorë nga 7 vende të Rajonit dhe Evropës. Me një masivizim të tillë është arritur që konferenca “Java e Shkencës” të bëhet një ngjarje shkencore e njohur në Rajon. Meqë konferenca ka arritur qëllimin e saj të parë, në të ardhmen fokusi do të përqendrohet kryesisht në rritjen e cilësisë së punimeve shkencore të paraqitura dhe ndërkombëtarizimin e kësaj ngjarje.

Për ta rritur cilësinë e hulumtimit shkencor në vend dhe për të ngritur cilësinë e punimeve të paraqitura në konferencën e ardhshme ne kemi riorganizuar të gjitha këshillat shkencore të fushave dhe Këshillin Shkencor të MASHT. Në të ardhmen paraqitja dhe prezantimi i punimeve shkencore do të bazohet në standardet ndërkombëtare dhe sistemi i pranimit dhe i vlerësimit do të bëhet krejtësisht i digjitalizuar ndërsa që sistemi i

vlerësimit do të ngrihet në nivele të njohura evropiane, etj. Këto, shpresojmë, që do të ndikojnë që konferenca përfundimisht të shndërrohet në një ngjarje me vlerë ndërkombëtare të shkencës.

Për t'i arritur qëllimet e mësipërme, MASHT do të krijojë rrethana mbështetëse për veprimtarinë kërkimore-shkencore, si përmirësimi i bazës ligjore dhe nënligjore për veprimtarinë kërkimore-shkencore, ngritja e nivelit të financimit të kësaj veprimtarie si dhe ndërkombëtarizimi i saj, si dhe ne kemi nënshkruar shumë marrëveshje bilaterale dhe rajonale në fushën e bashkëpunimit shkencor me vendet e ndryshme që e lehtësojnë inkuadrimin e punëtorëve shkencorë kosovarë në aktivitete dhe projekte ndërkombëtare.

Gjithashtu punë të rëndësishme do të bëjmë që veprimtaria kërkimore-shkencore të krijojë lidhje të vazhdueshme për të qenë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit. Për të arritur këtë qëllim, MASHT ka hartuar strategjinë kombëtare të Inovacioneve e cila ka për qëllim që hulumtimin shkencor, ta shndërroj në veprimtari kombëtare në funksion të zhvillimit ekonomik dhe industrial të Kosovës.

Duke dëshiruar që konferenca e vitit 2015 të shënojë rritje cilësore në fushën e kërkimit shkencor, shpresojmë që këto dy vëllime të jenë një pikënisje për rezultate të reja drejt arritjeve të standardeve ndërkombëtare në këtë sferë.

Ministri,
Arsim Bajrami

Dy fjalë lexuesve

Botimi i kësivjetshëm i kumtesave po bëhet, gjithashtu, në dy vëllime. Edhe këtë vit ne u munduam që, në funksion të rritjes së cilësisë, të rrisim kriteret e pranimit të punimeve të cilat, përveq recensimit, shikuar edhe teknikat dhe metodologjinë e hartimit. Një numër i punimeve nuk janë botuar për shkaqe të mospërdorimit të mundësive dhe funksioneve që ofrojnë programet për procesimin e tekstit siç janë referencat, fusnotat, endnotat të cilat shpesh ishin të përziera me tekstin bazë. Gjithashtu në një numër të punimeve të arritura ishin përdorur formatizime të cilat nuk na mundësonin, në asnjë mënyrë, radhitjen dhe përpunimin kompjuterik të tekstit apo pjesëve tjera të punimeve. Edhe punimet e tilla nuk i kemi botuar ngase nuk mund të kuptonim se cili ishte teksti bazë dhe cila pjesa e referencave dhe shënimeve apo ku duhej të vendosej një tabelë, figurë apo element tjetër i punimit. Duke parë së një pjesë e pjesmarrëve shfaqin probleme në përdorimin e softuerëve për procesim të tekstit apo janë ende në fillim të përvojës së tyre në të shkruarit akademik dhe shkencor, për punimet e konferencës së vitit 2015, ne kemi përgatitur një formë të gatshme (template) e cila do t'iu shpërndahet pjesëmarrësve dhe, shpresojmë, do ta lehtësojë edhe punën e hulumtuesve por edhe të redaksisë.

Dëshirojmë tua bëjmë me dije lexuesve se radhitja e punimeve në libër është bërë në bazë të fushave shkencore duke mos përdorur ndonjë seleksionim të mëtutjeshëm por duke i radhitur kumtesat në mënyrë të rastësishme, bazuar në kohën kur janë dërguar ato. Gjithashtu dua t'i njoftoj lexuesit se, sipas marrëveshjes me autorët, ata ishin të obliguar dhe përgjegjës që punimin e tyre të lekturuar ta sjellin për botim edhe me dy recensione nga ekspertë eminentë të fushave, emrat e të cilëve mund të gjenden në fillim apo në fund të çdo punimi të veçantë. Në këtë kuadër, ne kemi bërë disa lëshime për tre a katër autorë të cilët njihen si ekspertë eminentë të fushave të tyre shkencore apo udhëheqin institucione të rëndësishme shkencore në Kosovë dhe ne vendet nga kishin ardhur.

Unë dua t'i falënderoj të gjithë pjesëmarrësit e konferencës së sivjetme dhe konsideroj se këto dy vëllime paraqesin një kontribut tjetër të madh në zhvillimin e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit në vendin tonë dhe në rajon. Dua të nëvizoj, gjithashtu, se ne do të bëjmë përpjekje që në konferencat e viteve që vijnë të përqendrohemi më shumë në ekselencën shkencore gjë që për pjesëmarrësit dhe MASHT paraqet një angazhim shtesë më intensiv dhe më profesional. Ne mendojmë se vetëm duke u përqendruar në ekselencën shkencore do të jemi të zotët për konkurrencë dhe ballafaqim me komunitetin shkencor evropian dhe rajonal.

Për fund dua të theksoj se botimi i këtyre dy vëllimeve është bërë i mundur edhe nga ndihma dhe mbështetja e pakursyer e Ministrit të MASHT, Prof. Dr. Arsim Bajrami, nga përkrahja e vazhdueshme e këshilltarit të Ministrit për shkencë, Prof. Dr. Hysen Bytyqi si dhe nga puna e palodhshme e anëtarëve të Këshillit Shkencor të MASHT, këshillave shkencore të fushave dhe stafit të Departamentit të Shkencës dhe të Teknologjisë. Gjithashtu, nuk ka munguar as ndihma e punëtorëve të departamenteve tjera të MASHT për çka dua t'i falënderoj të gjithë.

Dr. Murteza Osdautaj, drejtor i DSHT, MASHT

NGA SEANCA PLENARE...

ETIKA NË SHKENCË

Salvatore Bushati

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, sbushati@yahoo.com

Abstrakt

Marrëdhia etike e sociale e shkencës i vë theksin përgjegjësisë së individit që merret me shkencë. Në lidhje me këtë duhet bërë dallimi midis çështjeve që lidhen me rolin e shkencës në shoqëri dhe atyre që prekin rregullat morale të kërkimit shkencor. Asnjë kufi i prerë nuk mund të skicohet midis këtyre dy çështjeve: disa prej formave të dhunimit të normave të sjelljes që lidhen me punën kërkimore mund të shkaktojnë dëme serioze bashkësisë së kërkuesve e më gjërë, duke u rrezikuar atyre shëndetin apo mirëqënien, prandaj dhunimet proceduriale mund të jenë imorale në kuptimin e gjerë të fjalës.

Në themel të fuqisë motivuese të kërkimit shkencor qëndron etja natyrale e njeriut për njohuri, dëshira për të njohur botën e fizikës, biologjisë dhe të shkencave shoqërore, mendjen njerëzore dhe atë çka ajo prodhon. Shkenca në vetvete është një sasi njohurish të sistematizuara, të cilat përthithen gjatë observimeve , përgjatë diskutimeve të gjata dhe shkëmbimit të opinionëve. Qëllimi i kërkimit shkencor është njohja e natyrës dhe e principeve bazë të objektit apo fenomenit të studiuar dhe bërja publike e rezultateve të përfuara gjatë eksperimentit.

Kërkimi shkencor është qartazi i shumëllojshëm dhe i papërshkrueshëm me një përkufizim të vetëm faktik apo normativ. Madje dhe kërkimet shkencore brenda së njëjtës fushë mund të ndryshojnë nga njëri-tjetri pavarësisht traditave që ekzistojnë dhe metodave që aplikohen. Për më tepër, tipari dallues i një kërkimi shkencor është të bazuarit mbi të dhëna të qarta dhe të themeluara mbi vëzhgimet e produkteve të natyrës apo aktivitetit njerëzore dhe mbi rezultate të përfuara prej këtij aktiviteti.

Kërkimi shkencor është një aktivitet që kryet nga individë apo grup kërkuesish, por edhe kur ai kryhet nga individë; ai nuk përbën një veprimtari të izoluar, por është një sinergji apo bashkëpunim ndërmjet kërkuesve. Në mënyrën e saj të të arsyetuarit dhe të të çuarit përpara, përse i përket hapësirës së shtrirjes, shkenca nuk njeh kufij kombëtar. Komuniteti shkencor përcakton metodologjinë e duhur për kërkim dhe konfirmon rezultatet e kërkimit. Kërkimi shkencor ka aftësinë të kontribuojë në bagazhin e njohurive të çdo individit, nëse rezultatet bëhen njësoj të vlefshme për të gjithë dhe vlera e së vërtetës të arrihet me një shkallë të lartë sigurie.

Fjala shkencë ka një kuptim të gjerë dhe përfshin bashkësinë e shkencave natyrore, sociale e të sjelljes si dhe ato humane. Kërkimi shkencor synon të prodhojë njohuri të reja sistematike. Karakterizohet nga një frymë e vazhdueshme bashkëpunimi, shpirt garues dhe global duke përdorur dhe zhvilluar teknologji të reja që zhvillohen në mënyrë progresive.

Kërkimi shkencor duhet të jetë i pavarur, i paanshëm dhe autonom. Edhe në botë, realizimi i këtij procesi shpeshherë është i vështirë; në disa raste ai pengohet prej presionit që ushtrohet nga politika, individëve që gëzojnë njëfarë pushteti apo institucioneve dhe interesave ekonomiko- financiare. Kërkuesi duhet të ketë lirinë e nevojshme për t'u mbështetur në rregulla dhe kritere të formuluar prej tij për t'i shërbyer njohjes së realitetit dhe të ketë parasysh gjithmonë mirëqenien publike. Duhet parë qartë nëse kërkuesi e bën detyrën e tij për të prodhuar vlera: supozimet e tij, pikat e fillimit të kërkimit shkencor, përzgjedhja e objektit të kërkimit, metoda e grumbullimit të të dhënave, efektet e rezultateve të kërkimit shkencor dhe zbulimet janë të lidhura me moralin, etikën dhe mardheniet shoqërore ku shkencën përparon.

Sfidat me të cilat përballlet shkencën e sotme dhe marrëdhëniet komplekse midis shkencës dhe shoqërisë i vënë theksin nevojës që kërkuesi duhet të jetë i vetëdijshëm për përgjegjësitë e tij. Pra sfidat e reja të etikës ngrihen prej zhvillimeve të shkencës.

Shkencëtarët kanë role të ndryshme: si kërkues, supervisor, vlerësues dhe recenzentë e po kështu këshillatarë të vendimmarrjes e politikbërjes së qeverive dhe institucioneve. Principet e etikës gjejnë vend të gjitha hapsirat e sipërpërmendura e për pasojë edukimi mbi etikën në kërkim shkencor duhet të forcohet që të sigurojë besimin dhe shpresën në kërkimin shkencor, një mjet i sigurtë ky për përballimin e sfidave nga ana e shkencëtarëve.

Etika në shkencë duhet të jetë një pjesë integrale e edukimit dhe trajnimit të gjithë shkencëtarëve. Një sjellje pozitive ndaj refleksionit, vigjilencës, dhe ndërgjegjësimit përsa i takon dilemave etike është e rëndësishme për kërkuesit e rinj. Gjithashtu kërkuesit e për më tepër drejtuesit e vjetër shkencor kanë përgjegjësinë të promovojnë dhe integrojnë etikën e kërkimit në mësimdhënien e tyre. Kështu trajnimi mbi aspektet e etikës duhet të jetë pjesë e karrierës së kërkuesit nga fillimi deri në fund. Por standardet ndryshojnë, e po ashtu dhe metodat e përgjegjësitë, e kërkuesit duhet të përditësohet.

Etika e kërkimit shkencor mund të klasifikohet në aspekte me problematika të brendshme dhe të jashtëme. Fusha e etikës së kërkimit është më e gjerë se problematikat që vijnë prej ndershmërisë së kërkimit. Gjatë vëzhgimeve tona në shkencë në morinë e marrëdhënieve të tyre etike e sociale, shtrohen një sërë pyetjesh etike:

Për sa i takon objektit të një kërkimi: a ja vlen barra qiranë e këtij zbulimi?

Cilat janë pasojat e rezultateve të kërkimit për individin e shoqërinë?

Mundet kërkimi të kufizohet mbi baza etike apo sociale; mundet shkencën i imponohet disiplinës vetjake nëse si pasojë e aktiviteteve të saj mund t'i shkaktojë dëm njerëzimit, a ka efekte të dëmshme në faunë, shoqëri apo natyrë?

Çfarë mund të bëhet nëse produktet e kërkimit shkencor hyjnë në konflikt me vlerat njerëzore (dinjiteti, autonomia, liria, barazia, ndalimi i shfrytëzimit prej të tjerëve); apo që ato mund të përdoret kundër njerëzimit?

Mundet që kërkimi të mbetet mjaftueshëm i pavarur nga grupi i interesave, a ekziston rreziku që kërkimi shkencor të bëhet tepër i varur nga financuesit?

Mundet kërkuesi të ndrydhet nga një përdorim selektiv dhe keqinterpretim i rezultateve të kërkimit shkencor të kryer prej tij dhe a mundet ai të ndalojë një përdorim të papranueshëm të zbulimeve të tij?

Përsa i takon etikës së disiplinës vetjake të kërkimit (aspekteve të brendshme), në duhet fillimisht të merremi me normat e etikës që do përfshihen në rezultatet e punës kërkimore. Detyrat e shumëanëshme administrative, masat financiare e tensionet e

prodhuara nga kokurrenca, dobësia e karakterit njerëzor dhe ndryshimet sociale, në mënyrë të dyshimtë dhe të papranueshme, rrisin tundimin e kërkuesit për të arritur sukses të shpejtë në shkencë. Ndaj është e nevojshme që rregullat e përcaktuara në kodin e sjelljes të eliminojnë përpjekje të tilla që zbehin vlerat e kërkimit shkencor, me qëllim që ai të mbetet i moralshëm dhe autentik.

Një aspekt i rëndësishëm i kërkimit shkencor është etika në publikime ku ne shpesh përballemi me dukuri të tilla si ajo e plagjiaturës. Në publikimin e rezultateve shkencore kërkuesit duhet të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë e përmbytjes në punimin e paraqitur të cilat duhet të jenë të bazuara në hulumtimet e tyre dhe të shprehura me fjalët e tyre. Publikimi i rezultateve që nuk kanë dalë nga eksperimenti në fjalë dhe/ose tjetërsimi i punës së dikujt tjetër klasifikohen plagjiaturë. Gjithashtu, një material nuk duhet të publikohet në më shumë se një revistë. Plagjiatura konsiderohet një praktikë e keqe dhe jo etike.

Si pasojë e shkeljes së normave të etikës janë evidente rreziqet që ekzistojnë në kërkimin shkencorë. Sjellja e kërkuesit që shkon kundër normave të etikës së shkencës është e dëmshme për shkencën në vetvete, sepse ajo mund të japë udhëzime të gabuara tek kërkuesit e tjerë duke sjellë një paraqitje të kërkimit që nuk përputhet me qëllimet e zhvillimit të kërkimit. Nëse përshembull në se një menaxher kërkimi, paraqet një doktrinë që është hedhur poshtë nga ana profesionale, por autori vazhdon ta mbajë e ta propogandojë atë, ai s'bën gjë tjetër veçse kthen mbrapa në kohë fushën e kërkimit shkencor në fjalë. Një sjellje e tillë dëmton dhe shoqërinë gjithashtu: kërkimi i rremë psh në një marketing produktesh farmaucetike apo produkteve të tjera industriale, mund të rezultojnë të rrezikshme për shoqërinë. Nëse politikat apo legjislacioni bazohen mbi rrezultate kërkimore të rreme, pasojat e dëmshme janë të paparashikueshme.

Më tej, efekte të dëmshme mund të ketë nëse besimi i publikut në shkencë tronditet dhe pse shkenca gjithmonë duhet të jetë burim i besueshëm orientimi dhe përgatitjeje vendimi. Së fundmi sjellja që dhunon etikën në shkencë mund të jetë gjithashtu e dëmshme për vetë kërkuesin, i cili herët a vonë do të përjashtohet nga komuniteti i kërkuesve shkencorë.

Në përgjithësi, sjelljet e padenja me etikën në shkencë janë mjaft të përhapura. Shtimi i presionit publik e shtetëror në shkencës në drejtim të: aspekteve të vlerësimeve të ndryshme, praktikave dhe sistemeve të vlerësimit që rregullojnë karrierën e shkencëtarëve, të sferës së biznesit, garës gjithnjë e më e vështirë për të siguruar burime të ndryshme me mënyra të pa drejta, e keqpërdorimin e burimeve të informacionit nga interneti, të gjitha këto ndëshkohen me instrumenta ligjorë.

Forma e ndëshkimit moral do të ishte bërja publike.

Nuk ka kufij të prerë midis shkeljes së etikës korrekte dhe ofendimit ligjor, në këtë rast kategorizimi i shkeljes nuk është detyrë e thjeshtë.

Në lidhje me problematiken e trajtuar me sipër, i një rëndësi të madhe është roli që duhet të luajnë institucionet qëndrore në etikën e kërkimit shkencor.

Përmbledhtazi duhet të hartohen detyrime statutove të institucioneve kërkimore shkencore, të cilat të marrin përgjegjësinë për ruajtjen e moralit dhe autenticitetit të kërkimit shkencor në Shqipëri, në sajë të:

thirrjes që të gjitha institucionet shkencore që veprojnë në që të ngrejnjë organizma që do të mbikqyrin integritetin e kërkimit shkencor mbi bazën e këtij Kodi Etik në Shkencë apo rregullat etike të shkencës;

dëshirave që të gjithë individët të angazhohen të përmbushin normat e përshkruara në Kodin e Sjelljes duke u bërë njësh me të; angazhimin nga ana e drejtuesve të institucioneve dhe institucionve vetë për të ruajtur integritetin e shkencës; të parit si kërkesë kyç, të vëzhgimit të përhershëm të rregulloreve ligjore shqiptare dhe rregullave ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me kërkimin njerëzor dhe testet mbi kafshët; një rëndësisë jetësore në proceset mësimore, të sistemit të mesëm dhe në atë të lartë arsimor dhe veçanërisht në trajnimet, principet dhe praktikat në fushën e etikës në shkencë për doktorantët, duhet vazhdimisht të studiohen dhe përditësohen.; të të drejtës që i jepet Komitetit për Etikën në Shkencë për të vepruar hap pas hapi në të gjitha rastet që dëmtojnë apo rrezikojnë integritetin e kërkimit shkencor e që paraqesin sjellje jo të hijshme nga ana e shkencës. Në këto raste komitetet e etikës që kanë institucionet e kërkimit, institucionet e arsimit të lartë apo institucionet dhe organizatat e tjera, mund të bashkëveprojë dhe si një forum për zgjidhje të problematikës në etikën në shkencë.

Shpesh përballemi me pyetje të tilla si, a ka patur në Shqipëri kërkim shkencor? Pa u zgjeruar në një tematikë të tillë do të thoja që trashëgimia shkencore në Shqipëri e Kosovë nuk ka munguar, si në studimet bazë ashtu edhe në ato të aplikuara. Rastet janë të shumta dhe ne duhet të punojmë fort ti analizojmë ato dhe të nxjerrim pozitiven, ta promovojmë për brezin e ri, e më pas ta thellojmë atë duke nisur jo nga zeroja në studimet tona.

Për të patur kërkim shkencore duhet që investojmë thellë në vite për të vendosur bazat e tij. Një arsimim i shëndetshëm e vizionar duhet të kryhet nga parashkollori e deri te arsimi i lartë, për të siguruar kontigjente kërkuesish të rinj. Nga ana tjetër Institucionet kërkimore duhet të strukturohen e të kenë prioritete në përputhje me kërkesave e zhvillimit.

Prodhimi i politikave të shëndetëshme në shkencë, Hartimi i Strategjive për kërkimin shkencor, zhvillimin teknologjik e inovacionet, Mbështetja e Qeverisë për komunitetin shkencor, por jo vetem financiarisht janë faktorë shumë të rëndësishëm të suksesit. Nga ana tjetër, pandalshmëria e përditësimit të sistemit të kërkimit shkencor në vend dhe infrastrukturave në përputhje me Prioritetet e zhvillimit të vendit duke shfrytëzuar eksperiencat në vend, mes vendeve tona, në rajon, Europë e më gjerë, duhet të jetë një proces i vazhdueshëm e që duhet të jetë detyrë e vetë komunitetit shkencor.

Për arritje në këtë drejtim kemi mjaft instrumenta, si Strategjinë Kombëtare të Kërkimit, Zhvillimit Teknologjik e Inovacioneve; Programet Kombëtare për kërkim e zhvillim; Rritjen të fondeve të kapaciteteve në infrastrukturë e laboratore; Jemi pjesë e Programit Kuadër të BE; Janë dhënë buxhete për projekte të Kërkimit nëpër universitete;; Janë bërë hapa para për autonominë në kërkimin shkencor, si dhe janë në përgatitje dokumente bazë për arsimin parauniversitar atë universitar dhe atë të kërkimit shkencor. Për të patur orjentim të saktë në lidhje me fushat përparësore të kërkimit shkencorë, duhet të udhëhiqemi nga Strategjitë Kombëtare të Kërkimit e Zhvillimit Teknologjik dhe Inovacioneve, si dhe Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit.

Kërkimi shkencor duhet t'i përgjigjet, kërkesave të zhvillimit të vendit. Në këtë orjentim çmarrëdhënie duhet të ketë kërkimi shkencor për bizneset dhe etikën në kërkim?

Kërkimi shkencor, që nuk gjen zbatimet e tij në praktikat prodhuese, sidomos ai aplikativ, nuk është kërkim shkencor i mirëfilltë, nuk gjen zbatime dhe nuk mund të ketë edhe zhvillim; për më tepër ai nuk mund të ketë shpresë të jetë inovacion.

Kërkimi shkencor i shërben zhvillimit ekonomik, prodhimit; e shumë biznese kanë lidhje direkte me:

- me kërkime biologjike në bujqësi në frutikultuëe e më gjerë në ferma private;
- me kërkime të fizikës bërthamore në fusha të ndryshme të shëndetësisë, në kërkime biologjike e në shkencat tjera, në bujqësi, në certifikimin e cilësisë së saldimeve në uljen e rrishtit në objekte të sigurisë së lartë; në shkencat e tokës, në fushën e trashëgimisë kulturore, e shume e shume fusha;
- me studime hidraulike, hidrologjike e meteorologjike në sistemet ujore e energjitike;
- me studime të emrgjencave civile, rrishtit e masave lehtësuese e parandaluese të tyre;
- me studime e aplikime të matematikës dhe informatikës në sektorët ekonomike që lidhen me cilësinë, koston e ulët e shpejtësinë, drejt standardeve më të avancuara të kohës;

Aplikimet e shkencës për intensifikimin, modernizimin, uljen e kostove e rritjen e cilësisë si dhe orjentimin e futjen e veprimtarive prioritare për zhvillimin e vendit e qëndrueshmërinë e bizneseve me largpamësi e në përputhje me interesat nga ai lokal deri në atë të interesave europiane, që nënkupton qëndrueshmëri, intensifikim e një konkurrencë të suksesëshme në treg.

Por ajo që është më e rrezikshme e lidhjes shkencë – prodhim është mungesa e etikës në studimet shkencore dhe prodhimit nga ana tjetër. Jemi sot dëshmitarë të përdorimit të studimeve shkencore në fusha të ndryshme të prodhimeve prsh bujqësore për stimulimin e tyre etj, që del jashtë rregullave etike..., raste të tilla ka shumë, gjë që është e papranueshme dhe bile spekulative.

INDIKATORËT NDËRKOMBËTARË TË MATSHMËRISË SË VEPRIMTARISË KËRKIMORE – SHKENCORE

Murteza Osdautaj

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë

Hyrje

Punimi ka për qëllim që të sjell një pasqyrë të shkurtër të indikatorëve të njohur dhe të pranuar ndërkombëtarë të cilët përdoren për të bërë matjen kualitative dhe kuantitative të veprimitarisë kërkimore - shkencore në vendet e zhvilluara dhe në zhvillim. Paraqitja e këtyre indikatorëve dhe aplikimi i tyre do të mundësojë që vendet dhe institucionet të kenë një numër instrumenteve me të cilat ato mund ta masim performancën shtetërore por edhe në nivel të institucioneve.

Definicioni dhe llojet

Indikatorët paraqesin prezantim relevant kuantitativ të punës kërkimore shkencore të fokusuar në:

- qëllimin,
- cilësinë dhe
- vitalitetin e shkencës dhe inxhinierisë

Indikatorët janë të shumtë dhe të shumëllojshëm. Në përgjithësi, bazuar në dokumentet ndërkombëtare, ata përmbledhen në tri lloje kryesore që përfshijnë fushën e financimit, atë të të dhënave lidhur me veprimtarinë dhe të publikimit. Kohëve të fundit, sidomos në Evropë, përdoren edhe indikatorë të tjerë të cilët merren me matjen e impaktit (ndikimit) të veprimitarisë kërkimore – shkencore në zhvillimin ekonomik dhe social të një vendi dhe që ka të bëjë me fushën e inovacioneve. Në këtë punim do të flasim kryesisht lidhur me tre lloje të indikatorëve të cilët mund të klasifikohen në:



- Indikatorët buxhetorë
- Indikatorët statistikorë
- Indikatorët bibliometrikë

Indikatorët Buxhetorë

Tregojnë se cili është buxheti (% e GDP) që ndan një vend apo një regjion për hulumtimin, zhvillimin apo inovacionin. Në përgjithësi dihet se vende të caktuara dhe regjione të caktuara në botë kanë hartuar strategji dhe dokumente të posaçme që e rregullojnë këtë fushë. Bashkimi Evropian, p.sh., me deklaratën e Lisbonës, kishte venë shifrën 3% të bruto prodhimit kombëtar (GDP) si një qëllim që vendet e këtij unioni duhet të arrijnë deri në vitin 2017. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në anën tjetër,

përdorin instrumente të tjera të cilat bazohen kryesisht në ruajtjen e lidhësive amerikane në ekonomi dhe zhvillim tekniko-teknologjike. Gjithashtu edhe vendet e Azisë kanë vendosur caqë dhe qëllime lidhur me këtë fushë.

Duhet të ceket se kriza ekonomike e vitit 2008, sidomos në Evropë, ka ndikuar që 3% i GDP ende të jetë larg nga realiteti edhe pse disa vende të veçanta e kanë arritur dhe tejkaluar tashmë. Më poshtë do të paraqesim një hartë¹ të investimeve në disa nga vendet evropiane ku shihet se vetëm pak vende janë në kufijtë e paracaktuar evropian:




Source of boundaries: UNEP (2011): UNEP Environmental Data Explorer.
United Nations Environment Programme. <http://geodata.grid.unep.ch>.
Source of data: Eurostat

Por paraqitja grafike² është më e qartë ku shihet konkretisht paraqitja sipas vendeve:


¹ Harta për të cilën po flasim është marrë nga: <http://www.ons.gov.uk/ons/rel/rdit1/gross-domestic-expenditure-on-research-and-development/2012/stb-gerd-2012.html?format=print>, më 30.04.214

² E shkarkuar nga Eurostat-i




Nëse dëshirojmë të flasim në terma globalë atëherë mund të themi se ende SHBA-ja është vendi lider i investimeve në këtë fushë me 32.2% të investimeve botërore. Gjithsesi se, bazuar në trendet e zhvillimit ekonomik dhe përpjekjeve të vazhdueshme për konkurrencë botërore për tregje dhe mbizotërim ekonomik, SHBA përcillet në mënyrë të vazhdueshme nga Azia Jugore dhe Juglindore që investon 31.6% të investime botërore dhe Evropa që qëndron në shifrën prej 24%. Përçindjet e vendeve dhe regjioneve tjera janë jokonkurrense, nëse i krahasojmë me shifrat e përmendura më lartë.

SHPENZIMET BOTËRORE PËR HZH



Interesante është edhe prejardhja e investimeve që bëhen në vendet e zhvilluar në botë. Shembujt nga SHBA, Evropa dhe Azia na tregojnë se sasia më e madhe e investime të përgjithshme të vendeve të zhvilluara, praktikisht vjen nga sektori i industrisë dhe ekonomisë, ndërsa një pjesë tepër e vogël e këtyre investimeve rrjedhin nga sektori qeveritar apo institucionet tjera akademike dhe shkencore. Shembulli i ShBA³ është një tregues shumë qartë i këtyre trendeve. Në këtë vend rreth 70% të investimeve totale vijnë nga industria ndërsa vetëm rreth 30% të investimeve të përgjithshëm janë investime qeveritare apo nga institucionet kërkimore - shkencore, akademike apo organizatat joqeveritare. Më poshtë do të paraqesim një grafik ku paraqitet origjina e investimeve për HZH (hulumtim, zhvillim dhe inovacion) në ShBA:



³ Shih për këtë në:
<http://www.nsf.gov/statistics/seind14/index.cfm/etc/pdf.htm>

Indikatorët statistikorë


Indikatorët statistikorë janë instrumente të cilat përdorën për të paraqitur performancën e vendeve të caktuara dhe të institucioneve. Gjithashtu indikatorët statistikorë janë instrumente matëse edhe për matjen e performancës individuale të shkencëtarëve. Bazuar në dokumentet evropiane dhe botërore ekzistojnë dy lloje kryesore të indikatorëve statistikorë të cilët përdorën për hulumtimin shkencor dhe për inovacione. Në bazë të kritereve të njohura ndërkombëtare mund t'i veçojmë këta indikatorë për hulumtimin shkencor:

- Numri i hulumtuesve të punësuar për 1000 të punësuar.
- Përqindja e femrave në numrin e përgjithshëm të stafit akademik.
- Numri i të doktoruarve në njëmijë banorë të moshave 25-34
- Numri i publikimeve ndërkombëtare për 1 milion banorë
- Numri i publikimeve në 10 revistat më të cituara në krahasim me numrin total të botimeve.
- Numri i hulumtuesve të punësuar me kontratë të fiksuar kohore.
- Numri i doktorantëve të huaj të diplomuar.
- Numri I hulumtuesve postdoktoralë që kanë kryer mobilitete ndërkombëtare në 10 vitet e fundit.
- Përqindja e doktorantëve të huaj karshi numrit të përgjithshëm të doktorantëve.

Ndërsa indikatorët e inovacionit janë:

- Përqindja e doktorantëve në shkencat inxhinierike
- Të diplomuarit në proporcion me popullsinë
- Investimet publike dhe private në H dhe ZH
- Shpenzimet kombëtare për Inovacione
- Shpenzimet kombëtare për ICT
- Inovacionet e pavarura dhe me bashkëpunim të NVM
- Të punësuarit në sektorin e teknologjisë së lartë
- Eksporti I teknologjisë së lartë
- Numri I prodhimeve të reja në treg
- Balanca teknologjike në mes pagesës dhe prodhimit
- Numri I patentave, markave tregtare dhe dizajnit sipas EPO USPTO dhe Triadike (SHBA, BE dhe Japonia).

Duke e njohur gjendjen në vendin tonë dhe në Shqipëri, mund të konstatojmë se si vende por edhe si institucione kërkimore – shkencore dhe subjekte ekonomike qëndrojmë tepër poshtë në realizimin e mesatareve evropiane sipas këtyre njërive matëse. Për ta pasur një pasqyrë të gjendjes në vendet evropiane po e sjellim rastin e Gjermanisë krahasuar me BE 27 dhe grupin e vendeve më të zhvilluara në fushën e inovacioneve:



Indikatorët bibliometrikë

Bibliometrika është një grup i metodave të përdorura për të studiuar ose për të matur tekstet dhe informacionin. Koncepti së pari u zhvillua nga Dr. Eugene Garfield dhe ky koncept u zhvillua shumë pas zhvillimit të teknologjisë së informacionit i cili zhvillim bëri që koncepti të zgjerohet në një numër nënstrumentesh që vlerësimin punës kërkimore – shkencore e bëjnë shumë të dukshme në aspektin statistikor. Ky koncept aplikohet për autorët individualë, revistat dhe punimet shkencore dhe mbi institucionet.

Çka merret parasysh

Tek indikatorët bibliometrikë merren parasysh një varg faktorësh të cilët ndikojnë që një matje të posedojë cilësi dhe ndikimin për tu arrirë një cilësi e tillë dhe për të qenë e pranueshme ndërkombëtarisht, faktorët që do t'i sjellim më poshtë janë të rëndësishëm për tu marrë parasysh:

- Standardet botuese
- Recensimi Peer,
- Konventat botuese
- Përmbajtja e botimit
- Njohuritë shtesë (të sjella) në fushën specifike shkencore
- Diversiteti
- Ndikimi ndërkombëtar dhe rajonal i autorëve, redaktorëve, këshilltarëve
- Analiza e citimit
- Puna e mëhershme e redaktorëve dhe autorëve

Indeksi i citimit

Indeksi I citimit është një indikator që impakton institucionin, revistën, autorin dhe punimin. Një nga elementet që përcaktohet nga numri I botimeve është edhe indeksi I njohur *Impact factor* ose faktori I ndikimit (FI). Faktori i ndikimit (IF) i një reviste akademike është një masë që reflekton numrin mesatar të citimeve të artikujve të botuar kohëve të fundit në atë revistë. Rreth 15% të revistave⁴ e rrisin numrin e citimeve në kuadër të botimeve të tyre ndërsa që në garën për tu indeksuar me këta faktorë brenda vitit konkurrojnë rreth 1200 revista të reja prej të cilave vetëm 15% e tyre ia arrijnë këtij qëllimi.

Përveq IF-së në botë, viteve të fundit, janë zhvilluar edhe dy faktorë të tjerë. I pari prej tyre është faktori H^5 (Hirsh) ndërsa i dyti faktori G i cili kalkullohet bazuar në numrin më të madh (eksponencial) të citimeve të fituara nga një punim. Kohëve të fundit përdoren edhe indekse të tjera siç janë H-G indeksi dhe G indeksi të cilët e bëjnë edhe më të komplikuar vlerësimin e veprimtarisë shkencore në një vend të caktuar.

Përfundim

Nga sa u tha këtu është një infrastrukturë tejet e komplikuar e indikatorëve të cilët e vënë punën kërkimore – shkencore para një filtri të jashtëzakonshëm. Aplikimi i këtyre indikatorëve i vë të gjithë faktorët para një detyre shume të rëndësishme dhe para një pune të rëndë dhe kualitative. Angazhimi i qeverive, implikimi i industrisë dhe ekonomisë si dhe puna serioze shkencore e shkencëtarëve është një kërkesë imediate për ta mundësuar futjen e vendeve tona brenda sistemit të vlerësimit të punës kërkimore-shkencore në nivele ndërkombëtare. Duhet të fillohet me vlerësimin e brendshëm dhe aktiviteti duhet të jetë i pakompromis.

⁴ Është me rëndësi se një numër i revistave për ta mbajtur apo për ta rritur IF-në e tyre, me qëllim e ngrisin numrin e citimeve të botimeve të tyre duke i obliguar autor në këtë. Ky faktor e bën IF-në një koncept bukur diskutabil.

⁵ Nënkupton që një shkencëtar ka një indeks h kur ka botuar h punime dhe secili prej tyre është cituar nga të paktën h herë. Edhe faktori h ka të metat e tija të cilat shpesh nuk e paraqesin performancën e vërtetë të shkencëtarit të veçantë.

SHKENCAT GJUHËSORE DHE
KULTURORE

INTERNETI DHE GJUHA E TË RINJËVE (KULLERA VE)

Afërdita Abdullahi

Instituti Albanologjik, Prishtinë

Fillimi i shekullit të ri në Kosovë, që nënkupton përfundimin e luftës së fundit dhe lirinë nga okupimi shumëshekullor, solli ndryshime të mëdha, ndryshime të cilat u manifestuan në shumë fusha të jetës sociale, e këto ndryshime u sollën edhe në gjuhë.

Këto ndryshime, pos të tjerash, janë pasojë e ndryshimeve që kanë përfshirë edhe popuj të tjerë të Evropës dhe të botës. Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë informative, krijimi i raporteve të afërta me botën e jashtme, nevoja e bashkëpunimit ndërkombëtar në shumë fusha, e shumë faktorë të tjerë, ndikuan në shumë sfera të jetës në Kosovë. Në këtë kontekst të ri të krijuar duhet pasur parasysh ndikimin e anglishtes si gjuhë globale, ndikim ky që shfaqet pothuajse në të gjitha gjuhët e botës.

Zhvillimi i medieve elektronike dhe i atyre digjitale, bashkë me zhvillimin e teknikës kompjuterike dhe të internetit, kanë sjellë përmasë të re në përdorimin e gjuhës shqipe, qoftë në të shkruar, e edhe në të folur.

Interneti, si një ndër agjentët media, është shumë i rëndësishëm sidomos në kohën e angazhimeve të shumta, ku njerëzve në përgjithësi iu mundëson qasje të shpejtë dhe marrje të burimeve apo informacioneve të ndryshme pothuajse nga secili vend.

Revolucioni komunikues është në një proces shumë intensiv, prandaj edhe sot e kësaj dite njeriu është bërë jo vetëm subjekt, por edhe objekt i kësaj teknologjie që zhvillohet me një dinamikë të jashtëzakonshme, duke e ndihmuar dhe lehtësuar komunikimin, por edhe duke e rrezikuar përveç formës dhe përmbajtjes së komunikimeve, edhe vetë të qenit e tij social, human dhe solidar.⁶

Sipas rezultateve të projektit Web Characterization të OCLC-së, 4 të realizuar në vitin 2002, deri 72% e përmbajtjeve tekstore në sajte janë në gjuhën angleze, 7% në gjuhën gjermane, 6% në gjuhën japoneze, 3% në spanjishte e 3% në frëngjishte dhe 9% në të gjitha gjuhët e tjera të globit⁷. Kur i kemi parasysh këto shifra, tash pas 10 vjetësh, me plot gojë mund të themi se anglishtja është gjuha "zyrtare" e internetit.

Edhe pse në Kosovë përdorimi i internetit nuk ka kohë të gjatë në përdorim, përhapja dhe ndikimi i tij rrodhi shumë shpejt, sa që u kthye në domosdoshmëri pa u kuptuar mirë nga ne.

Interneti, si një medium mjaft i rëndësishëm përdoret nga një numër i madh njerëzish pothuajse të gjitha moshat, me përjashtim të fëmijëve të vegjël, edhe pse ata shumë shpesh në një mënyrë apo tjetër qasen në internet në momentin që prindi i jep celularin në dorë për ta hutuar dhe në këtë mënyrë fëmija sapo të vetëdijesohet pak, fillon edhe ta shoqëroj prindin apo secilin anëtar të familjes në internet, faktikisht përmes përdorimit të pc elektronike dhe manovrimit nëpër tastierën e tij, pak a shumë fillon të njoftohet me botën e kompjuterit.

Me fjalë të tjera, interneti është rrjet i rrjeteve që përmban miliona linja të vogla rrjetesh rajonale, akademike, të biznesit e qeveritare, të cilat në vete përmbajnë informata dhe shërbime të ndryshme, siç janë posta elektronike, format e kontaktit, transferuesit e skedave dhe dokumentet e tjera nga e gjithë bota. Që të gjitha këto forma të kontakteve që mundësohen nëpërmes internetit, në njëfarë forme kanë efekt mjaft të madh në përditshmërinë tonë sociale, pothuajse në çdo aspekt.

Konkretisht, me vënien e internetit në funksion të gjerë të shfrytëzimit, i cili ka marrë epitetin e “teknologjisë” së lirë”, nuk janë thyer vetëm barrierat dhe kufijtë fizikë të komunikimeve, por edhe vet kufiri ndërmjet virtuale dhe reales. Më nuk mund të bëhen shpjegime të thella të teknologjisë. Pa vënien në funksion të saj, ngecja dhe moszhvillimi i shoqërive dhe vendeve të prapambetura socio-ekonomikisht, vetëm sa do të thellohej edhe më shumë.⁸

Gjuhëtarja Shefkije Islamaj e cila merret me gjuhën dhe problematikën e ndryshimeve të saj, në mesin e disa publikimeve të saja për gjuhën dhe internetin, ndër të tjera shkruan, citoj: Një keqndihmues i madh në degradimin e kulturës gjuhësore janë bërë mjetet elektronike të informimit, radiot dhe televizionet, sidomos disa nga emisionet e të rinjve në të gjitha këto. Duke i parë e duke i dëgjuar pothuajse të gjitha emisionet e të rinjve, krijohet përshtypja se është shpallur garë ndërmjet televizioneve e radiove se cila do të afirmojë më shumë gjuhën e rrugës, çorodinë e skajshme gjuhësore, në të vërtetë kulturën e rrugës.⁹

Shqetësime dhe kritika të tilla mund të gjejmë edhe tek gjuhëtarë të tjerë, të cilat në forma të ndryshme shprehin pakënaqësitë e tyre me keqpërdorimin e gjuhës shqipe në përgjithësi, qoftë nga kullerat, qoftë nga studentet dhe pothuajse nga secila kategori shoqërore që konsiderohet të ketë ngecje në gjuhën standarde shqipe.

“Kullerat” dhe gjuha e tyre komunikuese

Me gjithë përparësitë që na krijon përdorimi i internetit, ndikimi i tij në gjuhë është i madh dhe po shtohet dita ditës. Në këtë kontekst, mund të thuhet se është krijuar një “grup apo nëse mund të quhet komunitet” i veçantë i përdoruesve të internetit, të cilët me ose pa vetëdije kanë krijuar një “lloj zhargoni” të vetin, që funksionon jashtë normës së gjuhës shqipe në të shkruar e shumë shpesh edhe në të folur.

⁶ Ibrahim Berisha, “MEDIA agjensët e komunikimit”, botimi i tretë, a-Print, Prishtinë, 2009, f-10

⁷ Shefkije Islamaj, Aspekti gjuhësor i globalizimit dhe shqipja standarde, Sesioni shkencor në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 2008, Prishtinë.

⁸ Po aty, f-63

⁹ Shefkije Islamaj, Gjuha, Ligjerimi dhe fjala, IAP, Prishtinë, 2004, f-75

Kjo risi gjuhësore e njohur si, gjuha e kullerave”, gjuhë kjo e cila nën ndikimin e gjuhëve të huaja, ka sjellë edhe shumë fjalë të reja dhe të shumë kuptimshme në të folmen e përditshmërisë dhe rrugës, dhe në shkrimet që bëhen nëpër portale dhe rrjete të ndryshme sociale, që e bëjnë internetin edhe më interesant.

Të ndikuar nga përdorimi i internetit, të rinjtë kanë krijuar një “gjuhë të internetit”, e cila na del me veçanti të shumta. Ajo është shumë praktike për të bërë dialog në internet, sepse përdorën vetëm dy ose disa shkronja, shpeshherë të kombinuara me numra, për të shprehur një mendim me përmbajtje të pasur dhe për tu marrë vesh mirë me njëritjetrin.¹⁰

Kjo gjuhë, është e përdorur nga të rinjtë e shumë rajoneve, mirëpo konsiderohet që Prishtina është nismëtare e këtij lloj komunikimi, të pranuar dhe tashmë e bërë gjuhë standarde e “kullerave”, të urbanizuarve apo “underground tipave”.

Por, kush janë Kullerat?.. Fjala kuller është huazuar nga anglishtja “cool”. Fjala “cool” në gjuhën shqipe del me kuptime të ndryshme, si emër freski, vetëpërmbajtje: si folje : ftoh, freskoj, marr me qetësi, si mbiemër: i freskët, i qetë, gjakftohtë, i ftohtë, rrumbullak (fig), i lezetshëm, i hijshëm etj.. Ka shumë elemente me të cilat kullerat dallohen, duke filluar nga pamja e jashtme, qëndrimi i tyre në raport me shoqërinë, qëndrimi indiferent ndaj të tjerëve, karakteri i tyre i menduar si “super modern”, etj.¹¹

P.sh: disa shkrime të marra në rrjetin social tashmë me të njohurin dhe më të përdorurin, në “varësinë e”. Facebook-ut hasim në shumë biseda interesante, mirëpo vetëm disa biseda të shkurtra i përdorin si shprehje kështu :

- * Ej njeri a e ke mjell gjyshen a..
- * Thenkju uuu kejtve per urimet...
- * Koha për movie'z :p...etj
- * ncuk no koment a
- * Mka marr malli me honger pitee o daaaj!! godblessyoumama.
- * pak me vones hahaha urime brotha ishalla edhe shum tjera (K).

Këto dhe shumë shprehje të tjera të këtyre “kullerave”, mund ti hasim në shumë faqe interneti, ku logjika e kullerit përdor më shumë mjeshtri fjalë të ndryshme, duke ua dhënë një kuptim sa të ndryshëm po aq edhe shumë shpesh qesharak, më të veçantë këtë mënyrë komunikimi e bënë edhe kombinimi mes gjuhës angleze dhe shprehjeve në gjuhën shqipe.

Sot, kur e jetojmë të ashtuquajturën epokë të mjeteve dhe rrjeteve sociale, si: Facebook, Twitter, Mesenger etj, është formuar një prirje interesante e shkrimit me më shumë shkurtesa të ndryshme, të përziera me numra e simbole për shprehjen e emocionit, të cilin mendoj që e sollën “kullerat”.

Shembujt janë të shumtë, p.sh: *flm* (faleminderit), *sps* (s'ka përse), *çka ka 3* (çfarë ka të re), *1herë* (njëherë), *vër8* (vërtetë), *3gim* (tregim), *2shim* (dyshim), *7zënë* (shtatzënë) e shumë e shumë shembuj të tjerë.

¹⁰ Anila Çepani, Seminari Nderkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2006. f-83

¹¹ Naim Berisha, Shqipja e internetit dhe “fjalori i kullerave”, Gjuha Shqipe, 1/2010, IAP, Prishtinë, f-84.

Edhe pse përdorime të tilla e lehtësojnë komunikimin dhe mundësojnë përgjigje të shpejtë, kombinimet e tilla edhe me numra janë të paparanueshme për natyrën e gjuhës tonë. Prandaj, përpjekja për një kulturë të zhvilluar gjuhësore që parakupton në rend të parë respektin dhe kujdesin për gjuhën, si trashëgiminë tonë intelektuale të përbashkët, është kusht qenësor për të ardhmen tonë gjuhësore dhe për të ardhmen tonë kulturore në përgjithësi.

Recensentë.
Ma. Naim Berisha
Ma.Shpresa Ismaili.

DALLIMET EVENTUALE DHE NGJASHMËRITË FUNKSIONALE MIDIS MË SE TË KRYERËS DHE TË KRYERËS SË TEJSHKUAR

Agnesa Hasimja

Fakulteti i Filologjisë– Dega e Gjuhës Shqipe

Universiteti i Prishtinës

Abstrakt

Gramatikat tradicionale kohën më se të kryer dhe kohën e kryer të tejkshuar i konsiderojnë si dy kohë sinonimike. Kjo për shkak që studimi i këtyre gramatikave mjaftohet vetëm me studimin brendapërbrenda fjalisë, pa kaluar caqet e saj. Ndërsa, qëllimi kryesor i këtij punimi është të paraqesim dallimet eventuale dhe ngjashmëritë funksionale midis kohës më se të kryer dhe kohës së kryer të tejkshuar në rrafshin tekstor. Do të bëjmë edhe një përshkrim të shkurtër të këtyre dy kohëve nga studiuës të ndryshëm.

Ndër studiuësit e parë të huaj, i cili propozoi që për përshkrimin e kohëve për bazë të merrej teksti, është gjermani Harald Weinrich. Ndërsa, i pari që vuri re dallimin midis kohës më se të kryer dhe të kryer të tejkshuar në gjuhën shqipe, bazuar në qëndrimin folës, është dijetari Victor Fridman.

Dallimi midis më se të kryerës dhe të kryerës së tejkshuar ekziston, dhe kjo përforcohet ndër të tjera kur merret parasysh qëndrimi folës. Nisur nga kjo, kohët e foljes ndahen në dy grupe: komentative dhe rrëfimore. Ndarja mbështetet në raportin e dërguesit, objektin që rrëfen, dhe marrësin e mesazhit.

Studimi i kohëve në rrafshin tekstor

Është e kuptueshme, se duke qenë Rexhep Ismajli një ndër gjuhëtarët e parë shqiptarë që shtruan çështjen e kërkimeve shkencore përtej periudhës, gramatikat e shqipes përpara publikimeve të veprave të tij nuk i kalonin kufijtë e saj. Por, kjo dukuri vazhdoi rrugën e saj tradicionale edhe pas vërejtjeve që bëri studiuësi i lartpërmendur, duke i mbetur besnike fjalisë si njësi më e madhe. Edhe sot ende nuk ekziston një gramatikë e tërë e morfologjisë së shqipes, e cila merr parasysh studimin e tekstit. Rexhep Ismajli në disa nga veprat e tij, si: "Shumësia e tekstit" (1977), "Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit" (1984) etj., pos tjerash trajton edhe kohët e foljeve në rrafshin tekstor, duke përfshirë

qëndrimin dhe pikëvështrimin e folësit. Nëpërmjet hulumtimeve të tij, ai mëton t'i sjellë rezultatet e përdorimeve të foljeve nëpër lloje të ndryshme të teksteve, duke bërë edhe klasifikimin e tyre në kohë rrëfyese dhe përfolëse. Këta janë termat që i propozon vetë Ismajli në vend të emërtimeve të tjera: "narrative" dhe "komentative", si terma të Benvenistit të shfrytëzuar nga Weinrich-u.

Gjuhëtari gjerman Weinrich është ndër studiuesit e parë që bëri analizën e formave kohore në tekst. Ai trajton qëndrimin folës dhe këndvështrimin. Ndarja e parë bën dallimin ndërmjet botës së "diskutuar" dhe të "rrëfyer", ndërsa ndarja e dytë bën ndarjen e planit të parë dhe të dytë. Ndarja e parë më tutje sqaron marrëdhëniet ndërmjet dërguesit (rrëfyesit) dhe subjektit të dërguar prej tij (rrëfimit). Kjo marrëdhënie mund të jetë më intime, më e drejtpërdrejtë dhe mund të jetë më e veçuar: më e përfolur. Në rastin e parë, dërguesi (e me të edhe marrësi) është i ndërlidhur drejtpërdrejt në ngjarjet e rrëfimit (kohë rrëfyese). Në rastin e dytë, dërguesi zgjedh të përfolurit e asaj që ka ndodhur, pra vë një distancë më të madhe mes vetes dhe rrëfimit (kohë të komentit ose të përfoljes) (Rugova, 2009:190). Përkundër kohëve të rrëfimit, kohët e komentit i sjellin dëgjuesit ose lexuesit një qëndrim të tendosur të pranimit dhe kundërvënien në mes të këtyre dy grupeve, të grupit të kohëve të botës së komentit dhe të rrëfimit, shënohen me konceptin e lartpërmendur "qëndrim folës". Paraqiten edhe dy veçori të tjera të sistemit kohor: perspektiva folëse dhe reliefizimi. Sipas perspektivës folëse kohët e të dy grupeve (komentit dhe rrëfimit) paraqesin raportin në mes të kohës së tekstit (trungu i një tekstit të folur ose të shkruar në rrjedhën e tij) dhe kohës së aktit. Parainformatat dhe pasinformatat shpijnë tek përcaktimi i kohës së tekstit. Që të dyja këto informata të mëparshme dhe të mëvonshme shprehin raportin në mes të kohës së tekstit dhe kohës së aktit. Sipas reliefizimit të tekstit, dallohen kohët të cilat japin planin e parë dhe kohët të cilat e japin prapavijën (sfondin) (Rexhepi, 2012:20).

Dallimet eventuale dhe ngjashmëritë funksionale midis kohëve relative

Koha më se e kryer dhe koha e kryer e tejkohuar kanë që të dyja forma analitike. Koha më se e kryer është e ndërtuar nga folja ndihmëse *kam* në kohën e pakryer (kisha) + pjesorja e foljes kryesore: *kisha pasur*. Koha e kryer e tejkohuar po ashtu është e ndërtuar nga folja ndihmëse *kam*, por në të kryerën e thjeshtë (pata) + pjesorja e foljes: *pata pasur*. Që të dyja këto kohë janë kohë relative. Ato janë forma që paraqesin kohën e kryerjes së veprimit foljor duke pasur si pikë referimi një çast të së shkuarës. Gramatika e shqipës (2002) këto dy kohë i konsideron të jenë sinonimike.

Koha më se e kryer dhe koha e kryer e tejkohuar janë kohë të prapavijës. Duke u bazuar në kriterin e parë, kohët e foljeve të një gjuhe ndahen në kohë komentative dhe në kohë narrative. Sipas kësaj ndarjeje koha më se e kryer bën pjesë në grupin e parë, ndërsa koha e kryer e tejkohuar në grupin e dytë. D.m.th. ndryshe nga koha më se e kryer, që është kohë komentative, koha e kryer e tejkohuar është kohë e rrëfimit. Dallimi thelbësor qëndron te qëndrimi folës. Koha e kryer e tejkohuar përdoret për të treguar një ngjarje, të cilën dërguesi vendos ta rrëfejë si pjesë të drejtpërdrejtë të saj, ndërsa koha më se e kryer përdoret për të treguar një ngjarje, me të cilën dërguesi zgjedh të lërë distancë dhe në vend të rrëfimit të drejtpërdrejtë zgjedh të përfolurit. Përfolja ose komenti, pra, janë fjalët e rrëfyesit që tejkalojnë rivendosjen e veprimit dhe të kontekstit të tij (Rugova, 2010:130).

Dallimi i parë tekstor u përcaktuar nga Friedman i cili thotë se dallimi “sipas disa folësve” është se në kohën e parë, kohën e kryer të tejshkuar, folësi është dëshmitar i veprimit, ndërsa në kohën e dytë, më se të kryerën, ai nuk është.

Shembull: S. M. (1953) nga fshati Burim (ish Joviq) i Malishevës ka vdekur të mërkurën në objektin KK të Malishevës ku, sipas njoftimeve, kishte shkuar së bashku me njërin nga fëmijët e tij të kërkonte ndihma ushqimore. Vdekja sipas burimeve të informimit kishte ardhur si pasojë e një sulmi momental në zemër, pasi i ndjeri kishte vuajtur nga sëmundja e zembrës edhe më herët.

(Koha Ditore, Vdes derisa kishte shkuar të kërkonte ndihma në komunë, 28 dhjetor 2012, fq.6)

Këta shembuj tregojnë për një ngjarje që folësi i saj nuk ka qenë në vendin e ngjarjes. Kështu ai përdor kohët përfolëse, si: *kishte shkuar, kishte ardhur, kishte vuajtur*. Madje, gazetari bën të ditur edhe vetë duke u shprehur se rreth lajmit ishte njoftuar nga të tjerët: “...sipas njoftimeve kishte shkuar...”, ose “Vdekja, sipas burimeve të informimit kishte ardhur si pasojë... pasi i ndjeri kishte vuajtur...”.

Kjo vazhdon të dëshmohet edhe në shembuj të tjerë kur citohen të tjerët.

Shembulli:

“Kam dalë dhe e kam parë të shtrirë një person dhe menjëherë kam filluar t’i jepja ndihmën e parë”, ka njoftuar B., sipas të cilit, në ndihmë i kishte shkuar edhe shoferi i komunës, B. K..

Burim i informacionit në shembullin e mësipërm ka qenë B., dhe kjo kuptohet edhe kur lexojmë fjalinë. Aty kemi “...*ka njoftuar B., sipas të cilit, në ndihmë i kishte shkuar...*”.

Fiedler-i dhe Bucholz-i (Rugova, 2010) theksojnë se koha e kryer e tejshkuar për sa i përket kohëshmërisë është vetëm një kohë e *parakohshme* (a), ndërsa më se e kryera mund të ndodhë në funksionin *paskohor* (b) gjithashtu.

Shembulli:

Si pat vënë gjithçka në rregull, u nis për në punë.

Stavri pushoi një copë herë, sikur donte të sillte në hatër, ç’i kishte ndodhur më tej. (Buchholz-Fiedler, 1987:132).

Dallim tjetër midis dy kohëve relative të së shkuarës qëndron edhe në kategorinë gramatikore të foljes, aspektit. Me *aspekt* shënohet mënyra e paraqitjes së zhvillimit të veprimit të emërtuar nga folja me kundërvënien veprim i kryer : veprim i pakryer, të shprehur me format gramatikore përkatëse në të gjithë paradigmen e zgjedhimit foljor (Rexhepi, 2012:94). Domethënë, kohët e foljeve në gjuhën shqipe mund t’i kundërvihen njëra-tjetrës edhe nga rrafshi aspektor, edhe pse shqipja nuk ka mjete të caktuara morfologjike për to, siç ka për shembull për kategorinë gramatikore të kohës. Edhe kohët relative ndër vete i kundërvihen njëra-tjetrës nga këto aspekte. Derisa koha më se e kryer karakterizohet nga aspekti i papërfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës, koha e kryer e tejshkuar karakterizohet nga aspekti i përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës.

Literatura:

De Beaugrande R., Dressler W. (1981). *Introduction to text linguistics*. London-New York: Longman.

Dykro O., Todorov C. (1984). *Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërimit*. Prishtinë: Rilindja.

Friedman V. (2004). The Pluperfect in Albanian and Macedonian. In *Studies on Albanian and other Balkan Languages*. Pejë: Dukagjini, 225-237.

Gramatika e gjuhës shqipe I (1995). Tiranë: ASHRSH.

- Halliday, M.A.K. (2002). *Text and Discourse*. London: Continuum.
- Hamp E. (2007). Shqipja. In *Studime krahasuese për shqipen*. Prishtinë: ASHAK, 23-78.
- Ismajli R. (1974). *Shenjë e ide*. Prishtinë: Rilindja.
- Ismajli R. (1980). *Shumësia e tekstit*. Prishtinë: Rilindja.
- Kelmendi T. (1993). Funksionet e kohës foljore të pakryer të dëftores në shqipen e sotme letrare. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.
- Rexhepi, Sadije. (2012). Analizë tekstore e përfaqësive të kohëve të shkuara në gjuhët gjermane dhe shqipe (Punim disertacioni). Prishtinë.
- Rugova B. (2009). *Gjuha e gazetave*. Prishtinë: Koha.
- Rugova B., Rugova L. (2011). "Impluperfect and aor-pluperfect in Albanian" në *Scritti in Onore di Erip P. Hamp per il 90. compleanno. Rende*: Universita Della Calabria
- Rugova B. (2010). *Kohët e foljeve në gjuhën e gazetave në Kosovë*. Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare 29/1. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.
- Rugova B. (2012). Past tenses of Indicative in Albanian in Different Text Categories, në *Poznac Balkany*, Torun: Zakład Języków Słowiańskich i Bałkanistyki UMK
- Rugova L., Rugova B. (2010). Selman Riza për kohët e foljeve në *Studime filologjike*
- Werlich E. (1983). *A Text Grammar of English*. Stuttgart: Quelle&Meyer.
- Weinrich H. (2001). *Tempus - Besprochene und erzählte*. München: Welt.
- Van Dijk Teun. (1995). *From Text Grammar to Critical Discourse Analysis*. University of Amsterdam. Program of Discourse.

RRETH PËRDORIMIT TË FORMAVE TË PASHTJELLUARA NË SHKRIMET E HERSHME TË ARSHI PIPËS

Ma. Aimir Osmani

Nga jeta...

Arshi Pipa ka hyrë në historinë e kulturës sonë si poet, përkthyes, estet dhe studiues. Lindi në Shkodër, më 28 korrik 1920 dhe vdiq në SHBA, më 20 korrik 1997, duke lënë si amanet që hirin e të ndjerit ta hidhnin në detin Adriatik, amanet që e kreu shoqata "Durrësi", në nëntorin e atij viti në plazhin e atij qyteti.

Shkollën fillore dhe të mesme e ndoqi në Shkodër, kurse të lartën në Itali, në Fakultetin e Letërsisë dhe të Filozofisë. Pasi kthehet në Shqipëri, në vitet e Luftës do të shërbejë si arsimtar në Shkodër, Tiranë dhe Durrës.

Arshi Pipa nuk e pranoi regjimin e ri monist, duke dalë hapur si kundërshtar i tij. Për idetë e tij politike, ai u burgos në vitin 1946, ku u dënua me 10 vjet burg. Pasi kreu dënimin e plotë, më 26 prill 1956 lirohet nga burgju. Duke qenë kundërshtar i hapur i shtetit komunist, kërkon një jetë më të lirë dhe arratiset bashkë me të motrën në Jugosllavi. Dy vjet më vonë largohet nga Jugosllavia dhe shkon në Itali e më pas emigron në SHBA. Aktivizohet në mërgatën shqiptare, duke botuar disa shkrime në shtypin shqiptar të asaj kohe, si në "Dielli" dhe "Flamuri". Fillimisht si emigrant i ri punoi si kasier në një hotel-restorant të Nju-Jorkut. U deshën tri vjet që Arshiu të përfshihej në radhën e pedagogëve të atij shteti të madh, duke u emëruar në një kolegji amerikan, për të kaluar më vonë në disa universitete amerikane dhe së fundi në Universitetin Minnesotës në Minneapolis. Këtu doli në pension me titullin "Profesor emeritus".

Zgjidhet kryetar i Federatës "Vatra" gjatë viteve 1991-1992 dhe drejtor i gazetës "Dielli" në SHBA.

Vizitën e parë në Shqipëri e bëri në vitin 1992, pas përmbysjes së regjimit monist, ku qëndroi në Shkodër pranë shokëve dhe kolegëve të tij. Gjatë kësaj kohe bëri takime me intelektualë, zhvilloi biseda, organizoi konferenca, si në Shkodër, Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Lezhë. Vjen edhe dy herë të tjera në Shqipëri. Vdiq në moshën 77-vjeçare. Është përfshirë në FESH, vëll.III, Tiranë, 2009.

Veprimtaria letrare dhe studimore e Arshi Pipës.

Ai ka botuar disa vepra, përkthime dhe studime në italisht dhe anglisht. Në shqip trashëgojmë këto krijime:

1. *Lundërtarë*, Tiranë, 1944, ribotim, Tiranë, 2000;
2. *Libri i burgut*, Romë, 1959, italisht, Tiranë, 2010, shqip;
3. *Rusha*, Mynih, 1968, Tiranë, 1995, shqip.

Përmbledhja e veprës letrare në shqip nga shtëpia botuese "Plejad" u realizua në katër vëllime: Vëllimi I : *Lundërtarë*, Tiranë, 1944, ribotim, Tiranë, 2000.

Vëllimi II: *Autobiographia*, 1998, Tiranë, 2010, 101 f. anglisht, Ka edhe në shqip poezinë "Veneriada".

Vëllimi III: *Lyrrika latine* (përkthyer në shqip dhe paraqitur nga Arshi Pipa). Është shkruar në Sarajevë në vitin 1958, Tiranë, 2010.

Vëllimi IV : *Lyrrika evropiane moderne* (përkthyer në shqip nga autori), Tiranë, 2010. 148 f. (Tekstet e poezive në origjinal dhe në shqip).

Para dhe pas vdekjes u botuan disa studime nga Arshi Pipa , kryesisht në gjuhë të huaj , disa prej tyre edhe u përkthe në gjuhën shqipe.

* * *

E gjithë veprimtaria letrare dhe publicistike e Arshi Pipës është shkruar, kryesisht, në gegërisht, por na është dukur më e arsyeshme që këtë veprimtari ta shohim në dy etapa kryesore: Shkrimet e hershme të Pipës para arrestimit dhe ato të daljes nga burgu e më pas për të parë se sa ka evoluar gegërishtja e Arshi Pipës. Mendimi ynë se Arshi Pipa nuk ka pasur së qëllim të shkruajë një gegërishte letrare me prirje afruese, por ai ka dashur të përdorë një gegërishte letrare, ndonëse në disa raste nuk ia ka mohuar vlerat edhe toskërishtes në atë pikësynim që ka pasur.

Në këtë kumtesë do të ndalemi te përdorimi i formave të pashtjelluara të përdorura nga Arshi Pipa në periudhën e parë, kryesisht te "Lundërtarë" (1944), "Libri i dashunËs dhe i fatit" (dorëshkrim dhe botuar në Tiranë në vitin 2010) dhe në artikujt e botuar në revistat e kohës 1944-1945. (*Kritika*, 1944, *Fryma*, 1944, *Bota e Re*, 1945)

* * *

Arshi Pipa në shkrimet e tij ka një larmi formash foljore që lidhen me dialektin që ai përdor, konkretisht të gegërishtes, por konstatohen edhe disa prirje që kanë të bëjnë me zhvillimet e gjuhës shqipe në fund të gjysmës së parë të shekullit XX. Siç e kemi theksuar edhe më sipër, Pipa nuk ka ndonjë arsenal të pasur të shkruar në prozë në gjuhën shqipe, por vetëm pak artikuj studimorë ku ne jemi mbështetur.

* * *

Rreth formave të pashtjelluara të përdorura në krijimtarinë hershme të tij:

Pjesorja, përcjellorja, paskajorja, forma mohore etj.

Pjesorja

Pipa edhe përsa i përket formave të pashtjelluara i qendron besnik dialektit që përfaqëson, por duhet theksuar se jo ligjërimin të folur, por atij të shkruar, ku patjetër ka pasur ndikimin e vet Komisia Letrare Shqipe në Shkodër (1916-1918), me ato vendime që mori. Kështu kjo Komisi, në mes të tjerash, rekomandonte të shkruhen të plota grupet e zanoreve *ie, ue, ye*, ashtu siç janë "në dialektin tosknisht e në disa dialekte gegnishte." (*Laimet e Komisis Letrare Shqipe në Shkodër*, 1918, nr. 1. f. 12, paragraf 5), prandaj edhe Pipa këto pjesore që sot përfshihen në zgjedhimin e parë, togjet e zanoreve do të shkruante të plota, si: *shikue, tregue, dallue, gjykue, prodhue, afrue, kthye* etj. Por foljet e këtij zgjedhimi, por që i përkasin një klase tjetër që të kryeren e thjeshtë dalin me temë të zgjeruar, pjesoren e përdorin të shkurtuar: *ba, hy* etj. Kështu e bëjnë pjesoren edhe foljet: përfshi, , shfry, bre, ndi, dhe foljet e pa rregullta: *pa, vu*.

Foljet që dalin me temë në bashkëtingëllore, Pipa ashtu si në të folmet gege përdor pjesoren e shkurtuar me ë, si: *çuditë, përmbushë, shkarravitë, mbledhë, heshtë, njoftë, kqyrë, veshë*, pritë zhgulë, sjellë, mbyllë, mbështjellë (por edhe mbështjellun) etj.

Disa nga foljet që janë përfshirë në foljet e parregullta supletive apo ato josupletive, përdoren me prapashitesën trajtëformuese – në: *dhanë, thanë, qenë, lanë* etj..

Si raste të izoluara ndeshim pjesoret me –un: *prekun, mbajtun, virrun, ngrejtun, nisun*. Por në poezi, që është një dukuri pothuajse e zakonshme e Pipës, ndeshim trajtën me –un, kur në prozë i përdor me –ë: *bujtun, ardhun, shndritun, ngjitur, rritun, flladitun, vozitun, ramun, dalun, ngjallun* etj.

Paskajorja

Lidhur me format e pashjtelluara, te krijimtaria e Arshi Pipës ndeshim disa trajta të përdorimit të paskajores. Trajektorja për përdorimin më të dendur i përket paskajores së tipit me punue, por ndeshim edhe trajtat për me punue, për të punue, me një status më të kufizuar.

Paskajorja e tipit *me punue*, që kryen shumë funksione sintaktike, është formë shumë e vjetër, që sipas Shaban Demirajt, gegërishtja e ka përdorur shumë kohë para Gjon Buzukut e në gegërishte kjo paskajore kryen edhe shumë funksione të lidhore. Ajo është një dukuri e gjallë dhe vepruese në ligjërimin e folur, por që transmetohet edhe në të shkruar në shkrimet në gegërisht dhe pasqyrohet qartë edhe te Pipa p.sh.

Me folë e mos me përfundue, me u-sjellë rrotull tue pretendue me hy në mes, me trokitë, pa hy mbrendë, te dyert e misterit. (F.7-8, 299.)

...ku kishte shkue me ndrrue klimë. (K.3,112.)

...Ndryshej nuk do të kishte mujtë me vijue studimet (K.3.117)

Por te vepra e Pipës vihet re se ai evoluon edhe përsa i përket këtyre trajtave.

Trajtën mohore e ndërton me pjesëzën mohuese *mos*, duke e vendosur përpara paskajores:

Mos me u-betua ma për Krisht e Muhamet, por për Shqipnî. (K.4,123.)

Me përdorime të rralla ndeshim edhe një trajtë të mbipërbërë të kësaj paskajoreje:

Me pasë orientue problemin ...kah një studim i ri... (F.7-8, 305.)

Me pasë mësue mjetin e mënyrat e shprehjes (K.2, 46.)

...njef fatin e vet para se me pasë jetue deri në fund. (K.3,113)

Pipa, në një fjali të shkurtër apo në një periudhë përdor radhazi disa paskajore me funksione të ndryshme sintaktike, si:

Me folë pa gjykue, me çmue! (K.1,5.)

Ai kufizohet me vëzhgue, me matë, me bâprova.(K.1, 3)

Dhe nuk asht pra për t'u-çuditë se si Bergsoni arrini në fund me e quejtë krijimin e botës qëllim, por që të manifestohet dashunija hyjnore..7-8, 304.)

...me dashtë për andjen, me bâ tjerët me dashtë, me krijue për andjen, me pa tjerët tue krijue .(F.7-8,304)

Ndër funksionet më të rëndomta të kësaj paskajoreje është përdorimi në fjalitë kryefjalore, kundrinore, qëllimore, kohore etj. kryesisht për fjalinë kryefjalore, shoqëruar me foljet *jam, duhet, asht e nevoja, asht dashtë* etj., me folje jokalimtare, joveprore, si *shkoj, kthehet, kufizohet* etj. P.sh.:

...detyra e kritikut asht me dallue të mirat e të këqijat e veprës...(K.1,1.)

Tash duhet me pasë sidomos shije. (K.1,2).

Asht e domosdoshme me dijtë ma parë me u-orientue.(K.1, 4)

... i ishte dashtë me kalue në seminar (K.3, 117)

E atëherë asht nevoja me i dliirë (K.1,2.)

Fillon me njoftë ku gjindet (K.3,115.)

...por asht e tmerrshme me vrejhtë se si mundimet e tija...dështojnë...(K.3,119.)

Aj i kërcnohet me i rá grusht në zemër.(K.3,115)

Kan dijtë me përfitue nga rahatia e jetës...(K.2,45)

Paskajorja me punue ka përparësi ndaj trajtave të tjera. Pipa nuk e anashkalon përdorimin e mënyrës lidhore në vend të kësaj paskajoreje, të shoqëruar me foljen modale mund (në kohën e tashme, por edhe në kohët e tjera) që është ndër përdorimet më të shpeshta:

Ajo mund të prodhojë vepra madhështore. (K.1,1)

...ashtu si vetëm ai dinte të shante.(K.2,41.)

Do të mund t'ecim këshu me siguri.(K.1, 4)

me foljen duhet:

Por *dubet të shënojmë* se kritika letrare nuk asht si çdo kritikë tjetër. (K.1,2.)

Njeriu dubet të zhduket për t'ardhë mbinjeriu. (K.3,116.)

Lidhoret mund t'i paraprijnë edhe folje kalimtare dhe jokalimtare :

...ashtu si vetëm ai dinte të *shante*. (K.2,41)

Kam ardhur të shoh miqt e vjetër e të *përpiqem të fitonj* miq të rinj. (K.4,125.)

Në Pukë aj *kishte dashtë të shkonte* për arsye të shëndetit të tij të dobhtë. (K.3,112.)

Ftisija e përgjumun për do kohë kish nisë t'i çfaqej atëherë... (K.3,112.)

Theksojmë se Pipa lidhoren e shoqëron në shumicën e rasteve edhe me foljen modale due:

Atje ásht një lypës i vogël qi nuk don të vdesë urije. (B.R.,36)

...*iluzion i fundëm me të cilin don të mbahet jeta.*(B.R.42.)

Dhe në veprën e Pipës këto përdorime nuk janë të rralla, përkundrazi. Autori ynë nuk është konsekuent në përdorimin e një trajte të caktuar. Kështu foljen dua e shoqëron edhe me paskajore:

me jetue don me thanë me u ndeshkue pá bā faj.(L. F.136).

Nuk due me pá nder sytë e botës. (L.F.117),

Na nuk duem me thanë ase filozofija e Bergsonit asht vetëm një maskë poezije. (F.7-8, 304).

...*don me fjetë një gjúm nëndhes.* (L.F.140).

Pjesëzën mos për lidhoren e përdor para foljes:

Me gjithkë asht vështirë me kuptua...*që të mos drejtobet kah kurnji send.* (F.7-8,302)

Forma tjetër e paskajores është tipi *për me punue* që është një kontinim i dy formave të pashtjelluara, por e përdorur jo shpesh në gegërishten veriore, ndonëse në krijimtarinë e Pipës një formë e tillë nuk është e rrallë. E ndeshim te krijimtaria e autorit tonë në disa përdorime:

Migjeni vinte në Torino *për me u regjistruue* në Fakultetin e LetërsIs (K.3,112)

Për me gjykue veprat e dështueme nuk asht fort nevoja *për me pasë* cilsitë veçanta. (K.1,2).

...aj kishte tashti kohë e mundësi *për me punue* me ngë në fushën e letravet. (K.2,44).

Pipa, ka raste që brenda një periudhe i përdor të dy trajtat e paskajores, duke i dhënë përparësi herë njerës e herë tjetrës:

Kishte fitue një burse dikur, dhe *për me e ruejtë*, i ishte dashtë *me kalue* në seminar, ndryshe nuk do të kishte mujtë *me vijue* studimet. (K.2,117).

Në rasën e parë duhej *me pasë* sidomos fund, themel, *për me u-mbështetë* me siguri: hapësinë, horizont *për me përfshi* gjithë veprën; masë *për me kqyrë* drejtë e saktë. (K.1,2).

Pjesëzën e mohimit mos e vë para paskajores me me :

Bota sjell kryet *mënjatë për mos me i pá* kto qenje të mjera të neverituna. (K.3,114).

...u vendos n'Amerikë *për mos me luejtë* ma... (K.2, 44)

Paskajortja e tipit *për të punue* që në shqipen është e vonë dhe në shumë raste është sinonimike me mënyrën lidhore në disa funksione të kësaj të fundit, nuk ndonjë ka përdorim të gjerë nga autori. Atë e ndeshim në disa funksione sintaksore, si :

Krahasoni Nolin që bahet prift për t'u shërbye bashkatdhetarvet të vet (K.2,42).

Ishte një burrë i pashëm, me një shëndet për t'i pasë zili.(K.2,42).

Dhe çka asht për t'u shënue , kjo vepër ásht ende e pambledhun e tana.(B.R.5, 51).

Por A. Pipa brenda një periudhe përdor disa here këtë trajtë, si:

Me të pasion që shkroi për të ngrejtun e për të ngushllue skamnorët e të mjerët, me atë pasion ai mësoi n shkollën e katundit për të ndritun errsinën e mendjes së trashigume prej shekujsh robnije. (B.R.3, 34).

E përdor këtë paskajore krahas asaj me formantin me:

Si me kritikue, kur mungon materiali për t'u- kritikue? (K.1,3)

Një veçori tjetër dalluese është përdorimi i shpeshtë i së ardhmes, me konstruktin kam+paskajore duke u ndikuar edhe nga ligjërimi i folur i gegërishtes, që është përdorim mjaft i shpeshtë i tij, si:

Keni me gjetë te kjo e dyta këtë paragraf. (B.R. 3, 34).

Nuk ka me heshtë pra. (K.3,115).

Vallen , gazmendin kush ka me na i ndezë? (L.14).

Ndeshim edhe konstruktin e dytë kam + formën me për të, si:

Amerika, ajo nënë bujare qi i ka dhënë botës Wilson-in ka për të lindur edhe të tjerë kalorës si ay...(K.4,126).

është më tepër se për t'uruar: është për t'u habitur guximi i njeriut...(K.4,127).

Thojshë se mallin qi ka me t'përvlue (L.15).

Autori duket e ka ndërë, si dhe i ndikuar ndoshta edhe nga shkrimtarët bashkëkohës që të përdorë, sado rrallë edhe të ardhmen do+lidhore, formë gjithnjë e më shumë po bëhej mbizotëruese për të dy dialektet dhe në ndonjë rast duke hequr formantin të-:

E tue i matë, tue i peshue kështu, veç do t'i gandojë, do t'i prishi: do t'i profanojë. (K.1, 3).

Pipa në disa raste kryesisht në fjali të thjeshta, por edhe në të përdor në vijin këtë të ardhme:

Do të mund t' ecim kështu me sigurí. (K.1, 4).

Do t'a vijojmë traditën e do t'a rikrijomë simbas rasës. (K.1, 4).

Do të marrim andej parimet, kriteret me të cilat do të gjykojmë prodhimin e kohës(K.1, 4).

Forma mohore

Autori përdor edhe formën e pashtjelluar mohore me formantin pa, e cila ka një përdorim të kufizuar, si:

Vargjet e lira mbetën kështu pa u botue (K.3,112).

...t'a luftojë të tinë, pa vënë ndër ballë një vulë të madhe prej "tradhtari." (K.4,124).

Te shkrimet e Pipës ndeshim edhe një trajtë të mbipërbërë:

...nuk shkatrron pa pasë ndërtue ma parë.(K.1,5).

Përcjellorja

Vihet re ndikimi i dialektit që përfaqëson duke e përdorur përcjelloren me formantin tue,;

...qi grumbullohet mbi trajtat e saja, tue ja veshë, tue ja mashtrue.(K.4,121).

Edhe tek kjo formë në stilin e autorit vihet re rreshtimi e së njëjtës formë të pashtjelluar:

...për me edukue popullin, tue ndezë ndjenjën kombtare, tue afrue zemrat me fjalën e butë të fës, tue zgjue dashunin humanitare.(K.4,121).

Edhe te përcjellorja ndeshim një trajtë të mbipërbërë:

Fén (ortodokse) aj e njihite mirë, tue pasë krye seminarin e Manastirit. (K.3,117).

Nga materiali i mësipërm vëmë re se Pipa shkruan në gegërishte, por larg skemave të ngushta dialektore, në raste të veçanta ndeshim edhe trajta të mbidialektore, ndoshta mund të ketë ndikuar edhe prejardhja familjare, pasi i ati ishte nga jugu .

Bibliografi:

- 1.U.Kalakulla, *Arsbi Pipa, njeriu dhe vepra*, Tiranë, 1999.
- 2.Sh.Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986.
- 3.J.Gjinari-Gj.Shkurtaj, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997.
4. M.Çeliku, *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2000.
- 5.M.Gero, *Lidhja dhe paskajorja në prozën letrare të Martin Camajt*, në botimin "Martin Camaj , tradita dhe bashkëkohësia", Shkodër, 1994.
6. M.Priku, *Rreth disa ndërtimeve dhe kuptimeve foljore në veprën e M.Camajt*, në botimin "Martin Camaj për kulturën shqiptare "Shkrimtari dhe albanologu", Studime shqiptare 17, Shkodër, 2011.

Vepra dhe artikuj të shfrytëzuar të A.Pipës:

1. A. Pipa, *Lundërtarë*, Tiranë, 1944 (Më pas : L.).
2. A. Pipa, *Lundërtarë dhe Libri i dashunËs dhe i Fatit*, Tiranë, 2010 (Më pas : L.F.).
3. Revista "Kritika", Tiranë, 1944, nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr.4.(Më pas: K.1. K.2, K.3, K.4.).
4. Revista "Fryma", Tiranë, 1944, nr.2, nr.7-8 (Më pas: F.2, F.7-8).
5. Revista "Bota e RE", Tiranë, 1945, nr.3

PËRDORIMI I FJALËVE TË HUAJA NË LIGJËRIMIN E SOTËM TË FOLUR E TË SHKRUAR

Alma Tirana

“Gjuha jonë duhet shkruar thjesht shqip, se fjalët e huaja e shëmtojnë shumë. Është e gjerë gjuha jonë dhe e bukur shumë; ka fjalë fort të mira për të vënë në vend të fjalëve të huaja.”

Naim Frashëri

Leksiku është nënsistemi i gjuhës që pasqyron më shpejt dhe më drejtpërdrejt ndryshimet në jetën e bashkësisë që e flet. Me daljen nga përdorimi të sendeve, objekteve, koncepteve e të institucioneve shoqërore e shtetërore të një epoke të caktuar, dalin nga përdorimi e harrohen pak nga pak edhe fjalët përkatëse; nga ana tjetër, me futjen në përdorim të sendeve e objekteve të reja, me konceptet dhe institucionet e reja, lindin edhe fjalët që i emërtojnë ato. Edhe në gjuhën shqipe, e cila që nga Rilindja Kombëtare e këndej ka njohur procese të vrullshme zhvillimi, shumë fjalë janë zhdukur bashkë me sendet a me konceptet e kohës, shumë fjalë të tjera shqipe janë zëvendësuar nga fjalë të huazuara prej gjuhësh të tjera ose nga fjalë të reja të krijuara me mjete të tjera. Po ta shqyrtojmë zhvillimin e leksikut në lidhje të ngushtë me historinë e popullit, zhvillimin shoqëror, ekonomik e kulturor, “do të vëmë re se si në periudhat më aktive të historisë së popullit tonë janë bërë ndryshime të mëdha edhe në leksikun e shqipes, siç janë: huazimi leksikor nga gjuhë të tjera gjatë pushtimeve, pastrimi e pasurimi i leksikut të gjuhës sonë me formime nga brumi i saj, sidomos gjatë periudhave të lëvizjeve të mëdha kombëtare...”¹².

Bashkësia gjuhësore nuk është indiferente ndaj këtyre lëvizjeve në leksikun e gjuhës së vet, sepse fjalët gjallojnë në trurin dhe në gojën e folësve. Janë pikërisht këta që i “fshijnë” disa njësi leksikore nga leksiku mendor i tyre dhe që regjistrojnë pandërprerë në trurin e tyre njësi të reja leksikore dhe i përdorin ato në ligjërim. Po jo vetëm kaq. Lëvruarit e gjuhës që kanë një kulturë gjuhësore mbi mesataren ose që kanë një formim linguistik – shkrimtarët, përkthyesit, gjuhëtarët – nuk janë indiferentë ndaj fjalëve të reja që hyjnë në leksikun e gjuhës, sidomos kur këto janë huazime, duke u përpjekur të gjejnë për to fjalë gjegjëse të shqipes ose të krijojnë me brumin e shqipes fjalë të reja. Këto përpjekje përbëjnë thelbin e kujdesit për gjuhën. Kështu, përkujdesjet dhe përpjekjet për ta mbajtur të pastër gjuhën shqipe kanë nisur që herët, duke filluar me autorët e vjetër e duke vijuar me shkrimtarët arbëreshë të fillimit të shekullit XIX për të arritur në epokën e Rilindjes Kombëtare.

¹² J. Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2002.

Këtë kujdes të autorëve tanë të vjetër e gjejmë të shprehur qartë te P. Bogdani, i cili thotë se “tue vumë roe të gjymtët’ e giuhësë arbëreshe, e silla për të pakë të vet të madhe pjesë huan giuhëshit konfinjëtare, sado herë më ka râm dëshir gjākafshë me të shkruesit tem me sjellë mbë dritë”¹³ “...shumë fjalë plaka e të harrueme”¹⁴. Studiuesit mendojnë se në veprën e Buzukut “ka fjalë që duhet të jenë krijuar nga vetë auktori”¹⁵. Por në qoftë se nuk janë në gjendje të dallojnë se cilat janë fjalë të krijuara prej Buzukut dhe cilat rrjedhin nga një traditë e mëparshme apo nga goja e popullit, te Budi dhe tek autorët e tjerë të Veriut janë identifikuar një varg fjalësh të krijuara prej tyre.

Këtë kujdes për pastrimin e shqipes dhe pasurimin e saj e vërejmë edhe te shkrimtarët arbëreshë të Italisë, arbërishtja e të cilëve nga struktura fonetiko-gramatikore e leksikore ishte shumë e afërt ose gati përputhej me strukturën e të folmeve a të nëndialekteve të tjera të shqipes¹⁶. Ata e kanë pasuruar gjuhën letrare shqipe me neologjizma, si: *ujanë* (=oqean), *mjekërar* (=berber), *ndejë* (=vendbanim) etj. Megjithatë, përpos disa fjalëve që gjetën shtrirje, disa fjalë, si *thëri* (për atom), *gjithëçishte* (për univers) etj., me gjithë dëshirën e madhe të rilindësve për të “pastruar” gjuhën shqipe nga fjalët e huaja, prapëseprapë mbetën formime që nuk i qëndruan kohës.

Me përjashtim të bejtexhinjve, të cilët nuk bënë kujdes për pastërtinë e gjuhës, autorët e shek. XVIII–XIX vijuan traditën e hershme të punës për pasurimin e leksikut të shqipes dhe për ta ruajtur gjuhën nga fjalët e huaja dhe të panevojshme. Tek autorët e shek. XVIII vërehet prirja për të përdorur më pak fjalë të huaja dhe, nga kjo pikëpamje, ata janë pararendës të rilindësve. Ndërkohë, kujdesi i këtyre të fundit ishte për pastrimin e gjuhës kryesisht nga turqizmat e greqizmat, duke i zëvendësuar ato me fjalë shqipe të gjuhës popullore ose me fjalë të rikrijuara, shumë prej të cilave u morën nga goja e popullit e u përpunuan në përputhje me kërkesat e gjuhës (p.sh. *mbledhje*, *zbritje* në terminologjinë e matematikës nga J. Vreto etj.), si dhe u formuan fjalë të reja me brumin e gjuhës amtare (p.sh. *kryeqytet*, *ndërgjegje*, *udhëheqës* tek K. Kristoforidhi, *fletore* tek N. Veqilharxhi, *cilësi*, *sasi* tek N. Frashëri, *rrokje*, *nyjë*, *mbiemër* tek S. Frashëri etj.).

Kontributi i rilindësve shpaloset jo vetëm me mbrojtjen e gjuhës shqipe, jo vetëm në prurjet e reja për shqipen, por edhe në ironizimin e përdorimeve vend e pa vend të fjalëve të huaja në veprat e tyre. Nga poezia e Filip Shirokës “Si po prishet gjuha shqype?”, veçojmë vargjet që kanë edhe sot të njëjtën peshë, duke u kthyer në këtë mënyrë si universale për nga vlera:

...Kur flet shqyp, asht çud’ m’e ndi,
Gjyspërëgjysë tue e përzi me fjalë t’gjuhve t’hueja!
Thotë: me thanë la veritá
ktu në Shkodër sot diçka janë civilizuemun
La gioventù ka studiue
di me folë, me ragionue...

Natyrisht, ashtu si çdo ndryshim, edhe ai në gjuhë kërkonte një lloj përkujdesjeje dhe një punë e tillë me vlera kombëtare dhe historike për gjuhën e vendit tonë u bë edhe në

¹³ P. Bogdani, *Cuneus Prophetarum* (Çeta e profetëve), Tiranë, 2005, f. XV.

¹⁴ *Po aty*, f. XVII

¹⁵ *Historia e Letërsisë shqipe*, vëll. I, Tiranë, 1959, f. 194.

¹⁶ M. Samara, *Historia e gjuhës letrare shqipe* (shek. XV–XX), SHBLU, Tiranë, 2000.

periudhën nga Rilindja e deri në gjysmën e parë të shek. XX, kur vijuan përpjekjet për pasurimin e leksikut me fjalë të leksikut abstrakt, që ishin të nevojshme për shprehjen e mendimit letrar, shkencor e politik të një shoqërie që kishte hyrë në rrugën e qytetërimit. Gjatë kësaj periudhe u shquan për ndihmesat e tyre figura të shquara të shkollës shqipe, si A. Xhuvani, M. Logoreci, S. Peçi, P. N. Luarasi, S. Koleja apo L. Gurakuqi.

Por periudha që është cilësuar si më dinamika për zgjerimin e leksikut, është gjysma e dytë e shekullit XX, kur në vendin tonë jeta shoqërore dhe ekonomike mori një tjetër hov zhvillimi thujse në të gjitha fushat e jetës. Kjo periudhë i dha letërsisë dhe shkencës shqiptare emrat më të mëdhenj në të dy anët e kufijve shtetërorë. Ndër ta renditen edhe emrat e gjuhëtarëve E. Çabej, A. Kostallari, S. Riza, M. Domi, I. Ajeti, Sh. Demiraj etj., të cilët e ngritën në një stad më të lartë punën për studimin e gjuhës. Falë punës së ekipeve të studiuesve në institucionet gjuhësore ku drejtuan e zhvilluan veprimtarinë e tyre këta studiues, u hartuan fjalorë të tipave të ndryshëm të shqipes: fjalorë normativë, fjalorë të fjalëve të huaja, fjalorë të fjalëve shqip që zëvendësonin fjalët e huaja etj.

Kështu, po t'i referohemi fjalorit "Për pastërtinë gjuhës shqipe", të hartuar nga A. Kostallari, E. Lafe, J. Thomai dhe E. Angoni, vëmë re se autorët kanë bërë një lloj klasifikimi të fjalëve të huazuara në shqipe sipas përfshirjes ose jo të tyre në "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe" (1980). P.sh., janë përfshirë në fjalor fjalë të tilla, si: *abis* (në kuptimin, *humnerë deti*), *agrar* (edhe pse në një pjesë të madhe të përdorimeve të saj si fjalë është zëvendësuar me *bujqësor*), *agjent* (në kuptimin, "veprues" – kimik, atmosferik etj.), *akoma* (fjalë e huazuar nga *greq.*, por që në shumicën e kuptimeve të përdorimeve zëvendësohet me fjalën shqipe *ende*), *aksident* etj. Ndërkohë, janë pasqyruar edhe fjalë, si: *abandonoj*, *abrogim*, *absorbim*, *afinitet*, *akcent*, *difezë* etj., për të cilat shkruhet se janë fjalë që kanë gjegjëset e tyre në shqipe, përkatësisht *braktis*, *shfuqizim*, *përthithje*, *afri*, *theks*, *mbrojtje* etj., që, me të drejtë, nuk janë përfshirë në FGJSSH¹⁷.

Me ndërrimin e sistemit dhe me hapjen e trevave shqiptare ndaj botës, në gjuhën shqipe kanë vërshuar një mori fjalësh të huaja dhe togfjalëshash me të dy ose me njërin përbërës një fjalë të huaj. Po të krahasojmë shtypin e kohës para përmbyesjes së regjimit komunist në Shqipëri me periudhën postkomunizëm, vihet re se ka një shtim të numrit të fjalëve të huaja. Në fusha të ndryshme të shkencës, të teknikës dhe të jetës së përditshme, veçanërisht në teknologji, informatikë, ekonomi¹⁸ etj., kanë hyrë fjalë të tilla, si: *kompjuter*, *printer*, *skaner*, *monitor*, *blog*, *gugëll*, *fejsbuk*, *tuitar*, *link* (që ndeshet dhe me shumësin e përshtatur linke ose linqe), *internet*, *software*; *clearing*, *dividend*, *kartë krediti*, *kartë debiti*, *marrëveshje eskrou* (escrow agreement), *lizing* (leasing), *faktoring* (factoring), *home banking* etj. Prurje të reja për shqipen janë edhe emërtimet disa lloj gatimesh, si *picë*, *hamburger*, *fokaçe*, *ravioli*, *sufllaqe* etj.; të emrave të bimëve apo frutave ekzotikë që kanë hyrë në vendin tonë bashkë me bimën a frutin përkatës, siç janë p.sh. *kurkuma*, *xhinseng*, *tartuf*, *graviola*, *kivi*, *avokado*, *mango* etj.; emërtime detyrash e profesioneesh, si: *menaxher*, *menaxhoj*, *menaxhim*, *bejbisitër*, *killer*, *mis* (për bukuroshe), *modele*, *topmodele* apo fjalë të

¹⁷ Shih: *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1998.

¹⁸ Nëse i referohemi edhe faqes zyrtare në internet të Bankës së Shqipërisë, do të vëmë re se ka një broshurë të pasur me terma nga ekonomia, ku një pjesë të konsiderueshme e zënë edhe fjalët e huazuara. Për më shumë, shiko: http://www.bankofalbania.org/web/pub/101_termat_6370_1.pdf

tjera të fushave të ndryshme. Fjalë të tilla kanë hyrë në përdorim të gjerë, duke u bërë pjesë e leksikut të shqipes.

Por krahas fjalëve për të cilat gjuha shqipe ka nevojë, vërehet edhe një vërshim fjalësh të huaja të panevojshme, që shoqërohen me një bjerrje të kulturës gjuhësore në shtyp apo në veprimtari të tjera politiko-shoqërore në vend. Veçanërisht në ligjërimin politik dhe në stilin publicistik gjejmë një numër bukur të madh fjalësh të huaja, të cilat zor se kuptohen lehtë nga qytetarë të thjeshtë, madje nganjëherë as nga ata që i përdorin. Në fillim të viteve '90 kjo dukuri ishte më e përhapur, a thua se përdorimi i tyre u vishte më shumë dije dhe njohuri përtej të zakonshmes.

Në këtë klasë përfshihen edhe emërtimet e huaja të objekteve dhe të koncepteve nga fusha të ndryshme të artit dhe shkencës, të cilat e kanë gjeçjësuar e tyre në shqipe, si psh.: *bodigard* për truproje, *supervizor* për mbikëqyrës ose përmbykëqyrës, *garazh* (garazhd!) për larje makinash, *investigjor* për hetoj e *investigim* për hetim, *workshop* për seminar, *lider* për udhëheqës e *leadership* për udhëheqje, *trajnoj* për stërvit etj.

Pavarësisht nga mungesa e kujdesit të instituteve e të katedrave të gjuhës shqipe për pastërtinë e gjuhës, kjo temë ka qenë shumë e rrahur. Në kumtesa në tubime gjuhësore dhe në shkrime në shtypin e përditshëm, mbahet një qëndrim kritik e stigmatizues ndaj një lloji "snobizmi" gjuhësor, që ka gjetur vend tek shumë shqipfolës, dhe ngrihet shqetësimi për teprinë e përdorimit në mediet e shkruara e elektronike të fjalëve e huaja, që nuk janë vërtet të nevojshme apo pa ngjyrim të qëllimshëm stilistik. Ka edhe ndonjë organizëm, si Këshilli Ndërrakademik i gjuhës shqipe, që si objekt të punës së tij qëndrimin ndaj anglicizmave.

Megjithatë, të bie në sy se në mediet tona, sidomos në radiotelevizion, ku informacioni përcillet në mënyrë më të shpejtë në krahasim me shtypin e shkruar, ka përdorime të panevojshme e të gabuara të fjalëve të huaja. Efekti i këtyre përdorimeve mbi lexuesit a dëgjuesit është i dyfishtë, sepse përveç informacionit të paqartë, që buron nga mosnjohja e kuptimit të fjalëve të huaja, u jepet edhe një shprehje gjuhësore e shtrembëruar. Në radhë të parë, televizioni si media me shikueshmërinë më të lartë, ndikon negativisht me gjedhet gjuhësore joshqipe dhe me fjalët e huaja që përdorin drejtuesit e emisioneve. Të tilla fjalë të huaja që i dëgjojmë përnatë, janë: *publicitet* (reklamë), *puntatë* (pjesë), *show* (shfaqje), *deciziv* (vendimtar), *kurioz* (kureshtar), *këngëtar* i *afirmuar* (i njohur), *divergjencë* (mosmarrëveshje), *survejoj* (mbikëqyr), *abrogoj* një *ligj* (shfuqizoj), *internacional* (ndërkombëtar), *detyra emergjente* (urgjente), *impenjim* (përkushtim), *inaugurim* (përrurim), *konsensus* (marrëveshje), *diskret* (i matur, fjalëpak), *stopoj* (ndaloj), *startoj* (nis, filloj), *anunçoj* (njoftoj, lajmëroj), *event* (ngjarje) etj.—*okej, shou, skup, bekgraund, bord, fidbek, uorkshop* etj.

Për më tepër, dita-ditës po shtohen programe apo rubrika televizive dhe radiofonike me emra të huaj, si: *Wake Up, Lifestyle, Aldo Morning Show, Showbiz, Blue* etj. Edhe në programe televizive me tema për mbrojtjen e gjuhës shqipe, ku dhe vëmendja e teleshikuesit është e përqendruar tek gjuha që flitet, prapëseprapë ndeshen përdorime të fjalëve të huaja, si p.sh. përdorimi nga vetë drejtuesi i emisionit i togfjalëshit *marr spunto* në vend të *marr shkas*. Ky fakt mjafton për të na bërë të kuptojmë se duam apo s'duam ne, jemi të ndikuar nga fjalët e huaja dhe kjo "sëmundje" ka pushtuar "nënvetëdijen gjuhësore" të folësve, që shfaqet në stereotipa apo frazeologji karakteristike të programeve televizive që transmetohen herë pas here në vendin tonë.

Nëse ka prirje të tilla në mjetet e komunikimit masiv, të cilat janë burim informacioni për mbarë shqipfolësit, dhe shpeshherë burim i vetëm informacioni për individë të caktuar, çfarë mbetet për të kërkuar prej një qytetari të thjeshtë, kur modeli ligjërimit që ai ndjek është i gabuar dhe i shmanget normës letrare, duke i mëshuar përdorimit të fjalëve të huaja, jo rrallë, me mendimin se po e përzgjedh gjuhën apo po flet me “fjalë të mëdha”!?

Nuk mund të paragjykojmë kurrsesi rastet kur ndeshemi me një fjalë të huaj në një tekst shqip, kur nga pikëpamja stilistikore ajo perceptohet si e përshtatshme për të arritur efektin shprehës dhe jo sepse mungon fjala përkatëse për të emëruar në shqip. Shpeshherë, në të folur, kjo fjalë ndeshet me një ndryshim të intonacionit dhe disa herë i shoqëruar dhe me një gjest me duar që nënkupton përdorimin e thonjzave për fjalën. P. sh.: *Se nuk rri dot pa folur kjo signorina, ka naze për çdo gjë.*

Në të shkruar, kur nuk bëhet fjalë për një krijim artistik (ku lexuesi e kupton nga konteksti përftesën përkatëse), por sërish e përdorur me efekt stilistik, fjala e huaj ose vendoset mes thonjzave, ose shkruhet me të errët, ose me shkronja të pjerrëta, për t'ia lehtësuar lexuesit përmbajtjen. Për këtë të fundit, efekti stilistik jep hapësirë mendimi që, fjala vjen, personazhi në tekst nuk e njuh mirë gjuhën, por prapëseprapë shfaq veten duke përdorur fjalë të huaj në vend të asaj shqipe.

Shpesh jepet alarmi për gjuhën e atyre që komunikojnë në rrjetet sociale, si fejsbuk, tuitar, netlog etj., që përdorin shpesh fjalë të huaja a shkurtime fjalësh në gjuhë të huaja, të cilat gjejnë hapësirë përdorimi pikërisht në atë që do ta quanim “ligjërimit virtual” a “kompjuterik”. Shkurtime të tilla që përdorin kryesisht të rinjtë në rrjetet sociale, janë *thnx* – thanks, *omg* – oh my God, *bc* – baci, *tvb* – ti voglio bene etj. Duke u nisur nga përdorime të tilla në ligjërimitin e thjeshtë, joformal, nxirret konkluzioni se gjuha shqipe po masakrohet etj. Në të vërtetë, përveç asaj që komunikimi virtual pasqyron nivelin gjuhësor të brezave të rinj, që është pasqyrim i punës së dobët të shkollës për formimin gjuhësor të tyre, nga ky lloj komunikimi gjuhësor standarde nuk i vjen ndonjë dëm. Gjuha e internetit është një formë e posaçme e konvencionale e gjuhës së përgjithshme, qoftë kjo shqipja, italishtja, anglishtja etj. Ajo nuk mund të zëvendësojë gjuhën standarde në funksionet e saj¹⁹.

Dëmi gjuhësor i vjen nga përdorimi i fjalëve të huaja të panevojshme dhe nga mungesa e barrierave penguese ndaj kësaj dukurie. Megjithatë është folur e shkruar shumë për ruajtjen e pastërtisë së gjuhës standarde, ende nuk ka një propozim konkret për themelimin e një institucioni si “policia gjuhësore”. Meqenëse mjetet dhe rrugët e komunikimit janë të shumta, ngritja e një institucioni monitorues dhe këshillimor do të ishte mënyra më e mirë për t'i ndërgjegjësuar shqipfolësit për nevojën e mbrojtjes së gjuhës sonë amtare, e cila është pasuria jonë kulturore më e çmuar dhe shenja themelore e identitetit tonë kombëtar.

Bibliografia

Bogdani, P., *Cuneus Prophetarum* (Çeta e profetëve), Tiranë, 2005, f. XV. (botim kritik përgatitur nga A. Omari).

Fjalori i Gjuhës Shqipe, Tiranë, 2006.

Fjalori i Shqipes së Sotme, Tiranë, 2002.

Historia e Letërsisë Shqipe, vëll. I, Tiranë, 1959, f. 194.

http://www.bankofalbania.org/web/pub/101_termat_6370_1.pdf

Memushaj, R., *Shqipja standarde*, Tiranë, 2002.

¹⁹ A.Tirana, “E shkruar baras me e folur?!”, gazeta “Standard”, 15.12.2009.

Për pastërtinë e gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1998.

Samara, M., *Historia e gjuhës letrare shqipe (shek. XV-XX)*, SHBLU, Tiranë, 2000.

Tirana, A., *E shkruar baras me e folur?!*, gazeta "Standard", 15.12.2009.

Thomai, J., *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002.

VEÇORI TË LIGJËRIMIT TË KADARESË NË ROMANIN “KRONIKË NË GUR”

Msc. Aseda Behari

Qendra anglo-shqiptare “Fenix”

Tiranë, Shqipëri

“Ismail Kadare është një shkrimtar që krijon hartën e një kulture të tërë, të historisë, pasionit, folklorit, politikës dhe katastrofat e saj. Ai është një shkrimtar universal, me një traditë narracioni që e ka origjinën që nga Homeri.”²⁰ “E kanë krahasuar me Gogolin, me Kafkën, me Oruellin. Por zëri i Kadaresë është zë origjinal, e prapë me rrënjët thellë në tokën e vet.”²¹ Ai ka një krijimtari mjaft të pasur, të fuqishme dhe të llojeve të ndryshme, të përbërë nga poezi, tregime, novela, romane, ese, publicistikë, studime letrare e folklorike, ditare, biseda etj. Megjithatë, ndihmesat e tij më të mëdha janë në poezi dhe roman. “Krijimtarinë në prozë Kadareja e nisi me tregime të shkurtra. Por shumë shpejt ai kaloi te romani, saqë sot është e vështirë të dallosh në krijimtarinë e tij ndonjë periudhë ku shkrimtari të jetë marrë vetëm me tregimin.”²² “Kur nisi Kadareja të lërojë anën e prozës shqipe, asaj i ngatërroheshin nëpër këmbë ferrat dhe trajtat e poetikës së sentimentalizmit dhe ia kufizonte hapësirën trysnia e poetikës së një romantizmi social të shpallur si realizëm, që ishte në thelb një realizëm i futur brenda shtratit të Prokrustit.”²³

“Kadareja e bëri romanin roman, pra e ktheu atë te përmbajtja e tij tipologjike, që sipas R. Foksit është konflikti i individit me shoqërinë dhe me institucionet e saj morale, kërkimet e tij shpirtërore dhe rravimet ekzistenciale të njeriut ose të bashkësisë njerëzore.”²⁴

Me Kadarenë erdhi në letërsinë shqipe një tip i ri proze. Nga një prozë ku ligjërimi rrjedh pak a shumë në mënyrë të njëtrajtshme, romani shqiptar krijoi struktura të reja komplekse kompozicionale e ligjërimore. Lëvizja e mendimit, asosacioni, analogjitet dhe paralelet historike, kundërvëniet dhe parabola e kanë bërë strukturën e romanit shumë shtresore, të thyer e dinamike, ndryshe nga ndërtimi i prozës me ndërtim linear, bazën e të cilit e formon zakonisht narracioni epik për ngjarjet.

²⁰ Shih për këtë: Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, Tiranë, 2000, f.1

²¹ Shih: Ismail Kadare, *Darka e gabuar*, Tiranë, 2009, ballina

²² Shih për këtë: Dilaver Dilaveri, *Mbi tipologjinë e romaneve të Ismail Kadaresë në Studime Filologjike*, nr 1-4, Tiranë, 1995, f.115

²³ Shih për këtë: Jorgo Bullo, *Kadareja dhe letërsia shqipe në Studime Filologjike*, nr 1-2, Tiranë, 2006, f.7

²⁴ Po aty, f.8

Romanet e Ismail Kadaresë janë të estetikave dhe të llojeve të ndryshme. Romani “Kronikë në gur”, ashtu si edhe romane të tjerë të tij, është me një estetikë realiste dhe për pasojë ka një lexim realist.

Titulli i romani është një titull metonimik, i shkallë-shkallshëm, në të cilin guri nënkupton qytetin dhe qyteti banorët e tij. Po ç’quajmë kronikë në kuptimin gjuhësor? Kronika, në kuptimin gjuhësor, është një vepër ku shënohen ngjarjet historike në kohën që kanë ndodhur dhe ashtu siç kanë ndodhur, njëra pas tjetrës.²⁵ Pra, një përmbledhje faktesh e ngjarjesh historike sipas kronologjisë.²⁶

Dashuria për vendlindjen dhe nostalgjia për fëmijërinë janë dy ndjenja mbarënjerezore, që me stilin original dhe me mjeshhtërinë e Ismail Kadaresë janë ngritur në shkallën e vlerave letrare universale gjithësore. Prandaj, *Kronikë në gur* është botuar deri tani në 34 gjuhë: shqip, frëngjisht, gjermanisht, anglisht, danisht, finlandisht, holandisht, katalanisht, arabisht, bullgarisht, maqedonisht, portugalisht, rumanisht, serbisht, spanjisht, suedisht, turqisht etj.²⁷

“Pasuria e patundshme dhe e pashtershme e shkrimtarit, dihet se është koha. Kurse për prozatorin posaçërisht do të mund të thuhet se pasuria më e madhe dhe e pashtershme e tij, është edhe koha, e ndyrë, e metaforizuar në rrëfim.”²⁸ “Kronikë në gur” është një roman njëkohor, sepse rrëfen për një kohë historike të përcaktuar qartë, rrëfen për vitet ‘40 të shek. XX në Gjirokastrë. “Lidhjen themelore reciproke të marrëdhënieve të kohës dhe të hapësirës, të kuptuar artistikisht (...) do ta emërtojmë si kronotopos.”²⁹

Rrëfimin për fëmijërinë mund ta mendojmë si një “bluzë” të thurur njëkohësisht me disa fije shumëngjyrëshe, ku njëra fije të simbolizojë rrëfimin për vetveten, njëra rrëfimin për botën ose qytetin dhe tjetra rrëfimin për luftën. Të trija këto fije “thuren” prej heroit kryesor të romanit, që është një fëmijë.

Kur Alain Bosquet i thotë Kadaresë: “Lutemi, na flisni për fëmijërinë tuaj në Gjirokastrë, qytetin ku ju keni lindur më 1936.”³⁰ ai i thotë: “Kam folur gjerësisht për fëmijërinë time në librin *Kronikë në gur*.”³¹ Por, duhet thënë, që ky fëmijë mbart shumë të dhëna të jetës së autorit, por nuk është vetë autori, ndaj edhe “Kronikë në gur” është një roman artistik dhe jo një biografi për jetën e Ismail Kadaresë.

Koherenca dhe kohezioni në vepër

Tashmë teksti vlerësohet si njësia më e madhe ligjërimore që realizon komunikimin gjuhësor.³²

Tekstualiteti përbëhet nga shtate kritere: kohezioni, koherenca, qëllimi, pranueshmëria, karakteri informues, karakteri rrethor, ndërtekstualiteti; dhe mungesa e sikur njërit prej tyre bën që vepra të mos ketë formë dhe përmbajtje të plotë.

Le të shohim tani disa prej këtyre kritereve në veprën në shqyrtim:

4.1 Rimarrja

Përsëritja e drejtpërdrejtë e elementeve quhet *Rimarrje*. Rimarrja mund të jetë:

²⁵ Shih për këtë: Grup autorësh, *Letërsia bashkëkohore shqiptare*, Tiranë, 2004, f.278

²⁶ Shih: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 496

²⁷ Shih për këtë: Bashkim Kuçuku, *Kadare në gjuhët e botës*, Tiranë, 2005, f.51

²⁸ Shih: Bashkim Kuçuku, *Kadare në gjuhët e botës*, Tiranë, 2005, f.21

²⁹ Shih për këtë: Kristanthe Fecani, Veçori të kronotoposit në vepërën “Prilli i thyer” të Ismail kadaresë dhe “Mali Magjik” të Tomas Manit në *Studime Filologjike*, nr. 1-2, Tiranë, 2004, f.33

³⁰ Ismail Kadare, *Dialog me Alain Bosquet*, Tiranë, 2002, f.8

³¹ Po aty

³² Shih: Dibra Klodeta, *Varfi Nonda; Gjuhësia e tekstit*, Tiranë, f.30

1. Rimarrje e plotë

2. Rimarrje e pjesshme

Rimarrja është e plotë kur përdorim të njëjtin material gjuhësor, pa ndryshim të kategorisë leksiko-gramatikore, kurse kur përdoret i njëjti material gjuhësor, por me ndryshim të kategorisë kemi rimarrje të pjesshme.

Në veprën "Kronikë në gur" rimarrja është e shpeshtë. Autori rimerr të njëjtin material gjuhësor, por "riprodhon" dhe material të ri. Kështu ai nxit kureshtjen për të mbajtur gjallë leximin dhe për ta shpënë atë deri në fund. Raste të rimarrjes kemi:

"Ushtritë gjermane kishin kapërcyer kufirin shtetëror të jugut dhe po marshonin drejt qytetit, që po zbrazej. Kjo ishte braktisja e tretë gjatë gjithë jetës së tij. Braktisja e parë ishte shkaktuar nga një murtajë një mijë vjet më parë. E dyta ishte bërë para katërqind vjetësh, në kohën kur trupa perandorake osmane, kishin kapërcyer kufirin, nën shenjë të Islamit, pikërisht në atë vend ku po lëviznin tani trupat gjermane.

Qyteti po zbrazej. Parandihej vetmia..."³³

"Në shtëpinë tonë ishin mbledhur Mane Vocoja e Bido Sherifi bashkë me gratë e fëmijët dhe Nazoja me nusen. Maksuti ishte zhdukur. Unë isha i trishtuar për shkak të gjyshes. Ajo përsëri nuk do të vinte. Nuk do të vinte as Kako Pinua. Kisha frikë se mund të bëheshin dasma në mungesë të saj. Mund ta kërkonin. Për gjashtëdhjetë vjet rresht kishte stolitur gjithë nuset e qytetit. Tani s'mund t'i linte. Nusja e pastolisur është shëmtria më e madhe mbi dhe, kiameti, kishte thënë ajo, kur qenë përpjekur t'i mbushnin mendjen për të ikur."³⁴

"Kaluam urën e lumit. Përpara kishim fushën e braktisur të aeroportit, përmes së cilës duhet të kalonim. Më në fund u gjendëm mbi të. Kurrënjëherë nuk e kisha menduar se mund ta shkelja me këmbë. Më pikoi në zemër. Ajo fushë kishte qenë për mua e shenjtë. Një farë motër apo grua e qiellit. Me fat të zgjedhur si një princeshë. Tani e ndarë prej qiellit, krejt si gruaja e lënë, ishte mvrejtur dhe egërsuar."³⁵

"Një partizan. Nga lagjja e qendrës kishte dalë një partizan. Një javë më parë ai kishte qenë një njeri i zakonshëm...Dhe ja papritur ishte shndërruar në partizan."³⁶

Kemi rimarrje te: nusen-nuset-nusja; mund-mund; nuk do të vinte-nuk do të vinte; një partizan-një partizan-partizan; një-një etj.

4.2 Elipsi

Është një tjetër element i kohezionit, që ndihmon në unitetin dhe vlefshmërinë e tekstit.³⁷ Në veprën "Kronikë në gur" është një ndër elementët më të pranishëm të kohezionit. Shembull-pasazhi i mëposhtëm: *Ajo fushë kishte qenë për mua e shenjtë.*(Kishte qenë-shënim imi ky) *Një farë motër apo grua e qiellit.*(Kishte qenë) *Me fat të zgjedhur si një princeshë. Tani e ndarë prej qiellit, krejt si gruaja e lënë, ishte mvrejtur dhe egërsuar.*³⁸

4.3 Deiktikët në vepër

Elementet që realizojnë format tradicionale të deiksisit në veprën tonë "Kronikë në gur" janë:

³³ Shih për këtë: Ismail Kadare, "Kronikë në gur", Tiranë, 2000, f.277

³⁴ Po aty, f.277

³⁵ Po aty, f.278

³⁶ Po aty, f.228

³⁷ Shih: Klodeta Dibra, Nonda Varfi, "Gjuhësi teksti", f.63

³⁸ Po aty, f.278

a) Deiktikët vetorë: unë, ti, ne, ju etj

“Unë u afrova te dritarja dhe u mundova të vështroja përjashta.”³⁹

“Ti mund të ecje rrugës dhe po të doje, mund të zgjatje pak krahun e të vije kësulën tënde mbi majën e një minareje.”⁴⁰

b) Deiktikët pronorë: i imi, i yti, i yni, i juaji

“Këmbët e mia prekën me druajtjeshpinën e udhëve të tij të gurta”⁴¹

c) Deiktikët dëftorë: ky, kjo, ai, ajo (me të gjitha paradigmën e tyre)

“Ky ishte një qytet i çuditshëm, që (...)”⁴² “Ata të tre (...)”⁴³

ç) Deiktikët hapësinorë: këtu, atje, në atë qytet, në atë vend

“Ato janë atje, të përjetshme, të ngrira në gur, bashkë me shenjat që kanë lënë sipër tyre tërmetet, dimrat apo rrebeshet njerëzore.”⁴⁴

d) Deiktikët kohorë: sot, nesër, pasnesër, dje, pardje, javën e kaluar, vitin tjetër, muajin e ardhshëm etj

“Tani e merrja me mend se si (...)”⁴⁵ “Erdha prapë pas një kohe të gjatë (...)”⁴⁶

Konektorët në vepër

Çfarë janë konektorët? Konektorët janë mjete që realizojnë vazhdimësinë logjike të tekstit⁴⁷, ndërsa “lidhëza është ajo pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, që lidh dy gjymtyrë fjali dhe shpreh marrëdhënie të ndryshme sintaksore ndërmjet tyre”⁴⁸. Nga dy përkufizimet e mësipërme duket qartë ngjashmëria që ekziston mes konektorëve dhe lidhëzave: të dyja shërbejnë për të lidhur. Ndryshimi është se ‘konektorët tekstualë’ sigurojnë lidhje që shtrihen në të gjithë gjatësinë e tekstit. Ndërsa lidhëzat lidhin fjali dhe përbërës të tjerë. Sipas raportit që shënojnë në tekst, konektorët i ndajmë në tri kategori:⁴⁹ 1. Konektorë logjikë, 2. Konektorë që saktësojnë organizimin tekstual, 3. Konektorë që shprehin qëndrimin e folësit apo të shkruarit.

Në veprën “Kronikë në gur” konektorët luajnë një rol shumë të rëndësishëm. Shembuj të tyre kemi:

a) Me pasthirrma: eh, ah, uh, pupu etj.

“Pupu, ç’kiamet”⁵⁰ “Uh, moj Selfixhe, -rënkoj Xhexhoja, - të zeztë ne, të zeztë! (...)”⁵¹ “Ah ç’na the!”⁵² “Kohë të këqija, kohë të turbullta, ah moj xhiko, është kohë e pabesë kjo.”⁵³

b) Me lidhëza bashkërenditëse, lidhëza nënrenditëse dhe shprehje lidhëzore si: *dhe, por, ose, prandaj, megjithatë, pra, ndërsa, sepse, me qëllim që* etj.

“Nuk kisha ndonjë dëshirë të shkoja te shpella, më ishin mërzitur zgafellat dhe vendet me lagështirë, megjithatë nuk ia prisha.”⁵⁴ “Të gjitha këto më mërzitnin, por e qetësoja

³⁹ Po aty, f.16

⁴⁰ Po aty, f.14

⁴¹ Po aty, f.304

⁴² Po aty, f.14

⁴³ Po aty, f.17

⁴⁴ Po aty, f.306

⁴⁵ Po aty, f.18

⁴⁶ Po aty, f.304

⁴⁷ Shih për këtë: Klodeta Dibra, Nonda Varfi, “Gjuhësi teksti”, f.89

⁴⁸ Shih: Grup autorësh, Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995, f.397

⁴⁹ Shih për më gjerë: Klodeta Dibra, Nonda varfi, “Gjuhësi teksti”, f. 92

⁵⁰ Shih për këtë: Ismail Kadare, “Kronikë në gur”, Tiranë, 2000, f.18

⁵¹ Po aty, f.19

⁵² Shih për këtë: Ismail Kadare, “Kronikë në gur”, f. 237

⁵³ Po aty, f.20

veten kur dëgjoja gjyshen që thoshte se ishte një kohë e tillë kur nuk dije nga të mërzhiteshe më parë.”⁵⁵ “Nëna mbante bishtukun, ndërsa im atë vështronte poshtë”⁵⁶ “(...) sepse asnjë udhë e botës nuk mund të ushte aq bujare sa të linte t’ia ngrije gurët dhe pllakat dhe të bëje ç’të doje me të mu në mes të ditës”⁵⁷

c) Ndajfolje dhe shprehje ndajfoljore: atëherë, domethënë, pas, para, dje, nesër, atje lart, me sa duket, pikërisht, përreth, pak a shumë, pothuaj, për rrjedhojë, së pari etj.

“Pikërisht në çastin kur bëheshin gati (...)”⁵⁸ “Ato do të kalonin shumë ditë e muaj të mërzhitshëm atje poshtë(...)”⁵⁹

ç) Shprehje komplekse : sa për fillim, ndryshe nga ç’e prisnim, siç parashikohej, e merrja me mend etj. “E merrja me mend se si pikat e panumërta rrokulliseshin tani në pllakat e Pjerrëta...”⁶⁰

Në vepër është me vlerë të theksohet, se dallojmë disa lloje konektorësh:

Konektorë që shprehin marrëdhënie kohe: *kur* (lidhëz), *tashmë* etj.

b) Konektorë logjikë që shprehin marrëdhënie të zgjerimit të informacionit: *dhe*, *e*, *edhe*.

“Ata panë sytë tanë të tmerruar, panë dhe Kako Pinon që po shkulte faqet dhe pa e bërë të gjatë e pa kërkuar sqarime të tepërta, nisën kërkimet te vendi ku kishim drejtuar sytë të gjithë ne.”⁶¹

c) Konektorë logjikë që shprehin marrëdhënie shpjegimi: *nëse*

ç) Konektorë që shprehin marrëdhënie përmbyllëse: *kështu*

“(...)Ku po shkojmë kështu?” dhe pa e mbledhur veten mirë nga ky vrap...”⁶²

d) Konektorë logjikë që shprehin marrëdhënie kundërvënije: *madje*, *por* etj

“Të gjitha këto më mërzhitnin, por e qetësoja veten (...)”⁶³

Nivelet ligjërimore në prozë

Te romani “Kronikë në gur” kemi një ligjëratë të përqendruar te folësi. Kjo ligjëratë i kundërvihet ligjëratës së përqendruar te dëgjuesi. Po t’i referohemi Jakobsonit, funksioni fatik është neutral. Po çfarë do të kuptojmë me funksion fatik? Funksioni fatik është një ndër shtatë funksionet e gjuhës (funksioni njohës, funksioni ekspresiv, funksioni fatik, funksioni konativ, funksioni poetik, funksioni perfomativ, funksioni metagjuhësor). Gjuha përdoret me këtë funksion atëherë kur me anë të saj synohet të vendoset kontakti midis folësit dhe dëgjuesit ose të verifikohet nëse kanali i komunikimit funksionon.⁶⁴ “Ligjërimi në këtë roman ka zhdërvjelltësinë, gjallërinë e spontanitetin e bisedave të përditshme.”⁶⁵ Aty dallojmë:

a) Shumë fjalë e shprehje të dhëna në ligjëratë të drejtë dhe të zhdrejtë. Për shembull: “S’më thua dot se ta kam bërë unë?”⁶⁶

⁵⁴ Po aty, f.221

⁵⁵ Po aty, f.264

⁵⁶ Shih për këtë: Ismail Kadare, “Kronikë në gur”, Tiranë, 2000, f. 17

⁵⁷ Po aty, f.52

⁵⁸ Po aty, f.16

⁵⁹ Po aty, f.16

⁶⁰ Po aty, f.15

⁶¹ Po aty, f.50

⁶² Po aty, f.15

⁶³ Po aty, f.264

⁶⁴ Shih më gjerë: Memushja Rami, Funksionet e gjuhës në ‘Hyrje në gjuhësi’, Tiranë, 2006, f. 21

⁶⁵ Shih për këtë: Emine Sadiku, Kadareja-Ky stilist i madh, Tiranë, 2000, f.41

⁶⁶ Shih: Ismail Kadare, Kronikë në gur, Tiranë, 2000, f.217

b) Metafora librare-artistike

"Netëve projektori ndizte syrin e tij të vetëm. Ai ishte qiklopi Poliform."⁶⁷

c) Njësi me një shkallë të lartë të ngjyrimit poetik

"Nëpër të cilën frynte një erë e akullt."⁶⁸

ç) Kompozita të tipit libror që e rritin shprehësinë dhe shkallën e abstraksionit.

"Qetësi krimbëdëgjuese."⁶⁹

d) Mbiemra me prapashtesën –shëm që janë formime me burim popullor e me potencialitet të madh.⁷⁰"(...) *me kuptime të rrëshqitshme si ujët.*"⁷¹

e) Një grup fjalësh që kanë ekuivalente në leksikun ndërstilor.

"Ti je me zemër."⁷² (je e sëmurë)

ë) Fjalë fatike

"Mos, more..."⁷³

f) Krahasime të stilit bisedor

"Me atë zë si gomari i Kiços."⁷⁴

g) Metafora të stilit bisedor

"Spiun, posi. Gjarpër nën gur."⁷⁵

gj) Metonimi të gjuhës bisedore

"Të jetoj nën grekun."⁷⁶

h) Hiperbola

"Të zestë ne, të zestë."⁷⁷

i) Onomatopetë

Përdoren shumë dendur. Duke imituar me anë të tyre tinguj, zëra, gjallërohet ligjërimi e fiton natyrshmëri: "*Kërcisnin dërrasat e vjetra... Kërr, kërr, kërr.*"⁷⁸

j) Shtrembërimë fjalësh

"Ku jeni, moj fatzeza."⁷⁹

Përfundime

Ismail Kadare ka një krijimtari mjaft të pasur, të fuqishme dhe të llojeve të ndryshme, të përbërë nga poezi, tregime, novela, romane, ese, publicistikë, studime letrare e folklorike, ditare, biseda etj. Megjithatë, ndihmesat e tij më të mëdha janë në poezi dhe roman.

⁶⁷ Po aty, f.77

⁶⁸ Po aty, f.150

⁶⁹ Po aty, f.145

⁷⁰ Për këtë shih: Bashkim Kapaj; Pasurimi i vargjeve sinonimike në prozën letrare të I.Kadare në Studime Filologjike, Tiranë, 1993, nr 1-4, f. 49

⁷¹ Po aty, f.11

⁷² Shih: Ismail Kadare, Kronikë në gur, f. 127

⁷³ Shih: Ismail Kadare, Kronikë në gur...f.85

⁷⁴ Po aty, f.98

⁷⁵ Shih: Ismail Kadare...f.215

⁷⁶ Shih: Ismail Kadare...f.130

⁷⁷ Po aty, f.9

⁷⁸ Shih: Ismail Kadare...f.61

⁷⁹ Shih: Ismail Kadare...f.214

Me Kadarenë erdhi në letërsinë shqipe një tip i ri proze. Nga një prozë ku ligjërimi rrjedh pak a shumë në mënyrë të njëtrajtshme, romani shqiptar krijoi struktura të reja komplekse kompozicionale e ligjërimore.

Romanet e Ismail Kadaresë janë të estetikave dhe të llojeve të ndryshme. Romani “Kronikë në gur”, ashtu si edhe romane të tjerë të tij, është me një estetikë realiste dhe për pasojë ka një lexim realist. Titulli i tij është një titull metonimik, i shkallë-shkallshëm, në të cilin guri nënkupton qytetin dhe qyteti banorët e tij. Rrëfimtari fëmijë mbart shumë të dhëna të jetës së autorit, por nuk është vetë autori, ndaj edhe “Kronikë në gur” është një roman artistik dhe jo një biografi për jetën e autorit.

Dashuria për vendlindjen dhe nostalgjia për fëmijërinë janë dy ndjenja mbarënjerezore, që me stilin origjinal dhe me mjeshtërinë e Ismail Kadaresë janë ngritur në shkallën e vlerave letrare universale, duke bërë që vepra të botohet në shumë gjuhë.

Tekstualiteti i romanit përbëhet nga shtate kritere: kohezioni, koherenca, qëllimi, pranueshmëria, karakteri informues, karakteri rrethanor dhe ndërtekstualiteti.

Deiktikët më mbizotërues janë: deiktikët vetorë, pronorë, dëftorë, hapësinor dhe ata kohorë. Rastet më të shpeshta të konektorëve janë me: lidhëza bashkërenditëse, nënrenditëse dhe shprehje lidhëzore; ndajfolje dhe shprehje ndajfoljore; shprehje komplekse, pasthirrma etj. Ata shprehin në vepër: marrëdhënie kohe; marrëdhënie të zgjerimit të informacionit; marrëdhënie shpjegimi; marrëdhënie përmbyllëse dhe marrëdhënie kundërvënijeje.

Në ligjërimin e kësaj vepre dallojmë: shumë fjalë e shprehje të dhëna në ligjëratë të drejtë dhe të zhdrejhtë; metafora librorë-artistike; njësi me një shkallë të lartë të ngjyimit poetik; kompozita të tipit libror që e rritin shprehësinë dhe shkallën e abstraksionit; mbiemra me prapashtesën –shëm, që janë formime me burim popullor e me potencialitet të madh; një grup fjalësh që kanë ekuivalente në leksikun ndërstilor; fjalë fatike; krahasime të stilit bisedor; metafora të stilit bisedor; metonimi të gjuhës bisedore; hiperbola; onomatope etj.

Bibliografia

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Studime Filologjike*, nr 1-4, Tiranë, 1993
2. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Studime Filologjike*, nr 1-4, Tiranë, 1995
3. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Studime Filologjike*, nr 1-4, Tiranë, 1997
4. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Studime Filologjike*, nr 1-2, Tiranë, 2004
5. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Studime Filologjike*, nr 1-2, Tiranë, 2006
6. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, “Gramatika e gjuhës shqipe”, Tiranë, 2002
7. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Alfred Uçi, *Estetika e groteskut*, Tiranë, 2001
8. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006
9. B. Kuçuku, *Kadare në gjuhët e botës*, Tiranë, 2005
10. E. Sadiku, *Kadare-ky stilist i madh*, Tiranë, 2000
11. Grup autorësh, *Letërsia Bashkëkohore shqiptare*, Tiranë, 2004
12. Fjalori i Gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980
13. I. Kadare, *Darka e gabuar*, Tiranë, 2009
14. I. Kadare, *Kronikë në gur*, Tiranë, 2000
15. I. Kadare, *Dialog me Alain Bosquet*, Tiranë, 2002
16. K. Dibra, N. Varfi, *Gjuhësi teksti*, Tiranë, 1999
17. R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2006
18. Xh. Lloshi, *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1987

PRIRJA E DEFONOLOGJIZIMIT TË ZANOREVE HUNDORE NË TË FOLMET E GEGËRISHTES

Asllan Hamiti

Fakulteti i Filologjisë "Bllazhe Koneski", Shkup

Abstrakt

Hundorësia e zanoreve në të folmet e gegërishtes ka filluar të lëkundet dhe gjithnjë e më pak mund të gjenden çifte minimale fjalësh, te të cilat një zanore gojore i kundërvihet një zanoreje hundore.

Është e vërtetë se çdo e folme geqe ka zanore të hundorëzuara. Por, për çdo të folme fonemat duhet identifikuar veç e veç nëpërmjet kundërvënieve fonologjike (kuptimdalluese ose gramatikore).

Të folmet geqe në çështjen e hundorësisë së zanoreve tani gjenden në një fazë kalimtare. Te të gjitha ka pritje për defonologjizimin e hundorësisë së zanoreve. Në ndërgjegjen e folësve nuk është gjithnjë e qartë vlera e hundorësisë. Në mjaft krahina të Gegërisë dallimi fonemë zanore gojore ~ zanore hundore është rrafshuar. Fjalët janë kthyer në homofone, duke ia lënë kontekstit diferencimin e kuptimit.

Fjalët çelës: hundorësi, fonemë, kundërvënie, defonologjizim, prirje

Në dialektologjinë shqiptare janë arritur rezultate të lakmueshme. Janë përshkruar pothuajse të gjitha të folmet shqipe, janë hartuar punime përgjithësuese si dhe janë botuar e ribotuar disa tekste universitare shumë të vlefshme (Gjinari, Jorgji – Shkurraj, Gjovalin: *Dialektologjia*, ShBLU, Tiranë, 1997, 2000), është botuar edhe Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe. Deri më tani janë shkruar shumë monografi dialektore. Çdonjëra nga to, duke marrë parasysh kohën kur është shkruar, ka vlerë të madhe. Megjithkëtë, vëzhgimet dialektore duhet vazhduar edhe më tej. Pothuajse për çdo të folme geqe thuhet se ka zanore hundore, pa u saktësuar se hundorësia është e tipit fonetik apo fonologjik. Andaj, nga përshkrimet e deritashme dialektore vështirë se mund të krijohet mozaiku i plotë i sistemit vokalik të gegërishtes, sepse për shumë të folme të dhënat për vlerën fonologjike të gjatësisë dhe të hundorësisë së zanoreve janë të pakta ose mungojnë fare, rrjedhimisht edhe nuk është përcaktuar me saktësi inventari i fonemave për disa të folme.

Të arriturat teorike dhe praktike të dialektologjisë shqiptare si dhe të gjuhësisë shqiptare e të gjuhësisë së përgjithshme duhet zbatuar edhe në përshkrimet dialektore. Dukuria e hundorësisë së zanoreve në gjuhën shqipe ka ngjallur interesim të madh ndër gjuhëtarët shqiptarë dhe të huaj, rrjedhimisht për këtë dukuri janë shkruar disa artikuj e studime të ndryshme. Në Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe I, vëllimi I, Napoli 2007, vëllimi II Napoli 2008⁸⁰, në hartat 8, 9, 10, 11, 12 është paraqitur përndarja e fonemave hundore /ā/, /ē/, /ī/, /ÿ/, /ū/ në të gjitha të folmet shqipe të trungut e të diasporës nëpërmjet fjalëve *bān* 'bën', *ēn* 'end', *u pī* 'u mpi', *sÿ* ose *sø* 'sy', *hū* 'huri'. Më pastaj, në hartën përgjithësuese nr. 19 është paraqitur numri i serive të fonemave zanore të theksuara. Sipas kësaj harte përgjithësuese mund të përfundohet se kemi tri areale: 1. Areal me një seri fonemash zanore të theksuara; 2. Areal me dy seri fonemash zanore të theksuara; 3. Areal me tri seri fonemash zanore të theksuara.

Konstatimi i përgjithshëm se toskërishtja (dhe shqipja standarde) nuk ka fonema zanore hundore është plotësisht i saktë dhe ka karakter universal, ashtu siç është i saktë konstatimi i përgjithshëm se të folmet geqe kanë një inventar vokalik prej dy seri zanorësh: a) zanore gojore të shkurtra, dhe b) zanore gojore të gjata.

Por, por se të folmet geqe në gjendjen e sotme kanë fonema zanore hundore është i diskutueshëm. Duhet rishqyrtuar vlera fonologjike e zanoreve hundore të gegërishtes. Mendojmë se kundërvënia e gjatësisë së zanoreve dhe hundorësia e tipit fonetik është mbarëdialektore geqe; por, hundorësia në pikëpamje fonologjike nuk ka vlerë absolute. Gjykojmë se hundorësia e zanoreve tani më është defonologjizuar jo vetëm në nëndialektin e gegërishtes jugore, por edhe në shumë të folme të nëndialektit të gegërishtes veriore. Për ta përdëftuar këtë, përshkrimi i sistemit vijor (segmentor, linear) veçmas të të folmeve geqe në të ardhmen duhet bërë si nga aspekti fonetik, ashtu edhe nga ai fonologjik.

Fonetikanët kanë shpjeguar prej kohësh se hundorësia shtrihet si ndër zanoret që i prijnë ashtu edhe ndër ato që ndjekin një bashkëtingëllore hundore. Ky hundorëzim është fryt i përshtatjes nyjetimore të zanoreve nën ndikimin e bashkëtingëlloreve në kontakt, i përzierjes së fazës së fundit të tingullit paraprak me fazën e fillimit të tingullit pasues, përkatësisht të ndryshimeve kombinatorë që shkaktohen për shkak të akomodimit të organeve të të folurit (Hamiti, Asllan, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, Interdiskont, 2005, f. 218-220). Zanojta /ë/ e theksuar nuk bën pjesë në inventarin vokalik të të folmeve geqe, ndërsa /o/-ja nuk i nënshtrohet ligjit të hundorësisë. Prandaj, nëpër të folmet geqe me hundorësi mund të dëgjojmë 6 zanore /i/, /ÿ/, /ø/, /ê/, /â/, /û/ e më pak.

Siç dihet, në të folmet e gegërishtes shqiptohen me timbër hundor ato zanore që gjenden ose dikur janë gjendur në pozitë para bashkëtingëlloreve hundore [m, n, nj], sipas skemës *zanore + bashkëtingëllore hundore > zanore hundore* ([a] + [n] = [â] = /â/).

Është pranuar nga të gjithë se zanoret hundore, krahas atyreve gojore dikur kanë qenë të mbarë shqipes, me intensitet më të ulët në të folmet e gegërishtes dhe me intensitet më të lartë në ato të toskërishtes, por në një fazë të zhvillimit të saj, në të folmet e Jugut rotacizmi (shndërrimi i /n/-së ndërzanore në /r/, që ka vepruar para më se 1300-1500 vjetësh) shkaktoi edhe çhundorëzimin e zanoreve (Demiraj, Shaban, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996).

⁸⁰ AShSh, *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, vëllimi I, Napoli, 2007; vëllimi II, Napoli, 2008.

Ka zanore me hundorësi në këto pozicione: a) përpara bashkëtingëlloreve hundore; b) pas bashkëtingëlloreve hundore; c) në mes dy bashkëtingëlloresh hundore; ç) kur pas zanores ka qenë një bashkëtingëllore hundore që ka rënë; d) hundorësi për ngjashmëri (analogji).

Në përshkrimin dialektor të çdo të folmeje geqe kundërvënia e fonemave zanore të theksuara hundore me fonemat gojore duhet parë në çifte minimale fjalësh, si p.sh.:

/a:/ ~ /ā:/ *ha:n* (ata hanë) ~ *hā:n* "hënë", *va:th-i* ~ *vā:th-t* "vëthët";

/ā:/ ~ /a:/ *kā:m* "këmbë" ~ *kam* (unë), *hā:n* "hënë" ~ *han* (ai ha), *atā* "atë" ~ *ata*, *ktā* "këtë" ~ *cta* "këta";

/ā/ ~ /ā/ *lām* (ne) "lam" ~ *lā:m* "lëmë", *kān* "kanë" ~ *kā:n* "kënë";

/e:/ ~ /ê:/ *ve:* "vezë" ~ *v ê:* "(unë) vë";

/i/ ~ /ī:/ *mi* (djemt e) "mi" ~ *mī:* "miu" etj., por ato mund të jenë të ndryshme nga një e folme në një të folme tjetër.

Në qoftë se një e folme ka çifte të tilla ose të ngjashme fjalësh, atëherë mund të nxirret përfundimi se ajo e folme, përveç gojoreve, ka fonema të veçanta hundore, që krijojnë edhe seri fonemash më vete, të cilat mund t'i quajmë zanore hundore. Nga ana tjetër, nëse nuk kemi çifte fjalësh të tilla, rrjedhimisht realizimet e zanoreve me timbër hundor janë variante kombinatorë të fonemave përkatëse gojore, ato nuk krijojnë seri të posaçme fonemash dhe mund të quhen zanore të hundorëzuara.

Megjithëse shqiptimi i ndërhuandshëm i zanoreve në të folmet Veriore të shqipës ka tërhequr vëmendjen e shumë gjuhëtarëve shqiptarë dhe të huaj, prapë kanë mbetur pa u sqaruar përfundimisht disa çështje të rëndësishme:

Cilat të folme geqe kanë fonema zanore hundore e cilat kanë zanore të hundorëzuara?

Çfarë inventari vokalik kanë të folmet veç e veç?

Çfarë kundërvëniesh krijojnë ato me zanoret e tjera hundore e gojore?

Çfarë shkalle të hundorësisë kanë ato?

Vallë në gjendjen e sotme hundorësia e zanoreve në të folme të veçanta geqe është defonologjizuar apo jo?

A formojnë zanoret hundore në mbarë gegërishten seri zanoresh më vete apo diku janë variante kombinatorë të zanoreve përkatëse gojore?

Nuk mëtojmë se mund të japim përgjigje në këto çështje, por po i parashtrojmë si një nga detyrat që duhet zgjidhur në të ardhmen me një bashkërendim të punës, jo vetëm për këtë problematikë, por edhe për çështje të tjera të dialektologjisë e të gjuhësisë shqiptare në përgjithësi.

Bie fjala, ka mundësi të hartohet një pyetësor dialektor i veçantë për vjeljen e materialit në fushën e fonetikës e të fonologjisë, në të cilin do të përfshihen pyetje për kundërvëniet fonologjike të zanoreve sipas mungesës ~ pranisë së hundorësisë dhe ai të bëhet publik në një faqe elektronike në Internet. Materialet e siguruarat përmes kësaj forme të grumbullohen, sistematizohen dhe përpunohen, natyrisht duke u mbështetur edhe në të dhënat që mund të sigurohen edhe nga punimet e deritashme si dhe nga Atlasi dialektologjik i shqipës.

Në studimet e deritashme dialektore për të folme të veçanta geqe vërehet një larmi e madhe. Kjo laryshi është e natyrishtme po të kihet parasysh se:

a) Përshkrimi i të folmeve tona është bërë brenda një periudhe kohore 50-60 vjeçare, kryesisht pas Luftës së Dytë Botërore e deri më tani.

b) Një numër jo i vogël gjuhëtarësh janë marrë me studime dialektore në fazën e hershme të pjekurisë profesionale.

c) Gjatë vjeljes së materialit dialektor dhe përpunimit të tij janë përdorur metoda kërkimore-shkencore të ndryshme.

ç) Veshi ka qenë dhe vazhdon të jetë edhe sot e kësaj dite aparati i vetëm i përshkrimit të të folmeve tona.

d) Sistemi tingullor në disa përshkrime të folmesh është paraqitur shkarazi, vetëm në aspektin fonetik, ndërsa mungon pikëpamja fonologjike.

Fjala vjen, mund të lexojmë përshkrime të folmesh gege ku thuhet se “akëcila e folme përveç zanoreve gojore ka edhe zanore hundore”, por nuk jepen çifte minimale fjalësh për të përdëftuar vlerën fonologjike të tyre, e as nuk saktësohet inventari i fonemave zanore. Është e vërtetë se çdo e folme gege ka zanore të hundorëzuar. Pra, mungon vështrimi fonetiko-eksperimental (deri më tani kemi vetëm një të këtij lloji për të folmen e Shkodrës) dhe ai fonologjik (me disa përjashtime). Kuptohet se vëzhgimet eksperimentale kërkojnë mjete teknike ndihmëse të posaçme, laborator të fonetikës eksperimentale, të cilin fatkeqësisht nuk e kemi as në Shqipëri, as në Kosovë e as në Maqedoni. Për këndvështrimin fonologjik të sistemit tingullor të të folmeve lipset një përgatitje e nevojshme teorike dhe një përkushtim e punë serioze, veçmas tani kur literatura përkatëse teorike (Dodi, Anastas: *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, IGjL, Tiranë, 2004); dhe modelet e mira të monografive dialektore nuk mungojnë (Shkurtaj, Gjovalin: *E folmja e Rranxave të Mbishkodrës, Dialektologjia shqiptare IV*, IGjL, Tiranë, 1982, f. 144-278).

Praktikisht, për çdo të folme fonemat duhet identifikuar nëpërmjet kundërvënieve fonologjike (kuptimdalluese ose gramatikore).

Prania e hundorësisë së zanoreve është vërtetuar në shumicën e të folmeve të nëndialektit të gegërishtes veriore, si në grupin veriperëndimor ashtu edhe në grupin verilindor, si në të folmen e Shkodrës, Nikaj-Mërturit, të Krasniqes, të Gashit e Bytyçit, të Tropojës, të Hasit, të Rugovës, në të folmen e Lugut të Drinit të Bardhë, të Zhurit të Prizrenit, të Drenicës, të Shalës së Bajgorës, të Gollakut, të Ferizajt, të Gjilanit, të Kaçanikut etj. Edhe akademik Idriz Ajeti me të drejtë konstaton se “rëndom thuhet se e folmja e Shkodrës ka mjaft hundorësi sekondare. Më në fund, kjo është njëra ndër çështjet më të ndërlikuara të gramatikës historike të të folmeve gege, ku numri i shembujve të çhundorëzimit nuk është i vogël. Për të ndriçuar deri diku hundorësinë e tyre, është e nevojshme një analizë e veçantë e çdo zanoreje ose fjale...”⁸¹

Përgjithësisht, në të folmen e skajshme të etnisë: të Preshevës, të Bujanovcit, të Ulqinit, të Llapit e Gollakut si dhe në të folmet lindore të gegërishtes qendrore (veçmas ato të Maqedonisë) hundorësia e zanoreve është defonologjizuar, përkatësisht aty më nuk mund të gjejme çifte minimale fjalësh me kundërvënie zanore gojore me zanoren hundore përkatëse.

Nga leximi i punimeve përshkruese të të folmeve gege, lidhur me hundorësinë e zanoreve nuk mund të përftohet pasqyrë e qartë: në disa përshkrime dialektore fitohet ideja se hundorësia e zanoreve ka vlerë fonologjike, ndërsa në disa punime të tjera nuk janë sjellë dëshmi të mjaftueshme për ta pohuar ose për ta mohuar atë. Gjatë punës sonë në të ardhmen nuk duhet të kënaqemi vetëm me konstatimin se “në një të folme gege dëgjohen

⁸¹ Idriz Ajeti, *Studime dialektore dhe etimologjike*, AShSh, Tiranë, 2005, f. 33.

apo nuk dëgjohen zanore hundore”, kur dihet se hundorësia fonetike e zanoreve është veçori e përgjithshme e dialektit Verior, por duhet analizuar vlera fonologjike e tyre, duhet përcaktuar inventari vokalik me: a) serinë e zanoreve gojore të shkurtra, b) serinë e zanoreve të gjata, dhe c) serinë e zanoreve hundore. Gjithsesi, mendojmë se çështja e shtrirjes së hundorësisë së zanoreve, e përcaktimit të inventarit të këtyre fonemave nëpër të folme të veçanta, e intensitetit të saj, e vlerës fonologjike të hundorësisë si dhe shumë dukuri të tjera duhet rishqyrtuar.

Për gjendjen e sotme të studimeve dialektore në përgjithësi mund të thuhet se shkalla e hundorësisë së zanoreve bashkëpërkon me shtrirjen gjeografike të tyre: sa më në veri që janë, hundorësia është aq më e madhe dhe anasjelltas. Kështu, në të folmet e nëndialektit verior të gegërishtes kemi një hundorësi me intensitet të lartë, ndërsa në nëndialektin e gegërishtes jugore kemi një shkallë më të ulët hundorësie. Zaten, po të duam të krahasojmë të folmet e Kosovës me të folmet shqipe të Maqedonisë, sipas një shkallëzimi hundorësie, duke filluar nga një shkallë më e lartë e përfunduar me një shkallë më të ulët, afërsisht do të kishim edhe një zbritje gjeografike veri – jug: të folmet e Kosovës, të Preshevës e Bujanovcit, të folmet e Kumanovës, të Shkupit, të Tetovës, të Gostivarit, të Kërçovës, të Dibrës dhe të Strugës. Në këto dy të folmet e fundit pothuajse nuk dëgjojmë fare zanore me timbër hundor. Por, ashtu si për gjatësinë e zanoreve, edhe për shkallën e hundorësisë fjalën e fundit mund ta thotë vetëm analiza laboratorike, ndërsa vlera e tyre fonologjike duhet provuar me metodën e zëvendësimit (komutacionit).

Të folmet geqe në çështjen e hundorësisë së zanoreve tani gjenden në një fazë kalimtare. Te të gjitha ka prirje për defonologjizimin e hundorësisë së zanoreve. Nga punimet dialektore që na kanë rënë në dorë, kemi fituar përshtypjen se të folmet e nëndialektit jugor të gegërishtes po shkojnë drejt çhundorëzimit dhe në këtë proces prijnë të folmet shqipe të Maqedonisë, ku hundorësia e zanoreve është defonologjizuar, ndërsa gjatësia e tipit fonologjik ende ruhet (sidomos në saje të mosshqiptimit të [ë]-së fundore). Në nëndialektin verior të gegërishtes aty-këtu (por jo gjithkund) vlera fonologjike e hundorësisë së zanoreve ende ruhet.

Përfundim

Si përfundim, nga monografitë, nga punimet dialektore për të folmet e gegërishtes që i kemi konsultuar gjykojmë se hundorësia e zanoreve në të folmet e gegërishtes është përzjerje e sistemit të vjetër të trashëguar me zanore hundore që janë fonema më vete, me tipin e ri të hundorësisë jofonologjike. Edhe brendapërbrenda gegërishtes dallimi fonologjik i zanoreve gojore me zanoret hundore nuk është dukuri e përgjithshme, sepse nëpër të folme ka larmi. Ajo ka filluar të lëkundet dhe gjithnjë e më pak mund të gjenden çifte minimale fjalësh, te të cilat një zanore gojore i kundërvihet një zanoreje hundore.

Në ndërgjegjen e folësve nuk është gjithnjë e qartë vlera e hundorësisë. Kjo tregon se gegërishtja në çështjen e hundorësisë së zanoreve gjendet në një fazë kalimtare: pjesa më e madhe e të folmeve të nëndialektit verior gegë e ruan tipin fonologjik të hundorësisë, ndërsa një numër i madh i të folmeve të nëndialektit të gegërishtes jugore, prijnë të folmet shqipe të Maqedonisë, kanë evoluuar në tipin fonetik të hundorësisë. Edhe atje ku ruhet kundërvënia fonologjike e mungesës kundruall pranisë së hundorësisë së zanoreve në saje të traditës, vlera fonologjike po zbehet. Në mjaft krahina të Gegërisë dallimi

zanore gojore ~ zanore hundore është rrafshuar. Fjalët janë kthyer në homofone, duke ia lënë kontekstit diferencimin e kuptimit.

Recensentë:

Prof. dr. Zeqirja Neziri, Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare, Universiteti i Shkupit
Prof. dr. Avzi Mustafa, Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare, Universiteti i Shkupit

Literatura:

- AShSh, *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, vëllimi I, Napoli, 2007; vëllimi II, Napoli, 2008.
- Gjinari, Jorgji – Shkurtaç, Gjovalin: *Dialektologjia*, ShBLU, Tiranë, 1997, 2000.
- Beci, Bahri, Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës, IGjL, Tiranë, 1995.
- Hamiti, Asllan: *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit*, Shkup, 1999 (disertacion doktorati në dorëshkrim, 293 f.).
- Hamiti, Asllan, Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe, Shkup, Interdiskont, 2005.
- Demiraj, Shaban, Fonologjia historike e gjuhës shqipe, Tiranë, 1996.
- Dodi, Anastas: Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe, IGjL, Tiranë, 2004.
- Trubeckoi, N. S.: *Parime të fonologjisë*, Rilindja, Prishtinë, 1985.
- Shkurtaç, Gjovalin: *E folmja e Rranxave të Mbishkodrës*, Dialektologjia shqiptare IV, IGjL, Tiranë, 1982, f. 144-278;
- Beci, Bahri, Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës, IGjL, Tiranë, 1995.
- Qemal Murati, *E folmja shqipe e rrethit të Tuhinit të Kërçovës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 3-113.
- Fadil Sulejmani, *E folmja e Malësisë së Sharrit të Tetovës*, Tetovë, 2006.
- Fehim Reçani, Të folmet shqipe të Pollogut, Shkup, 2001.
- Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997.
- Carlo Tagliavini, *Të folmet shqipe të tipit të gegërishtes lindore*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 105-152.
- Mustafa Ibrahim, *E folmja shqipe e rrethit të Prilepit dhe Krushevës*, Interlingua, Shkup, 2005.
- Naim Basha, *E folmja e qytetit të Dibrës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 137-221.
- Petar Skok, *Hulumtime gjuhësore te popullsitë joslave të luginës së Shkupit*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 81-152.
- Mulaku – Mehdi Bardhi, *Mbi të folmen shqipe të Peshterit*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 275--325.
- Mehmet Halimi, *Disa tipare të së folmes së Moravës së Epërme*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 353-401.
- Mehmet Halimi, *Disa tipare të së folmes së Moravës së Poshtme*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 403-450.
- Idriz Ajeti, *Studime dialektore dhe etimologjike*, ASHSh, Tiranë, 2005, f. 33.
- Hasan Kelmendi, *Disa veçori morfologjike të së folmes së lokalitetit të Turiçevcit*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 453-478.
- Abdullah Zyberi, *Vëzhgime mbi të folmen e fshatrave të Lugut të Drinit të Bardhë*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 481-501.
- Fadil Raka, *E folmja e qytezës së Kaçanikut*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 503-543.
- Tafil Kelmendi, *Sistemi foljor i së folmes së Balincës*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 545-569.
- Mehdi Bardhi, *Disa veçori karakteristike në vokalizmin e së folmes së Hasit*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 115-135.
- Mehmet Ahmetaj, *E folmja shqipe e Plavës dhe e Gucisë*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 223-342.
- Sejfedin Haruni, *E folmja shqipe e Rekës së Epërme të Gostivarit*, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1994.

TOPONOMIA DHE MIKROTOPONOMIA E REKËS SË EPËRME

Avzi Mustafa

Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare
Fakulteti i Filologjisë "Blazhe Koneski" – Shkup

Studiues të ndryshëm krahinën e Dibrës e ndajnë në dy pjesë, në Dibrën e Epërme dhe Dibrën e Poshtme. Një ndarje të këtillë bën edhe Myler, i cili gjithashtu e ndan atë në dy krahinë, në Dibrën e Epërme dhe Dibrën e Poshtme⁸².

Në Lindje të Dibrës, rrethuar nga malet Korab, Velivar dhe Kërçin, në të dyja anët e lumit Radika, shtrihet një krahinë shumë e bukur e magjepsëse, me shumë ujë, kullota të shumta, lisa e klimë të mirë.

Në këtë krahinë, gjegjësisht në fshatrat e Rekës, jetonin shqiptarë që i përkisnin besimit të krishterë ortodoks, të cilët më vonë një pjesë u konvertuan në myslimanë, por të gjithë ishin shqiptarë. Kjo përçarje ishte rezultat i shumë grabitjeve e sulmeve të ndryshme, që zgjatën deri në shekullin XX. Masakrimet, djegjet e vjedhjet bënë, ashtu siç shkruan një gazetë, "...u shkret fare prej rrëmbimesh.... rrembjein, repin, pjekin". Prandaj ata filluan të quhen të shkretë (Shkretë)⁸³.

Fshatrat e kësaj zone janë të vendosura në shpatet e malit Korab dhe të maleve lidhur me të, si malet e Kabashit (2395 m), Bradasit (2168m), Lerit (2197m), Ostricës (1717m) dhe malit të Kus-Babait (2200m).

Territori i Rekës së Epërme përfshin rrjedhën e epërm të Lumit Radikë, ku janë të vendosura 16 fshatra: Beliçica, Bibaj, Bogdi, Grekaj, Kiçinica, Krakornica, Nishtrova, Niçpuri, Nivishta, Rimnica, Senca, Tanushaj, Vau, Valkovia, Vërbeni, Zhuzhnja, Dufi, Stezimiri, Reçi, Spiroglica, Bibaj, Grekaj e etj. Përgjatë rrjedhës së epërme të lumit Radikë dhe në shpatet e maleve shtrihen së paku 17 fshatra të banuara me popullsi shqipfolëse. Kjo krahinë e vogël nga veriu kufizohet me malin Vraca dhe Republikën e Kosovës, nga lindja me malet Bistrica e Kozhuf dhe Liqenin e Mavrovës, nga jugu mbaron me fshatin Sencë, i cili shtrihet në anën e majtë të lumit Radikë dhe nga perëndimi ka përballë malin e Korabit dhe krahinën simotër të Lumës⁸⁴.

Rekën e Epërme, në bazë të një dokumenti të kohës, ku përmendet krahinë e Dibrës, e përmend Pukëveli, por edhe regjistrat turk të vitit 1467 e ndajnë gjithashtu krahinën e Dibrës në dy pjesë Dibra e Poshtme dhe Dibra e Epërme⁸⁵. Po ashtu kemi

⁸² Defteri i Dibrës dhe i Matit, Stamboll, dosje 508 pranë AIH të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

⁸³ "Shqypja e Shqypnis, Sofje, 21. 10.1909, nr. 10

⁸⁴ Nebi Dervishi Dëshmitë e Rekës shqiptare sipas regjistrimeve nëpër shekuj

⁸⁵ Cit. sipas R. Matotës, Josif Bageri, f. 4

shfrytëzuar edhe defterët e shek. XV- XVI, të përkthyer e të botuar nga Arkivi i Maqedonisë, të përkthyesve nga Dr. Aleksandër Stojanovski dhe Metodija Sokolovski, edhe pse nuk përjashtohet mundësia e subjektivizmit të përkthyesve dhe redaksive të tyre. Të dhënat janë për fshatrat: Beliçica, Bogdevo, Volkovi, Vërbena, Girqan, Kiçinica, Krakornica, Nishtrova, Niçipuri, Rimnica (Luminca siç e quajnë anasit), Senca dhe Zhuzhla ose Zhuzhnja. Për secilin fshat, në bazë të defterëve, do të japim një pasqyrë për vendbanimin dhe popullsinë, ashtu siç janë të shkruar, përkthyer dhe adaptuar në gjuhën maqedonase.

BELIÇICA – në regjistrimin e vitit 1467 është shënuar me emrin Bliçicë. Është fshat i krishterë, i pabanuar (hali). Shtrihet në verilindje të Dibrës dhe bënte pjesë në Nahinë e Rekës. Në vitin 1519 numëronte 18 familje; në vitin 1536-1539 janë regjistruara 18 familje, ndërsa në regjistrimin e vitit 1583 fshati futen në Nahinë e Rekës së Epërme (të Madhe), që bënte pjesë në sanxhakun e Ohrit dhe numëronte 30 familje të krishtera me 56 persona. Fshati posedonte 4 mullinj.

BOGDEVA – është fshat i krishterë dhe shtrihet në verilindje të Dibrës, në Nahinë e Rekës. Në vitin 1467 Bogdeva është “has” i Karagjoz beut dhe hyn në përbërje të Vilajetit të Rekës; në regjistrin e vitit 1467 është shënuar me emrin BOGDV. Në regjistrimin e vitit 1519, fshati është regjistruar me emrin BOGDEVË, me 16 familje të krishtera, që nuk ndryshojnë as në regjistrimin e vitit 1536-1539; ndërkaq në regjistrimin e vitit 1583 fshati shtrihet në Rekën e Madhe ose të Epërme, hyn në Nahinë e Rekës dhe bën pjesë në Sanxhakun e Ohrit. Fshati numëronte 10 familje të krishtera.

VOLLKOVA – në vitin 1467 fshati ka qenë derven e i krishterë; shtrihet në verilindje të Dibrës, i takonte Nahisë së Rekës. Në defterin themeltar të këtij viti është regjistruar në kuadër të Vilajetit të Rekës si “has” i “zaimit”. Pra, bënte pjesë në Zaimet e Rekës së Karagjoz Beut dhe numëronte 6 familje të krishtera. Në regjistrimin e vitit 1519 i ka të regjistruara 13 familje të krishtera. Fshati Vollkovi në vitet 1519-1583 ishte derven, shtrihet në Rekën e Epërme ose të Madhe, pranë fshatrave Tërnicë e Debovë (fshat i zhdukur). Edhe në regjistrimin e vitit 1583 fshati Vollkovi është fshat derven, që bën pjesë në Nahinë e Rekës.

GIRQANI ose **GREKAJ** – është fshat i krishterë. Shtrihet në verilindje të Dibrës dhe bënte pjesë në Nahinë e Rekës, në kuadër të Sanxhakut të Ohrit. Në regjistrimin e viteve 1536-1539 fshati ka të evidentuar 11 familje, ndërsa në vitin 1583 fshati numëronte 20 familje dhe ka pasur 2 mullinj, që kanë punuar tërë vitin.

VËRBENI – shtrihet në verilindje të Dibrës dhe bënte pjesë në Nahinë e Rekës. Në vitin 1467 fshati ka numëruar 9 familje të krishtera, me 722 akçe të ardhura dhe ishte “has” i Karagjoz Beut. Është shënuar me emrin VIRBNI. Në regjistrimin e vitit 1536/39 fshati numëronte 93 familje të krishtera dhe 1 familje myslimane. Në defterin osman për Sanxhakun e Ohrit të vitit 1583, mes tjerash, thuhet se: “fshati është i evidentuar me emrin VIRBEN me 50 familje të krishtera dhe 20 familje myslimane, prej të cilave 13 të islamizuara; fshati shtrihet në verilindje të Dibrës, ndërmjet fshatrave

Shtirovicë dhe Sencë.” Me këtë regjistrim fshati ka numëruar 165 persona ose 120 familje të krishtera.

KIÇINICA – është derven dhe kryesisht i krishterë. Ai shtrihet në verilindje të Dibrës, në Nahinë e Rekës. Në vitin 1467 ka qenë i shkretuar e i pabanuar, ndërkaq në vitin 1519 fshati ishte mera dhe në të ishin vendosur 8 familje të krishtera. Pra, fshati shtrihet në Rekën e Epërme (të Madhe). Në regjistrimin e vitit 1583 fshati Kishnicë është derven dhe ka ruajtur e mirëmbajtur rrugën Tetovë-Dibër dhe i takon Nahisë së Rekës që hynte në Sanxhakun e Ohrit dhe ka të evidentuar 12 persona ose 6 familje të krishtera.

KRAKORNICA – është fshat i krishterë dhe shtrihet në verilindje të Dibrës, në Nahinë e Rekës. Në vitin 1467 fshati ka qenë “has” i Karagjoz Beut dhe bënte pjesë në Vilajetin e Rekës. Ai ka numëruar 3 familje të krishtera. Në vitin 1519 fshati ka numëruar 12 familje çifte të krishtera. Në regjistrimin e vitit 1583 fshati Kakornicë është në kuadër të Nahisë së Rekës, që shtrihet në verilindje të Dibrës në kuadër të Sanxhakut të Ohrit. Fshati ka numëruar 33 persona, 1 familje jobsimtare, 20 familje të krishtera dhe aty ka punuar 1 mulli .

NISTROVA – është fshat i krishterë dhe shtrihet në verilindje të Dibrës në Nahinë e Rekës. Në Vitin 1467 Nistrova është “has” i Karagjoz Beut, bënte pjesë në kuadër të Vilajetit të Rekës dhe numëronte 11 familje të krishtera. Në regjistrimin e vitit 1519 fshati është evidentuar me emrin NSTROVË dhe ka numëruar 36 familje të krishtera. Në vitin 1583 fshati Nistrovë, hyn në përbërje të Nahisë së Rekës, në kuadër të Sanxhakut të Ohrit. Numëron. Ai numëronte 83 persona, 70 familje të krishtera dhe ka pasur 3 mullinj që kanë punuar tërë vitin.

NIÇPURI – është fshat i krishterë dhe shtrihet në verilindje të Dibrës. Ai bën pjesë në kuadër të Nahisë së Rekës. Në vitin 1467 është “has” i Karagjoz Beut dhe ka qenë në kuadër të Vilajetit të Rekës. Në regjistrimin e vitit 1536/39 fshati ka numëruar 16 familje. Në vitin 1583, fshati Niçpur është në kuadër të Nahisë së Rekës në Sanxhakun e Ohrit, numëronte 28 persona, 20 familje, 2 tjerretore leshi dhe 1 mulli.

RIBNICA – është fshat i krishterë në Nahinë e Rekës dhe shtrihet në verilindje të Dibrës. Në shek. XV-XVI kanë qenë dy fshatra fqinje, Ribnica e Madhe (Byjuk Ribnica) dhe Ribnica e Vogël (Kuçuk Ribnica). Në vitin 1467 Rimnica e madhe numëronte 10 familje, në vitin 1536/39 fshati ka të evidentuar 34 familje të krishtera, ndërsa në regjistrimin e vitit 1583 Ribnica e Madhe nuk është e evidentuar. Si duket, ato vite ajo u bashkua me Rimnicën e Vogël.

RIBNICA E VOGËL (Kuçuk Ribnica) – është fshat i zhdukur dhe shtrihet në verilindje të Dibrës në Nahinë e Rekës. Në vitin 1467 është evidentuar me emrin Ribicicë dhe ka numëruar 4 familje. Në regjistrimin e viteve 1536/39 është shënuar me emrin Ribicica e Vogël dhe ka pasur 42 familje, mes tyre 1 familje muslimane. Ndërkaq në regjistrimin e vitit 1583 fshati nuk është evidentuar ose së paku mund të jetë i evidentuar me emër tjetër.

SENCA – është kryesisht fshat i krishterë dhe shtrihet në verilindje të Dibrës në Nahinë e Rekës. Në vitin 1467 në regjistrer është shënuar me emrin SENÇI. Ka qenë “has” i Karagjoz Beut, ka numëruar 4 familje, ka pasur 1 mulli. Në vitin 1519 fshati i ka evidentuar 42 familje të krishtera e 1 familje muslimane. Regjistrimi i vitit 1583 për fshatin Sencë është i plotë. Fshati është në kuadër të Nahisë së Rekës, në Sanxhakun e Ohrit. Ai numëronte 42 persona ose 30 familje.

ZHUZHLE – është fshat i krishterë në Nahinë e Rekës. Në vitin 1467 fshati është “has” i Karagjoz Beut, në përbërje të Vilajetit të Rekës. Në këtë regjistrim ka 5 familje dhe 2 mullinj. Në vitin 1519 fshati i ka numëruar 14 familje të krishtera dhe shtrihet në Rekën e Madhe (Epërme) pranë fshatit Nistrovë.

Në bazë të regjistrimit, që është kryer nga përfaqësues të shtetit bullgar në fillim të viteve 1900-të, në fshatrat e Rekës kemi 2861 shqiptarë ortodoksë dhe 2262 shqiptarë të fesë myslimane. Interesant është fakti se në Rekë kemi tre fshatra që banoreshin nga shqiptarët ortodoks, si në Z'LVAJSKO, KIÇENICA, BELIÇICA dhe tre fshatra të banuara vetëm nga shqiptarë myslimanë, si: SHTIROVICA, 400 shqiptarë mysliman, STROJÇA me 300 shqiptarë myslimanë dhe TANUSHA me 350 shqiptarë myslimanë. Për Shtirovicën kemi dëshmi edhe nga Bajazid Doda dhe Nopça.⁸⁶

Më poshtë po sjellim emrat e fshatrave që kanë banuar shqiptarët ortodoks të Rekës ashtu siç janë shkruar nga autorët bullgarë, serb dhe grek duke ruajtur origjinalitetin e tyre:

1. V'RBEN, ka pasur 300 shqiptarë ortodoksë dhe 360 shqiptarë myslimanë
2. V'LKOVIIJA, 150 shqiptarë ortodoksë dhe 150 shqiptarë myslimanë
3. GREKANE, 25 shqiptarë ortodoksë dhe 14 shqiptarë myslimanë
4. Z'LVAJSKO, 35 shqiptarë ortodoksë
5. ŽUŽNE, 150 shqiptarë ortodoksë dhe 160 shqiptarë myslimanë
6. KIČENICA, 120 shqiptar ortodoks
7. BELIČICA, 450 shqiptar ortodoks
8. BIBANE, 32 shqiptarë ortodoksë dhe 90 shqiptarë myslimanë
9. BOGDEVO, 180 shqiptarë ortodoksë dhe 108 shqiptarë myslimanë
10. BRODEC, 360 shqiptarë ortodoksë dhe 150 shqiptarë myslimanë
11. NIVIŠTA, 170 shqiptarë ortodoksë dhe 180 shqiptarë myslimanë
12. NISTROVO, 150 shqiptarë ortodoksë dhe 230 shqiptarë myslimanë
13. NIČPUR, 250 shqiptarë ortodoksë dhe 220 shqiptarë myslimanë
14. D'BOVO, 24 shqiptarë ortodoksë dhe 90 shqiptarë myslimanë
15. REČ, 150 shqiptarë ortodoksë dhe 140 shqiptarë myslimanë
16. RIBNICA, 120 shqiptarë ortodoksë dhe 200 shqiptarë myslimanë
17. SENCE, 195 shqiptarë ortodoksë dhe 120 shqiptarë myslimanë

Sa i përket Rekës së Epërme, kjo trevë shqiptare me popullsi autoktone shqiptare është dyndur shumë herë nga vatrat e veta. Dyndjet e këtyre banorëve kanë kaluar në katër faza. Këto fshatra denbabaden kanë gjallëruar, mirëpo shkaqet

⁸⁶ Bajazit Doda dhe Nopça, Jeta fshatare shqiptare ne Rekën e Epërme, Tetovë, 2012

ekonomike benë që lëvizja migruese të bëhet brenda trojeve shqiptare për të kërkuar të ashtuquajtur “tokë pa zot”.

Sa i përket Rekës së Epërme dyndjet e para filluan menjëherë pas vdekjes së Skënderbeut. Këtë mendim e arsyetoj me një citat të nxjerr nga Marin Baleti: “Për besnikërinë dhe trimëritë e shumta dhe të shënuara që banorët kishin treguar për hir të mbretërisë së t’et, Gjonit në kohën kur i binte në qafë Otomani”⁸⁷. Mirëpo dyndja më e madhe e këtyre fshatrave filloi në shekullin XVIII, pas humbjes së një lloj autonomie të fituar më 1467. Nga një defter turk kuptojmë se figurojnë të boshatisura 13 fshatra, të cilat u vendosën rreth malit të Thatë dhe në Karshiakë e deri në Veles, ku ata tani formojnë një kurorë të fshatrave të migruara nga Reka e Epërme.

Sipas disa të dhënave, deri në vitet e ’60-ta të shekullit XIX Reka e Epërme fliste vetëm shqip. Këtë e na e përshkruajnë më së mirë udhëpërshkruesit bullgarë. Sipas profesorit universitar të Sofjes, Jordan Ivanov: “Popullsia shqiptare e Gostivarit, e krishtera, është bullgarizuar në kontakt me bullgarët”⁸⁸.

Mizoritë me format më të ulëta, si: përdhunimet, plaçkitjet, djegiet, vrasjet e torturat, që i kjo popullatë përjetoi më së miri i përshkruan Edit Durhami,⁸⁹ e sidomos shkrimtari Haki Stërmilli, i cili i ka parë me sytë e tij dhe i ka përjetuar këto skena ferri. Ai do të shkruajë se: “terri i natës ishte zhdukur nga drita e zjarrit të katundeve të djegun prej serbëve ...”⁹⁰.

Studiuesi Hamit Kokallari kur bën fjalë për vendbanimet shqiptare ortodokse në viset lindore, gjegjësisht për Rekën e Epërme, pyet: “Përse në shumë katunde të Shqipërisë etnike lindore (Maqedoninë Perëndimore), sikur kam mundur të vërtetoj vet, pleq e plakat e folshin me droe shqipen tonë me një të folme të kthjellët e të kullueme, kur mirshin vesh se ai qi kuvendonte me ta nuk ishte bullgar ose tjetër kush përveç shqiptar” që më pas të përgjigjet: “Vetëm puna, pse ata pleq e plaka na e folshin me dashje e me sy të përlotun shqipen”⁹¹. Dyshimi i tyre ishte sepse të huajit më qëllime të caktuara i “masakrofshin pa mëshirë në shtëpitë e tyre natën”⁹². Kësaj popullate askush nuk i doli në ndihmë – ata mbetën gjatë gjithë historisë së tyre si të shkretë, andaj edhe sot e kësaj dite nga tjerët quhen të shkret “Shkreti”.

Për të zhdukur gjurmët e shqiptarëve të kësaj ane, përpjekjet nuk janë ndalur as në kohën e Jugosllavisë së Titos, kur pushtetarët maqedonas të përkratur nga disa antishqiptarë vazhdonin edhe më tej shkombëtarizimin e ortodoksëve shqiptarë⁹³. Me këtë rast po ofrojmë një dokument arkivor, që mban datën 4.12. 1967. Edhe pse shumica e shqiptarëve ishin shpërngul, ata që kishin mbetur në vitin 1967 kërkuar që në fshatin Sencë të mësojnë në gjuhën amtare. “Sivjet për here të parë prindërit nëpërmjet referendumit u deklaruan që mësimi të zhvillohet në gjuhën mësimore shqipe, duke mos u futur në zgjedhjen e kësaj çështje, megjithatë sjellja e disa shokëve nga Senca se ky akt nënkupton aksion që të shpërngulen maqedonasit nga Senca është i dëmshëm dhe për

⁸⁷ Marin Baleti. “Histori e Skënderbeut”, Vatra Shkup, 2004, f. 164

⁸⁸ Cit. sipas Mark Tirtës në vepren Echo de Bulgarie, Sofia, 1913, nr. 4 f. 12

⁸⁹ M. E. Durham, Njëzet vjet ngatërresa ballanike, Tiranë, 1944, f. 247

⁹⁰ Haki Stërmilli, Dibra në prag të historisë, Tiranë, 1940. f. 95

⁹¹ Arkivi Qendror Shqiptar, F. 203. Pa vit, D.1409, f. 21 cit, sipas Qerim Litës.

⁹² Po aty

⁹³ Qerim Lita, Disa burime arkivore për Rekën e Epërme, botuar në gazetën ditore Lajm.

lloj kritike⁹⁴. Çfarë absurdi – të gjithë ishin shqiptarë, por qëllimi ishte që popullsia me fe ortodokse të asimilohet dhe ata ia arritën qëllimit. Sot në tërë Rekën mund të gjesh vetëm turistë dhe barinj në stinën e verës.

Edhe pse nuk ka banorë që jetojnë ose ka shumë pak sosh, nga toka e Rekës del gjuha dhe vendi stërgjyshor i këtyre shqiptarëve. Këtë më së miri e dëshmon emërtimi i vendeve. Këtu do t'i japim vetëm ato që kemi mundur t'i evidentojmë, sepse në fakt kjo punë kërkon angazhim ekipor.

Makrotoponomia

Në klasifikimin e materialit nuk e kemi ndjekur asnjë kriter, por vetëm i kemi evidentuar, sepse qëllim ynë nuk është që të mbështetemi në kriteret e klasifikimit, as në prejardhjen e as në pikëpamjen shtresore e lesiko-semantike, por vetëm që të evidentohen ashtu si i përdorin banorët lokal dhe si janë të evidentuar në hartat topografike: Bgjeska e Rudovës, Bgjeska e Bistrës, Bgjeska e Kabashit, Bgjeska Vërbeni, Bgjesha e Vaut, Leri, Guri i Zi, Sutovica, Gjolet Karkornicës, Guri Kush, Guri Dashit, Vorri Shkaut, Stanet e Baltës, Bgjeska e Reçit, Gropza, Skrel. Guri i Markut, Kodra e Fudanit, Rast e Ngult, Gjini Voda, Golem Argat, Guri i Zi i Vogël, Çesma e Zhypit, Kodra e Made, Taume e Ali Baklavës, Krasta, Kulla e Asanit, Qafa e Kadisë, Strezimirski Çam, Kisha e Dingozit, Gun Gabash, Kushi Baba, Guri i Deplnis, , Kepi Bard, Guri i Zhytetit. Manastiri (ec), Korabi i Nistrovës, Cuselija,⁹⁵ Bgjeska Tuentes. Shumica e këtyre emetimeve janë shkruar në gjuhën maqedonase me deformime si grafike ashtu edhe drejtshkrimore, që sot me të vërtetë të kemi një kakokofoni të turpshme jo vetëm për shqiptarët, por edhe për vetë maqedonasit.

Mikrotoponomia

Kështu është bërë vetëm evidentimi i tyre sipas fshatrave dhe materiali është marrë nga njerëz, gjegjësisht bashkëbisedues drejtpërdrejt. Në vazhdim do t'i japim ashtu siç i quajnë këto mirkotoponime banorët lokalë në të folmen e tyre.

Duf: Guri i Xhinit, Uji i Zanave, Ajozma e Merzivecit, (edibe), Gropa e Shabanit, Bgjeska e Madhe, Bgjeska e Vogël, Kisha e Dingozit, Argaqi i Katunit, Korija i madh, Korija i Livadheve, Guri Cakut. Tolej, Brozovec, Çajane, Ballaban Jerqevish,⁹⁶ Grika, Sulo, Livadhi Karshi, Livadhi Garipit, Livadhi Torit, Te Arat e Dervishit, Te Arat e Izvorit, Te Lenishta, Te Rrafsha e Llambit, Te Bataranka, Te Kroj i Xhemës, Te Kroj i Gjonit, Te Guri i Kulenit, Te Jazi i Mullinit, Ujte e Mellcës, Te Prroi i Kojës⁹⁷.

Zhuzhnjë: Vorret e Llatinëve, Groshticë, Bigori i Nivishtes, Bgjeska e Nistrovës, Bgjeska e Tutens(Nopça), Gun Gubash, Sila Vort, Prrue i Likës, Alnishtë, Prroi Thell, Përroi i Bukovenit, Hurda te Zabelet, Klenjt⁹⁸

⁹⁴ ДАРМ – отделение Тетово, Ф. ОК на СКМ Гостивар, Извештај на Општинскиот комитет меѓу I и II Општинска конференција, Гостивар, 1967

⁹⁵ Map-cart, (www. Gorna Reka)

⁹⁶ Vitomir Tanaeski, 60 vjeç. I lindur nga fshati Vërben.

⁹⁷ Shahidie Ahmeti, e lindur në Duf, 86 vjeçare

⁹⁸ Enis Jakupi Reka – vendi im, Tetovë, 2007, f. 57

Niçipur: Shullo, Guri Gorit, Mulla Ambl, Kroj Ftoet, Fushija, Guri Stomit, Guri Shushes, Kumlla e Rediti, Guri Kush (Kuç), Vorret e Mlla, Kroj i Dullës, Kroj i Smilit, Darda e Made, Prroi i Panës, Ara e Alisë, Ura e Dubanes, Kroj i Verrinit, Llomba e Neselkut, Kroj i Similverit, Guri Shtjafit, Livadhi Kagjos, Guri Vërcakut, Bregu i Botës (dheut), , Guri i Katilit, Ara e Lagut, Kroj i Kustaret, Guri Zhypit. Kroj Elinaket, Kroj i Pecit, ⁹⁹. Kisha e Shumtanasit¹⁰⁰. Livadhet e Niçpurit, Guri i Shushesh, Ara e Ivanit, Guri i Katillit, Vorri i Gjurçinit, Kurti i Kishës

Bogdë: Kroj i Shushes, Reka e Endigos, Boget .Shavare, Vorri i Bibës, . Gorishta, Përroi i Folit, Pëçushta, Legala, Rrasa e Haxhisë, Livadhi i Gjurës, , Mërizi i Llopfve, Shpella e Madhe, Kandova, Llombet, Reçicat, Lugu i Priftit, Tallonbazi, Reshkia, Leret, Bgjeska e Bogdit, Livadhet e Tërshanës, Rrasa e Kushe, Ligatat e Shpatit, Çuka, Karapushi, Guri i Dardhishtës, Vorret Rimjan, Korja, Lloqet, Livadhi i Plakut, Bogëze¹⁰¹. Stani i Sadikut, Stani i Dairt, Merizi i Vjetër¹⁰², Kroj i Vanes

Beliçicë; Kroj i Madh, Kisha e Shumkollit, Korija, Ballaban, Brezovec, Goverdanik, Toljane, Korilja e Vjetër.

Krakornicë: Kroj Katundit. Gjolet e Karakornicës, Kisha e Endigos, Guri I Kojës , Shtëpia e Pashës, Guri i Kush, Livadhet e Pashës¹⁰³ . Tumba, Guri i Ukut, Gropsa, Guri i Dashit, Llomba, Dradha , Çeshma e Katundit, Çeshma e Sollomonit, Çeshma e Pashës, Çeshma e Nuses së Re, Skrel, Strazhnik, Guri Kush, Guri Bullit, Arat e Vasilit, Kaliba e Zhypit, Stogjet, Livadhet, Bigori, Vasilja, Krroi i Tomes, Llofka i Janes. Vau: Ujë të Vaut, Bgjeska e Vaut, Bulli Vau, Livadhi Madh, Guri Bigorit (Bigorski Kamen), Dedebeq, Zenelbeg, Bgjeska e Brodashit ¹⁰⁴. Guri Bunarit (Bunarski Kamen).Ligata e Madhe, Boge, Radovec, Tumba, Proska, Fudan, Rasilla, Livadhi i Nidës, Bunar, Bigori, Shpella e Helvës, Shpella e Shtirovicës, Guri Deshat¹⁰⁵

Vallkavija: Ura e Vallkavisë, Përroi i Thellë, Guri i Gostilës. Ara e Nelit, Kazana, Bandera, Ligata e Madhe, Delmna, Kroj i Ukut, Kroj i Madh, Rrafsha e Epërme, Kroj i Sharitun, Kroj i Ftoftë, Guri i Andonit, Gropa, Ara e Bilallit, Ara e Madhe, Vorret e Eperta, Murizi, Ara e Vegjisë, Kërçelja, Guri i Minit, Te Ara e Zheshkut, Guri Abazit, Sadoli, Ligata e Madhe, Dardhat e Brenit, Guri i Orlit, Kroj i Kakudës, Sllana, ¹⁰⁶

Sence: Ura e Shtremët, Qafa e Sencës

⁹⁹Enis Jakupi, Reka – vendi im, Tetovë, 2007

¹⁰⁰ Edibe Osmani, Rite e besime popullore ne viset e Tetovës dhe Gostivarit, Shkup, 1997

¹⁰¹ Lifet. K. Informator, Jeton në Gostivar, 51 vjeç, .Punon në Shkup në kompaninë "Life com" si patron i shitores për kadaif.në Gjorçe Petrov.

¹⁰² Life, K.po ai.

¹⁰³ Vitomir Taneski,

¹⁰⁴ Бајазид Дода & Франц Нопча, Албанскиот селски живот во Горна река кај Дебар (1914).

¹⁰⁵ Enis Jakupi, Reka Vendi im, Tetovë, 2007, f.54

¹⁰⁶Lifet. K. Informator, Jeton në Gostivar, 51 vjeç. Punon në Shkup në kompaninë "Life com" si patron i shitores për kadaif.në Gjorçe Petrov.

Gregaj: Përroi i Gregajt, Qafa e Belart(dalje për tu lidhur me fshatrat Gregaj dhe Tanushe ¹⁰⁷.

Tanushë: N'Pirg, Meniku, Skretec, Lisenj, Tri Sinure, , Guri i Arushës, Skretec, Bacili, laket Zhypet, Livadhet e Tanushës, Maja e Madhe, Guri i Lam, Hurdet, Laktar, Bregu i botës, , Ligatat e Medhaja, , Ligata e Tanushës, , Q(shaja)afa Barallavit, Kykul, Shall t' Rimnicëces, Krroi i Dushkut, Krroi i bregut, Krroi i Barallavit, Krroi i Ftohet, Krroi te Mullinjt, Krroi i Skrtecit, Krroi i Marleshit, Hurzet, Te Burimi, Bregu botës, Shpella e Dinkos, Shpella e mehmetit, Guri Kush (j), Guri i Memet, Guri Mexhit, Krroi Bibe, Ujt Kalar, Krroj Bibe, Te Jurukut¹⁰⁸

Nistrovë, Rrafshi i Madh, Bgjesaka e Nistrovës, Kodra e Kullës, Mali i Grabovës, Gunga e Bashës (Kjuselija), Kodra Kulla, Mali i Grabovës, Livadhet e Grabovës, Ara e Korabit, Pirgu Radomir, osog, Strung, Mollka, Kisavica, Livadhi i Priftit

Belicë: Bigori i Ternicës, Manisterishte, Kazan, Korija

Vërben: Livadhet e Turkut, Trauli, Livadhet e Traulit, Jonxha e Tanallarëve, Livadhi Hajdarit, Fusha e Llukovës, Bozhina, Guri i Damanit, Arat e Damanit, Krroi i ftoht te Bgjeska e madhe, Krroi i Markut, Krroi i Varaçes, Guri Hulës, Manastiri Kozha, Kozha e Vërbenit, Molla e ambëll (ogradë), Kroj i Vogël, Kryet e Livadhet, Ograda e Kryshes, Jonxha e Nazisë, Kisha e Vogël, Beli Kovaç, Ograda e Kostas, Ograda e Dojçit, Kroj i Hoxhës, Voret e Muslimaëve, Voret e ortodoksëve ¹⁰⁹. Mëlla e Epërme, Mëlla e Mjedisme, Mëlla e Poshtme.¹¹⁰

Shtirovicë: Kroj i Razhnikut, Fusha e Korabit, Belanxha, Stanet e Niçpurit, Rasa e nguljt, Ura e Torbeshve, (Torbeski Most), Qafa e Kadisë, Kuçi Baba, Guri Bardh, Guri zi, Stani i Baltës, Silanski Kamen, Mengallova Kulla, Karpa, Skalsi Rid, Guri Madh. Gropsa, Guri i Deplnis (Dhelpës), Kepi Bard (Bardh), Strezimirski Çam , Guri i Dutetit (Zhuteti,)Vorri Osmanit, Guri Kush.

Rimnicë: Pralluka, Shullo, Kroj i Xhamisë, Kroj i Shahides, Kroj i Shtutkajve, Shpella e Veljanit, Livadhet e Priftit, Guri Gjatë, Krroi i Ftohohëet, Krroi i Azemicës, Rrasat e Zeza, Vorret e Kondes, Ujt e Shumes, Vorret e Vashave, Guri i Shqypes, Skalica, Kunorçe, Ara e Gjatë, Ragapec, Mihavec, Gradinec, Bregu,

Leskova: Dikur ka qenë si lagje më vete afër Vaut. Ky fasht është boshatisur. Banorët e këtij fshati një pjesë janë shpërngul në Vërbjan dhe një pjesë në Jabollçishtë të Velesit.¹¹¹. Tani këtë fshat, siç thotë bashkëbiseduesi, e kanë zaptuar gjarpërinjtë, që dalin nga themelet e shtëpive. Aty kemi vetëm livadhe dhe i quajmë Livadhet e Leskovës, Përroi i Rimnicës.

¹⁰⁷ Бајазид Дода & Франц Нопча, Албанскиот селски живот во Горна река кај Дебар (1914),

¹⁰⁸ Enis Jakupi, ve. E cit. f. 61

¹⁰⁹ Vitomir Tanaeski, 60 vjeç. I lindur nga fshati Vërben

¹¹⁰ Vitomir Taneski

¹¹¹ Lifet. K. Informator nga Gostivari i lindur në Verbjan.

Reç: Hurdha e Idrizit, Bgjeska e Reçit, Kodra e Kulsit, Guri i Shtytrit, Ujmisht , Llukovo Pole,

Nishirova (Nikiforovo), Leunova. Në këto dy fshatra jeton një pjesë e shqiptarëve të Rekës së Epërme. Këto dy fshatra i takojnë Rekës së Vogël: Sendaktash, Golema Krasta, Crn Kamen, Izvorçe, Baçilishte, Zhezhnica, Radimost, Prisoj, Livada, Dukesh, Dominoo, Livajca, Jaori, Masllarica, Ogragje, Lekoec, Gjuroec, Petilep ¹¹².

Toponimet e Rekës së Epërme, si çdo toponimi tjetër, pasqyrojnë imazhin e vendit, të banorëve, të gjuhës, të historisë etj. Prandaj ne nuk do të ndalemi në këtë punim në klasifikimin e toponimeve ose në mbështetjen e klasifikimeve të ndryshme që ekzistojnë në literaturën shkencore, por do t'i ndaj toponimet e Rekës në toponime natyrore dhe në toponime kulturore. Pra, në toponime që pasqyrojnë reliefin e vendit dhe toponime që pasqyrojnë historinë e vendit, të cilat me gjuhën e tokës na dëshmojnë për autoktoninë tonë.

Ne bazë hartave dhe në botime të autorëve të ndryshëm, toponimet e Rekës së Epërme i gjejmë edhe me emra të ndryshëm si. p.sh, fshatin: Zhuzhnje e gjejmë si: Zhuzhnja, Zhezhen, Zhuzhnje; po shtu Verbjanë dhe Vrbjane; Gurin e Qytetit si: Guri Dutetit dhe si Zhutetit; Gurin e Kuq si Guri Kush; Shen Pjetrin si Shen Qetri. Ne Shtirovice toponimin Guri i Dhëlpnës si "Guri Delpnis", Gurin e Bardh si "Guri Bard", "Sila Vort" (tautologji interesante), pastaj Beliçicën si: Beliçica dhe Belçica, Bogdi si Bogdevë, Gryken si Grikë, Kepi Bardhë si "Kepi Bard" (Mapcarte) Valkovija si Volkovijë

Në botimet e ndryshme të autorëve të vendit dhe të huaj toponimet e Rekës së Epërme i gjejmë edhe në këto forma: fshatin Sence si SENÇI, Ribnicen si Rimnicë dhe si Luminicë¹¹³, Mllakin si Ligata, Gregejn si Girqani, Vaunën si Brodec, Kishën e Shën Nikollës si Kisha e Shumkollit, Kishën Shën Pjetrit si Kisha e Sheqentrit¹¹⁴, Bogdin si Bogdevo¹¹⁵.

Në këtë regjion sot ndeshemi me shumë toponimi të burimeve të ndryshme shqipe, romake, turke, sllave. Janë këto toponime të formuara me fjalë të parme, me parashtesa dhe prapashtesa, me parafjalë, me kompozita, por edhe më keq – edhe me përkthime prej një gjuhe në një gjuhë tjetër. Bashkëbiseduesit tim me inicialet Vitko T. më pohon: "se ne kur folim me të qetrat (të tjerit) i "rrotullojmë" (që to të thotë se i përkthejmë) aty ku mundemi. Kjo shihet qartë te toponimi që gjendet në Shtirovicë. Ai që e ka "rrotulluar" nuk e ka ditur se si i thonë çamit, andaj e ka bërë Stezimirski çam e jo Stezimirski bor"; "Mahija e Madhe" në vend të Nahisë së Madhe ose Gjini Voda për Uji i Gjinit, Kodra Made në vend të Kodra e Madhe etj. Është shumë interesant edhe një toponim që mendojmë se do të zgjojë interes dhe diskutim. Toponimi "Guri nguljt", me të cilin banorët lokalë të dikurshëm të Shtirovicës e quajnë vendin e tyre, kurse banorë të fshatrave përreth këtë toponim e emërtojnë si "Guri Shtrum" e dikush "Rasa ngult". Tani shtrohet pyetja se cili emërtim është i drejtë dhe si do të përdoret.

Duke përfunduar do të themi se duket se ka ardhur koha që toponimet të gjejnë zgjidhje të drejtë që ato të përdoren ashtu siç i emërtojnë banorët e vendit dhe të standardizohen.

¹¹² Danica Milloshevska, 59 vjeçe) e lindur ne Gostivar, por prindërit e saj janë nga Nikiforova.

¹¹³ Enis Jakupi, Reka – vendi im, një tjetër këndvështrim, Gostivar 2007

¹¹⁴ Edibe Osmani, Rite e besime popullore ne viset e Tetovës dhe të Gostivarit, Shkup, 1997

¹¹⁵ Sefedin Haruni, E folmja shqipe e Rekës së Epërme të Gostivarit, Shkup, 1994,

Ndryshe do të ndodhë ashtu siç i shkruan një mik Milan Kunderës, Hubel: “Për të asgjësuar popujt fillohet duke asgjësuar kujtesën e tyre. Shkartohen librat, kultura dhe historia e tyre. Dhe, dikush tjetër shkruan libra të tjerë, i përcjell një kulturë tjetër shpik për to një tjetër histori. Mbas kësaj populli fillon dalëngadalë ta harrojë atë që është dhe atë që kishte. Dhe, bota përreth tij harron më shpejt se akoma”.

Burimet:

Arkivi Qendror Shqiptar, F. 203. Pa vit, D.1409, f. 21 cit, sipas Qerim Litës.

Barleti Marin, “Histori e Skënderbeut”, Vatra Shkup, 2004, f. 164

Defteri i Dibrës dhe i Matit, Stamboll, dosje 508 pranë AIH të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

“Shqypja e Shqypnis, Sofje, 21. 10.1909, nr. 10

Dervishi Nebi, Dëshmitë e Rekës shqiptare sipas regjistrimeve nëpër shekuj

Doda Bajazit & Noqça Franc, Jeta fshatare shqiptare ne Rekën e Epërme, Tetovë, 2012

Durham, M. E., Njëzet vjet ngatërresa ballanike, Tiranë, 1944, f. 247

Jakupi Enis, Reka – vendi im, Tetovë, 2007

Haruni Sefedin, E folmja shqipe e Rekës së Epërme të Gostivarit, Shkup, 1994,

Lita Qerim, Disa burime arkivore për Rekën e Epërme, botuar në gazetën ditore Lajm.

Osmani Edibe, Rite e besime popullore ne viset e Tetovës dhe Gostivarit, Shkup, 1997

Stërmilli Haki, Dibra në prag të historisë, Tiranë, 1940. f. 95

ДАРМ – отделение Тетово, Ф. ОК на СКМ Гостивар, Извештај на Општинскиот комитет меѓу I и II Општинска конференција, Гостивар, 1967

Бајазид Дода & Франц Нопча, Албанскиот селски живот во Горна река кај Дебар (1914)

Vitimir Tanaeski, 60 vjeç. I lindur nga fshati Vërben.

Shahidie Ahmeti, e lindur në Duf, 86 vjeçare

Lifet. K. Informator, Jeton në Gostivar, 51 vjeç

Danica Milloshevska, 59 vjeçe) e lindur në Gostivar, por prindërit e saj janë nga Nikiforova.

HAJDAR SALIHU - STUDIUES I PËRKUSHTUAR I POEZISË SHQIPE ME ALFABET ARAB

Dr. Sc. Besim Muhadri

Hajdar Salihu (1950-1995)* është autor romaneve: “Udha e ditës së nesërme, 1990, “Jerina dhe helmi”, 1994, “Raport për jetën paralele”, 1994, “Stina e mjegullës, 1999, “Baladë për kthimin e nizamëve”, 2005. Ai është autor edhe i monografisë “Poezia e bejtexhinjve”, që është një nga studimet e vetme të kësaj letërsie, ndoshta më të plota të bëra deri më tani për poezinë shqipe të shkruar me alfabet arab. Monografia dhe dy romanet e para janë botuar për të gjallë të autorit, i cili u shua në një moshë fare të re dhe kur pritej që t’i jepte shumë prozës sonë por edhe studimit letrar. Veprat e tjera të tij janë botuar *post mortum*. Që të gjitha këto vepra na dëshmojnë për një autor mjaft të përkushtuar, i cili la gjurmë të pashlyera, qoftë në fushën e prozës së gjatë, qoftë në atë të studimit letrar.

Temë e vështrimit tonë është kontributi i Hajdar Salihut në studimin e poezisë shqipe me alfabet arab, të cilin e sublimoi me studimin e thelluar, me titull “Poezia e bejtexhinjve¹¹⁶”, të botuar në Prishtinë në vitin 1987, që u botua tash së voni edhe në Tiranë. Duke lexuar këtë monografi, rezulton se studimi në fjalë i Hajdar Salihut, pa dyshim se paraqet një nga arritjet e rëndësishme të këtij studuesi, duke e renditur atë në njërin nga studiuesit më të thelluar dhe më seriozë të kësaj letërsie, të kultivuar në Shqipëri dhe Kosovë gjatë shekujve XVIII, XIX dhe XX.

Poezia me alfabet arab dhe interesimet e vonuara për të

Studimin e tij për poezinë shqipe me alfabet arab, Hajdar Salihu e fillon me trajtimin e *udhës së zhvillimit të letërsisë shqipe me alfabet arab*, ku si shembull të parë merr disa vargje të Mulla Dervishit. Në këtë kontekst ai ka parasysh gjithsesi kohën dhe rrethanat e krijimit të kësaj letërsie si dhe të përballjes me sfidat e ndryshme ekzistenciale të së saj, të cilat janë kohore, por edhe shoqërore. Duke pasur parasysh rrethanat jonormale të krijimit të letërsisë dhe kulturës shqiptare në përgjithësi, H. Salihu shpërfaq mendimin se letërsia shqipe me alfabet arab është shkruar në kushte të vështira historike e shoqërore, gjë që ka ndikuar te studiuesit në krijimin e vështirësive në përcaktimin e

* Hajdar Salihu lindi në fshatin Borushë të Gjakovës. Shkollën fillore e kreu në fshatin e afërm të Molliqit, kurse normalen dhe SHLP në Gjakovë. Më tej vazhdoi studimet universitare dhe pasuniversitare në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës, dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe. Magjistroi me temën “Poezia shqipe me alfabet arab në Kosovë”. Disa vite punoi arsimtar në fshatrat Krelan dhe Molliq, kurse më vonë profesor në gjimnazin e Deçanit, ku më 1981 përjashtohet. Në vitin 1987 filloi të punojë në Teatrin Popullor në Gjakovë. Vdiq në vitin 1995. Në vitin 2013, Shtëpia Botuese “Jeta e re” e Prishtinës, ia botoi kompletin e veprave të tij në katër vëllime.

¹¹⁶ Monografia “Poezia e Bejtexhinjve”, u botua edhe në kuadër të kompletit të veprave të tij, vëllimi 1, nga i cili do të marrim edhe citimet.

kohës së krijimit të saj. Modelin e shkrimit të kësaj letërsie studiuesi e sheh te modeli i letërsive të Lindjes. Këtë ai e heton te përcaktimi jo vetëm i formës, por edhe i alfabetit. Ndonëse thuhet se kjo letërsi u shkrua në kohë dhe në rrethana të caktuara kur në atdhe krijohet një letërsi e një natyre tjetër, siç ishin letërsia e romantizmit apo ajo e Rilindjes Kombëtare, por që nuk ngjante fort në të, Hajdar Salihu është shfaq mendimin se edhe letërsia e bejtexhinjve, që do të thotë ajo që shkruhej me alfabet arab, ka efektin dhe rëndësinë e vet, e cila, me gjithë karakterin e saj religjioz, dukshëm pasuroi përmbajtjen e letërsisë shqipe si dhe preokupimet lokale, krahinore e fetare, të cilat u zëvendësuan me idetë dhe preokupimet e përgjithshme kombëtare.

Hajdar Salihu, kur është fjala te shtrirja kohore të kësaj letërsie, ai nuk e konteston mendimin e studiuesve të shpërfaqur në historitë e ndryshme letrare. Mirëpo ai është ithtar i zgjerimit të këtij kufiri krijues, duke e shtyer atë më tutje për një shekull, përkatësisht deri në shekullin XX. Kufirin më i skajshëm të dëshmisë së shkrimit të kësaj letërsie ai e përcakton në vitin 1725, vit në të cilin botohet apo shkruhet poezia *Imzot, mos më lerë pa kave* të Muçi Zades, kurse skajin i tjetër, atë të përfundimit të saj, Salihu e shpie në vitin 1947, në kohën kur Hysni Statovci e shkruan poezinë *Ni e permenje n'gjuhën shqip*. Sipas kësaj rezulton se poezia shqipe me alfabet arab është shkruar në një hapësirë kohore prej dy shekujsh të plotë.

U tha edhe më lart se poezia shqipe me alfabet arab u shkrua në shekujt 18, 19 dhe 20 dhe përshkoi formacionet historike të këtyre kohëve. Hajdar Salihu është i mendimit se letërsia shqipe me alfabet arab, e shkruar në shkullit XVIII, është e njëkohshme edhe me letërsinë e vjetër shqipe dhe se ajo shkarkohet dukshëm nga karakteri i saj religjioz, duke pasuruar kështu përmbajtjen e vet me tema të patrajtuara deri atëherë. Në këtë kontekst ai shquan poezitë me tematikë sociale të Hasan Zyko Kamberit, ato me tematikë dashurie të Sulejman Naibit dhe tematikës së natyrës, të Ibrahim Nezimit¹¹⁷. Ndonëse poezia me alfabet arab e tejkalon letërsinë e vjetër për nga aspekti tematik, ajo, megjithatë, sipas konceptit analitik dhe studimor të Hajdar Salihut, mbetet prapa në aspektin gjuhësor¹¹⁸.

Ndonëse te poezia me alfabet arab e shekullit 19, Hajdar Salihu heton me të drejtë përmbajtjen dhe formën arkaike, megjithatë në krijimet e autorëve që shkruan në këtë periudhë, si Baba Meleqi, Baba Salihu, Baba Ibrahim, Dervish Salihu, Sheh Jonuzi, Nasibeja e Gjirokastrës etj., ai gjen inkorporimin e ideve të Rilindjes.

Ndërkaq, poezinë shqipe me alfabet arab të shekullit 20 dhe përafrimet e saj me letërsinë sociale, ai i sheh si të vonuara. Hapësirën e kultivimit të saj e përcakton në Kosovë, ndërsa si vendburimet dhe përhapjen e kësaj poezie e gjen te teqetë dhe xhamitë, me autorë kryesisht dervishë, shehlerë e hoxhallarë. Arsytet e lërimin të saj në këtë formë H. Salihu i kërkon te rrethanat shoqërore dhe politike të kohës, por edhe te mungesa e institucioneve arsimore dhe kulturore e letrare të kësaj pjese të atdheut, e cila pas daljes nga pushtimi pesëshekullor osman, bie nën pushtimin sllav, ku nuk lejohej hapja e shkollave shqipe dhe përdorimi i alfabetit shqip, që tashmë përdorej në shtetin amë, që kishte shpallë pavarësinë në vitin 1912.

Në këtë kontekst studiuesi Salihu e sheh edhe çështjen e mosnjohjes dhe të mospërhapjes së kësaj poezie, e cila në të shumtën e rasteve nuk arriti deri te lexuesi, por

¹¹⁷ Hajdar Salihu, vepra letrare 1, "Jeta e re", Prishtinë 2013, fq. 12-13.

¹¹⁸ Vepra e cituar, fq.13.

mbeti brenda për brenda qarqeve të vendit ku u shkrua, ku u këndua dhe si e tillë edhe u harrua, u zhdruk dhe shumë nga krijimet e kësaj natyre mbetën pa autorë. Duke pasur një fat të tillë të rrugës së krijimit dhe të zhvillimit të saj, Hajdar Salihu është i mendimit se ajo mbeti e njohur vetëm ndër qarqet e ngushta të atyre institucioneve fetare ku u krijua dhe përhapja e saj në të shumtën e herëve u bë përmes ithtarëve të atyre teqeve, që kishin kontakte të ngushta me autorin. Mirëpo mosbotimin, mospërhapjen dhe mosnjohjen e kësaj poezie studiuesi e kërkon edhe te faktorë të tjerë.

Kur flet për aspektin historik të krijimit të kësaj poezie, Hajdar Salihu është mbron tezën se sado që ajo është një poezi e shkruar me alfabetin e sjellë prej pushtuesit, në anën tjetër, ajo ka sjellur shpesh përmbajtje origjinale dhe përparimtare për kohën e vet. Zhdukjen e kësaj poezie Salihu e gjen te mungesa e ndihmës së duhur për përkrahjen e zhvillimit dhe përhapjen e saj në kohën e duhur. Sipas tij poezia me alfabet arab është gjetur përherë në mes dy zjarresh¹¹⁹, shkaku dhe pasojat e të cilëve i ka bartur në vete dhe mbi vete. Dëmtimin e saj ai e sheh, në radhë të parë, edhe te forma e saj e jashtme, modeli i bartur nga kultura e huaj, ndërsa, në anën tjetër, kur është fjala te botimi i saj, ai është i mendimit se në këtë aspekt atë e ka dëmtuar përmbajtja, shpesh demokratike e përparimtare, sidomos në planin shoqëror dhe atë patriotik. Interesimet për poezinë shqipe me alfabet arab janë të vonuara dhe madje në periferi të interesimeve shkencore, pikërisht për shkak të fokusimit të studiuesve kah trashëgimia, përkatësisht kah letërsia e periudhave më të rëndësishme letrare. Sipas Hajdar Salihu kjo e ka dëmtuar në masë të madhe këtë poezi, e cila për një kohë të gjatë mbeti nën pluhurin e harresës dhe të mosngjalljes së kërshërisë shkencore dhe kulturore. Ai është i bindur se heshtja ndaj kësaj poezie ka ardhur edhe për shkakun se shumica e autorëve të këtyre krijimeve ishin shehlerë, dervishë e hoxhallarë, të cilët, bashkë me institucionet që i udhëhiqnin për një kohë të gjatë u sfiduan nga pushteti komunist në Shqipëri që kishte mbyllur këto institucione, duke i burgosur, internuar dhe madje edhe duke e ekzekutuar një pjesë të madhe të klerit fetar. Kjo blasfemi bëri që një pjesë e madhe e dorëshkrimeve të zhdrukeshin tërësisht, apo të mungonte edhe autorësia.

Katër përmbajtjet e poezisë me alfabet arab dhe faktorët frenues të saj

Hajdar Salihu *beton katër përmbajtje kryesore* të poezisë me alfabet arab: Përmbajtjen patriotike dhe politike, përmbajtjen shoqërore dhe sociale, përmbajtjen e iluminizmit kombëtar dhe fetar si dhe përmbajtjen fetare të misticizmit islame¹²⁰. Kur është fjala te përmbajtja patriotike dhe politike, ai është i mendimit se vendosja e çështjeve patriotike e politike brenda kornizës së vetëdijes fetare nuk është vetëm strategji e autorit për ta vu në kontakte poezinë e tij me masat, por më tepër se strategji ajo është vetëdije e tij dhe përpjekje e qëllimshme që poezia patriotike të lirohet nga përmbajtja fetare, që mendon se gjithësesi del si një përpjekje e panevojshme¹²¹. Në këtë prizëm ai e shikon

¹¹⁹ Vepra e cituar, fq.18.

¹²⁰ Po aty, fq. 52.

¹²¹ Vepra e cituar, fq.35

poezinë patriotike të Dervish Salihut, poezinë fetare të Baba Meleqit, të Sheh Jonuzit, Sheh Malës e deri diku edhe atë të Sheh Ahmetit si dhe poezinë e vetme të Sheh Idrizit. Madje te poezia e Dervish Salihut gjen informacione dhe vlerësime interesante për kohën, përkatësisht klimën e ngjarjeve të para dhe të pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, pjesëtar i së cilës ishte edhe vet autori ai atyre poezive (pra Dërvish Salihu). Te poezia e Dervish Salihut me titull *Bismilahi nokt e nisa* ai gjen propaganduesin e flaktë dhe luftëtarin besnik të realizimit të qëllimeve që Lidhja shtronte para popullit shqiptar. Po nga ky prizëm ai shikon edhe poezinë e Sheh Jonuzit, të shkruar në çerekun e fundit të shekullit XIX. Elemente të mjaftueshme të angazhimit kombëtar gjen edhe në poezinë e Sheh Malës dhe te ajo e Baba Meleqit¹²². Madje ky i fundit, sipas Hajdar Salihut, është ndër të rrallët i cili ka kultivuar poezinë patriotike në formën e saj të pastër dhe plotësisht në frymën e letërsisë së romantizmit. Ndërkaq, kur është te ky aspekt, ai te poezia e Hasan Zyko Kamberit dhe te ajo e Baba Salihut gjen tiparet e një poezie kronikë. Për ndryshim nga Anonimi i Gjirokastrës, i cili poezinë e tij e ndërton mbi bazën e dramës kolektive, sipas Hajdar Salihut Hasan Zyko Kamberi dhe Baba Salihu poezitë e tyre i ndërtojnë mbi bazën e përvojave jetësore personale. Karakteristikat e poezisë patriotike me tipare të theksuara romantike ai gjen te edhe poezia e Baba Meleqit, Baba Ibrahimit apo edhe te ajo e Hafiz Islamit, ndërkaq karakteristikat e poezisë patriotike me tipare politike do t'i gjejë te poezia e Vesel Xh. Gutës dhe ajo e Hysni Statovcit. Në kuadër të iluminizmit kombëtar dhe fetar, brenda për brenda poezisë shqipe me alfabet arab, Hajdar Salihu shquan iluminizmin për bashkim kombëtar, atë në fushën e arsimit, kulturës dhe dijes në gjuhë amtare dhe iluminizmin që ka për qëllim përsosjen morale dhe shpirtërore mbi bazat e filozofisë islame¹²³. Ndonëse, sipas Hajdar Salihut, mungon poezia me përmbajtje shoqërore dhe sociale, megjithatë ai arrin të gjejë disa elemente të saj në poezinë e Ibrahim Nezimit, Hasan Zyko Kamberit, te një poezi e Sheh Elmazit dhe te disa pjesë të poemës së Vesel Xh. Gutës. Kur jemi te kjo përmbajtje e poezisë, qoftë ajo e gërshëtuar edhe me përmbajtje të tjera, H. Salihu tek ajo dallon tri forma të shkrimit të saj që janë si pasojë e tri mënyrave të vështrimit, përjetimit dhe të pasqyrimit të jetës shoqërore: Poezinë shoqërore dhe sociale përmes së cilës kritikohen sistemet shoqërore dhe klasat; poezinë përmes së cilës jipet pozita e vështirë sociale e popullit, që është pasojë e momenteve dhe situatave të caktuara politike dhe poezinë shoqërore, tek e cila jeta shoqërore dhe marrëdhëniet brenda saj jipen përmes ndjenjave, emocioneve si dhe disponimeve kryesisht të ngrysurat e të zymta të autorit të poezisë.

Kur merret me shqyrtimin e poezisë fetare dhe të misticizmit islame, Hajdar Salihu kërkon që poezia e autorëve që lëruan këtë lloj poezie duhet të trajtohet në nivel të barabartë me poezinë e angazhimit patriotik, të atij politik dhe shoqëror si dhe iluminist. Si tipar të përbashkët që shtrihet nëpër gjithë mendimin fetar të kësaj poezie studiuesi gjen karakterin Alevi të tyre. Këtë mendim Hajdar Salihu e ndërlihdh dhe e forcon me faktin se të gjithë ata që e

¹²² Aty, fq.35-39.

¹²³ Vepra e cituar, fq.58.

lëruan këtë lloj poezie i takonin ndonjërit nga dymbëdhjetë tarikateve alevi të bësimit islam (siç i takonte edhe vet studiuesi- vër.ime- B. M), apo në mos jo, ata gjithsesi ishin njohës të mirë të mendimit teorik të alevizmit dhe misticizmit. Gjatë studimit të poezisë me alfabet arab, Hajdar Salihu arrin te përcaktimi i tre faktorëve, të cilët frenuan apo e penguan zhvillimin dhe njohjen e kësaj letërsie të krijuar nga vet shqiptarët. *Faktorin e parë* frenues e gjen te karakteri i theksuar religjioz, që jo rrallë është shoqëruar me fatalizma dhe me disponime të ngrysurat për jetën dhe për problemet e kohës¹²⁴. *Faktorin e dytë* e sheh të receptimi i botës dhe kërkesat ndaj saj, ndaj realitetit dhe ndaj universit¹²⁵. Ndërkaq, *faktorin e tretë* frenues e sheh te mungesa e komunikimit të duhur më masën, që është rezultat i mosbotimit dhe i mosqarkullimit të kësaj poezie për të arritur deri te lexuesi¹²⁶.

Përfundim

Duke qenë njëri ndër njohësit më të spikatur të poezisë shqipe me alfabet arab, përkatësisht të poezisë së bejtexhinjve, gjatë studimit të saj, studiuesi Salihu arrin në konstatimin e pranueshëm se kjo poezi, e krijuar në rrethana të caktuara politike, shoqërore dhe kulturore, ka arritur të shtrijë ndikimin e saj aq sa ia kanë mundur format dhe rrethanat konkrete. Madje ai konkludon se kjo poezi, me vlerat, idetë dhe me mendimet brenda për brenda saj, ka arritur të shtrihet më tepër se në hapësirat nacionale, në rrethet e ngushta regionale e fetare, mirëpo komunikimi dhe ndikimi i saj, ishte dhe mbeti gjithsesi i ngushtë dhe i frenuar.

Recnesues:
Prof.dr. Sali Bashota
Prof.ass. dr. Kamber Kamberi

¹²⁴ Vepra e cituar, fq. 125

¹²⁵ Vepra e cituar, fq.129

¹²⁶ Vepra e cituar, fq.131.

REFLEKSET MODERNISTE NË ARTIN PAMOR NË KOSOVË

Agnesa Muharremi

Në punimin Reflektet moderniste në artin pamor në Kosovë, jam orvatur t'i përfshijë karakteristikat më parësore të zhvillimit që nga vitet e 60-ta e deri në vitin 2000. Për një trajtim në aspektin estetik-filozofik që në fillim kryesisht jam mbështetur në ca shkrime për fillimin e një nisme të artit modern. Koncepti im ka qenë për këtë kapitull mjaftë interesant, definimi i veprave dhe autorëve ku reflektojnë elementet e para në aspektin figurativ modern, zhvillimi dhe ndikimi i tyre në brezat e ardhshme të krijuesve.

Gjithashtu në punim kam trajtuar edhe shfaqjen e nocionit modern, e cila është mjaftë diskutabile në aspektin reflektues në historiografinë e arteve moderne.

Motoja e kumteses sime fillon: kur dhe me të cilët artist fillon kapitulli i ri i modernizmit në artin botëror? Si dhe në artin shqiptar? Pra, për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve mjaftë fundamentale më është dashur jo vetëm të konsultohem me ato materiale shumë të pakta që deri më sot janë shkruar për ecurinë zhvillimore të arteve pamore në trojet shqiptare. Por, gjithnjë jam shërbyer me veprat e krijuesve, duke i aplikuar mendimet e mia të prera rreth selektimit të veprave që nga brezi i parë i krijuesve e deri të krijuesit më të ri, brez ky që fillon me piktorët: Muslim Mulliqi, Gjëlosh Gjokaj, Xhevdet Xhafa, Rexhep Ferri, Agim Cavdarbasha, Kolë Idromeno, Abdurrahim Buza, Odhise Paskali, Sadik Kaceli e shumë të tjerë si në Kosovë poashtu edhe në Shqipëri përmes veprave të tyre padyshim kanë kontribuar në zhvillimin e artit modern.

Nismat e para të artit modern shpërfaqen me veprat e para të piktorit Kolë Idromeno me veprën "Motra Tone" si dhe peizazhet e nënqiellit të Shkodrës, gjithnjë të realizuara në frymën pleneriste dhe realiste, ndërsa fryma impresioniste i përshkon veprat e Vangjush Mios, Guri Madhit, Salih Shijakut, Androniqi Zengos etj. Këta piktor si dhe një numër i madh i tyre shkallë shkallë do të depërtojnë në suazat e artit modern duke na dhënë vepra krejt të tjera përkundër atyre drejtimeve paraprake të stilit realo-bizantin. Stil ky, që në artin shqiptar ka zgjatur jashtëzakonisht shumë përkundër artit Regjional dhe Evropian.

Për një definim të saktë se kur kanë filluar elementet moderniste të aplikohen në veprat e krijuesëve shqiptarë? Cili është ai, i pari që filloi? Dhe me cilën vepër vecohet?, janë vetëm disa pyetje që patjetër duhen të shqyrtohen në aspektin shkencor. Dihet mirëfilli, se rruga zhvillimore e arteve në përgjithësi, si në Kosovë po ashtu edhe në Shqipëri nuk e ka pas vijimësinë zhvillimore, sikurse që ka ndodhë me viset tjera të Rajonit. Poqese nisemi nga zhvillimi i artit evropian-botëror i cili në shekullin e XIX, jo vetëm që do

reflektojnë në Paris me plejadën e piktorëve impresionist, të cilët me hulumtimet e elementit natyral të dritës do jenë prioritarët e skenës refleksive të artit modern. Nismat e para pa dyshim, fillojnë pas vitit 1874, me Klod Moneun, Eduard Mane, Ogist Renoarin, Edgar Dega, Pol Sezanin, Van Gogun, Pol Gogenin e shumë të tjerë, të cilët pas eksperimenteve të shumta me motivet e natyrës që gjithnjë i pikturonin në intenzitetin më të lartë të dritës natyrale, bile edhe hijet në veprat e tyre ngërthenin dritën natyrale. Historia e artit modern sipas Arnasonit, historian i artit modern amerikan në librin: “Historia e artit modern” 1., fillon pikërisht me dilemat se kur fillon etapa e re e artit modern? Me cilët piktor?, dhe cila është ajo vepër që i ngërthen të gjitha këto tipare? Dilemat e t’ia ishin të mëdha. Pra, shumë vështirë ishte për ta definuar saktësisht rrjedhën zhvillimore të artit modern. Pas shumë e shumë studimeve vie në përfundim, se periudha e paraqitjes së impresionizmit është pikënisja e një kapitulli që do t’i hap shtigjet e reja drejtë izmave moderniste. Nisma e filluar nga pikturimi i plenerizmit me dritë natyrale, do të vazhdojë eksperimentet e mëtejshme me Pol Sezanin, vecanërisht gjatë shndërrimit të formave natyrale në ato gjeometrike. Një eksperiment i tillë do të na sjellë një imazh dhe një qasje krejt më ndryshe nga piktura apo fushat tjera artistike që ishin trajtime standarde e tradicionale artistike me shekuj të tëra. Ky koncept i ri, do të sjell një frymë të re, duke filluar nga arti abstrakt e deri tek izmat më të reja të postmodernizmit, e që, edhe sot e ka kapluar pjesën dërmuese të Evropës, dhe më gjerë përmes artit konceptual, video-artit.

Një rrugëtim i tillë nga dalja e artit standard, në artin shqiptar është dashur, fatkeqësisht për shkak të rrethanave historike që kanë dominuar në atë kohë të zgjasin me qindra vjet, e atë duke filluar nga periudha e Rilindjes e tutje. Fillet e artit modern në Kosovë fillojnë tek në vitet e tetëdhjeta të shekullit XX. 2. Kur brezi i artistëve, të prirë nga Muslim Mulliqi, Gjelosh Gjokaj, Tahir Emra, Nysret Salihamixhiqi, Rexhep Ferri, Xhevdet Xhafa, Agim Cavdarbasha, Fatmir Krypa, Hysni Krasniqi e shumë të tjerë, që nga kjo periudhë, vec do të kthehen nga Akademitë e ndryshme të Ish Jugosllavisë, apo nga specializimet në qendrat e ndryshme evropiane. Artistet që patën rast të shkollohen nëpër Akademitë e qendrave të ndryshme evropiane, patën rast në mënyrë imediate të njohtohen me rrjedhat moderniste të arteve pamore, përmes pedagogëve nga fushat e ndryshme të artit, ndonëse pjesa dërmuese e tyre i kishin të kryer studimet në qendrat e ndryshme evropiane. Një përvojë e tillë e përfutur që në fillim të karrierës së tyre, pa dyshim, që do të ndikoi në mënyrë të vullshme në shpirtin e tyre për ta vazhduar, (kuptohet pas përfundimit të shkollimit) rrugën zhvillimore kreative në frymën moderne.

Një ballafaqim i tillë me këto rrjedha moderniste për ta vazhduar ritmin zhvillimor, edhe ashtu të stagnuar, dhe të ndërprer, për shkak të luftërave që, në Kosovë kanë zgjatur që nga pesë Perandoritë e deri në atë të vitit 1999, kur njëherë e përgjithmon parcialisht u shkëput nga thundra e okupatorit serb. Kushtet dhe rrethanat jo vetëm që ndikuan edhe në kontinuitetin e artit, sic ishte rasti te shtetet tjera fqinje dhe të rajonit më të gjerë, por artistët kosovarë gjithnjë i kthehen në një tematikë, me burim frymëzim të skenave të përditshme që ishin të shpërfaqura gati në cdo mjedis të nënqiellit kosovar, me një dhunë të paparë. Andaj, skenat parësore që dominonin në veprat e krijuesve kryesisht trajtonin cikle kompozimesh në të gjitha gjinitë e artit, duke filluar nga “Shqetësimet”,

“Mbijetesa”, “Kalvari” e deri të veprat e shumë krijuesëve që kanë pikturuar “Ekzodin” Largimin nga trojet e stërgjyshërve tanë.

Duke u nisur nga këto kushte dhe rrethana, arti kosovar me emrat e lartëcekur do të bëjë përpjekje që krahas artit të vendeve të Rajonit të rrugëtoj me një art autokton, original në aspektin e trajtimit të motiveve dhe imazheve të nënqiellit tonë, ku piktorët, skulptorët, grafistët e të tjerët u orvatën që t'i mpleksin në veprat e tyre, vecanërisht nga periudha e përfundimit të shkollimit dhe kthimit në Kosovë. Reflekset e para të këtyre izmave që do të spikasin në veprat e krijuesëve kosovarë janë : ekspresionizmi, fovizmi, kubizmi, abstrakcioni, enformeli, asemblazhi, pop-arti, te brezi i mesëm dhe i ri do reflektojnë primesat e artit konceptual, video-arti, vecanërisht këto shprehje shfaqen në ekspozitat e të rinjve, që pas viteve të nëntëdhjeta e njëzeta janë shumë të shfaqura, në ambientet e Galerisë së Arteve. Vecanërisht do theksoja manifestimin kryesor nga reportoari i Galerisë: “Artistët e së Nesërme”. Ekspozitë e të rinjve me koncepte e ide krejt më ndryshe.

Gjithashtu edhe për artin kosovarë është shumë vështirë të definohet se kur paraqiten elementet moderniste?, cili është ai që shpërfaq një frymë të re? Dhe cila është vepra e parë që ngërthen elemente të kësaj fushe në konceptin më të gjerë? Pra, duke filluar nga këto pyetje e shumë të tjera që mund të parashtrohen, ne duhet të fillojmë nga krijuesit e gjeneratës, të cilët fushëveprimin e vet kryesisht do ta fillojnë, nga vitet e shtatëdhjeta, kur në artin Rajonal dhe atë evropian, konceptet e reja moderniste evoluimin e vet e kishin arritur gati në të gjitha fushat e artit. Një ritëm të tillë zhvillimore më së miri mund të vrojtohet në artin përtej oqeanit atlantik, ku, në vend të Parisit, tani si qendër e artit do të bëhet Neë Yorku me një potencial të madh të krijuesve nga katër anët e botës.

Flluskullat e para të frymës moderne në artin kosovarë padyshim, që do të paraqiten në veprat e Muslim Mulliqit, në ciklin “Pushtimi i hapësirave të reja” 3. Ky cikël është rezultat i vijmësisë së krijimtarisë, e cila në aspektin ekspresiv i përfshinte tablotë që nga cikli i kullave dhe i peizazheve, duke hyrë në botën e portreteve të nënqiellit kosovar. Të gjitha këto eksperimente si në aspektin figurativ, po ashtu edhe në atë tematikë, do të drejtojnë nga një qasje krejt tjetër, në një rrugëtim sa evolutiv, po aq bashkëkohor, duke prekur primesat e drejtimeve aktuale evropiane, por gjithnjë përmes imazheve të nënqiellit tonë koloristik. Andaj, edhe elementi i ngjyrës së bashku me atë të formës do jenë dy elemente parësore që do spikatën në tërë këtë spektër të “Pushtimit të hapësirave të reja”, që do ta lartësojnë tërë opusin krijues të doajenit të pikturës shqiptare, i cili ngjyrën e ka ndie dhe në mënyrë pasionante e ka aplikuar në imazhet kompozicionale, me furishmërinë më të madhe të penelit. Andaj, me të drejtë kritikët dhe teoreticientet e artit Bardin e pikturës shqiptare e quajnë Piktor ekspresiv dhe maestro i ngjyrës. Krijues i cili, që nga veprat e para me tematikë sociale e deri te tablotë e ciklit të “Pushtimit të hapësirave të reja”, i është qasur me përkushtim të madh elementit të ngjyrës, përmes të cilit edhe opusi krijues i të tri fazave do t'i vecohet, dhe do ta rradhitë Mulliqin në grupin e ekspresionistëve modernist të artit shqiptar. Nga i cili drejtim do spikasin edhe lëvizjet të tjera moderniste në veprat e krijuesëve pamor shqiptar në vokacione të ndryshme të artit.

Elementet moderniste reflektojnë edhe të krijuesit të tjerë të këtij brezi, si Xhevdet Xhafa, në ciklin “Autobiografi”, me një frymë të enformelit dhe asemblazhit. Xhafa që nga veprat e para të realizuara nga përfundimi i studimeve pasdiplomikë në Slloveni, me devotshmëri është qasur eksperimenteve që më vonë do t’i bëhen identifikim i stilit të ri të opusit të tij krijues. Imazhet nga jeta e përditshmërisë kosovare që nga e kaluara e deri të e tashmja janë evokuar me një gjuhë të rrjedhshme kreative e cila ka kulmuar në ciklin “Autobiografi”, që për piktorin Xhafa, është sinonim i tërë konceptit figurativ. Padyshim, ky opus, pason si rrjedhojë e realizimit të shumë veprave në frymën e introduktit simbolik, ekspresiv e që vazhdon me frymën e ekspresionizmit abstrakt-enformelist.

Enformeli dhe pop-arti janë dy lëvizje, që deri me sot krijuesi i ka mbetur besnik shprehjes dhe trajtimit të veprave. Apo sic thotë: kritiku i njohur Slloven Jesha Denegri, 4. për ekspoziten retrospektive të Xhevdet Xhafës hapur në Muzeun e Arteve Bashkëkohore – Shkup, me rastin e retrospektivës:...” Xhevdet Xhafa dëshiron të theksojë karakterin subjektiv dhe intim të domethënies që shpreh. Objektet dhe shenjat që përbëjnë këtë tërësi pikturale, fjala është për poetikën e kultivimit të kujdesshëm të gjësendeve të mbetura, të cilat në kompozicion ruhen duke fituar domethënien evokative e simbolike të atyre gjësendeve”. Në veprat e realizuara gjatë viteve të nëntëdhjeta paraqiten reflekset e një fryme moderne, gjithnjë në evokim të ngjarjeve dhe aktualitetit kosovar.

Tahir Emra, piktor i subtilitetit kolorist, me primesa të frymës ekspresivo-gjeometrike, si dhe fryma e re e enformelit nga faza e viteve të nëntëdhjeta, refleksion nga veprat e realizuara për ciklin “Elegji për Kosovën”, flasin për talentin dhe kontributin që kishte në afirmimin e rrjedhave zhvillimore drejtë artit evropian. Elementi i ngjyrës dhe dritës janë dy elemente parësore në tërë opusin e ciklit “Elegji për Kosovën”. Në këtë dikitomi mbarshtohën veprat kompozicionale, që në esencë spikasin një frymë krejtësisht tjetër në aspektin figurativ po ashtu edhe konceptual. Pikturat e tij janë të liruara nga të gjitha elementet e tepërta dhe të thjeshtësuara deri në maksimum, por figurativisht shumeë të pasura dhe, mu për atë gjuhë të thjeshtë, lënë përshtypje të analizës së thellë psikologjiko-filozofike. Me këtë fazë të krijimtarisë piktori Tahir Emra rrugëton drejtë avancimit si në aspektin koloristik po ashtu edhe përmbajtësor të veprave artistike, që e vecojnë nga brezi i bashkohorëve si në aspektin evolutiv të pikturës së tij po ashtu edhe në krijimin e vecantisë stilistike të opusit krijues.

Gjelosh Gjokaj, grafist dhe piktor, i cili tërë jetën e ka kaluar jashtë vendlindjes, tani jeton në Augsburg të Austrisë. Observimet e tij kryesisht janë bazuar në motivet dhe imazhet nga vendlindja, të realizuara në frymën moderne të abstraksionit gjeometrik, me ngërthim të elementeve simbolike, zakonisht të nënqiellit të krijuesit. Kontributi i Gjeloshit ndaj artit modern kosovar reflekton përmes fletëgrafikave dhe tablove pikturale. Shpirti i tij shumë më lehtë është josh përmes vrojtimit të drejtpërdrejt të izmave të shumta aktuale moderne që përfshinin tërë Evropën, duke filluar nga Parisi e deri te qendrat tjera. 5.

Një fantazi e bujshme përmes formave ireale dominante do jetë gati në tërë ciklin e punimeve të piktorit Nusret Salihamixhiqi, i cili gjatë tërë jetës së vetë me një përkushtim dhe devocion punoi duke shpërfaqur tema dhe motive nga ambienti i Kosovës, të titulluar me emrin "Loja", e cila në esencë, është një fantazi surreale që shpërfaqet në deformimet e figurave dhe formave kompozicionale.

Sipas piktorit tonë Nusret Salihamixhiq, e tërë bota është lojë, revolt, cirk, maskenball geniesh e gjallesash të pidentitet apo me identitet të fshehur ose të rremë. 6.

Vecantia e vërtet e piktorit Salihamixhiq, reflekton në këtë cikël, dhe njëherit spikat drejtim të ri në artin modern shqiptar. Një frymë moderniste e përfshinë edhe veprat e Gazmend Lekës, Ali Oseku, Adrian Pacit, Agim Cavdarbashës, Daut Berishes, Mikel Gjokajt, Omer Kaleshit, Adem Rusinovcit, Ismet Jonuzit, Sislej Xhafës e shumë krijuesve të të tjerë të brezit më të rinjë, të cilët kanë dalë nga Fakulteti i Arteve në Prishtinë, Tiranë apo gjetiu. Një pjesë e tyre rrugëtimin e kanë vazhduar në qendrat e ndryshme evropiane, ku edhe sot janë duke vepruar dhe janë mjaftë produktiv e aktiv në shumë ekspozita të galerive të ndryshme evropiane. Këta dhe shumë të tjerë të cilët janë shumë aktiv në punën e tyre krijuese kanë arritur të cilësohen në emra që bartin primesa të drejtimeve të ndryshme moderniste, duke e ngritur njëheri veten dhe artin kosovarë në përmasa më të gjëra evropiane. Pra, kontributi i tyre si dhe shumë krijuesëve të tjerë, posacërisht brezit të mesëm përmes hulumtimeve të shumta kanë arritur në vecantinë stilistike të tyre duke i prekur drjtimet mëavangarde të artit botëror, dhe duke ndikuar në zhvillimin e rrjedhave të shumta moderniste në artin kosovarë e më gjerë në trojet shqiptare.

Pra, në fund, pyetjeve të parashtruara në fillim të studimit mbi refleksat e para moderniste të shpërfaqura në artin shqiptar, shumë vështirë është t'i ipet pergjigja, se cili ishte i pari që filloi të krijoj në këtë frymë, apo në cilën vepër ngërthejnë primetat e elementeve moderniste në artin shqiptar. Dihet fakti, se gjatë historisë së artit botëror, në definimin dhe përcaktimin e drejtimeve, lëvizjeve apo stileve historike kryesisht i kanë kontribuar aspektet zhvillimore të krijuesëve, përkatësisht grupeve që me veprat e tyre kanë shpërfaqur elementet më parësore për një drejtim apo izëm artistik. Kështu që, edhe arti shqiptar tek ne me një rrugëtim të tillë historikë ka filluar në vitet e nëntëdhjeta që të reflekton elementet e para moderniste nga vokacionet e ndryshme të arteve pamore. Ne i përmendem disa emra më karakteristik të këtij rrugëtimi zhvillimor me primetat të artit modern, por, në historigrfinë e arteve shqiptare, sidomos gjatë viteve të fundit të shekullit XX., vecohet një plejadë e krijuesve të rinjë, ku një pjesë e tyre vepron edhe jashta kufijve në shtetet e ndryshme evropiane dhe botërore. Këta dhe krijuesit e brendshëm sjellin një frymë krejt më ndryshe, një frymë aktuale evropiane, vecmas të izmave konceptuale përkatësisht të artit bashkëkohor.

Në një rrugëtim të tillë që nga vitet e shtatëdhjeta e tutje krijuesit e arteve pamore në Kosovë paralajmërojnë, përkatësisht futen në botën eksperimentale të drejtimeve të ndryshme evropiane, edhepse fryma e nënqiellit tonë në veprat e pjesës dërmuese të krijuesëve pamor do jet pjesë përbërëse e opusit krijues e artistik. Andaj, nismat e para të

këtyre refleksioneve moderne në historiografinë e arteve shqiptare fillojnë me peizazhet impresioniste duke vazhduar me izmat e tjera moderniste, deri te arti konceptual, ku pa mëdyshje kontributi i madh ishte dhe është të brezi i ri i krijuesve ku një pjesë e tyre veprimtarinë kreative e zhvillojnë jashta Kosovës, në qendrat e ndryshme botërore.

Refleksionet moderniste në artin shqiptar paraqiten në veprat e tri brezave të lartëcekura, me një karakteristikë, ku cdo njëri prej tyre ka filluar me imazhet-motivet e nënqiellit të vet.

Recensentë:
Prof. dr. Josif Papagjoni
Prof. dr. Fejaz Drancolli

ÇËSHTJA E FORMIMIT TË GJUHËS LETRARE NË REVISTËN "ALBANIA" TË FAIK KONICËS

Besmira Palushaj

Debatet mbi ndryshimet në standardin e gjuhës shqipe i kanë filluesat në vitet '90, gati në të njëjtën kohë me ndryshimet e vullshme politike të vendit. Gjatë dy dekadave të fundit, debati mbi gjuhën letrare të njësuar, apo ndryshe standardin, është hapur e mbyllur disa herë, por vitet e fundit, me zhvillimin e teknologjisë dhe përhapjen më të shpejtë të informacionit, jo vetëm nëpërmjet medias audiovizive, por edhe internetit e rrjeteve sociale, ka kapërcyer madje ndonjëherë edhe nivelin ekspertëve. Tashmë, gjuhëtarët shqiptarë, pas rreth 50 vjetëve jetë të formimit të gjuhës standarde, që nga miratimi me unanimitet i Kongresit të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe më 1972, diskutojnë për problemet e gjuhës letrare, madje diskutimi nga një debat për çështje përmirësimi, shkon deri aty sa të vihet në dyshim baza e saj, pra toskërishtja. Por si shtrohej çështja e formimit të gjuhës letrare të njësuar, më shumë se një shekull më parë, në revistën *Albania* të Faik Konicës?

Revista *Albania*, është vlerësuar si një nga organet publicistike kryesore, që ka influencuar në lëvizjen kombëtare në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX. Ajo botohej në gjuhën shqipe e frënge dhe pjesërisht në atë arabe, duke propaganduar programin e lëvizjes kombëtare shqiptare, historinë dhe kulturën e popullit tonë. Si një enciklopedi e vërtetë, për vite me radhë (1897-1909), ajo zë një vend nderi në historinë e periodikut shqiptar, ndihmesat e së cilës mund të vëzhgohen nga një varg aspektesh. *Albania* ishte "një organ që synonte të ngjallte, të rriste e të forconte ndërgjegjen kombëtare të shqiptarëve duke i bërë ata të vetëdijshëm për historinë, traditat dhe vlerat e tyre"¹²⁷. Përmbajtja e saj shkon nga çështja kombëtare dhe politike tek problemet e gjuhës shqipe, të pajisur me një alfabet të përcaktuar, duke kaluar tek debatet, esetë, kritika letrare, përkthimet, tekstet poetike etj. Në faqet e kësaj reviste u botuan artikuj me vlerë nga dijetarë shqiptarë e të huaj mbi probleme të historisë, gjuhës dhe etnografisë shqiptare.

Faik Konicës i takon merita, që shtroi me profesionalizëm në revistën *Albania*, çështjen e krijimit të një gjuhë letrare të përbashkët për të gjithë shqiptarët, duke e konsideruar atë si një instrument të domosdoshëm për funksionimin e jetës së një kombi. Ai u përpoq të argumentonte rëndësinë e *letrarishtes* dhe të tregonte rrugët dhe mënyrat e formimit të saj. Koncepti i Konicës për letrarishten ishte ai i një gjuhe të shkruar, e cila më pas do të shërbente si model për gjuhën e folur. Në përgjithësi, ai iu përmbajt idesë së përfundimit të një gjuhe letrare përmes përzjerjes së dialekteve dhe rruga ishte e gjatë dhe e vështirë: "*Puna s'është e lehtë dhe pakë nga pakë do të mbarohet*"¹²⁸. Letrarishtja që do të ngjizej nga përzjerja e dialekteve të shqipes, duhej orientuar, sipas Konicës, nga gjuha e popullit për të mbrojtur natyrshmërinë e saj. "Në mënyrë të ndërgjegjshme, ai e orientoi gjuhën drejt modeleve të toskërishtes veriperëndimore, pra, atij i duhet njohur merita e

¹²⁷ Kristina Jorgaqi, *Mendime gjuhësie*, Ombra GVG, Tiranë, 2007, fq. 12.

¹²⁸ Revista *Albania*, 1902, nr. 4.

jashtëzakonshme e vënies së bazave të një koineje toske, duke kontribuar kështu për atë që kishte luftuar e aspiruar aq shumë – afrimin e dialekteve të shqipes”¹²⁹.

Prej vitit 1897, Faik Konica hapi në revistën *Albania* rubrikën “Për themelin e një gjuhës letrarishtes shqip”, duke botuar më pas dhjetëra shkrime për 12 vjet me radhë. Kështu, çështja e krijimit të një gjuhë letrare të përbashkët do të bëhej objekt diskutimesh të gjera edhe nga gjuhëtarë apo studiues të ndryshëm, që botonin artikujt e tyre në revistë. Por, natyrisht mërita e jashtëzakonshme i takon Konicës, i cili nëpërmjet shkrimeve të tij argumentoi rëndësinë e *letrarishtes* për shqiptarët, si faktor i unifikimit të kombit.

Gjuha shqipe e përbashkët, si tregues i identitetit kulturor dhe kombëtar, kishte nevojë të përpunohej, në mënyrë që të krijonte një sistem të qëndrueshëm për t’u kristalizuar në të gjitha hallkat kryesorë të strukturës fonetike, gramatikore e leksikore. Në njësimin e saj ndihmuan shumë përpjekjet e gjuhëtarëve, shkrimtarëve, mësuesve etj. për të përdorur në shkrim dhe në të folur një gjuhë të përbashkët. Me zgjidhjen e çështjes së alfabetit në Kongresin e Manastirit, problemi i njësimin të gjuhës letrare u kthye në një shqetësim kryesor për shumë gjuhëtarë, të cilët ishin të vetëdijshëm për situatën e vështirë ku ndodhej shqipja, si një gjuhë e zhvilluar me ritme shumë të ngadalta dhe e pa lëvruar.

Vetë Faik Konica në shkrimet e tij iu përmbajt në përgjithësi idesë së një gjuhe letrare të përbashkët, të përfutur nga përzierja e dy dialekteve, toskërishtes dhe gegërishtes. Ndër dialektet e të folmet e gjuhës shqipe, Konica e shihte elbanishten, për nga shkalla e pastërtisë, si të përshtatshme për t’u vënë në bazë të *letrarishtes*, por më pas ai do të dilte kundër kësaj ideje, me argumentin se kjo e folme nuk ishte e njësuar, për shkak të popullsisë së përzier që e fliste. Ndërsa në vitin 1922, në një artikull botuar te gazeta *Posta e Korçës*, ai do të dilte në mbrojtje të toskërishtes, duke e cilësuar atë si gjuha klasike e Shqipërisë, një qëndrim ky që kundërshtonte idenë e tij për një gjuhë që do të ngjizej nga përzierja e dialekteve.

Lidhur me këtë çështje një ndër shkrimet që mori vlerësime të mëdha dhe pati jehonë të gjerë ishte artikulli “Për themelin të një gjuhe letrare”, botuar në *Albania* në vitin 1905 nga Aleksandër Xhuvani (pseud. Dok Sula). A. Xhuvani zë një vend nderi në radhën e studiuesve më të shquar të gjuhës shqipe. Gjuhësia shqiptare me ndihmesën e tij të palodhur shënoi një ngritje cilësore. Ai trajtoi në veprat e tij një varg problemesh të gjuhës shqipe, që u përkasin fushave të ndryshme, si gjuhës letrare kombëtare e normës gjuhësore, pastërtisë e pasurimit të saj, gramatikës, leksikologjisë, leksikografisë etj. I frymëzuar nga idetë përparimtare të rilindësve dhe si pasardhës i drejtpërdrejtë i Samiut dhe i Kristoforidhit, zhvillimin e masave të popullit shqiptar e shihte te zhvillimi i arsimit kombëtar në gjuhën amtare. Prandaj, ai punoi gjithë jetën për ta ngritur gjuhën shqipe në shkallën e një gjuhe të zhvilluar kulture.

Xhuvani, i pajisur me dije të thella shkencore të nivelit evropian dhe duke iu referuar modeleve të formimit të gjuhëve të kombeve të tjera, mendonte se gjuha “*letrare*” do të njësohej vetëm pas krijimit të një letërsie të pasur, punë kjo të cilën ua atribuonte “*shkruesvet të mbasandajshëm*”, të cilët i cilësonte si udhërrëfënës. Ata do të mund t’i jepnin gjuhës shqipe qëndrueshmërinë për të cilën kishte nevojë, drejt procesit të

¹²⁹ Kristina Jorgaqi, *Mendime gjuhësie*, Ombra GVG, Tiranë, 2007, fq. 22.

njësimit: “Për me e sigdhë sidokudo kët çashije, e cila nuk asht e vogël dha e letë, e me i çelë udhën shkrujësvet (aux ecrivains) të mbasandajshëm, të cilët ato vetëm dhe jo gjuhësoret a shkronjëoret kanë me kriue një gjasë gjuhësore të qindrueshme e të patundune, sikurse asht ba në gjithë gjuhët e tjera, për me u ba, pra, udhërrefnjës në kët punë”.¹³⁰

Duke dëshmuar se e njihite mirë historinë e formimit të gjuhëve letrare të botës, Xhuvani argumentonte se edhe shqipja e njësuar mund të formohej duke u bazuar në një nga skemat e gjuhëve të mirënjohura. Sipas tij, historia e gjuhëve letrare, me përjashtim të disa vendeve, nuk njih raste që një gjuhë e tillë të jetë krijuar si produkt i përzierjes dialektore: “Nga istoria e gjuhëries, pra, mësojmë se cilado gjuhë e çdo kombi - ndofta, përveç në disa vise - nuk asht kriue duke u ngjiturë e duke u trazumë bashkë ligjëronjat (les dialectes) e vendeve...” (po aty); dhe shprehej se këtë mendim e mbështet edhe Konica te Albania në numrin VI.

Xhuvani, argumenton mendimin se çdo dialekt mund të behët gjuhë letrare zyrtare në kushte të caktuara historike, jo pse ai dialekt a varietet është më i mirë se të tjerët, por për shkak të rrethanave të caktuara: “Çdo gjuhë shkrintare letrëtare e sotshme ka qenë hejret, kur u fillue me u shtëllisë e me marrë një gjasë të përgjithëshme, një ligjëronjë si gjithë ligjëronjat e tjera; i la pasë motrat e saj e duel sipër mbi ato jo se kishte talente, qi nuk i kishin të tjerat, por vetëm se disa shkajke istoriake, disa arrësyje të përjashtme e ngritën dhe e lartësuenë kaqi fort, saqi të gjithë bashkkombëtarët atë vetëm u detyruen me e përdorunë e me e marrë për organ shoqërimi” (po aty).

Duke pasur parasysh faktorët historiko-shoqërorë e kulturorë, veçoritë fonetike, gramatikore e leksikore të gjuhës shqipe dhe shkallën e zhvillimit të dy varianteve letrare, Xhuvani parashtrroi një tezë të re shkencore për formimin e shqipes letrare, duke iu referuar përvojës historike të gjuhëve të tjera dhe pikërisht shembujve të formimit të latinishtes, greqishtes, italishtes e frëngjishtes në bazë të të cilave ka qenë një dialekt i caktuar që është ngritur në nivel të një gjuhe kombëtare. Kështu, Xhuvani sugjeronte se gjuha jonë kombëtare duhej ngritur mbi bazën e toskërishtes letrare, e cila gjendej në një kontekst politik, shoqëror dhe kulturor që e favorizonte: “Unë në toskënishtet shof ato dukje istoriake, ato gjarje, atë udhëtim shtëllisje, qi kallzova sipër për gjuhët greqishte, latinishte etj” (po aty).

Ndër arsyt kryesore përse varianti i toskërishtes letrare duhej të përbënte bazën e gjuhës shqipe të njësuar, ishte përhapja e gjerë në shkrim. Pjesa më e madhe e organeve publicistike dhe botimeve të kësaj periudhe ishin shkruar në toskërishten letrare. “Lartësimin e toskënishtes në shkallë të gjuhës letrëtare vetëm një arrësyje, përdorimi saj në ma të shumtat e libravet qi kanë dalë deri tashti, asht mjaft i fort me e ba të nevojshim dhe të kërkueshëm, por jo me damnimin e gegërishtes....” (po aty). Natyrisht ai përjashton revistën Albania, e cila duke përdorur alfabetin e Bashkimit, artikujt e saj i botonte edhe në toskërisht edhe në gegërisht, kjo në funksion të idesë së Konicës për formimin letrarishtes mbi përzierjen e dy dialekteve të shqipes. Ndonëse pranonte origjinën e tij gege, ai ishte kundër mendimit të Faik Konicës për të vënë në bazë të letrarishtes elbasanishten, e folme që i takonte gegërishtes: “...nonse jam gegë dhe e di se këto qi thashë

¹³⁰ Revista Albania, 1905/11

për toskënishten nofta nuk do t'i vinë mirë gegëvet mi, më thotë mendja se nuk gjanë ta marrim dialektin e Elbasanit si udhëhëqes a si paitor, sikurse thotë Albania ...” (po aty).

Në thelb A. Xhuvani shprehet kundër ngritjes së drejtpërdrejtë të një dialekti të shkruar në funksionin e gjuhës letrare kombëtare, kundër bazës së ngushtë, tërësisht njëdialektore të gjuhës letrare, por për një bazë më të gjerë, që të ushqej nga ndërveprimi e bashkëveprimi i dialekteve, “... toskënishten lypset me e marë për themel, mbi të cilin të ndërtojm gjuhën tonë letrëtare [...] gjuha toskëvet ka - pas mendjes s'eme persi - disa vetija (qualites), qi s'i kanë motra asaj dhe të cilat e bajnë dialektin e toskëvet ma të letë në të mësuemit së gegënishtes.” (po aty). Dhe, duke pranuar toskërishten në themel, e kushtëzon rolin e saj nëpërmjet dy parimeve themelore: toskërishtja të merret si *pasqyrë* në fonetikë e në sintaksë dhe leksiku i gjuhës kombëtare të ketë një bazë më të gjerë dialektore, duke marrë nga të gjitha të folmet çdo fjalë që nuk gjendet në toskërisht. Kjo do të thotë se në leksik duhet të hyjnë njësitë leksikore të përbashkëta të të dy dialekteve dhe njësitë e veçanta të secilit prej tyre. Parimet bazë për krijimin e gjuhës letrare, sipas Xhuvanit ishin këto:

1. Të merret për pasqyrë toskënishtia si në përmbledhjet ashtu dhe në zanësit...
2. Atje ku zanësia e fjalëvet në të dy dialektet asht fort e ndryshme sicilado fjalë të marri - sikurse thotë dhe Albania - një domethanjë të veçantë...
3. Të mirret nga gegënishtia dhe nga nonji dialekt tjetër çdo fjalë, qi nuk gjindet në toskënishtet.... (po aty)

Sipas tij, dialekti i toskërishtes letrare ka lehtësinë për t'u mësuar më shpejt se gegërishtja letrare, duke u bazuar kështu në të ashtuquajturin kriter i “mirëtingëllimit” të cilin e vlerësonte edhe Konica: “...kur këqyret dhe letësia (facilite) me të cilën ky dialekt mësohet ma shpejt dhe prej bashkëkombëtarvet dhe prej të hujvet, atëherë bindem se ky dialekt asht premtue naturisht me u ba një gjuhë e përgjithëshme” (po aty). Parimin pro futjes në gjuhën letrare të fjalëve e trajtave nga dialekti i gegërishtes apo nga të folme të tjera dialektore, Xhuvani e mbështet edhe në shembullin që ofron gjermanishtja; “Parimin e funtë, [...] e dëshmon dhe gjuha gjermanishte, tek e cila Bodmer-i, Eieland-i, Herder-i futën mjaft fjalë nga dialektet, saqi një pies' e madhe të thesarit fjalëtor të gjermanishtes vjen nga dialektet” (po aty).

Në fund të artikullit Xhuvani shkruan se parimet themelore të mësipërme nuk duhen marrë si “urdhënime”, por si propozime: “Gjuha asht gjë organike, si rrobet, si shtëpiat etj., e cila në gojë dhe në mendjet ati qi e flet ndryshohet, ndërrohet, përfytyrohet, shtëlliset, mirësohet, vdirret pas nevojës qi ka njeriu për ditë” (po aty). Xhuvani argumenton më tej se “këjo asht punë e shkrujësvet mbasandajshëm, nuk asht punë qi bahet a priori” dhe “në qoftë se në kët çështje nuk liben mbënjatë simpahinat dialektore, le t'jemi sigur se kurgja s'jemi tyj kriue” (po aty). Formimi i gjuhës sonë letrare kombëtare vërtetoi se në thelbin e saj teoria e A. Xhuvanit ishte e drejtë, duke u bërë baza kryesore e veprimtarisë normëzuese të disa brezave. Pas shpalljes së pavarësisë, gjuha jonë letrare u ndërtua si një koine “sui generis”, në strukturën e së cilës, mbi një bazë të përbashkët të gjithë shqipes janë shkruar organikisht në përpjesëtime të ndryshme edhe elemente thelbësorë të veçanta të të dy dialekteve.

Natyrisht që çështja e themelimit të një gjuhe të përbashkët letrare e zyrtare ishte një çështje kombëtare që duhej të zgjidhej sa më parë. Atdhetarë të shumtë punuan me

ngulm që gjuha shqipe të ngrihej në nivelin e një gjuhe kombëtare, dhe ata përfaqësoheshin nga A. Xhuvani, L. Gurakuqi, F. Shiroka, Asdreni etj. Ata dëshironin një gjuhë letrare të vetme e të përbashkët për të gjithë kombin, mbi një bazë të gjerë, jo thjesht njëdialektore.

Dijetari dhe atdhetari i shquar Luigj Gurakuqi (pseud. Lek Gruda) do të luftonte me guxim për zgjidhjen e kësaj detyre historike dhe rëndësinë e saj në bashkimin e kombit: "... gjuha asht batori ma i math i komsies, diftuesi ma i neltë e sheji ma i kjartë i njisiës e i bashkimit t'nji popullit"¹³¹. Gurakuqi e shtron çështjen e formimit të gjuhës letrare kombëtare nga një këndvështrim teorik, ndryshe nga Xhuvani i cili propozoi një tezë shkencore konkrete. Si njohës i mirë i formimit të gjuhëve klasike, Gurakuqi do të vejë në pah evoluimin e gjuhës së folur, duke nënkuptuar dialektet, si një fazë natyrore në zhvillimin e gjuhës: "...gjuhët e foluna njëkin edhe ato t'shtredhunit e jetës s'komit, qi i flet, due me thanë, shvillohen e nrojnë pa pra. E këtu për gjuhë t'foluna merren ma fort vesht dhialektet, qi gjinen n'gojë t'popullit, pse gjuhët e dekuna, si sanskritishtja, greqishtja e moçme e latinishtja, qi nollen nër libra e zehen vetëm nër shkolla, asht e dietun se nuk mun t'psojnë nrimë" (po aty). Nëpërmjet shembullit të formimit të zhvillimit të gjuhëve të tjera evropiane, Gurakuqi thekson edhe ndryshimin mes gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar, duke argumentuar se gjuha e shkruar gjatë evoluimit, ndryshon më pak se gjuha e folur. Por gjatë këtij zhvillimi: "... gjuhët marrin mrapa kanunet e rregullat e veta, kur mos t'jen t'trazueme prej nonji shkajkut t'përsjastun, si me thanë, prej t'përzemimit me popuj t'nji gjuhët t'tjetre gjinijet, qi disa herë munet me iu nrue rriedhën" (po aty).

Edhe gjuha letrare kombëtare, sipas Gurakuqit, duhet të ngrihet mbi një bazë të gjerë dialektore dhe nëpërmjet këtij bashkëveprimi të dialekteve të shqipes do të arrihej drejt njësimi. Por, natyrisht kjo punë kërkonte një studim të mirëfilltë shkencor dhe duke synuar afrimin mes këtyre dialekteve do të mund të krijohet baza e shqipes letrare: "...na do t'këqyrim e do t'kena kujdes me i livrue e me i vue oroe mirë dhialektet e para t'gjuhës sonë, e me i afritë e me i përkrahë shoq me shoq për me ditë me zgjedhë" (po aty). Gurakuqi kishte ide të qarta për formimin e gjuhës letrare kombëtare, ai mendonte se kjo ishte një çështje që kërkonte kohë. Fillimisht duhej studiuar se cila forme dialektore përkrahej dhe pëlqehet më shumë: "Tesh për tesh asht t'vishtir me dhanë nji përgjigje t'shkurtë: po tham vetëm se, tuj rrahë çashitjen e gjuhës s'përbashkme, kena me pa se cilla trajtë do t'pëlqehet. E për me ba këtë, un kujtoj se do t'jen mirë t'zgjidhen e t'përdorohen njato trajta, qi i përkasin asaj shkalle, n't'cillën t'gjinët shvillimi i shumicës s'fjalëve t'gjuhës sonë" (po aty).

Që shqipja të arrinte në fazën e formimit si gjuhë kombëtare, fillimisht duhej përpunuar në bazë të rregullave dhe ligjësive që veprojnë në të. Kërkohej një punë e madhe sidomos në fushë të leksikut dhe të terminologjisë, në mënyrë që ajo të përmbushte funksionet e saj në të gjitha sferat: "... duhet me e punue e me e livrue, por me men, me zellë e me kujdes; duhet me i shtue fjalët e me i kufisue skajet, por me dije e me urtie e tuj vue oroe e tuj marrë mrapa ligjet e rriegullat e shvillimit e t'natyres e t'kjenjes s'saj" (po aty)

Një punë e madhe, sipas Gurakuqit, duhet të bëhej edhe në fushën e fonetikës, pasi ai e shihte shqipen si një gjuhë të ngurtë, që kishte nevojë të zhvillohej dita-ditës dhe në këtë mënyrë do të mund të rikuperoheshin mungesat, në varësi të nevojave të saj.

¹³¹ Revista Albania, 1905/12

Ndërsa në fushë të leksikut ai propozonte: “...skajet e përgjithëshëm t’gjith degëve t’dijes, qi janë, po thue, gjithnji nër t’tanë gjuhët e qi ma t’shumët erdhnë prej greqishtes vietrë, kena me i marrë edhe na, por, tuj i shtie n’gjuhë shqype, do t’iu apim trajtën qi lypë natyra e kësaj, e, për kët qëllim, maston t’vem oroe nryshimet qi kan psue fjalë tjera greqishte t’përdorueme ka ditë prej nesh e t’shqupëtarësueme (po aty). Ai i kushton një vëmendje të madhe formimit të fjalëve me mjetet dhe mënyrat e gjuhës shqipe. Kështu, sugjeron që të analizohet dhe të merret për bazë formimi i fjalëve të prejardhura që do të shërbejë si model për krijimin e fjalëve të reja: “Fjalët e skajet tjerë kena me i trajtue vetë tuj i ba me rriedhë prej rrajëve shqype, por, edhe n’trajtim t’tyne, kena për t’marrë mrapa ato methudha mas t’cillave kjenë përba fjalët e prejardhura, qi nollen qysh e tesh n’gjuhë tone” (po aty).

Një rëndësi të veçantë Gurakuqi i kushton edhe metodës të të shkruarit: “S’mramit, për me e begatësue gjuhën e me i dhanë trajtë t’bukur, t’ rriedhtë e t’përkulun përmladhjes s’saj, duhet me e livrue fort e me kujdes, e me i dhanë shtërngim vedit, qi t’ushtrohena¹³² n’gjithfarë shkrimesh [...]. Pas këtij shkrimi, në një tjetër artikull, Gurakuqi do të shtronte edhe çështjen e terminologjisë shkencore të shqipes, duke parë hovin e madh që mori zhvillimi i literaturës: “Kështu po vjen tuj përparue e tuj u shtue përditë letrëtura e jonë; sot njeni, nesër tjetri po çpallë ka një sen e veprat shqype, si letrarishte, si shkencëtare, po shkojnë gjithnji tuj u shumue” (1905/8). I lidhur ngushtë me çështjen e formimit të shqipes letrare, problemi i terminologjisë shkencore kërkonte një punë të guximshme, dhe sipas Gurakuqit duhej mbështetur mbi disa parime gjuhësore. Albania, sipas Gurakuqit, ishte një shembull edhe në pasurimin e zhvillimin e leksikut të shqipes sidomos të atij kulturor dhe shkencor.

Puna e këtyre studiuesve dhe atdhetarëve në çështjen e themelimit të gjuhës letrare kombëtare është vërtet e madhe. Nëpërmjet shkrimeve të tyre bëhet hap pas hapi kalimi në një periudhë të re të shqipes letrare, ku gjuha jonë zhvilloi më tej veçoritë e saj të përgjithshme. Idetë dhe përpjekjet e bëra nga këta intelektualë, duke mbajtur lart flamurin e “bashkimit kombëtar”, përgatitën kushtet për zgjidhjen e problemit të gjuhës së njësuar.

Bibliografia

- Daka, P., (1998) *Fjalor pseudonimesh (1743-1944)*, Akademia e Shkencave e RPSH, Tiranë, Shkencë.
- Fullani, Dh., (2001) *Ashtu si e pashë Faik Konicën*, Tiranë, Eurorilindja.
- Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2002.
- Instituti Albanologjik i Prishtinës, (1997) *Faik Konica, jeta dhe vepra*, Prishtinë.
- Jorgaqi, K., (2007) *Mendime Gjuhësie*, Tiranë, Ombra GVG.
- Konferenca shkencore për Faik Konicën*, Prishtinë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2006.
- Likaj, E., (2006) *Zhvillimi i eptimit në gjuhën shqipe*, Morfologji Historike, Tiranë.
- Osmani, T., (1999) *Udha e shkronjave shqipe, Histori e alfabetit*, Shkodër, Universiteti i Shkodrës “Luigi Gurakuqi”, Sektori shkencor i Albanologjisë.
- Resuli, N., (1976) “Faik Konica në qindvjetorin e lindjes”, në *Faik Konica (1876-1976)*, Seminar studimesh me rastin e qindvjetorit të lindjes së Faik Konicës, New-York, Kolonja Press.
- Samara, M., (2000) *Historia e gjuhës letrare shqipe*, Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë.
- Starova, L., (2001) *Kthimi i Faik Konicës*, Shkup, Flaka.
- Starova, L., (2001) *Një miqësi evropiane, Faik Konica dhe Guillaume Apollinaire*, Tiranë, Onufri. (bot. I, Faik Konitza et Guillaume Apollinaire, Une amitié européenne, Paris, L’esprit des Péninsules, 1998).
- Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit*, Tiranë, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, 1986.

¹³² S'exerqer. (shënim i autorit)

KONCEPTI I SË FSHEHTËS NË VEPRËN “ËNDËRRIME” TË NAIM FRASHËRIT

Blerina Harizaj

Vëllimi me poezi “Ëndërrime”, është një vepër që i përket fazës së parë së krijimtarisë poetike të Naimit. Në këtë fazë shohim një poet i cili shqetësohet më shumë për çështje të karakterit metafizik si; jeta, natyra, bota, gjithësia, njeriu, Perëndia etj, dhe ndër këto prokuptime të Naimit bën pjesë edhe misteri apo e fshehta, që për të shfaqet në univers në kohë dhe hapësirë. Para se të analizojmë mënyrën se si e percepton poeti Naim këtë mister, do të shohim se çfarë kuptojmë në radhë të parë me këtë nocion. Dhe për këtë së pari do t'i referohem fjalorit të gjuhës shqipe të vitit 1980, ku e fshehta përkufizohet si diçka që nuk është zbuluar a nuk është njohur ende, psh, si të fshehtat e natyrës..Dhe së dyti duke qëndruar në atë që thamë se për filozofë apo poetë të ndryshëm ajo është edhe një çështje që i përket filozofisë do t'i referohem fjalorit të filozofisë të vitit 2007, ku ajo përkufizohet si, qetësi, heshtje dhe vjen nga greqishtja mys, dhe që shikohet si një gjë e madhërishme, si fuqi hyjnore, ku ndër të tjera misteri mund të jetë dhe një objekt i soditjes së heshtur dhe besimit. Pikërisht, e fshehta për Naimin është një objekt soditës-meditativ. Dhe këtë përpjekje të poetit për ta zbuluar e shohim te poezia, “ Filozofi” dhe “Qielli”. Gjithçka në natyrë që e habit dhe e mrekullon është një e fshehtë për poetin, dhe përpjekjet e kërkimet e tij për të zbuluar atë janë të parreshtura.

Natë e qetë, hëna e bukur plot me dritë
Fllad i ëmbël, toka e hapur ka stolitë

Zogu i mendjes, po më sulet drejt nga qielli
N' hapësirat plot me afsh e dritë dielli

Kjo natyrë dhe ky det, burim i jetës
Këto ligje, këto pamje të së fshehtës

O ti qiell dritëderdhës, magjiplot
Fund e krye me të fshehta ti je plot

Qielli

Mëndja ime, që s'gjen prehje
Dhe rropatet me aq pyetje- e mërmërimë

Kush pse çfarë ku e kur e si e sa
Por më kot se nga çdo anë tallje ka

Filozofi

Poeti ynë, përsiatjet e veta për të zbuluar të fshehtën i nis nga qielli¹³³, dhe si kohë të përshtatshme, ai sheh mesnatën dhe mëngjesin¹³⁴, nga ku merr hov udhëtimi i tij meditativ (shpirtëror), drejt shtigjeve të së panjohurës. Ai i lutet zogut¹³⁵ të mendjes (mendimeve) që të sulet drejt qiellit për të zbuluar (njohur) misterin e natyrës. Duhet të theksojmë se poeti për të formuluar idetë e tij filozofike, metafizike apo mistike përdor figura të ndryshme letrare si; simbole metafora apo edhe imazhe poetike, sepse në radhë të parë ai është poet dhe jo filozof. Ai nuk krijoi një sistem të vetin filozofik, por ai huazoi filozofinë e të tjerëve, pasi ai nuk ndërtoi asnjëherë argumenta të rinj lidhur me çështje të ndryshme filozofike. Për Naimin, fuqia e mendjes në procesin e njohjes së botës, natyrës apo atë hyjnore, njihet që në antikitet, ku më vonë e huazon edhe filozofia e mesjetës. Le të përmendim Platonin¹³⁶, dhe pikërisht te *Fedri*, i cili i vë krahët shpirtit (mendja ose arsyeja), që më lehtë t'u afrohet ideve të tij, që gjenden në qiell. Apo edhe filozofi, Xhon Loku, ku theksonte se njohja e Zotit dhe e botës del nga vetë natyra e arsyes (mendjes) njerëzore. Duket qartë që Naimi del si ithtar i kësaj filozofie, dhe pikërisht në momentin që ai i kërkon ndihmë mendjes, në përpjekjen e tij për të gjetur të vërtetën, sepse e fshehta për poetin është e vërteta dhe thelbi i gjithçkaje në univers. Shohim se ai i drejtohet qiellit (hapësirës me afsh dhe me dritë dielli), i cili e sheh si hapësira, ku është vendosur Zoti (hidh një sy nga qielli lart që të glesh fron e madhështisë së llagartë)¹³⁷, si një hapësirë që është universale, e përjetshme dhe e pandryshueshme, por reflektohet edhe si imazh i përsosmërisë hyjnore. Një arsye tjetër që shpjegon faktin se pse Naimi i drejtohet qiellit për të zbuluar aty, thelbin e botës, ka të bëjë me ndikimin që poetët sufite persianë kanë patur në poezinë e tij, dhe pikërisht në përshkrimet që sillnin dalldisjen e tyre për t'u ngjitur lart në qiell, ku si model është marrë ngjitja e profetit Muhamed, në qiell një natë prej xhamisë së shenjtë në një xhami tjetër. Ky motiv kuranor është përpunuar nga tradita poetike persiane. Madje dhe frekuentimi i dukurive kozmike nga ana e poetit shpjegon ndikimin e poezisë persiane, dukuri të cilat janë evidente te kjo poezi. Koncepti i së fshehtës te Naimi, lidhet me vetë konceptin e së amshuarës, e së përjetshmes, të trashedentales, lidhet me vetë konceptin e

¹³³ qielli nuk merret si materie apo lëndë, por si imazh i përsosmërisë shpirtërore, si vendi ku ndodhet e fshehta, hyjnorja.

¹³⁴ Sipas mistikëve, mëngjesi dhe mesnata, qenkan kohët e sulmit të shpirtit, që ata nënkuptonin zemrën, drejt shtigjeve të së panjohurës, dhe shkrirjen e qenies individuale, në njësinë harmonike të natyrës. Prandaj dhe lutjet e tyre e ndryshme që bëjnë njerëzit e shpirtit më këtë kohë-thonë ata, dëgjohen në qiell.

¹³⁵ Është zogu mitik, Simurg, zogu i padukshëm, që jeton në hapësirë, simbol i pastërtisë njerëzore. Ai është Simurgu poetik i qiejve mistikë.

¹³⁶ Platoni ishte nga ata filozofë që përkrahte teorinë, se mendja dispononte aftësinë më të lartë, në njohjen e botës, Zotit, dhe të vetnjohjes në raport me vetveten.

¹³⁷ Aludon për fronin e Zotit

Zotit. Ezoterikja¹³⁸ gjithmonë e ka tërhequr poetin, i cili me magjinë e fjalës, kërkon të futet në skutat më të errëta të botës, madje të shkrihet në njësinë harmonike të saj, të zhduket në të fshehtë dhe të bëhet njësh me të vërtetën hyjnore. Kjo zhdukje ekzistenciale, në një shenjtërim shpirtëror të poetit e ka burimin nga sufizmi, i cili përsosmërinë shpirtërore të njeriut ata e shihnin vetëm te unifikimi i tyre me Zotin dhe te braktisja përfundimisht i gjërave materiale të kësaj bote. Por për poetin ndodh ndryshe, shkrija në njësinë harmonike të natyrës sjell dhe njohjen e së fshehtës, të së vërtetës (se çdo të bëhem pas kësaj më s'di ç'të them, pas kësaj ah s'do të jem...),¹³⁹ d.m.th tretjen në Zotin, ku sipas, të cilit nuk është e prirur të kapet prej mendjes së hallakatur, e cila gjithnjë e më shumë e fut në dyshime atë, për mundësitë e saj të pakta në njohjen e së fshehtës së universit, (zogu i mendjes¹⁴⁰ te ky det kaq i gjerë, më fundoset poshtë ingjirit si humnerë, shkrehet mbetet pa mbështetje, i topitur, i pazoti, nga dyshimi i pazotur).¹⁴¹ Poeti arrin në përfundimin se edhe me anë të të filozofuarit, nuk mund të arrihet në njohjen e së vërtetës, duke vënë në pikpyetje edhe rolin e filozofisë në gjetjen e atyre rrugëve që të mundësojnë në arritjen e saj (por më kot se nga çdo anë tallje ka, si edhe, mund ta thonë dot të fshehtë qiellore, kjo gjuhë dhe kjo gojë njerëzore)¹⁴². Në një kuptim figurativ, këtë e shohim në poezinë e poetit mistik persian, Mevlana Rumiut si edhe te njohësit persianë përgjithësisht. Mevlana Rumi akuzon filozofët, kur thotë:
Këmbët e filozofëve prej druri janë

Dhe këmba e drurit e paqëndrueshme është

Rumi

Prandaj, poeti duke parë pamundësitë njohëse të mendjes, si e paaftë në perceptimin e së fshehtës dhe duke mos besuar më në fjalët boshe dhe në të filozofuarit, pasi ky i fundit errëson njohjen e së vërtetës, shprehet:

Rrug' e saj nuk mund ta gjejnë sytë tanë
Se vështrimet e njeriut të shkurtër janë

Thelbin tënd s'e di njeriu moj natyrë

Edhe pse thellë kësaj fushe i ka hyrë¹⁴³

¹³⁸ Ezoterika (nga greq. *εσωτερικός*, *esoterikos*, - "i brendshëm"), është mësimi ose dija e së fshehtës. Këto mësimë mbaheshin nga mjeshtrat, të cilëve u mundësohej zbulimi (çvelimi) i së vërtetës *okultike* (së fshehtë). Ezoterizmi anon në përqëndrimin e (mendje) ndriçimit vetjak dhe ushtrimin e brendshëm shpirtëror. Sor me ezoterizëm tregohet zakonisht ndërthurja e sistemeve të mendimit filozofik dhe *fetar* që shfaqen në dukuritë *kultore* si: *magjia*, *alkimia*, *kabalah* dhe besimet misterike dhe *gnostike*.

¹³⁹ Frashëri Naim "Ëndërrime" Tiranë, 2007, fq 50

¹⁴⁰ mendja merr formën e zogut për të çuar lart mendimet e poetit, pasi një nga cilësitë dalluese të tij është fluturimi i tij drejt qiellit, ndaj mendimet e poetit sulen drejt qiellit (simbol i poezisë persiane)

¹⁴¹ po aty, fq 92

¹⁴² po aty fq 92

¹⁴³ po aty fq 92

Poeti sheh zemrën, si të vetmen rrugë që njeriu të arrijë në njohjen e së vërtetës, e cila kjo e fshehtë absorbohet nga kristalizimi e zemrës, pastrimi i saj nga të këqijat, dhe vetëm në këto kushte vetpastrimi, ndërluftimi me të keqen, ai mund të zbulojë esencën e universit. Naimi na shfaqet eklektik në mënyrën se si ai e percepton këtë të fshehtë, zbulimin e saj herë ia atribuon mendjes dhe herë zemrës, dhe kjo vjen pikërisht nga ajo çfarë thamë më lart se si ai qëndron në pozitë e një poeti sesa të një filozofi, që kurrë nuk ndërtoi një sistem të vetin filozofik, por duke qenë një njeri i hapur ndaj doktrinaeve të ndryshme filozofike bëri që ky eklektizëm të vihet re jo vetëm në këtë vepër, por pothuajse në gjithë veprat e tij. Perceptimi i kësaj të vërtete është për poetin tonë, një përcjellshmëri në brendësi, dhe të kuptuarit e saj është funksioni i të qenit në vetvete, është një kërkim në radhë të parë vetpastrues, se vetëm atëhere duke hequr perdet e errëta nga zemra, mund të hyjë drita e së vërtetës. Poeti Naim duke parë pafuqinë e mendjes i drejtohet zemrës, që në thelb ndryshe nga mendja nuk është racionale por ndjesore, vetë shpirti i njeriut, bota e brendshme e tij. Dhe ndryshe nga mendja, zemra ka një gjuhë, dhe kjo gjuhë për poetin është gjuha enigmatike, hyjnore, përmes së cilës poeti arrin të komunikojë me Zotin, që në esencë është vetë misteri(e fshehta) i universit.

Prandaj zemërës kjo gjuhë i është dhënë
 Që t' thotë asaj të fshehtë e pathënë
 Që nga qielli mendja ime të kërcasë
 Në të fshehtëzën e dashur të humbasë

Të lexoj " Fytyrën " e Zotit ke aty
 Dhe selinë¹⁴⁴ të zbulojnë këta sy

Poeti me fjalën (të lexoj), në këtë varg, nuk kupton (leximin) me fjalë, por mbërritjen e njohësit në fazën e përsosmërisë shpirtërore, me qëllim që të qetësohet për bëmat e tij, pasi nuk sheh tjetër përveç Zotit. Shprehja që përdor poeti në këtë varg, "fytyrën e Zotit ke aty", është pjesë e ajetit kur'anor: "Ejnema teualu fe themme vaxhh Allah", dhe ka kuptimin që kudo që vështroni(universin) do të shihni aftësinë e Zotit e madhështinë e Tij. Shohim se vargjet kuranore që përdor poeti shërbejnë si hipertekst, që nënkupton atë relacion bashkues të tekstit origjinal(kurani) me tekstin tjetër (poezia e Naimit). Kjo tregon edhe njëherë atë ndikim që kanë patur librat e shenjtë në poezinë e Naimit, duke huazuar prej tyre vargje dhe motive, me qëllim për të formuluar idetë e tij filozofike dhe mistike, dhe për të na dhënë gjithashtu një vepër origjinale pavarësisht lëndës prej së cilës ai frymëzohej. Dhe nëse vazhdojmë me analizën e vargjeve të mësipërme do të pohojmë se poeti, me fjalët "gjer sa sytë e mi të zbulojnë selinë e Tij", nuk ka kuptimin e njohjes filozofike, ai ka parasysh mbërritjen në përsosmëri e njohje: në atë njohje që e dëshiron qenia e tij dhe në fuqizimin e forcës së dritës së tij; të shohë madhështinë e krijuesit në zemrën e tij.

¹⁴⁴ Selia: froni i Zotit, sipas Kuranit, si mishërim i përsosmërisë shpirtërore

Njohja e kësaj të vërtete (e fshehtë) kuptohet nga poeti si faza më lartë e njohjes njerëzore, që sjell tretjen apo shkëritjen perfundimtare të njeriut me Zotin. Njohja e saj është njohja e së përvetshmes, hyjnore, largimi nga kjo jetë (botë) jo fizikisht, por shpirtërisht dhe bashkimi (fuzioni) me Zotin, kthimi te origjina e tij. Dhe kjo finalizohet përmes këtyre vargjeve:

Shpirti im-o hapi krahët përsëri
Lart në qiejtë, drejt nga Zoti sulu ti

Dhe pse kryeneçe që rropatet kot
Zemra me atë është mbushur plot.

Lamtumirë

Bashkimi me Zotin është për poetin çasti më i bukur që reflekton atë tendosje dhe qetësi shpirtërore që është atribut vetëm i mëshirës së tij. Si përfundim mund të themi se Naimi përmes poezisë së tij arriti që çështjet e ndryshme të karakterit filozofik, metafizik apo edhe mistike t'i poetizonte, t'i hidhte në vargje duke bërë që të ishte një ndër poetët që lëvroi poezinë filozofike duke pasqyruar shpirtin ideal edhe botkuptimin e vet filozofik. Naimi përmes poezisë filozofike do të fuqizonte më shumë pozitën e tij si poet, duke sjellë atë vizion të qartë mbi jetën dhe universin dhe për misterin që qëndron në thelb të këtyre të dyve. Ai përmes dy fjalëve çelës, qiell dhe zemër tregon atë lidhje shpirtërore të njeriut me Perëndinë që ka ekzistuar që në zanafillë, që në krijimin e botës, dhe që njohja e Zotit mund të arrihet vetëm përmes zemrës dhe jo mendjes. Dhe për poetin zemra dhe e fshehta janë sinonime të njëra tjetrës, duke i bashkuar e njëjta gjë, e fshehta si diçka e pazbuluar në univers dhe zemra, bota e brendshme e njeriut, vatra e ndjenjave vetjake, e të fshehtave të tij. Edhe pse në trajtimin e çështjeve filozofike ai do të shfaqet eklektik, kjo nuk do ta pengonte atë që të krijonte një vepër origjinale, duke e renditur atë në ndër poetët që përmes poezisë së tij do të arrinte t'ju jepte zgjidhje problemeve ekzistenciale.

FJALORI ITALISHT-GREQISHT-SHQIP I THIMI MITKOS, VLERAT DHE KARAKTERISTIKAT E TIJ NË PËRQASJE ME FJALORIN E KOSTANDIN KRISTOFORIDHIT

Ma. Doriana Tuxhari

Përmbledhje

Ky shkrim është një ndihmesë në njohjen e fjalësit shqip të fjalorit italisht-greqisht-shqip të Thimi Mitkos. I hartuar rreth viteve 1887-1888 për qëllime praktike komunikimi midis shqipfolësve, italishtfolësve dhe greqishtfolësve, fjalori e pa dritën e botimit në vitin 2013. Ai ndahet në dy pjesë: fjalori tematik, me fjalë të ndara sipas fushave tematike (kulturë, arsim, fe, kafshë, shpendë, orendi, veshje, gatesa, vegla pune, dukuri atmosferike etj.), dhe fjalori bisedimor, me dialogë të jetës së përditshme.

Nëpërmjet krahasimit me leksikon e fjalorit të gjuhës shqipe të Kostandin Kristoforidhit (1904), dalin në pah vlerat e leksikut të fjalorit tematik të Thimi Mitkos, duke plotësuar njohjen tonë për leksikografinë shqiptare, dhe për leksikon e gjuhës shqipe gjatë periudhës së rilindjes kombëtare (çereku i fundit i shek. XIX).

Fjalë kyçe: fjalor, leksik, fjalë, rilindje, krahasim.

1. Leksikografia shqiptare në gjysmën e dytë të shek. XIX është e pasur me fjalorë e fjalës (glosarë) të tipit të vogël, por në atë periudhë të vështirë përpjekjesh për liri e pavarësi nga sundimi osman, pjesa më e madhe e tyre nuk e pa dritën e botimit. Të njëjtin fat pati edhe fjalori trigjuhësh italisht-greqisht-shqip i Thimi Mitkos (1820-1890). Ky fjalor, që mendohet të jetë përfunduar në vitet 1887-1888, u bë e mundur të botohej vetëm pas 125 vjetësh, falë punës plot përkushtim të z. Shpëtim Sala¹⁴⁵.

Thimi Mitkoja, veprimtar i shquar i Lëvizjes Kombëtare të Rilindjes, njihet si themelues i folkloristikës shqiptare, me veprën e njohur “Bleta shqiptare” (botuar në maj të vitit 1878, një muaj para krijimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit), ndërsa veprimtaria e tij në lëmë të gjuhës deri kohët e fundit kishte mbetur pak e njohur. Në “Bleta shqiptare”, siç

¹⁴⁵ Thimi Mitko: *Fjalor tematik dhe bisedimor italisht-greqisht-shqip*. Dorëshkrimi original. Përgatiti për botim: Shpëtim Sala. I, VIII + 326 ff.; Shpëtim Sala, *Fjalori italisht-greqisht-shqip i Thimi Mitkos*. Transliterimi dhe fjalësi i pjesës shqip. II, 298 ff. – Qendra Mbarëkombëtare e Koleksionistëve Shqiptarë. West Print, Tiranë, 2013.

dihet, Mitkoja ka përfshirë lëndë folklorike (këngë të ndryshme, përralla, gjëgjëza, fjalë të urta etj.) nga viset e jugut e të veriut të Shqipërisë, nga Moreja dhe Kalabria. Të njëjtën natyrë gjithëkombëtare ka edhe fjalori i tij italisht-greqisht-shqip, të cilin autori e la në dorëshkrim, së bashku me dy fjalorë të tjerë: një fjalor greqisht-shqip dhe një tjetër shqip-greqisht. Tashmë ka ardhur koha që puna e Mitkos si leksikograf të njihet më mirë. Siç është njoftuar nga studiuesi i zellshëm i dorëshkrimeve të Mitkos, prof. Dhori Q. Qirjazi, lënda e këtyre dy fjalorëve, rreth 6.000 fjalë, po përgatitet prej tij për botim me kritere shkencore¹⁴⁶.

2. Në këtë shkrim do të merremi me fjalorin trigjuhësh tashmë të botuar. Për të nxjerrë në pah pasurinë leksikore dhe rëndësinë e këtij fjalori për leksikografinë shqiptare, pjesën e parë të tij (fjalësin tematik) e kemi krahasuar me fjalorin më të rëndësishëm të hartuar po në atë periudhë, d.m.th. me fjalorin e Kostandin Kristoforidhit.

Nga përjasja e të dy fjalorëve, na rezulton se kanë disa anë të përbashkëta. Së pari, si fjalorë të hartuar në periudhën e Rilindjes Kombëtare, ata pasqyrojnë gjendjen e shqipes në gjysmën e dytë të shek. XIX, më saktë në dhjetëvjeçarët e fundit të këtij shekulli.

Së dyti, të dy fjalorët mund të quhen gjithëkombëtarë, sepse leksiku i tyre përmban fjalë prej të dy dialekteve të shqipes dhe të arbëreshëve të Italisë e të Greqisë. Burimi i mbledhjes së fjalëve është pak a shumë i njëjtë: më fort *gjuha e folur*, por edhe *gjuha e shkruar*.

Fakti që të dy hartuesit ishin miq dhe mbanin letërkëmbim me njëri-tjetrin, është pasqyruar edhe në ngjashmërinë që kanë veprat e tyre leksikografike. Ata shkëmbejnë mendime për mënyrën e hartimit të fjalorit dhe për kuptimet e fjalëve të veçanta. Në njërin prej letrave, që ruhen në Arkivin Qendror të Shtetit dhe në Institutin e Kulturës Popullore, Mitkoja i shkruan Kristoforidhit: “...një herë e një kohë kam studiuar gjuhën tonë dhe kam mbledhur disa fjalë shqipe, të cilat do t’jua dërgoj kur të më dalë rasa. Ndoshta do të jenë të vlefshme për Fjalorin tuaj të gjuhës shqipe”. Kjo është dëshmi se Thimi Mitkoja i kishte hyrë me zell punës për mbledhjen e pasurisë leksikore të gjuhës shqipe. Ai, nga njëra anë, kërkonte mendime dhe këshilla mbi origjinën e fjalëve dhe mbi çështje të ndryshme gjuhësore dhe leksikografike, por edhe i ofronte ndihmën e tij Kristoforidhit.

Mitkoja – “i pari toskë mbledhës i këngëve dhe përrallave popullore”, siç e ka quajtur Gustav Majeri, – ka shënuar mjaft fjalë nga gjuha e folur e dialektit të tij, toskërishtes, si: *ftua-ja*, *grua-ja*, *kushëri-ri*, *liqer-i*, *krahëruar*, *qumështuar-i*, *i paralinduri*, *e paralindura*, *pesëdhietë*, *vëreshtë-a* etj. Por, ashtu si Kristoforidhi, edhe ai i ka kapërcyer kufijtë dialektorë duke shënuar në krah të pjesës më të madhe të lemave edhe sinonimin në gegërishte ose variantin fonetik të gegërishtes, si: *diell* – *dill*, *gjalpë* – *të lymë*, *gjarpër* – *gjarpën*, *hapës* – *çelës* – *qyç*, *krijuasi* – *basi*, *i lartë* – *i naltë*, *lloz* – *shul*, *mëri* – *mëni*, *mëz* – *maz*, *mullinës* – *mullirës*, *nëntë* – *nëndë*, *dhietë* – *dhetë*, *plagë* – *varë*, *qën* – *qen*, *rëra* – *rana*, *verë* – *venë*, *vërer* – *vëner* etj., madje ka edhe raste kur ka shënuar vetëm lemën në gegërishte: *i dhetë*, *landë-a*, *shkruetor-i/-tar*.

Fjalori i Thimi Mitkos, ashtu si ai i Kristoforidhit, përfshin edhe fjalë të të folmeve arbëreshe ose në formën fonetike të këtyre të folmeve, si: *kllishë*, *gluhë*, *bil’-a*, *i nevolëshimë*,

¹⁴⁶ Shih: Dhori Q. Qirjazi: *Fjalë “plaka” dhe fjalë “nuse” në shtresimin leksikor në fjalorët greqisht-shqip të Th. Mitkos dhe P. Kupitorit, Perla*, 18/2013, nr. 2, f. 26-45.

val-i (vaj) etj., të cilat i mësonte nëpërmjet botimeve të kohës dhe letërkëmbimit. Përveç Kristoforidhit, Mitkoja mbante letërkëmbim edhe me shumë atdhetarë e albanologë të tjerë të kohës, si: J. De Rada, G. Majer (1850-1900), U. Jarnik, F. Krispi, Dora d'Istria, Dh. Kamarda, P. Kupitori, Th. Krei, Abdyl Frashëri, V. Dodani etj., nëpërmjet të cilëve ai informohej për botimet e librave dhe të periodikëve të kohës, që ishin një burim prej nga përzgjidhte mbledhjen e fjalëve të fjalorëve të tij. Ashtu si Kristoforidhi, Mitkoja ishte në dijeni të botimeve të kohës në gjuhën shqipe, por dhe të veprave të autorëve të vjetër. Ai ka përfshirë në fjalorin e tij fjalë të Budit e të Bogdanit, si: *bretëk, dryn, dhuna, e shtëmangëtë, farmaku, gurrë, gjakësi, gjytet, i fështirë, kallës, kasulë, këshillë (kuvend), lakëmia, litar, mënia, paq, pasëqyrë, petëka, pëllanga, truall, zonja* etj.

Së treti, të dy autorët, si rilindës, kanë pasur kujdes për të mos përfshirë në fjalorët e tyre fjalë të huaja dhe kanë punuar për mënjanimin e tyre nga gjuha shqipe duke krijuar edhe vetë mjaft fjalë të reja. Mitkoja, aty ku e sheh të mundshëm zëvendësimin e fjalës së huaj, qoftë kjo edhe ndërkombëtarizëm, shënon krahas saj edhe fjalën shqipe, si: *artiqok-u* (e cila kohët e fundit është rimarrë dhe po përdoret gjerësisht në reklamat televizive) – *aqjinare, bejtim – kënkëri, byzyliket – rrahdhuarshet/rrahtë-duarset, filllologë – i kënduashimë, gjeografi – dheshkres, opinga – këpucë, pitrop – kujdestar, legen – dor-larës, kollomboq – misër, podiqe/podjako – përparëca, protimët – atëria, zali – të fikët, kurm – trup, tufan – erë-shtuellësë, vivli – libër* etj.

3. Përveç këtyre anëve të përbashkëta, këta fjalorë kanë edhe disa dallime. Fjalori i Thimi Mitkos është një fjalor tematik trigjuhësh, një libër bisedimesh si ata që botohen sot kryesisht për turistët. Ai do të shërbente për biseda të thjeshta të shqiptarëve me italianë e grekë, ose më gjerë me italishtfolës e greqishtfolës. Ndërsa fjalori i Kostandin Kristoforidhit dihet se është një *fjalor i gjuhës shqipe* (megjithëse ka formën e një fjalori dygjuhësh shqip-greqisht, pasi shpjegimet e shumë fjalëve janë dhënë greqisht). Ai do t'u shërbente shqiptarëve të njihnin pasurinë leksikore të gjuhës së tyre dhe ta përdornin atë në gjuhën e folur e të shkruar.

Për shkak të natyrave të tyre të ndryshme, edhe ndërtimi i dy fjalorëve është i ndryshëm. Te Kristoforidhi fjalët janë renditur alfabetikisht, si në çdo fjalor, ndërsa Thimi Mitkoja e ka ndarë fjalorin në dy pjesë. "Pjesa e parë onomastike" përfshin fjalë të ndara në 46 fusha tematike. Fjalësi tematik përmban fjalë dhe shprehje të fushave të ndryshme të jetës, kulturës, arsimit, fesë, ekonomisë, fjalë që shënojnë vegla pune, kafshë, shpendë, orendi, veshje, gatesa, dukuri atmosferike etj. Pjesa e dytë, e titulluar "Dialogë bisedimorë", përfshin 40 dialogë tematikë. Fjalori i Mitkos përbëhet vetëm nga emra, mbiemra e lokucione emërore dhe nga fjali të paraqitura në formën e dialogëve. Në fjalësin tematik ai nuk jep të dhëna (që janë të shpeshta në fjalorin e Kristoforidhit) për origjinën e fjalës, për kategorinë leksiko-gramatikore, për numrin etj., të cilat janë të shënuara në mënyrë mjaft sistematike te Kristoforidhi. Mitkoja shënon vetëm treguesit e shquarsisë dhe të numrit, por edhe në shënimin e tyre ka luhatje.

Fjalorët ndryshojnë edhe nga pikëpamja e madhësisë së fjalësit. Mitkoja ka rreth 4.160 fjalë lema në fjalësin tematik¹⁴⁷, ndërsa Kristoforidhi rreth tri herë më shumë: 11.675 fjalë.

¹⁴⁷ Ndoshta duke marrë parasysh edhe sinonimet, Shpëtim Sala shënon se fjalësi i fjalorit tregjuhësh të Thimi Mitkos ka 5.093 fjalë (shih vëll. II, f. 44).

Thimi Mitkoja, ndryshe nga Kristoforidhi, ka përfshirë një varg fjalësh, kryesisht të ligjërimit të përditshëm, që u përkasin fushave të ndryshme kuptimore, si:

gatesa, pije dhe lëndë me të cilat ato përgatiten: aguridhe, arrë-myshk, birra, brizollë, budingë, byrek, çajë, çikollatë, domate, kafe, kanellë, kungull, lakërë-lule, lakëror, leqikë/marule, lëpietë, mendrëzë, patlixhan, pazi, pekësimadh, pelin, portokallade, qimion, raki, resmari, rrillë, symadhe etj.;

veshje ose materiale të tyre: astar, çorapet, disgat (e kallcavet), duarza, fermele/neja, gaitan, jakë, këmishë-gjumi, masur-i, nënë-fustane, pallto, gubere, pantallone/brakeshe, pështuellës, pirpiri/beden, pisuz, rodhan, rrobe-shtëpie, syrtyke, shami-qafe, shirit, çapar, tiranta, velladhë, xhamadan, xhoketë etj.;

ndërtimtaria dhe urbanistika: kryeqytet (fjalë e krijuar nga Kristoforidhi), llokantë, maqeli-ja, minare, murnime, panagjyr, peshkëri, piacë, qacë, gjytet a qytet, spital e të marrëvet, spitale, theatrë, udhëkryqe-ja, ulicë e verbrë, xhami etj. Fjalët gërbëje dhe murnime¹⁴⁸, që i përkasin kësaj fushe semantike, të bëjnë të mendosh se Mitkoja e ka njohur “Ëvetarin” e N. Veqilharxhit, ku dalin së pari këto fjalë.

Ndryshe nga Kristoforidhi, Mitkoja ka përfshirë më shumë fjalë të fushës fetare, si emërtime të pjesëve të kishës a të ditëve të kalendarit fetar: *ambo, dera e madhe, ditë e kungimit trupit zotit, dita e shën Thomait, dita e shpyrtëravet, ditë të argerimsime, ditë të përbuleçime, e enjët’ e madhe, gjymësat e kreshmëvet, igumen, java e zezë, kardhinal, këmbanë/këmbona, këmbanore, kollonat e kishës, kor (i kishës), kremtet e apostojëvet, kryeati/patriku/papa, kryedhiak, kryepeshkëvë, kube, të lerit/lindëja e shën Mëriës, e mart’e javës bardhë, mënjilleja e kërshëndellevet/tuke gdirë kërshëndellet, mitropolit, mshallt, e para ditë e kreshmës/e hëna e madhe, peshkëvë, e prënte e zezë, qemës, ristoz/kryqëzuari, rrështaet, shentërore etj. Ndër këto ka edhe fjalë të përdorura kryesisht në veri nga katolikët shqiptarë, si *kardhinal, kërshëndellet*.*

Në disa raste Mitkoja ka dhënë krahas fjalës kryesore e më të njohur edhe sinonimin e saj, që mund të ketë pasur një shtrirje më të kufizuar, p.sh.: *perëndija, zoti-ynë, fare-miri; virgjirat, çupa-t; yliberi, brez i zotit; fjalëtor, kopallamadh; viesht’ e dytë, shëm’Mitri; viesht’ e tretë, shë(r)-Mëhilli; dimëror-i, shën-Endreu etj.*

Edhe pse është treguar i kujdesshëm në përfshirjen e huazimeve, Mitkoja nuk ka ngurruar të përfshijë në fjalor mjaft turqizma e greqizma që ishin atëherë në përdorim, sepse fjalori i tij kishte qëllime praktike, do të shërbente për të biseduar e për t’u marrë vesh për tema të caktuara. Ai ka përfshirë turqizma, si: *fillxhan, gajtan, ibrik, kazan, qilar, sofat, tepsi, xhamadan etj.*¹⁴⁹; greqizma si: *apostima, areti (dhunti, dhuratë), dhamaskë, ipso, kollomboq, papagallo, panagjyr (panair), peksimadh, qimion, vivli (libër) etj.* Nga kjo pikëpamje, mund të themi se fjalori i Mitkos e pasqyron më me vërtetësi sesa Kristoforidhi gjendjen e gjuhës shqipe në gjysmën e dytë të shekullit XIX.

Është me interes të vëmë në dukje se Mitkoja del edhe si përpunues (ndoshta i pari) i vetëdijshëm i formulave e shprehjeve të mirësjelljes dhe të sjelljes së qytetëruar. Pjesa e dytë e fjalorit të tij, “Fjalori bisedimor”, mund të bëhet objekt i studimeve më të thelluara.

¹⁴⁸ Këtë kuvënt (“fjalë”) Gërbjë, që do të thotë, parg dhe kulë si e themi sot...; ...unë sikundër e di mirë që kalasë i thoshin *murnime* dhe forcomje... (N. Veqilharxhi, “Fare i ri ëvetar shqip për djelm nismëtorë”, 1845).

¹⁴⁹ Por te sinonimet *perëndija, zoti-ynë, fare-miri*, siç ka vënë re dhe Sh. Sala, mungon emri *allah*.

Ndërkaq duhet pasur parasysh se Mitkoja fjalorin e tij e hartoi sipas ndonjë modeli të kohës, d.m.th. pati në duar ndonjë fjalor italisht-greqisht, të cilit i shtoi dhe shqipen. Pra ai nuk u nis drejtpërdrejt nga shqipja. Ndërsa Kristoforidhi u nis drejtpërdrejt nga shqipja, mblodhi fjalët e gjuhës shqipe nga goja e popullit e nga botimet dhe i renditi e i përpunoi si fjalor.

4. Në fjalorin e Thimi Mitkos vend të rëndësishëm zënë fjalët e reja (neologjizmat), të cilat mungojnë në fjalorin e K. Kristoforidhit. Ato janë kryesisht fjalë të formuara me mjete të shqipes, të krijuara nga vetë Thimi Mitkoja ose nga rilindës të tjerë, për të zëvendësuar fjalët e huaja që kishin hyrë ndërkaq në gjuhën shqipe ose për të plotësuar fjalët që i mungonin shqipes, p.sh.: *besësë-i* (besëtar), *cipë-gjarpëri* (për dantellë), *derëhapësi*, *derëhapuri*, *derëtar*, *ditëtore*, *dorë-larës* (për lavaman), *dorëshkrume*, *dritshore*, *e imët-a* (për sekondë), *erë-shtiellësa* (për tufan), *fëlliqëri*, *fletore*, *frikësi*, *trëmbësi*, *frysë*, *gojëti*, *grurënar*, *gjellore*, *gjellësë*, *kryeati*, *kryedukë*, *krye-dhëmbëjë*, *të lyerët* (për pomadë), *mal'i ziartë* (për vullkan), *nënë-krenethë*, *nënëkryes*, *nënë-krene*, *ngrohësë*, *qemës*, *rrathduarshet* (për byzzyk), *stresë*, *shkruetor/shkruetar*, *trokëllore*, *udhësë*, *vargu* i *gushës* etj.

Nga pikëpamja e fjalëformimit, në fjalorin e Thimi Mitkos përfshihen një varg fjalësh të prejardhura dhe të përbëra që mungojnë në fjalorin e Kristoforidhit. Kjo dëshmon se disa gjedhe fjalëformimi në atë periudhë kanë qenë më prodhimtare nga ç'paraqiten në fjalorin e Kristoforidhit dhe vijojnë të jenë prodhimtare edhe sot. Në fjalorin e Mitkos, një gjedhe më e përhapur se në fjalorin e Kristoforidhit është formimi parashtesor kryesisht me parashtesat *nën-* dhe *pa-*, me të cilat formohen një varg fjalësh që nuk gjenden në fjalorin e Kristoforidhit, si: *i paçëlyerë*, *i pashpërlarsimë*, *i pa-çimuarë*, *i paçporrurë* dhe *i palarguarë* dhe *i pashtëmangurë*, *i pafisëmë*, *i pagjegjurë*, *i pa-harijshimë*, *i pamentuashimë*, *i pahieshimë*, *i pakallëzuarë*, *i pakujdesë*, *i palëruarë*, *i paligjë*, *i paluajturë* dhe *i palëvizurë*, *i pamarëshimë*, *i pamartuarë*, *i pambesuarë*, *i pamenciëmë*, *i pamësuarë*, *i pan(d)iejschimë*, *i pa-ndarë* dhe *i pa-darë*, *i pandermë*, *i pa-ndërruarë*, *i panginjurë*, *i pangopurë*, *i pa-pajëturë*, *i papiekurë*, *i paqelluashëmë*, *i paqytetëruarë*, *i pa-sosurë*, *i pashtruarë* dhe *i pasheshëmë*, *i patretëshimë*, *i patrushimë*, *i pa-vendë*, *i pa-vëjëjeshimë* etj. Te Mitkoja ka edhe një varg emrash të formuar me parashtesën *nën-*, që gjithashtu mungojnë te Kristoforidhi, si p.sh.: *nënëbishte*, *nënë-fustane*, *nënëgojëzë*, *nënëkonte* dhe *nënëkont*, *nënë-krenethë*, *nënëkryes*, *nënë-krene*, *nënëlaimës*, *nënëmbëret*.

Në fjalorin e Thimi Mitkos bien në sy edhe fjalë të përbëra e të përngjitura që mungojnë në fjalorin e Kristoforidhit, si: *arrë-myshku*, *bëgati-zemërë*, *i bërëmirë*, *cipë-gjarpëri* (dantellë), *dorëshkrume*, *dorështrëngimi*, *dor-larës*, *fare-miri*, *fytyrë-hiri*, *gënjeshtrëmadh*, *gojë-lëshimi*, *gojë-prishëjë*, *grykë-dhëmbëjë*, *gur-argjendi*, *gjellëbërës*, *gjuhë-huajë*, *gjylypërë-kryeje*, *hundë-lartësia*, *hundë-ngrehuria*, *keqpiekurë*, *këmbështrëmbërë*, *këmishë-gjumi*, *kondil-plumbi*, *krye-dhëmbëjë*, *krye-lartësi*, *lëkurë-rregjës*, *lëvdatëkot'*, *lëvdatëmadh*, *mbulesë-zie*, *mëndië-hollë*, *mëndiëmëshehurë*, *mëndiëmprehëtë*, *njeridashurë*, *njeri-dashuri*, *poçe-shurre*, *qiri-sulfuri*, *rriturë-mirë*, *rrobe-shtëpie*, *symadhe*, *shami-qafe*, *shtat-mirë*, *japi-mirë*, *shtëpizë-fushe*, *zemër-bëgati*, *zemër-dashurë*, *zemër-dashuri*, *zemërmadhëri*, *zë-madh*, *zoti-ynë*. Drejtshkrimi i tyre është i paqëndrueshëm, shkruhen herë bashkë e herë me vizë në mes të gjymtyrëve. Një pjesë e këtyre fjalëve nuk janë bërë pjesë e leksikut të shqipes së sotme, megjithatë gjedhet e fjalëformimit sipas të cilave janë krijuar, janë prodhuese edhe sot.

Të gjitha këto veçori dhe të tjera që mund të vërehen në një studim më të thelluar, janë dëshmi e vlerave të fjalorit italisht-greqisht-shqip të Thimi Mitkos. Ato plotësojnë njohjen tonë për leksikun e shqipes gjatë Rilindjes Kombëtare dhe pasurojnë historinë e përpjekjeve të lëvrujesve të shqipes për ta pasuruar atë qoftë me neologjizma të formuar me mjete e mënyra fjalëformimi të shqipes, qoftë me huazime të reja kulturore.

Fjalori trigjuhësh i Thimi Mitkos është një dëshmi e gjendjes gjuhësore dhe e kërkesave të rilindësve për kriteret në të cilat duhej të mbështetej lëvrimi i saj. Ai paraqet një material të vlefshëm për studime më të thelluara në leksikologji, fonetikë, dialektologji, filologji, etnologji etj. Edhe pse nuk u botua dhe nuk u bë i njohur në kohën e vet, ky fjalor pasqyron kriteret kryesore që përdorën leksikografët e mëvonshëm në përzgjedhjen e leksikut të fjalorëve: pastrimin e gjuhës shqipe nga huazimet e panevojshme dhe ruajtjen e fondit leksikor të shqipes.

Ky shkrim është një përpjekje e parë¹⁵⁰ për të dhënë një karakteristikë të përgjithshme të fjalorit trigjuhësh të Mitkos, duke e vendosur në kuadrin historik dhe duke e përqsuar me fjalorin e Kristoforidhit. Qëllimi ynë ka qenë që ta sjellim këtë fjalor në vëmendjen e opinionit shkencor, pasi ai ende është pak i njohur. Kemi bindjen se lënda e pasur gjuhësore që përmban jep mundësi për më shumë analiza, krahasime e vrojtime. Në të ardhmen do të përpiqemi ta thellojmë hulumtimin tonë për këtë fjalor, i pari i kësaj natyre në leksikografinë shqiptare.

Bibliografia

1. Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, "N. P. Veçilbarxhi, 'Fare i ri ëvëtar shqip për djelm nismëtorë, mot'i dytë, 1845'", Tiranë, 1984.
2. Dhori Q. Qirjazi, "Fjalë 'plaka' dhe fjalë 'nuse' në shtresimin leksikor në fjalorët greqisht-shqip të Th. Mitkos dhe P. Kupitorit", *Perla*, 18/2013, nr. 2, f. 26-45.
3. Kostandin Kristoforidhi, "Fjalor shqip-greqisht", Rilindja, Prishtinë, 1977.
4. Shpëtim Sala, "Thimi Mitko, 'Fjalor tematik dhe bisedimor italisht-greqisht-shqip, dorëshkrimi original I'; 'Fjalori italisht-greqisht-shqip i Thimi Mitkos. Transliterimi dhe fjalësi i pjesës shqip II'", Qendra Mbarëkombëtare e Koleksionistëve Shqiptarë, West Print, Tiranë, 2013.

¹⁵⁰ Disa vështrime të përgjithshme e me interes janë dhënë edhe nga Shpëtim Sala, në vëll. II të veprës, f. 51-57.

GJUHA SHQIPE NË TEKSTET TONA SHKOLLORE

Phd.C. Gentiana Shahini¹, Phd.C. Fadil Latifi²

¹SHFMU "Selami Hallaçi", Gjilan, g.shahini@outlook.com

²SHFMU "Selami Hallaçi", Gjilan, fadilatifi@hotmail.com

Abstrakt

Tekstet shkollorë janë dokumente shkollorë, ku shtjellohen njohuritë dhe përmbajtjet shkencore të një lënde, të caktuara në pajtim me kërkesat e programit, mjete pune për nxënësit, një nga burimet kryesore për të fituar njohuri e shprehuri mësimore-edukative dhe në të njëjtën kohë mjete për organizimin dhe zhvillimin e punës së pavarur. Ky studim ka për qëllim analizën e teksteve shkollorë të gjuhës shqipe, përputhjen e tyre me planet dhe programet e reja mësimore, përshtatshmërinë ose jo të teksteve në krahasim me moshën e nxënësve, zhvillimin e shkathtësive komunikuese përmes tyre, gabimet gjuhësore që u përvihen autorëve e të cilat barten edhe te nxënësit dhe ndikojnë në kultivimin e kulturës gjuhësore të tyre etj.

Për hulumtim të mirëfilltë të këtij problemi, janë përdorur disa metoda: metoda e analizës teorike, metoda përshkruese, metoda statistikore dhe metoda krahasuese. Si instrument për matjen e mendimeve të mësimdhënësve janë përdorur pyetësorët. Mostrën tonë e kanë përbërë 132 mësimdhënës të ciklit të ulët dhe 29 mësimdhënës lëndorë (Gjuhë shqipe), gjithsej 161 mësimdhënës. Rezultatet nga hulumtimi tregojnë se gjuha nuk trajtohet si duhet në tekstet e gjuhës shqipe, formulimi jo i mirë i fjalive e vështirëson të kuptuarit e lëndës, gabimet që i ndeshim bëjnë që ato të pranohen si të sakta (për shkak të bindjeve të krijuara të nxënësve ndaj teksteve shkollorë), pasaktësi në rregullat gramatikore me shembuj të mangët, fjalë dhe shprehje të huaja, njësi mësimore të stërngarkuara me informacione dhe të papërshtatshme për moshën dhe nivelin e nxënësve, etj.

Fjalë kyçe: tekste shkollorë, plane dhe programe, gjuha standarde, gabime të ndryshme.

Hyrje

Arritja dhe zbatimi i një kulture gjuhësore në shkallë më të lartë është kusht qenësor, si në procesin edukativo-arsimor, ashtu dhe në fushat tjera të jetës sonë. Për kultivimin, ngulitjen dhe zbatimin e normës letrare, rol dhe përgjegjësi të veçantë kanë shkollat duke pasur për bazë tekstet shkollorë. Mësimi i gjuhës amtare, në çdo sistem arsimor, vlerësohet si çelësi i tërë zhvillimit, i përparimit dhe i suksesit të nxënësit në shkollë dhe pas mbarimit të saj, sepse përvetësimi i gjuhës është një bazë e domosdoshme në zhvillimin intelektual, emocional e shoqëror për nxënësit. Mësimi i gjuhës amtare në shkollën tonë është shoqëruar nga përpjekje të vazhdueshme për ndryshimin e

programeve mësimore dhe të teksteve, duke i rishikuar, rikonceptuar, ristrukturuar dhe përmirësuar ato.

Rëndësia e teksteve shkollore në vendin tonë, si burim kryesor për nxënie, është një ndër faktorët kryesor në zhvillimin e procesit edukativo-arsimor, ndërsa qasja metodologjike e mësimdhënësit, si interpretues i njohurive, duhet të mbështetet në përdorimin e strategjive të reja të mësimdhënies dhe të nxënimit në mësim për t'ua bërë nxënësve më të lehtë dhe më të kapshme ecjen në rrugën e tyre të dijes dhe të rritjes intelektuale.

Thelbi i problemit të këtij punimi, pykëzohet kryesisht në aspektin gjuhësor dhe metodologjik të teksteve të gjuhës shqipe, të vështruara nga më shumë pikëpamje, të cilat do të ndihmojnë në avancimin e teksteve shkollore të gjuhës shqipe dhe në funksionimin praktik të tyre. Të dhënat e këtij hulumtimi do të jenë të dobishme, jo vetëm për nxënësit dhe mësimdhënësit tanë të cilët ballafaqohen në çdo kohë me këtë problematikë, por edhe për autorët e teksteve të gjuhës shqipe, për hartuesit e kurrikulave të gjuhës shqipe dhe për të interesuarit e tjerë.

Gjuha shqipe në tekstet tona shkollore

Gjuha është element kryesor i identitetit individual dhe përbën një nga tiparet themelore të një kombi. Mësimi i gjuhës është proces i cili asnjëherë nuk përfundon, prandaj edhe kërkon përkushtim të madh, sepse ka peshë të veçantë, sidomos në shkollë ngase kryen funksion të dyfishtë: si lëndë kryesore mësimore dhe si gjuhë mësimore për lëndët tjera shkollore. (MASHT, 2005) Përdorimi si duhet i gjuhës profesionale në tekstet mësimore është me rëndësi të veçantë për përvetësimin e dijeve të parapara, për zhvillimin e të menduarit dhe për edukimin gjuhësor të nxënësve.

Çështjen e teksteve shkollore e kanë diskutuar shumë autorë vendorë dhe të huaj, të cilët kanë shprehur këndvështrime të ndryshme. Derisa disa prej tyre janë përqendruar te përmbajtja, në atë se çka duhet të mësojnë nxënësit, në përdorimin e standardit të gjuhës në ato tekste, disa të tjerë interesimin e tyre e kanë shprehur përkitazi me rezultatet e pritura, të cilat pasqyrojnë se çka duhet të jenë në gjendje të dinë dhe të bëjnë nxënësit. Librat shkollorë, përveçse janë të stërngarkuar me materie jopërkatese për moshën e nxënësve, shpesh janë të shkruar me një gjuhë të pakuptueshme. **Thyerjet e normës drejtshkrimore, morfologjike, sintaksore; thyerjet e normës së pikësimimit, janë bërë dukuri në tekstet tona shkollore.** “Zotërimi i normave të gjuhës letrare përbën detyrën kryesore të mësimimit të gjuhës shqipe në shkollë. Mosnjohja e thelbit të secilës prej këtyre normave, e lidhjeve të ndërsjella midis tyre dhe e veçantive të punës me çdonjërin prej tyre, përbën një nga shkaqet e dobësive në zotërimin e gjuhës në shkollë.” (Memushaj, 2012, fq. 85)

Shqetësimi ynë bëhet edhe më i ndjeshëm sot, kur dihet se kushtet e punës, kuadrot për hartimin e teksteve dhe teknologjia e zbatuar për botimin e tyre, ofrojnë shumë më tepër mundësi sesa vite më parë. Megjithatë, për shkak të papërgjegjësisë e të neglizhencës, do të thoshim ne, në radhë të parë të hartuesve të teksteve të tilla, në shkollat tona ndodh të kemi libra jo cilësorë, jo të hartuar e të përgatitur mirë metodologjikisht e gjuhësisht. Kështu që përdorimi i gjuhës në këta libra, në vend që të bëhet shembull për t'ua ndjekur, në vend që të ndihmojë mësimin e gjuhës drejt e mirë, bën shpesh të kundërtën: përhap laramanin e trajtave gjuhësore jonormative në fushën e fonetikës, morfologjisë, sintaksës etj.

Ndër çështjet e ndjeshme në tekstet tona mësimore mund të konsiderohet edhe çështja e përdorimit të fjalëve të huaja, përdorimi i tyre pa përfillur kriterin e moshës dhe aftësitë psiko-motorike të nxënësve, përdorimi vend e pavend dhe përdorimi i gabuar i tyre shpesh paraqet pengesë për përvetësimin e lëndës. Fjala është për njësitë leksikore si këto: *aspekt, botëkuptim, drejtpërdrejt, dukuri, intelektual, kusht, moral, pasojë, pikëpamje, raport, rrethanë, shkak*, etj. Në rast se nxënësit nuk i kuptojnë fjalët që i ndeshin në tekstet mësimore dhe ato nuk shpjegohen nga mësimdhënësit, paraqiten pengesa serioze në të kuptuarit e lëndës.

Gjuha me të cilën shërbehemi në procesin mësimor, duhet t'i përshtatet moshës së nxënësve, natyrës së lëndës mësimore dhe procesit të njohjes. "Gjuha është e domosdoshme për zhvillimin konjitiv, sepse ajo ofron një mënyrë për të shprehur idetë dhe për të bërë pyetje, për të dhënë kategoritë dhe konceptet e të menduarit, si dhe për të bërë lidhjen midis të shkuarës dhe të ardhmes." (Woolfolk, 2011, fq. 45)

Objektiv i përgjithshëm i programeve mësimore të gjuhës shqipe është aftësimi i nxënësve për komunikim të suksesshëm. Komunikim i suksesshëm është rezultat i zhvillimit të shkathhtësive të komunikimit – të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit. Sipas Kornizës së Kurrikulës (2011), nxënësit kosovarë vlerësohen në bazë të shkathhtësive që do t'i fitojnë pas përfundimit të vitit shkollor, por edhe duke u mbështetur në kompetencat e fituara gjatë një viti mësimor. Për t'i përmbushur kërkesat e planeve dhe programeve të lëndës Gjuhë shqipe, autorët e librave shkollorë detyrohen t'i mbushin tekstet e tyre plot me rregulla gramatikore, shpeshherë shumë abstrakte për fëmijët.

Andaj, duke pasur parasysh pasojat e përdorimit të larmishëm të drejtshkrimit tonë të njësuar, veçanërisht autorët e teksteve shkollore, redaksitë e botimeve tona, komisionet e veçanta dhe lektorët e teksteve, duhet të ndiejnë një përgjegjësi më të madhe në respektimin e standardit të gjuhës sonë.

Interpretimi i rezultateve të hulumtimit

Në aspektin teorik, janë analizuar tekstet e gjuhës shqipe prej klasës së parë deri në klasën e pestë, duke përdorur metodën e analizës teorike, metodën përshkruese-deskriptive, metodën krahasuese dhe metodën statistike. Nga aspekti empirik, përmes teknikës së anketimit dhe instrumenteve të hulumtimit - pyetësorëve kemi hulumtuar opinionet e mësimdhënës të cilët kanë paraqitur mostrën, të qëllimshme dhe të zgjedhur rastësisht. Mostrën tonë e kanë përbërë 132 mësimdhënës të ciklit të ulët dhe 29 mësimdhënës lëndorë (Gjuhë shqipe), gjithsej 161 mësimdhënës. Me qenë se mësimdhënësit janë ata të cilët punojnë me tekste shkollore, ata ballafaqohen me probleme të ndryshme të cilat i ndeshin në to. Për ti vënë në pah vështirësitë që ndeshin mësimdhënësit gjatë procesit mësimorë me tekstet shkollore, kemi zhvilluar hulumtimin, ku kemi kërkuar mendimet e një numri të konsideruar të mësimdhënësve që punojnë në shkollat fillore të qytetit dhe të fshatit dhe njëkohësisht kemi krahasuar të dhënat e grumbulluara.

Tabela nr. 1

| | | | | |
|------------|-----------|-----|-----|-----|
| Pyetj a | Përgjigja | | | |
| | a.) | b.) | c.) | d.) |

| | Qytet | | | Fshat | | | Gjithsej | | | Qytet | | | Fshat | | | Gjithsej | | |
|---|-------|-------|----------|-------|-------|----------|----------|-------|----------|-------|-------|----------|-------|-------|----------|----------|-------|----------|
| | Qytet | Fshat | Gjithsej | Qytet | Fshat | Gjithsej | Qytet | Fshat | Gjithsej | Qytet | Fshat | Gjithsej | Qytet | Fshat | Gjithsej | Qytet | Fshat | Gjithsej |
| 1 | 15 | 8 | 23 | 92 | 37 | 129 | 9 | 0 | 9 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | 18 | 10 | 28 | 88 | 31 | 119 | 9 | 3 | 12 | 1 | 1 | 2 | 1 | 1 | 2 | 1 | 1 | 2 |
| 3 | 43 | 27 | 70 | 19 | 6 | 25 | 38 | 6 | 44 | 16 | 6 | 22 | 16 | 6 | 22 | 16 | 6 | 22 |
| 4 | 3 | 1 | 4 | 91 | 30 | 121 | 22 | 14 | 36 | /// | /// | /// | /// | /// | /// | /// | /// | /// |
| 5 | 6 | 2 | 8 | 59 | 21 | 80 | 51 | 22 | 73 | /// | /// | /// | /// | /// | /// | /// | /// | /// |
| 6 | 14 | 3 | 17 | 85 | 28 | 113 | 13 | 14 | 27 | 4 | 0 | 4 | 4 | 0 | 4 | 4 | 0 | 4 |
| 7 | 26 | 11 | 37 | 18 | 1 | 19 | 40 | 22 | 62 | 32 | 11 | 43 | 32 | 11 | 43 | 32 | 11 | 43 |
| 8 | 80 | 32 | 112 | 36 | 13 | 49 | /// | /// | /// | /// | /// | /// | /// | /// | /// | /// | /// | /// |
| 9 | 67 | 26 | 93 | 25 | 15 | 40 | 22 | 4 | 26 | 2 | 0 | 2 | 2 | 0 | 2 | 2 | 0 | 2 |

Të dhënat e grumbulluara nga pyetësi i mbajtur me mësimdhënës

Në pyetjen e parë: *A janë tekstet tona shkollore të përshtatshme për nxënie?*, nga 161 mësimdhënës të anketuar 23 mësues apo 14.28% konsiderojnë se janë plotësisht të përshtatshme, 129 mësues apo 80.12% mesatarisht, 9 mësues apo 5.60% konsiderojnë se janë pak të përshtatshme.

Në pyetjen e dytë: *A i përshtaten tekstet tona shkollore moshës dhe nivelit të nxënësve?*, 28 mësues apo 17.39% mendojnë se i përshtaten plotësisht, 119 mësues apo 73.92% mesatarisht, 12 mësues apo 7.45% pak dhe 2 mësues apo 1.24% mendojnë se tekstet shkollore aspak nuk i përshtaten moshës dhe nivelit të nxënësve.

Në pyetjen e tretë: *Çfarë vlerësoni më shumë në tekstet shkollore?*, 70 mësues apo 43.48% vlerësojnë përmbajtjet, 25 mësues apo 15.53% qasjen metodologjike, 44 mësues apo 27.33% pyetjet, shembujt dhe ilustrimet dhe 22 mësues apo 13.66% vlerësojnë gjuhën e përdorur në tekste shkollore.

Në pyetjen e katërt: *Ç'nivel gjuhësor kanë tekstet aktuale shkollore të ne?*, 4 mësues apo 2.48% konsiderojnë se tekstet aktuale shkollore kanë nivel të ulët gjuhësor, 121 mësues apo 75.16% nivel mesatar gjuhësor dhe 36 mësues apo 22.36% konsiderojnë se tekstet aktuale shkollore kanë nivel të lartë gjuhësor.

Në pyetjen e pestë: *Sa ndikojnë tekstet e gjuhës shqipe në zhvillimin e shkathtësive komunikuese?*, 8 mësues apo 4.97% mendojnë se tekstet aktuale shkollore ndikojnë fare pak, 80 mësues apo 49.69% pjesërisht dhe 73 mësues apo 45.34% mendojnë se tekstet aktuale shkollore ndikojnë plotësisht në zhvillimin e shkathtësive komunikuese. Arsyetimet e mësuesve në këtë pyetje janë të ndryshme, si:

- Gjuha e përdorur në tekste është e pakuptueshme për nxënësit, ndikimi i teksteve është i pjesërishtëm pasi që në zhvillimin e shkathtësive komunikuese ndikojnë edhe faktorë tjerë si familja dhe rrethi ku jeton nxënësi;

- Ndikimi i tyre është i madh sepse nxënësit duke u bazuar në tekste përdorin gjuhën letrare edhe në familje, mësohen të jenë më të lirë në të shprehur dhe në të shkruar, e që gradualisht evitohen edhe gabimet e ndryshme gjuhësore, etj.

Në pyetjen e gjashtë: *A keni ndeshur gabime në tekstet e gjuhës shqipe?*, 17 mësues apo 10.56% pohojnë se kanë ndeshur shumë shpesh gabime në tekstet e gjuhës shqipe, 113

mësues apo 70.19% nganjëherë, 27 mësues apo 16.77% rrallë dhe 4 apo 2.48 pohojnë se asnjëherë nuk kanë ndeshur gabime në tekstet e gjuhës shqipe.

Në pyetjen e shtatë: *Në çfarë gabimesh keni ndeshur më tepër në tekstet e gjuhës shqipe?*, 37 mësues apo 22.98% konsiderojnë se kanë ndeshur gabime drejtshkrimore në tekstet e gjuhës shqipe, 19 mësues apo 11.80% gabime gramatikore, 62 mësues apo 38.51% gabime teknike dhe 43 apo 26.71 konsiderojnë se kanë ndeshur gabime të ndryshme në tekstet e gjuhës shqipe.

Në pyetjen e tetë: *A kanë ndikim ato tek nxënësit tuaj?*, pra është fjala për gabimet që ndeshen në tekstet e gjuhës shqipe, prej 161 mësuesve të anketuar 112 apo 69.56% mendojnë se kanë ndikim tek nxënësit dhe 49 mësues apo 30.44% mendojnë se nuk kanë ndikim tek nxënësit. Në kërkesën për të arsyetuar përgjigjen e qarkuar, mësimdhënësit kanë dhënë mendime të ndryshme, si:

- Gabimet e ndeshura në tekste të gjuhës shqipe kanë ndikim tek nxënësit sepse nxënësit konsiderojnë se çdo gjë e shkruar në tekste shkollore është shkruar drejt dhe vështirë mund të vërehen e të korrigjohen gabimet, e këto gabime pastaj barten edhe në të shkruar edhe në të folur të nxënësve.

- Por ka edhe mësimdhënës të cilët konsiderojnë se gabimet nuk kanë efekt tek nxënësit pasi që ato vërehen me kohë nga mësimdhënësit dhe nxënësit, analizohen, sqarohen dhe përmirësohen.

Në pyetjen e nëntë: *Çfarë bëni ju si mësimdhënës në mënjanimin e këtyre gabimeve?*, 93 apo 57.76% i korrigojnë gabimet, 40 mësues apo 24.85% konsultohen me kolegët, 26 apo 16.15% konsultojnë literaturën profesionale dhe 2 apo 1.24% i kalojnë gabimet pa u ndalur në to.

Në pyetjen e dhjetë: *Çfarë do të kishit ndryshuar në tekstet e gjuhës shqipe?*, pjesa më e madhe e mësimdhënësve kanë dhënë këto propozime apo sugjerime:

Ka njësi mësimore të cilat i hasim në të dy librat, në gjuhë shqipe dhe në lexim. Do të ishte mirë që këto njësi mësimore të përmbliidhen në një tekst;

Të thjeshtohen njësitë në gramatikë, të ketë më shumë shembuj si dhe të parashihen rubrika për ushtrime;

Në gramatikë, të mësohet fillimisht fonetika, pastaj morfologjia dhe në fund të mësohet sintaksa, e jo të kombinohen njësitë, siç ndodhë në disa tekste të gjuhës shqipe.

Temat-njësitë mësimore t'u përshtaten nivelit dhe moshës së nxënësve;

Gjatë hartimit të teksteve të gjuhës shqipe, njësitë mësimore të radhiten prej të thjeshtës kah e ndërlikuara-përbëra dhe temat-njësitë të radhiten sipas stinëve të vitit;

Gjuha e përdorur në tekste të jetë standarde, fjalët e huaja të zëvendësohen me fjalë shqipe dhe të evitohen gabimet e ndryshme të ndeshura në tekste të gjuhës shqipe.

Në tekstet e gjuhës shqipe do të ishte mirë të bëhet rifreskim i materies mësimore duke përfshirë materiale edhe të autorëve të tjerë;

Të formohet një komision profesionistësh duke përfshirë edhe mësimdhënës, të cilët do t'i korrigonin tekstet e gjuhës shqipe, si në aspektin përmbajtjesorë, gjuhësorë, ashtu edhe nga ai teknik.

Konkluzionet dhe masat për përmirësimin e gjendjes

Tekstet shkollore kanë një rëndësi të posaçme për mësimdhënie dhe për të nxënit e suksesshëm të mësimin. Vështruar nga ky prizëm, me botimet shkollore ndër ne nuk mund të mburremi aq. Pavarësisht standardeve të përkufizuara, pavarësisht përvojës së krijuar në hartimin e teksteve, çështja e vlefshmërisë së teksteve mësimore nga shumë aspekte mund të thuhet se ngre më vete një varg problemesh që dëshmojnë se tekstet tona vazhdojnë të hartohen pa kriteret e kërkuara, pa kujdesin e merituar dhe pa profesionalizmin e domosdoshëm.

Gjatë përpunimit të rezultateve të hulumtimit të zhvilluar me mësimdhënës të anketuar janë evidentuar një varg vështirësish të cilat i hasin ata në tekstet e gjuhës shqipe. Gjuha nuk trajtohet si duhet në tekstet e gjuhës shqipe, formulimi jo i mirë i fjalive e vështirëson të kuptuarit e lëndës, gabimet që i ndeshim bëjnë që ato të pranohen si të sakta (për shkak të bindjeve të krijuara të nxënësve ndaj teksteve shkollore), pasaktësi në rregullat gramatikore me shembuj të mangët, fjalë dhe shprehje të huaja, njësi mësimore të stërngarkuara me informacione dhe të papërshtatshme për moshën dhe nivelin e nxënësve, pyetje herë-herë jo të shtruara drejt, kryesisht të lidhura me përmbajtjet mësimore dhe me përgjigjet të gatshme brenda tekstit, të cilat nuk e zhvillojnë të menduarit e nivelit të lartë, etj.

Luhatje të qëndrimeve në mes të mësimdhënësve ka pasur në pyetjen e tretë: *Çfarë vlerësoni më shumë në tekstet shkollore?, ku pjesa më e madhe e mësuesve të ciklit të ulët vlerësojnë përmbajtjet ndërsa mësuesit lëndorë vlerësojnë pyetjet, shembujt dhe ilustrimet; në pyetjen e pestë: Sa ndikojnë tekstet e gjuhës shqipe në zhvillimin e shkathtësive komunikuese?, mësuesit e ciklit të ulët konsiderojnë se tekstet aktuale shkollore ndikojnë pjesërisht, ndërsa mësuesit lëndorë dhe mësuesit që punojnë në fshatra konsiderojnë se tekstet shkollore ndikojnë plotësisht në zhvillimin e shkathtësive komunikuese.*

Bazuar vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna të mësimdhënësve për përmirësimin e gjendjes aktuale janë të nevojshme që të merren masa. Në mesin e këtyre masave janë:

- Planet dhe programet aktuale mësimore të rifreskohen në funksion të ndryshimeve shoqërore, ekonomike, teknologjike dhe shkencore.
- Tekstet shkollore të gjuhës shqipe të jenë në përputhje me planin dhe programin mësimor të miratuar nga MASHT-i.
- Tekstet shkollore t'u përshtaten moshës, nivelit dhe aftësive të nxënësve. Në tekste të përfshihen materiale të cilat do t'u përshtaten pjesës dërmuese të nxënësve të një klase.
- Materialet e përdorura në tekstet shkollore të jenë të vërtetuara shkencërisht, të sjellin informacione të sakta dhe të përtërihen në hap me zhvillimet e kohës, si ato teknologjike, kulturore, artistike, etj.
- Përmbajtjet mësimore të radhiten prej të thjeshtës kah e ndërlikuara, të shoqëruara me shembuj konkret dhe ilustrime të përshtatshme.
- Radhitja e përmbajtjeve të bëhet në bazë të stinëve aktuale të vitit shkollor, e jo të bëhet p. sh. radhitja e poezive si në tekstin Leximi 5: *Ku është pranvera* (faqe 58), *Verë* (faqe 69), *Fillim Vjeshte* (faqe 76).
- Materialet e përfshira në tekste të jenë unike, e jo të përsëriten në disa tekste shkollore, siç ndodh në disa tekste shkollore të gjuhës shqipe, në tregimet: *Rozafati*, *Luli i vocërr*, *Plaku i mençur*, *Fshati im*, *Dhelpra dhe lejleku*, etj.
- Njohuritë për gjuhën të radhiten nga fonetika, morfologjia, sintaksa, si dhe të zgjerohen nëpër klasë.

- Të ketë saktësi në rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore, të shoqëruara me më shumë shembuj.
 - Gjuha në tekste të jetë e pranueshme dhe e kapshme për çdo nivel të nxënësve. Të kihet kujdes në përdorim dhe përshtatje të fjalëve dhe shprehjeve, në formulim të fjalive, paragrafëve, teksteve.
 - Të shpjellohen tekste edukative, që zhvillojnë tolerancën, mirëkuptimin, respektin, dashurinë ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj të tjerëve.
 - T'u iket fjalëve të huaja, duke përdorur fjalë shqipe. Fjalët e panjohura të sqarohen në rubrikat përkatëse.
 - Pyetjet të shtrohen drejt, formulimi i tyre të mos jetë vetëm në nivelin e njohjes dhe të riprodhimit të thjeshtë të informacioneve, por të përfshihen edhe nivelet tjera, si: të kuptuarit, zbatimi, analiza, sinteza dhe vlerësimi, të cilat e zhvillojnë të menduarit e nivelit të lartë.
 - Në tekste shkollore të përfshihen më tepër ilustrime dhe ato t'u përshtaten njërive mësimore.
 - Të rishikohen tekstet dhe evitohen gabimet drejtshkrimore, gramatikore, teknike, të lëshuara në tekste shkollore të gjuhës shqipe.
 - Të hartohet një tekst i vetëm, ku do të përfshihet gjuha dhe letërsia shqipe, e jo të punohet me dy tekste të ngjashme, paralelisht.
 - Gjatë hartimit të teksteve të reja shkollore të kërkohen propozime dhe sugjerime nga ekspertë të fushës së gjuhësisë dhe letërsisë.
 - Të formohen komisione të veçanta, ku do të përfshihen të gjithë akterët që bashkëveprojnë në mënyrë direkte apo indirekte me tekste shkollore.
 - Të përpilohen tekstet shkollore nga më shumë autorë. Bashkëpunimi dhe konsultimi i sa më shumë autorëve gjatë hartimit të një teksti shkollor do të sjellë rezultate më të larta dhe më të frytshme.
 - Tekstet shkollore të botohen në shtëpitë botuese që kanë ekipe të specializuara, teknologji të avancuar dhe material të cilësisë së lartë.
- Shpresojmë se nga të dhënat e këtij hulumtimi dhe rekomandimet e bëra do të përfitojnë jo vetëm nxënësit dhe mësimmësuesit, por edhe autorët e teksteve të gjuhës shqipe, hartuesit e kurrikulave të gjuhës shqipe, MASHT-i, të cilët përmes standardeve të krijuara bëjnë vlerësimin e teksteve shkollore. Gjithashtu, krahas avancimit të teksteve shkollore të gjuhës shqipe do të ndihmohet në ngritje të cilësisë së arsimit dhe të përmirësimit të nxënies së nxënësve në veçanti.

Referencat

- MASHT (2011), Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Prishtinë.
- MASHT (2005). Plani dhe programi, Gjuhë shqipe III, Prishtinë.
www.masht-gov.net/advCms/documents/klasa_3_Gjuhe_shqipe.pdf
- Memushaj, R. (2012). Për shqipen standarde I. Çështje të normës morfologjike dhe drejtshkrimore, Tiranë: INFOTUES.
- Woolfolk, A. (2011). *Psikologji edukimi*, Tiranë: CDE.

BOTA E BRENDSHME E P. MARKOS PËRMES FIGURACIONIT GJUHËSOR E STILISTIK

Greta Jani

Një çështje e rëndësishme e analizës së një vepre letrare është çështja e gjuhës, figuracionit gjuhësor e stilistik të saj, nga ku buron gjallëria dhe fuqia shprehëse e veprës. Letërsia artistike lejon edhe parakupton që gjuha e saj dhe figuracioni në përgjithësi të jenë gjithnjë të freskët dhe origjinalë¹⁵¹. Ky figuracion i përtërirë si dhe lidhje të tjera fjalësh që shkrimtari vendos në veprën e tij janë burim i origjinalitetit të stilit që është një nga kriteret bazë të veprës së tij. Kështu, stili i Petro Markos dallon qartë nga stili i I. Kadaresë, D. Agollit etj.

Dihet që stili është shprehje e botë së brendshme të individit, d.m.th. nëpërmjet stilit shprehen personaliteti i shkrimtarit dhe kushtet psikologjike të tij. Prandaj një gjendje e veçantë emocionale, dallohet nga gjendja normale e përbashkët, i përgjigjet një gjendjeje që, nga pikëpamja gjuhësore dallohet nga shprehjet e përbashkëta dhe të zakonshme.

Vepra e Petro Markos, ashtu si e bashkëkohësve të tij me gjuhën, me pasurimin e përpunimin që i kanë bërë asaj, me zbulimin dhe përdorimin e mjeteve të reja e të panjohura gjuhësore, me shfrytëzimin e mundësive gjuhësore, kanë ndihmuar shumë edhe estetikën e gjuhës, sepse dihet se sa më të pasura e më të larmishme të jenë këto mjete e këto mundësi, aq më e pasur e më e larmishme potencialisht është edhe estetika e gjuhës¹⁵².

Duke kundruar sistemin e pasur figurativ të romanit "Nata e Ustikës" shohim se përmes tij shprehet një botë e pasur shpirtërore, me ndjenja të forta të dashurisë për jetën, njeriun, vendlindjen etj.

Figurat gjuhësore, ato që lidhen me fjalën, kuptimet e saj, lëvizjen kuptimore etj., janë të shumta dhe janë përdorur me mjeshtëri nga autori. Parapëlqimi i disa figurave të caktuara nga ana e shkrimtarit kthehet në tipar dallues të stilit të tij.

Vlera më e madhe e prozës së Markos, stilistike e estetike qëndron veçanërisht në figuracionin e tij shumë të pasur e origjinal. Gjuha e tij dallon për një figuracion spontan, po edhe të befasisëm, të tjeshtë dhe të përbërë që i ka dhënë dorë për të shprehur shumësinë e mendimeve, ndjenjave e për të ngjallur emocione të paharrueshme.

Në romanet e tij janë përdorur figurat fonetike si: aliteracioni, onomatopeja, simbolizmi tingullor; figurat e leksikut si: metafora, krahasimi, epiteti, personifikimi, perifriza,

¹⁵¹ Shkurtaç, Gjovalin, "Kultura e gjuhës", Tiranë, 2006, f. 250.

¹⁵² Islamaj, Shefkije, "Gjuha, ligjërimi, fjala", Prishtinë, 2004, f. 227.

apostrofa, metonimia, oksimoroni, ironia, hiperbola etj.; figurat sintaksore si :shkallëzimi antiteza, inversion, elipsa, asindet, polisindet, anafora, epifora, etj., të cilat përbëjnë strukturën e figuracionit dhe anën estetike të prozës së gjerë të Markos.

Metafora është një nga figurat më të pëlqyera të Markos dhe kjo jo pa arsye. Ai e di mirë se metafora nuk është fakt gjuhësor formal, as “zbukurim i jashtëm, as lojë fjalësh,¹⁵³ po një element i domosdoshëm ideo-artistik, që do ta shfrytëzojë maksimalisht e në shkallë cilësore.

Siç e pamë edhe më lart në këtë studim, lëvizja kuptimore me metaforë paraqet shmangie, ndërsa shmangia e qëllimshme është konstante e qëndrueshme dhe e përhershme në prozën e tij dhe i jep anës stilistike të saj një pasurim të ndjeshëm në shumë plane. Ajo merr kuptim të gjerë filozofik estetik dhe kjo mund të dëshmohet lehtë me një lexim të rëndomtë. Shumë metafora dalin evokuese, emocionale dhe shpesh të përziera me krahasimin.

Më poshtë po paraqesim shembuj metaforash që modelojnë artistikisht dhe pse jo sistematikisht gjuhën e prozës së Markos. P.sh.: *Biseda po ngrohej. Shpresat tona po fishken. Dëgjua borinë e jetës. Oshëtinte himni i jetës. Mendja m'u err. Nata ishte e thellë etj.*

Përsa i përket strukturës më tepër autori përdor metafora me bazë foljen ose metaforat foljore. P.sh.: *Mendimet më rëndonin. Qeshte me zemër. Deti sikur mbulohej me një velenxë tërë xixa shumëngjyrëshe. Dallgët e dëshpërimit përplaseshin në zemrën time. Zëri i saj i atëhershëm kishte humbur në thellësinë e asaj nate. Dëgjoja rrahjet e zemrës së kësaj bote të shqetësuar. Këndoja me shpirt. Sytë e saj si nuk deshën të flisnin me sytë e mi. Dëgjonin erën që këndonte me ëmbëlsi.* I gëlltiti përsëri fjalët. Shpirti arratiset. Mushkëritë u janë bërë shoshë. Deti këto fjalët e mia t'i rrëmbente e t'i çonte në brigjet e Jonit. Gjaku më ishte ndezur. Biseda u thartua. Qielli nxinte. Më kumbonte në tru. M'u drodh zemra. Fjalët e saj më therën në zemër. etj.

Metaforat emërore janë përdorur më pak në krahasim me metaforat foljore, gjithsesi, metafora mbetet figurë mjaft e pëlqyer nga Marko në veprën e tij. Disa metafora emërore janë: *Bisedë e debur nga vallja. Me atë gjuhë të tij të akullit. Buzëqeshje më të mirë se atë të detit, më të gjerë se atë të horizontit. Ekspozitë mjerimi. Duke i rënë lahutës së dertëve të tyre. Shpirt shokërie. Rinia jonë plumb. Njerëz të gjallë me fytyrë e me tesha ngjyrë shkëmbi. Ma bëri gjakun mjegull kjo fjalë “dënohet”. Bëje gur zemrën. Mendime të hidhura. Lëvizte buzët e saj të vogla bojë trëndafili etj.*

Krahasimi paraqet burim të gjerë shprehësie e figurshmërie në romanet e Markos. Duke vënë raporte të reja ndërmjet dukurive e objekteve me anë të krahasimit, Marko ndikon, jo vetëm në rritjen e peshës semantike të tyre, por edhe në krijimin e kuptimit poetik. Marko e përdor këtë figurë të mendimit si kategori estetike a si figurë të analogjisë për krijimin e pamjeve ekspresive, të gjendjeve dhe të mjediseve njerëzore.

Përshkrimet ku janë përdorur krahasime janë më të bukurat, më të gjallat, më të gjerat, janë përshkrime shumë domethënëse dhe lidhen me fakte dhe shoqërime, që kanë të bëjnë me njeriun e jetën e tij, me historinë e tij e të vendit dhe me kulturën materiale dhe shpirtërore të tij. Krahasimi tregon cilësitë e posaçme të sendeve, të dukurive edhe personale, duke zbuluar ngjashmëri dhe ndryshime, që e emocionojnë lexuesin ose i sugjerojnë një këndvështrim të ri të ngjarjeve në vepër.

¹⁵³ Lloshi, Xhevat, "Njohuri për stilistikën", Rilindja, 1988, f. 24.

Përgjithësisht Marko përdor më shumë krahasimin e thjeshtë dhe krahasimet me frazeologjizma, sesa krahasimin e zgjeruar. Me të tilla krahasime është e mbushur edhe jeta e përditshme. Të tilla krahasime në vepër janë: *Shikonin me sytë e tyre si prej qelqi. Si breshka te nallbani. Si bajga në këpucë. Si rrodhëza në gunë. Mendimet vërtiteshin si shqiponjat mbi Tomorr. Vrapoja si mendimi im. Kërcitën si breshëri në çati. Zëri i saj që më ishte bërë si muzika e ëmbël e shpresës dhe e gëzimit. Heshtën si deti, si Ustika. Gëzim si vesa e prillit. etj.* Në bazë të strukturës këto krahasime i klasifikojmë në krahasime të ndërtuara me:

Lidhëzën si + shprehje/shprehje frazeologjike

Zë si të erës kur lot me degët e plepit; Se më shikonte me dhembje, siç shikohet një qengj në mes të ujqve; Ishim tamam si nëntë sardete në një kuti; Zë i humbur , e i rrumbullakët si mesha që ha prifti; Ne vinim rrotull si kuajt në lëmë; Si era e bavës që fliste me detin; Si në një kafkë krimbat e vegjël; Njerëz si skelete që zgjasnin duart e lëshonin zëra; I shtrirë si ata që shtrijnë në qivur; Më dukej si kapaku i ndonjë varri antik; Si nga fundi i dheut ngrihej kënga; Si bletët që vijnë vërdallë nga tymi në zgjua; Ashtu si në kllapi më gjeti agimi në vapor; Zëri i saj më ishte bërë si muzika e ëmbël e shpresës; Shkoi si qeni në vësht; etj.

lidhëzën si + grup emëror

Përpëlitem si peshku në stere; I tundej si gjuhëz kabanë; Fluturonte si shpresat e mia; Dukeshin si xixa drite; Dukej si kaçupi i kovaçit; Lëkundeshim si kufoma e Hamidit...; Ishin kapur si dy mundës; Si kështjella mesjetare; Zmadhohej si plagët e vjetra; Të më ngrinin si një pendë; Me mustaqe si vetulla balerinash; E ne këtu si gurë të ngrirë; Ne e njohim fytyrën e saj si fytyrën e nënës; ...doli një nëndetëse si një balenë vigane; Ishin ngulur si thikë në zemër; Me ata sy që i lëviznin si flakë në erë; Dhe qysh atëherë rri si një thëllëzë e plagosur; I mbështjellë si foshnjë në pelena; Zërat ngriheshin si shigjeta hakmarrëse; Mullari ngrihej si mal në kurrizin tonë;

lidhëzën si + emër

Me mustaqe spic si vetulla; U fry si qumështi; Ecte si breshka; Dritarja është si buhari; Me trup të mbushur si boksier; Shket si ngjala; Na dukej vetja si turistë; Shfrynte si kau; Cof si qeni; Pëllëmbëve të mia të çelura si munxë; I ka shtrirë këmbët kudo si oktapodi; Me pëllëmbë si shpatë; Këtu do të vdesim nga veremi si krimbat; ...po hesht si memec; Kam ngrënë si princi; Ti po e nxjerr kokën si kërmilli; I isha ngjitur shkëmbit si gaforrja; Mizëri njerëzish si skelete; E kisha si mollë; etj.

lidhëzën si + emër në rasën gjinore

Me sytë si të maces; Nofullat i kishte si të kalit; Atë gojë që ma ke si të balenës; Dy sy të mëdhenj si të kalit etj.

dh) lidhëza si + mbiemër

Hante si i babëzitur; U ul si e truar; Duke qeshur si e shkalluar; Dukej si i mjerë; U hodhën përpjetë si të marrë; Unë prisja si i dalldisur; M'u bë si e vdekur; E dashurova si i marrë; Dëgjoja si i marrosur; Ata e ngritën më shumë zërin si të çakërditur etj.

lidhëza si +emër me parafjalë

Për të na rrahur si në dybek; Më dukej vetja si në kllapi; Rrinim si ndër gjemba; U gdhiva si mbi re.

Epiteti, si një figurë me vlerë gjuhësore-letrare, zë vend të dukshëm dhe me rëndësi në sistemin e figuracionit të Markos. Përdorimi i tij shumë i shpeshtë dhe në mënyrë shumë vetjake, është një tregues tjetër i shprehësisë dhe i figurshmërisë së lartë të prozës së tij. Edhe ngjyrimet subjektive, që e shoqërojnë ose që lindin me përdorimin e epitetit paraqesin burim figurshmërie për Markon.

Epitetet në romanin "Nata e Ustikës" kanë vlera të shumta dhe janë të ndërlidhura ngushtësisht me metaforat, metonimitë dhe personifikimet. Funkzioni i tyre nuk është vetëm cilësues, po edhe përcaktues. Me cilësimin dhe përcaktimin, Marko ka arritur tipizime, individualizime dhe karakterizime të veçanta artistike. P.sh.: *Sytë e zjarrtë bojëqielli i lëshojnë shkëndija. Ullinjtë dhe portokallet nxinin në muqëtirën e thellë të natës pa hënë. Me fytyra të djegura, flokë të lëshuar dhe sy të egërsuar, na shikonin sikur do të na hanin. Gëlltiti me pahir lotët e shqetësimit të ëmbël. Vapor i zi çante dallgët. Perëndimi i kuqerremtë, atje në fund të horizontit, kishte kredhur në të kuq një varg resh në formë malesh të largëta. Deti i gjerë me gjuhën e tij të çuditshme, me ngjyrën dhe madhërinë e tij të përjetshme.*

Epitetet e Markos ndërtohen kryesisht me mbiemra të nyjshëm. P.sh.: ëndërr e ligë, flokë të ashpër, ditë të bardha, heshtje e ftohtë, truri i mjegulluar etj.

Personifikimin si figure stilistike e hasim shpesh në prozën e Markos. Ai përdoret për shprehësinë e lartë që mbart kjo, prandaj konsiderohet kategori afektive leksikore e shprehjes së figurshme. Të gjitha objektet sendet dukuritë që personifikohen lidhen me bregdetin, kampin e përqendrimit, luftën, natën etj.

Ashtu si njerëzit edhe objektet e dukuritë natyrore shpirtëzohen dhe përcjellin te lexuesi emocione e përjetime të veçanta. *Deti* ky objekt me rëndësi të veçantë në vepër është gjithmonë aty pranë personazheve dhe si ata, ai hesht, dëgjon, psherëtin nga dhimbja për vuajtjet pa fund të tyre në Ustikë. P.sh.: *Deti hesht. Deti dëgjonte. Vinçi hesht. Një erë shiroku që frynte i bënte dallgët të nxirrnin dhëmbët. Vala e detit nxirrte psherëtimat e saj. Mendja fluturon larg. Burgu merrte frymë me ankth. Areoplanët flisnin. Duart e saj mendonin. Mendimet e mia u shkrinë. U dëgjua gërbitja e zinxhirit. Fashizmi...po jep shpirt. Dëgjonim erën që këndonte me ëmbëlsi në fletët e pjegullave. Fryu një fllad e psherëtiu në degët e qiparisit. Dhe valët që bënin sikur mbllaçiteshin brenda gurëve të errët etj.*

Hiperbola është një krahasim i posaçëm. Kjo figurë e medimit mbart shumë intensitet dhe emocionalitet. Duke e njohur mirë efektin e kësaj figure, si formë e veçantë e metaforës, Marko do të krijojë hiperbola me efekte të shënuara, shprehëse e emocionale, por gjithnjë në kufijtë e mundësive logjike, në raport me rrethanat e faktorët e tjerë në terrenin gjuhësor e artistik. Hiperbolat më të qëlluara i gjejmë në përshkrimet e gjendjeve dhe të rrethanave, ku sillen e jetojnë personazhet e Markos. P.sh.: *Nga fundi i detit, tani në qiell. Deti ishte një pellg i pafund trishtimi. Miliona e miliona zogj vinin si re të dendura nga Afrika dhe binin në nisi... Tani predhat që binin ishin aq të shpeshta, sa kodra nisi të nxibej nga tymi i zi dhe në atë skëterrë të vërtetë dheu dridhej e asgjë, asgjë nuk mund të dallohej, përveç zjarrit që shquante i*

dendur mes shtëllungave të tymit që dridheshin në çdo pëllëmbë toke. Ndjeva piskime, mijëra pickime, në këmbë, në duar në qafë... I shkriu gjaku. Mizat nxinin muret e kalldrëmin etj.

Autori për të na dhënë përmasat e mëdha të dhimbjes për humbjen e Maqos dhe Antonios në romanin “Nata e Ustikës” përdor hiperbolën: Varri juaj do flasë. Dheu-shkëmb lëshonte tinguj të zymtë. Kitara e Alqit sikur vajtonte etj.

Petro Marko parapëlqen kundërvënien në rrafshet e ndryshme, ndaj edhe oksimoroni, si figurë letrare, gjen shprehjen e plotë artistike dhe bëhet tipar dallues i gjuhës së tij. Ndonëse oksimoroni shpreh lidhje të pazakontë logjike, ai në prozën e Markos realizohet me dendësim të madh kuptimor e shprehësi të lartë. Ky dendësim kuptimor i theksuar, ndonjëherë, sjell habi momenti për shkak të shfaqjes së befasishme dhe plot asociacione, por për shkak të shprehjes së tij tejet të qartë, oksimoroni rrallë mbetet i pakuptuar. P.sh.: *Dielli, ai diell i ngrohtë e llagar i Mesdheut, shkëlqente mbi ujën e detit të lodhur nga furtuna e shkurtit. Ato vdekje humanitare i përdor kuestura.. Toni i fjalëve të fundit ishte mallëngjyes dhe i egër, i ngashëryer dhe brutal,... Nuk dallohej nëse ishte i zi apo i bardhë. ... blatimet tokësore dhe qiellore,... Përplasjet shurdhuese dhe monotone të dallgëve të egërsuara etj.*

Oksimoroni stilistik te Marko del me logjikë të nënkuptueshme, me harmoni kuptimore të hetueshme dhe me ndjenjë e shije gjuhësore e artistike.

Shkallëzimi është figurë e mendimit që përftohet nga renditja e fjalëve, pamjeve dhe mendimeve, që nxisin zmadhim ose pakësim gradual të përshtypjes ose të mendimit të parë¹⁵⁴. Shkallëzimet që janë evidentuar në vepër, përgjithësisht, janë me intesitet rritës duke shprehur në një shkallë më të lartë ndjeshmërinë e autorit për gjithçka që ai sheh, ndjen, përjeton, pasi dihet që heroi kryesor i romanit është zëdhënës i autorit në vepër. P.sh.: *Era e rëndë burgut, hekurat e ftohtë, psherëtimat e shokëve hyjnë e dalin në nervat e mi, në trurin tim. Sonja e quajnë! Emër të mirë ka. Dhe zërin shumë të ëmbël. Dhe duart shumë të buta... e shumë të ngrohta... Pushton sytë, fytyrën, nervat, frymëmarrjen.Gratë thërrisnin. Fëmijët qanin. Urdhërat e ushtarakëve shtoheshin e egërsobeshin. Ky zë më tingëlloi fort në zemër e në tru e në gjak e në palcë... Sikur mundoheshin të mbulonin thirrjet, sharjet, këngët, urdhërat... Qejfi i tij ishte të shikonte fytyra të tmerruara, të vrara, të munduara, të shtypura.etj.*

Shkallëzimi ka raste kur nuk përfundon brenda një fjalie, por shtrihet në dy apo tre fjali të cilat përcjellin emocione të forta e përjetime ndjenjash të paharruara.

Një tjetër figurë e mendimit, por që bazohet në ballafaqimin e të kundërtave është edhe *antiteza*. Ajo shpreh edhe përmbledh gjithë idenë e autorit duke mënjanuar kështu përshkrime të gjata e të rëndomta të skenave ku zhvillohen ngjarjet apo të ndjenjave të personazheve etj. P.sh.:

Sa vinin e sa dilnin, sa i shpinin në kuesturë. Se në fund do të fitojnë të gjallët dhe do të humbasin të vdekurit. Gdhihej e ngrysej . Ngrysej e gdhihej. Këndojnë e qajnë, qajnë gratë tona, harruam hekurat , lagështirën , çimenton , çimkat, qypin-nevojtoje që mbanim aty ditë e natë, aty dita dhe nata ishin një. Më vinte mirë e më vinte turp. Më vinte t’i hidhesha e ta përqafoja e t’i thosha mijëra fjalë ose më mirë një fjalë. Herë syhapur, herë symbyllur e kalova natën gjersa ra agimi...etj.

Një tipar që dallon stilin e Markos është edhe konçiziteti. Të shprehurit me fjali të shkurtra për nga ndërtimi, por të plota për nga kuptimi është karakteristikë e prozës së tij. Shpesh ndodh që nga tërësia e fjalisë të mungojnë një apo disa fjalë, në atë mënyrë që

¹⁵⁴ Ombashi, Rahim, “Hyrtje në teorinë e letërsisë”, Kotti, 2006, f. 98.

domethënia e tërësisë së saj mund të kuptohet. Kështu përftohet figura e *elipsës* e cila realizon dendësi, thukëti dhe fuqi në shprehjen e mendimeve e qëndrimeve të autorit apo personazheve. Më poshtë po paraqesim disa fjali eliptike: *Para fiton mjaft. Gratë i pëlqejnë. Sidomos italiankat e kuplarave...*

Kthehem nga muri. Mbaj frymën. Vetëm gramafoni, ja atje përkundruall, në shtëpinë publike dëgjohet. Një tango...një tango... Ata kërcëjnë...jetojnë jetën e tyre. Dhe unë jetën time. U ula. I lidhur. I vetëm. Pa njeri. Pa asnjë shok. Njëzet metra larg ishte vapori...Njëzet metra Shqipëri akoma! Numëronim çastet e orët e ditët e sidomos netët... Netët e tmerrshme... Të mërzit dora jote . Këmba jote. Këmisha jote ... Të gjithë më dukeshin si pleq te fishkur. Si pleq me oftikë. Fjalë më pikëlluese thanë. Fjalë më të trishtuara. Ah, të kisha pak ujë nga ai i burimeve tona. Ujë nga ai i lumenjëve tanë... Përposh dëgjohej një gramafon. Dhe të qeshura. Të qeshura vajzash. Vetëm këto fjalë u thanë. Asgjë tjetër. Shikoja pranë derës kurorën. Pa lule. Vetëm me gjethe ulliri e limoni. Herë më dukej si e egërsuar. Herë si prej mermeri. Fliste si e përhumbur. Si në ëndërr. Përsëritja e tingujve të caktuar apo e fjalëve në veprën e Markos, sidomos brenda një fjalie bën që të kthejmë vëmendjen te gjuha, në atë që është trupi i fjalës e jo kuptimi i saj. *Përsëritja* është qasje shumë e ndërlikuar stilistike, në të cilën fjala e caktuar fiton çdo herë kuptim të ri, për shkak të relacionit të saj të ri, ndaj fjalëve të mëparshme ose ndaj fjalëve të ardhshme¹⁵⁵.

Kjo figurë e diksionit në vepër i jep shprehjes gjuhësore intesitet karakteristik duke pasuruar përmbajtjen kuptimore dhe domethënien emocionale të saj. P.sh.: *Më duket se ishte me gërsbeta, me dy gërsbeta të mëdhenj të hedhur përpara. Trembi gjakun tim të mjegulluar, trembi natën e burgut... Më dukej se buzëqeshja. Më dukej lehtësohesha. Më dukej sikur lozja... Koka më rëndonte. Trupi më rëndonte. Duart më rëndonin... Ja ku janë banditët...Ja ku janë kasapët e popullit Italian! Nuk ishte lagur nga lagështia e çimentos dhe nuk ishte ftohur nga ftohtësia e hekurave. Ashtu e kishim shprehjen. Ashtu e kishim zërin. Ashtu e kishim zemrën. Shkëmbinjtë nxinin më shumë, siç nxinin më shumë fytyrat e të uriturve. Ky fill i lidhjes me jetën është torturë e përhershme. Është tërbim dhe kujtesë, një trishtim më kaploi, deti ishte një pellg i pafund trishtimi , qiparisat ishin majat e një gjelbërimit të trishtuar, edhe kjo këngë monotone e trenit sikur ligjëronte trishtimin e lodhjes së tij. Zëri i saj i atëhershëm kishte humbur në thellësitë e saj nate, në thellësitë e trupit tim.*

Kur lexon prozat e Markos nuk mund të mos ndalesh edhe tek një figurë tjetër e shqiptimit poetik e cila përdoret shpesh nga autori me qëllim që lexuesi të ndjejë e përjetojë njëlloj si personazhet e tij. Është figura e *pyetjes retorike* përmes së cilës përjeton nga afër gjendjen shpirtërore të Andreas në momentin kur njeh dhe dashuron Sonjën apo të përjetosh fatin tragjik të personazheve, vuajtjet e brengat e tyre të mëdha në burg e më pas në kampin e përqendrimit. P.sh.: *Pse po ngrij? Pse po mërdhij? Apo, siç ishte edhe salla e ftohtë, e zbrazët ashtu ishte edhe koka ime? Ç'bëja aty brenda në pellg...në pellg...po dale të pi ujë...ujë. Po pse uji është i ngrirë...Pse s'del nga xhami i zi...Ç'është ky xham i zi këtu? Kush e thërrmoi xhamin... po pse të lahem mbi xhamin e thërrmuar? A thua edhe në shpirtin tim po binte nata e errët?... Pse flet si e truar? Si e mjerë?*

¹⁵⁵ Ombashi, Rahim, "Hyrije në teorinë e letërsisë", Kotti, 2006, f. 70.

Në letërsi për nevoja të shprehjes artistike, mund të përdoret gjithçka që i shërben me efekt plotësimi të funksionit artistik¹⁵⁶. Figurat gjuhësore e stilistike kanë përherë vend të posaçëm në të.

Si përfundim, theksojmë se Petro Marko është shkrimtari që botën e tij shpirtërore e ka shprehur në prozën e tij përmes figuracionit të pasur e të larmishëm, gjuhësor e stilistik. Ai dëshmon se e njej mirë fjalën shqipe, kuptimin e saj, di ta përdorë atë kur duhet dhe ku duhet duke realizuar kështu përshkrime të bukura e personazhe të individualizuar, që të mbeten gjatë në kujtesë.

Bibliografia:

- Islamaj, Shefkie, (2004) "Gjuha, ligjërimi, fjala", Prishtinë.
 Lloshi, Xhevat, (1988) "Njohuri për stilistikën", Rilindja.
 Marko, Petro, (2007) "Nata e Ustikës", Tiranë.
 Ombashi, Rahim, (2006) "Hyrje në teorinë e letërsisë", Kotti.
 Shkurtaj, Gjovalin, (2006) "Kultura e gjuhës", Tiranë.
 Shkurtaj, Gjovalin, (2009) "Pesha e fjalës shqipe", Tiranë.

¹⁵⁶ Shkurtaj, Gjovalin, Pesha e fjalës shqipe, UFO Press, Tiranë, 2009, f. 6.

DY KODIKË EK FONETIKË TË SHEK. XI NË ARKIVIN QËNDROR TË SHTETIT SHQIPTAR

Doc. Dr. Holta Sina (Kilica)

Pedagoge në Universitetin e Arteve, Tiranë

Kodikët ekfonetikë të AQSH janë pjesë e listës së 100 kodikëve¹⁵⁷ që disponon ky arkiv në fondin me numër 488, nga ku 18 kodikë janë me shenjëzim muzikor bizantin dhe, konkretisht 11 prej tyre me shenjëzim ekfonetik.

Por çfarë janë së pari kodikët ekfonetike?

Ata janë dorëshkrime me përmbajtje biblike, ungjillore, liturgjike etj., pra përgjithësisht teologjike-kishtarë, të cilët përveç tekstit të shkruar në gjuhën greke kanë edhe shenjëzim muzikor (mbitekst) të periudhës së parë, e cila njihet si periudha ekfonetike që përfshin shekujt ~ IV-XV¹⁵⁸.

Për rrjedhojë, periudha ekfonetike është dhe periudha me një vlerë të shtuar historike e dokumentare, pasi është pikënisja nga mori udhën dhe “rrugëtoi” shkrimi e këndimi bizantin në shekuj. Në historinë e muzikës bizantine dhe pasbizantine, njihen pesë etapa (periudha) në të cilat ka kaluar muzika kishtarë e ritit orthodhoks, etapa të cilat, tashmë janë të njohura dhe të aprovuara në parim nga studiuesit evropianë e më gjerë, por me ndryshime në lidhje me kohëzgjatjen dhe karakteristika të veçanta të secilës prej tyre¹⁵⁹. Këto ndarje apo gjykime “ndryshe” të studiuesve, sidomos për kohëzgjatjen e këtyre periudhave, justifikohen me faktin se nuk ka një kufi ndarës të menjëhershëm mes njerës apo tjetrës etapë kohore, pasi sistemi pararendës i shenjësimit muzikor vijon të “bashkëjetojë” për njëfarë kohe edhe në periudhën pasardhëse pra, njëkohshëm me sistemin tjetër më të avancuar.

Konkretisht, periudha ekfonetike është periudha që shënon dhe themelin e sistemit të shkrimit dhe këndimit bizantin si dhe është periudha me kohëzgjatjen më të madhe, rreth 12 shekuj. Specifikisht, me termin ekfonetik është nënkuptuar ai sistem i shenjave - neumave, me të cilin shkruhet melodja dhe këndohen perikopetë e ungjijve. Në kuptimin etimologjik, termi ekfonetik do të thotë “Lexim me zë të lartë”, term i përdorur fillimisht nga dijetari grek Tzetzes¹⁶⁰, ndërsa bizantologu i njohur Tardo bën një shpjegim pak më të ndryshëm, kur pohon se “ekfonesis quhet lutja apo mbyllja e lutjes” të cilën prifti e

¹⁵⁷ Tekste liturgjike me neuma (shenja) bizantine.

¹⁵⁸ Hoeg, C. *La notation ekphonetique*, Copenhagen, MMB Subsidia, Levin Munskgaard, Ejvar Munskgaard, 1935, f. 103-109.

¹⁵⁹ Për periudhizimin (etapat) e muzikës bizantine, jemi referuar studiuesve të cituar më poshtë, duke qenë në të njëjtën linjë me ta, pasi ka edhe të tjerë studiues, të cilët kanë një tjetër gjykim (ndjekin tjetër linjë) në lidhje me ndarjen e etapave (periudhave muzikore).












¹⁶⁰ Tzetzes, J. I epikoisis tis parasimantiqis ton Vizantinon, Parnassos 9/ 1885, f. 441.



thotë me zë të lartë dhe të modular lehtë d.m.th.ekfonos”¹⁶¹. Në këtë kontekst, njëserë studiuesish e pohojnë se ndryshe ky shkrim është quajtur edhe shkrimi i të kënduarit recitativ, pasi në këtë periudhë, meloditë bizantine ekfonetike, ndërtoheshin mbi një karakter të theksuar recitativ, gjë që rridhte nga mënyra e leximit dhe njëkohësisht e këndimit të teksteve liturgjike, ku melodite ishin quasi parlando¹⁶². Interpretimi në këtë mënyrë qëndron në kufirin midis tekstit të folur dhe melodisë së kënduar.

Metri & Ritmi i stilit recitativ në të kënduarin ekfonetik të këtyre kodikëve nuk është i përcaktuar. Është rënë dakort nga studiuesit, që si njësi matëse e transkriptimit, të merret vlera 1/8 për një neumë të thjeshtë dhe 1/4 për një neumë të dyfishtë.


Melodia recitative zhvillohet në varësi të ritmeve dhe thekseve të fjalës, të cilat janë të kombinuara me ato të prozodisë, por nga ana tjetër, ajo nuk u nënshtrohet rregullave të kësaj të fundit, pasi shkrimi ekfonetik ka sistemin e vet të shenjzimit dhe njëkohësisht rregulla të përcaktuara të përdorimit dhe kombinimit të tyre. Përcaktimi i lëvizjes, tempit apo metrit saktësohen vetëm në periudhën e fundit, atë krisantine.


Për një njohje më shumë, shenjat (neumat) bizantine që krijuan sistemin e parë të shenjzimit, të paraqitura kaligrafikisht, janë të ndara në dy kategori (të cilat kanë rregullat e tyre të çiftëzimit shenjë me shenjë):

shenjat e thjeshta: Okse-ja  ; Vare-ja  ; Sirmantiqi-ja  ; Kathist-i 
 ; Kremast-i  ; Sinemba  ; Paraklitiqi-ja  (ose  etj.) ; Apostrof-i 
 ; Tele-ja  (ose  etj.)

si dhe shenjat e përbëra (të dyfishta): Okse-ja e dyfishtë  ; Vare-ja e dyfishtë  ;

Kentimata  (ose  ose  etj.); Apeso Ekso   ;

Hipokrisis me dy Apostrof  , Hipokrisis me tre Apostrof  (në raste të

veçanta dhe me 4 Apaostrof¹⁶³) si dhe Apostrofoi  .

Këto shenja tregojnë tinguj me lartësi pak a shumë të fiksuara në raport me një tingull referencë (tingullin bazë, tonikën)¹⁶⁴.

¹⁶¹ Tardo, L. *Lantica melurgia bizantina*, Grottaferrata, 1938, i ristampa Roma, 2005, f. 48.

¹⁶² Wellesz, E. *A Histori of the Byzantinischen Music and bibliography*, Oxford, 1961, f. 249.

¹⁶³ Tek kodiku i Beratit nr. 16, shihet një tendencë më e madhe se në kodikët e tjerë ekfonetikë të AQSH-së, për të përdorur Hipokrisis në të treja format (me dy, tre dhe katër Apostrof) dhe, për më tepër, përdorimi i veçantë i Hipokrisis me katër Apostrof, dëshmon për një ambitus më të madh të zërit të psaltit, gjë që nuk është konstatuar tek kodikët paraardhës ekfonetikë (kuinta fa – do dhe anasjelltas).

¹⁶⁴ Shupo, S. *Muzika bizantine. Shkrimi muzikor dhe sistemi modal*, Shtëpia botuese “Libri universitar”, Tiranë, 1997, f. 8 - 9.

Duke i'u rikthyer objektit të këtij kumtimi, siç u përmend edhe në hyrje të tij, fondi i kodikëve muzikologjikë në AQSH, arkivon gjithsej 18 kodikë me neuma muzikore bizantine; 11 prej tyre janë kodikë ekfonetikë, ku i pari që hap këtë listim është pikërisht Kodiku i Purpurt i Beratit, "Beratinus-1" shek. VI, në të cilin, së fundmi, janë "zbuluar" neuma bizantine në fletët 45, 111 dhe 156 (ku tek kjo e fundit, neumat janë tepër arkaike të periudhës ekfonetike)¹⁶⁵. Më pas, në rradhë, vjen kodiku nr. 3 i Beratit i shek. IX, i cili paraqitet si një kodik i plotë me shenjëzim muzikor bizantin dhe pas tij renditen përkatësisht kodiku i Vlorës nr. 7 dhe ai i Beratit nr. 8, të cilët i përkasin (sipas karakteristikave të tyre) ~ shek. XI, shekullit të skizmës së madhe.

Përpara se të ndalemi konkretisht në këta dy të fundit, po ju njohim me listën e plotë të kodikëve ekfonetikë të dokumentuar dhe të pasaportizuar të këtij fondi:

Kod. i Purpurt Br. nr. 1 shek. VI, dy ungjijsh; Kod. Br. nr. 3 shek. IX, perikope ungjijsh; Kod. i VI. nr. 7 shek. XI, per. ungj.; Kod. Br. nr. 8 shek. XI, per. ungj.; Kod. Br. nr. 9, shek. XI-XIII, per. ungj.; Kod. Br. nr. 15 shek. XII-XIII, katërungjill; Kod. Br. nr. 16 shek. XIII, per. ungj.; Kodiku i Br. nr. 21 shek. XII, per. ungj.; Kod. Br. nr. 26 shek. XIV, katërungjill; Kod. Br. nr. 89, shek. XIV, per. ungj.; Kod. Vosk. (frag.) nr. 5 shek. XIV, per. ungj.

Këta kodikë ekfonetikë i përkasin periudhës së shekujve VI-XIV dhe rrokin një har kohor prej 9 shekujsh.

Konkretisht, kodiku i Vlorës nr. 7, i shek. ~XI është perikope ungjijsh në pergamenë, me 287 fletë. Përmasat janë 27 x 22.3 cm. Kodiku përmban perikope ungjijsh, fragmente relativisht të plota. Teksti liturgjik është në dy kolona për fletë, me 21 rreshta, në greqishten e vjetër.

Ky kodik bën pjesë në familjen e dorëshkrimeve krysografike (të arta)¹⁶⁶, ku konkretisht një pjesë e shkrimit është prej ari. Studiuesi Sh. Sinani sjell një tjetër fakt se në listën e kodikëve të Fondit 488 të AQSH-së si dhe në "Katalogun..." e Th. Popës, ky kodik vlerësohet si kodik i gjetur në Berat dhe ka ngjashmëri me kodikun e 4-t dhe të 5-të të Beratit që janë kodikë të shek. X (kjo në lidhje me tekstin liturgjik), por sipas vinjetës në fletën 3 të kodikut, siç pohon studiuesi Th. Popa "kjo vinjetë është e ngjashme me një vinjetë të Psaltrit të Petërburgut (Cod. Gr. 214); me një vinjetë të Cod. Gr. 44 të Patmosit dhe me një tjetër të Cod. 110 të Oksfordit" thuhet se janë "të gjithë të shek. të 10-të, deri shek. i 11-të"¹⁶⁷. Ndërsa, në botimin "Albanica - 1" konsiderohet "kodik i Vlorës" dhe ky është përcaktimi më i saktë i vendit të origjinës¹⁶⁸.

Gjithashtu, kodiku bën pjesë në familjen e ungjijve gërmëvegjël (minuscule), shkruar me ngjyrë kafe ku, siç u pohua, një pjesë e tij është prej ari, kurse shkrimi muzikor ekfonetik është me ngjyrë të kuqe.

Kapakët janë prej dërrase, veshur me pëlhurë në ngjyrë blu. Në faqen e sipërme ka një medalion argjendi ku është punuar figura e Krishtit. Kjo mban datën 1886. Kurse kapaku i faqes së poshtme ka një pllakë argjendi në formë trapezoidi, me skenën e kryqëzimit të Krishtit. Punimi i këtyre ilustrimeve është me forma naive, pa art¹⁶⁹.

Kodiku ka pësuar dëmtime të tilla si brejtje nga insektet, zbehje të tekstit, grisje, prerje, shqitje, të cilat janë prezente në fletë të ndryshme të tij.

¹⁶⁵ Shupo, S. *Gjurmët më të lashta të shkrimit muzikor bizantin në Shqipëri: Neumat ekfonetike në Codex Graecus Purpureus Beratinus, Shek. VI*. Documentation and communication Center for Regional Music, Mvsica Albanica, Studime dhe dokumente IV, Asmus, Tiranë, 2008, f. 11 – 30.

¹⁶⁶ Konkretisht, në listën e kodikëve ekfonetikë, kodikët krysografikë janë: kodiku i Vlorës nr. 7; i Beratit nr. 15 dhe i Beratit nr. 89 si dhe *Beratinus - 1*, me elementë krysografikë.

¹⁶⁷ *Kodikët e Shqipërisë* (botim shkencor – kritik i ilustruar), DPA dhe UNESCO, Tiranë, 2003, f. 92.

¹⁶⁸ Sinani, Sh. *Kodikët e Shqipërisë në "Kujtesën e Botës"*, Studim monografik, ASHSH, Tiranë, 2010, f. 104 - 105.

¹⁶⁹ *Ibid.*

Në këtë kodik, neumat muzikore ekfonetike janë shkruar sipër, poshtë dhe në mes të pjesëve të tekstit si p.sh, Hipokrisis, e cila është një neumë vertikale që vendin e saj e ka më shumë në mes dhe më rrallë anash kolonës së tekstit.

Në disa fletë shkrimi me ngjyrë të kuqe nuk është shumë i dallueshëm pasi gjykohet se shkruesi ka përdorur të njëjtën penë si për tekstin ashtu edhe për neumat ekfonetike, por e ka ngjyer në dy bojra të ndryshme. Kjo vihet re që në pjesën e parë të ungjillit, tek disa prej gërmave të tekstit, ku ngjyra e kuqe është më e dallueshme se ngjyra kafe.

Kaligrafia e neumave është më e lakuar (më e rrumbullakosur) me bishta më të shkurtër dhe ka ngjashmeri me kaligrafinë e kodikut të Beratit nr. 8. Diferencohen vetëm në kombinimet e ndryshme të neumave ekfonetike.

Nga analiza konkrete, konstatohet përdorimi i shenjave ornamentale (Sirmantiqi-ja dhe Paraklitiqi-ja) të cilat dëshmojnë prirjen melizmatike, që në fillim të këtij kodiku (në himnin e parë të tij). Lëvizja melodike dhe intervale pasurohet nga njëri kodik në tjetrin, gjë të cilën e dëshmon edhe shkrimi ekfonetik i kodikut të Vlorës nr. 7, konkretisht që në fillim, në himnin e parë të tij, ku largësia më e madhe intervalore midis


Hipokrisis me tre Apostrof-ë ($\overset{\curvearrowright}{\cup}$) - pikës më të ulët dhe Okse-së ($\overset{\curvearrowleft}{\cup}$) - pikës më të lartë, krijon intervalin e kuintës ngjitëse (sol - re) të shfaqur disa herë.



Kodiku i Vlorës nr. 7, f. 1r
(Foto marrë nga AQSH)

Edhe kodiku i Beratit nr. 8 është gjithashtu perikope ungjijsh në pergamenë, me 348 fletë gjithsej. Përmasat e tij janë 26.4 x 21.4 cm (duke llogaritur përmasat e fletës së brendshme). Kodiku përmban fragmente të ungjijve sipas Mateut, Lukës dhe Markut. Ka, gjithashtu, dhe minej gjithëvjeter (nga shtatori në gusht).

Teksti liturgjik i këtij kodiku është në dy kolona, gjermëvogël, dhe vihet re ndryshim kaligrafik gjatë fletëve të tij, duke dëshmuar se është shkruar nga dy duar, gjë që e dëshmon nga ana tjetër edhe numri i ndryshëm i rreshtave të kolonave (sipas shkruesve, kodikografëve). Kjo vërtetohet edhe përcaktimin e Th. Popës, që mendon se dorëshkrimi është dypjesësh, dy duarsh, por sipas studiuesit Sh. Sinani “është i pamjaftueshëm argumenti i tij se mund të jetë dykohësh dhe se pjesa e dytë duhet të jetë më e vonët se shekulli të XI”¹⁷⁰. Ky kodik është gjykuar nga studiuesi R. L. Mullen si kodik i shek. XI. Duke u nisur nga referencat e mëparshme të studiuesve Koder – Trapp dhe Popa, ai pohon se “ose Koder dhe Trapp, ose Popa, gabohen në lidhje me datën”¹⁷¹. \



Kodikut i Beratit nr. 8, f. 1r

¹⁷⁰ Sinani, Sh. Kodikët e Shqipërisë në “Kujtesën e Botës”, f. 106.

¹⁷¹ Kodikët e Shqipërisë (botim shkencor – kritik i ilustruar), f. 218.

(Foto marrë nga AQSH)

Ngjyra shkrimit të tekstit është me ngjyrë kafe të çelët deri në faqen 43, kafe të errët deri në fletën 182 dhe kafe të errët në të zezë si dhe të shkruar më imët, përkatësisht në fletët 288-292.

Në përgjithësi gjendja fizike e kodikut është e mirë, por me mungesë të dy fletëve të para, të cilat nuk egzistojnë (janë grisur), kështu që kodiku fillon në fletën numër 3. Ndërsa, dy kapakët e kodikut janë origjinalë, ku vihen re dëmtime të vogla anësore. Vinjetat që gjenden, përkatësisht, në fletët 3 dhe 100 janë të dëmtuara. Por, ka mjaft vinjeta dhe shkronja nisëtoze të zbuluara, veçanërisht në hyrje të fragmenteve ungjillore.

Shkrimi muzikor ekfonetik në këtë kodik, është përgjithësisht i rrumbullakosur, por stili kaligrafik është i shkujdesur. Kjo kaligrafi vihet re deri në fletën 10, ku shkrimi me bojë të kuqe është i trashur dhe shumë i shkujdesur, supozohet se është dhe pjesa e shkruarit (shenjzuesit) të parë, më e herëshmjja. Deri në fletën 43 ky shkrim bëhet më i rrumbullakosur dhe me bishta më të shkurtër, ndërsa neumat vijojnë të jenë shkruar trashë me ngjyrë të kuqe. Në fletën 184 shkrimi ekfonetik bëhet vishnje i thellë dhe neumat e përdorura në këtë fletë janë: Okse-ja, Sirmantiqi-ja, Tele-ja, Apostrof-i, Kathist-i, të cilat e ndryshojnë kaligrafinë e tyre duke u zmadhuar në formë. Po kështu edhe Paraklitiqi-ja është një shenjë që varion shumë: rreth pesë herë në këtë kodik. Përdoren pothuajse të gjitha shenjat ekfonetike dhe ka shtim neumash, gjë që vihet re nga ndryshimi i stilit kaligrafik dhe i ngjyrës në vijim (bojës së shkrimit). Ky ndryshim trajtash kaligrafike dëshmon *së pari* për stilin individual të kaligrafëve të ndryshëm dhe në kohë të ndryshme dhe, njëkohësisht për përsosjen në shekuj të shkrimit muzikor në kodikët ekfonetikë. *Së dyti* dhe më e rëndësishmja qëndron në faktin se duke kaluar në duar të ndryshme scribe-ësh, shkruarit apo shenjzuesit (dhe në kohë të ndryshme) në disa prej kodikëve me shenjzime muzikor, ashtu si tek kod. i Beratit Nr. 8, hasen shtime neumash, të cilat dëshmojnë për pasurim të këtij shkrimi dhe këndimi në kohë.

Me gjithë diferencat në kombinacionet e ndryshme shenjje me shenjje është pikërisht ngjashmëria kaligrafike e neumave të rrumbullakosura me bishta relativisht të shkurtër mes dy kodikëve një e dhënë e shtuar, e cila përforcon më shumë tezën se të dy kodikët i përkasin të njëjtit shekull.

Si përfundim, nga kjo analizë muzikologjike sillen argumente të reja që përforcojnë arsyetimet e studiuesve tanë dhe të huaj (të cilët i kanë analizuar këta kodikë pothuajse vetëm në drejtim të tekstit liturgjik dhe jo aq në drejtim të shenjzimit muzikor) se pikërisht këta kodikë kanë karakteristika të ngjashme në pikëpamje muzikologjike dhe që përputhen me shkrimin ekfonetik të shek. XI në drejtim të stilit kaligrafik të neumave, përdorimit dhe çiftëzimit të tyre (që do të jenë objekt i një punimi tjetër).

Këta kodikë kanë mbi të gjitha një rëndësi historike dhe dokumentare, duke dëshmuar se shkrimi muzikor dhe vetë këta kodikë në kompleksitetin e tyre artistik (miniaturat, zbulimet etj.) janë pjesë e çmuar e trashëgimisë kulturore të vendit tonë, të krijuar dhe ardhur në shekuj, ashtu siç edhe kjo kulturë me specifikat e saj ishte prezente në Ballkan e më gjerë.

Dy kodikët e shqyrtuar (kodiku i Vlorës nr. 7 dhe kodiku i Beratit nr. 8) janë nga dokumentet e para historike të shkrimit muzikor të dokumentuar në Shqipëri, të cilat vijjnë si dëshmi të hershme 'arkeologjike' prej fondit 488 të AQSH.

MBIJETESA SHUMËSHEKULLORE E ARBËRESHËVE NË VATRAT E GJUHËS DHE TË LETËRSISË

(një vështrim mbi dy poezi të Vorea Ujkos)

Hysni Ndreu

Gjuha dhe letërsia janë dy elementet që, përgjatë disa shekujve, kanë mbajtur të ndezur vetëdijen arbnore të banorëve të atyre trevave, si dhe lidhjen e tyre shpirtërore me vatrën amë. Gjuha, duke qenë elementi kryesor që identifikon një komb, i ka dalluar arbëreshët nga i huaji/tjetri, por njëkohësisht i ka bashkuar ata vetëmevete, duke bërë që t'i mbijetojnë rrjedhës së gjatë asimiluese 5-shekullore, e cila në jo pak raste ua ka rrezikuar seriozisht ekzistencën. Ndërsa letërsia, si mjeti me anë të të cilit shkruhet, regjistrohet e gjallon një gjuhë ka qenë edhe pasqyra e gjallimit të tyre shpirtëror. Ajo është zhvilluar në vazhdimësi përkrah historisë e kulturës së bashkësisë arbëreshe, duke trashëguar nga paraardhësit e përcjellë te pasardhësit vlerat më të spikatura artistike letrare, por edhe duke ruajtur të gjallë vetëdijen e tyre etnike.

Gjuha, me të gjitha nuancat dhe tiparet identifikuese të saj, u bart në vetëdijen e ikanakëve si urë lidhëse me dheun e të parëve, një urë lidhëse totale dhe e përplotësuar me elementet e veta përbërëse. Identifikimi ishte total dhe në të gjithë aspektet ekzistencial, për arsye se arbëreshët menduan dhe krijuan një ishull të moskomunikimit shpirtëror me vendin që shkuan dhe të ruajtjes me çdo çmim të komunikimit me atdheun që lanë pas, të detyruar prej rrethanave ekzistenciale. Po kaq, identifikimi i tyre, i të ndryshmit, krahasimisht me vendin ku shkuan, lidhet me faktin se, në sistemin e gjuhës shqipe, varësisht në variantin thelbësor të arbërishtes, ata projektuan një sistem të vetëmjaftueshëm kulturor, gjuhësor dhe letrar, identifikues dhe veçues nga bota përçark. Pra, prania totale e kësaj fryme, si dhe pasuria tërësore e të gjitha elementeve, e ka shndërruar identitetin e arbërishtes, si frymë dhe substancë, në një identitet të ngurtësuar, që do të thotë, të hershëm; në një identitet shumëngjyror, që do të thotë, shpirtëror, etnik, filozofik, gjuhësor, letrar; po kaq edhe në një identitet fillimtar të genies së gjuhës shqipe, sepse tek arbëreshët dhe varianti letrar i arbërishtes, ruhet më mirë se kudo kronika e epokës së ndritur të Skënderbeut.

Nga ana tjetër, ekzistenca e arbëreshëve është e lidhur pazgjidhshmërisht me vetë ekzistencën e botës shpirtërore që bartën me vete, po kaq është e lidhur fort me gjuhën si institucion i ekzistencës së genies njerëzore. Varianti i arbërishtes, duke qenë nga të paktat vatra të shqipes, që konfirmon dhe dëshmon se një gjuhë mund t'u bëjë ballë të

gjitha rrethanave, shtrënguese dhe mohuese, mbështetëse dhe asgjësuese, të mbijetesës si ligjërimit i folur dhe i shkruar, tregon se misioni i saj është sa diakronik, aq edhe sinkronik. Pra, është një variant i gjithëkohshëm. Nëse do të kundrojmë aspektin diakronik të mbijetesës së qenies arbënore dhe të gjuhës si thelbi i saj (pra i qenies), faktet historike dhe letrare do të na çonin tek ideja që, qysh në hershmëri, arbërishtja u bë pjesë e ekzistencës dhe e udhëtimit të gjuhës shqipe.

Krahas elementit gjuhë, një rol të veçantë në krijimin, ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit e ka luajtur edhe letërsia, sidomos poezia, qoftë ajo gojore, ashtu edhe ajo e shkruar; qoftë ajo e Rilindjes apo midis dy luftërave, ashtu edhe ligjërimit poetik bashkëkohor. Poezia, siç e cekëm edhe më sipër, është njëri nga elementet kryesore që tregon për përpjekjet disashekullore të arbëreshëve për t'i mbijetuar asimilimit shoqëror e kulturor. Të larguar në kohë të ndryshme nga vendi mëmë, bashkë me dheun e të parëve, arbëreshët morën me vete edhe këngët popullore, doket, zakonet, legjendat apo proverbat, aq të larmishme dhe me vlera të rrokshme artistike. Të gjitha këto elemente u ruajtën dhe mbërritën të gjalla deri në ditët e sotme, u shfrytëzuan nga thuajse të gjithë poetët e të gjitha periudhave, u jetësuan kështu në poezinë e shkruar, duke krijuar një muze të gjallë, i cili jo vetëm mban zgjuar e forcon ndërgjegjen e tyre, por edhe pasuron botën shpirtërore arbëreshe dhe mundëson mbijetesën e elementit kryesor të ekzistencës së tyre, atë të gjuhës.

Edhe në poezinë e ditëve të sotme ndjehet, nga njëra anë puhiza e këngës popullore, e nga ana tjetër një lloj vazhdimësie në frymën shprehëse e poezisë së shkruar nga poetët pararendës. Sigurisht, autorët bashkëkohorë nuk mbetën thjesht në hullinë e veprave letrare tradicionale. Vërtet vazhdojnë ta ruajnë e trajtojnë motivin patriotik në poezinë e tyre, veçse ndryshe nga rilindësit, jo vetëm që nuk e kanë parësor atë, por edhe atëherë kur e rimarrin, e pasurojnë me të tjera elemente leksikore e sintaksore, me figura të reja shprehëse; i japin përmasë, frymë e strukturim të poezisë moderne; e ngërthejnë me figura, kumte e imazhe që karakterizojnë edhe poezinë bashkëkohore europiane. Numri i poetëve bashkëkohorë është i madh, duke nisur nga Dushko Vetmo, Vorea Ujko, Xhuzepe del Gaudio, Mario Belici, Karmel Kandreva, Xhuzepe di Maxhio, Enca Skutari, Xhuzepe di Modika e të tjerë.

Këtu do të ndalemi konkretisht në poezinë e Vorea Ujkos, i cili veçohet si njëri ndër përfaqësuesit më të konfirmuar dhe dinjitozë të poezisë arbëreshe. Ligjërimit i tij poetik shquhet për një larmishmëri tepër të pasur tematikash e motivesh, ndër të cilat edhe ato që kanë si gurrë traditën popullore. Po ashtu, në krijimtarinë e tij hetojmë edhe një sërë poezish që konfirmojnë trashëgiminë shpirtërore të mbërritur që nga kohët e largëta. Kjo vihet re në disa të tilla, nga të cilat kemi përveçuar atë me titull "*Bisedë me xha Pjetrin në Farnetë*" dhe "*Burimi*".

Në të parën shohim një poet që identifikohet me të tjerët, kryesisht me bashkësinë. Këtu, e tashmja konkrete përplasen me vetëdijen e së shkuarës. Brenda kësaj vetëdije bëhen përpjekje hipotetike (dialogohet në mënyrë imagjinare me xha Pjetrin), jepen kujtime e mbresa të së shkuarës dhe ballafaqohem me të tashmen, me të tashmen e një

qyteti të mbetur shkreti, të braktisur nga të rinjtë, nga prifti e nga varrtari, një qytet “...*ku ecën udhëkryqeve / uria dhe kurvëria, / droga, histeria, marrëzia...*”. Fill pas kësaj, poeti zhvendoset në të ardhmen, edhe kjo, sigurisht hipotetike, por që na vjen nëpërmjet vargjeve si një parashikim bindës, si një siguri e poetit që përçohet krejt natyrshëm te lexuesi, aq sa të merret si e mirëqenë.

Pavarësisht shkretisë që ka pushuar mbi qytet, poeti nuk ndihet i vetëm, sepse, thotë ai: “... *nuk e humba ende veten / e deri që jam me veten / nuk ndihem i vetëm...*”, madje dyshten poet/un poetik, ai përpiket ta ripopullojë me “zëra” që i vijnë nga të gjitha anët, duke u shtuar atyre zërin e vet, me këngë djepi e martese, me këngë vallesh e baladash, me ison që ia mbajnë era dhe lumi. Kjo poezi është konceptuar mbi tri rrafshë kohore:

- Rrafshi i së shkuarës, i cili, në mënyrë implicite na vjen nëpërmjet përmendjes së elementeve të tilla si: këngëve të djepit, të martesës, të valleve, të baladave, të cilat përfaqësojnë identitetin kulturor dhe kanë përmasë shpirtërore; po ashtu, nëpërmjet përmendjes së elementit gjuhë, “...*s’dua që të flas me tjetër gjuhë*”, si shenjë ndërlidhëse dhe konfirmuese e identitetit arbënor, por njëkohësisht, vargu i mësipërm ngërthen edhe frikën për bjerrjen e kësaj gjuhe; si dhe nëpërmjet kujtimeve kur ndërmend edhe emra konkretë, “homologë” të poetit, Dritëroi, Fatmiri, Llazari, Fatosi, Vehbiu, Xhevahiri, kujtimet me të cilët, bëjnë që “*zemra t’i kërcejë në gojë*”, e këto si shenjë e një shoqërie/miqësie me interesa të përbashkëta, me mbremje, udhëtime, përfaqime, diskutime. Pra, kemi një shkrimje e identifikim me ata që flasin të njëjtën gjuhë, këndojnë të njëjtat këngë, ndajnë të njëjtat interesa shpirtërore.

- Rrafshi i së tashmes, i cili jepet në mënyrë më të drejtpërdrejtë, ndoshta sepse e tashmja është e tillë katandisur, sa duhet shqiptuar shkoqur pasoja e saj. Qyteti është braktisur nga të gjithë, aq sa varrtari ka mbyllur kangjellat, pasi prej kohësh, thotë poeti, “*edhe vdekja iku nga këto troje*”. Braktisja këtu nuk na vjen vetëm në një kuptim, pra, jo thjesht si largim, apo arrati nga një vend, por tërthorazi, na ndërmend edhe braktisjen nga tradita, nga elementet ruajtëse të identitetit, braktisje nga sjellja e normëzuar e një shoqërie dhe prirja drejt fenomeneve të tilla si: droga, histeria, kurvëria, marrëzia, të cilat poeti i përmbledh në togfjalëshin “*vorbulla pa shpirt*”.

- Rrafshi i së ardhmes, i cili nga këndvështrimi hipotetik i poetit na vjen i zymtë. Tërthorazi, ideja qendrore e poezisë përvijohet e tillë: Nga një e shkuar e ndritur, gjendemi në një të tashme në degradim e sipër dhe po shkojmë drejt një të ardhmeje bjerraditëse, humbëse të vlerave shpirtërore, sigurisht, për sa ka të bëjë me ruajtjen e identitetit të një komuniteti, pjesë e të cilit është edhe vetë poeti.

“*Kur s’do mund të këndoj / kur do jem aq i vetëm / sa s’do të kem as veten*”, janë tri vargje që thejnë qëndresën e deritashme të poetit, qëndresë kjo, e cila që në vargun e katërt të poezisë na vjen nëpërmjet simbolit të gurit, mbi të cilin gjendet i ulur ai, e që konfirmohet sërish disa vargje më pastaj, kur tregon se mbi këtë gur ulet mbrëmanet e mendon, mendon dhe pret, e në pritje i vijnë zëra nga të gjitha anët, që e çojnë drejt një gjendjeje agonie, brenda së cilës ndihen e përjetohen gjurmët e identitetit, tashmë vetëm shpirtëror, arbëresh.

E gjithë pjesa e fundit e poezisë është konceptuar me sintagma foljore të së ardhmes, të tilla si: *do ta marr vendimin, do ta shkëpus fenerin, do të zbres hap pas hapi, do t'ia nis këngës së fundit* etj. Në kontekst të poezisë, këto trajta bartin një lloj zymtësie, si një parashikim ogurzi (do t'ia nis këngës së fundit), por pavarësisht kësaj, ruhet edhe një fije shprese, e cila do të mundësojë vijimësinë, mbajtjen gjallë të identitetit, të mallit përvëlues për dheun e të parëve. Kjo fije është pikërisht kënga arbëreshe, kënga si këngë e kënduar, si poezi e shkruar, si një mënyrë e ruajtjes së gjuhës. “... *do të jem i lumtur,- shprehet Ujko,- të nisem heshtazi / me një këngë arbëreshe në buzë.*” Të gjitha elementet e tjera identitetruajtëse bjerren. Edhe xha Pjetrin, “... *nuk jam i sigurt / nëse do ta gjej gjallë*”, - përfundon ai.

Poezia tjetër, ajo me titull “*Burimi*”, na udhëheq sërish drejt së njëjtës tematikë. Ndoshta, për nga shenjat që ofron kjo poezi, për nga mënyra se si na ofrohen ato e si na detyron t'i qasemi, mund të themi se është një ndër krijimet, ku tema e identitetit /kombësisë, na jepet në mënyrë më eksplicite të mundshme. Këtë mund ta hetojmë që në vargjet e para të saj, sipas të cilëve poeti prej shekujsh po ndjek të njëjtat gjurmë që trashëgoi nga brezat para tij, nga stërgjyshërit: “*Duke i ndjekur gjurmët e stërgjyshëve / kam ecur pesëqind vjet*”, - shprehet ai. Përcaktimi kohor, *pesëqind vjet*, na e qartëson edhe më tej mesazhin e këtij dyvargëshi, dhe na shpërngul në një tjetër kohë, atëherë kur ndodhi eksodi i madh, në fillesat e pushtimit osman ndaj Ballkanit, pra, në kohën e Kastriotëve.

Vargu i tretë, “*me këngë arbëreshe në buzë*”, ka një simbolikë të disafishtë: së pari, fjala këngë na çon edhe te kënga popullore, edhe te kënga e dasmës, edhe te kënga e djepit apo e vajit, e të gjitha këto përbëjnë disa nga elementet kryesore të trashëgimisë shpirtërore të arbëreshëve, të cilat janë formuar përgjatë historisë në jetën e tyre dhe janë ruajtur, trashëguar e zhvilluar më tej nga njëri brez në tjetrin, duke u shndërruar në një thesar të çmuar identitetruajtës. Janë pikërisht këto këngë që kanë ndihmuar në konturimin e veçorive dhe tipareve arbëreshe, për t'i dalluar ata nga tjetri, nga i huaji. Simbolika tjetër e fjalës “këngë” na çon te gjuha, sepse, para së gjithash, kënga është tekst, e teksti është germë, është fjalë a fjali, e gërmat, fjalët a fjalitë, janë gjuhë, e gjuha jo vetëm identifikon, por edhe ruan e gjallon identitetet. Parë nga ky këndvështrim, edhe vargu pasues, “*e sot unë e gjej burimin*” vetëm sa e forcon dhe më tej faktin që poeti, si gurrë të frymëzimit të tij, ka pikërisht këtë trashëgimi, poetike dhe shpirtërore, të cilën, ashtu siç e trashëgoi nga pararendësit, ashtu është i gatshëm t'ua falë atyre që e rrethojnë e që do ta pasojnë, gjë që na e thotë në vargun e fundit: “*dhe juve jua fal këngën time*”. Po ashtu, “*Për të pasuruar dhe rindërtuar botën e arbëreshëve, Ujko përjetësoi artistikisht qytete, personalitete, ngjarje e shenja që kanë pasur e kanë një rëndësi të shumëfishtë, si janë, fjala vjen, Kruja, Skanderbegu, De Rada, Gjergj Fishta, shqiptarizma, shqiponja. Ata shërbyen e shërbejnë si dritërrëfyese shtegtimi e qëndrese nëpër kohë, ishin e janë ylli polar i vijimësisë për një gjallim të ndershëm e meritore; janë, si shprehet poetikisht Ujko, dashuri të gjata që nuk tradhtojnë. E këtillë është edhe Kruja, simbolika e së cilës nuk nënkupton vetëm qytetin dhe udhëheqësin e*

*lavdishëm, Gjergj Kastriotin Skanderbegun, por njëherazi, domosdonë e qëndresës, dashurinë, gatishmërinë për flajm dhe qenësinë e njësimi etnik, kombëtar.*¹⁷²

¹⁷² Berisha, A. Nikë, në parathënien që shoqëron vëllimin poetik *Fshehtësi e rrënjëve*, shtëpia botuese TOENA, Tiranë 2007, faqe 15.

NOTACIONI I RI MUZIKOR SI SPROVË PËR PEDAGOGJINË PIANISTIKE (MODEL SET NJOHURISH PËR QASJE PEDAGOGJIKE)

Indira Çipa

Hyrje

Pas një periudhe të gjatë, që nga baroku e deri në gjysmën e shekullit XX (1950) pedagogjia pianistike u zhvillua duke krijuar një pianizëm me rezultate të larta në virtuositet duke trajtuar stile kompozicionale dhe shkolla të interpretimit me tipare të ndryshme teknike dhe estetike , por me një notacion dhe sistem notal të pandryshuar. Shumësia e veprave dhe e stileve të trashëguara prej shekujsh në njërin anë, dhe sistemi notal tradicional në anën tjetër, për sistemin shkollor në botën e sotme nënkupton një periudhë të edukimit pianistik që zgjat nga 14 deri 18 vite shkollimi. Ky proces i edukimit pianistik përmban një vister detyrash të rëndësishme në aspektin e deshifrimit dhe të kuptuarit të muzikës, veç tjerash, përmes leximit vizuel të notave. Pedagogjia pianistike, duke edukuar pianistë paraqitet si një medium ndërlidhës i idesë kompozicionale të veprës pianistike dhe interpretimit teknik dhe estetik të saj. Kështu me novatorizmat që paraqiten nga viti.1950 e këndej po paraqitet mundësia të sfidohet edhe me një notacion të ri me të cilin po realizohet grafika e ideve të reja muzikore. Kështu duket se muziktarët e sotëm ndodhen në një udhëkryq të paraqitjes së një sistemi të shenjave sikur që ka ndodhur edhe në periudhat tjera historike. Në këtë drejtim po



sjellim disa dimensione njohurish të supozuara si përkrahje në synimiin pedagogjik të përafrimit të nxënësit-studentit me veprat bashkëkohore pianistike.

Për elementet novatore

Vepra muzikore qenësinë e vet e realizon përmes kohëshmërisë dhe procesualitetit, me një depedencë të veçantë të formateve të saja të ekzistimit dhe të

formave të idealitetit dhe të objektivizimit, si edhe shtresave dhe planeve që krijohen brenda indit të saj krijues.

Veprat e sotme muzikore në përghithsi dhe ato pianistike në veçanti që po krijohen me teknika kompozicionale nga më të ndryshmet (tendenca stitlistike), me struktura tonale e modale nga më të ndryshmet, me harmoni disonante, me përdorim jostandard të instrumenteve (goditje nëpër trupin e instrumenteve (duke krijuar efekte akustike në vend të tingullit instrumental), me organizim të lojës tonale me formula të kuantifikuara, me një dramaturgjii muzikore të pakrahasueshme me periudhat paraprake, me tematizëm human dhe kosmik, me polimetri dhe ametri, notacion të ri, shkrim skematik e grafik dhe shumë e shumë elemente të tjera novatore që krijojnë tërësi dhe unitete të atilla strukturore dhe tonale, e të cilat ndonjëherë ndodh të mos vetmjaftohen si gjë individuale estetike por aplikohen brenda instalacioneve me artet tjera. Veprat e sotme muzikore ndodh të mos mund ta arrijnë formatin e konkretizimit (objektivizimit real) duke e lënë shumë pas vetes vullnetin, gadishmërinë dhe aftësinë e interpretuesit dhe të perceptuesit. Objektivizimi i veprës muzikore (loja) si edhe preceptimi i saj, që janë format e ekzistencës së veprës muzikore na bëjnë të mendojmë se termi BASHKËKOHOR, jo nga përmbajtja estetike por nga aspekti filozofik nuk mund ta mbulojë plotësisht fenomenin në fjalë sepse cikli i realizimit të plotë të objektivizimit të krijimeve ndoshta do të marrë më shumë kohë se vet kohëzgjatja e, thënë kushtimisht, stilit krijues.

Pikërisht procesi i konkretizimit (interpretimi) i muzikës me koncepte të reja ideore kompozicionale (në interesimin tonë të ngushtë të literaturës bashkëkohore pianistike) po përballlet me notacion (shenja) të reja të derivuara nga ideja krijuese, qëllimi i shprehjes, funksionaliteti dhe praktikiteti.


Ndërtimi i marrëdhënies së interpretit me këto tendeca muzikore, thënë ndryshe- edukimi, pedagogjinë pianistike po e sfidon me dy detyra të rëndësishme: 1.edukimin e dëgjimit të koncepteve të reja akustike 2. njohja e notacionit të muzikës së re. Ky sistem i shenjave të reja, krahasuar me sistemet paraprake notale duket të paraqitet si një notacion i ri, ngjajshëm sikur që ka ndodhur në historinë e notacionit. Me këtë rast duhet distancuar nga ndonjë përkufizim se notacioni i ri do ta zëvendësojë notacionin tradicional.


Zhvillimi historik i notacionit

Megjithqë Sumerët kanë lënë gjurmë të notacionit që nga viti 2000 p.e. sonë, sistemi notal më i vjetër i deshifruar konsiderohet pllaka e gurit nga sh.VII para erës sonë me prejardhje nga kultura e Greqisë së lashtë ku është i paraqitur një tekst i pandrëprerë me shenja diskrete mbi të.


Vitet 800-1200 (mesjeta) paraqesin periudhën e notacionit paramenzural, përkatësisht periudhën e *neumeve* sistem shenjash grafike muzikore (shih foto 2) të cilat më shumë i gjasojnë një mbidekori të tekstit që duhet kënduar se sa notacionit tradicional, e të cilat rregullonin pjesërisht lartësinë, akcentuimin dhe kohëzgjatjen e rrokjeve.

Sembull i notacionit
adiastematik (Shën Gallen)





E njëjtra këngë në transkript modern



Fundi i shekullit të XIII sjell kërkesa për një saktësim më të madh ritmik se sa që ofronte sistemi i neumeve, gjë që zhvillimin e sistemit notal në shek. XIV e shpie drejt sistemit të ri notal të ashtuquajtur *menzural*, me të cilin notat shenohen me figura romboide dhe një sërë shenjash të reja që më qartë e përcaktonin vlerën (kohëzgjatjen) e tingujve. Në këtë vazhdë vie edhe deri të përsosja e përcaktimit më të saktësuar të lartësisë së tingullit duke begatuar sistemin vijor nga një, nëpër dy, tre deri në katër vija të sistemit vijor, ndërkaq në Barok, përfundimisht i shtohet edhe vija e pestë (pentagrami).

Baroku definon shumë elemente të sistemit të sotëm tradicional të notacionit, kur, veç tjerash, ndarja metrike e masave fiton edhe taktoren. Sistem ky notal i cili mundësoi regjistrimin e suksesshëm të muzikës instrumentale që fillon e zhvillohet hovshëm në shekujt vijues. Ky notacion vazhdon të përdoret që nga baroku, klasicizmi, romantizmi, impresionizmi, ekspresionizmi, muzika e shek XX dhe vazhdon të jetë notacion në funksion të regjistrimit edhe në ditët e sotme.

Tendencat stilistike nga gjysma e shekullit XX që po gjenerojnë notacionin e ri muzikor

Nga vitet e pesëdhjeta të shekullit XX, muzika bashkëkohore sjell të ashtuquajturat *grafika muzikore* ose *notacioni grafik* i përbërë nga shenja të përzgjedhura dhe të hartuara individualisht dhe në formën e vizatimeve (pa shenja të notacionit tradicional), që realizojnë të shënuarit e rrjedhave tingullore të sajura si lloje improvizuese të muzikës bashkëkohore si: aleatorika dhe teknika të tjera kompozicionale (2005, *Hrvatski obiteljski leksikon*).




Foto 3. Notacioni grafik

Një preokupim tjetër stilistik i muzikës bashkëkohore është edhe marrëdhënia e rikonstruktuar emocionale raportet e së cilës dukuri, veç sugjerimit nga ana e kompozitorit sigurohen edhe me mënyrën e përdorimit të tekstit në këngë si p.sh. kënga korale e finlandezit Perttu Harpen (2012), ku teksti formohet nga burime të ndryshme ku kompozitori sugjeron mbajtjen e distancës emotive në raport me përmbajtjen e saj dhe eliminimin e interpretimit ekspresiv. Kompozitori, tekstin, anagramet dhe sintagmat e tjera i përsërit deri në pafundësi. E fragmenton dhe e zërthen tekstin në komponente

të saj fonetike aq sa teksti tingëllon si një absurd me çka interpretuesit privohen nga të shprehurit emotiv duke u lënë hapësirën kërkimeve timbrale.

Ky koncept krijues bën të supozohet sikur vepra ka të bëjë me një të sëmurë mental. Ky dhe preokupime të tjera krijuese muzikore flasin për zgjerimin e interesit krijues për dukuritë dhe fenomenet brenda të cilave zhvillohet jeta e njeriut të sotëm. Sëkëndejmi edhe pamjaftueshmëria me të cilën po përballet muzika bashkëkohore me trashëgiminë nga komponentet tradicionale: instrumentariumi, sistemi grafik, edukimi i degjuesit dhe i interpretit. Kështu muzika e sotme po rezulton me: forma grafike individuale, kyçjen në rrymë të orkestrës, manipulime me strukturën orkestrale, preparim instrumentesh, prodhim të dukurive të reja akustike duke e përdorur instrumentin/tet në mënyra jotradicionale (goditje, trokitje, grrithje nëpër trupin e instrumentit, etj.).



Deklarimet e kompozitorëve bashkëkohor lidhur me preokupimet e tyre krijuese po paraqiten si përkrahje në të kuptuarit të idesë muzikore. Kështu kompozitori amerikan John Cage-it (1812-1992), i njohur për përdorimin jostandard të instrumenteve në shkrimin e tij të titulluar *Anarhich Harmony* thotë: “Muzika është kudo, vetëm ju duhet të keni vesh për ta dëgjuar atë. Para se gjithash ne kemi nevojë për muzikën në të cilën jo vetëm që tingujt janë vetëm tinguj, por muzikë ku edhe njerëzit janë vetëm njerëz, jo subjekte të udhëhequra nga kompozitori ose dirigjenti, por është pjesëmarrës i përfshirë aktivisht në krijimin e muzikës, një muzikë ku nuk ekziston ndarja mes audiencës dhe interpretit. Pra, një muzikë të krijuar nga të gjithë”.


















Notacioni i ri i gjetur në veprat pianistike të kompozitorëve Kosovarë

Në mesin e veprave pianistike të analizuar të kompozitorëve Kosovarë (artefakte të grumbulluara në qershor të vitit 2010) shenja-notacion të ri kanë përdorur: Zeqirja Ballata, Rafet Rudi, Mendi Menxhiqi, Drinor Zymberi. Praktikimi i notacionit të ri nënkupton udhëzime dhe përsoshkrime individuale si shtojcë e veprës-LEGJENDA (foto 4.a)

Megjithkëtë praktikë metodika e pianos po publikon lista të shenjave me përsoshkrime sikur që është shembulli i publikimit të Jela Krshiq, *Nastava klavira* (1990. fq 118-122) ku paraqet një listë prej 79 shenjash të notacionit bashkëkohor pianistik duke u bazuar në *Notation in new Music* të E. Karkoschka, *Notation* e John Cage, etj.

Notacioni i ri nuk është i standardizuar dhe tendenca për ti kategorizuar ato ende nuk mund të japë rezultate definitive. Programi kompjuterik muzikor SIBELIUS 6 ka të aplikuara një sërë shenjash të këtilla, por jo të gjitha, sepse ato po krijohen në vazhdimësi. Funksionet e tyre shprehëse në të shpeshtën janë: praktikiteti në shkrim dhe lexim, prodhimi i efektit të caktuar akustik që nuk ka të bëjë me mundësitë standarde të instrumenteve, inkorporimi i objekteve të jashtme për prodhimin e efektit akustik, etj.

| Nr. | Shenja | Deshifrimi i shenjës |
|-----|---|---|
| 1 |  | Shkurtimi i vlerave të notave (të luhet duke nxituar deri në shpejtësi sa më të madhe të mundshme) |
| 2. |  | Accelerando në kuadër të disa toneve, në temp të fiksuar duke filluar nga tetëshje deri në një shpejtësi sa më të madhe të mundshme |

| | | |
|----|---|--|
| 3. |  | Colpire con la palma della mano nell' corpo doli (Goditje me pëllëmbë nëpër trup të instrumentit) |
| 3 |  | Colpire con la palma della mano nelle corde (Goditje me pëllëmbë të dorës nëpër kordha) |
| 4 |  | Claster Kllaster (me vlerë të plotë) |
| 5 |  | Pika më e ulët në instrument |
| 6 |  | Corona lunga (koronë e gjatë) |
| 7 |  | Pizzicato (tërheqje e kordhës) |
| 8 |  | Buttare giu il coperchio della tastatura (hidhet poshtë kapaku i tastaturës) |
| 9 |  | Glisando nga kordha më e ulët |
| 10 |  | Zgjat për aq sekonda sa është e shenuar |
| 11 |  | Sempre piu vivo e viceversa (Gjithnjë duke e shpejtuar dhe anasjelltas) |
| 12 |  | Pizzicato nella corda del pianoforte (Tërheqje e kordhës) |
| 13 |  | Suono preparato (Tingull i preparuar) |
| 14 |  | Glisando nga lartë |
| 15 |  | Goditje në kordhë të caktuar ose Shtypje e kordhes me nje gisht ndersa me gishtin e dorës tjetër luhet ne tast |
| 16 |  | Repeticion i goditjes në kordhë të caktuar duke shpejtuar. Shtypje e kordhes me nje gisht ndersa me gishtin e dorës tjetër në tast luhet repeticioni në accelerando |
| 17 |  | Glisando për kohë të shenuar |
| 18 |  | Glisando nga tinguli i shenuar për kohë të caktuar |

Rezultate empirike nga praktikimi pedagogjik i veprave bashkëkohore

Në vitet e 70-ta të shekullit të kaluar shkolla pianistike e ish Jugosllavisë, duke ndjekur tendencat muzikore botërore, vuri në program edukativ muzikën me harmoni disonante që në metodën e mësimin fillestar (J. Krshiq 1973), si një element bazik për edukimin

estetik lidhur me kompleksin e novacioneve bashkëkohore. Në programin mësimor në Kosovë duke përdorur terme: muzika e shek. XX dhe muzika e autorëve shqiptar nuk saktësohet më tej detyra pedagogjike për njohjen e novacioneve të caktuara, përkatësisht të notacionit bashkëkohor. Sepse korespondenca kohore ose përkatësia nacionale nuk nënkupton edhe përkatësinë stilistike. Kështu kihet përshtypja se përzgjedhja eventuale e veprave me harmoni disonante në një fazë të caktuar lëshon binarët e edukimit estetik dhe interpretues të veprave me tendenca stilistike bashkëkohore duke mos trajtuar fare notacionin bashkëkohor. Qendrat tjera edukative kulturore kanë shenuar rezultate shumë të ndryshme nga kjo që praktikohet në Kosovë. Le ta përmendim festivalin-garën ndërkombëtare „ *Valentino Buchi*“ në Itali që praktikon që veprat e Buchit të jenë vepra obligative për garuesit.

Procesi i edukimit pianistik mbështetet në pesë shtylla ose aspekte të të mësuarit (I. Çipa, 2010, *Njohja e talentit në pedagogjinë pianistike*): 1. vizuel, 2. auditiv, 3. motorik, 4. emotiv dhe 5. logjik. Që të pestat, si pjesë të një procesi, në vete paraqesin nënprocese komplekse, si përnga struktura ashtu edhe përnga ndodhja e njëkohëshme dhe ndërrimi i pozicionit në përparësi të njëjës kundruall të tjerave.

Shqyrtimi i deritashëm ka sjellur fakte për të mësuarit vizuel, i cili gjatë shkollimit zhvillohet deri në atë masë sa që nga shikimi i parë i tekstit notal mund të aktivizojë idenë interpretuese deri në formën e përfytyrimit tingullor i cili me lehtësi çon edhe drejt njohjes së stilit të veprës. Fotot e paraqitura në këtë shqyrtim edhe për syrin e perceptuesit jomuziktar paraqet diferencë të theksuar vizuale, ndërsa për syrin e muziktarit, veç diferencës vizuale, paraqet një botë të tërë të ndryshme të përmbajtjes muzikore. Janë sisteme të atilla shenjash që vetëm një prej tyre paraqet shumë punë për një jetë të tërë profesionale. Sëkëndejmi edhe konstatimi se kemi të bëjmë me një detyrë sfiduese.

Pas 3, përkatësisht deri 6 vite shkollimi muzikor një vepër me notacion tradicional, për nxënësin paraqet një objekt vizualisht të njohur, të pranueshëm dhe bazë për fillimin e të mësuarit auditiv, motorik, emotiv dhe logjik deri në masën që edhe vetëm një shikim mund të vendos se a do të përzgjedhet vepra për interpretim si gjë estetike e pëlqyer.. Ndërkaq që nuk mund të thuhet kështu për efektin që krijon kontakti i parë vizuel me veprat si në (foto 4.a. dhe b).



FOTO 4, a. Zeqirja Ballata: *Hexaphonia*, b. Mendi Mengjiqi: *Vizion*

Rezultatet empirike në përvojën time pedagogjike vijnë e radhiten si refleksione që, në aspektin psikologjik kategorizohen si refleksione nga e panjohura si: refuzim, habi, moskuptim, me pyetje: çka qenka kjo, e të tjera reagime subjektive. Nga rreth 10 përpjekje për ti mësuar nxënësit ishte numër i vogël i interpertimeve që arritën interpretimin publik-koncertain. Nga konsiderata se një muzikë e këtillë nuk mund të jetë lehtësisht e perceptuar nga shumica, janë përzgjedhur vetëm nxënësit me cilësi të veçanta muzikore dhe intelektuale. Padyshim se qasja pedagogjike dallonte për aq ose për më shumë se sa që ishte vet diferenca stilistike dhe semiotike e veprës në krahasim me stilet e trajtura deri atëherë në përvojën e nxënësit. Duke qenë se interpretimi pianistik mbështetet në dy shtylla të rëndësishme: të kuptuarit (muzikologji-objektivitet) dhe të pëlqyerit (psikologji-subjektivitet), gjatë dhe në fund të përpunimit të veprave të stilit bashkëkohor si njëra ashtu edhe tjetra shtyllë herë herë mbeteshin të porealizuara plotësisht duke mos arritur plotësisht të preket boshti i veprës dhe palca e ndjeshmërisë interpretuese qoftë si pasojë e përmbajtjes së veprës qoftë si pasojë e mungesës së vullnetit interpretues. Edukimi i veshit për një shije të caktuar artistike kërkon kohë dhe furnizim në masë të caktuar. Rrethanat sociale dhe materiale në të cilat janë punuar këto vepra janë shumë më modeste se këto që janë sot: mungesë e formatit të incizuar, mungesa e qasjes në internet, mungesa e koncerteve dhe festivaleve, mungesa e një kuantumi të përshtatshëm për përzgjedhje, të mësuarit joobligativ programor i këtyre veprave, etj. Në kërkim të arsyeve dhe të shkaktarëve të kësaj dukurie përdërisa të mos provohet një eksperiment pedagogjik i orjentuar, duhet supozuar se përgaditja e nxënësit për interpretim të lehtësur dhe të suksesshëm duhet bërë me metoda alternative dhe me një edukim me forma më komplekse: aktivitete grupore (dëgjim, interpretim, diskutim), inkorporimi i muzikës bashkëkohore në programe studimore, disenjimi dhe realizimi formave të komunikimit me kompozitorët, muzikologët, interpretuesit në nivele të ndryshme,

Aspekti i të mësuarit motorik merr një dimension të ri dhe kompleks. Duke njohur shenjat e reja (notacionin bashkëkohor) përballemi me njohjen e dukurive të reja akustike, mundësitë e panjohura të instrumentit. Krahas kësaj, procesit të edukimit i imponohet një njohje e detajuar e pjesëve të instrumentit. Produktet jostandarde nxjerrin jashtë standardit gjithashtu edhe lëvizjet interpretuese. Projektimi i lëvizjeve që dalin nga hapësira e tastaturës: goditje dhe trokitje nëpër trupin e pianos (kapaku i tastaturës, dërrasat anësore të tastaturës), ngritja nga karriga për të gjetur kordhën e kërkuar brenda rezonatorit, ushtrimi i picikatos, glissandos në kordhë, përshtatja e të njejtave nga pianino në pianoforte, koordinimi i dëgjimit me lëvizjen, shkathtësitë e manipulimit me mjete ndihmëse (të jashtme), manipulimi kompleks me pedalet dhe mbajtja nën kontroll e efektit akustik, etj.

Të mësuarit auditiv, emotiv dhe logjik kanë një afërsi kohore me të mësuarit vizuel dhe motorik të pakrahasueshme me stilet tjera. Ato duhet të ndodhin njëkohshëm që në leximin e parë. Sëkëndejmi vendosja e veprës (e ashtuquajtura faza e leximit) zgjat më shumë por përpunimi, si fazë e ndarë dhe si pasuese e fazës së leximit, minimalizohet dukshëm.

Të mësuarit auditiv, duke u bazuar në faktin se shenja e caktuar është dizajn individual dhe jo i standardizuar shpesh edhe me kuptime duale e më shumë, duhet ti paraprijë njohja e saktë e shenjës. Në këtë drejtim informacionin më të saktë duhet siguruar në kontakt të drejtpërdrejtë me kompozitorin gjatë të cilit do të sigurohet edhe një

informacion dhe sugjerim për përmabjtjen dhe porosinë emotive të efektrit akustik të planifikuar brenda shenjës së caktuar.

Konkluzione

- Njohja dhe interpretimi i veprave me shenja të notacionit të ri paraqet transferin horizontal të njohjeve dhe novacioneve që siguron tranferin vertikal në kohë
- Notacionin bashkëkohor nuk duhet trajtuar si diçka të vështirë , por si diçka të re
- Njohjen dhe interpretimin e përmabjtjeve akustike të përfaqësuar në notacionin bashkëkohor duhet trajtuar si detyrë programore edukative.
- Qasja pedagogjike duhet të mbështetet në një koncept multidimensional
- Shtyllat e edukimit duhet të zhvillojnë dhe implementojnë aktivitete edukuese (interpretime, publikime, diskutime, publikime të legjendave të notacioneve me sqarime të sakta, promovime veprash, prezentime) gjithpërfshirëse (muzikologë, studiues, studentë, nxënës, pedagogë të pianos, media)
- Bashkëpunimi kompozitor-pedagog i pianos do të sjellte përfitime të dyanshme: përcjelljen e drejpërdrejtë dhe të saktë të domethënies semiotike, përmabjtjes estetike, detyrave teknike për pianistin-pedagogun, dhe sugjerimet nga ana e pianistit-pedagogut për kompozitorët lidhur me interpretueshmërinë e veprës në përgjithësi dhe të të dedikuar për nivel të caktuar moshor dhe pianistik.

Recensent:

1. PhD kandidat, Valton Beqiri, UP-Fakultetit i arteve/DAM
2. PhD kandidat, Bekim Ramadani, USHT Tetovë/Maqedoni

ERNEST KOLIQUI DHE VENDI I TIJ NË STUDIMET LETRARE SHQIPTARE PAS VITEVE '90

Irma Sokoli (Bilali)

Objekti i këtij punimi është drejtuar të zbulojë mesazhe dhe fakte në mënyrë që të ndihmojë në idenë e një rigjykimi të plotë të personalitetit letrar të Ernest Koliqit. Bota kulturore-intelektuale ka shprehur në rrjedhën e kohës mendimin e saj për krijimtarinë e tij. Rivlerësimi i kësaj figure po realizohet në rrjedhën e viteve. Në mënyrë sintetike kërkohet të rindërtohet dhe të vendoset në plan krahasues linja e mendimit estetik e pas viteve të '90-ta, për trashëgiminë letrare të njërit prej autorëve më të spikatur në panoramën letrare gjatë viteve '20-'40 në Shqipëri.

Kjo trajtesë konfigurohet si paraqitje e vlerave të autorit nën vështrimin e syrit kritik të 20 viteve të fundit, për të kontribuar në shkrimin e plotë të historiografisë letrare shqipe. Konsideratat teorike janë përfshirë duke përmbushur kërkimin në një linjë hapësinore-kohore për këtë vepër dhe kontributin e kësaj figure në zhvillimin e letërsisë së fillimshkullit XX, nga analiza shkencore letrare në ditët e sotme.

Fjalët çelës: Koliqi, mendimi estetik, historiografi e letërsisë, analizë shkencore
Hyrye

Historia e letërsisë luan një rol të veçantë në zhvillimet letrare dhe kulturore të kombit. Lidhja e saj me disiplinat e tjera, sidomos didaktikën ofron instrumente kritike për një edukim kombëtar të rinjve dhe një qasje krahasuese për studimin mbikombëtar historiko-letrar. Historia e letrave shqipe njih zhvillimet e saj në ecurinë progresive të historisë së kulturës shqiptare. Bota kulturore-intelektuale ka shprehur në rrjedhën e kohës mendimin e saj për Ernest Koliqin e krijimtarinë e tij. Në vështrimin panoramik të letërsisë shqipe figura e këtij krijuesi zë një vend të shquar në kulturën kombëtare në Shqipëri e jashtë kufijve të saj në etnitetet shqipfolëse në Itali e më tej. Proza e shkurtër e tij e lartëson në rrafshin e themeluesit të kësaj gjinie letrare, në historinë e letërsisë shqipe përkatësisht në tre qarqe kryesore ku u studiua vepra e tij. Në këtë këtë punim shkurtimisht pasqyrohet mendimi kritik-letrar në Tiranë, në atë bashkëqytetar; në atë kosovar dhe pa munguar vlerësimi jashtë kufirit shqiptar. Ajo që u mundua për shumë kohë të fshihej, të lihej në harresë e në rastet më të shpeshta, të kthehej në tabelë sulmi, doli në pah prej kërkimeve e studimeve shkencore, kushtuar veprës së tij nga përvoja e katedrave akademike në Shqipëri, Kosovë e me gjerë, pas viteve të '90-ta.

Rivlerësimi i kësaj figure po realizohet në rrjedhën e viteve. Në një përpjekje për të komunikuar në historiografinë tonë letrare i qasemi disa linjave të interpretimit të njërit prej figurave kyçe të letërsisë shqipe dhe veprës së tij tregimtare. Duke inkuadruar figurën e Koliqit në letërsinë shqipe në funksion të receptimit dhe vlerësimit të gjithkohshëm të tij, do të përcjell fillimisht një konstatim të Xh. Valentinit, dhënë më 1962, përsa i takon pritjes së veprës: *"Si novelist dhe lirik Koliqi shkaktoi skandal kudo.*

*Sipas konservatorëve nuk konservonte sa duhej; sipas novatorëve konservonte më shumë se duhej*¹⁷³. Një skandalitet absurd do ta shoqëronte Koliqin për një gjysëmshkulli të tërë në Shqipëri.

Rivlerësim për autorin e mohuar (redimensus)

Do desha ta filloja shqyrtimin analizues për veprën e këtij autori me një tjetër autoritet të një tjetër dimensionit për rrjedhën e historisë së letërsisë sonë. Në vitin 2005 shfaqet një shprehësi e re e Kadaresë për Ernest Koliqin. Kadare pohon se *"Në veprën e tij letrare nuk ka asgjë fashiste"*¹⁷⁴.

Pasi ka përshkruar ferrin e dhimbjeve e vuajtjeve të Koliqit autori përfundon "për në habi që shpesh ndodh me shkrimtarët, mallkimet kundër Koliqit, ashtu sikundër Fishtës, ashtu sikundër të tjerëve, nuk zinin vend. Me sa dukej, shqiptarët ishin mësuar me to"¹⁷⁵. Po në këtë linjë ai i nje Koliqit shërbimin e madh në funksion të arsimit, me hapjen e shkollave shqipe, duke thënë "hapja e tyre ngjante me një mision të shenjtë. Kjo ishte, me sa duket, arsyeja që balanca e gjykimit të tij, qysh ditën e parë pas rënies së komunizmit, anoi në favor të tij. Ernest Koliqi u rehabilitua". Dhe, po sipas gjykimit të Kadaresë "Rehabilitimi ishte i menjëhershëm dhe pa kurrfarë mëdyshje"¹⁷⁶.

Në funksionin e profecisë rehabilituese, Kadare ka drejtuar objektivin e tij tek drama e "pikëllueshme" e Koliqit "Rrajët lëvizin". Në kuadrin e një përqsaje ai e ka krahasuar "atmosferën disi të çuditshme" të kësaj vepre me atmosferën e ndodhive në Purgator "Në këtë kah nga të gjitha leximet që i bëhen dramës, ka gjasë që njëri prej tyre të jetë jashtë çdo dyshimi: kjo është drama e shkruar prej një banori të Purgatorit, atje ku, ashtu siç vuajtja është pa dhimbje, ngadhënjimi po ashtu, është pa hare"¹⁷⁷.

Në linjën e vlerësimeve të vetë shkrimtarëve për shkrimtarin sigurisht do të drejtohem tek një figurë tejet e rëndësishme si Martin Camaj, i cili e quan këtë autor si "themelues të prozës moderne"¹⁷⁸, konsideratë kjo që vazhdon të përdoret dhe nga studiuesit më bashkëkohorë, të cilët përcaktojnë rolin e veprës së Koliqit në prozën e shkurtër, si vendimtar në përvojën e narracionit shqiptar.

Martin Camaj, zbuluar si talent me një zë origjinal, nga "Shejzat" e Koliqit, i kthen borxhin mësuesit¹⁷⁹ e bashkëpunëtorit të tij¹⁸⁰, duke e cilësuar si nismëtar e avanguardist në sjelljen e ideve e formave të reja letrare.

Artikuj dhe studime në Shqipëri

Studiuesit pas viteve '90 i janë drejtuar me një vëmendje të veçantë personaliteti koliqian. Revista shkencore periodike "Studime filologjike", në vitin 1998, në një nga

¹⁷³ Valentini Zef, "Ernest Koliqi një pasqyrë e kalimit njerëzor" në *Studime Shqiptare* 3, Universiteti i Shkodrës Volaj, Shkodër 1995, fq. 13.

¹⁷⁴ Po aty, fq. 38

¹⁷⁵ Po aty, fq. 41

¹⁷⁶ Po aty, fq. 41

¹⁷⁷ Po aty, fq. 43

¹⁷⁸ M. Camaj (nga shkrimet në Lenggries, prill 1991) "Koliqi e vepra e tij letrare", Drita, Tiranë 22. 01. 1995

¹⁷⁹ Po aty: "Unë si vetje Koliqit i jam mirënjohës për dhanien e ideve nxitëse si krijohet alnanologjia si landë universitare... "

¹⁸⁰ Hafizi, Alma LETËRSIA E KUFIJVE (Përqsaja Magris-Camaj), Botimet "Camaj-Pipa", Shkodër 2008 "Camaj ndonëse larg atdheut e kishte gjetur vatrën amtare tek Ernest Koliqi, tek arbëreshët e Kalabrisë dhe të Sicilisë, tek revista "Shejzat", për të cilën dha ndihmesën e tij për vite me radhë" fq. 35.

artikujt e saj na përcjell një ekspozë rreth efektit që ushtroi në rrethet dhe qarqet intelektuale të kohës kur u bë publike vepra e Ernest Koliqit¹⁸¹.

Qëndrime pro dhe kundër këmbehen nëpërmjet shqyrtimeve që bën studiuesja Laura Smaqi. Koha e pritjes së veprës koliqiane mbart kontradikta të ndryshme në vetvete që lidhen me kohën dhe rrethanat në të cilat ndodhet vendi e në forma të ngjashme edhe kritika e publicistika e botuar në organet e ndryshme të shtypit. Në vitin 2009 studiuesja Smaqi boton librin e saj studimor kushtuar figurës koliqiane me titull "*Zbulimi i vetvetes në pasqyrë të letrave*".

Në vitin '91, Aurel Plasari sjell një panoramë ekspozuese të tregimit koliqian. Që në shkrimin e tij të parë mbi këtë nyje të procedimit artistik në prozën shqipe, studiuesi do të paraqesë një trajtesë aq sa shkencore, por gjithashtu edhe mbresëlënëse përsa i takon autorit "*të tregimit psikospektiv shqiptar*"¹⁸² të Ernest Koliqit.

Ai e paraqet Koliqin si një autor mbizotërues në zhvillimet e historisë së letrave shqipe të fillimshkullit XX për lëvrimin e llojeve të reja të shkrimeve, qoftë për nga ideja që parashtrajnë, qoftë nga format e gjetura për ta përcjellë denjësisht tek lexuesi. Korpusi tregimtar i Koliqit, përmes këtij shkrimi, do të përcaktohet si i lidhur më ngushtë me novelat e Pirandelos.

Në përmbylljen e tezës së tij studimore "*Qasje tregimit të Koliqit*", mjaft të vlefshme për lexuesit dhe interpretuesit e prozës koliqiane, autori do të ritheksojë faktin se *tregimi psikospektiv* shfaqet si "*zotërues në cilësi*" në krijimtarinë e Ernest Koliqit. Gjithashtu, me lëvrimin e këtij lloji të prozës, Plasari i atribuon Koliqit edhe rolin e udhërrëfyesit për pasaardhësin tregimtar e bashkëqytetar, Migjenin, në krijimin e novelzave të këtij lloji.

Viti 1995, si një vit përkujtimor përballë figurës madhore të letrave shqipe, rendit një sërë veprimtarish, artikuj e studime edhe në formë të përmbledhur kushtuar trashëgimisë letrare, publicistike e studimore të Ernest Koliqit. Ky vit përkon edhe me botimin e përmbledhjes "*Hanë gjaku*", në të cilën janë përfshirë veprat në prozë të Koliqit, si dhe artikuj studimorë kushtuar kësaj vepre.

Në librin "*Letërsia shqipe si polifoni*", në udhëpërshkrimin e tij shumëzënanor, Ali Xhiku, i përcakton prirjen e tregimtarisë së Koliqit në novelat e vëllimit "*Hija e maleve*" "*pas së veçantës, së jashtëzakonshmes dhe vegimtares*".

Në vizionin e historianit të letërsisë, A. Xhiku i rezervon një vend të tillë krijimit të Koliqit "nga pikëpamja e prirjes për ta identifikuar etnopsiqikisht jetën shqiptare, shfaqej si vazhdim i romantizmit të Rilindjes, po sigurisht një fazë e re e tij"¹⁸³.

Studiuesja Blerina Suta, duke e pranëvënë në krah të Mitrush Kutelit, si bashkëkohës e personalitet të një rëndësie të veçantë dhe Migjenit, si një zbulim e bashkëqytetas i autorit i ka dhënë funksionin e kulmit të një trekëndëshi barabrinjës që shërben si baza e ndërtimit të modernitetit në letërsinë shqipe. Trajtat shkrimore të Koliqit, Kutelit e Migjenit B. Suta do t'i bëjë objekt në veprën studimore "*Pamje të modernitetit në letërsinë shqipe*".

¹⁸¹ Smaqi, Laura, Receptimi i veprës së Ernest Koliqit në vitet '30, Studime filologjike, Nr. 3-4, Tiranë 1998

¹⁸² Studime letrare (Për mësuesit e letërsisë të shkollave të mesme), AEDP, Tiranë, 1998

(shkrimi i A. Plasarit në këtë përmbledhje daton në vitin 1991)

¹⁸³ Po aty, fq. 244

Më tej emri i studiuesit Kastriot Gjika, na shfaqet shpesh në interpretimet kritike kushtuar veprës tregimtare koliqiane. Gjika shprehet për Koliqin, duke vazhduar mendimin paraprijës të Plasarit¹⁸⁴ mbi kapërcimin e mediokritetit letrar të letërsisë shqipe, në konferencën shkencore “Letërsia si e tillë”, në vitin 1996. Në këtë kontekst ai thekson: “më së pari shfaqja e modernitetit në prozën shqipe përkon me botimin e prozave të Mitrush Kutelit dhe të Ernest Koliqit”¹⁸⁵.

Po në këtë përmbledhje shkencore, Koliqi rivjen bashkë me përrallën e tij në artikullin e Dhurata Shehrit. Studiuesja, që në vitet më pas do t’i drejtohet me një angazhim sistematik veprës së Koliqit na sjell si konceptim të rëndësishëm të rrëfimit në prozë nga Koliqi, pikërisht strukturën dhe elementet përfshirëse të përrallës. Shehri procedon në punimin e saj me analizën morfologjike të përrallës si kërkim i përshtashëm letrar¹⁸⁶ për disa nga tregimet e vëllimit “Hija e maleve”. Procedimi i një analize tekstuale, si një mundësi e interpretimit ngushtësisht shkencor, formalizohet në studimin pothuaj shterues për veprën “Paqyrat e Narcizit” të Dhurata Shehrit “Koliqi mes malit dhe detit”, vetëm disa vite më vonë, si një realizim i detyrës që i kishte vënë vetes.

Një vend nderi i rezervon Jorgo Bullo teksa rindërton historinë e letërsisë shqiptare “Lëvrues të shquar të prozës së shkurtër ishin E. Koliqi (1903-1975), M. Kuteli (1907-1967) dhe F. Konica (1875-1942). I pari krijoi një prozë subtile (të mprehtë), plot kolorit të qytetit të vet, Shkodrës (“Tregtar flamujsh”, 1935).

Në vitin 2008, në veprën “Fjala poetike –kuti e Pandorës” vlera e veprës së Ernest Koliqit interpretohet në forma të ndryshme nga Koçi Petriti duke u përqendruar në format e kërkimit krahasues mes analogjive e veçorive mes Migjenit e Koliqit nën fokusin e problematikës së mjerimit.

Në formë konkluzioni ky studiues poet thotë: “Kështu Ernest Koliqi është pa diskutim shkrimtar i madh dhe poet i shquar.”¹⁸⁷

Në mendimin intelektual bashkëqytetar Koliqi përkujtohet si shkrimtar si një personalitet i çmuar i kulturës qytetare, por dhe i fushës akademike. Universiteti i Shkodrës i kushton atij përmbledhjen “Studime shqiptare 3” në përkujtimin e 20 vjetorit të vdekjes. Kjo përmbledhje u botua pas organizimit të një simpoziumi shkencor nga vetë Universiteti, në qershor 1995.

Rreth 13 artikuj u botuan në këtë numër të kolanës “Studime shqiptare”. Lektorët, studiuesit si dhe artikujt e sjellë nga shtypi i huaj, rivlerësojnë individualitetin shumëdimensional të Ernest Koliqit. Ndër të tjera, Stefan Çapaliku në shkrimin e tij shqyrton disa nga pikëpamjet estetike me të cilat mund të zërthehen kodet e komunikimit koliqian. Ai gjithashtu reflekton për një shprehje artistike, e cila vjen si rezultat i njohjes intuitive të realitetit. Çapaliku dallon, me anë të kësaj njohjeje përmasat kapërcyese të artit të Koliqit

¹⁸⁴ Përcaktimin e Plasarit për Koliqin në këtë konferencë e kemi përmendur më parë.

¹⁸⁵ Gjika Kastriot, Duke hulumtuar fillimet e prozë moderne shqipe, Letërsia si e tillë, Toena, Tiranë 1996, fq. 201

¹⁸⁶ Shehri, Dhurata, Përralla si tregim brenda tregimit, Letërsia si e tillë, Toena, Tiranë 1996, fq. 223. Shehri i drejtohet veprës teorike të letërsisë “Morfologjia e përrallës” nga Vladimir Propp

¹⁸⁷ Po aty, fq.155

" intuitë dhe shprehësi, këto dy kategori të huajtura nga Benedetto Croce, e bëjnë atë revolucionar në letërsinë shqipe"¹⁸⁸.

I rëndësishëm për nga mënyra e shpjegimit dhe interesant për nga konceptimi, na përcillet studimi i një tjetër intelektual të fushës së mendimit kritik shqiptar. Ardian Marashi, në perceptimin e tij pesëpolësh, na ka çkodifikuar mjaft nyjëtime të rrënjëve koliqiane si " ide drejtuese e gjithë veprës së Koliqit"¹⁸⁹.

Ardian Ndrecaj, një shkodran jashtë atdheut, i afrohet shpesh me artikuj të ndryshëm figurës së Ernest Koliqit.

Në janar 2009 pedagogia e letërsisë në Universitetin e Shkodrës, Ledri Kurti në studimin e saj, shkruan "Koliqi na la vlerë, qoftë në llojin e tij si shkrimtar, qoftë në esenë e tij, si art dhe mendim kritiko-estetik"¹⁹⁰.

Vepra e Koliqit në mendimin intelektual kosovar

Në vitin 1991 del në dritë monografia shkencore e Anton Berishës, e cila përbën një pikë të rëndësishme referimi për vijimtarët e fushës së kërkimit letrar shqiptar dhe shtron çështje me rëndësi që, të marra gjithsecila më vete, mund të bëhen teza studimore në punimet e mëvonshme. Në një pamje arkitekturore të prozës shqipe, Berisha i projekton Koliqit vendin e " themeluesit dhe ndër lavruetit më të shquar të prozës psikologjike shqiptare"¹⁹¹. Ai do të bëjë objekt studimi të punimit të tij, pikërisht ato tipare stilistike që e lidhin ngushtë prozën e Koliqit me realitetin shqiptar, në të gjitha fjetet e mundshme të lidhjes së tyre.

Në vazhden e kërkimeve shkencore, drejtuar krijimtarisë së Ernest Koliqit e ngushtësisht tregimtarisë së tij, emri i Sabri Hamitit zë një sfond bazë në mendimin analizues drejtuar prozës së Koliqit. Tek "Letërsia moderne shqiptare", një tekst kushtuar zhvilimeve letrare në gjysmën e parë të shekullit XX në Shqipëri, Hamiti vlerëson dukshëm shkrimin në prozë të Koliqit. Studiuesi Sabri Hamiti shprehet se modeli shkrimor i këtij autori është i veçantë në letërsinë shqipe.

Studiuesi kosovar, Kujtim Rrahmani përqendrohet në karakterin intertekstual të veprës prozaike koliqiane. Ai i kushton një të tretën e studimit të tij, intertekstualitetit dhe oralitetit të këtij autori, duke u rezervuar, pothuaj të njëjtën hapësirë edhe për dy autorë të tjerë, të cilët mendohet se kanë elemente të përbashkëta dhe, madje, vazhduese në këtë aspekt, të prozës.

Ndue Ukaj, një nga përfaqësuesit e kritikës së sotme kosovare, e përcakton si të tillë veprën në prozë si një vepër që njeh shkallën e lartë të diskursit duke futur në lojë ndërkomunikime për të shfaqur një karakter intertekstual e strukturë shumështrësore të Koliqit.

Përsëri një autor tjetër kosovar i qaset veprës koliqiane në formë të tillë. Ilir Sefaj përqendrohet në disa aspekte të prozës koliqiane, si: ideja, fabula, karakteret e patjetër objekt studimi bëhet *Mitikja* në novelën e Koliqit. Studiuesit kosovarë përherë i janë mirënjohës përkushtimit të Koliqit në drejtim të emancipimit arsimor e kulturor të tyre.

¹⁸⁸ Çapaliku, Stefan, Artisti si auto-da-fe, Studime shqiptare 3, , Volaj, Shkodër 1995, fq19

¹⁸⁹ Marashi, Ardian, Pole koliqiane, Studime shqiptare 3, fq34, Volaj, Shkodër 1995

¹⁹⁰ Po aty, fq. 202

¹⁹¹ Po aty, fq 99

Vlerësimi i studiuesve të huaj për shkrimtarin (Vlerësimi në mërgim)

Nga e fundit *Histori e Letërsisë Shqipe*¹⁹² e shkruar nga një albanolog i shquar i kohës sonë, Robert Elsie, e cila na vjen prej përtej kufijve trashëgimia artistike e Ernest Koliqit vlerësohet e tillë. "Nga të gjithë prozatorët e periudhës, askush nuk qe më i madh e më i fuqishëm se Ernest Koliqi"¹⁹³. Në vendin e rezervuar për Koliqin historiani i letërsisë na përshkon edhe me frymën e kohës, kur u shfaq vepra e parë në prozë e shkrimtarit. "Trajtimi pak a shumë realist dhe analiza psikologjike e karaktereve njerëzore nuk u prit dhe aq mirë nga shkrimtarët e njohur të kohës, një pjesë e mirë e të cilëve ende lëngonin nga sentimentalizmi i romantikës kombëtare". Në përshtypjen për vëllimin me tregime "Hija e maleve", shprehet kështu: "Shpirtrat e maleve janë gjithmonë në mendjet e fiseve të veriut dhe u japin mjaft tregimeve një frymë të së mbinatyrshtes"¹⁹⁴.

Kryesisht i drejtuar nga vlerat narrative të shkrimtarit, Robert Elsie përcjell mendimin e tij edhe për daljen e dytë në tregun letrar të Koliqit me përmbledhjen e dytë, me ato që ai i quan rrëfenja "tregimet e vëllimit "Tregtar flamujsh" vlerësohen përgjithësisht si më të mirat e prozës shqiptare në periudhën e pasluftës"¹⁹⁵.

Në përfundimet e përcaktimit të vet albanologu kumton cilësimi "Si personalitet i letërsisë e i kulturës, Ernest Koliqi ishte dhe mbetet gjigant, sidomos për rolin e tij në zhvillimin e prozës së Shqipërisë së veriut". Në vizionin e tij ai mbështetet në elementet që bëjnë pjesë në krijimtarinë individuale të Koliqit dhe në rolin që ajo pati për zhvillimin më të gjerë të letërsisë për kohën.

Një nga profesorët arbëreshë të Italisë Italo Costante Fortino referon në konferencën shkencore "Shkodra në shekuj" të vitit 2004, në pjesën kushtuar letërsisë proza e Ernest Koliqi gërmon në të kaluarën për të vlerësuar limfën jetike të fluksit kulturor të ri prej Perëndimit që po investonte Shqipërinë, përfaqësojnë rrjedhjen e parë të dukshme dhe me rëndësi për kulturën shqiptare të rilindur"¹⁹⁶.

Në historinë e letërsisë dhe studimeve italiane, kushtuar autorëve të migruar në këtë vend, Ernest Koliqi shfaqet shpesh si një fenomen që përbën interes për italianët, e sidomos për ata që ishin miqtë, bashkëpunëtorët e studiuesit e të veprës së tij në Universitetin "La Sapienza" të Romës. Ndër këta, një pikë e fortë mbështetëse ka qenë e mbetet vepra studimore e Giuseppe Gradilones.

Floresha Dado njeh si të rëndësishëm kontributin e Gradilones me veprën "L`opera letteraria e culturale di Ernesto Koliqi"(1974), ku profilizohet portreti i Koliqit si artist shkrimtar, përkthyes gazetar e kritik.

¹⁹² Robert Elsie "Histori e letërsisë shqiptare" përktheu nga anglishtja Abdurrahim Myftiu, Dukagjini, Tiranë-Pejë, 1997, fq. 328

¹⁹³ Po aty, Ernest Koliqi, Mitrush Kuteli dhe proza e periudhës së pavaresisë. fq. 328. (Në përcaktimin përkatës studiuesi ka përmbledhur pohimet e një grupi të madh emrash të studiuesve shqiptarë dhe të huaj për figurën madhore të Ernest Koliqit si Guzzetta 1968, Bartl 1973, Gradilone 1969, 1974 f. 230-272, Shejza numër përkujtimor 1976, Plasari 1991, Stefan Çapaliku 1995, S. Schëartz 1992 dhe A. Berisha 1995.)

¹⁹⁴ Ernest Koliqi, Mitrush Kuteli dhe proza e periudhës së pavaresisë. fq. . 333

¹⁹⁵ Po aty, fq. 333

¹⁹⁶ Prof. Italo Fortino, Ernest Koliqi dhe "Kangjelet e Rilindjes", Muzeu Historik i Shkodrës, Seminari I Katërt Ndërkombëtar "Shkodra Në Shekuj" Vëllimi III, Shkodër, 2004, Shtypshkronja "Rozafa 01Shkodër"fq. 217

Në një nga studimet e fundit që na vjen përtej Adriatikut e quan letërsinë e Koliqit, ashtu si atë të De Radës *letërsia e udhëtarëve*. Pierfranco Bruni, autor një libri studimor mbi letërsinë e etniteteve pranë në shkrimin e tij Koliqin, si vazhdues të denjë dhe trashëgimtar të De Radës, jo vetëm në planin historik, por edhe atë letrar.

Përfundime

Në një kënvështrim përmbledhës janë paraqitur disa nga orvatjet e studiuesve të cilat rrugëtojnë nëpër një udhë përmes së cilës ecën receptimi i veprës letrare sipas kohës, mjedisit dhe vendit.

Janë evidentuar disa prej linjave kyçe nëpër të cilat ka ecur mendimi kritik rreth figurës së Koliqit dhe shkrimit të tij në prozë.

Në rikthimin e tij për të kërkuar vendin që i takon cilësimi për Koliqin, interpretimi dhe analizat për veprën e tij janë sigurisht një tregues esencialisht i vlerësueshëm.

Vlerësimi i tregimtarisë së tij njih një plan të shumëfishtë analitik dhe sintetik, por ka gjithashtu rrugë e shtigje për t'u eksploruar ende në kuadrin e përcaktimit të zërit kushtuar atij në historinë e Letërsisë Shqipe.

Sigurisht flasim këtu për një angazhim të rëndësishëm në fushën e historiografisë letrare shqipe, një detyrë kjo e konceptuar dhe shtruar edhe nga autoritet e kësaj shkence në Shqipëri.

Shkodër, më 11.07.2014

MUZEU HISTORIK ETNOGRAFIK NË VUSHTRRI TEMPULL I KOMUNIKIMIT QYTETAR ME TRASHËGIMINË KULTURORE

Jehona Hajrullahu

Që nga periudhat e hershme kur njerëzit krijuan njëfarë përvojë dhe dëshirë për të koleksionuar diçka personale apo kolektive dhe për t'i paraqitur të tjerëve, kështu për herë të parë ka ndodhur në vitin 260. para krishtit, pra një grumbull objektësh të kohës krijuan muzeun e parë në Aleksandri. Më pastaj u hapën edhe shumë muze të tjerë në mesjetë e sidomos në periudhën pas revolucionit francez, vërtetë kjo periudhë shënon një kthesë të madhe për muzetë në vendet e ndryshme të botës duke e vënë në baza të shkencës madje duke e kthyer në disiplinë shkencore. Kështu, pra, edhe në trojet shqiptare, përgjatë historisë, pothuajse nga të gjitha etapat e zhvillimit historik, shoqëror e ekonomik, janë grumbulluar e formuar koleksione të ndryshme si ato të karakterit historik, kulturor e shkencor. Kosova, për dallim prej viseve tjera shqiptare, nuk ka arritur akoma të konsolidohet në aspektin e grumbullimit të fondeve për zgjerimin e rrjetit të muzeve në të gjitha hapsirat e vendit (Sahiti. F. 2012 : 491). Muzeu, krahas funksionit themelor për ruajtjen, mbrojtjen, mirëmbajtjen dhe prezentimin e tërësisë së vlerave shpirtërore dhe materiale të një populli të krijuara përgjatë historisë së tij që janë pjesë e trashëgimisë kombëtare, mbase mund të konsiderohet pasqyrë e qytetërimit të lashtë të një populli. I tillë muze është "Muzeu Historik Etnografik" në Vushtrri dhe para se të kalojmë në prezentimin e këtij muzeu ne me këtë rast, do të ndalemi dhe të përmendim disa fakte për këtë qytet antik, por edhe modern.

Vushtrria me rrethinë sipas udhëpërshkruesve dhe studijuesve të huaj dhe vendas dëshmohej si qendër e Dardanisë antike. Të dhënat më të hershme nga ky rajon datojnë nga periudha antike, pra koha e krijimit të Mbretërisë Dardane. Resurset natyrore, kryesisht ato minerale qenë shkaktarë (në kuadrin e hapsirës së gjërë Ilire) kryesor i invadimeve romake në këto hapsira. Në saje të eksploatimit të këtyre resurseve u bë dhe finalizimi i tyre, duke bërë të mundur dhe krijimin e qendrës së njohur urbane, me një zejtari të avansuar për kohën të quajtur Vicianum. Evlia Çelebi në udhëpërshkrimet e tij Vushtrrinë e prezanton si një qendër urbane të njohur në këto hapsira me shtresë sociale të dominuar nga zotrinjë e bejlerë, dhe një qytet me oda dhe hane për miqë (Bajrami. Z. 1959 : 849). Ndërkaq Ami Bue-udhëpërshkrues-në vitin 1838, jep të dhëna për familjen shqiptare të Gjinollëve, e ardhur këtu në shek. XVIII, të cilët e sundonin këtë qytet. Ushtrimin e pushtetit mbi këtë qytet, pas Gjinollëve (1850) e ushtruan mydirët (drejtorët) më vonë kajmekamët (që ishin kryetar rrethi), (Bajrami. Z. 1959 : 849).

Gjithnji sipas Evlia Çelebiut, Vushtrria në periudhën austriake pësoi një rendje të gjithmbarshme në zhvillim, me pasoja të zhvendosjes mekanike të popullsisë (emigrim) dhe parametra ekonomik (Bajrami. Z. 1959 : 853).



Monument kulturo-historik, Ura e Gurit në Vushtrri

Kalaja e qytetit, Ura e vjetër e Gurit, Hamami, Xhamiat, kishat, mbi 22 lokalitete arkeologjike, varrezat e vjetra e shumë objekte të tjera të trashëgimisë kulturore, por edhe të trashëgimisë shpirtërore e artistike të kësaj treve pasqyrojnë gjurmët e së kaluarës, historinë ekonomike, sociale e kulturore, të cilat rezultuan dhe patën synimin e vazhdimësisë së studimit dhe trajtimit të mëtutjeshëm drejt së ardhmes. Meqenëse kjo komunë ka një histori të trashëgimisë materiale, shpirtërore, historike, kulturore për ruajtjen e gjithë këtij thesari është përkujdesur, Kuvendi Komunal derisa në vitin 2005 themeloi "Muzeun Historik-Etnografik" të Vushtrrisë i cili tashmë është formësuar në një institucion bartës të traditës etnokulturore gjë që do të kontribuojë në ngritjen e imazhit dhe të një reflektimi qytetar mbi thesarin e kulturës së këtij qyteti madje edhe në Kosovë. Pra, pavarësisht funksionalizimit të tij të vonshëm, muzeu në vete përmbanë një thesar të çmuar eksponatesh që shprehin kulturën shqiptare ndër shekuj.

Muzeu është i vendosur përkohësisht në lokalet e Shtëpisë së Kulturës "Hasan Prishtina" dhe ka këta sektorë: sektorin e Arkeologjisë, Historisë, Etnografisë, Kinotekën dhe Fototekën, ndonëse vazhdon të bëjë edhe inçizimin e trashëgimisë kulturore në terren.

Në sektorin e arkeologjisë, eksponatet i përkasin periudhave të ndryshme historike duke filluar nga ato të qytetërimit Ilir, të gjetura në Topogërmadhën e Gjytetit Dubofc i njohur për një civilizim ilir që nga shek. VIII para krishtit, (Grup Autorësh. 2003 : 469-470), pastaj me gurë varri me mbishkrime latine, siq është; BICI FELICI – ANVS (anus), F (ACIENDUM), C (URAVIT)- SH . II- Autopsi - i deshifruar sipas studiuesit Zef Mirdita (Grup A. 2003 : 470). Ndërkaq sipas studiuesit Muhamet Pirraku, shkrimi deshifrohet - rrjeshti i parë -BCEFILLICI, rrjeshti i dytë - ANVS (Anus) që do të thotë viti, ndërsa rrjeshti i tretë FACIT (Shkurtesë) për Facit – "u bë, u mbarua"(Grup A. 2003 : 470). Po ashtu, i një vlere të veçant kulturore, mendojmë se është altari votiv (në këto hapsira unikal deri më tani) kushtuar perëndisë së Jupiterit, i gjetur në themelet e "Kishës së Vogël" në lokalitetin antik Baja (Komuna e Vushtrrisë. Kjo Kishë është identifikuar e periudhës së mesjetës së vonshme (Mehmetaj. H. 2007 : 10). Në territorin e Kosovës së sotme viteve të fundit janë zbuluar monumentet me përkushtime: IOM COH (ortalis), (Ferri. M. 2012 : 37), duke përfshirë këtu edhe monumentin në fjalë. Nga koha e vjetër kemi edhe fotografi të gurëve me mbishkrime e simbole të vjetra, të cilat na rrëfejnë për Vicianën antike. Sipas historianëve vendi i gjetjes së tyre është rrethina e Kumanovës, (Grup A. 2003 : 47-48) për të cilat tani nuk

dihet se ku ndodhen. Nga koha e mesjetës, muzeu disponon edhe gurë mbivarrorë me simbole dhe forma otomane, gjeometrike e florale. Gurët në fjalë janë gjetur në fshatrat Sllakofc, Vërrri dhe Çeltinë (Komuna e Vushtrrisë).



Altar i Juipterit - Banjë

Një numër i madh i eksponateve nga mesjeta gjenden në këtë muze si: enë guri e qeramike, copëza nga qeramika si gypa të ujit, llulla duhani etj, kallëp monedhash nga guri, vegla pune të metalit, etj, të grumbulluara kryeshit nga kjo trevë.

Me qëllim të njohjes për historinë e shumë veprimtarive dhe aktiviteteve përgjatë proceseve të ndryshme historike, politike e kulturore, mbase edhe rikujtimit të ngjarjeve dhe veprave të rëndësishme të popullit shqiptarë, në mjediset e këtij muzeu gjenden eksponate historike fotografi të figurave dhe personaliteteve të shquara historike kombëtare si: Fotografi të: Hasan Prishtinës, Ismail Qemalit, Azem e Shotë Galicës, etj, e deri tek fotografitë e heronjëve dhe dëshmorëve të luftës së fundit në Kosovë të vitit 1999 të shoqëruara me ditarë të ndryshëm me përshkrime të ngjarjeve përgjatë luftës së UÇK-së, si dhe veshje ushtarësh e aksesore të ndryshëm. Ndonëse ky sektorë është pasuruar edhe me armë e mjete tjera lufte periudhash e prodhimesh nga më të ndryshmet.

Eksponatet në fushën e Etnografisë janë dominuese në këtë muze dhe ka një fond të pasur nga pjesë të veshjeve të srukturave moshore dhe gjinore, sociale e ekonomike nga më të ndryshmet, si dhe shtrojë e mbulojë, mga enterieri enë e orendi, vegla e mjete pune bujqësore, instrumente popullore etj,



Pshallak dhe mbrapanik nga leshi me simbole gjeometrike, kozmike dhe florale

Kinoteka posedon një numër solid të inçizimeve të vjetra dhe ngjarjeve e ceremonive të reja. Ndonëse Fototeka është shumë më e pasur me fotografi të ngjarjeve dhe personaliteteve e figurave të ndryshme historike kombëtare, arsimore-edukative, kulturore e artistike. Nga mbretërit Ilir e deri tek ushtarët e UÇK-së, foto të masakrave të Luftës së Fundit në Kosovë, foto të selektuara sipas fushave përkatëse si: foto të shkollave të para në Vushtrri, foto të mësuesve të parë të fushës së arsimit, ndërsa nga fusha e kulturës me foto të objekteve me vlerë arkitektonike; foto me veshje të ndryshme, e posaqërishtë me foto të shoqërive kulturo-artistike që nga vitet 1916-1918; etj. Sipas shpjegimit të punonjësve të muzeut dhe literaturës së konsultuar, motivet e realizuara në ekspozate pavarësisht materialit në përgjithësi janë të njejta që i dedikohen kultit të parardhësve, kulteve kozmogonike, të pyjeve, burimeve, bimëve etj., që pasyrojnë lidhjen e njeriut me natyrën dhe fenomenet e saj. Duke filluar nga pikësimi, vijat e shkurtëra, zig-zaket, vijat e lakuara-meandret, rruga e humbur, figurat gjeometrike: trekëndëshi, katërkëndëshi, rrombi, rromboidi-të njohura si art gjeometrik, për të kaluar në simbolikën motivore floreale, besnikërishtë të ruajtur nga flora e arealit vendor si: kamë pule, lulë shëngjergji, lulë gjarpëri, lulë dielli, etj.; pastaj në motivet zoomorfe, dominojnë figura demonjake dhe totemike siq janë: gjarpëri, bolla, ujku, dhelpra, shqiponja, dallëndyshja, lejleku, bilbili, sorkadhja, pëllumbat, etj., e për të ardhë deri te motivet antropomorfe.

Peshën shkencore këtyre vlerave të krijuara ia rritë fakti se janë fenomene dhe dukuri përkatësisht krijime apo prodhime masash të gjera popullore, që flet për një kulturë burimore. Gjithashtu është me rëndësi të potencohet, sidomos në mitologjinë popullore të realizuar përmes ceremonishë e rithesh, individuale, grupore deri te ato

pelegrinazheske, në vende kultesh në trollin autokton. Kjo konsiderohet si një dëshmi e autoktonisë në trojet e saj., duke filluar nga pikësimi, vijat e shkurtëra, zig-zaket, vijat e lakuara-meandret, rruga e humbur, figurat gjeometrike: trekëndëshi, katërkëndëshi, rrombi, rromboidi-të njohura si art gjeometrik, për të kaluar në simbolikën motivore floreale, besnikërishtë të ruajtur nga flora e arealit vendor si: kamë pule, lulë shëngjergji, lulë gjarpëri, lulë dielli, etj.; pastaj në motivet zoomorfe, ku dominojnë figura demonjake dhe totemike siq janë: gjarpëri, bolla, ujku, dhelpra, shqiponja, dallëndyshja, lejleku, bilbili, sorkadhja, pëllumbat, etj., e për të ardhë deri te motivet antropomorfe.



Furkë, me simbole gjeometrike e kozmike

Duhet thënë se praktika e muzeve modern në Perëndim po tregon se nuk ka rëndësi aq të madhe numri i eksponateve të cilat i ka muzeu, por ka rëndësi mënyra si aktivizohen ato, sepse muzeu nuk konsiderohet më vetëm si "shtëpi" eksponatesh, por edhe si shtëpi idesh për veprime të reja në trajtimin dhe prezantimin e trashëgimisë materiale dhe jomateriale kulturore. (Stublla. Sh. 2012 : 29).

Sidoqoftë , duhet pohuar se ky material përgjithësisht na mundëson që që të njihemi me një rrugëtim të përvijuar të këtij thesari të trashëgimisë kulturore të kësaj treve përfshirë këtu shpërfaqjen e ngjarjeve te bujshme ndër shekuj të popullatës shqiptare në vend me fenomenet, historike, ekonomike e kulturore. Ruajtja, prezentimi dhe studimi i tyre kontribuojnë në njohjen dhe edukimin e vlerave morale e qytetëruese.

Ajo çka mbetet për të kontribuar për të ardhmen e këtij muzeu është vënia në funksion e shërbimit propagandues për të shpërndarë kështu përmbajtjen dhe njohjen me trashëgiminë kulturore të vendit në përgjithësi. Ky thesar i trashëgimisë kulturore nuk duhet të na përmbush derisa në këtë drejtim duhet vazhduar edhe më fuqishëm duke prezentuar kulturën dhe historinë e një populli me traditë të lashtë.

Recensentë:
Prof.Dr. Zymer Neziri
Dr. Bashkim Lajçi

PROFILI KRIJUES I PETRIT PALUSHIT

Kosovare Krasniqi

Ndryshimet që ndodhen në shoqërinë shqiptare - rënia e ideologjisë komuniste dhe demokratizimi i raporteve shoqërore e njerëzore - ndikuan edhe në letërsi dhe arte. Krijuesit e vërtetë me vepra e treguan personalitetin e tyre, ndërsa të tjerë, edhe pse vazhdojnë të botojnë edhe më tej, vetëm sa e rëndojnë botën e letërsisë pa na dhënë vepra që i qëndrojnë kohës, pa marrë parasysh patericat e kritikës klanore që i mbështet.

Një krijues krejt i veçantë që u shfaq në letrat shqipe pas viteve '90, është Petrit Palushi, i cili pos si romancier, herë pas here merret edhe me publicistikë dhe eseistikë, njihet edhe si studiues i letërsisë shqipe, veprat kritike të të cilit janë: "Shkrimtari dhe anatema" (1995), "Misteri i rrëfimit", (1999) etj., por që me këmbëngulje e kultivon prozën dhe mbetet prozator deri në fund, i dalluar në fushën e romanit. E tërë proza romanore e tij përbëhet nga këto vepra: "Përroi i Andrrës" (2004), "Tri motra në një qytet" (2006, botimi i dytë 2011), "Njeriu që kujdesej për varrin e vet" (2007), "Artemisa e mëkatit" (2010), dhe "Këpucët e Kaltrinës" (2013). Por Petrit Palushi nuk ndalet, ai vazhdon të punojë në projektin e tij romanor i cili nuk mbyllet me këto vepra, sepse ai vazhdon të krijojë vepra të reja. Shënoj gjithashtu se në vitin 2011 është botuar libri i studiuesit Halil Haxhosaj "Vështrim në prozën romanore të Petrit Palushit", ku shqyrtohen tri romanet e para të Palushit.

Këtu duhet të shtojmë se Petrit Palushi është ndër të parët dhe ndoshta edhe i vetmi, i cili e ka ndriçuar figurën "heretike dhe antidiktaturë" të Havzi Nelës me veprën "Kryqëzimi i Havzi Nelës" (2008), gjithashtu është autor i librit-ditar "Kukësi në 79 ditë" (1999), në të cilin përshkruhet eksodi i shqiptarëve të Kosovës gjatë periudhës së bombardimeve të vitit 1999.

Lidhjet në mes romaneve

Romanet autori i ndërlihdh me stilin dhe gjuhën e tij, por në to kemi edhe disa lidhje të jashtme. Këto lidhje, edhe pse të vogla, bëjnë lidhjen "fizike" të romaneve të tij. P.sh. Vesa, personazh i romanit "Tri motrat në një qytet" fut në shishe një letër dhe hedh në ujanë, në të cilën ishte lutur për fatin e saj dhe të tjerëve, ndërsa Dardani, personazh i romanit "Këpucët...", gjen në ujanë Librin e Biblës dhe brenda faqeve të librit një letër, në të cilën dikush, nga larg lutet për ta. Pastaj në romanet e tij hasim personazhe që kalojnë nja njëri roman në tjetrin, p.sh. Vesa është personazh i romanit "Tri motra në një qytet", po ashtu në romanin "Njeriu që kujdesej për varrin e vet" shfaqet si personazh, edhe pse periferik, pastaj Flaka, personazh i "Tri motra...", shfaqet me imazhin e Përroi të Andrrës: "Prandaj Përroi i Andrrës s'i bëri shumë përshtypje... Domethënë, edhe uji nuk qe njësoj, se atypari duhej t'ish më e kujdesshme se kudotjetër: ai vend kish të bënte

me ëndrrat, më saktë me trazimin që i shkaktonin njeriut ëndrrat e rënda dhe duhej të ruhej prej tyre njësoj siç mund të ruhej prej gjarpnit, në mos dhe më tepër.¹⁹⁷

Këto “fakte”, në sy të parë të vogla, diku të dukshme e diku të padukshme, kryejnë funksionin e ndërlihdjes së romaneve të Palushit, të cilat, në fund të fundit, mund të lexohen si një roman.

Te “Këpucët e Kaltrinės” dhe te “Të tri motra në një qytet” pikëlidhje është i njëjti shtrat ku lëvizin personazhet; në të dy romanet e sipërcituara është një kohë mungese totale e dashurisë, një kohë zbrazëtie shpirtërore, një kohë pa Zot. Personazhet kërkojnë shtëpinë e Zotit, e cila nuk ekziston fare, gjejnë Biblën - fjalën e Zotit -, e fshehin për të mos u përrjashtuar nga shkolla, etj.

Gjeografia e rrëfimeve të romaneve të Palushit është gjithnjë veriu shqiptar; ndërsa te “Artemisa e mëkatit” një pjesë e subjektit bartet në Komo te Italisë. Toponimet e veçanta, reale dhe imagjinare, janë pjesë e romaneve të Palushit, i përdor në të gjitha romanet, ndërsa më shumë i hasim te “Përroi i Andrrës”.

Atmosfera e romaneve

Krijimtaria e Petrit Palushit është ndër më të veçantat në letërsinë shqipe, kështu që në këtë kumtesë qëllimi im është të shpalos botën krijuese të tij, e cila shpërfaqet në romanet që i përmenda më lart.

Petrit Palushi në prozën bashkëkohore shqiptare hyri fuqishëm që me botimin e romanit të tij të parë, “Përroi i Andrrës” (2004), me të cilin tërhoqi vëmendjen e kritikës letrare; pikërisht ishte proza e tij e veçantë që bëri që kritika të kthejë sytë nga krijimtaria e tij, si ndër më të veçantat në letërsinë tonë më të re. Me temat që trajton, me mënyrën si e formëson lëndën, me gjuhën dhe stilin e veçantë të tij, me strukturën dhe mikrostrukturën e prozës së tij, proza e Petrit Palushit e nxit lexuesin të përsiasë për të, të mendojë më thellë, por edhe kritikën të gjykojë për këtë vepër, për secilën veç e veç, por edhe si vepër të tërësishme.

Ky krijues, në veprën e tij, përgjithësisht, paraqet jetën nën diktaturën e egër komuniste dhe të gjitha anët e errëta të këtij sistemi, i cili për dekada me radhë kishte mbajtur të ngujuara fatet e njerëzve që kanë jetuar nën atë sistem. Mungesa e lirisë së individit, mungesa e lirisë së fjalës, ndalimi i religionit, nëpërkëmbja e të drejtave më të zakonshme, varfëria e skajshme apo uria ekstreme, mungesat më elementare në një kohë kur mund të thuhet se edhe ëndrrat ishin të ndaluara, shpërfaqen në pjesën dërrmuese të romaneve të tij. Megjithatë, në këtë prozë vërehet edhe kundërshtia që i është bërë këtij sistemi dhe “tejkalimi” i tij, në mos në realitet, së paku në imagjinatën e këtyre njerëzve. Mirëpo, ky krijues, nuk ka mbetur i barrikaduar te temat e diktaturës, por në romanet e tij si temë trajton edhe tradhtinë bashkëshortore, po edhe abuzimin me pushtetin, çka do të thotë se temat e romaneve të tij janë nga më të larmishmet.

“Jeta” e personazheve në romanet e tij fillon si jetë reale, pastaj ajo pothuaj shkëputet nga realiteti duke kaluar në fantazi, që do të thotë se ai përmbush atë që e thotë Bernard Clavel: “Për të qenë romancier duhet të kesh tharm, rrëfenjeza për t’i shkoqitur, personazhe për t’u dhënë jetë e gjallëri, me një fjalë duhet të mbartësh një botë”.¹⁹⁸ Pra, Palushi është mjeshtri i cili krijon rrëfenja, u jep jetë personazheve të tij, duke i futur ata në një jetë plot ankth dhe shpresë.

¹⁹⁷ Tri motra në një qytet, botim i dytë (2011), f. 76

¹⁹⁸ Borges, Nabakov, Kenzabura Oe etj., Një univers në një rrokje (Përzgjedhje dhe përktheu Luan Canaj), Tiranë 202, f. 170.

Atmosfera ku zhvillohen ngjarjet e romaneve të tij është e zymtë. Autori është shumë realist, përshkruan ngjarjet pa u dhënë zbukurime, pa dhënë shumë anë të ndritshme apo të errëta, shumë të ëmbla apo shume të hidhura, shumë serioze dhe shume ironike, pra jep jetën me nota reale të saj, pa anuar nga asnjëra ana - as nga ajo e keqja e as nga ajo e mira, gjithnjë shkon në një mjedis gri.

Një pasqyrë e romaneve

Krijimtarinë e tij Petriti Palushi në fushën e romanit e ka filluar me romanin “Përroi i Andrrës”, menjëherë pas botimit të të cilit, kritika ka filluar të interesohej për krijimtarinë e tij. Si pjesë të geografisë së këtij romani ai mori një pjesë të natyrës - përroin, në mes rrjedhës së dredhuar të të cilit vijnë vërshime ose lumë fjalësh të përziera me nuanca ritmesh. Njerëzit përreth tij thoshin se, po të të zinte gjumi afër tij, do të shihje ëndrra të këqija. Sipas tyre, “përroi” ishte i xhindosur dhe kjo ngjallte frikë tek njerëzit. Vetëm Shpendi, personazhi kryesor i këtij romani, kishte guximin të bënte gjumë tek përroi, përderisa fshatarët vuajnë nga ankthi i ëndrrave torturose. Lexuesi këtu e ka të vështirë të kuptojë ku mbaron ëndrra dhe ku fillon realiteti.

Te “Përroi i Andrrës” as koha nuk është e përcaktuar, as ngjarjet zhvillohen në rrjedhë kronologjike, romani nuk ka një subjekt të qartë, këtu të gjitha rrefenjëzat janë pjesëza të ndërlidhura me njëra-tjetrën, por që mund të jetojnë edhe si tërësi më vete.

“Tri motra në një qytet” është një tjetër roman i Palushit, subjekti i së cilës zë fill me kthimin e tri motrave nga një shtet i huaj në atdhe dhe zhgënjimi me atdheun e tyre.

Asgjë nuk i ndalon motrat Lisi për të takuar vëllanë e tyre, i cili me dëshirën e tij ishte kthyer për studime në Shqipëri, me gjithë qortimet e të atit, i cili ia kishte tërhequr vërejtjen se “Sa më larg ferrit. Njeriu vetëm një herë vjen në jetë”.¹⁹⁹

Në këtë roman, realiteti i Shqipërisë komuniste shihet me syrin e shqiptareve të kthyer nga jashtë. Ashpërsia e këtij realiteti më së miri shihet nga sytë e atyre që e përjetojnë për herë të parë, sepse banorët e këtushëm, nga jeta e gjatë nën këtë realitet, e kishin humbur aftësinë e perceptimit të drejtë të tij.

Motrat e vuajnë për shkak të babai të tyre, i cili ishte arratisur para se të lindnin ato. Ky faj “i tmerrshëm” është i ngjashëm me fajin e tragjedive greke, në të cilat personazhet e tyre i trashëgonin fajet nga fati i tyre tragjik; fati i tyre përcaktohej nga faji që e trashëgonin.

Romani në vijim, “Njeriu që kujdesej për varrin e vet”, siç nënkuptohet nga vetë titulli, është një histori e dhimbshme e një njeriu të goditur nga fati i tij. Rrëfimtari i këtij roman, Bardhi, në pafuqinë e tij për të ndaluar vdekjen e fëmijëve të tij, bën veprimin më të pazakonshëm që është bërë ndonjëherë – hap një varr për veten e vet. Për ta luftuar këtë fat, duke e hapur varrin e vet, ai është i gatshëm të flijohet për ta mbrojtur vijimësinë e familjes së ti. Pra, këtu autori Petrit Palushi ka krijuar modelin e organizmit të jetës në baza humane, të cilin model ia vë përballë modelit të shoqërisë së organizuar në baza ideologjike, e cila për të mbajtur vijimësinë e ekzistencës së saj, i flijon anëtarët e saj. Këtu, prindi është i gatshëm të flijohet për të siguruar vijimësinë e familjes së tij.

Ndërsa në romanin “Njeriu që kujdesej për varrin e vet” është dhënë bota e mashkullit, bota e prindit, në romanin “Artemisa e mëkatit”, paraqitet bota e femrës. Nuk është lehtë të kuptohet bota e femrës; gruaja e romanit në fjalë, Artemisa, është vetë një dilemë. Këtu na del misteri i botës së femrës si grua dhe sidomos të gruas si personalitet: Artemisa - një botë e panjohur dhe e vështirë ose edhe pamundur për t’u deshifruar nga lexuesit.

¹⁹⁹ Tri motra në një qytet, botim i dytë (2011), f. 42

Autori, me figurën e Artemisës, krijon një personash që rrezaton në vete siguri dhe pushtet. Krijon një shpirt njeriu të lirë. Ajo, Artemisa, duke e krijuar botën e brendshme të ndjenjave të saj, ndan për tre muaj një jetë mes për mes, pa anuar nga asnjëra palë, as nga ajo e burrit e as nga ajo e dashnorit. Kur flitet për Artemisën, mendja të shkon te zonja Bovary e Floberit, pastaj te Ana Karenina e Tolstoit dhe kam mendimin që këtu kemi një pikëlidhjeje me këto dy romane.

Ndoshta edhe më shumë se tek romanet e tjera, në këtë roman vërtetohet konkluzioni se personazhet e romaneve të Petrit Palushit synojnë lirinë.

Në mesin e veprave të cilat si teme qendrore kanë temën e jetës nën diktaturë, hyn edhe romani “Këpucët e Kaltrinės”.

Përderisa të rinjve evropianë iu hapen horizonte të reja dhe të shumta të jetës, të rinjve shqiptarë iu mohohet gjithçka, mirëpo si brez i ri (gjimnazistë), personazhet e këtij romani prapë ëndërrojnë, duke shpresuar se një ditë e gjitha kjo që shohin para sysh, do të mbetet e kaluar, e gjitha do të ndryshojë si në një përrallë me mrekulli. Dardani, Etniku dhe Valoni, gjimnazistë që kërkonin ndryshimin në heshtje, janë në kundërtënie me atë që ndiejnë dhe atë që shprehin, por ata orientohen nga ajo anë e horizontit në të cilën e shohin të ardhmen e tyre dhe duan të dalin nga tmerrin në të cilën gjenden.

Struktura e romaneve

Autori pëlqen formën e shkurtër të romanit (veçori e prozës romanore të tij), sepse kjo i jep mundësi që sa më shkurt, të depërtojë në thelbin e subjektit që shtjellon.

Rrëfimet në romanet e tij, narratori i rrëfen në vetën e tretë, që ndonjëherë kombinohet me vetën e parë, ndërsa dialogët dhe monologët i zënë vendin njëri-tjetrit. Herë pas here, linja e romaneve ndërpritet me disa rrëfenjëza apo historizëza, me ngjarje të ndryshme të cilat i rrëfejnë personazhet, në ndonjë rast ndodh që autori të fusë edhe ndonjë minidramë si p.sh.: te romani “Njeriu që kujdeset për varrin e vet”, kemi bisedën në mes Bardhit dhe Egzonit, të birit të tij, e po ashtu një minidramë e tillë është edhe te “Artemisa e mëkatit”, që zhvillohet në mes Artemisës, burrit dhe gjyqtarit, për çështjen e shkurorëzimit. Pastaj te romani “Tri motra në një qytet” fut vargje të Robert Frostit, te “Këpucët e Kaltrinės” vargje të “Komedisë Hyjnore” të Dante Aligierit.

Subjektet e romaneve të Palushit, kryesisht janë nga jeta reale, pastaj autori fut trillimin artistik, siç thotë Gerar Genete, “t’i hysh trillimit do të thotë të dalësh nga hapësira e zakonshme”, duke shtuar më tej edhe përsëritjen e disa filozofëve se “parashtrimi trillimor nuk është as i rremë e as i njëmendët”; kalimet nga procesi i reales në ireale ose anasjelltas e kompletton tërë veprën romanore të tij.

Romanet dallohen për nga tema që trajtojnë, si dhe nga mënyra e trajtimit. Në disa romane, si për shembull në “Tri motrat në një qytet” teksti është më i kapshëm nga lexuesi, rrëfimi rrjedh më shtruar, ndërsa te “Artemisa e mëkatit” autori luan me nëntekstin.

Pra, kur lexojmë romanet e Palushit, hasim një gjuhë që ndryshon nga gjuha që përdorin shkrimtarët e tjerë. Ashtu siç shprehet edhe Borges, në prozën e Palushit “çdo fjalë del si e gdhendur, sikur të ishte hajmali”.²⁰⁰ Fjalët që i hasim në prozën e tij, si: e qielltë, fletëz, përrojz, rrjetëza-rrjetëza, u ëmbëltua, njomështi dhe dhjetëra fjalë të tjera, ndoshta në shikim të parë të duken fjalë të thjeshta, por janë fjalë të bukura e melodioze, dhe me një forcë magjike tërheqëse. Mund të themi se nuk është i vetmi autor i cili krijon fjalë apo shpik fjalë të reja, mirëpo është shumë e vërtetë se fare pak shkrimtarë modernë kanë guximin të bëjnë diçka më ndryshe nga të tjerët dhe, përderisa prozatori më i mirë i

²⁰⁰ Luan Canaj, Një univers në një rrokje, f. 14.

gjuhës spanjolle, Alfonso Reyes, ka thënë për Groussac, “Groussac me mësoi se si duhet shkruar spanjishtja”, unë me plot të drejt mund të them se Palushi, me gjuhën që përdor në romanet e tij, po na mëson se si duhet shkruar shqipja dhe, po ashtu, përmes gjuhës së tij po afrohem me afër gjuhës autoktone shqipe. Ai përdor të dyja dialektet, bën përzjerjen e atij toskë me atë gegë, i lë një frymëmarrje të lirë gjuhës, pa censurë, pa rregulla, kështu ai na jep një gjuhë të veçantë me një fjalor shumë të pasur.

Udhëkryqi i personazheve

Personazhet e romaneve të Petrit Palushit pothuajse vazhdimisht gjenden në një udhëkryq, real apo imagjinar. Kështu p.sh. Shpendi, personazhi kryesor i romanit “Përroi i Andrrës”, bën një jetë në mes ëndrrës dhe realitetit; Bardhi, personazhi kryesor i romanit “Njeriu që kujdesej për varrin e vet”, jeton me gropën e varrit hapur; Vesa, Flaka dhe Jehona, heroinat e romanit “Tri motra në një qytet”, jetojnë me ëndrrën e ikjes nga vendi, në të cilin asnjë njeri nuk mendon me kokë të vet, por me kokë të partisë. Ndërkaq, personazhi i Artemisë, në romanin “Artemisa e mëkatit”, dallon nga të tjerët. Artemisa na jep shembullin e njeriut që bën jetë të dyfishtë; ajo jeton në mes të fajit të bërë me qëllim dhe atij pa qëllim; ndërsa te romani “Këpucët e Kaltrinës”, tre gjimnazistët: Dardani, Etniku dhe Valoni jetojnë me ëndrrën për të jetuar në qytete të mëdha dhe për të lexuar kryeveprat e letërsisë botërore. Me një fjalë, personazhet e romaneve të Palushit gjithnjë tentojnë të shkojnë përtej pozitës që kanë, përtej atij realiteti të përditshëm, përtej kornizës që ua kanë caktuar të tjerët. Pra, duke parafrazuar titullin e një libri me kujtime për kohën në të cilën jetojnë personazhet e romaneve të Palushit, (“Bardhyl Londo, “Jeta që na dhanë”), këto personazhe tentojnë të kapërcejnë jetën që u është dhënë dhe të bëjnë jetën e tyre. Kjo ndodh pothuaj në të gjitha romanet e tij, ashtu siç ndodh në romanin “Këpucët e Kaltrinës”, në të cilin, edhe përmes gjësendeve që sjellin ujërat e lumenjve, këto personazhe bëjnë përpjekje t’i kapërcejnë kufizimet që ua kanë caktuar të tjerët. Këtë jetë që ua dhanë, ata duan ta tejkalojnë secili në mënyrën e vet: dikush duke tentuar ikjen nga atdheu, të cilin e do aq shumë, të tjerë duke ikur në ëndrrat e tyre etj., në një kohë kur dashuria mungon kudo. Pra, është një kohë me mungesë totale e dashurisë, si dhe e mungesës së lirisë personale të personazheve, prandaj ata, personazhet, janë në kërkim të të dyjave. Kështu vepron Flaka (“Tri motrat në një qytet”), e cila pos që nuk humb dashurinë (sepse arratiset së bashku me të dashurin, Fatjonin), po ashtu rifiton lirinë e shumëkërkuar, atë që i kishte munguar.

Për hapësirën në të cilën jetojnë, personazhet e Palushit shprehen se është një vend ku “edhe ajrin duhet ta thithim me lejen e shtetit”. Personazhet duan lirinë, të mohuar nga sistemi komunist, duan të drejtën e tyre të jetojnë si të duan vetë. Vetë shikimi i Shpendit nga Lisi i Gjatë, përtej asaj vije tmerrri i *quajtur kufi*, na tregon dëshirën e personazhit për të bërë një jetë tjetër, e cila, sipas tij, mund të gjendet përtej asaj vije që të kalte datën, përtej asaj vije tmerruese, por edhe mendimi për një gjë të tillë ishte i ndaluar, pra kush guxonte të kalonte atë vijë tmerrri, të quajtur kufi, përtej atij horizonti të ndaluar, e përpinte e zeza, në kohën kur një kufitar dekorohet vetëm pse ka vlarë një pëllumb që po fluturonte përtej kufirit (pëllumbi simbolizon lirinë, ndërsa vrasja burgosjen e kësaj lirie) (“Këpucët e Kaltrinës”), këtu shfaqet një ironi e theksuar nga ana e autorit.

Personazhet e romanit disa dalin në sipërfaqe disa mbeten vetëm si hije, si p.sh. Kaltrina, Sibora, burri i Artemisë, nuk duken gjëkund, por janë aktorë që lëvizin në brendësi të veprës pa u hetuar shumë nga lexuesi.

Pra, autori fuqishëm jep mesazhin e veprave të tij, në të cilat temë mbi temat mbetet liria e individit dhe dashuria e tij ndaj njeriut.

Rrjedhja e ujanës ose ujit nëpër rrëfenja

Një element i rëndësishëm dhe disi i misterioz që e hasim në rrëfenjat e Palushit është uji apo ujana, siç emërtohet në romanet e tij. Autori jo vetëm në një vepër të tij përmend ujanën, por ky element përmendet në të gjitha veprat e veta, pra është një element karakteristik i cili del nga vetë natyra, dhe që autori jo pak i jep rëndësi në veprat e veta. Pra, si një fenomen që Uji është edhe si kryetemë e të gjitha romaneve të tij. Uji në rrëfenjat e tij ngërthen të frikshmen, por edhe qetësinë. Uji, përveç shumë të mirave që i sjell njerëzimit, i sjell edhe shumë të këqija, duke marrë edhe jetë njerëzish, “ku çdo verë pothuajse mbytej nga një fëmijë”.²⁰¹ Pra, ujana është ajo e cila edhe u jep jetë edhe u merr, me ujin e saj sjell edhe të mirën edhe të ligën. Në ujërat e liqenit, që mbushej prej dy lumenjve që rridhnin prej andej kufirit, aty bashkohet rrjedha e të dy Drinave, që vijnë nga Kosova e Maqedonia, autori e gjen frymëzimin për të na dhënë romane shumë të bukura, pavarësisht që “Njeriu që kujdesej për varrin e vet” dhe “Përroi i Andrrës”, të cilët kanë një bukuri të frikshme; i pari për shkak të ëndrrave kobndjellëse që sjell, ndërsa i dyti për shkak të frikës së vdekjes.

Përfundim

Bukuria e veprave të Petrit Palushit del nga rikrijimi artistik i atij realiteti të trishtë të kohës së komunizmit në romanet e tij. Pra, veprat e tij, po të parafrazojmë kryeveprën e Bodlerit, njëherësh veprën prijatare të poezisë moderne evropiane, janë lule të së keqes, krijime që dalin nga rikrijimi i realitetit të egër komunist, i cili kishte burgosur qenien shqiptare në krejt hapësirën e Shqipërisë.

Në krijimtarinë e tij, përveç lëvizjes në realitet të personazheve, merr krahë fuqishëm fantazia. Sipas tij “Letërsia e ka pjesë të vetes abstraksionin, por një abstraksion me një lëndë të kultivuar jete. Me një fjalë, është një lëndë jetësore, është një ngacmim nga ku lind metafora, sepse ajo kurrsesi s’mund të lindë në një truall të zbrazët” (*Gazeta “Lajm”, Prishtinë/ 21 qershor 2008*).

Palushi, i lindur në një mjedis ku realiteti bëhet një me botën e legjendave, duke shfrytëzuar këtë botë, krijon një prozë moderne.

Proza e Palushit është në vazhden e prozës bashkëkohore shqipe, romanet e tij lexohen me një frymë; Petrit Palushin e mban arti i tij, jo patericat e kritikës klanore, ideologjike, partiake apo të klaneve kulturore që janë krijuar në bazë interesin e ngushtë.

Përdor një leksik jashtëzakonisht të pasur, fjalë të cilat ekzistojnë në trevën kuksiane, prej të cilit vend narratori i rrëfen pothuajse të gjitha ngjarjet e romaneve të tij, dhe që na i na sjell begatshëm në romanet e tij, për të cilën, Vath Koreshi vërente në parathënien e romanit “Përroi i Andrrës” se Palushi krijon “një gjuhë nga më të përpunuarat, nga më të bukurat dhe nga më pasurat me fjalë e me shprehje frazeologjike të përdorura në veprat tona”.

Si përfundim, tashmë shkrimtari Petrit Palushi ka krijuar stilin e tij, i cili nuk ka shok në prozën shqipe, ka një stil të vetin “duke mos u rrekur t’i shkojë pas fill e për pe një shkrimtari të madh”,²⁰² ashtu siç i ka edhe lexuesit e tij, të cilët veprat e tij i lexojnë me endje, në kohën kur letërsia ka gjithnjë e më pak lexues.

²⁰¹ Petrit Palushi, Përroi i Andrrës, f. 30.

⁷ Luan Canaj, Një univers në një rrokje, f. 100.

E FOLMJA MALËSORE NË MAL TË ZI NËN DRITËN E SHQYRTIMEVE SOCIOLINGUISTIKE

Mr. Marjan Lulgjuraj

E folmja e Malësisë së Madhe dallohet nga të folmet e tjera të gegërishtes veriperëndimore, jo vetëm në një sasi të madhe dukurish, por edhe në tiparet më të qenësishme që merren si bazë e dallimit të grupit veriperëndimor nga grupet e tjera.

Karakteristikë e të folurit të shqiptarëve të Malësisë është përdorimi i togjeve zanore: *uo*, *ua* dhe *û* (nasale) në vend të përemrit *unë* dhe vetës së tretë të prezentit të foljes ndihmëse. Togjet konsonantike; *nd*, *nb*, *ng* etj. përdoren fare pak, por ka raste të tilla. Të folmet malësore të shqiptarëve në Mal të Zi paraqesin unitet të plotë me të folmet e tjera të Malësisë së Madhe edhe me ruajtjen e togjeve zanore *uo* dhe *ua*. Siç dihet, ruajtja e këtyre togjeve u jep vend të veçantë këtyre të folmeve në kuadrin e të folmeve të gegërishtes veriperëndimore, sepse *uo*, *ua* përbëjnë një dukuri ruajtëse me vlerë, që dëshmon një gjendje uniteti të kahershëm të mbarë gjuhës sonë, siç na tregojnë edhe krahasimet me fazat më të moçme të dokumentuara në shkrimet e Buzukut e të autorëve të tjerë të vjetër". Gjithashtu edhe në ndryshimet morfologjike, edhe pse të vogla, janë mjaft karakteristike.

Fonetika

Theksi dhe zanoret

Në fjalët e gurrës së vendit nuk ka shumë lëvizje theksi. Mund të shënohen një sasi e kufizuar fjalësh si *ái*, *níer*, *véri* në të cilat theksi është zhvendosur nga rrokja e fundit (khs. *ái*, *njerí*, *verí*) në të parafundit. Këto fjalë siç do të themi edhe në paragrafin përkatës, në pasojë të zhvendosjes së theksit kanë kaluar nga mënyra e shquarësisë me mbaresën –u: *njeriu*, *veriu*, në atë me mbaresën –i: *nier-i*, *ver-i*, në këtë të folme e kemi gjetur gjithnjë vetëm me këtë trajtë: *po fry véri, â kë dit'* me *véri*. Nën ndikimin e gjuhës letrare në brezin e ri kemi dëgjuar edhe *veríu*, *njeríu*. Disa emra vetjakë si: *Márash*, *Mírash*, *Prêtash* zakonisht dalin me theksin në rrokjen e parafundit. Tek këta emra, theksi nuk lëviz as kur marrin mbaresën - i: *Márashi*, *Mírashi*, *Prêtashi*.

Disa fjalë oksitone me origjinë nga gjuha turke, në këtë të folme, ashtu si në të folmet e tjera veriore, i janë nënshtruar një procesi të fortë asimilues, frut i të cilit nuk kanë qenë vetëm lëvizja e theksit nga rrokja e fundit në të parafundit që duket në trajtën e rasës emërore të njëjësit të pashquar në disa emra si: *híle*, *hále*, *pixhére*, *tenéqe*, *çéhre*, etj.

Në gojën e brezit të vjetër kemi dëgjuar me theks në rrokjen e parafundit edhe *Itále* nga *Italí*.

“Përsa i përket shpjegimit të gjatësisë ose të zgjatimit të një zanoreje të theksuar të një zanoreje të theksuar, dijetarë të ndryshëm janë shprehur me mënyra të ndryshme; pjesërisht e kanë shpjeguar me vendin që ka ajo përbrenda fjalës, pjesërisht (edhe numrin) e konsonanteve që ndjekin, që vijnë pas, e pjesërisht me zhdukjen e ë-së së pathekse fundore, zhdukje që sjell një zgjatim kompensator. Pa mohuar ekzistencën e gjatësive natyrale e pozicionale edhe në gjuhën shqipe, edhe pa mohuar vlerën e shpjegimeve më sipër, duhet bërë vërejtja që këto shpjegime rrokin më fort fazat e reja të zhvillimit të gjuhës dhe që përveç kësaj nuk i dalin zot kompleksit të problemit. Për të arritur këtë do shikuar ky problem në rrjedhën historike të dukurive, vihet re se përbrenda pozicioneve të barabarta ka kuantitete të ndryshme, opozicione fonematike, me një anë rrokje të shkurtëra m’anë tjetër të gjata edhe kur janë të pathekse.”²⁰³

Një varg zanoresh të gjata paraqiten si kontraksione dy a më shumë zanoresh të ndodhura në pranëvënje si p.sh.: me : marr < me e marr, me:pre < me e pre, mç: mir < ma e mirë, mç : madhe < ma e madhe, djali : math < djali i madh.

Në fjalët që mbyllen me bashkëtingëllore prapa të cilave nuk ka pasur të shumtën e herës ka zanore të shkurtëra: brīsk, bishtūk, çarāp, çardāk, dāsh, shkōp, aj rrīn, aj pīn, aj shkōn.

Zanoret e mesme sipas vëzhgimeve tona, përftohën herë nga shkurtimi i të gjatave herë nga zgjatimi i të shkurtërave që ngjet gjatë fleksionit. Kështu për shembull të gjatat si: zā:, pē:, tok: etj. në trajtën e shquar, pasi marrin mbaresën e shquarësisë kthehen në të mesme: zāni, pēni, toka etj. Nga ana tjetër të shkurtërat në emra si: bishtūk, çarāp, dāsh etj. kur këta shquhen dalin të mesme: bishtuku, çarapi, dashi.

Së mbrami duhet përmendur e që është me shumë interes të shënojmë se në gjatësinë e zanoreve, krahas arsyeve historike dhe pozicionale që u rrekëm t’i sqaronim më sipër, një ndikim të rëndësishëm ka patur dhe ka theksi sintagmatik. Kështu p.sh. ne kemi vëzhguar se një shumicë emrash vetjakë të gjinisë femërore, po edhe ndonjë i gjinisë mashkullore, kur janë vetëm domethënë, papatronimet përkatëse, shqiptohen gjithnjë me zanore të gjatë: Dīl, Hān, Tōm, Dōd, Kōl, Lūc, Nīk, Nōk etj. Mirëpo kur këta emra janë të shoqëruar me patronimet përkatëse, theksi sintagmatik nuk bie më mbi emrat po mbi patronimet e tyre, kështu që ata shqiptohen më me nxitim sesa kur janë vetëm. Për pasojë edhe zanorja nga e gjatë kalon në të shkurtër: Dīl Gjokja, Hān Mirashja, Tōm Gjoni, Dēd Vata, Kōl Gjetja, Nōk Gjeloši, Lūc Marku etj.

Bashkëtingëlloret

Bashkëtingëlloret e kësaj të folme në trevën e Malësisë për nga artikulimi neve na duket se nuk shmangen nga mënyra e zakonshme e artikulimit të mbarë shqipes. Bashkëtingëlloret h ruhët mirë në çdo pozicion që të jetë; në fillim të fjalës: ha, heret, hjek, hīrr, hāna, hāgēr, në mes të fjalës duke qenë edhe midis zanoresh: bâhet, hahet, rruhem, pshehem, krahi etj. në fund të fjalës: shoh, sheh, njeh, me u grah etj. Nuk ndihet h në fjalët i let < i lehtë, lecoj (lecoj punë) < lehtësoj, i zet < i nxehtë, nim < ndihmë, nimoj < ndihmoj.

Pra, I letë si era (I lehtë si era);

Ia lecova punën (Ia lehtësova punën)

I zet si prushi (I nxehtë si prushi)

²⁰³ E.Çabej-“Mbi disa rregulla të fonetikës historike të shqipes” SF. 2, 1970, f.76.

Nima e Zotit (Ndihma e Zotit)

Të nimoj unë ty (Të ndihmoj unë ty)

Tingulli nj, të shumtën e herës, në këtë të folme, na del se ka evoluar në j si në fund të fjalës: zoj, ftoj, shkoj, maroj. Kemi trajtaj ku nj jep j si për shembull: jesajt, jâshtu, jeto, kurrjâ, jâj etj.

Shkurtimisht ishin këto disa nga veçoritë fonetike duke lënë shteg për një trajtim në ndonjë studim më të gjërë.

Morfologjia

Trajtat morfologjike të folmes së Malësisë, ashtu siç u pa për anën fonetike, ka ruajtur në vijat themelore, po ato karakteristika që ka edhe Malësia andej kufirit apo Malësia në territorin e Shqipërisë.

Emri

Trajta. Ata emra që në trajtën e pashquar mbarojnë me ua ose uo në të shquarën ruajnë formën e vjetër me bashkëtingëlloren e temës n: prrua-prroni, ftua-ftoni, thua-thoni. Emrat që në të pashquarën mbarojnë më: -uor, -uoll, -yer, -yell, në trajtën e shquar marrin mbaresën i dhe ruajnë zanoren e temës të pazbërthyer: shuoll-sholli, mzuor-mzori, fyell-felli, gjypnyer-gjypneri etj.

Emrat që mbarojnë me zanore hundore, në të shquarën marrin mbaresën -i dhe ruajnë bashkëtingëlloren e temës n: mllâ-mllani, hû-huni, pê-peni, mullî-mullini etj.

Gjinia. Emrat e gjinisë asnjane në këtë të folme përgjithësisht janë rralluar. Pothuajse të gjithë emrat e sendeve që kanë qenë asnjane, s'janë më të tillë, po kanë marrë ose trajtën e mashkullorëve si: mish-i, drith-i, miell-i, djath-i, vaj-i, ose trajtën e femërorëve: brum-a, dyll-a, mjalt-a, dhjam-a. Mirëpo është me interes të thuhet se këta emra nuk janë shkëputur krejtësisht me gjininë asnjane.

Lakimi. Lakimi i emrave nuk paraqitet shumë i dallueshëm nga ai i mbarë gjuhës, prandaj ne do të përshkruajmë vetëm ato trajta që kanë interes dialektor.

Trajtat e rasës kallëzore njëjës të emrave të gjinisë mashkullore formohen nga trajtat e emërores së shquar + mbaresën n. Kështu kemi: kronin, prronin, ftonin, shollin, mzorin, fellin, hûnin, pragun, krahin etj. Bëjnë përjashtim emrat që në të pashquarën mbarojnë me zanore gojore të theksuar: kâ,vllâ, shkjà. Këta emra, në rasën emërore të trajtës së shquar kanë trajtat me nyjën u: kau, vllau, shkjàu.

Përemrat

Për vetën I njëjës, trajta më e zakonshme është û. Në rasat dhanore e kallëzore përemri û del me trajtën mua, si trajtë e plotë, kur është si trajtë e shkurtër: m'thirri edhe mua; pse s'ëm prite, s'ëm kapi plumi.

Në rasën rrjedhore ka trajtën mejet, buz mejet, afer mejet, teshu per mejet, pije i got prej mejet etj.

Veta e dytë njëjës, në rasën emërore ka trajtën ti. Në dhanore e kallëzore ka trajtën tÿ (si trajtë të plotë) dhe t si trajtë të shkurtër: po vi me tÿ, tÿ t'lutme po z'deshte. Në rrjedhore ka trajtën tejet: buz tejet, larg tejet, pas tejet etj.

Veta e parë shumës në rasën emërore është na: po vim edhe na; na nuk nigueme; në dhanore e kallëzore ka trajtën ne: me zanore shumë të gjatë: hajde me ne:, mos shko pa ne:, etj. Trajta e shkurtër është na: ne: na that me shkua, atyne jo; duen me na nimua; etj. Në rasën rrjedhore ka trajtën nesh: a kje kush prej nesh aty, pse s'kje dhe ja prej nesh me ta etj.

Veta e dytë shumë në emërore ka trajtën ju: po ju çka doni? As na as ju. Në rasat dhanore e kallëzore ka trajtën jū: po rri me ju:, po flas me ju:, po punoj per ju. Siç vihet re edhe nga shenja grafike e gjatësisë, dallimi i trajtës së rasës emërore nga ajo e dhanores e kallëzores bëhet pikërisht me ndyshimin e gjatësisë së zanores, në emërore u është e shkurtër, ndërsa në dhanore e kallëzore ajo është e gjatë.

Përemrat dëftorë janë po ata që dalin në të folmet e tjera e në mbarë gjuhën: ky, kjo, kta, kto, at, aj, ajo, ata, ato, por prej tyre janë formuar edhe disa përemra të tjerë me anë të prapashtesimit si: jeky, jekjo, jāj, jājō.

Përemrat që përmendem përdoren edhe në shumë: jekta,jekto, jata,jato.

Jekta njerëz po kërkohë diçka.

Jekto vajza janë shumë të bukura.

Jata jatje nalt nuk po i njo.

Jato po i sho mirë.

Përemrat e pakufishëm

Si përemër i pakufishëm,në këtë të folme,përdoret edhe pyetësi kush. Gjatë lakimit si i pakufishëm, kush, në rasën gjinore e dhanore del me trajtën kuj,po në kallëzore ka trajtën kân: a pe kân,a gjiete (gjete) kân, mos po tije kân se po vjen. Me sa duket kâ te kallëzorja e kush si pyetës është rrjedhojë e rënjes së n në trajtën kân.

Folja

Mënyra dëftore e foljeve veprorë tërheq vëmendjen e dialektologut me këto trajta themelore e që në të folmen e Malësisë jetojnë ende: në kohën e tashme,foljet e zgjedhimit të parë, klasën e parë, në vetën e parë të numrit njëjës marrin mbare të cilin –i: çili, hapi, nisi, xbathi, korri, kapi, qiepi (qepi), përplasi etj.

Në vetën II dhe III njëjës këto folje nuk kanë mbare të (ti,ai): hap, nis, xbath, korr, kap, përplas etj.

Foljet e zgjedhimit III,me përjashtim të bāj, kjaj, në vetën II e III njëjës të së tashmes dalin me mbare të (unë) luej (ti) lua (ai) lua; (unë) ruej (ti) rua (ai) rua; (unë) lyej (ti) lye (ai) lye, etj.

Foljet bāj, kjaj në vetën II, III njëjës dalin me mbare të –n: (unë) bāj, (ti) ban, (ai) ban; (unë) kjaj, (ti) kjan, (ai) kjan. Në shumë të gjitha këto folje marrin mbare të: - (j) m, -ni, -(j), n; (na).

Pjesorja

Në këtë të folme pjesorja del përgjithësisht pa mbare. Foljet e zgjedhimit të tretë dalin me togznor ose me zanore: shkua, punua, thye, frÿ, la etj. foljet e të tri zgjedhimeve të tjera dalin me bashkëtingëllore: kap, çil, viel, marr, qit, rrit, prit, shetit, etj.

Leksiku

Edhe pas zbritjes në fushë, malësorët, si ata që vinin nga Hoti, Gruda,Trieshi apo Koja vazhduan të mbanin tufa të mëdha dhensh, si dhe lopë, që etj. Në këtë mënyrë deri në ditët tona, kanë ruajtur një sasi të madhe emra kafshësh. Një pjesë e madhe e tyre paraqiten si emërtime të vëna mbi bazën e ngjyrës,të shenjave me ngjyrë ose të shenjave të tjera që kanë ato në trup. Kështu ne kemi mbledhur këta emra si: Bardhukë (=lopë me ngjyrë të bardhë), Kuqeshë (=lopë me ngjyrë të kuqe), Balishja (=dele me nje shenjë të bardhë në ballë), Larukë (=lopë me të paktën dy ngjyra), Bishtuka (=lopë e zezë ose e kuqe me bisht të bardhë), Galan (= dash apo qengj krejt i zi), Shyta (=dhia pa brirë) etj.

Me interes dialektor janë edhe fjalët që emërtojnë pjesët e trupit të njeriut ose të kafshëve: rrashta (= kafka e kokës së një kafshe pasi i është hequr mishi, trutë etj.) në mënyrë figurative rrasht-a ndonjëherë përdoret edhe për njerëz; psh. i ka plas rrashta e kresë (= rrashta e kokës).

Muajt janar dhe shkurt në këtë të folme thuhet: kallnuer-Kallnori, fruor-frori, n'nate-ja (=mëngjezi), prejrate-ja (= mbas-dreke), mjesdi (=mesditë), n'tëjmit t'diellit (=në perëndim të diellit), n't'nisun t'drits (=në të gdhirë), priher me drit shumë heret, duke zbardhur), n'pik t'mesdits, n'pik t'dits, n'pik t'mjesnats, n'pik t'nats etj.

Përfundim

Nga vëzhgimi dhe përshkrimi i veçorive të kësaj të folme del se malësorët e vendosur në zonat fushore të Malësisë kanë ruajtur shumë mirë të folmen.

Siç mund të vërehet Malësia është e mbushur përplotë me fenomene gjuhësore të cilat vërtetë i vlejné dialektologjisë shqiptare dhe fondit leksikor të shqipes, prandaj në një studim tjetër do të trajtohen edhe më gjerësisht.

Bibliografi

Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatikë e gjuhës shqipe*, I Tiranë 2002.

Dialektologjia e gjuhës shqipe, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, Tiranë, 1971-2005.

Recensentët e punimit
Prof. dr. Gjovalin Shkurtaç
Prof. dr. Palokë Berisha

VEPRIMTARIA E POETËVE TË SOTËM ARBËRESHË NË KUSHTET E DYKULTURËSISË DHE DYGJUHËSISË

Msc. Kristo Kolçi, Msc. Denis Himçi, Dr. Meli Shopi
Universiteti "A.Xhuvani", Elbasan

"Të rralla janë në botë diasporat që, për shumë shekuj, edhe pas shpërnguljes në dhé të huaj ruajnë me ngulm gjuhën, kulturën, traditat dhe dashurinë për mëmëdheun e tyre të lashtë, siç janë ngulimet arbëreshe të Italisë. Dhe jo vetëm i ruajnë, por edhe i punojnë pa pushim për t'i shtuar, duke nxjerrë breza të tërë veprimtarësh, që janë shquar për lëvrimin gjuhës së vet amtare dhe i kanë dhënë letërsisë, kulturës e shkencës shqiptare një numër të mirë veprash me merita të shënuara" – thekson akademiku Gj. Shkurtaç në studimin e tij.

Poezia e sotme arbëreshe

Vështirë të gesh sot ndonjë ngulim arbëresh ku nuk vepron ndonjë poet a shkrimtar, ku të mos ketë, në mos tjetër, një vjershëtar a këngëtar popullor. Natyrisht, ka prej tyre që janë pak të njohur, qoftë për shkak të modestisë që i karakterizon, qoftë edhe për mjetet e pakta e të pamjaftueshme që kanë në dorë për botim e përhapje të krijimtarisë së tyre. Shumëçka mbetet brenda rrezes së disa prej organeve të shtypit arbëresh, sidomos të revistave "Zëri i arbëreshëve", (Ejaninë), "Zjarri (Shën – Mitër, Korone)", "Katundi ynë", (Çivita), "Mondo Albanese", (Piana degli Albanesi – Palermo), etj, por ka edhe poetë që prej kohësh i kanë kapërcyer kufijtë e revistave e botimeve të ciklo – stiluara të katundeve, duke botuar vëllime poetike me interes dhe me një njohje relativisht të mirë me bashkësinë arbëreshe të Italisë dhe ndër ne. Të tillë janë: Dushko Vetmo (pseudonimi i Francesco Solano) nga Fransita, Lluka Perrone, Vorea Ujko etj, të cilët do t'i citojmë e do t'i pasqyrojmë më poshtë. Krijimet e tyre, në përgjithësi, karakterizohen nga fryma e gjallë patriotike, nga shqetësimi për fatet e gjakut arbëresh, nga dëshira që poezia të shërbejë si mjet i vetëruajtjes dhe i pohimit të mëtejshëm se "shpirti i arbitron", edhe pse kanë kaluar kaq shumë shekuj. Kjo tregon se letërsia e sotme arbëreshe jo vetëm nuk ka shtuar, por vazhdon denjësisht traditën e saj, por tashmë në kushte të reja, me problemet dhe shqetësimet e kohës së sotme. Natyrisht, ajo nuk është në ato përmasa as në atë lartësi që qe dikur letërsia e Rilindjes Arbëreshe, zemra e së cilës qe Lëvizja Kombëtare Shqiptare e Rilindjes. Ndihtesat qenë shumë të vyera e të çmuara, por duke u mbyllur ajo epokë, u mbyll edhe periudha më e ndritur e letërsisë arbëreshe. Por, fatmirësisht, letërsia arbëreshe nuk u shua. Në kushte tepër të vështira që erdhën

më vonë, duke luftuar kundër diskriminimit e pengesave të ndryshme, në ngulimet arbëreshe u ruajt gjuha shqipe, u mbrojtën kultura dhe traditat e bukura arbërore dhe mbi atë shtrat, në këto njëzet – tridhjetë vjetët e fundit, si bari nën gurë, mbiu sërishmi edhe poezia arbëreshe e përpunuar, lulëzoi diçka në prozën e shkurtër dhe si për mrekulli, nuk mungojnë jo vetëm dramet e shkruara po edhe po mëkëmbet një Teatër Popullor arbëresh me qendër në Piana degli Albanesi të Siçilisë. Të gëzon shumë fakti i shtimit të numrit të poetëve dhe shkrimtarëve arbëreshë ku të tërheq edhe tematika e vjershërisë apo e krijimtarisë së tyre. Talentet më të mira të kësaj lëtërsie së sotme arbëreshe shkruajnë në gjuhën shqipe apo siç quhet në sociolinguistikën e sotme: në *shqipen standarde*; ka edhe asish që përpiqen ta zbatojnë, por nuk mund të mos e përziejnë ndopak me dialektin e vet arbëresh që edhe u jep një endje të posaçme, siç ka edhe asish që nuk e njohin gjuhën letrare shqipe dhe shkruajnë kryesisht në dialektin e katundit të tyre.

Dushko Vetmo, emri i vërtetë i të cilit është Francesco Solano, ka lindur më 1914 në Fransitë. Njeri me formim të gjerë dhe dije të shumta, njohës i shumë gjuhëve të huaja moderne dhe ekzotike, deri edhe i kinezishtes, personalitet me ndihmesa në fusha të shumta: poet, prozator, dramaturg, përkthyes, si edhe gjuhëtar e filolog i klasit të parë, pedagog i gjuhës shqipe e profesor titullar i dy katedrave: të gjuhës e të letërsisë shqipe dhe të dialekteve arbëreshe pranë Universitetit të Kalabrisë. Tashti është në pension dhe famulltar në katundin e tij, në Fransitë. Të gjithë e duan dhe e nderojnë jo thjesht si prift, por si njeri të ditur e bir të nderuar të katundit, sepse prapa asaj modestie të skajshme e atij qëndrimi aq të përvuajtur prej njeriu të fesë, qëndron studiuesi i gjuhës dhe i letërsisë arbëreshe, një nga burrat më të shquar që ka nxjerrë ai vis, poet dhe veprimtar i njohur në Itali e më gjerë. Ka shkruar në tri gjini letrare: në poezi “Burbuqe të egra” 1946, që mbahet si përruuese e letërsisë së sotme arbëreshe, “*Te praku*” 1977. Në prozë janë të njohura “*Lalë Ndreu nuk thotë përralla*” 1975: novelat “Bijtë e Dodonës” e “Dhaskal Mitri”, romani “Akullnajat”, përmbledhjet më tregime “*Vjeshtë e thatë*”, “*Tregimet e lërimit*”, 1975; dramet: “*Epo hëna*” dhe “*Shkretëtira prej guri*”. Në moshë të re ai pati shkruar me pseudonimin *Paolo Illyrico*, pastaj që nga 1946 e këtej me pseudonimin Dushko Vetmo. Tipar i gjithë vjershërisë, mbase edhe i shkrimtarisë, së Dushko Vetmos është përkotësia dhe shjellimet pa bujë, pa poza e tëhollime të tepërta. Ai ishte edhe në krijimtari ashtu si në jetë: një njeri i ZOTIT, famulltar i urtë dhe njeri zemërgjerë, i kudogjendur në veprimtaritë për të mirën e letërsisë dhe të kulturës arbëreshe, po edhe i lidhur fort me studion e librat e tij aq të shumta.

Derisa shkoi rreth të 85 vjetëve, Dushko Vetmo nuk i pakësoi as hulumtimet e studimet rreth dialekteve arbëreshe e gjuhës shqipe, as perkthimet nga gjuhët e huaja, me të cilat, siç thoshte ai me shaka. “bierr

motin”.¹²Përmendim ndihmesat e tij kushtuar dorëshkrimeve të de Radës, Santorit, Dorsës etj. Me interes të veçantë janë shqyrtimet filologjike rreth librit të F.A.Santorit “*Këngëtorja arbëreshe*”, botuar si fashikull më vete në “*Rradhontë e Zjarrit*”, 1974, ribotimi dhe pajisja me shënime e analiza filologjike e dramave “*Emira*” dhe “*Alesia Dukagjini*” të F.A. Santorit, analizë filologjike dhe krahasime me të folmen e sotme të Fransitës e “*Vangjelit*”, të përkthyer nga V. Dorsa etj.

Vorea Ujko, emri i të cilit ishte Domenico Belici (1914-1989), meshtar dhe veprimtar i dalluar i letërsisë dhe i kulturës arbëreshe, ndoshta, më i madhi lirik arbëresh i kohëve të reja. Ai qe, gjithashtu, nga rrëzët e Pulinit, nga Frasnita, ngulimi që, ndonëse me përmasa modeste në banorë e në shtrirje. në rrjedhë të shekujve ka dhënë aq shumë njerëz të penës, gati të gjithë të shquar e të përmasave më se vetëm arbëreshe. Vorea Ujko punoi si famulltar në Fermë (it. Firmo), jo larg vendlindjes së tij dhe qe kryesisht poet. Ai jo vetëm shkruante poezi dhe pati edhe një prodhimtari të bollshme, por edhe rronte për poezinë, bënte çmos që poezia arbëreshe të hynte në vallen e bukur të vjershërisë shqiptare. Ai qe, ndoshta, poeti më “bredharak” i diasporës arbëreshe të Italisë. Ai gjendej, papritur, herë në Kosovë ku piqej me miqtë e tij të shumtë, herë në Ulqin e, ndonëse pa vizë, ia behnte edhe te Hani i Hotit, prej nga telefononte në Lidhje të Shkrimtarëve. Ishin vite që, as zogjtë e malit nuk mund të kalonin kufirin shqiptar pa vizë hyrjeje, personalitetet e të cilëve iu drejtohej ai nuk mund të mos e bënë një përjashtim për poetin që vinte e shkonte ashtu siç kishte emrin: si vorea. Fjala vorea në të folmen arbëreshe do të thotë era. Me këtë fjalë, duke e bashkuar me ujk ai krijoi emrin e penës apo pseudonimin e tij: Vorea Ujko, ashtu si jo pak nga poetët frasniorë bashkëkohës të tij.¹³ Vorea Ujko është nga poetët arbëreshë që ka botuar më shumë vëllime poetike në Kalabri dhe ndër ne. Përmendim: “Zgjimët e gjakut” (1971), “Kosovë” (1973), “Mote moderne” (1976), “Ankth” 1978, “Stinët e mia” 1980. Më 1982 qe botuar në Tiranë nga Shtëpia Botuese “N. Frashëri” vëllimi “Këngë arbëreshe”, zgjedhur e përgatitur nga poetët Dritëro Agolli e Vehbi Bala pastaj më 1985 “Burimri” i përgatitur nga Fatmir Gjata e Xhevahir Spahiu. Më 1990, po ata përgatitën një përmbledhje më të gjerë me vjersha të zgjedhura të Vorea Ujkos me titull “Hapma derën zonja mëmë”, prirë nga një parathënie e Nasho Jorgaqit. Kohët e fundit është botuar në Itali një antologji e poezisë së Vorea Ujkos “Gërmime në dhimbje”, zgjedhur nga Anton Nikë Berisha. Vjersha të tij janë botuar, gjithashtu, në të përkohshmet letrare “Shejzat” “Zgjimi”, “Zëri i Arbëreshëve”, “Drita”, “Nëntori” “Jeta e re”.

Vorea Ujko bën pjesë në brezin e parë të poetëve arbëreshë, që bashkë me Dushko Vetmon, Karmell Kandrevën e Lluka Perronen e ringjallën poezinë e De Radës e të Serembes në gjysmën e dytë të shekullit tonë. “Ai ishte dhe mbeti figura qëndrore e poezisë së sotme arbëreshe. Me veprat e tij të fuqishme ai dha një ndihmesë të veçantë për ta ngritur letërsinë arbëreshe në një realitet letrar të nivelit bashkëkohor”¹⁴

Karmell Kandreva (1931-1982), një nga poetët dhe veprimtarët arbëreshë më të dalluar, qoftë për freskinë e frymëzimit, qoftë për motivet e poezisë së tij. Autori i tri përmbledhjeve poetike me të njëjtin titull “Shpirti i arbërit rron” 1976, “Shpirti i arbërit rron, arbëreshi tregon” II , 1977 dhe “Shpirti i arbërit rron, vuan dega e hershme” III, 1979. Më 1981 Shtëpia Botuese “N. Frashëri” ka botuar një përmbledhje me vjersha të zgjedhura të Kandrevës.¹⁵ Poezia e Kandrevës, ashtu si përgjithësisht letërsia e sotme arbëreshe synon të tregojë se ngulimet e kësaj diaspore janë ende qendra të gjalla, janë vise ku arbëreshët jo vetëm rrojnë e punojnë, po edhe këndojnë e krijojnë. Kjo kulturë e gjallë me gjuhën, këngët, zakonet dhe traditat e veta, sipas Kandrevës është ende e zonja të dëshmojë botërisht se edhe pas kaq shekujsh “shpirti i arbërit rron”. Kandreva qe, gjithashtu, një nga veprimtarët më të dalluar të lëvizjes mendore e kulturore arbëreshe, mësues dhe pedagog me ndihmesa të mira në lëmin e mësimin të shqipes në katundet artëreshe, pjesëmarrës dhe mbështetës i zjarrit në të gjitha nismat e grupeve apo

shoqatave kulturore arbëreshe për vlerësimin, mbrojtjen e gjuhës shqipe e të trashëgimisë letrare e kulturore arbëreshe dhe për pohimin e asaj diaspore si një pakicë e njohur etnolinguistike. Kandreva ishte poet i krenarisë etnike, por edhe i angazhimit social, që ngriti zërin për të luftuar për të drejtat e pakicave e për drejtësi shoqërore. Por në malet e Kalabrisë fitoi diçka, fitoi lidhjen e ngushtë me tokën dhe me traditat e popullit të tij tmerrësisht të varfër e analfabet në fshatrat e thella. Njëkohësisht, dhe kjo është kryesorja, fitoi edhe vetëdijen se nuk mjaftonte lidhja me tokën. Personazhi idilik i vendlindjes ishte për të edhe vend i mjerimit dhe i mundimeve. Së bashku me Karmine Stamilen ai ndërmori edhe sprovën e kërkimeve fort interesante për dygjuhësinë dhe mësimin e shqipes në mjediset arbëreshe, parashtruar gjerë e me argumentime serioze në vëllimin “Sprovë didaktike në një mjedis dygjuhësh arbëresh”, botuar në Kozencë më 1979. Vdekja e parakohshme e preu në mes punën e tij plot merita dhe krijimtarinë poetike gjithashtu të ndërjetë të tij. Lluca Perrone (1920-1984), poet dhe studiues i folklorit nga Ejanina (Kalabri), një ngulim i vogël arbëresh rrëzë maleve të Pulinit, rreth 65 km larg Kozencës. Që në moshë të re u mor me zell e dashuri të spikatur me kërkime gjuhësore e folklorike

në Ejaninën e tij, si dhe në Frasnitë e gjetkë nëpër ngulimet arbëreshe të krahinës së Kozencës. Më 1967 ai botoi përmbledhjen “*Novelistica italo-albanese*” një pasuri e paçmueshme e prozës popullore arbëreshe, si dhe një studim me titull “*Luka Miranda poet arbëresh*”, ku ai përmend vlerat e njërit nga pararendësit e poezisë së sotme arbëreshe, prej të cilit Perrone kishte mesuar të parat modele të vjershërimit në shqip. Perrone u shqua qysh në rini edhe si njëri nga poetët më të dalluar të qendrave rrëzë Pulinit, duke bashkëzuanuar hijshëm me “korin” poetik të përbërë nga Dushko Vetmo, Vorea Ujko, Leshkuqi, Buzëdhelprri, që të gjithë nga Frasnita e Ejanina, që ndodhen fare pranë, jo më larg se një km nga njëra-tjetra. Përveç vjershave e cikleve të botuara nëpër të përkohshmet arbëreshe, Lluca Perrone ka botuar në Itali vëllimet poetike “*Lule shkëmbi*” (1968). “*Hieja e Ariut*” (1969), “*Vjersha lirie*” (1971) dhe “*Dërrrudhëz*” (1977). Vjersha të tij janë botuar edhe tek ne në antologjinë “*Degë e blertë*” (Tiranë, 1980) dhe në gazetën “*Drita*” etj., si dhe një përmbledhje me vjersha të zgjedhura me titull “*Lule shkëmbi*”¹⁶, (Tiranë, 1985). Perrone është kryesisht poet lirik, i dhënë pas bukurisë së natyrës, pas jetës së njerëzve të thjeshtë të vendlindjes dhe historisë e kujtimit të paharruar të mëmëdheut të parë të arbëreshëve, Shqipërisë. Vjershat më të mira të tij ndjekin traditën e Serembes. Aty shprehet dhimbja për ata që vuajnë, shqetësimi për gjendjen e rëndë të arbëreshëve që e ndiejnë veten përjetësisht të huaj e larg atdheut, por edhe krenarë për origjinën e tyre arbërore. Në vjershat e Perrones gëlojnë edhe ndjenjat e shpresa për një të ardhme më të mirë për njerëzimin, pa tirani e shtypje. Shtysë e frymëzimit të tij janë ngjarje e pësime të ndryshme në mjedisin ku ai rron, të cilat poeti i përjeton duke mbajtur edhe qëndrimin e vet prej veprimtari e qytetari të gjallë. Poetin e prekin shumë skamja dhe jeta e vështirë e bujkut dhe e punëtorit, pësimet dhe hidhërimet e tyre dhe qëndron përherë në krah të tyre, sepse edhe vetë ai ishte bir i një minatori të varfër, që la eshtrat në moshë të re, diku në minierat e Amerikës, ku e kishte shpënë nevoja për bukën e gojës. Mbi çdo gjë Perrone adhuron lirinë, së cilës i këndon në shumë nga vjershat e tij, duke mos i kursyer fjalët dhe figurat e bukura.

“Liri vojnë argjendi/Liri qiell i kthjellët,/Liri lule e erësuar,/Liri burim i kulluar,/Liri yll i udhës sime”,

("Vjersha lirije")

Në vjershat e Perrones lirisë i këndohet me shpresë e me besim, me bindjen se ajo është e çmuar dhe e domosdoshme për çdo njeri, për çdo vend, për mbarë rruzullin që vuan e psherëtin për çlirim. Ai dënon ata që shkelin lirinë dhe mbajtur nën thundër popujt kudo që të jenë:

"Ligjën shkelin pa turpëri, Sa të shtrembëra n'emrin tënd, o liri!"

Vjershëria e Perrones e tërheq lexuesin me fjalën dhe vargun, me figurat dhe ritmin me ëmbëlsinë dhe melodinë e saj. Kjo i jep këtij poeti një fytyrëzim të pasur, të pastër dhe njerëzor e ku zotërojnë tonet e gëzueshme. Ashtu si pjesa dërrmuese e poetëve të sotëm arbëreshë Perrone shkruan në një gjuhë të pastër, të pasur dhe mjaft afër gjuhës së sotme letrare shqipe.

Pietro Napolitano (1931) nga katundi arbëresh Fermë (it. Firmo). Mësues dhe veprimtar i njohur, shkruan shqip dhe italisht. Në gjuhën shqipe ka botuar vëllimet "Nderim fermës" 1976 dhe "Një botë që birret". Në italisht ka botuar vëllimet "Sussuri" (Fëshfërima) 1960, "All'ombra dei miracoli" (Nën hijen e mrekullive) 1963, "Qualcosa si e' fermato" (Diçka ndaloj) 1970. Boton shpesh vjersha edhe në periodikun arbëresh. Pietro Napolitano rreh po atë udhë të vjershërisë së sotme arbëreshe, ka po ato përjetime e shqetësime. porse qysh nga titujt e librave të tij, merret vesh se ai është disi më i frikësuar nga rreziqet që ndesh sot bota arbëreshe. Në qoftë se bashkëkohës të tij janë optimistë se "shpirti i arbërit rron" (Kandrevia) apo se "goditjet e shekujve nuk na përkulën" (Lluka Perrone), Napolitano me një drithërimë pikëllimi e më vagëllimë loti të përmallshëm sheh se arbëreshët janë "një botë që birret".

Pietro Napolitano është një vjershëtar i lidhur fort me katundin e tij, me bëmat e përjetimet e djeshme e të sotme të atyre që përbëjnë forcën lëvizëse të botës arbëreshe, botës që i është përkushtuar i tëri. Vargjet e tij sjellin natyrshëm e pa bujë një lumturi të thjeshtë, të përbërë nga pak gjëra të thjeshta, si loja me cinël e me rreth. Por e gjithë kjo botë e bjerrë, vjen të ripasqyrohet nga Napolitano me vargje që ngajnë më shumë me filastrokat popullore; ai na sjell një botë që i shtrin rrënjët në traditat e poetëve popullorë, pa mëtuar tjetër, në mos diçka tashmë të humbur e të largët. Një nerv i hollë melankolie dhe pikëllimi e përshkon tejpertej kërkimin e poetit rreth kohës së humbur, rreth kujtimeve të largëta të bukurisë së botës arbëreshe. Pietro Napolitano i qaset shumë fëminisë së vet, për të na dhënë përfytyrimin e një bote: të botës arbëreshe që sot nuk është më e lehtë të gjendet, sepse ajo është bota që po birret.

Zef Skiro Maji (Giuseppe Schiro di Maggio), lindur më 1944 në Piana deli Albanezi (Sicili), është diplomuar për letërsi dhe punon si mësues në vendlindjen e tij. Ka botuar vëllimet poetike: "Sonata (1975), "Më para se të ngriset" (1977), "Nëpër udhët e parrajsit shqiptar dhe arbëresh", "Kopica e ndryshku" (1981), "Pugare të reja", "Trima të rinj arbëreshë apo arsyeja e gjërave", "Fatosat" - poemë epiko-popullore, "Vjeç të tua 500" (1988), "Laerti i jati" (1989), "Metaforë" (1990), "Kosova lule" (1991), "Anije me vela e me motor" (1992), "Poezi gushtore e tjera (1995), "Kopshti me dritare" (1996). Në Shqipëri është botuar një përmbledhje me vjersha të zgjedhura të tij me titull "Përtej malit prapa kodrës" (1985), zgjedhur dhe pajisur me shënime e parathënie nga Nasho Jorgaqi, ndërsa në Prishtinë, qysh më 1981 qe botuar vëllimi "Gjuha e bukës". Tashti së fundi, në Itali, është botuar një antologji e gjerë e poezisë së Di Maxhios në shqip dhe në italisht: "Dhembje e ngrirë" (Dove antico dolore), prirë nga një hyrje e gjerë nga Anton Nikë Berisha¹⁷. Për

poezinë e Di Maxhios është shkruar jo pak ndër ne, prandaj po kufizohemi vetëm në ndonjë prej vëllimeve të tij që paraqet më shumë rëndësi edhe në dritën e situatës së sotme, siç është “Kosova lule” (1991). Poeti i këndon me shumë dhimbje, po edhe me dashuri të thellë Kosovës martire të dhunuar më rëndë se çdo vis tjetër i rruzullit tokësor në këtë fundshekulli, vetëm pse “ajo i “Gjykatë” “Shtetrrrethi” “Adem Demaçi - Nelson Mandela” , “Paqe e vërtetë për Kosovën” “Evropa” etj. Të gjithë intelektualët dhe atdhetarët shqiptarë në Kosovë - thotë poeti në vjershën “Shpikja” janë vënë në mëdyshjen e provës së të pamundurës më tragjike:

“Të provojnë nëse mund të marrin frymë pa ajër, / nëse mund të jetojnë pa shpirt”, prandaj edhe janë bërë “eshkë e thate” e nuk mund ta përbijnë më vallen makabre të “bashkim-vëllazërimit”. Në vjershën kushtuar Ali Podrimës ai shprehet: “Fjala jote / poet kosovar / këndon si Fryma / e Kosovës së gjal/ që hedh në luftë / si armë të bindjes gërma të mëdha/ në nderim të farës njerëzore të qytetëruar ”

Askush deri më sot, nuk i ka ndjerë e shprehur aq “crudo” brengat e një etnie, mjerimet e pamerituara të një populli fisnik e të lashtë, tragjedinë shumëkatshe e të pambaruar të një toke të ndezur, të Kosovës, si Zef Skiro Maji në vjershat “Fluid i një populli” “Kronika e televizionit 1-5”, “Gjykatë” “Shtetrrrethi” “Adem Demaçi-Nelson Mandelda” “Paqe e vërtetë për Kosovën”, “Evropa” etj.

Zef Skiro Di Modika (Giuseppe Schiro di Modica), ka lindur më 1938 në Piana deli Albanesi, ku prej shumë vjetësh, krahas veprimtarisë së tij kryesore si mësues në shkollën e mesme të atjeshme, është marrë edhe me studime historike e gjuhësore, me onomastikën arbëreshe si dhe me gazetari. Ai themeloi dhe drejtoi për disa kohë revistën “Lajmëtari arbëresh” si dhe ka bashkëpunuar në pothuajse të gjitha revistat arbëreshe, sidomos të “Pranvera”, “Mondo Albanese” dhe në organe të Lidhjes së Shkrimtarëve e të Artistëve të Shqipërisë, si “Drita”. “Nëntori”, Ka botuar disa vëllime me vjersha: “Emocione ndër kujtimet” (1977), “Motive tej gjuhës” (1978), “Segmenti” (1982) dhe “Përshtypje” (1984), “Një gostar “shartim” për Kosovën” (1991), “Babele boomerang” (1992), “Ordangofë” (1993) dhe “Një gjyshe arbëreshe” (1998) gati për shtyp.

Prej vitesh ai ka ndjekur me përkushtim edhe problematikën letrare dhe rrjedhat e reja të kulturës arbëreshe në Sicili, duke botuar edhe artikuj problemorë në “Lajmëtari i arbëreshëve”, pastaj edhe në “Mondo Albanese”. Ka botuar gjithashtu vëllimet me vlerësimet e shkrime kritike e ese. Palcën e poezive të Di Modikës e përbën lidhja e fortë shpirtërore e arbëreshit me Shqipërinë dhe shqiptarët. Ashtu si gati të gjithë poetët e sotëm arbëreshë, në vitet ‘70 – 80’, ai pati rastin të vizitonte disa herë Shqipërinë dhe Kosovën në përbërje të grupeve, të miqve arbëreshë apo të kursantëve të gjuhës shqipe gjatë verës që organizonte Universiteti i Tiranës. Edhe vajtja e shqiptarëve në ngulimet arbëreshe preket me ndjenjë në vjershat e Di Modikës: “Ndër ne ju pres, shqiptarë, me ngrohtësi e nder!”. Kohët e fundit është botuar në Itali një përmbledhje e re me poezi të Di Modikës, me titullin “Ujë Lumi”, me një parathënie të Klara Kodrës, por ne nuk kemi pasur ende rastin ta marrim. Në diasporën arbëreshe të Italisë veprojnë sot edhe shumë poetë të tjerë, të cilët nga dita në ditë po japin vjersha e vëllime të reja, Kate Cukaro, Matilde Ferrara, Enza Skutari, Vinçenc Belmonte, Paskal Renda, Pino Kakoca, Luis de Rosa e të tjerë, për të cilët për arsye të mungesës së botimeve dhe në pamundësi për të shkruar vetë në ngulimet arbëreshe nuk mundëm t’i përfshinim në vështrim kësaj here. Shpresojmë të shkruhet për ta në një rast tjetër.

Recensentë:
Prof. Elvira Lumi
Prof. Dr. phil. Emine Teichmann
Salzachstr. 39
53332 Bornheim – Uedorf
Deutschland

BIBLIOGRAFIA

Gj. Shkurtaj, Poezia e sotme arbëreshe.

N. Jorgaqi, Bardi i madh arbëresh, parathënie e librit V. Ujko, Hapma derën zonja mëmë, Shtypshkronja "8 Nëntori", Tiranë, 1991.

Karmell Kandreva, Shpirti i Arbërit rron, Zgjedhur e pajisur me shënime dhe parathënie nga Gj. Shkurtaj, Shtëpia botuese "N. Frashëri", Tiranë, 1981.

L. Perrone, Lule Shkëmbi, zgjedhur e përgatitur për botim nga Gj. Shkurtaj, Shtëpia Botuese "N. Frashëri", Tiranë, 1985.

Quaderni di Biblios; Giuseppe Schiro'di Maggio, dove antico dolore (Dhembje e ngrirë), Palermo, 1998
dëfton botës mbarë se nuk mund të jetohej: a) të kushtëzuar, b) nën tutelë, c) të kategorisë së dytë.

LETËRSIA GOJORE SI INTERTEKST NË POEZITË E NAIM FRASHËRIT

Msc. Meral Shehabi-Veseli
Universiteti i Evropës Juglindore
Tetovë, Maqedoni

Hyrje

Poezia e Naimit me origjinalitetit dhe me gjuhën e bukur, të jep kënaqësi të veçantë. Po këtë origjinalitet e hasim edhe te disa poezi të Naimit, të cilat janë në relacion me letërsinë popullore. Këtu lexuesit i referohen elemente intertekstuale. Në kumtesen do të përdoret teoritë e Zhenetit dhe Blumit për teorinë e intertekstualitetit. Kjo teori që është mjaft e vjetër, njihet si teori e posmodernes. Metodrat që janë përdorur janë komparacioni dhe ajo analitike e poezive të Naimit. Kur themi koparacion, nënkuptojmë relacionin që kanë këto poezi me poezinë popullore. Letërsia popullore, mbetet teksti referencë për poezitë që do të analizohen në raport me lexuesin e tekstit. Hipoteza e studimit është se a ekzistojnë relacione intertekstuale dhe në cilën sferë janë më të dukshme.

Elementet referuese nga letërsia popullore

Naimi është njohës i mirë i poezisë popullore, poashtu ai do të quhet autor i popullit. Dëshmi për njohjen e mirë të letërsisë popullore është veprimtaria e tij, edhe pse nuk ishte i afirmuar me kulturë të tillë si autorët romantik evropian të shekullit të 19. Krahasuar me autorët tjerë romantik është i vetmi që në mënyrë eksplicite thirret në letërsinë popullore. *Asnjë autor nuk shkëputet krejtësisht nga letërsia popullore*, edhe te Naimi është i dukshëm dialogu me letërsinë popullore. Sipas Getes “ *të gjithë ne duhet të mësojmë si nga ato që ishin para nesh ashtu edhe nga ata që jetojnë njëkohësisht me ne. As gjeniu më i madh nuk do të shkonte larg nëse dëshironte cdo gjë të arrijë me fuqitë e veta*” (J.P.Ekerman, f. 539).

Lidhja e poezisë së Naimit me letërsinë gojore është e kushtëzuara nga edukimi i tij, por edhe nga kushtet shoqërore nga është edukura vet poeti. Në veprimtarinë e Naimit nuk flitet në veçanti për letërsinë popullore, ashtu si flitet në veprat e autorëve si Santori, De Rada ose Thimi Mitko. Por, Naimi i referohet poezisë popullore duke e berë që lexuesit t’i mundësohet lidhje intertekstuale.

Kur Naimi filloi të merret me letërsi krijuese, letërsia popullore asokohe akoma ishte veprimtari kyçe e popullit shqiptar. Interesi për letërsinë popullore i kaploi edhe vllëzërit Frashëri. Dialogu me letërsinë popullore nuk është shumë i hapur, por ky raport i Naimit me poezinë popullore, është i pranishëm në shumë sfera. Më së shumti lidhëshmëria e tillë është e shprehur, në vargun dhe strukturën e poezisë.

Shumë figura në veprimtarinë e Naimit janë si rrjedhojë e letërsisë popullore. Gjithashtu, Naimi përdor shumë krahasime të cilat janë përdorur në letërsinë popullore,

përveç figurave ai përdor edhe epitete nga kjo letërsi, me të cilët karakterizohen sendet, dukuritë, shprehi nga jeta e popullit. Nuk është befasuese se në këtë poezi, *gjuha është e zjarrtë, trëndafili është i kuq, nata e zezë, qielli i kthjellët* etj.

Përveç epitetëve, ai përdor edhe metafora me prejardhje folklorike. Në poezinë e Naimit vajza mund të quhet dallëndyshe, djali mund të quhet luan etj. Fjalët që i përdor si metafora shpeshherë kanë funksionin e simboleve. Dialogu me letërsinë popullore është i dukshëm edhe në përdorimin e lidhësave (e, dhe, edhe) që vargut të Naimit ia shtojnë shijen.

Për të zbuluar këto lidhje intertekstuale, faktor mjaft i rëndësishëm paraqitet edhe lexuesi. Një lexues që ka kulturë letrare, është në gjendje të zbulojë këto relacione që paraqiten në teorinë e interteksti. *Lindja e lexuesit* vetvetiu inicon *vdekjen e autorit* sipas teorisë së studiuesve si: Kaler, U. Eko, R.Bart etj. Sipas Kristevës, “*Të kuptuarit e intertekstualitetit mundëson të kuptohet se edhe lexuesi participon në dinamikën e tekstit*”.

Naimi në poezitë e tij përdor edhe elemente tjera nga letërsia popullore, personifikimin. Ai u drejtohet gjërave, objekteve, vendeve të ndryshme, flet me ta sikur të kenë ndjenja, i pyet, përgjigjet, si gjeniu popullor, e ngjall natyrën dhe e bën që edhe ai të merr pjesë në këtë, me përjetimet e veta. Në poezinë “*Zëri i zemrës*” e përmbledhjes *Ëndërrime*, ai e ngjallë erën mjegullat, lumin, trëndafilin, qiellin, yjet, bilbilin duke i zbuluar fshehtësitë që ka natyra:

“Flet natyra në çdo ças ` në këtë botë

Dhe të fshehtën që ka Brenda shkoqur thotë.

Herë flet me përshpëritje, me ngadalë,

Her` me fjalën` e trupëzuar, her` pa fjalë,

Kaq të fshehta i thotë era trëndafilit,

Këto thotë` dhe rënkimi i bilbilit.

(N. Frashëri, *Vepra I*, Toena, Tiranë, 2007.f.

167.)

Naimi në mënyrë perfekte shërbehët me elementete e letërsisë popullore, duke i përdorur për qëllime stilistike. Kur flitet për deminitivin me mbaresat për të zvogluar – th, -zë, që ai i përdor aq me mjeshhtëri në veprimtarinë, pa dyshim mund të theksohet se nuk do të ishin aq të bukura, poezitë dhe emocionalisht të pasura pa përdorimin e zvoglimeve. Për të përdëftuar këtë citohen vargjet në vijim:

Vashë bukurosh` e bariut! që vjen me llërë përveshur,

Me zëmërë të dëfryer e më buzëzë të qeshur

me dyshqerrëza ndër duar, të bukura si dhe vetë,

në sythit` tënt e shoh gazë, që s` e kam gjetur ndë jetë...” (Ibid., f. 72.)

Poezia Qershori si hipertekst

Zherar Zheneti, njohës i mirë i teorisë së intertekstualitetit sqaron pesë relacione për termin intertekstualitet, që është emruar nga Julia Kristeva. Ai për këtë nocion përdor termin transtekstualitet, që nënkupron leximin e teksteve të vjetra në një tekst të ri. Me paratekst nënkupton titujt, nëntitujt, parathënien. Metateksti që nënkupton, raportin e kritikës më tekstin për të cilën flitet. Dhe hipertekstualitetin që nënkupton raportin e tekstit B (hipertekstit) me tekstin A (hipotekst).

Duke u shërbyer me teorin e Zhenetit mund të potencohet që nga komparacioni i poezisë “ Qershori” me poezinë popullore, na vë në dukje se poezia popullore është në funksion të hipotekstit.

“O bilbil, bilbil i gjorë!
Qaj me lot, me mallëngjime,
Se moti të pru qershorë,
Që të shtije për pushime!
Me zë të bukur këndonje,
Edhe unë të dëgjonja,
Nga gju` i ëmbël më xgjonje,
Zën` e bukur sa ta donja!”(N. Frasheri, *Vepra II*, faqe, 143)

Kënga popullore, që parashihet se mund të ketë qenë materiali parësor, ka funksionin e hipotekstit :

Që ditën që hyri prilli,
zuri e këdon bilbili
O bilbil o zogu i parë,
kënga jote s`ka të share
Këndona, bilbil, këndona,
këndona në bacet tona,
në na zëntë gjumi zgjona,
O bilbil ta bëra benë,
në të gjeça dot folenë,
Do t`ta marr ta hedh në lumë,

se na le çupata pa gjumë. (Dh.S. Shuteriqi, *Kënga e popullit*, Naim Frashëri, Tiranë, 1955, f.75.)

Në të dy poezisë shihet qartë që imagjinata e poetit është e nxitur nga imagjinata e këngëtarit popullor, për shkak se autori shprehet me figurat e parardhësit të tij. Por autori, preferon figurat simbolike si që është bilbili, me të cilin paraqet rininë që është kalimtare. Derisa gjeniu popullor, shprehet se bilbili këndon te Naimi po i njëjti qan, te kënga popullore ndihet një kërcënim për bilbilit që i lë vashat pa gjum, Naimi ndjen kënaqësi kur e zgjon ky zë i ëmbël. Pra, si tekst bazë, hipotekst është përdorur kjo këngë popullore. Kur përsëri do të këndoje bilbili, ai shprehet:

“ Përsëriten gjithë ç`janë,
E kurrë nuk qetohen.” (N.Frashëri, *Ibid.*)

III. Kënga popullore si hipotekst i poemës Bukurija

Kur shkruan për bukurinë ai është i magjepsur, jep përshkrim të vashës shqiptare duke përdorur epitete nga poezia popullore. Në këngën e nëntë të poezisë lirike *Bukurija*, e cila mund te quhet si një nga këngët më të realizuara Naimi shprehet:

“Zemra jote në krahorrt tent

Është hekur brënda n` ergjënt,
 Dhe në linj` ajy krahuar
 Si ndë dhe gur`i paçmuar;
 Dielli zënë me rezë,
 Vera në qelqe të zezë,
 Shpirti brënda ndër qivure,
 Zot`i math në katër mure“. (N. Frasheri, *Vepra I, Bukurija*, f. 152)

Letërsia gojore është një burim tjetër i motiveve të poemës *Bukurija*, ndoshta këtu është më e shprehur, interteksti se të gjithë poezitë lirike të Frashërit. Poema e tij që fiton ngjyrimet emocionale jo vetëm me metrikën por edhe me motivet e letërsisë popullore. Ashtu siç e përshkruan Naimi se vasha është qafëgjatë dhe ai është gati që të vdes për këtë bukuri.

Në poezinë popullore:

1Moj sorkadhja qafëgjatë,
 Kur del në saraje lartë
 2 Fekëstin si kollonatë.
 Laj e krih baluket mbrapa
 Mojt sorkadhe qafëgjata.
 3 Syzez` e vetullapë,
 Do vi sonde natënë,
 Nga muri do ngjitemë,
 Ta di se do vritemë “(këngë popullore)

Nuk mund të mos vërehet se Naimi ka përdorur epitete nga letërsia popullore, por me mjeshtri të rallë e tejkalon poezinë popullore, duke e përshkruar vashën, por në vazhdim bën një kthim, duke medituuar për Perendinë. Zoti në kuptimin mistik sufist, gjindet në zemrën e njeriut, për këtë arsye e përfundon poemën me vargun : “Zoti i madh në katër mure”

Një referim tjetër me letërsinë popullore mund të hetohet me strukturën e shprehjes poeike, (sipas parimit të paralelizmit), ndërmjet natyrës dhe gjendjes shpirtërore të subjektit lirik. Sipas këtij parimi janë shkruar vargu i pesëmbëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë i poemës *Bukurija*. Vargjet lirike të poemës nëse vihen në komparacion me një këngë popullore, të mbledhura në Skapar, nga zona folklorike nga ka prejadhjen edhe vet Naimi. Vera vate, shkoi, // Bilbili pushoi // Dimri u qas // shprehet Naimi dhe zemra e tij, duron dhe njëkohësisht vuan, derisa brenga ritet vazhdimisht, kur vjen vera dhe lulet lulëzojnë, i ndriçon faqet e vashës. Derisa hipoteksti në këtë rast mund të jetë kënga popullore

Behari po na vjen,
 e dimri po shkon,
 plagët e mia seç i lëndon.
 Gjethi po çel, bari jeshilon.
 Bilbili po ia thotë ,
 e qyqja po këndon.
 Këmbora kërcet e zilja gjëmon,

plagë e mia seç i lëndon.
 Syzeza ime aman mua më s'më do.
 (N.Mustafara, *Këngë popullore të Skraparit*, Tiranë, 1998. f. 225.)

Naimi nuk e emiton geniun popullor, ai e koncepton si nxitje për të krijuar në krijimtarinë e tij. Është autor i cili mundohet të afrohet mendimit popullor, i cili mençurinë e vet e thotë për popullin, d.m.th. e zgjedh mënyrën popullore të shprehjes, pasi që populli më mirë do të memorizoj mençurinë e tij në vargje. Nuk është vështirë të thuhet se Naimi është i vetëdijshëm për burimet që i përdor por atë e ngrit pasi që i ndihmoi të jëtë ajo që është tani, edhe përkundër kësaj nuk mundet të mohojë, varshmërinë nga ndikimi. Sips kësaj flitet për veprimin Askezis sipas teorisë së Blumit.

Përfundimi

Autori i cili u referua në letërsinë gojore, arriti që të quhet autor popullor duke mundësuar që veprimtaria e tij të përdoret si intertekst, në veprat e autorëve pasardhës si Lazgushi, Noli. Jo vetem letërsitë e vogla marrin apo huazojnë nga letërsitë e njohuar por shpesh ndodhë edhe e kundërta. Ky huazim është në shërbim të vet autorit, që më shpejtë të pranohet nga lexuesit e tij. Kjo e përdëfton hipotezën e studimit që relacionet intertekstuale ekzistojnë dhe akoma më ia shtojnë vlerën tekstit të ri, dhe kënaqësinë lexuesit, që arrinë të zbulojë këto relacione.

Bibliografia

- Babtin. Mihail, (V.N. Vološinov), *Marksizam i filozofija jezika*, Nolit, Beograd, 1980.
 Bulo. Jorgo, *Magjija dhe magjistarët e fjalës*, Diturija, Tiranë, 1998.
 Fraj. Northrop, *Anatomia e kritikës*, Rilindja, Prishtinë, 1990.
 Frashëri. Naim, *100 vjet pas*, Konferencë shkencore, Prishtinë, 2000.
 Frashëri. Naim, *Vepra I-VI*. Përgatitur nga. Rexhep Qosja dhe Jorgo Bulo. Toena, Tiranë, 2007.
 Gennete. Gerarde, *Pamlimpsestes (la littearture au secondimedegree)*, Paris, 1982.
 Hamiti. Sabri, *Letërsia filobilike Letërsia Romantike*, Vepra letrare 7, Faik Konica, Prishtinë, 2002.
 Kriçka-Beqiri. Mirlinda, *Intertekstualiteti në poezinë shqipe mes dy luftërave*, Fakti, Shkup, 2003.
 Qosja. Rexhep, *Porosia e madhe*, Rilindja, Prishtinë, 1986.
 Qosja. Rexhep, *Historia e letërsisë shqiptare III, Romantizmi*, Rilindja, Prishtinë, 1990, ribotuar në Tiranë, 2000.
 Qullavkova. Katica, *Теорија на интертекстуалноста*, Kultura, Shkup, 2003.
 Th. S. Eliot, *Tradita dhe talenti individual*. Cituar sipas Anton Nikë Berishës "Çështje teorike të letërsisë", shtëpia botuese "Faik Konica", Prishtinë 2005.

ASPEKTET POZITIVE DHE NEGATIVE TË SHUMËGJUHËSISË

Prof. dr. Mustafa Ibrahim

UEJL, Tetovë

m.ibrahimi@seeu.edu.mk

Hyrje

Edhe përkundër shumë dallimeve, njerëzit gjithmonë kanë qenë të prirë të komunikojnë nëpërmjet kufijve gjuhësorë dhe kulturorë. Për rolin e gjuhës në bashkësi të caktuara njerëzore ekzistojnë shumë dëshmi. Çdo gjuhë posedon karakteristikat e veta që e bëjnë të jetë më specifike në krahasim me gjuhët tjera të botës. Gjuhët, ashtu si geniet tjera, lindin dhe vdesin, konfrontohen midis veti, ose shkatërrohen, disa dalin si fitues e disa si humbës, që varen nga shumë faktorë.

Ky komunikim imponon pyetje të ndryshme, si: Cilat janë raportet midis gjuhëve, shtrirja e gjuhëve të mëdha në llogari të gjuhëve të vogla; vlerat simbolike dhe komunikative të gjuhëve; globalizimi dhe lokalizimi i gjuhëve?

Shumë nga këto pyetje i gjejmë në veprën „*Lufta midis gjuhëve*” të Luj Zhan Kalve-së, ku gjuha merr përmasa ndërkombëtare dhe paraqitet si faktor kryesor i mospajtimeve, grindjeve dhe luftërave të ndryshme lokale, rajonale, por edhe botërore. Në lidhje me këtë, disa mendojnë se pas çdo paraqitje të shumëgjuhësisë, rezultojnë me pushtetin e një gjuhe ndaj tjetrës, për shkak se sipas mendimit të tyre, nuk është e mundur të bashkëjetojnë dy gjuhë të ndryshme, që mos të ndikojë njëri ndaj tjetrit, gjegjësisht njëri mos ta shkatërrojë tjetrin ose ta absorbojë. (Hajric 2005:371).

Organizmat e ndryshëm botërorë, kësaj çështjeje sot i kushtojnë një rëndësi shumë të madhe, sepse konsiderohet një faktor fundamental dhe empirik në nivel botëror. Në Evropë dhe kontinentet e tjera me vëmendje të veçantë studiohen rastet e shumëgjuhësisë. Përkrah shumëgjuhësisë studiohet edhe shumëkulturalizmi, edhe pse, nga ky aspekt deri më tani shumë pak është punuar. Kohëve të fundit mbahen shumë takime dhe zhvillohen diskutime për dukurinë e shumëkulturalizmit. Kjo dukuri mund të vrojtohet nga tri pikëpamje: (1) planetare, (2) shoqërore dhe (3) individuale.

1. Pikëpamja planetare

Që nga rënia e kullës së Babilonit, njerëzimi është ballafaquar me shumëgjuhësinë. Është fakt i pakontestueshëm se bota është shumëgjuhësore. Cilado që të ketë qenë gjuha e parë që e kanë dëgjuar apo mësuar njerëzit dhe kudo që të ketë qenë e lokalizuar, përditë takohen me gjuhë të tjera. Ata sot janë në kontakt të pandërprerë me gjuhën e tjetrit dhe janë të detyruar të jetojnë me këtë realitet, pavarësisht se e kuptojnë apo nuk e kuptojnë,

i duan apo nuk i duan, sundojnë me atë gjuhë, apo janë të nënshtruar (Kalve 1995: 47). Si dukuri planetare, shumëgjuhësia manifestohet me ekzistimin e mijëra gjuhëve. Është vështirë të përcaktohet gjuha e parë. Pikëpamjet e gjuhëtarëve janë të ndara rreth çështjes se ç'kuptojmë me semantemën gjuhë. Sipas disave nga 6000 gjuhë sa ekzistojnë sot në botë, vetëm rreth 30% e tyre e kanë statusin e gjuhës, të tjerat janë të folme pa norma gramatikore, apo që fliten nga ndonjë bashkësi të vogël. Ndërkaq, sipas të tjerëve të gjitha janë gjuhë, sepse shërbejnë për komunikim midis njerëzve. Lidhur me këtë çështje lind pyetja: *sa gjuhë dhe sa kultura ka në botë?* Kësaj pyetjeje nuk mund t'i përgjigjemi me saktësi, sepse, sipas Bugarskit, është shumë vështirë të përcaktohen kufijtë midis gjuhëve dhe kulturave (Bugarski 2005: 29).

2. Pikëpamja shoqërore

Shumëgjuhësia plotësohet si përdorim i më shumë gjuhëve në një bashkësi shoqërore. Kjo dukuri është masive në botë. Kudo në botë ekzistojnë shtete shumëgjuhësore. Kjo dukuri është e pranishme si në shtetet në zhvillim, ashtu edhe tek ato të zhvilluara. Kjo do të thotë se, kudo në planetin tokë, ku jetojnë njerëzit nuk ka shtet njëgjuhësor. Të gjitha shtetet ballafaqohen me shumë gjuhë, e jo vetëm me një gjuhë. Nga kjo del se shumëgjuhësia paraqet fatin e përbashkët njerëzor. Ky fenomen gjuhësor ka lindur shoqëritë shumëkulturore.

Rrallë do të gjejmë shtet njëgjuhësor, kurse shumë prej shteteve janë shtete të vërteta shumëgjuhësore, si: Papua, Guineja e Re, Indonezia, Nigeria, India. Në Evropë, edhe pse shumë shtete konsiderohen si shtete kombëtare njëgjuhësore (disa prej tyre edhe formalisht janë shumëgjuhësore, si: Belgjika, Zvicra dhe Finlanda, këtu mund të hyjnë edhe ish-federatat). Megjithatë, në jetën reale të gjitha shtetet evropiane janë shumëgjuhësore, me përjashtim të Islandës dhe Portugalisë. Në kontinentet e tjera ky fenomen as që mund të fshihet, sepse formula karakteristike evropiane: një komb, një shtet, një gjuhë, atje nuk kishte lëshuar rrënjë.

Vetëdija për trajtimin e shumëgjuhësisë si faktor kryesor është dukshëm e zgjeruar dhe është shumë aktuale. Nesër sigurisht do jetë edhe më aktuale (p.sh. në Bashkimin Evropian një e treta e mjeteve harxhohen për përkthime dhe ka tendenca që kjo shifër të rritet në të ardhmen, kuptohet me pranimin e shteteve të tjera). Në BE u jepet rëndësi gjuhëve kombëtare, gjuhëve për komunikim ndëretnik, gjuhëve për komunikim ndërkombëtar dhe global.

3. Pikëpamja individuale

Në komunikimin e përditshëm, çdo individ, së paku shërbehet me një gjuhë tjetër. Dukuria e dygjuhësisë është e përhapur në të gjitha kontinentet, si p.sh. në Afrikë dhe Azi. Kudo shumë njerëz vazhdimisht shërbehen me dy e më shumë gjuhë. Çdo njeri i arsimuar, në parim është shumëgjuhësor, por ngelet pyetja, çfarë në të vërtetë do të thotë dy gjuhë të ndryshme?

Nuk ka dyshim se shumëgjuhësia individuale paraqet dukuri masive në tërë botën dhe vazhdimisht rritet. Anglishtja, si gjuhë globale tanimë ka përfshirë gjysmën e popullsisë së botës dhe ekziston tendenca e rritjes së vazhdueshme të numrit të tyre. Tashmë, njëgjuhësia paraqitet si anomali. Si duket homo-sapiensi, si qenie me kapacitet shumëgjuhësor evoluon edhe gjenetikisht, edhe në aspektin hapësinor.

Rëndësia e njëgjuhësisë

Për ta kuptuar të plotë problemin e shumëgjuhësisë, duhet ta shpjegojmë dhe ofrojmë kuptimin e “njëgjuhësisë” (kuptimi i gjuhës së përbashkët) në një hapësirë. Përvoja e të kaluarës dhe të tashmes, në lindja e në perëndim, qartë vërteton se gjuha është faktori kryesor i bashkimit dhe solidaritetit midis pjesëtarëve të një populli.

Gjatë shekujve ka pasur përpjekje të shumta që pluralizmi global i gjuhëve të zëvendësohet vetëm me një gjuhë. Gjithçka filloi në shek. XVII, kur në Evropë lindi ideja për zgjidhjen e problemeve që paraqiten nga shumëgjuhësia dhe mund të zgjidheshin *in vitro* ashtu që mund të krijohet gjuhë universale, një gjuhë e përbashkët ndërkombëtare si mjet komunikimi, p.sh. esperanto. Në shek. XX dhe në fillim të shek. XXI anglishtja krijoi pozicion hegjemonal ndaj gjuhëve tjera, kurse sipas ekspertëve në përgjithësi në vitin 2050 asnjë gjuhë nuk do ta ketë pozicionin hegjemonal (Graddol 1997:58).

Atëherë lind pyetja: pse gjuhët janë të kërcënuara të shuhen dhe çfarë do të ndodh me gjuhët në të ardhmen?

Një nga shkaqet është globalizimi që ka shekuj që thellohet. Në një botë që bëhet gjithnjë e më shumë e ndërvarur, gjuhët më të vogla rrezikojnë të shtyhen derisa madje edhe të shuhen nga dukja. Kërcënime të tjera për gjuhën janë edhe vrasjet e racave shoqërore dhe sëmundjet ngjitëse shfarosëse.

Pra nuk ishte ideja e tyre për një shoqëri monolinguale, si para ngjarjes dramatike në Babiloni, as ideja për një shoqëri monolinguale me një gjuhë të përbashkët ndërkombëtare si mjet komunikimi, p.sh. si esperanto, por për shtet monolingual nacional. Këto të drejta rreth trashëgimisë në fakt janë lojëra politike-gjuhësore, duke i lënë hapësirë lindjes së nacionalizmit. (Kalve 1981:22).

Përkundër rrezikut të gjuhëve nga globalizimi, gjuhët shtohen dhe marrin një rëndësi më të madhe identiteti. Këtë më së miri e pasqyron A. Meje, i cili thekson se “paradoks në vete është thënia “ *Bota mundohet të ketë vetëm një civilizim, por gjuhët e civilizimit shumëzohen në të*”.

Bilinguizmi

Problemi i shumëgjuhësisë lidhet me pushtimet kolonialiste. Duke krijuar kolonitë mbretërore të disa shteteve evropiane jashtë kufijve të Evropës, shumë popuj erdhën nën ndikimin e kulturës evropiane (Milardović, 1998.). Gjatë kolonializmit shtetet evropiane në botën e re bartën edhe institucionet shtetërore, fetare dhe politike. Kolonitë e tyre ishin thjesht anekse të shteteve amë, kurse shtetet evropiane i kishin nën kontrollin politik dhe fetar shumë prej shteteve të tilla. Gjuhët filluan të barten nga njëra anë e botës në tjetrën. Kështu me zgjerimin e perandorisë romake latinishtja u shndërrua në *lingua franca* në Mediteran dhe në pjesën më të madhe të Evropës; zgjerimi i islamit solli deri te dominimi i gjuhës arabe në Lindjen e afërt dhe në Afrikën Veriore. Ekspansioni i rusëve në lindje dhe kinezëve në perëndim, rezultoi me përhapjen e gjuhëve të tyre në vendet e pushtuara. E njëjta gjë është edhe me gjuhët evropiane (spanjishtja, portugalishtja, anglishtja dhe frëngjishtja) të cilët pas zbulimeve dhe kolonizimit të kontinentit amerikan, kolonizimit të Afrikës dhe Australisë kishin të njëjtin dominim. P.sh. në Amerikën Latine edhe sot e kësaj dite flitet spanjishtja, gjegjësisht portugalishtja, pasi edhe kjo ishte gjuhë e kolonizatorëve, në të njëjtën mënyrë u veprua edhe me kulturën dhe mënyrën e jetesës.

Në të njëjtën kohë kur gjuhët e kolonizatorëve u eksportua, filloi procesi i tkurrjes por edhe i zhdukjes së gjuhëve autoktone vendase. P.sh. kur në shek. 16 portugalishtja arriti në Brazil, për një kohë shumë të shkurtë u zhdukën 75% të gjuhëve burimore autoktone, kurse prej 208 gjuhëve për të cilët dihet se ndonjëherë janë folur në Brazil, në fund të shek. XX vetëm një gjuhë ka mbetur me 10.000 banorë, nga gjithsej 160 milionë banorë sa kishte në Brazil; ose deri sot kanë ngelur vetëm 20 nga 250 gjuhëve vendase të aborixhinëve në Australi, të cilët kanë qenë në përdorim para dhe gjatë ardhjes së evropianëve në Australi më 1788; në Alaskë ka vetëm 2 gjuhë nga 20 etj. (*Speaking...* 1997:53; usp. Watson 1999:8-9).

Kjo praktikë e zgjerimit të disave dhe zhdukja e tjerëve, vazhdon edhe sot nën trysinë e ashtuquajturës globalizimi joliberal, duke krijuar modelin e "multikulturalizmit të korporatave dhe duke sjell në pyetje pluralizmin e kulturave, me çka zhdukja e gjuhëve rrjedh shumë shpejt. Mesatarisht çdo dy javë nga një gjuhë i humb folësit e vet pasi vdesin ose nuk flasin më. Pra nëse për dy javë vdes një gjuhë, kjo do të thotë se 25 për një vit. Shtrohet nevojë se nëse nuk përgatitet një politikë globale për gjuhët e rrezikuara, në shekullin XXI do të zhduken krejtësisht rreth 80% të gjuhëve në botë, 10 % do të mbahen vetëm në formën gojore, edhe atë midis folësve të popullatës së mesme dhe të vjetër (d.m.th. nuk do të mësohen në shkollë) dhe vetëm 10 % ose 600 gjuhë do të kenë folës që do t'i përcjellin brezave të ardhshme dhe ashtu do të vazhdojnë të përdoren (*Cambridge Encyclopedia of Language* 1996; Crystal 1997; usp. Watson 1999:9). Por ka edhe prognoza pesimiste se deri në mesin e shek. XXI do të zhduken deri 90% nga numri i përgjithshëm i gjuhëve të sotme të gjalla. (Grbiç 2004:244).

Në botë janë të pranueshme konstatimet e gjuhëtarëve, ekonomistëve, sociologëve, politikanëve etj. se në shumicën e shteteve të pazhvilluara dhe në zhvillim ose ata që janë në tranzicion multilinguale ose multikulturore, kanë një numër të madh analfabetësh. Për dallim nga ta, shtetet njëgjuhësore homogjene janë më të zhvilluara ekonomikisht dhe kanë arsim më të përparuar dhe politikë më moderne për ruajtjen e gjuhëve. Por edhe nga aspekti ideologjik-politik janë më stabil (Fishman 1968, sipas Watson 1999:6). Këtë mund ta ilustrojmë me shembujt konkret, p.sh. sot në botë fliten rreth 6000 gjuhësh, prej tyre në Evropë 3%, në Afrikë 30%, në të dyja Amerikat 15%, në Azi 32%, kurse në rajonin e Pacifikut: 19%. Nga kjo mund të shihet se në shtetet e zhvilluara përdoren vetëm disa gjuhë, kurse në të tjerët më tepër. (Maurais 2004; Skutnabb-Kangas 2001; Maffi 2002; Fishman 2000; *The World's...* 2001; *Winners...* 2000; Watson 1999; Crystal 1997; Bugarski 1997a; Raloff 1995).

Ekspansionizmi dhe dominimi i anglishtes

Kur në vitin 1879 Martin Schleyeri e krijoi volapük dhe për bazë zgjodhi gjuhën angleze (rreth 60%), arsyetoi se këtë e ka bërë për shkaqe praktike sepse anglishtja është gjuha më e përhapur në botë. (Harlow 2003). Dominimi i anglishtes e fascinoi edhe politikanin gjerman Otta Eduarda von Bismarcka. Kur e pyetën më 1898 se cila ngjarje në historinë moderne ishte më e rëndësishme, u përgjigj se një gjë të tillë ndodhi kur amerikanët verior filluan të flasin anglisht (Watson 1992:12). Në vitin 2000, në rruzullin tokësorë jetonin 430 milionë njerëz që të cilët gjuhën angleze e kanë gjuhë amtare, si gjuhë e parë. Edhe një miliardë e gjysmë njerëz anglishten e flasin si gjuhë e dytë apo të tretë. Rreth 75 % të postës botërore dhe 70% postës elektronike që është dërguar në internet kanë qenë të shkruar në anglisht. Në gjuhën angleze zhvillohen të gjitha punët dhe plotësohen dhe botohen të gjitha dokumentet e organizmave të

ndryshme botërore, si: bankat botërore, tregjet botërore, Fondi ndërkombëtar monetar, programet e ndryshme zhvillimore të Kombeve të Bashkuara, organizatat transkombëtare, si Lidhja e kombeve juglindore të Azisë, Organizata e Bashkimit afrikan etj. Me fjalë tjera të gjitha organizatat të Azisë, Afrikës, Evropës, Lindjes së Afërt dhe Paqësorit, veprimtarinë e tyre dhe distribuimin e informatave e bëjnë vetëm në anglisht. Rreth 80% e filmave botërorë dhe programeve televizive gjithashtu prodhohen në anglisht, kryesisht nga ajo se SHBA-të e kontrollojnë tregun botërorë e industrisë së filmit me 85%. Shumica e revistave shkencore të akademive botërore botohen në anglisht, pa marrë parasysh se a hyjnë në shkencat shoqërore, humane apo natyrore. Në internet anglishtja është e pranishme me 84%, kurse sipas disa raporteve të UNESCO-s rreth 60% të shfrytëzuesve janë të gjuhëz angleze. (Watson 1999:9-13; Defenders... 2000:32; Maurais 2004:20).

Një tjetër faktor të globalizmit nëpërmjet anglishtes dhe dominimit të saj është rritja e turizmit dhe industria e reklamave që janë kryesisht në anglisht. Edhe informatat në aeroportet, limanet dhe stacionet e ndryshme ndërkombëtare dhe lokale jepen në gjuhën angleze. Teknologjia, telekomunikacioni dhe interneti gjithashtu informatat jepen në anglisht. Pra krejt këta shndërrohen në folës, të gjuhës universale që i shpërndan ato reklama dhe kulturat e ndryshme (Watson 1999:13).

Sipas disa hulumtimeve të zhvilluara në British Council, të koordinuara nga David Graddol, ekzistojnë indice se dominimi global i anglishtes mund të dobësohet. Ai vjen në konkludime se gjuha angleze përafërsisht në mesin e shek.XXI nuk do ta ketë monopolin gjuhësor, por do të jetë pjesë e "monopolit të disave", gjegjësisht secili do të ketë pushtet në domenin e vet (Graddol 1997).

Përfundime

Pyetjes se pse gjuhët do të ekzistojnë, mund t'i përgjigjemi se gjuhët janë pjesë e identitetit etnonacional, kurse identitetet janë ngulitur thellë në vetëdijen e folësve.

Shtetet evropiane shumë herët e formonin identitetin e tyre në bazë të vlerave kulturore të rrënjësura thellë në gjuhë. Shtetet e reja të lindur nga nacionalizmi e rritën edhe më shumë numrin e gjuhëve zyrtare në Evropë. Qoftë ta arsyetojmë, qoftë edhe ta dënojmë këtë, bëhet fjalë për një nga karakteristikat më të theksuara të kontinentit të vjetër, që i jep botës edhe vlera kulturore. Këtë e mundëson edhe Karta e të drejtave të njeriut që është kusht për çdo pranim të ri në familjen evropiane, nëse i respekton gjuhët e nacionaliteteteve.

Disa analist, siç edhe përmendëm më lartë, shumëgjuhësinë e shkojnë si dukuri ku njëra gjuhë do ta sundojë tjetrën gjuhë, për shkak se, sipas mendimit të tyre në një hapësirë nuk mund të mbijetojnë dy gjuhë.

Nga ana tjetër, globalizmi si rend i ri botëror, nuk lë hapësirë për shumëgjuhësi. Të gjitha gjuhët e botës (përveç gjuhës angleze), janë vetëm dukuri antropologjike, të cilët ngadalë vdesin dhe zhduken. Për shembull, interneti sot kryesisht është në gjuhën angleze, dhe secili që do të shërbehet me atë duhet ta mësojë anglishten. Anglishtja është gjuha e konferencave ndërkombëtare dhe diplomatike, që do të thotë se globalizmi ka imponuar gjuhën e re të rendit botëror, ku nuk ka vend për shumëgjuhësinë.

Ekzistojnë indice se dominimi global i anglishtes mund të dobësohet. Ai vjen në konkludime se gjuha angleze përfaqëson në mesin e shek.XXI nuk do ta ketë monopolin gjuhësor.

Referenca:

- AЖЕЖ, Клод (1997). *Душата на јазикот*. Скопје.
- BEYFLUSS, J. (1997): *Globalisierung im Spiegel von Theorie und Empirie*. Koln.
- BUGARSKI, Ranko (2002). *Nova lica jezika*. Beograd: Bibliotek XX vek.
- BUGARSKI, Ranko (2005). *Jezik i kultura*. Beograd: Bibliotek XX vek.
- BUGARSKI, Ranko. (1997a). *Jezici*. Beograd: Čigoja štampa. (XX vek]
- CEL (1996). *Cambridge Encyclopedia of Language*. Cambridge: Cambridge University Press.
- CRYSTAL, David. (1997). *English as a Global Language*. Cambridge: Cambridge University press.
- DEFENDERS... (2000). "Defenders of Diversity". *UNESCO Courier* 53/4:30-32.
- HAJRIĆ, Amrudin. (2005). *Višejazičnost: pozitivni i negativni aspekti*. ZBORNIK RADOVA, XXIII, nr.10. Sarajevo.
- FISHMAN, A. Joshua, ur. (1968). *Reading in the Sociology of Language*. The Hague: Mouton De Gruyer.
- FISHMAN, A. Joshua. (2000). "English: 'The Killer Language? Or a Passing Phase?'" . *Whole Earth*, Spring.
- GRADDOL, David. (1997). *The Future of English*. London: The British Council.
- GRBIĆ, Jadranka. (2004). *Jezični procesi, identitet i globalizacija*. Në Narodna umjetnost, 41/2. Zagreb.
- IBRAHIMI, Mustafa. (2012). Tema sociolinguistike dhe etnolinguistike. *Interlingua*. Shkup.
- KALVE, Luj Žan (1981). *Lingvistika i kolonijalizam*. Beograd. Biblioteka XX vek.
- KALVE, Luj Žan (1995). *Rat među jezicima*. Beograd: Biblioteka XX vek.
- MAURIS, Jacques. (2004). "Towards a new linguistic world order". U *Languages in a Globalising World*. J. Maurais i M. A. Morris, ur. Cambridge: Cambridge University Press, 13-36.
- MILARDOVIĆ, A. (1999.). *Globalizacija*, Pan Liber, Osijek-Zagreb-Split.
- SHKURTAJ, Gj. & MEMUSHAJ, R. (1998). *Shkolla dhe shqipja letrare*. "Gjuha jonë", nr.1-4/1998, Tiranë, f.56-63.
- SKUTNAB, B & KANGAS, Tove. (2001). "The Globalisation of (Educational) Language rights". *International Review of Education* 47/3-4:201-219.
- SPEAKING ... (1997). "Speaking in Tongues". *Time Magazine*. July 7:52-58.
- STEGER, Manfred B. (2005). *Globalizacija*, Šahinpašić, Sarajevo, 157.
- STIGLITZ, JOSEPH E. (2007). *Globalizimi dhe pakënaqësitë e shkaktuara prej tij Zenith*.
- TUREK, F. (1999.): *Globalizacija i globalna sigurnost*, Hrvatska udruga za međunarodne studije, Varaždin, pp. 159.
- WATSON, Keith. (1999). "Language, power, development and geopolitical Changes: conflicting pressures facing plurilingual societies". *Compare* 29/1:5-22.

FRAZELOGJIA NË TREVËN E GJAKOVËS

Naim Berisha

Instituti Albanologjik-Prishtinë

Gjuha si një aktivitet social, pasqyron jetën shpirtërore e materiale të një vendi. Njësitë frazeologjike, me format e tyre të ngurosur apo relativisht të ngurosur, janë të shtrira me kohë në të gjitha sferat e jetës. Njësia frazeologjike është njësi gjuhësore me kuptim të mëvetëshëm, e përbërë nga dy ose më shumë fjalë shënuese, me gjymtyrë e ndërtim të qëndrueshëm, e formuar historikisht e për një kohë të gjatë, që ka vlerën e një fjale të vetme, që riprodhohet e funksionon në ligjërim si njësi e gatshme dhe e pandashme²⁰⁴.

Për breza me radhë, jetesa në trevën e Gjakovës ishte jetesë e thjeshtë fshatare. Zhvillimi i jetës në këtë mënyrë ndikoi edhe në formimin e njësive frazeologjike kryesisht të karakterit popullor, të cilat lidheshin me përditshmërinë dhe ambientin përreth. Me fillimin e organizimit të jetës qytetare dhe lindjen e artizanateve të ndryshme, u formuan edhe njësi frazeologjike që lidhen me to (Gjocaj), shumica e tyre tashmë i përkasin shtrirjes mbarëkombëtare.

Dihet se formimi i njësive frazeologjike bëhet historikisht dhe për një kohë të gjatë, pjesa më e madhe e tyre kanë shtrirje mbarëkombëtare. Njësitë frazeologjike me shtrirje lokale janë më të pakta, andaj, vëmendja jonë në këtë studim është nxjerrja e atyre veçantive që përkasin me këtë trevë gjuhësore. Një grup më vete përbëjnë njësitë frazeologjike që lidhen me emrin e dikujt, të një vendi a të një ngjarje, me ndodhi historike a me një anekdotë: (flet) *si e ëma e Zeqos*, (shkoi) *dushk për gogla, lëshon brezin (e humbi) si Xhaferi simiten*) e të tjera që janë përgjithësuar²⁰⁵. Pikërisht, karakteri lokal i njësive frazeologjike vërehet me elementet që lidhen me personat e veçantë, me emra vendesh të ndryshme që i përkasin asaj treve etj.

Bien në sy edhe frazeologjitë që lidhen me sferat të ndryshme të jetës, sidomos ato që lidhen me bujqësinë e blegtorinë. Këto njësi në të shumtën e rasteve janë të ndërtuara me fjalët më tipike të vendit dhe e shfaqin shumë qartë karakterin popullor të tyre. Ashtu siç e theksuam edhe më lartë, në këtë punim, do të mundohemi që t'i paraqesim kryesisht njësitë frazeologjike që i kemi mbledhur gjatë punës në terren, të cilat përkojnë me këtë trevë gjuhësore dhe njëkohësisht paraqesin veçanti nga trevat tjera përreth. Pra, në kuadër të kësaj që thamë, jemi munduar që t'i mbledhim njësitë frazeologjike të cilat janë krijuar në dekadat e fundit.

Leksikografia shqiptare, për qëllime studimi njësitë frazeologjike i ka klasifikuar duke u nisur nga *ndërtimi, shkalla e motivimit dhe vlera leksiko gramatikore* (J.Thomai).

²⁰⁴ Jani Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe. Prishtinë, 2000.

²⁰⁵ Zenun Gjocaj, Struktura leksiko-semantike e stilistike e frazeologjisë shqipe, Prishtinë, 2001

Njësitë frazeologjike që lidhen me emrin e një njeriu kanë zënë vend në këtë trevë, p.sh: si shati i bac's Met – I shtrembër, i deformuar (Baca Met ishte bujk i cili nuk kujdesej shumë për veten, dhe mbante me vete një shati me bisht të shtrembës, fshati Rracaj); si lopa e Mejremit – i(e) humbur, njeri i lënë pas dore e pa përkujdesje (Mejremja është e vetme, për të mbijetuar ajo mban lopë dhe përkujdeset për to, por moshja e saj e shtyrë bën që lopët shpesh t'i humbin, fshati Rracaj), Këto njësi frazeologjike tashmë e kanë zënë vendin e tyre në ligjërimin e përditshëm të kësaj treve, në të shumtën e rasteve këto shprehje përdoren me kuptim përcmues.

Në mesin e njërive frazeologjike të formuara dhe të ngurosura tashmë është njësi frazeologjike “si bunkeri i Mark Avdyt – e fortifikuar, e fortë” (Mark Avdyli ishte një burrë plak që luftoi në luftën e fundit dhe e kishte ndërtuar një bunker për punimin e armëve dhe shquhej për qëndrueshmërinë e tij ndaj bombardimeve të mundshme, fshati Ramoc). Njësi tjetër frazeologjike e cila gjithashtu nuk është shumë e vjetër por tashmë është ngurosur me këtë kuptim, është: si dardha e Çetit – me bollëk (Çeti ishte një burrë plak i cili jetonte në qytet e tokën e kishte në fshatin Madanaj, i gjithë fshati por edhe ajo anë i kanë shijuar dardhat e tij pa i penguar askush, megjithatë ato kishin shumë fruta vazhdimisht).

Po të klasifikohen sipas ndërtimit, këto njësi frazeologjike janë me strukturë togfjalëshi. Gati në të gjitha këto njësi, gjymtyrët e tyre e kanë humbur përgjithësisht pavarësinë kuptimore. Rendi i këtyre fjalëve tashmë është në formë të ngurosur dhe prishja kësaj renditjeje do ta prishte edhe kuptimin e tyre. Sipas ndërtimit, këto njësi hyjnë në grupin e njërive me strukturë togfjalëshi emër + emër: *si dardha e Çetit, si lopa e Mejremit* etj.

Sipas vlerës leksiko-gramatikore, shembujt e mësipërme janë njësi frazeologjike mbiemërore. Formimi i këtyre njërive është bërë sipas një krahasimi. Formime sipas gjedheve të tilla të tilla janë të shtrira në mbarë shqipen, si: *si kal pa fre* – i shfrenuar, *si pulë e lagur* – i nënshtuar etj.

Disa nga njësitë frazeologjike të përmendura me lartë hynë në grupin e njërive të formuara në vitet e fundit, ngurosja e tyre tashmë ka ndodhur dhe përdorimi në të folurit e përditshëm i nxjerr pothuajse vetëm në këto forma. Kombinimi i këtyre fjalëve nuk është bërë rastësisht, përkundrazi, shqiptimi i tyre nga folësit e kësaj ane ka qëllim dhe domethënie të caktuar, përdorimi i tyre bëhet në mënyrë të thjeshtë por fort të ngjeshur.

Ashtu si në mbarë shqipen, njësitë frazeologjike që lidhen me emrin e një vendi nuk mungojnë as në trevën gjuhësore të Gjakovës, të tilla si : si pasuli i Mollit – cilësor, fasule që shquhet për nga cilësia që kultivohet në fshatin Mollit; si specat e Dobroshit – cilësor, specat të shquar për cilësi që kultivohen në Dobrosh; si rrushti i Cermjënit – i ëmbël, i një kualiteti të lartë pasi që Cermjani në atë anë shquhet për kultivimin e rrushtit cilësor; si podrimçaki n'ar' – i përkushtuar, punëtor; si kshatjat n'Mollit – me bollëk. Formimi i njërive frazeologjike sipas një krahasimi në trevën gjuhësore të Gjakovës del i shpeshtë. Këto njësi hyjnë në grupin e njërive frazeologjike të motivueshme. Në këto raste kemi shndërrim të figurshëm të togfjalëshave të lirë. Në ligjërimin e përditshëm mund t'i hasim paralel në përdorim që të dy llojet e togfjalëshave, si togfjalësha të lirë, p.sh: *Sivjet u kan' sene e that, te na nuk ka pasul veç n'u baft pasuli i Mulliqit se n'vene tjera nuk ka* – kuptim i drejtpërdrejt; *Çka po t'kesh ftyra o Gani? Jam i gzum se per gjys dite i shita krejt drut', kan shku si pasuli i Mulliqit* – kuptim i figurshëm, togfjalësh i

qëndrueshëm. Sipas vlerës leksiko-gramatikore, shumica e këtyre njësive kanë kuptim kategorial të mbiemrit dhe e luajnë rolin e tyre.

Në grupin e njësive frazeologjike që lidhen me emrin e një vendi është edhe njësia me strukturë fjalie: *S'e lan as Ereniki* – turp i madh. Kjo njësi frazeologjike është e hershme, ka një përdorim të shpeshtë në këtë trevë. Një sinonim i saj me përdorim aktiv është edhe njësia frazeologjike *S'e lan Dri: as Erenik*. Njësia në fjalë ka përdorim më të gjerë, sidomos në pjesë të caktuara të Rrafshit të Dukagjinit, këtë njësi e gjejmë të vjelë edhe nga studiuesit tjerë që merren me frazeologjinë.

Meqenëse Gjakova më rrethinë në të kaluarën ka zhvilluar kryesisht një jetë bujqësore dhe blegtorale, nuk mungojnë edhe njësitë frazeologjike që lidhen me këto dy veprimtari shumë të rëndësishme për vendin. Njësitë frazeologjike që lidhen me sferën bujqësore dhe blegtorale nuk mund të themi se kanë shtrirje lokale, ato mund të hasen edhe në treva tjera. Përzgjedhjen e disa njësive që lidhen me jetën fshatare, bujqësore dhe blegtorale, e kemi bërë duke u bazuar nga denduria e përdorimit dhe "krahasimi klasifikues" me literaturën që e kemi shfletuar, si p.sh.: *u bâ per shati* – kjo njësi frazeologjike përdoret me kuptimin e kohës së përshtatshme për të prashitur, por, i thuhet edhe djalit i cili e ka arritur moshën e pjekurisë; *e ma:n shatin mos me u rru* – nuk punon, është dembel; *Prashit n'uj* – bën punë kot; e ngjashme për nga ana kuptimore është edhe njësia *ke:p(qepë) pa nyje* - bën punë kot; *livron pa ajâm* – flet kur nuk duhet; *korr mi tromak* - flet pa bazë, flet hava, gënjen. Ashtu siç dihet, njësitë frazeologjike që motivohen me elementet fshatare, kryesisht kanë kuptim kategorial të foljes dhe në përdorimin e përditshëm e luajnë rolin e foljes.

Njësitë frazeologjike që lidhen më kafshët janë të shumta. Përdorimi i tyre është i një rëndësie të veçantë sepse lidhen në masë të madhe me mënyrën e jetesës në atë vend. Pra, kemi njësi të tilla si: *qeni i t'fortit* - i shitur, argat i okupatorit; *si kali i Bardhecit* – punëtor i madh, i etur për punë, nuk ndalet (Bardheci është banor i fshatit Osek kali i të cilit kishte nam në atë anë), kjo njësi tashmë është përgjithësuar në këtë trevë; me kuptim përçmues përdoret njësia frazeologjike *thi: Novoselle* – kokëtrashë, i padëgjueshëm (Novosella është fshat banorët e të cilit shquhen për rritjen e derrave të mëdhenj që shpesh u bëjnë dëme të tjerëve në ara dhe livadhe).

Dallimet gjuhësore qytet-fshat janë të evidente në trevën e Gjakovës, ato janë reflektuar edhe te njësitë frazeologjike. Pra, një numër i caktuar njësisish frazeologjike kanë përdorim vetëm brenda qytetit, përdorimi i tyre nëpër fshatra është i rrallë. Njësi të tilla janë: *i preken en'mell* - njeri me te meta, probleme me kokën (përdoret mjaft shpesh me kuptim përçmues, në shumicën e rasteve u drejtohet fshatarëve nga njerëzit që jetojnë në qytet); *mos ja le nomit* – e tepron, mos ia nxjerr fundin, mos e tepro; *e zuni ke:p* – e shfrytëzoi dikë; *si Mahalla e Qylit* – i (e) çoroditur ("Mahalla e Qyllit" është lagje e banuar me pjesëtar të komunitetit rom. Infrastruktura e saj dhe përkujdesja nga banorët janë në shkallë shumë të keqe prej nga është motivuar edhe kjo njësi frazeologjike).

Më poshtë po i paraqesim edhe një grup njësisish frazeologjike të cilat i kemi mbledhur gjatë punës në terren. Përdorimi i tyre është i shpeshtë, i gjejmë të përdorura edhe në treva tjera gjuhësore, sidomos në Rrafshin e Dukagjinit: *ni pu:shk e ga:t* - lindi djalë; *Iu ba barki prru:* – është uritur shumë; *s'e ka ftyra e toks'* – shumë i mirë (është sinonime me *s'e ka faqja* e dheut e cila përdoret pothuajse në mbarë shqipen); *si kerri i thy:m* - i ngadalshëm; *t'u vraft' ora* - u dobësofsh, *tredh miza* – rri kot, nuk punon etj.

Për fund, mund të themi se njësitë frazeologjike të paraqitura në këtë punim janë një pjesë shumë e vogël e korpusit të përgjithshëm të njësive frazeologjike që përdoren në trevën gjuhësore të Gjakovës, por, siç e theksuam më lartë, këto i kemi përzgjedhur si njësi që kanë karakter kryesisht lokal dhe që lidhen me studimin tonë. Pra, karakteri lokal i këtyre njësive del në pah kur ato lidhen me emra njerëzish, vendesh, ngjarjesh historike etj. Pjesa dërmuese e njësive të paraqitura në këtë punim mendojmë se nuk kanë shtrirje të gjerë gjeografike, gjithashtu nuk i kemi hasur të mbledhura apo të trajtuara në ndonjë studim tjetër.

HENRIK IBSEN PËRMES KONFLIKTIT PA RRUGËDALJE TEK "HEDDA GABLER"

Dr. Rregjina Gokaj

Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, Albania E-mail: gokajrregji@yahoo.it

Abstrakt

Në këtë konferencë guxoj të marr vëmendjen tuaj për të sjellë në analizë një zhanër gjithnjë e më pak të lëvruar për vetë shkallën e vështirësisë që ka, atë të dramës. Përmes zhanrit të dramës unë provoj të risjell në pah vlerat e dramaturgut të shquar norvegjez me famë botërore, Henrik Ibsen, i cili njihet edhe si babai i dramës moderne, por që pak është lëvruar nga studiuesit shqiptarë. Veprat e tij kryesisht lidhen me simbolizmin dhe me çështjet e ndërlidhjeve të brendshme të personazheve pa anashkaluar edhe çështjet e lidhjeve shoqërore. Për të bërë sa më evidente aspektet për trajtim gjatë punimit, mendova të marr parasysh një nga dramat më komplekse të tijat, por më pak të njohur nga studiuesit shqiptarë. Në këtë kuadër, artikulli i mëposhtëm ka synim të analizojë vlerat morale të shuara të protagonistes Hedda në dramën me të njëjtin titull '*Hedda Gabler*' të dramaturgut të madh norvegjez, Henrik Ibsen. Drama është një tragjedi e mirëfilltë morale dhe individuale e protagonistes dhe e njerëzve që e rrethojnë. Artikulli synon të ketë si lexues studentët e Letërsisë Botërore mbasi ata të jenë njohur me veprën; si dhe kritikët e artit e të dramaturgjisë për ngjallur një diskutim më të thellë e më interesant mbi kompleksitetin mendor e emocional të Hedda Gablerit.

Hyrje

Henrik Ibsen është një nga figurat norvegjeze më në zë të dramaturgjisë botërore moderne, pasi ai konsiderohet nga kritikët si një nga themeluesit kryesorë të dramës moderne, ku konsiston edhe drama e ideve e fundshekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX. Veprat e tij kryesisht lidhen me simbolizmin dhe me çështjet e ndërlidhjeve të brendshme të personazheve pa anashkaluar edhe çështjet e lidhjeve shoqërore. Edhe pse ishte një shkrimtar me tendencë aristokrate, ai rrëzoi lavditë e tepruara të popullit të tij dhe që në tragjedinë e tij të parë *Catiline*, kur ishte në moshën 20 vjeçare, e vuri veten në luftë me shoqërinë e kohës. Modernizmi i Ibsenit bazohet në sulmin e tij kundër traditës së idealizmit kulturor përmes lidhjes me të zakonshmen në dramat moderne realiste. Ai ishte pararojë në prekjën e plagëve më të thella të asaj periudhe duke përdorur

satirën e tij kundër ideve të gabuara të shoqërisë së kohës.²⁰⁶ Modernizmi i dramës së Ibsenit ka në thelb gjithashtu mospranimin e idealizmit, thyerjen e mitit dhe të kornizës tradicionale të zakoneve dhe farsitetit moral. Elementi më krijues i talentit të Ibsenit është energjia e tij morale që arrin të transformojë në dramë veprimet në fjalë të personazheve. Çdo gjë që ai ka shkruar mendon ta ketë shkruar më mirë nëse e ka përjetuar vetë. Kështu edhe shprehet tek *'The task of the Poet'* (Detyra e Poetit) në 1874 para studentëve norvegjezë, ku thotë: "por vetëm ajo që është përjetuar mund të shihet në të njëjtën mënyrë dhe të pranohet në të njëjtën mënyrë. Dhe sekreti i Letërsisë Moderne shtrihet pikërisht në çëshjten e përvojave që i përjeton vetë njeriu."²⁰⁷ Ai i dha letrave botërore mendimin e tij vizionar përmes 25 dramave gjatë 50 viteve të jetës së tij letrare. Ndër dramat e tij më të spikatura mund të renditim *Peer Gynt*, *Shtëpi Kukulle*, *Brand*, *Xhon Gabriel Borkmani*, *Rosa e Egër*, dhe sigurisht *Hedda Gabler* e cila është edhe fokusi i këtij punimi.

Konflikti i Hedda Gablerit

Hedda Gabler konsiderohet një nga dramat më të famshme të Ibsenit, pas *Peer Gyntit* dhe *Shtëpi Kukulle*. Tek *Hedda Gabler* ndërlihdja e personazheve është si një rebus që duhet menduar për tu zgjidhur. Simbolika e pistoletave të karikuara të të atit që Hedda i kishte në zotërim, është si një parantezë ogurzezë e asaj që vjen më pas. Këtu Ibseni, si edhe në disa drama të tjera të tij, na jep një simbolikë fillestare e cila nxjerr krye papritmas në fund në formë tragjike. Duke konsideruar potencialin për tragjedi tek veprat e Ibsenit, George Steiner flet për "përdorimin e një miti efektiv dhe veprimi simbolik" tek vepra e tij *"The Death of Tragedy"* (*Vdekja e Tragjedisë*) ku shkruan:

'Në Rosmersholm, Gruaja nga Deti dhe Hedda Gabler Ibseni pati sukses duke bërë atë që çdo dramaturg i madh ishte përpjekur të bënte pas fundit të shekullit XVIII dhe atë çfarë Gëte dhe Wagner madje nuk e kanë përmbushur plotësisht: Ai krijoi një mitologji të re dhe konvencionet teatrore me të cilat ta shprehë atë. Kjo është arritja më sublime e zheniut të Ibsenit, dhe deri tani akoma nuk është kuptuar plotësisht.'²⁰⁸

Që në konsideratën e parë që na jep autori për Heddan, ku e përshkruan si e bija e një gjenerali të ve, që është rritur sipas rregullave strikte dhe parimeve të tij, por që ndërkohë fillon të eksplorojë jetën me të gjitha të fshehtat e saj, del në pah karakteri i saj ambicioz dhe egoist. Në lidhjen e saj kalimtare me Lëvborgun e çthurrur e të pamoralshëm, ajo i bie ndesh konvencioneve të kohës dhe normave të moralit tek të cilat nuk beson më. Drejtimi i mëtejshëm që merr jeta e saj, duke u martuar me një profesor mediokër vetëm për ta zhvatur financiarisht që të përmbushë kënaqësitë e veta, i jep asaj rastin të shfaqë hapur kundërshtinë ndaj normave shoqërore që nënkupton martesë: së pari duke ruajtur mbiemrin e saj Gabler në çdo prezantim, dhe së dyti duke refuzuar të dhurojë një fëmijë në këtë lidhje martesore. Lidhja e Heddas me mbiemrin e saj tregon që ajo është akoma e bija e gjeneralit, siç është shkruar nga vetë Ibseni: "*Hedda* si

²⁰⁶ Ibsen, *Tragedy and the Tragic – Ibsen Conference in Athens 2002*. Edited by Astrid Seather. Center for Ibsen Studies, University of Oslo, July 2003. Article by Panos Katagiorgos, Corfu. Title: The earliest Greek appraisal of Ibsen by the poet Georgios Vizyinos. pp. 7-15 (përkth. im)

²⁰⁷ Henrik Ibsen: "Speech to the Norwegian Students, September 10, 1874," *Speeches and New Letters*, translated by Arne Kildal (Boston. Richard G. Badger, 1910), pp. 49-52.

²⁰⁸ Steiner, George. 1982 (1961). *The Death of Tragedy*. London, Faber and Faber. p. 292 (përkth. im)

personalitet duhet të shikohet me më shumë vëmendje si e bija e të atit sesa si bashkëshortja e të shoqit.”²⁰⁹ Qëllimi i saj është të arrijë të manipulojë dhe të ketë kontroll mbi personat e tjerë, duke përdorur gjuhën si një barrierë mbrojtëse mes asaj dhe të shoqit, Tesmanit.

Tensionin që krijon situata e saj e pakëndshme familjare dhe martesore ajo e shfryn në rilidhjen me Lëvborgun, edhe pse ai tashmë kishte lënë alkoolin dhe ishte martuar me një shoqe të vjetër shkollë të Heddas, Znj. Elvsted. Lëvborgu kishte një lidhje krejt tjetër me Znj. Elvsted, e cila përkujdesej ndaj ngritjes së tij profesionale dhe katarsisit të tij moral, duke e drejtuar në një jetë bashkëshortore të rregullt. Ajo e mbështeste fort moralisht në krijimin e ‘fëmijës’ së tyre – librit mbi të cilin ai po punonte, që ishte një manifesto mbi të ardhmen e shoqërisë, ndoshta punimi më i mirë i tij. Por Lëvborgu ose ishte i pandreqshëm, ose ishte kollaj i manipulueshëm, përderisa Hedda e risjell atë në gjendjen e tij të mëparshme imorale, të shturur dhe të alkoolizuar.

Ambicja dhe xhelozia e Hedda Gablerit

Hedda ishte xheloze për çdo arritje të Lëvborgut, pasi ajo e shihte veten të porealizuar në jetën e saj, meqë nuk ka patur kurajon të veprojë gabim. Vendosja monstroze e bërjes gabim të gjërave si përmbushje e një ideali vetjak dhe vendosja e gabusit në rolin e heroit përbën një tjetër konflikt të brendshëm tek Hedda. Të veprave gabim ishte të veprave kundër normave të moralit shoqëror të kohës, duke vënë në pedestal dhe mbi çdo gjë dëshirat apo aspiratat e brëndshme të individit. Ajo ishte xheloze edhe për Znj. Elvsted që kishte patur forcën të bënte pjesë të jetës së saj një burrë si Lëvborgu dhe ta kthente atë në një gjeni. Xhelozia e saj shfaqej, fillimisht, si një kureshtare e vogël për atë çfarë po ndodhte mes çiftit, duke rrëmuar në privatësinë e Teas (Znj. Elvsted) dhe, kur ajo vëren se çdo gjë po shkonte për bukuri, xhelozia e saj merr tjetër trajtë: atë të ambicjes së shfrenuar dhe të hakmarrjes ndaj asaj që mund ta kishte patur për vete vetëm sikur.... sikur të kishte vepruar gabim siç duhej.

Ajo çfarë dëshironte Hedda ishte autonomia etike dhe vetërealizimi i saj, që rrethohej nga konvencionet sociale, por që ofronte potencialin e duhur për të negociuar mbi hapësirën kuptimplotë të jetës për të. Personazhi i Heddas, si dhe personazhe të tjerë të Ibsenit, mishërojnë modernizmin dhe vetë thelbin e kësaj rryme si një ‘liri subjektive’²¹⁰; por, krahasuar me dëshirën e tyre për këtë liri, konflikti i brendshëm i Heddas është i pazgjydhshëm ndryshe nga liria e vetëfituar e Norës tek *Shtëpi Kukulle*. Nëse marrim në konsideratë hapësirën e identitetit të saj, vërejmë se janë figura mashkullore që e rrethojnë aq fort, saqë ajo ndien se po i marrin frymën dhe lirinë subjektive të cilën ajo po kërkon të ndërtojë. Fakti që Hedda është e bija e të atit, gjeneral, bie dukshëm në sy edhe nga tetot e të shoqit të cilat ia shprehin që në fillim të dramës admirimin e tyre për sërën e saj: “Epo, sigurisht. E bija e gjeneralit Gabler. Çfarë jete ka bërë ajo në ditët e gjeneralit! Mbaj mend që e shihja kur dilte me të atin – se si shkonte me hap të shpejtë me atë kostum të zi kalërimi, me një pupël në kapelen e saj?”²¹¹

²⁰⁹ Williams, Riamond. 1983 (1968). *Drama from Ibsen to Brecht*. Revised Edition, reprinted. Penguin Books and Chatto & Windus. p. 63 (përkth. im)

²¹⁰ Holleridge & Tompkins 2000, p. 21. Lidhur me lirinë subjektive nga Habermas, 1987, 83: “hapësira e siguruar nga kodi civil për kërkimin racional të kërkesave të individit: në shtet, si dhe në të drejtat e parimeve të barabarta për emancipimin në formimin e vullnetit politik; në sferën private si autonomi etike dhe vetërealizim.” Vep. Cit. Holleridge, Julie & Joanne Tompkins 2000. *Women’s Intercultural Performance*. London, Routledge. (përkth. im)

²¹¹ Ibsen. *The Complete Major Prose Plays*. Trans. Rolf Fjelde. New York: New American Library, 1978. pp. 696 (përkth. im)

Personazhi tjetër femër që e kishte spikatur me kohë të bijën e gjeneralit, ishte Tea Elvsted, ish shoqja e saj e shkollës, e cila nuk nguron t'i shfaqë dobësinë që kishte ndaj Heddas. Tea pranon se e kishte patur frikë që në shkollë Heddan, kur ia shkulte flokët dhe e kërcënonte se do t'ia digjte bashkë me kokën. Këtu del në pah rebelizmi i Heddas si dhe dëshira e hershme e saj për të mbizotëruar të tjerët dhe, sakaq që kupton se është superiore ndaj Teas, shfrytëzon dobësinë e saj për të marrë vesh çdo gjë që i intereson kureshtjes së saj në lidhje me Lëvborgun nga i cili dukshëm ishte e tërhequr. Ajo gjithashtu manipulon sjelljet e Lëvborgut për të shprehur haptas fuqinë që ka mbi të.

Dëshira për mbizotërim dhe hakmarrje

Përveç se e bija e gjeneralit, në atë periudhë ishte edhe vajza e cila refuzoi Lëvborgun për të futur veten në një situatë të re e aspak të kënaqshme për të, si bashkëshortja e Tesmanit. Tesmani ishte komplet indiferent ndaj ndjenjave dhe dëshirave të Heddas dhe ky zhgënjim i Heddas përbën motivin e zhgënjimit të saj, me përplasjen e një natyre pasionante si Hedda me një bashkëshort formal e të kotë si Tesman. Ajo mendon se e ka trashëguar ose, në të kundërt, dëshiron të zotërojë atë pushtet që kanë meshkujt për të mbizotëruar të tjerët në të gjitha format e mënyrat, duke harruar e lënë mënjanë zotësinë e saj femërore për të shijuar e zotëruar në formën e vet atë hapësirë subjektive që e rrethon. Ajo është një protagoniste femër dhe fati i saj është i lidhur me trupin e saj femëror. Duke i treguar pistoletat e të atit Lëvborgut si dhe gjykatësit Brak më pas, ajo në një farë mënyre tregon se nuk është thjesht dëshira për të qenë e fortë, trime e guximtare si i ati, por ama shpreh dëshirën për të përdorur fuqinë mashkullore për të shkatërruar fuqinë mashkullore. Në këtë kontekst, Elin Diamond vëren se: "ajo ka veçanërisht fuqinë e specifikimit gjinor të cilën i ati, Lëvborgu dhe Tesmani kërkojnë në emër të heteroseksualitetit normativ. Hedda kapet midis mitrës së fryrë të së ëmës dhe pistoletave të të atit dhe nuk mund të identifikohet me asnjërin prej tyre."²¹² Gruaja stereotipike e respektueshme nuk kishte asnjë lidhje me Heddan, pasi ajo kufizohej me rolin e zonjës dhe nënës në konvencioet shoqërore të kohës. Ndërsa 'hapësira e identitetit' të Heddas ishte e diktuar nga të tjerët dhe finalja e saj ishte si një lloj kompromisi: shlyerja e sjelljes së saj të dobët dhe mohimi i lirisë subjektive, në pamundësi për ta arritur atë.

Në këtë lexim të Diamond, mund të analizojmë se për Heddan, tashmë, hapësira e saj subjektive ngjan me mitrën e së ëmës ku është formuar, por që nuk mund të shkëputet para kohe prej saj. Në të njëjtën mënyrë konsiderohet edhe shtëpia e saj që ndan me Tesmanin, një rreth vicioz nga i cili nuk mund të dalë veçse në atë mënyrë tragjike që pati. Fuqia e saj për të përballuar mendërisht çdo mashkull që e rrethonte filloi të binte, sidomos, kur Lëvborgu u rikthye në jetën e saj duke e quajtur një frikacake dhe dështake, përderisa zgjodhi të martohej me Tesmanin. Hedda paraqitet nga Ibseni si një personazh kompleks edhe mendërisht, pasi veprimet e saj nuk janë pasuese të njëra - tjetrës, sjellja e saj është e pashpirt, persekutimi mendor që i bën të gjithëve përreth saj është i pakuptimtë dhe pa ndonjë qëllim të veçantë dhe, në fund, vetëvrastja e saj është pa ndonjë motiv të fortë.

Lidhja dhe zgjidhja e konfliktit

²¹² Diamond, Elin. *Unmaking mimesis: essays on feminism and theatre*. London & New York. Routledge, 1997. pp. 26-27 (përkth. im)

Ndoshta Hedda dëshironte më shumë të kishte fuqinë e një burri për t'u përballur me një burrë, kërkonte të sfidonte frikën e brendshme që ka parë tek burrat e jetës së saj. Ajo projektonte sfidën e saj si një shkatërrim të armikut të përjetshëm të femrës, por vetëm Lëvborgu mund ta përballojë atë me kurajo në zemrën e tij. Ajo ka mall dhe nostalgji për të dhe për të kaluarën e tyre dhe është e vetmja gjë që mund të fitojë admirimin e saj, pasi është i vetmi person me një zemër pasionante në gjendje të joshë natyrën e saj shpërthyes.²¹³ Tërheqja e vetme e saj ndaj tij, është mundësia për ta shkatërruar atë fizikisht ose shpirtërisht, vetëm duke hedhur fjalën magjike mbi të dhe ta asgjësojë duke shndërruar gjithë atë mall e pasion në xhelozie dhe urrejtje deri në kulmin e vet. Ajo zgjedh ti kundërvihet Lëvborgut, duke bërë xhelozie Tean dhe djeg librin e tij, duke përmbushur kënaqësinë e saj në shkatërrimin moral të Lëvborgut. Në shkatërrimin e tij fizik, përveç pistoletave, ajo përdor edhe fjalët, siç u tha më lart, por tashmë me Lëvborgun, ku i kërkon të vrasë bukur veten si e vetmja gjë dinjitoze që mund të kishte bërë ndonjëherë në jetën e tij.

Nga ana tjetër, Tea arrin të kuptojë se çfarë është Lëvborgu në të vërtetë dhe nuk bën gjë tjetër veçse, së pari e mëshiron kur merr vesh fundin e tij tragjik dhe, së dyti, e respekton për punën e tij në shkrimin e librit duke mbledhur dorëshkrimet e tij bashkë me Tesmanin dhe duke u munduar të rindërtojë librin e humbur. Ky libër i humbur ishte djegur nga Hedda në shenjë xhelozie dhe përçmimi për punën e Lëvborgut, pasi ajo e konsideronte atë të aftë për asgjë. Në këtë situatë, ajo nuk vëren fare se çfarë po ndodh me Tesmanin, i cili po anon gjithnjë e më tepër në shoqërimin e tij me Tean. Ndërkohë, edhe Tesmani ishte duke u mbështetur krejt lirisht tek aftësitë e Teas mbi librin, por ndoshta pa e menduar mund të shkonin dhe më tej. Pengesa e vetme e konkretizimit të lidhjes së tyre ishte se Hedda nuk i dha kohë as këtyre e as gjykatësit Brak të shkelin mbi dinjitetin e saj të copëtuar.

Rebelimi i saj në kërkim të dinjitetit të thyer arrin kulmin në përballjen me Brakun. Ai e shantazhon dhe përpiqet ta manipulojë dhe të përfitojë nga frika e saj për zbulimin e të vërtetës. Ai i ofron heshtjen e tij në këmbim të kënaqësive epshore që pretendonte prej saj. Në fakt, Hedda edhe pse e përçmonte Brakun për këtë, i ishte mirënjohëse për lajmin që i solli mbi vrasjen e Lëvborgut. Ajo çfarë Hedda nuk mund të binte kurrë në kompromis ishte skllavërimi i saj ndaj dëshirave dhe vullnetit të tij, mbajtja peng e saj nga njohja e fakteve prej tij. Në asnjë rrethanë Hedda nuk mund të bëhej pre e këtij shantazhi të ulët dhe, duke përmbushur atë që nuk mundi ta bënte bukur Lëvborgu, ajo e bëri me veten e saj; e qetë tashmë se edhe Lëvborgun e saj të dashur nuk e kishte në mes të kësaj shoqërie të paskrupullt në mes të rrënimin të vlerave dhe lirive të individit. Ajo, më në fund, pati kurajon të veprojë një herë siç duhet gabim dhe të godasë në shenjë një herë e mirë lirinë e saj subjektive të cilën nuk arriti ta ndërtojë mes konvencioneve të shoqërisë së kohës.

Përfundime

Me dramën *Hedda Gabler*, Ibseni tregon aftësinë e tij analitike në përzgjedhjen e admirueshme të personazheve rreth protagonistes, duke i vënë asaj një baba të rreptë, një bashkëshort të paaftë, një shoqe të dobët, një dashnor të paskrupullt dhe një admirues përfutues që e shantazhon. Personazhet mbi të cilët ai operon dhe çështjet jetike mbi të

²¹³ Lee, Jennette. *The Ibsen Secret: A Key to the Prose Drama of Henrik Ibsen*. New York: G.P. Putnam's Sons, 1910. pp. 20-36. (përkth. im)

cilat ai i shtron këta personazhe janë e kundërta e personazhit heroik që ne presim në një vepër. Madje, këta personazhe paraqiten si njerëz të vobektë në brendësinë e tyre dhe me egoizëm për kohëzgjatjen e veprimeve të tyre. Mes ndërlidhjes së këtyre personazheve, drama pati efektin e të gozhduarit të spektatorit në teatër, ku nuk donte t'i shpëtonte asnjë fjalë dhe asnjë veprim, duke qëndruar kështu në një gjendje të vazhdueshme - po aq edhe të dhimbshme – të suspansës.²¹⁴ Suspansa rritet me dy vrasjet në fund të dramës që mbartin në vetvete një moral të thellë: me vetëvrasjen e Lëvborgut dhe Heddas, Ibseni paraqet triumfin që ka fuqia e së keqes mbi dobësinë e së mirës dhe përzgjedhjen e saj të hollë të tipit modern ngjethës.

Literatura:

Ibsen, *Tragedy and the Tragic – Ibsen Conference in Athens 2002*. Edited by Astrid Seather. Center for Ibsen Studies, University of Oslo, July 2003. Article by Panos Katagiorgos, Corfu. Title: The earliest Greek appraisal of Ibsen by the poet Georgios Vizyinos.

Henrik Ibsen: "*Speech to the Norwegian Students, September 10, 1874*," *Speeches and New Letters*, translated by Arne Kildal (Boston. Richard G. Badger, 1910)

Steiner, George. 1982 (1961). *The Death of Tragedy*. London, Faber and Faber.

Williams, Riamond. 1983 (1968). *Drama from Ibsen to Brecht*. Revised Edition, reprinted. Penguin Books and Chatto & Windus.

Holleridge, Julie & Joanne Tompkins 2000. *Women's Intercultural Performance*. London, Routledge.

Ibsen. The Complete Major Prose Plays. Trans. Rolf Fjelde. New York: New American Library, 1978.

Diamond, Elin. *Unmaking mimesis: essays on feminism and theatre*. London & New York.

Lee, Jennette. *The Ibsen Secret: A Key to the Prose Drama of Henrik Ibsen*. New York: G.P. Putnam's Sons, 1910.

From an unsigned notice, The Times. 21 April 1891, 10.

Recensent:

Prof. Dr. Josif Papagjoni, Akademik

E-mail: josifpapagjoni@yahoo.com

²¹⁴ *From an unsigned notice*, The Times . 21 April 1891, 10. Aritkulli doli për shtyp të nesërmen e shfaqjes *Hedda Gabler* në Vaudeville Theatre, 20 Prill 1891 (përkth. im)

MODERNITETI I NDËRPRERË NË POEZINË E VITEVE '70: MOIKOM ZEZO

Prof. dr. Sali Bytyçi

Hyrje

Poezia e sotme shqipe, e krijuar në Shqipëri gjatë kohës së diktaturës, kishte raporte të çuditshme me censurën: herë i nënshtrohej asaj, herë e kundërshtonte, por vazhdimisht si hije ishte e përcjellë nga censura.

Pas poezisë së viteve '60, të cilës i dhanë tonin poetë si Ismail Kadareja, Dritëro Agolli, Fatos Arapi etj., në dekadën në vijim, poezia e krijuar në Shqipëri bëri përpjekje të shkonte përtej; të bëhej zë i subjektit lirik i cili e shihte ndryshe botën. Deri në këtë kohë ky subjekt lirik veten e kishte parë përmes botës, pikëvështrim që me poezinë e të lartpërmendurve ishte kthyer në një klishe letrare, tani kishte ardhur momenti të bëhej e kundërta, pra bota të vështrohej përmes pikëshikimit të subjektit lirik. Kështu, në fillimvitet '70 nisi të përvijohet një frymë e re që binte ndesh me frymën zyrtare të poezisë që ishte krijuar deri në këtë kohë, por edhe që vazhdonte të krijohej më tej. Poetët që e nisën këtë rrugëtim të ri dhe të cilët u ballafaquan me censurën ishin: Fatos Arapi, Moikom Zeqo, Thanas Dino, Xhevahir Spahiu, Frederik Rreshpja, Faslli Haliti, Viktor Qurku, Sadik Bejko etj. Në këtë kohë ka krijuar edhe Zef Zorba, por nuk ka botuar deri në vitet '90.

Kjo poezia, e shkruar në periudhën 1970-1973, është bashkëkohore me poezinë moderne, të krijuar jashtë Shqipërisë, por përpjekja e saj, që të tejkalonte praxisin e poezisë shqipe të deri kësaj kohe, që edhe ia arriti deri diku, ishte fatale, sepse dora e dhunshme e pushtetit e ndërpreu, duke mos e lënë të zhvillohej më tej.

Profili krijues i Moikom Zeqos

Para se të botonte ciklet me poezi moderne në vitet '70, Moikom Zeqo kishte botuar edhe dy vëllime poetike, "Vegime të vendlindjes" (1968) dhe "Qyteti Feniks" (1970), në të cilat shpërfaqej individualiteti i tij i veçantë krijues, por i cili shpërthen kryesisht në poezinë që e shkruan pas tyre.

Poezia e Zeqos, e shkruar në këtë kohë, shkëputet nga poezia zyrtare së cilës edhe i dhe i kundërvihet; ngjyrat e errëta, ankthi, trishtimi krijojnë atmosferën e këtyre poezive; mitikja dhe modernia gërshetohen, ndërsa imazhet surrealistike, simbolet dhe metamorfozat janë disa nga veçantitë që e shenjojnë poetikën dhe estetikën e poezisë së tij. "Kualitativisht te kjo poezi janë ngjizur në mënyrë të pastër e origjinale tiparet e lirikës bashkëkohore evropiane, kategori estetike të imazhit dhe vizionit spektral, çka e

bën këtë poezi të jetë, larg ajrit të vjetruar provincial”,²¹⁵ kështu e ka karakterizuar Agron Tufa, poezinë e Moikom Zeqos të viteve '70.

Zeço i kthehet mitit kombëtar dhe baladave popullore, ai është poet i bregoreve të detit dhe i limonëve që i stolisin ato; poet i erës së jugut, por edhe i antikitetit. As subjekti lirik i poezisë së tij, po as gjuha, as figuracioni, as harmonia e tij me botën dhe shoqërinë, nuk janë të realizmit socialist. Shkurt, poezia e Zeqos është e krijuar sipas poetikës moderne. Të gjithë përbërësit e saj të çojnë në këtë konkluzion.

Përmbysja e estetikës së realizmit socialist

Në kohën kur poezia, po edhe krejt letërsia shqipe, ishte e mbushur me një fjalor pozitiv, me të cilin shprehej optimizmi për perspektivën e ndritshme të shoqërisë së re, ku hapësira dridhej nga zhurma e zërave të njerëzve, subjekti lirik i poezisë së Moikom Zeqos refuzon komunikimin me jashtë. Ai është një qenie anonime, jeton në një botë të padefinuar, ekzistenca e tij nuk ka qëllim etj.:

Është bota pa emra,

ku ti s'ke emër,

s'di pse ke lindur, ekzistencë pa qëllim.²¹⁶

Ky subjekt mbyllet në vete, refuzon komunikimin me jashtë; në shenjë mospajtimi me të, por edhe në shenjë vetëmbrojtjeje nga rreziqet që i vijnë prej saj:

Mos më folë të lutem mos më folë!

Fantazma hamletiane më janë fjalët në ëndërr

(Mos më fol)²¹⁷

Përse mbyllet në vete subjekti lirik i poezive të Moikom Zeqos, në kohën kur shumica e poetëve shqiptarë i këndonin kohës së madhe të partisë, zhvillimit të teknologjisë, arritjeve të reja në industrializimin e vendit? Arsyen e kësaj mbylljeje e zbulojmë përmes dekodimit të fjalorit shekspirian, personazheve të Shekspirit dhe shprehjeve që i hasim në këtë poezi, kryesisht ato nga tragjedia “Hamleti”, si: fantazma hamletiane, kumti i orakujve etj. Pra, Shqipëria e subjektit lirik dhe Danimarka e Hamletit këtu vihen përballë, ndërsa jeta e subjektit lirik të kësaj poezie zhvillohet në analogji me jetën e Hamletit.

Të gjithë e dinë fatin e Hamletit.

Hamleti bir mbreti, student i cili para vetes ka jetën, por që e gjithë kjo shprehet kur atij i paraqitet fantazma e babait të tij të vdekur, e cila i tregon se vdekja e tij nuk ishte e natyrshme. Ashtu si Hamleti, edhe subjekti lirik i poezisë së Zeqos, të gjitha ato që nuk i mëson nga realiteti, i mëson nga ëndërra, kur fjalët i shndërrohen në fantazma hamletiane. Kur i lexojmë këto vargje, nëpër kokë na sillen thëniet nga tragjedia e Shekspirit “Hamleti”: Të rrosh apo të mos rrosh, është çështja; bota që u prish dhe Hamleti duhet ta ndreqë etj. Këtu zotëron një realitet i rremë, i cili, për t'u shprehur, mjafton një shkëndijë; pra është i njëjti realitet me atë të tragjedisë “Hamletit”.

Pra, sikur në tragjedinë e Shekspirit, edhe në këtë poezi, dominon vdekja; kur ajo është regjisore e dramës që quhet jetë, dihet fati i personazheve të saj.

²¹⁵ Cituar sipas: Moikom Zeqo, Meduza. “Onufri”, Tiranë 1994, f. 168.

²¹⁶ Moikom Zeqo, Meduza (Poezi 1970-1974). “Onufri”, Tiranë 1995, f. 12.

²¹⁷ Po aty, f. 23.

Si përfundim, nëse vepra prej së cilës i ka nxjerrë poeti këto figura që i përmendëm më lart është tragjedi, dihet fundi i subjektit lirik të kësaj poezie. Përfundimi me disfatë, është në analogji me fatin e Hamletit:

Me kafkën time në duar endem,
me ankthin sartrian e them dhe sentencën-
bëj të ringjallem e... abortoje vetveten!²¹⁸

Në çdo varg të poezisë së Zeqos kemi një përmbyesje të estetikës së realizmit socialist. Për subjektin lirik të kësaj poezie, pas ndarjes, "fjalët janë Afërdita të thyera, trena të përmbyesur nga shinat" (Mbas ndarjes),²¹⁹ por ky subjekt është edhe Krishti i fjalës:

Në kishën e artë e të pafund të vjeshtës
unë Krishti i fjalës kryqëzohem tani...
(Vjeshta e dhimbjes)²²⁰

Në poezinë e Zeqos, të krijuar në gjysmën e parë të viteve '70, fjala është një kalë i cili ia merr kohës lëvizjen, për ta dërguar subjektin lirik te dritarja e yllit (Për të mbërritur).²²¹

Subjekti lirik-identiteti

Ndërsa në poezinë zyrtare të kohës subjekti lirik identifikohet me klasoren, në poezinë e Zeqos ky subjekt identifikohet me kombëtaren. Ai botën e sheh përmes identitetit vetjak, i cili është edhe identiteti i komunitetit të cilit i takon, identiteti i popullit të tij. Shenja me të cilat identifikohet ky janë baladat, qytetet antike, Rozafa, e cila është "metaforë prej guri" etj.: "Metaforë popullore prej guri/ E gjakut tonë dhe jetës" (Rozafa).²²²

Ky subjekt është i lidhur me emrin e tij; është sa real po aq edhe mitik; lëviz në thellësi (në të shkuarën). Pra nuk është një qenie që lëviz në kohën e madhe të Partisë, nuk lëviz në sipërfaqe, po në thellësi:

Lëviz vertikalisht, emrin s'e jap,
se prapë i dyzuar ngrihem prej ëndrrës
gjigant i nëndheshëm legjende.
(Prej dheu jam)²²³

Ndërsa vazhdon jetën, ushqimin e merr nga vetvetja, pra është qenie që nuk ushqehet nga e huaja. Këtu "e huaj" mund të konsiderohet ideologjia që ishte në fuqi; ky subjekt lirik ushqehet nga vetja, nga e kaluara e tij, e cila përbën edhe trupin shpirtëror të tij:

Ushqehem për gjithë shekujt që vijnë
duke ngrënë e ripërtypur trupin tim!
(Vetëm)²²⁴

Vetmia, trishtimi, mërzia

Ky subjekt është dy herë i izoluar: ai, nga jashtë, jeton në një ishull të largët, por ai në të njëjtën kohë është i izoluar edhe nga brenda, pra dy herë i izoluar. Jeton në ishull, por edhe vetë është një ishull:

²¹⁸ Po aty, f. 23.

²¹⁹ Po aty, f. 42.

²²⁰ Po aty, f. 91.

²²¹ Po aty, f. 5

²²² Moikom Zeqo, Brenda vetes. "Rilindja", Prishtinë 1974, f. 13.

²²³ Moikom Zeqo, Meduza. "Onufri", Tiranë 1994, f. 80.

²²⁴ Po aty, f. 105.

Dhe ti thinjesh si Robinsoni,
jo vetëm në një ishull të izoluar të largët:
po dhe brenda vetes tënde mbyllur.

(Shpjegimi i fjalës vetmi)²²⁵

I vetmuar si Robinsoni, me ankthin sartrian në shpirt, një fantazmë që sillet hamletiane ja “dekori” në të cilin gjendet subjekti lirik i poezisë së Zeqos. Ky subjekt lirik më shumë është Hamlet dhe Faust, në të njëjtën kohë, por edhe një Robinson i vetmuar:

Në sfond Sahara dhe piramidat

Jam vetëm. Më tmerron vetmia (bile më tepër
se vdekja)

(Kënga e Urës së Qabesë)²²⁶

Tonet trishtuese e përcjellin subjektin lirik të poezive të Moikom Zeqos kur trishtimi ishte i ndaluar zyrtarisht:

Ku të futem Trishtim? me lëkurën time
u bëj metaforave një çati!

(Çast në muzg)²²⁷

Po ashtu edhe grotesku zë një vend të gjerë në poezinë e Moikom Zeqos. Çamçakezi i reve që mbllaçitet nga yjet ose një botë që mbllaçit vetveten, duke u kthyer në një çamçakëz universal (Çamçakëz),²²⁸ ose një kohë e marrëzishme mbyty ditët si Medea fëmijët! (Koha).²²⁹ Në një poezi tjetër koha përfytyrohet si një shpend vigan:

Koha është një shpend vigan,
një krah i saj dita, tjetra nata.

Krau, klith – unë i jap mishin tim
ndryshe fluturimi s’vazhdon.

Krau, krau – një skelet në kozmos fluturon!

(Koha)²³⁰

Përfundim

Izolimi i letërsisë së krijuar në Shqipëri nga zhvillimet artistike bashkëkohëse jashtë saj, në gjysmën e dytë të shekullit të njëzetë, ka qenë më i theksuar se në kohën e sundimit otoman apo gjatë periudhës së monarkisë. Fare të paktë ishin shkrimtarët shqiptarë që kishin privilegjin të dalin jashtë shtetit, të takonin ndonjë shkrimtar të huaj, të gjallë, të merrnim në dorë botimet e letërsisë moderne.²³¹ Megjithatë, në bibliotekën e Tiranës kanë ardhur botime të huaja, të cilat mund të lexoheshin me autorizime të posaçme.²³²

Poezia e tij është shumështrësore. Kjo poezi edhe pse edhe sot e kësaj dite nuk është studiuar sa duhet, që në kohën e krijimit të saj është karakterizuar qartë, edhe pse armiqësisht, nga kritika zyrtare: “Tipar themelor dallues i këtyre krijimeve ishte largimi i patosit qytetar, zëvendësimi i heroit të ditës me një ‘un’ individualist, abstrakt e shoqërisht të papërcaktuar. (.....) U botuan poezi (.....) me përmbajtje të errët (hermetike) apo pa kurrfarë brendie; filloi të ishte në modë tema e vogël individualiste,

²²⁵ Po aty, f. 12.

²²⁶ Moikom Zeqo, Brenda vetes, f. 11.

²²⁷ Po aty, f. 105.

²²⁸ Po aty, f. 62.

²²⁹ Po aty, f. 150.

²³⁰ Po aty, f. 85.

²³¹ Dr. Anton Papeleka, Kodi i metaforave. “Globus R.”, Tiranë f. 108.

²³² Po aty, f. 108.

tema nostalgjike nga e kaluara e largët (qytete antike, statuja, zhvarrime antike)) etj. tema e mallit të trishtuar (për fëmininë, plazhet, fiqtë e detit, vjeshtën, dashurinë e humbur etj), apo tema filozofike abstrakte (koha, lëvizja, njeriu, jeta, vdekja etj.). disa poezi e humbën lidhjen me realitetin, ato u zhvilluan mbi një plan abstrakt, jashtë kontekstit shoqëror bashkëkohor. (.....) Figura humbiste karakterin konkret dhe lidhjet me logjikën e sendeve; fitoi terren animizmi i theksuar në ndërtimin e tyre”.²³³ Të gjitha ato që kjo kritikë i regjistronte si vese të kësaj poezie, ishin pikërisht virtyte të saj, përmes së cilave krijuesit e kundërshtonin atë zgjedhë që i ishte vendosur artit të tyre. “Është hera e parë që poezia shqipe harmonizohet me koordinatat e bashkësisë së poezisë moderne. Është hera e parë që poezia shqipe universalizohet, duke sublimuar jo vetëm teknikat dhe poetikat e përparuara, por duke artikulluar fuqishëm edhe kredencialet kombëtare dhe shpirtërore”.²³⁴ Por ishte grushti i fortë i pushtetit ai që e ndërpreu prirjen moderne të poezisë shqipe, e cila sidomos në gjysmën e parë të viteve '70 kishte dhënë shenja të fuqishme drejt ngritjes së saj dhe përballjes me letërsinë zyrtare të realizmit socialist. Pas Plenumit të Katërt të Komitetit Qendror (qershor 1973) ishte krijuar një atmosferë e rëndë, botoheshin vetëm vargje folklorike ose vjersha të thata për nga figuracioni dhe metaforzmi, sepse pas çdo fjale kërkohet 'ujku ideologjik', shkurt poezia ishte kthyer në vargëzim që s'kishte të bënte me poezinë.²³⁵

²³³ Stavri Pone, "Novatorja dhe pseudonovatorja", cituar sipas librit "Probleme aktuale të traditës dhe të novatorizmit në letërsinë shqiptare të realizmit socialist", shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë 1975, f. 128.

²³⁴ Moikom Zeqo, "Poezia e viteve '70 në Kosovë ishte ndryshimi më i madh konceptual dhe shkëlqimi më i lartë estetik" (në librin "Pavdekësia e poetit" të Smajl Smakës, botoi "SMS", Prishtinë 2012, f. 186.

²³⁵ Bardhyl Londo, Jeta që na dhanë, f. 184.

RRETH DISA PIKËTAKIMEVE MIDIS SHQIPES DHE RUMANISHTES

Mr. Sc. Sejdi M. Gashi

Instituti Albanologjik-Prishtinë

e-mail: sejdi.iap@hotmail.com

Qëllimi i punës sonë në këtë punim me titull “*Rreth disa pikëtakimeve midis shqipes dhe rumanishtes*”, para se gjithash është që të bëhet krahasim midis këtyre dy gjuhëve dhe në këtë kontekst të vihen në pah pikëtakimet ndërmjet tyre, dy gjuhë këto pjesë e trungut të familjes indoevropiane.

Siç dihet, shqipja bën pjesë në grupin e gjuhëve indoevropiane, ku futen gjuhët indoiranike, greqishtja, gjuhët romane, gjuhët sllave, gjuhët gjermane, etj., por problemi i origjinës së saj (shqipes) edhe sot debatohet në shkencën gjuhësore, ndonëse vite më parë është arritur të vërtetohet se burimi i shqipes, pa dyshim, është prej njëres nga gjuhët e lashta të Gadishullit të Ballkanit, ilirishtes ose trakishtes²³⁶. Në literaturën gjuhësore qarkullojnë dy teza themelore për origjinën e shqipes: teza e origjinës ilire dhe ajo e origjinës trake, derisa e parë (ajo ilire), ka gjetur mbështetje më të gjerë bazuar në faktet historike dhe gjuhësore. Kjo hipotezë është formuar që në shekullin XVIII, kryesisht në rrethet e historianëve.

Përpjekjen e parë shkencore për të shpjeguar origjinën e shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre, e bëri historiani suedez Johann Erich Thunman në veprën e tij “*Untersuchungen über die Geschichte der Östlichen europäischen Völker*”, Leipzig 1774²³⁷. Ai, duke u mbështetur në burime historike latine e bizantine dhe në të dhëna gjuhësore e onomastike, arriti në përfundimin se shqiptarët janë vazhduesit autoktonë të popullsisë së lashtë ilire, e cila nuk u romanizua siç ndodhi me popullsinë trako-dake, paraardhëse të rumunëve.

Teza e origjinës ilire të shqiptarëve është mbështetur edhe nga albanologu i mirënjohur austriak Johannes Georges von Hahn në veprën e tij “*Albanesische Studien*”, publikuar më 1854, por edhe nga historianë dhe studiues të tjerë që, natyrisht nuk janë ta paktë.

Që nga ajo kohë deri në ditët tona, një varg dijetarësh të shquar historianë, arkeologë e gjuhëtarë, kanë sjellë duke plotësuar njeri-tjetrin, një sërë argumentesh historike dhe gjuhësore, që mbështesin tezën e origjinës së shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre. Disa nga këto argumente themelore, janë:

²³⁶ Aleks Buda, “*Etnogjeneza e popullit shqiptar në dritën e historisë*”, Konferenca Kombëtare për formimin e popullit shqiptar, Tiranë, 1988, fq.24.

²³⁷ J. Thunmann “*Untersuchungen über die Geschichte der Östlichen europäischen Völker*” Leipzig 1774, fq.124.

Shqiptarët banojnë sot në një pjesë të trojeve, ku në periudhën antike kanë banuar fise ilire, nga ana tjetër në burimet historike nuk njihet ndonjë emigrim i shqiptarëve nga vise të tjera për t'u vendosur në trojet e sotme.

2. Një pjesë e elementeve gjuhësore: emra sendesh, fisesh, emra njerëzish, glosa, etj., që janë njohur si ilire, gjejnë shpjegim me anë të gjuhës shqipe.

3. Format e toponimeve të lashta të trojeve ilire shqiptare, të krahasuara me format përgjegjëse të sotme, provojnë se ato janë zhvilluar sipas rregullave të fonetikës historike të shqipes, d.m.th kanë kaluar pa ndërprerje nëpër gojën e një popullsie shqipfolëse.

4. Marrëdhëniet e shqipes me greqishten e vjetër dhe me latinishten, tregojnë se shqipja është formuar dhe është zhvilluar në fqinjësi me këto dy gjuhë në brigjet e Adriatikut dhe të Jonit.

5. Të dhënat arkeologjike dhe ato të kulturës materiale e shpirtërore, dëshmojnë se ka vijimësi kulturore nga ilirët antikë te shqiptarët e sotëm.

Fillimet e shkrimit të shqipes

Para se të përiqemi të tregojmë për bashkëpërkimet ndërmjet shqipes dhe rumanishtes, e shohim të udhës që të japin një vështrim të shkurtër kronologjik rreth shqipes së shkruar dhe zhvillimit të saj nëpër faza.

Shqipja është një nga gjuhët e lashta të Ballkanit, por e dokumentuar me shkrim mjaft vonë, në shekullin XV, ashtu si rumanishtja.²³⁸

Dokumenti i parë i shkruar në gjuhën shqipe, është ajo që quhet "Formula e pagëzimit", e vitit 1462. Është një fjali e shkurtër në gjuhën shqipe "Unte paghesont premenit Atit et birit et spertit senit"²³⁹, që gjendet në një qarkore të shkruar në latinisht nga Kryepeshkopi i Durrësit Pal Engjëlli, bashkëpunëtor i ngushtë i Skënderbeut.

Ky dokument është gjetur në Bibliotekën Laurentiana të Milanos nga historiani i njohur rumun Nikolla Jorga dhe është botuar prej tij në vitin 1915 në "Notes et extraits pour servir l'histoire des croisades au XV siecle IV".

Dokumenti i dytë, i shkruar në gjuhën shqipe është "Fjalorthi i Arnold von Harfit", i vitit 1496.²⁴⁰ Udhëtari gjerman Arnold Von Harf, nga një fshat i Këlnit, në vjeshtë të vitit 1496, ndërmori një udhëtim pelegrinazhi për në "vendet e shenjta". Gjatë udhëtimit kaloi edhe nëpër vendin tonë, gjatë bregdetit, duke u ndalur në Ulqin, Durrës e Sazan dhe për nevoja praktike të rrugës shënoi 26 fjalë, 8 shprehje dhe numërorët 1 deri më 10 dhe 100 e 1000, duke i shoqëruar me përkthimin gjermanisht. Ky Fjalorth u botua për herë të parë më 1860 në Këln, nga Edvin.von Grote.²⁴¹

I fundit të shekullit XV ose i fillimit të shekullit XV është edhe një tekst tjetër i shkruar në gjuhën shqipe dhe i gjendur brenda një dorëshkrimi grek të shekullit XIV në Bibliotekën Ambrosiana të Milanos. Teksti përmban pjesë të përkthyer nga Ungjilli i Shën Mateut, etj. Ai është shkruar në dialektin e jugut dhe me alfabet grek. Ky tekst i shqipes i shkruar, njihet në literaturën shqiptare me emrin "Ungjilli i Pashkëve".

²³⁸ Shaban Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Prishtinë, 1989, fq.248.

²³⁹ Po aty.

²⁴⁰ Po aty.

²⁴¹ www.google.com/wikipedia (30.05.2009).

Këto dokumente nuk kanë ndonjë vlerë letrare, por paraqesin interes për historinë e gjuhës së shkruar shqipe. Shqipja, që në fillimet e shkrimit të saj, dëshmohet e shkruar në të dy dialektet, në dialektin e veriut (gegërisht) dhe në dialektin e jugut (toskërisht), si dhe me dy alfabetet, me alfabetin latin dhe me alfabetin grek, gjë që tregon se kultura shqiptare ishte njëkohësisht nën ndikimin e kulturës latine dhe të kulturës greko-bizantine.

Libri i parë i shkruar në gjuhën shqipe, që njohim deri më sot, është "Meshari" i Gjon Buzukut, i vitit 1555, i cili shënon edhe fillimin e letërsisë së vjetër shqiptare. Nga ky libër, na ka arritur vetëm një kopje, që ruhet në Bibliotekën e Vatikanit. Libri përmban 220 faqe, të shkruara në dy shtylla.²⁴²

"Meshari" i Gjon Buzukut është përkthimi në shqip i pjesëve kryesore të liturgjisë katolike, ai përmban meshet e të kremteve kryesore të vitit, komente të librit të lutjeve, copa nga Ungjilli dhe pjesë të ritualit dhe të katekizmit. Pra, ai përmban pjesët që i duheshin meshtarit në praktikën e përditshme të shërbesave fetare. Duket qartë, se kemi të bëjmë me një nismë të autorit, me një përpjekje të tij, për të futur gjuhën shqipe në shërbimet fetare katolike. Pra, edhe për gjuhën shqipe, ashtu si për shumë gjuhë të tjera, periudha letrare e saj nis me përkthime tekstesh fetare.

Libri i parë në gjuhën shqipe, "Meshari" i Gjon Buzukut, u zbulua për herë të parë në Romë nga njeri prej shkrimtarëve të veriut, Gjon Nikollë Kazazi. Por, libri humbi përsëri dhe u rizbulua më 1909 nga peshkopi Pal Skeroi, gjurmues dhe studiues i teksteve të vjetra. Në vitin 1930, studiuesi nga Shkoder Justin Rrota shkoi në Romë, bëri tri fotokopje të librit dhe i sollti në Shqipëri. Në vitin 1968 libri u botua i transliteruar dhe i transkriptuar, i pajisur me shënime kritike dhe me një studim të gjerë hyrës nga gjuhëtari i shquar, Eqrem Çabej²⁴³.

Në mënyrë të pavarur, tekstin e Buzukut, e pati transkriptuar edhe studiuesi N.Resuli. "Meshari" i Gjon Buzukut është shkruar në gegërishten veriore (veriperëndimore), me alfabet latin, të plotësuar me disa shkronja të veçanta. Libri ka një fjalor relativisht të pasur dhe ortografi e forma gramatikore përgjithësisht të stabilizuara, çka dëshmon për ekzistencën e një tradite të mëparshme të të shkruarit të shqipes.

Studiuesi Eqrem Çabej, që ishte marrë gjerësisht me veprën e Gjon Buzukut, ka arritur në përfundimin, se gjuha e saj "nuk është një arë fare e pa punuar"²⁴⁴.

"Duke e shkruar me një vështrim më objektiv këtë tekst – pohon ai – nga gjuha e rrjedhshme që e përshkon fund e majë atë dhe nga mënyra, me gjithë lëkundjet e shpeshta, mjaft konsekuente e shkrimit, arrin të bindet njeriu, se në Shqipëri ka qenë formuar që më parë, së paku që në mesjetën e vonë, një traditë letrare me shkrime liturgjike"²⁴⁵. Kjo tezë, sipas autorit, gjen mbështetje edhe nga gjendja kulturore e Shqipërisë mesjetare; "shkalla e kulturës së popullit shqiptar në atë kohë nuk ka qenë ndryshe nga ajo e vendeve përreth, sidomos e atyre të brigjeve të Adriatikut"²⁴⁶.

Për një traditë të shkrimit të shqipes para shekullit XV, flasin edhe disa dëshmi të tjera të tërthorta. Kleriku francez Gurllame Adae (1270-1341), i cili shërbeu për shumë kohë (1324-1341), si Kryepeshkopi i Tivarit dhe pati mundësi t'i njihnte mirë shqiptarët,

²⁴² Fadil Raka, *Historia e Shqipes Letrare*, Universiteti i Tetovës, Tetovë, 1997, fq.66-70.

²⁴³ Studimi i E. Çabejt mbi Mesharin e Buzukut, deri në ditë tona është studimi më gjithëpërfshirës.

²⁴⁴ Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1976, fq.50.

²⁴⁵ Po aty.

²⁴⁶ Po aty.

në një relacion me titull “*Directorium ad passagium faciendum ad terram sanctam*”, dërguar mbretit të Francës Filipit VI, Valua, shkruan ndër të tjera: “*Sado që shqiptarët kanë një gjuhë të ndryshme nga latinishtja, prapëseprapë, ata kanë në përdorim dhe në të gjithë librat e tyre shkronjën latine*”. Pra, ky autor flet për libra në gjuhën e shqiptarëve, duke dhënë kështu një dëshmi se shqipja ka qenë shkruar para shekullit XV.

Edhe humanisti i shquar Marin Barleti, në veprën e tij “*De obsi dione scodrensi*” (*Mbi rrethimin e Shkodrës*), botuar në Venedik, më 1504, duke folur për qytetin e Shkodrës, bën fjalë për fragmente të shkruara in “*vernacula lingua*” (d.m.th në gjuhën e vendit), të cilat flasin për rindërtimin e qytetit të Shkodrës.

Këto janë disa dëshmi që e bëjnë të besueshme ekzistencën e një tradite më të hershme të shkrimit të shqipes, megjithatë, derisa kërkimet të mos kenë nxjerrë në dritë ndonjë libër tjetër, “*Meshari*” i Gjon Buzukut do të vijojë të mbetet libri i parë i shkruar në gjuhën shqipe dhe vepra e parë e letërsisë shqiptare.

Disa pikëtakime midis shqipes dhe rumanishtes

Jeta e përbashkët me shekuj e popullit shqiptar dhe atij rumun, në Gadishullin Ballkanik, gërshetimi i kulturave të tyre, ndërthurja e gjuhëve, përthyerja e kulturave të popullsisë antike në kulturën autentike të popujve të Ballkanit, krijuan, veçori të përbashkëta në kulturën e tyre, bashkëpërkime, barazime dhe zhvillime paralele në gjuhët e tyre. “*Të gjitha këto janë studiuar prej shume kohësh, pothuajse dy shekuj e gjysmë, duke tërhequr, që nga fillimi, vëmendjen e shkencëtarëve evropianë... duke filluar nga studiuesi Johann Thunman, pastaj në vitin 1829 studiuesi, nga Sllovenia, Bartolomeu Kopitar, botoi në Vjenë punimin “Albanische, walachische und bulgarische Sprache (Gjuhët shqipe, rumune dhe bullgare), punim i cili përfaqëson në të njëjtën kohë edhe pikënisje për studimin e krahasuar të gjuhëve ballkanike”. Pra, siç e mund të shihet, gjuha rumune dhe gjuha shqipe kohë të gjatë kanë qënë pjesë e hulumtimeve dhe studimeve nga shkencëtarët- ballkanologë. Duke u bazuar në krahasimin e këtyre dy gjuhëve, u zhvillua teoria e substratit/nënshtrësës përse i përket gjuhës rumune*”.²⁴⁷

Nga ana tjetër, në studimin e kulturave të popullsisë të Ballkanit të lashtë, rrugët metodologjike nuk duhet zbatuar me rigorozitet pasi që kemi të bëjmë me një botë dhe me një qytetërim të përenduar, me një “përmbytje” popujsh e kulturash. Për këtë arsye vazhdimësia e kombeve të sotme në Ballkan s’është dhe nuk mund të jetë një gjë që kuptohet vetvetiu. Është krejtësisht i pranueshëm mendimi sipas të cilit kontaktet gjuhësore kanë mundur të krijohen vetëm në një hapësirë të ngushtë, gjë që shënoi rrugën për të krijuar kategori të reja gjuhësore në disa prej gjuhëve ballkanike: rumanishten, shqipen, bullgarishten, maqedonishten, greqishten, e në disa dialekte serbe²⁴⁸

“Mendohet, kryesisht, se njerëzit që kanë mësuar gjuhë të fqinjëve të tyre sipërfaqësisht, aq sa kanë pasur nevojë për të zgjidhur punët e tyre, kjo ishte praktike, elementare, kanë folur në mënyrë analitike, sepse dualizmi është veçori e çdo polilinguizmi të pa përsosur.

²⁴⁷ Nikolae Saramandu, *Konkordanca gjuhësore midis rumanishtes dhe shqipes*, punim i botuar në Buletinin shkencor, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë.

²⁴⁸ Shaban Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, SHLU, Tiranë, 1988, fq.101.

Njeriu që gjuhën e huaj nuk e njih mirë e flet atë me guxim, të folurit e tij e rruddh në një mënyrë të vogël kategorish, duke mos mbajtur parasysh finesat dhe "ngarkesat" e kësaj gjuhe të huaj. Gjuhëtari i njohur serb Ivie këtë fenomen e përkufizoi kështu: "Kontaktet e afërta shpesh kanë për pasojë thjeshtësimin e sistemit; nëse kryqëzohen një sistem me i nderligjshëm me një tjetër të thjeshtë - rezultati anon nga tipi me i thjeshtë... edhe në rastet kur përzihen dy sisteme të nderligjshme, të ndryshme, janë gjasat që përfundimi të jetë me i thjeshtë se sa janë këto dy sisteme"²⁴⁹. Ndërkaq Irena Grickat lidhur me këtë thotë: "...Më këtë nuk duhet harruar së folësit të cilët i kanë afruar në këtë mënyrë sistemet e tyre, në rastin tonë kanë qenë në radhë të parë blegtorë të lashtë dhe bujq, pastaj tregtarë mesjetar, zanatçinj, bredhës etj., e të tillët nuk çajnë kokën për normat e tyre (të gjuhëve), siç brengoset njeriu i arsimuar", Ballkanik.²⁵⁰ Por, ka edhe një mendim tjetër, që në këtë rast kemi të bëjmë me një dukuri ballkanike, pikërisht, një lagje dijetaresh si këtë veçori edhe zhvillime të tjera analitike i shohin të ardhura nga periudha të lashta para-romane, pra janë zhvillime gjuhësore para-ballkanike - tipare të trashëguara (Miklosich, Weigand, Budimir, Pisani). Çabej shton se në rastin tonë nuk është fjala për një ndikim mbi sistemin e formave, por, me parë, për një kalkim gramatikor, imitim i një forme të huaj shprehjeje me lëndën e gjuhës (factum habeo, casus sum, casum habeo) shq. "kam punuar, kam bërë, kam qenë", maq. përveç konstruktit të hershëm sum dosol - zhvilloi forma të tjera të reja imam dojdeno, sum dojden, rum. am vinita "kam ardhur", am vidzuta "kam parë". Siç dihet "dokumenti i parë i shkruar rumanisht është i shekullit XVI- letër e një bojari nga Këmpëlung më 1521. Letërsia e parë religjioze rumune ishte në fakt e përkthyer nga sllavishtja kishitare, ndërsa pas shekullit XVII rumunët nuk i drejtohen më burimit sllav, po kalonin drejtpërsëdrejti te bizantinishtja"²⁵¹.

Shqipja dhe rumanishtja, nga fusha e morfologjisë, kur është fjala për kohën e kryer, edhe foljet jokalmittare i ndërtojnë me anë të foljes ndihmëse *kam, kam qenë, kam ardhur, kam dalë*, kurse gjuhët romane me -jam: *sono venuto, sono stato, je suis venu, por j' ai ete; gjerm. ich bin gewesen, ich bin gekommen*. Për tipar karakteristik të ballkanizmave hiqen edhe format e përfutuara të admirativit në gjuhën shqipe, maqedonishten, bullgarishten. Format e shkurtra të participit dhe trajtat e së tashmes ndihmëse (kam): *pase + kam = paskam, imperfekti: pase + keshka = paskesha; paskam pasur, paskesha pasur*.

Tipare të përbashkëta janë konstatuar edhe në sistemin e numërimit prej 11-19 mbi gjuhë ballkanike (gjuhët sllave, letonishtja e grupit baltik, shqipja dhe rumanishtja). Në këtë sistem numërimi të shqipes (11-19), Çabej i mbahet mendimit të Joklit sipas të cilit kemi të bëjmë me një izoglose të vetme të gjuhëve: shqipe, baltike - sllave e jo një imitim nga gjuhët sllave, sikundër mendon Puscariu²⁵²

Kurrfarë ndikimi nga gjuhët sllave nuk mund të ketë, sidomos në mënyrën e formimit të numërorëve me njëzetëshe (20, 40, 60, 80). Këtu në shqipen, Jokli sheh një relik para indoevropian, sepse sistemi vigesimal i numërimit, në kundërshtim me sistemin dekadik, që është karakteristik për botën indoevropiane, është tipari i një substrati para-indoevropian në gjuhën shqipe (njëzet, dyzet, dikur trezet e katërzet). Këto tipare e

²⁴⁹ [www.google.com\(comperations\)](http://www.google.com/comperations) linguistics, Balkan case, 30 maj 2009).

²⁵⁰ Po aty.

²⁵¹ Rexhep Ismajli, *Standarde dhe identitete (rumanishtja dhe moldavishtja)*, Shtrëpia botuese "Dukagjini", Pejë, 2003, fq. 205-206.

²⁵² Besim Bokshi, *Prapavendosja e njes shquese në gjuhët ballkanike*, Prishtinë, 1984, fq.78 .

shumë të tjera, që dalin të përbashkëta për shumicën e gjuhëve ballkanike, studiohen këtu e një shekull më parë nga studiues - linguistë.

Në fushën e terminologjisë kishtarë, numri i latinizmave në shqipen është më i madh se në rumanishte, pasi që në të dytën (rumanishten) ekziston vërshim i termave kishtarë sllavë. Nga kjo rezulton se dyndja sllave në këto vise gjeti një kishë shqiptare të organizuar që s'kishte me nevojë për terma plotësues e të rinj ²⁵³ Në fondin e leksikut të shqipes ka huazime latine që nuk ruhen në gjuhë të tjera romane, siç është fjala *e diel*, për emrin e së cilës, s' është gjë tjetër veç përkthim fjale i shprehjes latine *dies solis* nga periudha pagane; e në gjuhët romane përdoret një emër shumë më i vonë, që është shfaqur në shekullin IV të erës sonë, *dominica*, fr. *dimanche*, it. *domenica*, rum. *domineca*.

Një interes të veçantë paraqesin sidomos ato fjalë të trashëguara të gjuhës shqipe që ndeshen edhe në rumanishte. Bashkëpërkimet e hershme leksikore midis shqipes dhe rumanishtes marrin një rëndësi të veçantë edhe për arsye së ndërmjet këtyre dy gjuhëve ka edhe bashkëpërkime të rëndësishme të karakterit gramatikor. Mjafton vetëm të përmendet këtu prirja e vjetër e këtyre dy gjuhëve për të prapavendosur përcaktorët e pa vetëmjaftueshëm të emrit.²⁵⁴ Edhe në rumanishte, ashtu si në shqipe, përcaktorët e pa vetëmjaftueshëm vendosen rregullisht pas emrit dhe kjo dukuri është mjaft e vjetër edhe në atë gjuhë.

Në fushën e leksikut, në përgjithësi, pranohet që numri i fjalëve të vjetra të përbashkëta të shqipes dhe rumanishtes është i konsiderueshëm. Sipas I.I.Russu-t, elementet autoktone arrijnë në 70 njësi kurse Brancus-i, e çon këtë numër në 89 njësi. Këtu ka më shumë rëndësi të theksohet se ky numër dikur duhet të ketë qenë më i madh dhe se disa nga fjalët e përbashkëta të këtyre dy gjuhëve, në rrymë të shekujve do të kenë dalë nga përdorimi në njëren gjuhë apo tjetrën gjuhë.

Këtu po veçojmë disa fjalë nga fondi i fjalorit të vjetër të përbashkët të shqipes e të rumanishtes (shq. *avull*- rum. *abur*, shq. *baltë*-rum. *balta*, shq. *brez*-rum.*briu*, shq.*flutur*-rum.*fluture*, shq. *gushë*-rum. *gusa*, shq.*gjysh*-rum.*ghiu*, shq. *gardh*-rum.*gard*, etj.)

Përfundime

Nga tërësia që u parashtrua përmbledhtas më lart, mund të themi se çështja e burimit të fondit të përbashkët të fjalëve të lashta të shqipes e të rumanishtes është bërë objekt diskutimesh dhe shpjegimesh të ndryshme. Madje një pjesë e mirë e atyre dijetarëve, që burimin e këtyre fjalëve e kanë kërkuar në një nga gjuhët e lashta të Ballkanit Lindor, përkatësisht qendror, e kanë përdorur këtë edhe si një nga argumentet kryesor në të mirë të hipotezës së tyre për prejardhjen jo ilire të gjuhës shqipe. Këtu nuk do të hyjmë në hollësi të tjera lidhur me mendimet e shprehura për burimin e këtyre fjalëve të përbashkëta të shqipes e të rumanishtes. Kjo çështje që mbetet e hapur, nuk mund të zgjidhet përfundimisht pa u bërë më parë shtresëzimi kohor i fondit të fjalëve që kemi në shqyrtim.

Natyrisht shtresimi kohor i këtyre fjalëve, paraqet vështirësi të mëdha për shkak të dokumentimit shkrimor mjaft të vonë si të gjuhës shqipe ashtu edhe të rumanishtes. Megjithatë duke u mbështetur në dukuritë e vjetra fonetike që kanë pasur një pjesë e

²⁵³ (Eqrem Çabej, Buletin, 1963/3).

²⁵⁴Shaban Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, SHLU, Tiranë,1988,fq.98.

mirë e këtyre fjalëve në të dy gjuhët dhe pjesërisht edhe në disa toponime të lashta të pjesëve lindore dhe perëndimore të Ballkanit, mund të veçohet, të paktën, një pjesë e shtresës më të vjetër të këtij fondi të përbashkët leksikor të shqipes e të rumanishtes, si dhe caku kohor i kësaj shkrese. Kur ky cak kohor i takon një periudhe, kur nuk ishin formuar ende as shqipja, as rumanishtja, atëherë nuk mund të bëhet fjalë për huazime të shqipes nga rumanishtja, apo anasjelltas. Në këtë rast mund të flitet për një trashëgimi të shqipes nga “nëna e saj” ilirishtja dhe të rumanishtes nga substrati i saj trako-dak apo geto-dak. Sqarimi i mëtejme i pranisë së këtyre fjalëve në gjuhën “nënë” të shqipes dhe në substratin e rumanishtes i kalon caqet e historisë së mirëfilltë të vetë shqipes e të rumanishtes. Sqarimi i kësaj çështjeje, pra, ka të bëjë në radhë të parë me sqarimin e lidhjeve burimore dhe të marrëdhënieve historike midis gjuhëve i.e., që fliteshin në pjesët lindore dhe perëndimore të Ballkanit, para se të formoheshin shqipja dhe rumanishtja.

Si caqe kohore për formimin e rumanishtes sot, në përgjithësi, pranohet periudha midis shekujve V-VIII të erës sonë. Kurse formimi i shqipes duhet të jetë kryer gjatë periudhës midis shekujve IV-VI të erës sonë. Prandaj fjalët e përbashkëta të këtyre dy gjuhëve, që mund të veçohen për periudhën para këtyre caqeve kohore, do të përfshihen patjetër në fondin e trashëguar leksikor të shqipes, përkatësisht të rumanishtes.

Burimet e konsultuara

1. Shaban Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Prishtinë, 1989.
2. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1976.
3. Rexhep Ismajli, *Standarde dhe identitete* (Greqishtja, turqishtja, rumanishtja), Shtëpia botuese “Dukagjini”, Pejë, 2003.
4. Aleks Buda, “Etnogjeneza e popullit shqiptar në dritën e historisë”, Konferenca Kombëtare për formimin e popullit shqiptar, Tiranë, 1988.
5. Aleks Buda, Rreth disa çështjeve të formimit të popullit shqiptar, të gjuhës dhe të kulturës së tij,, Studime historike, 1980, nr.1.
6. *Studia albanica* (Tiranë), 25/1988.
7. Rreth disa dukurive të përbashkëta morfologjike të shqipes e të rumanishtes (Në dritën e veprimtarisë së Eqrem Çabejt). - në: Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Përmbledhje e ligjëratave dhe e kumtesave të lexuara në seminarin XV e XVI - 1989 e 1990. Universiteti i Prishtinës Fakulteti Filologjik. Prishtinë, 1995.
8. Gjurmët e rrjedhës në rumanishte. - në: Seminari XVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare. Përmbledhje e ligjëratave, referimeve, kumtesave dhe e diskutimeve. Tiranë, 16-31 gusht 1995. Akademia e Shkencave - Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë - Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Filologjisë. “Eurorilindja”, Tiranë 1995.
9. *Konvertimi i shqiptarëve dhe prejardhja e shqipes*- (Disa vërejtje rreth dy monografive të kohëve të fundit). - në: *Krishterimi ndër shqiptarë*; Simpozium Ndërkombëtar Tiranë, 16-19 nëntor 1999.
10. *Prezantimi i shqiptarëve në Ballkan*, në: Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 23/1 (Materialet e punimeve të Seminarit XXIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Prishtinë, gusht 2004). Prishtinë, 2004.

ROLI I PËREMËRIT PRONOR VETVETOR I, E VET NË TË FOLMET BILINGUALE

Ma. Sci. Senad Neziri

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë

Email: senad_neziri@hotmail.com

senad.neziri@gmail.com

Hyrje

Përemri pronor vetvetor i shqipes *i, e vet* në të folmet e shqipes, përkatësisht në të folmet e Kosovës, sidomos në regjionin e Prizrenit, gjen një përdorim të madh. Përdorimi i tij në të folmet e përditshme ka mbetur si një domosdoshmëri, apo edhe një shprehje e folësve të shqipes së regjioneve të Republikës së Kosovës ose më mirë të themi të folësve të zonave bilinguale ose edhe trilinguale në bashkëjetesë me të folmet sllave ose me gjuhë të tjera. Atë e gjejmë me përdorime të ndryshme dhe me perceptime të ndryshme, si nga ana e folësve të përditshëm të shqipes, si nga ana e folësve bilingë apo trilingë në një shoqëri shumëgjuhëshe me ndërrime të shumta të kodeve gjuhësore brenda një kohe të shkurtër, ashtu edhe nga ana personave profesionistë, por bilingë e trilingë. Për këtë rast janë dhënë dhe jepen çdo ditë përkufizimet se, përemri pronor vetvetor nuk përdoret në raste të duhura dhe në vende të duhura gjatë të folurit të përditshëm. Këtë problem ne e kemi analizuar dhe për këtë arsye kemi vendosur të mirremi me ndriçimin e këtij ngërçi dhe ta japim përdorimin e saktë të përemrit pronor vetvetor *i, e vet*, duke mos i anashkaluar edhe shembujt e përdorimit të pasaktë si arsye për ta bërë dallimin e duhur.

1.Sfondi historik i përemrit pronor vetvetor *i, e vet*

Në bazë të shënimeve historike mbi morfologjinë e shqipes kemi gjetur disa shënime për pronorët dhe rrugën e tyre historike, por edhe për historinë e pronorit vetvetor *i, e vet*. Kemi konstatuar që problemet kryesore që paraqesin pronorët e shqipes, në planin diakronik, kanë të bëjnë me vetë gjenezën e tyre. Në këtë pikë Demiraj²⁵⁵ vëren se nuk paraqesin ndonjë vështirësi vetëm pronorët e vetës së tretë (*i tij, i saj, i tyre* dhe *i vet*). Këta janë përfutur, ashtu si edhe në shumë gjuhë të tjera indoevropiane, nga të cilët përemri *i vet* e ka burimin "tek gjindorja e përemrit *vetë* (...)" dhe se mbaresën e shumësit

²⁵⁵ Shaban Demiraj, Morfologjia historike e gjuhës shqipe, I dhe II, Prishtinë, 1980, f. 144.

femëror -a pronori *i vet* e merr si në përdorimin mbiemëror ashtu edhe kur përdoret i substantivuar (p.sh. *vajzat e veta – të vetat* etj.),²⁵⁶ ku në përgjithësi kanë qenë “në lidhje të ngushtë me gjindoren e përemrave vetorë”.²⁵⁷ Pastaj (po aty), në vazhdim, Demiraj përkufizon se në mjaft raste “ata janë zhvilluar nga format e gjindores së vetorëve, por, nga ana tjetër, ka edhe raste që gjindorja e vetorëve e ka burimin tek forma pronorësh, si p.sh. në latinishte gjindoret *mei, tuī, sui* etj.”

Nga studiuesit vendorë në kuadër të studimeve albanistike, Mjeda në punimin e tij “*Vrejtje mbi artikuj e prëmnja të giuhës shqipe*, Shkodër, 1934” e Riza në broshurën e tij “*Diftorët e shqipes dhe historiat i tyne*, Prishtinë, 1953” janë ndër të parët që problemin e gjenezës e të evolutës së pronorëve të shqipes e kanë bërë objekt studimesh të veçanta, ndërsa më pas janë marrë edhe studiues të tjerë të gjeneratave të reja. Nga ana tjetër linguistët e huaj janë marrë me problemin e pronorëve vetëm me rastin e gjurmimit të ndonjë problematike gjuhësore historike më të gjerë.

Bokshi në veprën e tij,²⁵⁸ mbi të gjitha, është marrë edhe me sqarimin e përdorimit të pronorit vetvetor *i, e vet* si dhe me prejardhjen dhe ndërtimin e tij. Ai formën e përemrit pronor vetvetor *i, e vet, i veti, e veta* e she të përfutur “nga përemri identifikues në përdorim përforcues ndaj emrit dhe përemrit vetor-dëftor në rasën gjinore (*i vetë atij djali, e vetë asaj gruaje, i vetë atyre burrave / grave; i vetë atij / asaj / atyre; i vetë djalit / vajzës, i vetë burrave(t) / grave(t)* etj.).²⁵⁹ Meqenëse, sipas tij, ky përemër nuk kishte fleksion rasor atëherë ai thekson se “në të njëjtën formë mund ta përforconte emrin edhe në rasën adnominale, që nuk është përdorim parësor.”²⁶⁰ Prandaj, duke qenë në funksion ndajshtimi ndaj emrit përkatës përemri *vetë* përfaqësonte të njëjtën vetë (vetën e tretë) që shënonte emri, e jo siç e përfaqëson dhanorja e vetorit (*i tij / i saj / i tyre djalë* etj.), tjetrën vetë. Për këtë arsye formën *i vet(ë), e vet(ë)* etj., Bokshi në një vepër tjetër²⁶¹ e shpjegon se “nuk e fitoi vlerën e pronorit nëpërmjet formës së gjinore, të cilën nuk e kishte, siç u përfutua *i tij-i, e tij-a, i saj-i, e saj-a*”. Por, “ajo do ta ketë përfutur këtë vlerë nga ndërtimet e tipit [*Djali i vetë asaj / atij / atyre*] (*fati i vetë asaj gruaje, i vetë atij burri, i vetë atyre djemve* etj.). Kështu, kur përdoret vetëm, nyjën e përparme e ka nyjë të gjinore, të marrë nga gjinorja e vetorëve, cila i bën të nënkuptueshme dhanoret [*tij, saj, tyre : atij, asaj, atyre*] apo dhanoren e emrit.”²⁶² Pra, kjo na bën të kuptojmë se nga kjo nyje atij i del kuptimi i përkatësisë a i pronës: [*djali i vet(ë) atij / asaj / atyre*] apo [*Fati i vetë atij burri / asaj gruaje / atyre djemve* etj.] dhe në këtë kuptim sipas Bokshit (po aty) “ai u bë përemër pronor vetvetor i nyjshëm [*i veti, e vetja, të vetët*]”.

2.Studiuesit e huaj dhe vendorë për pronorin vetvetor *i, e vet* dhe përfshirja e tij në sferën dialektore

Prej studiuesve të huaj, sa kemi mundur të vërejmë, Cimochowski erdhi në përfundim se “Mbiemri posesiv *i vet* mund të përdoret jo vetëm për vetën e tretë por

²⁵⁶ Po aty, f. 145.

²⁵⁷ Po aty, f. 144.

²⁵⁸ Besim Bokshi, *Për vetorët e shqipes*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2004.

²⁵⁹ B. Bokshi, *Po aty*, f. 157.

²⁶⁰ Po aty.

²⁶¹ Besim Bokshi, *Pjesorja e shqipes (vështrim diakronik)*, AShAK, Prishtinë, 1998, f. 124.

²⁶² B. Bokshi, *Për vetorët e shqipes*, 2004, f. 157.

edhe për vetën e parë dhe të dytë, po si në gjuhën polake. Kjo fjalë rrjedh nga indoevropianishtja *vet* < **suet*".²⁶³ Pra, këtu na paraqiten sqarimet e para se përdorimi i përemrit pronor vetvetor *i vet* përdoret edhe në dy vetat e para me mundësi ndikimi nga gjuhët sllave. Mënyrën e përdorimit të përemrit pronor vetvetor *i vet* Cimochowski e jep edhe për të folmen e Dushmanit, si: "duke theksuar se, nga pikëpamja sintaksore, ky përemër përdoret vetëm kur janë dy kryefjalë të ndryshme. Kur kryefjala është e njëjët (pra në rastin kur në latinisht përdoret përemri *suus*), atëherë përdoret në njëjës: *i vet* (m.); *e vët* (f.), në shumës: *e, t vët* (m.); *e, t veta* (f.) (...)".²⁶⁴ Dhe më pastaj e jep edhe paradigmen e lakimit të pronorit vetvetor *i vet*, por duke mos e përfshirë rasën rrjedhore, si p.sh. "numri njëjës mash.: em. i veti; gjin., dhan. t vetit (t vedit); kallëz. t vën. Fem. njëjës: em. e veta; gjin., dhan. t vëts; kallëz. t vën. Numri shumës mash.: em. t vët, -t; gjin., dhan. t vëtve, t; kallëz. t vët (, -t). Fem. shumës: em. t veta, -t; gjin., dhan., t vetave, -t; kallëz. t veta, -t".²⁶⁵ Në krahasim nga të lartcekurit Sami Frashëri në veprën e tij "Shkronjëto e gjuhës shqip" e shtypur nga shoqëria "Drita" në Bukuresht të Rumanisë në vitin 1886, e jep paradigmen e lakimit të përemrit pronor vetvetor *i vet* në gjashtë rase, si në: emërore (quanjëtorja), gjinore (pjellëtorja), dhanore (dhënëtorja), kallëzore (kallzonëtorja), rrjedhore (pritëtorja) dhe vendore (mërgonjëtorja – e cila në gramatikat e sotme nuk del fare). P.sh. "Vetë 3: njëjës prej zotsh mashkullë, njëjës prej gjëje – mashk.: q. i-vet, i; pj. të-vet, të; dh. të-vet, të; k. e-vet, të; pr. të-vet, të; m. të-vet, të. – Fem.: q. e-vet, e; pj. së-vet, së; dh. së-vet, së; k. e-vet, të; pr. të-vet, të; m. së-vet, së. Shumës prej gjëje – mashk. E fem.: q. të-ti, të; pj. të-vet, të; dh. të-vet, të; k. të-vet, të; pr. të-vet, të; m. të-vet, të".²⁶⁶ Edhe S. Frashëri argumenton përdorimin e përemrit pronor vetvetor *i vet* vetëm për vetën e tretë.

Për nga tipi strukturor pronorët e shqipes nuk paraqiten homogjenë. Format e tyre për vetën e tretë dalin të paranyjzuar, njëjtë sikur që dalin sot disa forma të shumësit për vetën e parë njëjës (*e mi*) dhe për vetën e dytë njëjës (*e tu*), të cilat dikur kanë qenë pa nyje të përparme (*mi, tu*), ndërsa për të gjitha rastet e tjera Demiraj përkufizon se "kemi të bëjmë me forma fjalësh të përngjitura, që kanë një lakim sui generis."²⁶⁷ Ndërsa Bokshi shënon "Pronorët shprehin kuptimin e numrit të pronarit e të pronës dhe kuptimin e gjinisë së pronës dhe të gjinisë së pronarit të vetës së tretë njëjës".²⁶⁸

Definicioni strukturor i lartshënuar për format e pronorëve të gjuhës shqipe, sipas gjitha gjasave, vjen nga fakti që pronorët janë përfutur në kohë të ndryshme. Ashtu që format *mi* dhe *tu* duhet t'i përkasin një periudhe më të vjetër, për shkak të strukturës së tyre të thjeshtë, ndërsa të një periudhe më të vonë janë format që kanë dalë nga përngjitja e dy elementeve *im* dhe *ynë*, ndërsa format e vetës së tretë (*i tij, i saj, i tyre* dhe *i vet*) janë më të vonshme ku "elementi nyjor nuk është shkruar me trupin e përemrit".²⁶⁹ Selman Riza në studimet e tij që i bëri pronorëve të shqipes në veprat e vjetra shqipe të Buzukut, Budit, Bardhit dhe Bogdanit, ndër ta, përemrin pronor vetvetor *i, e vet* e evidenton si

²⁶³ W. Cimochowski, *Gjuha shqipe*, ff. 399 – 468, në botimin e ASHAK Për gjuhën shqipe, Prishtinë, 2007, f. 456.

²⁶⁴ Waclaw Cimochowski, *E folmja e Dushmanit* (përshkrim i njëjës prej të folmeve të Shqipërisë Veriore), Poznanj, 1951, në botimin e ASHAK Për gjuhën shqipe, ff. 21-237, Prishtinë, 2007, f. 132.

²⁶⁵ W. Cimochowski, *E folmja e Dushmanit*, Po aty, f. 135.

²⁶⁶ S. Frashëri, *Shkronjëto e gjuhës shqip*, Drita, Bukuresht, 1886, në vëllimin V, Rilindja, Prishtinë, 1979, f. 101.

²⁶⁷ Sh. Demiraj, *Vep. e cit.*, f. 162.

²⁶⁸ B. Bokshi, *Për vetorët e shqipes*, 2004, f. 14.

²⁶⁹ Sh. Demiraj, *Vep. e cit.*, f. 163.

pronor i vetës së tretë, por si “pronori reflektiv”²⁷⁰, i përdorur në bashkrenditjen me pronorin *i, e atij*, si: “pronori për vehtjorët: *i, e, të (vetë) atij; (vetë) asaj; (vetë) atyre*.”²⁷¹ Dhe në vazhdim, Riza, i jep shembujt e përdorimit të pronorit vetvetor te autorët e vjetër, si: “Gjind. dhan. – Buzuku: (Suzana)... shetatën ëndër për perivojt të burit vet 54/1a (...); Budi: shtëpisë vet D. K. 16; Bardhi: mjeshtrisë së vet fq. 209; Bogdani: të mrekuillivet vetë pj. dt. II, VII, 5. Kall. – Buzuku: aih dërgoih atyne burrë e vet 49/1b (...); Budi: dhenë e vet P. R. 360 (...); Bardhi: gjithë dhe ka zakonet e vet fq. 215. Rrjedhore – Buzuku: tëh dalë dhandëri ën kamëret sëh vet 41/1b (...); Budi: n grashit cë vet. R.R. 67 (...); Bogdani: fëmijënjiet së vet, pj. dt. II, V, 36. Parafj. – Buzuku: (...) ndë ment të vet D. K. 123 (...); Bogdani: ndë petëkat të vet pj. dt. III, II, 20.”²⁷² Në të gjitha shembujt nuk është përdorur rasi emërore. Për këtë mospërdorim të emërores Riza arsyeton se “rregullisht pronori vetëvehtjor referon tek kryefjala pa bërë pjesë në të”.²⁷³ Mbi të gjitha këto studimet e bëra për përdorimin e pronorëve edhe në tekstet e vjetra të gegërishtes mund të vërejmë se në vend të formës së sotme “*të vet-a*” për shumësin femëror është përdorur forma “*të vet*”.

Përdorimi i pronorëve në përgjithësi, por edhe në veçanti pronori vetvetor *i, e vet*, gjetën një përdorim shumë të theksuar edhe në sferën dialektore të të gjithë zonave të të folmeve gege, por edhe toske “duke filluar që nga të folmet kalimtare e deri në Toskëri”.²⁷⁴ Me këtë problem përgjithësues janë marrë studiues të ndryshëm, por ne do të bazohemi në punimin e Ahmetajt, i cili duke u bazuar në shumë studiues të të folmeve dialektore,²⁷⁵ ka punuar në temën “Pronorët në sferën dialektore të shqipës”. Ahmetaj ka arritur, duke u bazuar në literaturë të bollshme shkencore, ta argumentojë përdorimin e pronorit vetvetor *i, e vet* gati në gjithë zonën e të folmeve të shqipës, si për: Moravën e Epërme dhe të Poshtme, Krahinën e Pukës, Krahinën e Hasit, Malësinë e Sharrit e të Tetovës, të folmen e Dushmanit, të folmen e Çeremit e të Valbonës, Shalën e Bajgorës, Zonën Deçanit, Anës së Malit, Anadrininë, Karadakun, Kavajën, Krahinën e Dibrës, Lumën, Shkrelin, Krasniqen, Rogamin, Bregun e Bunës, Shpatin, Manastirin, Durrësin, Polisin, Elbasanin etj. Gjatë punës së tij në një titull të veçantë “Përemri vetvetor në funksion të pronorit, ff. 92 - 97”,²⁷⁶ si thamë, ai ka arritur që ta argumentojë edhe përdorimin e pronorit vetvetor *i, e vet* gati për të gjitha zonat e areales së shqipës. Nga këto mund ta veçojmë paragrafin përfundimtar: “Pronorët vetvetorë *i vet - e veta/ e vet - e veta* për gjuhën standarde, në sferën dialektore të shoqëruar me emra të gjinisë mashkullore dhe femërore në njëjës, për rasën emërore na del me këto forma: *vët - vët, i vet - e vet, vet - vet, i vët - e vët, vet - vete, i v [e]t [e]t, [e]t, [e]t - vete*. Ndërkaq i shoqëruar me emra të gjinisë mashkullore dhe femërore në shumës, për rasën emërore na del me këto forma: *e vet - e veta, e vët - e veta, t'vet - e vet*.”²⁷⁷ Pra, këto argumente na

²⁷⁰ Selman Riza, *Pronorët e shqipës*, në *Studime albanistike*, I, Rilindja, Prishtinë, 1979, f. 331.

²⁷¹ Po aty.

²⁷² Po aty, ff. 331-332.

²⁷³ Po aty, f. 332; Kolec Topalli, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, QSA, Tiranë, 2011, ff. 620-621.

²⁷⁴ Arton Ahmetaj, *Pronorët në sferën dialektore të shqipës*, UP, FF, Prishtinë, 2012 (dorëshkrimi i masterit).

²⁷⁵ Si: Gjinari, Shkurraj, Beci, Mehmetaj, Mulaku, Gosturani, Sulejmani, Badallaj, Topalli, Halimi, Bokshi, Demiraj, Likaj, Lafe, Agolli, Ajeti, Çabej, Demiraj, Dhrimo, Angoni, Hysa, Pajaziti, Cimohovski etj.

²⁷⁶ Arton Ahmetaj, *Pun. i cit.*

²⁷⁷ A. Ahmetaj, *Pun. i cit.*, f. 97.

japin dëshmi se përemri pronor vetvetor *i vet* është shumë i pranishëm edhe në të folmet dialektore.

3. Pronori vetvetor *i, e vet* në gjuhën standarde dhe përdorimi e roli i tij në të folmen e përditshme

Duke u bazuar në gramatikën e sotme të gjuhës shqipe “përemër quhet ajo pjesë e ligjëratës që tregon në mënyrë të përgjithshme, pa i emërtuar frymorë, sende, tipare ose sasi të pacaktuara.”²⁷⁸ Përemër pronor është ai lloj përemri që tregon se “sendi i dhënë i përket një vete të caktuar: *oborri im, vajza jote, qëndrimi yt, shoku i tij, mësuesi ynë* etj. Përveç përemrave pronorë vetorë *im, yt, i tij* etj., shqipja ka edhe një përemër pronor vetvetor *i, e vet*. Përemri vetvetor tregon se sendi a frymori i dhënë i përket sendit a frymorit të shënuar prej kryefjalës.”²⁷⁹ Ai (*i, e vet*), në të vërtetë është “vetvetori i ndërtuar me anë paranyjzimi në funksion pronori”.²⁸⁰

Përemri pronor vetvetor *i, e, të vet* në “gjuhën tonë (...) përdoret vetëm si përemër i vetës III, njëjës ose shumës: *shoku i vet = i tij, i saj, i tyre; shoqja e vet = e tij, e saj e tyre; shokët e vet dhe shoqet e veta = e tij, e saj, e tyre.*”²⁸¹ Edhe pse këtu, si trajtë përfaqësuese, është dhënë trajta e emërores, përemri pronor vetvetor *i, e vet* rrallë përdoret në rasën emërore.

Përveç përdorimit të përemrit pronor vetvetor në vetën e tretë ai, pra *i, e vet* dhe *i, e tij; i, e saj; i, e tyre* etj., mund të përdoret në vend të njëri-tjetrit, p.sh.: *Ai u ul në vendin e vet (e tij), pranë dritares; Bardhyli thirri edhe një herë me zërin e vet (e tij) të trashë; Edhe Blerta kishte shkruar diçka për familjen e vet (e saj); Ajo do të kthehej përsëri atje në fshatin e vet (e saj).*

Te të gjithë shembujt e mësipërm në vend të përemrit *i vet* mund të përdoren përemrat *i tij, i saj*, që janë vënë në kllapa. Por, mbi të gjitha, te përdorimet e këtyre përemrave vërejmë një dallim sintaksor, si: përemri *i, e vet* mund të përdoret vetëm kur emri ose përemri që tregon *pronarin* është kryefjalë e fjalisë, ndërsa përemrat *i, e tij; i, e saj* etj., mund të përdoren jo vetëm kur *pronari* është kryefjalë, por edhe kur është ndonjë gjymtyre tjetër e fjalisë, p.sh.

Ashtu si ushtari në betejë i lidh ushtarit këmbën e prerë me fashën e vet.

Pra, këtu duhet të kuptojmë se fasha është e atij që i lidh këmbën ushtarit e jo e ushtarit të prerë, sepse përemri *e vet* i referohet kurdoherë kryefjalës, e cila në këtë rast është *ushtari*. Po të kishim thënë me fashën e tij, nuk do të ishte e qartë nëse fasha është e atij që i lidh këmbën ushtarit, apo e ushtarit të prerë. Ose nëse themi:

Ardita i dhuroi Kaltrinës fletoren e saj,

nuk është e qartë se fletorja është e Arditës apo e Kaltrinës. Sipas rregullave gramatikore pronari nuk është i përcaktuar. Por nëse themi:

²⁷⁸ ASHSh, IGJL, *Gramatika e gjuhës shqipe, 1 - Morfologjia*, Botimi i ASHSh, Tiranë, 2002, f. 215.

²⁷⁹ Po ary, f. 232.

²⁸⁰ H. Agani, Fjalori i Lubomir Kujunxhiçit në dritën e shqipes së Rahovecit e të Gjakovës, Prishtinë, 1981, f. 217.

²⁸¹ ETMMK, Gjuha Letrare Shqipe, Elemente të normës së sotme letrare, Prishtinë, 1984, f. 72.

Ardita i dhuroi Kaltrinës fletoren e vet,

atëherë qartësohet situata se fletorja e dhuruar është e Arditës.

Përdorimi i pronorëve vetorë edhe i pronorit vetvetor është një domosdoshmëri, sepse mënjanon keqkuptimin (si në rastin e lartshënuar), kur në të njëjtën fjali a frazë kemi të bëjmë me dy veta të treta dhe duam të dallojmë se cilës prej të dyjave i përket prona e dhënë.

Pronori vetvetor i referohet:
kryefjalës së fjalisë ku bën pjesë, p.sh.:

Pse erdhe? – nguli këmbë Zana, e tmeruar dhe e çuditur nga zëri i vet;

në dallim nga pronori vetor i cili mund t'i referohet:

a) çdo gjymtyre të fjalisë ku bën pjesë: “Kara Mahmut Bushatliu kujtoi se ngjarjet ndërkombëtare po zhvilloheshin në favor të tij. Pra disfata e tij qe fitore e drejtpërdrejtë e Ali Pashës, triumf i tij personal mbi armiqtë e tij. Kësisoj u ndodh befaz para Hamzait, pa pasur kohë të risillte ne mendje fjalët që kishte bërë gati prej kohësh për t'i thënë Skënderbeut kur ta takonte, apo cilitdo në vend të tij”²⁸²;

b) ndonjë gjymtyrë të ndonjë fjalie tjetër: “Skënderbeu e zhveshi pallën. Llamburutjet e saj erdhen gjer te ne e na hapën sytë. Kjo është lopata e Sadik V. E shoh shenjën që është prishur? Ka qenë emri i tij.”²⁸³

Pronori vetvetor dhe vetorët e vetës së tretë nuk kanë përdorim të barabartë në gjuhën letrare. Poashtu pronori vetvetor *i, e vet* lakohet njësoj si pronorët e tjerë të vetës së tretë si mbiemrat e nyshëm, p.sh.

Lakimi i përemrit pronor vetvetor²⁸⁴

| Rasat | Veta III | | | | |
|-------|---------------------|-------------------|---------------------|----------------------|-----------------------|
| | Prona | Njëjës mashk. | Njëjës femërore | Shumës mashkullore | Shumës femërore |
| | Pronari | Njëjës, m. ose f. | Njëjës, m. ose f. | Shumës, m. ose f. | Shumës, m. ose f. |
| E. | shoku i vet | | shoqja e vet | shokët e vet | shoqet e veta |
| Gj. | i (e) shokut të vet | | i (e) shoqes së vet | i (e) shokëve të vet | i (e) shoqeve të veta |
| Dh. | shokut të vet | | shoqes së vet | shokëve të vet | shoqeve të veta |
| K. | shokun e vet | | shoqen e vet | shokët e vet | shoqet e veta |

²⁸² Grup autorësh, Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe (Morfologjia), Prishtinë, 1986, f. 167.

²⁸³ Po aty, f. 167.

²⁸⁴ Shembujt e lakimit janë marrë nga botimi: Akademia e Shkencave e Shqipërisë - ASHSh, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë - IGJL, *Fjalor i shqipes së sotme*, Botimet Toena, Tiranë, 2002, tabela I f. 1559 dhe tabela II f. 1661.

| | | | | |
|-----|--------------------|--------------------|---------------------|----------------------|
| Rr. | prej shokut të vet | prej shoqes së vet | prej shokëve të vet | prej shoqeve të veta |
|-----|--------------------|--------------------|---------------------|----------------------|

Ndërsa përdorimi emëror i pronorëve është disi i ndryshëm nga emërimi i mbiemrave, si: *i veti – të vetët, e veta – të vetat, p.sh.:*

Lakimi i përemrit pronor vetvetor të emëruar

| Rasat | Veta III | | | | |
|-------|----------------|-------------------|-------------------|--------------------|-------------------|
| | Prona | Njëjës mashk. | Njëjës femërore | Shumës mashkullore | Shumës femërore |
| | Pronari | Njëjës, m. ose f. | Njëjës, m. ose f. | Shumës, m. ose f. | Shumës, m. ose f. |
| E. | i veti | | e veta | të vetët | të vetat |
| Gj. | i (e) të vetit | | i (e) së vetës | i (e) të vetëve | i (e) të vetave |
| Dh. | të vetit | | së vetës | të vetëve | të vetave |
| K. | të vetin | | të vetën | të vetët | të vetat |
| Rr. | prej të vetit | | prej së vetës | prej të vetëve | prej të vetave |

4.Përfshirja e pronorit vetvetor i, e vet nëpër fjalorë të gjuhës shqipe

Shpjegimet për përemrin pronor vetvetor i gjejmë edhe nëpër fjalorët e shqipes. Në *Fjalorin e gjuhës shqipe* të vitit 1954 gjejmë shpjegime: “VET (i, e) mbpr. që i përket atij për të cilin bëjmë fjalë (për vetën e tretë): djali i -, njeriu i -, njeriu i tij; ppr. i veti (për vetën e tretë): nusja shkoi ke të –ët, shkoi në shtëpi të babës, në njerëz të saj.”²⁸⁵ Në *Fjalorin e shqipes së sotme* të vitit 2002 përemri pronor vetvetor *i-e vet* shpjegohet: “VET (i, e) *pron. vetv. sh. ~ (të), ~ A (të)*. I tij ose i saj (kur ka të bëjë me kryefjalën e fjalisë dhe lidhet me të) (edhe *përd. em.*). *E ka djalin e vet. I ka njerëzit e vet. E tha me gojën e vet. Rrinte në shtëpinë e vet. Shkoi te një i veti. Ngul këmbë në të vetën. E bëri të vetën a) e përvetësoi; b) atë që kishte mundësi a deshi ta bënte, e bëri. U mundua me atë të vetën u mundua me sa kishte fuqi. E çoi në vend të vetën nguli këmbë e u bë siç tha a siç deshi ai, i shkoi e tija. Ai të vetën se të vetën ai ngul këmbë në kokëfortësi dhe sillet e vepron si do vetë. Guri është i rëndë në vend të vet. / fj. u.”²⁸⁶ Poashtu edhe në drejtshkrimin e shqipës është i sqaruar, si: “vet (i, e) *pron., sh. ~ (të), ~a (të)*.”²⁸⁷*

Përfundimet

Pra, në shumë fusha gjuhësore, si në morfologji, sintaksë, leksik etj., pronori vetvetor *i, e vet* është i sqaruar në vijat gjuhësore-shkencore dhe në të gjitha fushat mund ta gjejmë të përdorur dhe të shpjeguar për funksionet e tij në të folmen e gjuhës shqipe. Ndërsa janë çështje të tjera që ai gjen një përdorim të gabueshëm nga folësit e përditshëm dialektor, standard, bilingë e trilingë. Përdorime të tepruara të tij nga këta individë mund të arsyetohen me ndikim nga ndonjë gjuhë a dialekt tjetër fqinj, si ai sllavo-serb, sepse

²⁸⁵ Instituti i Shkencave, Seksioni i Gjuhës e i Letërsisë, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1954, f. 606.

²⁸⁶ AShSh, IGjL, *Fjalor i shqipes së sotme*, Botimet Toena, Tiranë, 2002, f. 1442.

²⁸⁷ Ali Dhrimo – Rami Memushaj, *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Infbotues, Tiranë 2011, f. 869.

Agani në studimin e tij që i bëri Fjalorit të Kujunxhiçit thotë se “këtu është një dallim i madh në mes të shqipes e serbokroatishtes, ngase në serbokroatishte kemi: *ja uzimam svoj deo, ti uzimaš svoj deo dhe on uzima svoj deo*; e po kështu edhe në shumë.”²⁸⁸ Këto sqarime mund t’i gjejmë edhe te Riza në punimin e tij mbi gramatikën e serbokroatishtes kur për pronorin vetvetor shënon “pronori vetëvehtjues ndërsa në shqipe përdoret soll për të zavendësue gjenitivin e njëj vehteje së tretë të shenjueme qoftë me një emën si në shëmbujt e sipërm (si: Vukica liçi na sestru sebe – Vukica përngjet motrës së vehtes; por Vukica liçi na svoju sestru – Vukica përngjet motrës së vet, f. 389, *plotësim nga S.N.*) qoftë me një përemën si në shëmbujt që pasojnë (Ja nađoh svoju knjigu – Unë gjeta librin *i'im*; / Ti nađe svoju knjigu – Ti gjetete librin *t'and*; / On nađe svoju knjigu – Ai gjeti librin *e vet*; / Mi nađosmo svoju knjigu – Na gjetmë librin *t'anë*; / Vi nađoste svoju knjigu – Ju gjetëtë librin *e juaj, t'uej*; / Oni nađoše svoju knjigu – Ata gjetnë librin *e vet, plotësim nga S.N.*); përkundrazi në serbo-kroatishte ai përdoret për të zavendësue jo soll gjenitivin e njëj vehteje së tretë por edhe atë të vehtjes së parë dhe të së dytës”.²⁸⁹

Pra, sa mund të shohim në gjuhët fqinje pronori vetvetor përdoret në të tri vetat, si në njëjës ashtu edhe në shumë, ndërsa në gjuhën shqipe, sipas rregullave gramatikore, duhet të përdoret vetëm në vetën e tretë njëjës dhe shumë.

Prandaj, duke u bazuar në këto shënime të konsultuara me literaturë shkencore të gjuhës shqipe, çdo përdorim tjetër përveç këtyre trajtave është i gabueshëm. Dhe çdo përdorim i pronorit vetvetor nëpër vetat e tjera, përveç të tretës është i papranueshëm, si p.sh. nuk duhet të themi: Ti gjithmonë e ke mbajtur fjalën e vet; / Mos ta humbim vaktin e vet; / Unë jam djali i vet; / Mos ta dërgoj veturën e vet etj. Por duhet të themi: Ti gjithmonë e ke mbajtur fjalën tënde; Mos ta humbim vaktin tonë; Unë jam djali i tij; Mos ta dërgoj veturën time etj.

Recensentë:

Prof. asoc. dr. Shkumbin Munishi, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë

Prof. ass. dr. Haki Hysenaj, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë

Literatura

Agani, Hilmi Fjalori i Lubomir Kujunxhiçit në dritën e shqipes së Rahovecit e të Gjakovës, Rilindja, Prishtinë, 1981.

Ahmetaj, Arton, *Pronorët në sferën dialektore të shqipes*, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2011 (dorëshkrimi i masterit).

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Fjalor i shqipes së sotme*, Botimet Toena, Tiranë, 2002.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe, 1 - Morfologjia*, Tiranë, 2002.

Bokshi, Besim, *Për vetorët e shqipes*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (AShAK), Prishtinë, 2004.

Bokshi, Besim, *Pjesorja e shqipes (vështrim diakronik)*, AShAK, Prishtinë, 1998.

Cimochowski, Waclaw, E folmja e Dushmanit (përshkrim i njërës prej të folmeve të Shqipërisë Veriore), Poznanj, 1951, në botimin e AShAK Për gjuhën shqipe, ff. 21-237, Prishtinë, 2007.

Cimochowski, Waclaw, *Gjuha shqipe*, në botimin e AShAK Për gjuhën shqipe, ff. 399 – 468, Prishtinë, 2007.

Demiraj, Shaban Morfologjia historike e gjuhës shqipe, I dhe II, Prishtinë, 1980.

Dhrimo, Ali – Memushaj, Rami, *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Infbotues, Tiranë 2011.

²⁸⁸ H. Agani, Fjalori i Lubomir Kujunxhiçit në dritën e shqipes së Rahovecit e të Gjakovës, Prishtinë, 1981, f. 217.

²⁸⁹ Selman Riza, *Gramatika e serbo-kroatishtes*, Mustafa Bakija, Prishtinë, 1952, në *Vepra 2*, ff. 317 – 597, AShAK, Prishtinë, 1997, f. 390.

- ETMMK, Gjuha Letrare Shqipe, Elemente të normës së sotme letrare, Prishtinë, 1984.
- Frashëri, Sami, *Shkronjëto e gjuhës shqip*, Drita, Bukuresht, 1886, në vëllimin V të kompletit, Rilindja, Prishtinë, 1979.
- Grup autorësh, Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe (Morfologjia), Prishtinë, 1986.
- Instituti i Shkencave, Seksioni i Gjuhës e i Letërsisë, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1954.
- Riza, Selman, *Gramatika e serbo-kroatishtes*, Mustafa Bakija, Prishtinë, 1952, në *Vepra* 2, ff. 317 – 597, AShAK, Prishtinë, 1997.
- Riza, Selman, *Pronorët e shqipes*, në *Studime albanistike*, I, Rilindja, Prishtinë, 1979.
- Topalli, Kolec, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, QSA, Tiranë, 2011.

FEJESAT E NDALUARA NË VENDIN TONË

Shkëlçesë Kurtaj

Martesa, sipas popullit, është traditë dhe obligim zakonor, e cila kontribon në qenësinë e familjes dhe të kombit. Gjithashtu është njëra ndër fazat më të rëndësishme në jetën e njeriut që sipas Antropologjisë kulturore konsiderohen: lindja, martesa dhe vdekja. Për martesën ishin caktuar disa rregulla të cilave i kushtoheshin shumë kujdes. Martesës si pjesa më e rëndësishme e jetës së njeriut i kushtohet mjaftë rëndësi në organizim. Bashkimet e çifteve bëheshin në mënyra të ndryshme, këtij bashkimi i kushtonin shumë rëndësi jo vetë çifti por familjerët e tyre madje edhe i gjithë farefisi, fisi përfshin lidhjet e gjakut ne rrugen atërore dhe ne rrugen amtare. Me këtë organizim merreshin edhe vëllezërit që nënkupton një grup social të përbërë nga familja që zakonisht jetojnë në të njëjtin territor, ndajnë të njëjtin mbiemër dhe arrijnë që të kuptojnë të parin e tyre të përbashkët në rrugën atërore.²⁹⁰

Fejesat

Fejesat janë të llojeve të ndryshme në kulturën tonë, Për të cilat studiuesit shqiptarë kanë bërë ndarjen si në vijim:

1. Fejesa në bark: kjo lloj fejese bëhet në takim të rasteve sidomos në gazmende, si në dasma, fejesa, kumbaria etj., kjo ndodh zakonisht kur dy gra shtatzënë kuptohen në atë ditë shumë mirë me njëra tjetrën, gjithashtu binin dakord për nga rangu familjar që ishte mjaft e rëndësishme, këtë fejesë përveç që e lidhnin gratë e lidhnin edhe burrat sidomos nëse ishin shokë lufte apo ushtrie dhe e dinin që i kishin gratë shtatzënë, kuptohet pasi nuk ishin arritur teknologjite adekuate për të shikuar çfare gjinie kishin fëmijët, ato ndodhte edhe të dështronin.
2. Fejsa në djep bëhet në formë thua se identike me atë në bark vetëm se këtu tanimë dihet gjinia e fëmijeve dhe nuk mund të dështoj vetëm në ndonjë perjashtim kur fëmijet pasi të arrinin moshën e pubertetit nuk dëshironin të lidheshin mes vete.
3. Fejesa në msitni²⁹¹ i kishte rezistuar më së shumti kohërave që kishin përfshirë vendin tonë, kur vajza arrinte moshën e pubertetit nëna e saj e merte atë në ceremoni të ndryshme që ta shihte ndonjë grua, motër apo gjyshe e ndonjë djali i cili poashtu kishte arritur moshën e pjekurisë, që në kulturën tonë ishte zakonisht koha kur qiftet arrin moshën e pubertetit.

²⁹⁰ Nebi bardhoshi, "Analizë e raportit lidhje Gjaku-Martesë", Qendra për studime albanologjike, Instituti i Antropologjisë kulturore dhe i studimeve të artit, Kultura popullore 1-2/2011, Tiranë, 2011f.143

²⁹¹ Uke Xhemaj, shtresime kulturore, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Narti, Prishtinë 2005 f. 168

Siç shihet mendimi i djalit e sidomos i vajzes ishte i pa rendesishëm në bashkimin e tyre, për këtë mendonin familjaret, madje ishte shumë e natyrshme që ata të mendojnë për fatin e fëmijëve të tyre.

Duke pasur parasysh mënyrën e jetesës në atë kohë, kontaktet e vajzave dhe djemeve ishin të pakta. Në shkollë kishte mungesa të vajzave kjo ishte një nder arsyet që meshkujt nuk kishin mundësi të gjenin vajzë për vete,²⁹² mundësia financiare ishte poashtu një arsye pse djali nuk kërkonte nuse vetë, pasuria ishte e përqëndruar në dorën e të rriturve të shtëpisë, kështu fëmja së bashku me të tjerët ishte i detyruar, të punonte ne pronën e përbashkët të familjes së tij. Duke mos pasur asnjëlloj të ardhure, i riu nuk ishte në gjendje të përballonte shpenzimet për martesën e vetë.

Për familjet patriarkale martesat ishin më shume një mareveshje për forcimin e pozitës së tyre për të shtuar fuqinë dhe pasurinë e shtëpisë, për vazhdim të gjeneratës e të emrit të mirë.²⁹³

Për të mbajtur këtë emër (nam), lidhjes miqësore I kanë vendosur disa ndalesa të cilat ishin shumë të rëndësishme. Këto rregulla janë vendosur kryesisht që të mos shuhet familja në rast gjakmarrje, të mos mirret ndonjë nuse e familjes jo të mirë në shtëpi dhe të shpërbëhet familja, të mos e martojë vajzen në një familje që e humbë nderin etj.

Në familjet patriarkale pra nuk shikohej vetëm vajza, zakonisht janë shikuar familjet, prejardhja e vajzës, nëse ishte familje burrnore (trimërore), mikëpritse, nuk ishte në gjak por ishin të qetë dhe mbi të gjitha shumë patriarkal, ajo pëlqej më shumë dhe nuk hezitonte askush të merte apo të jipte vajzë në atë shtëpi, madje konsiderohej nderë i madhë në rast se një familje e tillë kërkonte të lidhte miqësi me familjen e vajzës apo të djalit.

Për këto arsye ndalesat ishin të shumta dhe për këtë arsye unë kam vendosur t'i shtjelloj vetëm disa prej tyre të cilave I kanë kushtuar më shumë rëndësi dhe vëmendje. Më së shumti rëndësi I kanë kushtuar ndalimit të martesave me Gjakë të njëjtë.

Martesat tradicionale, në vendin tonë bazohen në organizimin mbi norma ekzogame, monogame dhe patriarkale²⁹⁴.

Duke pasur parasysh që dikur ishin prezente martesat endogame në kulturën njerëzore me kalimin e kohës martesat preferoheshin të ishin egzogame. Martesat e tilla kishin ardhur graduallisht, njerzitet filluan që të sjellin ligje të reja rreth martesës të cilat më vonë u shëndrruan në tabu. Martesat endogame, nuk kam hasur të kenë egzistuar në Kosovë sidomos jo në shek.XIX ose XX

as në literaturë madje as të përmendur. Ndonje incest i fshehtë ka pasur raste madje edhe gjatë vitit 2011 në të cilën unë kam hasur në teren, por martesat incestioze nuk kanë egzistuar gjatë kësaj periudhe, në vazhdim do e shohim zhvillimin e mënyrës së ndalimit të martesave endogame sipas Engelsit:

Familja e një gjaku: janë familjet që kanë martesat të përbashkëta që I takojnë një familje, vëllezërit e motrat, kushërinjtë e parë, kushërinjtë e dytë, kushërinjtë e tretë dhe ata më të largët, të gjithë janë midis tyre motra e vëllezër dhe për këtë arsye të gjithë janë burrë e grua midis tyre.

²⁹² Mark Tirta, Etnologjia e Shqiptarëve, GEER, Tiranë, 2003 f.272

²⁹³ Mark Tirta, Etnologjia e Shqiptarëve, GEER, Tiranë, 2003 f.272

²⁹⁴ Sabina Vaqorri, Tradicionalitet dhe rishi ne Dasmën Tiranase, Gjurmime Albanologjike Folklor dhe Etnologji nr.40/2010 Prishtinë 2011, f.315

Familjet punaluane përjashtim I mardhënjeve seksuale të vëllaut dhe motrës (spaku të një barku) dmth. nga ana e nënës, kështu disa vëllezër të një barku ose më të largët ishin të martuar së bashku me disa gra, vetëm se jo me motrat e tyre dhe këto gra e quanin shoqja shoqen punaluane.

Familja në çiftet lindi në cakun midis egërsisë dhe barbarisë, këtu ishin ndarë martesat në grupe, por burri shkonte te gruaja dhe në rast ndarje gruaja kishte të drejtën e fëmijëve.

Familja monogame lind nga familja në qifte, i takon periudhës midis shkallës së mesme dhe shkallës së lartë të barbarizës, është bazuar në sundimin e burrit dhe ka si qëllim të theksuar lindjen e fëmijëve, atësia e të cileve të dihet me siguri dhe fëmijët e trashegojnë pasurinë e atit të tyre.²⁹⁵

Këto ndalime kanë qenë te parapara deri në 7 breza large. Që të mos kenë asnjë kontakt edhe më të vogël me familjarët.

Për t'i ikur incestit janë paraparë të ndalohen martesat brenda fisit edhe nëse ndonjë i ndonjë fshatit tjetër ka qenë I fisit të njëjtë me personin e një fshatit tjetër atëherë nuk kanë pasur të drejtë të martohen ngase besohet që kanë lidhje gjaku dhe kanë një të parë të përbashkët. Arsyetimi për t'u mos u martuar me njeri-tjetër bazohet të besimi se ata që kanë gjakë të përbashkët nuk mund të martohen mes tyre sepse fëmija e tyre do të lindin me të meta mendore ose fizike pasi zoti do të ndëshkojë këtë lidhje si të padrejtë.²⁹⁶

Te katolikët e Prizrenit dikur, rreth tri javë para dasmës, prifti çdo të diele pas predikimit gjatë meshës në kishë lajmëronte fejesën e çiftit. Kjo bëhej me qëllim që nëse ndokush di për një pengesë martesë ndërmjet të fejuarve, ta lajmëronte për këtë famulltarin, I cili në atë rast nuk do t'u lidhte kuroren, zakonisht janë 2 pengesa kryesore: afërsia në gjini dhe gjak dhe martesë (nese të fejuarit kanë kunore me dikë tjetër).

Pjesë e ndalimit të martesave ka qenë edhe bashkimi i qiftit të cilët vinin nga I njëjti fshat, pra disa fshatra në Kosovë deri vonë nuk janë martuar me njëri – tjetër edhe nëse ishin fiset e ndryshme, këto fshatra quhen ndryshe edhe fshatra egzogame, kjo është bërë më shumë për shmangie ndaj kontakteve seksuale dhe ikjes nga problemet e ndryshme që mund të sillnin të rinjtë e fshatit duke u ngacmuar me njëri tjetrin, martesat ishin të ndaluara dhe djemtë e fshatit nuk ngacmonin vajzat e fshatit të tyre nëse do ishte ndryshe atëherë ata binin në gjak, këtu shembulli më i mirë për vërtetimin e këtij fenomeni është i quajturi kompleksi I Sokol – Halilit, të cilit i bënin presion kreshnikët e tjerë të martohen, ai u pergjigjej atyre “Në Jutbinë (komuniteti ku jetonte) nuk martohet kurr, sepse të gjitha vajzat e Jutbinës “ si motra i dukeshin” kjo ndalesë vlente edhe për nipat e mbesat e atij fshati.

Ndalese tjetër mjaftë interesante ishte edhe martesë mes personave që kanë ardhur nga një fis duke nderuar identitetin e tyre dhe duke u kthyer në një fis më të madhë, ata janë pranuar nga shoqëria apo nga fisi si vëllazeri, ky ndërrim fisi quhet “ mbështetje” ose “mbathje”.²⁹⁷ Kjo kishte ardhur si rezultat i klasifikimit të rangejve edhe në rast se familja ishte në gjak, zakonisht kur familjet ishin në gjak shkonin në një fshat tjetër për të

²⁹⁵ Fridrich Engels, Origjina e familjës pronës private dhe shtetit, familja, Rilindje, Prishtinë 1976 f.49-79

²⁹⁶ Nebi Bardhoshi, "Analizë e raportit lidhje Gjaku-Martesë", Qendra për studime albanologjike, Institui i Antropologjisë kulturore dhe i studimeve të artit, Kultura popullore 1-2/2011, Tiranë, 2011f.145

²⁹⁷ Nebi Bardhoshi, Analizë e raportit lidhje Gjaku-Martesë, Qendra për studime albanologjike, Institui i Antropologjisë kulturore dhe i studimeve të artit, Kultura popullore 1-2/2011, Tiranë, 2011, f.154

jetuar, aty pastaj pranoheshin nga të tjerët.²⁹⁸ Poashtu martesë e ndaluar ka qenë edhe me persona me të cilët familjet kanë lidhje kumbarie apo vllamnie.

Tabu tjetër ishin edhe fejesat në të cilat ndokush i fshatit kishte probleme apo kishte martesë të dështuara me një fshat tjetër kështu fshatarët vendosnin që të mos ipet apo miret në atë fshat askush spaku për një kohë të caktuar, edhe më strikte ishin ndalesat nëse nga e njëjta familje vëllzërit të njërit i kishte ndodhur që të ketë dështim në një fshate pastaj e njëjta familje nuk lidheshin me askënd tjetër të atij fshati, nëse pranohej që të ketë lidhje të tilla atëherë familja që thyente këtë ligj duhej së pari të pyeste personin që kishte pasur konflikte më parë në kete fshat edhe të merte leje nga ky që të mundë ta bëjë fejesën, nëse nuk ia jep pastaj ai nuk lidhej përndryshe do përjashtohet nga ai vend apo nga ajo familje, megjithatë këto ishin raste të rralla ngase praktikohet shumë që të mos lidhin miqësi s'paku për një kohë të caktuar. Vlenë të përmendim që burrat që lëshonin gruan ia caktonin edhe vendet në cilat fshatra kanë drejtë të

martohen, kjo bëhej që të shmangej miqësia familjare nga qumshti i nënës apo të babait, por edhe te familja e vajzës nuk martohej vajzë dhe nuk merte grua nga ai fshat.²⁹⁹

Vendi ynë është mjaftë i njohur për tolerancën fetare, në Deçan familjet myslimane kanë ruajtur manastirin e Deçanit në periudha të ndryshme politike, megjithatë nuk ishte kështu sa i përkiste martesave, në këto martesë deri tani ishin dhe vazhdojnë të jenë të ndaluara, një çifte përveç disa kushteve që i kishin kërkohej edhe t'i perkasin besimit të njëjtë. Edhe kësaj lloj martesë janë munduar t'i shmangen në mënyra të ndryshme madje duke i martuar vajzat në moshë shumë të re sidomos gjatë okupimit serb dhe periudhës së Osmanlinjëve, nga frika që të mos i grabisin vajzat dhe te martohen me të besimit tjetër, megjithatë ka pasur raste që edhe janë martuar me dhunë por edhe me dëshirë.³⁰⁰

Në kohën e Osmanlive shumë krishterë dhe Ortodoks shëndroheshin në musliman fshehurazi, kështu ata i quanin kripto-krishterë ata martoheshin sipas të dy riteve myslimane dhe krishtere si rregull një dhëndër mysliman duhej te bëhej kripto-krishtere dhe të pagezohej, ata shkonin edhe në xhami edhe në kishë.³⁰¹ Kriptokrishterët njihen në vendin tonë edhe si Laraman me ç'rast një familje mbrenda vetes mund të jete e përzier, një vëlla musliman dhe emrin musliman ndërsa vëllau tjetër dallohej poashtu nga emri se ishte i krishterë.

Gratë gjithmonë kanë ruajtur identitetin kombëtarë dhe besimin e tyre edhe nëse ato martoheshin me një burrë të besimit tjetër prapë ruanin besimin e tyre katolik, këtë na tregojnë misioneret katolik të vitit 1637 gjatë kohës ku kishte mjaftë kripto krishterë, ata shpreheshin të pakënaqur nga kushtet që ekzistonin në Dalmacinë Jugore dhe në Shqipërinë veriore. Malsorët ishin katolik vetëm nga emri, bënëin jetë të shturur dhe shumë prej grave martoheshin me mysliman, megjithatë, shumica e të konvertuarve në Islam ishin burra. Gratë e martuara me Mysliman shpesh ruanin fenë krishtere.³⁰²

Përveç besimit të njëjtë edhe shtresat feudalo klasore duhet t'i përkisnin rangut të njëjtë, familjet zeytare kanë zgjedhur gjithmonë për fëmijët e tyre familje të të njëjtit rang shoqëror, për këtë arsye ka pasur raste të familjeve të njohur si të mbathur, që kanë ardhur t'i përshtaten rangut të njëjtë që ata të mundë të martohen me të tjerët.

²⁹⁸ Rustem Bajraktari, prof. i Gjuhës dhe letërsisë shqipe, 70 vjeç, nga Juniku

²⁹⁹ Po aty

³⁰⁰ Halil Gjirkokaj, Jurist, 75 vjeçar, nga Deçani

³⁰¹ Stavro Skendi, Studime kulturore ballkanike, Botimet IDK, Tiranë, f.255

³⁰² Stavro Skendi, Studime kulturore ballkanike, Botimet IDK, Tiranë f. 261

Fatkeqsisht mjaftë ndikim kishin edhe atëherë kushtet ekonomike, madje ato luanin rol të rëndësishëm nëse një djalë ishte me pasoja fizike ose psiqike por kishte kushte të mira ekonomike ka ndodhur që të i ipet një vajzë e menqur dhe e bukur pa aftesi të kufizuara vetëm se familja e tij kishte kushte të mira ekonomike. Raste të tilla kemi edhe në ditët e sotme, një rast të tillë e kam shënuar në Fshatin Maznik të Deçanit në vitin 2012, më këtë rast janë martuar një djal i cili vjen nga ky fshat por që janë shpërngulur në Gjakovë, familja e të cilit qëndron mirë ekonomikisht por fatkeqsisht djali i tyre ka probleme psiqike, ai është martuar më një vajzë fshatare nga Shqipëria të krahinës së Tropojës ngase vajza kishte kushte të mjerushme në familjen e saj. Ajo është dashur ta marr djalin i cili është me aftësi të kufizara edhe pse vajza gjendet në kushte të mira shëndetsore.³⁰³ Vlenë të përmendim që martesat të cilat dikur bëheshin në bazë të shtresave sot nuk i kushtojnë rendesi, p.sh familjet zeytare kerkojnë që t'i martonin vajzat e tyre më ndonjë tjetër familje zeytare dhe e kundërta. Kjo tanimë ka ndryshuar madje zeytare tani ka shumë pak por edhe ata nuk i kushtojnë rëndësi, gjithashtu familjet e pasura që sot konsiderohen kryesisht biznismenët kerkojnë që femijët e tyre të lidhen me ndonjë më të pasur por megjithatë i mbetet fëmijëve të marrin këtë vendim. Në Shqipëri për këtë aspekt kishte një tjetër ndalim të fejesave. Familjet ishin të ndara në kohën komuniste me ç'rast ishin krijuar shtresa të ndryshme të cilat nuk u martonin me njëri - tjetrin. Ngase disa prej tyre konsideroheshin familje e deklaruar në periudhën komuniste i kushtonin shumë rëndësi martesës mes të rinjëve që familjet e tyre kishin krijuar biografi të mirë, në këtë kohë u krijuan kategori si familje komuniste, familje me biografi të mirë, familje e mirë, familje e prekur, familje e deklaruar nëse ishte anëtare i një familje komuniste do të thoshte se ishte familje e mirë dhe e kundërta do ishte familje e deklaruar d.m.th familjet me biografi të mirë nuk lidhnin miqësi me familjet e deklaruar pas kohës komuniste, kjo qështje ndryshoj dhe nuk ka më ndarje të tilla, aty këtu mund të jetë ndonjë familje që miret me këtë gjë.³⁰⁴ Familjet pra gjithmonë duke u munduar që të qendrojnë burra të ndershëm dhe të ruajnë atë ndershmëri shpesh nuk kanë lidhur martesë edhe me familjet që njiheshin si familje belaxhish të cilët vazhdimisht bënin probleme dhe ishin në gjakë, këto familje nuk konsideroheshin shumë të mira, për disa familje të cilat njiheshin për burra të mirë që nuk bënin probleme megjithatë në disa raste konsiderohen familje e mire ngase mbronin nderin pamvarsisht llojit dhe mënyrave të tyre. Familjet e padëshiruara për miqësi kanë qenë edhe familjet që ishin tradhetare të kombit që në raste lufte apo ndonjë aktivitet tjetër për mbrojtjen e kombit kane qenë laraman kundër njeri – tjetrit apo janë njohur si familje dyftyrësh e nuk kanë qenë shumë të deshiruar për lidhje miqësish, për këtë arsye sidomos mbas luftës së fundit në Kosovë vajzat është dashur të kenë kujdes nëse kishin babain e tyre patriot të mos bien në dashuri me një djal të këtij rangu familjarë. Vajzat që ishin të përbetuara që të mos martohen dhe ishin shëndërruar në të ashtuquajtura virgjërësha nuk kishin drejtë të maroheshin madje askush nuk shkonte që t'i kërkonte ato, ngase martesat e këtij lloji nuk ishin të pranuar në shoqëri e sidomos vajzen e përjashtonin nga familja. Unë kam futur në këtë pjesë ngase mënyra e vetme per

³⁰³ Gani Mehmeti, Bujk, 67 vjeç, nga Mazniku f.9

³⁰⁴ Nebi bardhoshi, "Analizë e raportit lidhje Gjaku-Martesë", Qendra per studime albanologjike, Institui i Antropologjisë kulturore dhe i studimeve të artit, Kultura popullore 1-2/2011, Tiranë, 2011 f.115

prishjen e fejesave pa ndonjë borgj ishte në rast se vajza vendos të behej virgjëreshë, duke u betuar që të mos martohet asnjehere ato duhet të bënin betimin para 12 pleqëve të fshatit e të fisit se do mbeteshin beqaresha dhe pas kësaj do sillen si mashkull,³⁰⁵ me këtë rast familja e burrit nuk kshihte drejtë të kërkonte dëmshpërblim nga familja e vajzës.

Në fund dua të shtoj që në ditët e sotme disa aspkete të së kaluares nuk janë më të ndaluara sidomos jo në atë masë siç ishin dikur, p.sh ndalesat deri në shtatë breza sot më nuk ekzistojnë. Megjithatë sot kemi ndalesa të tjera të cilat në të kaluarën nuk ishin prezente.

Vajzat sot sidomos ato të cilat jetojnë në perëndim i'u ndalohet të martohen me të huajt edhe pse në Kosovë mbas luftës për shkak kontakteve me të huajt shumë vajza janë martuar me ushtarë, puntorët e UN dhe Eulexit. Ndalesë tjetër është edhe ndalesa mes lidhjeve me gjini te njëjtë etj.

Mbas luftës së fundit në Kosovë shumë prind ndalonin vajzat e tyre të bashkoheshin me ndonjë djal që ato gjenin vet, deri u adaptuan me zakonin e ri, duke detyruar vajzat të martoheshin me ndonjë djalë që ia gjenin vet prindërit.

Vlen të përmendim që këtu filloj të rikthehet zakoni i rrëmbimit që ishte dikur. Grabitja si pjesë e pandarë e lidhjes martesore te qiftet përmendet edhe është njëra nder tri llojet e martesave që I ka përcaktuar e drejta zakonore e Laberise.

Martesën e rregulltë e plotësonte kurora, dikur martesat pa kurorë nuk pëlqeshin, shihet pra që grabitja gjithashtu ishte pjesë e dasmes kur nuk ipeshin vajzat për arsye të ndryshme, dikur ishte shumë e përhapur tani kemi mbetje të së kaluarës që janë praktikuar në grabitjen si kthimi I rrugës, shtënja me armë pasi marrin nuesn etj. Rastet e rrëmbimit të nuses të paktën 3-4 shekujt e fundit janë soradike. Të terheq vëmendjen e sinodi imzot Anton Babi-Nigeri, ipeshkevi I Shkodrës(1702-1729), shkruar më 31 mars 1704. në të thuhet, duke porositur famulltarët të kenë

kujdes të mos martojnë grabitësit me të grabiturat ndërsa këto të fundit janë në zotimin e tyre t'ua bëjnë me dije gjendjen ku ndodhen.³⁰⁶

Grabitja si pjesë e pa ndarë e lidhjes martesore të qiftit përmendet edhe është njëra ndër tri llojet e martesave që I ka përcaktuar e drejta zakonore e Laberise:

Martesa me kurore

martesa me shperblim

Martesa me grabitje³⁰⁷

Siç edhe u pa në këtë temë jame munduar t'i shtjelloj disa aspekte me te rendesishme te ndalesave në Kosove, duke bërë krahasime mes ndalesave në të kaluaren me atyre te sotme, kame ardhur në perfundim që ndalesat jane ishin bërë varsisht nga koha dhe menyra e jeteses që femijet të kënë një të ardhme siç ishin mesuar familjaret gjate jetës së tyre. Duke pasur parasysh që në të kaluaren jane shikuar familjet e kategorive te njejt ndersa sot që në shuëm familje egziston frika që femijet e tyre te dashurohen me gjinin e njejt.

³⁰⁵ Robert Ellsi, Leksiku i kulturës popullore shqiptare, besime, mitologji, fe, doke, rite, festa dhe veçori kulturore, Skanderbeg books, shypshkronja Arberia, Tiranë, 2005 f.214

³⁰⁶ Miaser Dibra, Ceremoniali i dasmës në qytetin e Shkodrës, Akademia e shencave e shqipërisë, Instituti i Kulturës popullore, Mësunjetorja, Tiranë, 2004f.143

³⁰⁷ Orjona Shegaj ,Ndikimi i kanunit të Labërisë në dasmën tradicionale Labe, Qendra per Studime albanologjike, Insituti i antropologjise Kulturore dhe studimeve te artit, Kultura popullore 1-2 2010, Tiranë, 2011 f.128

RRUGËTIMI DREJT PARISIT, VATRËS SË KULTURËS

Dr. Valbona Gashi-Berisha

Fakulteti i Filologjisë

Me këtë titull kritik *Parisi kot*, Bajram Sefaj nis rrugëtimin e tij drejt një të ardhme, drejt qytetit më madhështor në botë që është Parisi. Si gazetar, publicist dhe letrar, autori i këtij romani shpesh ka ëndërruar për të vizituar qytetin e kulturës dhe civilizimit evropian. Sefaj i krijon një opsion personazhit të këtij romani, Ndrecit, që bën 'kushtrimin intim se: nuk do të vdes pa e parë Parisin', këtë qytet që ka njohur kohën e artë dhe siç shkruan edhe Walter Benjamin Parisi jo si kryeqytet i Francës por i shekullit të XIX-të¹.

Aty, Ndreci do të takohet me personalitetet më të njohura të diasporës shqiptare. Me shkrimtarin më të famshëm, Ismail Kadaren do të flas për çështje të Kosovës, pastaj do të festoj Ditën e Flamurit, do të marrë pjesë në tubimet e Këshillit Koordinues të Shqiptarëve të Francës dhe në evenemente tjera...

Në këtë mënyrë, shpirti i një mërgimtari siq është ai i Ndrecit-Sefajt, mbart me vete barrën e luftës për liri, mallin për familje, por edhe për Prishtinën. Edhe pse gjatë gjithë jetës, autori e kishte imagjinuar veten në Paris, ai tashmë aty prezent nuk mund të shijonte bukurit e rralla që ia ofronte fati, e kishte kapluar lufta e brendshme shpirtërore e kthimit për në vendlindje.

"Parisi kot" është tregim i përjetimeve tronditëse të ekzodit të personazhit kryesor Ndreci që është vet autori. Rrëfimi personal i emigrimit e ndan këtë roman në dy pjesë kryesore: Pjesa e parë e romanit është përshkrim i ekzodit personal të Ndrecit. Rrugëtimi i tij nuk është i rendomt, ai së bashku me bashkatdhetar të tjerë që i takon gjatë mërgimit, niset drejt një destinacioni të panjohur, drejt ekzodit. Mos ndoshta ky ekzod, kjo ndarje e tij me familjen është njejt sikurse ndarja e motrës së tij nga kjo jetë? Ndreci nuk pushon së menduari se ky rrugëtim nuk dihet se ku fillon dhe ku mbaron.

Pjesa e dytë e romanit është përshkrim i gjendjes shpirtërore të Ndrecit në mërgim, në qytetin që gjithnjë e ka ëndërruar, në qytetin e civilizimit, aty ku është djepi i kulturës, në Paris. Gjendja shpirtërore e Ndrecit në diasporë është e paraqitur me një realitet që e prek shpirtin, jo vetëm të atyre që e kanë përjetuar fenomenin e ekzodit por edhe të atyre që fati i jetës nuk i ka sprovuar me gjëra të tilla.

Jo vetëm gjatë rrugëtimit, por edhe më vonë kur Ndreci vendoset në Paris, autori e paraqet jetën tejet të vështirë të një mërgimtari të cilit nuk ju jipet rasti të lexoi as më të voglin libër. Këtu Sefaj e paraqet filozofinë e ushqimit i cili ushqen trurin e njeriut por, mbi të gjitha Ndreci dhe bashkudhëtarët e tij kanë nevojë të lexojnë librin e shejtë që kërkon organizmi i tyre. Pra, librin e mënyve nëpër resorane. "Është libër mistik dhe i

panjohur për Ndrecin ashtu siq është i panjohur edhe për mijëra bashkatdhetarët e tij^{II}. Është realitet. Por shpresa ekziston “se një ditë të bukur të lirisë dhe të pavarësisë, do t’i lexojmë të gjitha librat që na i sheh syri dhe na i do zemra, pra edhe librin e sofrës”^{III}.

Edhe qyteti i ëndrrave, Parisi nuk i ofroi një jetë luksoze siq e paramendonte mërgimatri ynë i ardhshëm, as ushqimin e shijshëm delicioz francez nuk e shijonte. “Për shqiptarin, si këtu në Paris, si kudo tjetër në botë, hyrja në restorant, si të jetë e ndaluar”^{IV}.

Rrugëtimi i Ndrecit-Sefajt drejt emigrimit

Shqetësimi i autorit nuk është vetëm të siguroj një biletë udhëtimi për personazhin e tij, ai duhet të përkujdeset gjatë tërë ekzodit, që ai të arrin në botën e lirë dhe pa brenga. Fati për të është i tillë që ai të udhëtoj pikërisht në ditën e varrimit të motrës së tij. “Rruga në ditën e varrimit s’ ishte tjetër pos ikje, ikje...”^V. Ikje nga kush? Nga realiteti i hidhur i vdekjes së motrës apo ngjarjeve që ndodhin në vendlindje? Apo të të djave?

Përshtkrimi i rrugëtimin të Ndrecit është një asocim i ekzodit të të gjithë shqiptarëve. Sa i përket këtij rrugëtimi, ai kalon nëpër Maqedoni për të arritur në aeroportin e Sofies i cili: “kishte shfaqur gatishmërinë dhe zemërgjerësinë e bujarinë e tij për t’u ndihmuar shqiptarëve nga Kosova, që sa më shpejt e me ngut ta lëshonin vendlindjen e tyre, t’i lëshonin trojet e tyre etnike, të lëshonin varër e sofër shekullore e, sa më shpejt, aq më mirë, të shpërndaheshin në anë të ndryshme të Evropës dhe të botës. Me shpresë se nuk do të ktheheshin kurrë”^{VI}.

Rruga e emigracionit nuk dihet se ku përfundon për Ndrecin dhe bashkatdhetarët e tij. Aeroplani e sjell në aeroportin e qytetit Maastricht të Holandës. Por, këtu Ndreci nuk ka dëshirë të gjej strehim pasi që edhe emri i qytetit i duket si “mashtrim”.

Prej aty, ai nis në kërkim të vendit ku ai do të mund të jetoj në paqe dhe të vazhdoj veprimtarin e tij krijuese. Pa humbur kohë merr rrugën drejt Brukselit, kryeqytetit evropian, ku edhe shqiptarët kanë formuar një getto. Gjatë këtij rrugëtimin, në veshët e Ndrecit, tingëllon melodinë e këngëtarit Charles Aznavour me origjinë armenase “Bon anniversaire”. (Melodia e kësaj kënge ndoshta e nxisite të mendoj si e kishte sjell fati, në Francë, këngëtarin Charles Aznavour. i lindur rastësisht në Paris, kur prindërit e tij prisnin një vizë për USA).

Plot mëdyshje, Ndreci udhëtonte për në Bruksel por dëshira e tij ishte të gjindej në Paris, së paku për një vizitë. Rruga e mërgimit e bëri që ai të njihej vetëm me shqiptarë, të kishte kontakt dhe sidomos ndihmë. Ndër këta shqiptarë ishte edhe Qamili, shqiptar nga Maqedonia, i cili jetonte në Bruksel dhe kishte një jetë të lumtur që e kishte krijuar me shitoren e luleve. Edhe pse Ndreci i entuziazmuar nga kjo jetë e Qamilit në mendjen e tij thoshte: “se ç’jetë e lumtur është ajo në mërgatë!”^{VII}.

Përsëri Ndreci mori rrugën e mërgimit, këtë herë për në Luksemburg, që sipas këshillave të nikoçirit Qamil, ishte më mirë të jetoj në këtë vend të vogël. Tani ai bënte rrugë me makinën e Mihalit, të cilin e pagëzoi menjëherë Mihal Grameno, pa pasur dëshirën më të vogël të dij për mbiemrin e tij të vërtetë. Gjatë rrugës, muzika e transmetuar nga makina i zgjoi ndjenja Ndrecit pasi që iu duk si melodi shqiptare kënga e famshme e asaj kohe “Ajsha” e Cheb Khaled^{VIII}.

Qëllimi i Ndrecit për të shkuar në Luksemburg ishte, jo për të kërkuar strehim apo për qëllime tjera por atje shpresonte se do ta takonte “bukuroshen flokëbardhë të Dukagjinit”, “Sa për t’a parë. Sa për t’a ditur se në i ka flokët e bardhë. A i ka ende sytë e kaltër qiell? A i ka ende gjinjtë të gufuar, si më parë. E ka ende atë bel të hollë. Ato vithe

të hedhura si më parë. A i ka ende gjinjtë e harlisur, thimthet e të cilëve ishin në luftë të përhershme me rrobër përmbi to...^X.

Por, gjithë këto rrugëtime, gjithë këto qytete nuk e joshnin « mërgimatin e ardhshëm », admirimi për qytetin e ëndërrave sa vinte e shtohet. Ai ishte i magjepsur nga bota artistike pariziene. Për te, Parisi është qendër e botës. Ëndërronte të ishte aty. Ai adhuronte festivalin kinematografik të Cannes. Ëndërra e tij për të raportuar nga Festivali Ndërkombëtar i Filmit në Cannes iu bë fiksion që kur ishte në Prishtinë dhe tani po i rishfaqej.

Dëshira për të vizituar Parisin i kishte ardhur edhe kur studenti shqiptar Ksemili ndiqte aktrimin në Akademinë e Arteve të Bukura në Paris dhe kur kthehet në Prishtinë e nxiste imagjinatën e Ndrecit për këtë qytet të ëndërrave. Janë këto momente që kanë krijuar opsionin e tij duke bërë "kushtrimin intim se " nuk do të vdes pa e parë Parisin"^X.

Mirëpo, në këtë labirint të rrugëtimit të tij Ndreci përsëri kthehet në Bruksel ku takohet me burra "nga të gjitha viset e trojeve shqiptare"^{XI}. Ditët e para në mërgim, ai i kalonte në klubin "Anton Çetta" në Bruksel. Klubi i ofroi mërgimtarit tanë strehim, ushqim dhe një shtat. Një shtat ku kishin fjetur shkrimtar, poet, "personalitete të ndryshme që një ditë do të bëhen burrështetas, kryeministra dhe president"^{XII}.

Aty kishte takuar edhe shqiptar të papunë, "të dëshpëruar, të zhgënjyer". Sodomos atij i bëri përshtypje se në Bruksel, e askund tjetër në vende europiane, mund të takoje shqiptar të ashtuquajtur "zogist të dikurshëm, aderues të Legalitetit, një getto e moçme e "Sh'ipnisë së Vjetër". Gjëja e veçantë në këtë rast është, se shqiptarët tjerë në Bruksel nuk kishin dëshirë t'i takonin dhe iknin prej këtyre aderuesve të Legalitetit sikur këta të fundit të kishin ndonjë sëmundje të tmerrshme.

Përkundër kësaj, Ndreci aty ishte mjaft i mirëpritur si gazetar që ishte i Televizionit të Prishtinës, më pak i njohur si shkrimtar. Gjatë qëndrimit të tij në Bruksel, plot dy javë, kishte bredhur gjithandej dhe ajo që e pengonte, më së shumti në këtë vend, ishte dygjuhësia. Dhe padyshim, ai e krahason Kosovën me Brukselin : që të dyja e "durojnë dhunën e dyemësisë".

Si kurrë më parë, Ndrecit i lindi idea të vizitoi Parisin dhe mendoi se asnjëherë nuk do ta ket më afër se tani. Dëshirën për të vizituar Parisin, e quajti "sëmundje të vjetër", "një obligim". "Thjeshtë Ndreci ishte i ngarkuar, i preokupuar, i sëmurë me idenë e vajtjes atje!"¹³. As vet nuk e kuptonte se prej nga e dashuronte Parisin. Ndoshta pasi që si gazetar por edhe si shkrimtar e adhuronte letërsinë, muzikën, artin në përgjithësi e sidomos artin francez. Ai gjithashtu « admironte gjuhën frënge » të cilën e quan "gjuhë dashurie ».

Ëndërra e kahmotshme u realizua. Tani Ndreci ndodhej në veri të Francës, në qytetin Lille, dhe sikurse kishte shprehur dëshirën ai mund të rrinte "qoftë edhe vetëm një orë, për një çast. Veçsa ta shoh Parisin e lë të vdes"^{XIV}. Madje do të ishte i lumtur që të rrinte "Qoftë vetëm për një kafe"^{XV}.

Pjesa e dytë

Lumturia ishte në kulminacionin më madhështor kur Ndreci zbriti nga treni në stacionin Gare du Nord. Në euforinë e plotë ndodhte ajo që as si gazetar as si shkrimtar Ndreci nuk gjente dot fjalë për të përshkruar këtë gjendje emocionale që po e përjetonte.

Fatkeqësia që e kishte kapluar atë dhe popullin të tij tani, i dukej si më e lehtë, si diçka që donte ta anashkalonte dhe të merrte frymë lirisht në këtë vend hyjnor. Erdhi momenti i shumëpritur. Më në fund ai mund të shijonte kafën e Parisit. I ulur në kafenen Luxembourg, Ndreci shkroi disa kartëpostale, mënyra e tij për të informuar të gjithë se ai tani ishte në qytetin hyjnor. Në kohën kur ai përfundoi së shkruari kartëpostalet, mendoi se duhej të nxitonte të mirrte trenin e të kthehej në Bruksel. Mirëpo fati deshi që para tij të kaloi një person i hendikepuar që i dha më tepër trishtim gjendjes shpirtërore në të cilën gjindej. Personi i hendikepuar sikur ndikoi në mendimet e errëta të tij dhe fuqia e veprimit për të vazhduar më tutje nuk funksionoi kështu që Ndreci mbeti aty, në Paris “qoftë edhe për një natë të vetme”^{XVI}.

Tani dilema: për të qëndruar apo për tu nisur, e kishte kapluar mandjen e Ndrecit, mirëpo muzika që tingëlloi nga parku Luxembourg menjëherë e largoi. Pra, Parisi po e priste me “muzikë e fanfare». Muzikë kjo që kishte mbledh ansamble dhe grupe nga të katër anët e botës e poashtu edhe nga Shqipëria.

Parisi është i mahnitshëm por edhe i tmerrshëm. I tmerrshëm pasi që “ka edhe hijet e veta tejet të errëta». Ditët e para në mërgim, Ndreci i kaloi po thujse mirë, në qytetin ku gjetën inspirim autorët më të mëdhenjë botëror. Ai vizitoi këtë qytet që si emblem ka imazhin e së bukurës dhe që në kujtesën e Ndrecit do të mbeten të pashlyera. Vizitoi të gjitha monumentet e tij, prej lartësisë qiellore të Kullës së Eifelit e deri në banimet e njerëzve të pavdekshëm, tek varreza. Parisin e vizitoi i shoqëruar me librin e autorit Julin Green, *Parisi* ku flet me plot admirim për këtë qytet^{XVII}.

Mirëpo tani po ndodhte diçka që secili i huaj e përjeton kur gjindet në një vend të huaj. Pamundësia e komunikimit: « Tërë bota mbarë pra, e gjallë dhe e vdekur këtu fliste një gjuhë që Ndreci s’e njihnte »^{XVIII}. Ndoshta vetëm Roland Barthes do ta kuptonte gjendjen e tij se : “të jetosh në një vend që nuk ia dijmë gjuhën, të jetosh një kohë të gjatë, jashtë rrethit turistik, është më e rrezikshme prej aventurave(...) ... Nëse do të imagjinoja një Robinson të ri, nuk do ta vendosja në një ishull të shkretë, por në një qytet prej 12 million banorëve, ku nuk do të dinte as të kuptoj fjalën as shkrimin : mendoj se kjo do të ishte forma moderne e mitit”^{XIX}.

Robinsoni ynë, mërgimtari i ardhshëm, gazetari dhe shkrimtari që nuk kishte mundësi të shkruaj dhe as të fliste, gjindej në Paris në mesin e 60 million banorë. Edhe pse nuk dinte të fliste në gjuhën frënge, në kokën e tij zhurmonin fjalët si : Azilant. Ekzil. Ekzodus. Aparteid. Ekzodiadë. Diasporë...

Pas tri javë qëndrimi klandestin në Paris, Ndreci u bë emigrant prej kur u paraqit para institucioneve franceze siq ishte (FTDA France Terre d’Asile. Përpos këtij institucioni, ai duhet të kaloi edhe në « tempullin e shenjtë » siq e quan OFPRA (Office Français de Protection de Réfugiés et Apatrides).

Franca ka strehuar shumë azil kërkues, poet, shkrimtar, artist, burrshtetas e tani radha ishte e Ndrecit “i dyti “shkrimtar shqiptar” siq e quante veten. Këtu Sefaj bënë aluzion pas shkrimatri Ismail Kadare.

Në Paris, Ndreci u gjend në mesin e shumë intelektualëve shqiptarë. Pas një kohe ai filloi edhe të shkruaj artikuj të ndryshëm në gazetën Rilindja që botohej në Zvicër, pasi që botimi i saj ishte ndaluar në Prishtinë. Tani gëzimi i Ndrecit nuk kishte kufi, nuk u besonte syve sikur të shihe citimin e « famshëm » : « Nga korrespondenti ynë në Paris »^{XX}.

Në Paris, Bajram Sefaj gjeti burimin e inspirimi që e kishte ëndërruar prej kohësh. Aty i dha mundësi personazhit të vet të ftoj dhe të takohet me shkrimtarin e famshëm I Kadare, në kafën “café de Flore” (është vend ku artistët dhe intelektualët dëshirojnë të takohen për të ruajtur në njëfarë mënyre imazhin e Sartrit, Camus, Prevert...)

Përshkrimi i takimit të Sefajt me shkrimtarin më të njohur, “më të shquarin e këtij shekulli” e paraqet si të veçant, madje edhe si “historik”. Autori bënë një përshkrim madhështor për shkrimtarin më të famshmin dhe në këndvështrimin realist flet “për jakën e mantelit të ngritur pas qafes që, në Shqipërinë e ortodoksisë së egër komuniste, ishte privilegj vetëm e vetëm për shkrimtarin më të madh kombëtar shqiptar të të gjitha kohëve”^{XXI}.

Pastaj ai flet me një emocion tejet të theksuar për Jusuf Vrionin si intelektual i më i madhi shqiptar, dhe për tërë një plejadë krijuesish dhe intelektualësh shqiptar që autori bënë një homazh respekti dhe admirimi që ka ndaj tyre.

Pas një kohe fare të shkurtër (4-5 muaj) qëndrimi në Paris, Ndrecin e kaploi një pikllim i thellë vetmie në mëgrim. Malli për gruan dhe dy fëmijë që i kishte lënë në Kosovë sa vinte e rritej. Pësia e rëndë e pikllimit bëhej e paduruar për shpirtin e lënduar të mërgimtarit. Ëndërra e kthimit në vendlindje nuk e linte të flinte rehat. Madje, nga mendja nuk i hiqej të kthehej me dy libra të shkruara aty, në mëgrim. Librin e parë do t, ia kushtonte bashkatdhetarëve të tij dhe do ta titullonte: “Midis fisnikësh”, ndërsa të dytin do t, ia kushtonte qytetit të ëndërrave : “Kur Parisi zbret nga qielli”.

Parisi i ëndërrave, për mërgimtarin tanë, nuk ishte edhe aq hyjnor sa e kishte imagjinuar ai: “si çdo qytet tjetër në botë, edhe Parisi ka faqen e vet të bardhë, fort të shkëlqyer, por, në anën tjetër, ka edhe anën tjetër, të ngrysur, të errët... ka faqen e zezë, pa hezitim!”^{XXII}.

Miti mbi Parisin kishte kaluar nga Parisi i errët në Parisin e dritës dhe nga Parisi i ditës në Parisin e natës ashtu siç e ka paraqitur edhe Jean-Pierre Bernard.

Imazhi i Parisit sa vinte e zbehej për Ndrecin, i dukej i trishtuar, i zymtë e madje edhe i papastër nga qentë që i shihte ngado e poashtu edhe ata të cilët ishin të vendosur në “hotel” siq e quan ai qendrën e “qenëve të të gjitha racave”^{XXIII}. Ai me një ironi të theksuar përshkruan edhe dyqanin, që ishte ngjitas me “hotelin”, ku mund të gjeje gjërat më elementare ushqimore dhe veshmbathje e deri te parfumet pa e harruar se aty gjindej edhe mjeku i tyre, pra veterinari. I tronditur nga ky imazh i Parisit, Ndreci nuk do të shkruaj romanin për Parisin, këtë do t, ua lë shkrimtarëve që janë në hotel të tipit Zhorzh V (Georges V) të cilët “pinë më shumë uiski e shampanjë shumëbardhë, sesa emigrant shqiptar pi ujë robineti”^{XXIV}. Në këtë gjendje emocionale në të cilën ndodhej Ndreci nuk mund të shkruante për Parisin e ta paraqiste atë si qytet ku mund të jetohej në luks e mrekullira që ai nuk i përjetonte. Do të dëshironte aq shumë të shkruante një roman me titull “Paris, je t’aime” por realiteti nuk e frymëzonte dot. Që ëndërra e tij e dikurshme të rishfaqej, që ta adhuronte Parisin si dikur, që të fliste ato fjalë nga më hyjoret, Ndreci duhej të kthehej në vendlindje dhe nga Prishtina ta imagjinonte si dikur qytetin e ëndërrave. Pasi hoqi nga mendja të shkruaj për Parisin, Ndreci u tërhoq dhe pothuajse u izolua në dhomën e tij të vogël, aty në Paris. Filloi ta brente pak nga pak vetmia, sa që edhe kur shkruante ndonjë poezi nuk kishte kujt t, ia lexonte si dikur në vendlindje, dhe sapo i shkruante, i griste « pa i parë sy njeriu! »^{XXV}.

Idet e errëta kishin zënë fill në kokën e tij prej mërgimtari. Gjendja emocionale e kishte kapluar në një pikë të rëndë dëshprimit dhe tani nuk gjente ndonjë mbështetje sado e

vogël të ishte. Dëshpërimi kishte hyrë thellë në shpirtin e tij sa që disa herë mendoj për vetvrasje.

Vetmia ishte ngado ku shkonte Ndreci. Ishte prezente edhe në natën e vitit të ri 1994, në dhomën e vogël sa “një kuti shkrepse” në 163, rue de Rennes, në arrondissement 6, në “tryezën solemne për vetëm një person”^{XXVI}. Sefaj nuk harron të përshkruaj edhe prejardhjen e produkteve që gjinden mbi këtë tryezë, gjë që e bënte tryezë ndërkombëtare “Një univers kozmopolitizimi, në miniaturë, që ka fuqi shkatërrimtare, që prish e shemb çdo iluzion, që, aty për aty, pra, deziluzionon se gjendesh diku tjetër. Diku në një metropol në zë, siç është në zë Parisi.”^{XXVII}

Pasi që shoqëruesja e tij për natën e vitit të ri ishte vetmia, ai kishte vetëm një dëshirë: të luante lojën e dikurshme me eshtrat e pulës që e kishte blerë në lagjen arrondissement 10, në rrugën Saint-Denis. Pra, “digjej të luante jadec...! T,i vinte në lojë dy duart e veta?! / Të djathtë kundër të majtës? / Të majtën kundër të djathtës?»^{XXVIII}.

Mendimet e errëta e shkatërronin deri në atë masë sa që Ndreci dorëzohej dhe kjo gjendje e mjerueshme e përcillte edhe kur ishte në gjumë. Makthi nuk e linte rehat as ditën as natën, nuk mund të flinte e as të hante, madje “Bukës dhe ujit ia kishte harruar shijën. Mbase edhe pamjen!»^{XXIX}.

Qrregullimi shpirtëror ndikonte mjaft në jetën e përditshme. Ai vendosi që « për të ruajtur baraspeshën, ekuilibrin, higjienën mentale »^{XXX}. të mirret me shkrime. Ndreci filloi të shkruaj së pari : për metrot e Parisit, pastaj për bukinistët, për 33 urat e Parisit. Në këto momente shkrimi, lexuesi mendon se vegimet e tij janë larguar me të vërtetë dhe se kishte gjet shpëtim, mirëpo ndodh vendimi i papritur që çdo mërgimtar dëshiron : kthimin në vendlindje. Por, nuk ishte kthim i rëndomt : « Kishte vdekur me shpresë se valët e ujërave në kullim, herëdokur, hirin do t,ia sillnin, së pakut, në ujërat e vendlindjes.»^{XXXI} »

Bajram Sefaj i ka sjell letërsisë shqipe shkrime të shumta me tematika të kohës aktuale e sidomos me romanin *Paris kot* ai flet nga hapsira e përjetuar e mërgimit, me një imazh tejet tronditës të jetës jashtë atdheut. Përshkrimi i Parisit bëhet aq real dhe aq prekës sikurse në shkrimet e Annie Ernaux mbi luftën e ballkanit. E tërë fuqia tragjike e këtij shkrimi është se autori e vështron Parisin në një kontekst krejt tjetër, në atë të mërgimtarit të vetmuar në një metropol me miliona njerëz ku vetmia shpirtërore por edhe fizike e bëjnë që ai të përjeton dyshime, ankthe dhe vegime të shumta.

Çdo largim nga atdheu është një ndarje, një vdekje sikurse edhe udhëtimi i Ndrecit ditën e varrimit të së motrës.

Sefaj paraqet me një realitet të hidhur fatin e mërgimtarit, pikërisht të Ndrecit, symbol i mërgimtarit shqiptar, që largohet prej atdheut në kërkim të një jete normale. Ai është i lumtur vetëm në vendin ku ka lind dhe se, dëshpërimi e përcjell ngado që shkon. Endërrat e tij për të udhëtuar dhe për të kuptuar botën reale u shfaqën në momente të vështira vuajtje për te dhe për popullin e tij. Momente këto që i ka përjetuar populli shqiptar, me largimin nga vatra e vet drejt një destinacioni të panjohur. I dashuruar pas librit, Sefaj gjen ngushëllim me takime të shkurtëra (sa për të pirë një kafe) me shkrimtar: si Ismail Kadaren apo edhe me përkthyesin e njohur Jusuf Vrionin dhe veprimtar tjerë shqiptar në Paris.

Ndreci udhëton drejt horizontit ku kanë mërguar edhe më parë shqiptar të shumtë, mirëpo ëndërra e tij është të jetë pjesë e botës së famshme të Parisit. Si mërgimtar intelektual, ai dëshiron të integrohet, dëshiron të shkruaj, jo vetëm reportazhe por edhe

romane, të jep përshkrime për Parisin. Mirëpo, realiteti i hidhur e drejton në destinacionin e ankthit të tmerrshëm të vetmisë që fillon dhe e shkatërron drejt izolimit shpirtëror.

SISTEMI I NJOHJES PAMORE TË FJALËS

Dr. Zamira Shkreli

Universiteti I Shkodres "Luigi Gurakuqi"
Instituti I Studimeve Albanologjike

Abstrakt

Në këtë shkrim autorja sjell në vëmendje se funksioni i një sistemi njohjeje pamore të fjalës duhet të pranohet, në input, informacioni i përgjithshëm nga një fjalë e shtypur ose e shkruar dhe të prodhohet, në input, një identifikim abstrakt i asaj fjale. Ajo na njeh me propozimet e studiuesve dhe kërkuesve të shquar pra mënyra në të cilën stimuli i shtypur është përkthyer në fjalë abstrakte. Studiuesja e re vëren se duke u nisur nga konteksti, zakonisht nuk është shumë efikas, përsa ligjërimi është thelbësisht i paparashikueshëm. Meqë në njohjen dëgjimore të fjalës ndiejmë tinguj të ndryshëm në sekuencë, është e mundur të përdorim informacion kontekstual pasi të kemi dëgjuar pjesë të fjalës – në këtë rast, një informacion i tillë mund të përdoret realisht.. përkundrazi, njohja pamore e fjalës nuk vepron duke analizuar pjesë të stimulit. Përmbledhtas në këtë artikull është trajtuar njohja e fjalëve të folura e të shtypura. duke u mbështetur në përshkrimet e modelit Johnston-McClelland të njohjes pamore të fjalës dhe modelin coorte të njohjes dëgjimore të fjalës.

Është e njohur tashmë se funksioni i një sistemi njohjeje pamore të fjalës duhet të pranohet, në input, informacioni i përgjithshëm nga një fjalë e shtypur ose e shkruar dhe të prodhohet, në output, një identifikim abstrakt i asaj fjale. Me identifikimin *abstrakt* kuptojmë faktin që aftësitë semantike dhe fonetike të fjalës nuk janë të specifikuar në daljen e sistemit të njohjes pamore të fjalës. Një shembull identifikimi abstrakt është një afirmim tip, si ta zmw: "Kjo është fjala numër 538". Një afirmim i tillë nuk na thotë asgjë për domethënien e fjalës – për të zbuluar semantikwn e saj duhet transmetuar kodi 538 në sistemin semantik. Në mënyrë analoge, nëse duam të shqiptojmë fjalën, duhet të transmetojmë kodin 538 në sistemin e outputit të ligjërimin, për të pasur përfaqësimin fonologjik korrespondues (përgjegjës).

Një model i rëndësishëm i sistemit të njohjes pamore të fjalës ka qenë propozuar nga studiuesit dhe kërkuesit e shquar Johnston dhe Mc Clelland,³⁰⁸ mënyra në të cilën stimuli i shtypur është përkthyer në fjalë abstrakte. Johnston dhe Mc Clelland propozojnë një sekuencë prej katër stadesh përpunimi:

- a) parapërpunimi i pozicionit të shkronjës,
- b) përcaktimi i karakteristikave,

³⁰⁸J.C. Johnston, and J.L. McClelland, Experimental tests of a hierarchical model of word identification, 1980.(marrë nga M.Harris & M.Coltheart, Lelaborazione del linguaggio nei bambini e negli adulti, il Mulino, 1991, f. 155.)

- c) përcaktimi i shkronjës abstrakte,
- d) përcaktimi i vetë fjalës.

Në stadin e parë, *parapërpunimi i pozicionit të shkronjës*, do të thotë qw, çdo shkronjë në një fjalë është thjesht e izoluar nga konteksti dhe tregohet pozicioni rendor i saj. Rezultati është kodifikimi i fjalës si sekuençë njollash pamore, jo të analizueshme, ku, secila prej tyre, del e shënuar me pozicionin e saj rendor (i pari, i dyti, i treti, etj.) në sekuençën e njollave.

Në këtë procedurë studimore ka një stad të dytë, ku, në bazë të analizave, arrihet tek karakteristikat e disa fjalëve në vështrim.

Në stadin tjetër, përcaktimi i shkronjës abstrakte, të tridhjetw e gjashtw shkronjat e alfabetit janë paraqitur nga tregues të veçantë të shkronjave. Çdo tregues i karakteristikave në stadin e përcaktimit të vecorive lidhet me çdo përcaktues të shkronjës në stadin e përcaktimit të saj. Nëse janë, për shembull, 20 tregues të ndryshëm karakteristikash, ka $20 \times 36 = 720$ bashkëlidhje ndërmjet dy niveleve. Secila nga këto bashkëlidhje ka një funksion ngacmues. Çdo tregues karakteristikash u transmeton eksitim treguesve të shkronjave për shkronjat që përmbajnë dhe janë ndaluese për të gjitha të tjerat. Kështu, për shembull, nëse zbulohet aspekti *borw nw mal* do të ngacmohen tregues të shkronjës me atë karakteristikë (si: b, r ose o), dhe ndalohen të gjithë treguesit e shkronjave, për shkronja të privuara nga një karakteristikë tjetër (si: n, a ose l).

Treguesi i germw, për një shkronjë çfarëdo (marrim shkronjën R, bie fjala) shërben për ta identifikuar, pa marrë parasysh forcën e saj të saktë pamore: për shembull e madhe, e vogël, italic, bold etj. dhe forma dorëshkrimi të shkronjës R identifikohen të gjitha nga i njëjti tregues shkronjash. Kjo bëhet sepse treguesit e shkronjave konsiderohen në nivelin *abstrakt*: nuk japin informacione mbi një formë të veçantë pamore. Nga kjo del që një lexues, që sapo ka identifikuar një shkronjë të veçantë, nuk do të jetë në gjendje të thotë nëse ishte e madhe apo e vogël në bazë të informacioneve në nivelin e treguesit të shkronjës. Informacioni konkret i këtij tipi duhet të jepet në ndonjë mënyrë tjetër (për shembull, nga treguesi i karakteristikave).

Eksperimentet tregojnë qw, kur fjalë dhe shkronja paraqiten shumë shpejt, subjektet-fëmijë ngandonjëherë janë në gjendje të thonë se cilën shkronjë apo fjalë kanë parë, por jo nëse ishte e madhe apo e vogël.³⁰⁹ Këto eksperimente japin prova të vlefshme në të mirë të ekzistencës së një sistemi treguesish të shkronjës në nivel *abstrakt*. Megjithatë, është e vështirë të shohësh me saktësi se si nivelet e përcaktimit të karakteristikave dhe të përcaktimit të shkronjës në nivelin abstrakt, mund të lidhen në mënyrë të tillë për të përcaktuar një shkronjë, pa marrë parasysh karakteret me të cilët përfaqësohet.

Problemi është se, për disa shkronja, karakteristikat që vërtetohen në forma të mëdha e të vogla (si "E" dhe "e") janë të ndryshme. Kështu, për shembull, një karakteristikë si *Era fryn* transmeton ngacmime treguesit të shkronjës që vlen për E të madhe dhe *Po fryn erë*, transmeton ndalime ashtu si mundet treguesi "E" të ngacmohet nga stimuli "e".

Ky problem nuk është konsideruar ende në raport me modelin Johnston – McClelland, në të cilin ka një rëndësi themelore, sepse me të ndalimi është absolutisht vendimtar. Pavarësisht nga sasia e stimuljeve të ngacmuar që një tregues shkronje merr prej treguesit

³⁰⁹ M. Coltheart, and R. Freeman, *Case alternation impairs word identification*, 1974, (marrë nga: M. Harris & M. Coltheart, *L'elaborazione del linguaggio nei bambini e negli adulti*, il Mulino, 1991, f. 157)

të karakteristikave, një tregues shkronje të cilit i shtohet edhe vetëm një stimul frenues, është plotësisht i shkëputur. Treguesit e shkronjës për P e R do të marrin të dy impulse ngacmuese nga treguesit e karakteristikave *kontorno vertikale* dhe *kurbë anësore*,³¹⁰ nëse është paraqitur një R. Sidoqoftë, treguesi P do të jetë shkëputur në vazhdim të frenimit të transmetuar nga treguesi i karakteristikave *kontorno e pjerrët*. Nga ky koncept i stimulit frenues rrjedh që aktivizimi në nivelin e përcaktuesit të shkronjës, do të jetë gjithçka ose asgjë: kur paraqitet një shkronjë, treguesi për këtë shkronjë aktivizohet plotësisht dhe treguesit për të gjitha shkronjat e tjera mbeten të palëvizshme.

Teza e rëndësisë vendimtare të ndalimit mund të moderohet: aktivizimi i treguesve të shkronjës mund të jetë pak a shumë përveç gjithçka ose shumë. Në këtë rast sasia e përgjithshme e aktivizimit të një treguesi do të përcaktohej nga sasia e ndalimit. Kështu, stimuli R do të ngacmonte plotësisht treguesin R, treguesin P dhe treguesin B dhe treguesit e shkronjave të tjera me masë shumë më të vogël. Kjo alternativë është përshtatur në modelin e njohjes së fjalës së propozuar nga studiuesit e kësaj fushe. Siç është konstatuar, megjithatë, konceptimi i aktivizimit gjithçka ose asgjë, mund të jetë shumë i vlefshëm, i vërtetuar nga rezultate eksperimentale, që vlerësojnë hipotezën e Johnston e Mc Clelland mbi rëndësinë vendimtare të frenimit.³¹¹

Me këtë përshkrim mbyllet faza e modelit të Johnston e Mc Clelland, si *zbulim i fazës abstrakte*. Të njëzet e gjashtë shkronjat e alfabetit³¹² kanë lidhje me të gjitha fjalët në nivel treguesi të fjalës, për shqipen, kemi të bëjmë me alfabetin tonë, prej 36 shkronjash-fonema. Sipas gjuhëtarëve, çdo lidhje është ngacmuese e frenuese dhe, sërish, frenimi është vendimtar: një stimul i veçantë frenues është i mjaftueshëm që të pengojë aktivizimin e një treguesi të fjalës, pavarësisht nga sasia e stimujve nxitës të marrë. Kështu, nëse sjellim çiftin e fjalëve shqipe, fonetkisht të afërta, por pa lidhje semantike, si: *bari / barí* stimuj nxitës nuk janë shkronjat/tingujt e parë, por diferencimi ndodh nga zhvendosja e theksit. Frenimi këtu vjen nga theksimi dhe ky tip frenimi do të mund të ndodhte, nëse përfshihet ndër treguesit e shkronjave edhe një tregues hapësire, i aktivizuar nga mungesa e stimujve e nga niveli i treguesit të karakteristikave. Aktivizimi i këtij treguesi hapësire do të frenonte të gjithë treguesit për fjalët që përmbajnë më shumë shkronja se fjala shenjë. Ky tip treguesi i finales-së-fjalës (pjesës fundore) është diskutuar nga Humphreys, Quinlan dhe Evett.³¹³

Modeli Johnston-McClelland mund të duket mjaft i komplikuar, me nivelet e tij të shumta, me treguesit e tij të shumtë për çdo nivel dhe me ndërbashkimet e shumta të tij ndërmjet niveleve. Sidoqoftë, ky model është mjaft i thjeshtë për mundësitë e tij parashikuese dhe është mundur t'ua nënshtrijmë testeve eksperimentale, prej të cilëve ka dalë me sukses; të cilët tash duhen përshkruar, së paku disa prej tyre.

Për të kuptuar aftësinë parashikuese të modelit, duhet më parë të shqyrtojmë fenomenin e *maskimit pamor paraveprues*, meqë logjika e eksperimenteve varet nga fakti i përdorimit të një maskimi. Kur paraqitet shkurtimisht një fjalë shenjë në takistoskop, edhe detyra e

³¹⁰ Me terma të tillë "kontorno", "kurbë" pajisen tabela të ndryshme eksperimentale, të cilat paraqiten në punën me subjektet-fëmijë gjatë observacioneve dhe proceseve gjuhësore. (Autorja)

³¹¹ J.C. Johnston, and McClelland, Experimental rests of a hierarchical model of word identification, 1980, f. 157.

³¹² *Ky numër i shkronjave (26), lidhet gjithnjë me alfabetin e anglishtes, gjuhë në të cilën janë realizuar studimet e para të kësaj fushe kërkimore. (Autorja).

³¹³ G.W.P.T., Humphreys, and L.J., Evett, Automatic orthographic priming: implications for processing orthography, 1983, f. 268.

subjektit është të referojë fjalën, aftësia për ta bërë është e kufizuar, nëse fjala pasohet nga një stimul tjetër (*një maskim prapaveprues*) në vend të paqartësisë. Ka dy tipa të ndryshëm të maskimit prapaveprues:

- maskimi për shkëlqim dhe
- maskimi për strukturë.³¹⁴

Në *maskimin për shkëlqim*, përdoret një fushë shkëlqimi homogjene pas fjalës shenjë. Fusha sillet sikur të kishte qenë paraqitur në mënyrë simultane me paraqitjen e shenjës dhe redukton kështu, kontrastin ndërmjet përvijimeve të shenjës dhe sfondit (domethënë, konturet e shenjës do të duken gri në vend të të zezave). Nëse stimuli i maskuesit prapaveprues për shkëlqim vjen menjëherë pas shenjës dhe është mjaft i shndritshëm, do të reduktojë kontrastin në paraqitjen e shenjës deri në atë pikë që konturet të mos diskriminohen nga sfondi dhe shenja të mos mund të identifikohet. Maskimi për shkëlqim mund të konsiderohet si operues, sidomos në nivel të treguesit të karakteristikave, duke kufizuar diskriminueshmërinë e karakteristikave të shenjës, ai bën të vështirë dallimin (ose të pamundur, nëse maska është mjaft e shndritshme). Me fjalë të tjera, rezultati i maskimit për shkëlqimin është një *mangësi karakteristikash*.³¹⁵

Në *maskimin për strukturë*, stimuli që pason shenjën e paraqitur shkurtimisht nuk është një fushë homogjene, por përmban konture; për shembull një seri e renditur rastësisht me fragmente linjash të drejta dhe të përkulura. Një maskim për strukturë do të pengojë përcaktimin e shenjës jo vetëm duke provokuar një mangësi karakteristikash, por duke provokuar edhe një *kufizim kohe*. Supozojmë që shenja është një letër. Karakteristikat e saj do të dalin në pah në nivelin e treguesit të shkronjës për shkronjën shenjë. Nëse detyra e objektit është të referojë shkronjën, gjithashtu, është e nevojshme një punë e fundit: kodi abstrakt për shkronjën duhet të rrjedhë e të transmetohet nga sistemi leksikor i përshtatshëm i outputit. Supozojmë tash që një maskim i modelit është paraqitur gjatë intervalit të kohës ndërmjet aktivizimit të treguesit të shkronjës në sistemin e outputit të përshtatshëm. Meqë maska është modeluar, do të përmbajë karakteristika të përcaktuara nga treguesi i karakteristikave. Është shumë e mundshme se disa nga këto karakteristika të shfaqura *nuk* do të jenë të pranishme në shenjë e kështu përcaktimi i karakteristikave jo shenjë në stimul maskues *do të lërë pa hyrë në veprim aktivizimin në treguesin në shkronjën shenjë*, përmes frenimit nga niveli i karakteristikave në atë të shkronjës. Meqë kodi i shenjës ende nuk është transferuar në një sistem leksikor outputi, nuk do të ketë më një përfaqësim të shenjës në një pikë të çfarëdoshme. Në këtë mënyrë, një maskim për strukturë kufizon kohën e përfaqësimit të një shkronje-shenjë në sistem, dhe, nëse një kufizim i tillë i kohës është mjaft i madh për ta penguar në kodin e shenjës që të arrihet një sistem leksikor outputi, atëherë subjekti nuk do të arrijë të referojë shenjën, *edhe pse shenja ishte e identifikuar, në kuptimin që treguesi i tij në sistemin e outputit leksikor ishte aktivizuar*.

Për sa është thënë mbi diferencën ndërmjet maskimit të shkëlqimit dhe maskimit për strukturë, është mbështetur nga vrojtimit introspektive të subjektit në eksperimentet

³¹⁴ M.T. Turvey, On peripheral and central processes in vision, 1973, (marrë nga: M.Harris & M.Coltheart, L'elaborazione del linguaggio nei bambini e negli adulti, il Mulino, 1991, f.159)

³¹⁵ J.C. Johnston, Understanding word perception: clues from studying the word-superiority effect, 1981. (marrë nga: M.Harris & M.Coltheart, L'elaborazione del linguaggio nei bambini e negli adulti, il Mulino, 1991, f. 159-160.)

mbi maskimin. Në maskimin për shkëlqim, subjektet referonin që, ndonëse shenja dukej e pranishme për një periudhë arsyetimisht të gjatë, ishte përcaktuar në mënyrë shumë të mjegullt – kontrasti i tij ishte i pamjaftueshëm – për të qenë i identifikueshëm. Ndërsa, me maskimin për strukturë, subjektet referonin se kishin parë një shenjë neto, të qartë e shumë kontrastues për një periudhë kohe shumë të shkurtër, tepër të shkurtër për të identifikuar shenjën.

Kemi përshtuar vetinë e maskimit për shkëlqim dhe për strukturë, për të treguar se si studimet mbi njohjen e shkronjës dhe të daljes në eksperimentet me maskimin prapaveprues (retroaktiv) mbështesin modelin e përdorura nga studiuesit për arritjen e rezultateve eksperimentale.

Bibliografi

1. J.C. Johnston, and J.L. McClelland, Experimental tests of a hierarchical model of word identification, 1980, (marrë nga M.Harris & M.Coltheart, L'elaborazione del linguaggio nei bambini e negli adulti, il Mulino, 1991).
2. M. Coltheart, and R. Freeman, Case alternation impairs word identification, 1974, (marrë nga: M.Harris & M.Coltheart, L'elaborazione del linguaggio nei bambini e negli adulti, il Mulino, 1991).
3. J.C. Johnston, and McClelland, Experimental tests of a hierarchical model of word identification, 1980.
4. G.W. P.T., Humphreys, and L.J., Evett, Automatic orthographic priming: implications for processing orthography, 1983.
5. M.T. Turvey, On peripheral and central processes in vision, 1973, (marrë nga: M.Harris & M.Coltheart, L'elaborazione del linguaggio nei bambini e negli adulti, il Mulino, 1991).
6. J.C. Johnston, Understanding word perception: clues from studying the word-superiority effect, 1981. (marrë nga: M.Harris & M.Coltheart, L'elaborazione del linguaggio nei bambini e negli adulti, il Mulino, 1991).

FJALËT E HUAJA NË GJUHË SHQIPE PËRMES TERMINOLOGJISË SË INFORMATIKËS

Abdurrahim Maxhuni

Instituti albanologjik – Prishtinë

Abstrakt

Gjuha shqipe sikurse edhe gjuhët e tjera përballet vazhdimisht me fjalë të reja. Fushat që më së shumti huazojnë fjalët të huaja janë të shumta, duke filluar nga mediet, ekonomia, politika, teknologjia etj. Zhvillimet e mëdha teknologjike kanë bërë që shumë vende të huazojnë së bashku me teknologji edhe emërtimin e saj. Terminologjia e informatikës ka vërsuar çdo gjuhë, duke përfshirë edhe gjuhën shqipe. Gjuha shqipe është e pasur dhe ka aftësi të krijojë fjalë nga gurra e saj. Për shumë fjalë të kësaj terminologjie shqipja ka barasvlerësin e saj shqipe. Përmes këtij punimi do të përpiqemi të shohim mundësinë e zëvendësimit të fjalëve të huaja, që kryesisht vijnë nga gjuha angleze, me gegjësin e saj shqip.

Fjalët çelës: Fjalë të huaja, terminologji, informatikë, zëvendësim.

Hyrje

Gjuha shqipe po përballet me trusni të vazhdueshme të terminologjisë nga fusha të ndryshme. Terminologjia e kompjuteristikës është një fushë që po ushtron ndikim të madh në leksikon e gjuhës shqipe. Me përparimin e teknologjisë së informatikës, shqipja çdo ditë po vërshohet nga terminologjia e kësaj fushe. Numri i tyre është relativisht i madh, si: *maus, disk, internet, kompjuter, printer harduer* etj. Duke e pasur parasysh këtë numër të madh të fjalëve me veçori terminologjike, prof. Shefkije Islamaj (2007) me të drejtë thotë se mund të thuhet se filet për një gjuhë të re – gjuhën e internetit.

Nëse e shohim nga aspekti historik, gjatë historisë së saj, gjuha shqipe është përballur me trusnin e vazhdueshme të fjalëve të huaja. Gjuhësia shqiptare që nga fillimet e saj ka treguar kujdes për pastërtinë e gjuhës shqipe. Përpjekjet e para i gjejmë tek shkrimtarët e vjetër. Përpjekjet vazhduan edhe nga rilindësit. Ata u nisën nga nevoja për pastrimin e gjuhës letrare shqipe. Nuk i hoqën elementet e huaja, nëse ato nuk e dëmtonin gjuhën letrare shqipe. Pasurimi i gjuhës letrare shqipe duhet të bëhet me mjetet e gjuhës shqipe dhe jo me huazime, pasi që shqipja ka mundësi të mëdha shprehëse dhe pasuri të mëdha leksikore frazeologjike.

Gjuhëtari i shquar shqiptar Eqrem Çabej, duke trajtuar çështjen e pastërtisë së gjuhës shqipe, shkruante: “Një ndër detyrat kryesore të gjuhësisë shqiptare, krahas kërkimeve teorike, është edhe mbetet pasurimi i gjuhës me elemente të gurrave vetjake dhe

spastrimi i saj prej masës së fjalëve të huaja, që kanë vërsuar së jashtmi dhe që po vazhdojnë edhe ne ditët tona.”³¹⁶

Siç dihet nga parimet e gjuhësisë, leksiku është ajo pjesë e gjuhës që huazohet më së shumti dhe më së lehti, sepse fjalët vijnë bashkë me emërtimet e gjësendeve të ndryshme (krahaso: ang. *Computer, hardwar* etj. shqip *kompjuter, harduer*). Këtu kemi të bëjmë me dukurinë gjuhësore që quhet huazim gjuhësor, por kemi të bëjmë gjithashtu me një dukuri të veçantë që shprehet e pasqyrohet në shumicën e gjuhëve të botës, që është bërë pjesë e këtyre gjuhëve, e që quhen terma ndërkombëtar ose ndërkombëtarizma.

Rëndësia që ka terminologjia, duke përfshirë edhe terminologjinë e teknologjisë së informatikës, për funksionet që kryen si pjesë përbërëse e leksikut të shqipes, zgjerimi i përdorimit të saj dhe përfshirja e shumë termave në fondin e përgjithshëm të gjuhës letrare shtrojnë para gjuhëtarëve dhe specialistëve disa detyra me rëndësi për përsosjen e mëtejshme të sistemeve terminologjike, nga të cilat më kryesoret sipas studiuesit Leka³¹⁷ janë:

1. Njësimi i mëtejshëm i terminologjisë së çdo fushe, duke shmangur sa më shumë dyborët e panevojshëm (duke përfshirë edhe terminologjinë e informatikës A.M.).
2. Shqipërimi i termave me prejardhje të huaj, duke shfrytëzuar të gjitha mjetet fjalëformuese që na jep gjuha e sotme letrare shqipe.
3. Të mos ndërtohen terma të rinj, fjalë të prejardhura ose kalke, pa mbledhur dhe studiuar më parë termat e krijuar spontanisht në fushat e ndryshme të shkencës, të teknikës e të prodhimit.
4. Të shpien më tej studimet teorike, që tashmë kanë filluar të bëhen te ne, në fushën e terminologjisë.
5. Pas njësimit dhe shqipërimit të terminologjisë në një të ardhme të afërt të bëhen përpjekje për një hap cilësor që është standardizimi i terminologjisë.

Kur flitet për normëzimin e terminologjisë së informatikës, sipas Cakës³¹⁸ para së gjithash mendohet në terminologjinë që do të duhej përdorur në punimet shkencore dhe profesionale dhe në tekstet universitare dhe shkollore, por dhe në shtyp e televizion. Sipas Cakës³¹⁹ mosstandardizimi i terminologjisë së informatikës në gjuhën shqipe është duke u nxjerrë telashe jo vetëm gazetarëve, redaktorëve gjuhësorë, autorëve të teksteve profesionale e shkencore, por edhe njerëzve të rëndomtë – përdorues të kompjuterit e të Internetit – e sidomos mësimdhënësve e nxënësve të të gjitha niveleve të shkollës shqipe. Prandaj sa më parë duhet t’i qasemi

³¹⁶ Bejta, Murat, “Fjalët e huaja dhe mundësitë për zëvendësimin e tyre me terma të shqipes”, “Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe”, Prishtinë 1980, vep. cit. fq. 110

³¹⁷ Leka, Ferdinand, “Për njësimin, pastrimin dhe pasurimin e mëtejshëm...”, “Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe”, Prishtinë 1980, fq. 126

³¹⁸ Po aty

³¹⁹ Caka, Nebi, <http://arkivi.peshkupauje.com/standardizimi-i-terminologjisë-se-informatikës/2008/11/04>, Kontrolluar më 20.09.2010

standardizimit të terminologjisë së informatikës. Kjo është nevojë e ngutshme.

Studiuesi Leka³²⁰ mendon se puna për njësimin, pastrimin dhe pasurimin e terminologjisë të fushave të ndryshme mbetet një detyrë e përhershëm me rëndësi të veçantë për gjuhën tonë letrare, pasi ndodh që për të njëjtin koncept të shfaqen terma të ndryshëm, të krijuar nga brumi i shqipes, por duke u nisur nga kritere jo unike ose me burime nga gjuhë të ndryshme. Ai³²¹ thotë se problemet e terminologjisë duhet të ndiqen nga një grup i gjerë specialistësh e gjuhëtarësh, të cilët duhet ta kenë nën kontroll formimin dhe përhapjen e termave, duke mbajtur një qëndrim të vetëdijshëm e veprues ndaj çdo termi të ri që vihet në qarkullim.

Në terminologjinë e kompjuteristikës në gjuhën shqipe ndeshen mjaft fjalë të huaja që mund të zëvendësohen me fjalë shqipe, si:

Password për fjalëkalim

Maus për mi

folder për dosje

record për regjistër

fail për skedar

character për shkronjë

keyboard për tastierë

Përfundim

Mendojmë se e një rëndësie të veçantë është pasurimi i terminologjisë së kompjuteristikës me terma nga burimi i shqipes, mënjanimi i termave të huazuara pa nevojë. Kjo duhet të bëhet jo vetëm për të ruajtur gjuhën nga vështrimi i elementeve të huaja, por edhe për t'i bërë edhe më të kuptueshëm termat e shkencës e të teknikës, pasi që termat nuk mbeten brenda një rrethi të ngushtë e të mbyllur përdoruesish.

Fjalët e huaja që janë ngulitur në kujtesë shumë njerëzve u duken me vend dhe vështirë pajtohen t'i zëvendësojnë me fjalë të brumit të shqipes, që në fillim duket se tingëllojnë keq. Por, me kohë ato do të mëshirohen në jetën gjuhësor e do të kryejnë funksionin dhe misionin gjuhësor të duhur. Pasuritë e visarit leksikor të gjuhës shqipe janë të mëdha e të begatshme, prandaj ekzistojnë mundësitë që fjalët e huaja të zëvendësohen e fjalë vendi.

Literatura

Bejta, Murat, "Fjalët e huaja dhe mundësitë për zëvendësimin e tyre me terma të shqipes", "Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe", Prishtinë 1980.

Leka, Ferdinand, "Për njësimin, pastrimin dhe pasurimin e mëtejshëm...", "Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe", Prishtinë 1980.

Caka, Nebi, <http://arkivi.peshkupauje.com/standardizimi-i-terminologjisë-se-informatikës/2008/11/04>

³²⁰ Leka, Ferdinand, "Për njësimin, pastrimin dhe pasurimin e mëtejshëm...", "Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe", Prishtinë 1980, fq. 126

³²¹ Po aty

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI PËREMRA TË PACAKTUARA TË PËRNGJITURA TEK “MESHARI” I GJON BUZUKUT

Aida Bado-Beqiri

Meshari” i Gjon Buzukut, si vepra e parë e shkruar në gjuhën shqipe, gjithmonë ka ngjallur interesin e studiuesve që janë të interesuar të zbulojnë më shumë mbi gjuhën shqipe. Për të janë bërë studime të fushave të ndryshme, si: historike, fonetike, gramatikore, stilistikore, letrare etj.

Megjithatë, edhe pse kemi kaq shumë studime, mbi fjalëformimin e veprës së Buzukut nuk është shkruar shumë dhe veçanërisht mbi përngjitjen, si një metodë e krijimit të fjalëve të reja në atë periudhë.

Qëllimi është që të dallohen përemrat e pacaktuar të përngjitura që gjenden në këtë vepër duke u munduar njëkohësisht të përcaktojmë edhe: tipat kryesore, mënyrën e formimit, zhvillimin e kuptimeve të tyre në shekujt e mëpastajmë, kushtet sintaksore në të cilat është bërë procesi i përngjitjes, shtrirjen e fjalëve të përngjitura etj. Studimi do të shoqërohet me inventarin e plotë të përemrave të gjetur.

Tek Buzuku gjenden këto përemra të pacaktuar: asgjakafshë, askush, askana, asgja, asnjë, disa, ndonjë, gjakafshë, gjithëkana, gjithëkuj, gjithëkush, gjithëqish, gjithëqishdo, kushdo, porsiesiado, porsiiisillido, sejdo/sejdota, e siado, i sillido, siqishdo, zhdo, siisillido, siesiado, qishdo, tjetër. Ato janë numëruar gjithsej 25 përemra të pacaktuar të përngjitur.

Njëri nga elementët e përemrit të pacaktuar të përngjitur, zakonisht është i lakueshëm, kurse tjetri i ngurosur.

Në bazë të elementit të ngurosur, te Buzuku dallohen këta tipa kryesor përemrash të pacaktuar:

Përemra të pacaktuar me element të ngurosur do, i cili e ka burimin te veta e tretë njejës e foljes dua. Të tilla te vepra e Buzukut gjejmë:

- kushdo < kush + do
- sejdo < sej + do
- porsiesiado < porsi + (e) siado
- e siado < e sia + do
- zhdo < zh(ç) + do
- porsiiisillido < porsi + (i) sillido
- qishdo < qish + do.

- i sillido < i silli + do

Në këtë grup, ishte menduar të mos futeshin, përemrat e pacaktuar porsiesiado dhe porsisillido, po meqenëse, kuptimi i lidhëzës krahasore porsi, është i fortë, kjo do të thotë që s'mund ta konsiderojmë atë si parashtesë, po as si kompozitë, duke qenë se lidhëza nuk është një fjalë emërtuese po shërbyese.

Përemra të pacaktuar të formuar me elementin e ngurosur di-, që e ka burimin te folja di. Te Buzuku gjendet vetëm njëra: - disa < di + sa.

Përemra të pacaktuar të formuar me elementin e ngurosur ndo, që e ka burimin te lidhëza nënrenditëse kushtore në + folja dua. Te ky libër gjendet vetëm përemri i pacaktuar : ndonjë < ndo + një

Përemra të pacaktuar të formuar me elementin e ngurosur si, i cili e ka burimin te lidhëza e nënrenditur karahasore përkatëse. Te buzuku gjejmë:

- siisillido < si + (i) sillido.
- siqishdo < si +qishdo
- siesiado < si + (e) siado

5. Përemra të pacaktuar të formuar me elementin e ngurosur as, që e ka burimin te pjesëza mohuese as. Të tillë gjejmë:

- asgja < as + gja
- askush < as + kush
- askana < as + kana
- asnjë < as + një.
- asgakafshë < as + gjakafshë.

6. Përemra të pacaktuar të formuar me elementin e ngurosur gjithë, që e ka burimin te përemri i pacaktuar përkatës:

- gjithëkana < gjithë + kana
- gjithëkuj < gjithë + kuj
- gjithëqishdo < gjithë + qishdo
- gjithëkush < gjithë + kush
- gjithëqish < gjithë + qish.

7. Përemra të pacaktuar të formuar nga dy emra sinonime. Në vepër gjendet vetëm përemri : gjakafshë < gja + kafshë

8. Përemra të pacaktuar të formuar nga një të, që e ka burimin të nyja përkatëse. E tillë te Buzuku është vetëm përemri : - tjetër < të + jetër.

Përemrat e pacaktuar me elementin e ngurosur – do

Të tillë te Buzuku përmendëm më lart: kushdo, sejd, porsiesiado, e siado, zhdo, porsisillido, qishdo, i sillido. Përemrat e pacaktuar të këtij tipi, si element të parë kryesor kanë :

- një përemër pyetës (qish), tingullin zh që mund ta marrim si analoge me (ç'), si dhe fjalën (sej), e cila te Buzuku ka kuptimin e përemrit pyetës çfarë: "Qish te hame, o qish te pime, o n sej na te nvishemi ?" (f. 295/b).

- një përemër lidhor (e sia > cila, kush, i silli)
- një lidhëz krahasore (porsi).

Përemrat e pacaktuar të tipit të parë janë pra, qishdo, sejd dhe zhdo (çdo). Sipas Shaban Demiraj përemri qisho, te Buzuku ka pasur kuptimin e përemrit të sotëm "çdo apo secili", ndërsa përemri zhdo përdoret rregullisht me kuptimin e përemrit të

sotëm “disa”³²². Përemri qishdo është përdorur rreth 30 herë : “Per qishdo dite qi u ty te te theres, ti muo shpjert me diglo” (f. 45/b); “per qishdo dite qi u jam idhenuem, pervene prej meje veshete e tu” (f. 45/b) etj., ndërsa përemri zhdo është përdorur rreth 23 herë: “E thoshne zhdo prej Jerozolime” (f. 175/a); “Simon, u kam zhdo kafshe me thane” (f. 197/a) etj. Ato mund të jenë formuar në fjali, të tilla që i pranvinin dy fjalët prej të cilëve ato përbëhen. Psh., “E qish do me thane Patriarkete, perinte e pare tane, te perinte e gjithë perindet” (f. 81/b); “qish do u ty te te banj” (f. 113/a). Meqenëse si element i dytë është folja do, atëherë këto fjali shprehin gjithmonë një dëshirë. Këtë kuptim, me sa duket, e humbet folja do kur përngjitet me përemrin qish, për të formuar përemrin e pacaktuar qishdo. Përemri zhdo te Buzuku paraqitet e shkruar me germën ε, e cila vlen dhe për z dhe për zh. Sipas E. Çabej ndërrimi i zhdo në çdo, është thjeshtë fonetik.

Përemri sejdō është përdorur rreth 2 herë, një herë në formën sejdō dhe një herë në formën sejdota: “e ashtu te sakrifikoni Tinezot oferte te re mbe gjithë vend tuk ju t iteni, bukete e para dy n se dysh se dhjeta n sejdō drithe, qi ato t i ngrene prifti perpara Tinezot” (f. 273/a); “tu ju pelqyem me mare ere n sejdota e o n drandefillesh..” (f. 67/b). Tek të dyja rastet, kjo fjalë ka kuptimin e përemrit të sotëm “çdo”, mendim ky i pranuar më parë edhe nga Kolë Ashta.³²³

Përemrat e pacaktuar të tipit të dytë, pra kushdo dhe siado, sipas Shaban Demiraj janë formuar nëpërmjet njëfjalëzimit të dy gjymtyrëve kryesore të një fjalie përcaktore lidhore të pazgjeruar. Pra, nga ndërtimet e tipit: “Këtë e bën kush do” (ai që dëshiron), është arritur në ndërtime të tipit: “ Këtë e bën kushdo”. Po kështu edhe cilido.³²⁴

Përemrin e pacaktuar kushdo te Buzuku e gjejmë të përdorur rreth 2 herë të përngjitur dhe rreth katër herë të tjera të shkruar ndarazi: “Kush do gjellene e vet, aj ta bdjere..” (f. 361/a); “e kush do bijte o bijate ma se muo, nuke anshte i denje n meje” (f.359/b); “Kushdo te thoete t et o s amese” (f. 159/a); “E prashtu i thom se kushdo te hae kete buke o te pie kelqine e Tinezot tue mos klene i denje..” (f. 277/b) etj. Sikurse vihet re, ky përemër është formuar nga përemri lidhor kush : Kush do (ai që do) gjellene e vet, aj ta bdjere..” dhe folja do, e cila në këtë rast është në vetën e tretë. Në rastet kur ky përemër jepet si i përngjitur, ai tregon frymorë, të cilët janë të veçuar nga një grup i caktuar.

Përemri i pacaktuar e siado është i formuar nga përemri lidhor e sia (e cila) dhe folja do. Sikurse dhe vihet re, përemri lidhor i gjinisë femërore, tek Buzuku, shfaqet i shkruar, me siguri dhe e shqiptuar, pa tingullin ll, sikurse ndodh po me këtë përemër në gjininë mashkullore. Sipas studiuesit Ethem Likaj, tek përemrat e gjinisë mashkullore, ky tingull ll e ka burimin te fjala lloj në fjali të tipit: ai si lloji.. > (a)i silloji > i silli, më pas ll-ja është shkrire edhe në femërore.³²⁵ Tek Buzuku ky përemër del i përdorur vetëm një herë e shkruar më vetë: “porsi e siado fare” (f. 227/b) dhe një herë tjetër del e shkruar me një tingull të shtuar -j-, i cili mund të shërbej për te eliminuar hiatin : “si esjado fare” (f. 227/b). Në këtë rast të fundit edhe nyja e, është shkruar bashkë me pjesën tjetër të përemrit.

³²² Shaban Demiraj “Gramatika historike e gjuhës shqipe”, Tiranë , 1986, f. 517-518

³²³ Kolë Ashta “Leksiku historik i gjuhës shqipe I” Shkodër, 1996, f. 437

³²⁴ Shaban Demiraj “Gramatika historike e gjuhës shqipe”, Tiranë , 1986, f. 517

³²⁵ Ethem Likaj “Zhvillimi i eptimit në gjuhën shqipe”, Tiranë, f. 135

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për përemrin i sillido, pra që është formuar nga përngjitja e përemrit lidhor të gjinisë mashkullore i cilli (i cili) me foljen do. Është përdorur i shkruar një herë me nyjën i të ngjitur në trupin e fjalës dhe një herë tjetër e shkruar e ndarë : “porsi Jezu Krishti yne Zot nde passionet te ti dyve ua bani si isillido meritoi pagetyrene..” (f. 217/b); “aj te greshitete shenjt i sillido te jete shkruom nder te gjallet nde Jerusaemt” (f. 239/b).

Përemrat e pacaktuar të tipit të tretë, te Buzuku, si element të parë kanë lidhëzën krahasore porsi, e cila i është përngjitur përemrit të përngjitur të pacaktuar i sillido, në të dyja gjinitë, si në atë femërore ashtu dhe në gjininë mashkullore: “E tha Zotyne : Hinje se u u kam dhane gjithë bar qi ban fare permbi gjithë dhët, e gjithë peme qi fare ka porsiesiado fare, juve me u klene per gjelle” (f. 229/a); “E frujtoi dheu bare, siisillido bar farene porsi ish ban, e lisate porsisillido lis me faret te vet”(f. 227/b). Në këto shembuj, kuptimi krahasor i lidhëzës porsi, është i fortë, ndaj atë nuk mund ta trajtojmë si parashtesë apo si diçka tjetër. Në këto raste, kuptimi i përemrave porsiesiado dhe porsisillido mund të jenë të barabartë, përkatësisht, me kuptimin e “porsi cilido” dhe “porsi cilado”. Arsyeja pse kjo lidhëz jepet e shkruar bashkë me përemrin e pacaktuar e siado apo i sillido, nuk dihet.

Përemra të pacaktuar të formuar me elementin e ngurosur di

Përemra të formuar me këtë element te Buzuku kemi vetëm përemrin e pacaktuar disa, i cili është përdorur rreth 13 herë. Ky përemër është formuar nga përngjitja e foljes di me përemrin pyetës sa, në fjali të tipit: Di unë sa?³²⁶ Shembuj për këtë përemër kemi: “Perse disa thoshne se..” (f. 191/b); “e tue gjetune disa dishipuj..” (f. 263/ a) etj. Për këtë përemër Shaban Demiraj është shprehur se: “.. te Buzuku ky përemër, me trajtën fonetike zhdo, përdoret rregullisht me kuptimin e përemrit disa, që tek ai nuk ndeshet fare”³²⁷, në një kohë që ky përemër, nga Buzuku është përdorur rreth 13 herë. Përemri i pacaktuar disa në rastet e mësipërme, tregon sasi të pacaktuar frymorësh.

Përemra të pacaktuar të formuar me elementin e ngurosur ndo

Më këtë element, siç u shprehëm edhe më lart, tek Buzuku është formuar vetëm përemri i pacaktuar ndonjë. Ky përemër mund të jetë formuar nga elementi ndo, që e ka burimin te lidhëza bashkërenditëse veçuese përkatëse dhe numërori një, në fjali të tipit: Ai foli ndo për një djalë... (me kuptim veçues), që çoi më vonë në ndërtime të tipit : Ai foli për ndonjë djalë (me kuptim të papërcaktuar). Në këto raste, përngjitja mendohet të ketë ndodhur midis lidhëzës ndo dhe numërorit një. Po ka të ngjarë edhe që ky përemër i pacaktuar të jetë formuar “nga njëfjalëzimi i fjalive të varura kushtore të tipit në do një, të ndjekura nga fjalia kryesore”³²⁸. Në këtë rast mendohet që përngjitja të ketë ndodhur njëherësh për të tri elementët (lidhëzën, foljen, numërorin). Po te Buzuku ky lloj ndërtimi vërtetohet vetëm për rastin e ndokush: “E ne do kush me bam vollundetne e ti” (f. 173/b). Vetë përemri i pacaktuar ndokush nuk gjenden i përdorur te ky libër nga Buzuku. Duke u bazuar gjithmonë te ky libër, del që përemri i pacaktuar ndonjë të jetë formuar para përemrit ndokush.

Kështu, ky përemër është përdorur rreth 84 herë : “Mbas parti ti mbete Virgjene, pa ndonje makulle” (f. 23/b); “As ndonje kafshe te dhunuoshime ti mos

³²⁶ E. Çabej “ Studime gjuhësore I”, Tiranë, 1976, f. 125

³²⁷ Shaban Demiraj “Gramatika historike e gjuhës shqipe”, Tiranë , 1986 f. 517

³²⁸ Po aty f. 519

bajnsh" (f. 63/a); "mos ndonje te mire qish shoqi ka e ty te ndete keq se ka, e ti s ke" (f. 63/ b); "Mos seliçitoni per ndonje kafshe" (f. 87/ b) etj. Nga sa vihet re, ky përemër përdoret gjithmonë në fjali që kanë fjalë me kuptim mohues, siç janë në këtë rast lidhëzat as dhe mos dhe pjesëza pa. Në këto raste, ky përemër përjashton frymorë në mënyrë të papërcaktuar.

Përemra të pacaktuar të formuar me elementin e ngurosur si

Përemra të formuar me këtë element gjejmë siisillido, siqishdo, siesiado. Te këta përemra kuptimi i lidhëzës krahasore si (ose të grupit "shtu si"), ruhet vetëm në rastin e përemrit siqishdo. Mund të themi se këto përemra kanë këto kuptime përkatëse "secilido", "secilado" "siqishdo > si çdo". Le të japim disa shembuj : "E bani Zotyne balena te medha e n gjithë faresh pishq qi veliznjene, qi ujenate dhane n vetehej si esijado fare anshte, e gjithë zog qi fluturon siqishdo fare." (f. 227/b); "Bafte dheu shtanse te gjalla, siqishdo fare goveda" (f. 227/b); "Ansosh qi fluturonjine siesiado fare te jete, e n shtaseshit siesiado fare te jete, e n gjithë shtanseshit qi gjall jane permbi dhet siesiado fare, dy gjithë fareshit te hinjene me ty te ushqenene" (f. 229/b); " E frujtoi dheu bare, siisillido bar farene porsi ish bari.." (f. 227/b). Këta përemra, veç përemrit siqishdo, në këto raste, tregojnë një tërësi sendesh (farë apo barë), nga e cila nuk përjashtohet asnjë element. Për sa i takon përemrit siqishdo, ka një vështirësi në përcaktimin e kuptimit të tij. Në fjalinë: "Bafte dheu shtanse te gjalla, siqishdo fare goveda", kuptimi i fjalës siqishdo anon më shumë nga " në çdo", pra mund të kishim "Bafte dheu shtanse te gjalla, ne çdo fare goveda", çka tregon se kuptimi i lidhëzës krahasore nuk ruhet në çdo përdorim, të saj.

Përemra të pacaktuar të formuar me elementin e ngurosur as

Të tillë gjejmë: asgja, askush, askana, asnjë dhe asgjakafshë. Përemrat e pacaktuar të këtij tipi, si element kryesor kanë: një emër (gja, kana "me kuptimin njeri"), një numëror (një) dhe një përemër të pacaktuar (gjakafshë).

Përemrat e tipit të parë, asgja dhe askana nuk kanë një përdorim shumë të madh. Përemri asgja del i përdorur rreth 23 herë, ndërsa përemri askana është përdorur rreth 4 herë: "e u te kem gjithë fe, ashtu qi u te derpertonj gjithë malte, e te mos kem karitat, asgja nuke jam" (f. 111/ b); "Askana mos trazejme" (f. 121/a)

Përemri i pacaktuar asgja mund të jetë formuar nga as dhe gja (gjë) në fjali të tipit: As më dha gja.. që dha Asgja s'më dha³²⁹. Në të njëjtat tip fjalish mund të jetë formuar edhe përemri askana: As më dha kana.. ,që dha Askana s'më dha. Sipas Çabej, përemri i pacaktuar asgja, ka qenë kompozitë (ai shprehet me fjalën kompozitë edhe për fjalët e përngjitura) që në kohë të autorit tonë; ajo nuk zbërthehet në dy gjymtyrët e saj nga ana e parafjalëve.³³⁰ Po në një rast në transkriptimin e tij, kjo fjalë jepet e shkruara ndaras: "as gja te gjalle n si.." (f. 179/b) dhe për më tepër nuk ka as një parafjalë që ta pengojë shkrimin e saj bashkë, sikurse ndodh p.sh., me përemrin e pacaktuar asnjë. Kjo ndoshta do të thotë që edhe ky përemër, nuk është dhe aq i konsoliduar si përngjitje.

Te përemrat e tipit të dytë futet vetëm përemri askush. Ky përemër është formuar nga përngjita e fjalës me kuptim mohues me përemrin pyetës kush në fjali të tipit: As më tha kush.. që më vonë dha Askush s'më tha³³¹. Ajo është përdorur rreth 31

³²⁹ E. Çabej " Studime gjuhësore VI", Tiranë, 1977, f. 302

³³⁰ Po aty f. 309

³³¹ Po aty f. 302

herë: “E askush mos t u qendronje perpara juve” (f. 133/b); “askush gja nuke i ep” (f. 149/b).

Të përemrat e tipit të tretë futet përemri asnjë, i cili është formuar nga përngjitja e pjesëzës mohuese as me numërorin një, në fjali të tipit : “as me nje burre” (f. 67/a); që më vonë dha: “Me asnjë burrë”, apo në fjali të tipit “nuke zune as nje kafshe” (f. 245/b). Ky përemër është përdorur një herë si fjalë e përngjitur: “te mos jete i derejte perpara faqese sate asnje shpirt i gjalle” (f. 47/b) dhe rreth 8 herë të tjera e shkruar ndarazi: “perse as nje n jush mos banje shoqit ta qish mos pelqen ati as nde ndonje kafshe” (f. 135/b) ; “as me nje burre” (f. 67/a); “nuke zune as nje kafshe” (f. 245/b).

Për rastet kur midis pjesëzës as dhe numërorit një ndodhet një parafjalë, Çabej shpjegon se është parafjala që ndodhet midis tyre, që i ndan ato në dy njësi të veçanta, por për rastet kur nuk ndodhet një parafjalë midis tyre, ai nuk jep asnjë shpjegim për mënyrën e shkrimit të tyre. Ndoshta për këtë rast ai mbështetet te kuptimi, sikurse ka vepruar edhe për raste të tjera analoge p.sh., me përemrin asgja, që e shkruan herë bashkë e herë ndaras, duke u mbështetur te kuptimi që ka dhe jo te grafia e origjinalit.

Te përemrat e tipit të katërt, futet vetëm përemri asgjakafshë, i cili mund të jetë formuar nga përngjitja e pjesëzës më kuptim mohues as dhe përemrit të pacaktuar gjakafshë në fjali të tipit: As më dhe gjëkafshë, që më vonë mund të ketë kaluar në Asgjëkafshë s’më dhe.

Ky përemër rezulton i përdorur 1 në fjalinë: “Ju nuke dini asgjakafshe, as nuke kujtoni se duhete nje me vdekune per popullit” (f. 197/b).

Përemri asgjakafshë përdoret për të përforcuar kuptimin mohor që ka fjalia rreth një dukurie të papërcaktuar.

Përemra të pacaktuar të formuar me elementin e ngurosur gjithë

Të tillë përemra te Buzuku gjejmë: gjithëkana, gjithëkuj, gjithëqishdo, gjithëkush, gjithëqish. Përemrat e pacaktuar të këtij tipi, si element kryesor kanë: një emër (kana), një përemër pyetës (kush, kuj, qish) dhe një përemër lidhor dhe folja do.

Te përemrat e tipit të parë, futet vetëm përemri i pacaktuar gjithëkana. Ky përemër është përdorur rreth 4 herë: “E jane te dame veperate, e por nje anshte Zotyne, qi veperon gjithe kafshete nde gjithëkana” (f. 289/a); “perse edhe na munde ngushullojme gjithëkana qi anshte çkushulluom e nde gjithe nevoje..” (f. 359/a) etj. Ky përemër përdoret me kuptimin “gjithësecilin apo çdo njeri”. Mund të jetë formuar nga përngjitja e përemrit të pacaktuar gjithë me emrin cili në fjali të tipit: “E s mundeni, bani te keni paq me gjithe kana, tue mos bam vendete per vetevetehene” (f. 103/a) dhe tregon frymor të veçuar të një grupi të caktuar. Kjo fjalë nuk gjendet tek glosari i cituar i Kolë Ashtës.

Te përemrat e tipit të dytë, futen përemrat gjithëkush, qithëqish, gjithëkuj. Përemri gjithëkush është formuar nga përngjitja e përemrit të pacaktuar gjithë me përemrin pyetës kush. Meqenëse elementi i ngurtësuar në këtë rast është përemri i pacaktuar gjithë dhe meqenëse e vetmja kategori gramatikore e përemrit pyetës kush, është kategoria gramatikore e rasës, përemri i pacaktuar gjithëkush gjatë lakimit merr trajta të ndryshme morfologjike. Një nga këto trajta është ajo e dhanores, gjinores dhe rrjedhores, që japin formën gjithëkujt, që Buzuku e ka të shfaqur pa tingullin fundor –t, pra gjithëkuj. Kështu, përemri gjithëkush është përdorur rreth 41 herë: “E gjithëkush kete ere te bukura ban”(f. 67/ b) etj, ndërsa përemri gjithëkuj përdoret rreth 24 herë :

"Zotyne ka me kthym gjithëkuj për muo." (f. 57/b) etj. Këta përemra tregojnë vetëm frymorë të veçuar të një grupi të caktuar.

Përemri gjithëqish, siç u tha, mund të jetë formuar nga përngjitja e përemrit të pacaktuar gjithë dhe përemrit pyetës qish në fjali të tipit: "Gjithë ata qish muo ep Ati" (f. 59/a) që ka dhënë më pas: "Gjithëqish muo m ep Ati. (f. 59/a). Te Buzuku ajo si fjalë e përngjitur është përdorur rreth 6 herë: "Gjithëqish muo m ep Ati" (f. 59/a); "Kuj pelqen me gjegjune e me ditune gjithëqish nde kete shekulle banete" (f. 67/a); "E gjithëqish permby dhet te ndirete" (f. 229/b) etj. Me sa shikohet edhe nga këto shembuj, përemri i pacaktuar gjithëqish përdoret me kuptimin e përemrit të sotëm "gjithçka". Kjo fjalë, megjithatë, nuk shkruhet në të gjithë tekstin si përngjitje; janë rreth 20 herë të tjera ku kjo fjalë shkruhet e ndarë: "me gjithë qish mbrenda i anshte" (f. 59/b); "Bani gjithë qish u thote" (f. 101/b) etj. Për këtë fjalë Çabej është shprehur: "Te gjithë qish me kuptim përgjithësonjës..., i cili është zakonisht në tekst tonë, mbahet shkrimi dy pjesësh i origjinalit; po në kuptimin "gjithsej" që ka aty.. kjo fjalë ka arritur në kompozitë: Bani gjithëqish u thotë.."332 Në të gjitha shembujt e dhënë më lart, sikurse edhe në këtë shembull, përemri gjithëqish, nuk ka kuptimin "gjithsej", po kuptimin "gjithçka". P.sh., marrim fjalinë : "E gjithëqish permby dhet te ndirete", ky përemër do të kishte kuptimin "gjithsej" në qoftë se ai do të ndiqej nga një numëror, po duke qenë se këtu numëror nuk ka, atëherë duket më i drejtë zëvendësimi: "E gjithçka permby dhet te ndirete".

Te përemrat e tipit të tretë, futet vetëm përemri i pacaktuar gjithëqishdo. Ky përemër, mund të jetë formuar nga përngjitja e përemrit gjithë me fjalinë lidhore, që vinte pas tij: "perse gjithë qish doni, ju te mos e bani" (f. 293/ b), e cila më vonë mund të ketë dhënë: "perse gjithëqishdo te mos e bash". Folja do në këtë rast e ka burimin te veta e dytë shumës e së tashmës së dëftores. Ky përemër rezulton i përdorur vetëm një herë: "E gjithëqishdo dam aj shoq kish n teje, mbajtune je gjithë me ja kthym.." (f. 63/b). Tek glosari i Kolë Ashtës, ky përemër, nuk më rezulton.

Përemra të pacaktuar të formuar nga dy emra sinonime

Në veper gjendet vetëm përemri gjakafshë, i cili, siç u përmend edhe më lart, është formuar nga përngjitja e dy emrave, të cilat janë sinonime me njëra-tjetrën.

Sipas Shaban Demiraj ky lloj përemri "do të jetë përfutur në fjalitë pyetëse të tipit A ke parë gjë kafshë?, ku emir i dytë, dikur sinonim me të parin, ka shërbyer për ta përfutur atë. Ky përfutim është bërë i nevojshëm, pasi emri gjë në fjali pyetëse të tilla, kishte marrë pak nga pak një kuptim shumë të përgjithshëm dhe shumë abstrakt dhe si rrjedhim e kishte të dobësuar kuptimin leksikor si emër."333

Ky përemër është përdorur rreth 8 herë : "Perse askush nuke ban kun gjakafshe nde e nshshune" (f. 191/b); "e ne klofte qi t u jese kun gjakafshe, ju ta digjeni me zjarm." (f. 221/a) etj. Ky përemër, në këto raste, tregon ose përjashton sende në mënyrë të papërcaktuar.

Bibliografia

³³² Po aty f. 310

³³³ Shaban Demiraj "Gramatika historike e gjuhës shqipe", Tiranë , 1986, f. 521

- Eqerem Çabej "Studime gjuhësore I", Tiranë, 1976
Eqerem Çabej "Studime gjuhësore VI", Tiranë, 1977
Ethem Likaj "Zhvillimi i eptimit në gjuhën shqipe", Tiranë 2003
Kolë Ashta "Leksiku historik i gjuhës shqipe I", Shkodër, 1996
Shaban Demiraj "Gramatika historike e gjuhës shqipe", Tiranë, 1986

VËSHTRIM STILISTIKOR MBI POETIKËN E CAMAJT

Dr. Aida Uruçi

Martin Camaj, është mjeshtër i shkrimit letrar, në poezi dhe prozë, në dramë dhe studime të ndryshme. Shkrimtari përpiqet që të eksplorojë me anë të fjalës së magjishme pothuajse të gjitha gjinitë letrare duke filluar me krijimet e para në poezi, për të vazhduar me prozën, bën përpjekje që të shkruajë një madrigale e në fund kemi dramatikën. Poezia e Camajt është e veçantë për stilin e ngjeshur e plot imagjinatë saqë të duket se ka marrë jetë nga traditat gojore të Dukagjinit, madje siç shprehet shkrimtari A. Pipa: *“Ai ka guxuar të “sfidojë” poetikën e së fundmes, karakteristikë e poezisë së mësuar, me poetikën e tij të së pafundmes, karakteristikë e poezisë gojore”*.³³⁴

Prandaj, vështrimi stilistikor i shprehësisë së poetikës së Camajt paraqet interes për faktin se krijimi i poetit në këtë zhanër është bërë më tepër se para gjysmë shekulli, kështu që na shërben edhe për të njohur sistemin e mjeteve artistike të vjershërimit të kohës së tij, mjetet figurative e organizimin gjuhësor në shumë nivele të vargjeve camiane, sidomos sa i takon sintaksës poetike; por, nga ana tjetër, ky vështrim na vlen edhe për të njohur lidhjet e shkrimtarit-poet me idiomën popullore të vendlindjes e krahinës ku lindi dhe jetoi, në ç’masë i shërbyen ato në krijimin e poezisë dhe pasqyrimin e tablove të jetës në fëmijërinë e tij të vorfën. Në këtë punim jemi ndalur te ligjërimi poetik i krijimtarisë së Camajt duke e parë në dy kahe:

Së pari, ndërtimet sintaksore, të cilat janë mjaft të larmishme me forma e struktura.

Së dyti, kemi veçuar nga pasuria leksikore fjalë e shprehje prej gjuhës popullore, të cilat e kanë ndihmuar shkrimtarin të ndërtojë stileme mjaft të goditura.

1. Në lidhje me veçoritë sintaksore në veprën e Camajt studiuesi R. Ismajli shprehet, se: *“Sintaksa thellësisht shqipe, saktësia në përdorimin e fjalëve, eufonia në vjershat, janë elemente që e shquajnë këtë vepër”*.³³⁵

Në gjuhën shqipe është pranuar si rend asnjanes modeli kryefjalë + kallëzues + kundrinë + rrethanor, por prishja e këtij rendi bëhet për qëllime stilistikore. Në vargjet e mëposhtme vërejmë një gërshtim të rendi i drejtë sintaksor (S + P + O + C + A) me rendin emfatik (P + S + O + C = A / O + P + S + C + A etj.), tek vargu i tretë i parafundit.

(...Babagyshë!- vasha ia ktheu- / Nji re si plaf i zi kaloi nën diell / E hija e saj kaloi dhe në k’sollën tonë tash hyni. / Ishalla shi tash po bjen, bijo! / E tokën e rreshkueme zbut!- / ...Kam kenë e re, si kallzi i grunit shtalp / Dhe e lum me ‘i mij dishire në gj. / Nji rreze m’nxeu në

³³⁴ A. Pipa, Revista “Kritikë”, Tiranë, 1944.

³³⁵ R. Ismajli, *Gjuhë dhe etni*, Prishtinë, 1991, f. 32.

kët tokë si dielli / Nji burrë që m'dhanë për fat. / ...Un e nipësja maje gishtash përjashta dolëm / Nësa gjyshja, përmallue në kujtime, / Flitte me vete nën za, e ngrata....) (“Rrezet e diellit të ngrohta”, në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 233).

Ngarkesë të veçantë stilistikore paraqet tema e gjakmarrjes, që shkretton çdo gjë. Kemi një pikturë të vërtetë, skenë bukolike e gjeorgjike njëkohësisht; Drini i zbutur, pa valë e zemërim, natyrë e begatë plot bar sa qingjat ngopen me tambël e lodrojnë; lumi ka tashmë pak ujë (asht veshë bel-hollë) e rrjedh me naze: personifikim i natyrshëm, që jepet në tri fjalitë e para, shtruar me rend të drejtë asnjans (S + P); më pas, kujtimi i Lokës për një vrasje gjaku bërë po këtu në Drin, por kur lumi kishte valë dimri. Aktivizim i fjalëve të nënvizuara marrin vlerë shprehëse jo vetëm të idiomës geqe, por më gjerë.

(...Pranvera shkoi e Drini u zbut si kingji. / Kingjat u nginë me tambël e lodruen zallit / me plakën tue mbledhun coklat bregut: / Drini asht vashë bel-hollë, n'kalim plot naze. / E bija lexon prrallat e vjetra që i kish / e ama ndër sy dhe reciton: / “E shoqja e mjellmes pyeti, / Kush qe ai burrë në breg me flokë / të përthimë e tirq të bardhë e spik / të zi për gju? / Si nuk jam ujë – pritën t'ia za në va.” / Lokja n'gurgullimet e tingujve / të valave drinore ndien fjalën e gjakut / të vjetër, të marrun prej urave druni, / tue kërcllatë si n'djegje n'erë...) (“E bija e grues apo urat mbi Dri”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 159).

(...Gjamën e motit për së largut ndëgjoj / e jashta bjen shi. / Pullazi lëshon pikat n'enë, pikat e mëdha / si kokrra e rrushit të zi / në vilën e varun në lëpozë. / Zjarrmi xen gjyshën te votra e shndrit / trollin e shtypun prej thembrash sona, / shtratin me tesha ngrofë prej zemrash sona / e muret e nxime prej syve tanë....) (“Gjamën e motit për së largu ndëgjoj” në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 235).

Loja me rendin sintaksor përbën përftesën stilistike, që në vargun e parë dhe të dytë, të cilët përftojnë një ritëm të pazakontë, sepse përbëjnë remën (O + A + C + P); për të vazhduar me vargun III (ngarkuar me fjalë determinante/përcaktuese), vijon me vargun I të strofës II – rendi asnjans – ku folja/predikat “shndrit” mban sintaksorisht 3 vargje që nisin me kundrina (O) me vargje atributësh të pandashme (SA, SP, SA). Bashkimi parataktik lidhëzor (vargjet I-II) shërben për asociacionin e pandashëm natyror “gjama e motit / shiu përjashta”. Leksemat (zemrash, syve), të cilat nuk kanë valencë me pjesoren “ngrofë” dhe mbiemrin prejpjesor “e nxime”, që përftojnë dy stilema stilistike të gjetura, pikërisht falë “thyerjes” së valencës, a përdorimit të bashkimit sintaksor pavalent.

(...Në liqe të vjetër të Prespës / Përpiqen dielli e hana / mbramjeve verore n'ujë. / Ai bashkim i rrezeve, / dashnija e dy palë duerve / me gishta të kapërthyem, / a shmallimi i peshqve / në ma të shkëlqyeshmin shtrat: / - hana rrin e dielli shkon...) (“Liqeni i Prespës”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 194).

Duket se po shkruan Poradeci për liqerin e tij. Camaj ndalet para një peizazhi të rrallë, që i kalon për një çast para syve: mbrëmje vere, poeti-pikturor i fjalëve, ka kapur një moment që shfaqet e zhduket, me ndërrim të rendit sintaksor të drejtë/të zhdrejtë, është si një lojë tastire gjatë prodhimit të joneve tingëllore, për diellin që fshihet e hënën që del, kur bashkohen dy palë rreze si një dashuri e vetme njerëzore me kapërthim duarsh në personifikimin e peshqve në një shtrat të shkëlqyer uji: hana rrin e dielli shkon! Po vjen nata, koha romantike e dashurisë, pranë liqenit të Prespës.

b) Rendi asnjans i ka shërbyer autorit në disa poezi që të ruajë rimën e metrin, e më pas ai do të kalojë në prishje të këtij rendi për të tërhequr vemëndjen e të fitojnë ngjyrim vargjet.

(...*Ujë a ba gjethi e teshat e blegës / e pikat e shiut po bijnë mbi lum / dëshira e pjekun po bjen prej degës / shpirti s'don dhimba e shtati lyp gjum...*) ("Shiu mbi lum", në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 133).

Është ndër të paktat poezi të Camajt me rimë e metër të rregullt (në 11 rrokësh), thurur me rend të drejtë (asnjanës) sintaksor (S + P + A + C + O); është përsëri një ndërthurje e natyrës me një gjendje shpirtërore femërore, siç do ta shohim në mjaft poezi të poetit; dy fjalë "shtat-i" dhe "blegë-a" ka përdorur Camaj nga vlerat leksikore të fjalësit vendës, që janë mjaft tingëlluese, stilemore dhe mund të përfshihen në leksikun e përgjithshëm të gjuhës sonë.

(...*Ushtima ktheu përsëri në lum, / Pranverë, e ndër sy tu kthej unë, / Tue mbajtë ndër duer gjahun e vramë: / Mëllija, shepka e piktha trazuesa zguresh...*) ("Asaj që i përngjante pranverës", në *Vëllimi 3*, Tiranë, 2010, f. 145).

Është vjershë e Camajt, që nis me rimë e metër (në tre vargjet e para) e më pas kalon në varg të lirë. Kemi një pamje peizazhi pranveror, me ushtimë lumi dhe një gjahtar me duart plot zogj që ka vrarë asaj stine. Folja – predikat në vargun e dytë, mban gjithë "peshën" kuptimore e sintaksore të dy vargjeve të fundit ngarkuar me gjymtyrë funksionale homogjene.

(...*Era e krabnjerrit mbet e para dashni / n'fangjet e sukave verore n'muzg. / Gjumin ma qiti rrokja e shkambit n'Dri / dhe era e gurit t'shtypun më pëlqeu...*) ("Grue e pjekun", në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 158).

Duket se është një skenë kujtimi që vjen vetvetiu në mendjen e një gruaje të pjekun (të moshuar), që me Drinin dhe ujët e tij ka lidhur jetën, herë me bukuri, herë me dëshpërim, skena që e kanë shtangur; është ndër të rrallat poezi të Camajt me rimë dhe metër. Ky Dri që i ka dhënë mjaft pamje gëzimi, të parat dashuri, por edhe ia ka shkatërruar jetën e të ardhmen, e ka izoluar, e ka lënë pa dije (analfabet). Rendi asnjans sintaksor në dy vargjet e para e të fundit, përthyer me vargun III me rend emfatik (O + P + S + C).

c) Në gjuhën shqipe çdo tip fjalie ka gjymtyrë të domosdoshme dhe një numër mesatar të zakonshëm të gjymtyrëve. Luhatjet kundrejt këtyre modeleve shfrytëzohen për shprehësi³³⁶.

Tek pasazhi poetik i mëposhtëm kemi vënë re ndërtimin me fjali njëshe, pa subjekte (kryefjalët përkatëse), ku mungesa e gjymtyrës së nevojshme quhet elipsë³³⁷.

(...*Në kalim po marr me vete / sall duert e mija prej mëndashit të bardhë / që të baj kunora rrajësh me hjekë merzin / atje ku shkoj. / Në zungthat e thatë te buza e kënetës / zanin tem po u la. / zanin tem, therra iriqi, / gerhatjen e këmishës së vjetër tue u shkyemun, / klithmen e qymeve të kalit në lahutë, / që në veri t'ushtojnë në ket vend / kundra bubullimave të motit në vjeshtë. / Ndoshta s'kam me vdekë njimend...*) ("Zanin tem po u la", në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 246).

Mungesa e kryefjalëve referente lë gjurmët tek mbaresat vetore: janë 6 folje të shtjelluara, nga koha e tashme deri tek e ardhmja e veçantë e tipike vetëm në idiomën gege si formë

³³⁶ Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, Ribotim, Tiranë 2012, f. 83.

³³⁷ Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, Ribotim, Tiranë 2012, f. 83.

analitike (kam me vdekë), me vlerën “do të vdes”. Është si një testament i autorit për vendin dhe njerëzit e vet, një rrugëtim në dy jetët, por që “kunorat”, “zungthat”, “zani”, “këmisha e vejtër”, “qymet e kalit në lahutë”, “oshëtimat” dhe “bubullimat” kanë për ta mabjtur gjallë ende! Pamja ka gjithë jetën e poetit, nga fëmijëria deri në sosje të saj, shprehur me një leksik të vendit të tij, ku lindi dhe vazhdojnë të jetojnë njerëzit e tij. Në planin sintaksor ka ngjeshje gjymtyrësh funksionale me rend të përmbysur, siç ngjet nga vargu 6-9 i fragmentit, ndërsa 5 vargjet e fundit, në mënyrë simetrike, kanë adjunctive (rrethorë) të ndryshëm.

(...*Andej e këndej lumit shkambij / të bardhë e me rrasa të gjana. / Vetmija luate me rrezet e diellit / në pusat e ndritun t'ujit. / Atje vetëm vojta me gjuetun shejin. / Kisha mazerren nën krah / e hija eme e vogël në mjesditë ecte për anë / e zemra eme e madhe matet me lisa. / Vuna pushkën në faqe: / gishti tregues ngrehte kamzën kadalë / e mandej fluturoi shkëndija / prej synit në thumbin e tytës / e në shkamb përtej plasi dingaul / Ushtuen hummeret nji mbas nji: / me dy brijat e malit mirrsha frymë / e u ndala pa britë hiuhaa!...*) (“Andej e këndej lumit”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 62).

Nis fragmenti me fjali emërore në dy vargjet e para, vijohet me një fjali dyshe foljore, kurse më pas kalohet në fjali njëshe në 5 vargjet e tjera, përsëri alternime me fjali dyshe për t'u mbyllur me dy fjali njëshe foljore vetore të caktuara (I), rendi vjen përgjithësisht asnjans, sepse ka përshkrim të thjeshtë jo emotiv; dallojmë stilemat “marr frymë me bria mali”, “matet me lisa”; ka antonime si “hija e vogël”, “zemra e madhe”, gjejmë këtu një të dhënë etnografike për shenjën që gjuhet kur njerëzit dalin nga kisha, në vendin ku dallohen shejtarët.

(...*Zoteshtë, dy krena gjarpijsh ndër vllaj / gjij tu, qyshse vetdijse / për hijeshinë tande sadefti / për buze përvujtninë e vjollcës. / Dashnore e lilit të paçelun, / mëkati yt po të mbyt përditë / pse korpin tand të rrezitun / don me e pa në pasqyrën e hanës, / pse do me u ba sinor mes diellit / e njeriut...*) (“Zoteshtë”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 65).

Poezia nis me një formim neologjizmi nga fjala “zot” në “zoteshtë” – zoteshtë e hijeshisë prej sadefti, që del mbi përvujtninë e vjollcës, duke dashur veç lilin në gonxhe të paçelur ende; duket si motiv i narçizit koliqian për njeriun e dashuruar me veten, për t'u shndërruar në sinor (fushpamje) midis diellit e njeriut. Gjuhësisht, nga ana sintaksore, kumti ndërtohet me fjali njëshe vetore me vetë të caktuar, pasi subjekti lë gjurmë tek mbaresat vetore, por ato mund të perceptohen edhe si fjali përgjithësuese.

d) Duhet të vemë në dukje se në ndërtimet sintaksore shkrintari ynë duhet renditur si përdoruesi i *dukurisë së l'enjambement*.³³⁸

(...*Kishte ardhë për mik nji njeri i hajshëm / e i zbehtë si letra / Thoshin se ai me dorë të vet kishte vra / tre vetë e tash asht pendue. / E më kujtohet si dje / qeleshja e tij e bardhë, / nji sumbull e kuqe në kraholin e zi / e sjellja e përvujtë e ndeja e tij në shkam / pranë votre para nji tryeze të vogël: / nji të katërt bukë misri e 'i grusht krypë / kishte përpara – si mbas dëshirës së tij. / Kojet e bukës krisshin nën dhambët e njeriut / që përtypte trishtueshëm, njerzishëm / e me shije...*) (“Kishte ardhë për mik”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 26).

Në këtë sekuencë gjuhësore, është gjendja psikike e një vrasësi: i zbehtë si letra, sepse nuk ka gjak në fytyrë, ai ka derdhur gjakun e një njeriu, prandaj është zbehur. Ky pasazh

³³⁸ T. Topalli, *Gjuhësi teksti*, Shkodër, 2011, f. 276. *Lenjambement* / përkalim/ term që vjen nga një fjalë frenge që shënon hedhjen në fillim të vargut vijues të një a disa fjalëve.

ndërtohet mbi bazën e kontrasteve dhe krahasimeve, si: qeleshe e bardhë/sumbull e kuqe (gjaku i derdhur i njeriut), referim për sferën shpirtërore të njeriut pa mëkate e krime shoqërore si vrasësi i paraqitur këtu; atij i duhet të hajë me përvujtni dhe njerëzi bukën e dikujt, por pa iu hequr nga mendja vepra e kryer, prandaj dhe bie në trishtim – shfaqje që autori e jep me penelata leksikore, si me ngjyra. Nis fragmenti me fjali emërore në dy vargjet e para, vijohet me një fjali dyshe foljore, kurse më pas kalohet në fjali njëshe në 5 vargjet e tjera, përsëri alternime me fjali dyshe për t'u mbyllur me dy fjali njëshe foljore vetore të caktuara (I), rendi vjen përgjithësisht asnjans, sepse ka përshtim të thjeshtë jo emotiv; dallojmë stilemat “marr frymë me brijja mali”, “matet me lisa”; ka antonime si “hija e vogël”, “zemra e madhe”, gjejmë këtu një të dhënë etnografike për shenjën që gjuhet kur njerëzit dalin nga kisha, në vendin ku dallohen shejtarët; pa harruar dukurinë e l'enjambement-it, si në vargjet 1/2, 10/11. (...kishte vra + tre vetë)

(...Gjerza, e vetmja njollë / në qiellin e ndritun të Jugut / zgjon në mue ndjenjen e hapsisë / që mata dikur me vargun / e korrilave n'udhtim. / Krizmat e kaçubave në erë / bri prronit të thatë / e jehonat e largat të zhumburit / t'ujnave që ishin të turbullta / vejnë kufij mes qenjes seme tash e dje, / mes andrrës e gurit që e çoi prej dheut / dhe e tres në grumbullin e zhurit. / Marrfrymja e qetë, grue e mbështetun / në bar, në valën e parmzit tand m'avyt / prej majeve të bimve e ndër gishta / fjetet e indit / të një pëlhure t'unjishme...) (“Grue e mbështetun në bar”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 146).

Ngjan kjo poezi e Camajt me një fragment proze nga migjeniane me titull “Puthja e Cubit”. Është pamja e një njeriu që, ulur në kurriz, me sytë nga qielli vështron hapësirën e pamatë, duke e kufizuar me vijën që bëjnë korrilat në kaltërsinë e pafund. Nga ky përshtim në vetën e pare (sikur është vetë poeti), kalohet në rrethana zhumburi të ujnave të turbullta, që vënë kufij tek një qenie endërrimtare aty, me shikim nga qielli; pastaj, papritur, neologjizmi “marrfrymja” (frymëmartja) i vishet një gruaje, që, edhe ajo, shtrirë e me parzëm (gjoks) lart endërron, duke mbajtur fije bari midis gishtave, të cilat ngjajnë si inde të korpit të saj brenda një pëlhure në shtat! Ka edhe këtu dukuri të fenomenit l'enjambement, si në vargjet 4/5, 8/9, 13/14, 14/15 dhe në dy vargjet përmbyllëse; sigurisht, janë teknika jo të lehta të thurjes poetike, që aq saktë i zotëron Camaj.

(...Të zit e synit tand nuk due / ta ndeshi në shtiqet e ngushta. / Flakën e synit ta due mes fushës / e zemrën tande mollë, / të ndemun në degë, në naltsin / e krahut prej tokës. / Mos bzaj para muzgut / të njerzishëm në fushë / e erës zemërgjanë / që përqaqon çdo maje bari. / Lule, hiqe pëlhurën e zbetë prej hanës / e shtroje për tokë...) (“Koha e lules”, Pjesa II e ciklit, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 122).

Kjo pjesë e ciklit “Kanga e lules”, poezi simbolike që i këndon femrës së dashur, nis me l'enjambement krejt të natyrshëm në dy vargjet e para, mes dy foljesh që plotësojnë njëra-tjetrën, ashtu si përsëritet në vargjet 4/5 dhe vargjeve 5/6, për t'u rimarrë dukuria në fjalinë III (vargjet 7/8) dhe bëhet mbizotëruese nga ana sintaksore e semantike; shprehja poetike kalon në parafrazë: në vend të synit të zi – lexojmë “të zitë e synit”, në vend të “syrin të përflakur” që do të ishte një sintagmë poetike e Camajt, ndeshim “flakë e synit” – përcaktim më konkret dhe i drejtpërdrejtë; hidhet figuracioni me elipsë të lidhëzës karahasuese “si”: në zmerën si mollë – zemrën mollë të ndemun në degë aq sa merr krahu i njeriut për ta mbërri; më në fund figuracioni abstragohet me pëlhurë të zbehtë

hëne që duhet të bëhet shtrojë e dashurisë – një shprehje jo e lehtë për t'u kuptuar, kur dashuria vjen "mollë e ndaluar" në shoqërinë ku jeton poeti.

Gjuha e Camajt është e pasur me leksema dialektore, me fjalë "plaka" dhe shprehje frazeologjike të cilat gjejnë pasqyrim më së shumti në ligjërimin popullor. Dhe është e vërtetë që me pasurinë e thesarit gjuhësor, nga standardi e prurjet dialektore, Camaj arrin të shprehë atë që e dëshiron dhe ashtu si dëshiron, atë që duhet dhe si e sa duhet me anë të përdorimit të fjalës si me magji, me anë të formanteve të shumta dhe të larmisë së pakundshoqe të idiolektit të tij. Pikërisht, krijimtarisë së këtij shkrimtari jo aq të njohur deri më tani, do t'i shkante përshtat ajo që nënvizon një nga studiuesit e thukët të tij në planin letrar (të mitit, metaforikës dhe simbolikës), poeti dhe studiuesi i mirënjohur, K. Petriti, i cili nënvizon se *Fjala është e njëjtë për të gjithë, shpriti i fjalës është vetjak*.

(...Pava ndër qiellin e vrrinit dikur / tue kalue shum rë / dhe lumejt e tuebullt tue bajtun / gur e landë / Tue hy në t'shtatën vjetë / ujkun e pava n'ikje me bisht ndër kambë / e me veshë të çuem currek përpjetë. / Shkova me njerzit e mij / shtigjeve të ngushta t'malit / e pata û e ët. / Ndigjova ortiqet e bubullimën e motit / e fjalën "mos u tremb!" tim ët...) ("Tingujt e parë", në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 13).

Është një vizion, si një pikturë natyre, që i ka mbetur në kujtesë e shpirt poetit nga mbresat e fëmijërisë: qiell me re sipër vrrinit, lumenj të egërsuar me valë që bartin lëndë sipër tyre, një ujk i uritur trembshëm, shtigje malesh me ortiqe e bubullimë moti – përballë kësaj tabloje të frikshme për një shtatëvjeçar – fjala që jep zemër e të jatit "mos u tremb!". Gjithë peshën semantike autori e shpërndan si peshë nëpër disa kolona fjalësh, që janë: *vrrit*³³⁹, *re*, *lumej të tuerbullt*, *ujk me veshë currek*, *shtigje t'ngushta mali* (jeta e vështirë e malësorëve temalas), *me û e ët*, (i uritur dhe i etur bri lumenjve). Është një pasqyrë besnike, dhënë me pak fjalë e penelata si ngjyra peizazhi, mjete që i ka vetëm poezia dhe mjeshtëria e poetit të ri, pak më tepër se 25 vjeçar, Martin Camaj. Fjala "vërrini" e vargut të parë lidhet me jetën baritore, me fëmijërinë e vetë poetit, që duhet të ketë çuar një pjesë të viteve si bari nëpër mal e vërrin.

(...Ndodhi dikur, or burr, ke na një store / Kur brin e that mbi shpija e mblonte lisi, / Kur ishte humnerja atje vetëm tërthore, / Ndoshta tri shpia sall na kishte fisi. / Binte n'male bora, male biluri / E qiella e naltë e thimt si leshi i derrit. / Druni i dullis në shpellë u ndezte nuri / Para dy vllazne, vesh' në lkura berrit...) ("Sytë e gjarpnit", në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 246).

Është një tablo tipike e jetës baritore në Malësitë e Veriut, që Camaj e njeh, e ndien dhe e vizaton aq bukur; pra s'ka rrëfim në kuptimin e stores, por një pikturë dimri, bërë me ngjyrat që jep vetë stina e egër që mbështjell banorët e maleve, ku brinë (shpatin e kodrës) e thatë e mbëlonte lisi, me humnerë e tërthore (rrethinë fshati a rrugë me dredha), vetëm 3 shtëpi të veçuara midis egërsisë së natyrës, mali i bardh si biluri me bore të ngrirë dhe qiella e naltë me re të thinjura, që paralajmëron përsëri mot të lig; ndërsa në shpellën-shtëpi ndriçon driri i dullisë si nur, kur digjet në oxhak para dy vëllezërve që mbijetojnë brenda banesës së tyre, të veshur me lëkura berri (dash/dele).

³³⁹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 1184. *Vërrin-a*, f.sh.—(të) vend i ulët e i ngrohtë që nuk e zë era, kullotë dimërore në vise të ngrohta; dimërishtë; emër ambigjen: vërrin-ri (ni), ushqim i thatë, bar, jonxhë, kash të për dimërimin e bagëtisë. Në variantin gegë, më së shumti, përdoret në gjininë mashkullore.

(...*Shkyenje qiellin, zurla, / e kaltërsija e sferave të nalta / le të bijë mbi ne si shi. / Kamba e tupani çaj në tokën e me duer / virklojmë na shpatate me duer sutat / në mal i kapim në pikë të vrapit...*) (“Valle Rrugove”, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 24).

Ja dhe vazhdimi i tablosë më sipër, po kësaj radhe, jo e zymtë dhe e frikshme, e mjeruar, por si antitezë e natyrës të së pares, gjë që na del nga termat e përdorur si stilema, me një atmosferë kaltërsie, që s’pyet për shi, me curle, topane e valle ku vringëllohen shpata e vrapohet sa me zanë sutat (drenushat) në pike të vrapit. Folja “shkyenje” (shqyejeni) në urdhërore e pas saj, forma e lidhore – si urdhërore e zbutur – japin një gjendje ekstaze shpirtërore të një gëzimi njerëzor në gji të natyrës, mbështetur edhe në metaforat e qëlluara: “shkyenje qiellin”, “çaj në token”, “vringëllojmë shpatat” dhe idioma “në pikë të vrapit”.

(...*Vjollca që nis me çelë / i ka fletzat e njoma e të zbardhemta. / Ashtu dhe buza jote e mëngjestë...*) (“Koha e lules”, Pjesa V e ciklit, në *Vëllimi 2*, Tiranë, 2010, f. 124).

Krahasimi është i pazakontë, i gjetur poetikisht, që nga përcaktori nga të folmet geqe “të zbardhemta”, një poetizim i fjalës nga mbiemri “i bardhë”, një ngjyrim gjuhësor e stilematik; kurse sintagma emërrore (SN) “buza e mëngjestë” është krijim i Camajt, një mbiemërzim i emrit “mëngjes” kaq i goditur, që e ngre krahasimin në cilësi të lartë: buza e vajzës në një mëngjes vjen si lulevjollca që nis e çel gonxhe.

Si përfundim, mund të themi se shkrimtari-poet të gjitha e gjithçka i arrin me anë të gjuhës, përdorimit të saj me mjeshtri dhe me efekt të lartë shprehësie, të kursyer dhe me *fjalë-çelës*. Në ligjërimin poetik të krijimtarisë së Camajt të bie në sy së pari, pasuria dhe larmia e strukturavë sintaksore, përdorimi i rendit të drejtë sintaksor e thyerjes e së tij për qëllime stilistikore.

Së dyti, ndërtimi i fjalive njëshe, pa subjekte (kryefjalët përkatëse), ku ndeshëm dukurinë e elipsesë.

Së treti, në ndërtimet sintaksore shkrimtari ynë duhet renditur si përdoruesi i *dukurisë së l’enjambement*

Së katërti, shkrimtari vazhdimisht përpiqet të realizojë një ligjërim artistik sa më funksional, duke gërrshetur e harmonizuar me mjeshtri fjalë të zakonshme, të leksikut të gurrës popullore, herë-herë edhe krahinore (Temalit), me ato të zgjedhura, me termat e fjalëformimet librorë (ose të krijuara vetë) apo me leksikun e stileve funksionale të gjuhës së shkruar, që i përket mbarë shqipes.

Po e mbyllim këtë punim me thënien e njohur të psikolinguistit Wittgenstein³⁴⁰, i cili shkruante që *fjalën të mos e shohim nga kuptimi, por nga përdorimi...*, thënie që e kemi pasur parasysh gjatë trajtimit të këtij punimi.

³⁴⁰ L. Wittgenstein, *Filozofska istraživanja*, “Nolit”, Beograd, 1980, f. 56.

PËRDORIMI I VARIANTEVE GJUHËSORE NË TELEVISIONIN “KLAN KOSOVA”

Msc. Albulena Alidema & Msc. Majlinda Emini

Gjuha letrare shqipe, duke kaluar nëpër një rrugë të ndërlikuar e plot pengesa, ka arritur sot në shkallën e një gjuhe të përpunuar, të kristalizuar në hallkat e ndryshme të saj, të kodifikuar e të njësuar, të pasur të aftë për t'iu përgjigjur kërkesave të një shoqërie të zhvilluar e për të ecur më tej përpara³⁴¹.

Me gjithë arritjet e shumta të deritanishme ka ende mjaft punë për të bërë, për të siguruar përvetësimin e plotë të normës së gjuhës letrare dhe zbatimin e saj në të folur, e veçanërisht në media.

Dihet mirëfilli se mediat, si mjete përbashkuese të gjuhës, luajnë një rol të rëndësishëm në njohjen e gjithë thesarit gjuhësor, po ashtu, në anën tjetër, ato shërbejnë për ta prishur konceptin kohë.

Punimi është i karakterit sociolinguistik dhe trajton çështje që kanë të bëjnë me përdorimin e varianteve gjuhësore në televizionin “Klan Kosova”, me vështrim të veçantë, emisionin e mëngjesit.

Para se gjithash, duhet thënë se gjuha standarde e variantit të folur, për arsye të ndryshme, në pjesën dërmuese të mediave në Kosovë, karakterizohet nga një varg i gjatë shkeljesh të ligjeve gjuhësore, të cilat u takojnë të gjitha dijeve të gjuhësisë: fonetikës, fonologjisë, morfologjisë e ortoepisë në formën e ligjërimit gojor etj. Folës të ndryshëm, jo vetëm duke mos pasur njohuri rreth gjuhës standarde shqipe, por edhe për shkak të mendimit se kuptohen më mirë nga masa e gjerë, në këtë rast nga shikuesit e televizionit “Klan Kosova”, përdorin variantet gjuhësore.

Në këtë mënyrë, raporti gjuhë standarde-dialekt, gjen shprehje në pranimin e gjuhës së folur në media, por edhe në jetën e përditshme, e tërë kjo ndodh për shkak të mungesës së një norme ortoepike. Prandaj, kjo normë ortoepike duhet hartuar, ose së paku duhet hartuar një model shqiptimi.

Parë në dritën e fakteve, del se shqyrtimi i gjuhës së televizionit bëhet dhe më i vështirë kur dihet se në gjuhën tonë mungon një përshkrim i intonacionit model.

Pavarësisht kësaj, kohëve të fundit mbase janë bërë të shumta tekstet që kanë folur për (keq)përdorimin e shqipes në media, por kjo në vend që t'i motivojë mediat shqipe që ta përdorin drejt gjuhën standarde shqipe, si duket fare pak ka ndikuar, duke vazhduar kështu edhe më tutje tradita e shkeljeve të normës që e arrijnë edhe strukturën e shqipes dhe natyrën e saj³⁴².

³⁴¹Domi, Mahir; Ajeti, Idriz-Akademia e Shkencave e Shqipërisë- Konferenca Shkencore Gjuha Letrare Kombëtare dhe Bota Sot, 20-21 nëntor 1992, Tiranë 2002, fq 23.

³⁴²<http://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=51>

Është i pamohueshëm fakti se në nënsisteme të ndryshme të shqipes letrare kanë hyrë e bashkëjetojnë edhe dukuri gramatikore e elemente të tjera gjuhësore të dialekteve deri edhe ndër ato që përbëjnë dallime kryesore, pra edhe në media kemi përdorime të ndryshme të varianteve gjuhësore, prandaj me të drejtë shtrohet pyetja: a duhet të ketë përdorime të varianteve gjuhësore në media, ose më mirë, a lejohen variantet në gjuhën standarde? Dhe përgjigja në këtë pyetje nuk del të jetë shumë e lehtë, sepse një gjendje ideale, siç është e njohur botërisht, do të ishte të mos kishte përdorim të varianteve gjuhësore në media, pasi që ato, pra mediat, në rastin tonë, do të duhej të luajnë një rol të rëndësishëm për njësimin e gjuhës standarde shqipe.

Por, për fat të keq, në mediat tona, e posaçërisht në televizionin “Klan Kosova” kemi përdorime të varianteve gjuhësore tej mase, prandaj përdorimi i tepruar i këtyre varianteve ka dhënë shkas për nxitjen e shumë diskutimeve, ku gjuha e sotme e folur në TV dhe në masë të madhe edhe jashtë tij, është paraqitur apo parë si një antimodel i shqipes.

Pavarësisht kësaj, ekziston edhe një e vërtetë se variantet e format e ndryshme funksionale të shtresimit të strukturës së gjuhës sonë kombëtare nuk janë hulumtuar sa dhe si duhet, por as nuk janë vështruar, analizuar dhe studiuar në mënyra të njëllojta nga gjuhësia jonë.

Mjetet e informimit nuk janë vetëm kronikë e ngjarjeve në vend dhe në botë, por ato, me rubrikat e llojlojshme, janë edhe tribunë e jetës kulturore, artistike, arsimore³⁴³, pra ato duhet të pasqyrojnë një gjuhë standarde të mirëfilltë, por për fat të keq, në mediat e Kosovës, e posaçërisht në televizionin “Klan Kosova”, nuk pasqyrohet një gjuhë standarde e mirëfilltë, përkundrazi, kemi përdorime të varianteve gjuhësore, të cilat janë në kundërshtim me vetë natyrën e frymën e shqipes. Në rastin e analizës sonë, del se te ky televizion, numri i përdorimeve të tilla është tepër i lartë në krahasim me mediat e tjera të folura, të cilat së paku mundohen ta respektojnë normën letrare, gjithnjë brenda kornizës së aftësive dhe zotësive të moderatorëve dhe drejtuesve të emisioneve përkatëse televizive.

Për ta parë nivelin dhe shkallën e zbatimit të normës së gjuhës standarde të folur në televizionin “Klan Kosova”, dhe përdorimin e varianteve gjuhësore, ne kemi monitoruar emisionin e mëngjesit “Ora 7”, dhe për shkak të kufizimit, do të ndalemi vetëm tek ndryshoret kryesore me pikëvështrim te:

- përdorimi i zanores a kundrejt ë;
- përdorimi i pjesoreve të shkurtra, në vend të pjesoreve të zgjatura me –ur;
- përdorimi paskajores gege, në vend të lidhores;
- Përdorimi i grupeve mb, nd;

Po ashtu, përgjatë monitorimit të këtij emisioni, jemi munduar të sjellim mënyrën dhe shkallën e përdorimit të ndryshoreve të tilla.

“Çdo individ, që mendon të punojë në media, e sidomos në ato të folura, ne mendojmë se duhet ta njohë mirë gjuhën standarde dhe duhet ta përdorë atë gjatë punës së tij dhe t’i përdorë këto njësi gjuhësore që i përmendëm më lart.

³⁴³Nesimi, Remzi-Akademia e Shkencave e Shqipërisë- Konferenca Shkencore Gjuha Letrare Kombëtare dhe Bota Sot, 20-21 nëntor 1992, Tiranë 2002, fq 115

Në vëzhgimin tonë, ne jemi përqendruar në këto tipare dhe mendojmë që çdo shmangie nga përdorimi i këtyre ndryshoreve dhe zëvendësimi i tyre me njësitë alternative dialektore, sigurisht që rezultojnë me lëvizje të kodit drejt formave dialektore.

Për të realizuar hulumtimin tonë, ne kemi inçizuar tri intervista të zhvilluara gjatë emisionit të mëngjesit në "Klan Kosova". Në këto intervista të intervistuarit i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa edhe intervistuesit, përveç në intervistën e dytë, janë meshkuj gjithashtu.

Në vazhdim do t'i paraqesim gjetjet dhe përfundimet tona lidhur me zbatimin e normës standarde të folur në televizionin "Klan Kosova", po për arsye të privatësisë së gazetarit dhe mysafirit të ftuar në studio, pra intervistuesit dhe të intervistuarit, do t'i titullojmë me subjekti 1 dhe subjekti 2.

Intervista e parë

Subjekti 1:

Është duke u majt edicioni i nimbdhjet i festivalit Skena AP/që është festivali i teatrit dhe i filmit studentor a po? Cka po ndodh me Skenën Ap a ia fillon sot?

Subjekti 2: Sot në ora 7 fillon festivali Skena Up edicioni i nimbdhjet edhe realisht i kemi kry gjitha parapërgatitjet/ jemi tu i prit musafirët/ veç kanë fillu disa musafirë me ardh edhe na vin diku rreth 100 musafirë pej gjithkah pej plot veneve të botës/ ma interesant ata që vine pej Tajvani, Honkongu, do vene pak ma të largta, kështu përveç këtyne që vinë nga Amerika edhe do vene tjera/ po menoj tash nashta e kemi ba edhe një eksperiencë qe njimdhjet vjet gati edhe po menoj gjithçka po shkon mirë edhe menzi po presim me ja nis.

Pavarësisht se subjekti 2 ishte nje mysafir i arsimuar, ai nuk bën fare përpjekje të flasë në gjuhën standarde shqipe, pra ai të tërë bisedën e realizon në variant. Te ky person vërejmë që tiparet dialektore janë më të shumta në raport me ndryshoret sociolinguistike të standardit. Në të folurit e tij ai përdor fjalët me ã hundore në vend të ekuivalentit standard ë, përdor formën e shkurtër të pjesores, edhe përcjelloren e përdor në formën e variantit gjuhësor. (veç kanë fillu disa musafirë me ardh, jemi tu i prit musafirët), po ashtu ai përdor paskajoren geqe në vend të lidhores, grupet e bashkëtingëlloreve mb, nd i përdor në formë të ngurosur (përveç këtyre që vijnë nga Amerika dhe do vene tjera-nashta e kemi ba një eksperiencë qe njimdhjet vjet).

Intervista e dytë

Subjekti 1:

Pej 1983 tashti në Prishtinë, në Universitetin e Prishtinës që shumëçka funksionon nashta ma keq se në 83, qashtu po thojnë studentët që po studjojnë aty, shumë pej tyre. Sot kemi ftu subjektin 2, i cili ka shkrujt kto ditë në media një shkrim ku ka tregu gjithë ato vështirësi që po ballafaqohet UP-ja

Subjekti 1: A është Universiteti i Prishtinës qaq keq qysh e keni pasqyru në një shkrim?

Subjekti 2: Universiteti i Prishtinës është shumë ma keq se që kam mujt unë me e pasqyru me një shkrim të vetëm. Universiteti i Prishtinës në fakt nuk e ka njëfarë përcjellje çfarë duhet prej mediave dhe një vëmendje pej insitucioneve relevante për arsim, se po ta kishte pas, menoj se shumëçka kishte shku ma ndryshe në UP.

Edhe në intervistën e dytë vërejmë se as gazetari e as i intervistuari nuk bëjnë fare përpjekje për të zbatuar normën gjuhësore, por përkundrazi ata përdorin variantin e gjuhësor. Pra edhe te këta vërejmë përdorimin e ndryshoreve, të cilat i kemi marrë për analizim. Si: përdorimi i *ã* hundore në vend të *ë* (Universiteti është shumë ma keq... Universiteti i Prishtinës në fakt nuk e ka njëfarë përcjellje... se po ta kishte pas, menoj se shumë çka kishte shku ma ndryshe në UP). Po ashtu përdorin pjesoren e shkurtër në vend të asaj të zgjatur me *-ur* (Sor kemi ftu subjektin 2, i cili ka shkrujt kto ditë në media një shkrim ku ka tregu gjithë ato vështirësi që po ballafaqohet UP-ja. Gjithashtu vërehet edhe përdorimi i paskajores gege në vend të lidhores (...që kam mujt unë me e pasqyru me një shkrim të vetëm.) Grupet mb, nd, (...shumëçka funksionon nashta..., ...menoj se shumëçka...)

Intervista e tretë:

Subjekti 1: Tash po folim për një ndeshje tjetër, për ndeshjen Kosova-Haiti që do të mbahet më 5 mars në stadiumin "Adem Jashari" në Mitrovicë. Qysh po shkojnë përgatitjet?

Subjekti 2: Mirë, jemi n'fazën, n'javën e fundit t'përgatitjeve, n'përgjithsi janë t'gjitha si i kemi planifikuar, janë duke shkuar. Jemi çdo ditë, çdo ditë me një grup punues ashtu qysh e kemi formu nga Ministria e Kulturës, nga Federata, nga protokollit i shtetit, nga policia edhe nga ne organizatorët. Po ashtu e kemi edhe nje grup tjetër të komunës së Mitrovicës, ku ata janë tu u mirr me vendosjen e një parkingu t'përkohshëm munëm me kujt për ndeshje.

Në intervistën e tretë, për dallim nga dy të parat, vërejmë se i intervistuari përdor të dy format e pjesores, pjesoren e shkurtuar dhe atë të zgjatur me *-ur*. Gjithashtu vërehet edhe përdorimi i grupit nd, dhe përdorimi i paskajores në vend të lidhores.

Gjatë monitorimit të emisionit "Ora 7", kemi vërejtur përdorime të varianteve gjuhësore, jo vetëm të atyre që i kemi marrë në monitorim, përdorimi i *ã* -së hundore, përdorimin e pjesores së shkurtër por edhe përdorime të ndryshoreve të tjera të varianteve gjuhësore, pra, këtu të tëra bisedat realizohen në variant gjuhësor, madje as Subjekti 1 (gazetarët) e as Subjekti 2 (mysafirët në studio) nuk bëjnë as më të voglën përpjekje, që shikuesve të tyre t'u sjellin diçka nga gjuha standarde shqipe, për aq kohë sa zgjat emisioni në TV. Pra, me aq sa rezulton nga kjo analizë, është e nënkuptueshme se gazetari, i cili potencialisht mund të jetë më i thirrur dhe më përgjegjës për ta respektuar përdorimin e gjuhës standarde shqipe, për shkak të profesionit që ka dhe mediumit ku punon, as subjekti 1 as subjekti 2, fare nuk e respektojnë gjuhën standarde shqipe, por që të dy përdorin variantet gjuhësore. Dhe për më shumë, shqetësues vazhdon të mbetet fakti se këto, përdorime të tilla i gjejmë me bollëk.

Po ashtu, përveç këtyre të gjeturave që u evidentuan më lart, shumë më të mëdha janë problemet që dalin në fushë të sintaksës, kryesisht, për sa i përket zbatimit të normës letrare. Këtu, në të shumtën e rasteve rendi i fjalëve në fjali krijon probleme të mëdha dhe vazhdimisht të përsëritshme, krejt kjo, si rrjedhojë e mënyrës së përdorimit të gjuhës nga folësit, qofshin ata mysafirë apo edhe vetë prezentues emisionesh në TV, mirëpo, për shkak të kufizimit kohor te këto raste do të ndalemi në ndonjë kumtesë të veçantë me ndonjë rast tjetër.

Për ta mbyllur, dëshirojmë të theksojmë se, përgjegjësia për mbrojtjen e pastërtisë së gjuhës shqipe duhet të jetë e gjithanshme dhe jashtë kësaj nuk duhet të mbeten as

televizionet dhe mediumet e tjera. Aktualisht, te ne, nuk kemi ndonjë normë ligjore që sanksionon një obligim dhe përgjegjësi të tillë, por, megjithatë konsiderojmë se, vënia në promovimin e përdorimit të gjuhës standarde, pashmangshëm do të duhej të ishte një lloj misioni në vetëvete i medimeve, para se gjithash, i televizioneve.

Dhe krejt në fund, me aq sa u tha në të gjeturat e prezantuara në këtë punim, na duhet të konstatojmë me keqardhje, se "Klan Kosova", në vend se të dëshmojë përpjekje serioze për promovimin dhe mbrojtjen e gjuhës standarde shqipe, fatkeqësisht, është shndërruar në një shpërndarës të degradimit të shqipes standarde.

TIPIZIMI I PERSONAZHIT KRYESOR TE ROMANI “PALLATI I ËNDRRAVE” I ISMAIL KADARESE.

Alta Haluci

Universiteti “Ismail Qemali”, Vlore

Departamenti I gjuhës shqipe dhe letersisë

Paraqitja e tij në planin fizik dhe shpirtëror

Ebu Qerimi është personazhi kryesor i romanit “Pallati i ëndrrave”, një personazh rreth të cilit vërtiten të gjitha ngjarjet dhe dukuritë e këtij romani. Është një personazh disi i vecantë për shkak të karakterit që atë e karakterizon, është një personazh i cili karakterizohet nga ndjenja e ankthit dhe e tmerrit, ndjenja keto që e shoqërojnë gjatë gjithë romanit.

Kadare si një shkrimtar unik që është na e paraqit figurën e Ebu Qerimit edhe nëpërmjet mjedisit që atë e rrethon, pra mjedisi është pasqyra më e qartë e gjëndjes shpirtërore të personazhit tonë, mjafton që lexuesi të njohë ambjentin që e rrethon këtë personazh për të kuptuar botën shpirtërore të tij. Kështu për ta argumentuar mjafton të sjellim një fragment nga romani në lidhje me këtë çështje:

...Mëngjesi ishte i lagësht e me sqotë. Ndërtesat masive me portalet e tyre të rënda e me kanatat e mbyllura, e bënë edhe më të hirët fillimin e ditës. Ebu Qerimi mbërthen kopsën e fundit të jakës së palltos, vështron fenerët e hekurt të rrugës me sqotën e rrallë e cila vërtitej përreth dhe ndjeu një drithëtire në trup³⁴⁴...

Pra është një fragment i shkëputur nga romani, një moment ku Kadare bënë përshkrimin e një dite mëngjesore, të cilën na e shfaqë si një ditë të zymët, të turbullt dhe kjo nuk ndodh pa qëllim nga shkrimtari ynë i cili bënë një paraqitje të tillë për ta paralajmëruar lexuesin se e tillë do të jetë dhe gjëndja shpirtërore dhe bota e brendshme e Ebu Qerimit atë ditë.

Gjithcka lidhet më paraqitjen e tij të ‘Pallati i ëndrrave’, sepse ai e ndjente se prania e tij në atë pallat vetëm ditë të tilla mund t’i ofronte, dhe jo vetëm kaq por kjo ditë e ka shtuar praninë e ankthit dhe të tmerrit të Ebu Qerimi duke bërë që të jetë sa më pasiv dhe tepër i lëkundur në fjalët që ai thotë. Pra gjithcka lidhet me botën e brendshme të personazhit tone, një botë e rrethuar vetëm nga ndjesi të frikshme dhe jo një botë e karakterizuar nga qetësia shpirtërore.

Është Kadare ai, i cili ka zgjedhur këtë rrugë të tërthorte për ta paraqitur personazhin të lexuesit, por duhet të theksojmë se kjo nuk është e vetmja rrugë e zgjedhur nga shkrimtari sepse për të goditur në mendjen dhe në zemrën e lexuesit ai ka përdorur

³⁴⁴ Ismail Kadare “Nëpunësi i pallatit të ëndrrave”. Shtëpia botuese “Naim Frashëri”. Tiranë. 1981. fq. 1790

dhe rrugë të tjera të tilla si prania e monologut në roman ,një mënyrë ku duket sikur personazhi flet me lexuesin dhe ndodhet shumë prane tijë.Vlenë të theksojme se të gjitha situatat që e rrethojne personazhin tonë janë situata absurde ,të pakuptimta të cilat i sjellin vetëm ankth dhe aspak qetësi shpirtërore , madje mund të themi se i gjithë romani është i rrethuar nga të tilla situata ,ndaj po sjellim një të tillë:

...Ebu Qerimi e kishte kokën akoma të turullor kur doli në korridor,skishte asnjë frymë njeriu që ta pyeste se nga duhej të ecte ,ndaj nisi të ecte kuturu,dhe jo vetëm kaq por në veshë kishte ende copëra të fjalimit të nëpunësit të lartë³⁴⁵...

Është një tjetër moment i shkëputur nga romani i cili dëshmon për gjëndjen kaotike në të cilën ndodhet Ebu Qerimi ,një gjëndje e zymtë dhe e pashprese dhe është pikërisht moment kur personazhi ynë duhej të gjente zyrën e seleksionimit por ishte e pamundur që të arrinte te ajo për arsye e vetme se gjithcka që e rrethonte atë pallat ishte absurd dhe e pakuptimte .Mund të themi se situata në të cilën ndodhej ky personazh ishte një situata tragjike jo vetëm në pamjen e jashtme, por e tillë edhe në botë shpirtërore të Ebu Qerimit ,një gjëndje e cila nuk ishte e tillë në momentin kur ky personazh ishte në kërkim të zyrës së seleksionimit, por që në momentin e parë të kontaktit të tij me Pallatin e ëndrrave .

Kjo duket dhe në fragmentin e mesipërm ku Ebu Qerimi e kishte kokën të trullor kur erdhi në atë korridor ,pra me pak fjalë personazhi ynë nuk ndodhet në atë gjëndje vetëm në një moment të romanit por mund të themi në gjithë romanin .Pra si përfundim për sa i përket paraqitjes shpirtërore të personazhit tone mund të themi pa frikë se është një gjëndje aspak e pranueshme kaotike dhe tepër tragjike sepse ndjesite që kjo situata i ofron të tilla janë .

Për të kaluar në paraqitjen e tij fizike vlen të theksojme se Kadare nuk është shumë i dhënë në këtë aspektë ,pra shkrimtari ynë nuk merrt më paraqitjen e jashtme të Ebu Qerimit ,me tiparet e tij, por i përkushtohet më shumë botës së brendshme të tij ,gjëndjes psikologjike në të cilën ndodhet personazhi ynë,faktit se si dhe sa ndikon mjedisi në veprimet që ai kryen , sepse për poetin ajo është thelbësorja dhe më e rëndësishmja të individit ,por kjo nuk mohon mundësinë për të thënë se Ebu Qerimi paraqitet në roman si një personazh shtatëlartë ,i veshur më një pallto prej gëzofi me jakën e ngritur ku dorën e mbante te kjo jakë për shkakë të ankthit që e karakterizonte,pra kjo ishte paraqitja e Ebu Qerimit përta i përket aspektit fizik dhe atij shpirtëror.

Situatat që e rrethojnë personazhin

Ashtu si e përmendëm më sipër Ebu Qerimi është një personazh me një karakter disi të vështirë për t'u kuptuar .Është një personazh i karakterizuar nga ndjenja e ankthit dhe e tmerrit dhe jo vetëm kaq, por janë të vetmet ndjenja njëzore që mbizoterojne në roman ,ndaj duke qënë prezente te Ebu Qerimi të gjitha këto ndjenja është më se normale që të gjitha situatat që do e rrethojne këtë personazh do jenë të natyrave të ndryshme .

Ebu Qerimi përta i përket natyrës së tij është një personazh kompleks ,një personazh i cili nuk ndalet përpara asgjëje dhe synimi i tij i vetëm është të kapi majat e suksesit pavarsisht se cili do të jetë cmimi .Ndaj duke qënë prezente të gjitha këto synime te ky

³⁴⁵ Ismail Kadare" Nëpunësi i pallatit të ëndrrave".Shtëpia botuese"Naim Frashëri ".Tiranë1981.fq.190

përsonazh është e logjikshme se situatat nëpër të cilat ky personazh do të kalojë do të jenë të shumëllojshme dhe jo vetëm kaq, por dhe të natyrave të ndryshme .Ne si lexues jemi të mireinformuar se në një tekst shkrimor qoftë poezi apo dhe romanë situatat janë pjesë e domosdoshme dhe tepër thelbësore të këtyre krijimtarive dhe jo vetëm kaq por janë baza mbi të cilën keto krijimtari ndërtohen.

Kështu mund të themi se situatat mbi të cilën është ndërtuar ky roman janë situatë absurde,ironike madje dhe dramatike duke sjellë ndryshim në botën shpirtërore të personazhit i cili është i vetmi që ndjen dhe i përjeton jo vetëm kaq, por që ndikojnë në vazhdimësinë e tij. Ndaj vlen të theksojmë se personazhi ynë është i përfshirë në një tërësi situatash ,situatë të cilat mbartin në vetvete një humanizëm dhe qëndrueshmëri realiste të vetë personazhit ,i cili është një personazh që është në kontakt të drejtpërdrejtë me këto situatë dhe jo vetëm kaq, por është i përfshirë në to dhe e ka gati të pamundur daljen prej tyre ,madje Ebu Qerimi jo vetëm që është prezent në këto situatë por i përjeton emocionalisht.

Për të vazhduar argumentin rrethë kësaj çështje mjafton të sjellim një situatë të tillë të shkëputur nga romani : “Një gabim në gjykimin e ëndrrës dhe gjithcka shkonë së prapëthi ,më kupton?Me një fjalë puna jonë s’është dhe sduhet të jetë një hamallëk ,ashtu sic mund të mendoj ose ti duket dikujt³⁴⁶”

Është një situatë e shkëputur nga romani, një situatë e mirfilltë ironike ,pra mund të themi se është toni i talljes dhe ai i ironisë që mbizoteron në këtë situatë .Gjithcka lidhet me momentin kur Ebu Qerimi duhet të bëjë interpretimin e ëndrrave ,një detyrë e vështirë ndaj dhe ai paralajmërohet në mënyrën se si duhet të punojë dhe në vlersimin që duhet të bëjë ëndrrave, por duhet të theksojmë se më shumë se sa një paralajmërim mund ta marrim si një kërcënim sepse dhe toni që është përdorur në këtë situatë i tillë është shumë therës dhe tallës .Në këtë roman nuk kemi vetëm situatë të kësaj natyre, por dhe të natyrave të tjera të tilla si absurde ,ndaj po sjellim një fragment të shkëputur nga romani që i korrespondon kësaj natyre :

...C’kërkon tha i panjohuri .-Këndej është e ndaluar të kalosh .Kërkoj interpretimin,-u përgjigj Ebu Qerimi .-Kamë një orë që vërtitem.Njeriu e shikon më dyshim .-Ti punon në interpretim dhe nuk e di si shkohet atje³⁴⁷ ?...

Pra është një situatë e shkëputur nga romani një situatë tepër absurd sepse dhe fjalët që përdoren në këtë situatë të tilla janë .Gjithcka lidhet me momentin kur Ebu Qerimi kërkon zyrën e interpretimit dhe jo vetëm kaq, por absurdja qëndron në faktin e vetëm se personazhi jonë është i punësuar në këtë zyrë ,por nuk e di vendodhjen e saj ,pra me pak fjalë mund të themi se përvec situatës e cila është absurd ,i tillë është dhe vetë Ebu Qerimi i cili interesohet për vendodhjen e zyrës së interpretimit edhe pse është pjesë e asaj zyre,dhe kjo duket në këtë fragment të shkëputur nga romani dhe në fjalët që ai thotë.

Është një situatë e cila vlen që t’i bëhet një analizë më e hollësishme për faktin e vetëm se duket sikur ndodhemi përpara absurdit Kafkian ,pra janë disa moment,situatë,ndodhi në roman të cilat dëshmojnë për ngjashmërinë që egziston në stil midis Franc Kafkës dhe Kadaresë .Pra kjo dëshmon që Kadare për të arritur një sukses të mëtejshëm në

³⁴⁶ Ismail Kadare”Nëpunësi i pallatit të ëndrrave”.Shtëpia Botuese’Naim Frashëri’.Tiranë.1981.fq233

³⁴⁷ Ismail Kadare “Nëpunësi i pallatit të ëndrrave’Shtëpia Botuese’Naim Frashëri’.Tiranë.1981.fq.236

krijimtarin e tij artistike ka përdorur dhe taktikën e marrjes së njourive,informacioneve nga shkrimtarët më në zë ashtu sic është dhe Franc Kafka.

Pra prania e absurdit në këtë situatë bëri që Kadare të cilësohet si një përkrahës i Kafkës dhe kjo është dicka për t'u vlersuar sepse që një shkrimtar të ndikohet nga një tjetër shkrimtarë për të arritur sukses në krijimtarinë e tij artistike nuk është dicka negative përkundrazi më shumë i shtohen vlerat.Si përfundim vlen të theksojmë së të gjitha këto situata janë prezente në romanin Pallati i Ëndrrave ,situata të cilat e kanë bërë këtë roman disi të vështirë jo vetëm për t'u lexuar, por dhe për të bërë interpretimin e tij, por kjo nuk e mohon faktin se prania e të tilla situatave është shumë e vlefshme për ecurinë dhe vazhdimësinë e këtij romani duke bërë që të jetë një roman që di ti rezistojë kohës .

Gjuha përkrah ndjenjave që e karakterizojnë Ebu Qerimin

Pallati i ëndrrave është një roman i cili karakterizohet nga një gjuhë komplekse ,një gjuhë e cila pengon kapjen sensuale të ides që shpreh teksti³⁴⁸.Por kjo nuk pengon faktin që kjo të jetë një gjuhë e pasur ,e pasur jo për sa i përket figuracionit, por situatave të shumta dramatike, absurde dhe ironike ,ndërthurjes së fjaleve me njëra-tjetrën si dhe kuptimi që fshihet në to.Gjuha në këtë roman është një gjuhë metaforike, por mbi të gjitha një gjuhë simbolike dhe kjo duket që në titull të këtij romani ,një titull i cili është i ndërtuar mbi bazën e dy elementeve simbolik :pallatit dhe ëndrrës.

Vlen të theksojmë se gjuha në këtë roman është një gjuhë e cila ecën paralelisht me dy ndjenjat mbizoteruese ,ndjenjën e ankthit dhe të tmerrit,dy ndjenja njerëzore që e karakterizojnë Ebu Qerimin duke i dhënë një natyrë me të tërhequr. Ebu Qerimi është një personazh i karakterizuar nga një humanizëm dhe qëndrueshmëri realiste ,dhunti të cilat bëjnë që Kadare të praktikojë rrefimin e tij të akullt me epitete që e paraqitin Ebu Qerimin të trembur dhe në ankth.

Ebu Qerimi ndodhet në një situatë dramatike ,ai ndodhet në një dyshim shpirtëror,kryqëzon rrugët me dyshimin e hijes midis shtëpise së tij dhe pallatit dhe jo vetëm kaq por vlen të theksojmë se qilimi i shtëpise së tij i kujtojnë personazhit tonë të njëjtën blu të zbehte që kanë dhe kupolat e pallatit, pra kjo dëshmon trazirën shpirtërore që e karakterizon këtë personazh ,një gjëndje kaotike dhe e paqëndrueshmë pra me pak fjalë e tillë është bota shpirtërore e personazhit tonë.Një gjëndje e cila paraqitet te lexuesi nga Kadare më anë të një gjuhe herë të thatë artistikisht dhe herë të pasur me figuracion.

Përsa i përket kësaj gjuhe vlen të theksojmë se e ka bërë të pasur dhe lloji i fjaleve që shkrimtari përdor ,fjalë të cilat i përkasin funksionit kumtues dhe atij emotive,janë fjalë të shkurtëra ,përsa i përket strukturës mund të themi se janë fjalë në funksionin e një sintagme dhe bartin një kuptim të drejtpërdrejtë.

Ndaj mund të themi se Kadare ka zgjedhur rrugën e shkurtër ku me pak fjalë synon të trasmetojë shume,pra me anë të simbolit poeti synon që lexuesi të kuptojë më shume se fjala mund të thotë.Pra Kadare ka zgjedhur këtë formë për të trasmetuar te lexuesi informacionin dhe jo vetëm kaq, por fjalët e përdorura nga poeti janë enigmatike,symbolike ,pra egzistojnë fjalë të cilat nenkuptojnë dicka krejt ndryshe nga ajo e paraqitura.

4. Ebu Qerimi në marrëdhënie me personazhet e tjerë

³⁴⁸ Bashkim Kucuku"Kadare në gjuhët e botës ".Onufri.Tiranë.2005.fq.437

Ebu Qerimi është një personazh me një karakter disi të vështirë për t'u kuptuar ,është një personazh që në shumicën e rasteve është i karakterizuar nga pasiviteti dhe shumë pak e shohim aktiv në roman.Ai shfaqet i të tillë që në momentin e parë të romanit ,pra në momentin kur niset në zyrat e Tabir Sarajt ku thjesht ecën me synimin e vetëm :mbërritjen në këto zyra .

Ebu Qerimi është një personazh i cili nuk e ka një personalitet të tijën dhe të prerë por që janë fjalët e të tjereve ato që luajnë një rol shumë të rëndësishëm në vendimet që ai merr .Është një personazh i cili arrin t'i jap prioritet gjithçkaje që i thuhet nga ata që e rrethojnë dhe jo që në qëndër të vendos idene dhe mendimin e tij ,kjo është dicka që shfaqet në shumë moment të romanit..

Ebu Qerimi gjatë gjithë romanit është në kontakt me personazhe të tjerë ,me mendimet dhe veprimet e tyre.Kontaktin më të madh ai e ka kur arrin në zyrat e Tabir Sarajt, sepse duke qënë një institucion politik është normale që është i karakterizuar nga lëvizje ,por duhet të theksojme se personazhi ynë është në marrëdhënie me individ të ndryshëm dhe jashtë këtij institucioni ,pra është në kontakt me nënën e tij ,kushëririne dhe pjesëtarët e tjerë të familjes.

Duhet të theksojme se përsa i përket rolit të Ebu Qerimit në një marrëdhënie komunikimi midis nëpunësve të institucionit apo dhe në disa raste dhe me kushëririn e tij është pasiv,pra personazhi ynë në një marrëdhënie të tillë komunikimi midis nëpunësve të institucionit, apo në disa raste dhe me kushëririn e tij është pasiv ,pra personazhi ynë në një marrëdhënie të tillë komunikimi nuk flet ,nuk shkëmben informacion, të jap mendime rrethë një çështje të caktuar, por që vetëm merrë informacion prej tyre .I gjithë romani është i karakterizuar nga moment të tilla ndaj mjafton të sjellim disa prej tyre .

...Turqit na dhanë neve shqiptarve atë që na mungonte –vazhdoi kushëririn për të tërhequr vëmendjen ,hapsirat e mëdha .Por edhe ndërlikime të mëdha tha Kurti-Jeta e një njeriu të vetëm koklaviset kur plekset me mekanizmin e pushtetit ,pale pastaj drama e një populli të tërë ...Ebu Qerimi dëgjonte si i mahnitur ,por asnjë fjalë nuk fliste ,,,

...Mua kjo ëndërr më duket dicka e rëndësishme dhe zakonisht në raste të tilla është i këshillueshëm konsultimi me përvojën e vjetër | -Pa dyshim –tha Ebu Qerimi as që e vë në dyshim.Vecse...-Ti ske qënë ndonjëher në arkiv kështu që nuk mund të japësh mendim .

Këto janë disa nga momentet e shumëta në roman të cilat dëshmojnë për marrëdhënien që egziston midis Ebu Qerimit dhe personazheve të tjerë,një marrëdhënie e cila ndryshon në varesi të situatave, por që në shumicën e rasteve mbetet e njëjte për të gjitha situatat ,pra po flasim për rolin e personazhit tonë në këto situatë i cili është gjithmone pasiv dhe i paftë për të dhënë një argument të tijin ndaj dhe reagon në mënyra të ndryshme në situatë të tilla .

Për ta argumentuar më tepër këtë rol përqëndrohemi në paragrafin e parë ,është një paragrafë i cili ka të bëjë me marrëdhënien që egziston midis Ebu Qerimit dhe kushëririn të tij ,një marrëdhënie të cilës mund ti themi se është e ndërtuar mbi parimin fol –dëgjo, pra është kushëririn ai që vetëm flet dhe personazhi ynë dëgjon, por që në asnjë moment nuk reagon.Kushëririn flet për rolin e turqëve dhe Ebu Qerimi vetëm dëgjon dhe jo vetëm kaq por mahnitet nga fjalët e tij.

Ndërsa fragmenti i dytë lidhet me momentin kur personazhi yne shkonë te arkiva ku takohet me një nëpunës i cili fillon t'i flas për rëndësine e një ëndërr të caktuar dhe Ebu Qerimi vecse dëgjon, por nuk reagon dhe në një moment të vetëm që ai arrin dhe tenton

të thojë dicka nëpunësi e ndërpret .Pra edhe në një moment që personazhi ynë dëshiron të jap një mendim ,argument të caktuar,ai kundërshtohet pra me pak fjalë e tille është marrëdhënia që ekziston midis Ebu Qerimit dhe personazheve të tjerë,pra gjithmone pasiv dhe përqëndrohet në informacionin që transmetojne këta persona .

Por e rëndësishme dhe që duhet të theksohet është fakti se roli i këtij personazhi nuk është i tillë gjatë gjithë romanit, sepse ka dhe moment kur ekzistojnë dhe replika për çështje të ndryshme nga ana e personazhit tonë edhe pse në shumicën e romanit mbetet i tillë.Pra me pak fjalë i tillë është personaliteti i Ebu Qerimit ,një personalitet që e ka bërë një personazh të vecantë dhe karakteristik.Madje mund të themi se Ebu Qerimi mund të shprehet të reagoje vetëm në vetvete dhe kjo duket në një moment të tille:

..Punë e mallkuar tha me vete Ebu Qerimi ,i habitur edhe vetë nga ky cast rebelimii i ndërgjegjes së tij ..

Pra janë fjale të cilat dëshmojne për situatën shpirtërore në të cilën ndodhet ky personazh madje ai arrin të habitet dhe nga një cast rebelimi i ndërgjegjes së tij .Mund të themi se mjaftojne këto fjalë për të përcaktuar karakterin e personazhit tonë dhe jo vetëm kaq por që dhe marrëdhënia me të tjerët e tillë do të mbetet .Pra gjithcka e trajtuar në këtë çështje është e lidhur me rolin e personazhit tonë në një akt komunikimi i cili në shumicën e rasteve mbetet tepër pasiv, por kjo nuk do të thote që nuk argumenton dhe nuk shkëmben debate apo të jap informacion për një çështje të caktuar.

Përfundime

Është e rëndësishme të theksojme se të arrish të bësh analizën e një romanit të Kadarese, sic është romani “Pallati i ëndrrave” është një punë si e vështirë po aq dhe e bukur,vështiresia rrjedh prej faktit që romani i përket krijimtarise artistike të këtij shkrimtari kaq të talentuar ,i cili karakterizohet nga një krijimtari disi e vështirë për t’u interpretuar, por nga ana tjetër është dhe kënaqsi të arrishë të punosh me veprat e arta të Kadares.

Të analizosh romanin Pallati i ëndrrave është sikur të ndodhesh përpara një labirinthi,është një roman në të cilin trajtohet gjithcka në të gjitha këndvështrimet .Dukë arritur në përfundimin e analizës së këtij romani ,lexuesi arrin të njohë qëllimet e vërteta të Kadares në këtë roman dhe jo vetëm kaq por ai arrin të përfshihet emocionalisht në roman dhe ta ndjejë veten pjesë e tij dhe pikërisht kjo është një cilesi e Kadares, pra ta bëjë lexuesin jo vetëm që ta terheq vepra e tij letrare, por dhe ta përjetoje sikur të ishte ai protagonist në të.

E gjithë kjo menyrë e ndërtimit të romanit të Kadarese është një risi jo vetëm për krijimtarine e tij artistike, por për gjithë kulturën artistike të popullit shqiptar.Përfundimin më që ne marrim është bindja se folklori ynë kulturor është shumë i pasur me vlera të pacmuar vlera të cilat rrjedhin nga vepra të tilla artistike,vepra të cilave nuk u ikin këto vlera madje i rezistojnë kohës.

Bibliografia

Ismail Kadare“Nëpunësi i Pallatit të Ëndrrave”,Tiranë,1981

Bashkim Kucuku “Kadare në gjuhët e botës”,Tiranë,2005.

Ismail Kadare “Ftesë në studio”,Tiranë,1990.

ORGANIZIMI FAMILJAR DIKUR, FAMILJA BASHKËKOHORE SOT

Angjelina Hamza

Dega e Etnologjisë,

Instituti Albanologjik, Prishtinë

Përmbajtja e shkurtër: Në këtë kumtesë shkurtimisht dhe në mënyrë përmbledhëse jam munduar të sjell një krahasim të organizimit familjar tradicional dhe bashkëkohor dhe disa nga ndryshimet që pësoj familja shqiptare ndër vite. Mirëpo, edhe përkundër faktit dhe prezencës së këtyre ndryshimeve, duhet cekur faktin që : “Familja në raport me shoqërinë qoftë tradicionale qoftë bashkëkohore, bartë dhe përcjellë vlera të çmuara të familjes shqiptare në përgjithësi edhe në vazhdimësinë e zhvillimit dhe ndikimit kohor”.

Fjalët kyçe: familja, jetesa, organizimi, tradita, bashkëkohorja.

Hyrje

Familja është konsideruar dhe vazhdon të konsiderohet si një nga qelizat më të rëndësishme të çdo rendi shoqëror e si e tillë, ajo ka karakter historik.³⁴⁹

Mënyra e jetesës tek populli shqiptar njihet më tepër për një mënyrë patriarkale, ku familja kishte rend, organizim dhe respektim të rregullave brendafamiljare. Këto lloj familjesh të njohura ndër ne si familje të mëdha, përbëheshin nga disa familje, që sot i quajmë familje qelizë apo bërthamë familjare, që nënkupton se numri i anëtarëve ishte i madh dhe i ndryshueshëm.

Po ta hedhim një vështrim në kronologji të familjes patriarkale, shohim se me familje të madhe nuk kuptohej vetëm baza numerike e familjes por organizimi në të cilin kemi të bëjmë me titullarin apo zotin e shtëpisë. Madje edhe nëse në familje jeton vetëm qifti bashkëshortor, pra burri dhe gruaja, aty fjalën kryesore e kishte burri.

kryefamiljari. Familjet patriarkale shqiptare, kryesisht kanë jetuar duke u bazuar në kanunin e Lekë Dukagjinit.

Familja e madhe përmendet ndër shqiptarë që në mesjetë: familja e njohur e bujare e Dukagjinasve, që ka jetuar, siç dihet, edhe në Rrafshin e Dukagjinit, përmendet qysh me 1281 si familje e madhe patriarkale, e cila është rritur, kështu që ka formuar një vëllazëri

³⁴⁹ Mark Krasniqi, *Gjurmë e gjurmime albanologjike*, Prishtinë, 1979, fq. 416

të tërë. Kjo familje e madhe e Dukagjinasve (prej së cilës ka qenë edhe ligjdhënësi i njohur Lekë Dukagjini), quhej edhe “shtëpia e fortë”.³⁵⁰

Gjithnjë duke iu referuar studimeve të autorit Mark Krasniqi, për vendet e ekzistimit të familjeve të mëdha do t'i cekim edhe disa nga ato vende si : Peja, Gjakova, Deçani, Vokshi, Prizereni, Podrimja, Opoja, Drenica. Përveç në Rrafshin e Dukagjinit, familje të mëdha patriarkale kanë ekzistuar edhe në Rrafshin e Kosovës. Këtu kemi Vushtrrinë me rrethinat e saj, por dhe tutje në gjithë hapësirat shqiptare.

Organizimi i brendshëm familjar

Organizimit në shtëpitë shqiptare me mënyrë jetese patriarkale, e dimë që kanë ka pasur rregull në çdo aspekt. Familja e madhe shqiptare para se gjithash, është një bashkësi njerëzish të lidhur me gjini gjaku, që kanë pasuri të përbashkët, në të cilën jetonin dhe punonin së bashku dhe i konsumonin frytet e punës së tyre.³⁵¹

Nga sa shohim më lart, kuptojmë se të gjithë pjesëtarët e familjes kanë punuar të organizuar në bashkësi. Këtë organizim padyshim e bënte kryefamiljari, i cili nëse ishte në moshë mund ta kishte edhe një ndihmës.

Organizimi i brendshëm i familjes së madhe shqiptare në Kosovë është i ngjashëm me atë që kanë pasur dikur familjet e mëdha ndër popuj të tjerë të Ballkanit, ku gjithashtu ekzistonte parimi i pasurisë së përbashkët, e ndarjes së drejtë të punës dhe të frytit të saj.³⁵²

Zoti i shtëpisë. -Siç u cek më lart udhëheqësi kryesor i familjes ishte zoti i shtëpisë. Në Kosovë kryefamiljari quhej “zot shpie”, kështu që vet termi tregon mjaft qartë se të drejtat e tij për udhëheqjen e shtëpisë ishin të mëdha. Këto të drejta ishin të ndara në dy grupe: në ato të nderit, dhe në ato materiale.³⁵³ Për mbrojtjen e nderit kryefamiljari tregonte kujdes të madh, bënte edhe sigurimin e armëve në raste nevojë. Por, ndër të drejtat materiale të kryefamiljarit, më të rëndësishme janë ato që kanë të bëjnë me anën ekonomike të familjes së madhe.³⁵⁴

Zoti i shtëpisë ka të drejtë të hyjë borxh, të shesë, e të blejë, të lidhë fejesa e martesë për meshkujt e vajzat e shtëpisë etj. Atij i dorëzohen të gjitha ato ç’ka i fitojnë anëtarët e tjerë.

Detyrat e kryefamiljarit ishin të shumta dhe të rënda, por që të gjithat kishin vetëm një qëllim, interesin e familjes (shih Ali Muka, Banesa Fshatare dhe familja e madhe, Tiranë 2001).

Nga puna dhe organizimi i mbarë, si dhe drejtësia e kryefamiljarit, varet edhe familja e bashkuar. Pas zotit të shtëpisë e kemi edhe zonjën e shtëpisë që luan rolin kryesorë në udhëheqjen e punëve në shtëpi.

“*Zoja e shtëpisë*”, - kjo udhëheqëse punët rreth bulmetit dhe gjithë organizimin e punëve ndër gratë (femra), pra me kuzhinën. Zonjën e shtëpisë e emëron i zoti i shtëpisë dhe zakonisht është gruaja e zotit të shtëpisë, por jo kushtimisht. Ajo i ka edhe ndihmëset e

³⁵⁰ Po aty, fq. 199.

³⁵¹ Mark Krasniqi, *Gjurmë e gjurmime albanologjike*, Prishtinë, 1979, fq. 209

³⁵² Po aty, fq. 218

³⁵³ Po aty, fq. 208.

³⁵⁴ Po aty, fq. 215.

veta, numri i të cilave varet nga madhësia e familjes, përkatësisht nga numri i bagëtisë. Detyra e saj është që të mjetë bagëtinë dhe të përgatisë bulmetin. Baçica kryesore, zoja e shtëpisë, vendos çka do të përgatitet për drekë ose për darkë dhe kujdeset për vekshin e gjellës³⁵⁵.

Pra secili anëtar i familjes i kishte punët dhe të drejtat e veta, dhe qe të gjithë punonin për bashkësi, ngase individualisht nuk kishin shumë të drejta.

Martestat. -Martestat bëheshin me radhë sipas moshës, për fatin e vajzave vendoste i zoti i shtëpisë. Dhomat ishin të ndara për qiftet bashkëshortore, ndërsa plotësimi i kushteve për veshmbathje, shkollimi etj. varehin nga kushtet ekonomike.

Dasma e varrimi bëhen me shpenzime të familjes. Secila grua ka të drejtë të marrë një muaj pushim në vit, të cilin e kalon me fëmijët e vet të vegjël në gjini (te prindërit ose vëllezërit).³⁵⁶ Pushimi apo e drejta "e t'panit" - shkuarja e saj në gjini realizohet dy herë në vit, në pranverë dhe në vjeshtë, pasi të përfundonin punët e fushës.

Mirëpo, sikurse edhe shumë elemente të tjera të martesës ka evoluar, në përputhje me zhvillimin e gjithanshëm të shoqërisë. Sot martesat, gjithnjë e më tepër po merr tipare të reja bashkëkohore.³⁵⁷

Familja sot, ndryshimet dhe sfidat bashkëkohore

Kohëve të fundit, familja si një ndër institucionet më të rëndësishme të shoqërisë, ka bërë disa ndryshime të dukshme në shumë aspekte si për nga struktura, organizimi, numri i anëtarëve etj.

Kështu që të flasësh për familjen shqiptare sidomos mbas viteve të 90'ta, krijohet një përshtypje që mund të shkruash për çfarëdo fenomeni rreth familjes, por jo për një familje me rend e rregull familjar tradicional. Familja e dikurshme e një sistemi patriarkal, sot nuk mund të haset.

Tashmë, konsiderohet që struktura e familjes shqiptare tradicionale është ndryshuar.

Tranzicioni në shoqërinë tonë, me të gjitha kushtet dhe rrethanat e ndikuara nga shumë faktorë qoftë ekonomik, social etj, ka bërë që familja si bazë themelore të pësojë ndryshime duke filluar nga struktura e gjer tek organizimi, rendi dhe rregulli brëndafamiljar.

Familja sot gjithnjë po ngushtohet, si në aspektin e numrit të anëtarëve, po ashtu edhe më rrethin e gjerë familjar. Arsyeja qëndron në atë se pjesën më të madhe të jetës e kalojnë jashtë shtëpisë, në punë.

Nëse dikur është folur për një familje shumë anëtarësh, sot flasim për një familje me një numër të vogël anëtarësh.

Nëse dikur flitej për një jetesë në një bashkësi, sot takohemi me bashkëjetesën edhe vetëm në mes të dy personave ose një çift paramartesor.

Ndryshimet në organizimin e jetës familjare sot madje shkojnë deri aty që një çift i ri mundet lirshëm të vendosë që ende pa u kurorëzuar zyrtarisht apo pa kryer asnjë ceremoni tjetër traditore, si fejesa apo martesat, të bashkëjetojnë për një kohë të pacaktuar.

³⁵⁵ Po aty, fq. 216.

³⁵⁶ Po aty, fq. 217.

³⁵⁷ . Bashkim Lajçi, Gjurmime Albanologjike, Pejë, 2007, fq-192.

Si indikatorë tjetër në ndryshimin e familjes janë edhe migrimi dhe lëvizjet fshat – qytet, dalja në botën perëndimore, martesat me komunitete të ndryshme fetare, kulturore, gjuhësore, etj.

Pranimi me të shpejtë dhe adaptimimi ndaj këtyre ndryshimeve, të sjell bindshëm përshtypjen që as nuk mund të pretendohet ruajtja e konceptit të familjes shqiptare tradicionale.

Ndryshimi nga tipi tradicional i organizimit familjar, ku mbizotëronte një ngrohtësi dhe harmoni familjare dhe grupe, sot shihet në tendencën për individualitetin e pavarur me çka synohet një familje sa më e vogël.

Përveç kësaj vlen të ceket që, dikur në përgjithësi familja shqiptare, mësohej të zbatonte në mënyrë sa më të përpiktë traditat, kulturën, fenë, dhe të gjitha ato rregulla që ishin krijuar dhe trashëguar më shekuj nga të parët tanë.

Por sot, nuk është e mundur të jetohej kështu, ndoshta jo nga mos dëshira, por nga dinamika e jetës. Ajo çka sot po e preokupon më shumë një shoqëri bashkëkohore, është aspekti material, të fokusuar më shumë në atë çka kemi, dhe jo ajo çka jemi, çfarë kulture kemi bartur me vite, dhe si po transmetohet tek te tjerët sot ajo kulturë.

Këto fenomene dhe çasje ndaj konceptimit të jetesës, e varfërojnë dukshëm një shoqëri, e veçmas ato të cilat pësojnë ndryshime nga një mënyrë unike tradicionale, në atë që të gjithë po e jetojnë bashkëkohoren.

Përfundim

Si përfundim lidhur me këtë çështje, vlen të ceket që këto dukuri të shfaqura në pika të shkurtra dhe përmbledhëse, janë nga ato që më shumë i takonin të kaluarës.

Mënyra patriarkale e organizimit familjar sot, rrallë që mund të ndeshët. Jetesa në bashkësi siç quhej dhe vazhdon të quhet jetesa në familje të mëdha, është në shpërbërje e sipër, për të mos thënë nuk ekziston më.

Koha dhe dinamika e jetës kanë krijuar raporte më të zbehura në familjen shqiptare, në aspektin e takimeve më të shpeshta dhe kalim të kohës së bashku, mirëpo përkundër këtij fakti solidariteti dhe rastet eaktuara (festa të ndryshme familjare, fejesa, martesat, vdekje, etj), janë ato që prapë ndikojnë dhe e bashkojnë familjen e gjerë.

Dikur ajo bashkësi dhe puna që ka qenë kusht për të mbijetuar familja, sot është kthyer në individualitet ku secili punon dhe mundohet të ketë jetën e vet larg nga ngarkesat e "bashkësisë".

Pra, ishin këto disa karakteristika të së kaluarës, të cilat pasqyrojnë një organizim të trashëguar në breznitë, e cila në psikologjinë e individit si trashëgimtare brezash kodifikohet me kuptimin e një vlere të shenjtë që është familja.

Bibliografia

- Krasniqi, Mark (1979), Gjurmë e gjurmime, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë.
 Muka, Ali (2001), *Banesa fshatare dhe familja e madhe* (tipi me shtëpi zjarri në qendër), ASH, IKP, Tiranë.
 Lajçi, Bashkim (2007), " Gjurmime Etnologjike", Pejë, 2007.
 Statovci, Drita (2004), «Mendësi dhe besime popullore për shtëpinë», Gjurmime albanologjike, Folklor dhe etnologji», nr. 31-2001, IAP, Prishtinë, 2004, f-91.
 Tirta, Mark (2001), Etnologjia e përgjithshme- familja patriarkale, Geer, Tiranë.
 Xhemaj, Ukë (2003), "Etnokultura shqiptare në Podgur (monografi etnologjike)", IAP.

Recensentë:

Dr : Bashkim Lajçi, Shef i Degës së Etnologjisë në Institutin Albanologjik të Prishtinës
Mr : Vlora Fetaj Berisha, Hulumtuese e pavarur në Institutin Albanologjik të Prishtinës

DREJTSHKRIMI I FJALËVE DHE I EMRAVE ME PREJARDHJE TË HUAJ NË SHQIPEN MODERNE

Anisa Çuni

Të gjithë ne jemi të vetëdijshëm që po jetojmë në një epokë globaliste me prirje drejt Europës, botës. Kjo periudhë globalizimi i përfshin të gjithë e për pasojë dhe gjuhën që ne flasim. Për shumë arsye, komunikimi sa vjen e rritet mes popujve të ndryshëm, kultura shqiptare po hapet gjithnjë e më shumë, duke marrë dhe dhënë njëkohësisht nga këto kontakte të shumta. Duhet pranuar se jeta e shqiptarëve kudo ku jetojnë, ka ndryshuar shumë jo vetëm në të ushqyer, veshur, mentalitet, por edhe në të folur. Sidomos pas viteve 90(nëntëdhjetë) janë shtuar shumë edhe prurjet e reja në gjuhë të cilat jo gjithmonë janë të kontrolluara dhe të sjella ashtu siç duhet. Pasoja të dukshme në zhvillimin e gjuhës pati dhe gjatë ndryshimeve gjeopolitike në plan ndërkombëtar e kombëtar, por që nuk ishin kaq të theksuara sa sot. Në këtë periudhë që po jetojmë gjuha shqipe quhet moderne dhe e hapur ndaj gjuhëve të tjera, por në një epokë globaliste, dihet se fiton ai që është më i fuqishmi, më i forti. Si një gjuhë me ndikim të ulët mbi gjuhë të tjera dhe me zhvillim më të vogël, (dihet që një gjuhë ndryshon shumë më shumë ngadalë se dukuritë e tjera) me aftësi të kufizuara për mbrojtjen e saj, ajo vetëm mund të pësojë nga dukuria e globalizimit. Ky globalizim, tashmë ka përfshirë në përmasë të gjerë gjuhën shqipe, sidomos nga gjuha angleze, e cila ka prestigj dhe bazë më të fuqishme në raport me gjuhët e tjera. Në gjithë këtë sa thamë, ajo çka duket më shqetësuese sot është anashkalimi i normës së gjuhës shqipe dhe zbatimi sa më pak i rregullave të saj në shumë rrafsh, po sidomos në dy drejtime kryesore:

- a) Së pari: anashkalimi i normës gjuhësore në rrafshet gramatikore-morfologjike, ndonjëherë edhe sintaksore, por sidomos në rrafshin leksikor, e veçanërisht në gjuhën e folur, pa përjashtuar edhe gjuhën e shkruar
- b) Së dyti: përdorimi pa kriter i fjalëve me prejardhje nga gjuhë të huaja, sidomos nga anglishtja e cila është bërë gjuhë ndërkombëtare.

Çfarë po ndodh realisht me gjuhën shqipe?

Kur dëgjon një bisedë midis dy ose më shumë personave, qoftë nëpër studio televizive, qoftë në ndonjë tavolinë të zakonshme e ke të thjeshtë të kuptosh se shumë herë nuk zbatohet etika e të folurit dhe norma e gjuhës shqipe. Jo pak herë shkelen rregullat drejtshkrimore e shqiptimore duke përdorur fjalë të gabuara në vend të të duhurave. Disa herë kemi dhe gabime gramatikore p.sh.: *prespektivë* në vend të *perspektivë*, *eskursion* në vend të *ekskursion* apo dhe

sintaksore të tipit *mos të lejohet kjo gjë* pjesëza mohuese para nyjës të, në vend të fjalisë së rregullt shqipe, *të mos lejohet kjo gjë*.

I pashmangshëm është edhe huazimi i fjalëve të huaja të cilat sa vijnë dhe bëhen më të shpeshta duke i kaluar dhe kufijtë e pritshmërisë. Thuhet që të huazuarit është një përvojë e gjatë dhe e pashmangshme për të gjitha gjuhët, përfshi edhe gjuhën shqipe që në fillimet e saj. Fjalët e huaja kanë hyrë në mënyrë të pandërprerë, me intensitet të ndryshëm në periudha të ndryshme. Kjo për shkak të ndryshimeve të shumta që ka pësuar vendi ynë përgjatë gjithë këtyre viteve. Si p.sh. kontaktet me disa shtete jashtë vendit, ndryshimet gjeopolitike, ndryshimet teknologjike, e ashtuquajtura epokë dixhitale etj. Të huazuarit si proces, është dukuri shumë normale për aq kohë sa elementi gjuhësor i huaj huazohet sepse paraqet një nocion të ri që nuk ekziston në gjuhën marrëse dhe nuk është lehtë ose e mundshme të gjendet ndonjë term a shprehje përkatëse për ta zëvendësuar. Futja e fjalëve të huaja bëhet sepse, përmes këtij procesi, edhe pasurohet gjuha, por kur ky fenomen është i tepruar dhe vetëm për t'u dukur, për t'i treguar të tjerëve që ti zotëron një gjuhë të huaj, atëherë gjuha shtrembërohet, deformohet duke u shndërruar në një mishmash të vërtetë. Personat që e deformojnë më shumë gjuhën janë i këngëtarët, gazetarët televizivë, politikanët, studentët (jo se përjashtohen grupet e tjera të njerëzve). Po ta dëgjosh me vëmendje të folurën apo tekstet e tyre dallon lehtë se fjalët e huaja janë të shumta. Duhet pranuar se ky lumë fjalësh të huaja përdoren prej tyre për trend, për modë, jo për domosdoshmëri, apo nevojë të gjuhës shqipe, e cila ka gjegjëset e saj shumë të bukura. Kjo përpjekje për të futur sa me shumë fjalë të huaja në zhargonin e tyre të përditshëm i ka hutuar edhe më shumë ata vetë duke bërë që të mos jenë të vetëdijshëm se ku dhe kur duhet të përdoret gjuha e huaj. Thamë se të huazuarit si proces, ka qenë i pranishëm që në fillimet e gjuhës, por ka qenë e pranishme dhe përpjekja për ndalimin e tyre. Në mënyrë të veçantë gjatë Rilindjes Kombëtare përpjekjet kanë qenë të shumta për të frenuar depërtimin e fjalëve të huaja (sidomos të turqizmeve) me qëllim shpëtimin e gjuhës dhe ruajtjen e identitetit kombëtar. Ndërsa sot duket sikur janë hequr pengesat që ndalin depërtimin e fjalëve të huaja. Ato kanë vërsuar dhe po vërsojnë me shpejtësi gjithë arealin gjuhësor të shqipes, duke na bërë të papërgatitur për të frenuar këtë dukuri kaq të përhapur. Për shkak të kësaj hapjeje të madhe të politikës, të ekonomisë dhe të kulturës së vendit tonë ndaj botës, gjuha shqipe nuk ka fuqi të mjaftueshme për t'u përballur me turrin e fjalëve të huaja, siç do të mund t'u qëndronin gjuhët më të mëdha, si: anglishtja, gjermanishtja, frëngjishtja, italishtja, turqishtja e të tjera, të cilat kanë me dhjetëra miliona folës madje edhe me një traditë më të gjatë drejtshkrimi në krahasim me shqipen. Pavarësisht të gjitha këtyre prurjeve me vend ose jo, të kontrolluara ose jo, gjuha shqipe ka vërtet nevojë për një përkujdesje më të madhe në disa drejtime, sidomos në çështjet e të huazuarit gjuhësor, për të mbetur e unifikuar në të gjitha trojet ku ajo flitet, shkruhet dhe është gjuhë zyrtare.

Disa huazime të panevojshme për gjuhën shqipe

Live, Flash, intimidoj, asete, spot publicitar, mesazh promocional(promo), etj. Termi i anglishtes që përdoret shpesh sot në mediat televizive është live (*lajv* apo *llajv*), p.sh.: jemi *live*, program *live*, këndoj *live* etj. Nuk është zgjedhje aq e mirë, kur kemi mundësi të themi shqip: *drejtpërdrejt*. Jemi *drejtpërdrejt*, ose flasim direkt nga kjo studio etj. Gjatë një emisioni apo spektakli televiziv që jepet direkt, është bërë traditë që të këtë një përmbledhje të shkurtër lajmesh dhe jo pak herë gazetarë të ndryshëm thonë, *flash informativ*, në vend të *lajme shkurt*. Dihet që kjo bëhet për modë, për trend dhe jo për nevojë të gjuhës, pasi ne fare mirë kemi fjalën përkatëse shqipe (shkurt). Po të dëgjosh politikanët shqiptarë më vëmendje kur flasin, ajo që bie më shpejt në sy sesa informacioni që ata japin, janë fjalët e huaja që ata përdorin. P.sh. huazimi anglo-italian *intimidoj/intimidim* nuk i duhet shqipes meqë kjo gjuhë marrëse ka fjalë që shprehin kuptimin e këtij huazimi, madje edhe në kontekste e kuptime të ndryshme, si: *frikësoj/frikësim, kanos/kanosje*. Ndërsa politikanët tanë e kanë më të lehtë këtë fjalë sesa fjalën shqipe. Gjithashtu shpesh dëgjojmë nga goja e gazetarëve fjalën angleze *aset/asete* për fjalën shqipe *gjë e çmuar, me vlerë të konsiderueshme*. Kuptohet që kjo përdoret me qëllim për t'u dukur si fjalë më me vlerë. Fjala *Spot* është një anglicizëm i bërë tashmë fjalë ndërkombëtare e cila ka kuptimin e një hapësire ose njoftim reklame në radio ose televizion. Ndaj do të ishte mirë që në vend të saj të përdornim fjalën reklamë e cila është më e thjeshtë dhe më e kapshme për dëgjuesin shqipdashës. *Mesazh promocional/promo* fjalë angleze që do të thotë një hapësirë e gjerë reklame, që i kushtohet zakonisht produkteve të reja, përmes të cilës synohet njohja e hollësishme e tyre prej konsumatorit. Ndaj do të ishte mirë të zëvendësohej me fjalën *reklamë e re*. Fjalë që shqiptohen në disa variante

Sipas rregullit të shkruar në Drejtshkrimin e Gjuhës Shqipe (1973)³⁵⁸ fjalët e huazuara prej italishtes dhe frëngjishtes që përmbajnë tingujt ç e s, në shqip shkruhen dhe fliten me c. Por a zbatohet kjo sot konkretisht tek fjalët p.sh: agjenci/agjensi, certifikatë/certifikatë, proces/proçes etj? Realisht edhe pse kanë kaluar shumë dekada që nga kongresi i drejtshkrimit të 1973, akoma nuk është ngulitur përfundimisht shqiptimi i rregullt i këtyre fjalëve. Pasi jo pak herë dëgjojmë nga punonjësit e zyrave të ndryshme apo njerëz të medias, televizionit të thonë p.sh *çertifikatë* nderi, për *çertifikatë* apo p.sh. *proçes zgjedhor* për *proces zgjedhor* etj. Kjo dukuri shqetësuese për shoqërinë shqiptare dhe gjuhën shqipe ndodh akoma për arsye se formimi gjuhësor i shqiptarëve, ose nuk është bërë ashtu siç duhet ndër vite, ose rregullat e vendosura në Drejtshkrimin e 1973 kanë nevojë për rishikim.

Gjest apo xhest?

Jo rrallëherë dëgjojmë fjalën *xhest* (xhest i lartë, xhest i ulët) nga përdorues të ndryshëm të njohur ose jo qofshin ata. Për fjalën *normative gjest*³⁵⁹. Çdokush mund të bëhet kureshtar për trajtën "gjest": ku e ka burimin, si ka zënë vend në shqipen letrare? Thënë me dy fjalë, *gjest* është një trajtë "e shqiptarizuar" e huazimit italian *xhest*, sikurse gjirafë,

³⁵⁸ Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe, Tiranë 1973, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe letërsisë f. 94

³⁵⁹ Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, Tiranë, 1980, Akademia e Shkencave e Republikës të Shqipërisë, f.613

alergji, gjeneral. Për shumë fjalë të huazuara nga italishtja e frëngjishtja, gjuhëtarët prej kohësh(1973) kanë vendosur të mos shkruhen e shqiptohen as me xh si në italisht(xhest) as me zh si në frëngjisht(zhest), por me gj(gjest) si do t'i shqiptonte, bie fjala, këto huazime një shqiptar geg. Në këtë kuadër është shpallur normë fjala gjest, por dihet që norma është e vështirë për t'u ngulitur, e për pasojë për t'u zbatuar gjerësisht në të gjithë shqipfolësit. Ndaj shumë herë shqiptimi për trajtën normative gjest, ngatërrohet me shqiptimin sipas vendit të origjinës "xhest".

Si t'i shqiptojmë emrat e huaj të futur në shqipe³⁶⁰?

Emra të rinj hyjnë herë pas here në shqipe sidomos prej gjuhësh evropiane dhe të tjera, por ajo që të bie menjëherë në sy është shqiptimi i këtyre emrave. Sapo shqiptohen emrat e huaj të protagonistëve të ditës, nga gazetarët e mediave televizive e ke shumë të lehtë të kuptosh si dhe sa mire e njohin ata një gjuhë të huaj. Le të marrim disa shembuj p.sh. emrin e ish sekretares amerikane të shtetit, znj. Hillary Clinton, i cili u përmend gjatë disa kohë edhe për shkak të kandidaturës së saj si presidente e Sh.B.A në (2008). Ajo që të bën më shumë kureshtar kur dëgjon të flitet për të në Shqipëri është shqiptimi i emrit dhe mbiemrit të saj. Nëse për mbiemrin e saj dëgjohet veçse një variant shqiptimi i përshtatur në shqip, *Klinton* (paçka se në gjuhën origjinale shqiptimi i saktë është *Klintën*) për emrin "variacionet" mbi shqiptimin origjinal janë të shumta. Folësit apo gazetarët që e dinë mirë anglishten, emrin e saj e shqiptojnë si në origjinal: *Hilëri*, duke ruajtur të pandryshuar theksin e fjalës. Ky shqiptim në të vërtetë nuk tingëllon i natyrshëm në shqipe. Përveç kësaj, është një shqiptim që s'mund ta përqafojnë të gjithë, sepse jo të gjithë e njohin anglishten shumë mirë që të imitojnë shqiptimet e saj. Ka folës të tjerë të cilët duke qenë të ndikuar nga italishtja e shqiptojnë *Hilari*. Por mënyra më e zakonshme dhe më e përhapur është ajo, që shqiptohet pjesërisht si në origjinal e pjesërisht sipas veçorive të shqipes(duke qenë se emri shkruhet me ll): *Hillëri*. Në këtë mori modelesh, modeli më i mirë që do të rekomandohej për t'u ndjekur në përgjithësi për emrat e huaj, do të ishte ai i të shqiptuarit sipas vendit të origjinës. Një shembull tjetër është ai i zonjës së parë të shtetit amerikan Michelle Obama, ku jo pak herë dëgjojmë nga goja e gazetarëve variante të ndryshëm shqiptimi për emrin e saj. Herë ai dëgjohet *Mishëll* i shqiptuar sipas vendit të origjinës së personit(Amerika) dhe herë të tjera *Mishël* i shqiptuar sipas ndikimit të gjuhës së origjinës të këtij emri, frëngjishtes. Të gjitha këto raste dhe të tjera si p.sh. mbiemri i aktorit të famshëm *Michael Douglas*, shumë pak herë shqiptohet *Daglës* si në origjinal dhe më së shumti e dëgjon *Dagllas*. Të gjitha këto raste dhe të tjera tregojnë se te ne ka akoma probleme të shqiptimit të fjalëve të huaja sipas vendit të tyre të origjinës d.m.th. imitimit si në origjinal, për të mos thënë që ka akoma probleme me mësimin e gjuhës shqipe dhe zbatimin e normave të saj ashtu siç duhet.

Që në Kongresin e Drejtshkrimit³⁶¹ të (1973) janë përcaktuar rregulla dhe parime sa i takon fjalëve të huaja dhe shqiptimit të tyre. Ja disa rregulla konkrete.

³⁶⁰ Jorgaqi, Kristina, Sportel i Hapur i Shqipes, Studime 2008, f. 20-56

³⁶¹ Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe, Tiranë 1973, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe letërsisë f. 23

Për fjalët me burim nga gjuhët klasike, drejtshkrimi i shqipes bazohet në trajtat e këtyre gjuhëve dhe jo në trajta që paraqesin veçori fonetike të kësaj ose asaj gjuhe nëpërmjet së cilës ka ardhur fjala në gjuhën shqipe.

Për ata tipa fjalësh, shqiptimi letrar i të cilëve është i njësuar dhe i përgjithësuar me kohë, ky kriter të jetë vendimtar në caktimin e trajtës së tyre drejtshkrimore; kështu të shkruhet aksion, funksion, biçikletë, çimento.

Te fjalët e huaja që kanë ia, ie, io, iu me i të patheksuar në trup të tyre, të ruhet në shkrim zanorja i, pavarësisht nga shqiptimi i saj si j në disa prej këtyre fjalëve Emrat e përveçëm të huaj të shkruhen duke u mbështetur në traditën e përdorimit të tyre në gjuhën shqipe dhe duke marrë parasysh shqiptimin në gjuhën përkatëse.

Të njëjtat parime dhe rregulla i ka rimarrë dhe trajtuar më hollësisht edhe Rexhep Ismajli në "Drejtshkrimet e Shqipes"³⁶², duke i specifikuar edhe njëherë rregullat, me qëllim përforsimin dhe zbatimin e tyre në të shkruar e të shqiptuar.

Emrat e përveçëm të huaj në një pjesë të madhe shkruhen sipas shqiptimit që kanë në gjuhën nga e cila janë marrë. Kështu shkruhen emrat e përveçëm nga gjuhët e Evropës Perëndimore. Për herë të parë mund të shënohet në parantezë edhe shkrimi sipas ortografisë së gjuhës së origjinës. P.sh. Bajron(Byron), Gëte(Goethe), Shekspir(Shakespeare).

Në emrat e përveçëm të gjuhëve sllave që kanë alfabet jolatin, ortografia shqipe në përgjithësi shkon pas grafisë e jo pas shqiptimit të këtyre gjuhëve. P.sh. në fjalët rusishte nuk shkruhet i-ja e shkurtër fundore pas një i-je: Gorki, Majakovski (Polevoi). Zanoret e jotizuara të rusishtes *jo, ja, ju*, pas të gjithë bashkëtingëlloreve, me përjashtim të bashkëtingëlloreve të buta *l, nj*, jepen me *jo, ja ju*: Jura, Vanja, Gala, Ludmilla (po Orel)

Emrat e përveçëm të huaj në shqipe do të lakohen e do të marrin nyjen e prapme duke iu ngjitur temës pa vizë, p.sh. Ciceroni, Ciceronit; Gëteja, Gëten; Shekspiri, Shekspirit.

Fjalët e huaja³⁶³ që kanë hyrë në gjuhën tonë relativisht vonë, që ndihen si të tilla dhe që i përkasin gjuhës së shkruar, sidomos terminologjisë tekniko-shkencore, si dhe emrat e përveçëm të kësaj kategorie do të shkruhen kështu:

Fjalët që kanë -ia, -ie, -io, -iu, me i të patheksuar në trup të tyre do të shkruhen po njësoj dhe jo me -ja, -je, -jo, -ju. P.sh: arian, diabet, dialekt, diasporë, diapezi, materie, minierë, portier, aksion, leksion, radio, stacion, natrium, akuarium.

Fjalët dhe emrat e përveçëm do të shkruhen me -ja, -je, -jo, -ju: Jasoni, Jupiteri, Jemen.

Në pajtim me traditën e shkrimit në gjuhën tonë, do të shkruhen me -i dhe jo me -j emrat e përveçëm që burojnë prej gjuhëve sllave: Cajkovski, Dostojevski, Gorki.

Fjalët dhe emrat e përveçëm me burim prej greqishtes së vjetër, të cilat në atë gjuhë kanë γ (ipsilon), do të shkruhen me i: amidon, analizë, dinamikë, polisemi,

³⁶² Ismajli, Rexhep, Drejtshkrimet e Shqipes, Prishtinë 2005, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, f.306-307

³⁶³ Ismajli, Rexhep, Drejtshkrimet e Shqipes, Prishtinë 2005, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, f.393-395

simbol. Po kështu do të shkruhen edhe emrat e përveçëm që s'janë të burimit grek, p.sh: Egjipt, Libi, Siri.

Fjalët dhe emrat e përveçëm me burim grek, latin a iliro-trak me au dhe eu, do të shkruhen po kështu, dhe jo me av, ev, ose af, ef: centaur, glauku, euripidi, europa

Fjalët dhe emrat e përveçëm të burimit latin-roman me kua, kue, kui, kuo, do të shkruhen me -u- dhe jo me -v- pas -k-së: akuarel, ekuacion, kuesturë, ekuinoks. Fjalët me burim latin-roman të cilat janë shkruar herë me c, herë me ç a me s para zanores e ose i, do të shkruhen me c: celebrim, central, ceremoni, kancelari, leucemi, agjenci, ciklamin. Në pajtim me këtë rregull edhe emrat e përveçëm do të shkruhen me c: Cezar, Ciklop, Lukreci, Horaci. Disa huazime të reja prej italishtes do të shkruhen me ç: biçikletë, çiklizëm, motoçikletë.

Komisia Letrare Shqipe Në Shkodër³⁶⁴ (1916-1918)

Puna e Komisisë për drejtshkrimin e gjuhës shqipe për herë të parë në historinë e gjuhësisë shqiptare do të hartohet një kod drejtshkrimor që është konsideruar nga J.Kastrati "pikënisje e normalizimit të shqipes së shkruar të përbashkët", ndërsa kodifikimi i parë i drejtshkrimit tonë ishte një punë sa shkencore aq atdhetare dhe besnike. Nga diskutimet dhe debatet u vendos për të hartuar "një ortografi sa më tepër të përbashkët për të dy dialektet". Komisia shpalli parimin fonetik si parim i gjithë praktikës gjuhësore të shqipes, d.m.th. gjuha do të shkruhet ashtu siç flitet prej popullit. Si themel i ortografisë do të merrej dialekti i Elbasanit me disa përmirësime. Në mbledhjen e dt. 29 janar 1917 u miratua për herë të parë një kod drejtshkrimor "Parime e rregulla mbi ortografinë e gjuhës së shkrueme", që është varianti i parë dhe dy ditë më vonë, 31 janar 1917 u nënshkrua nga Gj. Pekmezi, N. Mjeda, N. Paluca, L. Gurakuqi, S. Peci, Gj. Fishta, L. Naraçi dhe H. Mosi. Komisia Letrare po bënte një hap përpara për zgjidhjen e shumë problemeve drejtshkrimore, duke i afruar në të shkruar të dy variantet letrare.

Pranoi të shkruhen të plota togjet e zanoreve *ie, ye, dhe ue* që në dialektin e Veriut ato ishin monotongizuar.

Edhe grupet e bashkëtingëlloreve *mb, nd, ng, ngj* do të shkruheshin të plota.

Anëtarët e Komisisë Letrare u përpoqën që zanorja *a* të përdorej edhe në ato pozicione, ku në të shumtën e të folmeve të Veriut dëgjohej pak ose kishte rënë fare. Për përdorimin e *ë-së* Komisia dha zgjidhje të kënaqshme, ndonëse ishte një nga problemet më të vështira për t'u zgjidhur përfundimisht meqë ishte e kushtëzuar nga shumë faktorë dhe nga vetë zhvillimi i gjuhës letrare shqipe në atë kohë. Komisia Letrare Shqipe vendosi që "për të gjitha format gramatikore të gjuhës do të mbështetet në shkrimet e K. Kristoforidhit³⁶⁵, ndërsa për ato forma që nuk gjenden në këto shkrime, atëherë do të caktohen nga Komisia Letrare". Rregullat e drejtshkrimit që u vendosën ishin të lehta, të thjeshta dhe të kapshme, "pothuajse gjithëpërfshirëse". Ky dokument tepër i rëndësishëm do të çonte përpara njësimin e shqipes së shkruar, veçanërisht në disa sfera të caktuara të kulturës sonë.

Përfundime

³⁶⁴ Osmani, Tomorr, Komisia Letrare Shqipe Në Shkodër, Shkodër 2004, f. 57-68

³⁶⁵ Studime Shqiptare 8, Komisia Letrare Shqipe në Shkodër, Shkodër 1997, f. 36-44

Në fund të këtij punimi mund të themi se: gjuha shqipe është pasuruar shumë me fjalë të huaja, drejtshkrimi dhe shqiptimi i të cilave lë shumë për të dëshiruar pasi jo gjithmonë i përmbahet shqiptimit sipas vendit të origjinës duke shkaktuar një kaos gjuhësor. Është lehtësisht e dallueshme që njerëz të ekranit, folës në median televizive apo të shkruar bëjnë vazhdimisht gabime në drejtshkrimin dhe shqiptimin e fjalëve me prejardhje të huaj. Të gjithë këta folës, që të mos bëjnë gabime në shqiptimin publik të këtyre fjalëve, mirë do të jetë që të konsultohen më parë me përkthyes a kompetentë të këtyre gjuhëve (në mungesë të një njohje vetjake të "x" gjuhe të huaj). Shqipja standarde ka nevojë më tepër për norma konkrete, që njësojnë sjelljen gjuhësore të shqiptarëve dhe që sigurojnë komunikimin efikas mes folësve të saj, sesa për norma që krijojnë hapësira për keqinterpretime, apo mendime për zëvendësimin e tij, a krijimin e një standardi tjetër. Gjuha shqipe sot ka arritur në një gjendje të tillë, kur i nevojiten ndryshime të arsyeshme dhe të gjykuara drejt nga ekspertë të saj. Ajo ka nevojë për zhvillim të mëtejshëm, që të pasurohet edhe më tej. Me synimin që të mos ketë diskutime për kriteret e zbatuara për normën drejtshkrimore që Kongresi i Drejtshkrimi vendosi në 1973.

VEÇORI LEKSIKORE TË FJALORËVE DIALEKTORË-KRAHINORË (BARDHI, GAZULLI E BENEDIKT DEMA)

Dr. Anisa Kosteri

Të tre këta autorë, leksikografë, fjalorët e të cilëve, në llojin e tyre të veçantë, kanë pasqyruar të folmen e gegërishtes veriperëndimore, leksikun e të folmes së Malësisë së Madhe dhe zonave përreth saj, duke përfshirë edhe qytetin e Shkodrës; më së pari, për arsye se të tre janë folës të lindur të kësaj të folmeje.

Sigurisht që vlerat pozitive janë ato që e karakterizojnë këtë vepër prej pionieri duke e vlerësuar Bardhin si leksikografi, i cili mori përsipër të pasqyronte pasurinë leksikore të gjuhës së vet. Nëse e vështrojmë sot Fjalorin e Bardhit, i botuar 400 vjet më parë, nga majat që ka arritur leksikografia shqiptare në hartimin e fjalorëve, do të na dukej një vepër me përmasa të rrudhura e me prurje të pakët gjuhësore, por duke marrë parasysh kohën dhe periudhën kur u krijua, mund të themi se fjalësi i Fjalorit të Bardhit përfshin bërthamën leksikore të gjuhës shqipe si dhe të parë me rëndësi të madhe potenciale edhe për bazat e një gramatike shqip. Kjo vlerësohet edhe nga Kostallari si e para përjasje e pranëvënie e korpusit leksikor të një gjuhe të madhe të kohës, "latinishtes" me shqipen, ende në hullitë e para të lëvrimit të saj.

Nga Dom Nikollë Gazulli kemi "Fjalorthi i ri" (fjalë të rralla të përdorura në Veri të Shqipërisë), Qershor, 1941, i cili mund të thuhet se shënoi dhe lindjen e leksikografisë dialektore shqiptare. Si leksikograf solli ndihmesë të shquar në gjuhësi sepse e pasuroi njohjen e sinonimisë krahinore të leksemave bazë të shqipes, gërmoi edhe në aspekte të hollësishme të tematikës së sferave jetësore arësore, si fjalë të bujqësisë, të blegtorisë, të zejtarisë popullore dhe aty-këtu dhe të frazeologjizmave përkatëse. Nikollë Gazulli ishte i dhënë edhe pas folklorit dhe historisë, fusha në të cilat boton shkrime, këngë të moçme etj.

Benedikt Dema, edhe ky një tjetër leksikograf i cili u mor gjerë me hulumtime në trevat veriperëndimore në lëmë të të shqipes, u la në harresë bashkë me Fjalorin e tij, deri në vitin 2005 kur u botua nga shtëpia botuese "Toena", na la një fjalor krahinor, që shërben padyshim si bazë e mirë për një punë studimore të pasur gjuhësisht. Duhet shënuar se kohët e fundit, shkrimtari françeskan At Zef Pllumi, në botimin e XV të veprës epike të Gj.Fishtës "Lahuta e Malcis", ka përfshirë si shtojcë edhe një fjalor të fjalëve të rralla dhe me shumë kuptime, që gjenden brenda poemës së madhe, shpjeguar nga B.Dema. Ky fjalor ka 1361 fjalë nga të cilat pjesa më e madhe janë të brumit të shqipes, por nuk qëndrojnë pas edhe huazimet nga turqishtja, ndërsa fjalë të burimit sllav gjenden në numër më të vogël. Fjalori Benedikt Demës, për të cilin po shkruajmë, u përfundua në vitin 1966, me qëllim botimin, por nuk doli në dritë deri në ditët e sotme.

Po të nisemi me Fjalorin e Frang Bardhit, ose Dictionariumin e tij, vetë titulli në latinisht të lë të kuptosh se kemi të bëjmë me një fjalor latin, por po të hyjmë më në brendësi dhe

sidomos të kemi parasysh qëllimin e autorit për hartimin e këtij Fjalori, kemi të bëjmë me një Fjalor dygjuhësh latinisht- shqip, i krijuar me shumë funksione, ku së pari kemi pasqyrimin e leksikut të gjuhës shqipe dhe pasurinë e saj, si dhe idenë për t'u shërbyer klerikëve shqiptarë në mësimin e gjuhës latine, por edhe klerikëve të huaj që nuk kishin njohuri për gjuhën shqipe.

“Me këtë shpjegohet, përse autori një pjesë të lëndës së shtojcave e ka dhënë duke u nisur nga latinishtja dhe duke e përkthyer në shqip, po ashtu një pjesë duke u nisur nga shqipja dhe përkthyer latinisht”³⁶⁶, thekson Xhevat Lloshi.

Vetë ai është i mendimit se Fjalori i Bardhit është me thënie nga fillimi deri në fund për qëllime mësimore, aq sa vjen deri te faqet e një libri bisedimesh. Pra, Bardhi e ka nisur si një fjalor dhe e ka përfunduar si libër mësimor, në të cilin pjesët përbërëse janë të ndërlydhura.³⁶⁷ Si një libër mësimor për mësimin e gjuhës shqipe nga të gjithë. Duhet theksuar edhe fakti se Bardhi zgjodhi ato fjalë latine, të cilave do t'u gjente përgjegjëset në gjuhën shqipe.

Sipas Demirajt, Bardhi ka raste që fjalëve nuk u jep një përkthim, por vetëm shpjegim. Kjo, sipas tij, se Bardhi nuk është përpjekur të gjejë ekuivalentet shqipe ose t'i krijojë vetë ato.³⁶⁸

Fjalësi shqip i Bardhit arrin rreth 2500 lema, prej të cilave 1300 janë autoktone.

Fjalori nuk ka karakter shpjegues. Shpeshherë krahas leksemave jepen edhe përdorimi i tyre me togfjalësha ose edhe lokucione foljore me vlerën e një fjale të vetme. Psh.:

coaceruare – me mbeleçe bafche (B. f.12).

cæptare - me εane fjl (B. f.13).

conciliare – me baam paich (B. f.14).

eicere – me nziere iaste (B. f.22).

feftinare – me ezune cpeit (B. f.25).

infpicat dentes – mprefen εambete (B. f.38).

intercludere – me mberfcele tefcuemite (B. f.39).

internectere, ligar infieme – meliξune bafche (B. f.39).

interfcindere- me e preem pergymffe (B. f.40).

inumbrare, far ombra – me baam hie (B. f.41).

Të njëjtën dukuri kemi vënë re edhe tek Gazulli e Dema. Mund të themi se autorët, përmes kësaj dukurie gjuhësore, janë munduar të japin një larmi të madhe leksemash e formime togjesh o togfjalëshash, për të nxjerrë më në pah thellësinë e gjuhës shqipe, pasurinë dhe variantet e ndryshme gjuhësore që na paraqet dialekti i gegërishtes, përkatësisht gegërishtja veriperëndimore. Po japim disa nga shembujt më të spikatur:

brufullue – 1. me brufullue krymbat. 2. brufulloi bari (G.f.71).

bukue – 1. me hangër bukë . 2. mos me përkue (G. f.74).

bukuritue – me i dhânë një sendit bukuri, zbukurue (G. f.74).

cërrlekue – me pikë cërrlek (G. f.82).

³⁶⁶Xhevat Lloshi, *Fjalori i Frang Bardhit dhe fjalësi shqip i Theodor Kavaliotit*, "400 – vjetori i Frang Bardhit", Prishtinë 2007, f.34.

³⁶⁷Xhevat Lloshi, *Fjalori i Frang Bardhit dhe fjalësi shqip i Theodor Kavaliotit*, "400 – vjetori i Frang Bardhit", Prishtinë 2007, f.33.

³⁶⁸Bardhyl Demiraj, "Dictionarium latino – epiroticum", Shkodër, 2008, f.41.

erue – 1. me lëshue erë, me i dhânë erë, të kandshëme e të pa-kandshëme. 2. m' u ndie era (G.f.124).

fatue – me urue kuj fat (G. f.127).

fëmnue – me bâ femna (G. f.127).

fijue – me shtî, me la me fî (G. f.130).

Nga Benedikt Dema:

dërrasue – shtrues, veshë me dërrasa (D. f.46).

dorëzanue – me hi dorëzanë dhanë në dorë, dorëzue (D. f.48).

dhelplue – me u ba dhelpen, sherr (D. f.53).

erue – marrë erë (me hundë) ; me u afrue (D. f.55).

fajisë – me i vu kuj fajin, perbuzë (D. f.56).

gargullue – me ba si gargulli, gargullite (D. f.67).

gazitë – bindë (dhenë), vu në gaz (D. f.68).

gjelmue – kerkue gjellen, gjelbzue (D. f.78).

Gjatë nxjerrjes në pah të këtyre lemave është vënë re se tek Fjalori Latinisht – shqip i Frang Bardhit, bie më tepër në sy dukuria e shpjegimit të fjalëve përmes lokucioneve ose togfjalëshave të ndryshëm, ndërsa Gazulli e Dema janë munduar të tregohen më të rezervuar në këtë pikë dhe kanë dhënë shpjegimin e tyre përmes fjalëve përkatëse. Kjo tek Bardhi mund të ketë ndodhur për dy arsye. Në radhë të parë, mund të jetë fakti se Bardhi nuk është përpjekur të gjejë ekuivalentet shqipe, ose është munduar t'i krijojë vetë ato, ndërsa arsyeja tjetër mund të jetë, se në atë kohë kur ku krijua Fjalori, 1635, nuk kishte as një alfabet të njësuar, as drejtshkrim e tejet larg për t'u folur për një gjuhë të konsoliduar, gjë që është e vështirë jo vetëm për Frang Bardhin, por edhe për çdo leksikograf tjetër që do merrej me hartimin e një Fjalori në kushte të atilla. Ndërsa, ndryshe qëndron puna për dy Fjalorët e tjerë, që u hartuan pothuaj tre shekuj më pas, të cilët vijnë pas një sërë përpjekjesh nga gjuhëtarë e studiues të ndryshëm për konsolidimin e gjuhës shqipe. Do veçonim këtu punën e vyer të Kongresit të Manastirit (1908) dhe Komisionit Letrar (1916), të cilat na dhanë edhe vendimin, se cilin alfabet do përdorte gjuha shqipe, gjithashtu hodhën edhe kërkesën për unifikimin e gjuhës letrare.

Për këtë arsye Gazulli e Dema janë treguar më të saktë në shpjegimin e fjalëve dialektore e krahinore.

Gjithashtu në fjalësin e Bardhit, Gazullit e Demës zë vend edhe shpjegimi me sinonimi, dukuri e cila e pasuron dhe u jep më tepër vlerë këtyre fjalorëve. Gjuha shqipe ka mundësi të mëdha për të përdorur shumë fjalë me kuptim të përafërt, por me një ngjyrim të fortë emocional, të cilat i gjejmë të pasqyruara në këto fjalorë. Këto lloj sinonimesh që do të pasqyrohen u përkasin sinonimeve stilistikore, të cilat mund t'i quajmë fjalë me ngjyrim emocional, ose sinonime dialektore. Po i vërejmë me radhë:

materfamilias – ama e ftepyffe oó εοgna estepyffe (B. f.56).

miles, foldato – luftetaar, foldat (B. f.58).

nuncius – scues, legaat (B. f.69).

nundinæ – paεaar oó treghetij, oó treggh (B. f.69).

obelifcus, aguglia – guur i giate, i ungine (B. f.71).

obferuare - me e chechyrune me i vum γγt (B. f.74).
 pannus – scegun, oó Zohe (B. f.82).
 patibulum – stanghe, oo Crγch (B. f.84).
 peruigil, vigilante - pergiues, ftraεnich (B. f.96).
 piger – vonues, pritues (B. f.98).
 populari – me pruem, me viežune (B. f.102).

Të njëjtën dukuri e ndeshim edhe tek Gazulli e Dema. Por, përveç sinonimeve të thjeshta, këtu kemi përdorimin e vargut sinonimik, që e gjejmë në mjaft shembuj:

matushue – matushitë, coptue, grimcue (G. f.251).
 mballim – mbarë, gjithëkah, t'i biem ballim (G. f.252).
 navig – shul, shiluer, drang (G. f.277).
 ndërkalitë – përdredhë, ndërmblyës (G. f. 283).
 përkye – m'u kulë, çplâ, lakue, shtrëmbënue (G. f.311).
 sklinë - skëlinë, deblim, bati, ligështi trupi (G. f.371).
 shdredhue – shvillue, shpalue (G. f.389).

Tek Benedikt Dema:

kaltue – shtupue, kalktue (D. f.95).
 kurdec – pelivrom, sifilit (D. f.113).
 lavere – lvere, zhele (D. f.117).
 lugzë – fillore, sovajkë, meqik (D. f.121).
 melak – 1. kacorr, zog lepuri, pegun. 2. bimë barore e fam. drandofillore (D. f.131).
 nutrue – nunukue, peshperitë (D. f.146).
 pakujti – pavemendje, pamendim (D. f.153).
 rripue – me u ba rryp, tha, fiktue (D. f.189).
 tefmtëf – gjithkrah, gjithkund, anemanë, anëperanë (D.f. 217).

Vargu sinonimik zgjerohet e pasurohet vazhdimisht duke u mbështetur “ te gjuha e gjallë e popullit, te bashkëveprimi ndër dialektor e te shkrirja e vlerave më të mira të ish-varianteve të mëparshme letrare në të gjitha nënsistemet e gjuhës letrare e kombëtare, te veprimtaria e shumanshme gjuhëkrijuese e popullit dhe e mjeshtërvë të gjuhës, të dalë nga gjiri i tij, si edhe te rritja e vijueshme e vetëdijes gjuhësore të masave punonjëse”.³⁶⁹ Sinonimia dialektore luan një rol të shumëfishtë në pasurimin e gjuhës letrare. Megjithatë, gjuha letrare ka mënjeluar shumë fjalë dialektore që e ngarkojnë së tepërmi atë. Por, sa më shumë të ketë sinonime gjuha letrare, aq më i begatshëm është leksiku i saj. Duke qenë se pasuria leksikore e këtyre fjalorëve është me të vërtetë e madhe, duhet të merret në konsideratë fakti, se ka fjalë, që mund të përfshihen në gjuhën letrare, të cilat mund t'i quajmë fjalë me “ mundësi normative, për të cilat gjuha letrare ka nevojë që të zhvillojë më tej aftësitë a saj shprehëse, pavarësisht nga burimi i tyre.”³⁷⁰

³⁶⁹ A. Kostallari, *Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës sonë letrare*, “Studime filologjike”, Tiranë, 1982, 2, f.4.

³⁷⁰ A. Hidi, *Sinonimet dialektore dhe pasurimi i leksikut të gjuhës letrare shqipe*, “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, III, Tiranë, 1989, f.375.

Fjalësi i fjalorëve është zgjeruar shumë edhe nga formimet e prejardhura, të përbëra, ose të përngjitura që autorët kanë pasqyruar.

Frang Bardhi përveç mjeteve fjalëformuese, kuptimin e së njëjtës fjalë është munduar ta shprehë edhe përmes formimeve me togfjalësha e shprehje foljore. Po i vërejmë me radhë:

Nga rrënja prit janë formuar emrat preitesa, pritues (f.1).

Nga sëmur janë krijuar mbiemri i sëmütë, format e pashtjelluara me u sëmütë dhe sëmütë dhe emri prejpsesor të sëmütë (f.2).

Kemi emrin prejpsesor te dashunë, dhe format e pashtjelluara me dashunë, me u dashunë (joveproja), dashunë (f.3).

Nga mik, kemi emrat miqësia dhe ndajfoljen miqësisht, por edhe migjësia (f.4). Me prapashtesa zvogëluese-përkëdhelëse kemi formimet mikëth, mikesha, mikeshëza (f.5).

Nga shpirt kemi shpirti, shpirtëthi (f.5).

Nga forma e pashtjelluar paskajore me ndëguem, kemi emrin ndëgues, pjesoren ndëguem (f.7).

Nga rrënja verbo kemi formën e pashtjelluar paskajore me u verbuem, mbiemrin i verbënë, emrin asnjans të verbënitë (f.9).

Nga rrënja nxe kemi formën e pashtjelluar paskajore me e nxem, mbiemrin e emëruar të nxehtë, si dhe ndajfoljen nxehtë (f. 9-10).

Nga kangë, kemi formimet kangëtuer, dhe formën e pashtjelluar paskajore me kënduem (f.10).

Nga rrënja njof kemi emrin prejpsesor të njofunë, format e pashtjelluara me njofunë, njofunë (f.13).

Nga rëfyem gjejmë emrin prejpsesor të rëfymitë dhe formën e pashtjelluar paskajore me u rëfyem (f.14-15).

Kemi formimet nga emri këshill, këshills, këshilltar, por edhe togfjalëshin me lypunë këshill (f.15).

Gjithashtu kemi formimet me bām, në formë togfjalëshi bām ashtë, emrin prejpsesor të bām, emëruarimin e mbiemrit e bameja (f.25), por edhe forma e pashtjelluar joveprore me u bām (f.26).

Ndeshim formimet nga mnia, ndajfoljen mënishim, ò mnishim, emrin mnīs (f.42).

Ndeshim formimet, fëdigë, fëdigëtë, fëdigëtär, me fëdigë, fëdigues, me u fëdigunë (f.44).

Nga folja dëlir kemi emrin prejpsesor të dëlirëtë, formën e paskajores me dëlirënë, dhe togfjalëshin dëlira shtëpënë (f.45).

Nga Gazulli kemi mjaft leksema të cilat janë zgjeruar më së tepërmi nga formimet me prejardhje ose edhe me anë të togfjalëshave të thjeshtë. Kjo dukuri ka pasuruar dhe e ka bërë më të larmishëm Fjalorthin e tij.

Nga emri bāngë, kemi foljen bāngëzue, por edhe mbiemrin bāngëc (f.55).

Gjejmë formimet nga bri, brie, brien dhe foljet bricue, brienuë (f.69), por edhe brijoke, brijue (f.70).

Nga tema dasi, kemi dasik, dasim, dasue (f.105).

Duke u nisur nga folja dëkë, gjejmë emrin dekan dhe foljen dekësue (f.107).

Nga rrënja dhamb kemi kompozitat dhambësutë, dhambëhekurt, dhambzezë por edhe formimet me prapashtesim dhambtuer, dhambzak, dhambzakue, dhambzëz (f. 118-119). Gjithashtu ndeshim formimet dhândrri, dhândrrorë, dhandrrue (f.119).

Nga rrënja fjalë kemi kompozitat fjalë-lashtë, fjalëmujshtë, fjalërrëxuem, fjalërryeshëm (f.133).

Nga gërdhâm, gërdhamue, gërdhatë (f.146).

Takojmë formimet gican, gicëm nga rrënja gicë (f.151).

Nga gryk kemi formimet me kompozim grykakuq, grykele, grykë-furre, grykëhollë (f.159).

Nga harma ndeshim foljen harmatue, emrin prejfoljor harmatim por edhe harmi (f. 172).

Kemi formimet hijeç, hijelehtë, hijenue (f.176).

Nga rrënja hut, kemi emrin prejfoljor hutim dhe foljen hutue (f.179).

Me rrënjën kambë kemi kompozimet kambëpulë, kambëshum, kambëzezë si dhe ato me anë prapashtesash kambëcuer, kambështue (f.190).

Nga kandi kemi format foljore kandetë, kandisë (f.190).

Me rrënjën lâng takojmë foljet langshstue, langue (f.228).

Nga emri lypë, kemi lypësi, lypësue (f.243).

Tek Benedikt Dema edhe këtu kemi formime fjalësh me anë të mënyrave të ndryshme fjalëformuese.

Nga tema adhrue, ndeshim formimet me prapashtesim adhrim, adhrimtar (f.11).

Nga fjala anmike ndeshim mjaft formime fjalësh me prapashtesim anmikeshë, anmikneshë, anmiqsi, anmiqsisht, anmiqsue, anmiqsuer si dhe me nyjëzim e prapashtesim i anmiqsueshëm (f.13).

Me rrënjën bashkë, ndeshim bashkarim, bashkaz, bashkëni (f.21).

Nga belbë takojmë belban, belbëzujë, belbuc (f.22).

Gjithashtu me besëtytni, kemi formimet me prapashtesim besëtytnisht, dhe nyjëzim e prapashtesim i besëtytshëm (f.23).

Ndeshim formimet blerë, i blerë, blerisë, blerush (f.25).

Nga mbiemri i bylmetshëm takojmë foljen bylmetë dhe ndajfoljen bylmyeshëm (f.31).

Ndeshim formimet me fjalën buzë: buzë, buzëdele, buzëkerveshë, buzëkjamë, buzëlepuri, buzështrembët, buzëvarun, buzëvjerrun, buzoç, buzore (f.31).

Nga çudni kemi çudini, çudnar, çudnue, çudue (f.41).

Nga folja damue kemi formimet dams, i damtueshëm, i damueshëm (f.43).

Ndeshim daralli, darallim, darallosë (f.44).

Nga dasë kemi dasi, dasim, dasie, i dashëm (f.44).

Nga mbiemri i fajshem kemi foljen fajisë dhe mbiemrin i fajisëshem (f.56).

Ndeshim: fershllue, fershllye, fershllim, fershllimzë (f.58).

Kemi: gazitë, i gazmueshem, gazullue (f.68).

Gjithashtu kemi formimet: gerdi, i gerdiçem, gerdimë, gerditë (f.68).

Kjo pasuri e madhe fjalëformuese që vërehet tek këta autorë në formimin e fjalëve të reja me formantë e tipa fjalëformues të ndryshëm, dëshmon për zotërimin e një ndjenje

gjuhësore dhe dëshirën për të nxjerrë në pah larmishmërinë e gjuhës me variantet dialektore e krahinore që mbart ajo.

duhet thënë se të tre këta autorë kishin edhe përgatitje filologjike në atë shkallë, sa t'ia dilnin mbanë ndërmarjes së tyre. Bardhi e Dema, kishin një kulturë latine e neolatine, kurse, Gazulli, përveç përgatitjes klasike, mori edhe shumëçka nga gjuhësia e filologjia gjermanike. Këta autorë dhanë një ndihmesë të vyer në lëmë të leksikografisë, duke hyrë në historinë e leksikografisë shqiptare me një vend të besueshëm e që u shërben edhe sot hulumtimeve e kërkimeve rreth leksikografisë krahinore e më gjërë. Së fundi, ajo që pa dyshim, i bashkon autorët e mësipërm, është fakti që pasqyruan në veprat e tyre, me fjalësin e regjistruar, veçoritë e qenësishme të së folmes perëndimore të dialektit të gegërishtes veriore.

BIBLIOGRAFI:

- A. Kostallari, Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës sonë letrare, "Studime filologjike", Tiranë, 1982, 2.
- A. Hidi, Sinonimet dialektore dhe pasurimi i leksikut të gjuhës letrare shqipe, "Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe", III, Tiranë, 1989.
- B. Dema, "Fjalori i fjalvet të rralla shqipe e i fjalvet të hueja të përdoruna në veprën e At Gjergj Fishtës, Lahuta e Malcis", Botimi XV, Botime Françeskane, Shkodër, 2006.
- B. Dema, "Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe", Tiranë, 2005.
- N. Gazulli, "Fjalori i Gazullit", Tiranë 2005 (botim postum).
- Xh. Lloshi, Fjalori i Frang Bardhit dhe fjalësi shqip i Theodor Kavalitotit, "400 – vjetori i Frang Bardhit", Prishtinë 2007.
- B. Demiraj, "Dictionarium latino – epiroticum", Shkodër, 2008.

STRUKTURAT KUSHTORE NË POEZINË “NËSE” TË R. KIPLINGUT

Ardita Berisha

Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë

Abstrakt

Me anë të strukturave kushtore shprehen referenca modale dhe kohore të caktuara varësisht nga tipi i strukturës. “Nëse mundesh” dhe “Në munç” janë dy versione të përkthimit në shqip të poezisë së Kiplingut, të cilët dallojnë nga njëri-tjetri nga lidhëza dhe mënyra e foljes, e kushtëzuar nga lidhëza. Në versionin e parë lidhëza nëse qëndron në relacion me foljen modale në të tashmen e dëftores, në diatezën joveprore: *nëse mundesh*; në versionin e dytë (që është versioni origjinal dhe më i vjetër) lidhëza në qëndron në relacion me foljen modale në të tashmen e dëshirores, *në munç (mundsh)*. Këto dy versione përkthimi të kësaj poezie nuk dallojnë për nga kuptimi modal që shprehin. Ato mund të konsiderohen sinonime. Në versionin e dytë “Në munç” theksohet rrafshi kohor i së ardhmes, përmes vetë strukturës, më shumë se sa në versionin e parë, por që të dy strukturat në tërësi përmbajnë referenca mbarëkohore. Fjalët kyçe: strukturë, modalitet, i vërtetësisë, i mundshmërisë, referencë kohore.

Struktura që shprehin kushtin në gjuhën shqipe mund të jenë fjali (frazë, periudha, sintagma), të cilat përbëhen nga fjalia kryesore dhe fjalia e varur: *Nëse bie shi nesër, ne nuk do të dalim në piknik*. Fjalia kryesore është, *ne nuk do të dalim në piknik*, ndërsa fjalia e varur, në të cilën shprehet kushti, *nëse bie shi nesër*. Një strukturë kushtore mund t'i mungojë njëra nga fjalitë e saj, por ajo mbetet e nënkuptuar nga konteksti. Në këtë rast kemi një strukturë kushtore eliptike.

Priftit (1971:386) thotë se fjalia kushtore shërben për të shprehur kushtin e veprimit apo të gjendjes, që përmbahet në fjalinë nga e cila ajo varet. Te këto fjali kemi raportin shkak-pasojë, pra realizimi apo mosrealizimi i veprimit varet nga kushti i dhënë më pare. Të dyja së bashku përbëjnë fjalinë apo periudhën kushtore (1971:386). Ndarjen në mënyrë të ngjashme të strukturave kushtore e bëjnë të gjithë gjuhëtarët që merren me këto struktura kushtore, meqenëse me trajtim të ndryshëm terminologjik. Riza, në kuadër të frazës kushtore, dallon *fjalinë e kushtueshme* dhe *fjalinë kushtzuese*. (443-444). “Çdo frazë kushtore përbëhet nga fjalia e kushtueshme, p.sh. Unë do të lexoja tash...”, dhe *ndëfjalia e kushtzuese p.sh. ...po të kisha një libër*”. Duke u mbështetur tek disa autorë të huaj siç janë Gortan- Gorski- Paus, Stevanovic, Tesniere, Kelmendi shprehet në këtë mënyrë: “Fjalitë, që formojnë periudhën me fjali të varur kushtore, ndryshe nga të tjerat, në përbërjen e periudhës kanë emra të veçantë: kushtorja quhet protazë, kurse kryesorja quhet *apaodozë*” (Kelmendi, 2010:225). Gramatika I e ASHSH-së (2002:327), po ashtu si

Prifti (1977:386) fjalinë që shpreh kushtin e quajnë fjali kushtore, ndërsa fjalinë që shpreh pasojën fjali kryesore apo drejtuese të periudhës (strukturës) kushtore.

Folja e fjalisë kryesore zakonisht shprehet përmes mënyrës kushtore, përmes së tashmes ose së kryerës së saj (Gramatika I, 2002:294): *Po të shkonte Arta atje, do të shkoja edhe unë, Po të kishte shkuar Arta atje, do të kisha shkuar edhe unë*; ndërsa folja e fjalisë së varur, ajo që paraqet kushtin është në mënyrën lidhore, në të pakryerën, *të shkonte*, apo në më se të kryerën *të kishte shkuar*. Por kushti në këtë rast shprehet edhe përmes lidhëzës *po*. Mirëpo mënyra kushtore, ashtu si edhe kushti mund të shprehen edhe me shumë forma të tjera foljore në mënyrora e kohë të ndryshme.

Korpusi

Poezia “Nëse” e R. Kiplingu e tëra është një strukturë kushtore, siç e tregon edhe vetë titulli i saj “*nëse*”. Natyrën e saj kushtore e përcakton lidhja semantike në mes njësisë të saj, fjalisë drejtuese dhe fjalisë së varur. Në këtë poezi 31 vargjëshe, vetëm në dy vargjet e fundit jepet fjalia drejtuese apo apodoza e saj, ndërsa në vargjet e mëparme paraqiten një varg kushtesh si premisa për realizimin e veprimit a gjendjes në fjalinë drejtuese. Vetëm në dy vargje të saj, në 6 dhe 7, jepen dy struktura të plota kushtore, pra me dy pjesët përbërëse të tyre, apodozën dhe protazën. Megjithatë, edhe ato dy struktura apo vargje, në kuadër të strukturës në tërësi, paraqesin vetëm një kusht. Kemi marrë dy versione të përkthimit të kësaj poezie, krahas originalit poezia është përshtatur edhe për lexues fëmijë në revistën “Vizatory”, duke pasur pak ndryshime edhe në strukturat kushtore. Dy versionet dallohen nga njëri-tjetri anë të lidhëzës dhe mënyra së foljes, së kushtëzuar nga lidhëza. Në versionin e parë përdoret lidhëza *nëse* dhe folja modale në të tashmen e dëftores, në diatezën joveprore: *nëse mundesh*; në versionin e dytë (që është versioni origjinal dhe më i vjetër) përdoret lidhëza *në*, e folja modale në të tashmen e dëshirores, *në munç (mundsh)*. Versioni i parë është në gjuhën standarde, ndërsa i dyti në dialektin toskë – gjuha e Nolit, prej nga kemi *munç* si rezultat i shurdhimit të bashkëtingëllores në fund të fjalës, dukuri e njohur kjo fonetike e toskërishtes dhe lidhjes me formantin sh, me ç’rast t+sh=ç.

Pasi që në strukturën e tyre, dallimi qëndron vetëm në përdorimin e foljes modale dhe lidhëzës, po e paraqesim versionin e parë dhe po ndalemi në analizë aty, e pastaj, në fund e bëjmë krahasimin me versionin e dytë dhe i paraqesim, nëse ka, veçoritë dalluese në mes tyre, në rrafshin modal apo kohor.

Strukturat kushtore në këtë poezi janë ndërtuar me dy lidhëza: me lidhëzën *nëse* dhe lidhëzën *në*.

Me lidhëzën *nëse*:

Nëse mundesh ta mbash në kokë terezinë,
Kur shokët huqin dhe ty fajtor të nxijnë,
Nëse mundesh të kesh besim, kur të dyshon
kushdo, dhe s’ka njeri që të beson; ...
Nëse mundesh të presësh dhe pritjen s’e kursen,

Nëse mundesh ta vësh mbi grumbull çdo thesar,
Dhe t’i luash të gjitha me një zar,

T'i humbësh dhe t'i fillosh përsëri
 Pa e thënë një fjalë për këtë humbje ti;
 Nëse mundesh të kesh një zemër, trup e kokë,
 Që të shërbejnë derisa të bëhen trokë
 Dhe të vazhdosh i djegur shkrumb në furrë,
 Dhe të thërret vullneti: "Mbahu, or burrë"!

Nëse mund të zbresësh në turmë e ta mbash nderin,

Të hash me mbretin, të pish me neferin...

Në të gjitha këto protaza kemi të njëjtën strukturë, kur ajo është shprehur e plotë, d.m.th. me lidhëz, me folje modale dhe foljen kryesore. Folja modale vetëm 1 herë del në formën veprorë: *Nëse mund të presësh dhe pritjen s'e kursen*; 9 herë del në diatezën joveprorë: *Nëse mundesh të shndërrohesh e të mendohesh*, meqenëse kjo nuk luan rol në kuptimin kohor e modal të strukturës në tërësi por e thekson vetën vepruese. Kemi këtë ndërtim:

Nëse + lidhores e tashme: mundesh të mbash

Lidhëza *nëse* në protazat e kësaj strukture qëndron në korrelacion me të tashmen e lidhores, e cila është ndërtuar me foljen *mund* që ka kuptim modal të mundësisë: *nëse mundesh të kesh një zemër, trup e kokë*; kemi vetëm një varg, ku ajo është në të tashmen e dëftores: *nëse i do të gjithë, po asnjërin pa masë*. Lidhëza *nëse* nuk bart më vete vlera stilistiko-emocionale, që d.m.th. se edhe struktura e ndërtuar nga ajo është neutrale, pa nuanca të tilla.

Me lidhëzën *në*

Me lidhëzën *në* kemi një protazë dhe dy struktura kushtore. Në reaksion me lidhëzën *në* qëndrojnë format foljore të dëshirores: *në mos të ngaftë as mik, as hasmë*. Kemi këtë tip strukturor:

Në + përemër + dëshirore e tashme

Në të gënjejshin, ti nuk gënjen

Në të urrefshin, ti s'i qan me brirë

. . .

Në mos të ngaftë as mik, as hasmë;

Pasi që dy vargjet e para kanë edhe protazën edhe apodozën, po i trajtojmë si struktura të plota kushtore. Lidhëza *në* e kombinuar me trajtën foljore të dëshirores së tashme në protazë në lidhje me trajtat foljore në të tashmen e dëftores në apodozë shprehin një kusht të mundshëm që në rrafshin kohor shpreh një veprim me vlerë mbarëkohore, me kuptim kohor të pacaktuar. Pra, është një strukturë hipotetike e mundësisë. Nga ana semantike, tipi strukturor kushtor me lidhëzën *në* dhe ai me lidhëzën *nëse* janë sinonim, sepse të dy bartin vlera të njëjta kohore dhe modale.

Apodoza

Zaptove dheun me çdo mall e hir,

Dhe ca më mire: qenke trim or bir!

Folja e apodozës në njërin varg është në të kryerën e thjeshtë të dëftores: *zaptove*, e në tjetrin në të tashmen e habitores: *qenke*. Kur e bëjmë lidhjen e protazës me apodozën kemi këtë strukturë kushtore:

Protaza

Apodoza

Nëse + lidhore e tashme/ në + dëshirore e tashme – dëftore, e kryer e thjeshtë, habitore e tashme

Nëse e vështrojmë vetëm apodozën e strukturës kushtore, vargun e parë të saj, ajo na shpreh thjesht një veprim të përfunduar. Por, kur e kryera e thjeshtë përdoret në një strukturë kushtore, në apodozën e saj, paraqet kryerjen e një veprimi të sigurt (Kelmendi, 2010:226). Folja tjetër *qenka*, në vargun tjetër, në të tashmen e habitores, paraqet një gjendje apo një pasojë në të tashmen, të shoqëruar me modalitet të vërtetësisë dhe me ndjenjën e habitës. Rrjedhimisht në apodozën e kësaj strukture kushtore, në të dy vargjet e saj, paraqitet vërtetësia e kryerjes së një veprimi. Mirëpo në protazat e saj paraqiten një varg kushtesh të mundshme për t'u realizuar. Modaliteti e mundësisë së plotësimi të atyre kushteve shprehet përmes lidhores së tashme, e për më shumë theksohet përmes foljes me kuptim modal *mund*, me të cilën është ndërtuar lidhorja.

Ky kombinim i protazës (protazave), me modalitet të mundësisë me apodozën (apodozat) me modalitet të vërtetësisë apo sigurisë së kryerjes së një veprimi në rrafshin modal paraqet në strukturë hipotetike të mundësisë së realizimit të veprimit, në rast se përmbushen kushtet e dhëna. Në rrafshin kohor kjo strukturë kushtore ka vlerë mbarëkohore, ajo mund t'i referohet së shkuarës, pasi që e paraqet pasojën e përfunduar në një çast të së shkuarës *zaptove dheun...*; së tashmes, pasi që e kryera e thjeshtë mund të përdoret edhe me vlerën e së tashmes, e gjithashtu edhe e tashmja e habitores në apodozë, që shpreh vërtetësinë për kryerjen e një veprimi, gjendje a ngjarje me ndjenjën e habitës; dhe mund t'i referohet edhe së ardhmes, me ç'rast nuk ka ndonjë tregues gramatikorë të veçantë që e paraqesin atë, por duke e vështurura si një këshillë e si një nxitje në formë kushti, merr po atë vlerë kohore që kanë edhe fjalët e urta.

Me lidhezen në + dëshirore

Siç thamë edhe më parë, në versionin e dytë të përkthimit të poezisë që po e trajtojmë si një strukturë kushtore, kushti shprehet me kombinimin e lidhëzës *në + e tashmja e dëshirore + e tashme e lidhore*. Në këtë version folja modale *mund* është në mwnyrwn dëshirore nw trajtën e toskërishtes, ashtu si edhe i gjithë përkthimi:

Në munç të mbash në kokë terezinë
 Kur shokët çmendër dhe fajtor të nxijnë;
 Në munç të kesh besim, kur të dyshon
 kushdo, dhe s'ka njeri që të beson;
 Në munç të preç dhe pritjen se kursen,
 Në të gënjejshin, ti nuk gënjen,
 Në të urrefshin, ti nuk i çan me brirë,
 dhe s'hiqesh as më i mënçëm as më i mire.

Në munç për çdo minutë të përpjetë
 Të rënç tamam sekunda gjashtëdhjetë;
 Zaptove dheun me çdo mall e hir
 Dhe ca më mirë: qenke trim, or bir!

Sipas Gramatikës I (2002:329), folja e dëshirores së tashme, kur përdoret në ndërtime kushtore të ndërtuara me lidhëzën *në*, shpreh kuptime kohore të së ardhmes, pa e shprehur dëshirën rreth asaj që thuhet. Që folja e dëshirores e humb efektin e saj në këtë

strukturë, shprehen edhe Buchholz dhe Fiedler (1987: 165). Edhe në këtë version përkthimi të kësaj poezie, në të cilin theksohet rrafshi kohor i së ardhmes, gjejmë edhe referenca mbarëkohore, të së shkuarës e të së tashmes. Po ashtu si në versionin e parë, kemi një strukturë hipotetike, që raportet midis kushtit dhe pasojës i paraqet në rrafshin modal të mundësisë.

Këto dy versione përkthimi të kësaj poezie nuk dallojnë për nga kuptimi modal e kohor që shprehin. Ato mund të konsiderohen sinonime. Në versionin e dytë *Në munç* theksohet rrafshi kohor i së ardhmes përmes vetë strukturës më shumë se në të versionin e parë, por edhe kjo strukturë në tërësi ka referenca mbarëkohore. Dallojnë vetëm për strukturën e tyre, ashtu siç e treguam dhe e paraqitëm edhe në fillim të këtij trajtimi.

Në kuadër kësaj strukture kushtore, poezisë, kushti apo protaza shprehet 19 herë:

11 herë me lidhëzën *nëse/ në*

Nëse mundesh të mbash në kokë terezinë / në munç të mbash në kokë terezinë

3 herë me lidhëzën *në*;

Në të gënjejshin, ti nuk gënjen;

3 herë nuk shprehet me lidhëz por bashkërenditet me lidhëzën dhe:

Dhe të vazhdosh i djegur shkruam në furrë;

2 herë me mënyrën lidhore

T'i humbësh, dhe t'i fillosh përsëri/t'i humpç dhe të nisësh përsëri;

Apodoza:

Dëftore e kryer e thjeshtë: zaptove dheun me çdo mall e hir

Habitore e tashme: dhe ca më mire qenke trim, or bir!

Bibliografia

Buchholz O. Fiedler W. (1987). Albanische Grammatik. Leipzig

Kelmendi T. (2010). Funksionet sintaksore në ndërtimet me paskajore në gjuhën shqipe. Instituti Albanologjik i Kosovës, Prishtinë

Camaj M. (1984). Albanian Grammar. Collaborated and translated by Leonard Fox. Otto Harrassowitz. Wiesbaden

Thieroff R. (2010). Moods, moods, moods. Në Rothstein B., Thieroff R. (redaktorë). Mood in language of Europe, John Benjamins Publishing Company, Amsterdam/Philadelphia.

Breu W. (2010). Mood in Albanian. Në Rothstein B., Thieroff R. (redaktorë). Mood in language of Europe, John Benjamins Publishing Company. Amsterdam/Philadelphia

Riza S. (1997). Sistemi foljor i letrarishes shqiptare bashkëkohore, Vepra 2. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë.

ASHSH. (2002). Gramatika I. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Shqipërisë. Tiranë

ASHSH. (2002). Gramatika II. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Shqipërisë. Tiranë

Palmer F.R. (1996). Mood and Modality, Cambridge University Press, Cambridge

Palmer F.R. (1996). Mood and Modality. Second Edition. Cambridge University Press, Cambridge.

Ismajli B (2012). Sa ballkanike janë mënyrat e foljeve të shqipes? Kushtortja dhe habitortja. Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit. Akademia e shkencave dhe e arteve e Kosovës. Prishtinë

Prifti S. (1971). Sintaksa e gjuhës shqipe. Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i krahinës socialiste autonome të Kosovës. Prishtinë.

Totoni M. (2000). Fraza me nënrenditje. Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë.

KOSTUMET POPULLORE TË JUGUT TË SHQIPËRISË NË VEPRAT E PIKTORËVE E SKULPTORËVE SHQIPTARË.

Arjan Zurbo

Një vështrim i përgjithshëm hyrës.

Trashëgimia popullore artistike – estetike dhe tipologjike e veshjeve të jugut ka qenë dhe mbetet , burim frymëzimi për arritje në artin e kultivuar figurativ shqiptar. Ajo përfaqëson një vlerë krenarie për shqiptarët si pjesë e vyer e trashëgimisë botërore . Banesat gjirokastrite e beratase , isopolifonia , kostumet popullore të cilësuar si “kostumet më të bukura ” dhe vallet popullore janë katër shtylla të artit popullor që e mbajnë kokën lart të shqiptarëve në arenën ndërkombëtare. Nëpërmjet pikturave me famë të piktorëve të frymëzuar nga kostumet popullore , natyra e vallet , Shqipëria u bë e njohur për përpjekjet në shekullin e XIX për liri, bashkim dhe shtet të pavarur. Trashëgimia e artizanatit dhe artit të larmishëm dekorativ fshatar e qytetar , gërshetuar me kulturën perëndimore të artit europian u bënë përcaktuese në përfaqësimin e periudhës rilindase nëpërmjet vetëdijes së piktorëve autodidaktë e të shkolluar në perëndim . Ngjarjet e luftës së dytë botërore, çlirimi i Shqipërisë dhe vendosja e shtetit i hapën rrugën ndërtimit të “shtëpisë “ së artit shqiptar. Periudha e gjatë pesëdhjetë vjeçare ndonëse në ndikimin e artit të realizimit socialist , ka një fond të pasur të pasqyrimin artistik të jetës të popullit shqiptar. Evidentimi i Etnosit kulturor ndër shekuj të vlerave shqiptare nëpërmjet festivaleve folklorike ka frymëzuar piktorët dhe skulptorët , duke lënë mënjandë imponimin e partisë – shtet për krijimet e stisura kushtuar kultit të saj. Vështruar në aspektin njerëzor , Festivali Folklorik Kombëtar festën e vërtetë e kishte pas shfaqjes në skenë në orët e vona deri në të gdhirë. Në konaket mikpritëse gjirokastrite larg çensurimit kërcenin e këndonin në një liri maksimale nga më i moshuari te më i riu. Artistët popullor të bujtur shijonin në tavolina gatimet më cilësore tradicionale . Aty ishte arti i vërtetë folklorik , aty ishte bujaria gjirokastrite. Artistët e artit të kultivuar të pranishëm në këtë ngjarje festive mblidhnin nektarin e bukurisë ornamentale të kostumeve popullore , me anë të skicave gërshetuar me idetë kompozicionale që lindnin në botën e tyre artistike. Ata fiksonin në skica lëvizjet e valltarëve brenda kërcimit , tipet e nëntipet e veshjeve , portretet e individëve me karaktere shprehëse. Siç shprehet korifeu i letrave shqipe D. Agolli : “Tiparet e dasmës , vdekjes , lindjes , punës , luftës , lodrës , zakonit , mënyrës së jetesës ato kanë vazhduar të jetojnë duke ndryshuar dialektikisht e duke fituar cilësi të reja , por duke ruajtur origjinalitetin kombëtar. Faktet historike janë trajtuar artistikisht dhe jo fotografisht . Ndihet në veprat e piktorit një pjekuri profesionale kur në to është nisja estetike , kur aty ndihet krenaria e gëzimi , tragjika e humori.” 1 Mund të veçojmë disa faktorë objektivë e subjektivë që kanë ndikuar tek shprehja estetike e kostumeve të jugut në veprat artistike figurative shqiptare.

Historia , jeta ekonomike

Subjektiviteti i faktorëve shpirtëror dhe objektiviteti i faktorëve ekonomikë kanë rol vendimtar në shprehjen estetike të kostumeve. Historia dhe ekonomia si pjesë e një trupi , formëzojnë indirekt nëpërmjet vetëdijes artistike përmbjatjen e strukturës tipologjike, por dhe shprehjes estetike të veshjes popullore. Natyra pastorale e ekonomisë fshatare të jugut nëpërmjet përdorimit të lëndës së parë, leshit të bagëtive dhe ngjyrave bimore nëpërmjet avlëmendit ndikon në formëzimin (ide dhe realizim) e kostumeve . Pasurimi i kambrikut , copës së leshtë , kadifes , mëndafshit nëpërmjet mbivendosjes të qendrisjes me fijet e arit , të motiveve , dekoracioneve, ornamenteve shton vlerat estetike midis krahinave jugore. Natyra shtegtare e barinjve për dimërim e verim shpjegon edhe afërsinë e tipologjisë së veshjeve të këtyre krahinave, lidhjen ekonomike e shpirtërore . Historia si faktor zhvillues ose pengues ndikon dhe në ekonominë e këtyre banorëve . Përpyqjet e shqiptarëve për liri e pavarësi janë pasqyruar në komponentë artistikë si poezi , valle , muzikë dhe veshje popullore. Ky vend blegtoral ka nxjerrë burra që ndihmuan luftërat e kaçakëve kundër portës së lartë , Ali Pashë Tepelenën , revolucionin Grek , Bushatllinj të e Shkodrës e deri te Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe shpallja e Pavarësisë , lufta e Vlorës , revolucioni 1924 i Nolit , lufta N.Ç L. etj. Të gjitha këto kanë lënë gjurmë në shpirtin e banorëve të jugut . Shembull i gjallë i materializuar në përjetësi janë veprat monumentale të skulptorëve profesionistë “Artistë të Popullit”. Madhështia e fustanellës është trupëzuar në gjetjet artistike të lëvizjeve skulpturale duke u kthyer në simbol të pa mohueshëm të vitalitetit frymëzues të kostumografisë popullore të jugut . Shembull i kësaj bukurie janë “ Luftëtari kombëtar “ në qendër të Korçës , “Flamurtari “ mbi varrin e I. Qemalit në Vlorë , vepra këto të pionerit të skulpturës shqiptare O. Paskali. Vepra Ali Pashë Tepelena e skulptorit M. Dhrami revokon kohën kur ky burrë shteti i Pashallëkut të Janinës kërkon të shkëputet nga Porta e Lartë . Aty ndërthuren monumentaliteti me natyrshmërinë njerëzore , plasticiteti me psikologjinë e figurës , vërtetësia e kostumit me interpretimin artistik. Historia ka fiksuar si moment kulmor shpalljen e pavarësisë 1912. Dëshira e madhe e popullit shqiptar për pavarësi realizohej pas 500 vjetësh robëri në kohën e humnerës së madhe , çastit tragjik ose fatlum , të ekzistencës mes popujve të tjerë ose mosekzistencës nëse nuk realizohej brenda atyre ditëve, ai akt madhor në Vlorën atdhetare. Ansambli skulptural pasqyron ansamblin e veshjeve veri e jug nëpërmjet konçizitetit të një piramide të abstraguar në vendosjen e figurave . Veçojmë domenin e luftëtarit me fustanellë dhe atë të labit me poture, ku ai me fustanellë është në lëvizje ngjitjeje dhe ai i labit në qëndrim stoik shqiptar. Kufiri midis popullores dhe të kultivuarës , midis të natyrshmes dhe monumentales , ekspresives dhe qëndrimit ballë lart me stoicitet është shkrirë më së miri . Shembull i përjetësuar i luftrave të 1920 dhe 1943 është vepra e Drashovicës ku skulptori M. Dhrami ka vendosur pranë labit partizanin , luftën ndaj italianëve me atë ndaj gjermanëve dhe triumfin e këtyre dy epokave nën harkun e flamurit shqiptar. Hapësirat e këtyre veprave janë shfrytëzuar në shërbim të ndërsjelltë . Lëvizjet apo gjetjet figurative janë çelësi i evidentimit të përmbatjes ideore me formën plastike , karakterin e veshjeve popullore me trajtimin diku realist, impresionist dhe modern .

Konstitucioni shpirtëror e fizik i popullsisë së jugut

Trupi e shpirti tek popullsia e jugut si bashkudhëtar të përhershëm mbeten të kondicionuar në shërbim të një jete plot vështrësi dhe pak gëzimesh. Në këtë raport marrëdhëniesh në një vend kryesisht malor në bashkësi të ndryshme mjeshtrërit

autoktonë me gjendjen e tyre shpirtërore e fizike , luajtën një rol të veçantë për krijimin e pasqyrimin e formave të pretjes , qepjes e qëndisjes në veshjet popullore . Ashtu si jeta me uljet e ngritjet ka gëzimet e hidhërimet e veta , ka dasmat e vdekjet , paqen e luftën ka dhe varfërinë e pasurinë në mes njerëzve . Nëpërmjet bartësve kemi të mishëruar në veshjet popullore jugore psikologjinë dhe karakterin e vendit ku jetojnë.Mikpritja bujare shqiptare është e ndërthurur me thjeshtësinë , bukuria më burrërinë të cilat janë virtyte të vlerësueshme dhe nga të huajt. Pranë parmendës dhe stanit shqiptari ka qenë i detyruar të mbajë pushkën për të mbrojtur veten e familjen , konakun dhe atdheun. Veshjet e jugut plot dritë dhe kontrast me pushkën e gjatë si zgjatim i shtyllës kurizore të shqiptarit në shtatin elegant e kokën lart , krijojnë figuracion tërheqës e madhështor.Funksionimi i veshjes me ornementikën zbukuruese plot shkëlqim janë një binom i veçantë.“Funksioni shoqëror i veshjes është shumë i gjerë dhe i rëndësishëm . Për të shprehur dallimet e moshës , të gjendjes civile të bartësit të klasës apo shtresës shoqërore të cilës i përket , format themelore janë po ato, por herë thjeshtohen e herë rëndohen me zbukurime sipas rastit ... në varësi të shtresës shoqërore “2, shprehet Prof. Dr . A. Gjergji . Për këtë përmendim pikturën” Mësonjëtorja shqipe në Pogradec në 1887” që pasqyron hapjen e shkollave shqipe nga rilindasit me thirrjen “ Feja e shqiptarit është shqiptaria “ që tregon qartë grupmoshat e ndryshme me fustanella.Idea e bashkimit jug e veri me “ Lidhja e Prizrenit 1887 “e Piktorit të Popullit A.Zajmi , të dy luftëtarëve me çakshir e fustanellë të bardhë shpreh fisnikërinë e burrërinë. Përveç ngjyrës së bardhë të fustanellës në gëzime e paqe, në momente lufte luftëtarët kishin përshtatur ngjyrën gri , bezhë etj.Këtë e shikojmë tek “Besëlidhja” e J.Drobonikut me qëndrimin stoik të luftëtarëve , te “ Betimi i Skënderbeut” të M.Deliut , te “ Çeta e Shahin Matrakut” të piktorit autodidakt S.Xeka ku fustanellat gri të errëta shkëlqejnë nën dritën e hënës pranë pushkëve të gjata”, Çeta e Themistokli Gërmenjit “ e Piktorit të Popullit G.Madhi si dhe “Çeta e Çerçiz Topullit” të Piktorit të Merituar K.Kodheli. “Fustanella ndryshonte sipas shtresave shoqërore nga numri i kindave .Të pasurit mbanin fustanella me 200 – 500 kinda, ndërsa ata të shtresave të ulta 40 – 50 kinda”3, shkruan prof.Dr.M.Tirta. Kjo shtrirje e fustanellës ekzistoi deri në shpalljen e pavarësisë . “Humbja” e fustanellës në një pjesë të territorit shqiptar u zëvendësua me derivate të saj si ajo e labërisë me kostumin me poture . Labi me qeleshen e bardhë në formë konike me thumb në krye dhe bërrucën në njërin sup tek “Ultimatumi i 1920” të S.Kamberit Piktor i Popullit , përballë ushtarakëve italianë tregonte forcën psikologjike të fituesit popull ndaj frikës psikologjike të pushtuesve. Gjendja optimiste shpirtërore të “Gëzimi i fitores “ të Piktorit të Popullit N.Jonuzi, tregon popullin pjesëmarrës në luftën N. Ç L. mes partizanëve , figurën e labit me qeleshe me thumb .Tabloja ”nënat”në muze të Piktorit të Popullit S.Shijaku dhe ajo e A.Sulajt kushtuar tragjedisë së Otrantos shpalosin tipin e veshjes të grave shamizeza , krijuar në jug të Shqipërisë që me emigrimin e parë të shqiptarëve, për lajmet e hidhura me humbjen e një pjese të tyre në kurbet.

Natyra dhe peisazhi i jugut shqiptar

Natyra e peisazhi në gjeografinë e terrenit jugor është një ndër faktorët e rëndësishëm që ka frymëzuar banorët autoktonë, për të ndërtuar jetën e tyre.Po kështu dhe një realitet malor e fushor pranë detit Jon, që me dritën mesdhetare ka frymëzuar udhëtarët e piktorët e huaj , por dhe ata shqiptarë. Bota e brendshme e bartësve është bashkudhëtare e peisazhit jugor, e frymëzuar nga bukuria plot kontraste që ka kaq pranë malin, fushën, detin.Struktura gjeografike e terrenit kryesisht malor ka ndikuar nëpërmjet vështirësive

të ambientit për një karakter të fortë të banorëve. Populli thotë : "Vështirësitë të burrërojnë". Kjo i shkon për shtat jetës malore nëpër lëndinat rrëzë maleve e kodrave, shkrepave e luginave ku blegtoria është ulur këmbëkryq dhe e ndihmon banorin për ushqimin bulmetor , por dhe për mishin e leshin. Blegtoria e zhvilluar në këto zona është frut i sakrificës së barinjve , që të veçuar në stane shumfishojnë bagëtinë, përballojnë natë e ditë kohën kapriçoze , por dhe egërsirat. "Rrethi i Gjirokastrës përshkohet nga veriperëndimi në juglindje prej tri vargmalesh paralele me njera tjetrën... Drejtimi ekonomik i rrethinave ndikonte mjaft në veshje, mbasi ajo përgatitej brenda ekonomisë shtëpiake "4, shprehet Prof. Dr. S. Shkurti. Po kështu do të shpreheshim dhe për zonën malore të Tepelenës, Përmetit, Korçës, Beratit, bregdetare e malore të Vlorës e Sarandës. Lënda e parë leshi, liri, përshtatur për çdo kohë të motit nga mjeshtrit popullorë në fshat, krijon efekte praktike e monumentale të veshjeve sipas një stili epiko-lirik. Ky epiko-lirizëm shprehet në kombinimin e silahut me koburet e zbukuruara në brez, në pushkët e gjata të veshura me filigram në argjend me sfondin e bardhë të këmishës dhe fustanellës. Kombinuar këto me jelekun blu e mëngoret qëndisur me fije ari e gajtanë dhe kalcat e opingat me xhufka me ngjyrë sipas moshës së personit që e ka veshur. Kjo frymë epiko- lirike është dhe në sfondin e natyrës si burim frymëzimi për piktorët shqiptarë. Për kryeqendrën e jugut , Gjirokastrën mund të përmendim tre variante të Piktorit të Merituar K. Dilo "Gjirokastra" në vaj e tempera dhe "Mbas shiut", me qëndrime të ndryshme monumentale, V. Mio Piktor i Popullit me "Gjirokastra" e "Kalaja e Gjirokastrës" në laps e vaj , të karakterit realist. Dy peisazhet e B. Ahmetit 1980 dhe tabloja "Për mort" ku spikatin simbolikisht qeleshet e bardha me "antenë" mbi çatitë gri të qytetit të gurtë, vepra me karakter romantik. Piktori Dh. Trebicka me dy vepra: "Festivalistët", "Çerçiz Topulli", që shprehin gjendjen emocionale të qytetit me kolorit të gëzuar në ditët e festivalit. A. Zurbo "Gjirokastra" 2004 peisazh kompozicional, në bashkinë e Gjirokastrës, e karakterit realist. Larmia e krijimeve për Gjirokastrën përmbledhtas shprehet në koloritin gri, të vrenjtur, dritë-hijet e saj me kontraste nën diellin ndriçues e të ngrohtë në ditët e festivalit, apo monumentale me kalanë mbi krye si kurorë mbretërore. Nga veprat në peisazh për Korçën kemi përzgjedhur punimet : "Rrugë në Korçë" 1934, Piktor i Popullit V. Mio, V. Tushi Piktori i Popullit "Rrugë në Korçë" 1952 në dy gjendje të ndryshme në rrugicat e saj të karakterit realist dhe arkitekturë vilash tipike korçare. F. Stamo Piktor i Popullit "Peisazh nga Tomorri" 1972 dhe peisaizhi "Gora" 1972, vepra me kolorit të pasur, e ndjesi monumentale, të relievit malor. Q. Meniko "Mijëra për në aksion" (Vunoi) 1968, me një realizëm e kolorit bregdetar të harmonizuar.

Përmbajtja e shprehjes estetike

Me shprehjen e tyre estetike kostumet dhe tekstilet e banorëve të jugut na shpalosin pasqyrimin artistik të figurshëm të mendimeve e ndjenjave. Në pikturat e krijuara gjejmë fuqishëm frymën epiko-lirike, ngjyrat dhe formën e përmbajtjen simbolike të ornamenteve, karakterin frymëzues e rrezatues të kostumeve popullore. Kur shikon strukturën tipologjike, artistiko – estetike të ornamenteve me fije ari mbi sfonde të errëta, që duken si rreze dielli të përthyerë në nota muzikore mbi pentagrame, me forma fraktale simbolike motivesh të një stili epiko-lirik, ndjen jehonën e largët fisnike të shkëlqimit bizantin.

Përmbajtja simbolike e shoqërore e ornamenteve

Duke hedhur vështrimin mbi kostumet popullore të jugut në veprat kompozicionale, portretet e shumta me këto veshje, ornamentet popullore në grafika e vizatime na kujtohet edhe vlerësimi i radhës, por shumë i veçantë i çmimit Laureat më 1970 në Dizhon të Francës për "vallet e kostumet më të bukura" të Ansambllit të Këngëve e Valleve, për bukurinë befasuese shqiptare. Shembull i veshjes së këtyre kostumeve në ceremoni festive është punimi i piktorit të popullit A.Buza "Shqipëria vallëzon" 1971 dhe "Barinjët në bjeshkë" të Piktorit të Merituar D.Jukniu. Këto punime me gjetje artistike, shfaqin qartë psikologjinë e shqiptarëve në situata të ndryshme, njëkohësisht përmbajtjen e fuqishme simbolike e shoqërore të ornamenteve në këto kostume. - Penelat e piktorit D.Jukniu kanë krijuar ekuilibrin e sipërfaqeve të mëdha me trajtesa grafike motivesh të ndritura mbi jelekët e mëngoret e bardha ose blu ,në harmoni me tërësinë e veshjes së bardhë, simbol blegtoral i veçantë. Brezat e kuq, si të flamurit, mbi fustanellë duket sikur lëshojnë rreze nëpërmjet kindave të shumta që zbresin nga lart – poshtë duke u zgjeruar në formë konike mbi valëzimet e tyre të bardha. Nga gjuri e poshtë shikojmë kalcat e bardha të shajakut të lidhura me gjalmë të kuqe dhe opingat prej lëkure me xhufkat e zeza mbi tapetin e kuq. Me formën dhe ngjyrën e veshjeve kemi një ndërthurje të elementeve simbolike që nga lashtësia deri më sot me ato natyrore , patriotike e fetare. Hapësirën, përmbajtjes së ornamentikës popullore ja shtojnë motivet e luleve, linjat e përdredhura e me zig - zake, simbolet e hënës, diellit, shqiponjës, zogjve, fetare etj. Shembull i vërtetë shprehës është kostumi i Lunxhërisë i nivelit të lartë shoqëror i vajzës që duket si një princeshë e pakurorëzuar me kostumin e qëndisur me fije ari e pikturuar nga N.Zajmi Piktor i Popullit më 1951 Tiranë, "Nëna labe" 1964 . "Vajza me kostum" e Piktorit të Popullit F.Haxhiu me shprehje të lartë estetiko-artistike dhe besnikëri ndaj ornamenteve të qëndisura te kostumi i saj. V.Tushi Piktor i Popullit me veprën në gjininë e portretit "Dhuratë paqeje" 1955 . A.A.Zengo me "Dardharja" 1956 , S.Kamberi Piktor i Popullit "Vajza nga Bodrishta" 1987 , "Nusja nga Sopiku" N.Jonuzi Piktor i Popullit. Vargjet e valles së kënduar "Lunxhëri plot lezete, ç'bukuri ke mbi vetë" të zgjojnë ndenja optimizmi për një jetë plot ngjyra ylberi, si mrekullia e veshjes lunxhiote. Gërshetimi kuptimplot i psikologjisë së poezisë me melodinë, vallen dhe simbolikën e ornamenteve, të koncentruara nga niveli i lartë krijues i bartësit si përfaqësues i bashkësisë të zhvilluar ekonomikisht dhe artistikisht shfaqet qartësisht në një krahinë si Gjirokastra.

Fryma epiko-lirike është baza e shprehjes estetike.

Kjo frymë sidomos epike, bëhet karakteristike e përgjithshme e shprehjes estetike të veshjeve dhe dekoracioneve në veçanti, nisur nga qëndrimi imponant i burrave luftëtarë me veshje me fustanellë e armë në brez, jelekë të qëndisur, me këmisha të bardha e mëngë të gjera dhe me qylaf të bardhë në formë konike me majë si thumb. Shembull marrim "Gjyqi i kryengritjes së Sinjës 1847" V.Kilica, "Bilbilenjtë" S.Milori, "Ç. Topulli" K.Kodheli, "Çeta e Themistokli Gërmenjit" G.Madhi, "28 nëntor 1912" P. Çeno, "Zgjimi" H.Dhimo etj. në GKA dhe "Monumenti i Pavarësisë" i skulptorëve Sh. Hadëri, K.Rama, M.Dhrami e "Drashovicë" M.Dhrami në Vlorë , "Flamurtari" O.Paskali, "Ali Pashë Tepelena" M.Dhrami në Tepelenë. Gërshetimi i epikes me lirikën, ku dëshira për liri veprimi përplasit me luftën për mbijetesë është si kombinimi i zhurmave me tingujt muzikorë. Dekoracionet popullore në veshjet e grave dhe burrave të jugut duken bukur në tablotë e artistëve figurativë shqipëtarë, sidomos në

gjininë e portretit, ku dekoracionet në jelekët e tyre ndrisin me dritë e qartësi sikur janë qëndisur me penel. Gërshetimi i tyre me lëvizjen epike të burrave me fustanella në tërësi na japin frymën epiko-lirike të tabloja “Betimi” i M.Saro, “Gëzimi i fitores” N.Jonuzi, “Çerçiz Topulli” Dh.Trebicka.Kostumet me akuarele me autor Dh.Mborja ku veshjet kombëtare me pamje të ndryshme, janë interesante me ngjyra të ngrohta dhe kombinim të mrekullueshëm të pjesëve të tjera funksionale përshkruar nga fryma romantike e kohës.

Simbologjia e ngjyrave

Nisur nga veshjet me dekoracione të Shqipërisë së jugut shikojmë qartë një numër të madh ngjyrash të çelta me mjaft dritë që sundojnë të përgjithshmen koloristike duke i dhënë vlerë kontrastit me ngjyrat e tjera. Ndjeshmërinë e këtij koloriti e shikojmë në veprat e G.Madhi, D.Jukniu, V.Kilica, N.Zajmi, A.Buza, F.Paci, Dh.Trebicka, A.Zajmi, K.Kodheli, P.Mele, M.Fushëkati, H.Nallbani, H.Dhimo, B.Ahmeti, A.Zengo S.Shijaku, Sh.Hysa, I.Lulani etj. Simbologjia e ngjyrave në veshjet, mbështetur emocionalisht në ndjenjat estetike, të mjeshtrave të jugut e përfaquar nga artistët e kultivuar, jepet besnikërisht dhe përpunuar profesionalisht. Trilogjia e ngjyrave: e bardhë, e kuqe, e zezë është e pranishme në evidentimin e dekoracionit popullor nëpërmjet ndjenjave estetike të përgjithësuara në imazhet epiko-lirike të mjeshtrave të jugut duke na dhënë simbologjinë e ngjyrave të kostumeve popullore. Me anë të tri ngjyrave bazë me karakter filozofik, në kostumet popullore të jugut kemi një kontrast të fortë që të emocionon dhe së bashku me trajtimin zbukurues me fije ari e gajtane, shikojmë mrekullinë e harmonisë me ngjyrat e tjera, si vetë natyra me dritë-hije të fuqishme mesdhetare. Artistët e çdo qyteti kishin marrëdhënie profesionale të ngushta midis tyre. Ata ishin vizitorë në atelietë e njëri-tjetrit dhe me këshillat profesionale për avancimin e punëve krijuan frymën artistike lokale dhe kombëtare. Kështu u krijuan vlerësime si: Fryma (shkolla) e pikturës Shkodrane, Lezhiane, Durrsake, Tiranase, Fierake, Vlonjate, Korçare, Gjirokastrite, Sarandiotë, etj. Në këtë këndvështrim mund të themi se koloriti i kostumeve popullore të krahinave përkatëse të jugut është bërë pjesë e qenësishme e paletës së ngjyrave të artistëve të kultivuar të këtyre qyteteve përfaqësuese. Disa prej tyre si: V.Mio Pikturor i Popullit; A.Buza Pikturor i Popullit; S.Kamberi Pikturor i Popullit; S.Shijaku Pikturor i Popullit etj, janë quajtur pikturorë të koloritit shqiptar. Vepra me karakter që shprehin gëzimin, lirizmin e kanë mbështetur në ngjarjet festive në jetën e popullit. Pikturorët si Dh.Trebicka me peisazhet kompozicionale “Ç.Toppulli”, “Delegatet”, M.Fushëkati me tablo kompozicionale “Para manifestimit”, F.Paci me “Shqipëria në festë”, P.Mele “Në sheshin Tien An Men” ku figurat me veshje shqiptare dhe veçanërisht ato të jugut kanë rol të rëndësishëm në këto punime. Veshjet me fustanella me armë në brez e pushkë të gjatë me këmisha të bardha e mëngë të gjera, me qeleshe me majë, me jelekë me mëngore, me opinga me xhufka pasqyrohen te piktura e H.Dhimos “Zgjim”, “Lidhja shqiptare e Prizrenit” Sh.Hysa, “Çeta e Shahin Matrakut” S.Xega, “Çerçiz Topulli” K.Kodheli, “Çeta e Lace Backës” H.Nallbani etj. me paraqitje monumentale. Veshjet e jugut në momente festive krijojnë një plastikë fleksibël, ku volumet lëvizin me zhdërvjelltësi nëpërmjet fustanellave në ndjeshmëri vizive uljeje, ngritjeje, rrotullimesh shoqëruar nga mëngoret e jelekëve në valle. Shembulli i spikatur është vepra në skulpturë “Valltari i jugut” S.Koci, valltarët gjirokastritë në “Shqipëria në festë” të F.Paci, “Barinjte në bjeshkë” D.Jukniu. dhe “Shqipëria vallëzon” A.Buza. Artistët e artit të kultivuar shqiptar janë mbështetur vazhdimisht në artin

popullor, në kostume, objekte, motive, duke marrë frymëzim nga folklori dhe duke sjellë vepra të papërsëritshme .

Një vështrim përmbyllës

Materialet më cilësore të artit të kultivuar, të veprave më të arritura ndodhen në GKA, në arshivën e saj. Me tema të ndryshme që pasqyrojnë brenda tyre ngjarjet historike, janë krijuar një numër i madh figurash me veshje popullore të jugut. Disa botime akademike të Prof. Dr. Ferit Hudhri dhe disa albume piktorësh e skulptorësh qenë frymëzim për të inicuar kumtesën “KOSTUMET POPULLORE TË JUGUT TË SHQIPËRISË NË VEPRAT E PIKTORËVE E SKULPTORËVE SHQIPTARË”. Moment frymëzimi janë dhe festivalet folklorike me larminë e kostumeve në qytetin e gurtë të Gjirokastrës. Mjeshtëria profesionale e artistëve të kultivuar shqipëtarë bëri të mundur pasqyrimin e bukurisë madhështore të kostumeve popullore të jugut në tablotë përjetësuese. Paraqiten një numër i madh veprash e autorësh të pikturës e skulpturës shqiptare me peisazhet, portretet, kompozimet, skulpturat monumentale, me realizëm dhe gjetje të bukura artistike në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë e në Shqipëri. Trajtuam lidhjen e artit popullor me artin e kultivuar duke zbërthyer aspekte të ndryshme në marrjen e dhënien midis tyre, trajtimin e ornamenteve. Duke pare shumë aspekte arritëm në përfundimin që arti popullor, veçanërisht në kostumet e jugut, ka shërbyer si frymëzim për pasqyrimin e tyre me madhësi e vërtetësi të kultivuar duke u bërë burim frymëzimi për brezat e ardhshëm.

Bibliografi

1. Dritëro Agolli – Parathënie në katalogun për pikturin e popullit A.Buza.
 2. “Veshje popullore shqiptare” V.I, fq.10 – Prof.Dr. Andromaqi Gjergji
 3. “Veshje popullore shqiptare” V.I , fq .110 – Prof.Dr. Mark Tirta
 4. “Veshje popullore shqiptare” V.I , fq .46 – Prof.Dr.Spiro Shkurti
- Arkiva elektronike e veprave në pikturë e skulpturë e GKA TIRANË

POSTULATET TEORIKO-SHKENCORE TE SHKATHHTESISE SE PERKTHIMIT DHE INTEPRETIMIT

Dervish Alimi

Hyrje

Shkenca e teorisë së perkthimit dhe interpretimit duket në shikim të parë një fushë shkencore e paeksploruar sa duhet, për vetë faktin se nuk është e afirmuar si shkencë më vehte, që do të kishte objektin e vet të specifikuar të studimit. Kështu, kur secili që thellohet më tej dhe i rreket seriozisht profesionit të perkthyesit, ballafaqohet me shumë paqartësi dhe mungesa teorike të studimit të kesaj fushe, dhe në fund të punës përfundon me dyshimin nëse e ka bërë punën në mënyrë krejtësisht profesionale, edhe pse e ka dhënë gjithë mundin dhe maksimumin e kapacitetit të vet profesional. Ky hezitim është e pashmangshëm, pasi që nuk kemi rregulla strikt të etabluara dhe të njësura për t'iu permbajtur gjatë punës sonë, dhe me të cilat do të verifikonim rezultatin tonë final, dhe se fundi, me të cilat do të mbronim shkencërisht zgjedhjet tona, eventualisht të kontestuara të prodhimit tonë akademiko-profesional.

Një përmbledhje modeste e rregullave elementare teoriko-shkencore të cilat do të sherbenin si postulate apo 'modus vivendi' gjatë perkthimit të teksteve të lëmive të ndryshme është më se emergjente dhe e dobishme për aktualitetin tonë profesional, dhe ky punim është i destinuar të sherbejë si udhërrëfyes dhe këshilltar profesional 'virtual' në rrugëtimin e tij nëpër botën e pafundme të shprehjeve dhe krijimeve artistike drejt daljes në dritë të prodhimit final, që do ta përcjellte besnikërisht mesazhin dhe kuptimin burimor të tekstit të perkthyer. Përcjellja letraro-artistike ekuivalente dhe besnike e tekstit të perkthyer është objektiv parësor, por vështirë i arritshëm nga ana e perkthyesit, i cili përveç njohurive të thelluara leksikore, është njëkohësisht i detyruar të posedojë edhe prirje për krijimtari artistike, por edhe njohuri të përgjithshme të fushave të larmishme shkencore.

Këtë detyrë aq të vështirë dhe njëkohësisht jo mjaft të vlerësuar mund ta ndjejnë mbi supet e tyre të gjithë ata që e marrin përsipër këtë barrë fisnike, dhe ky punim modest synon sadopak lehtësimin e bajeve të kesaj peshe të rëndë, por njëkohësisht bujare në drejtim të fisnikërimin të shpirtit njerëzor.

Definicioni i nocioneve 'perkthim' dhe 'intepretim'

Së pari, do të fillojme me kuptimin semantik të nocioneve të perkthimit dhe interpretimit, të cilët ndërmjet veti ndryshojnë për nga aspekti i gjuhës së shkruar apo të folur. Në fakt, fjala 'perkthim' më shumë i referohet perkthimit formal gjegjësisht me shkrim të dokumentacionit përkatës në fusha të ndryshme juridiko-administrative,

profesionale apo mediatike nga gjuha burimore ne atë qëllimore, (ku hapësira për parafrazim është më e ngushtuar), ndërsa ‘interpretimi’ nenkupton perkthimin me gojë konsektiv (=të njëpasnjëshëm) apo simultan (të njëkohësishëm) të fjalëve të thëna nëpër konferenca të llojeve te ndryshme shkencore e politike apo në seanca gjyqësore dhe administrative gjatë marrjes në pyetje të palëve, te cilat perkthyesi nuk ka mundesi teorike t’i mbajë mend tërësisht dhe t’iu permbahet fjalëve të thëna perpikërisht, dhe prandaj është i lejuar të bëjë zbërthimin semantik të tyre më anë të parafrazimit por njëkohësisht ta percjellë substancialisht përmbajtjen dhe porosinë e thënies gjate ndërveprimit komunikativ ndermjet palëve komunikuese.

Kuptohet se përgjegjësia profesionale e përkthyesit në të dyja rastet është e njëjtë, për vetë faktin se prej tij pritet të percjellë vërtetësinë burimore të domethënies së fjalës së shkruar apo të thënë, pasi që ai është urë kaluese dhe përçues indirekt apo ndermjetësues ‘akustik’ i fjalëve të dalura nga pena apo goja e folësit burimor deri te veshi apo sytë e dëgjuesit direkt apo indirekt të diskursit apo komunikimit ndermjet bashkëbiseduesve.

Kjo detyrë ne shikim të parë e lehtë, ne vehte ngërthen të gjitha njohuritë paraprake profesionale dhe shkathtësitë komunikative, së bashku me prirjet artistike të perkthyesit apo intepretuesit dhe njohuri të përgjithshme me raste edhe enciklopedike të fushave te ndryshme profesionale. Nga kjo rezulton se të kryesh profesionin e përkthyesit don te thotë te posedosh njëkohësisht edhe:

Njohuri te thelluara gjuhësore të gjuhëve protagoniste;

Gjindshmëri artistike, qoftë retorike apo gjestikulative, si edhe performancë të shkëlqyer komunikative si fonologjike ashtu dhe leksikore.

Prirje të zhvilluar për krijim artistik gjatë përcjelljes së tekstit te lexuar apo fjalës së thënë nga autori deri te lexuesi apo dëgjuesi.

Njohuri të pergjithshme të terminologjisë profesionale si teknike, mjekësore, juridiko-administrave, mediatike dhe të ngjashme.

Metodat dhe teknikat e përkthimit

Metoda e përkthimit literal gjëgjësisht të ‘fjalëpërfjalshëm’

a. Metoda fillestare e Perkthimit ‘literal’ apo e a.q. fjalë për fjalë (word-for word translation, traduction mot-à-mot) nënkupton transmetimin direkt pa ndryshuar asgjë, asnjë fjalë apo presje, të tekstit burimor, ku format e origjinalit janë te ruajtura sa më shumë të jetë e mundur, edhe kur keto forma nuk janë shumë natyrale për ta ruajtur domethënien origjinale.

b. Kjo metode është e ngjashme më metodë e përkthimit të ekuivalencës formale, e cila gjatë procesit të përkthimit gjithashtu tenton t’i ruajë sa më shumë të jete e mundur format gjuhësore të origjinalit, pa marrë parasysh nëse janë menyra me natyrale per ta shprehur kuptimin original.

Rrjedhimin, mbrojtësit e kësaj metode e arsyetonin këtë me domosdoshmërinë e ‘ekuivalences dinamike’, si James Barr, (1979, pp. 279-325), ndersa kundërshtuesit e kontestonin me nevojën e ‘transkulturalizmit’ që përfshin përshtatjen e tekstit jo vetem ëe aspektin gjuhësor, por edhe ne kontekstin kulturor dhe historik te lexuesit modern (Michael Marloëe, 2012).

c. Kjo teknike e perkthimit është e njohur edhe si “metafrazë” që nenkupton thënien e frazës ne formën e ‘njëjtë’ burimore, pa asnjë modifikim në zbërthimin dhe bartjen e

domethënies, të cilës më vonë do t'i kundërvihet teknika e 'parafrazes' gjegjësisht thënies së frazes me fjale jo krejtësisht të njëjtë, por thënia e të njëjtës gjë por "me fjale te tjera" të gjuhës qëllimore, mjafton që të percillet mesazhi i folësit burimor.

Me kete metode, rendi sintaksor i fjaleve eshte i ruajtur, dhe fjalet zakonisht perkthehen sipas domethenies se zakonshme. Perdorimi i tyre kryesor eshte per ta kuptuar mekaniken e gjuhes burimore ose per te ndertuar nje tekst te veshtire si proces i fazes se paraperkthimit. (Dr. Shadja Banjar, 2009).

d. Pastaj përkthimi i 'fjalëpër-fjalshëm' është një nënformë e përkthimit literal e cila kërkon perputhjen sa më afër të mundshme të fjalëve origjinale me fjalët individuale të gjuhës qëllimore. Nga ana tjetër, siç u përmend më lart, kësaj metode i kundërvihet metoda e parafrazës apo thënie ndryshe e "mendim-per mendim", me të cilën kuptimi i tekstit origjinal shprehet me shprehje gjegjësisht domethënie ekuivalente apo të barasvlershme.

Përfundimisht, të gjithë gjuhëtarët e ndajnë mendimin së përkthimi fjalë për fjalë që bazohet në percjelljen sa më besnike dhe semantike të thënies burimore është një pikënisje e mirë por jo e mjaftueshme, sepse kjo teori ndeshet me vështirësi sidomos gjatë përkthimit të aforizmave, proverbave dhe shprehjeve frazeologjike, pastaj në rastet kur në gjuhën qëllimore nuk kemi forma dhe dukuri të ngjashme. Nje rast i tille shume perfaqesues jane psh. foljet dhe shprehet frazale te gjuhes angleze (give up=heq dore, give me a break=lermë rehat, to be fed up with=me ka ardhur në majë të hundës, të cilat nuk i kemi në gjuhën shqipe, por nga ana tjetër kemi forma të përbëra të foljeve, si psh. aspiroj në kuptimin e synoj=kam synim, imagjinoj në kuptimin e paramendoj, marr me mend, apo, pretendoj në kuptimin 'them se', këm për qëllim, por që në gjuhën angleze ka kuptim tjetër 'shtirem sikur'.

Në kësi rastesh, përkthimi fjalë për fjalë s'është aspak i dobishëm, sidomos në shprehjet frazeologjike, ku s'do të ishim në gjendje të përcillim kuptimin burimor dhe semantik të shprehjes, psh. 'ëhat goes around comes around', apo anasjelltas nga gjuha shqipe, sikur ta përkthenim fjalë për fjalë proverbin: 'çka të mbjellësh, do të korrësh', dhe të ngjashme. Këtu detyrimisht vjen në shprehje nevojë e posedimit të 'abundances leksike' dhe kulturore të përkthyesit, i cili duhet të gurmtojë thellësisht për të gjetur ngjashmëri situatash në të dyja gjuhët.

Metoda e Parafrazimit ose e Përkthimit Intepretues

a. Vetë kuptimi semantik i metodës nenkupton thënien më fjalë të tjera te fjalës apo tekstit të përkthyer. Kjo metodë është e dobishme vetëm në rastet kur në gjuhën qëllimore kemi folje frazale apo folje dhe fjalë për të cilat nuk kemi fjalë te njëtrajtshme në gjuhën burimore.

Në aspektin historik, metoda e parafrazimit është kundërreagim ndaj metodës së metafrazimit, kështu që nga njëra skajshmëri e përkthimit literal u shkua në skajshmërinë tjetër të interpretimit të lirë të tekstit, ashtu si e ka kuptuar vetë përkthyesi, me çka rrezikohet largimi kuptimor-semantik prej tekstit dhe domethënies burimore të fjalës.

Në këtë rrafsh, për fat të keq vjen në shprehje interpretimi subjektiv nganjëhere edhe arbitrar apo i njëanshëm i përkthyesit, dhe më këtë rrezikohet interpretimi objektiv, gjë që është qëllimi esencial dhe misioni parësor i procesit të përkthimit. Në fund të fundit, lexuesit nuk i intereson mendimi dhe komenti personal i përkthyesit por vetëm komenti

burimor i autorit të tekstit, dhe çdo gjë tjetër përbën shtrembërim dhe zbehje e realitetit objektiv të ngjarjeve të rrëfyera në tekst.

b. Edhe metoda e a.q. e perkthimit intepretetues (Interpretative translation) si lloj i veçantë apo variacion, por jo edhe sinonim i metodës së parafrazimit, nenkupton se gjatë perkthimit duhet të perfshihet interpretimi i domethënies së tekstit burimor. Perdorimi i kësaj metodë vjen ne shprehje në raste kur përkthyesi fut informata të cilët jane ‘pa lidhje direkte’ për një pasazh të posaçem që është objekt perkthimi, dhe keto informata duken me shume si ‘komentuese’, me kusht që nuk duhet larguar shumë nga domethënia burimore e tekstit burimor.

Sidoqoftë, duke u nisur nga parimi i ‘eklekticizmit metodologjik’, se ne çdo metode duhet gjetur dhe pranuar ate qe është pozitive dhe flakur tej negative, edhe kjo metode ka në vete anen e vet pozitive në rastet kur nuk kemi fjalë dhe shprehje adekuate ne sfondin tone burimor të fjaleve, por kemi shprehje apo lokucione foljore dy dhe me tepërfjalëshe, te cilat na kryejne punë me rastin e bartjes sa më besnike të domethenies semantike dhe te mesazhit artistik të fjalës nga gjuha burimore në atë qëllimore dhe anasjelltas. Nga ana tjetër, duhet flakur dhe shmangur ne çdo hap ana e saj negative, qe është rreziku i arbitrarizmit dhe interpretimit subjektiv dhe personal të gjërave nga ana përkthyesit. Rrjedhimisht per t’iu shmangur ketyrë rreziqeve rekomandohet që kjo metodë të shfrytëzohet vetëm gjatë perkthimit te teksteve të shkruara me fjalor të varfër semantik.

Metoda e barasvlerësit funksional apo ‘metoda semantike’.

Metoda e barasvlerësit funksional quhet ndryshe edhe metoda e ‘kriticizmit të formës” si edhe metoda ‘semantike’ gjegjësisht e ‘perkthimit të bazur në domethënie (meaning-based)” sepse përqëndrohet në nevojën kritike që perkthimi ta ruajë domethënien.

Kjo metode fillimisht është zhvilluar nga shkollarët gjermanë në fillimet e shekullit të XX. Ithtarët e kësaj metode paralajmëronin për ndryshimet semantike ndërmjet gjuhëve psh. greke dhe hebraike ne raport me anglishten, sidomos gjatë perkthimit të teksteve fetare gjegjësisht përkthimit të Biblës, për hir të faktit që fjalët gjermanike të cilat kryesisht perdoreshin për terma teknike, për te cilat nuk mund te gjindeshin sosh ne gjuhen angleze, prandaj edhe rrjedhimisht pritej prej studentëve të dispononin me njohuri të terminologjisë profesionale të fushes perkatëse, per te pikasur ngjashmëritë dhe dallimet ndër-gjuhësore dhe për të gjetur në fund shprehjet e barasvlershme që do te kishin të njëjtin funksion apo efekt funksional.

Si çdo metodë, edhe kjo metodë i ka mangësitë e veta, sepse një perkthim adekuat nuk mundet gjithmonë t’i ruajë format e origjinalit, por duhet patjetër të ruajë domethënien e origjinalit.

Kundershtarët e kësaj metode të quajtur ndryshe ‘metoda e kriticizmit te formës’, ia zinin për të madhe se kjo e shmang theksin e situatës jetësore te tekstit, për nje arsye te vetme, sipas Michal Marlowe: “besoj se perkthimi i Bibles duhet te kete doemos parasysh “vendndodhjen sociologjike” në të cilën është paraqitur Bibla dhe te ciles i takon, pra Kishës së Jezu Krishtit” në krahasim me Biblën jashtë Kishes së Jezu Krishtit, per nevojat e femijëve apo qytetarit te thjeshtë’.Michael Marlowe (2012).

Si rrjedhoje e kësaj, në rrafshin sociologjik bashkëkohor, vjen ne shprehje fakti që perkthyesi duhet njëkohësisht pasur ne konsideratë se per kë është i destinuar teksti, për profesionista të fushëve perkatëse, apo per njeriun e rëndomte, të një moshe apo te një shtrese të caktuar shoqërore. Dilema e përzgjedhjes së fjalorit të sofistikuuar akademik

apo fjalorit të thjeshtë nga jeta e përditshme është sfidë e përhershme e përkthyesit. Nje tekst me terma komplekse nga fusha e specializur gjuhësore, te cilin si te tille do ta kuptonte vetem profesionisti, nuk eshte qellimi final i perkthimit, përveç nëse paraprakisht është i paradestinuuar për rrethe akademike.

Mjeshtria dhe madhështia e profesionistit qëndron në gjetjen e 'mesit të artë' apo mesatares ndërmjet këtyre dy rrafshëve gjuhësore, kështu që një perkthim është definitivisht i suksesshëm kur atë e lexon dhe kupton një rreth më i gjërë lexuesish. Funksioni informativ nuk është qëllimi parësor i perkthimit, por funksioni edukativ i tij, që d.m.th se tekstin duhet ta kuptojnë edhe atë që janë laike, por që duan të formësohen profesionalisht. Fundja, këtu qëndron edhe esenca e arsimimit dhe aftësimin profesional te njeriut, sepse askush s'ka lindur i ditur, por nëpërmjet mësimin dhe leximit ka arritur gradualisht nje shkallë të caktuar të arsimimit profesional.

Pra, edhe në këtë metodë, si në çdo metode tjetër, e mira e gjetjes së shprehjes se barasvlershme apo ekuivalente në raport me rrethanat e dinamikës shoqërore duhet perqafuar pa hezitim, ashtu siç duhet kritikuar dhe anashkaluar nevoja e gjetjes së formës strikte apo të ngurtë profesionale.

Metoda e përkthimit huazimor (loan translation)

Përkthimi huazimor nënkupton huazimin e pjesëve të fjalës burimore dhe përkthimi direkt i tyre në gjuhën qëllimore, në vend të përdorimit të nocionieve amë nga gjuha qëllimore. Ngadonjëhere huazimi është edhe i pjesëshëm, pra me një pjesë të termit të huazuar dhe një pjesë të formës së gjuhës qëllimore. Në bazë të kësaj, fjala e krijuar nëpërmjet të përkthimit huazimor quhet 'loan', 'borroëing' ose 'calqué'.

Huazimet dhe prurjet e ndryshme të fjalëve të huaja janë tendencë e pashmangshme e globalizmit dhe e kontakteve e komunikimeve të shpeshta ndërmjet banorëve të bashkësive të ndryshme etnike gjegjësisht të shteteve të ndryshme anembanë rruzullit tokësor.

Si rrjedhojë e kësaj tendence në teorinë gjuhësore ekzistojnë dy rryma përfaqësuese:

a. rryma e 'internacionalistëve' gjegjësisht e globalistëve, pra të atyre që i perqafojnë dhe jane pro procesit të përkthimit me huazime dhe që thirren në dobishmerine e këtyre prurjeve në aspektin e pasurimit të vokabularit të gjuhës qëllimore me fjalë të gjuhës burimore; dhe nga ana tjetër,

b. rryma e 'puritanistëve', pra e atyre që i kundërshtojnë kategorikisht këto prurje si të dëmshme dhe të panevojshme për procesin e përkthimit, pasi që e zbehin dhe varfërojnë thesarin burimor të gjuhës amtare qëllimore.

Ithtarët e dobishmërisë së prurjeve bazohen në pasurimin e fondit gjuhësor të gjuhës amtare me fjalë të cilat gjejnë vend në vokabularin e gjuhës se perkthimit për vetë faktin se këto shprehje edhe ashtu mungojnë dhe kësisoj nuk ka se si të demtojnë diçka që nuk është eksistente, porse zëvendësojnë dhe mbulojnë mangësitë evidente të fjalorit të gjuhës perkatëse.

Si pasojë e kësaj tendence sot kemi fjalë të bollshme të quajtura internacionalizma, pasi që të njëjtat tashmë i kanë pranuar shume popuj anembanë botës, dhe nuk mund të thuhet se i përkasin dhe janë me prejardhje të vetëm një gjuhe, pa marrë parasysh burimin fillestar të këtyre fjalëve. E njejtja gjë ndodh edhe me teknikizmat

nderkombëtarë, si pasojë e modernizimit të skajshëm dhe të prodhimitarisë industriale të teknologjise moderne, duke përfshirë edhe prodhimet e teknologjise se infomacionit.

Rrjedhimisht, fjalë të tilla fillimisht internacionale si 'apostrofim' (=thënia e emrit), absorbim (perthithje), si dhe aktualizim, operacionalizim, konkretizim, materializim dhe shume të tjera kanë leshuar rrënjë të thella në vokabularin tonë, në mungesë të përpjekjeve të perkthyesve dhe gjuhëtarëve të kohës për të gjetur shprehje ekuivalente nga sfondi burimor i fjalëve, dhe si pasojë ato janë mishëruar aq shume me natyrën e gjuhës amtare, sa që nuk është më problematik dhe relevant fakti që janë me prejardhje të huaj gjuhësore, edhe pse nuk do të duhej shume mund për t'i përkthyer dhe interpretuar këto fjale me fjalë autoktone shqipe.

Ithtarët e dëmshmerise së prurjeve bazohen në varfërimin e fondit gjuhësor të gjuhës amtare të perkthyesit dhe lexuesit të tekstit të përkthyer, me të cilat bëhet zëvendësimi i fjalëve ekzistente por të paafirmuara në gjuhën përkatëse, si psh. 'eksperiencia' e zëvendëson pa nevojë fjalën 'përvojë', 'demantoj' përdoret në vend të përgënjeshtroj, sugjeroj, në vend të këshilloj, dhe të ngjashme.

Ne kete prizëm, rezulton edhe dukuria e huazimit të 'shtrembëruar' gjegjësisht 'të specializuar' të fjalëve, në rastet kur fjala e huazuar nga gjuha burimore e ka humbur domethënien e vet fillestare, dhe ka zënë vend në fondin e gjuhës qëllimore me kuptim pjesërisht apo tërësisht të ndryshuar, si psh. preferoj, përdoret me kuptimin 'sygjeroj' dhe jo me kuptimin fillestar 'parapelqej', pronotoj, në vend të italishtes 'prenotoj', pastaj mbiemri 'i eksituar' (=i ngazëllyer, i emocionuar) nëse e përdorim të papërkthyer, fiton ngjyrim negativ, për vetë faktin se hapësira e përdorimit të kesaj fjale, në gjuhën shqipe është shumë e ngushtuar.

Te gjendur në mesin e këtyre skajshmërive, përkthyesi profesionist i ballafaquar me argumente kryesisht të qendrueshme të të dyja anëve të medaljes së njëjtë, s'ka rrugëdalje tjetër përveç se të udhëhiqet nga parimi i gjetjes së 'mesit të artë' ndërmjet tyre, gjegjësisht të menaxhimit të shkathtë me huazimet, pra të përdorimit të tyre vetëm atëherë kur nuk kemi rrugëdalje tjetër dhe kur s'kemi fjale analoge në vokabularin tonë letrar dhe dialektor, dhe të anashkalimit të tyre, atëherë kur kemi shprehje ekuivalente apo të barasvlershme në fondin e gjuhës së përkthimit.

Metoda e perkthimit të lire (The free translation method)

Brenda terminologjisë gjuhësore të kesaj metode, mund të dallojmë disa nënloje të metodave të përafërta ndërmjet tyre, si për nga definicioni ashtu edhe për nga lenda apo objekti i trajtimit.

Metoda e përkthimit të lirë është metoda që e ruan kuptimin e origjinalit por përdor forma të natyrshme të gjuhës qëllimore duke përfshirë rendin natyror dhe sintaksor të fjalëve në menyre që perkthimi të jetë i kuptuar në menyre të natyrshme.

Metoda e perkthimit të lirë është poashtu një lloj i përkthimit idiomatik apo si që e quajnë ndryshe përkthimit semantik, e cila, në njëfarë mënyre e riprodhon mesazhin e origjinalit, dhe tenton që të shtrembërojë nuancat e domethënies, duke preferuar kolokvizializmat dhe idiomat, e cila në fakt,

është një variacion stilistik i metodës së përkthimit besnik, e cila tenton që të riprodhojë domethënien kontekstuale të origjinalit brenda kornizave dhe kufizimeve të strukturave gramatikore, sepse kjo metodë tenton të siguroje

perkthimin sa më besnik të domethënies që e ka pasur ndërmend ta thotë dhe percjellë autori i tekstit burimor.

Në bazë të këtyre definicioneve mund të shohim se kjo metodë është e ngjashme me metodën e parafrazimit por hapësira e saj e parafrazimit është më e theksuar.

Ne fakt, kufiri terminologjik i bërjes së diferencës apo ndarjes me vijë të kuqe të këtyre metodave është relativ, sepse ata gërshetohen njëra me tjetrën dhe e permbushin njëra tjetrën.

Prandaj, poenta e përkthimit të suksesshëm dhe profesional qëndron në gjetjen dhe shfrytëzimin e dobiprurjeve të këtyre metodave dhe në shmangien e dëmprurjeve të tyre. Parimi i eklekticizmit metodologjik është më se i mirëseardhur dhe kush din të udhëhiqet nga ky parim, të gjejë mesin e artë e këtyre metodave, pa dyshim që e ka gjetur zgjidhjen dhe çelësin e suksesit.

Si perfundim, vijon: Lista e Postulateve teoriko-shkencore të shkathtësise së përkthimit dhe interpretimit:

Fjalori autokton dhe burimor i gjuhës qëllimore është prioriteti dhe postulati numer një.

Huazimet duhet shmangur gjithmone, përveç në raste të pashmangshme dhe të terminologjise profesionale.

Fjala e dykuptimshme duhet shmangur dhe zëvendësuar me fjale tjeter të barasvlershme dhe të njëkuptimshme.

Lejohet shmangja edhe anashkalimi i fjaleve të caktuara, si edhe për nevojë të pershtatjes me natyrën dhe stilistiken gjuhësore.

Përkthyesi i mirëfillte duhet të ketë edhe prirje artistike dhe shpirt krijues në gjuhën e përkthimit.

Idiomat dhe frazeologjizmat janë të papërkthyeshme fjale për fjale, dhe duhet gjetur të tilla dhe barasvlershme në gjuhën burimore, të përdorura për situata të ngjashme

Konstruksioni gramatikor i fjalisë dhe pershtatja kohore e foljes në gjuhës në të cilën përkthehet prevalon mbi konstruksionet e gjuhës së përkthyer.

Interpretimi dhe pershtatja nuk guxon të rrezikojë vlerën artistike të tekstit dhe shtremberimin e ngjarjes së rrefyer në tekst

Përkthimi i emrave të përveçem mund të pershtatet me rregullat fonetike dhe ortografike të gjuhës së përkthimit

Stili letrar i gjuhës qëllimore, 'i thjeshtë dhe i qartë', mbisundon ndaj stilit 'kompleks dhe absurd', të gjuhës burimore.

Si në çdo fushë tjeter shkencore, edhe në teorinë e përkthimit rregullat ekzistojnë edhe pse rrallëherë i takojmë të shkruara. Nëse nuk i gjejme të shkruara dikund me parë, ato edhe mund t'i ndiejmë kur e arrijmë shkallën e profesionalistit dhe atëherë kur e fitojmë ndjesinë e sensit dhe instiktin melodik të fjalës së shkruar, si muzikanti që e ndjen tingullin e degjuar, dhe e dallon "notën e paqelluar" gjegjesisht të panevojshme muzikore, gjegjesisht "fjalën e paqelluar gjegjesisht të panevojshme letrare dhe artistike. Siç shihet edhe përkthimi është art si muzika, dhe si rrjedhojë përkthyesi është po aq artist sa muzikanti, me të vetmin dallim se lenda e punës së tij është fjala dhe jo tingulli, por edhe fjala në fund të fundit përbehet prej tingujve, kështu që dallimi sa vjen e zvogëlohet dhe zhduket.

Bibliografia e shfrytezuar

Dr. Shadia Banjar, Assistant Professor of Linguistics at K. A. U on Dec 06, 2009

Elena Shapa, Dr. Associate Professor Moldova State University, Translation types

James Barr, "The Typology of Literalism in Ancient Biblical Translations," in *Mitteilungen des Septuaginta-Unternehmens*, 15 (Göttingen: Vandenhoeck & Ruprecht, 1979), pp. 279-325.

Against the Theory of 'Dynamic Equivalence' by Michael Marloëe

Revised and expanded, January 2012 by Michael Marlowe

John Beekman and John Calloë, *Translating the Eörd of God*. Grand Rapids: Zondervan Publishing House, 1974.

Sebastian Brock, "Aspects of Translation Technique in Antiquity," in *Greek, Roman, and Byzantine Studies* 20/1 (1979), pp. 69-87.

Martin Buber and Franz Rosenzëeig, *Scripture and Translation*, edited and translated by Laërence Rosenëald and Everett Fox. [from *Die Schrift und ihre Verdeutschung*, 1936] Bloomington: Indiana University Press, 1994. Argues for foreignizing translation, as exemplified in Everett Fox's [Five Books of Moses](#).

Calvary Baptist Theological Journal 12/1-2 (1996) is a thematic issue on the topic "Text and Translation," eith essays from a fundamentalist perspective on translation theory and textual criticism. The articles define a communication model in translation and hold that divine preservation of the biblical text does not necessarily require a pro-TR/KJV only vieë. Titles include: C. McLain, "Toëard a Theology of Language," S. Horine, "Bible Translations: Do Eë Have the Right Models?" G. Lovik, "The Controversy Over Greek Texts," C. McLain, "Variants: Villainous or Validating," D. Burggraff, "Paradigm Shift: Translations in Transition—Eë've Been Here Before" (Jerome vs. Augustine), C. Banz, "A Seventeenth Century English Bible Controversy" (early criticism of KJV).

Ellis E. Deibler, "An Index of Implicit Information in the Neë Testament," in *Translators Eörkplace* 3.0. Dallas and Neë York, SIL and UBS, 1999.

Paul Ellingëorth, "Translating the Bible," *Epëorth Revieë* 20 (1993):113-118. A broad survey of books for or about Bible translating, eich at the same time sketches the progress of the enterprise in this century. Some pungent paragraphs on theology and translation.

Edeïn Gentzler, *Contemporary Translation Theories*. London: Routledge, 1993.

Frederick C. Grant, *Translating the Bible*. Greenëich, Conn.: Seabury Press, 1961.

EMËRTIMET TOGFJALËSHORE NGA ANA E FORMËS SË BRENDSHME NË SHQIPE NË PËRQASJE ME GJEGJËSET BARAZVLERËSE NË ANGLISHTE DHE RUSISHTE

Diana Djaloshi

Zhvillimet e mëdha evolucionare në shoqërinë shqiptare posttotalitare, në mënyrë të veçantë këta dy dhjetëvjeçarët e fundit, me hapjen e Shqipërisë me botën, kanë çuar në shfaqjen e koncepteve të shumta në të gjitha fushat e jetës shoqërore, emërtimet e të cilave kanë zgjeruar dhe pasuruar fondin leksikor të gjuhës standarde shqipe. Zhvillimet në këtë leksik janë pasqyruar gjithashtu në ndryshimet brenda shtresave të fondit të njësisive emërtuese dhe të llojeve të tyre. Kështu, krahas shtimit të fondit të fjalëve të krijuara me brumin leksikor dhe mjete fjalëformuese të brendshme, sidomos vitet e fundit p.sh: bashkëvuajtës, bashkëjetues, bashkëpronar etj., është krijuar dhe një fond leksikor me fjalët e huaja, sidomos me burim nga anglishtja, çka ka bërë që, ndryshe nga më parë, para vitit 1990, anglicizmat të krijojnë një shtresë të mëvetësuar, si dikur italianizmat, por më të gjerë se ato³⁷¹. Një pjesë e madhe e tyre janë futur në fushat e reja të dijës, si në informatikë, në telekomunikacion, në gjenetikë: si p.sh. *computer, monitor, mouse, chat, performance* etj. Këto përpjesëtime të reja në shtresat leksikore të gjuhës, ku vihet re pakësimi i formimeve në nivel fjalësh me mjetet e brendshme të një gjuhe të caktuar dhe shtimi i formimeve me burim nga gjuhët e huaja, kryesisht nga anglishtja, kanë bërë që vetë gjuha, në rrafshin leksikor, të aktivizojë në përmasa më të mëdha, përmes përdoruesve të saj edhe mjete të tjera për të përballuar fluksin e madh të koncepteve të pafundme që qarkullojnë nga njëri areal gjuhësor në tjetrin. Këto mjete shfaqen në formën e “emërtimeve togfjalëshore”³⁷² që paraqiten nga ana strukturoro-semantike, si njësi emërtuese më të diferencueshme e më të përpikta se fjalët, që shtohen me sasi më të mëdha edhe për faktin se ndërtohen mbi bazën e emërtimeve njëfjalëshe, të fjalëve ekzistuese, rrallë të fjalëve të reja, çka del nga krahasimi i tyre në një gjuhë, psh, në shqipe, me gjuhë të tjera si: *pushtet i katërt* (shq.) me “*forth estate/ power*” (ang.), dhe *Четвертая сила/власть* (rus.). Fondi leksikor ka fituar tipare të reja, kushtëzuar nga një varg faktorësh jashtëgjuhësorë dhe brendagjuhësorë:

- Shtimi i fushave të reja të dijës dhe diferencimin në fusha të gjëra tematike e tematiko-konceptore, ku mbizotërojnë në masë strukturat togfjalëshore dhe që pasqyrohen me shumë sidomos në fjalorët e degëve të tilla si të informatikës, të politikës, të së drejtës etj.

³⁷¹ H. Shehu, “Rreth fjalëve angleze ose me prejardhje nga anglishtja në gjuhën e sotme shqipe”, në përmbledhjen “Seminar ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, 19, Prishtinë, 2001.

³⁷² A. Duro, “Togfjalëshar e qënrueshëm terminologjikë në shqipen e sotme”, Sf, 1982/4.

Kjo vihet re sidomos në gjymtyrët e përcaktuara të togfjalëshave, ku me kompjuter (informatikë), shtet (të së drejtës), parti (politike) takohen me dhjetra togfjalësha si njësi emërtuese të qëndrueshme që shënojnë koncepte të reja, si emërtimet njëfjalëshe: si psh., me kompjuter³⁷³ kemi rreth 25 togfjalësha si psh. *kompjuter personal*, me shtet³⁷⁴ kemi 28 togfjalësha si psh. *shtet civil, shtet demokratik, shtet juridik, shtet ligjor, shtet mirëqënie sociale* etj., me politikë³⁷⁵ kemi 27 togfjalësha si psh. *politikë financiare, politikë monetare, politikë fiskale, politikë krediti, politikë dividendi* etj. Përmes krijimit të shumtë të njësjive togfjalëshore janë krijuar një varg konceptesh të reja me përmbajtje të sakta dhe shumë të diferencueshme si psh. *kartë krediti, para të pista*, etj., edhe pse ndonjëherë të afërta semantikshtsi: *shplarje truri*. Duke vëzhguar sesi funksionojnë në gjuhë, por edhe se si pasqyrohen në fjalorë, sidomos në fjalorë të fushës politiko-shoqërore, ku si shëmbull do të merrnim fjalorin e termave juridikë si dhe fjalorin politik do të kishim këto tipare:

- Funksionimin e togfjalëshave të rinj në formë dhe në përmbajtje: Avokat i popullit.
- Funksionimin e togfjalëshave ku si element përcaktues shërben termi ekzistues *shtet, kod, bankë*, të cilat në përgjithësi kanë gje gjegjëset në gjuhët e huaja si psh. *shtet i së drejtës, kod elektoral, bankë kursimesh*.
- Funksionimin e togfjalëshave ku si element përcaktues shërben një fjalë e re: *shoqatë jofitimprurëse*.
- Aktivizimin më të madh të elementeve përcaktuese si *politik, demokratik, partiak* si njësi specifike (terminologjike), por edhe të zakonshme si: *i madh, i vogël, i lartë, i ulët* etj.: *pluralizem politik, shtet demokratik, koalicion partiak* etj.

Si tipar tjetër shumë të rëndësishëm mund të theksonim se këto njësi sot takohen shpesh jo vetëm në ligjerimin e shkruar, por edhe në të folur, madje deri në thjeshtëligjërime si: *kompjuter personal, para të pista, larje parash, bono thesari, kartë identiteti, kartë krediti*, të cilat dallohen për kompaktësinë e tyre semantike, meqë si njësi emërtuese shënojnë koncepte të lidhura me objekte të identifikuar, të përafërta me fjalët, dhe, si të tilla, shërbejnë si emërtime njësoj si fjalët. Vështruar nga kjo pikëpamje, siç është nënvizuar me të drejtë, ndonëse nga ana e forms si njësi të gatshme, ato janë struktura të hapura, si tek tipi *kartë identiteti*, kompaktësia e tyre kuptimore bën që tek to të mbizotërojnë "e tëra mbi pjesët"³⁷⁶ dhe nga ana e funksionit që kryejnë, d.m.th., si emërtime, të ndihen si fjalët. Togfjalëshat, përbëjnë problem të veçantë nga pikëpamja e vështirësive që hasen në gjuhë, kur ata përqsën me gjuhë të tjera (kur i mësojmë, i përkthejmë apo i përdorim) si nga forma e jashtme (kur togfjalëshi nuk i përgjigjet plotësisht ose kanë gjegjëse të përafërt në gjuhën gjegjëse, ashtu edhe kur nuk përputhen format e brendshme të gjymtyrëve të emërtimeve togfjalëshore), si të tillë ata duhen të trajtohen si fond njëgjuhësh për shkak të formës së shprehjes të veçantë për çdo gjuhë, por edhe si fond ndërgjuhësor, për shkak të koncepteve të njëjta që shprehin. Për shkak të formës së përbashkët konceptore ato bëhen të qarkullueshme nga një gjuhë në tjetren (kur krijohen mbi bazën e koncepteve që hyjnë nga njëra gjuhë tek tjetra si psh. *luftë e ftohtë* (shqip), *cold war* (ang.) dhe që mbi këtë bazë bëhen të përqsashme (të krahasueshme) edhe format e jashtme dhe të brendshme, për të vështruar se si realizohet pikërisht kjo

³⁷³ Sipas "Fjalor i Informatikës" (anglisht-shqip, shqip-anglisht), N. Caka, Prishtinë, 2005

³⁷⁴ Sipas "Fjalor i Drejtësisë"

³⁷⁵ Sipas "Fjalor Politik"

³⁷⁶ H. Pasho, "Togfjalëshat e zgjeruar emërorë në terminologjinë e ekonomisë", "Studime Filologjike", 1986/3

ndërthurje konceptore nga njëra gjuhë tek tjetra me anën e formave origjinale (specifike) për çdo gjuhë.

Kompaktësia e togfjalëshave qëndron në faktin që (a) janë emërtime dhe si të tilla ofrohen shumë me fjalën, (b) kanë gjegjëse një-fjalëshe në gjuhët amtare dhe në gjuhët e tjera apo dy-fjalëshë në gjuhën amatare dhe (c) kanë gjegjëse një-fjalëshe apo dy-fjalëshë në një gjuhë tjetër siç mund të sillen si shëmbuj tipikë: *këllef jastëku* → *pillow case* (ang.), *navolçoçka* (rus.); *hekurudhë* → *zheleznaïa doroga* (rus.), *railway* (ang.), *bedroom* (ang.) → *dhomë gjumi* → *spal'naja* (rus) etj. Emërtimet togfjalëshore, si njësi të qëndrueshme shprehin koncepte si dhe fjalët dhe përderisa këto emërtime togfjalëshore jo gjithmonë përputhen në gjuhë të ndryshme, nga ana e mënyrës se si e shprehin konceptin e përbashkët me format e jashtme gjuhësore, që janë origjinale për secilën gjuhë, por edhe me format e tyre të brendshme, të cilat gjithashtu kanë formësime pak a shumë të ndryshme, ndonëse ato herë përputhen nga anë të veçanta, herë vihen re dallime të spikatura, bëhen objekt i studimeve krahasuese në gjuhë të ndryshme. Kjo vihet re edhe brenda një gjuhe. Në gjuhën shqipe në historinë e njësisive haset “*udhë e hekurt*” (nga Sami Frashëri), “*hekurorë*” (autori që e ka përdorur për herë të parë është i paidentifikuar) dhe “*hekurudhë*” (nga Luigj Gurakuqi). Për rrjedhojë del problemi i raporteve fjalë-togfjalësh nga njëra gjuhë në tjetrën si dhe marrëdhëniet strukturoro-kuptimore të njësisive togfjalëshore. Kur emërtimet togfjalëshore krahasohen me njësitë barazvlerëse në gjuhë të tjera, ndodh shpesh që një njësi togfjalëshore në gjuhën “x” mund të ketë si barazvlerë një njësi togfjalëshore në gjuhën “y”, por në raste të tjera mund të ndodhë që një njësi togfjalëshore në gjuhën “x” mund të ketë si barazvlerë një njësi njëfjalëshe në gjuhën “y” dhe anasjelltas, siç u sollën më sipër një varg shëmbujsh. Prandaj do të kishte një vlerë të veçantë studimi nga pikëpamja e ndërtimit strukturor të tyre në raport me funksionimin e përbashkët që kanë. Në thelb studimi i problemit ka të bëjë me emërtimet togfjalëshore, sepse pikërisht tek njësitë togfjalëshore qëndron problemi i zbulimit të funksionimit të tyre kur fjalët e dy apo më shumë gjuhëve vihen përballë njëra tjetrës dhe krahasohen në strukturat semantike të tyre, siç del po të përballën “*hekurudhë*” dhe “*zheleznaïa doroga*” rus. (ku “*hekurudhë*” është njësi njëfjalëshe, ndërsa “*zheleznaïa doroga*” është njësi togfjalëshore edhe pse të dyja këto njësi emërtojnë të njëjtin koncept). Përdoruesi i fjalorit apo përkthyesi e ka të lehtë të gjejë barazvlerën përkatëse në gjuhën tjetër kur shfaqet me fjalë, por e ka të vështirë kur duhet të gjejë barazvlerën që shprehet me togfjalësh (në rastet kur ky nuk njihet si barazvlerës si psh. *thumb* (ang.) dhe *gisht i madh* (shqip), ose anasjelltas: *coffee pot* (ang.) dhe *xhezve* (shqip)³⁷⁷. Përveç kësaj është e rëndësishme të vështrohen këta togfjalësha kur krahasohen nga njëra gjuhë në tjetrën edhe nga pikëpamja e marrëdhëniet që ekzistojnë nëpërmjet elementeve përbërës të tyre për të mundësuar sa më shumë që të jetë e mundur harmonizimin e “formës së brendshme³⁷⁸”, ose të anës motivuese të kësaj forme³⁷⁹ (që do të thotë që të shihet nëse ka përputhje të njëjta nga pikëpamja strukturore: emër + mbiemër; emër+emër në barazvlerat e krahasuara në shumë gjuhë), si psh. emër + mbiemër. Vështruar nga kjo pikëpamje do të kishte vlerë të veçantë, nëse këto njësi emërtuese togfjalëshore të vështrohen në rrafshin e dy gjuhëve ose të disa gjuhëve me të cilat ato lidhen. Ky

³⁷⁷ Shih “Fjalor shqip- anglisht”, Pavli Qesku, Tiranë, 1999

³⁷⁸ E. Wuster, “Internationale Sprachnormung in der Technik”, UDI, Berlin, 1931

³⁷⁹ V. Zvegincev, “Semasiologia”, Moskva, 1957

vështrim ka vlerë për t'i evidentuar këto "mosbarasvlerësi" dhe për t'i pasqyruar në një fjalor, i cili do t'u shërbente sidomos përkthyesve në punën e tyre, ose edhe atyre që e mësojnë një gjuhë të huaj. Kjo e fundit ka rëndësi të theksohet, sepse në mjaft raste këto njësi merren në mënyrë aprioristike dhe mësohen si njësi të gatëshme në lidhjen e tyre me emërtimet njëfjalëshe dhe kjo vështirësi shfaqet edhe kur nuk përputhen strukturisht si psh. *xhezve* dhe *coffee pot* (në një rast fjalë, kurse në gjuhën tjetër togfjalësh), ashtu edhe kur në të dyja gjuhët janë janë strukturë togfjalëshore si: *pastrim parash* (shqip) dhe *money laundry* (ang.), ku në të dyja rastet është e vështirë të përcaktohen lirshëm gjegjëset në gjuhët përkatëse. Ato duhen mësuar dhe ditur "përmendësh" si njësi njëfjalëshe. Vlera e këtij studimi qëndron po ashtu në krijimin e një modeli për hartimin e një fjalori mbi bazën e të cilit mund të hartohet një fjalor i korrespondimeve të emërtimeve togfjalëshore dhe njëfjalëshe. Studimi i togfjalëshave emërtues në mënyrë krahasuese në disa gjuhë, ndihmon gjithashtu në saktësimin dhe diferencimin e shprehjes së koncepteve, si dhe krijon një bazë për standardizimin ndërkombëtar si dhe kontribuon në ruajtjen e parimit të "njëkuptimisë dhe saktësisë", shembull përbën togfjalëshi "pushteti i katërt". Një tjetër përfitim i rëndësishëm nga kjo përjasje e termave emërtuese njëfjalëshe dhe togfjalëshore në shumë gjuhë lidhet edhe me evidentimin e rasteve të sinonimisë për të bërë të mundur shmangien e termave sinonimë që të sigurohet sa të jetë e mundur që "ndërmjet termave sinonimë të zgjidhet ai që konsiderohet nga specialistët si një emërtim më i saktë". Kjo përjasje do të krijonte gjithashtu një model krahasimi duke u bazuar në parimet e terminologjisë "një term një koncept" dhe "një koncept një term"³⁸⁰.

Krahasimi i barazvlerave në disa gjuhë (duke e konsideruar në këtë rast gjuhën angleze si gjuhë lider) do të ndihmonte po ashtu të vëreheshin ndryshimet dhe pasaktësitë në mes të përmbajtjes konceptore dhe të formës së shprehur nëpërmjet emërtimeve për të bërë të mundur arritjen e identitetit si një harmonizim i plotë në mes të përmbajtjes konceptore dhe formës së shënjëzimit si dhe mundësimin të saktësimin të ndërkombëtarëzimit të termave. Një arsye tjetër se përse anglishtja mund të merret si gjuhë "burim" apo "gjuhë lider" është edhe sepse termat nga anglishtja shpesh shfaqen si "shënues të koncepteve ndërkombëtarisht të pranueshme", kështu që futja dhe integrimi i tyre në sistemin e fushës përkatëse mbështet sistemësinë në terminologji në formë e në përmbajtje. Terminologjia standardizohet nëpërmjet njësimin të koncepteve duke bërë përpykje për të harmonizuar formën (termin) me përmbajtjen (konceptin) për të bërë sa të jetë e mundur ofrimin e tyre. Në përgjithësi studimi i togfjalëshave emërtues në mënyrë krahasuese në disa gjuhë, ndihmon të përmirësohet cilësia e përkthimeve dhe mësimi efektiv i gjuhëve të huaja.

Si më poshtë, janë marrë si shembuj disa togfjalësha, që emërtojnë koncepte të reja me shtrirje ndërkombëtare të periudhës pas vitit 1990. Konceptet janë shpjeguar bazuar në përkufizimet e marra nga "Wikipedia" (free encyclopedia) "Enciklopedia e lirë" si dhe janë bazuar në shpeshhtësinë e përdorimit të këtyre koncepteve në media, nga specialistët e fushave përkatëse dhe deri në thjeshtëligjërime, sidomos në kohët e fundit. Emërtimi i këtyre koncepteve me togfjalësha emërtues dhe fjalë është studiuar në mënyrë krahasuese në tre gjuhë: shqipe, anglishte dhe ruseshte. Edhe pse janë marrë në studim gjuhët e mëdha, meqë është provuar që ato e bëjnë më mirë harmonizimin e formës me

³⁸⁰ E. Wuster, "Internationale Sprachnormung in der Technik", UDI, Berlin, 1931

përmbajtjen dhe merren si model standardizimi, mund të ndodhë që edhe një gjuhë e vogël të bëhet model standardizimi për një term apo grup termash të caktuar për arsye sepse kjo gjuhë mund të ofrojë standarde më efektive sesa gjuhët e mëdha në lidhje me standardizimin. Kundërvënia e njësive emërtuese njëfjalëshe dhe sidomos togfjalëshore në gjuhën shqipe, anglishte dhe rusishte është bërë duke patur parasysh tri tipare themelore:

Krahasime strukturore.

Krahasime strukturoro semantike.

Krahasime në nivel leksiko – gramatikor.

Është konsideruar po ashtu prania e njësisë emërtuese njëfjalëshe në gjuhën e huaj me barazvlerë njësi emërtuese togfjalëshore në gjuhën shqipe, prania e njësisë emërtuese njëfjalëshe në gjuhën shqipe me barazvlerës njësi emërtuese togfjalëshore në gjuhën e huaj, prania e njësisë togfjalëshore në gjuhën shqipe me barazvlerë njësi emërtuese njëfjalëshe në gjuhën e huaj, prania e njësive emërtuese togfjalëshore në gjuhën shqipe me barazvlerë njësi emërtuese togfjalëshore në gjuhën e huaj ku kemi rastet: barazvlera kuptimore e plotë apo e pjesëshme (e njërit element) apo e të dy elementeve të togfjalëshit, mungesë e barazvlerës kuptimore, zgjerimi apo ngushtimi i të kuptimit në njërin nga gjuhët, kur elementi i përcaktuar është i pabarabartë, prania apo jo e figuracionit, formimi leksiko gramatikor, shkalla e abstraksionit etj. Si më poshtë janë paraqitur situatat e kundërvënies së njësive njëfjalëshe dhe sidomos togfjalëshore në gjuhët e vëzhguara:

I. Krahasime strukturore

1. Njësi emërtuese njëfjalëshe në gjuhën e huaj me barazvlerë togfjalësh në gjuhën shqipe si në rastet: *наволочка* (rus.) → *këllef jastëku* (shqip); *thumb* (ang.) → *gisht i madh* (shq.); *coffeebreak* (ang.) → *pushim për kafe* (shq.)

2. Njësi emërtuese njëfjalëshe në gjuhën shqipe me barazvlerë togfjalësh në gjuhën e huaj si në rastet: *xhezve* (shq.) → *coffe pot* (ang.); *hekurudhë* (shq.) → *zheleznaia doroga* (rus.); *aeroplanmbajtës* (shqip) → *aircraft carrier* (ang.) *afat* (shq.) → *time limit* (ang.) etj.

3. Njësi emërtuese togfjalëshore në gjuhën shqipe me barazvlerë një fjalë në gjuhën e huaj si në rastet: *bono thesari* (shq.) → *bond* (ang.); *forca paqeruajtëse* (shq.) → *peacekeepers* (ang.) → *Миротворцы* (rus.); *punë në grup* (shq.) → *teamwork* (ang.); *gur kilometrazhi* (shq.) → *milestones* (ang.) etj.

II. Krahasime strukturoro semantike

Njësi emërtuese togfjalëshore në gjuhën shqipe me barazvlerësi ose pabarazvlerësi kuptimore në gjuhën e huaj. Problematikë nga forma e brendshme.

Në rastin e kundërvënies së togfjalëshave të qëndrueshëm kemi këto raste:

1. Prania e barazvlerësisë kuptimore (me forma të brendshme të njëjta në elementet e përcaktuar dhe përcaktues). Në këtë rast njësitë togfjalëshore emërtojnë të njëjtin koncept në të gjitha gjuhët e studiuara dhe në të njëjtën kohë si elementi i përcaktuar ashtu edhe elementi përcaktues kanë të njëjtën formë të brendshme: Tofgjalehat: “*mbledhje të hapura*” në shqipe, “*open meetings*” në anglishte dhe “*открытые собрания*” në rusishte; “*ngrohje globale*” në shqipe, “*global warming*” në anglishte, “*глобальное потепление*” në rusishte; “*faqet e verdha*” në shqipe, “*yellow pages*” në anglishte dhe “*Желтые страницы*”; “*barazi ekonomike*” në shqipe, “*economic equality*”

në anglishte “*экономическое равенство*” në ruseshte; “*Taksë mbi vlerën e shtuar TVSh*” në shqipe, “*A value added tax (VAT)*”, në anglishte “*Налог на добавленную стоимость (НДС)*”, në ruseshte; “*Карје shteti*” në shqipe, “*State capture*” në anglishte “*Захват государства*” në ruseshte, kanë barazvlerë të plotë të elementeve të përcaktuar dhe përcaktues. Në secilën gjuhë elementet e përcaktuar: “mbledhje” “ngrohje” “faqet”, “barazi”, “takse” dhe “kapje” dhe si dhe elementet përcaktues: “të hapura”, “globale”, “ekonomike”, “e verdha”, “mbi vlerën e shtuar” emërtojnë të njëjtat koncepte dhe në të njëjtën kohë togfjalëshat “Mbledhje të hapura”, “Ngrrohje globale”, “Barazi ekonomike”, “Faqet e verdha”, “Takse mbi vlerën e shtuar” dhe “Kapje shteti” si “koncepte rezultante” emërtojnë të njëjtat koncepte në të trea gjuhët e vëzhguara. Në të gjithë togfjalëshat e sipërpërmendur egziston harmonia e formës së brendshme. Prania e barazvlerës kuptimore (barazvlerës së plotë të elementeve të përcaktuar dhe përcaktues) gjendet po ashtu edhe në togfjalëshat si më poshtë: “Taksa e sheshtë” në shqipe, “A flat tax”, në anglishte dhe “Единый налог” në ruseshte; “Kartë krediti” në shqipe, “Credit card”, në anglishte dhe “Кредитная карта” në ruseshte; “Pasuri intelektuale” në shqipe, “Intellectual property”, në anglishte dhe “Интеллектуальная собственность” në ruseshte; “Projekt ndërkuftar” në shqipe, “Crossborder project”, në anglishte dhe “Трансграничный проект” në ruseshte; “Larje parash” në shqipe, “Money laundry”, në anglishte dhe “Отмывание денег” në ruseshte; “Trafikim njerëzor” në shqipe, “Human trafficking”, në anglishte dhe “Торговля людьми” në ruseshte; “Industria e seksit” në shqipe, “Sex Industry”, në anglishte dhe “Секс-индустрия” në ruseshte.

2. Prania e pabarazvlerësisë kuptimore të elementeve përbërës në njërin element
Elementi përcaktues është me formë të brendshme të ndryshme: p.sh. “red line” dhe “hot line”, ku “hot” dhe “red” kanë kuptim të ndryshëm, “linjë e kuqe” me “linjë e nxehtë” në këtë kontekst është i njëjtë. Togfjalëshat: “Linja e kuqe në shqipe”, “Hot line” në anglishte, “Служба горячей линии” në ruseshte; “Shplarje truri” në shqipe, “Brain washing” në anglishte dhe “Утечка мозгов” në ruseshte; “Qendër tregëtare në shqipe”, “Shopping center” në anglishte dhe “Торговый центр” në ruseshte kanë pabarazvlerë në njërin element të tyre dhe përkatësisht: në anglishte dhe ruseshte elementi përcaktues “e nxehtë” dallon nga gjuha shqipe ku si element përcaktues për elementin e përcaktuar “linjë” shërben “e kuqe”. Po kështu vërehet që në ruseshte togfjalëshi është i përbërë dhe si element i përcaktuar është “shërbimi (служба) dhe jo “linjë”. Në këtë rast lind nevoja e harmonizimit të formës së brendshme dhe besojmë që është pikërisht gjuha shqipe që duhet të përdorë “linjë e nxehtë” për të qënë në harmoni me gjuhët e tjera dhe për të bërë të mundur standardizimin e saktë të termit.

a) Elementi i përcaktuar e formë të brendshme të përafërt: Togfjalëshat: “Luftë klanesh” në shqipe, “Conflict between clans” në anglishte dhe “Конфликт между кланами” në ruseshte elementin e përcaktuar e kanë të pabarabartë dhe përkatësisht: në anglishte dhe ruseshte togfjalëshat janë të përbërë dhe kanë si element të përcaktuar fjalën “konflikt” ndërkohë që në gjuhën shqipe vërehet që elementi i përcaktuar është “luftë” që në kundërvënje me termin “konflikt” tregon për rritjen e nivelit të ashpërsisë nga “konflikt” në “luftë”. Edhe në këtë rast del nevoja e harmonizimit të formës së brendshme të termit në shqipe me gjuhët e tjera të studiuara. Togfjalëshi “luftë klanesh” është i konotuar dhe ngjan me termin “luftë klasash” që është përdorur kryesisht para vitit 1990.

Mbase është edhe "historia" e përdorimit të "luftë klasash" për një periudhë kohore 50 vjeçare që e ka bërë lehtësisht të përdorshëm elementin "luftë" në vend të "konflikt". Togfjalëshat "Pushteti i 4rt (media)" në shqipe" Forth Estate (Forth Power) në anglishte, Четвертая сила (власть) në rusishte kanë figuracion dhe është pikërisht elementi i përcaktuar "Pushteti" që është i konotuar në të trea gjuhët e vëzhguara. Në anglishte varianti zyrtar është "Forth Estate" por në të njëjtën kohë përdoret edhe varianti "Forth Power" si sinonim i këtij termi, që është edhe më i pranuar ndërkombëtarisht dhe e emërton dhe e identifikon më mirë konceptin. b) Ка пabarazvlerësi kuptimore në të dyja elementet si p.sh.: "brain drain" dhe "rrjedhje truri". Kjo pabarazvlerësi kuptimore vihet re në elementin përcaktues. Togfjalëshat: "prostitutë mbikqyrëse në shqipe", Bottom Bitch (girl, woman) në anglishte dhe "основная ложь" në rusishte kanë pabarazvlerësi kuptimore. Përkatesisht: elementi i përcaktuar "rrjedhje" është i ndryshëm me elementin e përcaktuar "tharje". Vihet re që në anglishte dhe rusishte elementet e përcaktuar janë të barabartë kanë të njëjtin kuptim "tharje" ndërkohë që në shqipe elementi i përcaktuar ka kuptimin "rrjedhje". Në togfjalëshin "prostitutë mbikqyrëse" vihet re i njëjti fenomen kur përballet me dy gjuhët e tjera të vëzhguara. Elementi përcaktues "mbikëqyrëse" nuk është i barabartë me elementet e përcaktues në dy gjuhët e tjera përkatësisht "e ulët" (bottom) në anglishte dhe "kryesore" (основная) në rusishte. Prania e pabarazvlerësisë gjendet edhe në togfjalëshat: "Krim i jakave të bardha" në shqipe, "White-collar crime", në anglishte dhe "Должностное преступление" në rusishte. Edhe në këtë rast sugjerohet standardizimi nëpërmjet harmonizimit të formës së brendshme të togfjalëshave në të trea gjuhët, edhe pse në këtë rast duket sikur koncepti emërtohet më mirë në shqipe dhe rusishte. Si bazë merret ajo gjuhë që e bën standardizimin më mirë.

III. Krahasime në nivel leksiko – gramatikor.

Togfjalëshat nga pikëpamja e formimit leksiko gramatikor:

Barazvlerësi leksiko gramatikore:

-Prania e raportit "emër + mbiemër" në gjuhët e vëzhguara: Togfjalëshat "qendër tregëtare", "punë vullnetare", "takse e sheshtë", "takse progresive" etj. përbëhen nga raporti "emër + mbiemër" në të tre gjuhët e studiuara.

-Prania e raportit "emër + emër" në gjuhët e vëzhguara: Togfjalëshat "industria e seksit", "kapje shteti", "larje parash" etj. përbëhen nga raporti "emër + emër" në të tre gjuhët e studiuara.

2) Pabarazvlerësi leksiko gramatikore Raportet leksiko gramatikore janë të pabarabarta në gjuhët e vëzhguara:

-Prania e raportit (emër + mbiemër) në shqipe dhe e raportit (ndajfolje + mbiemër) në anglishte dhe rusishte si në rastin analfabet funksional (emër + mbiemër) në shqipe, "functionally illiterate" (ndajfolje + mbiemër) në anglishte dhe "функционально неграмотный" (ndajfolje + mbiemër) në rusishte.

-Prania e njësisë emërtuese togfjalësh me dy elemente në shqipe dhe njësisë emërtuese togfjalësh të përbërë nga tre njësi në anglishte dhe rusishte si në rastet: "luftë klanesh" në shqipe ku është i pranishëm raporti "emër + emër" dhe "conflict between clans" apo "конфликт между кланами" që janë togfjalësha të përbërë dhe kanë të pranishëm raportin (emër + ndajfolje + emër) në anglishte dhe rusishte; "linjë e kuqe" në shqipe dhe "служба горячей линии" në rusishte etj.

Si përfundim: Nga sa parashtruam më sipër, për të çuar më tej studimin e ndërmarrë rreth problemit të trajtuar rekomandojmë:

-Të bëhen studime të thelluara krahasuese të emërtimeve togfjalëshore për gjuhët kryesore (anglishte, rusishte, gjermanishte, italishte, frengjishte, spanjishte etj) për të evidentuar rastet e përputhjes dhe të mos përputhjes së formës së brendshme si dhe për të siguruar saktësimin dhe diferencimin e shprehjes së koncepteve, si dhe krijuar një bazë për standardizimin ndërkombëtar si p.sh. pushteti i 4-rt me format e brendshme të njëjta.

-Të krijohet një model sistemor krahasimi shumë gjuhësor i emërtimeve të koncepteve të reja për të bërë të mundur që të shmanget sinonimia dhe të krijohet mundësia që për çdo koncept të ketë një emërtim në secilën gjuhë.

-Të hartohet një fjalor shumëgjuhësh me emërtimet togfjalëshore me njëra tjetren dhe në raport me gjegjesët e tyre njëfjalëshe të koncepteve të reja për të bërë të mundur përmirësimin e cilësisë në mësimin dhe mësimdhënien e gjuhëve të huaja si dhe për të përmirësuar cilësinë e përkthimeve.

Recensent:
Prof. Dr. Valter Memisha
Prof. Dr. Agron Duro

IMAGOLOGJIA, KRIJIMI I IMAZHIT DHE MIRAZHIT PËRMES SHKRIMIT LETRAR

Edelajda Cenaj- Çepa

Guidat, ditarët, manualët e udhëtimit të përdorura gjatë pelegrinazheve dhe udhëtimeve të ndryshme, nuk ishin vetëm një burim këshillash konkrete për udhëtarët por konservonin një dinjitet të tyrin letrar, interesant dhe nga pikëvështrimi krahasues, duke u kthyer kështu në “paraardhës” dhe një bazë e fortë për atë që më pas do të quhej ‘letërsia udhëpërshkruese’.

Veprat e para, të mirëfillta të letërsisë udhëpërshkruese, datojnë që në shek. XV-XVI, në kohën e ekspansionit të madh të europianëve drejtë tokave të reja e të panjohura, vepra këto që do të pasoheshin me të tjera, më elitare.

Letërsia udhëpërshkruese është një letërsi e cila është studiuar relativisht vonë, duke iu referuar, gjithmonë, kohës kur datojnë veprat e para që i përkasin asaj.

Fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX do të jenë periudha kur do të dalin në dritë studime serioze mbi letërsinë e krahasuar - dhe për pasojë, për imagologjinë si një nga rezultatet e mirëfillta të udhëpërshkrimit.

Mund të pranojmë se imagologjia dikur nuk njihte shumë drejtime apo shtrirje siç gëzon aktualisht. Përsa i përket imagologjisë tradicionale mund të tregojmë si parësorë elementë të tillë si: “ambienti”, “momenti” dhe “përbërja e popullsisë”, elementë këto që tërhiqnin më tepër vëmendjen e udhëtarit në mënyrë që të krijohej përshkrimi i parë mbi një komb të caktuar, për të ndërtuar më pas edhe detajet dhe njohjet më të gjera të jetës së tyre. Kështu nëse do të ndaleshim në periudhën e lufrave botërore, tek e dyta më saktësisht, njohja me “tjetrin” edhe në veprat e kësaj kohe ishte një “nevojë” që dominohej nga kriteri historik. Më pas është e vetëkuptueshme se falë influencës së popujve tek njëri-tjetri do të krijohej një këndvështrim i ri në letërsinë e krahasuar.

Aspektet e studimit, këndvështrimet, faktet që do të paraqiten në një vepër gjatë përballjes me tjetrin do të jenë natyrisht në harmoni të plotë me kohën së cilës ato i përkasin. Udhëtimet, përshkrimet, veprat model të atyre viteve sa vinin dhe largoheshin nga tradicionalja, për tu përmirësuar. Koncepte të reja ishin duke mbërritur gjatë studimeve letrare, të shkollave dhe studiuesve të ndryshëm. Një studim, i cili historiken e ndërthurte me artistiken për të krijuar një qëndrueshmëri disiplinash me njëra-tjetrën dhe për të tërhequr opinionin e gjerë publik drejt imagologjisë apo letërsisë së krahasuar. Të imagjinosh vende të tjerë, të formulosh gjykime mbi autorët e tjerë, të konfrontosh veten, të ndërmarësh aktivitete në një vend “tjetër”, janë një sërë reagimesh të provokuara nga takimi me turistin, me udhëtarin, pse jo dhe me imazhet televizive të realizuar po për të njëjtin qëllim.

Edhe letërsia luan një rol të rëndësishëm në formimin e këtij “imagjinari” që ka për objekt individët dhe vendet e rinj, të huaj për udhëtarin. Ajo është një burim “informacioni” i përhershëm, sugjestionues që edhe pse nuk vepron direkt, ushtron një influencë të padiskutueshme mbi mendimin tonë, për kombe e identitete të ndryshëm nga ne.

Letërsia, duke qenë se merret me të shkuarën transmeton tek ne imazhe, mendime, gjykime të shprehura në të gjitha kohërat dhe në të gjitha kulturat.

Edhe sot kur vendin e parë në komunikimin e imazheve, mendimeve e e përfaqësojnë mjete të tjera më të avancuara - si p.sh. interneti - qëllimi i letërsisë nuk zbehet aspak.

Paraqitja e vendeve të huaja në letërsi është shumë i vjetër si fenomen. Nevoja për t'i treguar një shoqërie të caktuar një realitet të ri, jashtë familjes, komunitetit, shtetit, do të përvijonte njohjen me të panjohurën, takimin e tërthortë me "tjetrin".

Për të vërtetuar keto që sapo thamë, mjafton të studiojmë manualët e Kristofor Kolombit ku përshkruhen "inigenët" e tokave që ai zbuloi, por mund të analizojmë edhe vepra letrare të shekullit tonë, të cilat krijojnë lidhje mes vizioneve që dalin prej tyre gjatë përshkrimit të "tjetrit" por edhe lidhjen me veprat antike ku "tjetri" sigurisht ishte edhe më i ndryshëm.

Analogjitë e krijuara kërkojnë të përcaktojnë më qartë kulturat, duke krijuar tek individit një ndërgjegjësim për një njohje të padiskutueshme me "tjetrin".

Është pikërisht ky qëllimi kryesor i imagologjisë.

Synimi është i qartë: përpjekja e vazhdueshme që tenton të studiojë çdo objekt të mundshëm letrar duke vënë në marrëdhënie me elementët e tjerë përbërës të një kulture.

Imagologjia, pra nënkupton studimin e imazheve, paragjykimeve, vlerësimeve, stereotipeve dhe në përgjithësi të opinioneve mbi popujt dhe kulturat e tyre që transmeton letërsia duke nisur nga bindja që këto imazhe kanë një rëndësi që e tejkalon faktin e pastër letrar.

Interesi më i madh dhe thelbësor i imagologjisë është të arrihet tek vlera ideale dhe perfekte që disa shfaqe të një vepre letrare mund të kenë, pikërisht prej faktit se aty konsiderohen më shyumë idetë që një autor ndan me ambientin.

Në të njëjtën kohë ai vë në krizë brënda vetes, apo shpesh të shprehur në vepër, vizionin për kulturën e tij dhe mënyrën sesi lidhet me të.

Të flasësh për të tjerët është gjithmonë një mënyrë për të zbuluar diçka nga vetja.

Në fund të fundit ekziston një lidhje varësie direkte apo indirekte mes teksteve që përmbajnë imazhe më të reja që kanë fituar tashmë një lloj karakteri harmonik në llojin e tyre.

Raste të tillë "harmonioziteti" mund të shkaktojnë nga njëra anë interpretime të idealizuara (mjafton të kujtojmë ndikimin e udhëtimit të Goethes në Itali mbi brezat e ardhshëm të shkrimtarëve, udhëtarëve, gjermanë ose jo), dhe nga ana tjetër të mëson si ushqehen opinionet negative për tjetrin të përvijuara më pas vetëm si mirazhe, të cilat shpesh përcaktojnë vlerësimin e një kulture tjetër si një kulture inferiore.

Takimi me "tjetrin" mund të sigurojë gjithmonë të papritura, aventura edhe kur nuk ndeshesh në rrugë direkte me të.

Të lexosh, të dëgjosh, të flasësh mbi një vepër të huaj do të thotë të kesh gjithmonë të bashkangjitur rrezikun për t'iu përgjigjur së pari një ligjërimi që është i huaj, e për më tepër t'iu përgjigjesh pyetjeve në situata shumë të pazakonta nga përballja me "tjetrin".

Të kapërcesh kombëtarin, atë pjesë që të takon dhe të ka takuar gjithmonë, për tu hedhur në krahët e së panjohurës, gjithmonë përmes letërsisë, përbën përherë e më tepër një sfidë.

Letërsia di të shkurtojë distancat, ta kthejë takimin me "tjetrin" në një aventurë të këndshme, të shoqëruar herë-herë nga "supremacia" e "tjetrit" e diku nga inferioritetet që të krijohen për të.

Vetëm në 20-vitet e fundit, me perspektivat metodologjike të hapura ndaj studimeve të zhanreve dhe të studimeve ndërkulturore, tekstet e udhëtimit janë futur në bashkësitë më të mëdha të teksteve kulturore. Në këtë mënyrë mund të lexohen në funksionin e tyre ideologjik, duke kërkuar detaje në dukje të parëndësishme por që përshkruajnë takimin me “tjetrin”, “supremacinë” e kulturave dominante që zakonisht udhëtari ndesh. Sot ne gjendemi në një moment rinovimi në ecurinë e letërsisë së udhëtimit dhe ndeshemi me një kujdes të madh gjatë përbaljes me të. Këtë e demostrojnë vepra të botuara dhe projekte të tjerë në zhvillim.

Udhëtimi është objekt i vëmendjes së zhanreve të ndryshëm; historikë, shkencorë, por edhe i një lloji të ndryshëm siç është turizmi.

Një nga problemet më të mëdha që shqetësojnë studiuesit sot është pyetja nëse në letërsinë udhëpërshkruese duhet të përfshihen edhe ditaret, manualët e udhëtimit apo guidat turistike të hasura më shpesh dikur.

Mendimet klasifikuese dhe toriko-letrare mbi këtë çështje, natyrisht, janë të ndryshme.

Letërsia e udhëtimit përpos të tjerave është një zhanër i cili mbështetet dhe vepron me zhanret e tjerë me të cilët formon kufinj vazhdimisht të lëvizshëm.

Pra, letërsia e udhëtimit mund të cilësohet në kuptimin e plotë si një pikënisje e krijimit të disiplinave të reja, ku mund të përmenden revolucionet e udhëtimeve të viteve 1500 që për herë të parë hapën edhe horizonte gjeografike shumë më të gjërë dhe më komplekse.

Por, letërsia e udhëtimit edhe për vetë natyrën e saj i kapërcen kufijtë e ndryshimeve. Madje është pikërisht ky karakteri i saj i parë, të kapërcejë kufinj të parë çfarë ka tjetër, të përbalë me njëra-tjetrën të brëndshmen me të jashtmen, të përkthejë dhe të interpretojë takimin me “tjetrin”.

Është pikërisht kjo pika më e rëndësishme e kontaktit në letërsinë e krahasuar që me mjete kritike, të ndryshme, bën ekzaktësisht të njëjtën gjë: sheh gjithçka dhe më pas krahason. Mund të thuhet se ky është qëllimi vendimtar i saj.

Takimi me “tjetrin” synon apo paraqet një simbiozë të një pritmërie, duke formuar kështu një imazh me të cilin “tjetri” dhe gjithçka përreth tij janë përkufizuar dhe përshkruar.

Si në letërsinë udhëpërshkruese tradicionale edhe në atë të kohëve të sotme, ditari mbetet forma më e lëvruar nga autorët për të krijuar strukturën e veprave të tyre.

Dikur ditaret, epistolarët, përkthimet nuk studioheshin si objekte letrare në vetvete, por thjeshtë si ndërmjetës, si pika të rastësishme kontakti midis shfaqeve kulturore të ndryshme.

Ndërsa sot ato janë të sistemuar në vendin që u takon.

Duke arritur në përfundim mund të themi se sot letërsia udhëpërshkruese prezanton në fakt një kuadër të rëndësishëm të komunikimit ndërkombëtar dhe ndërkulturore, si në mënyrën e prodhimit të veprave të reja, si dhe në interesin e publikut gjithmonë e në rritje.

Pra, letërsia e udhëtimit nuk ka si mision të vetëm të tregojë mbi vende të huaja, por në disa aspekte ajo aspirojnë edhe nderkombtarizimin apo ‘interkulturalitetin’ siç përdoret shpesh në manualët e ‘letërsisë së udhëtimit’.

TRONDITJA E MITIT TË BESËS TEK VEPRAT E KADARESË: “KUSH E SOLLI DORUNTINËN”, “PRILLI I THYER” DHE “URA ME TRI HARQE”

Edlira Çerkezi

Universiteti “Ismail Qemali”, Vlore

Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë

Në botën e letrave shqiptare, bashkëkohore ka një vlerësim të gjithëpranuar, që dëshmon pa asnjë mëdyshje se Ismail Kadare është figura më e ndritur e kulturës sonë kombëtare, është kryeambasadori i saj kudo në botë. Kadare është shkrimtari brilant që mjeshtërisht i ktheu mitet dhe legjendat në realitet. Është autori zëmadh që bëri histori moderne prej prehistorisë pa rënë në kundërthënie me vetveten. Në Shqipërinë e udhëkryqeve dramatike vepra e Kadaresë mbeti për të gjitha kohët një shpresë e gjallë dhe një ogur i mirë.

Dimensionet madhore kombëtare të Kadaresë i konfirmon fakti se shumicën e kryeveprave, veçmas në prozë, i ka shkruar nën peshën e censurës së egër të diktaturës komuniste duke provuar në mënyrë të pakundërshtrueshme mendimin se gjenitë e vërtetë mund të shkruajnë kryevepra edhe nën diktaturën më të frikshme. Të tilla janë vlerësuar edhe veprat: “Kush e solli Doruntinën”, “Prilli i thyer” 1977, “Ura me tri harqe” 1978, “Kështjella” 1967, “Nëpunësi i pallatit të ëndrrave” etj.

Si autor i temave të mëdha letrare, duket sikur Kadareja iu largua shqetësimeve, dramave dhe tensioneve të ditës sa prej të qenit një antikonformist ekzigjentë, aq edhe për të shmangur asgjësimin artistik dhe fizik të diktaturës. E vërteta nuk është kështu. Një shkrimtar i madh është njëherësh edhe një burrë i mençur. Si i tillë Kadareja jetoi me brengat dhe fatin e mbrapshtë historik të popullit të vetë.

Veprat e tij u ngjizën me lëndën dhe brumin jetësor, me lëngun e hidhur të jetës së gjymtuar të popullit shqiptar. Kadare e mori mbi vete në mënyrë permanente riskun e rrezikut të demaskimit dhe të asgjësimit. Le të kujtojmë rrethanat e trazuara kur autori u dyshua, u këndërshtua shpesh herë për vepra të ndryshme. Por Kadareja ja doli. Ai mbijetoi për të mirën e vet, të shqiptarëve dhe gjithë njerëzimit. Kjo mrekulli ndodhi kryesisht për shkak se shkrimtari përdori në mënyrë perfekte, si rrallë kush, alegorinë për transmetimin e ideve të mëdha dhe të mesazheve opONENTE shumëplanëshe.

Gjuha e përdorur prej tij ishte gjuha mjeshtërore e alegorisë dhe e simbolit që përbënin kodin e fshehtë të shkrimit dhe të ligjërimit të tij. E vërteta është se jo vetëm lexuesi elitar, por edhe ai i nivelit mesatar arrinte të dëshifronte palimpsestin ideor, kontekstin e dyfishtë të teksteve kadareiane dhe të mesazheve që përcillte.

Sigurisht, mënyra se si perceptohej dhe përjetohej realiteti që zbulohet në vepra është një çështje më vete. Për t'i qëndruar në kokë të temës, na duhet të theksojmë se Kadare, për

të realizuar idealet e veta të shkrimtarit dhe të misionarit bashkëkohor zgjodhi të operojë veç të tjerash edhe me mitin e besës, të cilin e tronditi skajshëm me interpretimin e tërthortë që realizoi.

Tek veprat e sipërcituara në krye të punimit, duke evokuar mitin e ringjalljes së vëllait të vdekur (siç ndodhi me Krishtin), Kadare shtronte domosdoshmërinë e ringjalljes së Shqipërisë, të mbërthyer nga darët vrasëse të diktaturës komuniste me arsyetimin se Shqipëria, shumë më herët kishte komunikuar gjerësisht me Europën, qysh atehere kur Doruntina ishte martuar tutje, larg, në Europën Qëndrore.

Kadare, në vepër shtron për zgjidhje shkallmimin e mureve të izolimit fatal nga Europa. Ndërkohë duke operuar me besën si institucion i fjalës së dhënë, i fjalës së mbajtur nga vëllai i vogël, i vdekur ndaj nënës për t'i sjellë motrën e martuar shumë larg si dhe duke intriguar me figurën e hetuesit, Stresit, për zgjidhjen e misterit se kush pra e solli Doruntinën, autori i përcjell lexuesit idenë, mesazhin se lidërsipi i pushtetit diktatorial e shkeli me këmbë premtimin, fjalën e dhënë, besën e shpallur gjatë LANCI-it” *Se pas Çlirimit, populli shqiptar do të vendoste i lirë sistemin e qeverisjes për të qenë i lumtur, për të realizuar amanetin e mijëra djemeve, vajzave, burrave dhe grave që u gjakosën dhe u flijuan për një të ardhme të bukur*”

Fjala që ngre edhe të vdekurin nga varri është “besa”. Këtë pushtet të madhërishtëm na e kumton balada e shkëlqyer e Konstandinit dhe e Doruntinës. Një baladë e cila ka mbijetuar në shekuj në variante të ndryshme, në popuj të ndryshëm. Qëllimi pse e zgjodhi këtë baladë Kadare është se donte që ta transliteronte në një prozë realiste. Si çdo vepër letrare edhe “Kush e solli Doruntinën” ka një strukturë dhe një ecuri të vetën që e dallojnë nga veprat e tjera dhe vënë në pah origjinalitetin e saj. Teknika e saj nuk është gjë tjetër vecse lindja e një enigme dhe përpjekjet e zbrërthimit të saj. Siç dihet enigma e romanit është kjo: “Kush e solli Doruntinën nga Bohemia në katundin e saj?

Kjo pyetje qëndron e nderur që nga faqa e parë e romanit e deri në fund. Rruga që përshkon enigma nga koha që kur shfaqet si fantazmë e derisa largohet si një dritë vezulluese është e mundimshme dhe e spërdredhur. Stresi, kapiteni simpatik, i zgjuar, tepër i aftë dhe këmbëngulës, i nderuar, i respektuar nga populli për punët e shkëlqyera që ka bërë për popullin parashikon të gjitha variantet e mundshme se kush e ka sjellë Doruntinën. Hipotezat janë të shumta. Ai që e ka sjellë mund të jetë: një mashtrues, një vagabond, ose një armik i familjes Vranaj, ose ajo e pabesueshmja Konstandini. Stresi i heton këto mundësi dhe pasi bindet për pavërtetësinë e tyre i flak që të gjitha. Dyshimet i lindin që në momentin kur dëgjon dëshminë e shitësit të ikonave sepse njëherë e pohon se ka sjellë Doruntinën dhe njëherë pohon se nuk e ka sjellë. Ringjallja e një të vdekuri nxori në shesh dhe qëndrimin opozitar të kishës.

Kundërvënia e saj ishte më e madhe për thashethemet se mund të egzistonte një njeri tjetër i barabartë me Krishtin sesa për çështjen e besës. Teknikat e zbrërthimit të enigmës shfaqen në një mënyrë të tillë që, sa më shumë kalon koha aq më shumë enigma sqarohet por edhe ngatërrohet. Atëherë kur asaj po i vinte fundi shfaqen dy kushurinjtë e burrit të Doruntinës, të cilët hedhin një vello dyshimi se kemi të bëjmë me një aventurë dashurie. Hetimet e ndryshme në vepër janë bërë për të shtuar dhe për ta mbajtur gjallë interesin e lexuesit.

Çdo gjë në roman duket sikur Kadare e ka trajtuar me një qëllim të caktuar. Duke filluar që nga tematika, duke vazhduar me mënyrën e trajtimit të saj, ngritjes së pikpyetjeve, shtimit të mistereve dhe të papriturës e deri tek atë çka personazhet shprehin me fjalët

dhe veprimet e tyre. Për këtë arsye kritika letrare ka pasur shumë kundërshti për botimin e kësaj vepre.

Martesa e largët është një çështje që është prekur jo pa shkak nga Kadare. Nëntë vëllezërit vendosin, kundër traditës së deriatëhershme të vendit, ta martojnë motrën e tyre të vetme në Bohemi, thellë në Evropë, atje ku zhvillohej lufta e shenjtë njëqindvjeçare, në një botë të largët, ku kishte popuj të fismë, të cilët, duke pranuar këtë krushqi të padëgjuar, faktikisht do të pranonin të bëheshin aleatë të arbanëve, një popull që ndodhej përballë rreziqeve të popujve që kohës.

. Me anë të kësaj Kadare kërkonte hapjen e jo mbylljen dhe izolimin e popullit shqiptar. Doruntina e pranon fatin e saj pa e kundërshtuar atë, ashtu si populli shqiptar i cili qëndronte i nënshtruar ndaj vendimive të një shteti izolu.

Në vepër Ismail Kadare e paraqit Kostandinin, sikur donte që ta përdorte besën, si institucion dokësor, si boshtin e ndërtimit të një modeli të ri politik dhe social për shoqërinë dhe popullin arbër, të ndryshëm nga modelet që ofronte Lindja dhe Perëndimi, të cilat Kostandini i gjen si të papranueshme dhe të rrezikshme. Pikpamjet e Konstandinit shfaqen në vepër në fjalët e shokëve të tij. Këtu kemi të bëjmë me një transferim në kohë të paradigmës politiko-kulturale zyrtare të Shqipërisë së kohës kur shkruante Ismail Kadare.

Paradigmës së armiqësisë ndaj Lindjes dhe Perëndimit, refuzimit të modeleve të tyre dhe të përpunimit të modelit politik, social e kultural ekskluziv shqiptar, krejt të painfluencuar nga modelet lindore dhe perëndimore. Ajo që synon të thotë Kadare është se, ashtu sikur Arbëria e kohës së Kostandinit nuk zgjodhi as modeli perëndimor, as atë lindor, por përpunoi një model shoqëror shpirtëror të vetin me kodin e vet dokësor, ashtu dhe Shqipëria e kohës së komunizmit, kur shkruante Kadare, duke ndjekur traditën e mësipërme arbëre, nuk po zgjedh as modelin kapitalist perëndimor, as atë lindor, por po e modelon shoqërinë dhe krejt jetën e vendit sipas një modeli ekskluziv shqiptar.

Tendenca për analogji duket që nga termat dhe deri tek konceptet që përdorin shokët e Kostandinit dhe kapiteni Stres. Me sa duket Kadare pretendon se arbërit e kohës do ta zëvendësonin shtetin që ende nuk e patën ndërtuar me një kod zakonor me bazë besën. Pra Kadare e kthen përmbys kursin e gjërave. Ndërsa në realitet korpusi i normave dokësore me bazë besën është krijuar në periudhën parashtetërore, prehistorike të organizimit shoqëror fisnor, Kadare i paraqet gjërat sikur normat dokësore do të krijoheshin pas shtetit, në kushtet kur ka parandjenjë të rrezikut të shembjes së shtetit.

Në këtë mënyrë Kadare i drejtohej lexuesit të vëmendshëm për diçka thelbësore, gati të shenjtë siç ishte besa, që klasifikohej si "purteka e arit" qysh mijëra vjet më parë. Imagjinoni guximin qytetar dhe artistik të shkrimtarit tonë që pretendon hapjen e Shqipërisë si dikur. Doruntina ishte martuar në kërthizë të Europës Perëndimore, ndërkohë që për Shqipërinë komuniste martesa me një të huaj konsiderohej tradhëti ndaj atdheut. Rrëngjethesh po të kujtosh divorcet e dhunshme, kriminale të qindra e mijëra burrave dhe prindërve të martuar me gra ruse, hungareze, polake, çeke, gjermane etj.

Përmes shtresëzimeve disakuptimeshe që autori krijon, arrin të shpërfaq guximshëm luftën çnjerëzore ndërmjet Lindjes Komuniste dhe Perëndimit Demokratik. Interesant është edhe fakti që Kadare, me modelin e shtetit të Arbrit të dikurshëm provoi se shqiptari nuk zgjodhi as modelin lindor, as atë perëndimor, por për të keqen e vet edhe

në kohën e shkrimit e botimit të veprës, klasa politike shqiptare e modeloi Shqipërinë, shoqërinë, gjithë jetën e vendit sipas një modeli tipik shqiptar të pangjashëm me asnjë vend tjetër të botës të asaj kohe.

Përfaqset mes njeriut të besës – Kostandinin dhe “njeriut të ri” të Partisë s’janë gje tjetër veçse njëjtësimi i së keqes. Sot ne, në themi se diktatura e djeshme, në vend të “njeriut të ri” krijoi domethënë “njeriun e tjetërsuar”, të depersonalizuar, të rrënuar komplet ose siç i thërriste Kadare “maska të kohës”. Ajo që duam të nënvizojmë është se, mesazhi thëlbësor që na vjen nga vepra është vetë ai që buron nga miti, legjenda, i cili nuk gjendet i shprehur vetëm në faqet e fundit të librit, por në të gjitha faqet që thurin në mënyrë solide subjektin që të rrëmben maksimalisht.

Në mbyllje të librit autori vendos në gojë të Stresit këto fjalë: “Unë e shpall dhe e rishpall se Doruntinën nuk e solli askush tjetër veçse vëllai i saj, Kostandini”, d.m.th fjala e dhënë e tij, besa e tij. Këndej lexuesi nxjerr disa konkluzione.

Së pari: Nuk ka pengesa, barikada e vështirësi që të ndalojë një popull evropian në shek e XX për të gjetur rrugëdalje në udhën e vete drejt lirisë dhe demokracisë, begatisë dhe prosperitetit.

Së dyti: Të kërkojmë mbajtjen e fjalës së dhënë, besës së premtuar qysh në luftën e paguar me gjak.

Së treti: Të mos e bjerrim institucionin e besës ndër shqiptarë, sepse ajo duhet të trashëgohet tek ata si kod moral e shoqëror, shumë i rëndësishëm.

Kadare, duke përcjell këto mesazhe, sado alegorike e të nenkuptuara, s’ka bërë gjë tjetër veçse me fjalën besë në mendje e në zemër ka luajtur me nentekstn sesa me kontekstin. Atehere, natyrshëm më lind pyetja: Si mund të tronditej ndryshe dhe më fortë miti i besës ndër shqiptarët e gjysmës së dytë të shekullit XX?

Ne novelen “Prilli i thyer” mitin e shohim si nje realitet kuazifiksional. Ndoshta kjo mund te tingelloje si e cuditshme, sepse ne nuk po flasim per mitologji greke, apo per nje kohe tjetere te lashte. Ne po flasim per nje kohe tjetere, per vite te tjera, por qe pjese e te cilave jane edhe keto mite.

Pra mund te shohim menyren se si miti ka ardhur dhe eshte bere pjese e kohes, me ane te kujt dhe si? Njeriu dhe ruajtja e tradites, e vlerave e kane sjelle mitin me afer nesh. Keshtu qe, mund te themi se miti vjen si nje realitet te cilin ne mundem ta shihnim nepermjet kodeve kanunore, ne novel.

Ne nuk jemi duke diskutuar per mitin e coca colesduke e pare ate ne dimensione te ndryshme, si psh. ate te ngjyres se kuqe e cila ishte dicka qe vihej re dukshem nga njerzit te cilet u njohen me te ne vitet tranzit, ne shqiperi. Nese ne sot do ta shihnim mitin brenda ne novel, ne keto dimensione, atehere do te ishim personi i jashtem, i larget, ashtu sic eshte lexuesi i jashtem, ai qe nuk ishte rritur me kanunin. Keshtu edhe ne nuk jemi personat e pare qe e shohim kete mit(kanunin), as personazhet e noveles nuk jane vendosur ne kete situatë. Jane te tjeret, ata qe kane jetuar shume me pare se ne, se personazhet.

Eshte theksuar edhe ne nje prej pikave te kesaj teze, se Kadare eshte nje percjelles i mire i realitetit Cdo gje te pare, cdo ndjesi, ai mundohet ta sjelle ashtu, ne menyre reale, qe ta beje lexuesin te ndihet me afer asaj qe lexon, me afer me kohen, me personazhin. Por Kadare kete realitet, kete mit, e sjell si nje fikSION. Them qe e sjell te tille sepse e tille ishte, jo vetem reale, por edhe tmerruese, absurde, e ashper. Kjo te ben te mendosh se miti ne kete novel eshte si nje realitet fikSIONAL. Dhe eshte gabim te them se nje fikSION i tille eshte teresisht i plote, sepse ai nuk eshte. Jo me kot une theksoj qysh ne vete emertimin e ceshtjes, se ky realitet ehste kuazifikSIONAL, sepse gjerat keshtu jane nderthurur.

Nje element i tille eshte miti, nderthurja e tij me vargun dhe fymen bashkekohore te autorit. Kadare ka ardhur si nje pervesues mjaft i mire i estetikes kulturore, me nje sere motivesh dhe figurash poetike. Kur trajtuam mitin si nje realitet kuazifikSIONAL, e pame ate edhe ne raport me

paraletersine. Ne kete menyre e pame edhe Kadarene. Duke shfrytezuar poezine popullore, perfsihijen e nje bote motivore e figurash poetike, baladen, sigurisht edhe mitin, Kadare ka vendosur lidhje me paraletersine. Ne raport me kete ai eshte gjendur ne shfrytezimin e nje lende mitologjike.

Tek vepra "Prilli i thyer", Kadare operon me fenomenin e gjakmarrjes qe shënon plagën më therëse të shqiptarëve të të gjitha kohëve. Gjakmarrja është sjell në faqet e veprës si një kuçedër qe vjen deri në ditët e sotme përmes zgafellave të errëta të jetës shqiptare qe prej mijëra vjetësh. Alegorikisht autori paralajmëron se përbindëshi nuk është zhdukur. Ai fle këtu nën këmbët e shqiptarëve, i gatshëm të vrasë tmerrshëm si dikur. Kadare i kundërvihet kështu iluzionit dhe të pavërtetës, se gjoja diktatura komuniste e shpëtoi përfundimisht shoqërinë shqiptare nga mënyra e të bërit drejtësi përmes gjakmarrjes.

Koha e vërtetoi katërcipërisht këtë intuete zhbiruese të shkrimtarit. Do të duheshin vetëm 10 – 15 vjet të tjerë pas botimit te librit, qe kuçedra gjakpirëse të zgjohej, qe "këmishat e bardha", të gjakosura të vareshin në shtëpitë shqiptare në pritje të marrjes së gjakut. Ky fenomen është i lashtë, më i hershëm se "Kanuni i Lek Dukagjinit". Gjakmarrja është produkt mizor i shpagimit në shoqëritë primitive. Ajo është një mënyrë e caktuar e të bërit drejtësi. Por dihet se kjo lloj drejtësie nuk prodhon drejtësi, përkundrazi. Ajo është barbare dhe primitive.

Mustafa Kruja, në letrën e vitit 1950, dërguar Paulin Margjokajt shkruan; "*Gjaku asht shpagimi ma mizor i një drejtësie barbare*". Sipas zakonit kanunor individi dhe jo shteti, dhunës, gjakut duhet t'i përgjigjet me gjak, duhet të shpaguehet me gjak, ndërsa nderi duhet shpërblyer me nder. Fataliteti qëndron në faktin se në rastet jetësore zbatimi ishte i verbër, sepse nuk merrreshin absolutisht parasysh rrethana, shkaqe dhe faktorë qe ndikonin drejtpërsdrejti në këtë apo atë rast dhune qe ishte ushtruar si vrasje e pastër, tërësisht e qëllimshme.

Theksuam se Kadare e sposton subjektin në kohë për ta aktualizuar atë nëpërmjet alegorisë dhe simbolikës. Gjorgu, personazhi bazik i novelës përjeton një dramë rrëngjethëse deri në çastin e kryerjes së aktit të tmerrshëm të marrjes së gjakut të vëllait të vrasë, madje edhe pas aktit tmerrues të vrasjes. Duke gjykuar se vetëm puna e ndritur e një kapaciteti artistik gjenial me emrin Kadare, mund te depërtojë deri në skutat më të fshehta e më drithëruese të shpirtit njerëzor duke i sjell lexuesit stermundimet, vuajtjet, përplasjet dhe dilemat shekspiriane mitike të djaloshit Gjorg, të përfshirë nga igranazhet vrasës të Kanunit Shqiptar.

Veçanërisht sot, "Prilli i thyer" vjen si një këmbanë e stërmadhe mitologjike qe burbullon me lemeri duke i kërkuar shoqërisë ta shkule nga rrënjët gjakmarrjen për ta bërë drejtësinë me ligje demokratike, me frymë demokratike dhe me vizione demokratike. Ajo qe Kadare deklaroi me zë të fuqishëm nëpërmjet alegorisë së tij gjatë viteve 60-70 ishte: Ndal krimeve komuniste! Ndal drejtësisë së mbarsur nga propaganda dhe ideologjia komuniste tipike shqiptare! Ndal izolimit fatal të vendit! Përsëri kemi të drejtë të themi se Kadare na tronditi me interpretimin dhe shpjegimin e mitit të gjakmarrjes, i cili edhe sot, më shumë se kurrë vret mizorisht njerëz, madje edhe femije, në Shqipërinë tonë të vogël.

Një vepër tjetër qe tronditi mitin e besës është edhe novela "Ura me tri harqe", veçse këtu autori rrok vertikalisht dhe drejtpërsdrejti çështjen madhore të izolimit historik të Shqipërisë. Edhe pak më parë tek romani "Kështjella" 1967, autori goditi mu në zemër fatalitetin e izolimit total të vendit tonë. Simbolikën e kështjellës, autori e solli edhe me

imazhin e qëndresës, por ajo që tërthorazi donte të nënvizonte ishte se kështjella (Shqipëria) dhe kështjellarët (shqiptarët) sado të fortë dhe legjendarë të ishin gjithsesi mbeten të zënë për fyti nga metastazat kanceroze të izolimit fatal dhe total. Ata kishin mbetur vetëm përballë botës tjetër me demokraci të vërtetë.

Shqiptarët historikisht kanë qenë të mbyllur, të izoluar. Ata, mbase jo gjithmonë për faj të tyre, nuk kanë mundur të gjejnë miq besnike në mënyrë permanente. Shqiptarët nuk kanë mundur t'i ngrenë urat e qëndrueshme të miqësisë me popujt fqinj etj. Shqiptarët ose i kanë prishur vet miqësitë e tyre, ose në shumicën e rasteve janë prerë në besë prej të tjerëve. Le të kujtojmë tri miqësitë "e mëdha", të dështuara në mënyrë skandaloze dhe ironikisht spektakolare me jugosllavët, rusët dhe kinezët gjatë mesit dhe gjysmës së dytë të shekullit XX.

"Ura me tri harqe", mbart brenda saj përpjekjen për të siguruar hapjen drejt Europës, por edhe dyshimin mundues për "të këqijat e saj". Logjika e kohës që vepronte ishte se përmes urës kalojnë miqtë, por tek e fundit mbi të mund të kalojnë edhe ushtarët e kalorësit armiq. Në vepër, thelbësor është mesazhi i fshehur i saj sipas të cilit është domosdoshmëri historike hapja e Shqipërisë ndaj Evropës dhe botës demokratike kryesisht perëndimore.

Së fundi nënvizojmë mendimin se Ismail Kadare, me operacionet e veta letrare të këtyre tri veprave, sikurse edhe në mjaft të tjera tronditi thellë mitin e besës, të gjakmarrjes dhe të izolimit duke i aktualizuar ato me realitetin dramatik të kohës, duke dhënë kështu një kontribut të çmuar e të pakrahasueshëm për kulturën dhe letërsinë shqiptare. Të tria veprat e sipërcituara janë margaritarë vezullues në gjerdanin mrekullues të krijimtarisë Kadareane.

BIBLIOGRAFI

Bibliografi

Andre Clavel, "Histori e letersise evropiane

Teoria e vepres letrare", "Poetika", Toena, Tirane, 2006.

At Shtjefen Gjeçev, "Kanuni i Leke Dukagjinit", Botime Franceskane, Shkoder, 2010.

W.Rene, W.Austin, "Teoria e letersise", Onufri, Tirane, 2007.

D.Jorgji, V.Musa, C.Ymer, "Letersia 4", SHBLSH, Tirane, 2003.

Gace .Bardhosh, "Perkime poetike", Triptik, Tirane, 2006.

Aristoteli, "Poetika ", Cabej, Tirane, 2006.

SHKRIMET KRITIKE TË REXHEP QOSES, METODA KRAHASUESE DHE GJURMË TË INETERTEKSTUALITETIT

Edlira Gugu

Universiteti "Aleksandër Xhuvani"

Elbasan, Shqipëri

E-mail: eqojdeshi@gmail.com

Abstrakt

Punimi merr në konsideratë disa nga veprat kritike letrare dhe shkrimet historike letrare të Rexhep Qoses. Duke iu referuar metodave të përdorura prej prof Qoses, punimi tenton të evidenojë karakteristika të këtyre metodave dhe njëkohësisht t'i shohë ato nën një dritë të re. Në pjesën më të madhe të shkrimeve të prof Qoses evidentohet metoda krahasuese e cila vendos në thelb konceptin e ndërtekstorësisë sipas të cilit, teksti duke u vendosur në dialog me tradita vendase dhe ato të huaja shihet si një ndërthurje teskstesh paraardhëse. Në këtë mënyrë mundëson njohjen e vlerave të vecanta të shkrimtarëve të ndryshëm, të origjinalitetit, rrezën dhe fuqinë e ndikimit nga vepra të tjera pararendëse. Duke ndriçuar dhe komentuar huazime të vetëdijshme prof Qosja mundëson një interpretim specifik të tyre dhe njëkohësisht përgatit rrugën e sintezave të procesit të evolimit historic të letërsisë kombëtare në një periudhë të caktuar. Në koherence me diskutimet e sotme të cilat pohojnë se intertekstualiteti është element kyç për të kuptuar letërsinë në përgjithësi, tentohet të hidhet një hipotezë se në shkrimet e tij, prof Qosja shfaq gjurmë edhe të intertekstualitetit në përpjekje për të zbuluar veçori të përgjithshme të estetikës së poetikës së shkrimtarëve, veprat e të cilëve merr në konsideratë studimi.

Fjalë kyç : Kritika letrare, metoda, intertekstualitet, estetike e poetikes, histori e letërsisë.

Kritika letrare është një nga fushat e aktivitetit krijues të R Qoses, që në të vërtetë lidhet ngushtë me punën e tij si historian i letërsisë. I orientuar prej kohësh jo thjesht në njohjen e vlerave dhe specifikave të letërsisë shqiptar, por sidomos në njohjen e *ligjësive* të zhvillimit historik të saj, tipar metodologjik i punës së këtij studiuesi mbetet gërshetimi i qasjeve të ndryshme, sa kontekstuale, aq edhe formaliste-stilistikore, çka i ka dhënë mundësi të shpjegojë prirjet dhe veçoritë e procesit letrar, historik apo bashkëkohor.

Dihet se kritika letrare, si një nga prirjet e tij studimore, është shtrirë, sa në plan sinkronik, aq edhe e gërshetuar me vështrimin diakronik; kjo vihet re sidomos në studime e monografi mbi traditën letrare shqipe. Në këtë trajtim të shkurtër kemi zgjedhur të përqendrohemi vetëm në dy studimet monografike, të titulluara përkatësisht : "Asdreni , jeta dhe vepra e tij" dhe "Porosia e madhe". Kjo përzgjedhje është bërë jo

pa qëllim, pasi veprat, për shkak të natyrës së tyre studimore komplekse, reflektojnë më dukshëm llojin e kritikës dhe metodës që aplikon studiuesi.

Në kritikën e R. Qosjes merr kuptim të plotë natyra dyfishe e kritikës: pasi evidentohet dukshëm statusi njohës e vlerësues i saj. Aplikon vështrimin së jashtmi dhe vështrimin së brendshmi artistik të veprës letrare, duke klasifikuar kritikën e tij në vetëdije të plotë si praktikë e aplikim i estetikës pozitiviste por historiko-kulturore. Në të dyja monografitë e sipërpermendura R Qosja ndjek këtë praktikë. Ato ndahen në dy pjesë kryesore: tek monografia e Asdrenit pjesa e I interpreton jetën dhe veprimtarinë politike, sociale dhe kulturore të tij. Monografia e Naimit e gëzon një ndarje të tillë, por me një ndryshim nis me një kronologji të jetës së Naimit dhe pjesa e parë emërtohet “Kultura e tij” duke mos u marrë në mënyrë të detajuar me aktivitetin dhe veprimtarinë politike a sociale të autorit.

Tek monografia mbi Asdrenin të dhënat biografike dhe ato psikologjike bëjnë të mundur të kuptohet psikologjia e autorit për të rendur drejt kuptimit të veprës së tij. Në parathënien e veprës autori justifikon këtë zgjedhje të tij për të hulumtuar veprën e Asdrenit pasi pranon që në shkrimet kritike dhe në historiografinë letrare të kohës mungonin gjykime shkencore mbi krijimtarinë poetike të Asdrenit, si për vlerën e saj artistike dhe për vendin e saj në letërsinë shqipe³⁸¹.

Te studimi mbi Naim Frashërin nuk kemi të njëjtën qasje, për të vëzhguar jetën e tij në mënyrë të shkëputur, por kjo bëhet në mënyrë të integruar, brenda pjesës së parë të emërtuar “Kultura e tij”.³⁸² Sigurisht Qosja si studiues, kritik dhe historian, nuk e sheh jetën e poetit të shkëputur nga vepra, duke i qendruar pranë, deri në një fare mase, pikëpamjes historiko-kulturore të Hipolit Tenit, i cili pohonte se “historia e letersise duhet t’i studiojë veprat letrare si shprehje e personave njerez te vecantë, të cilët duhet të kuptohen si rezultat i cilësive racore (cilesive kombetare) dhe ndikimit në të të mjedisit shoqëror”³⁸³. Tek studimi mbi Naimn kjo pikëpamje metodologjike vjen e integruar dhe pothuajse çdo çështje, e lidhur me zhvillimin e kulturës së tij, paraprihet nga një kontekst historik e shoqëror, duke e parë si proces të natyrshëm në të cilin merr kuptim gjithë krijimtaria e tij.

Kritika pozitiviste që përdor R Qosja për t’u qasur veprës së Asdrenit dhe Naimit gërshetohet me *metodën krahasuese*. Kjo mënyrë i krijon mundësi R. Qoses të vëzhgojë letërsinë shqipe romantike në tërësi si një proces evolues, e justifikuar me faktin që çdo epokë duhet të kuptojë një tekst të transmetuar në mënyrën e vet, sepse teksti është pjesë e tradites per te cilen epoka ka interes objektiv dhe ne te cilen ajo kerkon te kuptoje veteveten.³⁸⁴

Mënyra krahasimtare që praktikohet është *tipi gjenetik*, i cili ka për objekt ngjashmëritë që lindin përmes kontaktit, duke zbuluar të dhëna të hollësishme rreth tyre e duke pohuar që kontakti ka qënë i vërtetë, i realizuar për shkak të ndjeshmërive të caktuara sociale kulturore. Këto raporte afërsie analizohen prej Qoses duke vënë në dukje veçantitë e mendimit të Asdrenit apo Naimit, sa afërsitë, aq edhe specifikat origjinale të secilit. Kjo metodë krahasimtare çon në konkluzionin se veçoritë poetike të secilit autor

³⁸¹ Rexhep Qosja, “Asdreni jeta dhe vepra e tij”, Toena, Tiranë, 2002, f.22

³⁸² Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, Naim Frashëri, Tiranë, 1989

³⁸³ Muzzioli, Francesco, “Le teorie della critica letteraria”, La Nuova Italia Scientifica, Roma, 1995, f.54-55

³⁸⁴ Ann Jefferson , David Robey, “ Modern Literary Theory”, London 1997, kapitulli : “ Reading and Interpretation” nga Ian Maclean, f. 135

nuk janë kurrsesi imitime, por zhvillime të natyrshme që reflektojnë dukuritë e procesit të zhvillimit historik të letërsisë shqipe.

Ndërtekstorësia e brendshme është më e pranishme në vëzhgimet e Qoses por nuk mungojnë edhe rastet e asaj të jashtme. Tek Asdreni, për arsye të plotësisë së kontakteve letrare, vlerësohen edhe lidhjet personale dhe sidomos ato me korrespondencë.³⁸⁵ Tek Naimi nuk mungojnë edhe kontaktet e ndërmjetësuar, të cilat përthyen në veprën e tij në trajta të gjurmëve të lëna për shkak të njohjes së tij me kultura të ndryshme si : antikiteti grek gjatë shkollimit në Zosimea, apo kontaktet me iluminizmin francez³⁸⁶ etj.

R Qosja i kushton një vemendje të vecantë ndikimeve letrare, pasi për të ato shfaqen si fermente zotëruese të frymëzimit apo të paraqitjes artistike, të cilat e kanë çuar krijimtarinë e të dy shkrimtarëve në një shkallë më të lartë. Ndikimet, nuk shihen në mënyrë të thjeshtëzuar, por si marrëdhënie që zbulojnë çështje të origjinalitetit artistik. Në këtë konceptim Qosja shkon drejt konkluzionit se veprat e dy shkrimtarëve mishërojnë vlera të vecanta: në dialog me traditën së cilës i përkasin, por nga ana tjetër, duke çuar më tej, brenda kësaj tradite, kategorinë e cilësisë së tyre. Duke iu referuar konkretisht *ndikimeve integrale* metoda krahasimtare e ka ndihmuar studiuesin të hetojë dukuri të tilla si: reminishenca, huazime, imitime, përshtatje, ngjashmëri etj.

Psh, në studimin mbi Asdrenin: njeh ndikimin nga Naimi, më shumë në aspektin moral-idealit, sesa si poet³⁸⁷. Gjithashtu ndikimin nga këngët popullore³⁸⁸, nga letërsia e huaj³⁸⁹ : (Dante Aligeri- rigjallërimin e disa simboleve, shfrytëzimin e konceptimeve qiellore, sikundër janë Parajsa, Ferri, përzgjedhjen e njëmbëdhjetërokëshit dantesk etj). ndikim nga francezët (Marselino Debord, Hygo), ndikim nga kultura rumune (Eminesku), etj. Këto dukuri shpjegojnë ndjeshmërinë e vecantë të poezisë së tij, kryesisht pasromantike, apo krahasimin me parnasizmin (detajet në poezitë Liqeni i Prespës , Endërr e vërtetë), kultin e formës të huazuar prej tyre etj. duke pohuar se roli i tyre në krijimtarinë tij ka qenë vendimtar.

Por, nga ana tjetër, këto ndikime zberthejnë në mënyrë origjinale parimet krijuese (në planin psikologjik, në aspektin historik-letrar), përligjin vazhdimësinë e zhvillimit të lirikës shqipe në aspektin estetik formal, duke evidentuar si janë sendërtuar artistikisht këto ndikime.

Në studimin mbi Naimin, R. Qosja njeh rolin e traditës letrare vendase dhe traditës letrare botërore duke evidentuar arsyet e kësaj njohjeje³⁹⁰. Pranon që ndikimi I poezisë popullore në krijimtarinë e tij është i ndërmjetësuar³⁹¹, nuk mohon rëndësinë e këtij ndikimi duke pohuar që “ai nuk është thjesht ndikim, por një lidhje e natyrshme, e vetëkuptueshme mes krijimtarisë së një vjershëtari, i cili mendon se që të jetë i kuptuar

³⁸⁵ Rexhep Qosja, *Asdreni jeta dhe vepra*, Toena, Tiranë, 2002, f.91,127,203 etj.

³⁸⁶ Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, Naim Frashëri, Tiranë, 1989, f.37,53.

³⁸⁷ Rexhep Qosja, *Asdreni jeta dhe vepra*, Toena, Tiranë, 2002, f.250

³⁸⁸ Po aty, f.258

³⁸⁹ Po aty, f.271

³⁹⁰ Shënim : arsyet kryesore të ndikimeve Qosja I sheh si më poshtë: 1- për arsye se ashtu e kuptojmë dhe e përmitojmë më mirë krijimtarinë e tij poetike në tërësi, 2. Për arsye se ashtu e caktojmë drejt vendin e veprave të tij të veçanta poetike dhe të krijimtarisë së tij të përgjithshme në traditën letrare shqipe, 3. Për arsye se duke njohur rolin e traditës letrare vendase dhe të traditës letrare botërore në krijimtarinë e tij, njohim më lehtë dhe më mirë mundësitë që kjo krijimtari I ka hapur letërsisë shqipe të kohës së tij dhe letërsisë shqipe të pas asaj kohe. ³⁹⁰ Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, Naim Frashëri, Tiranë, 1989, f.13

³⁹¹ Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, Naim Frashëri, Tiranë, 1989, f.15

prej popullit të vet, e krijimtarisë shpirtërore të tij.”³⁹² Argumenton mbi kufizimin e ndikimit të poezisë së bejtexhinjve³⁹³, përvoja poetike, filozofike dhe historike që sjellin letërsia, filozofia historia dhe jeta shoqërore e Greqisë së vjetër, Perandorisë Romake zgjerojnë dhe pasurojnë përvojën krijuese të Naim Frashërit. Po kështu ndikimet nga letërsia italiane, iluminizmi francez, romanizmi evropian, letërsia persiane dhe arabe do të shihen nga Qosja brenda kesaj hullie.

Përpos ndikimeve, të cilat kanë rolin e tyre të rëndësishëm, mendoj se kritika e Qoses shfaq edhe gjurmë të qasjes *intertekstuale*. Elemente të intertekstualitetit shfaqen në momentin kur R. Qosja heton dhe interpreton marrëdhënie specifike me tradita të tjera krijuese. Të tilla janë, përshembull, vjersha “Shpirti i Dhespotit” e bazuar në një prej anektdave të shumta që tregon populli mbi priftërinjtë. Asdreni bën një ndryshim interesant në këtë anektdë, në vend të priftit në konceptim të përgjithshëm, ai vë në lojë priftin grek³⁹⁴. Po kështu dhe tek “Trimëria e Shqahut” ka bërë ndryshime të ngjashme: situatën dhe përfundimin i kurdis në pajtim me qëllimin e vet atdhetar propagandistik.³⁹⁵ Vjersha e Asdrenit “Epigonët” duket si imitim i vjershës me të njëtin titull “Epigoni”³⁹⁶ të Mihail Eminesku, simboli i korës, rasti i vjershës “Venediku” na rikujton tingëllimin e Mihail Eminesku “Venetia”. Përmbledhja e njohur “Psalmii” e Tudor Argezit etj³⁹⁷

Pikëpamjen e Naim Frashërit mbi barazinë e feve dhe takimin e tyre te zoti i përbashkët, të cilin e paraqet herë si një të vetëm dhe herë të shpërndarë në krejt natyrën- studiuesi e rigjen te mistiku arab Ibn Mensurit mbi njësinë e feve³⁹⁸.....Marrëdhëniet intertekstuale që zbulohen te Naim Frashëri në raport me Firdeusin interpretohen te vjersha “Zemra e pikëlluar dhe e brengosur”³⁹⁹, duke përmendur Rustemin – njërin prej personazheve kryesorë të *Librit të mbretërve* (*Shahnamesë*)⁴⁰⁰. Sulltan Murati në këngën e V të Istorisë së Skëndërbeut, aq shumë i frikësohet trimit shqiptar saqë natën fle me një sy hapur, duke i kujtuar lexuesit Polifemin në epopenë e Homerit “Odisea”⁴⁰¹.

Nga sa u citua më sipër mendojmë se Qosja ka arritur të hetojë dukuri të tilla, të cilat përvec reminishencave, janë shfaqje të imitimeve, pastishit apo parodisë, elemente me të cilat procedon teoria e intertekstualitetit. Sigurisht, hipoteza e përdorimit edhe të metodës *intertekstuale* në disa studime të R.Qosjes, meriton shtjellim më të thelluar, të mëtejshëm. Në praktikën e tij studimore mpleksen metoda të ndryshme interpretimi, çka dëshmon se qasjet e vërteta shkencore nuk mund të ngushtohen brenda kufijve të

³⁹² Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, Naim Frashëri, Tiranë, 1989, f.23

³⁹³ Shënim: Për Qosen poezia e bejtexhinjve karakterizohet nga botëkuptimi dhe botëpërjetimi I ngushtë , I njëanshëm, I thjeshtë, I vjetëruar dhe I tejkaluar në zhvillimin shpirtëror të popullit shqiptar në gjysmën e dytë të shek XX, duke moskënaqur shpirtërisht botën e gjerë e të pasur të Naim Frashërit. ³⁹³ Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, Naim Frashëri, Tiranë, 1989, f.32

³⁹⁴ Rexhep Qosja, *Asdreni jeta dhe vepra*, Toena, Tiranë, 2002, f.262

³⁹⁵ Po aty

³⁹⁶ Rexhep Qosja, *Asdreni jeta dhe vepra*, Toena, Tiranë, 2002, f.282

³⁹⁷ Shënim : “Në krijimtarinë e Tudor Argezit janë shprehur si ndikimi I Bodlerit dhe I simbolizmitashtu edhe ndikimi I ekspresionizmit. Me përmbledhjen e tij të njohur Psalmet (Psalmii) në të cilën janë të dukshme karakteristikat e të dy këtyre dy rrymave letrare, ai ka ndikuar dukshëm në vjershat e përmbledhjes së Asdrenit *Psallme Murgu* dhe këtë ndikim e dëshmon shëmbëllesa e titujve.” Rexhep Qosja, *Asdreni jeta dhe vepra*, Toena, Tiranë, 2002, f.284.

³⁹⁸ Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, Naim Frashëri, Tiranë, 1989, f.66

³⁹⁹ Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, Naim Frashëri, Tiranë, 1989, f.64

⁴⁰⁰ Po atyf.66

⁴⁰¹ ⁴⁰¹ Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, Naim Frashëri, Tiranë, 1989, f. 39

caktuar, se secila metodë ka përparësitë dhe kufizimet e veta, por të gjitha kanë të bëjnë me letërsinë, pra janë të domosdoshme.

Kështu, duke analizuar mënyrën me të cilën një vepër nënshkruhet në hullinë e një tradite dhe rimerr, por edhe anashkalon, edhe braktis disa burime, është e mundur të tregohet sesi tërësia e vlerave të përbashkëta të një epoke kërkon një rilexim të intertekstit dhe shpjegon përthyerjet e reja të tij. Studimi *intertekstual* nxjerr në pah jo vetëm veçantitë e një vepre në epokën e saj, por gjithashtu edhe diakroninë e një subjekti apo të një tradite. Mendoj se kjo lloj qasje, jo shumë e trajtuar në studimet tona, përbën një hapje tjetër në metodologjinë shkencore të kritikës së R. Qoses.

Recezenste :

Prof.Dr Floresha Dado
Prof. as.Dr Elvira Lumi

Bibliografi

- Academia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Akademia e Shkencave e Shqipërisë " *Historia e letërsisë shqipe*", materialet e konferencës shkencore, Prishtinë ,2009 ,30-31 tetor
- Allen, Graham, " *Intertextuality*" Routledge, London, 1996
- Chevrel, Yves, "Letërsia e krahasuar", Tiranë, 2002
- Dado, Floresha, *Teoria e veprës letrare , Poetika*, SHBLU, Tiranë, 1999
- Dado, Floresha, *Sfida teorike të historiografisë letrare shqiptare*, Bota shqiptare, Tiranë, 2009
- Gnisci, Armando, Sinopoli, Franca " *Manuale storico di letteratura comparata*", Meltemi, Roma, 1997
- Gadamer, Hans –George, "Truth and method", London, 1979
- Instituti Albanologjik i Prishtinës " *Krijimtaria shkencore dhe letrare e Rexhep Qosjes*", Prishtinë, 2007
- Hamiti, Sabri " *Kritika letrare*", Faik Konica, Prishtine , 2002
- Hamiti, Sabri " *Letërsia bashkëkohore*", vepra letrare 9, Faik Konica, prishtinë 2002
- Musliu, Bashkim " *Art dhe erudicion, krijimtaria letrare e R.Qosjes* ",Instituti Albanologjik I Prishtinës, Prishtinë, 2010
- Muzzioli, Francesco, " *Le teorie della critica letteraria*", La Nuova Italia Scientifica, Roma, 1995
- Rugova, Ibrahim "Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983", Eurorilindja", Prishtinë, 1996
- Qosja, Rexhep " *Porosia e madhe*", Naim Frashëri , Tiranë , 1989
- Qosja, Rexhep " *Asdreni, jeta dhe vepra e tij*", Botimet "Toena", Tiranë 2002
- Piegay-Gros, Nathalie " *Poetika e intertekstualitetit*" Parnas, Prishtinë, 2011
- Zhenet, Zherar, "Figura", Rilindja, Prishtinë, 1985
- Ëllek, Rene, Warren, Austin, "Teoria e letërsisë", Onufri, 200

VËZHGIME MBI VLERAT SEMANTIKORE TË FOLJEVE MODALE NË GJUHËN SHQIPE DHE ATË ITALIANE

Msc. Entela Mustafaraj

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Departamenti i Gjuhëve të Huaja

Hyrje

Modaliteti është një fenomen i pranishëm në të gjitha gjuhët e botës. Përkufizimi tradicional i tij është shprehja në nivelin gramatikor të një sërë konceptesh që i përkasin qëndrimin ose mendimit të folësit në lidhje me përmbajtjen e thënies në fjali (Palmer, 1986:18); (Bybee, Dale Perkins, Pagliuca, 1994:176). Modaliteti sipas Palmer-it (1986:18), ka lidhje me "statusin e fjalisë e cila përshkruan ngjarjen", pra modaliteti ndryshon nga kohët dhe aspekti, sepse nuk i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ndonjë karakteristike të ngjarjes, por i referohet thjesht statusit të fjalisë. Në rradhë të parë, modaliteti tregon qëndrimin e folësit në lidhje me të vërtetën e thënies. Pastaj shprehet se "modaliteti është një fenomen semantikor: është përmbajtja e një shprehjeje që pasqyron qëndrimin e folësit ose gjëndjen e njohurive në lidhje me fjalinë".

Ndërsa sipas Bybee & Fleischman (1995:2), modaliteti i referohet atyre elementeve të kuptimit që shprehin ndonjë gjykim rreth të vërtetës së një fjalie, ose ndonjë qëllim që i përket realizimit të saj. Demiraj (1995:261) jep këtë përcaktim të modalitetit: "kategoria e gramatikore e mënyrës është mjete kryesor për të shprehur modalitetin", duke shtuar, në formë shënimi: "Me termin modalitet kuptohet të shprehurit e qëndrimin të folësit ndaj asaj që kumton në lidhje të ngushtë me realitetin objektiv. Ky qëndrim i folësit mund të shprehet me mjete të ndryshme gjuhësore: me anë të mënyrave të foljes, me anë të foljeve me vlerë modale, me anë të pjesëzave modale etj."

Kjo kategori përfshin disa koncepte leksikore si: mundësi, detyrim, domosdoshmëri, lejim, dyshim, dëshirë, qëllim, mohim, d.m.th qëllimin apo mendimin e folësit në lidhje me përmbajtjen e fjalisë. Midis tipave të ndryshëm të modalitetit të njohura nga letërsia logjiko-filozofike, ato që kanë më shumë peshë nga pikëpamja gjuhësore, sepse mund të shprehen me mjete gjuhësore të ndryshme, Lyons (1977) dallon modalitetin epistemik dhe modalitetin deontik.

Modaliteti epistemik ka lidhje me qëndrimin e folësit ndaj vlerës ose statusit të vërtetë të fjalisë, pra nëpërmjet modalitetit epistemik folësit shprehin gjykimet e tyre rreth statusit faktik të fjalisë. Modaliteti epistemik vlen për të pohuar dhe treguar shkallën në të cilën folësi është i bindur rreth së vërtetës së fjalisë. Vlera epistemike e një thënieje varet nga proceset e njohjes, besimit, gjykimit personal të folësit, i cili e vlerëson gjëndjen ose ngjarjen e përshkruar nga thënia në bazë të një shkalle të mundshmërisë dhe vlerës koherente me besimet dhe konsideratat e tij:

- (1) Duhet të jetë ora shtatë. Xhulio mund të jetë nisur.
Devono essere le sette. Giulio potrebbe essere partito.

Modaliteti deontik u referohet ngjarjeve që nuk janë reale, ngjarje që nuk kanë ndodhur por që ka mundësi të ndodhin. Në modalitetin deontik faktorët e kushtëzuar të individit përkatës janë të jashtëm. Kështu, ky modalitet ka të bëjë me kuptimin modal të detyrimit dhe lejimit, që sipas Palmer-it (1986: 8-9) rrjedhin nga burime të jashtme:

- (2) Marko duhet të niset sot. Nuk mund të braktisen personat e vetmuar.
Marco deve partire oggi. Non si possono abbandonare le persone sole.

1.1 Nuancat kuptimore të foljeve modale në shqip

Foljet modale shprehin qëndrimin e folësit rreth veprimit të shprehur nga folja ndjekëse si të mundshëm ose të lejueshëm, të detyrueshëm ose të domosdoshëm. Foljet modale dallohen nga njëra-tjetra përsa i përket nuancave kuptimore, ato shprehin vlera kuptimore të ndryshme modale në fjali dhe përdoren për qëllime të ndryshme nga folësit.

Shprehja e mundësisë apo lejimit

Modaliteti i mundësisë apo lejimit në gjuhën shqipe shprehet me anë të foljes modale mund, e cila ndiqet nga një folje në mënyrën lidhore. Folja mund përdoret kryesisht në kohën e tashme të mënyres dëftore, është e pazgjedhueshme në numër dhe vetë, ndërsa folja kryesore është e zgjedhuar në të kohët e saj. Në këtë strukturë, folja modale mund del në vetën e tretë njëjës, ajo nuk ka kuptim vetor, as kuptim kohor. Këto kuptime i bart folja në lidhore, e cila mund të jetë në çdo formë kohore apo në çdo diatezë. Folja modale shpreh karakterin e mundshëm të veprimit a të gjëndjes, ndërsa folja në lidhore tregon se veprimi kryhet, në të tashmen ose në të ardhmen:

- (3) Mund të ketë edhe ndonjë djalë dhe kujton se ky juaji është djali i tij. (Zemër, f.108)

Folja mund në të tashmen e dëftorës, ndiqet nga folja kryesore në të tashmen dhe të pakryerën e lidhore, i gjithë togu shpreh kuptimin modal të lejimit:

- (4) Sot, mund ta merrni me vete vajzën tuaj – tha mësuesja. (Zemër, f.215)

Mund në të tashmen e dëftorës del në vetën e tretë njëjës, folja në lidhore paraqitet qoftë në kohën e tashme, qoftë në kohën e shkuar. E gjithë struktura shpreh karakterin hipotetik e të pasigurt të veprimit:

- (5) Mbaroi mirë por mund të kishite ndodhur edhe ndonjë mynxyrë. (Zemër, f.114)

Edhe folja duhet e vetës së tretë, njëjës, në tashmen dëftore kur ndiqet nga e kryera e lidhores, i gjithë togu shpreh kuptimin modal të mundësisë dhe jo të domosdoshmërisë:

- (6) Është rritur, duhet të ketë mbushur tetë vjeç. (Zemër, f.112)
Kushedi sa duhet të jetë lodhur Stardi i gjorë! (Zemër, f.67)

Shprehja e domosdoshmërisë apo detyrimit

Modaliteti i domosdoshmërisë apo detyrimit shprehet me foljen duhet (lypset), e cila ndiqet qoftë nga një folje në lidhore, qoftë nga një folje në pjesore. Folja duhet përdoret kryesisht si folje pavetore e ngurosur në formën e vetës së tretë njëjës, koha e tashme, e pakryer dhe e ardhme e mënyrës dëftore, si dhe në kohën e tashme dhe të pakryer të mënyrës habitore, në vetën e tretë njëjës. Duhet e ndjekur nga e pakryera e lidhores, sërish del e ngurosur në vetën e tretë njëjës, në kohën e tashme së dëftores, shpreh kuptimin modal të domosdoshmërisë:

- (7) Duhet ta doni dhe ta respektoni njëri-tjetrin. (Zemër, f.12)

Duhet në të tashmen e dëftores ndiqet nga folja kryesore e zgjedhuar në të tashmen e lidhores, në këtë strukturë shpreh kuptimin modal të detyrimit:

- (8) Duhet të thuash: “Në rroba ka shenjat e punës që ka bërë.” (Zemër, f.54)

Në strukturën me pjesore, folja modale duhet vendoset në kohën e tashme dhe të pakryer të dëftores, përdoret në vetën e tretë njëjës dhe shumë. Pjesorja qëndron e pandryshueshme, ndërsa kuptimi i saj ndryshon, ajo tregon veprim në pamjen më abstrakte. I gjithë togu shpreh kuptimin modal të domosdoshmërisë:

- (9) Këto duhen mbajtur afër dhe duhen përkrahur. (Gr. praktike e gjuhës shqipe, f.198)

Megjithatë duheshin parë me vëmendje arkivat. (Gr. praktike e gjuhës shqipe, f.199)

Gjithashtu, shprehja e domosdoshmërisë dhe e detyrimit shprehet edhe me foljen do, është veta e tretë njëjës e foljes dua, e cila del në trajtë të ngurosur, përdoret në kohën e tashme, veta e tretë njëjës, kur ndiqet menjëherë nga folja kryesore në pjesore të pandryshueshme:

- (10) Diskutimi do thelluar. (Gr. praktike e gjuhës shqipe, f.199)
Shpërndarja e librave do bërë me kujdes. (Gr. praktike e gjuhës shqipe, f.199)

Përdoren si folje modale për të shprehur domosdoshmëri dhe detyrim foljet ndihmëse kam dhe jam të ndjekura nga paskajortja e tipit për të bërë; kanë forma eptimi të ndryshme, kryesisht në mënyrën dëftore:

(11) S'është për t'u përbuzur (= s' duhet përbuzur) ky njeri! (Gr.praktike e gj. shqipe, f.199)

Do të shkoj në qytet. Kam për të marrë (= duhet të marr) edhe veglat.

(Gr.praktike e gj. shqipe, f.199)

Shprehja e gjasisë apo supozimit

Përveç dy kuptimeve të para, folja modale duhet përdoret dhe me kuptimin e gjasisë apo supozimit, vendoset në kohën e tashme dhe të pakryer, veta e tretë njëjës, dhe folja kryesore në lidhore që e pason, vendoset në të gjitha format kohore të saj.

(12) Është rritur, duhet të ketë mbushur tetë vjeç. (Zemër, f.112)

Duhet e ndjekur nga e tashmja e lidhore, sërish del e ngurosur në vetën e tretë njëjës, e tashme dëftore, dhe shpreh kuptimin modal të domosdoshmërisë ose supozimit për të ardhmen:

(13) Ti duhet të më betohesh që kjo nuk do të ndodhë kurrë më, derisa të jem gjallë. (Zemër, f.221)

Gjithashtu, modaliteti i gjasisë apo supozimit shprehet edhe me foljen mund në të tashmen e dëftorës e ndjekur nga folja në lidhore e zgjedhuar në kohën e kryer, e cila është e barasvlefshme me kohën e ardhme të përparme të mënyrës dëftore:

(14) Mendo se mbase ai fëmijë mund të ketë patur uri, mendo se ç'brenjë ka patur në shpirt ajo mëmë e mjerë. (Zemër, f. 50)

Struktura e foljes jam në kohën e tashme dhe të pakryer të lidhore, e ndjekur nga një folje në përcjellore, mund të paraprihet nga foljet modale mund ose duhet, dhe shpreh një gjëndje të mundshme apo të supozuar:

(15) Ndonjë mund të ishte duke e lexuar bashkë me mua. (Morfologjia, f. 264)

Kurse ata duhet të jenë duke dhënë shpirt – tha Melva Çelebiku. (Morfologjia, f. 264)

Shprehja e dëshirës apo vullnetit

Për të shprehur kuptimin modal të dëshirës apo vullnetit gjuha shqipe përdor foljen dua, e cila, ndryshe nga foljet mund dhe duhet, që kryesisht dilnin të ngurta dhe paraqisnin luhatje në bashkëlidhjen me foljen kryesore (herë lidhore, herë pjesore), dua paraqitet më 'e rregullt', është e zgjedhueshme në të gjitha kohët dhe vetat:

(16) O Zot, unë dua të jem i mirë, fisnik, guximtar, bujar dhe i sinqertë; (Zemër f.89)

A doni t'ua lidh më mirë fashon, zoti kapiten? (Zemër f.84)

1.2 Nuancat kuptimore të foljeve modale në italisht

Në gjuhën italiane, folje modale ose shërbyese (it. servili) do të konsiderohen foljet *dovere* 'duhet', *potere* 'mund', *volere* 'dua, dëshiroj', të cilat përdoren të pavarura ose ndiqen nga një folje tjetër në *paskajore*, pa ndërmjetësimin e ndonjë *parafjale*, të cilat i japin foljes kryesore një ngjyrim të veçantë kuptimor bazuar mbi mundësinë (*potere*), mbi domosdoshmërinë (*dovere*) dhe mbi dëshirën (*volere*). Në ndërtimet folje modale + paskajore folja modale luan rolin kryesor gramatikor duke treguar mënyrën, kohën dhe vetën dhe i jep ndërtimit kuptimin modal, kurse paskajorja tregon vetëm kategorinë gramatikore të diatezës dhe nga pikëpamja leksikore pëmban kuptimin themelor leksikor të të gjithë ndërtimit.

Shprehja e mundësisë apo lejimit

Në gjuhën italiane *potere* 'mund' e zgjedhur në kohën e tashme të dëftores, e ndjekur nga folja në paskajore 'infito', shpreh kuptimin modal të mundësisë, kur mundësia për të kryer një veprim varet nga kryefjala, përdoret për të shprehur pamundësi duke marrë përpara pjesëzën mohuese non:

(17) Quando ci avevo il banco giù nel portone, almeno poteva scrivere sul banco. (Cuore, f. 18)

- Ora non posso più tenerti compagnia,- mi disse; - a rivederci domani. (Cuore, f. 40)

Shprehja e domosdoshmërisë apo detyrimit

Modaliteti i domosdoshmërisë apo detyrimit në gjuhën italiane shprehet me foljen *dovere* 'duhet', e cila, është e zgjedhueshme në të gjitha kohët dhe vetat dhe ndiqet nga folja kryesore e vendosur në paskajore 'infito':

(18) Un uomo, che doveva essere suo padre, andava e veniva sotto gli alberi, leggendo la

gazzetta. (Cuore, f. 59)

Shprehja e gjasisë apo supozimit

Folja *dovere* 'duhet' dhe *potere* 'mund' shprehin jo vetëm një mundësi apo një detyrim por edhe konstatimin e një fakti të gjasshëm ose të mundur. Tek këto folje mund të dallojmë një kuptim "epistemik", në lidhje me vlerësimin objektiv të një fakti të paraqitur si të gjasshëm 'dovere' ose si të mundur 'potere':

- (19) Ora come ora, devono essere (è probabile) le 5. (Renzi, Salvi, Cardinaletti f.118)
Ora come ora, possono essere (è possibile) le 5. (Renzi, Salvi, Cardinaletti f.118)

Shprehja e sugjerimi apo këshillës

Për të shprehur një sugjerim apo këshillë, në italisht përdoret shpesh *dovere* e zgjedhuar në kohën e tashme të kushtores e ndjekur nga folja në paskajore, ndërsa *potere* e zgjedhuar në kohën e tashme të kushtores përdoret për të bërë një sugjerim, për të dhënë një ofertë, ose për të bërë një pyetje në mënyrë të sjellshme:

- (20) A quelli lì dovrebbero dare i primi premi! (Cuore, f. 18)
Spegni sempre ogni fiammifero acceso che tu trovi sui tuoi passi, che potrebbe costar la vita a qualcuno. (Cuore, f.153)

Shprehja e dëshirës së realizuar ose të porealizuar

Folja *volere* 'dua' e zgjedhuar në kohën e kryer të thjeshtë e ndjekur nga paskajorja, në këtë ndërtim folja modale shpreh një dëshirë të realizuar, ndërsa e zgjedhuar në kohën e shkuar të kushtores përdoret për të shprehur një dëshirë ose një qëllim jo të realizuar në të shkuarën ose që nuk mund të realizohet në të tashmen dhe të ardhmen:

- (21) L'ultimo si sforzò ancora di levarsi per fare il suo lavorino di nomenclatura, e volle tener la sua medaglia sul letto, per paura che glie la pigliassero. (Cuore, f.165)
Si vedeva che gli volevan bene e che avrebbero voluto tornare con lui. (Cuore, f.5)

Folja *potere* 'mund' e zgjedhuar në kohën e shkuar të kushtores përdoret për të shprehur një dëshirë ose një qëllim jo të realizuar në të shkuarën ose që nuk mund të realizohet në të tashmen dhe të ardhmen; për të dhënë një informacion jo të sigurt në të shkuarën:

- (22) E neppure avrebbe potuto partire il figliuol maggiore, che cominciava appunto allora a guadagnar qualche cosa... (Cuore, f.237)

1.3 Krahësimi i nuancave kuptimore të foljeve modale midis shqipës dhe italishtes.

Folja *mund* në shqip, ashtu si dhe folja *potere* në italisht, shprehin kuptim epistemik, në lidhje me vlerësimin objektiv të një fakti të paraqitur si të mundur:

- (23) Bëj çdo lloj pune: mund të punoj hamall, pastrues rrugësh, mund të çoj porosi të ndryshme, madje edhe në arë mund të punoj. (Zemër, f.192)

Io faccio qualunque cosa; porto roba, spazzo le strade, posso far commissioni, anche

lavorare in campagna; (Cuore, f.249)

Tek të dyja foljet modale, përkatësisht mund e shqipes dhe potere italisht shprehet karakteri hipotetik dhe i pasigurt i veprimit:

(24) Mbaroi mirë por mund të kishte ndodhur edhe ndonjë mynxyrë. (Zemër, f.114)

Finí bene; ma poteva seguire una disgrazia. (Cuore, f.142)

Një ngjashmëri tjetër është se, folja që shpreh kuptimin modal të lejimit në shqip është mund, ndërsa në italisht i përgjigjet folja potere:

(25) Sot, mund ta merrni me vete vajzën tuaj – tha mësuesja. (Zemër, f.215)

-Oggi vi potete pigliar con voi la vostra figliuola,-disse la maestra. (Cuore, f. 278)

Folja modale mund e shqipes përdoret për të shprehur një dëshirë ose një qëllim jo të realizuar në të shkuarën ose që nuk mund të realizohet në të tashmen dhe të ardhmen, të njëjtin kuptim e gjejmë edhe tek potere e italishtes e zgjedhuar në kohën e shkuar të kushtores:

(26) As djali i madh nuk mund të nisej dot, sepse kishte filluar të fitonte diçka edhe ai dhe i qe

bërë krah familjes. (Zemër, f.183)

E neppure avrebbe potuto partire il figliuol maggiore, che cominciava appunto allora a

guadagnar qualche cosa, ed era necessario alla famiglia. (Cuore, f.237)

Foljes potere e zgjedhuar në kohën e tashme të kushtores, e cila përdoret për të dhënë një ofertë, për të bërë një sugjerim ose për të bërë një pyetje në mënyrë të sjellshme, nuk i korrespondon folja mund e shqipes:

(27) Oh! Mund të shkonte shumë, shumë më mirë! (Zemër, f. 63)

Oh! potrebbe far molto, ma molto di più. (Cuore, f.74)

Folja potere e italishtes përdoret për të shprehur një sugjerim, ndryshe nga shqipja e cila nuk i përgjigjet këtij kuptimi:

(28) “Mbaje gjithnjë në mendje atë Enrikon e lumtur e të përsosur, siç do të jetë në jetën

tjetër, dhe lutu”. (Zemër, f. 89)

“Abbi sempre nel tuo pensiero quell'altro Enrico sovrumano e felice, che tu potrai essere

dopo questa vita”. (Cuore, f.110)

Duhet dhe lipset të shqipes përkatësisht dovere e italishtes, shprehin detyrim apo domosdoshmëri, gjithashtu tek folja duhet në shqip, ashtu si dhe tek dovere në italisht

dallojmë një kuptim epistemik, në lidhje me vlerësimin objektiv të një fakti të paraqitur si të gjasshëm ose të mundshëm:

(29) Një burrë, që duhej të ishte i ati, shkante e vinte nën pemë, duke lexuar gazetën. (Zemër, f.49)

Un uomo, che doveva essere suo padre, andava e veniva sotto gli alberi, leggendo la gazzetta.

(Cuore, f. 59)

Folja mund është e barasvlefshme me foljen dovere e vetës së tretë, njëjës, në të tashmen dëftore, kur shprehin kuptimin modal të mundshmërisë apo supozimit:

(30) Për momentin, duhet të jetë ora 5.

Ora come ora, devono essere (è probabile) le 5. (Renzi, Salvi, Cardinaletti f.118)

Të dyja foljet si në italisht ashtu edhe në shqip janë ekuivalente kur zgjedhohen në kohën e pakryer të mënyrës dëftore dhe shërbejnë për të treguar “të ardhmen në të shkuarën”:

(31) ...kopjova tregimin e përmuajshëm “Gjak romanjol”, që duhej ta kopjoje ti për muratorin

e sëmure. (Zemër, f.139)

... ho copiato per te il racconto mensile Sangue romagnolo, che tu dovevi copiare per il

muratorino malato... (Cuore, f.175)

Duke qënë se në gjuhën italiane mungon mënyra habitore, foljes duhet nuk i korrespondon folja dovere, kur shprehet një veprim të zakonshëm që ngjall habi tek folësi:

(32) U dashka të vdes rrugëve dhe të mos gjej nënën time! (Zemër, f.195)

Io dovrò morire per la strada senza trovare mia madre! (Cuore, f.253)

Folja dua e zgjedhuar në kohën e kryer të thjeshtë dhe në të pakryeren e dëftores, ndërsa ekuivalentia e saj në italisht volere e zgjedhuar në kohën e shkuar të kushtores përdoren për të shprehur një dëshirë ose një qëllim jo të realizuar në të shkuarën ose që nuk mund të realizohet në të tashmen dhe të ardhmen:

(33) Desha t’i them ndonjë fjalë, por s’dija nga t’ia nisja. (Zemër f.170)

Io avrei voluto dirgli qualche cosa, ma non sapevo. (Cuore, f.219)

Përfundim

Qëllimi i këtij punimi ishte që të evidentonte foljet modale në gjuhën shqipe në përjasje me gjuhën italiane. Nga studimi doli se foljet modale si në shqipen e sotme letrare ashtu edhe në italisht nga ana sintaksore nuk funksionojnë pa foljen që i pason, ndërsa nga pikëpamja leksikore, shërbejnë për të dhënë kuptime modale të përgjithshme të mundësisë, domosdoshmërisë, dëshirës. Nga përjasja e tyre doli se foljet modale të shqipes mund, duhet, dua (do) ndajnë së bashku formën e lidhores, kanë një formë pothuajse të njëtrajtshme, me përjashtim të foljes modale dua, kanë

kufizime strukturore nga pikëpamja morfologjike, ndërsa foljet modale të italishtes *dovere*, *potere*, *volere* jo vetëm që janë të bashkuara nga karakteristika të përcaktuara pragmatike, kuptimore dhe sintaksore, por ndajnë së bashku edhe formën e paskajores, parregullsi të paradigmave si dhe të njëjtën kategori gramatikore morfologjike.

Literatura

- Agalliu, Fatmir, (1988) Mënyra lidhore në gjuhën shqipe. Në Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe. Tiranë.
- Bertinetto, P. M., (1991) *Il verbo*, në Lorenzo Renzi e Giampaolo Salvi (a cura di), Grande grammatica italiana di consultazione, vol. II: I sintagmi verbale, aggettivale, avverbiale. La subordinazione, Bologna, Il Mulino.
- Bybee, Johan L., Fleischman S., (1995) *Modality in Grammar and Discourse*. Amsterdam- Philadelphia.
- Bybee, Johan L., Perkins Revere Dale, Pagliuca William, (1994) *The evolution of grammar: tense, aspect, and modality in the languages of the world*. The University of Chicago Press, Chicago.
- Çeliku, M., Domi, M., Floqi, S., Mansaku, S., Pernaska, R., Prifti, S., Ttoni, M., (1996) *Gramatika e Gjuhës Shqipe*. Vëllimi II, Sintaksa, Tiranë.
- Çeliku, Mehmet, Karapinjalli, Mustafa, Stringa, Ruzhdi, (2007) *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*. Tiranë, ILAR.
- Demiraj, Shaban, (1977) Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe. Në: Studime filologjike, Tiranë, nr.3, (101-129).
- Demiraj, Shaban, (1986) *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. 8 Nëntori, Tiranë.
- Lyons, J. (1977). *Semantics*. Vëll.2. Cambridge: Cambridge University Press.
- Mansaku, Seit, (1979) Ndërtimet me foljet modale mund dhe duhet te Gjon Buzuku. Në: Studime Filologjike, Tiranë, nr. 3
- Palmer, F. R. (1986). *Mood and modality*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Patota, Giuseppe, (1997) *Grammatica di riferimento della lingua italiana per stranieri*. Milano, Le Monnier, Società Dante Alighieri.
- Sensini, Marcello (1997) *La grammatica della lingua italiana*. Oscar Guide, Mondadori, Milano.
- Serianni, Luca (1989) *Grammatica italiana italiano comune e lingua letteraria*. Bologna, UTET Libreria, Torino.
- Topalli, Nikollë (1987) Çështje të përdorimit të mënyrës lidhore. Në: Gjuha jonë, Tiranë, nr.2
- Shembujt janë shkëputur nga:
- Romani 'Cuore' Eduardo De Amicis, 1892
- Romani 'Zemër' Eduaro De Amicis, përkthyer nga Agim Doksani, 2004

KONVEZIONI DHE NDJESHMËRIA SKENIKE

Prof. Asoc. Erald Bakalli

Universiteti i Arteve - Tiranë

Në periudhën e sistemit komunist, skenografia iu nënshtroa pa pushim një kontrolli e censure politike shumë më të madhe se zhanret e tjera, prandaj dhe në të vërtetë nuk pati mundësi të ecte e të lulëzonte. Një pjesë skenografike e vënë në një teatër duhet të shikohet nga "disa specialistë", dhe gjithçka, të kalonte në këto filtra, dhe pasi të interpretohet prej tyre si kritikë apo çdo gjë që dilte si e diskutueshme, të hiqej apo të korigjohet sipas mendimit të këtyre personave që në të shumtën e rasteve nuk kishin lidhje as me teatrin. Fryma e anti-konformizmit, aq e kudondodhur në teatrin dhe kulturën perëndimore përgjithësisht, as nuk mund të merrej me mend, sikundër nuk mund të përfytyrohet një individ siç ishte skenografi, me idetë e tij, të vinte në mendime spektatorin, ose t'i ngjallnin atij ndjesi jashtë kornizës politike të kohës.

Në raportin e skenografisë gjuha teatrore ndjehet më fort e pranishme në:

përpunimin figurativ të hapësirës skenike;

funksionalizimin në maksimum të mizanskenës;

në gjetjen e saktë të elementeve etnografik të folklorit për të cilën shkruhej në vepër;

vizionimin e idesë regjisoriale nëpërmjet alegorisë, simbolit, detajit apo gjetjes metaforike të dekoreve, rekuizitës, ndriçimit etj.;

raporteve koloristike në funksion të krijimit të atmosferës dhe gjendjeve të caktuara emocionale.

Që të pasurohet gjuha artistike e teatrit në përgjithësi, ishte e nevojshme të pasurohet veçanërisht gjuha artistike e skenografisë. Nga skenografia natyraliste e viteve '50-'60, që udhëhiqej kryesisht nga parimi i identifikimit dhe i imitimit fizik të mjedisit etnografik, teatri Shqiptar nisi të largohej prej saj, në disa nga shfaqjet e fundit të viteve '60 dhe fillimit të viteve '70, si psh. "Njollat e murrme", "Orfeu zbrit në ferr", "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Lumi i vdekur" etj. Elementët simbolike të përdorura dhe shfrytëzimi më i plotë i konvencioneve e çliruan disi hapësirën skenike nga ngurtësimi dhe mbingarkesa e dekoreve dhe rekuizitës që nuk shprehte gjë. Krijimi i një hapësire më të madhe në funksion të lojës së aktorit, si dhe zhveshja e kësaj hapësire nga tejmbushja bëri të mundur nxjerrjen në pah të aktorit si dhe krijoi një mizanskenë më të pastër dhe në funksion me veprën. Në njëfarë kuptimi kjo mund të themi se ishte sfida e parë e fituar nga skenografët e kohës për ndryshimin e madh mbi të ardhmen e teatrit shqiptar. Nga fundi i viteve '80 vihet re një përpjekje për t'i shpëtuar "çarkut" të skematizmit, që injektohet nga sistemi i kohës drejt realizmit socialist. Principi i arkitekturës dhe i skulpturës ekspresive qoftë kjo edhe nëpërmjet butaforive, përcaktimi i elementeve të konstruktivizmit dhe përpunimi i sheshit skenik ndërthurur një ideje të caktuar regjisoriale, detajet me ngarkesë metaforike dhe simbolike, zënë vend në disa shfaqje të kësaj kohe si "Gjaku i Arbrit" e Teatrit të

Shkodrës "Përshpirtje në shtëpinë e Matildës" e Teatrit të Durrësit, "Prometeu" e Teatrit Popullor, "Sa shumë gjethe të thata atë vjeshtë" e Teatrit të Elbasanit etj. Figurshmëria e lojës së skenografit në këto dekore të vëna në skenë arrijnë me shumë zgjuarsis dhe me një mprehtësi të kënaqshme, dhe të talentuar, të shprehin revolucionin në këtë fushë të artit. Me punën e tyre skenografët i kanë paraprirë futjes së tendencave bashkëkohore jo vetëm në teatër por edhe në artet pamore.

Nuk mund të vihet para gjyqit të kritikës së sotme kjo fantazi. Ajo ngulmoi sa më shumë për të kërkuar elemente shprehëse të një gjuhe teatrore sa më bashkëkohore. Flasin për një kohë kur fantazia ishte e trembur, sepse portat e autocensurës mbylleshin sakaq që edhe fobia shfaqej që të gjymtonte atë, për të mos e lejuar për të "fluturuar". Asaj i hakërreheshin gjithfarë dhëmbësh, në formë tezash, citatesh, parimesh, dogmash etj.. Skicimet e guximshme të grimit, me stilizimet e portretit të aktorit, flokët e ngjyrosur apo trajtimi surrealist i tyre, shpërfaqjet metaforike të dekorit, prerjet bashkëkohore të stilimit të veshjeve, ngjitja e detajeve të materive të ndryshme apo prerjeve në forma skulpturore (mbi veshjet ekzistuese, si dhe mbi pjesë të ndryshme të caktuara të dekorit etj.), po bëheshin dëshmi të evoluimit të gjuhës artistike në skenografi, si një pararojë e arteve vizuale në përgjithësi. Pastaj, loja me dritat dhe gjasat magjike të saj; sugjestionuan publikun që çlirohej nga paragjykimi i këtij arti, dhe iluzioni që krijohej i çonte ato në një magjepsje në pafundësi. Dhe më tej, dhe më tej...

Marrëdhënia regjisorit dhe aktorit me skenografin, në sy të parë, duket e "jashtme". Në fakt ajo është shumë e brendshme, vepruese, e vijueshme, me ndikim reciprok tek puna e secilit prej tyre. Siç dihet, hapësira dramatike në skenën e teatrit është iluzive dhe simbolike. Është iluzive sepse përballë, në hapësirën skenike pra në këtë pjesë të ngritur të skenës, kemi vetëm një mjedis e përcaktuar sipas rrethanave konvencionale, që ngjall e krijon në vetëdijen tonë iluzionin e së vërtetës, por jo vetë të vërtetën e saj. Aktori në procesin e tij e ka të qartë se mali në skenë s'është mali i vërtetë, dhe muri i dhomës së tij s'është veçse një telajo. Por ai në koshencën e tij dhe në atë që i trasmenton publikut shpreh domethënien ideore e artistike të vërtetësisë së dekorit, thelbin figurativ dhe emocional të mendimit artistik të shprehur nga skenografi.

Marrëdhëniet e aktorit me skenografin konkretizohen në tri funksionet kryesore të tyre. Domethënë, në atë të përshkrimit të vendit të veprimit sipas ngjarjes dramatike, në karakterin shprehës figurativ dhe së treti, (ajo që lidhet drejt për së drejti me artin e aktrimit) në vendosjen e lëvizjes së aktorit nëpër volumet dhe arkitekturën skenografike pra me mizanskenën e organizuar mbi këtë dekor. E rëndësishme në këtë marrëdhënie është respektimi i konceptit mbi stilin e ndërtimit të shfaqjes. Në një dekor të realizuar në planin monumental, interpretimi i aktorit në mënyrë natyraliste do të ishte jo vetëm i pamundur, por dhe do të stononte, sepse dekori ndikon pozitivisht ose negativisht në gjithë qenien e aktorit. Ai e vlerëson mjedisin, krijon marrëdhënie me të, dhe ky mjedis, dashur pa dashur, drejtpërdrejt apo tërthorazi, ndikon në tërë psikofizikën dhe sjelljen dhe lojën e tij integruar në këtë dekor.

Në tablotë e shfaqjes "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" të Teatrit Popullor me skenografi të Prof. Agim Zajmi, zgjidhjet skenografike janë njëherazi edhe të figurshme, monumentale, por dhe me mundësi praktike për lëvizjen e aktorëve. Për të nxjerrë në pah shpirtin e trazuar të Nicës, në monologun e saj të njohur, si dhe për të ballafaquar dy bote të ndryshme, krejt të kundërta e antagonistë. Skenografi në tablonë e dasmës e ndërton dekorin me dy kate. Lart, plakat, në mes tyre Nica tragjike, kurse poshtë në

planshet, dhe deri në qoshen e skenës, të vendosur gjenerali dhe prifti. Aktorja lartësohet si në një pedestal. Ana praktike dhe funksionale e mizanskenës ka dhënë, në këtë rast, mundësi për ndërtime e rindërtime të figurshme dhe ekspresive të lëvizjes, në marrëdhënie të drejta me aktorin.

Përveç aktorit dhe autorit, mendimi regjisorial duhet të ndërfitet. të përfshijë e të vihet në shërbim edhe të ndërtimit skenografik të spektaklit. Në këto dy komponentë të teatrit duhet të ketë ndërvarje reciproke. Madje teatri s'mund të kuptohet veçse si unitet në përshkallëzim i autorit, me regjisorin, dhe i këtij me skenografin, aktorët dhe formulimin muzikor. Në vazhdimësi të këtij procesi skenografia shqiptare ka shënuar hapa në rrugën e kualifikimit të saj profesional. Duke realizuar kompozimin arkitektonik të veprës dramatike, skenografia kurrsesi nuk mund të shndërrohet në një komponent «rob», apo «ilustrues», i thjeshtë dhe fotografues i ambientit, ku zhvillohet veprimi skenik. Ajo presupozon në vetvete praninë e një qëllimi artistik të përcaktuar, mendimin figurativ skenografik të skenografit, i cili s'mund të jetë i thjeshtë, por original. Ajo nuk ka përmasat reale të realitetit objektiv, nuk përshkruan dhe vizaton në mënyrë natyraliste anët e shumta, të imta dhe adekuate të fenomenit jetësor, ambientit natyror etj, por kap vetëm esencën e tij, thelbin veprues, shprehës, duke e përgjithësuar dhe tipizuar. Pra, në një kuptim, duke krijuar një konvencion artistik.

Në skenografinë e shfaqjes «Cuca e maleve», në sfondin e hirtë të maleve, vendoset një ambient shtëpie me një dërrase të zezë, ku është shkruar germa «a». Mendimi skenografik kërkon të thotë që drita e dijes, dhe diturisë e merr zanafillën me njohjen e germës «a», e cila jo pa mund e përpjekje do të futej në bjeshkët shqiptare. Veç kësaj, në sfondin e ashpër, ajo krijon «poezi», një lloj gëzimi të brendshëm. Natyrisht, spektatori e ka të qartë se mali s'është vërtet ashtu siç e shikon në skenë. Ai di të shohë mandej edhe domethënien e ndijimit të dekorit, të kuptojë mendimin e piktorit. Skenografia jep këtu esencën e fenomenit, kap një ambient tipik, por të figurshëm e të kthyer në një konvencion artistik që diçka thotë Teatri, ashtu si çdo praktikë sociale dhe kolektive, përmban një prezencë të dyfishtë, atë të aktorit dhe të spektatorit. Takimi, bashkimi dhe shkëmbimi i këtyre dy prezencave përshkruhet në hapësirë. Arti i organizimit të kësaj hapësire është "skenografia".

Një karakteristikë tjetër thelbësore e teatrit është ajo e pasjes së një funksioni dhe bërjes apel të imagjinatës së spektatorit. Një kundërshti specifike e teatrit e bën hapësirën në të cilën interpretojnë aktorët një vend ku marrin pjesë në të njëjtën kohë realiteti dhe imagjinaria, një hapësire reale (ku qëndrojnë aktorët), i mbivendoset një hapësirë imagjinare (nga ku marrin jetë personazhet).

Në teatër koncepti i hapësirës ka të paktën dy kuptime: i pari është hapësira fizike, vendi i paraqitjes, i dyti është hapësira e imagjinatës, ajo që Vladimir Toporov e përcakton si mitopoietica.

Vendi teatral, hapësira konkrete e veprimit skenik, mund të identifikohet me teatrin apo çdo lloj strukture tjetër të përshtatshme për të pritur realizimin e një veprë. Në rastin e teatrit të rrugës, kjo gjë ndryshon. Janë aktorët dhe publiku që përshtaten me një strukturë që shërben për qëllime të tjera. Brenda vendit teatral mund të shohim hapësirën skenike, apo perimetrin e prezantimit që i është besuar për lojën e tyre aktorëve.

Ka raste që hapësira e veprimit mund të përkojë me vendin teatral. Është rasti i performancës iper-realistike, një shembull është spektakli “Barboni” i Pippo Delbono, e vënë në skenë në një korridor në Stacionin Qendror të Milanos në 1998, në të cilën aktorët prezantonin vetveten, kryenin veprime teatrore në një vend që përkonte me vendin real ku ata mund të vepronin çdo ditë.

Skenografia është “një udhëtim që të çon nga vizioni letrar në një vizion imagjinar, nga realiteti në fantazi”, shprehet Anne Surgers. Një udhëtim shpesh i lehtësuar për publikun e tanishëm nga “kodi i tepruar ndërmjet imazhit në perspektivë dhe fjalës, duke mos bërë të mundur përfshirjen e njërës pa mbivendosjen e tjetrës”. Por kjo panoramë që studjuesja franceze na paraqet, na tregon se ky kod është aktiv jo prej një kohe të gjatë, por duke u nisur nga vendosja e idesë italiane të skenës dhe teatrit. Si në teatrin grek edhe në atë të periudhës mesjetare apo elisabetiane por edhe tek ajo franceze e gjashtëqindës një pjesë e rëndësishme i lihej imagjinatës së vetë spektatorit.

Nëse është e vërtetë, ashtu siç propozon Surgers, që skenografi është i barabartë me autorin dhe aktorin (si dhe regjisorin duke u nisur nga fundi i ‘800) është një figurë e nevojshme në teatër, duhet t’i njihet fuqia krijuese dhe gjuha specifike e përdorur nga ai për pjesë të ndryshme të dramaturgjisë si ajo e krijuar nga Appia për melodramën vagneriane.

Skenografia duhet të japë një përgjigje dy problemeve kryesore, të përfshira në çdo lloj praktike teatrale: si të përqendrojë shikimin, dëgjimin dhe vëmendjen e spektatorit mbi grupin tjetër, atë që vë në punë imagjinatën? Si të ftojë spektatorin të projektojë në hapësirën reale të aktorëve një pjesë imagjinare në mënyrë që trillimi të funksionojë? Skenografia ka në të njëjtën kohë detyrën të nënvizojë dhe të vendosi, në mënyrë të ndjeshme dhe të lexueshme, kufirin simbolik ndërmjet trillimit dhe realitetit, ndërmjet aktorit dhe spektatorit, me fjalë të tjera ndërmjet asaj që fshihet dhe asaj që shfaqet, ndërmjet të dukshmes dhe të padukshmes.

Skenografia është një mjet i paraqitjes së botës sipas një vizioni të caktuar. Nga origjina greke e teatrit, vizioni i botës, domethënë paraqitja mendore dhe hapësinore, dhe kodet e paraqitjes kanë evoluar, disa janë zhdukur dhe janë bërë për ne si një gjuhë e vdekur, të tjera kanë mbijetuar apo janë modifikuar.

REFLEKTIME TË LETËRSISË QËLLIMORE NË LETËRSINË SHQIPE ME SHKRIM ORIENTAL

Ermira Alia

Abstrakt

Punimi përpiket të shqyrtojë çështjen se si shfaqet letërsia me shkrim oriental, në pikëpamje të funksionit. Tregohet se funksioni utilitar dhe didaktik shfaqet kryesisht tek letërsia e mirëfilltë fetare e konfesionit islam: ilahitë, mevludet. Ndërsa tek krijimtaria e kultivuar, shfaqja e letërsisë si funksion mbetet e variueshme, në varësi nga autorët dhe shkrimet specifike të tyre.

Duke u fokusuar në divanin e parë të shkruar nga Nezim Frakulla, punimi tregon se interpretimi i poezisë si shfaqje e mistikës së mirëfilltë islame e bën të shfaqet tek lexuesit si konkretizim i një ideologjie fetare, duke e kërkuar artistiken në metafizikën e misticizmit si fenomen fetar dhe jo si fenomen letrar; kurse në raportin e kësaj letërsie me atë qëllimore, e shohim si fenomen kompleks, që shfaqet qysh në shfaqjen e individualitetit si formë e veçantisë së divanit, apo llojeve të tjera poetike orientale; si formë e individualitetit në raport me misticizmin islam, apo si shfaqje e transhendencës individuale gjuhësore.

Çështja e letërsisë qëllimore lidhet me funksionin e atëkohshëm dhe të sotëm të letërsisë, si edhe me çështjen e pavarësisë së saj si art.

Duke reflektuar si qasje shumëplanëshe, letërsia shqipe në periudha, lloje e zhanre të ndryshme letrare shfaqet në mënyra të ndryshme. Tek letërsia me shkrim oriental kjo marrëdhënie shfaqet edhe në varësi të temës fetare apo jofetare, krijime që nuk janë të ndara prerazi.

Në krijimet me destinacion të pastër fetar, siç janë mevludet, vëmë re se pavarësisht animit të tij si lloj nga funksioni didaktik e moralizues, dallohet një farë uni poetik lirik, veçantia e të cilit konsiston në pasqyrimin e botës së brendshme njerëzore të thjeshtë dhe nevojës së tij për mbështetje, si brendësim i artistit mistik që shfaqet më mirë tek ilahitë, si poezi lirike reflektive ndaj temës fetare.

Por, përgjithësisht brenda këtyre llojeve, fryma idealiste nuk kthehet në një raport të brendshëm me krijimin.

Por në letërsinë me shkrim oriental, përveç letërsisë me temë fetare, kemi edhe poezinë e Nezim Frakullës, poemën "Erveheja" të Muhamet Çamit, epin Hadikaja (Kopshti), të Dalip Frashërit, epopesë së parë në gjuhën shqipe, poemën "Myhtarnameja", të Shahin Frashëri; kemi edhe poezi me tema të ndryshme.

Në këtë krijimtari, poezia e Nezim Frakullës është parë nga studiuesit si më interesantja, në pikëpamje të literaritetit (letrarësisë). Kurse përjasjen e kësaj krijimtarie me atë qëllimore, e shohim si një përqsaje komplekse, që shfaqet qysh në raportin me individualitetin si formë brenda veçantisë së divanit, apo formave poetike orientale; si formë e individualitetit në raport me misticizmin islam, si formë e transhendencës individuale gjuhësore.

Nezim Frakulla konsiderohet krijues i divanit të parë në letërsinë shqipe, përmbledhje poezish sipas disa rregullive të karakterit oriental, por që ne nuk e kemi të lehtë të studiojmë individualitetin, për shkak të mungesës së rregullsisë së kopjeve që janë gjetur. Por, as se deri në ç'shkallë ka pasur sukses zbatimi i metrikës orientale, nuk mund ta përcaktojmë, për arsye të studimeve specifike, që nuk kanë qenë të shumta.

Ajo që është cilësuar tek poezia e Nezim Frakullës është fryma mistike, për të cilën thuhet se mbështetet mbi filozofinë e misticizmit islam. Raporti i letrarësisë me qëllimin, normalisht që përfshin edhe raportin e krijimit me filozofinë. Letërsia nuk është shfaqje e një rryme filozofike a fetare; ajo është shpërfaqje e shpirtit njerëzor dhe literariteti shfaqet si rrjedhojë e kësaj shpërfaqjeje. Edhe, nëse në edukimin e shkrimtarit dhe në qasjen e tij ndaj jetës ka ndikuar mistika islame, atëherë ajo është një mjet ndihmës për të kuptuar të përgjithshmen dhe individualitetin e Frakullës brenda kësaj qasjeje.

Pra, duke e kërkuar veçantinë e Nezim Frakullës në shfaqjet e veçanta të misticizmit të tij, mendojmë se kërkojmë artistiken dhe letraren brenda tij. Nëse do ta trajtonim poezinë e Frakullës thjesht si shfaqje të mistikës islame, nuk do të mund të shihnim kapërcimin e tij si poet dhe do të binim në kurthin e të trajtuarit ose qëllimor-didaktik të poezisë, ose si shfaqje a vargëzim të filozofisë.

Të shikuarit pa paragjykime të letërsisë nuk e përjashton mistikën islame, por as nuk e mbivlerëson atë në poezi.

Nga vetë Nezim Frakulla dhe nga studiuesit pohohet se ai e sheh poezinë si vlerë dhe bukuri më vete (...“Dëgjoni gjuha se ç’thotë/ Jabana fjalët s’i kam..”), kështu që tek kjo potencë e tij për të realizuar këtë bukuri më vete, shohim edhe mundësinë e artit, pra në veçantinë e shfaqjes (qoftë edhe të ndikimit mistik), në polisemantikën dhe diapazonin e përgjithshëm njerëzor që shfaq dhe mbart.

Në këtë aspekt na duken pak të ekzagjeruara thëniet e tipit ..realiteti shpirtëror i substancës profetike është tema e preferuar e sufizmit..; ajo ka pjesën e vet të vërtetë, por është shumë herë më shumë ose më pak se aq, ose thjesht është një reflektim individual dhe pikërisht tek individualja rri letërsia:

Ç’ ë ky hall, ç’ë ky alamet

S’muntë të gjenj në një karar,

Ç’të kam bërë që nuk flet

Buzë karafil në behar.

(Abdullah Hamiti, fq 262)

Mendojmë se letërsia e shekullit XVIII qëndron te persiatjet e subjektit lirik, pavarësisht se nga shtyhen ato persiatjet; qëndron te metafizika e shpirtit njerëzor, jashtë njëanshmërisë së të interpretuarit të sufizmit; qëndron në larminë ritmike dhe melodike që sjell tingëllimin e shpirtit shqip:

Sabër pa ty nuk kam, ah efendim ty të kam
Ymri im u bë haram, ah efendim ty të kam.

(Abdullah Hamiti, fq 388)

Tek kjo shfaqje e shpirtit shqiptar gjejmë argumentin e kombëtarësisë në poezi. Ndoshta studime më të thelluara me mekanizmat e duhur konceptualë, mund ta ndriçonin më shumë këtë vështrim, gjë që do të pasuronte shikimin e raportit të letërsisë qëllimore me këtë krijimtari.

Shfaqja e plotë gjuhësore shqipe i mungon veprës së Frakullës (Beratit) dhe e ka bërë atë të jetë objekt i vlerësimeve thellësisht kontradiktore. I bashkohemi mendimit të përgjithshëm se, nëse Nezim Frakulla do të ishte thelluar më shumë në metafizikën e gjuhës, në thellimin e shprehjes së saj, duke zëvendësuar fjalët e huaja me tipet e shprehjeve që ai ka përdorur, si: ... nën dimër, nën verë; le të qeshnjë kujt i vjen gas; ej zemër diç të të them; ej zemra ime mos qaj; tha zemra, gjuhë dëgjo; gonxheja për ty u çel, sikur qeshnë, sikur qanë; u ftohçë, u bëshë mermer; etj., kjo do t'i sillte atij shumë më tepër originalitet dhe poezisë shqiptare do t'i sillte një poet më të padiskutueshëm letrar.

Por tek raporti i gjuhës dhe i orientalizmave në letërsinë me alfabet arab, të lë përshtypje gjuha e pastër e Sulejman Naibit, megjithëse, nëse flasim për një divan të tij dhe për vdekjen më 1760, mbetet të pohojmë se nuk është shumë më pas në kohë se Nezim Frakulla, ose se nuk është më herët se Hasan Zyko Kamberi. Të lë përshtypje të kënduarit që i bëhet bukurisë dhe dashurisë së femrës me një gjuhë të pastër, me gjetje të bukura poetike, me patos të brendshëm emocional, pavarësisht se është e vështirë të krijojmë një ide të plotë vetëm nga tri poezi që na kanë mbërritur prej tij:

Xullufet e tua lulet e sbylylit,
Je vetë bukuria e kopshtit ku ke hyrë,
Pra ka hak bylbyli të shikonjë me sy,
Ta lërë trëndafilin, të këndonjë për ty.

(S. Naibi, Bandilli i djegurë, marrë nga *Poezi e bejtexhinjve*, fq 112)

Atëherë si duhet ta kuptojmë gjuhën e ngarkuar me orientalizma të Nezim Frakullës, (apo edhe të Hasan Zyko Kamberit), si dëshirë për t'iu larguar gjuhës popullore e për të krijuar një gjuhë të kultivuar poetike të cilën nuk arriti ta krijonte si duhet nga nënshtrimi i presionit të një gjuhe dhe kulture të madhe perandorake, apo mosnjohje e mirë e gjuhës shqipe dhe e mundësive të saj?

Nëse pranojmë dhe hetojmë tendencën për një gjuhë të kultivuar, pranojmë në mënyrë të tërthortë edhe ekzistencën e një synimi për ta larguar letërsinë nga funksioni, sepse kërkon të gjuha jo thjesht referencialen emërtuese, por atë estetike. Por sa arrin Nezim Frakulla ta bëjë këtë, kjo është një çështje tjetër.

Po ta shtrijmë çështjen edhe më gjerë, hetimi se sa arrin letërsia me shkrim arab të krijojë një gjuhë poetike estetike është një temë që ndriçon raportin e saj me letërsinë qëllimore.

Nga ana tjetër, tek letërsia me shkrim arab shfaqen një sërë kodesh poetike që do t'i gjejmë të zhvilluara më vonë, tek pena të spikatura të letërsisë së Rilindjes, me një ngarkesë ideologjike më të madhe:

O shokë mos na harroni,
Se vemi në dhe të huaj,
Një selam të na dërgoni
Bari në tre-katër muaj.

.....

Do të ju ap një amanet,
Të të shihni fushë e male
Të ju faleni me shëndet,
Prej meje, me shumë halle.

(Abdullah Hamiti, Nezim Frakulla, fq 260)

Kjo tregon se raporti i letërsisë qëllimore me letërsinë me shkrim oriental nuk është një raport i thjeshtë; vetë evoluimi i temave është tregues për këtë.

Në këtë pikëpamje do të ishte interesant edhe gjurmimi i afrisë së poezisë së Baba Ibrahimit (nuk dimë data të lindjes dhe vdekjes, por vetëm se u burgos më 1913) me poezinë e N.Frashërit, apo gjurmimi i afrisë së poezisë së Hafiz Islamit me letërsinë e rrethit të Shkodrës: të Mjedës e Shirokës, gjë që mund të vërtetonte se qarqet letrare janë më pranë njëri-tjetrit se ne mund të mendojmë. Veçantia nga krahasimi i kodeve poetike të tyre është ndriçim i rrugëtimit të letërsisë, i funksionit të saj, qëllimshmërisë dhe transhendencës.

Edhe vetë trajtimi i temës sociale dhe sjellja e satirës sjell një raport tjetër me letërsinë qëllimore, qoftë edhe me praninë e një përqsajeje tjetër me elementë gnoseologjikë si rrjedhojë e rritjes së laicitetit të ndërgjegjes.

.....

Mynafiku një gjidi qen
Më keq se shejtani gënjen,
Vallë ato fjalë ku i gjen

(Abdullah Hamiti, fq 28)

Por edhe ky mbetet një raport jo i thjeshtë. Kjo, sepse, pavarësisht faktit që pjesa dërmuese e kësaj poezie ka nota sociale, të bën përshtypje se tek disa poezi ("Paraja", apo "Bahti im" të Hasan Zyko Kamberit), qasja poetike e shmang vargun nganjëherë nga ligjërimet retorike e didaktiko-moralizuese, pavarësisht prej joshjes që provokojnë këto tema. Pushteti i madh e i pavarur që fiton paraja, raporti kompleks me trahananë janë elemente të konceptimeve

poetike që e kanë ruajtur finesën edhe sot, pasi zhvendosja e subjektit të poezisë së Hasan Zyko Kamberit tek paraaja, është interesante jo thjesht në pikëpamje të karakterit social, por të përdorimit të parasë si strumbullar poetik i dhënies së bukurisë të së shëmtuarës, që vjen si rrjedhim i deformimit njerëzor.

Konceptimi i Hasan Zyko Kamberit sjell veçanti në raport me trajtimin e temës sociale, që e gjejmë të shprehur në mënyrë sporadike tek poezia e Muhamet Kyçyikut:

Të mëdha halle që kanë,
që nuk i thotë kandari,

dhe të vdesnë në dhe s'janë,
kurmet s'jau tret as varri.

Muhamet Kyçyiku: "Nga gurbetlité", marrë nga "Poezia e bejtexhinjve", fq 162

Kjo është arsyeja që për lëvizjen myslimane Namik Ressuli thotë se ... "është e para lëvizje laike e kulturës shqiptare, dhe sikur vjershëtorët e saj t'ishin kujdesur më tepër për lërimin e qërimin e gjuhës dhe për shtypjen e veprave të veta, do t'a kishin prirë të pakën nja dyqint vjetë lëvizjen e Stambollit"⁴⁰².

Ne bashkohemi me idenë e lëvizjes laike, por shtojmë këtu që tema laike e letërsisë shqipe me shkrim oriental nuk është e papritur; ajo mendojmë se është vazhdim i nevojës së shprehjes poetike që filloi qysh me motivet sporadike të letërsisë filobiblike apo të poezisë së kushtimit, poezi e pastër laike.

Hajdar Salihu, në parathënien e "Poezia e bejtexhinjve", në formën e një studimi me titull "Koha e poezisë shqipe me alfabet arab", shpreh një opinion të përgjithshëm që konsiston në faktin se arritjet e poezisë së bejtexhinjve i konsideron të rëndësishme si fenomene letrare kryesisht në shekullin XVIII dhe fillimin e shekullit XIX, që e quan si etapë e parë e shkrimit të poezisë me alfabet arab, kurse atë të pjesës së dytë të shekullit XIX dhe XX e quan letërsi që u dezintegrua, sepse në një pjesë të madhe të saj qëndrimi ndaj jetës u bë pasiv, si një e dhënë e përhershme dhe e pandryshueshme. Ai mendon se kjo poezi ka "frymën e rezignimit", ku "vend kryesor kanë tonet vajtuese, lutjet, duatë dhe ka karakter pasiv" .. (fq 98).

Tema e atdheut është një bërthamë interesante ku mund të argumentohet kjo ide e studiuesit Salihu, pasi është një temë që trajtohet te letërsia me shkrim oriental e fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, që fshihet edhe nën simbolikat e dimrit (poezia "Dimri" e Baba Ibrahimit), apo në ndonjë simbolikë tjetër, gjë që flet për krijimin e lëvizjen e disa kodeve letrare, por që për kohën kur u shkruan, (pavarësisht se nuk e dimë me siguri, por me afërsi, fillimi i shekullit XX), nuk përbëjnë risi në letërsi.

⁴⁰² Namik Resuli, *Shkrimtarët shqiptarë*, Nga Buzuku tek arbëreshët e Greqisë, Histori e letërsisë shqipe 1, nën kujdesin e Ernest Koliqit, Botim I 1941, botim II PAKTI, 2007, fq 95

Po ta shohim në aspektin letrar, tek tema kombëtare mund të vëmë re lehtësisht këto shenja të rezignimit, pasi nuk gjendet ndonjë figurë e spikatur që të shtrojë temën kombëtare me një frymë më të re sesa Naimi dhe nga ana tjetër, krijimet me këtë temë bëhen letërsi qëllimore deri në misionare, pasi janë shprehje e vetëdijes së ngritur kombëtare dhe e dëshirës për ta tejçuar e propaganduar këtë frymë.

Bile bashkohemi me opinionin se për një kohë relativisht të gjatë, forma e qasjes ndaj kësaj teme ka qenë gur prove për talentin poetik. Por, në përgjithësi, ndjenjat personale dhe subjektivizmi i heroit lirik krijoi një lloj afiniteti të poezisë dhe e shmangu atë nga retorika a karakteri propagandistik. Por këto elemente nuk qenë shpesh të mjaftueshme për të dhënë një veçanti poetike. Një ide të tillë të japin edhe vargjet e Baba Meleq Shemberdhenjit i cili, pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në koloninë shqiptare të Kairos dhe pastaj në Shqipëri u muar me çështjen shqiptare:

Tinëzarët po më ndjekin
Unë s'e kursej vetëhenë,

Sikur në zjarr të më pjekin
S'e harroj dot Mëmëdhenë.

(Rrëmbeni pushkën dhe pallë, marrë nga: *Poezia e bejtexhinjve*, fq 300)

Ka raste, kur tema atdhetare shihet në këndvështrimin e metafizikës dhe misticizmit, gjë që sjell detaje interesante, (si tek poezia "Dashuria, dashuria" e Baba Meleq Shemberdhenjit), por, pavarësisht nga fakti se nuk mund të gjykojmë mbi aq pak vargje, ne përsëri nuk mund të mos themi se ato detaje nuk përbëjnë një strukturë, por paraqesin elemente sporadike në poezi.

Duke e parë poezinë me shkrim oriental nga aspekti i vargëzimit, mungesës së dokumentimit dhe përcjelljes gojë më gojë, studiuesi Jorgo Bullo quan popularexhante, por veçmas kësaj ai shikon si interesante te kjo poezi, shprehjen poetike të misticizmës dhe lirizmin filozofik që janë rrjedhojë e përjetimeve subjektive dhe frymëzimit krijues, duke vënë shpirtin njerëzor në qendër.

Mendojmë se literariteti (dhe jo qëllimshmëria si funksion didaktik) e letërsisë me shkrim oriental qëndron te persiatjet e subjektivitetit lirik, pavarësisht se nga shtyhen ato; qëndron te metafizika e njeriut, jashtë njëanshmërisë së të interpretuarit; ajo është rrjedhojë e përjetimeve subjektive që vënë në qendër shpirtin njerëzor që bëhet auto-objektivim i egos vetiake dhe nxjerr në pah transhëndencën e shqipes.

Literaturë:

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Rexhep Qosja, Shkrimtarë dhe periudha, Tiranë 2005
Bullo Jorgo, Magjia dhe magjistarët e fjalës, DITURIA, Tiranë, 1998
Çabej Eqrem, Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes, MÇM, Tiranë 1994

- Elsie Robert, Histori e letërsisë shqiptare, Dukagjini Tiranë-Pejë, 1997
Hamiti Sabri, Poetika shqipe, Shtëpia Botuese 55, Prishtinë 2010
Hamiti Abdullah, Nezim Frakuulla dhe Divani i tij shqip, Logos A, Shkup, 2008
HUSSERL Edmund, La fenomenologia trascendentale (antologia), a cura di Alfredo Marini, prima edizione: febbraio 1974, La Nuova Italia Editrice, Firenze, 1998
Hoxha Fatbardha, Letërsi e interpretuar, Camaj-Pipa, Shkodër 2013
Ismajli Rexhep, Tekste të vjetra, Dukagjini, Pejë, 2000
Jefferson Ann, Robey David, Teoria letrare moderne (Një paraqitje krahasuese), Albas 2004
Luli Faik, Dizdari Islam, Mevludet në gjuhën shqipe, Camaj-Pipa, Shkodër 2002
Ressuli Namik, Shkrimtarët shqiptarë, Nga Buzuku tek arbëreshët e Greqisë, Histori e letërsisë shqipe 1, nën kujdesin e Ernest Koliqit, Botim I 1941, botim II, PAKTI, 2007
UEGEN, Poezia e bejtexhinjve, Tiranë 2010, redaktor: Skënder Rusi
Wellek Rene, Warren Austin, Teoria e letërsisë, Onufri 2007

SHKENCAT HISTORIKE

NJË VËSHTRIM KRITIK MBI BAZAT KUSHTETUESE TË SHTETIT SHQIPTAR - ILUMINITETI I TYRE DHE REALITETI SHQIPTAR NË VITET 1920-1924

Albana Mema

QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

Instituti i Historisë

Sheshi "Nënë Tereza" Tiranë, Shqipëri.

Gjatë viteve 1920-1924 Shteti Shqiptar hodhi hapat e parë drejt organizimit mbi baza parlamentare dhe ligjore. Krijimi i një shteti liberal solli edhe nevojën e përpilimit të kushtetutave dhe akteve të tjera kushtetuese. Statuti i Lushnjës ishte një ndër aktet më të rëndësishme kushtetuese në historinë e shtetit shqiptar në këtë periudhë.

Por, "Bazat e Kanunores së Këshillit të Naltë", të përbëra nga vetëm 6 nene, tregonin paaftësinë e elitës politike shqiptare për të arritur një konsensus më gjithëpërfshirës. Ky kongres edhe pse i zhvilloi punimet në më shumë se katër ditë, tregoi dobësi në formulimin e bazave të organizimit të shtetit. Ato kishin mangësi të theksuara dhe nuk mbulonin shumë nga fushat e jetës në vend. Sigurisht, kishte arsye objektive që pengonin një veprimtari ligjvënës kushtetuese me format të plotë dhe të zhvilluar në ato momente kritike kur u mblodh Kongresi por, diçka më tepër duhej dhe mund të ishte realizuar në këtë drejtim.

Megjithatë nuk mund të mohojmë vlerën kushtetuese të Statutit të Lushnjës. Në dispozitat e tij theksohej se këto nene: "qenë shkruar shumë shkurt me një ngutësi të urdhënueme nga interesat e nalta të atdheut, nën presionin e kohës anormale".

Në punimin e tij "Organizimi i shtetit shqiptar dhe lufta politike rreth tij në vitet 1920-1924", Gramoz Hysi ndër të tjera shkruan: "Duke qenë një akt kushtetues i shkurtër, Statuti i Lushnjës nuk kishte mundur të përcaktonte me hollësi organizimin shtetëror të vendit. Për çështjet e këtij organizimi u fol, kur qe rasti dhe sa qe e mundur, edhe në seancat e tjera të Kongresit. Mbi bazën e kësaj, tërë punimet e Kongresit të Lushnjës, patën vlerën e Statutit të shtetit aq sa kopjes së procesverbalit të seancave të tij i është vënë, në ndonjë rast, edhe titulli i drejtpërdrejtë i Statutit të Lushnjës".⁴⁰³

Nga pikëpamja ligjore përcaktimi i Hysit nuk është i saktë, pasi punimet e Kongresit të Lushnjës ishin thjesht diskutime dhe nuk shprehnin vullnetin e politikës shqiptare, siç ishte rasti i "Bazave të Kanunores së Këshillit të Naltë", ku elita politike shqiptare e

⁴⁰³ Gramoz Hysi, Organizimi i shtetit shqiptar dhe lufta politike rreth tij në vitet 1920-24, Tiranë, 1988, f. 28-30.

kohës me vota unanime miratoi bazat kushtetuese të shtetit. Gjithashtu këtë pikëpamje kritike e vërtetoi periudha pasardhëse, ku mungesa e përcaktimeve të plota dhe precize konstitucionale, krijoi vështirësi në ndërtimin shtetëror.

Kongresi i Lushnjes, mund të vlerësohet si themeli i procesit të ringritjes së institucioneve kombëtare, në fazën e re ku kishte hyrë shteti shqiptar në vitet 1920. Vlera kryesore e tij ishte krijimi i një shteti unik, kombëtar dhe afetar.

Një çështje juridike në kuadrin kushtetues, ishte ajo e formës së shtetit. Në këtë pikë Kongresi u nis nga ideja e vazhdimësisë së Shtetit shqiptar sipas vendimeve të Konferencës së Londrës dhe ruajti formën e monarkisë. Pra, si për njohjen e monarkisë, ashtu edhe për caktimin e kryetarit të shtetit, Kongresi deshi të mbetej brenda atij “kuadri” juridiko-ndërkombëtar, duke u përpjekur kështu që vendimi i tij të ishte “ i mbështetur në ligj”.⁴⁰⁴ Sigurisht Kongresi nuk mund t’i rikthehej njohjes dhe rivendosjes së Vidit në krye të shtetit, për shkak se ai ishte pinjoll i një dinastie gjermane, shtet i cili, ishte fuqi e mundur në luftë dhe aq më tepër pasi Vidi kishte qenë ushtarak pjesëmarrës në këtë luftë. Kështu, krijimi i Këshillit të Naltë, si një institucion regjence ishte një zgjidhje e detyruar nga rrethanat.

Por, vendosja në krye të shtetit e Këshillit të Naltë me katër anëtarë nuk ishte e përshtatshme për situatën e Shqipërisë në atë kohë. Siç edhe e treguan ngjarjet në vitet pas Kongresit të Lushnjes, kjo formë qeverisjeje sillte përçarje në vend dhe mundësi shumë të mira për shtetet fqinje për të përfutur prej saj. Demokracia parlamentare, aq e përfolur në këtë kohë, nuk ishte forma më e mirë e qeverisjes për shtetin shqiptar por, ishte mundësia e vetme që kishin udhëheqësit e politikës shqiptare në atë kohë.

Në vitet 1920-1924 u krijua një kundërshti midis formës de jure të shtetit shqiptar dhe formës së zbatuar në praktikën e qeverisjes. Kjo, për faktin se u aplikua një formë republikane qeverisjeje, madje një formë origjinale me një kryetar shteti kolegial në krye.⁴⁰⁵

Edhe pse “Bazat e Kanunores” i referoheshin kryesisht Këshillit të Lartë, parimet e sanksionuara në të përfshinin tërë veprimtarinë shtetërore, dhe jo drejtpërdrejt, por përmes ligjit mbi Këshillin e Lartë; ai nuk përmbante as ligjin e plotë mbi të, por vetëm bazat e tij, ashtu siç edhe shihet nga vetë emërtimi i këtij dokumenti.

Një nga aktet më të rëndësishme ligjore, i miratuar nga Këshilli Kombëtar ishte Rregullorja e brendshme. Ndonëse Rregullorja, si çdo akt parlamentar i kësaj natyre, i kushtohej organizimit të brendshëm, ajo i kapërceu këta kufi dhe me nenin 45 vendosi një parim me karakter kushtetues. Në të thuhej se: “Këshilli Kombëtar me një shumicë prej 2/3 të numrit të anëtarëve të tij, mund të miratonte zgjerimin ose përmirësimin e Statutit të Lushnjes”.

Kjo pikë e Rregullores shërbeu si bazë juridike për plotësimin e Statutit të Lushnjes, që u bë nga fundi i vitit 1922 me “zgjerimin e Statutit të Lushnjes”.

Ky ishte një zhvillim shumë i rëndësishëm në krijimin e bazave konstitucionale të shtetit, ndonëse ishte provizor. Por, përveç mungesës së karakterit adekuat të këtij ligji themeltar në raport me situatën politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të shoqërisë shqiptare, duhet nënvizuar fakti se: miratimi i tij dy vjet pas Kongresit ishte një mangësi tjetër, pasi vonoi stabilizimin e shtetit mbi baza kushtetuese, duke ndikuar ndjeshëm në stimulimin

⁴⁰⁴ Po aty, f. 35.

⁴⁰⁵ Sali Hidri, *Këshilli i Lartë dhe forma e regjimit të shtetit shqiptar në vitet 1922-24*, Në: “Çështje të lëvizjes demokratike dhe revolucionare shqiptare në vitet 1921-1924”, Tiranë: Instituti i Historisë, f. 77.

e krizave institucionale dhe politike, siç ishin ato të fundit të vitit 1921 dhe të fillimit të vitit 1922.

Zhvillimet politike të viteve 1921-1923 vunë në provë të gjitha institucionet politike shtetërore të krijuara nga Kongresi i Lushnjës. Kriza më e rëndë institucionale ndodhi në tre mujorin e fundit të vitit 1921.⁴⁰⁶ Grushti i shtetit, dhe më pas si rezultat i tij, rënia e dy anëtarëve të Këshillit të Lartë shënoi pikën më kritike të këtij organi të lartë kushtetues. Duke sjellë edhe dështimin e formulës qeverisëse të përzgjedhur në Kongresin e Lushnjës.

Luan Omari bën këtë vlerësim të gjendjes së vendit në atë kohë: “Pas Kongresit të Lushnjës, Shteti Shqiptar i rimëkëmbur u konceptua sipas modelit të një demokracie liberale dhe në këtë drejtim u bënë disa hapa të rëndësishëm. Por, prapambetja e madhe ekonomike, shoqërore e kulturore, trashëgimia e rëndë e së kaluarës, gjendja e anarkisë dhe mbizotërimi i forcave konservatore të lidhura me sistemin feudal ishin një pengesë e madhe për zhvillimin e një rendi demokratik dhe për vendosjen e një shteti juridik”.⁴⁰⁷

Këtu shihet mjaft qartë se autori edhe pse ka hiperbolizuar demokracinë liberale si formën më të mirë të qeverisjes, përsëri nuk u shmanget dot kritikave dhe pohon ndonëse në mënyrë të tërthortë se, kjo formë ishte e pamundur të aplikohet në realitetin shqiptar të asaj kohe.

“Zgjerimi i Statutit të Lushnjës”, ishte një akt kushtetues i cili u mbështet në “Bazat e Kanunores së Këshillit të Lartë” dhe në historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri njihet me termin “Statuti i Shtetit Shqiptar” i vitit 1922. “Statuti i Zgjeruar i Lushnjës”, kishte një karakter demokratik, kombëtar e origjinal. Aurela Anastasi e vlerëson aq lart këtë Statut sa e konsideron si: “një akt krenarie për të drejtën kushtetuese shqiptare”.⁴⁰⁸ Vetë emërtimi i statutit të aprovuar pasqyrore lidhjen e tij të pandashme me dokumentin kushtetues të Lushnjës: ai ishte vazhdim dhe plotësim i Statutit të Lushnjës.⁴⁰⁹

Çështja e parë që trajtohej në këtë Statut ishte ajo mbi formën e qeverisjes. Duke dashur t'i përmbahej për këtë çështje jo vetëm frymës së Statutit të Lushnjës, por edhe germës së tij, ashtu siç u kërkua nga vetë deputetët, në të sanksionohej se Këshilli i Lartë “zë përkohësisht...vendin e mbretit” (neni 1).⁴¹⁰ Pra, mbetej ende e papërcaktuar forma e qeverisjes si dhe kreu i shtetit.

Statuti i Zgjeruar trajtonte të gjithë problematikën e së drejtës kushtetuese: pushtetin legjislativ, pushtetin ekzekutiv dhe pushtetin gjyqësor.

Sipas kushtetutave të shteteve të tjera, në veprimtarinë legjislativë merrte pjesë, si rregull, edhe kryetari i të ashtuquajturit pushtet ekzekutiv, kurse sipas Statutit të Lushnjës dhe zgjerimit të tij, -jo. Këshilli i Lartë nuk kishte asnjë kompetencë në raport me parlamentin. Ndodhte vetëm e kundërta, e pashprehur drejtpërdrejt nga statuti, por plotësisht e nënkuptuar.⁴¹¹

⁴⁰⁶ Afrim Krasniqi, *Sistemet Politike në Shqipëri 1912-2008*, Tiranë, 2009, f. 81-81.

⁴⁰⁷ Luan Omari, *Shteti i së drejtës*, Tiranë, 2002, f. 43-44.

⁴⁰⁸ Aurela Anastasi, *Historia e të drejtës kushtetuese në Shqipëri 1912-1939*, Tiranë: “Pegi”, 2007, f. 50-51.

⁴⁰⁹ Gramoz Hysi, *Organizimi i shtetit shqiptar dhe lufta politike rreth tij në vitet 1920-24 ...*, f. 140.

⁴¹⁰ “Statuti i Shtetit Shqiptar”, Tiranë 1922.

⁴¹¹ Gramoz Hysi, *Organizimi i shtetit shqiptar dhe lufta politike rreth tij në vitet 1920-24...*, f. 153.

Raportet e parlamentit me Këshillin e Lartë dhe me qeverinë statuti i linte sikurse më parë: të një varësie të tërthortë me Këshillin e Lartë dhe të drejtpërdrejtë me qeverinë.⁴¹² Përsa i përket pushtetit gjyqësor, Statuti i Zgjeruar sanksiononte parimin e njohur të pavarësisë së gjykatave.

Ashtu si “Bazat e Kanunores së Këshillit të Naltë”, Statuti i Shtetit Shqiptar i vitit 1922, sanksiononte parimin e ndarjes së pushteteve. Por në ndryshim nga “Bazat e Kanunores së Këshillit të Naltë”, ky ishte një statut më demokratik dhe më original. Në të afirmoheshin edhe dy parime themelore kushtetuese si: “Mospërgjegjësia e mbretit (Këshillit të Naltë) për aktet e përmbushura gjatë ushtrimit të detyrës së tij” dhe “Përgjegjësia e ministrave përpara Parlamentit”(neni 40).

Ky statut sanksiononte për herë të parë, parimin e barazisë së qytetarëve përpara ligjit dhe liritë dhe të drejtat themelore të qytetarëve, çka e bënte atë një akt kushtetues me karakter perëndimor.

Statuti i Zgjeruar i Lushnjës, edhe pse shënonte një fazë më të avancuar të përcaktimit të rendit shtetëror, kishte po ashtu karakter të përkohshëm. Ky fakt përcaktohet edhe në tekstin e tij, ku thuhet se: “Ky Statut është ligji themelor i shtetit shqiptar derisa Kuvendi Kushtetues të mos ketë vendosur Statutin definitiv”. (neni 128)⁴¹³

Gjithsesi, Këshillit Kombëtar iu dhanë prerogativa të gjera, sipas modelit të një parlamenti demokratik klasik. Tipari më karakteristik i “Statutit të Zgjeruar” ishte vendosja e regjimit parlamentar.

Me interes është ta shqyrtojmë përmbajtjen e “Statutit të Zgjeruar të Lushnjës” në raport me kushtet dhe situatën e atëherëshme në Shqipëri. Këtu kemi një shembull, se si një kushtetutë e përparuar dhe moderne, kur nuk i përgjigjej nivelit të zhvillimit dhe mentalitetit të vendit, mund të dëmtojë funksionimin e shtetit dhe stabilitetin e tij. Kështu, ky akt nga një instrument pozitiv e progresiv, u shndërrua në një faktor destabilizues dhe shkatërrimtar për shtetin. Pra, kjo është një provë se procesi i ndërtimit të institucioneve, nuk duron diletantizëm dhe amatorizëm, edhe kur këto janë të frymëzuara nga qëllime fisnike siç është demokracia, pasi mund të shoqërohet me një kosto të lartë për shtetin.

Për këtë arsye, duhet marrë me rezervë konkluzioni i disa historianëve, të cilët e kanë vlerësuar vetëm pozitivisht “Zgjerimin e Statutit të Lushnjës”, pa marrë parasysh vërejtjet e lartpërmendura që lidhen me faktin se, “Statuti i Zgjeruar” krijoi probleme të mprehta në funksionimin e institucioneve dhe në stabilitetin e tyre. Luan Omari dhe Gramoz Hysi pohojnë se, “deputetët me orientim përparimtar patën shumicën në komision dhe ata ndikuan në përpunimin e normave sa më të përparuara të së drejtës kushtetuese. Kjo pati si rezultat që akti i plotësuar kushtetues të ruante frymën demokratike të sanksionuar në Lushnjë”.⁴¹⁴ Ata nuk bëjnë asnjë koment dhe vlerësim për ndikimin e këtij dokumenti kushtetues në procesin politik dhe të ndërtimit të shtetit. Të kundërtën mendon politikani i asaj kohe Sejfi Vllamasi. Ai në kujtimet e tij pohon: “Shumica e deputetëve, nga dëshira e zjarrtë për ta parë popullin në një nivel të lartë qeverisje, kujtoi se ky nivel mund të arrihej me shpejtësi, duke i dhënë një popull të pazhvilluar liritë të pamerituara për të dhe duke u lënë dorë të lirë aventurierëve,

⁴¹² Po aty, f. 149.

⁴¹³ “Statuti i Shtetit Shqiptar”, Tiranë 1922.

⁴¹⁴ Luan Omari, Sistemi Parlamentar, f. 108; G. Hysi, Organizimi i shtetit shqiptar dhe lufta politike rreth tij në vitet 1920-24 ..., f. 137-141.

ambiciozëve dhe veglave të të huajve për intriga dhe demagogji me qëllim që ta gabonin popullin dhe ta bënin vegël për qëllimet e tyre jo legjitime”.⁴¹⁵

Në këtë linjë mendimi është edhe studiuesi i njohur Bernd J. Fischer, i cili në punimin e tij “Ahmet Zogu, Mbreti shqiptar mes dy luftërave”, ndër të tjera shkruan: “Në vitin 1924 ai kishte dëshmi të mjaftueshme për të mëtuar se, sistemi i një principate parlamentare që ishte ndërtuar prej Fuqive të Mëdha në vitin 1912, nuk i shkonte për shtat kushteve të vendit. Dështimi i Fan Nolit ishte një tjetër dëshmi e faktit se jo vetëm sistemi nuk funksiononte, por që Shqipëria në të vërtetë mund të shkonte keq e më keq duke vijuar në këtë hulli. Parlamentarizmi sipas orientimit perëndimor jo vetëm që kishte dështuar të hidhte bazat për një zhvillim të qëndrueshëm të vendit, por i kishte shtuar edhe një tjetër dimension, atë të politikës, nivelit tanimë alarmues të dhunës së brendshme”.⁴¹⁶

Periudha mes viteve 1920-1924, ishte një periudhë e përplasjeve mes trashëgimisë së sundimit osman dhe përpjekjeve për futjen e elementëve demokratikë në politikën shqiptare. Ky fakt solli krijimin e qeverive të ndryshme dhe paqëndrueshmëri në arenën politike të kohës.

Ka shumë arsye për të cilat sistemi i demokracisë liberale nuk funksionoi në Shqipëri.

Më kryesorja ishte prapambetja e theksuar ekonomike e vendit. Pa ekzistencën e një rrjeti të zhvilluar komunikacioni nuk mund të mendohej të ndërtohej një sistem i tillë.

Prapambetja kulturore ishte një tjetër arsye. Në këtë periudhë pjesa më e madhe e popullsisë ishte analfabete. Shqipëria në atë kohë ishte e përçarë politikisht. Akoma nuk ishte eliminuar sistemi fisnor. Politikanët e kohës ishin të pajisur me forca personale të armatosura. Është absurde të mendohej se këta politikanë mund të ndërtonin një sistem kushtetues demokratik.

Ky sistem krijonte përçarje fetare, dhe shpesh herë popullsia bëhej pre e presioneve të fqinjëve.

As situata ndërkombëtare nuk favorizonte zbatimin e sistemit demokratik.

Ekzistenca e një shteti autokratik i përshtatej më shumë kushteve në të cilat ndodhej shteti shqiptar në këtë periudhë. Por gjendja e forcave politike, që u bashkuan në Kongresin e Lushnjes dhe më pas, për krijimin e shtetit të ri të pavarur shqiptar, nuk krijonte premisa dhe mundësi për një formë të tillë shtetërore. Në këtë mënyrë parlamenti dhe parlamentarizmi, përveçse si ideal qeverisës, shërbeu edhe si një modus vivendi për të ndërtuar shtetin në rrethanat e një copëzimi politik të thellë dhe prapambetje të gjithanshme.

Sistemi demokratik i vendosur nga Kongresi i Lushnjes u bë joefektiv. Ai nuk solli stabilitet politik dhe ekonomik në vend, por përkundrazi, solli destabilitet, derisa e çoi shtetin në shkatërrim për shkak të grushteve të shtetit dhe kryengritjeve të shumta që karakterizuan këtë periudhë.

Si përfundim mund të themi se, kjo formë qeverisjeje dhe e formatimit të institucioneve kombëtare, nuk i përshtatej mundësive reale që kishte kombi shqiptar në atë kohë. Për këtë arsye, ajo jo vetëm që dështoi, por edhe ishte një nga faktorët që prodhoi destabilitet dhe kriza të rënda e të rrezikshme për vetë ekzistencën e shtetit shqiptar.

⁴¹⁵ Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942*, Tiranë: 2000, f. 285-286.

⁴¹⁶ Bernd J. Fischer, *Ahmet Zogu, Mbreti shqiptar mes dy luftërave*, f. 42-43.

ÇËSHTJA E KOSOVËS NË POLITIKËN SHQIPTARE NË FUND TË SHEKULLIT XX

Alida Avdullari

Hyrje

Në përfundim të Luftës së Dytë Botërore shqiptarët shpresonin se çështja e Kosovës do të zgjidhej në bazë të parimit të vetëvendosjes, si parashikohej në Kartën e Atlantikut. Vetë PKJ kishte deklaruar se në Jugosllavinë e re do të respektohej vullneti i popullit. Përfaqësuesit e ligjshëm të popullit të Kosovës në Konferencën e Bujanit, dhjetor-janar 1944, kishin shfaqur vullnetin e tyre për bashkimin pas luftës së Kosovës me Shqipërinë. Por zhvillimet ndërkombëtare dhe ato në Jugosllavi e në Kosovë nuk i justifikuan këto shpresa. Në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, as Shqipëria dhe as shqiptarët në Jugosllavi nuk patën mbështetjen e duhur ndërkombëtare për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Para përfundimit të luftës diplomacia britanike dhe ajo amerikane nuk e përkrahën idenë e ndryshimit të kufijve midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë dhe aq më pak, mund të pritej kjo nga Bashkimi Sovjetik. E ardhmja e Jugosllavisë për Fuqitë e Mëdha kishte qënë objekt diskutimi në konferencat ndërkombëtare dhe ato kishin arritur një kompromis, që pajtonte përkohësisht interesat e tyre, por dhe ato të palëve kundërshtare brenda në Jugosllavi. Ky kompromis u vulos përfundimisht në Konferencën e Jaltës (4-11 shkurt 1945) të Fuqive të Mëdha, ku Jugosllavisë iu njohën dhe iu garantuan kufijtë e paraluftës.⁴¹⁷ Shqipëria, çështjen e Kosovës nuk e ngriti në konferencat ndërkombëtare, ose pranë kancelarive të Fuqive të Mëdha, pasi ajo nuk kishte as forcën dhe as mbështetjen e duhur ndërkombëtare, por edhe për të mos krijuar probleme në marrëdhëniet me Jugosllavinë. Shteti jugosllav, duke shfrytëzuar rrethanat dhe qëndrimin e Aleatëve, përgjithësisht për çështjen e kufijve, në fundin e vitit 1944 dhe në fillimin të 1945 e bëri të qartë, se nuk do të lejonte shkëputjen e Kosovës dhe bashkimin e saj me Shqipërinë. Madje, nisi zbatimin e politikës së dhunës ndaj shqiptarëve dhe Kosovës i imponoi “bashkimin vullnetar” me Serbinë, si një njësi autonome e saj. Kjo pasi, qysh në 3 shtator 1945, Kuvendi i Serbisë kishte hartuar ligjin “Mbi caktimin dhe ndërtimin e Rajonit Autonom të Kosovë-Metohisë (RAKM). Ligi, i cili sanksiononte juridikisht Kosovën si njësi autonome. Ndërsa në kushtetutën e RSFJ të vitit 1963 ndodhi një ndryshim në emërtimin e saj nga rajon në krahinë (KAKM). Megjithëse formal dhe nuk solli asgjë të re në përmbajtje. Si pasojë e riorganizimit shtetëror të RSFJ, në vitet 1967,1968, 1971 pati diskutime lidhur me statusin e saj. Si pasojë e këtyre diskutimeve, tashmë Krahina Socialiste Autonome e Kosovës (KSA), arriti të fitojë disa të drejta krahasuar me të kaluarën të finalizuara në kushtetutën e vitit 1974. Pavarësisht

⁴¹⁷Histori e Popullit Shqiptar.(2009). Vëll.IV.Akademia e Shkencave, Tiranë, Toena,fq. 244

kësaj, krahiana vazhdonte të ishte e varur nga RS e Serbisë.⁴¹⁸ Në këto kushte pikat kyçe të pushtetit të administrimit të saj vazhdonin ti menaxhonin serbët, veçanërisht politikën e jashtme. Nga ana tjetër, për shkak të marrëdhënieve të vendosura me Jugosllavinë në këto vite, të ndikimit që Titoja kishte në udhëheqjen e Partisë Komuniste të Shqipërisë, Tirana nuk guxonte të ngrinte zërin për padretëjsitë dhe shtypjen që u bëhej shqiptarëve në Kosovë. Politika zyrtare e Tiranës, në vitet 1945-1948 prirëj më së shumti nga shmangia e diskutimit të kësaj çështjeje në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Lideri komunist, nisur nga pozitat e tij të dobëta e të pakonsoliduara në udhëheqjen shqiptare, nuk ishte i interesuar që t'i acaronte marrëdhëniet me Titon dhe PKJ. Megjithatë, gjatë vizitës së tij zyrtare në Jugosllavi, në verën e vitit 1946, ai e ngriti këtë çështje, por përgjigja e Titos ishte se bashkimi i Kosovës me Shqipërinë nuk mund të bëhej tani për tani, pasi kjo nuk mund të pranohej nga Serbia.⁴¹⁹ I gjendur në një situatë të tillë, E.Hoxha në Pleniumin e jashtëzakonshëm të KQ të PKSH, në dhjetor 1946, shprehej për çështjen e saj: “në rast se një anëtar partie e ka të qartë vijën e partisë ai e ka të qartë dhe çështjen e Kosovës. Jugosllavia demokratike është më e avancuar, më e përparuar se ne. A është në interesin tonë të kërkojmë Kosovën? Kjo nuk është progresiste. Kur ne të arrijmë në socializëm, kur në Jugosllavi dhe Shqipëri mbeturinat e kapitalizmit të jenë zhdukur, atëherë në një situatë të tillë Kosova do të bashkohej me RPSSH-në.”⁴²⁰ Në këto rrethana, kjo çështje ishte sqaruar deri diku dhe diskutimet zyrtare rreth saj qenë të pakta në vitet në vijim.

Politika shqiptare ndaj demonstratave të vitit 1981 në Kosovë

Shqipëria në fund të viteve '70-të, pas prishjes së marrëdhënieve me Kinën, u ndodh për herë të parë pas Luftës së Dytë Botërore pa mbështetjen e një fuqie të madhe. Në këto kushte, u vendos sistemi i triskëtitimit për të gjeneruar deri në krizë ekonomike në fund të viteve '80-të.⁴²¹ Ndërsa në aspektin politik po bëhej gjithnjë e më e nevojshme ndërmarrja e reformave që synonin një sistem më demokratik dhe shkëputje plotësisht nga regjimi ekzistues. Dukej qartë që regjimi komunist ishte në grahamat e fundit. Ai ishte konsumuar dhe për këtë filluan të merren iniciativat e para për një regjim demokratik. Kjo u duk në krijimin e partive politike, në dhjetor 1990, lejimin e disa lirive dhe të drejtave të individit dhe gjithashtu në përpjekjet për daljen nga izolimi i plotë që i ishte bërë vendit.⁴²² Një situatë e tillë ishte bërë shtysë, që në kongresin e VIII të Partisë së Punës së Shqipërisë të mbajtur në nëntor 1981, lideri komunist të formulonte në vija të përgjithshme parimet e politikës së jashtme në formën e një testamenti. Aty shpreheshin orientimet kryesore në aspektin ekonomik, politik, social dhe kulturor.⁴²³ Në këto orientime, një vend të rëndësishëm zuri dhe kompleksiteti në marrëdhëniet me Jugosllavinë, i cili vinte para së gjithash nga ndryshimet serioze në politikën e Federatës. Vdekja e Josif Broz Titos, në vitin 1980, ringjalljet e rivaliteteve të vjetra nacionaliste brënda Jugosllavisë dhe evoluimet që po trondisnin tërë sistemin e Luftës së Ftohtë në dekadën e fundit të saj, kishin nxitur procese të brëndshme politike, ekonomike dhe etnike në Federatën Jugosllave. Ky përshkallëzim i komplikimeve shqiptaro-jugosllave në

⁴¹⁸ Po aty, fq.365-366,376

⁴¹⁹ Po aty, fq.245

⁴²⁰ Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948, (1996).Dokumente, AQSH, Tiranë,fq.73

⁴²¹ *Histori e Popullit Shqipëtar*. (2009). Vëll.IV.vepër e përmend.fq.320

⁴²² Dervishi, K. (2006). *Historia e shtetit shqipëtar 1912-2005*, 55,Tiranë,fq.788-789

⁴²³ Bashkurti, L. (2004). *Diplomacia e veteizolimit*,Tiranë,Akademia Diplomatike Shqiptare,fq.583

këtë periudhë vinte dhe nga disa ndryshime të rëndësishme, në politikën e jashtme e shtetit shqiptar lidhur me statusin dhe trajtimin e shqiptarëve që jetonin në Jugosllavi, veçanërisht atyre në Kosovë.⁴²⁴

Lideri komunist në kongresin e VIII, për herë të parë bëri një vështrim historik mbi Kosovën dhe shpалosi qëndrimin e tij rreth çështjes së saj. Një shtysë për këtë analizë ishte bërë dhe situata e rëndë në Kosovë e pranverës së vitit 1981. Megjithëse në dukje, klima në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në këtë kohë, ishte shoqëruar me zhvillim të lidhjeve ekonomike, kulturore, shkencore dhe arsimore të Shqipërisë me Kosovën, populli i Kosovës e veçanërisht rinia, ishin të pakënaqur nga trajtimi që i bëhej Krahinës në pikëpamje ekonomike dhe sociale dhe nga statusi që kishte Kosova në kuadër të Serbisë e të Federatës.⁴²⁵ Në fakt, shqiptarët e Kosovës asnjëherë nuk ishin pajtuar me fatin e tyre të pasluftës së Dytë Botërore si pjesë e kësaj Federate. Gjatë gjithë kohës kishte patur përpjekje për të kërkuar liritë dhe të drejtat e tyre dhe të konsideroheshin të barabartë me kombet e tjera të saj. Këto kërkesa ishin shfaqur për vite me radhë, duke filluar nga viti 1964, për të vazhduar më 1968, më tutje në 1974 dhe kishin kulmuar në 1981.⁴²⁶ Demonstratat e vitit 1981 ishte ato që kulmuan dhe sensibilizuan botën mbarë, pasi aty u tregua qartë natyra e nacionalizmit serb. Këto demonstrata të nisura në 11 mars 1981, fillimisht për shkaqe ekonomike me parrullat: 'Duam bukë', 'Duam kushte', do të merrnin më pas tipare politike me parrulla të tilla: 'Poshtë borgjezia', 'Unitet', 'Rroftë vëllazërimi i popullit shqiptar', 'Bashkimi i të gjitha viseve shqiptare', 'Jemi shqiptarë dhe jo jugosllavë'.⁴²⁷

Qeveria shqiptare mbështeti që në fillim kërkesat e tyre dhe dënoi dhunën e ushtruar ndaj demonstruesve paqësorë. Në tre artikuj redaksional të botuar në Zërin e Popullit, organ i KQ të PKSH, në datat 8,23 prill dhe 17 maj të vitit 1981 u bëhej një analizë e gjithanshme shkaqeve që çuan në këto ngjarje, politikën diskriminuese të ndjekur prej vitesh ndaj shqiptarëve, mohimit që u ishte bërë të drejtave të tyre legjitime kombëtare, demokratike dhe humane. Në to i bëhej thirrje udhëheqjes jugosllave, që problemet e akumuluar t'i trajtonte me kujdes dhe qetësi, në dialog me shqiptarët duke hequr dorë nga imponimi e sidomos përdorimi i dhunës, "ndryshe,- paralajmërohej ajo, problemi do të acarohet e do të komplikohet më tej dhe një acarim i tillë do të influenconte në marrëdhëniet midis dy vëndeve".⁴²⁸

Si pasojë e përkrahjes publike që udhëheqja politike e Shqipërisë u bëri këtyre demonstratave, udhëheqësit e Jugosllavisë e fajësuan atë se i kishin nxitur këto demonstrata.⁴²⁹ Por, sekretari i KQ të PPSH-së, Ramiz Alia në një intervistë të tij, në lidhje me ngjarjet e vitit 1981 në Kosovë, shprehej se: "ngjarjet e vitit 1981 për ne kanë qënë krejtësisht të papritura. Nuk kishim asnjë të dhënë për këto ngjarje".⁴³⁰ Jo vetëm zyrtarisht, por dhe në kujtimet personale, në ditarin e tij sekret të viteve '80-82, E.Hoxha ndër të tjera, kishte shumë shënime ku argumentonte shkaqet e krizës së Kosovës. Në këto shënime ai ishte shprehur se:

⁴²⁴ Po aty, fq.591-593

⁴²⁵ *Histori e Popullit Shqiptar*.(2009). Vëll.IV.vepër e përmend.fq.320

⁴²⁶ *Çështja e Kosoves nje problem historik dhe aktual*,(1996).Instituti i Historise Prishtine-Tiranë,Simpozium i mbajtur më 15-16 prill 1993, Tiranë, fq.214

⁴²⁷ *Demonstratat e vitit 1981 bazë e fortë drejt fitores*, (mars 1988), Zëri i Kosovës, Organ i lëvizjes popullore për Republikën e Kosovës, fq.1

⁴²⁸ ATSH. (1981, 8 prill). Pse u përdor dhuna policore dhe tanket kundër shqiptarëve në Kosovë , Zëri i Popullit,fq.4

⁴²⁹ *Histori e Popullit Shqiptar*.(2009). Vëll.IV.vepër e përmend.fq.393

⁴³⁰ Alia, R. (1993). *Unë Ramiz Alia dëshmoj për historinë*, Dituria,Tiranë,fq.289

“kërkesa për t’i njohur Kosovës, statusin e Republikës brënda Federatës është një kërkesë e drejtë, ajo nuk çënon ekzistencën e Federatës.” Gjithashtu, ai mohonte akuzat që bënte politika jugosllave dhe serbe sipas të cilave Shqipëria ndërhynte në punët e brendshme të Jugosllavisë, frymëzonte dhe nxiste lëvizjet politike në Kosovë dhe ishte për shkatërrimin e Federatës Jugosllave. Ai theksonte: “Asnjëherë Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë nuk ka ndërhyrë në punët e brendshme të Jugosllavisë. Por duke mbajtur këtë qëndrim ne nuk kemi mohuar dhe as do të mohojmë kurrë faktin se në Jugosllavi rron një pjesë e madhe e kombit dhe e popullit shqiptar.”⁴³¹ Fakti që politika e jashtme e Shqipërisë i rikthehej pas 35 vjetësh, analizës dhe reflektimit historik mbi çështjen e shqiptarëve në Jugosllavi, veçanërisht çështjes së Kosovës, ishin hapa të rinj në politikën shqiptare. Me këto qëndrime të shpalosura, si në Kongresin e VIII, ashtu dhe në kujtimet e veta, lideri komunist fitoi respekt brënda faktorit shqiptar në Ballkan dhe sidomos në Kosovë. Kjo, pasi ai mbështeti kërkesat e tyre politike dhe shmangu përplasjet me faktorët ndërkombëtar, të cilët kundërshtonin ndryshimin e kufijve të shteteve sovraane ndërkombëtarisht të njohura.⁴³² Edhe pas demonstratave të vitit 1981, statusi shoqëror-politik e juridik i shqiptarëve dhe i vetë Krahinës Autonome të Kosovës erdhi duke u minimizuar. Qeveria serbe kishte miratuar një varg vendimesh për këtë qëllim.⁴³³ Ndjekjet e shqiptarëve, diferencimet politike, arrestimet, dënimet dhe burgosjet u vunë në rendin e ditës. Universiteti i Prishtinës u shpall ‘kështjellë e nacionalizmit shqiptar’, dhe çdo marrëdhënie e tij me Universitetin e Tiranës u ndërpre. Tekstet e botuara në shqip u hoqën nga përdorimi.⁴³⁴ Gjendja për shqiptarët e Kosovës u bë më e vështirë pas ardhjes së Sllobodan Millosheviçit, në krye të Serbisë, në gjysmën e dytë të viteve ‘80-të. Autoritetet e Beogradit u hodhën në sulm ndaj pozitës kushtetuese të KSA të Kosovës. Autonomia e saj u quajt “kancer në gjirin e Serbisë”.

Udhëheqja e Kosovës nuk qe në gjëndje të reagojë me efikasitet. E traumatizuar, ose e pajtuar me gjëndjen e krijuar gjatë viteve 1981-1989, i la fushë të lirë veprimi politikës serbe.⁴³⁵ Ndër objektivat e qarqeve drejtuese të Beogradit, gjatë represionit në këto vite kishte qënë dhe shkatërrimi i lëvizjes ilegale shqiptare që kishte si synim bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Shërbimi Sekret Jugosllav (UDB), kreu dhe likuidimin e disa prej veprimtarëve të kësaj lëvizjeje. Në 17 janar 1989 në Shtutgart të Gjermanisë u ekzekutua me atentat Jusuf Gërvalla, Bardhosh Gërvalla, Kadri Zeka, veprimtarë të organizatave ilegale që luftuan për çlirim dhe bashkim kombëtar.⁴³⁶

Të nxitur nga këto ngjarje, por duke parandier rrezikun e ndërprerjes së lidhjeve të drejtëpërdrejta me Federatën, shqiptarët e Kosovës iu përgjigjën mitingjeve serbe me kundër mitingje në dimrin e viteve 1988-1989. Ndërkohë, në diskutimet kushtetuese të këtyre viteve dhe në projektet e paraqitura nga Serbia dhe grupimi kroato-slloven, Kosova parashikohej të ishte pjesë përbërëse e Serbisë. Si pasojë e kësaj, pavarësisht revoltave dhe grevave mbarëpopullore të vitit 1988, apelimit të 215 intelektualëve kosovarë drejtuar opinionit jugosllav dhe Serbisë, në rrethanat e administrimit ushtarak, në 23 mars 1989, me dhunën e tankeve dhe me falsifikime,

⁴³¹ Bashkurti, L. (2004). *Diplomacia e vetëizolimit*, Tiranë, Akademia Diplomatike Shqiptare, fq.602-603

⁴³² Po aty

⁴³³ *Histori e Popullit Shqiptar*. (2009). Vëll.IV.vepër e përmend.fq.395

⁴³⁴ Verli, M. (2007). *Shqipëria dhe Kosova, historia e një aspirote*, Botimpex, Tiranë, fq.312

⁴³⁵ *Histori e Popullit Shqiptar*. (2009). Vëll.IV.vepër e përmend.fq.395

⁴³⁶ Verli, Marenglen. (2007). *Shqipëria dhe Kosova, historia e një aspirote*, Botimpex, Tiranë, fq.312

Kuvendi i Kosovës u detyrua të miratonte ndryshime në Kushtetutën e Kosovës të vitit 1974. Këto në fakt likuiduan autonominë e krahinës. Në 28 mars, amendamentet u miratuan edhe në Kuvendin e Serbisë. Në Beograd 28 marsi u kthye në festë të vërtetë, ndërsa në Ferizaj, në Prishtinë, në Podujevë, në Mitrovicë, Gjakovë etj. shpërthyen demonstratat dhe 25 manifestues u vranë.⁴³⁷

Në janar 1990 kryesia e Jugosllavisë votoi amendamentin, që Kosovës t'i hiqej statusi i elementit konstituiv federative. Me këtë akt Kosova shkëputte lidhjet me Federatën. Pasi e vuri Kosovën nën diktatin e saj të plotë, Serbia me një akt të Kuvendit republikan ndërpreu punën e Kuvendit të Kosovës. Pasuan disa ligje republikane, që e rrënuan përfundimisht autonominë e krahinës në të gjitha fushat e jetës.⁴³⁸

Shqiptarët e Kosovës duke përfutur nga lejimi i pluralizmit partiak në Jugosllavi, krijuan partinë e tyre të parë, Lidhjen Demokratike të Kosovës me kryetar shkrimtarin e njohur Ibrahim Rugovën. Lidhja Demokratike e Kosovës angazhohej për zgjidhjen e problemit kombëtar. Jo vetëm kaq ajo angazhohej për ngritjen e një shoqërie civile në Kosovë dhe zgjidhjen e problemeve ekonomike.⁴³⁹ Në këto rrethana, deputetë shqiptarë të Kuvendit të Kosovës ndërmorën hapa proceduriale për nxjerrjen e një kushtetute të re. Në 2 korrik të vitit 1990, 115 deputetë shqiptarë shpallën 'Deklaratën Kushtetuese', të cilësuar si dokumentin themelor mbi pavarësinë nga Serbia dhe barazinë e Kosovës me njësitë e tjera në Federatën apo Konfederatën e ardhshme jugosllave.⁴⁴⁰ Në 5 korrik 1990, Kuvendi i Serbisë si kundërpërgjigje shpërndau Kuvendin e Kosovës dhe shkarkoi qeverinë e saj. Krahina u vendos nën një administrim të veçantë, Serbia po zbatonte në Kosovë një politikë të mirëfilltë pushtuese.⁴⁴¹ Deputetët shqiptarë të Kuvendit të Kosovës reagueshan duke shpallur në Kaçanik më 7 shtator të vitit 1990 'Kushtetutën e Republikës së Kosovës'. Kjo kushtetutë pohonte sovranitetin dhe barazinë e popullit shqiptar të Kosovës me popujt e tjerë jugosllavë.⁴⁴² Shpallja e Republikës në Kosovë u bë në një kohë, kur ende nuk ishte shpërbërë Federata Jugosllave dhe kur Kosova rrezikohej. Mund të themi se, ky ishte veprimi më logjik që mund të ndërmerrej.⁴⁴³ Pra, shqiptarët e Kosovës zgjodhën rrugën paqësore dhe jo të dhunës, duke krijuar institucione paralele, të cilat ishin ende në embrion. Ato u përfaqësuan me organizimin e arsimit ilegal shqiptar, qendrat për shpërndarjen e ndihmave ekonomike familjeve të varfra shqiptare, qendrat e shërbimit shëndetësor, për të sfiduar sistemin e instaluar serb në Kosovë. Shqiptarët e vunë Serbinë në sytë e botës në pozitën e një fuqie pushtuese, rrethanë kjo që binte edhe në sytë e vizitorëve më të zakonshëm të Kosovës.⁴⁴⁴ Politika e rezistencës paqësore ishte një politikë e mirëpritur dhe nga Perëndimi. Në kushtet kur në Slloveni, Kroaci e në Bosnje zhvilloheshin luftime të përgjakshme, Kosova qëndroi e qetë. Në gjysmën e parë të viteve '90-të, politika e rezistencës paqësore pati sukses në organizimin e institucioneve paralele shqiptare dhe

⁴³⁷ *Histori e Popullit Shqiptar*. (2009). Vëll.IV.vepër e përmend.fq.396

⁴³⁸ Veri, M. (2007). *Shqipëria dhe Kosova, historia e një aspirate*, Botimpex, Tiranë, fq.315

⁴³⁹ Po aty, fq.316

⁴⁴⁰ Po aty

⁴⁴¹ *Histori e Popullit Shqiptar*. (2009). Vëll.IV.Akademia e Shkencave, Tiranë, Toena, fq.397

⁴⁴² Repishti, S. (1996). *Koncepti i vetevendosjes dhe aktualiteti kosovar*, 'Çështja e Kosovës një problem historik dhe aktual', Instituti i Historisë Prishtinë-Tiranë, Simpozium i mbajtur më 15-16 prill 1993, Tiranë, fq.345

⁴⁴³ Lalaj, A. (1996). *Aspiratat e popullit shqiptar të Kosovës*, 'Çështja e Kosovës një problem historik dhe aktual', Instituti i Historisë Prishtinë-Tiranë, Simpozium i mbajtur më 15-16 prill 1993, Tiranë, fq.279

⁴⁴⁴ Hasani, E. (2000). *Shpërbërja e Jugosllavisë dhe Kosova*, MNS, Tiranë, fq.50

të organizimit të qëndresës kundërserbe.⁴⁴⁵ Nga ana tjetër, duhet theksuar se shpallja e Republikës nuk do të thoshte mohimi i aspiratës së shqiptarëve për bashkim kombëtar. E gjithë periudha e pas vitit 1968 dëshmonte se, aspirata për bashkim, e shprehur herë hapur e herë fshehur ka qënë e pranishme dhe është manifestuar pandërprerë te shqiptarët e Kosovës.⁴⁴⁶ Ndërsa, ndryshimet demokratike që po ndodhnin në Shqipëri, që nga dhjetori i vitit 1990, krijuan premisat e favorshme që ndihma, përkrahja dhe mbështetja për Kosovën të fitonte dimensione të reja. Për rrjedhojë dhe lufta për çështjen kombëtare në Kosovë u ngrit në një shkallë më të lartë.⁴⁴⁷ Mirëpo realiteti duhej parë në sy, me iluzione e premtime boshe nuk mund të shkohej gjatë. Organizma ndërkombëtare me peshë si dhe personalitete të larta të Europës dhe të Amerikës, presidentë e kryetarë shtetesh e bënë dhe njëherë të qartë se, edhe pas ndryshimeve që ndodhën në Shqipëri, politika amerikane dhe ajo europiane për çështjen e Kosovës nuk do të ndryshonte se, ajo do të vazhdonte t'i mbahej formulës se, "kufijtë nuk mund të ndryshohen me dhunë", për rrjedhojë dhe më tutje ta shikojë "Kosovën si pjesë e asaj që përbënte ish-Jugosllavinë."⁴⁴⁸

Edhe pse rruga paqësore e ndjekur nga lidershipi i Kosovës ishte inkurajuar nga shumica e anëtarëve të bashkësisë ndërkombëtare, me kalimin e kohës kjo qasje u kthye në një rreth vicioz për të gjitha palët: Kosovën, Serbinë dhe bashkësinë ndërkombëtare. Ndërsa për kosovarët pavarësia paraqiste një çështje mbijetese, për Serbinë Kosova shërbente si një mjet për mbajtjen e pushtetit. Ndërsa për bashkësinë ndërkombëtare ishte një çështje e sigurisë dhe stabilitetit ndërkombëtar.⁴⁴⁹ Këtë e tregoi dhe fakti, që pas vitit 1992 një konfiguracion i ri etnik e politik u krijua në territorin e Federatës Jugosllave. Sllovenët, kroatët, maqedonasit, krijuan republikat e veta të pavaruara, të cilat u njohën nga Europa.⁴⁵⁰ Ndërsa në Kosovë, në 26-30 shtator 1991 me anën e një Referendumi për Kosovën si shtet i pavarur sovran, votuan pro 90% e popullsisë. Në këto rrethana në tetor të po atij viti u formua Qeveria e Përkohshme e Kosovës, me kryetar Bujar Bukoshin. Më 24 maj 1992 u organizuan zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale. President i Republikës u zgjodh Ibrahim Rugova. Faktori ndërkombëtar nuk e njohu Republikën e Kosovës (përveç Republikës së Shqipërisë).⁴⁵¹ S.Milosheviçi dhe qeveria serbe pasi kishin shpërndarë parlamentin e Kosovës, në 5 korrik 1990, nuk njihnin më asnjë institucion ligjor në Kosovë. Një pjesë e anëtarëve të qeverisë së Kosovës u burgosën, ndërsa të tjerët se bashku me kryetarin Bujar Bukoshin, zhvillonin veprimtarinë e tyre në emigracion. Me paratë e mbledhura nga emigrantët shqiptarë, qeveria e Kosovës arriti të financojë institucionet shqiptare ilegale, që ekzistonin në Kosovë.⁴⁵² Kjo qeveri, i dorëzoi Konferencës Europiane për Paqe (EPC) kërkesën e saj për njohjen ndërkombëtare të Kosovës si një shtet sovran dhe i pavarur. Edhe pse Kosova ka poseduar gjithnjë territorin dhe popullsinë e saj, kërkesa për njohjen ndërkombëtare nuk u pranua. Sipas

⁴⁴⁵ *Histori e Popullit Shqiptar*.(2009). Vëll.IV.Akademia e Shkencave, Tiranë, Toena, fq.398

⁴⁴⁶ Lalaj, A. (1996). Aspiratat e popullit shqiptar të Kosovës,vep. e përmend.fq.279

⁴⁴⁷ Gjecovi, Xh. (1998). *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës*, Botimpex, Tiranë ,fq.155

⁴⁴⁸ *Po aty*, fq.156

⁴⁴⁹ Hasani, E. (2000) *.Shpërbërja e Jugosllavisë dhe Kosova*, MNS, Tiranë,fq.68

⁴⁵⁰ *Histori e Popullit Shqiptar*.(2009). Vëll.IV.Akademia e Shkencave, Tiranë, Toena, fq.398

⁴⁵¹ Vickers, M.(1996). *Roli i Kosovës në marrëdhëniet jugosllave-shqiptare pas luftës*, Çështja e Kosovës një problem historik dhe aktual, Instituti i Historisë Prishtinë-Tiranë,Simpozium i mbajtur më 15-16 prill 1993, Tiranë, fq.252

⁴⁵² *Histori e Popullit Shqiptar*.(2009). Vëll.IV.Akademia e Shkencave, Tirane, Toena,fq.398

kësaj konference, por dhe institucioneve përkatëse ndërkombëtare që merreshin me këtë çështje, organet që përfaqësonin Kosovën dhe popullsinë e saj në shumicë, nuk kishin arritur asnjëherë të kontrollonin efektivisht territorin dhe popullsinë në shumicë të Kosovës.⁴⁵³ Ndërkohë ndryshimet e realizuara në Shqipëri me fitoren e revolucionit demokratik, ligjërimi i pluralizmit partiak, hapja e saj me botën krijuan premisat e duhura që të bashkërendoheshin më mire veprimet me shqiptarët e Kosovës dhe viseve të tjera e të sigurohej një mbështetje më e gjerë, më efektive e Komunitetit Europian dhe e SHBA për këtë çështje. Në kuadër të këtyre ndryshimeve, në janar 1992, një miting i madh u mbajt në Tiranë, nga qeveria shqiptare në përkrahje të kosovarëve. Kërkesat në përkrahje të të drejtave të popullit kosovar për Republikë, ishin bërë brënda Shqipërisë, për një veprimtari qeveritare më të drejtëpërdrejtë në problemin e Kosovës.

Nga ana tjetër paralajmërimet serbe kundër ndërhyrjes së Tiranës në punët e Jugosllavisë u bënë më të ashpra. Politikanët shqiptarë në të vërtetë dëshironin të ofronin një angazhim të plotë për të ndihmuar popullsinë e Kosovës, por ata ishin shumë të kufizuar në mundësitë e tyre dhe vetëm mund të shprejonin për të bindur komunitetin ndërkombëtar për të ndërhyrë në emër të tyre.⁴⁵⁴ Një shtet i vogël dhe i dobët, me mundësi të kufizuara nuk kishte alternativë përveçse të kërkonte zbatimin e normave ndërkombëtare, duke u përpjekur për mbrojtjen e interesave kombëtare.

Një Shqipëri e zhvilluar dhe demokratike do të thoshte dhe një Shqipëri në krah të popullit shqiptar, jo vetëm brenda kufijve por dhe jashtë tyre.⁴⁵⁵ Sot që ne flasim pas një periudhe të gjatë, më shume se një dekadë nga vitet e mundimshme 1988-1989, Kosova ka fituar pavarësinë e saj dhe është njohur nga një sërë shtetesh të fuqishme botërore. Por dhe në ditët tona, aspirata për bashkim ende është e forte. Për studiuesin e njohur kosovar Rexhep Qosja në librin e tij "Shqipëria dhe Kosova si janë dhe si duhet të jenë", "Bashkimi i Kosovës me Shqipërinë sot është një çështje shumë më tepër se politike dhe ekonomike, është një çështje ekzistenciale historike".⁴⁵⁶

Nga sa u tha më sipër, konkludohet se Shqipëria që nga fundi i viteve '70-të, fillimi i viteve '80-të, shënoi hapa të rinj në qëndrimin ndaj çështjes së Kosovës. Por ky angazhim ka qënë më i madh pas ndryshimeve që solli revolucionin demokratik në Shqipëri. Gjithnjë brënda suazave të lejuara nga bashkësia ndërkombëtare, sepse zgjidhja e problemit nuk ishte thjesht dhe vetëm në duart e saj.

⁴⁵³Hasani, E. (2000). *Shpërbërja e Jugosllavisë dhe Kosova*, MNS, Tiranë, fq.51

⁴⁵⁴Vickers, M. (1996). Roli i Kosovës në marrëdhëniet jugosllave-shqiptare pas luftës, Vep.e përmend. fq.252

⁴⁵⁵Verl, M. (2007). *Shqipëria dhe Kosova, historia e një aspirate*, Botimpex, Tiranë, fq.328

⁴⁵⁶Qosja, R. (2013). *Shqipëria dhe Kosova si janë dhe si do të duhej të jenë*, Toena, Tiranë, fq.328

GJASHTË MUAJ PRINC I SHQIPTARËVE - TË METAT NË QEVERISJE DHE KËRCËNIMET

Alma Prendi

Hyrje

Konferenca e Ambasadorëve, e cila i zhvilloi punimet në Londër përgjatë viteve 1912 – 1913, mori në shqyrtim çështjen e njohjes së shtetit të saposhpallur shqiptar si dhe nisi konsultimet për përcaktimin e princit të ardhshëm të Shqipërisë. Kandidaturat për këtë post ishin në një numër jo dhe aq të vogël. U përmendën figura si: Princi i Montpasiësë, Don Aleandro Kastrioti, Gjika i Rumanisë, Rolando Bonaparte etj. Porta e Lartë, duke u nisur nga përbërja fetare e shqiptarëve, propozoi tre princa myslimanë: princ Burhanedinin, djalin e tretë të Abdyl Hamitit; princin egjiptian Ahmed Fuat Pashën, pasardhës i Mehmet Aliut me origjinë shqiptare⁴⁵⁷ dhe Izet Pashën, si kandidaturnë më serioze me emrin e të cilit u përgatit edhe komploti i Beqir Grebenesë⁴⁵⁸.

Më në fund, pas kundërshtimesh e debatesh të forta, Princ trashëgimtar i shtetit të sapokrijuar shqiptar u zgjodh Vilhel Vid⁴⁵⁹, propozuar nga Italia dhe Austro – Hungaria. Megjithatë sipas ambasadorit Barclay, Vilhelm Vidi, kishte vendosur disa kushte paraprake para se të pranonte fronin shqiptar, që sipas tij ishin: të gjashtë Fuqitë e Mëdha të pranonin kandidimin e tij; të gjashtë Fuqitë e Mëdha ta mbështesnin atë financiarisht; statuti organik i principatës shqiptare që pritej të aprovohej të ishte i pëlqyeshëm për të (ai nuk kishte dëshirë të kishte parlament) dhe që Fuqitë e Mëdha të garantonin kufijtë e Shqipërisë⁴⁶⁰.

Sikundër përzgjedhja e princit nuk ishte e lehtë, po aq i vështirë ishte edhe misioni që Vidi mori përsipër. Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë më 1912 dukej të ishte pikënisja e një kalvari të gjatë deri në formimin dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës. Problemet ishin të shumta dhe pritshmëritë e popullsisë gjithashtu. Në kujtime e saj Edith Durham shkruan: “Shqipëria kërkon në të vërtetë pavarësi, kërkon të njihet nga Evropa dhe do një princ, mundësisht evropian, që të miratohet nga Fuqitë e Mëdha...”⁴⁶¹ Përcaktimi i një princi gjerman në fronin shqiptar, pa asnjë lidhje me të shkuarën osmane, por njëkohësisht me origjinë evropiane, rriti pritshmëritë e popullit shqiptar. Në sytë e

⁴⁵⁷ Ferdinando Salleo, *Shqipëria: gjashtë muaj mbretëri*, (Tiranë, ShLK, 2001), 53.

⁴⁵⁸ *Dokumente Britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (janar – dhjetor 1914) II*, përgatitur nga Valentina Duka, (Tiranë, Botimet Toena, 2012), Nr. 31, 57, Nr. 36, 59.

⁴⁵⁹ Joseph Swire, *Shqipëria: Ngritja e një mbretërie*, (Tiranë, Dituria, 2005), 165.

Princi Vilhelm është djali i tretë i Vilhelmit, princit të Vidit dhe Marisë, princeshës së Holandës, nip i mbretëreshës Elizabeta të Rumanisë (“Karmen Silva”) dhe stërnip i perandorit Vilhelmit I. Ai ka lindur më 26 mars 1876, jetonte në Nojvid, Prusia Renane dhe është martuar më 1906 me princeshën e zgjuar, të guximshme dhe ambicioze, Sofinë e Shënberg-Valdenburgut. Ai ka dy fëmijë, princeshën Mari Elinor (1909) dhe princin Karl Viktor (1913).

⁴⁶⁰ *British Documents on the Origins of the War, 1898-1914, vol. X*, pjesa e I, botuar nga G.P Gooch & H.W. Temperley, (London: His Majesty Stationary Office, 1936), 56.

⁴⁶¹ Edith Durham, *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera*, (Tiranë, Naum Veqilharxhi, 2001), 43.

shtetasve të tij, Princ Vidi ishte “Skënderbeu i ri”, i cili do të sillte begati e prosperitet në vend. Pra, dukej qartë se ç’ka Princi kishte pranuar, ishte një sfidë shumë e vështirë.

Princ Vidi. Vështirësitë dhe të metat në qeverisje

Deri në momentin e mbërritjes së Vidit në Shqipëri, kontrolli i administratës civile dhe financave të vendit i ishin besuar Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, i cili, me mbërritjen e Princit, i kaloi këtij të fundit kompetencat e veta, por vijoi t’i qëndrojë në krahë, në rolin e këshilltarit⁴⁶².

Problemet me të cilat Vidi u përball që në ditët e para të mbërritjes së tij, ishin të shumta. Pavarësisht se i zgjedhur prej Fuqive të Mëdha dhe nën garancinë e tyre, dukej se mbizotëronte një skepticizëm i fortë në drejtim të tij. Vetë Grei, ministri i jashtëm anglez, nuk besonte në aftësitë e tij dhe dukej se priste edhe dështimin e tij. Po ashtu edhe Franca dhe Rusia, mbështetëse të përhershme të sllavëve të Ballkanit⁴⁶³, dukej se kishin miratuar kandidaturën e tij, pikërisht për faktin se ato dyshonin në aftësitë e Princit. Fuqitë e Mëdha që nuk kishin interes për Shqipërinë, kishin nisur t’i mohonin zotimet e bëra.

Nuk mund të fajësohet për gjithçka Vidi. Fuqitë e Mëdha, të cilat garantonin shtetin e sapokrijuar shqiptar, pavarësisht premtimeve, nuk e mbështetën asnjëherë financiarisht në masën e duhur sovranin e zgjedhur prej tyre. Me finanacat të pakta dhe i gjendur në mes të një rivaliteti shumë të vjetër dhe njëkohësisht të egër ndërmjet Italisë dhe Austro – Hungarisë (rivalitet ky që u duk se u zbut pak në momentet kur dy shtetet u kthyen në aleatë për të mbrojtur çështjen shqiptare), mundësitë Vidit ishin shumë të pakta. Nga ana tjetër, edhe situata brenda vendit nuk dukej të ishte dhe aq e lehtë. Pavarësisht se kandidatura e tij u mirëprit nga popullsia shqiptare, situata paraqitej e vështirë.

Së pari, Princ Vidi u përball me kundërshtimet e Klerit: muslimanët e urrenin princin e krishterë, katolikët dhe ortodoksët e shihnin me sy dyshues, sepse ai ishte luterian.

Së dyti, Shqipëria gjendej në një katrahurë politike. Qeveria e dalë prej Kuvendit të Vlorës ishte dubluar prej Pleqësisë së Shqipërisë së Mesme të krijuar nga Esat Pashë Toptani, nisur nga ambicjet e këtij të fundit për të qenë në krye të shtetit shqiptar. Pavarësisht dorëheqjes së të dy organizmave në pritje të mbërritjes së Princit, situata nuk dukej se po stabilizohej në zonat e tyre të kontrollit.

Së treti, Princi dhe princesha nuk kuptonin as gjuhën dhe as mentalitetin e popullit shqiptar. Kjo i pengonte ata të vendosnin lidhje, t’i kuptonin, por edhe t’u përçonin ndjenjat dhe idetë e tyre. Ky mirëkuptim mund të shndërrohej në çelësin e suksesit të princit në Shqipëri.

Financat dhe aspektet kulturore nuk dukej të ishin problemet e vetme të principatës së re shqiptare. Ndër të tjera, ishte e domosdoshme krijimi i Forcave të Armatosura dhe Xhandarmërisë Shqiptare. Në ditët e para të mbërritjes së Princit, shteti shqiptar kishte një numër shumë të vogël xhandarësh. Ishte vendosur nga Fuqitë e Mëdha se qetësia dhe rregulli publik do të siguroheshin nga një xhandarmëri e organizuar ndërkombëtarisht. Ky organizim iu besua oficerëve suedezë dhe hollandezë të cilët kishin komandën eprore dhe efektive të xhandarmërisë⁴⁶⁴. Por mungesa e trupave ushtarake dhe të xhandarmërisë të përgatitur vijonte me mungesë municionesh. Qeveria

⁴⁶² Nicola Guy, *Lindja e Shqipërisë*, (Tiranë, Pegi 2012), 93.

⁴⁶³ Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri 1897 – 1942*, (Tiranë, Marin Barleti, 1995), 82.

⁴⁶⁴ Joseph Swire, vep. e përmendur, 149.

e Durrësit iu lut qeverisë austriake dhe asaj italiane që ta furnizonin me armët e nevojshme për armatosjen e 10 000 burrave që do të përdoreshin për përfshirjen me forcë të krahinave të Epirit të Veriut në shtetin shqiptar. Austria dërgoi 3 bateri artilerie malore bashkë me oficerët instruktorë, me nënoficerët dhe gjithë pajisjet përkatëse. Italia premtoi 10 000 pushkë (modeli 1891) bashkë me municionin përkatës, por solli vetëm 4000⁴⁶⁵. Fatkeqësisht, sipas Edith Durhamin, edhe këto municione nuk shkuan në destinacionin e duhur. Sipas saj, Esat Pashë Toptani i çoi në zotërimet e veta në Tiranë⁴⁶⁶. Armatimet e kërkuara prej Vidit do të shërbenin për t'i bërë ballë ndërhyrjes greke në Shqipërinë e Jugut dhe krijimit të Qeverisë së Përkohshme të Epirit Autonom të Veriut nën kryesimin e Zographos. Në kujtimet e tij, Egerem bej Vlora nënvijëzon: "Thuhet – ndonëse dëshmitë për këtë mungojnë – se zoti Venizellos, kryeministri i atëhershëm i Greqisë, kishte marrë më përpara miratimin e Rusisë dhe Francës për inskenimin e kësaj tragjedia dhe se pa trysninë e Austro – Hungarisë dhe të Italisë, në periudhën prill – gusht 1914, Shqipëria e Jugut do të kishte qenë e humbur. Gërshetimi i ngjarjeve në Shqipërinë Jugore në verë të atij viti, mund të vërtetonte pa dyshim, këtë hamendje, sepse u pa qartë që të gjithë kundërshtarët e pavarësisë shqiptare (rastësisht apo të parapërgatitur) vepronin në harmonizim të plotë."⁴⁶⁷

Nga ana tjetër, situata po vështirësohej edhe më shumë prej rebelimit të Shqipërisë së Mesme. Kjo lëvizje kishte karakter antikombëtar dhe synonte rikthimin nën juridiksionin e Perandorisë Osmane, ose të paktën vendosjen e një princi musliman "nga barku i Ali Osmanit"⁴⁶⁸. E gjetur në prag të fillimit të Luftës së Parë Botërore, Europa nuk mundi, ose nuk dëshoi të ndërhynte në stabilizimin e gjendjes në shtetin shqiptar, duke mos respektuar vendimin e tyre për ta garantuar sigurinë dhe stabilitetin e tij. Gjatë qeverisjes së tij, Vilhelm Vidi bëri një numër jo të vogël gabimesh, të cilat lidheshin si me faktin që ai nuk thelloi njohjen e tij me vendin dhe popullsinë që do të qeveriste. Ai nuk ndërmori një udhëtim në krejt vendin, sikundër iu sugjerua edhe nga figura të shquara të kohës, ndër të tjera edhe miss Durham, e cila në udhëtimet e saj të shpeshta nëpër Ballkan, kishte mundur ta njihje dhe ta kuptonte shume mirë filozofinë e popullit shqiptar⁴⁶⁹. Ai nuk e njihje vendin, atij i mungonte aftësia për t'i kuptuar dhe për t'i trajtuar njerëzit, toni i nevojshëm për t'i bindur, përvoja e nevojshme për t'i marrë përdore ata dhe për t'u mbrojtur prej tyre, kuturia për të çarë përpara nëpër të gjitha rreziqet dhe mundimet⁴⁷⁰. Kjo e vështirësoi së tepërmi ushtrimin e autoritetit nga ana e tij, duke shkaktuar rënien e optimizmit të fillimit.

Përzgjedhja e gabuar e kryeqytetit ishte hapi i dytë i nxituar. Shumë fort Vidit iu rekomandua Vlora si kryeqytet, duke qenë se Shkodra ishte nën mbrojtjen e KNK. Në këmbënguljen e Esat Pashës, princi zgjodhi të kishte kryeqytet Durrësin, territor nën kontrollin e pashës⁴⁷¹. Përzgjedhja e Kabinetit Qeveritar u bë nisur nga rekomandime, por nuk ishte zgjidhja më e mirë e mundshme. Kabineti që krijoi Vidi ishte jopopullor. Vetëm dy prej anëtarëve të tij kishin banuar kohët e fundit në Shqipëri. Anëtarët e

⁴⁶⁵ Egerem bej Vlora, *Kujtime 1885-1925*, (Tiranë, Botimet IDK 2010), 375.

⁴⁶⁶ Edith Durham, *Njëzet vjet ngatërresa ballkanike*, (Tiranë, Argeta – LMG, 2001), 279

⁴⁶⁷ Egerem bej Vlora, vep e përmendur, 373 – 374.

⁴⁶⁸ Lef Nosi, *Dokumente Historike 1912 – 1918*, (Tiranë, Instituti i Historisë, 2007), 187

⁴⁶⁹ Edith Durham, *Brenga ...*, vep. e përmendur, 405.

⁴⁷⁰ Egerem bej Vlora, vep. e përmendur, 369.

⁴⁷¹ *Dokumente Britanike ...*, vep. e përmendur, Nr. 88, 124 – 125.

Kabinetit konsideroheshin si tejet të mbujtur me metodat e qeverisjes otomane dhe klasa e latifondistëve muslimanë të tokës ishte e mbipërfaqësuar. Shumë prej tyre nuk dinin as të flisnin e të shkruanin shqip. Turhan bej Pasha, i cili kishte pasur një karrierë të shkëlqyer në trupin diplomatik otoman u zgjodh kryeministër. Sipas Eqerem bej Vlorës, ai ishte një burrë i kultivuar dhe tejet i arsimuar, që mund të kishte qenë çdo gjë, vetëm jo kyeministër në shtetin e sapokrijuar shqiptar në vitin 1914⁴⁷². Ai nuk kishte jetuar në Shqipëri qysh prej shumë vitesh dhe nuk ishte angazhuar në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Disa mendonin se ai kishte prirje proruse, si rrjedhojë e shërbimit të tij si diplomat në këtë vend, disa të tjerë thoshin se ai kishte simpati për otomanët e madje disa syresh të tjerë thoshin se ai ishte agjent italian. Edhe Hasan Prishtina konsiderohej nga Lamb si një “kukull në duart e Esat Pashës”, ndonëse të dy shpesh kishin qëndrime të kundërta⁴⁷³. Ndërkohë që gabimi më fatal duket të jetë emërimi i Esat Pashës në dy poste ministrorë (ministër i Brendshëm dhe i Luftës), kur ky i fundit konsiderohej si tradhëtar prej shumë nacionalistëve, kryesisht për rolin e tij në kapitullimin dhe dorëzimin e Shkodrës në duart e Malit të Zi (prill 1913). Duket se de facto, ishte Esat Pasha i cili mbizotëronte qeverinë, duke bërë që prej tij të ndruheshin edhe kolegët bashkëqeverisës⁴⁷⁴.

Ai nuk u tregua vigjilent për t’u bërë ballë kompleteve të rivalëve të tij. Në një darkë të shtruar për nder të Princit, Preng Bib Doda, si me të qeshur i drejtohet: “Nëse doni vërtetë të qeverisni në Shqipëri, masa e parë që duhet të merrni është të mënjaroni Ismail beun dhe Esat pashën. Me këtë rast, ju lutem të mos harroni edhe personin tim të parëndësishëm dhe mjaft gjela të tjerë grindavecë më të vegjël. Ndryshe as mos t’ju shkojë ndërmend se mund të bashkoni Shqipërinë dhe të qeverisni këtu me të vërtetë”⁴⁷⁵. Vilhelm Vidi u kritikua për shpërdorim parash për gjëra të vogla si Gjykata e Lartë e Apelit, në një kohë kur gjykatat vendore ishin në një gjendje të mjerueshme, caktoi inspektorë shkollorë në një kohë kur numri i shkollave ishte shumë i vogël, duke emëruar njëkohësisht edhe ministra të plotfuqishëm pranë vendeve të tjera, ndërkohë që ata nuk u larguan kurrë nga Shqipëria⁴⁷⁶.

Kërcënimet e jashtme dhe të brendshme

Pavarësisht se Vidi është kritikuar mjaft për dështimin e shtetit të parë shqiptar, është më se e kuptueshme, që ai nuk mund të ishte i vetmi përgjegjës për këtë dështim. Pavarësisht se Vidi vetë nuk kishte cilësitë e duhura për të dalë si “shpëtimtar i situatës” në Shqipëri dhe as personalitetin e nevojshëm për të përballuar një situatë kaq të rëndë, ai vinte në Shqipëri si “i zgjedhuri” i Evropës. Si krijesë e fuqive të mëdha, regjimi i Vidit do të mbante deri në fund vulën e kontradiktave e të ndërhyrjes së tyre. Në të vërtetë, Britania e Madhe dhe Gjermania, në dukje shfaqen neutrale, por realisht nuk janë. E përkëdhelura e Fuqive të Mëdha gjatë zhvillimit të punimeve të Konferencës, Greqia, ishte arsyeja e këtij “neutraliteti aktiv e favorizues”. Aleancat që do të çonin në Luftën e Parë Botërore kishin arritur pikën e pjekjes dhe tani kishin nevojë për zgjerim dhe konsolidim. Britania e Madhe do ta donte Greqinë në Aleancën Trepalëshe. Kaizeri gjerman (motra e të cilit ishte edhe gruaja e mbretit grek), gjithashtu do të parapëlqente

⁴⁷² Eqerem bej Vlora, vep. e përmendur, 369.

⁴⁷³ Nicola Guy, vep. e përmendur, 94.

⁴⁷⁴ D. Heaton Armstrong, *Princ Vidi. Shqipëria, gjashtë muaj mbretëri*, (Tiranë, AHS 2010), 37.

⁴⁷⁵ Eqerem bej Vlora, vep. e përmendur, 393 – 394.

⁴⁷⁶ Nicola Guy, vep. e përmendur, 93

një aleat më shumë në Bosht, me një pozicion strategjik të përkryer në Mesdhe. Dy të fundit, Italia dhe Austro – Hungaria ishin të vendosura që të mos lejonin asnjë fuqi tjetër të kontrollonte bregdetin shqiptar prandaj këmbëngulën për formimin e një Shqipërie të pavarur. Interesi i tyre ishte që shteti i ri shqiptar të kishte një shtrirje sa më të madhe territoriale për dy arsye:

Së pari, sa më i madh territori i përfshirë brenda kufijve zyrtarë të shtetit të ri shqiptar, aq më i vogël do të ishte ndikimi sllav në Ballkan. Nëpërmjet aneksimit të Bosnjë – Hercegovinës dhe krijimit të shtetit të pavarur shqiptar, Austro – Hungaria planifikonte të zvogëlonte hegjemoninë e Serbisë në gadishull. Kuptohet që, nëpërmjet privimit të Serbisë nga dalja në Adriatik, qëllimi i vërtetë ishte mbajtja sa më larg e Rusisë nga ky bregdet. Kufijtë e propozuara prej tyre duhej të ndiqnin karakteristika natyrore të cilat do të bënin të mundur që Shqipëria të zhvillonte dhe të mbronte vetveten dhe vijën e saj bregdetare, me apo pa ndihmë, nga ndonjë agresion i mundshëm⁴⁷⁷.

Së dyti, interesat ekonomikë. Shteti i ri shqiptar shihej si një mundësi e artë përfitimi ekonomik. Kuptohet që një nga nevojat më të para dhe më të rëndësishme të shtetit të sapokrijuar shqiptar ishte ngritja e Bankës Kombëtare, e cila jo vetëm do të shërbente si bankë e nivelit të parë dhe si e tillë do të realizonte të gjitha politikat monetare të vendit, por njëkohësisht pa të nuk do të mund të lëvrohej as huaja prej 75 milionë franga që Fuqitë e Mëdha do t'i mundësonin qeverisë shqiptare në mënyrë që kjo të realizonte funksionet e saj. Përfaqësuesit austriakë dhe italianë kishin përfunduar me Qeverinë e Përkohshme në shtator 1913 një marrëveshje për krijimin e Bankës së Shqipërisë me kapital italo – austriak, duke përfituar kështu të drejta ekskluzive bankare në territorin shqiptar⁴⁷⁸. Kuptohet që kjo marrëveshje nuk u prit mirë nga Fuqitë e tjera, të cilat gjithashtu dëshironin të përfitonin të njëjtat privilegje si Italia dhe Austro – Hungaria⁴⁷⁹.

Mosmarrëveshjet austro-hungareze dhe italiane në gjirin e pushtetit të Vidit sollën ndarjen e qeverisë së tij në dy kampe: në atë proaustriak dhe atë proitalian, të kryesuar nga Esati. Në të vërtetë këto rryma do të ndikonin drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë në gjithë veprimtarinë e qeverisë së Vidit, si në planin e brendshëm, ashtu edhe në atë të jashtëm. Kapiteni italian, Kastoldi, së bashku me diplomatin austriak Buçberger formonin kabinetin politik të Vidit, të cilin më shumë e çoroditën se e ndihmuan.

Por, faktorëve të jashtëm shumë të rëndësishëm iu shtuan edhe trazirat e brendshme që sipas njoftimeve që siguronin në teren qeveria angleze, Esat Toptani, ishte në krye të intrigave kundër princit. Më 19 maj 1914, për shkak të përfshirjes së tij në një lëvizje të armatosur kundër princit, ku zë fill edhe rebelimi i fshatarëve të Shqipërisë së Mesme, ai arrestohet dhe me ndihmën e Italianëve nisët në Itali⁴⁸⁰. Nën këshillën e baronit Alioti, Princi zgjedh ta dëbojë Esat Pashën, pa hapur një proces gjyqësor⁴⁸¹.

Në këto kushte të vështira edhe për jetën e vetë princit, filloi të qarkullojë ideja e një ndihme ushtarake për principatën e brishtë shqiptare. Por siç del nga dokumentet

⁴⁷⁷ *Dokumente Britanike ...*, vep. e përmendur, Nr. 26, 326 dhe Nr. 37, 333.

⁴⁷⁸ Joseph Swire, vep. e përmendur, 155.

⁴⁷⁹ *Dokumente Britanike ...*, vep. e përmendur, Nr. 159, 175 dhe Nr. 174, 183.

⁴⁸⁰ Po aty, Nr. 95, 414.

⁴⁸¹ Ferdinando Salleo, vep. e përmendur, 83.

britanike, qeveria angleze nuk ishte e gatshme të kontribuonte me forca ushtarake Shqipërinë, por tregonte gadishmëri të ndihmonte rruajtjen e jetës së princit⁴⁸². Si rezultat i veprimit të shumë faktorve të brendëshëm dhe të jashtëm Vidi dështoi dhe u detyrua të largohej nga Shqipëria më 7 shtator 1914, duke e lënë Durrësin pa ushqime, pa para dhe pa forca të mjaftueshme ushtarake për ta mbrojtur atë. Më 3 shtator ai lëshoi këtë shpallje:

“Shqiptarë! Kur erdhën të dërguarit tuaj, për të më ofruar kurorën e Shqipërisë, unë pranova me besim thirrjen e një populli të fisëm e bujar, që më lutej ta ndihmoja gjatë përpjekjeve për rilindjen e tij. Unë erdha tek ju me dëshirën e flaktë për t’ju ndihmuar në këtë detyrë patriotike. Ju keni patur rast të shihni se qysh nga fillimi i jamp përkushtuar me të gjitha forcat e mia riorganizimit të vendit, me dëshirën për t’ju dhënë një administratë të mirë e drejtësi për të gjithë. Mirëpo ngjarje të mbrapshta e penguan punën tonë të përbashkët. Disa shpirtëra të verbuar nga pasioni, nuk deshën t’i kuptonin vlerat e reformave të kishin besim te qeveria që po formohej. Gjendjen tonë e ndërlikoi akoma më tepër lufta që shpërtheu në Evropë. Në këto rrethana unë mendova që, për të mos e lënë të papërfunduar veprën, së cilës i kisha kushtuar fuqitë dhe jetën time, do të ishte e dobishme të largohesha për një farë kohe në Perëndim. Por duhet ta dini që, qofsha larg apo afër, do të udhëhiqem vetëm nga mendimi për të punuar për mirëqenien e atdheut tonë të fisëm e bujar shqiptar. Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit i caktuar nga Evropa, që krijoi atdheun tonë, do të marrë përsipër qeverisjen gjatë mungesës sime.”⁴⁸³

Është e vërtetë që princ Vidi nuk ndihmoi në ushqimin e nacionalizmit shqiptar, por ai u përpoq të realizonte ruajtjen e tërësisë territoriale prej shovinizmit ballkanas. Arsyet e dështimit pa dyshim nuk mund të kërkojnë në një person të vetëm. Pavarësisht pamundësisë apo paaftësisë së Princit, shkaqet e dështimit lidhen ngushtëmërisht me situatën politiko – ekonomiko – sociale në Shqipëri dhe me Europën që ishte përfshirë ndërkohë në Luftën e Madhe. Ndërkohë që njerëzit e fuqishëm të Shqipërisë ishin po ata që tashmë qenë afirmuar në sistemin osman dhe kalimi në rendin e ri të shtetit shqiptar u shfaq jashtëzakonisht i vështirë. Sigurisht, i ndërlikuan edhe më shumë gjërat agjentët serbë, që korruptuan disa prijës në veri, Greqia, që arriti me manipulim të nxirrte në dritë një Epir filohelenik dhe me prirje separatiste, por sidomos qe lufta e zotërve të territorit për pushtete të reja apo potenciale ajo që frymëzoi grindjet e gjata, ashtu sikurse edhe dallimet në gjuhë, fe dhe në vizionet politike midis interesave lokale dhe rajonale⁴⁸⁴.

Në përfundim, do të citoja Edith Durham: “Historia e princ Vilhelm Vidit është një nga meseletë më të ndyra që kanë kurdisur Fuqitë e Mëdha. Me caktimin e princit, Fuqitë e Mëdha u tërhoqën vëmendjen grekëve që të zbraznin Shqipërinë e Jugur deri te kufijtë që kishte caktuar Komisioni i Kufijve.⁴⁸⁵... Shteti i porsalindur shqiptar do t’u hidhej në gojë ujvqe për të shpëtuar më të mëdhenjtë.”⁴⁸⁶

⁴⁸² *Dokumente Britanike ...*, vep e përmendur., Nr. 101 -102, 417.

⁴⁸³ Vilhelm, Princ i Shqipërisë, Princ i Vidit, *Promemorie mbi Shqipërinë*, (Tiranë, Skanderberg Books, 2010), 44.

⁴⁸⁴ Egidio Ivetic, *Luftërat ballkanike*, (Tiranë, Dituria, 2008), 157.

⁴⁸⁵ Edith Durham, *Brenga ...*, vep. e përmendur, 404

⁴⁸⁶ Po aty, 402

Bibliografi

- Armstrong D. Heaton, Princ Vidi. Shqipëria gjashtë muaj mbretëri, Tiranë, AIIS, 2010
British Documents on the Origins of the War, 1898-1914, vol. X, pjesa e I, botuar nga G.P Gooch & H.W. Temperley, (London: His Majesty' Stationary Office, 1936)
 Dokumente Britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor – dhjetor 1913) I, përgatitur nga Valentina Duka, Tiranë, Botimet Toena, 2012
 Dokumente Britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor – dhjetor 1913) II, përgatitur nga Valentina Duka, Tiranë, Botimet Toena, 2012
 Durham Edith, *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera*, Tiranë, Naum Veqilharxhi, 2001
 Durham Edith, *Njëzet vjet ngatërresa ballkanike*, Tiranë, Argeta – LMG, 2001
 Fabius J., *Gjashtë muaj në Shqipëri*, Tiranë, Skanderbeg Books, 2005
 Guy Nicola, *Lindja e Shqipërisë*, Tiranë, Pegi 2012
 Ivetic Egidio, *Luftërat ballkanike*, Tiranë, Dituria, 2008
 Nosi Lef, *Dokumente Historike 1912 – 1918*, Tiranë, Instituti i Historisë, 2007
 Salleo Ferdinando, *Shqipëria: gjashtë muaj mbretëri*, Tiranë, Shtëpia e Librit & Komunikimit, Istituto Italiano di Cultura, 2002
 Smirnova Nina, *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, Tiranë, Ideart 2004
 Swire Joseph, *Shqipëria: Ngritja e një mbretërie*, Tiranë, Dituria, 2005
 Vllamasi Sejfi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897 - 1942)*, Tiranë, Marin Barleti, 1995
 Vilhelm, *Princ i Shqipërisë, Princ i Vidit, Promemorie mbi Shqipërinë*, Tiranë, Skanderberg Books, 2010
 Vlorë Eqerem bej, *Kujtime 1885 – 1925*, Tiranë Botimet, IDK 2010

QËNDRIMI POLITIK I SHQIPËRISË DHE PENGESAT E NDESHURA NË KONFERENCËN E PARË DHE TË DYTË BALLKANIKE

Anduana Shahini (Kertalli)

Lagjia "Popullore" Shijak-Durrës, Shqipëri
E-mail: kanduana@yahoo.it

Politika e jashtme shqiptare në vitet '30, për shkak të shumë faktorëve, merr një orientim ballkanik. Pjesëmarrja e qeverisë shqiptare në Konferencën e Parë dhe të Dytë Ballkanike shoqërohet me një interes të madh brenda dhe jashtë vendit. Platforma e qeverisë mbështetet tërësisht në mbrojtjen e interesave kombëtare pavarësisht vështirësive që paraqiten herë pas here gjatë konferencës.

Me gjithë vështirësitë ekonomike, delegacioni, i kryesuar nga Mehmet Konica, kërkoi si në Konferencën e Parë dhe të Dytë të zgjidhej çështja madhore e minoriteteve shqiptare në vendet fqinjë dhe përfshirjen e Shqipërisë në çdo pakt apo marrëveshje me lehtësira ekonomike. Në këtë rast vendet pjesëmarrëse nuk nguruan të paraqesin pakënaqësitë e tyre, optimizmin apo në rastin më të keq synimet e tyre hegjemoniste. Me gjithë karakterin joqeveritar konferencat kishin në themel platformat e qeverive që ato përfaqësonin.

Në tërësi, Shqipëria, për shkak të pozicionit të saj gjeopolitik, përpigjej të aplikonte një politikë të jashtme adriatiko – ballkanike, me synim mbijetesën në mes kthetrave të fqinjëve të saj tokësor dhe jo vetëm. Ftesa për të tilla konferenca e takime me shtetet ballkanike vjen pikërisht në kohën e krizës së marrëdhënieve shqiptaro – italiane, presionit Italian për të rinovuar Traktatin e Parë të Tiranës që kërcënonte drejtpërdrejtë pavarësinë e Shqipërisë dhe shfrytëzohet pozitivisht nga qeveria shqiptare.

Fjale kyçe: Konferenca Ballkanike, politika adriatiko-ballkanike, politika rajonale.

Organizimi i Konferencave Ballkanike është nisma më e bujshme e shteteve të Ballkanit drejt idesë për bashkëpunim në vitet '30 të shek. XIX. Periudha përpara viteve '30 të shek. XIX përshkohet nga një klimë jo e favorshme ekonomike dhe diplomatike mes vendeve ballkanike. Historikisht bashkëjetesa e tyre ka kaluar në rrjedha të vështira, mes konfliktesh territoriale dhe nacionale. Shkaqet e fenomeneve të tilla e kanë origjinën në zgjidhjet e gabuara të diktuar nga Lufta e Parë Botërore. Të njëjtin problem ekonomik po e kalonte edhe Evropa e viteve '30, e cila prej kohësh po punonte dukshëm drejt zyrtarizimit të idesë për bashkim.

Në situatën politike të viteve '20 – '30 të shek. XIX sistemi i marrëdhënieve ndërkombëtare kishte ndryshuar. Evropa Qendrore, kryesisht Gjermania, e shikonte

Ballkanin si një mundësi të mirë depërtimi ekonomik. Ndërkohë që Franca dhe Italia i kishin të hershme ndikimet e tyre në Ballkan si pjesë të politikës së jashtme. Gjermania tenton të ndërhyjë për të ndryshuar këto ekuilibra, ndërsa Italia e sheh veten të lidhur ngushtë me Ballkanin, sidomos me Shqipërinë edhe pse në vitet '30 shfaqet dukshëm kriza mes dy vendeve. Pra interesi për Ballkanin shtohet në prag të thirrjes për krijimin e një konfederate ballkanike.

Një tjetër faktor i shfaqur në aspektin ekonomik dhe evidentuar në këtë periudhë ishte Amerika. Ajo ishte kthyer në superfuqi ekonomike pas Luftës së Parë Botërore, ndërsa Anglia po konkurohej ndjeshëm nga Franca në tregun evropian. Presione ekonomike dhe jo vetëm kishte edhe përtej kontinentit nga shtete, si Rusia apo edhe Turqia, të cilat tashmë po ecnin të sigurta drejt zhvillimit të tyre. Pra pozicioni i Evropës nuk ishte më i njëjti si ai përpara Luftës së Parë Botërore. Në kuadrin e këtij fenomeni të ri, në Evropë lind nevoja e një bashkëpunimi ndërshtetëror. Ideja e një bashkëpunimi të tillë mban autorësinë e Aristidh Briandit, politikanit të njohur francez.

Franca ishte një nga vendet kryesore të Evropës, interesat e së cilës prekeshin nga luhatjet e tregut ndërkombëtar, ekuilibri ekonomik kishte ndryshuar në Evropë dhe kështu që ndihej domosdoshmëria e një bashkimi mes vendeve të Evropës në aspektin ekonomik. Plani i Briandit mbi formimin e një konfederate evropiane konsiderohet si një përpjekje tepër serioze drejt krijimit të frymës bashkëpunuese të shteteve evropiane. "Nisma të tilla në Evropë kishte pasur edhe në të shkuarën, por rëndësia e planit të Briandit qëndron në faktin e jetëgjatësisë dhe jehonës që shkaktoi, si dhe pjesëmarrjes masive të vendeve"⁴⁸⁷

Ndikimi planit të Briandit përcaktohet edhe nga shpeshësia e letrave që vinin për këtë qëllim nga legata Franceze. Ndër to përmendim letrën që përcjell idenë bazë të platformës së tij ku ndër të tjera shprehet se "në përgjithësi është fakti që Z. Briand nuk do të improvizojë "shtetet e bashkuara të Evropës", sepse e gjithë kjo do të ishte e parealizueshme edhe e frikshme për të... por të krijojë përmes një pakti një kontakt të vazhdueshëm për të marrë vendime në raste të veçanta në favor të tyre"⁴⁸⁸

Citimi i planit të Briandit është tepër i rëndësishëm, pasi ka një ngjashmëri të madhe mes tij dhe idesë për krijimin e konfederatës ballkanike. Ideja e planit të Briandit zhvillohet pothuajse në atë frymë që nisën Konferencat Ballkanike. Pra, huazohet e njëjta ide për t'u vënë në jetë, por kësaj radhe në kushte dhe në një terren krejt tjetër, në Ballkanin e viteve '30.

Vendet ballkanike e kristalizuan idenë e tyre për bashkëpunim dhe ftuan zyrtarisht për pjesëmarrje shtetet, si: Jugosllavia, Bullgaria, Shqipëria, Rumania, Turqia dhe vetë Greqia. Jehona e kësaj konference rajonale kishte filluar që në shtator të vitit 1930 përmes shtypit dhe propagandës së qeverive të vendeve pjesëmarrëse. Shtypi shqiptar e nisi informimin pikërisht në shtator të vitit 1930. Ky bashkëpunim sipas tyre përcaktohej si i ngjashëm me organizatën e Lidhjes së Kombeve, ku më e rëndësishmja është që se çdo shtet e ruan statusin e vet dhe nuk cenohet nga asnjë shtet tjetër.

Konferenca e Parë Ballkanike u realizua nën moton "Ballkani ballkanasve"⁴⁸⁹, e cituar nga Jugosllavët përkundërt popujve ballkanas. Në parim kjo nismë është pozitive, por mendoj se problemi i ballkanasve është i dyfishtë, ai buron së brendshmi dhe nga

⁴⁸⁷ Gazmend Shpuza, "Shqipëria ndërmjet Ballkanit dhe Apenineve" Ekstra, Tiranë 1999, f. 17

⁴⁸⁸ AQS, F. 151, V. 1930, D. 103, fq. 23 (Letër e legatës shqiptare në Francë dërguar MPJ-së)

⁴⁸⁹ E. Rossi "La seconda conferenza Balcanica" Botuar në revistën "L'Europe Orientale" Roma 1932, nr.1-2, f.6 (pjesë e koleksionit të revistës "Les Balkans" në fondin e Bibliotekës Kombëtare Tiranë)

ndërhyrjet e fuqive të mëdha. Megjithëse marrëdhëniet diplomatike pas Luftës së Parë Botërore ishin rimodeluar, Ballkani mbeti përsëri me shumë probleme. Vendet ballkanike shqetësoheshin përsëri për problemet nacionale dhe problemet e minoriteteve. Madje në këndvështrimin perëndimor të viteve '30, Konferenca e Athinës u perceptua si një aktivizim i përbashkët i popujve ballkanas, për t'u mbrojtur ndaj lëvizjeve revolucionare të kohës, fashizmit dhe komunizmit. Kjo do të shërbente si një nismë, për të marrë pjesë në mënyrë të përbashkët e për t'i siguruar kompetencat e nevojshme bllokut antisovjetik. "Masat revolucionare dhe klasa punëtore në Ballkan i njihnin mirë kontradiktat dhe përgatitjet e reja për luftën interballkanike"⁴⁹⁰. Ato njihnin njëllor qëllimet kriminale të këtyre qeverive, thekson Prof. E. Rossi, një studiues i Ballkanit, duke iu referuar themelimit e gjallërimit të lëvizjeve politike ekstremiste në vendet kryesore të Ballkanit. Gjithashtu masat revolucionare, kryesisht punëtore, në Ballkan do të mblidhnin forcat për të parandaluar politikën kriminale të diktaturave qeveritare të asaj kohe. Ato do të gjenin forcën e nevojshme për të ndërtuar, për të ngritur me duart e tyre bashkimin e popujve të Ballkanit në një federatë ballkanike të popujve punëtore⁴⁹¹. E megjithatë Padefordi, një tjetër studiues i fenomenit, pohon se "formimi i grupimeve rajonale bazuar në objektiva të përbashkët dhe afërsitë gjeografike, kanë qenë një nga drejtimet kryesore të marrëdhënieve ndërkombëtare që nga Lufta e Parë Botërore"⁴⁹² duke na dhënë kështu një këndvështrim tjetër të fenomenit. Megjithatë Konferencat Ballkanike parashtruan fillimisht problemin ekonomik, me gjithë ndërhyrjen e qeverisë shqiptare dhe asaj bullgare për të përfshirë edhe problemin e minoriteteve.

Qeveria Shqiptare u njoftua përmes një shkrese zyrtare dërguar në prill të vitit 1930 në MPJ në Tiranë. Përmes saj bëhej e ditur natyra, qëllimi dhe objektivat e Konferencës së Parë Ballkanike që do të mbahej në tetor të po atij viti. Në vazhdim të shkresës zyrtare pranohej se do të kishte çdo vit konferencë dhe se vendet e ndryshme të Ballkanit do të ishin mikpritëse të saj. Komisioni i krijuar paraprakisht për vendet pjesëmarrëse ishte krijuar dhe kishte marrë jetë në Kongresin XXVII Universal të Paqes të mbajtur në Athinë në 6-10 tetor 1929. Shqipëria ftohet të merrte pjesë "pa qenë nevoja që të merret me punë apo me të drejta, gjatë konferencës së parë, me qëllim që ta informojë qeverinë mbretërore mbi punimet e konferencës"⁴⁹³

Qëllimi i kësaj konference është afrimi i popujve që kanë interesa ekonomike dhe afërsi territoriale, ngjashmëri kulturore dhe historike. Qëllimi i shërben bashkëpunimit, i cili mund të përmblihet në një projekt - ide si më poshtë:

Do të hartohet programi i konferencës në mënyrë që të evidentoheshin problemet që i ndanin ballkanasit në mënyrë që të hartoheshin zgjidhjet më të mira të mundshme pa krijuar probleme të reja.

Në organizimin e konferencës do të merrte pjesë një delegacion, ku në këtë delegacion nuk duhej të kishte më shumë se 30 personalitete nga çdo vend përfaqësues.

Përzgjedhja e delegatëve do të bëhej në funksion të qëllimit të konferencës. Personalitetet duhet të përfaqësonin interesat e shtresave të ndryshme sociale,

⁴⁹⁰ Po aty, fq.1-6

⁴⁹¹ Po aty, f.1-6

⁴⁹² Norman J. Padelford "The movement towards international organization in the Balkans", New York, Oxford university press, 1935, f.2

⁴⁹³ AQSH, F.151, D.103, V.1930. F.101

por edhe interesat e shteteve në përgjithësi. Ato mund të zgjidheshin nga shoqata të ndryshme, mjafton që të përcillnin idetë e drejtësisë dhe solidaritetit ndërkombëtar.

Zyra ndërkombëtare do të ishte konsultative, në të do të merrnin pjesë edhe dy përfaqësues ndërkombëtarë, njëri nga Lidhja e Kombeve dhe tjetri nga ndonjë organizatë tjetër e kësaj natyre.⁴⁹⁴

Konferenca parashikohet të zhvillohet në të gjithë kryeqytetet ballkanike, por komiteti drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Paqes vendosi Athinën si qytetin e parë ku do të zhvillohet konferenca.

Për të informuar në mënyrë të detajuar qeverinë shqiptare dhe vendet e tjera pjesëmarrëse përpilohet edhe memorandumit nga Komiteti Ndërkombëtar për Paqen në Gjenevë. Përmes këtij memorandumit jepen të gjitha udhëzimet e duhura për krijimin e delegacionit për çdo vend. Përfaqësuesit duhet të jenë pjesë të komiteteve lokale të krijuara për këtë qëllim. Ata duhet të jenë përfaqësues të qarqeve parlamentare e politike, anëtarë të shoqatave kombëtare, të dhomës së industrisë, të dhomës së agrikulturës, shoqërive tregtare, shoqatave intelektuale apo shkencore, universiteteve, gazetarë dhe të shoqatave të gruas. Delegacioni përgjithësisht nuk duhet të ketë më shumë se 30 përfaqësues.⁴⁹⁵ Për sa i përket programit paraprak të konferencës ai përmbledhet në tre zëra kryesorë:

Parimet e përgjithshme mbi të cilat duhet të organizohet Bashkimi Ballkanik (organet, kompetencat, marrëdhëniet me Lidhjen e Kombeve) si dhe organizimi i Konferencave Ballkanike.

Masat për afrimin politik dhe intelektual të shteteve ballkanike.

Masat për të favorizuar bashkëpunimin ekonomik⁴⁹⁶

Për çështje të tilla si dobia dhe mundësia e locarno-s ballkanike, krijimit të një instituti intelektual ballkanik, reforma e mësimin të historisë në shkolla, krijimit të një banke ndërbalkanike, do të merrej parasysh opinionin e çdo delegacioni duke u mbështetur veçanërisht në opinionin e specialistëve në delegacion.⁴⁹⁷

Menjëherë pas mbërritjes së këtij lajmi hartohet një qarkore nga MPJ në Tiranë, e cila u shpërndahet secilës legatë (Athinë, Beograd, Sofje, Bukuresht, Romë⁴⁹⁸), sidomos atyre të vendeve ballkanike që të informoheshin mbi këtë ngjarje. Një rëndësi të veçantë duhej t'i kushtonin interpretimit të pjesëmarrjes së Shqipërisë në këtë konferencë. Çfarë mendimi kishin krijuar qarqet politike të çdo vendi mbi konferencën dhe pjesëmarrjen e Shqipërisë, sigurisht aty ku ekzistonte mundësia të sigurohet mendimi i tyre. Për këtë konferencë vetë ministri i jashtëm është "favorevole" dhe sipas tij observatori "nuk ka aspak të drejtë të angazhojë qeverinë por vetëm të raportojë mbi qëllimet, dëshirat, sugjerimet dhe internacionet e konferencës në fjalë"⁴⁹⁹. Pra shkresa përcjell jo vetëm kërkesën ndaj legatave për të raportuar mbi mendimet e vendeve ku ato punonin por

⁴⁹⁴ AQSH, F.151, D.103, V.1930. F.105 (Lidhja e Kombeve, Zyra Ndërkombëtare e Punës, Dhoma Ndërkombëtare e Tregëtisë, Bashkimi Interparlamentar, Bashkimi Parlamentar Ndërkombëtar i Tregëtisë)

⁴⁹⁵ AQSH, F. 151, D. 103, f. 19 – 20(Sipas Memorandumit të dërguar më 30 qershor 1930 nga Bureau International De La Paix)

⁴⁹⁶ AQSH, F. 151, D. 103, F. 21

⁴⁹⁷ AQSH, F. 151, D. 103, F. 29 (Dok. në emër të Komisionit Ndërkombëtar të Paqes, hartuar nga sekretari I përgjithshëm H. Golay)

⁴⁹⁸ AQSH, F. 151, D. 103, V. 1930. F. 101-102 (Qarkore, nr. 1013/4)

⁴⁹⁹ AQSH, F.151, D.103, F.103- 107

edhe qëndrimin e ministrit, i cili në fakt është edhe qëndrim i qeverisë të cilën ai përfaqëson.

Pra në qershor të vitit 1930 qarkorja mbërrin në Bukuresht dhe më 11 qershor 1930, menjëherë vjen edhe raporti me qëndrimin e qeverisë dhe perceptimin e Rumanisë mbi pjesëmarrjen e Shqipërisë në Konferencën e Athinës. Raporti “ fton Shqipërinë të marrë pjesë me anë të një observatori në konferencë”⁵⁰⁰ Meqenëse qëllimi i konferencës është afrimi i popujve ballkanas në aspektin ekonomik, kulturor, historik dhe shpirtëror në kuadrin e Lidhjes së Kombeve, nuk mund të ketë ndonjë përplasje në parim. Nga ana tjetër qeveria nuk ngarkohet domosdoshmërisht me detyrime pasi konferenca organizohet si një nismë jashtë sferave qeveritare, por që sigurisht pa mbështetjen e tyre nuk do të mund të organizohej. Rëndësia e saj në sferën ekonomike është për t'u vlerësuar, pasi, në delegacionet që do të përfaqësojnë vendet, kërkohen jo vetëm politikanë të shquar por edhe përfaqësues të organizatave të mëdha si Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Dhoma e Agrikulturës, Shoqatat e punës dhe Shoqatat Bashkiake. Ajo pra e sheh me pozitivitet pjesëmarrjen dhe madje vlerëson edhe interesin e qeverisë mbretërore shqiptare. Ndër të tjera në raport thuhet se “ ka disa legjenda të cilat duhet të marrin fund në mënyrë që Ballkanet të pushojnë së qeni vendi nevralgjik i Evropës, e për këtë ilaçin e ka brenda vetes”⁵⁰¹ shprehet ministri në këtë raport.

Një përgjigje nga Beogradi pritej me interes në qarqet shqiptare, për vetë faktin e natyrës së marrëdhënieve të krijuara me këtë shtet. Në retrospektiven historike Jugosllavia karakterizohet në atë kohë si një shtet me synime hegjemoniste, i cili gjatë viteve 1912-1920 në çdo rast kishte këmbëngulur në shtrirjen e autoritetit të saj në territoret shqiptare. Në historiografinë shqiptare rivaliteti tradicional italo-jugosllav në Shqipëri ka qenë një nga faktorët negativë që ka penguar konsolidimin e shtetit shqiptar⁵⁰²

Në prill të vitit 1919 Pashic kishte biseduar me Willson-in për çështjen shqiptare dhe i kishte lënë të kuptonte këtij të fundit që nuk kishin asnjë kundërshtim me parimin “Ballkani popujve të Ballkanit, dhe se popullit shqiptar t'i jepej pavarësia brenda kufijve të caktuar”⁵⁰³ duke ju referuar hapsirave për veprimtari ekonomike dhe intelektuale e kulturore.

Entuziazmi i tij vazhdon edhe më tej përpara Willson-it me idenë e bashkëpunimit me Shqipërinë në aspektin doganor. Por ndryshimet politike në Beograd kishin ndryshuar edhe kursin e politikës së jashtme, revanshi agresiv i Jugosllavisë ndaj Shqipërisë u ndal vetëm me pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, pas përpjekjeve të vazhdueshme të Britanis. Periudha më pas shoqërohet me incidente të krijuara në kufi, për të ekuilibruar depërtimin italian në Shqipëri. Periudha 1924-1928 përkon me një klimë të turbullt politike në Jugosllavi, rreth 24 qeveri zëvendësuan njëra-tjetrën duke e thelluar akoma më tepër krizën ekonomike, politike dhe ndërhyrjen masive të kapitalit të huaj në ekonominë jugosllave. Sektorët industrialë e bankarë, në pjesën më të madhe ishin të financuar nga Franca. Ndërhyrja franceze konsiderohej nga historiografia shqiptare përpara viteve '90- të si një tentativë për “Stabilizim të situatës nën petkun e rivendosjes

⁵⁰⁰ AQSH, F.151, D.103, F.103- 107 (Në këtë raport paraqiten të detajuara të gjitha arsyet e pjesëmarrjes së Shqipërisë në Konferencën e Para Ballkanike 5 tetor 1930)

⁵⁰¹ AQSH, F.151, D.103, F.106.

⁵⁰² Paskal Milo “Shqipëria dhe aleanca ballkanike” Tiranë, Studime Albanologjike, 1997, fq.55

⁵⁰³ Vuk Vinaver “Anglia dhe pozita ndërkomëtare e Shqipërisë midis dy luftrave botërore” Gjurmime Albanologjike, Prishtinë 1968, fq. 187

së rendit konstitucional, u shërbente planeve e interesave politike dhe ekonomike të imperializmit Francez në Jugosllavi dhe Ballkan.”⁵⁰⁴ Marrëdhëniet mes dy vendeve ishin acaruar në 1926 kur u nënshkrua Pakti i Parë i Tiranës, impakti negativ i të cilit kishte drejtuar Jugosllavinë drejt nënshkrimit të një serie traktatesh dypalëshe me Francën, Bullgarinë dhe Rumaninë. Situata kishte degraduar në ndërprerje të marrëdhënieve deri në fillim të vitit 1930, kohë kur ishte shfaqur edhe fillimi i krizës italo-shqiptare.

Në lidhje me këtë fenomen të shfaqur në marrëdhëniet ndërballkanike, Beogradi përfaqësonte një nga aktorët kryesorë. Për këtë arsye nga Beogradi vjen përgjigjja relativisht e shpejtë (20 qershor 1930) drejtuar MPJ-sw, Z. Reuf Fico. Përfaqësuesi i Shqipërisë në Beograd njofton ministrin e Punëve të Jashtme mbi qëndrimin e Jugosllavisë. Pas takimit që kishte pasur me Z. Marinkovic kishte kuptuar se “Jugosllavia do të merrte pjesë, por me qenë se çështja e konfederatës apo e bashkimit ballkanik shkakton “objeksione” dhe se vështirësitë që ekzistojnë janë të mjaftueshme, delegatët nuk do të jenë përfaqësues të qeverisë dhe kjo e fundit nuk do të lidhet zyrtarisht me vendimet që do të merren në këtë konferencë.”⁵⁰⁵ Qëndrimi i qeverisë jugosllave dukej se do të ishte në përputhje me rrethanat që do të krijoheshin gjatë konferencës.

Qeveria bullgare ndërkohë e kishte pranuar fresën dhe kishte konfirmuar pjesëmarrjen e saj⁵⁰⁶ Megjithatë vizioni i saj në lidhje me konferencën është tepër pesimist. Sipas qeverisë bullgare realizimi i një afrimi të vërtetë ballkanik nuk mund të ndodhë pa u zgjidhur disa çështje:

Çështja e minoritetit bullgar në Greqi, Rumani dhe Serbi.

Çështja e kufijve të saj me shtetet fqinje

Dalja e Bullgarisë në detin Egje, premtim i parealizuar ndaj shtetit bullgar.

Bullgaria nuk e shikon me simpati edhe për faktin se Greqia këmbëngul në idenë e hedhjes së bazave të reja për afrimin ndërballkanik, por kjo nuk është e mundur pasi sipas saj nuk mund të shkelen të drejtat e popujve të cenuar më parë. Optimizmi i Bullgarisë shfaqet në aspektin ekonomik dhe kulturor kur e quan këtë konferencë si një mundësi për të shtuar bashkëpunimin ndërballkanik. Për arsye të natyrës jozyrtare të konferencës edhe qeveria bullgare vendos të mos i bëjë publikë delegatët e saj.

Përgjithësisht ruajtja e ekuilibrave në Evropë ishte “meritë” e diplomacisë britanike. Në se do t’i referohemi çështjes së bashkimit ballkanik, Britania përpieq të krijonte “Lokarnin e Ballkanit”⁵⁰⁷. Që në vitin 1926 ajo u përpjek të krijonte paqe në këtë rajon duke ekuilibruar mbivendosjen e synimeve ekspansioniste të Jugosllavisë që mbështetej nga Franca dhe Italisë që kishte nisur në atë kohë të investonte aq shumë në Shqipëri. Në studimet e kohës ndërhyrje e kapitalit të huaj në Shqipëri paraqitet në shifra shumë të larta. Kështu, në periudhën 1929-1931 sasia e mallrave në franga ari për eksport – importin variojnë për Italinë 60.4%-46.2% në 66.1%-46.8%, për Jugosllavinë 1.5%-7.9% në 1.9%-9.7%, për Britaninë 0.4%-7.0% në 1%-5.9%⁵⁰⁸. Ndërhyrja italiane është ajo që shqetëson Jugosllavinë, ndërsa ndërhyrja e kapitalit Britanik merret si një investim në eksporte për të ekuilibruar ndërhyrjen italiane⁵⁰⁹

⁵⁰⁴ Paskal Milo “Histori e evendeve të Ballkanit 1918-1939” Kombinati Poligrafik, Tiranë 1987, fq.35

⁵⁰⁵ AQSH. F.151, D.103, F.192

⁵⁰⁶ AQSH. F.151, D.103, F.17 (25 qershor 1930, nr.152/1)

⁵⁰⁷ Vuk Vinaver “Anglia dhe pozita...” f.207

⁵⁰⁸ Naqo Sinani “Politika reaksionare e Portës së hapur të qeverisë së Zogut” Tiranë, Studime historike, nr.1, 1893, f.98

⁵⁰⁹ Vuk Vinaver “Anglia dhe pozita...” f.221

Për sa i takon legatës mbretërore në Londër, përmes shkresës zyrtare, më 22 korrik 1930 njoftohet se ministri i Shqipërisë në Londër është ftuar të marrë pjesë në një mbledhje të organizuar nga ministri i Greqisë në Londër me qëllim komunikimin e përgatitjeve të Greqisë për Konferencën Ballkanike. Në të merrnin pjesë ministrat e të gjithë vendeve ballkanike në Londër dhe vetë nismëtari i konferencës, Z. Papanastasiu, mbajti fjalën e rastit. Ai porositi dhe nxiti pjesëmarrësit që të këmbëngulnin në krijimin e komiteteve lokale në vendet e tyre.⁵¹⁰ Ministri shqiptar pohon në letër se në një bisedë me Z. H. Lafontaine⁵¹¹ si dhe me disa përfaqësues grekë e bullgarë pranojnë se ndjehet domosdoshmëria e një afrimi të popujve të Ballkanit⁵¹² Në këtë rast nuk mund të kuptojmë cili është qëndrimi i qeverisë britanike në lidhje me konferencën apo pjesëmarrjen e Shqipërisë në të, por fakti që lejon organizimin e mbledhjeve të ndryshme me këtë rast, tregon interes ndaj çështjeve ballkanike. Këtë e dëshmon edhe përpjekja e vitit 1930 kur ajo hyri në tratativa mes Italisë, Francës e Jugosllavisë që të parandalonte nënshkrimin e pakteve analogë mes Shqipërisë, Italisë, Francës e Jugosllavisë. "Nuk duhet t'i japim mundësi Italisë të thotë se ishte e detyruar ta përtëri Paktin e Tiranës, sepse nuk ishte në gjendje të sigurojë pavarësinë e Shqipërisë në një mënyrë tjetër."⁵¹³ Roma dukej shumë e ndjeshme ndaj lëvizjeve që po ndërmernte qeveria Shqiptare, sepse përgjigje pozitive arritën të marrin pothuajse nga të gjithë vendet e tjera, përveç Italisë, e cila nguroi të japë pëlqimin e saj. Në fillim të viteve '30, mes Shqipërisë dhe Italisë kishte nisur një krizë në marrëdhëniet dy palësh. "Pakënaqësia kishte nisur në shtresën e ulët shoqërore, por nuk përjashtohej edhe pakënaqësia e elementëve të veçuar në rrethet politike."⁵¹⁴ Ndërhyrjet e kapitalit italian në Shqipëri ishin në nivelet më të larta⁵¹⁵ dhe ekonomia pothuajse ishte e varur plotësisht nga huat dhe kreditë e Italisë. "Marrëdhëniet italo - shqiptare veçanërisht gjatë qeverisjes së Musolinit kanë qenë të komplikuar"⁵¹⁶ shprehet prof. Kerner, dhe mendoj se kjo ka shërbyer si një shtysë drejt politikës adriatiko - ballkanike të Zogut. Pra drejt trajektoreve të reja politike me vendet fqinjë. Rasti më i mirë i paraqitet me ftesën për pjesëmarrje në Konferencën e Parë Ballkanike të cilën e vlerësoi menjëherë.

Qeveria Shqiptare në aspektin e brendshëm po punonte për krijimin e një komisioni me specialistë për t'u përfaqësuar në konferencë. Këshilli i Ministrave në praninë e kryeministrit z. Pandeli Evangjeli, të z. Reuf Fico, ministër i Punëve të Jashtme dhe kabinetit qeveritar, morën vendimin që do të merrnin pjesë në Konferencën e Parë Ballkanike dhe do të dërgojnë në këtë konferencë një komision të përbërë nga z. Mehmet Konica, z. Mid'hat Frashëri e Patër Gjergj Fishta.⁵¹⁷ Më vonë komisioni mori trajtë të plotë. Pjesë e komisionit u bënë edhe Jul Bonati, Maliq Bushati, Bedri Peja, Asim Jakova, Stavro Stavi, Leonidha Naci, Fasil Frashëri, Seid Toptani, dhe Zj. Emine Toptani.

⁵¹⁰ AQSH. F.151, D.103, F.20

⁵¹¹ AQSH. F.151, D.103, F.20 (Z.H. Lafontaine është kryetar i Zyrës Ndërkombëtare të Paqes në Gjenevë)

⁵¹² AQSH. F.151, D.103, F.20.

⁵¹³ Vuk Vinaver "Anglia dhe pozita ..." f.222

⁵¹⁴ Massimo Borgogni "Tra continuata e incertezza. Italia e Albania 1914-1939) Francoangeli, Milano, f.117

⁵¹⁵ Iliaz Fishta "Ndërhyrja e kapitalit të huaj dhe pasojat skllavëruese për Shqipërinë 1931-1936" 8 Nëntori, Tiranë 1989, (shih kreu III "Tensioni në marrëdhëniet shqiptaro-italiane" f.57-116)

⁵¹⁶ Robert J.Kerner & Harry N.Howard "The Balkan Conferences and the Balkan Entente" University of California Press, Berkeley, California 1936, f. 18

⁵¹⁷ AQSH. F.151, D.103, F.30.(Vendim nr. 622 dt. 23. 07. 1930, Këshilli i Ministrave)

Në aspektin e respektimit të pakicave duhej të punonin shumë diplomatët shqiptarë, pasi kjo çështje përbënte problem për mbarëvajtjen e konferencës. Në të njëjtin qëndrim shfaqen edhe bullgarët, të cilët kërkojnë domosdoshmërisht respektimin e pakicave të tyre. Shqipëria u bë pjesë e Konferencës së Parë Ballkanike dhe u përpoq të arrinte qëllimet e saj. Motivet që e shtynë qeverinë shqiptare në pjesëmarrje ishin të shumta: kriza ekonomike botërore, kriza në marrëdhëniet me Italinë, problemet e vazhdueshme nacionale me fqinjët dhe mundësia e perspektivave të reja. Impenjimi i delegacionit duket në të gjitha fushat e bashkëpunimit. Komisionin politik, ku edhe situata paraqitej shumë e nxehtë, u menaxhua nga diplomacia e hollë e z. Mehmet Konica. Po ashtu edhe komisionet e tjera patën përfaqësuesit e tyre, p.sh., ai i komunikimit dhe gazetarëve u përfaqësua nga Leonidha Naci apo komisioni mbi çështjet sociale, sektori i gruas u përfaqësua nga znj. Emine Toptani.

Të gjithë delegatët u munduan të përfshihen në politikat rajonale përmes mbështetjes që i dhanë krijimit të unionit ballkanik. Megjithëse Konferenca e Parë hodhi vetëm themelet e krijimit të këtij unioni, mund të themi që impakti i saj filloi të ndihet në rajon sidomos në Shqipëri. Kjo e fundit më shumë se kurrë e ndiente domosdoshmërinë e ndryshimit të kursit të politikës së jashtme. Rishikimi i pozitave të saj me fqinjët tokësor dhe pozicionimi në lidhje me Italinë ishin problemet kryesore që duhej të zgjidhte.

Në të gjitha drejtimet mbreti Zog dëshironte, madje këmbëngulte në fqinjësi të mirë dhe përfshirjen aktive të Shqipërisë në Konferencat Ballkanike. Nisma e tij për të orientuar shtypin të shkruaj sa më shumë për konferencën ballkanike⁵¹⁸ dhe miratimi që ai personalisht i akordoi përfaqësuesve janë dëshmi e dukshme e orientimit të tij. Të tilla veprime diplomatike në favor të politikës ballkanike ndodhin në të njëjtën kohë me krisjen e marrëdhënieve shqiptaro-italiane. Pas kërkesave të vazhdueshme nga qeveria shqiptare për ulje të nivelit të shlyerjes së kredisë dhe akordimit të një kredie të rem, por jo me kushtet e pretenduara nga Musolini, vjen edhe kjo hapësirë e re për politikën e jashtme shqiptare.

Mbyllja e punimeve në Konferencën e Parë Ballkanike, që u mbajt 5-12 tetor 1930 dhe rikthimi i delegacionit në atdhe, çel siparin e debateve publike në qarqet akademike shqiptare dhe në diasporë. Çështja kryesore ishte se sa ishte arritur të dëgjohej zëri i Shqipërisë dhe se sa përparësi do të sillte anëtarësimi i vendit atje. Në shtypin e kohës u trajtuan gjerësisht çështja e programit dhe e statusit që do të gëzonte çdo shtet pjesëmarrës. Në përgjithësi intelektualët ishin ata që prisnin realizimin e këtyre aspiratave ballkanike. Nën moton e lokarnos evropiane kërkonin të realizonin lokarnon ballkanike, mbi baza reale dhe të drejta.

Shqipëria kishte meritat e saj në lidhje me përfaqësimin dhe çështjet e drejta që parashtrroi në konferencë. Problemi i minoriteteve, edhe pse nuk i shkante për shtat politikave jugosllave apo greke, arriti të diskutohej në konferencë e madje të sigurojë mbështetjen e Bullgarisë e Rumanisë⁵¹⁹. Shqipëria u përfaqësua denjësisht në të gjashta komisionet e krijuara në seancën e parë të konferencës. Komisioni i politikës, që përfaqësohej nga Mehmet Konica, e përballoi me sukses akuzën e delegacionit jugosllav kur u shpreh se mund të arrihej një marrëveshje vetëm nëse nuk kishte ndërhyrje në punët e brendshme nga fuqi të treta, duke iu referuar Shqipërisë dhe pozitës së saj me

⁵¹⁸ AQSH. F.151, D.52, F.150. (Mbretëria Shqiptare, Zyra e shtypit; Porosi Fletorevet Shqiptare "rezervat")

⁵¹⁹ AQSH. F.151, D.103, F.248

Italinë. Argumentet e paraqitura nga diplomati Konica, ku theksoi mbi të gjitha independencën shqiptare, u vlerësuan me ovacione nga të gjithë pjesëmarrësit, aq sa e detyruan përfaqësuesin jugosllav të tërhiqej nga deklarata e tij dhe të theksonte se ishte tërësisht mendim personal dhe jo qëndrim i qeverisë që ai përfaqësonte. Sipas delegacionit, afërsi politike u krijua më tepër me Turqinë, Rumaninë, Bullgarinë Greqinë e më pak me Jugosllavinë. Në Konferencën e Parë qëndrimi i Shqipërisë ishte i njëjtë me atë të pjesëmarrësve të tjerë, pra në favor të një bashkimi ballkanik, por në platformë disi më ndryshe nga sa e parashtronin vendet e tjera.

Me gjithë dëshirën e mire për veprimtari kombëtare në favor të Konferencës Ballkanike, vendi pati praktikisht më tepër artikuj të shkruar nëpër gazeta se sa veprimtari konkrete. Pra, përgjegjësia që mori me vete delegacioni mbeti praktikisht në letër. Gjendja e vështirë ekonomike e bashkërenduar edhe me faktorët e tjerë diplomatikë patën efektin e tyre frenues për sa i takon iniciativave organizative. Përplasjet ideore dhe polemikat mbi qëndrimet e ndryshme të palëve, në rastin më të mirë botoheshin në gazeta. Vitet e krizës së thellë ekonomike e kishin përqendruar vëmendjen e qeverisë shqiptare drejt gjetjes së mundësive për të kapërcyer vështirësitë ekonomike dhe mesa duket tek Konferencën e Parë Ballkanike nuk i perceptuan sinjalet e bashkëpunimit.

Në verë të 1931 u intensifikua veprimtaria proballkanike e qeverisë shqiptare. Mbreti Zog në atë periudhë pohonte se “çështja Shqiptare është një çështje Ballkanike dhe jo e Adriatikut siç propagandonte Italia.”⁵²⁰ Përpyekjet e tij u thelluan në drejtim të vendeve fqinjë sidomos me Jugosllavinë, nga e cila shpeshohej për rrugë të reja bashkëpunimi, sidomos në kushtet e krizës së thellë me Italinë. Pra “larg” Italisë por jo presionit të saj dhe në mes të krizës së thellë ekonomike, projektohet pjesëmarrja në Konferencën e Dytë Ballkanike. Ministri i Jashtëm, Hysen Vrioni, deklaroi në qarqet politike vendase dhe në takimet me përfaqësuesit e huaj se qeveria ishte e entuziazmuar për pjesëmarrjen në Konferencën e Dytë Ballkanike. Këtë e përforcoi më tej me urdhrin e saj zyra e kryeministrit ku përmes një letre i kërkonte gazetave shqiptare që të botonin aktivitete nga konferenca e Stambollit.⁵²¹

Mbi bazën e një raporti të ardhur në MPJ në Tiranë (25 qershor 1931)⁵²² u ngrit dhe funksionoi programi i komisionit përfaqësues në Konferencën e Dytë Ballkanike. Programi u hartua mbi baza kombëtare, madje karta nacionaliste vazhdoi të përsëritet edhe në këtë konferencë. Zhvillimet e Konferencës së Dytë të mbajtur në Stamboll, sollën një detajim të problematikave të gjashtë seksioneve të konferencës. Sipas perceptimit të shumicës së vendeve pjesëmarrëse orientimi i tyre duhet të orientohej drejt aspektit ekonomik, sepse aty ishte i garantuar sukcesi. Nëse edhe në këtë konferencë do të hapej çështja e pakicave, çdo arritje do të vihej në diskutim. Presioni më i madhe ishte i fokusuar në sesionin politik, vetëkuptohet për natyrën e problemeve që paraqiste Ballkani. Aspektet sociale dhe ekonomike në përgjithësi hodhën bazat e bashkëpunimit rajonal, “thembra e Akilit” vazhdonte të ishte çështja e minoriteteve. Përmes traktateve bilaterale ishte rregulluar çështje postare, gjithashtu u hodhën bazat për bashkëpunimin tregtar, doganor, intelektual dhe universitar. Risia që sjell Konferenca e Dytë është plani për hartimin e draftit të parë për realizimin e paktit ballkanik.

⁵²⁰ Paskal Milo “Shqipëria dhe ...” fq.61

⁵²¹ AQSH, F.151, V.1931, D.52, F.150

⁵²² AQSH, F.151, V.1931, D.52, F.60-62

Detyrat e vendosura në Konferencën e Parë Ballkanike kishin filluar të zbatoheshin. Në vende si Jugosllavia dhe Greqia jehona e veprimtarive kombëtare në favor të unionit ballkanik vazhdonte, megjithëse jo në ritmet e kërkuara. Shpeshherë raportet që duhej të vinin nga selitë e vendeve pjesëmarrëse në selinë qendrore nuk mbërrinin në kohën e duhur ose nuk vinin fare. Një mungese e tillë vështirësonte punën e komisioneve të ngritura në konferencë. Për pasojë të mungesës së koherencës, problemet nuk evidentoheshin siç duhet dhe pasonin njëri-tjetrin.

Për të motivuar qeverinë shqiptare, shpesh është drejtuar nga Athina edhe diplomati Mehmet Konica. Ai e informon qeverinë mbi seancat parlamentare që zhvillohen në parlamentin grek, me qëllim përsheptimin e punës së komisioneve intelektuale dhe postare, dhe e udhëzon këtë të fundit të krijojë një komision me gjashtë specialistë përkatësisht në fushat: politikë, ekonomi, sociale, intelektuale dhe komunikacion⁵²³, të cilët duhet të hartojnë raportet përkatëse dhe t'i dërgojnë ato në Stamboll në prill të vitit 1931. Në këtë kuadër do të ketë edhe vizita të ndërsjella midis vendeve përfshi edhe Shqipërinë, sidomos në fushën e administrimit lokal. Gjithashtu, ai informon përmes raportit mbi veprimtarinë e këshillit të konferencës ballkanike në Selanik. Në këtë këshill ishin diskutuar disa aspekte të rëndësishme të organizimit të Konferencës së Dytë Ballkanike. Çështje të tilla, si: natyra dhe organizimi i unionit ballkanik, krijimi i një komisioni paraprak për hartimin e një projekt-ideja mbi paktin ballkanik, masat për unifikimin e drejtësisë, caktimin e një dite ballkanike në nder të bashkimit ballkanik, zgjedhja e një komisioni për mbrojtjen e duhanit dhe komisioni i financave, ishin çështjet parësore në këtë mbledhje të kryesisë së këshillit të konferencës.

Çështja më e rëndësishme ishte ajo e ngritjes së një komisioni, i cili do të hartonte draftin e paktit ballkanik, dhe në këtë pikë komisioni parashikonte se çdo grup kombëtar do të caktonte dy specialistë që do të studionin çështjen dhe do të paraqisnin platformën e tyre në këtë komision. Në fazën e dytë vetë komisioni do t'i studionte variantet dhe do t'i publikonte ato edhe për grupet e tjera kombëtare dhe do të diskutoheshin publikisht në Konferencën e Stambollit.⁵²⁴ Gjithashtu Konica e njoftoi qeverinë shqiptare se me disa reduktime është pranuar edhe plani i punës për Konferencën e Dytë Ballkanike, sigurisht me shumë polemika nga ana e përfaqësuesve jugosllavë për çështjen e minoriteteve. Me rëndësi është pika tre e planit të punës ku pranohet se do të ketë " bisedim mbi raportin e komisionit të posacëm për aplikim pikërisht të marrëveshjeve në fuqi dhe të detyrimeve që rrjedhin prej tyre, tue marrë brenda edhe ato që u përkasin pakicave."⁵²⁵ Pranimi i kësaj çështjeje, krahas aspekteve të tjera, ishte një mundësi e mirë për t'u shfrytëzuar nga ana e popujve që ndiheshin të cenuar nga ky fakt. Mbetej vetëm impenjimi i tyre dhe dëshira e mirë e popujve të tjerë dhe e kryesisë së vendeve ballkanike për t'u trajtuar. Për të realizuar pjesën e publicitetit në shtyp, mbi Konferencën Ballkanike dhe arritjeve të saj, çdo grupi kombëtar do t'i akordohesh një mijë dollarë, të cilat do të përdorëshin për botimet e ndryshme me në fokus unifikimin ballkanik. Vetë qeveria shqiptare, përmes përfaqësuesit të saj, i ishte bashkuar nismës së Greqisë dhe Turqisë për të ndihmuar selinë e kryesisë për veprimtarinë e saj me shumën 25000 franga.

⁵²³ AQSH, F.151, V.1931, D.52, F.10-11

⁵²⁴ AQSH, F.151, V.1931, D.52, F.13

⁵²⁵ AQSH, F.151, V.1931, D.52, F.14

Shqipëria vazhdoi të ishte mjaft e interesuar për veprimtarinë e fqinjëve të saj në lidhje me Konferencën e Dytë Ballkanike e cila po afronte. Eksperienca e Konferencës së Parë dhe polemikat e vazhdueshme me Jugosllavinë e kishin qartësuar trupën diplomatike shqiptare për terrenin e vështirë të krijuar në konferencë. Por në kushtet e krizës së thellë ekonomike dhe ndërprerjes së marrëdhënieve diplomatike me Italinë, fqinjët tokësore dhe nisma e bujshme e krijimit të unionit ballkanik ishin e vetmja shpresë për Shqipërinë. Për t'u parapërgatitur për situatën dhe qëndrimin e Jugosllavisë, nga legata e Beogradit, në prill të vitit 1931 vjen një kopje e memories së tyre që do të paraqite në konferencë. Përpjekjet e Jugosllavisë kishin nisur me mbajtjen e mbledhjes së Antantës së Vogël, thelbi i të cilës kishte qenë qëndrimi i tyre kundër iniciativës gjermano-austriake mbi projektin e bashkimit doganor⁵²⁶. Sigurisht që pas organizimit të mbledhjes qëndronte Franca, e cila do të mbështeste Jugosllavinë në çdo aspekt për t'u kundërvënë potencialit gjithmonë e në rritje të Gjermanisë.

Qëndrimi i tyre shkonte në favor të bashkimit ekonomik, sepse e shikonin si jo të plotë edhe pse midis vendeve ishte nënshkruar pakti Kello-Briand, si dhe nënshkrimin e një pakti arbitrazhi. "Disa çështje të varura nga pakti Kello-Briand krijojnë një pengesë serioze drejt unionit ballkanik."⁵²⁷ Pikëpamja e Jugosllavisë mbështet bashkëpunimin ekonomik, sidomos atë bujqësor për vetë natyrën e ekonomisë së shteteve ballkanike. Kjo memorie u shfaq publikisht në mbledhjen e Bukureshtit ku u diskutuan disa aspektet të afrimit ballkanik dhe veprimtaritë e Konferencës së Stambollit⁵²⁸.

Memoria e Jugosllavisë paraqitej skeptike për sa i takon afrimit politik. Ajo sugjeron realizimin e dy faktorëve për të arritur një bashkëpunim ndërballkanik.

Së pari, ndërhyrja në jetën e brendshme të shteteve fqinje me qëllimin që të ndalojë konsolidimin e tyre, të turbullojë paqen dhe qetësinë ndër to, të jetë drejtpërsëdrejti ose indirekt me anë të organizatës ose tolerimit në tokën e tij, të grupeve të armatosura, të cilat kanë për qëllim të atakojnë paqen e brendshme e sigurinë e shteteve fqinje.

Së dyti, afrimet dhe aleancat me shtetet ekstra-ballkanike që kanë për qëllim tendenca kolonizimi në tokat ballkanike e që toka e tij dhe forcat e tyre dhe institucionet janë në dispozicion për t'u përdor kundra një ose më shumë shteteve ballkanike.

Mbretëria shqiptare pasi kishte siguruar informacionin e nevojshëm e kishte të qartë terrenin politik me të cilin do të përballej në Konferencën e Dytë. Përmes zyrës së shtypit, më 5 shtator 1931, përpilohet një deklaratë. Midis rreshtave pohohet qëndrimi kombëtar i delegacionit shqiptar dhe luten gazetatat të realizojnë një fushatë energjike dhe të pareshtur⁵²⁹ në favor të çështjes së minoriteteve. Delegacioni do të mbështesë këto parime dhe nuk do të pranohet asnjë detyrë nëse ndodhe kundërta.

Në Konferencën e Dytë Ballkanike sesioni politik kryesohej nga Z. Pella dhe në rend të ditës qëndronin çështjet: pakti ballkanik, pengimet që ndalojnë afrimin politik midis kombeve të Ballkanit dhe çarmatimi. Duke iu referuar çështjes së paktit ballkanik, zyrtarisht u shpaloj një projekt-ide nga delegacioni grek i kryesuar nga z. Spiropoulos. Ky draft përmbante të gjitha parimet e vendosura në Konferencën e Parë, kriteret e realizimit të një pakti mosulmimi, arbitrazhin dhe ndihmën reciproke, si edhe probleme të tjera ku përfshihej edhe çështja e pakicave. Grupi bullgar paraqitet me një

⁵²⁶ AQSH, F.151, V.1931, D.52, F.81

⁵²⁷ AQSH, F.151, V.1931, D.52, F.60

⁵²⁸ AQSH, F.151, V.1931, D.52, F.138.

⁵²⁹ AQSH, F.151, V.1931, D.52, F.150

memorandum për çështjen e pengesave morale dhe politike të afrimit ballkanik. Sipas pikëpamjes së tyre duhet të krijohet një bazë e përbashkët ligjore, veçanërisht për trajtimin e minoriteteve në Ballkan. Për këtë arsye memorandum i referohet edhe artikullit 19 të Paktit të Lidhjes së Kombeve. Jugosllavia paraqitet me platformën e saj që bazohet në dy parimet e sipërpërmendura. Përfaqësuesit turq e vënë theksin tek mungesa e traktateve bilaterale mes shteteve si parakusht për krijimin e unionit ballkanik dhe përfunduan me dhënien e dy rekomandimeve për vendet e tjera të rajonit: së pari, sheshimin e mosmarrëveshjeve me natyrë madhore, dhe së dyti, domosdoshmërinë e lidhjes së marrëveshjeve dypalëshe midis shteteve që nuk kanë ende.

Delegacioni shqiptar, i kryesuar nga Mehmet Konica, propozoi krijimin e gjashtë komisioneve në gjashtë vendet pjesëmarrëse për të studiuar gjenden e pakicave, nëse për pakicat zbatohen traktatet respektive. Këto komisione do të kishin varësi nga kryesia e komitetit ballkanik dhe do të ushtronin veprimtarinë për tre muaj, duke nisur nga dita e mbylljes së Konferencës së Dytë Ballkanike. Parimisht delegacioni shqiptar u shpreh pro për cilindo propozim që do të siguronte gjerësisht të drejtat e pakicave.⁵³⁰

Çështja e pakicave fillon të marrë rëndësinë e duhur pikërisht pas deklaratës së delegacionit shqiptar. Menjëherë përfaqësuesi grek, Papanastasiu, propozoi krijimin e një komisioni të vetëm për çështjen e pakicave, ndërsa delegacioni bullgar propozoi që çështja të zgjidhej me traktate dypalëshe jashtë konferencës. Për sa i takon qëndrimin të delegacionit jugosllav mund të themi që këtu shpërthyen polemikat mes përfaqësuesve të delegacioneve. Memoria shqiptare kishte tronditur palën Jugosllave, sepse thellësia dhe këmbëngulja mbi çështjen e pakicave në përmbajtjen e platformës i referohej drejtpërdrejtë shqiptarëve, që pas traktateve të paqes së Luftës së Parë Botërore jetonin jashtë territorit etnik shqiptar. Z. Topallovic deklaroi se memoria shqiptare është një sharje kundër shtetit jugosllav⁵³¹, por vetë Konica e mohoi një deklaratë të tillë. Tensioni mes dy grupeve vazhdoi më tej kur fjalën e merr Z. Jonic, që ishte edhe kryetar i delegacionit jugosllav. Përmes toneve të ashpra ai akuzoi delegacionin shqiptar për memorien e tyre, e cila, sipas tij, ishte tërësisht e krijuar nën influencën italiane, duke e quajtur "emertinencë". Por, Konica sërish e kundërshtoi qetësisht atë duke u shprehur se "emertinencë quhet sjellja e juaj që është e një t'egri të zbritur prej maleve dhe jo të një njeriu të qytetëruar siç pretendoni ju. Do të bëni mirë të heshtni se ndryshe kam për t'u parashtruar këshillit të gjithë keqbërjet e juve kundër pakicave shqiptare."⁵³² Vetëm kaq mjafton për të kuptuar brishtësinë e një nisme të tillë. Konica e shfrytëzoi këtë moment dhe përpara të gjithë delegacioneve pohoi publikisht se Jugosllavia po e akuzonte Shqipërinë padrejtësisht, madje po e vendoste përpara përgjegjësisë atë "ose me italinë kundër neve ose me neve kundër Italisë". Por interesat e të gjithëve ishte që Shqipëria të mbetet e paanshme. Marrëdhëniet me Italinë erdhën, përveç të tjerave, edhe si rezultat i refuzimit dhe i pretendimeve të Jugosllavisë. Madje Konica nuk e humbi këtë rast për t'i ballafaquar edhe aleancën mes Jugosllavisë dhe Francës. Por këto të fundit u justifikuan nga ana e tyre se nënshkrimi i aleancës ishte si pasojë e traktateve italo-shqiptare, megjithëse realisht aleanca franko-jugosllave është më e hershme se ajo italo-shqiptare. Në këtë ngjarje akuzat shkuan deri në atë pikë sa Shqipëria u akuzua nga Jugosllavia për pranim të forcave ushtarake italiane në territorin e saj, fakt i cili

⁵³⁰ AQSH, F.151, V.1931, D.52, F.200-201.

⁵³¹ AQSH, F.151, V.1931, D.52, F.202

⁵³² AQSH, F.151, V.1931, D.52, F.202

shqetësonte këtë të fundit. Mbi këtë çështje edhe vetë delegacioni jugosllav u kristalizua në dy rryma të ndryshme, pjesa që ishte kundër një marrëveshje ballkanike (përfaqësuar nga Z. Jonic) dhe pjesa pro një marrëveshje të tillë (përfaqësuar nga Z. Marinkovic) Meritë e delegacionit shqiptar ishte që e mbajti të mbërthyer akoma në agjendën e Konferencës Ballkanike çështjen e pakicave. Me gjithë vështirësitë që pati, këmbëngulja e tyre bëri të mundur krijimin e një komisioni të veçantë që do të merrej me problemet që solli kjo çështje, zgjidhjen e konfrontimeve dhe vendosjen e veprimtarive në rrugë të drejtë.

Arritjet më të mëdha të Konferencës së Dytë Ballkanike i përkasin aspektit të afrimit intelektual. Raporti i delegacionit shqiptar mbi afrimin intelektual, u botua në organin e konferencës "Les Balkanes". Për sa i takon unifikimit të së drejtës në Ballkan, u krijua një seksion juristësh njohës të mirë të të drejtave të shteteve të tyre, të cilët do të bashkërendonin punën e tyre për të sjellë një të drejtë të përbashkët. Pjesë e këtij seksioni ishte dhe delegati shqiptar Suad Aslani. Për sa i takon çështjes së krijimit të federatës së shtypit ballkanik, rolin kryesor në krijimin e statutit të saj e ka Rumania. Rëndësi i kushtojë aktiviteteve të "Javës Ballkanike" të përcaktuara në janar të çdo viti, për të cilën edhe shkrimet do të bëheshin në gjuhën amtare. Masa duhej të merreshin në lidhje me lëndët e historisë dhe gjeografisë në shkollat e mesme, ku duhej të vendosej një raport i ri mes njohurive që merren dhe atyre që duhej të merreshin për historinë dhe gjeografinë rajonale. Gjithashtu u hodh ideja e mësimin në shkolla si gjuhë e huaj e dytë një gjuhë ballkanike, apo të krijimit të një instituti ndërballkanik në formën e një shkolle normale ku të mësonin nxënësit dhe nxënëset nga i gjithë Ballkani.

Bibliografi

Burime arkivore

- Aqsh (Arkivi qendror i Shtetit në Tiranë) Shqipëri.
- Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme Tiranë, Shqipëri.

Literaturë e huaj

- Borgogni, Massimo "Tra continuata e incertezza. Italia e Albania 1914-1939" Francoangeli, Milano
- Norman J. Padelford "The movement towards international organization in the Balkans", New York, Oxford university press, 1935
- Robert J.Kerner & Harry N.Howard "The Balkan Conferences and the Balkan Entente" University of California Press, Berkeley, California 1936

Literaturë vendase

- Akademia e Shkencave "Historia e popullit shqiptar" vëll.IV, Toena, Tiranë 2007;
- Naqo Sinani "Politika reaksionare e Portës së hapur të qeverisë së Zogut" Tiranë, Studime Historike, nr.1, 1893;
- Fishta. Iliaz "Ndërhyrja e kapitalit të huaj dhe pasojat skllavëruese për Shqipërinë 1931-1936" 8 Nëntori, Tiranë 1989;
- Paskal Milo "Shqipëria dhe Aleanca Ballkanike" Tiranë, Studime Albanologjike, 1997;
- Shpuza. Gazmend, "Shqipëria ndërmjet Ballkanit dhe Apenineve" Ekstra, Tiranë 1999
- Ushtelenca, Ilir. "Diplomacia e mbretit Zog I" Ermir, Tiranë 1997;
- Vuk Vinaver "Anglia dhe pozita ndërkombëtare e Shqipërisë midis dy luftërave botërore" Gjurmime Albanologjike, Prishtinë 1968;

QËNDRIMI I POLITIKËS BRITANIKE NDAJ SHQIPËRISË NË VITET 1939 – 1942

Armand Sheqi

Qendra Ndëruniversitare e Studimeve Albanologjike

Abstrakt: Në këtë kontekst, mund të themi se qëndrimi i Britanisë karshi Shqipërisë në periudhën në fjalë, nuk kushtëzohet nga ndonjë interes i veçantë (i cili dukshëm mungonte), por nga rrethana të tjera, që rridhnin prej politikës së saj të përgjithshme të paqes në Europë, në përgjithsi, dhe qëndrimin ndaj shtetit pushtues të Italisë në veçanti. Periudha kronologjike dy vjeçare, e shënuar nga pushtimi i Shqipërisë (7 prill 1939), deri në fillim të fushatës gjermane në Ballkan (prill 1941), u shoqërua nga ngjarje me rëndësi për Europën, Ballkanin dhe Shqipërinë në veçanti.

Politika britanike ndaj Shqipërisë në periudhën e viteve 1939 - 1942, u karakterizua nga mospërfillja totale e interesave të Shqipërisë, të cilat u sakrifkuan për arsye egoiste, që u konsideruan më të rëndësishme. Ato pak interesa që kishte në atë vend, Britania u tregua e gatshme t'i sakrifkonte në favor të palëve të tjera, fillimisht Italisë, dhe më pas Greqisë. Në terma afatgjatë, mungesa e parimeve dhe orientimi nga frynte era për momentin, nuk dha ndonjë rezultat praktik, përveç se një dyshimi permanent dhe të fortë të shqiptarëve ndaj Britanisë së Madhe.

Fjalët çelës: Shqipëri, Britania e Madhe, Lufta e Dytë Botrore, Marrëveshje.

Qëndrimi i politikës britanike ndaj Shqipërisë në vitet 1939 – 1942

Ndjeshmëria e Italisë karshi Shqipërisë, të cilën lidhshipi fashist e shihte pak a shumë si një farë kolonie të tijën përtej detit, nuk përbente një sekret, dhe nuk kontestohet nga Londra.⁵³³ Qëndrimi ndaj këtij vendi qysh në fillim të luftës, ishte sekondar, dhe në varësi të qëndrimit karshi Italisë, të cilën autoritetet britanike e cilësonin si primare.

Marrëveshja dypalëshe e 16 prillit të vitit 1938, e cila kishte të bënte drejtpërdrejtë me Shqipërinë, u bë baza e marrëdhënieve italo - britanike deri ditën e hyrjes së Italisë në luftë. Sipas marrëveshjes, Londra do të punonte për të shmangur ç'do përplasje me italianët në Mesdhe dhe Lindjen e Mesme, duke rënë dakord që të njihje pushtimin italian të Etiopisë, dhe të përdorte influencën e saj për t'i bindur shtetet e tjera të bënin të njëjtën gjë. Në këmbim, Italia ishte e detyruar të tërhiqte trupat e saj nga Spanja, në përfundim të luftës civile, dhe të hiqte dorë nga propaganda në Lindjen e Mesme. Marrëveshja hyri në fuqi më 16 nëntor të vitit 1938, edhe pse lufta në Spanjë ende nuk kishte përfunduar.

⁵³³ Bernd J. Fischer: *Italian policy in Albania 1894 - 1943*, në *Balkan Studies*, vol. XXVI, No. 1, Thessaloniki, 1985, f. 101 – 112.

Pavarësisht informatave që kishte, pushtimi italian i Shqipërisë e gjeti qeverinë britanike të papregatitur, në një gjëndje konfuzioni, dhe pa një strategji të qartë reagimi. Çambërlen, i cili ndërpreu pushimet e tij në Skoci, e konsideroi atë një veprim personal të Musolinit. Sido qoftë, ai vazhdoi të mbante të njëjtën linjë qëndrimi ndaj diktatorit italian. Marrëveshja italo - britanike vazhdoi të mbetej në fuqi, dhe nuk pati asnjë protestë për shkeljen e njëanshme të saj nga ana e Italisë.⁵³⁴ Synimi i qeverisë për të mos reaguuar, bëhet i qartë edhe nga kablogramet që FO u dërgoi ambasadorëve në Athinë dhe Beograd, ku i udhëzon që të mos i lënë të kuptojnë qeverive pranë të cilave ishin akredituar, se qeveria britanike kishte ndërmend të përfshihej në mënyrë aktive në ngjarjet dhe situatën në Shqipëri.⁵³⁵ Thirrjet e dëshpëruara për ndihmë nga ana e ambasadorit shqiptar në Londër, L.Kurti, të bëra një ditë pas pushtimit, u kaluan gjithashtu në heshtje.⁵³⁶

Pushtimi i këtij vendi të vogël dhe të pambrojtur ballkanik, nuk u gjykua aq i rëndësishëm sa të çonte në ndryshimin e politikës britanike ndaj Italisë së Musolinit, në dallim nga pushtimi i mëparshëm i Çekosllovakisë, i cili kishte shënuar fillimin e ndryshimit të qëndrimit karshi Gjermanisë naziste. Në këtë mënyrë, mund të arrijmë në përfundimin se Shqipëria ishte njëkohësisht edhe viktimë e agresivitetit italian, edhe e tolerancës britanike ndaj tij.

Në këto kushte, më 18 shtator Forin Ofis hartoi një dokument të hollësishëm për politikën e cila ishte ndjekur kundrejt Shqipërisë. Përveç të tjerave, dokumenti theksonte se njohja e statusit të atij vendi mund t'u ofrohej italianëve, pa shkaktuar shumë probleme, edhe pse mund të sillte fërkime me princin regjent të Jugosllavisë, Pavelin. Proçesi mund të shtyhej, derisa të qartësohej çështja e një ndërhyrje të mundshme në Ballkan. Sidoqoftë, shpejt a vonë, njohja do të jepej. Fjalë për fjalë në dokument thuhet: " Nga pikëpamja politike, është e një rëndësie të madhe që Italia të mos i bashkohet Gjermanisë në luftë, njohja e statusit të ri të Shqipërisë prej nesh, nuk do të bëhet një faktor deciziv, por është diçka që ne mund t'u japim italianëve, pa humbur gjë nga ana jonë. Në të vërtetë, siç u shpjegua edhe më lartë, ne jemi aktualisht në vështirësi, nëse është më mirë që njohja të bëhet tani apo më vonë ".⁵³⁷ Rekomandohej që pasardhësi i A.Rayan të dërgohej në Shqipëri pasi të merrte një notë besueshmërie, çka do të thoshte njohje de fakto e statusit. Më vonë mund të ndërmerren hapa edhe për një njohje de jure. Në tërësi, urdhëri i ditës ishte të shmangeshin komplikimet dhe përplasjet, dhe të ecej përpara.⁵³⁸

Në këtë mënyrë, pushtimi i Shqipërisë dhe statusi i saj i ri u njohën zyrtarisht nga qeveria e Madhërisë së Tij, diçka të cilën kjo e fundit ishte treguar e gatshme ta bënte menjëherë pas pushtimit. Ky akt, padyshim i dënueshëm nga pikëpamja morale, nuk erdhi si pasojë e presionit të brendshëm, apo në këmbim të diçkaje tjetër. Ai nuk kishte

⁵³⁴ Bernd, Fischer.- *Albania at War, 1939 - 1944*, West Lafayette, Indiana, 1999, f. 30.

⁵³⁵ Documents on British Foreign Policy (DBFP), Kablogramet e Forin Ofisit dërguar ambasadorëve në Athinë dhe Beograd, Third Series, Vol.V, London, 1952, f. 132.

⁵³⁶ Documents on British Foreign Policy (DBFP), Thirrjet e ambasadorit shqiptar në Londër, L.Kurti drejtuar Forin Ofisit, Third Series, Vol.V, London, 1952, f. 139 - 140.

⁵³⁷ Public Record Office/Foreign Office/371/ 23717, Dokument i hartuar nga Forin Ofisi në lidhje me njohjen e statusit të ri të Shqipërisë, 29 shtator 1939.

⁵³⁸ PRO/FO/371/ 23717, Dokument i hartuar nga Forin Ofisi në lidhje me njohjen e statusit të ri të Shqipërisë, 29 shtator 1939.

vlërë praktike, dhe nuk mund të konsiderohet ndryshe veçse si një gjest dashamirësie ndaj Italisë fashiste.

Në prillin e vitit 1940, M.I.(R) hartoi planin për një kryengritje në Shqipëri, me të cilën do të bashkoheshin edhe agjentët e seksionit D në Jugosllavi. Ata morën kontakte me tri grupime që mund të përfshiheshin në aksion. E para drejtohej nga ish-ambasadori jugosllav në Tiranë, J.Djonoviç, e dyta nga kosovari Gani Bej Kryeziu, dhe e treta nga gjeneral Kokoshi. Dy organizatat e fundit dërguan informatorë në Shqipëri për të mbledhur informata lidhur me ushtrinë italiane dhe situatën e përgjithshme në vend. Seksioni D raportoi se shanset për organizimin e incidenteve dhe për një kryengritje të përgjithshme, në pjesën lindore të vendit, veçanërisht në zonën e Mirditës, ishin të mira.⁵³⁹ Por, për një arsye, apo një tjetër, plani nuk u aprovua, dhe mbeti vetëm në letër.

Kur Italia e sulmoi Greqinë nga territori shqiptar më 28 tetor të vitit 1940.⁵⁴⁰ pas një avancimi fillestar, në territorin grek, ushtria italiane hasi në një rezistencë të ashpër dhe të papritur të grekëve, të cilët si kundërpërgjigje organizuan një kundërsulm të suksesshëm në territorin shqiptar. Ndërkohë, Britania dhe Italia ishin angazhuar në një konflikt të hapur në territoret e tyre në Afrikën Veriore dhe Lindore.

Në këto kushte, britanikët panë sërish një mundësi të shkëlqyer për t'i shkaktuar probleme armikut në territorin shqiptar. Ngjarjet gjithashtu nxorën sërish në qendër figurën e Zogut, i cili ishte gati të drejtonte gjëndjen e favorshme të krijuar. Mendimi i FO ishte që, edhe nëse do të përfshihej, Zogu nuk do të pranohej me cilësinë e monarkut, por si një patriot shqiptar, nën titullin Ahmet Bej Zogu. Përsa i përket të ardhmes së vendit, opinioni më i pranueshëm ishte ai sipas të cilit, kjo çështje do të shqyrtohej në bisedimet paqësore pas luftës.⁵⁴¹

Plani, i cili u pranua nga FO, Ministria e Luftës dhe Ministria e Ajrit, u kundërshtua sërish nga Athina. Më 21 dhjetor, ambasadori britanik, M.Palairret, raportonte se qeveria greke e kishte pritur shumë keq idenë e krijimit të një qeverie provizore. Në këtë pikë, as forca ajrore mbretërore nuk kishte mundësinë teknike të ndërmerre furnizime nga ajri. Shtabi i Përgjithshëm Grek dhe ekspertët britanikë ishin të mendimit se alternativa më e mirë ishte infiltrimi i grupeve të vogla guerrile. Grekët sugjeruan që kjo të bëhej nga territori jugosllav. Përfundimisht, SOE në Londër u tërhoqi vëmendjen agjentëve të saj, se ata i kishin tejkalur kompetencat, duke ju rikujtuar atyre se vendimi për revoltën shqiptare varej nga ushtarakët në Kajro dhe Greqi. Në këtë kohë grekët po korrnin suksese të reja në frontin shqiptar. Aprovimi për një kryengritje të përgjithshme mund ta çonte qeverinë e Metaksait në vendime që ishin krejt të padëshirueshme për momentin.⁵⁴²

Sidoqoftë, agjentët e SOE në Ballkan i vazhduan përpjekjet e tyre. Kësaj here nga zyra e Stambollit, ku kolonel W.Stirling, i cili gjatë luftës kishte shërbyer si inspektor i xhandarmërisë dhe këshilltar në Ministrinë e Brendshme, ishte caktuar të merrej vesh

⁵³⁹ Po aty.- British Policy in South - East Europe in the Second World War, London, The Macmillan Press Ltd, 1976, f. 48.

⁵⁴⁰ Mario, Cervi.- *The Hollow Legions, Mussolini's Blunder in Greece, 1940 - 1941*, London, Chatto & Windus, 1972, On the role and place of Albania in this war, shih: Bernd, Fischer.- *Albania and the Italian invasion of Greece, 1940*, në *Greece and the War*, f. 91 - 100.

⁵⁴¹ PRO/FO/371/24868, Shënim i Forin Ofisit për të përfshirë Ahmet Zogun në rezistencën që do të organizohej në Shqipëri, 8 nëntor 1940.

⁵⁴² Elisabeth, Barker.- *British Policy in South - East Europe in the Second World War*, London, The Macmillan Press Ltd, 1976, f. 52 - 53.

me shqiptarët. Nën drejtimin e tij, emigrantët politikë shqiptarë formuan Komitetin për Çlirimin e Shqipërisë, me kryetar ish-ambasadorin shqiptar në Londër, Mehmet Bej Konica. Komiteti i kërkoi qeverisë britanike të bënte një deklaratë me të cilën të premtonte restaurimin e Shqipërisë në kufijtë e saj të para 7 prillit të vitit 1939 (siç kishte bërë në drejtim të shteteve të tjera) dhe ngritjen e menjëhershme të një qeverie kombëtare shqiptare. Kjo duhej bërë me qëllim që të inkurajoheshin shqiptarët për rezistencë, dhe për të hedhur poshtë dyshimet mbi aneksimin e territoreve nga Greqia. Më 25 shkurt të vitit 1941, W.Stirling propozoi që Komiteti të transformohej në një qeveri të përkohshme shqiptare.⁵⁴³ FO nuk mori një qëndrim mbi këtë iniciativë duke mos i dhënë rëndësi.

Si përfundim, u arrit të organizohej një operacion në territorin italian. Një grup shqiptarësh, të udhëhequr nga lt.koloneli D.Oakley Hill (një tjetër ish-oficer i xhandarmërisë shqiptare të paraluftës), hyri në territorin shqiptar dhe avancoi në drejtim të Shkodrës. Për fat të keq, përveç mungesës së mbështetjes logjistike, ky operacion koinçidoi pikërisht me datën e sulmit gjerman ndaj Jugosllavisë dhe Greqisë, 6 prillin. Grupi u shpërnda ndërsa vetë Oakley Hill, i veshur si një refugjat shqiptar, u kthye në Beograd dhe kërkoi strehim në ambasadën amerikane. Meqënëse kërkesa ju refuzua, ai vendosi të dorëzohej tek gjermanët, të cilët e transferuan në një kamp të robërve të luftës.⁵⁴⁴ Ky ishte fundi i planeve britanike për një revoltë në Shqipëri.

Pozicioni zyrtar mbeti i pandryshuar për një kohë të gjatë, ndërsa u shqyrtuan edhe variante të tjera për të ardhmen e Shqipërisë. Për shembull, nga fundi i vitit 1941, FO nxori një variant, sipas të cilit vendi do të bëhej pjesë e Federatës Ballkanike, hapi i parë i së cilës do të ishte në marrëveshje mes qeverive greke dhe jugosllave, që ndodheshin në mërgim në Londër. Ideja ishte këtë herë që, Italisë të mos i njihej pozita e saj në Shqipëri, dhe ajo të zëvendësohej nga një protektorat greko - jugosllav, brenda federatës.⁵⁴⁵

Më 6 shkurt, majori V.Cazalet (anëtar i Komitetit Ballkanik, Konservator dhe mik personal i W.Çerçill), i shkroi një letër Sekretarit të Jashtëm, duke sugjeruar që pavarësia e Shqipërisë të deklarohet si një nga qëllimet ushtarake të Britanisë, por pa komentuar çështjen e kufijve të ardhshëm apo rikthimin e Zogut. Përgjigja, e ardhur një javë më vonë, thoshte shkurtimisht se ideja e një deklaratë që do tu jepte besim shqiptarëve lidhur me të ardhmen e statusit të tyre, po shqyrtohej, por për arsye të ndryshme momentale, nuk mund të bëhej publike.⁵⁴⁶

Duhej të vinte 17 dhjetori i vitit 1942, që sekretari i jashtëm, përsëri në formën e një përgjigjeje gjatë kohës së pyetjeve, të anonçonte njohjen e pavarësisë së Shqipërisë.⁵⁴⁷ Në atë kohë politika britanike kishte filluar të përballej me sfida të reja, ndaj të cilave duhej të përshtatej. Ato erdhën nga vetë Shqipëria, me lindjen dhe rritjen e lëvizjes së rezistencës.

⁵⁴³ PRO/FO/371/29719, Propozim i kolonel W.Stirling për Forin Ofisin, 7 mars 1941.

⁵⁴⁴ Nicholas, Costa.- *Invasion - Action and Reaction. Albania, a case study.*- East Quarterly, vol. X, No. 1, 1976, f. 55.

⁵⁴⁵ PRO/FO/371/29783, Shënim i Forin Ofisit, 24 nëntor 1941.

⁵⁴⁶ PRO/FO/371/29714, Përgjigje e ministrit të jashtëm të Britanisë A.Eden për anëtarin e Komitetit Ballkanik V.Cazalet, 12 shkurt 1941.

⁵⁴⁷ PRO/FO/371/37144, Përgjigje e A.Eden në Dhomën e Komuneve më 17 dhjetor 1942, 15 tetor 1943.

KONKLUZIONE

Megjithatë, politika britanike ndaj Shqipërisë së pushtuar, nuk kishte mbetur pa alternativa. Politikanë të ndryshëm, figura publike dhe njerëz të tjerë të rëndësishëm, që nuk ishin indiferentë ndaj fatit të Shqipërisë, ngritën zërin në mbrojtje të saj.

Politika britanike do të shprehej hapur më 23 janar të vitit 1941, ku Sekretari i Jashtëm, A.Eden i deklaroi Lordit Cecil se qeveria ishte për një Shqipëri të pavarur, por për momentin ishte e detyruar të koordinonte politikat e saj me dëshirat e grekëve.⁵⁴⁸

Komiteti Ballkanik në Londër, gjithashtu nuk qëndroi indiferent, dhe shtroi të njëjtat kërkesa në mbrojtje të çështjes shqiptare. Presidiumi i tij drejtohej nga Lordi Noel Buxton, me kryetar E.Boyle. Në një mbledhje të 27 janarit të vitit 1941, Komiteti adoptoi një rezolutë drejtuar qeverisë, në të cilën shprehte simpatinë për popujt grek dhe shqiptar, dhe dëshirën për restaurimin e plotë të pavarësisë së Shqipërisë. Përveç kësaj, dokumenti bënte një përshkrim të aktivitetit të mëparshëm të Komitetit për Mbrojtjen e Popujve të Ballkanit, dhe i bënte apel qeverisë lidhur me rëndësinë e mbrojtjes së idealit të vetëvendosjes.⁵⁴⁹

Ky ideal i vetëvendosjes nuk u mbrojt siç duhej nga qeveria britanike në këto vite, pasi u pa më me rëndësi interesi i shtetit grek sesa ai i popullit shqiptar. Kjo ishte një politikë miopë për një fuqi të madhe si Britania.

Bibliografia

- 1- J. Fischer. Bernd.- *Italian policy in Albania 1894 - 1943*, në *Balkan Studies*, vol. XXVI, No. 1, Thessaloniki, 1985.
- 2- Fischer, Bernd.- *Albania at War, 1939 - 1944*, West Lafayette, Indiana, 1999.
- 3- Documents on British Foreign Policy (DBFP), Kablogramet e Forin Ofisit dërguar ambasadorëve në Athinë dhe Beograd, Third Series, Vol.V, London, 1952, f. 132.
- 4- Documents on British Foreign Policy (DBFP), Thirrjet e ambasadorit shqiptar në Londër, L.Kurti drejtuar Forin Ofisit, Third Series, Vol.V, London, 1952, f. 139 - 140.
- 5- Public Record Office/Foreign Office/371/ 23717, Dokument i hartuar nga Forin Ofisi në lidhje me njohjen e statusit të ri të Shqipërisë, 29 shtator 1939.
- 6- PRO/FO/371/ 23717, Dokument i hartuar nga Forin Ofisi në lidhje me njohjen e statusit të ri të Shqipërisë, 29 shtator 1939.
- 7- Barker, Elisabeth.- *British Policy in South - East Europe in the Second World War*, London, The Macmillan Press Ltd, 1976.
- 8- Cervi, Mario.- *The Hollow Legions, Mussolini's Blunder in Greece, 1940 - 1941*, London, Chatto & Windus, 1972, On the role and place of Albania in this war, shih: Bernd, Fischer.- *Albania and the Italian invasion of Greece, 1940*, në *Greece and the War*, f. 91 - 100.
- 9- PRO/FO/371/24868, Shënim i Forin Ofisit për të përfshirë Ahmet Zogun në rezistencën që do të organizohej në Shqipëri, 8 nëntor 1940.
- 10- PRO/FO/371/29719, Propozim i kolonel W.Stirling për Forin Ofisin, 7 mars 1941.
- 11- Costa, Nicholas.- *Invasion - Action and Reaction. Albania, a case study.*- *East Quarterly*, vol. X, No. 1, 1976, f. 55.
- 12- PRO/FO/371/29783, Shënim i Forin Ofisit, 24 nëntor 1941.
- 13- PRO/FO/371/29714, Përgjigje e ministrit të jashtëm të Britanisë A.Eden për anëtarin e Komitetit Ballkanik V.Cazalet, 12 shkurt 1941.
- 14- PRO/FO/371/37144, Përgjigje e A.Eden në Dhomën e Komuneve më 17 dhjetor 1942, 15 tetor 1943.
- 15- PRO/FO/371/29714, Shënim i Komitetit Ballkanik në Londër, 7 shkurt 1941.

⁵⁴⁸ Elisabeth, Barker.- *British Policy in South - East Europe in the Second World War*, London, The Macmillan Press Ltd, 1976, f. 51.

⁵⁴⁹ PRO/FO/371/29714, Shënim i Komitetit Ballkanik në Londër, 7 shkurt 1941.

KRYENGRITJA E KOSOVËS E VITIT 1910 – PARAPRIJËSE E SHPALLJES SË PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

Mr. Avni Rexha

Qëllimi i këtij punimit është trajtimi i Kryengritjes së Kosovës të vitit 1910, që ka të bëjë me njërën ndër etapat më të rëndësishme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe që i parapriu pavarësisë së Shqipërisë. Bëhet fjalë për fazën e katërt të kësaj lëvizje, që kap vetëm një vit kalendarik, atë të motit të madh 1910, drama e të cilit ndodh në Vilajetin e trazuar të Kosovës, si pjesë përbërëse e Perandorisë Osmane, tashmë të rraskapitur. Ndër aspektet e rëndësishme të kryengritjes së vitit 1910 janë marrëdhëniet shqiptaro-xhonturke që njohën një ngritje të vazhdueshme të tensionimit, si rrjedhojë e përpjekjeve këmbëngulëse të qeverisë nga Stambolli për të shpartalluar dhe për të asgjësuar përfundimisht Lëvizjen Kombëtare Shqiptare dhe për të hequr nga rendi i ditës çështjen shqiptare.

Kjo aspiratë e xhonturqve bëhet edhe më e qartë sidomos pas dështimit të ekspeditës ndëshkimore të Xhavit Pashës në vjeshtë të vitit 1909, kur pasuan masat e reja ligjore kufizuese të qeverisë së tyre siç ishin: ndalimi i mbajtjes së armëve, Ligji për rekrutimin e përgjithshëm, vendosja e taksave të reja, Ligji kundër veprimtarisë politiko-kulturore të klubeve kombëtare e të shoqatave, Ligji mbi çetat, si dhe fushata shtetërore kundër alfabetit kombëtar dhe të shkollës shqipe. Këto masa në thelb preknin thellë të gjitha shtresat e popullit shqiptar. Qeveria osmane i prezantonte, si në rastet e mëparshme, masat e reja kundër shqiptarëve para opinionit të jashtëm e të brendshëm, si masa për zbatimin e reformave në Shqipëri, ndërsa shqiptarët si popull kundëreformist dhe përkrahës të regjimit hamidan. Dervish Hima, veprimtar dhe publicist i shquar, e hodhi poshtë me forcën e argumenteve këtë teze të qeverisë xhonturke në një intervistë që i dha së përditshmes „La Turquie”, duke theksuar se nuk mund të akuzoheshin shqiptarët si kundërevolucionarë për shkak të pamundësisë së tyre ekonomike për të shlyer taksat e reja.⁵⁵⁰ Ai përkujtonte në këtë rast indinjatën e thellë të shqiptarëve për dhunën e ushtruar gjatë ekspeditës ndëshkuese të Xhavit Pashës më 1909, e cila, sipas tij, kishte lënë pasoja të rënda dhe do të ishte shumë vështirë që plagët e shkaktuara të shëroheshin dhe të zhdukeshin. Përpjekjet e qeverisë që shqiptarëve kudo që jetonin t'u vishej epite „kontrarevolucionarë” ishin të papranueshme për të. Në të vërtetë, sipas tij, ishte dëshira e qeveritarëve osman për të nënshtruar me forcë pretendimet kombëtare të popullit shqiptar.⁵⁵¹

Në fakt, regjimi i Turqve të Rinj, që nga shpallja e Kushtetutës nuk ndërmoi asgjë për të përmirësuar gjendjen e rëndë ekonomike në Shqipëri. Gjatë gjithë kohës së

⁵⁵⁰ AIH, Raport i konsullit austro-hungarez, Kral nga Manastiri, 04.04.1910 (Material i përkthyer në shqipet).

⁵⁵¹ Po aty.

qeverisjes së tij u përdorën të gjitha intrigat e mundshme për të shtypur qysh në fillim çdo ide për emancipimin kombëtar të shqiptarëve. Sepse, bësheshin gati dy vite të plota që nga shpallja e Kushtetutës dhe kërkesat themelore të shqiptarëve, siç ishin përdorimi i alfabetit kombëtar dhe hapja e shkollave shqipe, nuk po përfillehin. Kjo rriti tej mase pakënaqësinë e tyre, që në fakt vihej re edhe nga vrojtimet e diplomacisë evropiane të kohës. Kështu Ministri i Punëve të Jashtme i Austro-Hungarisë dispononte me informacione rreth një shpërthimi eventual të një lëvizjese kundër regjimit xhonturk në Shqipëri. Edhe në rrafshin e politikës së jashtme qeveria osmane e drejtuar nga komiteti „Bashkim e Përparim” po zbatonte politikën që binte ndesh me interesat jetike të popullit shqiptar. Për t’u kundërvënë politikës austro-hungareze në Ballkan, ajo zbatoi politikën e afrimit dhe të bashkëpunimit me Serbinë dhe Bullgarinë, sidomos me këtë të parën, duke i bërë asaj koncesione në viset e banuara me shqiptarë.

Në këtë kuadër, Serbia, pasi kishte marrë pëlqimin paraprak të Francës, të Rusisë dhe të Italisë për ndërtimin e hekurudhës së Adriatikut, që do të kalonte në drejtim Danub-Merdar-Prizren-Shëngjin, ajo mori edhe pëlqimin e qeverisë osmane, madje në shtatorin e vitit 1909. Aktivizimi i projektit të hekurudhës së Adriatikut, përbënte në fakt parapërgatitjen e projektit serb për aneksimin e tokave shqiptare. Mirëpo, nën ndikimin e Austro-Hungarisë dhe të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare qeveria osmane do të heqë dorë nga ky hap i rrezikshëm. Deputetët shqiptarë në parlamentin osman me Hasan Prishtinën në krye, pasi e kuptuan këtë lojë të rrezikshme të qeverisë osmane, iu drejtuan Vezirit të Madh me një interpelancë.⁵⁵²

Këto qenë shkaqet që bashkëpunimi ndërmjet Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe xhonturqve tashmë të bëhej i pamundshëm. Lëvizja Kombëtare Shqiptare nuk mund të hiqte dorë nga aspiratat kombëtare të shqiptarëve. Për më tepër qeveria osmane i jepte karakter reaksionar çdo kërkesë të tyre. Studiuesi i njohur i historisë së Perandorisë Osmane, Joseph von Hammer, vlerëson me të drejt se atdhetarët shqiptar shpresonin se me shpalljen e kushtetutës në vend, t’u plotësoheshin aspiratat e mohuara në vazhdimësi, që nga Kongresi i Berlinit.⁵⁵³ Njëri ndër veprimtarët e shquar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe ndër themeluesit e „Bashkim e Përparim”, dr. Ibrahim Temo, që atëherë kishte ardhur në përfundim se shqiptarët, pasi kishin përdorur të gjitha mjetet demokratike për të fituar të drejtat e tyre të ligjshme, tashmë nuk u mbetej rrugë tjetër veçse të rrëmbenin armët. Këto qenë arsytet që edhe prijësit e tjerë të Lëvizjes Kombëtare të vinin në përfundim se i vetmi mjet për realizimin e të drejtave të ligjshme të pasardhësve të ilirëve të lashtë ishte lufta e armatosur. Në përgatitjen e kryengritjes së armatosur që atëherë po bashkëvepronin të gjitha personalitetet e angazhuara rreth çështjes kombëtare, të cilat intensifikuan edhe më tepër aktivitetin politik kur panë se regjimi i ri nuk po jepte prova të përmbushjës së kërkesave elementare të shqiptarëve, të garantuara me Kushtetutë. Kjo çështje, si gjithnjë, i bashkonte prijësit tradicionalë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, sidomos të Vilajetit të Kosovës, të cilët dhanë kontribut të çmuar për shembjen e regjimit hamidan. Një rol të rëndësishëm për përgatitjen e kryengritjes së armatosur luajtën edhe klubet shqiptare me Klubin e Manastirit në krye. Në lëvizjen e atyre klubeve u vunë në veprim komitetet e fshehta. Klubet shqiptare sipas një burimi të kohës kishin krijuar një aleancë të fuqishme midis tyre dhe ishin vënë

⁵⁵² „Vardar” Artikulli, Arnautska pobuna, Nr. 20, Skopje, 28.03.(10.04) 1910.

⁵⁵³ Joseph Von Hammer, Istorija turskog (osmanskiog) carstva 3, Zagreb 1979, 519.

në levizje për përgatitjen e kryengritjes së armatosur. Sipas tij, për marrjen e vendimit rreth fillimit të kryengritjes kishte ndikuar vetë qeveria xhonturke me masat që ndërmorri kundër alfabetit kombëtar dhe gjuhës shqipe.⁵⁵⁴ Vendimi për kryengritje të përgjithshme u mor që në dhjetorin e vitit 1909 në mbledhjen konsultative të bërë në një fshat afër Shkupit, ku morën pjesë prijës të shquar të Lëvizjes Kombëtare të Vilajetit të Kosovës, si: Isa Boletini, Idriz Seferi, Shaban Kopriwa, Sulejman Batusha, Hasan Ferri, Hasan Hysen Budakova, Ramadan Zaskoci, Haxhi Rrustem Kabashi, Bajram Daklani etj.

Sipas informacioneve të qeverisë osmane, pjesmarrës në këtë mbledhje ishin edhe katër deputetë shqiptarë, emrat e të cilëve nuk janë të njohur. Mund të thuhet se dy prej tyre ishin Hasan Prishtina dhe Nexhip Draga. Në mbledhje u vendos që të kundërshtoheshin taksat e reja të qeverisë së Stambollit, ndërsa në themel të programit u vu kërkesa kryesore për autonominë e Shqipërisë dhe krijimi i një ushtrie kombëtare shqiptare.⁵⁵⁵ Ky program do t'u bëhej i njohur viseve të Vilajetit të Kosovës dhe provincave të tjera shqiptare me anë të emisarëve, e do të shërbente si platformë në përgatitjen e terrenit për kryengritjen e përgjithshme, që do të ndodhte në pranverë të vitit 1910. Përgatitjet për kryengritjen e armatosur filluan qysh në fund të vitit 1909, pas ekspeditës së përgjakshme të Xhavit Pashës dhe fushatës së qeverisë osmane kundër alfabetit kombëtar dhe shkollës shqipe, gjatë dimrit të vitit 1909-1910. Komitetet e fshehta shqiptare po bënë përgatitje intensive për organizimin e luftës së armatosur. Aktiviteti i tyre ishte i përqendruar sidomos në fshatrat e Vilajetit të Kosovës dhe të Manastirit, duke propaganduar që të mos paguheshin taksat e reja, të mos dorëzoheshin armët dhe të mos dërgoheshin të rinjtë në ushtrinë osmane.⁵⁵⁶ Kështu, fuqizimi i veprimtarisë së komiteteve përkonte me përpjekjet për t'i dhënë asaj karakter kombëtar dhe që përmes luftës së armatosur të jetësoheshin objektivat programatikë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Në mbështetje të mbledhjes që u bë në afërsi të Shkupit, prijësit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare ishin të interesuar që kryengritja e armatosur të merrte përmasa mbarëkombëtare dhe të vinin atë në funksion të zbatimit të programit kombëtar. Për këtë qëllim planifikonin të organizonin një kuvend të madh në Ferizaj, ku do të merrnin pjesë përfaqësuesit e të gjitha viseve të banuara me shqiptarë. Ndërkaq, në kuadrin e informacioneve që dispononin autoritetet e Vilajetit të Kosovës, në fund të marsit dhe në fillim të prillit 1910 në terren kishin dalë veprimtarë me ndikim të Levizjes Kombëtare Shqiptare, për të siguruar masivizimin e luftës së armatosur dhe organizimin e Kuvendit të madh në Ferizaj, prej nga i ishte drejtuar ultimatumit Sulltan Abdyl Hamidit II, që i referohej shpalljes së Kushtetutës. Sipas këtij plani, parashihej që nga ky vend masa e madhe e shqiptarëve të armatosur, të prirë nga krerët e tyre, të parashtronte kërkesa programatike të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Ky program, sipas autoriteteve osmane, kishte mbështetjen e fuqishme në viset e Shqipërisë Verilindore, që nga Presheva deri në Lumë e më gjerë. Po ashtu, autoritetet qeveritare të Stambollit konfirmonin se në krye të kësaj lëvizje ishin deputetë të shquar nga Vilajeti i Kosovës.

⁵⁵⁴ Arkivi i Kosovës, Prishtinë, (më tutje AK), „Fondi i Arkivit diplomatik të Sekretariatit Fedarativ për Punë të Jashtme në Beograd”, Raport i konsullit të Serbisë nga Selaniku Nr. 324, më 13 (29) 04.1910.

⁵⁵⁵ AIH, Vjeti 20-19-1100, Raporti nr. 21i konsullit austro-hungarez nga Selaniku.

⁵⁵⁶ Sadullah Brestovci, Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kazanë e Gjilanit dhe Islam Pira (1866-1931), „Rilindja”, Prishtinë, 10.06.1971, 7.

Kërkesa programatike për autonominë e Shqipërisë zinte vendin kryesor edhe në mbledhjen e drejtuesve të kryengritjes, të mbajtura diku në Vilajetin e Kosovës në fillim të majit 1910. Sipas korrespondentit të gazetes „Shqypeja e Shqypnis”, kërkesa e drejtuesve të kryengritjes ishte autonomia e Shqipërisë nën sovranitetin e Sulltanit.⁵⁵⁷ Jetësimi i autonomisë së Shqipërisë si kërkesë themelore programatike përkon edhe me atë të Komitetit Qendror të Kryengritjes në dhe të huaj, i cili mbështetej në komitetet shqiptare në mërgatë, në Bullgari, Rumani, Egjipt, SHBA, Rusi etj. Programi u bë i njohur përmes një shpalljesë të nënshkruar nga Komiteti Qendror i Kryengritjes. Në të thuhej se qeveria xhonturke, jo vetëm që nuk ishte treguar mirënjohëse për „shërbimet madhore të lirisë”, që kishin dhënë shqiptarët, dhe në vend që t’i merrte parasysh kërkesat e tyre, ajo përpiqej t’i shuante ata nga faqja e dheut.⁵⁵⁸ Programin për autonominë e Shqipërisë e përkrahi edhe ideologu dhe publicisti i shquar shqiptar Dërvish Hima, në gazetën e tij „Shqiptari”, që filloi ta nxirrte në Stamboll. Sipas tij, për realizimin e kësaj kërkesë programatike nevojitej krijimi i një vilajeti të vetëm shqiptar, pastaj që shërbimi ushtarak të kryhej vetëm në viset evropiane të Perandorisë, caktimi i fondeve për hapjen e shkollave shqipe etj. Sipas tij nëse Shqipëria do të organizohej në një vilajet të vetëm, atëherë do të merrte fund ëndrra e Serbisë për Kosovën.⁵⁵⁹ Për këtë si dhe për disa çështje të tjera, drejtuesit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, në prag dhe në kohën e gjatë të shpërthimit të kryengritjes së armatosur të vitit 1910 dhe gjatë zhvillimit të saj, u përpoqën të gjenin mbështetjen e lëvizjeve edhe të shteteve fqinje. Në këtë kuadër, Nikollë Ivanaj dhe Themistokli Gërmenji shkuan në Athinë për të kontaktuar me qeverinë greke. Përfaqësuesi i kësaj qeverie, ish-sekretari i saj i përgjithshëm me prejardhje shqiptare, i deklaroi delegacionit shqiptar se Greqia ishte e gatshme ta mbështeste kryengritjen shqiptare me armë dhe materialisht, por këtë e kushtëzonte me arritjen e një marrëveshje paraprake.

Sipas qeverisë greke, pas çlirimit të Shqipërisë nga Perandoria Osmane, duhej të formohej mbretëria greko-shqiptare, me autonomi të plotë për të dy vendet dhe me mbretin e Greqisë në krye të saj. Ndërkaq, marrëveshja do lypsej të nënshkruhej prej gjashtë përfaqësuesve shqiptarë, tre myslimanë dhe tre të krishterë. Delegacioni shqiptar pranoi kërkesën e palës greke, por me kusht që paraprakisht të përcaktoheshin kufinj të ndërshtetërorë ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë. Mirëpo këtë kërkesë pala greke nuk mund ta përmbushte për shkak të pretendimeve të saj në Shqipërinë jugore. Mbetet e paqartë nëse drejtues të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare bënë përpjekje të ngjashme edhe me Beogradin dhe me Sofjen. Një hap i tillë me Beogradin sigurisht që do të dështonte, për arsye të afrimit të ndjeshëm të politikës së jashtme të Serbisë me qeverinë xhonturke, po aq edhe të mëtimeve të saj mbi tokat verilindore të Shqipërisë. Po kështu, afërsi u ndie edhe me marrëdhëniet me Bullgarinë, pasi Sofja zyrtare, për dallim nga Beogradi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare e shikonte pak më ndryshe, padyshim si një realitet. Megjithatë, edhe ajo nuk hiqte dorë nga projekti i Shën Stefanit.⁵⁶⁰ Kur bëhet fjalë për politikën e Serbisë karshi kryengritjes së vitit 1910, atëherë duhet thënë se ajo ishte

⁵⁵⁷ „Shqypeja e Shqypënis”, Nr.22, Sofje 1 (14) maj 1910, 2.

⁵⁵⁸ AIH, Vj-20-5-2145, Raport i konsullit austro-hungarez nga Manastiri nr.70, më 31.10.1910 për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë; Sh. Rrahimi, Lufta e Shqiptarëve për Autonomi, 161-162.

⁵⁵⁹ Kristaq Prifti, Dërvish Hima, Tiranë 1993, 263.

⁵⁶⁰ Më gjerësisht për këtë: „Shqiptari”, Pera-Konstantinopojë 1910, „Shqypeja e Shqypënis”, Sofje 1910, „Bashkimi”, Shkodër 1910, „Lirija”, Selanik 1910.

krejtësisht sabotuese e minuese. Ajo i ndiqte hap pas hapi operacionet e ushtrisë turke në Kosovë dhe nuk pushonte të ndërhynte në Stamboll për shtypjen e kryengritjes shqiptare në mënyrë sa më të përgjakshme. Serbia theksoi disa herë se nënshtrimi i shqiptarëve ishte i domosdoshëm në mënyrë që të sigurohej paprekshmëria territoriale e Perandorisë Osmane dhe t'i pritej rruga ndërhyrjes së mëtutjeshme të Austro – Hungarisë, e cila sipas Serbisë mund të sillte ndërlikime të reja në Ballkan. Pra, Serbia me politikën e saj u mundua të dilte fitimtare duke dobësuar Portën, më pastaj, duke i dërmuar shqiptarët, për të cilët ajo shpresonte që më vonë të viheshin në shërbim të idesë së madhe shtetërore të saj. Kryengritësit nuk patën përkrahjen as të Malit të Zi, por që ndryshe nga Serbia, politika e tij zyrtare nuk ishte e disponuar armiqësisht. Thënë shkurt e qart, ai nuk e përkrahu „rrebelimin” e vitit 1910, nuk u angazhua në shuarjen e saj dhe pranoi refugjatët shqiptarë, por, në anën tjetër, krejt këtë e bënte që nëpërmjet krerëve shqiptarë t'i materializonte aspiratat e tija territoriale në vetë Vilajetin e Shkodrës.

Sidoqoftë, me gjithë shtypjen e përgjakshme të kryengritjes së vitit 1910, Porta nuk arriti të siguronte rendin dhe qetësinë në Vilajetin e Kosovës dhe më gjerë. Nuk ndryshuan në këtë drejtim as represaliet nga më të ndryshmet: internimet, burgosjet, ndalimi i gazetave, librave, mbyllja e shkollave dhe e klubeve. E ndrydhur nga brenda dhe nga jashtë, qeverinë xhonturke po e priste një sprovë tjetër e madhe: ajo e paralajmërimin të një kryengritje të re, e cila do të zgjerohej në të gjitha vilajetet shqiptare, atë të vitit 1912 me dimensione më të gjera dhe me një program më të avancuar, që do të çonte drejt shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë.

Sa i përket Fuqive të Mëdha, për shkak të interesave të tyre politike dhe ekonomike, ato ishin të interesuara në ruajtjen e status-quo-së në gjithë Perandorinë Osmane. Kryengritja e Kosovës u trajtua nga Fuqitë e Mëdha si një çështje e brendshme e Perandorisë Osmane duke i dhanë dorë kësaj të fundit shtypjen e kryengritjes. Megjithatë, Fuqitë e Mëdha nuk qëndruan pasivë ndaj dhunës që ushtruan autoritetet osmane për ta shuar kryengritjen. Rusia këmbëngulte tek Porta për ta zhvilluar deri në fund ekspeditën ushtarake në Shqipëri, kurse Austro-Hungaria dhe Italia sugjeruan Portën t'i përmbahej ushtrimin të dhunës, respektivisht mos të ushtronin dhunë të tepruar. Në fakt, Austro-Hungaria dhe Rusia në përgjithësi ishin kundër lëvizjeve revolucionare, prandaj në një mënyrë e mbështetën veprimtarinë e qeverisë së Stambollit në shtypjen e kryengritjes.⁵⁶¹

Megjithatë, përkundër këtij qëndrimi të përgjithshëm, Austro-Hungaria dëshironte t'i shfrytëzonte shqiptarët si barrierë kundër ndonjë sulmi të mundshëm serbo-malazez kundër Sanxhakut. Sipas një burimi historik, përfaqësuesi ushtarak austro-hungarez në Stamboll kishte zhvilluar bisedime me krerët shqiptarë. Ai lajmëronte Vjenën se më se 100.000 shqiptarë brenda 24 orëve do t'i kapnin armët në rast se Serbia dhe Mali i Zi ndër marrin aksion ndaj Sanxhakut.⁵⁶²

Në anën tjetër, Italia kishte synime t'i krijonte rrethanat për depërtim në Adriatikun Lindor. Për të ushtruar më tepër ndikim mbi tokat shqiptare, ajo u angazhua më tepër në kohën kur po zhvillohej revolucioni xhonturk dhe në kohën kur Bosnja e Hercegovina aneksohet nga Austro-Hungaria. Duke shfrytëzuar rrethanat e krizës në

⁵⁶¹ Sh. Rahimi, Vilajeti, 145.

⁵⁶² E. Pllana, Kosova, 253.

Perandorinë Osmane , Italia hapi përfaqësi ekonomike, hapi posta e zyre, zhvilloi tregti me qytetet shqiptare si Shkodrën, Durrësin, Vlorën, duke u lidhur drejtpërdrejt me tregtarët shqiptarë.⁵⁶³ Mirëpo, Italia nuk i kishte duart e lira për ndonjë veprim konkret për shkak se interesat e saja binin në konflikt me ato austro-hungareze.

Qëndrim më racional kishte Gjermania e cila ia bëri të qartë Stambollit se ndjekja e këshillave ruse dhe ashpërsimi deri në skaj i konfliktit me shqiptarët, do të sillte dobësimin e dyja palëve dhe do t'ua lehtësonte shteteve ballkanike plotësimin e pretendimeve territoriale ndaj trojeve shqiptare.⁵⁶⁴ Gjermania ishte e interesuar për ruajtjen e status-quo-s sepse konflikti turko-bullgar do t'i jepte goditje të rëndë interesave ekonomike të ndërmarrjeve gjermane në Perandorinë Osmane, kurse Franca pajtohej me qëndrimet e Rusisë.⁵⁶⁵ Britania e Madhe pavarësisht se nuk i përkrahu zyrtarisht lëvizjet kryengritëse shqiptare, diplomacia e këtij vendi nuk pati qëndrim zyrtar as kundër interesave të shqiptarëve. Situata në Ballkan dhe zhvillimet brenda Perandorisë Osmane ishin bërë çështje që e preokuponte diplomacinë britanike që nga Lufta e Krimesë e këndeje. Si rezultat ajo përcillte me vëmendje gjitha ngjarjet që mund t'i preknin interesat e saj, jo vetëm ato diplomatike por edhe ato në terren. Ambasadori anglez kishte takuar Isa Boletinin në Nikshiq dhe kishte biseduar rreth arsyeve për kryengritje në Kosovë.⁵⁶⁶

Kryengritja shqiptare e vitit 1910 në Vilajetin e Kosovës, megjithëse nuk parashtrioi ndonjë program politik dhe mbeti e izoluar nga viset tjera të banuara me shqiptarë, ajo ka një rëndësi të madhe historike, sepse ishte lëvizja e parë masive e armatosur në fillim të shekullit XX, në të cilën morën pjesë masat e gjera popullore. Ruajtja e status quo-s në Ballkan prej Fuqive të Mëdha bënte që ato me gjithë kontradiktat e thella antagoniste që ekzistonin në mes tyre, të gjenin gjuhë të përbashkët kur ishte fjala për të shtypur luftërat çlirimtare të popujve që bënin pjesë në Perandorinë Osmane. Me gjithë shuarjen e saj, falë epërsisë së ushtrisë turke, kjo lëvizje e gjithëmbarshme popullore ndikoi në ngritjen e mëtejme të vetëdijes kombëtare dhe para Lëvizjes Kombëtare Shqiptare parashtrioi domosdonë e organizimit të një kryengritjeje në shkallë kombëtare.

Aspekt tjetër me rëndësi i Kryengritja e vitit 1910 në Kosovë, ishte edhe reagimi i deputetëve shqiptarë në parlamentin osman. Qëndrimi i tyre mund të vlerësohet si guxim i pashembullt me rastin e reagimit në parlament, si dhe angazhim i drejtpërdrejtë i elitës politike dhe intelektuale shqiptare në mbrojtjen e interesave të popullit të tyre pavarësisht privilegjeve që ua mundësonte të qenit deputet në parlamentin osman. Me rëndësi është edhe shkëputja përfundimtare e shqiptarëve nga komitetet xhonturke, përmes së cilave xhonturqit synonin manipulimin e masës shqiptare, sidomos asaj me orientim fetar islamik, dhe orientimi i lëvizjes shqiptare drejt realizmit të interesave kombëtare duke përdorur edhe rrugë tjera pos atyre politike, dhe në këtë mënyrë duke e marr fatin e atdheut në duart e tyre. Kjo kryengritje ishte vetëm një fitil për kryengritjen e përgjithshme të vitit 1912.

⁵⁶³ Islam Dobra, Disa konflikte midis Italisë, Turqisë dhe Serbisë kundër interesave shqiptare në vitet 1908-1913, Shqiptarët në rrjedhat ballkanike, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1996, 85-86.

⁵⁶⁴ HPSH

⁵⁶⁵ Z. Cana, Politika, 59-74.

⁵⁶⁶ I. Bicaj, Marrëdhëniet..., 116.

TRASHËGIMIA MONUMENTALE NË DEÇAN

Phd.Sc. Bekim Vishaj

Hyrje

Kumtesa ka për qëllim të bëjë një pasqyrim të trashëgimisë kulturore të Deçanit, njihjen me gjendjen aktuale të objekteve, gjithmonë duke ditur rëndësinë e trashëgimisë kulturore të popullit tonë, nga e kaluara e deri në ditët e sotme. Në kumtesë trajtohen aspekte të trashëgimisë monumentale-materiale në komunën e Deçanit.

Kumtesa ka këtë strukturë: 1. Trashëgimia monumentale në komunën e Deçanit. 2. Objektet fetare në komunën e Deçanit. 3. Objektet fetare myslimane në komunën e Deçanit(Xhamia e fshatit Isniq) 4. Kullat shqiptare(Kulla me Çardak e Ahmetajve në fshatin Lëbushë) 5. Mullinj të me ujë(Mulliri i Shabanajve në Deçan) 6 .

Fjalët çelës: Trashëgimi monumentale,objekte historike,kulturore,fetare,restaurim, kulla shqiptare.

Trashëgimia monumentale në komunën e Deçanit

Deçani si vendbanim, deri vonë ka pasur fizionominë e fshatit, që përbëhej nga ndërtime të ulëta të kullave shqiptare, si ndërtime për banim,që i kanë dhënë elemente të një arkitekture tipike rurale. Deçani është një ndër trevat më të pasura me trashëgimi monumentale historiko-kulturore në Kosovë e më gjërë. Objektet e ndryshme monumentale të trashëgimisë kulturore në Deçan datojnë qysh nga kohët e hershme. Përkundër stuhive të shumta shkatërruese nga pushtuesit e ndryshëm, që kaluan mbi popullin dhe vendin tonë, disa prej këtyre objekteve ekzistojnë edhe sot. Trashëgimia monumentale në qytezën e Deçanit dhe fshatrave përreth, shprehet në formën e saj ndërtimore-monumentale,dhe është prezente me objekte të ndryshme që kanë vlera të rëndësishme historike, fetare, artistike, arkitektonike, etnografike dhe ekonomike, që nga e kaluara e deri në ditët e sotme. Këto janë:Objekte fetare, xhami, kisha, tyrbe, kulla(shtëpi të banimit), mullinj(objekte me rëndësi ekonomike) dhe duke mos lënë anash lokalitetet e mundshme arkeologjike, e që të gjitha këto dhe shumë vlera tjera dëshmojnë për një zhvillim etno-kulturor për Deçanin prej Parahistorisë, Antikës, Mesjetës e deri më sot. Deçani me fshatrat, deri para luftës, kishte rreth 300 objekte si pjesë e trashëgimisë kulturore-monumentale, ndërsa sot, pas luftës së viteve 1998/1999, në komunën e Deçanit janë vetëm rreth 50 objekte të tilla.

2. Objektet fetare në komunën e Deçanit, janë pjesë e rëndësishme e kulturës materiale dhe monumentale, janë objektet me të vjetra monumentale në komunën e Deçanit. Kemi disa lloje të objekteve fetare si: ato të ritit mysliman, bektashinj dhe ortodoks etj. Objektet fetare kanë vlerë të rëndësishme për kulturën tonë, ngase përveç si objekte ku kryheshin ritet fetare, kanë edhe vlera arkitekturore dhe artistike, e pa dyshim edhe historike. Pra, janë vlera monumentale shqiptare për kulturën dhe historinë e komunës së Deçanit.

3. Objektet fetare myslimane në komunën e Deçanit Me ardhjen e Perandorisë Osmane dhe pushtimit të saj në Ballkan, kultura dhe arti islam depërtoi edhe në territorin e Kosovës. Me kushtet e reja "të bashkëjetesës shqiptaro-osmane" dhe përqafimit gradual të fesë islame nga shqiptarët, filloi edhe depërtimi i monumenteve kulturore islame në artin shqiptar në Kosovë, e që kjo më së shumti vërehet në objektet fetare, gjegjësisht në xhamitë monumentale të periudhës së hershme të sundimit osman. Xhamitë, si ndërtime të realizuara në proveniencën turko-osmane, janë klasifikuar dhe njëheri bëjnë pjesë në vepra të stilit islamo-shqiptar, përkatësisht kosovar.⁵⁶⁷ Në territorin e komunës së Deçanit gjithsejtë janë 14 xhami myslimane.⁵⁶⁸ Si xhamitë më të vjetra në komunën e Deçanit janë: Xhamia në fshatin Isniq (1630), xhamia në fshatin Prejlep (1686), xhamia në fshatin Lëbushë (1793) etj.⁵⁶⁹



Foto nr. 1, Xhamia në fshatin Isniq

Xhamia në fshatin Isniq

Xhamia e Isniqit është xhamia më e vjetër në komunën e Deçanit. Kjo xhami është ndërtuar në vitin 1630.⁵⁷⁰ Xhamia e Isniqit hyn në rangun e objekteve sakrale, e cila është

⁵⁶⁷ Fejaz Drançolli, *Trashëgimia Monumentale në Kosovë*, Prishtinë. 2011, fq.100.

⁵⁶⁸ Bashkësia Islame e Deçanit, 10.3.2012.

⁵⁶⁹ Bashkësia Islame e Kosovës, *Barbaria serbe ndaj monumenteve islame në Kosovë* (shkurt'98-qershor '99), Prishtinë, 2000, fq.147.

⁵⁷⁰ Bashkësia Islame e Kosovës, *Barbaria serbe ndaj monumenteve islame në Kosovë* (shkurt'98-qershor '99), Prishtinë, 2000, fq.108.

të e ndërtuar në stilin islamo-shqiptar. Xhamia në pjesën e brendshme përbëhet prej: sallës së lutjeve, hajatit dhe minares. Pjesë përbërëse në ambientin rrethues nga jashtë janë edhe varrezat. Kompleksi i xhamisë është i rrethuar me murin rrethues. Gjatë luftës, në vitet 1998-99, kjo xhami është djegur nga brenda dhe është demoluar pothuajse tërësisht, por pas përfundimit të luftës xhamia është restauruar. Në oborrin e xhamisë janë edhe varrezat e fshatit.

4. Kullat shqiptare në komunën e Deçanit

Ndër objektet e shumta të trashëgimisë sonë historike në komunën e Deçanit, vend me rëndësi zë "Kulla Shqiptare". Kulla luajti rol me rëndësi në jetën shoqërore e sociale të banorëve shqiptarë. Përveç funksionit për banim të anëtarëve të familjes, kulla u shfrytëzua edhe për strehimin e bagëtive. Në rast lufte, për të mbrojtur interesat kombëtare e personale, kulla kthehej në fortesë. Në gjuhën e popullit në Kosovë "kullë" quhet çdo shtëpi që ka dy e më shumë kate të ndërtuar me gurë.⁵⁷¹ Si në pjesë tjera të Dukagjinit edhe në komunën e Deçanit, kullat si ndërtime ,depërtuan në fund të shek. XVII për të vazhduar në shek. XVIII-XIX e XX.

Kulla, si krijimtari materiale shqiptare, mund të ndiqet në vazhdimësi qysh nga periudhat e hershme e deri në ditët tona.⁵⁷² Këto vepra arkitekturore shqiptare, sot kanë vlerë si monumente kulturo-historike. Në fillim kulla ndërtonin vetëm të pasurit e tek më vonë filluan të ndërtojnë edhe shtresat tjera të popullsisë.⁵⁷³ Kulla si ndërtim është paraqitur si individuale, e vetme por në disa raste edhe si kompleks kullash në afërsi. Kullat janë dy-tri e më rrallë katërkatëshe, e që kjo varej nga pozita ekonomike e pronarit dhe në disa raste edhe numri i anëtarëve të familjes.⁵⁷⁴ Kati i parë shfrytëzohej për strehimin e kafshëve. Kati i dytë shfrytëzohej për dhoma gjumi për anëtarët e familjes, ndërsa në katin e tretë ishte oda e mysafirëve. Materiali që përdorej për ndërtimin e kullave ishte guri dhe druri. Në Komunën e Deçanit, deri para luftës së fundit gjatë viteve 1998-1999, kanë ekzistuar 263 kulla me shumë objekte tjera përcjellëse si: Posllome, hambare, kosha drithi etj, ku gjatë luftës janë shkatërruar ose dëmtuar pothuajse tërësisht. Pas luftës janë restauruar rreth 30 kulla nga donatorë të ndryshëm vendorë dhe të huaj.⁵⁷⁵ Ekzistojnë edhe shumë kulla-rrënoja që presin për të intervenuar donatorët e mundshëm. Edhe në ditët e sotme në komunën e Deçanit, ende ekzistojnë mundësi të krijimit të komplekseve të kullave si në qytetin e Deçanit (pjesa e vjetër e qytetit), dhe në fshatrat Isniq dhe Drenoc.

⁵⁷¹ Mark Krasniqi, *Shtëpia shqiptare në Kosovë*, Gj. Albanologjike, F. dhe Etnologji, IAP, nr.1, Prishtinë, 1971, fq.38.

⁵⁷² Po aty, fq.112.

⁵⁷³ Mark Krasniqi, *Shtëpia shqiptare në Kosovë*, Gj. Albanologjike, F. dhe Etnologji, IAP, nr.1, Prishtinë, 1971, fq.38.

⁵⁷⁴ Fejaz Drançolli, *Kulla Shqiptare*, Prishtinë, 2001, fq.96.

⁵⁷⁵ Shkëlzen Shehu, *Intervistë, dhënë autorit*, Deçan, 19.5.2012; Shkëlzen Tahirsylaj, *Rrafshi i Dukagjinit identifikohet me kullën prej guri*, "Koha Ditore", Prishtinë, 2.11.2006.



Foto nr. 2, Çardaku me kullë në fshatin Lëbushë

Kulla me Çardak e Ahmetajve në fshatin Lëbushë

Kulla me Çardak (e Ahmetajve në fshatin Lëbushë) është njëra ndër kullat me të vjetra në komunën e Deçanit. Në fshatin Lëbushë kjo kullë ruhet ende si ekzemplar.⁵⁷⁶ Ky tip i banesës me çardak në Rrafshin e Dukagjinit, del nga shek. XVII-XVIII. Kulla e Ahmetajve si objekt është dykatëshe, përdhes (ambient ahuri) kati i dytë me dhoma të vogla që janë përdorur për nevojat e familjes, në katin e dytë gjendet edhe oda e burrave, kulla ka edhe çardakun. Materialet e ndërtimit të kullës janë guri dhe druri. Kjo kullë-çardak, është unike dhe shumë e rëndësishme për kulturën materiale-monumentale në komunën e Deçanit e më gjërë.

Mullinjtë me ujë

Edhe mullinjtë janë objekte të trashëgimisë monumentale në komunën e Deçanit. Mullinjtë i takojnë objekteve të trashëgimisë kulturore, që në të kaluarën kishin rëndësi ekonomike. Mullinjtë ishin fabrikat e kohës, sepse aty bluhej drithi që përdorej për ushqim nga banorët e këtyre anëve. Mullinjtë kryesisht janë ndërtesa njëkatëshe, e më rrallë dy e trekatëshe dhe janë të ndërtuar prej guri. Mulliri si objekt njëkatësh, zakonisht ka dy ambiente: ambienti ku bluhej drithi, aty ishin të vendosur gurët për bluarje, dhe një dhomë e vogël për mullisin. Mullinjtë punonin me ujë. Në fshatrat e komunës së Deçanit dikur ka pasur me dhjetëra mullinj. Vetëm në fshatin Isniq deri në fillim të shekullit XX kanë ekzistuar 8 mullinj.⁵⁷⁷ Sot i vetmi mulli në Isniq është mulliri i Tahir Sadrive të Dervishajve i cili edhe sot është në funksion. Aty bluhet drithi për banorët e fshatit Isniq dhe fshatrave tjera përreth. Zhvillimi dhe arritjet e teknologjisë moderne për bluarjen e drithit dhe grurit në ditët e sotme, ka bërë që shumica prej mullinjve me ujë janë zhdukur pothuajse tërësisht në komunën e Deçanit. Mullinjtë me ujë janë

⁵⁷⁶ Fejaz Drançolli, *Kulla Shqiptare*, Prishtinë, 2001, fq.165.

⁵⁷⁷ Rexhep Maksutaj, *intervistë dhënë autorit*, Deçan, 13.5.2012.

zëvendësuar në mullinj me rrymë elektrike. Në komunën e Deçanit sot ekzistojnë 4 mullinj me ujë. Këta mullinj, edhe tani janë në funksion dhe shërbejnë popullsinë.



Foto nr. 3, Mulliri i Shabanajve në Deçan

Mulliri i Shabanajve në Deçan

Ky mulli është ndërtuar në fund të shek. XIX dhe është pronë e familjes Shabanaj nga Deçani. Mulliri punonte me ujë por koha dhe lufta e kishin dëmtuar tej mase. Në vitin 2005, me donacionet e shoqatës italiane INTERSOS, mulliri është restauruar. Ky mulli, për kohën fund shek. XIX dhe shek. XX, kishte një rëndësi të madhe për popullsinë e këtyre anëve. Mulliri si objekt është njëkatësh dhe ka dy hapësira. Objekti është i ndërtuar me material prej gurit dhe drurit. Mulliri nuk është në funksion ekonomik për popullsinë vendase, por është një ndër objektet me të rëndësishme të trashëgimisë monumentale në komunën e Deçanit. Ky mulli ditët e sotme shfrytëzohet nga një OJQ vendore që merret me ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Si përfundim

Deçani ruan elemente të rëndësishme të trashëgimisë monumentale-kulturore shqiptare nga e kaluara e deri në ditët e sotme. Në Deçan e në fshatra përreth, vërehet lehtë një arkitekturë e cila dallon nga rajonet tjera të Kosovës. Si objekte monumentale-kulturore në komunën e Deçanit kemi: Objektet fetare (xhamitë, tyrbet, dhe një manastir ortodoks), objektet e banimit-kullat, objektet ekonomike-mullinjtë me ujë etj.

Para luftës, në komunën e Deçanit kishim rreth 300 objekte të trashëgimisë monumentale. Edhe përkundër dëmeve nga lufta e fundit në komunën e Deçanit, sot janë afërsisht 50 objekte -monumente të trashëgimisë kulturore si: 30 kulla, 14 xhami, 1 manastir ortodoks dhe 4 mullinj me ujë. Këto objekte, si monumente të kulturës, në vete paraqesin vlera të shumëfishta të historisë sonë. Në disa prej këtyre objekteve të vjetra, pjesë e trashëgimisë-monumentale në komunën e Deçanit, pas luftës gjatë viteve të 2000-ta është intervenuar nga organet qeveritare (MKRS), si dhe donatorët e jashtëm (OJQ-

të nga vende të ndryshme evropiane si CHWB, INTERSOS etj.). Edhe pse ka pasur intervenime-restaurime në disa prej objekteve të trashëgimisë-monumentale në xhami, kulla, mullinj dhe në objektet tjera, ende kanë mbetur edhe shumë të tjera si rrënoja që përballen me sfida të mëdha me faktorin njeri dhe kohë, gjë që ua vështirësojnë mbijetesën. Mbetët edhe shumë për tu bërë në të ardhmen që ky procesi i restaurimit të përfundojë sepse është një vlerë tejet e rëndësishme trashëgimisë-monumentale në komunën e Deçanit, e pse jo, në të ardhmen të jenë në funksion të zhvillimit ekonomik për banorët vendas. Një shembull nga terreni ,se është duke u bërë diçka në këtë drejtim, pra të ruajtjes dhe të promovimit të trashëgimisë kulturore, është ai në fshatin Beleg të komunës së Deçanit ku është restauruar një kullë, por janë edhe tri kulla tjera si rrënoja që presin për tu restauruar, kulla këto të cilat kanë vlera të shumëfishta: historike, artistike e kulturore. Objektet e tilla me vlerë nga e kaluara e popullit tonë, duhet patjetër të mbrohen me ligj nga shteti. Mbetët të shihet në të ardhmen se sa do ti kushtohet rëndësi ruajtjes, restaurimit dhe shfrytëzimit të trashëgimisë-monumentale të komunës së Deçanit si nga organet lokale kompetente për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, ashtu edhe nga ato qendrore të Kosovës.

QËNDRIMI I AUSTRO-HUNGARISË NDAJ ÇËSHTJES SHQIPTARE GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE

Ma.Blerim Haziri

Territoret shqiptare gjatë Luftës së Parë Botërore fillimisht ishin nën pushtuesit e politikës së egër serbe e malazeze, të cilët nuk ishin aspak të drejtë me shqiptarët.

Autoritetet austro-hungareze, duke vijuar politikën e tyre tradicionale në fushën nacionale, propagandonin se do të mbështetnin dëshirat e kombit shqiptar.⁵⁷⁸

Duke i pasur parasysh rrethanat e asaj kohe në trojet shqiptare, forcat austro-hungareze ishin pritur si çlirimtar, madje pati raste që shqiptarët u kishin prirë Fuqive të Boshtit për ti larguar serbo-malazezët nga trojet shqiptare. Kjo dukuri zanafillen e kishte pasur në Kosovë e kishte vijuar deri në kufijtë veriorë të Shqipërisë së Jugut, ku kishin depërtuar forcat e Perandorisë Dualiste. Në krye të forcave shqiptare ishin krerët Bajram Curri, Ahmet Zogu, etj. Figura të tjera të njohura politike, si Luigj Gurakuqi, Aqif pashë Elbasani, Hasan Prishtina etj, u kishin drejtuar thirrje shqiptarëve t'i prisnin austro-hungarezët si rojtës dhe çlirimtarë, pasi këta kishin mbrojtur në çdo rast qënien... dhe të drejtat e shenjta të kombësisë shqiptare.⁵⁷⁹

Të drejtat e përgjithshme qytetare si: liria e lëvizjes, liria personale, mbrojtja e shtëpisë, ruajtja e sekretit të letrave, e drejta e organizimit në shoqëri, e drejta e mbajtjes së mbledhjeve, liria e shtypit, etj. Garantohen nga autoritetet austro-hungareze.⁵⁸⁰

Gjatë periudhës kur Shqipëria ishte e pushtuar nga forcat e Boshtit, qysh në fillim shqiptarët tentuan të shfrytëzojnë gjendjen e cila mbretëronte në fillim të hyrjes së trupave austro-hungareze, të cilët ende kishin ballafaqime me bullgarët për ndarjen territoriale, shqiptarët tentuan dhe u bënë thirrje elites politike për të mbajtur një Kongres dhe nga ai Kongres të dal një Qeveri shqiptare.⁵⁸¹

Ky Kongres mendohej të mbahej në Elbasan më 18 mars 1916,⁵⁸² që donte të thoshte ribashkim të shqiptarëve me bashketnikët e tyre. Kjo përpjekje e shqiptarëve binte ndesh me planet e Vjenës për të ardhmen politike të Shqipërisë.⁵⁸³

⁵⁷⁸ *Historia e Popullit Shqiptar, III - Periudha e Pavarësisë 28 nëntor 1912- 7 prill 1939*, eds. K. Prifti, Gazmend Shpuza, Akademia e Shkencave e Shqipërisë (Tiranë: TOENA, 2007), p. 439.

⁵⁷⁹ *Historia e Popullit Shqiptar, III*, p. 84.

⁵⁸⁰ Aneks për raportin nga Shkodra, më 9 prill 1916, Nr. 35/ politik. Vija të përgjithshme për administratën e pjesëve të Shqipërisë Veriore dhe të Mesme që i përkasin sferës së interesave austro-hungareze.

⁵⁸¹ Valentina Duka, *Qytetet e Shqipërisë në vitet 1912-1924*, (Tiranë: TOENA, 1997), p. 48; Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes Shqiptare, 1878- 1926*, (Tiranë: DUDAJ, 2010), p. 235.

⁵⁸² Paskal Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë*, (Tiranë: TOENA, 2013), p. 360.

⁵⁸³ Nicola Guy, *Lindja e Shqipërisë- Nacionalizmi, Fuqitë e Mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare*, (Tiranë: Pegi, 2012), p. 163; Puto, op. cit.p. 180.

Kongresi i paralajmëruar ishte me rrezik për politikën austro-hungareze dhe mendohej të anulohet, sepse autoritetet austro-hungareze mendonin që nga ai *Kongres* mund të shfaqen revolta të mëdha kundër pushtuesve. Si duket Komanda austro-hungareze u tregua jotolerante në këtë situatë të krijuar, të cilët menjëherë përdorën një metodë kinse në Elbasan kishte rënë një sëmundje e kolerës dhe duhet vendosur karantinë për të penguar mospërhapjen e saj.

Pas kësaj ngjarje në një telegram që konti Turn i dërgonte Korpskomandës lajmëron: "...me rastin e një Kongresi të projektuar të Partisë Nacionale në Elbasan (të cilin organizatorët gjatë kësaj kohe e anuluan vetë), ajo i urdhëroi që mos lejohet tani mbledhje politike në krahinat e okupuara prej saj. Në qoftëse mbledhje të tilla projektohen për qëllime ekonomike ose qëllime të ngjajshme me këto, duhet marr leje nga komanda ushtarake ma e lartë duke treguar objektin e bisedimit dhe në rast se lejohen, të dërgohen në bisedimet një deri në dy organe".⁵⁸⁴

Austro-Hungaria nuk dëshironte që shqiptarët të vetëudhëhiqen, qëllimi i tyre ishte që gjithçka që vendoset nga shqiptarët të jetë nën kontrollin Perandorak, për këtë arsye anuluan të mbahen të gjitha organizimet me qëllime politike.

Autoritetet austro-hungareze kishin ndërmarrë disa hapa për përmirësimin e gjendjes politike ndaj shqiptarëve. Ishte ligjësuar përdorimi i flamurit shqiptar, pushteti vendor ju kishte besuar shqiptarëve, gjuha shqipe lejohej të përdoret në administratë, nuk pengohej hapja e shkollave shqipe, pastaj finançohej botimi dhe shpërndarja e librave në gjuhën shqipe.⁵⁸⁵

Gazeta "Vullnetari", shkruante se: "...u ngrit flamuri kombëtar në gjithë objektet qeveritare dhe fetare në Shkodër dhe këto veprime po vazhdojnë kudo që po shkel këmba e ushtarëve austro-hungarez".⁵⁸⁶

Mund të pohojmë se të drejta të tilla shqiptarët nuk kishin pasur në dispozicion nga pushtuesit e mëparshëm, prandaj për këtë arsye kishin krijuar raporte mjaft të mira me pushtuesit austro-hungarez.

Austro-Hungaria nuk mbante qëndrim unik në raport me çështjen shqiptare. Dalloheshin dy vija kryesore: ajo politike që përcaktohej kryesisht nga Ministria e Punëve të Jashtme (Ballplatz) dhe ajo ushtarake e përfaqësuar nga shtabi i përgjithshëm i ushtrisë perandorake (Konradi). Pikëpamja e Ballplatz-it ishte shpallur nga titullari, baroni I. Buriani. Ai mbështeste idenë që jo vetëm të ruhet pavarësia e Shqipërisë, por ti bashkoheshin edhe pjesët që iu kishin aneksuar gjatë Luftërave Ballkanike.⁵⁸⁷

Ndërsa mendim tjetër për çështjen shqiptare kishte baroni Konrad fon Hëntendorf që ishte shëf i shtabit të përgjithshëm të ushtrisë perandorake, ai ishte kundër një Shqipërie të pavarur sepse mendonte se një Shqipëri e pavarur nuk do të mund të ekzistonte për shkak të homogjenitetit të elementit shqiptar, të gjuhës, të origjinës e të fesë së tij. Projekti i tij ishte aneksimi i Shqipërisë së Veriut deri në lumin Mat nga Austro-Hungaria, Greqisë t'i jepet Shqipëria e Jugut së bashku me Vlorën,

⁵⁸⁴ Haus und Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien (më tej: HHSt. A. PA. A.) në Arkivin e Institutit të Historisë- Tiranë (më tej: AIH) . vj -26-6-631, Tel. sh. nr. 3112. Konti Turn. Ref. I. a. Nr. 933. Res. Tel. Bert. Abt. 101, më 17 mars 1916, dërguar Korpskomandës në Shkodër.

⁵⁸⁵ Historia e Popullit Shqiptar, III, op. cit. p. 439.

⁵⁸⁶ "Vullnetari", nr.12. d.t. 29.08.1916, "Te Gezohe mi apo të helmohemi".

⁵⁸⁷ Milo, op. cit. p.p. 282- 283; Zhivko Avramovski, Konflikti austro-hungarez-bullgar rreth Kosovës dhe synimet bullgare për të dalë në Detin Adriatik përmes Shqipërisë (1915-1916), *Gjurmime Albanologjike*, seria e shkencave, III/1973, Prishtinë, pp 144- 145.

ndërsa Bullgarisë t'i jepet Shqipëria e Mesme përfshirë dhe Durrësin. Me këtë projekt synonte të mbante larg Italinë.⁵⁸⁸

Kompromisi ishte arritur më 9 dhjetor 1916, mes Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe ushtrisë. Buriani pranoi që autoriteti kryesor për të zbatuar politikën e Vjenës në kohën e luftës në Shqipëri do të ishte komanda e korpusit XIX e ushtrisë perandorake me seli në qytetin e Shkodrës. Komanda e Përgjithshme pranoi qëndrimet e Ballplatz-it për ndërtimin në të ardhmen, një shtet shqiptar të pavarur nën protektoratin efektiv të Austro-Hungarisë.⁵⁸⁹

Baroni Burian i kishte dërguar notë zyrës ushtarake të perandorit, kjo notë u bë në lidhje me krijimin e policisë shqiptare që krijonte Korpusi XIX, kurse procedura ishte organizuar asisoji sikurse të bëhej me një territor austro-hungarez dhe me shtetasit e saj e jo me shqiptar. Gjenerali Konrad kishte pranuar kërkesat e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe në udhëzimet e dhëna Komandës së Korpusit XIX të armatës mbi përgatitjen e banorëve shqiptar për krijimin suksesiv të policisë nën mbrojtjen e vendit, ishte distancuar nga mobilizimi dhe si formë kalimtare kishte pranuar paraqitjen vullnetare. Secilit batalion iu kishte lejuar flamuri shqiptar, betimi kishte të bënte me mbrojtjen e Shqipërisë, kurse për nga kushtet materiale ishin të barabartë me ushtrinë e rregullt. Edhe pse në këtë rast Gjenerali Konrad iu ishte përlulur Ministrisë së Punëve të Jashtme, ai vazhdoi të mbes kundërshtar i idesë për krijimin e Shqipërisë së pavarur.⁵⁹⁰

Mirëpo, Gjenerali Konrad jo që ishte kategorikisht kundra shqiptarëve, por në rrethana çfare ishin trojet shqiptare, mendonte se ishte e pamundur ose tepër e kushtueshme që të krijohet një shtet shqiptar, sepse Shqipëria në atë kohë ishte e pushtuar ose që kishin ambicie pushtuese Italia, Bullgaria, Greqia dhe kurrë nuk do të lejonin paqësisht që të krijohet një shtet shqiptar.

Masat që ndërmerreshin nga autoritet austro-hungareze nuk përkraheshin që të gjitha unanimisht nga shqiptarët. Pakënaqësi të madhe solli një urdhëresë e 29 prillit 1916, e cila dekretoi konfiskimin e të gjitha armëve.⁵⁹¹

Austro-hungarezët si masë të parë ndërmorën çarmatimin e popullsisë, që të pengojnë eventualisht ndonjë rezistencë të armatosur. Komandanti i forcave ushtarake, Konrad for Hecedorf, në mars 1916, raportonte komandën ushtarake në Beograd se ishte duke e çarmatosur popullin. Ai kishte dhënë urdhër që qetësia dhe siguri duhet patjetër të ruhen nëse është nevojë me masat më të rrepta, urdhër ky që mbaronte me kërcënim se me gjak do ta paguajë secili që tenton t'u kundërvihet organeve të pushtetit.⁵⁹²

Gjatë nëntorit të vitit 1916, u kuptua se perandori austro-hungarez Franc Jozef⁵⁹³ mendonte që një pjesë të pushtetit t'ia jepte trashëgimtarit të fronit Karl, diplomacia bullgare posa kuptoi këtë informacion dëshironte ta shfrytëzonte për zgjidhjen e çështjes serbe. Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë bullgare të Punëve të Jashtme Kosev, më 17

⁵⁸⁸ Milo, op. cit. p. 283.

⁵⁸⁹ Ibid., p. 286.

⁵⁹⁰ Avramovski, op. cit. p. 150.

⁵⁹¹ Peter Bartl, *Shqipëria, nga mesjeta deri sot*, (Prizren: DRITA, 1999), p. 173.

⁵⁹² Limon Rushiti, *Rrethanat Politiko-Shoqërore në Kosovë 1912-1918*, (Prishtinë: RILINDJA, 1986), p. 187.

⁵⁹³ HHSt. A. PA. A. në AIH. Korpskomanda perandorake dhe mbretërore, rezervate Nr. 8283. Qarkore telegrafike. Vendbanim i korpskomandës, më 22 nëntor 1916. Gjenerali i këmbësorisë Trolnan bënte me dije, që Madhëria e tij Franc Jozef Irë, perandor i Austrisë dhe mbret apostolik i Hungarisë, vdiq më 21 nëntor 1916, në ora 9 e 51 minuta pas dite. Duke qenë i bindur se të gjithë pjestarët e ushtrisë të perandorisë mbretërore austro-hungareze janë të tronditur prej kësaj ngjarje shumë të dhimshme, le t'a durojmë atë me burrëri ushtarake dhe të kryejmë detyrat tona me besnikëri të papyeshme edhe më mirë për të mirën e shtetit dhe popujve të tij.

nëntor 1916, i kishte deklaruar të ngarkuarit gjerman me punë ushtarake Fon Masovit, se me këtë akt lehtësoheshin negociatat për paqe. Edhe pse Qeveria bullgare dhe Ferdinandi më me ëndje do të zhduknin Serbinë tërësisht, Kosev sugjeronte që të krijohet një mbretëri malazeze-serbe nën dinastinë malazeze, të cilës do ti aneksoheshin edhe disa pjesë të Shqipërisë, duke aluduar se me këtë pajtoheshin Italia që kishte pasur raporte të mira me malazezët, madje edhe Rusia do të pajtohet me këtë fakt sepse Serbia mbetet, vetëm se në një formë tjetër.⁵⁹⁴

Edhe pse Masovit ai kombinim ju duk zgjidhje e mirë që mund ti afronte Fuqitë e Boshtit me Italinë dhe Rusinë, mirëpo ai nuk besonte se Austro-Hungaria do të lejonte një gjë të tillë. Vjena këto zhvillime i përcillte me vëmendje dhe ishte e vetëdijshme se Bullgaria me këtë rekomandim dëshironte që të krijohet një monarki malazeze-serbe dhe pastaj t'ia bashkangjiste një pjesë të trojeve shqiptare, madje një pjesë të Serbisë ta aneksoj vetë. Mirëpo, krijimin e një shteti shqiptar nga Austro-Hungaria, Bullgaria e shihnte si me rrezik dhe mendonte se kurdoherë Austro-Hungaria do të mund të aneksonte shtetin shqiptar dhe do t'ia shuaj ëndrrën bullgarëve për dalje në Adriatikë.

Një çështje e një rëndësie të veçant ishte biseda ndërmjet Ferdinandit dhe baronit Burian e datës 5 dhjetor 1916, që Bullgaria aspironte Prizrenin dhe Prishtinën. Baroni Burian shtroi çështjen e zgjerimit të Shqipërisë me trevat që në bazë të *Paqës së Bukureshtit* i qenë aneksuar Serbisë dhe Malit të Zi. Buriani kishte paraqitur argumente se në këto treva nuk jetonte asnjë bullgar, ndërsa Shqipëria ishte e lidhur në pikëpamje ekonomike-geografike, madje këto treva i shërbejnë edhe si sipërfaqe të punueshme dhe ishshin të një rëndësie të madhe, për Shqipërinë dhe ardhmërinë e saj. Bisedimet që ishshin zhvilluar mes Burianit, Ferdinandit dhe Radosllavit nuk kishte pasur mosmarrëveshje. Ruajtjen e shtetit të pavarur shqiptar nën protektoratin e Austro-Hungarisë, Buriani e konsideronte çështje të kryer.⁵⁹⁵

Për çështjen shqiptare ishte diskutuar në seancën e Ministrisë austro-hungareze për Punë të Përbashkët më 12 janar 1917, nën Kryesinë e perandorit Karl. Konti Tisa përqiqej që në disfavor të Shqipërisë t'i aneksoj Greqisë një pjesë të Shqipërisë së Jugut, me arsyetim që në konflikt për këtë pjesë shqiptare të konfrontoheshin Italia dhe Greqia, kurse për pjesën tjetër shqiptare të ruhet protektorati austro-hungarez.⁵⁹⁶

Në një dokument që i dërguari perandorak e mbretëror Kuhn i kishte dërguar telegram Ministrisë të punëve të Jashtme, kontit Çernin, thuhet se: Hasan Prishtina, duke u kthyer nga Vjena për në Mitrovicë kishte qëndruar edhe disa ditë në Beograd, ndër të tjera ai kishte aluduar se së shpejti do të shpallet një Shqipëri e pavarur, territorialisht e zgjeruar me të tri rrethet: Pejë, Prizren dhe Mitrovicë, por si duket ky paralajmërim i tij ka të bëjë me *Proklamatin* drejtuar shqiptarëve në Shkodër.⁵⁹⁷

Austro-Hungaria kishte për qëllim të prekte vetëdijen kombëtare të popullit shqiptar dhe për këtë mjaft mirë ia arriti kur edhe e shpalli Autonominë e të gjithë Shqipërisë nën egjiden (patronazhin) e Monarkisë Dualiste.⁵⁹⁸

⁵⁹⁴ Zhivko Avramovski, op.cit. pp. 167-171.

⁵⁹⁵ Ibid., p. 172.

⁵⁹⁶ Ibid., p.174.

⁵⁹⁷ HHSSt. A. PA. A. në AIH. Vj. 27-5-504, Nr. 4 / pol. A.B. Beograd, më 31 janar 1917. Ref. Ia. I dërguari perandorak e mbretëror Kuhn, i dërgoi shkëlqësisë së tij, Ministrisë të Punëve të Jashtme, kontit Çernin mbi, Qëndrimi i Hasan be Prishtinës në Beograd. Shpallja gjoja e afërt e një Shqipërie të lirë territorialisht të zgjeruar.

⁵⁹⁸ Arben Puto, *Shqipëria Politike, 1912-1939*, (Tiranë: TOENA, 2009), p. 178.

Disa historian thonë që është shpallur autonomi e të gjithë Shqipërisë, kurse në dokumente austro-hungareze që kemi hulumtuar dhe konsultuar në shpalljen e lartpërmendur nuk kemi hasur që të jetë përmendur fjala autonomi, për këtë argumentojmë më poshtë.

Gjatë përvjetorit të hyrjes në Shqipëri të trupave austro-hungareze më 23 janar 1917, Shtabi madhor kishte përpiluar një shpallje politike: atë ditë në Shkodër komandanti i Korpusit gjeneral G. Trolman dhe përfaqësuesi i Ballplats-it pranë kësaj komande, August Kral, i pari në gjermanisht dhe i dyti në shqip iu drejtuan thirrjen... shpallja fillonte ne nuk kemi ardhur si pushtues në vendin tuaj, por për ndjekjen e atyre armiqve të Monarkisë, që prej kohësh kanë qenë edhe armiqtë tuaj shekullorë.⁵⁹⁹

Në *Proklamata* sulmohej politika e Antantës si të përkundërta me politikën e Austro-Hungarisë. Gjithashtu, për të ardhmen e Shqipërisë thuhet se Austro-Hungaria ka për qëllim ti respektoj religjionet, gjuhën shqipe, të drejtat dhe zakonet shqiptare. Gjithashtu, do të organizonte një administratë efikase dhe të garantonte sigurinë e personelit, nderin dhe posedimin e pronës, të rregullonte dëmet e shkaktuara nga lufta, pastaj thuhet se një administratë e tillë ishte vetëm hyrje në autonomi, e cila do t'i jepet Shqipërisë kur do të jenë të aftësuar.⁶⁰⁰

Sipas kësaj *Proklamate* kuptohet shumë mirë se Austro-Hungaria mendonte se shqiptarët ende nuk janë gati për vetëqeverisje.

Në pjesën e parë të *Proklamatës* Austro-Hungaria kishte radhitur përpjekjet për të plotësuar besimin fetar, gjuhën, të drejtat dhe zakonet e trashëguara. Ndërsa në gjysmën e dytë të tekstit ishin bërë premtime afatshkurtra dhe afatgjata, ndërsa shpallja përfundonte: Duke e ditur që komandanti i përgjithshëm ushtarak i trupave të vendosura në Shqipëri është dhe mbrojtësi i të gjitha aspiratave të drejta kombëtare të shqiptarëve, duke pasur besim tek Austro-Hungaria e ushtria e saj, populli shqiptar mund të hedhë plotësisht i qetë vështrimin drejt së ardhmes.⁶⁰¹

Proklamata e shpallur më 23 janar 1917, thelloi pakënaqësi tek populli shqiptar. Në këtë tubim të shpalljes së *Proklamatës* ishte një masë e vogël e popullit dhe kjo të bënë të kuptosh se ekzistonte një mosbesim i madh ndaj pushtuesit. Mbasi edhe pas mbajtjes së fjalimit pati shumë kundërshtime, ngase populli shqiptar priste që të shpallet autonomi. Hasan Prishtina deklaronte vazhdimisht se monarkia ka simpati për vendin e tyre. Por pas kësaj *Proklamate* edhe autonomistët mbeten të pakënaqur, sepse në këtë *Proklamata* nuk u fol për krijimin e menjëhershëm të autoriteteve shqiptare autonome sikundër shpresonin ata.⁶⁰²

Proklamata në Shkodër u interpretua në mënyra të ndryshme. Korpskomanda e XIX nuk e kuptonte se si vendasit e dëshirojnë një autonomi të menjëhershme. *Proklamata* nëpër viset malore dhe fshatra për dallim nga Shkodra ishte mirëpritur, që i kishte bërë austro-hungarezët të mendonin se pjekuria më e madhe politike qëndronte në Shqipëri të Mesme dhe se Shkodra të mos konsiderohet si matës i gradës së opinionit të vendit.

⁵⁹⁹ Milo, op. cit. p. 286.

⁶⁰⁰ Avramovski, op.cit. p. 174.

⁶⁰¹ Milo, op. cit. p. 287.

⁶⁰² HHSt. A. PA. A. në AIH.-27-6-609. Aneksi 2) për raportin nga Shkodra më 11 mars 1917, Nr. 34/ politik.Kopje. Zyra e policisë imperialiste dhe mbretërore në Shkodër, nr. 62/ rez. Raport mbi situatën. Komandës së bezirkut I në Shkodër. Shkodër, më 16 shkurt 1917.

Veçanërisht fakti që Austro-Hungaria edhe më tutje dëshiron ta ketë vetë në dorë udhëheqjen e administratës, i qetëson shumë shqiptar për të ardhmen.⁶⁰³

Diplomacia vjeneze në shtator të vitit 1918, për herë të fundit kishte dërguar një shkresë me titull “Direktivat politike për administratën e Shqipërisë”, ajo i qëndroi pikëpamjes së saj se populli shqiptar duhet të shikohet dhe të trajtohet si komb neutral dhe me ide promonarkike.⁶⁰⁴ Por Ballplatz-i ishin të bindur se në rast se e humbin luftën fati i Shqipërisë do të varet nga përfundimi i Luftës së Parë Botërore dhe epilogut të bisedimeve.

Lufta e Parë Botërore kishte mbaruar ashtu siç nuk e dëshironin shumica e shqiptarëve, të cilët me gjithë zhgënjimet që pësuan, anonin nga fitorja e Fuqive të Bllokut Qendror, ngase mendonin që kështu mund të shfrytëzoheshin kontradiktat midis Fuqive të Mëdha në interes të çështjes kombëtare, sidomos për të ardhmen e Kosovës.⁶⁰⁵

Fuqitë Qendrore gjatë gjithë kohës bënin plane për tokat e pushtuara, mirëpo ofensiva e trupave të Antantës, në vjeshtë të vitit 1918, i detyruan që të shpallin kapitullimin, fillimisht Bullgaria pastaj Austro-Hungaria dhe me kapitullimin e tyre për fatin e Ballkanit vendoste Aleanca e Antantës.

⁶⁰³ HHSt. A. PA. A. në AIH. -Vj. 27-6-608. Aneks 1) për raportin nga Shkodra, më 11 mars 1917, nr. 34/politik. Kopje e një raporti të Komandës së korpusit 19 mbi proklamatin drejtuar Kryekomandës të ushtrisë në mars 1917 E.V. nr. 284.

⁶⁰⁴ Milo, op. cit. p. 288.

⁶⁰⁵ Muin Çami, Shqipëria në rrjedhat e historisë- Përmbledhje Studimesh, 1912-1924, (Tiranë: Onufri, 2007), pp. 91-93.

DIMENSIONI EVROPIAN I MËSIMDHËNIES SË HISTORISË NE SHKOLLË NGA RIPRODHIMI NË INTERPRETIM TË FAKTEVE DHE TË NGJARJEVE HISTORIKE

Desara Karaj

Arsimi shqiptar, në procesin e reformimit të tij, ka si përparësi përafrimin me atë të vendeve më të përparuara, duke i dhënë shkollës dimensionin evropian, ku edukimi i shprehive afatgjata mbetet një nga synimet themelore të realizimit të objektivave të integritimit në shoqërinë e dijes. Në këtë kuadër gjetja e formave, teknikave dhe praktikave aplikative ka tërhequr vëmendjen dhe angazhimin e kërkuesve shkencorë të fushës së edukimit. Nëpërmjet këtij prezantimi synojmë të ndikojmë në krijimin e kushteve dhe klimës së përshtatshme për edukimin e shprehive afatgjata të nxënësve, nëpërmjet transformimit të teknikës së dhënies nga riprodhim në analizë dhe interpretim të fakteve, nga ato me karakter riprodhues dhe faktik që pothuaj mbizotërojnë.

Në praktikën tona të trajnimit dhe të kualifikimit të mësuesve i është kushtuar një vëmendje e madhe mësimdhënies dhe vlerësimit të arritjeve të nxënësve, por pak jemi marrë me procesin dhe mekanizmin e të nxënësve të fëmijëve dhe akoma më pak me edukimin e shprehive të nxënësve se si të punojnë me tekstin dhe me çdo material tjetër të shkruar mësimor ose jo, me detyrat mësimore në tërësi.

Lind pyetja: Si mund të arrihet **dimensioni evropian në kurrikulat e historisë të shkollës së mesme?**

A është kjo një domosdoshmëri e formimit të qytetarë në shoqërinë demokratike?

Sigurisht që po. Në aspektin teorik kjo qasje e re e mësimdhënies së historisë bazohet në modelet konstruktiviste dhe social- kognitiviste të të nxënësve, sipas së cilave dy janë parimet bazë Arsimi shqiptar, në procesin e reformimit të tij, ka si përparësi përafrimin me atë të vendeve më të përparuara, duke i dhënë shkollës dimensionin evropian, ku edukimi i shprehive afatgjata mbetet një nga synimet themelore të realizimit të objektivave të integritimit në shoqërinë e dijes. Në këtë kuadër gjetja e formave, teknikave dhe praktikave aplikative ka tërhequr vëmendjen dhe angazhimin e kërkuesve shkencorë të fushës së edukimit. Nëpërmjet këtij prezantimi synojmë të ndikojmë në krijimin e kushteve dhe klimës së përshtatshme për edukimin e shprehive afatgjata të nxënësve, nëpërmjet transformimit të teknikës së dhënies nga riprodhim në analizë dhe interpretim të fakteve, nga ato me karakter riprodhues dhe faktik që pothuaj mbizotërojnë.

Në praktikat tona të trajnimit dhe të kualifikimit të mësuesve i është kushtuar një vëmendje e madhe mësimdhënies dhe vlerësimit të arritjeve të nxënësve, por pak jemi marrë me procesin dhe mekanizmin e të nxënësve të fëmijëve dhe akoma më pak me edukimin e shprehive të nxënësve se si të punojnë me tekstin dhe me çdo material tjetër të shkruar mësimor:

Të nxënësve është më i qëndrueshëm kur nxënësit përfshihen aktivisht në proces; Nxënësit ndërtojnë dijen duke përpunuar informacionin dhe duke i modeluar sipas përvojave vetjake. Në kontekst të rishikimit të kurrikulës së lëndës së historisë, shtrohen për diskutim edhe shumë pyetje të tjera të rëndësishme :

Cilat janë / duhet me qenë qëllimet e mësimin të historisë?

A do të përqendrohemi në shprehje të menduarit apo vetëm në përmbajtje: ku qëndron barazpesha?

Si mund të shfrytëzohet dhe të përdoret këndvështrimi shumë-përmasor i ngjarjeve, dukurive dhe fakteve historike?

Si të nxitet dhe të kultivohen shprehjet e të menduarit kritik?

Si të veprohet me çështjet e ndjeshme dhe kontradiktore?

Në një këndvështrim më të gjerë, përmes një kurrrikule të konceptuar mbi bazën e pikëpamjeve konstruktiviste dhe të përdorimit në klasë të metodave të menduarit kritik, këta faktorë, dhe shumë të tjerë, do të mundësojnë përgatitjen e nxënësve për shoqërinë e dijes.

Demonstrimi i dijeve të ndërtuara, të krijuara dhe i shprehive të përvetësuara do të bëjnë të mundur që nxënësit të jenë në gjendje t'i zbatojnë ato në praktikë duke përdorur materiale burimore të qëmtuara e të skeduar në mënyrë sistematike, bazuar në përvojat, interesat, nevojat dhe këndvështrimin personal. Mësimdhënia bashkëkohore ndihmon në sistemimin e dijeve dhe në një praktike të suksesshme, të zbatuara në cikle të ndryshme shkollimi. Në vendet e zhvilluara përëndimore mësimdhënia e historisë shoqërohet me një material teorik bazë me karakter psikologjik, që bashkëshoqërohet nga materiale teorike më të përgjithshme metodologjike duke shërbyer edhe si udhëzues që mundësojnë zbatimin e suksesshëm të këtyre metodologjive të reja në kushtet konkrete të klasës.

Në situatën aktuale, në Shqipëri, nxënësi përballet me vështirësi të pakapërcyeshme. Ai është mbuluar nga anëtarët e grupit ose ka qenë pasiv në proces, angazhimi i tij në shtëpi është i sforcuar, i orientuar te roli i të tjerëve dhe ka gjasë që të mos i kryejë me sukses detyrat. Pra, kemi një frenim apo ngecje të procesit të të nxënësve, pasiguri, mungesë motivimi e cila çon deri në zverdhjen e dëshirës për të nxënë, duke i hequr dëshirën për shkollën.

Qëllimi i sotëm i edukimit është të edukojë shprehje të të nxënësve afatgjatë, synim që në vetvete përmban shansin e të nxënësve gjatë gjithë jetës, përtej viteve të shkollimit.

“Qëllimi kryesor i arsimit- shprehet Piazhës- është të krijojë njerëz që janë të aftë të bëjnë gjëra të reja, jo thjesht të përsëritin ato që kanë bërë brezat e tjerë-njerëz që janë krijues, shpikës dhe zbulues. Qëllimi i dytë i arsimit është të formojë mendje që mund të jenë kritike, që të mund të verifikojnë dhe jo të pranojnë çdo gjë që u jepet”.⁶⁰⁶

Kjo thënie e Piazhës përbën detyrën parësore për shkollën sot. Zhvillimi i të menduarit kritik të nxënësve dhe studentët, në të gjitha nivelet duhet të përbëjë shtyllën kurrizore të

⁶⁰⁶ Fisher 1995, faqe 29

tërë sistemit: planet, programet, tekstet, metodologjinë që me një fjalë përmbledhen në konceptin kurrikul.

Kjo kërkesë objektive buron nga prirja e sotme e zhvillimit, nga orientimi strategjik që kemi përcaktuar tashmë në shqiptarët: Integrimi në familjen e kombeve të përparuara.

Unë kam një përvojë në mësimdhënie në të gjitha nivelet e arsimit dhe problemi i trajtimit të temave në lëndën e historisë ka qenë objekt diskutimi dhe debati midis mësuesve, nxënësve dhe prindërve. Metodologjia bashkëkohore zakonisht zbatohet nga mësues novatorë e bashkëpunues dhe unë besoj jam një nga ata. Përvoja me organizimin e krijimtarisë së nxënësve dhe sidomos si trajnere më kanë dhënë mundësinë ta njoh në thellësi këtë fushë. Nisur nga ky qëllim unë e shoh veten të përfshirë në këtë studim duke menduar t'i shërbej kërkesës objektive që kemi përcaktuar për zhvillimin e arsimit shqiptar: integrim në familjen e kombeve të përparuara

Në përfundim të studimit do të arrijmë të evidentojmë përmes analizave sasiore dhe cilësore, efektet e praktikave konkrete në përcaktimin e metodave të vlefshme në mësimdhënie e historisë. Mbi bazën e rezultateve të arritura do të formulojmë udhëzime dhe rekomandime për hartuesit e kurrikulave, autorët e teksteve dhe mësuesit, që të mbështeten në një platformë praktike për lëndë, klasa e lëndë të ndryshme.

Një rendësi të veçantë kanë dhe orët model të paraqitura duke patur parasysh metodat bashkëkohore si dhe realizimet e tyre. Mendoj se paraqitja e disa shembujve konkrete do të jetë e domosdoshme dhe plotësuese për studimin duke sjellë më pranë realizimin e asaj çka kemi ndërmend të paraqesim më këtë studim. Duke patur parasysh dhe kërkesat e kohës mendoj se praktikën bashkëkohore do të ketë një influencë pozitive në hartimin e planeve mesimore, teksteve dhe oreve të mesimit duke vënë në qendër nxënësin dhe zhvillimin e mendimit kritik në qendër të vëmendjes.

Problemet e mësimdhënies së historisë janë trajtuar edhe herë të tjera madje janë diskutuar dhe mbledhur shpeshherë dhe tryeza diskutimi në aspekt metodik me pjesëmarrjen e vendeve të ndryshme të Evropës Juglindore

Një ndër karakteristikat kryesore dhe domosdoshmëri jo vetëm në lëndën e historisë por edhe në lëndë të tjera janë dhe përdorimi i metodave bashkëkohore të cilat janë shumë praktike, të pëlqyera dhe nga nxënësit. Nëpërmjet tyre realizohet fillimisht një situatë praktike nga jeta ose nga ajo e klasës, kalohet pastaj në shpjegimin e metodës dhe më pas jepen hapat e zbatimit të saj (metodsë).

Mësimet model përbëjnë një ndihmë të madhe për mësuesin të cilët janë në fazën e përvetësimit të metodave të reja. Do doja të theksoja nga përvoja ime personale që një rëndësi të veçantë në përcaktimin e një mësimdhënie efektive të lëndës së historisë kanë dhe programet dhe përgatitjet e studentëve në fakultetet e mësuesisë, kjo përgatitje e cilat nis që në auditor fillimisht teorikisht pastaj me praktikën universitare do të shoqërojnë këta studentë më pas mësues, në përgatitjen e tyre gjatë gjithë punës së tyre si mësues duke hedhur kështu baza të shëndosha në procesin e mësimdhënies.

Ashtu sikurse përmenda më lart dimensionin Europian në procesin e mësimdhënies duhet të ndiqet në çdo aspekt të kurikulës në tekste, plane mesimore, plane ditore.

Gjatë këtyre viteve në vendin tonë janë krijuar përvoja pozitive, të cilat duhen përmendur. Përvoja e vendeve të përparuara ofron disa modele të cilat bazohen në Taksonominë e Blumit, në modelin Hunter, në modelin e të nxënësve me këmbime, të stileve të të nxënësve, të mësimdhënies për zhvillimin e inteligjencave të shumfishta etj. Duhet patur parasysh disa parime të përgjithshme:

Planet të hartohen në mënyrë të tillë që të synojnë të nxënë të nxënësve në lidhje me sferën njohëse, emocionale apo të zhvillimit fizik të nxënësve
 Objektiva të qarta dhe të arritshme
 Veprimtaritë mësimore të jenë në përputhje me arritjen e objektivave mësimore
 Veprimtaritë e vlersimit të jenë konkrete objektivat dhe veprimtaritë mësimore.

Bashkësia e vendeve ku duam të integrohemi quhet ndryshe shoqëri e dijes.

Metodologjia e mësimdhënies së të menduarit kritik duhet bazuar tek të menduarit kritik , është kjo arsyeja që kjo metodologji do jetë mjaft efikase gjatë procesit mësimorë. Njëpërmjet të menduarit kritik arrihet një shpjegim më i mirë, një arsyetim shkencorë, vlersim i fakteve.

Arsimi luan një rol tepër të rëndësishëm në jetën e çdo individi dhe ajo që është e rëndësishme ka të bëjë pikërisht me mënyrën se si mund të zhvillohet ai në ditët e sotme. Arsimi nënkupton marrjen e dijeve në sfera të ndryshme të jetës dhe në këto sfera bën pjesë edhe mësimi i lëndës së historisë nëpërmjet metodave bashkohore.

Ajo që është e rëndësishme dhe që duhet theksuar lidhet me mënyrën se si duhet të arrihet dhe të zhvillohet mësimdhënia dhe në këtë rast i referohemi sidomos mënyrës së përdorimit të mjeteve mësimore gjatë procesit mësimor, në mënyrë që rezultatet të jenë sa më efikase për të gjithë nxënësit.

Mësimdhënia nuk është një proces aspak i thjeshtë, por përkundrazi është një proces i cili përfshin elementë të ndryshëm dhe që nuk kanë të bëjnë thjeshtë me transmetimin e informacioneve apo të dijeve. Mësimdhënia ka të bëjë mbi të gjitha me vendosjen e një ure komunikimi midis nxënësit dhe mësuesit dhe që të arrihet kjo gjë, është e nevojshme pikërisht realizimi i një klime të përshtatshme gjatë orës së mësimi.

Gjithmonë jemi mësuar të dëgjojmë nxënës të shumtë të cilët ndjehen plotësisht të lodhur pas një ore mësimi dhe nuk kanë aspak dëshirë që të studiojnë. Përkundrazi kanë prituri me padurim mbarimin e orës së mësimi në mënyrë që të ndjehen sa më të çliruar nga ky angazhim që i jepet, mbi të gjitha një angazhim i padëshiruar. Një pjesë tjetër nxënësish, e konsiderojnë mësimin e historisë të pavlere me metodat e vjetra të mësimdhënies. Përballë një situatë të tillë, ndiej dëshirën dhe nevojën për të dhënë kontributin tim me anë të këtij punimi duke nxjerrë në pah vlerat e vërteta të përdorimit të mjeteve mësimore të përshtatshme gjatë procesit mësimor si pjesë e një mësimi sa me bashkëkohor.

Përdorimi i mjeteve mësimore përbën një nga elementët kryesorë në arritjen e suksesshme të transmetimit të dijeve nga ana e mësuesit duke i dhënë nxënësit motivimin e nevojshëm për të arritur rezultatet e duhura. Gjithashtu mbarëvajtja e orës mësimore përcaktohet edhe nga atmosfera e klasës, teknikat e kontrollimit , modeli i disiplinës dhe disponimi i nxënësve në ditën dhe orën e caktuar.

Mësuesit dhe nxënësit janë të vetëdijshëm për rëndësinë e përdorimit të mjeteve mësimore gjatë zhvillimit të një ore mësimi

Në shumicën e rasteve, aftësitë dhe shkathtësitë e mësimdhënësit janë natyrale ose edhe te përfituara nga mësimi ose përvoja gjatë jetës, por përballja me këtë formë të organizuar

të ideve mund ta provokoj për të mirë mendimin e tij për tu perfeksionuar edhe më shumë në metodologjinë tij për mësimdhënie të suksesshme.

Një rëndësi të vecantë ka përdorimi i përdorimit të mjeteve mësimorë. Për këtë duhet të kemi parasysh:

- ç'janë mjetet mësimore dhe qëllimi i tyre
- nga përvoja arsimore shqiptare në përdorimin e mjeteve mësimore
- sa efikas është përdorimi i tyre sot
- llojet që përdoren në lëndën e historisë
- kriteret pedagogjike për zhvillimin, zgjedhje dhe përdorimin e materialeve mësimore
- metoda Montessor

Të gjithë këto elementë do të na ndihmojnë të kuptojmë më mirë së si mund të arrihet mësimdhënia efektive nëpërmjet mjeteve mësimore.

Fletët e punës, shihen si dhe materialet e tjera ndihmëse të shkruara ose jo, kërkojnë aftësi për t'i përgatitur. Shpesh, është e rëndësishme që një përdorim i tillë kërkon veprimtari të bashkërenduar me kolegët e jo si diçka që mund të bëhet vetëm. Burime të këtij lloji janë përdorur edhe më parë dhe nëse ato hartohen për t'ju përshtatur mirë programit mësimor, të jenë në funksion të testeve diagnostikuese, formuese dhe përmbledhëse, atëherë koha e harxhuar për përgatitjen me cilësi të lartë të këtyre materialeve do të jetë me vlerë.

Para se të ndërmeret një përgatitje e tillë është mirë të hetohet vlera e mjeteve të tilla. Për këtë mund të shfrytëzohen edhe botimet e materialeve të tjera ndihmëse. Në përgatitjen e fletëve të punës, skedave apo materialeve të tjera të shkruara, cilësia dhe saktësia merr një rëndësi të madhe. Ato duhet të jenë të sistemuara, jo të mbingarkuara në informacion dhe të tërheqin më lehtë interes të nxënësve. Duhet theksuar se një vend të rëndësishëm në materialet që shërbejnë për zhvillimin dhe shpjegimin në klasë të një ore mësimi është edhe shkumësi. Ai mund të përdoret për dërrasën e zezë me anë të së cilit mund të demostrojmë shumë mënyra që nxënësit të jenë të aftë të përvetësojnë një orë mësimi.

Vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet përdorimit të gjuhës. Gjuha të mos shumë e thjeshtë por as shumë e vështirë për shkallën e aftësive të nxënësve.⁶⁰⁷ Fletët e punës dhe detyrat duhet të kenë ushtrime dhe detyra të shkallëzuara duke filluar nga ato më të thjeshtat, që synojnë në nxjerrjen e fakteve nga të cilat i jepet përgjigje pyetjeve të paraqitura, deri në materiale mjaft të ndërlikuara që synojnë t'u japin nxënësve mundësi për analiza e gjykime të pavarura.

Një shembull i tillë është një detyrë me diagram që përmbajnë përqindjet e ritmeve të zhvillimit të një dege të caktuar të prodhimit të një produkti të caktuar.

Materiale të tjera mund të përgatiten e planifikohen për punën me grupe. P.sh, përdorimi i dorëshkrimit të Aktit të Shpalljes së Pavarësisë, si burim dëshmie për interpretimin e një ngjarjeje të shënuar historike (e merr parasysh se kur dhe për kë është nënshkruar ai, rrethanat në të cilat u shpall Pavarësia etj.) Këtu zhvillimi i diskutimit në grup hedh dritë mbi idenë se çdo interpretim dhe vlerësim i çdo dëshmie apo burimi autentik përfshin edhe gjykime personale.

⁶⁰⁷ Musai, B. "Mjeshtëritë themelore të mësimdhënies". fq.45.

Materialet për vlerësim.

Përgatitja e aftësive gjithashtu përfshin nevojën për të përgatitur materialet për vlerësim. Në të vërtetë vëzhgimi i përparimit dhe arritjeve të nxënësve gjatë viteve të shkollimit kërkon që të mbahet e një dokumentacion i rregullt.

Përfshihen këtu testet diagnostikuese, formuese dhe përmbledhëse të zhvilluara në sekunca të caktuara të programit dhe pajisja më e madhe e vlerësimit bazohet në vëzhgimet e veprimtarisë së nxënësve në klasë.⁶⁰⁸

Kjo është e rëndësishme të lidhet me vëzhgimin e zhvillimit të aftësive, shkathtësive e shprehive të ndryshme të nxënësit të përcaktuara në programin mësimor. Kjo kërkon që të përgatiten vlerësime të përshtatshme dhe të përfshihen në planin ditor.

Për planifikimin e tyre mbajmë parasysh:

Së pari, sa nxënës do të vlerësohen në një mësim të caktuar?

Së dyti, çfarë procedurash do të përdoren për të vlerësuar nxënësit?

T'u thuhet nxënësve që do të zhillojnë një testim formues dhe nëse po, si do të përfshihet në dokumentacionin e mësuesit?

Në përcaktimin e materialeve vlerësuese që do të përdoren gjatë veprimtarisë në klasë, kujdes i veçantë duhet treguar që ato të shfrytëzohen me efektshmëri në dobi të të nxënët që parashikon mësuesi të arrijë.

Kjo përfshin jo vetëm vlerësimin e drejtë të asaj që ai ka ndërmend të vlerësojë por siguron edhe një vlerësim objektiv.

Çdo mësues, para se të përgatisë materialet dhe procedurat vlerësuese, mësuesi duhet të ketë të qartë natyrën dhe saktësinë e kërkuar për vlerësim.⁶⁰⁹

Vlerësime të tilla duhet të jenë të paanshme, të drejta dhe të ndërtuara në mënyrë të tillë që çdo nxënës të vlerësohet në të njëjtën mënyrë, pra të shmanget subjektivizmi sa më shumë të jetë e mundur.

Mbajtja e shënimeve.

Për mënyrën se si duhet të mbahen shënimet për vlerësimin ia vlen të diskutohet. Këto kërkojnë mendim të përparuar e duhet të përshtaten me shënimet e kolegëve të tjerë, që shënimet të jenë të qëndrueshme dhe koherente. Është e domosdoshme që ato të tregojnë progresin e nxënësve gjatë shkollimit të tyre.

Mbajtja e shënimeve të tilla duhet të bëhet normë e detyrueshme e punës së mësuesve dhe drejtorive të shkollave.⁶¹⁰ Kurrsesi ato nuk duhet të marrin trajtën e një dokumentacioni formal e të pavlefshëm.

Në praktikën shkollore, tekstet mësimore duhet të përdoren me qëllim që:

- t'u japin nxënësve informacione të vlefshme dhe të sakta;
- të ngjallin kureshtjen dhe të nxisin motivimin;
- t'u ofrojnë nxënësve material për punë të pavarur;
- të stimulojnë iniciativën e nxënësve dhe t'u japin "ushqim pëe ide të reja";
- të sigurojnë ushtrimet e aktivitetet e nxënësve për të zbatuar diturinë e marrë dhe shkathtësitë;

⁶⁰⁸ Musai, B. "Mjeshtëritë themelore të mësimdhënies", fq.46

⁶⁰⁹ Po aty, fq.46.

⁶¹⁰ Musai, B. "Mjeshtëritë themelore të mësimdhënies", fq.47.

- t'i stimulojnë nxënësit për t'i identifikuar e zgjidhur problemet në mënyrë krijuese;
- t'u ndihmojnë nxënësve të përfytyrojnë dhe të organizojnë informacionet në mënyrë sistematike;
- t'i sigurojnë veprimtaritë për përforcimin e arritjeve në mësim;
- të sigurojnë veprimtari me karakter ndërdisiplinor dhe ndërkurrikular.

Shkolla është "laboratori" më i rëndësishëm e i domosdoshëm, në të cilin duhet të kalojë domosdoshmërisht çdo njeri. Shkolla, si një pjesë e rëndësishme e jetës së njeriut, nuk mund të jetë gjë tjetër veçse një etapë e veçantë me shumë vlera, një sekuencë e "eksperimentit" të madh të jetës së çdo njeriu, në të cilin ka gjithmonë dy palë që eksperimentojnë njëra-tjetrën.⁶¹¹ Këto dy palë janë: njerëzit, nga njëra anë dhe jeta, në anën tjetër. Me qenë se shkolla ka mision që të përgatitë qytetarin e ardhshëm, të aftë për t'u përballë me çdo sfidë të jetës, apo të aftësojë atë që të "ecë" vetë për t'i dhënë vlera jetës e shoqërisë, mendoj se të mësuarit në shkollë, pra mësimi i dhënë tradicionalisht brenda njësisë klasike kohore, që është ora e mësimit, e, për rrjedhim kjo e fundit meriton një përqendrim vëmendje e pse jo, edhe të një harxhimi energjish më të mëdha, për ta parë atë si "laboratorin" e vërtetë, pra nxënësit dhe mësuesit me shumëllojshmërinë e teksteve e të përmbajtjeve të tyre, me botën, ndjenjat, gjykimet, metodat, mjetet, qëllimet e përvojat e tyre jetësore.

Ora e mësimit është pra, "laboratori" ku eksperimentohen në çdo etapë të saj, botët shpirtërore të nxënësve, me kompleksitetin e ndërlikuar të ndjenjave që kërkojnë të formohen dhe të orientohen drejt.

Çdo orë mësimi, ashtu si shkolla në tërësinë e vet, ka si qëllim që të ngrejë në nivelet më të larta mendjet e nxënësve dhe kjo mund të arrihet me përdorimin e mjeteve mësimore të ndryshme.

Të gjitha së bashku pra kurikula në tërësi e bazuar në dimensionet europiane e përshtatur sipas kërkesave të kohës do na cojnë në një dimension të ri bashkëkohorë në procesin e mësimdhënien.

Referencat

Kincheloe, Joe L. *Knowledge and Critical pedagogy*, Springer, 2008

McKimm, Judy. *Curriculum Design and Development*, 2003

Musai, Bardhyl. *Psikologji Edukimi, zhvillimi, të nxënësve, mësimdhënia*. Tiranë, 1999

Maththeës, Bob & Ross, Liz. *Research Methods – a practical guide for the social sciences*, Pearson 2010, London

Strategjia kombëtare e arsimit parauniversitar 2007-2013

⁶¹¹ Internet.

SFIDAT NË ADAPTIMIN DHE IMPLEMENTIMIN E POLITIKAVE EVROPIANE NË SISTEMIN POSTKOMUNIST SHQIPTAR

Dritan Palnikaj

Organizimi dhe funksionimi i shteteve është sa temë e zakonshme e studiuesve, por njëkohësisht dhe shumë komplekse. Kjo për faktin se sisteme politike të ndryshme kanë funksionuar në forma jo të njëjta nga njeri vend tek tjetri, në varësi të kushteve historike, sociale, ekonomike dhe mendësisë politike të shteteve. Ajo çfarë është arritur, janë sanksionimi i disa parimeve dhe karakteristikave bazë që bëjnë të dallueshëm qoftë dhe teorikisht një sistem qeverisës nga tjetri, zbatimi i të cilave i jep tiparet një qeverie duke e skematizuar atë demokratike ose jo. Instalimi i një sistemi qeverisës është një proces i vazhdueshëm integrimi i cili merr jetë nëpërmjet përbaljes me sfida të ndryshme dhe suksesi i tij është i kushtëzuar pikërisht nga kapërcimi dhe zgjidhja e këtyre sfidave.

Shqipëria post komuniste zgjodhi sistemin parlamentar të qeverisjes si një ndër modelet më demokratike të mara nga Evropa, si nevojë e një qeverisje me rrotacion e dalë nga konkurrenca e partive politike. Por parlamentarizmi në Shqipëri është zhvilluar në etapa të ndryshme edhe pse nuk mund të shprehem se ka një histori të gjatë, implementimi dhe zhvillimi të tij në Shqipëri. Ai është shfaqur në forma të ndryshme me karakteristika të veçanta dhe të dallueshme në varësi të kushteve historike. Megjithatë ashtu si çdo proces edhe parlamentarizmi në vendin tonë ka evoluar drejt demokratizimit dhe zhvillimit të mëtejshëm. Në Shqipëri sistemi parlamentar ndonëse me kufizime, fillon me krijimin e Shtetit të Pavarur Shqiptar 1912.⁶¹² Aktet e para legjislativë u sanksionuan në vendimet e Kuvendit Kombëtar të Vlorës, i cili përfaqësonte organin më të lartë të shtetit dhe ishte shprehës i vullnetit të gjithë kombit. Kuvendi Kombëtar në fakt ishte vetëm embrioni i një parlamenti të vërtetë. Megjithatë ai kreu me sukses detyrën kryesore për të cilën ishte mbledhur; shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë dhe krijimin e tërë mekanizmit të domosdoshëm të shtetit.⁶¹³

Ishte eksperiencia e gjatë nën diktaturën komuniste që diktoi këtë zgjedhje. Ekzistenca e një parlamenti fantazmë në periudhën e monizmit dhe përqendrimi i pushtetit në duart e partisë - shtet tregoi humbjen e vlerave demokratike të parlamentarizmit. Periudha e monizmit u karakterizua nga një diktaturë e cila e çoi vendin në një prapambetje institucionale, por dimensionaliteti i këtij ndikimi negativ të komunizmit u shtri në të gjitha fushat e veprimtarisë së shoqërisë shqiptare, pasojat e të cilit ndihen dhe sot.

⁶¹² Luan Omari, *Sistemi parlamentar*, Tiranë 2004, fq. 153

⁶¹³ *Po aty*, fq. 156

Ideologjia komuniste, kontrolli i plotë i shtetit, i mediave, eliminimi i te drejtave të njeriut, regjimi policor janë elementët thelbësor të diktaturës komuniste, pjesë e eksperiencës së hidhur që shërbeu si mësim për të mos u kthyer mbrapa, por për të përkrahur dhe vendosur në Shqipëri demokracinë parlamentare. Frika nga diktatura e së kaluarës, bëri që shqiptarët ta përkrahin sistemin parlamentar si forma më e mirë e qeverisjes, duke u shmangur kështu nga monarkia apo sistemi presidencial.

Një sistem i ri demokratik kërkonte medoemos të funksiononte mbi bazën e një ligji themeltar e cila është kushtetuta. Tipari i vendeve evropiane me demokraci të konsoliduar është nënshtrimi i politikës ndaj kushtetutës. Nisur nga kjo, një tjetër sfidë ishte tejkalmi i krizës kushtetuese nëpërmjet nxjerrjes së një Kushtetute të re. Në 1992 u ngrit një komision për hartimin Kushtetutës. Por ky proces solli përçarjen midis pozitës dhe opozitës. Partia Demokratike angazhohej që Kushtetuta e re të përcaktonte një pushtet të fortë ekzekutiv duke forcuar kompetencat e Presidentit, e ngjashme kjo me modelin francez ose atë të SHBA-së, pra një sistem të kombinuar parlamentar dhe presidencial. Opozita me në krye Partinë Socialiste dhe Socialdemokrate, këmbëngulnin për një model tipik parlamentar, ku roli i Presidentit të ishte formal. Nga ana tjetër nevoja e hartimit të Kushtetutës ishte imediate, meqë Shqipëria ishte i vetmi vend post-komunist që nuk kishte arritur të nxirrte Kushtetutën e re që pas rrëzimit të diktaturës. Shqipëria në këtë periudhë ishte nën presionin e brendshëm dhe të jashtëm, pasi Këshilli i Evropës kushtëzonte anëtarësimin e Shqipërisë, me një Kushtetutë të re. Komisioni arriti të përfundonte tekstin e projekt Kushtetutës por ajo në 1994 u rrëzua me referendum. Më 28 Nëntor 1998 hyri në fuqi Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e cila nga organizmat evropiane u vlerësua si në pajtim të plotë me standardet evropiane. Megjithatë, përgjegjësia e një shteti nuk mbaron me hartimin e kushtetutës, por ajo rritet më nënshtrimin ndaj rregullave që e përbëjnë atë. Një kushtetutë demokratikë synon jo vetëm vendosjen e themeleve të institucioneve të shtetit, por edhe kufizimin e ushtrimit të pushtetit prej këtyre institucioneve.⁶¹⁴ Stabiliteti i saj është një vlerë e madhe kushtetuese, një nga parakushtet e vazhdimësisë së shtetit.⁶¹⁵

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, përcakton shprehimisht kompetencat respektive të institucioneve ekzekutive, legjislativë dhe gjyqësore duke respektuar parimin e ndarjes së pushteteve. Megjithëse parimi i ndarjeve të pushteteve ka një origjinë moderne, edhe në kohën e lashtësisë mendimtarë të ndryshëm janë përpjekur të numërojnë dhe të klasifikojnë shfaqjet e ndryshme të fuqisë së shtetit. Një nga këta mendimtarë ishte Aristoteli i cili dallonte tri veprime kryesore të organeve shtetërore: vendimin, urdhërimin, drejtësinë...⁶¹⁶ Gjithashtu, mendimtari i shquar francez Montesquje (Charles de Montesquieu 1689-1755), në veprën e tij të mirënjohur "De l'esprit de lois" botuar më 1748,⁶¹⁷ shtroi për herë të parë nevojën e ndarjes dhe respektimi të këtij parimi në sistemin e brendshëm të çdo shteti të veçantë, pasi përmes tij bëhet e mundur të shmangët abuzimi me pushtetin dhe ushtrimi arbitrar i tij.⁶¹⁸ Realizimi konkret i këtij

⁶¹⁴ Fondacioni Moisiu, Realiteti i sotëm shqiptar dhe sfidat e ardhshme kushtetuese ligjore, Sokol Sadushi, Drejtësia kushtetuese sot dhe neser, Tiranë 2012, fq. 134

⁶¹⁵ Po aty, fq. 130

⁶¹⁶ Luan Omari, *Shteti i së drejtës*, Tiranë 2004, fq.17

⁶¹⁷ Charles de Montesquieu, *De l'esprit de lois*, Libre II, Chap.II, cituar në Zaganjori XH., *Demokracia dhe Shteti I së Drejtës*, fq. 99

⁶¹⁸ Xhezair Zaganjori, Aurela Anastasi, Eralda (Methasani) Çani, *Shteti i së drejtës në kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*, Tiranë 2011, fq.28-29

parimi në Kushtetutë dhe në praktiken e përditshme, sigurisht që varet nga disa faktorë, si natyra e shtetit dhe madhësia e tij, forma e qeverisjes, trashëgimia shtet formuese, ekonomike dhe kulturore e të tjerë.⁶¹⁹ Në Shqipëri, pavarësisht përcaktimeve në kushtetutë, realizimi praktik i parimit kushtetues të ndarjes dhe balancës së pushteteve ka qenë i vështirë. Nga një vend me traditë të drejtimit 50 vjeçar të një partie kalohej në modelin e ndarjes së pushteteve, ndalimit të rolit dhe ndikimit të partisë në shumë institucione dhe vendimmarrje, në qeverisje me ekip, etj. Ajo çfarë ndodh në realitetin e politikës shqiptare është cenimi i herë pas herëshëm i këtij parimi demokratik. Kështu qeveria duke qenë se del nga partia që ka fituar shumicën e votave në zgjedhjet elektorale apo koalicioni që ka fituar shumicën e votave, përbën njëkohësisht shumicën në parlament, duke dominuar në këtë formë dhe legjislativin pasi e kanë të lehtë të miratojnë ligjet edhe pa votat e opozitës. Nga ana tjetër, zgjedhja e Presidentit të Shqipërisë bëhet nga parlamenti dhe Presidenti është kryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Fenomeni që vihet re ndër vite si në qeveritë që drejtohen nga e majta ashtu dhe nga qeveritë që drejtohen nga e djathta, roli i Presidentit në gjyqësor ka qenë përcaktues. Ajo, çfarë dua të them është se në varësi të forcës politike nga e cila ka dalë zgjedhja e Presidentit, ajo forcë politike ka pasur ndikim në gjyqësor, kryesisht në promovimin e gjyqtarëve, në emërimin e drejtuesve të gjykatave dhe prokurorive, plotësimin e vendeve vakant në Gjykatën e Lartë apo Gjykatën Kushtetuese.

Duhet pasur parasysh se ndarja e pushteteve nuk është vetëm një kriter ndarjeje kompetencash, por lidhet edhe me garantimin e të drejtave, duke qenë një parim thelbësor i tij. Prandaj shumica e kushtetutave evropiane i kushtojnë një kapitull "pushtetit gjyqësor".⁶²⁰ Në Kushtetutën e Shqipërisë përcaktohet se "gjykatat janë të pavarura dhe nënshtrihen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve".⁶²¹ Analiza e dispozitave kushtetuese të çon në konkluzionin se ato sigurojnë pavarësinë e gjyqtarëve nga ndërhyrjet e pushteteve të tjera, duke rregulluar edhe mardhënie të drejta hierarkike ndërmjet gjykatave të shkallëve të ndryshme.⁶²²

Por kjo pavarësi nga organet e tjera shtetërore nuk do të kishte efektin e duhur në rast se gjyqtarët nuk do të ishin të imunizuar nga presione të tjera, të paligjshme që mund të ushtrohen ndaj tyre. Rastet e korrupsionit në gjykata nuk kanë qenë të pakta në këtë dhjetëvjeçar të tranzicionit postkomunist, siç e dëshmojnë denoncimet në shtyp dhe sidomos vendimet që janë marrë herë pas here nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë ndaj gjyqtarëve që kanë dhënë gjykime të kundërligjshme, prapa të cilave dyshohej se kishte shfaqje korrupsioni. Është e qartë se një gjyqtar i joshur nga oferta për pasurim të paligjshëm nuk mund të jetë kurrsesi i pavarur në gjykimin e çështjes penale ose civile. Lufta kundër korrupsionit, që nuk është i pranishëm vetëm në gjykata, por edhe në sektorë të tjerë të veprimtarisë publike, është një luftë afatgjatë, por e domosdoshme dhe vendimtare për të siguruar ekzistencën e një drejtësie të vërtetë dhe të një shteti juridik mbi baza të shëndosha.⁶²³ Si përfundim mund të them se ka disa faktorë që kanë ndikuar në shfaqjen e problemeve në gjyqësor të tilla si mospërshtatja e sistemeve të adaptuara në

⁶¹⁹ Po aty, fq. 30

⁶²⁰ Luan Omari, *Shteti i së drejtës*, Titanë 2004, fq.65

⁶²¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 145

⁶²² Luan Omari, *Shteti i së drejtës*, Titanë 2004, fq.152

⁶²³ Po aty, fq. 152-153

realitetin shqiptar, mosrespektimi i parimeve kushtetuese, mungesa e profesionalizmit të gjyqtarëve, problemet institucionale etj.

Një tjetër sifidë për demokracinë parlamentare në Shqipëri ishte ndërtimi i raporteve në mes pozitës dhe opozitës. Në periudhën e viteve 1992-1996, Partia Demokratike kishte epërsi mbi partitë e tjera sepse kishte mazhorancë absolute në parlament, kështu: Partia Demokratike kishte 92 vende në parlament, Partia Socialiste 38 vende, Partia Socialdemokrate 7 vende, kurse vendet e tjera; Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, Partia Republikane dhe parti të tjera të vogla.⁶²⁴ Kjo epërsi i mundësoi PD të formojë dhe të drejtojë ekzekutivin duke marrë kështu përsipër drejtimin dhe zhvillimin e vendit. Megjithëse i jepte mundësinë për të udhëhequr plotësisht vendin, kjo kishte dhe anën tjetër të medaljes sepse kjo parti i ekspozohej rrezikut të dështimit, për shkak të trashëgimisë së të kaluarës, situatës politike, ekonomike dhe sociale në vend. Raportet pozitive - opozitë, në Shqipëri nuk arritën të reflektojnë një kulturë parlamentare. Opozita në të shumtën e rasteve zgjidhte bojkotin si metodë veprimi brenda parlamentit, dhe nga ana tjetër në veprimin jashtë institucional me nxitjen e krizave politike, ekonomike, sociale me qëllim të nxitjeve të zgjedhjeve të parakohshme. Nga ana tjetër gjatë zgjedhjeve elektorale, pala humbëse akuzonte palën tjetër për abuzim, manipulim etj. Ky fenomen u bë i vazhdueshëm duke krijuar kështu një imazh negativ për Shqipërinë në arenën ndërkombëtare e cila e shikonte me dyshim aftësinë e shtetit shqiptar për të ndërtuar një shoqëri të qëndrueshme demokratike. Hapi i parë në këtë drejtim mund të hidhet duke u ndërtuar besimi i ndërsjellë midis palëve me përjashtimin e gjuhës së drunjtë të urrejtjes dhe pranimit në parim se asnjëra palë nuk është kundër integritetit të vendit.⁶²⁵ Rëndësia e opozitës në një sistem është shumë e madhe. Modelet e ekzistencës, veprimit dhe funksionimit të opozitës në sistemet demokratike të qeverisjes i japin asaj një funksion të rëndësishëm në zhvillimin e demokracisë dhe ndërtimin e shtetit të së drejtës. Për praninë e saj kërkohet klimë e moderuar politike, shanse të barabarta për zgjedhje dhe hapësirë për veprim e shprehje qëndrimesh, kushte që janë tërësisht të realizueshme vetëm në një sistem të demokracisë moderne.⁶²⁶

Në një shtet demokratik ka shumë rëndësi mjete me të cilët qytetarët shprehin vullnetin e tyre. Ky mjet janë zgjedhjet e lira dhe demokratike. Janë një sërë faktorësh që përcaktojnë zgjedhjet demokratike si psh. ekzistenca e konkurrencës së lirë dhe të barabartë e partive politike duke shmangur ndërhyrjet e qeverisë në garën elektorale, periodiciteti i zhvillimit të tyre, pjesëmarrja e lartë e qytetarëve në zgjedhje, baza ligjore mbi të cilën ngrihet e drejta e votës, roli i medias në informimin sa më të saktë duke shmangur njëanshmërinë etj. Debate të shumta kanë karakterizuar ndër vite zgjedhjet në Shqipëri për shkak të problemeve të ndryshme. Sipas opinionit publik në tërësi, sipas vlerësimit të vetë partive politike, (pavarësisht interesit të tyre të rastit), por më shumë sipas vëzhguesve ndërkombëtarë, vlerësimet e të cilëve janë të gjithë-pranuara, mundet të thuhet se problematika e zgjedhjeve në Shqipëri ka si shkak të saj, përveç vullnetit të munguar të partive politike pjesëmarrëse edhe sistemin e administrimit të zgjedhjeve.⁶²⁷ Kjo gjë nuk ka ardhur vetëm nga vullneti dobët i palëve për të zhvilluar zgjedhje të lira

⁶²⁴ Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr.2/92, f.99

⁶²⁵ www.shqiperialine.tv/shkenca-politike/sfidat dhe e ardhmja e demokracisë, parë për herë të fundit me dt. 11.07.2014

⁶²⁶ Afrim Krasniqi, *Partitë politike dhe sistemet politike*, Tiranë 2008, fq.243

⁶²⁷ ⁶²⁷ Fondacioni Moisiu, *Realiteti I sotëm shqiptar dhe sfidat e ardhshme kushtetuese ligjore*, Sokol Sadushi, Drejtësia kushtetuese sot dhe neser, Tiranë 2012, fq. 160

ashtu siç është dëshmuar prej kohësh në raportet dhe rekomandimet e OSBE dhe ODIR-it për ti përmirësuar pasi i kanë certifikuar ato, por edhe në kulturën e dobët demokratike të Shqipërisë në këtë drejtim.⁶²⁸

Gjithsesi edhe pse kalimi i Shqipërisë nga një vend totalitar në një vend të lirë dhe demokratik ka kaluar përmes një procesi të vështirë që ka dëmtuar shumë rëndë imazhin e vendit, është pranuar gjerësisht nga partnerët tanë ndërkombëtar se Shqipëria në këto 20 vjet tranzicioni politik ka arritur një progres të pranueshëm demokratik për tu pranuar në institucionet euro-atlantike si është NATO dhe për tu anëtarësuar brenda kësaj dekade në Bashkimin Evropian.⁶²⁹ E ndeshur me politikën e mbylljes totale në raport me bashkësinë ndërkombëtare, Shqipëria ndër prioritetet e saj kishte hapjen ndaj komunitetit ndërkombëtar, aderimin dhe integrimin në shumë mekanizma ndërkombëtare. Që në fillim të tranzicionit Shqipëria rivendosi marrëdhënie diplomatike me shumë shtete, dhe filloi gjithashtu procesin e integritimit drejt institucioneve evropiane dhe euroatlantike. Në rrugën e saj të bashkëpunimit rajonal dhe evropian, Shqipëria është përballur me shumë sfida siç ishte ngjarja e pranverës së 1997 e cila frenoi marrëdhëniet me shumë vende. Gjithashtu dhe lufta e Kosovës krijoi probleme duke qenë se Shqipëria kishte një rol të dukshëm dhe qeveritë evropiane treguan shumë vëmendje dhe kujdes ndaj saj.

Si përfundim, realizimi praktik i parimit kushtetues të ndarjes dhe balancës së pushteteve. Nga një vend me traditë të drejtimit 50 vjeçar të një partie kalohej në modelin e ndarjes së pushteteve, ndalimit të rolit dhe ndikimit të partisë në shumë institucione dhe vendimmarrje, në qeverisje me ekip, etj. Institucioni i zgjedhjeve, bazë e sistemit demokratik, nuk ka qenë gjithnjë funksional. Këto ishin dhe mbeten ende sfidat më të mëdha. Ende sot ka mosmarrëveshje midis institucioneve dhe pushteteve për shkak të aplikimit me mangësi të këtij parimi kushtetues, i cili qëndron në themel të modelit të demokracisë parlamentare. Në tjetër sfidë ishte dhe dizenjimi institucional sepse ato u morën shabllon nga modelet e vendeve të tjera pa u preokupuar nëse këto ishin të përshtatshme për kushtet e Shqipërisë. Sfidat kanë qenë nga më të ndryshmet duke filluar që nga mungesa e një kulture demokratike, që mungon në Shqipëri. Mosfunksionimi i elitave dhe vullneti për të akumuluar pushtetin në duar e tyre, kjo më e theksuar tek Partia Demokratike në disa raste dhe tek Partia Socialiste sepse kjo është treguar më neglizhente. Dizenjimi i institucioneve nuk është bërë që të kemi institucione demokratike por për ti shërbyer një qëllimi të caktuar, të një personi apo një partie. Kjo ka lidhje padyshim me eksperiencën e së kaluarës, me një traditë rashmë të akumuluar të forcave elitare nga shembujt e partisë - shtet të periudhës së komunizmit. Duke treguar kështu mungesë të theksuar të kulturës demokratike dhe zbatimit të principeve të saj.

⁶²⁸ www.shqiperonline.tv/shkenca-politike/sfidat dhe e ardhmja e demokracisë, parë për herë të fundit me dt. 11.07.2014

⁶²⁹ Po aty

PRONËSIA NË MYZEQE SIPAS REFORMËS AGRARE 1945 - 1990

Elona Gjellaj

Pedagoge e Shkencave Politike

gjellaj.elona@yahoo.com

“Çdo familje fshatare në ekonominë ndihmëse kishte edhe disa bagëti, prodhimtaria e të cilave, për shkak të mbarështimit thjeshtë natyror ishte i ulët”.⁶³⁰

Shqipëria ishte një vënd thellësisht agrar, ku 90% e popullsisë jetonte dhe punonte në fshat. Ekonomitë çifligare synonin të siguronin të ardhura pa bërë investime për tokën. Çlirimi i Shqipërisë nga nazifashistët në vitin 1944 e gjeti Shqipërinë me 14% të ekonomive fshatare pa tokë, në një kohë kur 3% e ekonomive të pronarve të tokave dhe të shtetit kishin 40% të sipërfaqes, që pjesën më të madhe nuk e punonin vetë. “Rreth 1/4 e popullsisë fshatarëve punonte tokën e pronarëve të tjerë, sepse kishin pak ose ishin fare pa tokë. Në të njëjtën kohë, një pjesë e mirë e fshatarëve pronarë kishtë në dispozicion ngastra shumë të vogëla tokë. Mbi 40% e ekonomive bujqësore kishin nga 0.31 hektarë gjer 0,68 apo 1 hektar, që në tërësi nuk arrihej as 8 % e sipërfaqes së përgjithëshme e tokës”.⁶³¹ Me çlirimin e vendit lindi detyra për ndërtimin e tij. Ndërtimi i rendit socialist kërkonte reforma të thella. Kryerja e reformës është një punë e vështirë dhe e koklavitur e cila për zbatimin e saj duhet të ndërtuar një aparat i ri. “Për realizimin e këtij synimi të tillë qeveria e sapo krijuar ndërmori disa hapa paraprake të cilat do të çonin më vonë në një reformë përfundimtare për tokën.”⁶³² “Prandaj Ministria e Ekonomisë po bënë përpjekjet më të mëdha për të arritur një ndarje sa më të mirë të jetë e mundur.”⁶³³ Në një urdhëresë të posaçme të datës 21.06.1945 del për komitetet fshatare. “Qëllimi i komiteteve është:

Të zbulojë të gjitha tokat e shtetit, dhe të tradhëtarëve të popullit t’u gjejë kufijtë e vërtetë të përcaktojë sa më qartë sipërfaqen e tyre.

Të regjistrojë çifligjet e madhe private duke pare gjendjen e tyre kulturore.

Të regjistrojë familjet fshatare të viseve ku mungon toka dhe që duan të shpërngulen e të instalohen në vise ku ka tokë tepër.

⁶³⁰ Po ary

⁶³¹ Akademia e Shkencave Instituti i Historisë, *Historia e popullit Shqiptar*, vëllimi IV, Tiranë: Toena, 2008, f. 179

⁶³² Paskal Haxhi, *E drejta Agrare e Shqipërisë*, Tiranë: Albin, 2005, f. 54

⁶³³ *Gazeta Bashkimi*, E diel 1 korrik 1945, viti II Nr 160, f. 3

Të ndihmojë në ndarjen e tokave ndër fshatarët sipas numrit të frymëve dhe kualitetit të tokës.”⁶³⁴

“Pas diskutimesh të shumta dhe pasi ishin bërë përgatitjet e nevojshme Kryesia e Këshillit Antifashistë Nacional Çlirimtar më 29 gusht 1945 shpalli Ligjin mbi Reformën Agrare.”⁶³⁵

U dhanë disa pika paraprake të cilat ishin kryesore të Ligjit mbi ndarjen e tokave.

“ 1- Bujqit që ndodhen në pronat që shpronësohen në bazë të këtij Ligji zgjidhen nga çdo detyrim kundrejt pronarëve të deriatëhershëm e kundrejt cdo të treti që zë vëndin e pronarit.

2- Bujqit që ndodhen në pronat që shpronësohen në bazë të këtij ligji vazhdojnë të punojnë për llogari të vetë tokat që kanë për derisa të zbatohet Ligji mbi Reformën Agrare. Ata nuk kanë të drejtë ti shesin, ti japin me qira, ti ndërrojnë ose ti hipotekojnë.”⁶³⁶ Në këtë Projekt- Ligj u përcaktuan edhe cila toka goditen nga shpronësimi dhe përjashtimet.

Neni 1

Me shpalljen e kësaj Ligji shpronësohen detyrimisht në favor të fshatarëve nënshtetas shqiptarë që s’kanë tokë të tyre ose nuk u mjafton toka.

- 1)Çifligjet e Shtetit
- 2)Pronat bujqësore private dhe Enteve private dhe Fetare.
- 3)Pronat bujqësore të konfiskuara përgjithësisht.
- 4) Tokat e instaluar nga Reforma Agrare e regjimit të Zogut ose nga ish Drejtoria e Imigracionit, kur tokat janë braktisur nga të instaluarit.
- 5) Ullinj të konfiskuara.
- 6) Vreshtat dhe pemishtet e konfiskuara.

“ Kur në një familje bujqësore numri i pjesëtarëve kapërcejnë të 6 frymëve dhe nuk mund të ketë vënd shtesa prej 3 hektarë, atëherë për cdo frymë më tepër shtohet dhe gjysmë ha”.⁶³⁷ Në rast se cilësia e tokës është e keqe asaj i shtohen 50% në rast se kur kjo cilësi është e mirë i zbritet deri në 30%. Çdo familje bujqësore përveç sipërfaqes së llogaritur si më sipër i jepet edhe 30 arë për truall shtëpie. Në qoftëse bujku që shpronësohet dhe punon tokën dhe zotëron pasuri private i njihet zotërimi në tokën e shpronësuar vetëm në masën për të plotësuar sasinë që i lihet çdo familje bujqësore në bazë të frymëve së kësaj ligje.

Në literaturën e shumtë që shfletuam ajo që më ra në sy ishin këto raporte justifikuese për zbatimin e Reformës Agrare. Ky ligj sipas këtij raporti justifikues do të bëjë që të zhduken format më flagrante të parasitizimit dhe të sigurimit të një jetese të rëhatshme nga të ardhurat të hazërta e të bollshme . Ja si jepet pak arsytim për pikat themelore të këtij ligji:

I “Mbi shpronësimet: Ligji shqyrtonte zhdukjen e sistemit të çifliqeve të mëdha shtetërore e private dhe çliron nga zgjedhja fshatarë-bujq që kanë vaditur ato toka gjatë kohëve me djersë dhe gjakë”⁶³⁸.

⁶³⁴ Po aty

⁶³⁵ Akademia e Shkencave Instituti i Historisë , *Historia e popullit Shqiptar*, vëllimi IV, Tiranë: Toena, 2008, f. 185

⁶³⁶ AQSH, F.494, V. 1945, D. 766, F. 2

⁶³⁷ AQSH, F.494, V. 1945, D. 150, F. 4

⁶³⁸ AQSH, F. 490, V. 1945, D.150, F. 17

Ligji siguron integritetin, madje edhe shtimin e fermave dhe fidanishteve shtetërore që shërbejnë si model për përmirësimin dhe ngritjen e nivelit të bujqësisë sonë të prapambetur. Çështja që të bie në sy dhe të bënë shumë përshtypje është:

II. – Mbi sipërfaqen e tokës që u koncidohet fshatarëve dhe preferimi i këtyre në pronësim. Mund të bjerë në sy si e pamjaftueshme sipërfaqja që caktohet për çdo familje bujqësore për të çliruar fshatarin dhe ngritur nivelin e tij eko-shoq. Është vendosur kështu në këtë pikë për këto arsye:

Karakteristika e ndarjes proporcionale të tokave në vendin kemi toka të mirë e mesatare dhe të copëtuara midis fshatarëve të shumtë që nuk arrijnë të plotësojnë nevojat ushqimore ose latifontet të punuara pjesërisht”.⁶³⁹

Çifligjet kryesore janë në Lushnje, Fier dhe Berat me respektivisht 2000, 1533 dhe 600 bujq.

“Ndarja e tokës së shtetit sipas kulturave është kjo:

| | |
|--------------------------|---------------------------------------|
| Ara 13917 ha = 21.2% | pyll 14501 ha = 22.1% |
| Çaire 1652 ha = 2.5% | të grabitura 5240 ha = 8.0% |
| Kullota 27509 ha = 41.9% | këneta 2817ha = 4.3%”. ⁶⁴⁰ |

Është për të rieluar sasia e grabitur gjatë kohëve me 8% po që sigurisht do të jetë e madhe. “Pjesa e arave në sipërfaqen e përgjithshme, me 21,2% dhe kullotat me 41, 9% tregojnë nivelin e ulët të bujqësisë në tokat e shtetit”.⁶⁴¹

“Bujqëve u takon për frymë në ha:

| | Lushnje | Fier | Berat |
|----------------|---------|------|-------|
| Tokë buke | 0.42 | 0.32 | 0.35 |
| Kullota, çaire | 0.81 | 0.48 | 0.99 |
| Së bashku: | 1.23 | 0.80 | 1.34 |

Këto të dhëna tregojnë se në Fier ka tokë më pak se sa duhet”.⁶⁴²

Vendosja e Demokracisë në Shqipëri shtruhej si problem të mprehtë dhe të rëndësishëm rregullimin e marrëdhënieve Agrare, veçanërisht vendosjen e një regjimi juridik të ri për tokën që ti përgjigjej ekonomisë së lirë të tregut.

“Tokat në Shqipëri deri në 1990 ishte pronë ekskluzive e shtetit dhe mbrojtja e saj ishte detyrë e organeve shtetërore, ndërmarjet dhe kooperativat bujqësore, organizatave shoqërore dhe shtetërore.”⁶⁴³ Ajo është në përdorim shoqëror të atyre ose në përdorim vetjak të shtetasve kudo që ndodheshin në fshat, qytet qendra të banuara. U ndërmorën një sërë masash organizative dhe legislative.

“Hapi i parë në këtë drejtim ishte miratimi nga parlamenti i parë pluralist i Ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese” ku saksionohej se ekonomia e vendit bazohet në shumëllojshmërinë e pronave, iniciativën e lirë për të gjithë subjektet ekonomike.”⁶⁴⁴ “Në bazë të ligjit Kushtetues Parlamenti miratoi ligjin nr 7501 dt. 19.07.1991 “Për Tokën”.⁶⁴⁵ Sipas këtij ligji toka ndahet në:

⁶³⁹Po aty, F. 18

⁶⁴⁰Po aty

⁶⁴¹AQSH, F. 494, V. 1945, D.766, F. 29

⁶⁴² Po aty, F. 30

⁶⁴³ Paskal Haxhi, *E drejta Agrare e Shqipërisë*, Tiranë: Albin, 2005, f.87

⁶⁴⁴ Po aty

⁶⁴⁵ Po aty

“ a) Toka bujqësore të zëna me bimët e arrive, pemishtet, vreshtat dhe ullishtet, kudo që ndodhen, në fshatra, në qytete e në qendra të tjera të banuara, pavarësisht nga madhësia e tyre;

b) toka të zëna me pyje, kullota e lidhave;

c) toka jobujqësore: ato të zëna nga ndërtimit ekonomike, social- kulturore, repartet ushtarake dhe oborret e tyre, tokat e zëna nga udhëtimet e banimit dhe oborret e tyre, tokat në përdorim të përgjithshëm (rrugët autostradat, varrezat)

vëndet shkëmbore, rërat bregtetare, plazhet; tokat ujore (liqenet, rezervuarit, kanalet e ndryshme, lumenjtë, përrenjtë, zallishtet, kënetat; sheshet e ndërtesave e monumenteve me interes historik e arkeologjik si dhe të gjitha tokat e tjera që nuk përfshihen në pikat a dhe b”. Shteti u jep tokë personave fizikë a juridikë. Këta gëzojnë të drejtën e pronësisë mbi sipërfaqen e tokës dhe të gjitha të drejtat që përmbahen në këtë ligj. Ndalohet shitja dhe blerja e tokës.

“ Sipas V.K.M.nr 255 trajton kriteret e ndarjes së tokës.

Kriteret bazë janë:

-Përcaktimi i normativës për frymë;

-Qënia me banim në fshat;

-Qënia antarë i kooperativës;

-Numër i antarëve të familjes më 1 gusht vitit 1991”⁶⁴⁶

Në datë 07.03.2006 Komisioni Qeveritar i Tokës analizoi ecurinë e Reformës së ndarjes së Tokës, Tapive dhe konfliktet për Qarqet; Shkodër, Vlorë, Fier duke përcaktuar dhe detyra konkrete sipas një plani vjetor.

“ Për Qarkun Fier problematike u cilësua përgatitja dhe ndarja e akteve në pronësi për 2620 ha ose total 2112 tapi.”⁶⁴⁷

Por në punën e këtyre komisioneve konstatova që haseshin shumë vështirësi të cilat janë:

1.Në formularin Nr. 6 dhe Aktit të marrjes së tokës në pronësi janë shkruar me gabime emri, atësia, mbiemri.

2.Ka mospërputhje të sipërfaqes së tokës midis formularit Nr. 6, Aktit të marrjes në pronësi dhe faktit në terren.

3.Ka ndryshime të numrit kadastral në Aktin e marrjes në pronësi me atë aktualisht në terren, krahasuar me hartën kadastrale.

4.Mospërputhje të kufizimeve të shkruara në Aktin e marrjes së tokës në pronësi me tokën në terren.

Në të gjitha këto, unë mendoj se ka ardhur momenti ku ky ligj Nr. 7501, dt. 19.07.1991 të arkivohet dhe t’ia lerë vendin një ligji tjetër ku të bëhen të gjitha rregullimet e nevojshme dhe të shmangen sa më shumë konfliktet e krijuara.

⁶⁴⁶ Paskal Haxhi, *E drejta Agrare e Shqipërisë*, Tiranë: Albin, 2005, f. 95

⁶⁴⁷ Kadastra e Qarkut Fier, *Reforma e Tokës*, f. 9

RRETHANAT DHE FAKTORËT QË FAVORIZUAN KTHIMIN E AHMET ZOGUT NË PUSHTET SIPAS HISTORIOGRAFISË SË HUAJ

Elona Kazazi

Shqipëria në fillim të viteve '20 ishte një vend që po përpiqej të ruante pavarësinë e territoreve të saj pavarësisht kompromiseve dhe pazarllëqëve të shumta të Fuqive të Mëdha. Sikur të mos mjaftonin problemet me shtetet fqinjë dhe më gjere, vendi po përballej edhe me vështirësi të shumta në fushën ekonomike, diçka mëse normale duke marrë parasysh rrethanat në të cilat ndodhej shteti shqiptar. Në lidhje me gjëndjen në të cilën ndodhej Shqipëria në këto vite, në një vepër të njohur të tij studiuesi Bernd Fisher shkruan: "Shqipëria ishte e përçarë jo vetëm në aspektin racor dhe gjuhësor, në bazë të të cilëve, ishte ndarë midis toskëve në jug, dhe gegëve në veri por edhe në aspektin fetar, pasi ekzistonin tre grupe të mëdha fetare, që përfshinin myslimanët sunitë dhe bektashinj, katolikët dhe ortodoksët", ndërkohë që unë nuk jam aspak dakord me atë që thuhet më sipër sepse shqiptarët asnjëherë nuk kanë patur përçarje racore, gjuhësore dhe aq më pak fetare. Mund të them se lidhur me këtë aspekt Shqipëria ka qënë një shtet shembull.

Ky është terreni i përgjithshëm mbi të cilin u zhvillua jeta politike e këtyre viteve, në të cilën do të spikatëshin dy figura kryesore: Ahmet Zogu dhe Fan Noli.⁶⁴⁸ Në lidhje me figurën e Zogut mund të themi se karriera politike e tij kishte qënë shumë e shpejtë. Ahmet Zogu kishte kjuar reputacionin e tij politik si një komandant i guximshëm në periudhën që pasoi menjëherë pas Luftës së Parë Botërore, kur ai kishte udhëhequr malësorët luftëtarë të fisit të tij në luftë me pushtuesit e huaj në një kohë kur shumë udhëheqës të vjetër politikë ishin përfshirë nga paniku.⁶⁴⁹ Gjatë kësaj periudhe ai do të jetë shumë herë ministër i brendshëm dhe herë-herë kryeministër në kabinetet e njëpasnjëshëm.

Më 1920 kur ishte 25 vjeç, u bë ministër i brendshëm në qeverinë shqiptare të dalë nga Kongresi i Lushnjës. Ai kishte pozitën e liderit të forcave konservatore që u kundërvihën atyre reformiste, të cilat më 1924, mundën të krijojnë qeverinë jetëshkurtër të Fan Nolit. Më 24 dhjetor 1922 Zogu e shpalli veten kryeministër.

Si rezultat i një atentati që iu bë më 24 shkurt nga Beqir Valteri, anëtar i "Bashkimit të Shqiptarëve të Rinj", një organizatë e krijuar nga Avni Rustemi, Ahmet Zogu detyrohet

⁶⁴⁸ Gustavo Traglia., *L'Albania di re Zog*, Roma: TIBER, 1930, f.13-14

⁶⁴⁹ Terenzio Tocci , *Il re degli albanesi*, Milano: A.MONDADORI, 1938, f. 131-132

që më 25 shkurt 1923, pas një viti e dy muajsh në postin e kryeministrit, të japë dorëheqjen. Në pushtet do të vijë qeveria e Shefqet Vërlacit, vjehrrit të mundshëm të ardhshëm të Zogut. Në këtë periudhë Zogu do të bëhet pushteti mbrapa qeverisë.⁶⁵⁰

Pas vrasjes së dy turistëve amerikanë në rrugën Tiranë - Shkodër nuk vonoi shumë shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme. Vrasja e Avni Rustemit më 5 maj 1924, deputet i Asamblesë Kushtetuese, u përdor si pretekst nga Noli dhe pasuesit e tij për të treguar se jeta e deputetëve të opozitës nuk ishte e sigurtë në Tiranë. Qeveria e Shefqet Vërlacit duke parë se si po shkonin ngjarjet, dha dorëheqjen. Ngjarjet që pasuan më vonë e detyruan Zogun të tërhiqej bashkë me disa luftëtarë të tij në Jugosllavi.⁶⁵¹

Kështu vitet e para të jetës së tij si politikan aktiv në Shqipëri u mbyllën në një mënyrë jo shumë të suksesshme. Arritjet e Zogut në këtë periudhë ishin të pakta, pasi problemet me të cilat ai u përball ishin shumë të mëdha. Megjithatë në Shqipërinë e asaj kohe ekzistonin vështirësi të shumta ende, mund të themi se Zogu ka merita për vendosjen e njëfarë stabiliteti në Shqipëri. Si rezultat i çaromatimit të pjesës më të madhe të popullsisë, numri i vrasjeve ishte ulur. Ai pranoi si problemin kryesor në Shqipëri problemin agrar. Nga kjo periudhë Zogu kishte nxjerre disa mësim. Ai kishte mësuar se qëndrueshmëria politike nuk mund të arrihej pa një qëndrueshmëri të mirë ekonomike. Ai ishte i sigurt se edhe nëse do të bëheshin shumë përpjekje për ta kthyer Shqipërinë në një shtet të tipit perëndimor, modeli politik perëndimor në rastin e Shqipërisë kishte shumë mundësi që të dështonte.⁶⁵²

Në këtë kohë përballë Ahmet Zogut qëndronte një figurë shumë e rëndësishme ndër shqiptarët e Amerikës, Fan Noli. Mund të themi se Zogu dhe Noli në lidhje me shkollimin, eksperiencat dhe idetë për ndërtimin e një shteti ishin dy figura shumë të ndryshme nga njëri-tjetri. Noli kishte krijuar në Amerikë kishën e parë ortodokse autoqefale shqiptare në vitin 1908. Ai ishte diplomuar në Universitetin e Harvardit dhe ishte mbajtur me idetë demokratike amerikane, duke shpresuar të çrrënjoste rendin e vjetër e të korruptuar, prapambetjen dhe shfrytëzimin në Shqipëri. Ndërhyrja e tij e parë në politikën shqiptare ishte si përfaqësues i Shqipërisë në debatin e Lidhjes së Kombeve mbi mundësinë e aderimit të vendit të tij në të.

Nga ngjarjet që do të pasojnë më pas ai do ta kuptojë se nuk do të ishte e mundur të bashkëpunonte me Zogun dhe se nëse do të donte të punonte për modernizimin e Shqipërisë, Zogu do të largohej nga skena. Kjo është edhe arsyeja se qeveria e ardhur në pushtet si rezultat i revolucionit të qershorit do të ishte një koalicion shumëngjyrësh që ishte formuar për rrëzimin e Zogut nga pushteti.⁶⁵³

Mund të themi se politikisht ai nuk ishte shumë i aftë për t'u përshtatur me strukturën politike të Shqipërisë së atyre viteve. Kjo vinte mbase nga fakti se ai kishte qënë larg Shqipërisë për një kohë të gjatë. Me ardhjen e Nolit në pushtet u shpall një program, i cili synonte të krijonte një shtet modern të stilit perëndimor. Disa nga pikat kryesore të programit të tij ishin: a) çarmatosja e përgjithshme e popullsisë, b) çrrënjësja e feudalizmit, emancipimi i popullit dhe vendosja në mënyrë përfundimtare e demokracisë, c) ndërmarrja e një reforme rrënjësore në të gjitha degët e administratës, si

⁶⁵⁰ Camillo Libardi., *Come si e fatto re d'Albania Ahmet Zogu*, Trento: SCUOLA TIPOGRAFICA PR. ARCVESCOVILE ARTIGIANELLI, 1940, f. 31-32

⁶⁵¹ Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit të XX*, Tiranë: IDEART, 2004, f.91-92

⁶⁵² Roberto Moroco Della Roca, *Kombesia dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, Tirane: ELENA GJJK, 1994, f. 117-118

⁶⁵³ Robert J. Stevens B.S, *Zhvillimet politike në Shqipëri 1920-1939*, Tiranë: GEER, 2004, f. 15-17

në atë civile ashtu edhe ushtarake, d) ekuilibrimi i buxhetit përmes futjes së sistemit të kursimit, e) lehtësimi i futjes së kapitalit të huaj në vend etj.. Noli, një njeri i kulturuar, politikan i zgjuar dhe atdhetar i padyshimtë, dukej se nuk kishte një aftësi të domosdoshme për të qeverisur.⁶⁵⁴

Përsa i përket periudhës së qeverisjes së Fan Nolit është e rëndësishme të përmendim se për herë të parë në Shqipëri u bënë përpjekje që të zbatohet një program demokratik, të cilin do ta kishin zili dhe për të cilin do të krenoheshin edhe shtetet perëndimore, pavarësisht se gjendja në të cilën ndodhej Shqipëria e bënte të pamundur zbatimin e tij. Në një kohë kur Noli po haste shumë vështirësi në drejtimin e vendit, Zogu nga ana tjetër po përgatiste terrenin për të marrë pushtetin përsëri. Një sërë rrethanash të brendshme dhe të jashtme në këtë kohë, do të luajnë një rol pozitiv në përpjekjet e tij për të ardhur në pushtet. Disa prej këtyre rrethanave ishin:

Së pari: Noli kishte ardhur në pushtet në një mënyrë zyrtarisht jokushtetuese dhe kryengritëse. Megjithatë ai nuk pranoi ta formalizonte ose ta legjitimonte pozitën e tij nëpërmjet zgjedhjeve të përgjithshme. Si pasojë qeveria e tij nuk u njoh në arenën ndërkombëtare.⁶⁵⁵ Beogradi refuzoi ta mbështeste për shkak të përkrahjes që i dhanë atij irredentistët e Kosovës. Përveç kësaj, jugosllavët ishin në bisedime me Zogun, i cili ishte i strehuar në Beograd. Në lidhje me Francën mund të themi se ajo nuk kishte interesa ndaj shtetit shqiptar por meqënëse ajo ka përkrahur gjithmonë politikën jugosllave, të njëjtën gjë do të bënte edhe me interesat jugosllave ndaj Shqipërisë. Më dëmprurëse për qeverinë e re, ishte mosnjohja nga qeveria britanike, e cila megjithëse si pretekste nxirrte se Noli nuk kishte ligjruar pushtetin dhe duhet të shpallte amnistinë e përgjithshme, pas qëndrimit të saj mbeteshin marrëveshjet ekonomike që ajo kishte bërë me Zogun në fushën e konçensioneve të naftës. Noli kishte lidhje të ngushta me grupin shqiptaro-amerikan "Vatra", i cili me sa dukej mbronte interesat e shoqërisë amerikane "Standard Oil". Gjithashtu Noli ishte në disavantazh para britanikëve, për shkak të lidhjeve të ngushta të Harry Eyres-it me Zogun. Eyres-i kishte mbështetur hapur qeverinë e Zogut dhe të Vrionit kundër kryengritësve.⁶⁵⁶ Të njëjtën gjë bëri edhe Italia, e cila refuzoi edhe kërkesën e Nolit për një kredi. Kjo sepse Musolini kishte bërë një marrëveshje mosndërhyrjeje me Beogradin. Duke qënë se objektivi kryesor i Nolit ishte sigurimi i pavarësisë së Shqipërisë nëpërmjet eliminimit të depërtimit të huaj dhe ndërhyrjeve në punët e brendshme, Musolini e dinte se nuk do të kishte një vullnet të mirë për konçensione nga ana e shqiptarëve. Noli bëri të mundur që qeveria e tij të njihej nga Greqia, por edhe ajo mendonte se me Zogun do të merrej vesh më lehtë sesa me Fan Nolin. Ai pati sukses në këtë aspekt vetëm me Bashkimin Sovjetik, me të cilin u lidhën marrëdhënie diplomatike që në dhjetor 1924.⁶⁵⁷

Së dyti: Regjimit të Nolit i mungonte uniteti. Vetë Noli ishte në konflikt me shumë nacionalistë kryesorë, duke përfshirë Elez Isufin, Aqif Elbasanin, Bajram Currin, Luigj Gurakuqin etj..... të cilët përkrahnin një monarki kushtetuese dhe mendonin se ata ishin ende të lidhur me betimin e tyre për besnikëri ndaj princit Vilhelm. Pjesa më e madhe e pasuesve që erdhën në pushtet bashkë me të, kishin të përbashkët me të vetëm

⁶⁵⁴ Joseph Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie*, Tiranë: DITURIA, 2004, f. 318-319

⁶⁵⁵ Bernd J. Fisher, *Ahmet Zogu, Mbreti shqiptar midis dy luftërave*, Tiranë: AHS, 2010, f.18-19

⁶⁵⁶ Albert Mousset, *Shqipëria përballë Europës 1912-1929*, Tiranë, :DITURIA, 2004, f.20-22

⁶⁵⁷ Georges Castellani, *Histori e Ballkanit, shek XIV-XX*, Tiranë: CABEJ, 1996, f.451-452

urrejtjen dhe xhelozinë ndaj Zogut. Në momentin që qëllimi i tyre i përbashkët ishte arritur, koalicioni filloi të shpërbëhej.

Së treti: Noli shpalli një program të thellë reformash, por nuk arriti ti zbatonte ato. Megjithëse studiues të ndryshëm si p.sh. Antonello Biagini shprehen se : “ Noli nuk bëri shumë përpjekje për t’i vënë në jetë reformat e tij dhe u shqetësua më shumë për të krijuar një përshtypje të favorshme tek opinioni publik europian, duke shpallur shumë angazhime liberale dhe modernizuese , që nuk kishin shumë lidhje me realitetin shqiptar” ,unë mendoj se Fan Noli nuk arriti ta zbatonte programin e tij jo sepse i mungonte dëshira por sepse nuk kishte fonde të mjaftueshme dhe mbeshtetjen e brendshme.⁶⁵⁸

Së katërti : . Mungesa e përvojës në fushën politike bëri të mundur që Noli të bënte shumë gabime . Një nga gabimet më trashanike të kësaj qeverie ishte ngritja e një gjykatë politike për të eliminuar kundërshtarët politikë. Kjo gjykatë mori vendime për dënim me vdekje për Ahmet Zogun , Shefqet Vërlacin, Iljaz Vrionin dhe të tjerë. Prona e tyre u konfiskua dhe u shtetëzua. Ky veprim do të shkaktojte turbullira të tjera dhe nxiste ata që shpallëshin fajtorë dhe që ndodhëshin në mërgim të përpiqëshin të rikthenin statuskuonë.⁶⁵⁹

Së pesti: situata ndërkombëtare ishte e favorshme dhe Beogradi ishte gati. N. Pasic, i kthyer përsëri në postin e kryeministrit të Jugosllavisë kërkonte sukses në politikën e jashtme në mënyrë që të errësonte popullaritetin në rritje të S.Radicit dhe Partisë Fshatare Kroate. Italia i përmbahej marrëveshjeve me Nincicin dhe kishte refuzuar përsëri kërkesën e Nolit pas vizitës së tij të dytë në Romë. Rënia e kabinetit Macdonald në Londër dhe formimi i një kabineti të dytë Baldwin-Chamberlain ishte në favor të Zogut, pasi Chamberlain-i kishte shprehur mirëkuptim për depërtimin italian në Shqipëri.⁶⁶⁰ Gjithashtu kushtet ishin pjekur edhe në planin e brendshëm, pasi në nëntor Noli kishte shpallur mbajtjen e zgjedhjeve të reja për Asambleenë Kushtetuese. Zogu nuk mund t’i lejonte Nolit mundësinë për ta kthyer regjimin jokushtetues në një regjim juridikisht kushtetues, i cili për rrjedhojë do të njihet edhe nga shtetet e tjera.

Zogu përpunoi një plan të kujdesshëm , duke shpresuar të përfitonte prej elementit të befasisë. Një problem që shqetësonte si Zogun ashtu edhe Beogradin, ishte përshtypja që do të bënte në opinionin e brendshëm dhe të jashtëm artilleria jugosllave në tokën shqiptare. Për këtë u morën masa për të fshehur sa të ishte e mundur pjesëmarrjen e Beogradit. Ushtarët jugosllavë u veshën me petka karakteristike shqiptare dhe u vendos që operacionet e tyre të kufizoheshin vetëm në fazën e parë të invazionit.⁶⁶¹ Megjithë përpjekjet për të fshehur lidhjen me jugosllavët, aleanca e Zogut me Jugosllavinë ngjalli frikë të madhe në Shqipëri. Plani ushtarak parashikonte një sulm të njëkohshëm në shtatë drejtime të ndryshme, që mbulonin krejt kufijtë shqiptaro-jugosllavë dhe greko-shqiptarë. Sulmi i njëkohshëm do të fillonte më 17 dhjetor. Në veprën “Shqiptarët nga mesjeta deri në ditët tona”, studiuesi Peter Bartl shprehet se : “ushtria kryesore e Zogut përbëhej nga këto trupa:

-1.000 vullnetarë nga ushtria e rregullt jugosllave

⁶⁵⁸ Antonello Biagini, *Historia e Shqipërisë nga zanafilla deri në ditët tona*, Tiranë: SHTËPIA E LIBRIT DHE E KOMUNIKIMIT, 2000, f 132-133

⁶⁵⁹ Miranda Vickers, *Shqiptarët, një histori moderne*, Tiranë: BOTA SHQIPTARE, 2008, f. 102-104

⁶⁶⁰ Joseph Rothschild, *Evropa Lindore Qëndrore midis dy luftërave botërore*, Tiranë: DITURIA, 2004, f. 355-356

⁶⁶¹ Herman Bernstein, Hugh.G. Grant, *2 diplomatë amerikanë për mbretin Zog*, Tiranë: DARDANIA, 1994, f.22-24

- 1000 rezervistë të rekrutuar nga krahinat jugosllave të banuara nga shqiptarë
- 500 malësorë nga Mati, që kishin ardhur me Ahmet Zogun
- 800 veta të ushtrisë së refugjatëve të gjeneralit Vrangel, që kishte gjetur strehim në Jugosllavi, të komanduar nga dyzat oficerë rusë të bardhë.
- 16 oficerë të ushtrisë së rregullt jugosllave”.⁶⁶²

Gjithashtu ishin vënë në dispozicion të Zogut edhe disa nga njësitë e ushtrisë së rregullt jugosllave, si : mitraloza të rëndë, bateri të artillerisë malore etj

Duke u mbeshtetur tek një informacion i gabuar , qeveria e Nolit arriti në përfundimin se sulmi kryesor do të përqëndrohej në veri dhe verilindje. Për pasojë pjesa më e madhe e forcave u përqëndrua në Shkodër. Në përgjithësi Noli ishte i papërgatitur. Në orët e para të mëngjesit të 17 dhjetorit forcat me në krye Zogun rrethuan qytetin e Peshkopisë. Duke qënë se Zogu e dinte se e kishte humbur popullaritetin, ai u dha urdhër njerëzve të tij të mjaftoheshin vetëm me çarmatosjen e trupave kundërshtarë. Ndërkohë pas sukseseve në zonat e tjera, forcat e Zogut e morën shumë lehtë Tiranën në mbrëmjen e 23 dhjetorit , në të cilën trupat qeveritare drejtoheshin nga major Shefqet Korca, kryekomandant i forcave qeveritare.⁶⁶³ Brenda pak orësh Noli dhe pjesa tjetër e qeverisë u nisën për në Vlorë, ku supozohej se do te organizonin qëndresën e tyre të fundit. Sapo mbërritën në Vlorë , Noli i shoqëruar nga përkrahësit e tij, ndër to edhe disa anëtarë të kabinetit të tij si: Luigj Gurakuqi (ministër i Financave) , Rexhep Shala (ministër i brendshëm) etj.. u larguan në Brindizi. Mënyra se si u largua qeveria e Nolit, la një përshtypje të përgjithshme negative në popull.

Më 24 dhjetor 1924 Zogu hyri në Tiranë me ushtrinë e tij dhe e shpalli këtë datë si “ditën e legalitetit”. Ai shpalli ligjin e jashtëzakonshëm deri në formimin e një qeverie të rregullt.⁶⁶⁴

Nëse rrethanat e krijuara në këtë kohë nuk do të ndikonin në mënyrë të drejtpërdrejtë në ardhjen e Ahmet Zogut në pushtet, do të ishin faktorët, ato që do të luanin rolin vendimtar. Kështu, ndër faktorët kryesorë mund të përmendim:

1-Mbështetja e Jugosllavisë. Ajo synonte të merrte Shën Naumin dhe Vermoshin, zona që kishin qënë të diskutueshme që në vitin 1913. Në veprën “Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri” Bernd Fisher shkruan: “ Jugosllavia mendonte se një qeveri e kthyer në pushtet me ndihmën e saj, do të mbetej në vartësi të Jugosllavisë dhe do të pranonte kërkesat e këtij shteti. Beogradi mendonte se do ta shtrinte ndikimin e vet në Shqipëri, duke dalë në këtë mënyrë si rival i madh i Italisë, e cila kishte shumë probleme të brëndshme në këtë kohë. Megjithatë Ahmet Zogu u tregua jo thjesht një gur shahu , pavarësisht se ai i lejoi ta përfytyronin të tillë derisa qëllimit të tij do t’i leverdiste t’i zhgenjente ata”. Ndihma e Jugosllavisë kishte më shumë karakter ushtarak .⁶⁶⁵

2-Ndihma financiare e shoqërisë Anglo-Persiane. Kjo shoqëri i dha Zogut 50 milionë dinarë, gjysma e të cilave do të paguhej menjëherë dhe gjysma tjetër pas ardhjes në fuqi të Zogut dhe ratifikimit të konçensionit të naftës, një marrëveshje e lidhur në vitin 1922, e cila i jepte të drejta ekskluzive kësaj kompanie mbi fushat naftëmbajtëse

⁶⁶² Peter Bartl, *Shqiptarët nga mesjeta deri në ditët tona*, Tiranë: INSTITUTI I DIALOGUT DHE KOMUNIKIMIT, 1995, f. 199-200

⁶⁶³ Bernd J. Fisher, *Diktatorët e Ballkanit*, Tiranë: AIIS; 2009, f. 32-33

⁶⁶⁴ Edwin Jacques, *Shqiptarët*, Tiranë: KARTË E PENDË, 1995, f. 415-416

⁶⁶⁵ B. J. Fisher, *Mbreti Zog dhe përpjekja.....*, vepër e përmendur , f. 79-80

shqiptare. Kjo marrëveshje pritej të ratifikohej me ardhjen e Ahmet Zogut në pushtet, përmes së cilës ai do të siguronte mbështetjen diplomatike të Britanisë së Madhe.⁶⁶⁶

3-Zogu ndeshi shumë pak kundërshtim brenda vendit. Shumica e popullit e shpërfilli urdhërin e qeverisë për mobilizim të përgjithshëm dhe shumë njerëz përveç anëtarëve të fiseve të Matit të tij e lidhën fatin me Zogun.

Pas ardhjes në pushtet Zogu shpalli një amnisti të përgjithshme dhe pa kushte për të gjithë refugjatët politikë. Ndërkohë gjatë prillit u zhvillun zgjedhjet e përgjithshme përmes të cilave qeveria legalizoi pozitën e saj. Por ky ishte një përfundim i paravendosur, sepse mungonin të gjithë udhëheqësit kryesorë të opozitës. Një pjesë e vogël e popullsisë mori mundimin të votonte.⁶⁶⁷

Si përfundim mund të themi se pavarësisht mjeteve dhe metodave që përdori për të ardhur në pushtet dhe për ta mbajtur atë, Zogu ishte i vetmi person që mund të qeveriste Shqipërinë e asaj kohe, gjë të cilën e tregon edhe fakti se ai do ta drejtojë atë për 14 vite rresht, në një kohë kur në Shqipëri ishte e vështirë ta mbaje pushtetin qoftë edhe për pak muaj dhe kjo jo vetëm prej vështirësive të brëndshme por edhe prej rivalitetit të Italisë dhe Jugosllavisë për të ndikuar mbi të.

⁶⁶⁶ Haris Silajxhic, *Shqipëria dhe SHBA në arkivat e Washingtonit*, Tiranë: DITURIA, 1999, f. 150-151

⁶⁶⁷ C. Libardi, *Come si e fatto re.....*vepër e përmendur, f.33-34

GJETJE MONEDHASH NË ANAMORAVË

Mr.Sc. Elvira Reçica

HYRJJE

Kosova si regjion gjeografik është vend që dëshmon për gjurmë të shumta të zhvillimit të xehetarisë në periudha të ndryshme historike. Mungesa e përnjohjes dhe hulumtimeve të avansuara kanë ndikuar që shumë gjetje arkeologjike e sidomos monedha të periudhave të ndryshme të gjenden nga qytetarët, por edhe të hulumtohen jashtëligjshëm nga klandestinët. Numizmatika është disiplinë që ka ngecur mbrapa në Kosovë. Ajo na ofron informacione për zhvillimin e jetës ekonomike dhe shoqërore në periudha të ndryshme, për qarkullimin monetar, tregëtinë e lirë etj. Mungesa e kontrollit ndaj poseduesve të monedhave të ndryshme dhe krijimit të rendit ligjor rrezikon që të humbet pasqyra e të kaluarës historike të këtij rajoni andaj për këtë duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje në të ardhmen. Me fjalë të tjera qëllimi im kryesor ka qenë dhe është studimi, deshifrimi, identifikimi dhe përshkrimi i monedhave të periudhave të ndryshme, konkretisht të periudhës romake dhe bizantine, të zbuluara në Kosovë.

Territori i Dardanisë luante një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të rajonit që nga Mbreteria Dardane pastaj në Perandorinë Romake dhe Bizantine për arsye sepse si territor ishte shumë i pasur me miniera. Historia e prodhimit dhe prerjes së monedhave në Dardani ka një histori të hershme duke filluar nga Shteti Dardan dhe dinastitë e tij me mbretërit Bato, Monun dhe Longar, gjë që na bën të kuptojmë se kemi të bëjmë me një mbretëri të fuqishme ekonomike. Një gjë tjetër e rëndësishme është gjithashtu zhvillimi i xehetarisë dhe rrjetit rrugor në kohën e sundimit romak, gjë që vërteton rolin e rëndësishëm ekonomik të provincës së Dardanisë në atë kohë.

Territori i Dardanisë

Dardania shtrihet në territorin e Kosovës së sotme, në Maqedoninë veriperëndimore, në Serbinë jugore dhe në një pjesë të Sanxhakut, kurse Peonia dhe Bylazora (Vlesi i sotëm) iu bashkangjiten mbretërisë në gjysmën e dytë të shek. III p.e.s. Dardania kishte pozitë të volitshme gjeografike dhe gjeostrategjike, sepse përshkohej nga luginat e lumenjëve Vardar, Drin, Moravë, Ibër dhe Sitnicë, që ndikuan që ky territor të shëndrrohej në udhëkryq të rrugëve më të mëdha ballkanike.⁶⁶⁸ Zona qendrore e Ballkanit, e cila njëherësh ishte edhe trevë e dardanëve, është e ndarë në pjesën qendrore ose Rashkën e sotme, në pjesën e Vardarit (territorin e Maqedonisë) dhe në Kosovën si territor qëndror i trevës së dardanëve.⁶⁶⁹ Kryeqyteti i mbretërisë dardane ishte Damastioni, i cili në këtë kohë kishte monedhën e tij me emrin e qytetit. Ky qytet u krijua si një qendër zejtarësh e organizuar politikisht në shembullin e qyteteve të kohës.

⁶⁶⁸ Akademia e Shkencave e Shqipërisë & Instituti I Historisë, Historia e Popullit Shqiptar I, Toena, Tiranë, 2002.fq. 104

⁶⁶⁹ Zef Mirdita, Studime Dardane, Rilindja, Prishtinë 1979, fq. 15

Argjendi dardan ishte një nga burimet kryesore të veprimtarisë monetare dhe kishte pushtuar tregjet e Apollonisë dhe Dyrrahut në shekujt IV-I para Kr.⁶⁷⁰

Dardania kishte një pozitë shumë të mirë gjeografike dhe gjeostrategjike, gjë që I mundësonte krijimin e ndërlidhjeve me hapësirat fqinje dhe ato më të largëta. Territori i saj, duke u përshkuar nga luginat e lumenjve Vardar, Drin, Moravë, Ibër dhe Sitnicë, përbënte një udhëkryq të rrugëkalimeve të rëndësishme ballkanike që shpinin drejt Egjeut, Adriatikut dhe Detit të Zi.

Falë pasurive natyrore (arit, argjendit, hekurit, fushave pjellore, pyjeve), si dhe të klimës së përshtatshme, kontinentale dhe mesdhetare, Mbretëria Dardane në shek.IV-II p.e.sonë njohu lulëzimin më të madh.

Aktiviteti minerar në Dardani

Kosova është e pasur me resurse natyrore dhe posedon rezerva të metaleve e mineraleve te ndryshme si: plumb, zink, nikel, argjend, ari, kobalt, bronz, hekur, linjit, boksit etj Edhe ne periudhat e hershme (prehistorike) Iliria posedonte keto pasuri minerale, të cilat ishin atraksion i madh për romakët. Mirëpo, nga të gjitha pasurit minerale të Kosovës më e rëndësishme gjatë historisë së hershme të saj ishte begatia e argjendit. Që në kohët para romake ka pasur miniera, si të argjendit, ashtu edhe të plumbit në këtë rajon (sipas të gjitha gjasave, edhe një sasi të arit); këto miniera u shfrytëzuan gjërësisht gjatë periudhës romake. Në shekujt V-IV para Krishtit Mbretëria Dardane ishte në kulmin e zhvillimit të saj. Në këtë periudhë metalet e çmuara, sikurse ari dhe argjendi, përdoreshin për të bërë stoli të ndryshme. Këto shërbenin për të bërë shkëmbime me qytete e zhvilluara greke si dhe qytetet në Gadishullin Ilirik. Sipas Plinit burrat dardanë bartnin rrathe ari⁶⁷¹ dhe kjo na bën të kuptojmë se ky territor luante një rol të rëndësishëm ekonomik dhe kulturor. Gjetjet në Artanë dëshmojnë për një përdorim të madh të pasurive minerale.⁶⁷² Kjo dëshmi na jep të kuptojmë se dardanët e njihnin zejen e përpunimit të metaleve dhe se Dardania ishte një regjion mjaft i pasur më minerale. Kjo informatë me siguri se njihej mirë edhe nga romakët të cilët ishin më se të interesuar t'i shtrijnë kufijtë e tyre sidomos në regjione të pasura me minerale.

Ndër lokalitetet e pasura me minerale në Dardani ishin municipiumet Ulpiana dhe Soçanica,⁶⁷³ të cilat ishin qendra urbane me karakter minerar, por me organizim municipiumesh.⁶⁷⁴

Ulpiana ishte themeluar si një qendër pre-romake.⁶⁷⁵ Romakët në Ulpianë nxirrnin ar, argjend, hekur dhe plumb. Gjatë periudhës së sundimit të perandorit Trajan (98-117), në shekullin II pas Krishtit, pati një zhvillim të madh përpunimi i metaleve dhe puna në miniera.⁶⁷⁶ Kjo ishte periudha e zhvillimit të madh minerar në Gadishullin Ilirik dhe në veçanti ne Dardani. Perandori romak Trajani 117-135 kishte kuptuar rëndësinë dhe pasurinë minerare të këtij territori, kështu që për këtë arsye mori masat për të rritur

⁶⁷⁰ Luan Perzhita., Mbretëria Dardane, Botart, Tiranë,2009, f.27

⁶⁷¹ Edi Shukriu, Kosova Antike, Prishtinë, 2004, fq. 82

⁶⁷² Edi Shukriu, Dardania Paraurbane, Studime Arkeologjike të Kosovës e Dukagjinit, Dugagjini, Pejë 1997, fq.49

⁶⁷³ Ibid. fq.49

⁶⁷⁴ Zef Mirdita, Studime Dardane, Rilindja, Prishtinë, 1979, fq.115.

⁶⁷⁵ Zef Mirdita, po aty; ; Municipiumet ishin qytete me të drejta romake, qytet qe u zhvilluan dhe u organizuan nën pushtimin romak duke filluar nga shek. II ne Dardani.

⁶⁷⁶ Edi Shukriu, Kosova Antike, Prishtinë 2004, fq.108

⁶⁷⁶ Prof.Dr. Jahja Drançolli, Raguzanët në Kosovë, Prishtinë, 1986, fq.205.

aktivitetin minerar, aktivitet i cili ishte zhvilluar më parë nga vendasit.⁶⁷⁷ Edhe sot ne qytetin e Ulpianës antike shihen gjurmët e kohës së Trajanit I cili konsiderohet si I pari romak që ndërtoi qytetin. Eksploatimi i minierave zhvilloi shumë edhe ekonominë e këtij qyteti që me vonë do të bëhet qender monetare ku u farkuan edhe monedhat.

Monedhat

Dardanet kishin organizim të mirë shtetëror, ushtarak dhe ekonomik dhe si mjet këmbimi kishin monedhat. Sipas burimeve të shkruara deri me tani për dardanët mund të pohojmë se ata kanë farkuar monedhat e veta. Madje duket se në Dardani janë farkuar tipet më të hershme të monedhave të emituara e të ashtuquajtura monedha "barbare".⁶⁷⁸

Në gjysmën e dytë të shekullit IV para Krishtit në Dardani u themelua qyteti Damastion, i cili supozohej të ishte i pari qytet ilir që preu monedha argjendi.⁶⁷⁹

I ndodhur pranë minierës së argjendit në tokat e dyestëve ky qytet u krijua si një qender zejtarësh e organizuar politikisht nën shembullin e qyteteve të kohës. Argjendi dardan ishte një nga burimet kryesore të veprimtarisë monetare, I cili kishte pushtuar tregjet në qytetet si Apollonia, Dyrrahu në shek IV-I para Kr. Kaq I rëndësishëm ishte ky aktivitet sa që Plini shprehët si në vijim

`` rrrathë ari vinin nga Dardania dhe prandaj quheshin dardan. ``

Ndërsa mbreti I parë dardan që preu monedha argjendi ishte Monuni. Sidomos ishte i njohur stateri me mbishkrimin *Basileos Monuniou*. Kjo monedhe dallonte nga monedhat e Dyrrahionit sepse në monedhat e Dyrrahut paraqitej lopa dhe shkurtesa *DYR*, gjë që tregonte vendin e prerjes së monedhës dhe sovranitetin mbretëror mbi qytetin.⁶⁸⁰

Damastioni farkoi monedhat e veta të argjendit midis viteve 400 - që zgjati deri më 280 para erës së re. Kjo gjë dëshmon për përdorimin e hershëm të monedhave si shkëmbim në këto troje.⁶⁸¹ Në rrethinën e Janjevës dhe Prishtinës janë gjetur monedha të qytetit xehetar Damastionit.⁶⁸² Në simbolet e monedhës së Damastionit janë përdorur çekani i minatorit, që dëshmon se qyteti ishte qendër e një treve me minerale argjendi.⁶⁸³

Monedha të prera në qytetin e Damastionit janë gjetur në shumë lokacione, si: tetradrahma në Kutina (ndërmjet Nishit dhe Leskovcit); tetradrahmet e Aleksandrit të Madh dhe Kasandrit në Risan (Rizoni antik) në Dalmacinë Jugore; tetradrahma e Filipit të Dytë në Râžinci (Sofia, Bulgaria); Rumani, Sinj (Split, Dalmaci).⁶⁸⁴

Supozohet që edhe në Ulpianë është farkuar një monedhë e moçme e quajtur "Metallum Ulpianum", kushtuar punëtorëve të këtyre minierave.⁶⁸⁵

Pas vdekjes së Teodosit në vitin 395 pas Krishtit perandoria romake u nda në dy pjesë: në pjesën perëndimore (pars occidentalis) dhe lindore (pars orientalis). Trevat iliro-shqiptare hynë në përbërje të Perandorisë Bizantine, siç quhet zakonisht pas kësaj date Perandoria Romake e Lindjes sipas emrit antik të kryeqytetit të saj, Bizant, që për nder të Konstandinit të Madh u quajt Konstandinopojë. Ashtu siç i kishin dhënë në shek. III

⁶⁷⁷ Prof.Dr.Jahja Drançolli, Raguzanët në Kosovë, Prishtinë 1986, p.205

⁶⁷⁸ Edi Shukriu, "Kosova Antike", Prishtinë, 2004, fq.82

⁶⁷⁹ Aleksandër Stipçeviq, Ilirët, Historia, Jeta, Kultura, Prishtinë, 1990, fq. 81

⁶⁸⁰ Neritan Ceka, Ilirët, Ilar, Tiranë, 2001, fq. 95

⁶⁸¹ Aleksandër Stipçeviq, Ilirët, Historia, Jeta, Kultura, Simbolet Kultit, Tiranë 2002, fq. 184

⁶⁸² Emil Çershkov, Revista kulturore dhe shkencore "Përparimi" 1-2, Prishtinë, 1964, fq.76

⁶⁸³ Qazim Namani, Monumentet e Kosoves nr.2, Prishtinë, 2014, fq.39-61.

⁶⁸⁴ Margaret Thompson, Otto Morkholm, Colin M. Kraay, An Inventory of Greek Coin Hoards, New York, 1973, fq. 59-64.

⁶⁸⁵ Qazim Namani, Monumentet e Kosoves nr.2, Prishtinë, 2014, fq.39-61.

-IV Perandorisë Romake një numër perandorësh e gjeneralësh të shquar, po ashtu gjatë periudhës së hershme bizantine (shek. V-IX), trevat iliro-shqiptare i dhanë Perandorisë Bizantine disa perandorë, ndër të cilët shquhen në mënyrë të veçantë Anastasi I (491-518) dhe Justiniani I (527-565). Me reformat dhe me masat e zbatuara në administratën civile e ushtarake, këta dy perandorë përgatitën kalimin nga antikiteti në mesjetë dhe hodhën bazat e asaj që do të ishte perandoria më jetëgjatë në historinë e qytetërimit mesdhetar.

Nuk do të ndalem ti trajtoj monedhat e gjetura në tërë territorin e Dardanisë sepse ka shume sosh por më interes janë ato të gjetura në Livoç të Ulët, si dhe në Pogragjë në komunën e Gjilanit si një ndër rajonët monetare me të zhvilluara të Dardanisë. Këto monedha janë të panjohura dhe të pabotuara më parë.

Në vazhdim do të paraqes disa monedha të gjetura në Anamoravë, konkretisht në Pogragjë, Livoç të Ulët, disa monedhat që posedon Qendra Kulturore për Trashëgimi Kulturore në Gjilan. Ndër të tjera në Anamoravë janë gjetur monedha të Gordianit III (238 – 244 pas Krishtit), Flavius Valensit (364–378 pas Krishtit), Teodosit I (379-395 pas Krishtit), Justiniani I (527-565 pas Krishtit) etj.

Në Periudhen Imperiale, në Viminacium, që ishte kryeqendra e Mezisë së Epërme, u stampuan monedha argjendi.⁶⁸⁶ Monedhë e cila ishte stampuar në Mezinë e Epërme është gjetur në Anamoravë, konkretisht në Livoç të Ulët. Në avers paraqitet portreti i perandorit Gordian III me kurorë dafine dhe mburojë kthyer djathtas, kurse në revers Mezia me kokën kthyer djathtas. Afër këmbëve të saja qëndrojnë demi dhe luani, mbi të cilët ka vënë duart e saja.

PËRFUNDIM

Historia e monedhave ka një rëndësi të veçantë për ndriçimin e shumë komponenteve për të deshmuar të kaluarën tonë ku shpeshhërë janë të vetmet burime të sakta që argumentojnë sidomos kronologjinë dhe nivelin ekonomik, komunikimin tregtar që nga origjina kur u paraqiten ato, nga kohërat antike e deri në ditët e sotme. Imazhet që paraqiten në monedhat e gjetura në Livoç I Ulët dhe Pogragjë janë një deshmi e presences romake në Dardani që fillon nga shek III-VI qka edhe dëshmon se romanizimi në këtë provincë ishte më i ngadalshëm se në provincat tjera nga vetë fakti i prezencës së monedhave pararomake. Historia e prerjes dhe qarkullimit të monedhave referon që nga koha e lulëzimit të Shtetit Dardan dhe dinastitë e tij, konkretisht me kohën e sundimit të mbretërve Bato, Monun dhe Longar për të vazhduar deri të ato të kohës së perandorit Justiniani i Madh 525-565.

Gjetjet e sotme të monedhave në Kosovë u përkasin periudhave të ndryshme, gjë që na bën të kuptojmë se kemi të bëjmë me një dinasti të fortë dardane e cila e ka njohur zëjen e farkimit të monedhave e cila do të percillet në kontinuitet që nga antikiteti e deri në ditët e sotme ku janë të njohura edhe produktët zejtare të argjendarisë të cilat kanë motive origjinale vendore gjë të cilën nuk mund ta shohim tek popujt tjerë. Kjo me siguri bazen duhet ta ketë pasur pikërisht tek kjo dinasti respektivisht shtetit dardan i cili pati prerje monetare vendore, por me ardhjen e romakeve dhe me pushtimin e Dardanisë numizmatika dardane merr fizionomi romake siq ndodhi në të gjitha provincat romake pa përjashtime. Popullata vendore nuk pati kohë ta rimarr veten deri në mesjetën e vonë

⁶⁸⁶ John F. Merkel, Imperial roman Production of lead and silver in the Northern Part of Upper Moesia, Fq.49

kur filluan të lulëzojnë produktet artizanale të filigranit dhe zejeve tjera të cilat shquheshin edhe në tregun evropian. Prandaj për ta përcjellur këtë porosi sot duhet që ti kushtohet kujdes më i madh prerjeve monetare, tipologjisë së tyre dhe shtrirjes së tyre që të mund të futen në shërbim të historisë. Këto dy qendra, Livoçi i Ulët dhe Pogragja, janë një thesar numizmatik që pret të studiohet dhe të interpretohet nga ana e shkencëtarëve.

Bibliografia

- Aa. Vv. Akademia e Shkencave e Shqipërisë & Instituti i Historisë, Historia e Popullit Shqiptar I, Toena, Tiranë, 2002.
- Bellinger A.R. & Grierson P., Catalogue of the Byzantine Coins in the Dumbarton Oaks Collection and in the Whittemore Collection, volume 1, Anastasius I to Maurice, Washington, D.C., 1992.
- Borić – Brešković B., Novac Kolonije Viminacijuma, Beograd 1976.
- Carson R.A.G., Kent J.P.C., Burnett A.M., The Roman Imperial Coinage, volume X, The Divided Empire and the fall of the Western Parts, AD 395 – 491, London 1994.
- Ceka N., Ilirët, Ilar, Tiranë 2001.
- Çershkov E., Revista kulturore dhe shkencore "Përparimi" 1-2, Prishtinë.
- Draçollli J., Raguzanët në Kosovë, Prishtinë, 1986.
- Grierson Ph., Byzantine Coinage, second edititon, Washington, D.C. 1999.
- Kent J.P.C. , Roman Coins, London 1978.
- Mattingly h. & Carson R.A.G., The Roman Imperial Coinage, volume 9, Valentinian 1 to Theodosius 1, London 1951.
- Merkel J. F., Imperial roman Production of lead and silver in the Northern Part of Upper Moesia, London.
- Mirdita Z., Studime Dardane, Rilindja, Prishtinë 1979.
- Namani Q., Qazim Namani, Monumentet e Kosoves nr.2, Prishtinë, 2014.
- Përzhitë L., Mbretëria dardane, Botart, Tiranë, 2009.
- Shukriu E., Kosova Antike, Prishtinë, 2004.
- Shukriu E., Dardania Paraurbane, Studime Arkeologjike të Kosovës e Dukagjinit, Dugagjini, Pejë 1997.
- Stipçeviq A., Ilirët, Historia, Jeta, Kultura, Prishtinë, 1990.
- Thompson M., Mørkholm O., Kraay C. M., An Inventory of Greek Coin Hoards, New York, 1973.

PERSEKUTIMI I INTELEKTUALËVE NGA PKSH

Ma. Enis Kelmendi

Komunizmi sipas shumë studiuesve e veçanërisht Alen Bezansonit është sistem kriminal së bashku me nazizmin hitlerian, meqë të dy sistemet diktatoriale u bënë shkak i vrasjes së miliona njerëzve.⁶⁸⁷

Të dy sistemet ishin të ngjashme në formën e kriminalitetit dhe shkallës së gjenocidit që ato shkaktuan ndaj një ose më shumë popujve, megjithatë kujtesa historike nuk i përcepton njëloj këto sisteme.

Gjithnjë sipas Bezansonit, ekzistojnë mjaft arsye pse sot e kësaj dite nuk u denua njejt edhe komunizmi si nazizmi, ngase këtë të fundit evropianët e përjetuan në lëkurën e vet, ndërsa komunizmi dhe kampet e përqëndrimit si Gulagu sovjetik e Laogaj kinez, ishin diçka e largët për evropianët.

Ndërë arsyet e shumta të kësaj indiference është edhe dobësia e një grupi njerëzish të aftë për të ruajtur kujtesën mbi komunizmin.

Pastaj fakt tjetër është se nazizmi e pati kohëzgjatjen e sundimit të shkurtër afërsisht 12 vite, ndërsa komunizmi në kontinentin e Evropës zgjati nga 50 deri 70 vite. Gjatë kësaj kohëzgjatjeje vlerat demokratike u shuan, elita intelektuale u asgjësua, gjeneratat e reja i'u nënshtruan një lloj edukimi ku bëhej shpërlarja e trurit etj.

Vlen të theksohet se gjatë hulumtimeve të bëra në lidhje me sferën e interesimit tim që ka të bëjë me persekutimin e elitës intelektuale nga Partia Komuniste e Shqipërisë, hasëm në të dhëna shokuese të krimeve gjenocidiale që diktatura komuniste kishte shkaktuar mbi një shtresë së popullsisë së vet veçanërisht ate intelektuale.

Mënyrat e eliminimit të kundërshtarëve në Shqipërinë Komuniste ishin të kopjuara direkt nga stili stalinist, vetëm këtu shpeshherë hasim në procedura edhe më të shkurtra kur bëhet fjalë për ekzekutimin e shumë intelektualëve të dëshmuar e atdhedashës.

Pushteti komunist goditjet më të ashpra ndaj reaksionarëve siç është e ditur i dha në dekadën e parë deri sa u arrit konsolidimi dhe përderisa mirë e mirë i'u fut në palc friga popullit, saqë njerëzit as brenda familjes nuk e kishin guximin të shpreheshin lirshëm.

Intelektualët e shumtë u denuan pa gjyq, u ekzekutuan pa fakte duke mos e kuptuar se përse akuzoheshin, apo vetëm pse për fatin e tyre të keqë ata kishin të përfunduar ndonjë shkollim të lartë jashtë vendit dhe atë dije ishin kthyer të ja dhurojnë atdheut të tyre.

Është për të ardhë keq se si sot e kësaj dite si në Europë ashtu edhe në Shqipëri, komunizmi nuk e mori denimin e merituar. Qeveritë dhe organizmat ndërkombëtar pas rënjes së këtij sistemi nuk e morën guximin që personat përgjegjës të vihen para drejtësisë dhe diktaturave të ngjashme të i'u pamundësohet ardhja në pushtet.

⁶⁸⁷ Fjalor Enciklopedik i Viktimave të Terrorit Komunist, Vëllimi I (A-Ç), ISKK, Tiranë 2012, fq.6.

MËNYRAT E KONSOLIDIMIT TË DIKTATURËS KOMUNISTE NË SHQIPËRI

Konsolidimi i sistemit komunist në Shqipëri pati etapat e veta, meqë si ideologji e re ishte e paparanueshme nga një pjesë e popullit shqiptarë.

Fillimisht me themelimin e PKS-së më 1941 u vërtetua se shumica e pjestarëve të saj ishin njerëz të shtresës së ult (zanatqinj), si nga ana financiare ashtu dhe intelektuale. Në fakt shumica e popullit nuk e dinin se çka do të thotë të jesh komunist, vetëm se një pjesë e krahasonin komunistin me njeriun që nuk ka fe dhe që e lufton besimin.

Mbartësit e ideve komuniste në Shqipëri nuk e njihnin filozofinë marksiste, përveç Sejfulla Malëshovës shumica ishin të pashkollë, të varfër ose punëtorë.

Se sa ishte autoriteti i komunistëve në popull e dëshmon përkrahja që populli i dha Ballit Kombëtar dhe udhëheqësit të tyre Mir'hat Frashërit, edhe pse kjo e fundit ishte themeluar një vit më vonë (1942).

Sipas të dhënave që janë të disponueshme, vendosja dhe rehabilitimi në terren i komunizmit ishte hartuar nga jashtë do të thotë ishte një marrëveshje ndërkombëtare e bërë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Por influenca më e madhe vinte nga jugosllavët dhe britanikët, të parët me qëllimin ta bëjnë sferë të influencuar Shqipërinë, ndërsa të dytët me pretekstin që sa më shumë të krijohen grupe të rezistencë në këtë pjesë të Evropës dhe ushtria gjermane të detyrohet ta intensifikoj luftën në këto anë, për ti mundësuar Frontit Perëndimor frymarrje më të lehtë nga sulmet e furishme të ushtrisë gjermane.

Hapat më të rëndësishëm politik që PKS ndërmorri gjatë LIIB ishin : Konferenca e Pezës (1942), Konferenca e PKS në Labinot (1943), Konferenca e Dytë e LNÇ (1943), Kongresi i Përmetit (1944).

Periudha e dytë ishte ajo e pas çlirimit, ku ende pa u tërheqë mirë trupat gjermane Enver Hoxha jep urdhër për të eliminuar fizikisht çdo kundërshtarë të regjimit të ri, e sidomos intelektualët e pabindur.

Dokumentacioni i kohës e vërteton qartë mënyrën se si duhej vepruar dhe çka duhej bërë për ta ndërtuar një shtet stalinist.

Po e citojmë vetëm një pjesë të një radiogrami që mbanë datën 17 nëntor 1944 ku Enver Hoxha i dërgoi general Dali Ndreut si : " ...Bëni kujdes. Kapni, arrestoni dhe ekzekutoni njerëz me ndikim që të bëhen shembull për të tjerët. Këta bëjnë përshtypje në popull.⁶⁸⁸

Po në këtë kohë (1944) ishte krijuar një Komision Qendror me degët dhe nëndegët e tij që të hetonte krimet e luftës. Ky komision kishte nëntë anëtar dhe përbëhej nga rinia komuniste, fronti I gruas, Këshilli Nacional Çlirimtar dhe një gjykatës.

Ky komision shpalli kriminel lufte të gjithë bashkpunëtorët e pushtuesit dhe ata që kanë përfituar nga ata si : Anëtarët e Regjencës, inspektorët, Ballin Kombëtar, Legalitetin, divizionin Skanderbeg etj.

Në bazë të ligjit që mban datën 15.12.1944, për të lartëcekurit parashikoheshin denime deri në 30 vjet, denime të përjetshëm dhe me vdekje. Gjithashtu po sipas të njetit ligji parashikohej sekuestrimi i të gjithë pasurisë.

⁶⁸⁸ B. Fevziu, 100 Vjet-Një ekskursion në Politikën e Shtetit Shqiptarë nga 1912-2012, Botimi i II, UET Pres, Tiranë 2012, fq. 184.

Numri i personave të denuar vetëm brenda vitit 1945 të kategorisë së lartëshenuar arrinë deri në 2048 persona.⁶⁸⁹

Gjykata për krime lufte u themelua më 15.12.1944. Kjo gjykatë po përdorej më tepër për ti eliminuar njerëzit që nuk kishin fare lidhje me fashizmin por vetëm si preteks për ti eliminuar ata dhe jo për të vendosur ndonjë drejtësi, siç edhe deklaroi Jacobs "...Gjyqetë tilla po përdoreshin për të hequr qafe kundërshtarët politik,..."⁶⁹⁰.

Opinion të kundërt me gjykatat kishte edhe populli, ku përmes shumë letrave i'u drejtohej kryeministrisë që tua falte jetrat e shumë të pafajshmëve që çdo ditë denoheshin pa asnjë mëshirë.

ELIMINIMI I INTELEKTUALËVE PAS ÇLIRIMIT

Gjatë përfundimit të Luftës së Dytë Botërore tanimë u vërjet se forcat e Boshtit po e humbisnin luftën dhe me ose pa Shqipërinë fundi i tyre po u dihej.

Duke u bazuar në këtë Enver Hoxha me bashkëpuntorët e tij e hartuan një strategji të marrjes së kontrollit në vend.

Në bazë të urdhërave që marrin vartësit e Enver Hoxhës në terren nga ai, vërehet qartë qëllimi dhe aplikimi i një strategjie të veçantë për eliminimin e pengesave që eventualisht pas çlirimit mund të u'a rrezikonin marrjen e pushtetit komunistëve.

Tendencat e paepura për pushtet e dërgojnë regjimin komunist aq largë sa që shumë autor e konsiderojnë edhe tradhëti kombëtare një veprim të tillë.

Autori më i zëshmi në këtë drejtim, Uran Butka në librin e tij Masakra e Tivarit, konstaton se pushkatimi i të rinjëve kosovar në Tivar ishte i projektuar nga PKJ dhe PKSH, ndërkaq veprimi i kësaj të fundit cilësohet si tradhëti kombëtare, duke argumentuar dhe ofruar fakte në zbardhjen edhe të rastit por edhe të qëllimit të kryerjes së këtij akti të tmerrshëm në Tivar, fatkeqësisht me ndihmën edhe të komunistëve shqiptarë⁶⁹¹.

Siç e kemi cekur dhe më lartë, krimet kundër njerëzimit nga ana e komunistëve shqiptarë kishin filluar edhe gjatë luftës, megjithatë fytyra e vërtetë e komunistëve të etur për pushtet filloi të zbulohet tërësisht pas çlirimit (28.XI.1944),

Në një document që studiuesi B. Fevziu e citon në librin e tij ' 100 Vjet Shtet', shihet qartë qëllimi dhe metodat që do të përdorë Enver Hoxha për të kontrolluar pushtetin e tij të sapofilluar : ' Të organizohen burgjet dhe fushat e përqëndrimit dhe të burgosen të gjithë ata element të akuzuar me faje të mëdha, me tradhëti të naltë dhe bashkëpunim të hapët. Të mos ketë mëshirë ndaj tyre....Të gjithë robërit të mblidhen në fushën e përqëndrimit, të mos bëhen arrestime në masë sepse veprime të tilla e trembin popullin....Kapni, arrestoni dhe ekzekutoni njerëz me ndikim që të bëhen shembull për popull.⁶⁹²

Po sipas të njëjtit autor, gjatë marrjes së kontrollit mbi teritorin e Shqipërisë, rreth 2000 veta u ekzekutuan pa gjyq, kundërshtarëve politik dhe të pushkatuarve por gjithashtu edhe tregëtarëve i'u konfiskua pasuria etj.

Gjatë gjithë periudhës komuniste denigrimi public, vrasjet, torturat, inskenimet ishin realitet e përditshmëri sidomos për intelektualët, megjithatë presioni më i madh ndodhi gjatë dekadës së parë.

⁶⁸⁹ Arkivi Qëndror i Shtetit (AQSH),F515,V.1945, D4, fl.1-22.

⁶⁹⁰ B.Fisher, 'SHqipëria 1943-45,Një vështrim përmes dokumentave perëndimore',AIIS 2012, fq 116.

⁶⁹¹ Almanak, Viti i dytë i botimit, nr. 2, ISKK, Tiranë 2012, fq.94.

⁶⁹² 100 Vjet –Një Ekskursion në Politikën e Shtetit Shqiptarë nga 1912-2012, Botimi II, UET Pres, Tiranë 2012, fq. 184.

Gjatë kësaj dekade nënvizojmë disa momente famëkeqe të represionit dhe euforisë nga PKSH, fushata këto të orientuara në shpërlajren masive të trurit.

fushata kundër rajonit të Shkodrës

hakmarrja ndaj prijësve fetar

eliminimi i opozitës demokratike

inskenimet nga shërbimi secret me rastin e shpërthimit në Ambasadën Sovjetike.

Euforia e tillë e Byrosë Politike dhe në tërësi PKSh, na bënë me dije se qëllim i vetëm final i tyre ishte marrja e pushtetit e jo rindërtimi e zhvillimi i vendit, duke e katandisur Shqipërinë në njërin ndërë vendet më të varfra të Evropës.⁶⁹³

HAKMARRJA PAS KRYENGRITJEVE NË KELMEND E POSTRIBË

Kryengritja e Kelmendit filloi më 13.01.1945 dhe zgjati 34 ditë gjerë më 16.02.1945.

Lufta u zhvillua në mes të burrave të Kelmendit dhe ushtrisë qeveritare. Kjo kryengritje u shua me dorëzimin e udhëheqësit të kryengritjes Prek Calit, I cili për të shpëtuar popullatën dhe sidomos të rinjtë u dorëzua pranë komandantit dhe fratit të Vuklit.

Kjo kryengritje ishte një paknaqësi e shumicës së popullit dhe u organizua kryekëput në vetëmborjtje të nderit, fesë dhe traditave shumëvjeçare të popullatës së Malësisë.

Bilanci i dëmeve ishte I madh diku rreth 200 persona të vrarë, 34 shtëpi të djegur, qindra të burgosur e mijëra të internuar.⁶⁹⁴

Pasojat e kryengritjes nuk ndodhën vetëm gjatë 34 ditëve por hakmarrja vazhdoi dhe ishte shumë më tragjike për një rajon të tërë siç është Malësia e Shkodra, ku si rajon gjatë një epoke të gjatë u etiketua si reaksionare, armike e tradhëtare. Intelektualët e saj u denuan, prijësit fetar të kësaj treve u denuan e u persekutuan në forma e mynyra më çnjerëzore. Dhe si rezultatë i kësaj, pasojat ende sot e kësaj dite vërehen, meqë rajoni i veriut edhe sot është prej regjioneve më të prapambetura ekonomikisht e infrastrukturor. Për dallim nga kryengritja në Kelmend, ajo e Postribës u organizua nga intelektualët dhe ishte decidivisht lëvizje për rrëzimin me forcë të regjimit komunist madje në bashkërendim edhe me vendet e Perëndimit.

Kryengritja e Postribës bëri një jehonë të madhe brenda e jashtë shtetit me përmasat organizative të saj.

Megjithatë suksesi nuk u arrit dhe kryengritja u shua, ndërsa udhëheqësit u pushkatuan e u denuan pa mëshirë.

E keqja e madhe ishte inkenimet e ndryshme nga shërbimi secret vetëm e vetëm për të kamofluar argumente të rrejshme, të kopjuara direkt nga BRSS e Jugosllavia komuniste. Raste të inskenuara thuajse pati në çdo rast të denimeve politike por më i paskrupullt është me fshehjen e armëve në Kuvendin Françeskan,ku me këtë rast u pushkatuan e u denuan shumë klerik.

Fatkeqësisht mllëfin e çdo reagimi të popullit e paguanin intelektualët dhe me këtë rast edhe klerikët pandashëm, ku kemi raste që intelektualët janë denuar me vdekje vetëm pse janë përshëndetur me ndonjë udhëheqës të kryengritjes, janë pushkatuar vetëm pse ka qenë mik shtëpije etj.

Dhuna dhe terrori nëpër burgjet e kampet komuniste ishin të tmerrshme saqë kishte raste ku nëna i lutej rojeve që t'ia vrisnin të birin vetëm të mos i'a torturonin më.⁶⁹⁵

⁶⁹³ Prapambeturia e Shqipërisë mund të I faturohet pa hezitim PKSH, ngase vrasja e intelektualëve të shquar dhe mbyllja e shumë shkollave prestigjioze perëndimore si p.sh. Shkolla Teknike Amerikane e Tiranës Henri Fulz shkaktoj ngecje në zhvillimin intelektual e ekonomik

⁶⁹⁴ U. Butka, 'Kryengritjet e Para Kundërkomuniste', ISKK, Tiranë 2012, fq.157.

Qëllimi I vetëm pse denoheshin e pushkatoheshin intelektualët ishte që të goditej truri I kombit.

Dëshmitari që përjetoi këto katrohura S.Repishiti deklaroi çka I thanë në hetuesi:

“Për ne më tha oficeri hetues “armiku” I vërtetë janë intelektualët dhe sidomos kleri katolik. Tregëtarëve u marrim pasurinë dhe njafton. Por pasuria e jujë është në kokë, në kulturë e ide perëndimore. Prandaj do t’jua presim kokën...”⁶⁹⁶

Represaljet ndaj klerikëve fetar

Klerikët 473ultu çdo vend komunist ishin të urryer e të përbuzur, ngase ishin pengesë e madhe për shtrirjen e komunizmit. Gjithashtu edhe në ideologjinë marksiste feja trajtohej si mbeturinë e panevojshme që u’a mpinë trurin njerëzimit.

Megjithatë Shqipëria ishte vendi që i tejkaloi të gjithë në këtë aspekt, duke u bërë vendi i vetëm në botë që e ndaloi më ligj ushtrimin e praktikave fetare.

Propagandës antifetare i’u ishin përveshur shumë institucione duke filluar nga sigurimi shtetëror që përgatiste inskenime të ndryshme sikurse për çdo rast të aktgjykimit politik e veçanërisht kur bëhej fjalë heqja e “mbeturinave” fetare përmes denimeve të prijësve fetar.

Poashtu në radhën e propagandës padyshim që radhitej kinemaja dhe radiotelevizioni, në një mision trushpërlarës ku thuajse në çdo moment apo film përçeshej feja dhe traditat shqiptare.

Nënçmimit e dhunës komuniste nuk i shpëtoi asnjë klerik, megjithatë përshkak të lidhjeve me perëndimin dhe me Vatikanin, prijësit katolik u vunë para një kasaphaneje të tmerrshme nga organet shtetërore të partisë shtet.

Ndërë klerikët e parë që u persekutuan, janë priftërinjtë françeskan, si hakmarrje ndaj lidhjeve të tyre me Italinë dhe përshkak të kryengritjeve në rrethinën e Shkodrës. Priftërinjtë fatkeqë janë: At Anton Harapi, Dom Lazër Shantoja, Dom Ndre Zadeja, At Lek Luli.

Gjithashtu skena dhune dhe torturash deri në eliminim përshkruhen edhe nga vet përjetuesit e këtyre terroreve si p.sh. At Zef Pllumbi, i cili në veprën e tij ndërë të tjera thot: “Ishim 29 priftërinj që punonim të ndarë. E kishim të qartë se aty do të vdesim. Këtë na e kishin deklaruar disa herë komandantët e burgut”.⁶⁹⁷

Përveq pushkatimit, denimit, internimit dhe nënçmimit të klerikëve fetar, lufta kundër fesë nga shteti, manifestohej me mbylljen e shkollave fetare, revistave të bashkësive fetare, mbyllja dhe asgjësimi i objekteve fetare etj.

Goditja ndaj fesë që e frikshme, rreth 2035 objekte kulti u mbyllën ose u shkatërruan, shumë prej tyre u bënë bare, restorante ose shtëpi kulture.⁶⁹⁸

VRASJA E OPOZITËS DEMOKRATIKE

Opozitë për regjimin komunist ishin të gjithë ata që nuk pajtoheshin me diktaturën por jo vetëm kaq por edhe të gjithë ata që nuk e përqaftonin me zellë komunizmin.

⁶⁹⁵ Torturat në burgjet dhe kampet e përqëndrimit në Shqipëri ishin më të tmerrshmet. Torturimi i madh i avokatit nga Shkodra Paulin Pali, e kishte detyruar nënën e tij që ti lutej rojeve ta vrisnin Paulinin, meqë atij gjatë torturave i’a kishin thyer kurrizin dhe dhimbjet i kishin të papërballueshme.

⁶⁹⁶ S.Repishiti, ‘Nën hijën e Rozafës’, Onufri, Tiranë 2004, fq.

⁶⁹⁷ At Zef Pllumbi, ‘Rrno vetëm për me tregue’, 55, Tiranë 2006, fq. 122.

⁶⁹⁸ B Fevziu, vep e cit....fq.209.

Siç e kemi cekur dhe më lartë shumë intelektual të mirëfilltë vetëm pse nuk pajtoheshin me ideologjinë komuniste, etiketoheshin si mbeturina borgjeze.

Shumë dijetar me renome botërore u pushkatuan vetëm për këtë shkak, siç po i veçojmë më poshtë tre të tillë : Asim Ambdurrahmani, farmacist, konsull nderi i Austrisë, Mit'hat Araniti përkthyes e studiues i madh, Kujtim Beqiri, inxhinier i rangut botëror.⁶⁹⁹

Ndaj eliminimit nuk kishte imunitet askush edhe për një të ri që tentonte ilegalisht ta kalonte kufirin e të mos flasim për një grup intelektualësh që tentonte ta themelonte një opozitë demokratike në Shqipëri. Ata do të denoheshin pa mëshirë nga pushkatimi, denimi me 30 vjet burgim dhe internimi.

Opozita u formua nga tri grupe : Grupi Monarkist, grupi i Rezistencës dhe grupi Socialdemokrat i Musine Kokalarit të cilët u bashkuan në një organizatë të quajtur Bashkimi Demokratik Shqiptarë.⁷⁰⁰

Më 11 janar 1946 u arrestua grupi i intelektualëve të lartëcekur, që u quajt grup i nxitur nga reacioni. Nga ky grup nënt veta u pushkatuan, shtatë të tjerë me denime të rënda deri në 30 vjet.

Një ndërë intelektualët e denuara me 30 vjet burgim ishte Musine Kokalari që ishte doktor shkence, ku dhe pas vuajtjes së denimit u internua dhe vdiç në internim.

Me denimin e opozitës, regjimi i'u bëri me dije të gjithëve se në Shqipëri po vendosej një diktaturë e tipit stalinist dhe jeta plurale po merrte fund.

Inskenime e persekutime gjatë periudhës 50 vjeçare të diktaturës komuniste kemi mjaft por sidomos gjatë dekadës së parë me ç'rast e tipit të njejtë është inskenimi i rastit të shpërthimit në Ambasadën Sovjetike, ku për këtë rast u arrestuan 108 veta dhe u pushkatuan pa gjyq 23 persona, ndërë ta edhe shkencëtarja e parë shqiptare Sabiha Kasimati shoqe klase e Enver Hoxhës.⁷⁰¹

⁶⁹⁹ Fjalor enciklopedik...vep. e cit. fq. 69, 121, 172.

⁷⁰⁰ U.Butka, Kryengritja...vep. e cit...fq.175.

⁷⁰¹ B.Fevziu,-100 vjet...vep. e cit. fq.187.

VEPRIMTARIA E FAN NOLIT NË MBROJTJE TË ÇËSHTJES SHQIPTARE NË VITET E PARA TË PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Erjon Dervishi

Abstrakt: Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri vendoset një sistem i ri, ai komunist. Diaspora shqiptare e Amerikës, Federata “Vatra”, vihet në dispozicion të plotë në përpjekje për të njohur ndërkombëtarisht Shqipërinë në arenën ndërkombëtare çështje e cila ishte primare për qeverinë komuniste. Ai që merr iniciativën është Fan Noli. Një figurë me eksperiencë në fushën diplomatike tek e cila besonte “Vatra”, organizatat e tjera në Amerikë dhe vetë udhëheqja komuniste e kohës. Si pasojë e ridimensionimit të ri të marrëdhënieve ndërkombëtare, të konsolidimit të shtetit shqiptar dhe të pamundësisë së bashkëpunimit të vetë organizatave shqiptare në Amerikë, Fan Noli do të dështojë në përpjekjet për afrimin e Shqipërisë me Perëndimin dhe në ftohjen e tij me regjimin komunist.

Fjale kyçe: Federata “Vatra”, Fan Noli, Enver Hoxha, Lidhje diplomatike.

Hyrje

Veprimtarinë e Fan Nolit në dobi të çështjes shqiptare është e pamundur që ta shkëpusësh nga Federata “Vatra”. Në momentet më vendimtare të historisë së Shqipërisë ai ka qënë prezent, duke ofruar njohuritë e tij diplomatike e kulturore, eksperiencën e tij dhe të gjitha këto pa marrë as edhe një post në hierarkinë politike shqiptare si shpërblim. Ndryshe nga Faik Konica, aleati dhe rivali i tij në politikë dhe në Federatën “Vatra” i cili shpesh herë diti të përfitonte nga kënaqësitë që offronte pushtetit, Noli i qëndroi besnik idealeve të tij duke mos u përzier me kompromiset dhe ofiqet e larta. Këtë ideal Fan Noli do ta ruante deri në fund të jetës së tij.

Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri formohet qeveria komuniste me Kryeministër dhe Ministër të Jashtëm Enver Hoxhën.⁷⁰² Federata “Vatra” e priti mjaft mirë çlirimin e Shqipërisë dhe priste me padurim që të bashkëpunonte me udhëheqjen e re. Detyra parësore e Shqipërisë ishte fitimi i njohjes ndërkombëtare nga aleatët e mëdhenj. Kjo njohje do t'i jepte mundësi regjimit që të fitonte legjitimitet ndërkombëtar. Menjëherë në skenë del “Vatra” duke angazhuar të gjitha kapacitetet e saj intelektuale dhe financiare në dobi të Shqipërisë. Por këtu fillon problemi. Përpara Luftës së Dytë Botërore “Vatra” ishte kthyer në një organizatë pothuajse në shërbim të plotë të Mbretit Zog, tashmë në ekzil, dhe disa herë kishte përdorur organin e saj periodik “Dielli” për t'i bërë elozhe politikës dhe doktrinës së Benito Musolinit.⁷⁰³ “Vatra” ishte e vetëdijshme se

⁷⁰² Historia e popullit Shqiptar, Vëll.4, fq, 168.

⁷⁰³ Gazeta, “Dielli”, 12 Maj 1938, art. “Doktrina e Benito Musolinit”, fq, 2.

qeveria komuniste me natyrën e saj etatiste⁷⁰⁴ nuk mund ta pranonte një shërbim të tillë nga kjo organizatë e cila ishte me natyrë liberale dhe nacionaliste. Për këtë arsye është Fan Noli ai që merr iniciativën për t'i ardhur në ndihmë Shqipërisë. Noli ishte njeri me peshë në diasporën shqiptare dhe tek i vetmi të cilët komunistët kishin besim kjo për shkak edhe të kaluarës së tij.

Fan Noli dhe qeveria komuniste

Angazhimet e "Vatrës" por edhe të "Shqipërisë së Lirë", një tjetër orgnizatë e krijuar më 1941 nga Chostandine Chekrezi, janë pasqyrim i mungesës së një autoriteti përfaqësues në mërgim gjatë Luftës së Dytë Botërore. Që nga pushtimi i Shqipërisë nga Italia fashiste nuk ka patur një përfaqësi të Shqipërisë jashtë vendit që të ishte e aftë për të bërë bashkimin ndërmjet tyre.⁷⁰⁵ Kjo situatë krijoi shumë amulli gjatë luftës dhe kontradita mes shumë atdhetarëve dhe vetë Mbretit Zog për të ardhmen e Shqipërisë paslufte. Kjo pasi kontaktet me Shqipërinë ishin shkëputur prej kohësh dhe si rrjedhim askush nuk kishte informacione të sakta për situatën që ishte krijuar në Shqipëri. Informacionet që vinin nga Shqipëria ishin të cinguara dhe shpesh herë të pasakta. Vetëm në fund të vitit 1944 "Vatra" mësoi se në krye të çetave partizane ishte një njeri që quhej Enver Hoxha.

Pamavarsisht këtyre pengesave Fan Noli filloi rrugën e tij për të ndihmuar në njohjen ndërkombtare të Shqipërinë. Gazeta "Dielli" shpesh herë u bë hapsirë për të analizuar situatën nërkombëtare dhe për të treguar itinerarin e Nolit në takimet e ndryshme që ai do të zhvillonte. Si fillim Noli u dërgoi telegrame të veçanta Amerikës, Anglisë dhe Bashkimit Sovjetik për njohjen e qeverisë provizore të Enver Hoxhës.⁷⁰⁶ Po ashtu edhe "Vatra" i bashkangjiti një letër në anglisht të tria fuqive të mëdha për njohjen ndërkombëtare të Shqipërisë dhe qeverisë së saj.⁷⁰⁷ Pas këtyre angazhimeve të para fillon një korrespondencë e gjatë mes Fan Nolit dhe Enver Hoxhës. Në një letër të datës 3/X/1945 Noli i shkruan se *"ka shumë dëshirë që të jetë me të tani por duke qënë se udhëtimet tani janë të kufizuara nuk është e mundur. Do të jem në shërbim tuajin dhe do të jap ndihmën time të plotë"*.⁷⁰⁸ Natyrisht që ky rast nuk mund t'i linte pa ikur Enver Hoxhës i cili ia dërgon menjëherë përgjigjen duke thënë se *"fjalët e juaja shprehin ndjenjat e larta patriotike dhe shpirtin e vërtet demokratik të gjithë vëllezërvet tanë në Amerikë"*.⁷⁰⁹ Gjatë kohës që Noli merrej me angazhime diplomatike nuk nguroi të përdorte edhe fondet e mbledhura nëpërmjet organizatës Albanian Relief Found për t'i ardhur në ndihmë shqiptarëve të cilët kishin dalë nga lufta tepër të demoralizuar. Sipas Qerim Panaritit, në atë kohë sekretar i "Vatrës" Noli shpenzoi nja pesë mijë dollarë prej fondit në fjalë, kusuri që mbeti nja 15 mijë dollarë, ia dorëzoi "Vatrës".⁷¹⁰ Megjithë këtë marrëdhënie "speciale" të krijuar midis Fan Nolit dhe Enver Hoxhës punët në dukje po ecnin mirë. Por me kalimin e kohës do të vihet re një ngurtësim midis tyre.

Pamundësinë e njohjes së Shqipërisë jashtë vendit e shqetëson edhe vetë udhëheqjen shqiptare. Në një raport të mbajtur më 1946 Komiteti Qendror i Partisë Komuniste

⁷⁰⁴ Rymë filozofike që lindi në Francë dhe që nënkupton se drejtimi dhe kontrolli i jetës ekonomike e shoqërore bëhet nga shteti. (Ian Mc Lean, "Fjalor Politik", fq. 132).

⁷⁰⁵ Foreign Relations of United States (FRUS), Vol.3, V.1944, "Albania", pg. 1.

⁷⁰⁶ Gazeta, "Dielli", 9 dhjetor 1944, art. "Imzot Noli përkrah lëvizjen e Kishave", fq. 1.

⁷⁰⁷ Po, aty, art. "Vatra endorses Appeal to Big Three", fq. 1.

⁷⁰⁸ Arkivi Ministrisë së Jashtme (AMPJ), Fondi i Përgjithshëm, V.1945, D.61, "Përsëndetje Fan Nolit Enver Hoxhës", fq. 5.

⁷⁰⁹ Po, aty, fq. 6.

⁷¹⁰ Qerim, Panariti, "Album I Hirësisë së Tij", fq. 85.

raporton se “Shoqënitë e Anglisë dhe Amerikës janë më të shumta në numër. Këto paraqiten si miq të Shqipërisë dhe neve duhet të dijmë me përfitue nga kjo miqësi e tyre. Ne duhet t’i bashkojmë ato për disa principe: për integritetin tokësor, për independencën e Shqipërisë e për një Shqipëri Demokratike. Kështu ato bëhen si protektore për këto qëllime, sot na intereson për me i bashkue sidomos për integritetin tokësor.”⁷¹¹ Më tej raporti vazhdon se “Në marrëdhëniet t’ona me këto shoqni duhet të kemi kujdes qi mos t’u hapim dyert e Shqipnis në asnjë mënyrë, dhe mos të lejojmë që të zhvillohen marrëdhënie kulturele e tregtare me ta. Tani sparit ne mendojmë se mund të shfrytëzojmë miqsin e tyre dhe t’i përdorim pse në fillim duhet të tregojnë me punë qi janë miq të Shqipërisë.”⁷¹² Pra nga ky raport del qartë se interesi i udhëheqjes shqiptare ishte thjesht përdorimi i këtyre organizatave për intereset e tyre. Nëse interesi i tyre binte ndesh me ato të “Vatrës” ose të “Shqipërisë së Lirë” atëhere ata mund të goditeshin si agjentë të perëndimit.

Në rrugën e saj të gjatë për njohjen ndërkombëtar Shqipëria po përballej me disa kërkesa të reja nga ana e Shteteve të Bashkuara dhe Britanisë së Madhe. Tashmë Amerika kishte vënë një klauzolë e cila e detyronte shtetin Shqiptar që të njohë të gjitha traktatet dhe marrëveshjet e lidhura midis Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara përpara vitit 1939. Amerikanët u mbajtën fortë mbas kësaj klauzole e cila do ta largonte Shqipërinë nga perëndimi për rreth pesdhjetë vjet. Legata jonë në Beograd njoftonte se “Amerikanët thanë gojarisht: Qëndrimi i Qeverisë Amerikane karshi nesh s’është si ai i Ingliterrës. Ajo do të njohë qeverinë tonë në rast se ne merremi vesh për traktatet.”⁷¹³ Tashmë ngjarjet po zhvilloheshin në drejtim të kundërt me dëshirat e Fan Nolit. Këtu fillon prova vendimtare e Fan Nolit. Cilin kah do të përkrahte ai. Kahun shqiptar pra atë të vendit të tij të lindjes për të cilën ai kishte luftuar aq shumë dhe për vite të tëra apo kahun amerikan, vend tek i cili ai jetonte tashmë prej shumë vitesh dhe zhvillonte aktivitetin e tij kishtar. Amerikanët ishin në djeni të aktivitetit që zhvillonte Noli në Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Shën-Gjergji. Kjo kishë shpesh herë është bërë tribunë e propagandës majtiste dhe e mbrojtjes së idealeve të shqiptarizms. Natyrisht Noli e zgjidhi dilemën duke përkrahur pikpamjen amerikane dhe duke kërkuar nga udhëheqja shqiptare njohjen e traktateve me Shtetet e Bashkuara. Noli e dinte dhe e kuptonte se ishte e pamundur të mbante nje qendrim ndryshe nga ai amerikan. Legata jonë në Beograd raporton për një letër të ardhur nga Fan Noli i cili shpjegon se “zyrtarët e Departamentit të Shtetit janë në pritje për heshtjen tuaj të gjatë në lidhje me çështjen e traktateve midis Shteteve të Bashkuara dhe Regjimit të mëparshëm të Shqipërisë.”⁷¹⁴ Më tej letra sqaron se “heshtja juaj prej disa muajsh inerpretohet si një akt mos-besimi. Ata ankohen gjithashtu se anëtarë të ndryshëm të Misionit Amerikan janë ndaluar të lëvizin dhe kjo me fjalë të tjera konsiderohet si kundërshtim. Ju sugjeroj përçapje të menjëhershme për të ndrequr situatën dhe për të përmisuar relatat me Shtetet e Bshkuara të cilat unë i konsideroj të mira për zgjidhjen e problemeve tuaja ndërkombëtare.”⁷¹⁵ Të njëjtat shqetësime Noli i pasqyronte edhe në takimet që ai zhvillonte më përfaqësues të shtetve të ndryshme të cilat ishin anëtarë të Kombeve të Bashkuara.

⁷¹¹ Arkivi Qendror Shtetëror (AQSH), Fondi 14/AP, V.1946, D.152/1, “Raport për kolonitë”, fq. 4.

⁷¹² Po, aty, fq. 4.

⁷¹³ AMPJ, FP, D.44, V. 1946, “Mbi vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me SHBA”, fq. 35.

⁷¹⁴ AMPJ, FP, D.61, V.1946, “Telegrafi i hapët inglisht i ardhur nëpërmjet Londrës nga Fan Noli”, fq. 7.

⁷¹⁵ Po, aty, fq. 7.

Këtë aktivitet të dëndur diplomatik e ka ndjekur nga afër edhe Charles C. Hart. Një shqiptaro-fil dhe ish-minister amerikan në Shqipëri i cili shpesh herë është ngarkuar nga "Vatra" për të mbrojtur çështjen shiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në disa letra që ai i dërgon John Nasses nënkryetar i organizatës "Shqipëria e Lirë" thotë se "Sekretari Brynes dhe anëtarë të tjerë të katër fuqive të mëdha do të kishin dëgjuar prezantimin tim për çështjen shqiptare e cila do të ishte e pakundërshtueshme nese do te ishim me aktive".⁷¹⁶ Më tej si deklaroi se "kështu si qëndron puna ne duket se e kemi humbr betejën për çështje lindore, sepse nuk ka patur fare prezantim për Shqipërinë dhe sepse paratë nuk janë të mjaftueshme."⁷¹⁷ Kjo tregon mjaft qartë se aktiviteti i Nolit nuk po merrej seriozisht qoftë nga Shqipëria qoftë nga Shtetet e Bashkuara dhe Britania e Madhe. Këtë situatë të vështirë për Shqipërinë e ka kuptuar vetë Hart i cili nuk e merr përsipër çështjen shqiptare. Ai shprehet se "duhen shumë para për t'ju ndihmuar për të dhënë këshilla por edhe për të shkruar ndonjë artikull në gazetatat e Parisit dhe tek Nju York Times Herald Tribune. Brynes dhe çdo anëtar i konferencës së paqes do të më lexoje se çfarë do të them. Do të mundohem që ta kap çështjen nga një këndvështrim tjetër nga ai i dy paraardhësve të mi."⁷¹⁸ Si përfundim të letërës së tij Hart deklaroi se "Peshkop Noli dhe të gjithë bashkpunëtorët e tij nuk e njohin situatën midis Shqipërisë dhe vendit tonë, prandaj ata po operojnë në një terren të rrezikshëm".⁷¹⁹

Duke mos mjaftuar këto pengesa, është vetë udhëheqja komuniste e cila po fillon që kolonitë në Amerikë t'i ketë në zotërim krejtësisht për qëllimet e saj politike. Synimi ishte i qartë, duhej propaganduar imazhi i Shqipërisë në Amerikë. Për këtë arsye një delegacion me në krye Tuk Jakovën u nis për në Amerikë. Rasti më i mirë ishte Konferenca Ndërkombëtare e Shëndetësisë që do të zhvillohej në New-York. Me këtë rast Enver Hoxha u dërgon një letër organizatave shqiptare në Amerikë. Në këtë letër Enver Hoxha shprehet se "Këta shokë janë Shqiptarët e parë që po vijnë nga Shqipëria e lirë e po takohen me ju. Ata do t'ju kallzojnë luftat e mëdha plot sakrifica po dhe plot heroizma që bëri populli ynë".... "Shokët që po vinë do t'ju thonë se populli ynë, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe unë personalisht i dimë dhe i kemi ndjekur me simpathi të veçantë përpjekjet e të gjithë juve, për lirinë dhe të drejtat e atdheut të largët".⁷²⁰ Mbas kësaj letrë, e cila e shpreh qartë së delegatët do të flasin vetëm për të mirat e Shqipërisë, fshihen të tjera synime. "Vatra" dhe Fan Noli duhej mbajtur nën kontroll. Në përfundim të mbledhjes së "Vatrës" më 4 korrik 1946 u ftua edhe delegacioni shqiptar. Natyrisht nga kjo mbledhje u nxorën shënime të hollësishme. Në raportin e paraqitur nga delegacioni shqiptar vihet re se që në kontaktin e parë ata morën mendimin e Fan Nolit dhe ai "u shpreh për ndihmat që di t'i dërgoheshin Shqipërisë e gjera të vogla".⁷²¹ Më tej ata deklarjnë se "Që të dyja organizatat na premtuan se do të mbajnë qëndrim të prerë kundrejt elementeve ballistë në Amerikë. Edhe për politikën e jashtme të Shqipërisë të mbajnë qëndrim të drejtë përsa i përket marrëdhënieve me Amerikën, por për këtë ju shmangen çdo premtimi, edhe vetë

⁷¹⁶ AMPJ, FP, D.61, V.1946, "Letter to Nasse", pg, 55

⁷¹⁷ Po, aty, pg, 55.

⁷¹⁸ Po, aty, fq, 56.

⁷¹⁹ Po, aty, fq, 56.

⁷²⁰ AMPJ, FP, D.144, V.1946, "Vëllezër Shqiptar të Amerikës", fq, 1.

⁷²¹ AMPJ, FP, D.144, V.1946, "Delegacioni Shqiptar në Amerikë", fq, 31.

ato të "Shqipërisë së Lirë".⁷²² Kjo tregon se Amerika do të ishte një problem midis "Vatrës" dhe udhëheqjes komuniste. Madje edhe vetë Noli do të bëhej pengesë. Përshtypjet e delegacionit për Nolin ishin mjaft të lëkundura. Ata deklarojnë se "Noli është i disponuar mjaftë kundrejt regjimit t'onë popullorë dhe se regreton akrobacirat e bëra me Zogun. Këtë dispozim e ka qoftë për principet dhe botkuptimin e tij, i cili sa do që të mos shkojë shumë larg, është demokratik; si dhe për dëshirën e msheftë që ka për t'u bërë një ditë përfaqësues permanent i Shqipërisë në UNO ose Kryetar i Kishës Autoqefale Orthodoxe të Shqipërisë."⁷²³

Duke parë këto stonime midis "Vatrës" dhe qeverisë komuniste Noli mundohet që ta mbajë largë organizatën tjetër në Amerikë "Shqipëria e Lirë", e cila shpesh herë ishte në kundërshti dhe rivalitet me "Vatrën", karshi regjimit komunist. Noli nuk mund ta lejonte që të humbiste reputacioni i tij përballë disa individëve të cilët në sytë e tij nuk kishin asnjë të kalur patriotike. Aq më tepër që rivali i tij kryesor Chekrezi kishte hequr dore nga "Shqipëria e Lirë" dhe i ishte përveshur mësimdhënies në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Fuqinë e tij brenda "Vatrës" e vërteton edhe delegacioni shqiptar që shkoi në Amerikë kur thotë se "në organizatën "Vatra" Noli është shefi i pakontestueshëm dhe i vetëm, me gjithëse besoj ruhet nga Qerim Panariti që e di se është në lidhje me Departamentin e Shtetit Amerikan".⁷²⁴ Në disa telegrame Noli i raportonte legatës tonë në Beograd se "John Nasse dhe gangserët e tij të të ashtuquajturit Komitet i Shqipërisë së Lirë bëjnë korrespondencë të fshehtë dhe kanë bashkëpunim me reaksionarët dhe fashistët përtej përmbysjen e regjimit t'uaj demokratik."⁷²⁵ Se me cilin bashkëpunon organizata "Shqipëria e Lirë", Noli ngurron ta thotë sepse nuk do që të fitojë armiqësinë e udhëheqjes komuniste, pasi kjo organizatë shikohej me simpati nga udhëheqja komuniste. Por kur Tuk Jakova, kryetar i delegacionit në Konferencën Ndërkombëtare të Shënderësisë, e akuzon Nolin si shkaktar të mosbashkëpunimit midis dy organizatave, Noli shperthen në akuza kundrejt tij. Në një letër që i dërgon Enver Hoxhës ai shprehet i irrituar për Tuk Jakovën si "njeri që nuk di shqip, as gegërisht as toskërisht. Në çdo dialekt që i flisnja ay nuk më merrte vesh nga shkak që është një budalla pa kulturë."⁷²⁶ Në përfundim Noli duke ndjerë edhe kontrollin që mundoheshin të bënin komunistët mbi të shprehet se "Në doni bashkëpunimin tim, duhet të dërgoni një njeri, i cili të më ketë besim dhe i cili të dijë të paktën shqip që të merremi vesh. Nga ana tjetër nuk duhet të më impononi zezekë të këtushëm si bashkëpunëtorë, të cilët ju nuk mund t'i njihni."⁷²⁷ Udhëheqja shqiptare e kishte kuptuar mjaft mirë këtë ngurtësim ndërmjet tyre dhe kolonive në Amerikë. Nga Shqipëria vjen një urdhëzim i ri për përfaqësiuesin tonë në New-York, Theodor Heba, e cila thotë se, "Të dy organizatat si "Vatra" dhe "Shqipëria e Lirë" po t'i shikojmë nga përberja e tyre, nuk kanë se si të ndjekin atë vijë politike që është në favor të vendit t'onë. Situata që ndyshej në Shqipëri i bëri ata të marën qëndrim të sipërfaqshëm se janë me ne por në të vërtetë nuk bëjnë gjë për Shqipërinë. Veçanërisht "Vatra" dhe krerët e saj".⁷²⁸ Më tej letra analizon çëshjen e

⁷²² Po, aty, fq, 33.

⁷²³ Po, aty, fq, 34.

⁷²⁴ Po, aty, fq, 31.

⁷²⁵ AMPJ, FP, D.61, V.1946, "Telegram për Enver Hoxhën", fq, 34.

⁷²⁶ AMPJ, FP, D.61, V.1946, "Letër Enver Hoxhës", fq, 1.

⁷²⁷ Po, aty, fq, 69.

⁷²⁸ AMPJ, FP, D.158, V.1947, "Letër e Hysni Kapos për Theodor Hebën, 4.9.1947", fq, 174.

bashkimit ndërmjet dy organizatave, çështje për të cilën ishte prishur edhe Fan Noli me delegacionin shqiptar, dhe shprehet se, *“Ne nuk e shtruan çështjen e bashkimit pse jo vetëm që nuk bashkohen por as na intereson bashkimi i tyre sa kohë që organizatat kanë shumicën e anëtarëve jo të mirë, sa kohë që në këtë organizatë është gjithë i departamentit të shtetit me agjentët e tij”*.⁷²⁹ Në fund vjen një orientim për Fan Nolin ku thuhet se, *“Përsa i përket priftit dhe deklaratave të tij për të cilin ti ç’faqe besimin se ai është i vendosur pa rezervë me ne, unë të them se ke mendim të gabuar, qëndrimi unë duhet të jetë i rezervuar kurdoherë por të mundohemi ta vëmë në shërbimin t’onë, të punojë në koloni e me anë tjetër të mos qëndrojë si bajraktar por influencën e tij t’a marin punëtorët përparimdashës të zotë dhe të zgjuar dhe këta ta kenë vendin nesër në drejtimin e kolonisë.”*⁷³⁰

Konkluzione

Megjithëse kjo letër tregon qartë çarjen e parë midis Nolit dhe Enver Hoxhës “Vatra” nuk u kursye në dhënien e ndihmave për shqiptarët. Qëndrimi karshi Shqipërisë do të marrë një drejtim tjetër mbas vitit 1947, kohë kur Shqipëria do të lidhet më shumë me bllokun lindor. Për këtë gjë “Vatra” dhe Fan Noli do të zhgënjehen me kalimin e kohës duke u bindur dhe duke hequr dorë përfundimisht nga Shqipëria. Dalëngadalë “Vatra” po kthehej nga një organizatë politike në një organizatë kulturore që do të merrej me botime librash dhe përkthime të ndryshme. E kundërta do të ndodhte me “Shqipërinë e Lirë” e cila do të bëhej pre e lehtë e sigurimit të shtetit dhe e cila do të finançohej nga Shqipëria. E gjitha kjo për t’i bërë propagandë një vendi i cili nuk njihej në perëndim dhe nga ku vetë besnikët e këtij regjimi po hiqnin dorë dalë nga dalë nga komunizma shqiptare.

Recensente:
Akademik Beqir Meta- Qendra e Studimeve Albanologjike, Tirane.
Prof.Dr. Romeo Gurakuqi- Universiteti Europain i Tirane

⁷²⁹ Po, aty, fq, 174.

⁷³⁰ Po, aty, fq, 176.

VËSHTRIM MBI VEPRIMTARINË E SHOQËRIVE TË PARA FEMËRORE NË SHQIPËRI NË VITET 1912-1924

Dr. Esilda Luku

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

Abstrakt

Ky punim ka për qëllim të analizojë veçoritë e lëvizjes femërore në Shqipëri, në vitet 1912-1924, duke u përqendruar tek aktiviteti dhe shtrirja gjeografike e shoqërive të para të grave, si dhe marrëdhëniet e tyre me homologet në Europë.

Shoqëritë femërore, të krijuara në qytete të ndryshme të Shqipërisë, synonin përmirësimin e pozitës së gruas në familje dhe në shoqëri, nëpërmjet ngritjes së nivelit arsimor dhe kulturor të saj. Ato kontribuan me hapjen e kurseve për mësimin me shkrim e këndim të gjuhës shqipe dhe zanateve të punës së dorës e të makinës për vajzat e gratë, që të siguronin burimet e nevojshme ekonomike. Objektivi i lëvizjes feministe shqiptare ishte kapërcimi i mentalitetit konservator dhe garantimi i lirive dhe të drejtave të barabarta të burrit me gruan, të sanksionuara në legjislacionin shtetëror të kohës.

Krahas përpjekjeve për emancipimin e femrës shqiptare, shoqëritë e grave kryen vepra bamirësie, duke ndihmuar vajzat e familjeve të varfëra të ndiqnin shkollën; duke dërguar ushqime, veshmbathje dhe barna për luftëtarët e ushtrisë kombëtare, si dhe duke mbledhur ndihma për muhaxhirët e Kosovës të strehuar në Kavajë. Gjithashtu, shoqëritë femërore kontribuan për çështjen kombëtare, nëpërmjet sensibilizimit të opinionit publik ndërkombëtar, për mbrojtjen e sovranitetit dhe të tërësisë tokësore të Shqipërisë nga synimet e shteteve fqinje.

Fjalë kyçe: shoqëri të grave, arsimimi, të drejtat e grave, çështja kombëtare, lëvizja feministe.

Idealet e lirisë dhe të barazisë frymëzuan lëvizjen femërore në Perëndim, që përkon me periudhën e Revolucionit Francez, në fund të shek. XVIII. Gratë në Paris dhe qytete të tjera të Francës ishin të parat që formuan klubet e tyre dhe hartuan "Deklaratën për të Drejtat e Grave", në të cilën kërkohej respektimi i të drejtave natyrore njëloj për të dyja gjinitë.⁷³¹ Kjo pikëpamje mbështetej edhe nga ideologët e feminizmit liberal, si Mary Wollstonecraft dhe John S. Mill, që mohonin dallimet në aspektin e kapacitetit mendor midis meshkujve dhe femrave. Ata argumentonin se pozita dytësore e grave në shoqëri i atribuohet pabarazisë së mundësive.⁷³² Teza iluministe mbi të drejtat qytetare udhëhoqi

⁷³¹ Sabit Alidema, *Bota dhe femra shqiptare*, Tiranë: Emal, 2011, f. 224

⁷³² Zekerije Demir, *Feminizmi modern dhe postmodern*, Shkup: Logos A, 2006, f. 55

po ashtu feministet në SHBA, të cilat miratuan, më 1848, “Deklaratën e Pikëpamjeve”, të përpiluar në përputhje me Deklaratën Amerikane të Pavarësisë. Përpjekjet për përmirësimin e gjendjes ekonomike e shoqërore të femrës nxirrnin në pah nevojën për të garantuar të drejtën politike, me të cilën identifikohet veprimtaria e sufraxhets në Britani e SHBA.⁷³³

Organizimi i gruas shqiptare në lëvizjen feministe, në fillim të shek.XX, është relativisht i vonë krahasuar me shtetet e zhvilluara perëndimore. Kjo shpjegohet me disa faktorë, si: 1) sundimi pesëshkullor osman që pengoi aspiratat e shqiptarëve për liri dhe shtet kombëtar; 2) prapambetja e thellë ekonomike në vend, që nuk lejoi shkëputjen e gruas nga ekonomia e mbyllur shtëpiake; 3) funksionimi i të drejtës zakonore dhe normave të komuniteteve fetare që rrenjosën koncepte të fanatizmit dhe konservatorizmit në lidhje me rolin e gruas në familje e në shoqëri dhe, së fundi, mungesa e një sistemi arsimor kombëtar diktoi mbizotërimin e analfabetizmit, sidomos në popullsinë femërore.⁷³⁴

Në këtë situatë, u krijua në qytetin e Korçës shoqëria e parë e grave “Yll'i Mëngjezit”, në janar 1909, me iniciativën e intelektualeve të shquara Sevasti e Parashqevi Qiriazit. Detyra kryesore e shoqërisë ishte arsimimi i vajzave dhe grave, me ndikim të drejtpërdrejt në përparimin e kombit. Krahas mësimin të gjuhës shqipe, aktiviteti i shoqërisë përfshinte zhvillimin e konferencave me tema mbi historinë, edukatën, moralin, por edhe dhënien e shfaqjeve teatrale, siç ishte vënia në skenë e pjesëve të dramës së Vilhelm Telit.⁷³⁵ Veprimtaria arsimore, kulturore dhe artistike e shoqërisë “Yll'i Mëngjezit” u vë nën presionin e xhonturqve, të cilët kushtëzuan mbylljen e saj, më 1911.

Shpallja e pavarësisë dhe formimi i shtetit kombëtar krijuan premisa për riorganizimin e lëvizjes femërore. Me njohjen zyrtarisht nga Qeveria e Përkohshme e Vlorës filloi përsëri aktivitetin, më 27 shkurt 1913, shoqëria “Yll'i Mëngjezit”. Në praninë e 100 zonjave korçare, shoqëria zgjodhi komisionin dhe pleqësinë, me kryetare znj. Sevasti Dako. Veprimtaria e saj do të diskutohej në mbledhjen e përjavshme, ndërsa dy takimet e tjera në mes të javës kishin për qëllimin mësimin e shkrimit dhe të leximit nga anëtarët e shoqërisë prej mësueseve të shkollës së “Vashave”. Për Parashqevi Qiriazin ishte e domosdoshme kapërcimi i mendësisë së prapambetur, duke ndërgjegjësuar pikësëpari gratë për rolin e tyre në shoqëri. “Le të mos na gënjejë mendja duke thënë, “ç’ mund të bëjmë ne, ne jemi gra”. Mund të bëjmë shumë. Po duhet të punojmë me gjithë zemër, duke ndihmuar njëra-tjetrën dhe duke pasur ndërmend gjithnjë se “Dora që tund djepin urdhëron botën””.⁷³⁶

Një tjetër shoqëri e grave u themelua në qytetin e Vlorës, më 10 maj 1914, me mbështetjen e M. S. Mbretëreshës së shqiptarëve, Sofisë. Shoqëria “Shpresa Kombëtare”, e kryesuar nga zonja e Syrja bej Vlorës, synonte mbledhjen e ndihmave për vëllezërit e mjeruar të jugut që vuanin nga barbarizmat greke.⁷³⁷ Ajo i bënte thirrje popullit shqiptar për të kontribuar, sepse “në jug të Shqipërisë burra e gra, foshnje e pleq janë therrur me bajoneta, janë shkrumbitur në zjarr, janë munduar e janë shkelur tiranisht. Kasollet e katundevet, shtëpitë e bujqërvet kanë ulur kryet në tokë e janë bërë

⁷³³ Anthony Giddens, *Sociologjia*, Tiranë: Çabej, 2004, f. 184

⁷³⁴ Prof. as. dr. Fatmira Musaj, “Roli i shoqërive të grave dhe i shtypit të tyre”, *Diana*, viti I, nr. 1, mars 2003, f. 8

⁷³⁵ Drita Siliqi, Gruaja shqiptare: Probleme të gruas në shtypin e Rilindjes dhe Pavarësisë, Tiranë: Globus R., 2003, f. 20

⁷³⁶ Arkivi Qendror Shtetëror (AQSH), F47 (Parashqevi Qiriazit), V. pa vit (1912-1924), D. 13, Fl. 1

⁷³⁷ “Lypset kujdesim për femëra”, *Shpresa Kombëtare*, viti I, nr. 1, Vlorë, 6 shkurt 1921, f. 1

hi e pushuan së nxjerri tym".⁷³⁸ Një gjendje e tillë brenda vendit do të përkeqësohej me shpërthimin e Luftës së Parë Botërore, që e shndërroi Shqipërinë në një shesh beteje të ushtrive ndërluftuese, duke detyruar të dyja shoqëritë e grave të ndërprisnin aktivitetin e tyre.

Por, përfshirja e tokave shqiptare në konfliktin ushtarak të Fuqive të Mëdha nuk pengoi krijimin e "Shoqërisë vepruese ndihmëtare të grave të Shkodrës", më 1917. Misioni i saj ishte të lehtësonte ndjekjen e shkollës nga fëmijët e varfër të qytetit, duke i ndihmuar veçanërisht me veshje dhe ushqim. Kjo shoqëri arriti të mbledhte prej bujarisë së bamirësve ushtarakë dhe civilë jo më pak se 16.773 korona, deri në muajin Prill të vitit 1917. Në emër të Shoqërisë nënshkruanin Maria Trollman, Elisabeta Halia dhe Augusta von Kral.⁷³⁹

Përfundimi i Luftës së Parë Botërore shënoi rifillimin e aktivitetit të shoqërive të grave në qytete të ndryshme të Shqipërisë. Lëvizja feministe e pasluftës u përqendrua jo vetëm në arsimimin dhe emancipimin e femrës shqiptare, por edhe në kryerjen e veprimtarive me karakter bamirës dhe në mbrojtje të çështjes kombëtare. Në këtë periudhë, qendra më e rëndësishme e lëvizjes femërore ishte qyteti i Korçës, ku ndodhej shkolla e vashave. Ish nxënëset e saj u angazhuan në mësimdhënie për ngritjen e nivelit arsimor e kulturor të vajzave dhe grave.

Më 6 prill 1919, u themelua shoqëria e zonjave të Korçës "Përlindja", me kryetare Thomaidha Race. Në nenet 2 dhe 3 të Kanonizmës përcaktohej se qëllimi i shoqërisë ishte: a) përparimi i femrave korçare, arsimimi, zgjimi dhe dorëlëshimi i gruas; b) mirëbërësia tek gratë dhe vajzat e varfëra dhe, c) stërvitja e vajzave në shkolla. Për realizimin e këtij objekti shoqëria do të përkujdesej për përhapjen e mësimin të gjuhës shqipe dhe frënge midis femrave, si dhe të përkthente librat e nevojshëm nga gjuhët europiane në gjuhën amtare. Gjithashtu, ajo do të ndihmonte vajzat e varfëra të vazhdonin mësimet e tyre në shkolla më të larta.⁷⁴⁰

Shoqëria "Përlindja" botoi organin e saj "Mbleta", me synim që të informonte mbi aktivitetin e zonjave anëtare, të vetëdijësonte vajzat dhe gratë për pozitën e tyre në familje e në shoqëri dhe të siguronte bashkëpunimin e tyre për emancipimin e femrës shqiptare. Artikujt e revistës përfshinin tematika të tilla, si: edukimi i fëmijës, këshilla për mënyrën e sjelljes së femrës, çështje të hijenës dhe të shëndetit etj.⁷⁴¹ Për mungesë fondesh, revista "Mbleta" arriti të botonte vetëm tetë numra.⁷⁴²

Kontradiktat e brendshme për drejtimin e shoqërisë së zonjave të Korçës "Përlindja", me mbi 300 anëtare, shkaktuan shkëputjen e një fraksioni të konsiderueshëm, që themeloi shoqërinë "Përlindja Shqiptare", me kryetare Evanhi Kotten. Ndërsa, 70 anëtarët dhe simpatizantët e mbetura u riorganizuan dhe formuan shoqërinë femërore me emrin "Rilindja", nën kryesinë e zonjës Helidhona Falli. Ajo shprehte keqardhjen për përçarjen e shoqërisë së grave të Korçës, që shtonte problemet financiare dhe mungesën e efikasitetit në zgjidhjen e çështjeve që preokuponin femrën shqiptare.⁷⁴³

⁷³⁸ AQSH, F.447 (Shoqëria ndihmëtare e grave të Vlorës), V. 1914, D. 203, Fl. 1

⁷³⁹ AQSH, F.447 (Shoqëria vepruese ndihmëtare e grave Shkodër), V. 1917, D. 172, Fl. 1

⁷⁴⁰ AQSH, F. 447 (Shoqëria e grave "Përlindja shqiptare" në Korçë), V. pa vit, D. 297, Fl. 2-3

⁷⁴¹ Maria Kalapohtaqi, "Shëndetësia e lehonës", *Mbleta*, viti I, nr. 4, Korçë, prill 1922, f. 53-58

⁷⁴² "Lajmërim", *Mbleta*, viti I, nr. 4, Korçë, prill 1922, f. 63-64

⁷⁴³ AQSH, F. 447 (Shoqëria e grave "Rilindja", Korçë), V. 1924, D. 128, Fl. 2, 6

Ndihmesë të vyer për zhvillimin e lëvizjes feministe, në planin përmbajtësor dhe organizativ, dha Mit'hat Frashëri, Ministër Fuqplotë i Shqipërisë në Athinë. Ai kishte një letërkëmbim të rregullt me kryetaret e shoqërive të grave të Korçës, më 1924, të cilat i këshillonte mbi nevojën e krijimit të degëve të reja në qytetet e Shqipërisë. Sipas tij, duke komunikuar me zonjat që njihnin, për t'i dërguar ndihma në veshmbathje për të varfërit, shoqëria do të siguronte: a) fitime materiale nga plaçkat që do të mblidhte; b) zonjat e qyteteve do t'a ndienin veten të interesuar për avancimin e shoqërisë dhe, c) nëpërmjet bashkëpunëtorëve të reja do të zgjerohej aktiviteti i shoqërisë në shumë vise, në shërbim të njerëzisë.⁷⁴⁴

Në korrespondencën me drejtueset e shoqërisë "Përlindja Shqiptare" dhe "Rilindja" të Korçës, Ministri shqiptar në Athinë, i bënte të ditur vendosjen e marrëdhënieve me Lady Aberden, Kryetare e Lidhjes Internacionale të Shoqërive të Grave në Skoci, dhe Nënkryetaren, Henni Forchhemmer, njëkohësisht drejtuese e Shoqërisë së Grave në Kopenhagen të Danimarkës. Mit'hat Frashëri i ftonte anëtarët e lëvizjes feministe të merrnin pjesë në kongresin e afërt për paqen e përbotshme dhe të ndiqnin punimet e konferencave ndërkombëtare.⁷⁴⁵ Ato duhet të komunikonin edhe me shoqëritë e tjera të grave në Shqipëri, për të zgjedhur përfaqësuesen e tyre në Zyrën Ndërkombëtare të Grave në Gjenevë.⁷⁴⁶

Përpos bashkërendimit të veprimtarisë me lëvizjen feministe botërore, gruaja shqiptare nuk qëndroi indiferente ndaj problemit kombëtar, duke marrë pjesë në frontin e luftës për çlirimin e Vlorës nga pushtuesit italianë (1920), apo nëpërmjet përkrahjes materiale dhe shpirtërore për mbrojtjen e kufijve të vendit nga sulmet e ushtrisë malazeze.⁷⁴⁷ Ndihma ndaj ushtrisë kombëtare ishte qëllimi themelor i krijimit të Komitetit "Grueja shqiptare", në gusht 1920, në qytetin e Shkodrës, me kryetare Shaqe N. Çoba. Nën qeverisjen e Kryeparisë, Komiteti kishte për detyrë: a) mbledhjen dhe shpërndarjen e ndihmave; b) dërgimin e letrave dhe pakove të veçanta në destinacion; c) shërbimin ndaj të sëmurëve në spitale e në fushë të luftës dhe, ç) përkujdesjen për familjet e larguara për shkak të luftës.⁷⁴⁸

Të udhëhequra nga ndjenjat patriotike, anëtarët e Komitetit "Grueja shqiptare" i drejtuan një thirrje familjeve shkodrane, sidomos grave, për të kontribuar 2-5 korona në muaj për frontin.⁷⁴⁹ Gjithashtu, ato i kërkuan Këshillit të Ministrave t'i linte në dispozicion mjete udhëtimi për dërgimin e pjesëtarëve të Komitetit në lëmë të luftës, që të kryenin shërbimet e nevojshme për të plagosurit.⁷⁵⁰ Ndërsa, nota për Ministrin e Punëve të Brendshme, Ahmet Zogu, përmbante kërkesën e zonjave shkodrane, për realizimin e procedurave, mbi dorëzimin në arkën e Komitetit "Grueja shqiptare" të shumës së të hollave që gjendeshin në arkën e shoqërisë Bashkveprore, me qëllim që t'i shfrytëzonin për blerjen e sendeve të dobishme për luftëtarët.⁷⁵¹

⁷⁴⁴ AQSH, F.447 (Shoqëria e grave "Përlindja shqiptare", Korçë), V. 1924, D. 127, Fl. 4

⁷⁴⁵ *Ibid.*, Fl. 1

⁷⁴⁶ Fatmira Musaj, *Gruaja në Shqipëri në vitet 1912-1939*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, 2002, f. 119

⁷⁴⁷ Fatmira Musaj, "Aspekte të lëvizjes femërore në Shqipëri gjatë viteve 1912-1924", *Studime historike*, Viti L, nr. 1-4/ 1996, Tiranë: Akademia e Shkencave e RSH, Instituti i Historisë, 1997, f. 31-32

⁷⁴⁸ AQSH, F.447 (Komiteti "Grueja Shqiptare", Shkodër), V. 1920, D. 176, Fl. 1

⁷⁴⁹ AQSH, F.447 (Komiteti "Grueja Shqiptare", Shkodër), V. 1920, D. 177, Fl. 1

⁷⁵⁰ AQSH, F.447 (Komiteti "Grueja Shqiptare", Shkodër), V. 1920, D. 178, Fl. 2

⁷⁵¹ AQSH, F.447 (Komiteti "Grueja Shqiptare", Shkodër), V. 1920, D. 179, Fl. 1

Aktiviteti i Komitetit “Grueja shqiptare” tregonte qartë karakterin bamirës të tij, i organizuar pothuaj në formën e Kryqit të Kuq, anëtarët e të cilit ndihmuan bujarisht ushtrinë kombëtare në luftën në Koplik, duke ndarë tesha e mjete të tjera, pa u frikësuar nga rreziku i pranisë në llogore.⁷⁵² Madje, kontributi i grave shkodrane nuk u kufizua vetëm brenda vendit, por u shtri edhe në arenën ndërkombëtare, me thirrjen drejtuar zonjave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për t’u solidarizuar në mbrojtje të çështjes shqiptare, në respekt të deklaratës së “14 pikave” të Presidentit Wilson, për të drejtën e vetëvendosjes së kombeve të vegjël, gjatë punimeve të Konferencës së Paqes në Paris.⁷⁵³

Në shërbim të qytetarisë dhe përparimit të atdheut, gratë shkodrane ishin të parat, ndër të gjitha zonjat e qyteteve të tjera të Shqipërisë, që themeluan të përkohshmen e tyre.⁷⁵⁴ Revista mujore me të njëjtin emër përmbante literaturë mbi të drejtat dhe detyrat e grave, artikuj për rolin dhe pozitën e gruas në familje, me titujt: “Feminizmi”, “Familja”, “Prindër të mirë”, “Vajzës shqiptare”, “Detyrat e nanës” etj., si dhe lajme me të dhëna të hollësishme për prodhimet farmaceutike dhe të mirat materiale që Komiteti dërgonte në spitale dhe në frontin e luftës.⁷⁵⁵

Në numrin 5 të revistës “Grueja shqiptare”, të muajit mars 1921, Parashqevi Qiriazi lajmëronte krijimin e shoqërisë së zonjave, në Tiranë, më 27 dhjetor të vitit të kaluar. Qëllimi kryesor i shoqërisë ishte të ndihmonte gratë shqiptare të përparonin në arsim, duke hapur katër klasa, përkatësisht për mësimin e shkrimit dhe të këndimit për zonjat që nuk kishin patur mundësi të shkolloheshin, mësimin e gjuhës angleze e frënge, si dhe punë dore. Anëtarët e shoqërisë “Grueja shqiptare” në Tiranë shfaqnin gëzimin për ngritjen e shoqërive të zonjave në qytetet e tjera të Shqipërisë, duke evidentuar nevojën e bashkëpunimit midis tyre, për përmbushjen e misionit të përbashkët dhe të shtrenjtë të emancipimit të femrës shqiptare.⁷⁵⁶

Lufta kundër analfabetizmit nuk mund të kuptohej pa pjesëmarrjen e gruas, e cila ishte mësuesja më e mirë dhe shkolla e parë për fëmijën. Ajo, e pajisur me kulturë të gjerë dhe ndjenja fisnike, do të përgatiste brezin e ardhshëm të denjë për ndërtimin e një shoqërie të qytetëruar.⁷⁵⁷ Përpjekjet për përhapjen e arsimit kushtëzuan po ashtu formimin e shoqërisë së vajzave korçare, me emrin “Çvillimi”, që u miratua me vendim të Këshillit Administror të Prefekturës të Korçës, më 4 korrik 1921.⁷⁵⁸

Një organizim tjetër i grave me vokacion për çështjen e edukimit të femrës shqiptare, si instrumenti kryesor për nxjerrjen e saj nga padituria e prapambetje, ishte ripërtëritja e shoqërisë “Shpresa Kombëtare”, në qytetin e Vlorës, më 1921. Programi i saj përqendrohej tek “përparimi dhe lartësimi, moral e material, i femrës, duke u përpjekur me të gjitha fuqitë, që t’i forcojë ato zakone të mira që i kanë mbajtur lart dhe të lavdëruara femrat shqiptare; dhe, të thithen si bleta, nga ato të botës, që mund të

⁷⁵² Roza Skiró – Rasha, “Randësija e Shoqënis së Grave”, *Republika*, vjeta 2, nr. 24, Shkodër, 17 Prillë 1924, f. 3

⁷⁵³ AQSH, F.447 (Komiteti “Grueja Shqiptare”, Shkodër), V. pa vit, D. 47, Fl. 1

⁷⁵⁴ “E Përkohshmëja e ynë!”, *Grueja Shqiptare*, vjeti I, nr. 8, Shkodër, Shtyshkroja Franciskane, Qershuer 1921, f. 61

⁷⁵⁵ “Sende të çueme në lamë të luftës”, *Grueja Shqiptare*, vjeti I, nr. 2, Shkodër, Shtyshkroja Franciskane, Dhjetuer 1920, f. 17

⁷⁵⁶ “Program i Shoqnis së zonjavet “Grueja Shqiptare” në gjytet e Tiranës”, *Grueja Shqiptare*, vjeti I, nr. 5, Shkodër, Shtyshkroja Franciskane, Marc 1921, f. 34-35

⁷⁵⁷ Zoi Xoxe, “Gruaja shqiptare në shoqërinë njerëzore”, *Drita*, viti III, nr. 84-9, Gjinokastrë, E premtë, 14 Prill 1922, f. 4

⁷⁵⁸ AQSH, F. 447 (Shoqëria e vajzave “Çvillimi”, Korçë), V. 1921, D. 125, Fl. 2-5

pajtohen me të vetat, për plotësimin dhe mbarimin e detyrës së lartë, që femra ka kundrejt shtëpisë, shoqërisë dhe mëmëdheut”.⁷⁵⁹

Krahas zhvillimit intelektual, pozita e dobishme e femrës vërehej edhe në marrëdhëniet shoqërore dhe ekonominë e vendit. Prandaj, nevojitej respektimi i të drejtave ekonomike të grave, duke i garantuar mundësi të barabarta punësimi jashtë ekonomisë shtëpiake. Degët më potenciale të angazhimit të grave në qytete ishin: “Shkodra, me pelhurat e saj të nryera dhe të bardha ...; Kruja në të qëndisurit e gjilpërës; Tirana aq e përparuar në hollësinë e punimit të mëndafshit; gjithë femrat e Shqipërisë së jugut, qëndisëse dhe mjeshtrë për shtroje dhe hallia të leshta me push; Krahina e Vlorës, me ato shajakëra të leshta, aq të pëlqyera, që t’i punonte femra evropiane, do të merrte lavdet për zotësimin dhe çmimet kombëtare të saj, më të pëlqyera”.⁷⁶⁰ Për këto arsye, paraqitej imediate marrja e masave për organizimin më të mirë të punës së gruas, që do të sillte zhvillimin e ekonomisë dhe rritjen e pasurisë ndër viset e Shqipërisë.

Ndryshe nga lëvizja femërore europiane, shoqëritë e grave në Shqipëri nuk lobuan për sigurimin e të drejtës universale të votës. Deputetët konservatorë në parlament kundërshtonin dhënien e të drejtës elektorale grave, me argumentin se nuk kishin nivelin e duhur të edukatës politike dhe pavarësinë e ndërgjegjes. Ndërsa, grupet liberal-demokrate këmbëngulnin të paktën t’u garantohej e drejta e votës grave të cilat dinin shkrim e këndim. Por, me shumicë votash, parlamenti hodhi poshtë projektligjin për të drejtën e përgjithshme elektorale të femrës, duke përjashtuar nga angazhimi politik gjysmën e popullsisë. Pabarazia juridike midis femrave dhe meshkujve në aspektin politik ishte tregues për shkallën e qytetërimit të kombit.⁷⁶¹

Më 25 korrik 1924, në qytetin e Gjirokastrës u themelua shoqëria mirëbërëse e zonjave dhe e zonjushave me emrin “Përmirësimi”, që kishte për qëllim: a) mbrojtjen e vajzërisë orfane gjirokastrite, moralisht dhe materialisht, duke e udhëzuar në stërvitjen e punës dhe duke u përkujdesur për vazhdimin e saj në shkollë; b) përmirësimin e jetës familjare dhe shoqërore, me anë të zhvillimit periodik të konferencave me tema mbi detyrën e gruas si “ekonome”, “mëmë”, “motër”, “bashkëshorte” dhe si grua anëtare e shoqërisë njerëzore; c) përhapjen e arsimit dhe zanatit përgjithësisht në zonjushat e zonjat e qytetit, duke u dhënë mësim praktikë në gjuhë, aritmetikë e punë dore, dy herë në javë.⁷⁶² Shoqëria “Përmirësimi” ekspozonte për t’u shitur punët e dorës së grave dhe të ardhurat e siguruara u dhuroheshin familjeve të varfëra. Nuk mungonin as veprimtaritë argëtuese, si shëtitjet e përbashkëta jashtë qytetit apo ndjekja me interes e shfaqjeve teatrale, të përgatitura nga vajzat e shkollës femërore “Koto Hoxhi” të Gjirokastrës.⁷⁶³

Ndërsa, gratë e kryeqytetit, të nxitura nga oksidentalizmi i Kryetarit të Bashkisë, në kuadër të fushatës së transformimit të Tiranës, kërkuan ndërtime të një parku femëror, që do t’i mësonte gratë të jetonin të shoqëruara.⁷⁶⁴ Përgatitja e femrave për një jetesë moderne përcaktohej edhe në statutin e shoqërisë së grave “Shqiptarka”, të themeluar në Tiranë, më 24 mars 1924. Nën kryesinë e Sevasti S. Dakos, qëllimi i shoqërisë ishte

⁷⁵⁹ “Lypset kujdesim për femëra”, *Shpresa Kombëtare*, viti I, nr. 1, Vlorë, 6 shkurt 1921, f. 1

⁷⁶⁰ Elisa Blazaj, “Zotësim dhe punë me çemesë”, *Shpresa Kombëtare*, viti I, nr. 1, Vlorë, 6 shkurt 1921, f. 3

⁷⁶¹ Fatmira Musaj, “Probleme të gruas në parlamentin e viteve 1921-1924”, *Studime historike*, viti XLIX, nr. 1-4/ 1995, Tiranë: Akademia e Shkencave e RSH, Instituti i Historisë, 1997, f. 67-70

⁷⁶² AQSH, F447 (Shoqëria mirëbërëse të zonjave “Përmirësimi”), V. 1926, D. 98, Fl. 1-3

⁷⁶³ D. Siliqi, *op.cit.*, f. 27-28

⁷⁶⁴ “Pak mëshirë për të mjerat gra”, *Shqiptari i lirë*, viti I, nr. 16, Tiranë, E hanë, 22 korrik 1923, f. 2

përhapja e arsimit tek gratë shqiptare për të rritur dashurinë midis tyre dhe ndaj Atdheut; mbrojtja e zakoneve të pëlqyeshme dhe lufta kundër çdo vesi e tradite që dëmtonte moralin e tyre. Këto objektiva diktuan hapjen e kurseve kundër analfabetizmit, për punimin e mëndafshit, dhënien e instruksioneve arsimore për punët shtëpiake etj.⁷⁶⁵ Për më tepër, shoqëria "Shqiptarka" e grave të Tiranës, duke marrë parasysh gjendjen kritike të muhaxhirëve të Kosovës, që ndodheshin në Kavajë,⁷⁶⁶ vuri në dispozicionin një shumë të hollash nga arka e shoqërisë. Gjithashtu, ajo bëri thirrje për mbledhjen e ndihmave, të cilës iu përgjigjën vetëm disa tregtarë të Durrësit dhe mësuesit e nxënësit e shkollës fillore femërore që kontribuan me grumbullimin e petkave të përdorura. Ndihmat konsistonin në 500 palë rroba për gra, fëmijë e burra, të cilat u paketuan për t'u dërguar në Kavajë.⁷⁶⁷ Pas përfundimit me sukses të kësaj vepre bamirësie, kryetarja Sevasti K. Dako dhe nënkryetarja Shadije Bogdo falenderuan Ministrinë e Brendshme, atë të Punëve Botore, të gjithë zyrtarët e tjerë, si dhe zonjat për ndihmën e tyre bujare ndaj shoqërisë femërore të Tiranës.⁷⁶⁸

Por, zhvillimet politike në Shqipëri, me përmbysjen e kabinetit të F. Nolit dhe rikthimin në pushtet të Ahmet Zogut, kushtëzuan ndryshimin e politikës në raport me lëvizjen femërore, nëpërmjet centralizimit dhe rritjes së kontrollit të autoriteteve qeveritare në organizimin e shoqërive të grave shqiptare.⁷⁶⁹ Këtë fakt e vinte në dukje Evanthe Kotte, kryetare e shoqërisë "Përlindja" të Korçës, në letrën dërguar Mit'hat Frashërit, të cilit, pasi i shprehte mirënjohjen për kontributin moral dhe material në lulëzimin e shoqërive femërore, e informonte me hidhërim për veprimin e qeverisë mbi mbylljen e dy shoqërive të grave korçare, në janar 1925, që kishte dëshpëruar dhe shkurajuar anëtarët të riorganizoheshin në lëvizjen feministe.⁷⁷⁰

Përfundime

Lëvizja femërore, në vitet 1912-1924, përkon me veprimtarinë e shoqërive të para të grave në Shqipëri, të cilat kishin për qëllim përmirësimin e gjendjes së gruas në familje dhe në shoqëri, duke e larguar atë nga prapambetja e padituria. Kërkesa themelore e tyre ishte arsimimi i femrës, duke ndihmuar me hapjen e kurseve për mësimin e gjuhës shqipe, të punës së dorës e të makinës, me synim përgatitjen e vajzave e grave për të marrë pjesë në jetën ekonomike e shoqërore të vendit. Përpos edukimit të femrës shqiptare, ato dhanë një kontribut të rëndësishëm moral e material për çështjen kombëtare.

Shoqëritë e grave, të formuara në qytete të ndryshme të Shqipërisë, u dalluan për organizimin e brendshëm demokratik. Ato vetëfinancoheshin nga pagesat mujore të anëtareve, por mirëprisnin edhe ndihma e dhurata nga jashtë. Shoqëritë femërore funksiononin në bazë të një strukture hierarkike dhe zgjidhnin me votë të fshehtë përfaqësueset e tyre në organet përkatëse. Ato vepronin në mënyrë të veçantë, pa bashkërenduar aktivitetin me shoqëritë e tjera të grave shqiptare, për t'i dhënë lëvizjes feministe karakter mbarëkombëtar.

⁷⁶⁵ D. Siliqi, *op.cit.*, f. 24

⁷⁶⁶ "Një thirrje", *Dajti*, viti I, nr. 52, Tiranë, E enjte, 30 tetor 1924, f. 2

⁷⁶⁷ "Lëvizje shoqërore", *Shekulli*, viti I, nr. 4, Tiranë, E shtunë, 22 nanduer 1924, f. 2

⁷⁶⁸ S. K. Dako, Sh. Bogdo, "Drejtorisë Fletore "Bashkimi"", *Bashkimi*, viti I, nr. 30, Tiranë, E prende, 21 Nanduer 1924, f. 4

⁷⁶⁹ Prof. as. dr. F. Musaj, "Roli i shoqërive të grave...", f. 9

⁷⁷⁰ AQSH, E447 (Shoqëria e grave "Përlindja shqiptare", Korçë), V. 1924, D. 127, Fl. 7

Qendra e organizimit femëror ishte qyteti i Korçës, jo thjesht pse u krijua shoqëria e parë e grave “Yll'i Mëngjezit”, por aty u konsolidua më tej lëvizja feministe, me formimin e shoqërive të zonjushave e zonjave, si: “Çvillimi”, “Përlindja” e “Rilindja”, të cilat vendosën kontakte me homologet e tyre në Europë. Përfshirja në lëvizjen femërore ndërkombëtare do të shërbente si shtysë për braktisjen e mendësisë konservatore dhe përqaftimin e idealeve të lirisë dhe të barazisë së gruas, të nevojshme për t’u sanksionuar në legjislacionin e kohës. Pasi lartësimi intelektual dhe moral i femrës tregonte për nivelin e qytetërimit të një kombi.

QENDRIMI I FUQIVE TË MËDHA NDAJ REVOLUCIONIT TË QERSHORIT TË VITIT 1924 NË SHQIPËRI

Estela Palnikaj (Hoxha)

Fuqitë e Mëdha dhe shtetet ballkanike, ndoqën me vëmendje ngjarjet e qershorit 1924 në Shqipëri. Qeveria e re e Nolit paraqiti programin demokratik i cili në përmbajtjen e tij përfshinte elementë që kishin si qëllim përmirësimin tërësor të gjendjes së brendshme, por dhe vendosjen e marrëdhënieve miqësore me të gjitha shtetet e veçanërisht me shtetet fqinjë. Qeveria e re ju bëri thirrje për bashkëpunim shteteve të Fuqive të Mëdha dhe fqinjëve ballkanikë, por ato ju përgjigjen negativisht duke treguar mos besim në kapacitetin e qeverisë së re për konsolidimin e brendshëm, por dhe në planin ndërkombëtar. Qëndrimi i tyre argumentohej me mungesën e legjitimitetit të qeverisjes.

Aksioni diplomatik që u ndërmor për njohjen u fillua pranë qeverisë italiane.⁷⁷¹ Roma e cila ishte dhe fuqia më e interesuar për Shqipërinë shpejtoi të paralajmëronte se ishte e gatshme për të zbatuar angazhimet e saj të njohura në rastin kur vihej në pikëpyetje pavarësia e integriteti territorial i saj. Noli si kryetar i opozitës që me 26 maj nga Vlora i kishte tërhequr vëmendjen qeverisë italiane të Musolinit për mundësinë e rrezikut që paraqiste një ndërhyrje e qeverive të vendeve fqinjë në punët e brendshme të Shqipërisë në rastin e fitores së lëvizjes kryengritëse. Musolini u dha mesazhe të qarta Beogradit dhe Athinës se një ndërhyrje në punët e brendshme të Shqipërisë do të vlerësohej si akt jo miqësor ndaj Italisë.⁷⁷² Nga ana e tij, ministri italian nga Durrësi i rekomandonte qendrës, përpara se të formohej qeveria e re në Tiranë, që “njerëzit e ardhur në fuqi në Shqipëri jo vetëm të lireshin të lirë të bënin eksperimentin e tyre, por edhe të ndihmoheshin nga qeveria e Romës”. Ai e mbyllte raportin e tij me propozimin që qeveria italiane “të kapërcente mbi diskutimet e stërholluara të së drejtës kushtetuese që shtronte një ndërrim i tillë qeverie (me kryengritje) dhe të hynte menjëherë në marrdhënie zyrtare, pra ta njihte atë.”⁷⁷³ Gjithashtu në notën që dërgon Musolini, sigurohej se Italia ashtu si dhe më parë do të jepte gjithë ndihmën e vetë për zhvillimin paqësor dhe përparimin e vendit fqinj e mik.⁷⁷⁴ Ishin këto dy nota të cilat i dhanë shpresë Nolit se qeveria e kryesuar prej tij do të njihej nga Italia.

Në të vërtetë, Italia kishte qëllime ekonomike për të shkëputur koncesione, por dhe qëllime politike ndaj Shqipërisë e cila në këtë periudhë kishte pozita mjaft të dobëta, të cilat Italia kërkonte ti shfrytëzonte. Musolini mendoi e ky ishte një moment i volitshëm për të dalë më disa propozime politike, thelbi i të cilave në fund të fundit do të ishte

⁷⁷¹ Arben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, Tiranë 2009, fq.365.

⁷⁷² Paskal Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë 1*, Tiranë, 2013, fq. 607

⁷⁷³ Arben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, Tiranë 2009, fq.365

⁷⁷⁴ Tel. I Musolinit për Fan Nolin, 21 qershor 1924.DDI Settima serie, 1922-1935.Vol.IIIId.nr. 306

përgatitja e terrenit për një supermaci italiane në Shqipëri.⁷⁷⁵ Musolini deklaroi përkrahjen e tij për qëndrimin e Shqipërisë dhe shtoi se do ishte më e lehtë t'i ofronte mbështetjen nëse Shqipëria dhe Italia do të kishin një "pakt politik".⁷⁷⁶ Kështu, Roma donte ta vinte Shqipërinë nën një lloj kujdestarie dhe për këtë të lidhte një pakt politik, por Noli nuk pranoi nënshkrimin e një pakti të tillë i cili do të çonte në humbjen e pavarësisë së Shqipërisë.

Noli nuk pranoi një pakt të tillë dhe qeveria italiane u përpoq ta kompensonte me joshjen e dhënies së huas për të cilën Shqipëria kishte nevojë. Musolini njoftoi se qeveria e tij ishte përgatitur ti jepte Shqipërisë një hua prej 100 milion liretash, por iniciativa duhej të vinte nga Shqipëria.⁷⁷⁷ Italia i përmbahej me këmbëngulje idesë që ta bënte Shqipërinë territor italian dhe të ndiqte politikën e pritjes derisa Shqipëria të lypte hua dhe ajo pastaj të kërkonte koncesione. Noli i kuptonte qartë qëllimet e Italisë për të fituar kontroll më të madh mbi vendin e tij dhe gjatë gjashtë muajve që ishte në pushtet ai qëndroi i palëkundur në refuzimin për të pranuar kërkesat e Italisë.⁷⁷⁸ Duket se mungesa e një kompromisi midis dy shteteve Italisë dhe Shqipërisë, frohu marrdhëniet dypalëshe, fakt ky që evidentohet nga refuzimi që bëri Musolini për dhënien e ndihmës financiare dhe municioneve të nevojshme për të përballuar ndonjë sulm të mundshëm të jashtëm. Roma hoqi dorë nga mbështetja e qeverisë së Qershorit, por jo nga interesat e saj në Shqipëri. Përpara një rrethane të tillë shpresat u kthyen nga Britania e Madhe.

Noli ishte i ndërgjegjshëm për rëndësinë e vendosjes së marrdhënieve të rregullta diplomatike me Britaninë e Madhe, qëndrimi i së cilës ndikonte edhe në qëndrimin e vendeve të tjera të kontinentit. Ai shpresonte të vendoste marrdhënie miqësore, nisur dhe nga përvoja e Lidhjes së Kombeve ku përkrahja e Britanisë kishte qenë shumë e madhe. Në një intervistë dhënë në Gjenevë gazetës *Times* të Londres, Noli deklaronte se shqiptarët nuk do të harronin shpejt që pranimi i vendit të tyre në Lidhjen e Kombeve i detyrohej kryesisht mbështetjes britanike.⁷⁷⁹

Me gjithë përpjekjet për të mbajtur lidhje të forta me Britaninë e Madhe, qëndrimi i saj doli jashtë parashikimeve të Nolit. Qeveria e Londrës mbajti ndaj qeverisë shqiptare të qershorit 1924 një qëndrim tejet kundërshtues dhe më të vendosur, krahasuar me qëndrimet e Fuqive të tjera të Mëdha.⁷⁸⁰ Rol të rëndësishëm në qëndrimin britanik luajti ministri britanik Eyres i cili ishte i lidhur ngushtë me Zogun. Përfaqësuesi anglez që me ardhjen në pushtet të qeverisë së re shfaqti pasiguri për interesat politike në përgjithësi dhe atyre ekonomike në veçanti. Shqetësimi ishte i lidhur drejtpërdrejtë me koncesionet e naftës të cilat kërkoheshin ti jepeshin kompanisë anglo-persiane. Opozita e kryesuar nga Fan Noli e kishte kundërshtuar marëveshjen me termat me të cilat ishte nënshkruar dhe ishte shprehur për dhënien e koncesioneve të naftës shoqërive amerikane.⁷⁸¹ Informacioni që jepte Eyres e bindi Foreign Office-n se qeveria e re shqiptare nuk do të tregohej aq e gatshme ti jepte Londrës po atë trajtim të privilegjuar.⁷⁸²

⁷⁷⁵ Arben Puto, *Demokracia e rrethuar*, Tiranë 2010, fq. 82

⁷⁷⁶ Robert C. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit*, Tiranë 2003, fq.177

⁷⁷⁷ Po aty, fq. 178

⁷⁷⁸ Po aty, fq. 179

⁷⁷⁹ Robert C. Austin, *vep. cit.*, fq. 161

⁷⁸⁰ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Historia e Popullit Shqiptar III Periudha e Pavarësisë 28 Nëntor 1912- 7 Prill 1939*, Tiranë 2007, fq.233

⁷⁸¹ Paskal Milo, *vep. cit.*, fq. 610

⁷⁸² Arben Puto, *vep. cit.*, fq.370

Qeveria e Nolit u nxitua duke bërë një hap të gabuar diplomatik me letrën drejtuar kryeministrit e ministrit të jashtëm MacDonald. Në telegramin e qeverisë shqiptare për Mehmet Konicën jepej udhëzimi që ti bëhej e ditur Forin Offis qëndrimi i Eyres ndaj revolucionit se “ne kemi prova që ai ka nxitur qeverinë feudale në fillim për të shtypur revolucionin, e pastaj për të rezistuar deri në fund” dhe meqë “ka humbur të gjithë simpatitë, ai nuk është më person i përshtatshëm për të forcuar lidhjet e miqësisë që bashkojnë të dy vendet”⁷⁸³ Pikërisht kjo letër u bë shkaku i shfaqjes së qëndrimit tejet kundërshtues të Britanisë së Madhe. Eyres përfaqësuesi anglez në Durrës i rekomandonte Londrës zyrtare se “njohja duhej shtyrë derisa të sigurohej që qeveria ishte konstitucionale dhe nuk ushtronte reprezalje mbi kundërshtarët politikë”.⁷⁸⁴ Kjo kishte të bënte kryesisht me legalizimin e qeverisë demokratike nëpërmjet zhvillimit të zgjedhjeve dhe shqetësimin për marrjen e masave të ashpra ndaj anëtarëve të regjimit të vjetër. Edhe i ngarkuari tjetër anglez me punë në Durrës, R.Parr shkruante se “është e pamundur të thuhet në këtë moment që qeveria revolucionare ka kontroll të efektshëm në vend”.⁷⁸⁵ Qeveria angleze vendosi që qeverisë së re shqiptare të mos i jepej asnjë njohje zyrtare. Përgjigja për qeverinë e Nolit ishte që “... ne nuk mund të njohim një qeveri si qeveri legale derisa ajo të mos ketë ndërmarrë hapa për të provuar se ajo është përfaqësuese e shumicës së popullit. Parlamenti shqiptarë është shpërndarë dhe derisa ky të mos thirret përsëri ose të mos mbahen zgjedhje të reja, vështirë se mund ta quajmë qeverinë e re si të ligjshme, në të vërtetë ajo nuk ka fare status kushtetues”.⁷⁸⁶ Pra, një nga mënyrat nëpërmjet së cilës qeveria e Nolit do kishte siguruar njohjen nga Britania e Madhe të paktën teorikisht ishin zgjedhjet, pasi ajo kushtëzonte legalizimin e qeverisë me zhvillimin e zgjedhjeve parlamentare.

Franca dukej se nuk kishte interesa të veçanta për Shqipërinë, kjo shprehet dhe nga fakti se nuk i dha rëndësi njohjes së qeverisë shqiptare. Qëndrimet e Francës ishin kontradiktore. Kështu, kryeministri francez deklaronte se “Franca do të jetë gjithnjë e lumtur të japë ndihmën e saj morale në përpjekjet tuaja për të konsoliduar unitetin e Shqipërisë dhe për të mbajtur mardhënie miqësore me fqinjët tuaj dhe me shtetet e tjerë”.⁷⁸⁷ Kjo përgjigje u vlerësua si njohje për qeverinë shqiptare. Gjithashtu, me 2 gusht funksionari i lartë diplomat Larosh i deklaroi Konicës dhe Dinos se “çështja e njohjes nuk ka qenë e ngritur kurrë nga Franca duke qenë se qeveria aktuale e kryesuar nga Imzot Fan Noli e ka marrë pushtetin nga Këshilli i Regjencës dhe se pavarësisht nga kryengritja ajo ka qenë formuar në mënyrë të rregullt”.⁷⁸⁸ Por, konfirmimi deklarativ i njohjes franceze nuk u reflektua nga përfaqësuesi zyrtar i Francës në Shqipëri i cili nuk pranonte të hynte në marrëdhënie zyrtare me qeverinë e Nolit. Nuk vonoi shumë dhe u bë e njohur se Parisi ishte konsultuar me Londrën dhe kishin rënë dakord të mbanin një qëndrim të përbashkët në këtë çështje.⁷⁸⁹

SHBA mbajti të njëjtin qëndrim si shtetet evropiane ndaj njohjes së qeverisë së Qershorit. Qëndrimi pro amerikan i Nolit i ngjalli shpresa SHBA-së për realizimin e

⁷⁸³ Tel. I qeverisë shqiptare për Mehmet Konicën në Londër, 18 qershor 1924. AMPJ. Viti 1924. Dosja nr. 198, f.6

⁷⁸⁴ Pranvera Teli (Dibra), *Shqipëria dhe diplomacia Angleze 1919-1927*, Tiranë, 2005, fq. 247

⁷⁸⁵ Paskal Milo, *vep. cit.*, fq. 612

⁷⁸⁶ Pranvera Teli(Dibra), *vep. cit.*, fq. 248

⁷⁸⁷ Tel. I Kryeministrit e ministrit të jashtëm të Francës E.Herriot dërguar Fan Nolit. Paris, 26 Qershor 1924. AMPJ. Viti 1924. Dosja Nr.129, fq.26

⁷⁸⁸ Paskal Milo, *vep. cit.*, fq. 617

⁷⁸⁹ Arben Puto, *vep. cit.*, fq.371

interesave ekonomike amerikane në Shqipëri. Në bisedimet me Grand-Smithin kryeministri shqiptar u tregua i gatshëm të plotësonte dy çështjet që i paraqiti diplomati amerikan, të mbetura ende pezull midis dy vendeve: së pari, Qeveria shqiptare do të përpiqej të gjente vrasësit e dy amerikanëve në Mamurras dhe së dyti, do të plotësonte interesat ekonomike amerikane në Shqipëri që lidheshin me lëvrimin e koncesioneve shoqërive amerikane për kërkime në fusha naftëmbajtëse.⁷⁹⁰ Pikërisht për këtë Grant-Smith mori udhëzimin që çështjen e njohjes ta lidhte me gatishmërinë e qeverisë për të plotësuar këto dy kërkesa. Por, Grant-Smith ndryshoi mendim dhe i raportonte Departamentit të Shtetit se nuk mund të pritej asgjë nga një qeveri që nuk kishte shanse të mbijetonte gjatë, e paqëndrueshme brenda dhe e izoluar në shkallë ndërkombëtare.⁷⁹¹ Nga fillimi i vjeshtës 1924 u kuptua qartë se Uashingtoni nuk e njihte qeverinë shqiptare jo thjeshtë se nuk ishin realizuar kërkesat e tij, apo se vihej në dyshim legjitimiteti i saj, porse ajo nuk po njihej as nga qeveritë evropiane.⁷⁹²

As shtetet fqinjë, Greqi dhe Jugosllavi, nuk e njohën qeverinë e Nolit. Noli bëri thirrje për mardhënie të mira me shtetet fqinjë. Në gazetën serbe “Vreme”, me 13 shtator 1924, Noli shprehet: “Nga ana jonë, ne dëshirojmë mardhënie fqinjësie të mirë me shtetin jugosllav se kemi nevojë për qetësi që të mbledhim tërë vëmendjen tonë në organizimin e shtetit dhe zhvillimin e ekonomisë. Sa për mua, unë nuk shikoj ndonjë arsye, përse të dy shtetet tanë të mos rrojnë në miqësi. Si shtete fqinjë kemi interesa të përbashkëta”. Madje Noli shkoi më larg, ai hodhi idenë për një konfederatë Ballkanike.⁷⁹³

Noli e kuptonte se Shqipëria kishte nevojë për marrëdhënie të mira veçanërisht me Beogradin nëse donte që eksperimenti i tij demokratik të mbijetonte.⁷⁹⁴ Përgjigjja e Beogradit ndaj ardhjes së Nolit në pushtet nuk qe pozitive. Beogradi pa të drejtë e identifikonte fitoren e Nolit si produkt të ndikimit italian.

Shumë më e rëndësishme ishte çështja e Kosovës. Udhëheqësit jugosllavë ishin të kënaqur që regjimet paraardhëse, veçanërisht ato të drejtuar ose të kontrolluar nga Ahmet Zogu, nuk i kishin për zemër as ndryshimet radikale të kufijve as dhe presionet mbi Beogradin për të përmirësuar trajtimin e pakicës shqiptare.⁷⁹⁵ Një arsye tjetër për shqetësimin në Beograd ishte se qeveria e Fan Nolit mbante afër udhëheqësit e “irredentizmit kosovar”, Hasan Prishtinën, Bajram Currin etj. dhe ishte shprehur në mbrojtje të kauzës së tyre, në një kohë që Ahmet Zogu i kishte shpallur armiq të tij dhe kishte hyrë hapur në marrëveshje me qeverinë jugosllave për asgjësimin e tyre e të lëvizjes së tyre.⁷⁹⁶ Gjithashtu, në marrëdhëniet e tensionuara me Jugosllavinë ndikuan: prania e Zogut në Beograd; çështjet e pazgjidhura territoriale (çështja e Vermoshit dhe Shën Naumit).⁷⁹⁷

Në lidhje me Greqinë, Noli shpresonte se mund të vendoste mardhënie miqësore, meqenëse ai ishte ortodoks, por nga pala greke ai shihej si antigrek duke qenë se ishte

⁷⁹⁰ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *vep. cit.*, fq. 234

⁷⁹¹ Arben Puto, *vep. cit.*, fq. 373

⁷⁹² Paskal Milo, *vep. cit.*, fq. 623

⁷⁹³ Universiteti “Fan S. Noli”, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë Korçë, *Fan S. Nolin ë 130-vjetorin e Lindjes 1882-2012*, Korçë 2012, fq. 408

⁷⁹⁴ Robert C. Austin, *vep. cit.*, fq. 122

⁷⁹⁵ *Po aty*, fq. 123

⁷⁹⁶ Paskal Milo, *vep. cit.*, fq. 628

⁷⁹⁷ Universiteti “Fan S. Noli”, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë Korçë, *Fan S. Nolin ë 130-vjetorin e Lindjes 1882-2012*, Korçë 2012, fq. 409

themelues i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Mardhënet midis dy vendeve u ndikuan nga çështja e kufirit dhe të drejtat e minoriteteve. Në lidhje me minoritetet Noli shprehet: “Minoritetet duhet të shërbejnë jo si një pengesë, por si një lidhje dhe urë marrëveshjeje midis nesh”.⁷⁹⁸ Mosmarrëveshjet midis dy vendeve u thelluan prej përfshirjes së padrejte të popullit shqiptar të Çamerisë në politiken e shkëmbimit të popullsisë greke e turke në baze të traktatit të Lozanës 30 janar 1923. Athina i cilësonte shqiptarët e besimit mysliman si turq duke i shpërngulur me forcë nga vatrat e tyre. Për këtë arsye F. Noli i drejtohet me Note Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, me apelin e qartë drejtuar Aeropagut të Nalte të Gjenezës, ajo përmbushte jo vetëm natyrën patriotike, po edhe njerëzore, sepse padrejtësitë e adaptuara në Çameri kundër elementit shqiptar ishin aq të rënda sa që nuk mund të gjendej zemër njeriu të mos dridhej.⁷⁹⁹ Si përfundim, qëllimi i Fan Nolit për një politikë të mirë me fqinjët, nuk u përkrash nga Jugosllavia dhe Greqia.

Qeveria e Nolit u gjend përpara një izolimi të plotë ndërkombëtare e cila e detyroi atë të ndërmerre disa veprime të dëshpëruara. Përpjekjet e tij për vendosur marrëdhënie diplomatike me qeverinë sovjetike duhen parë pikërisht në këtë optikë.⁸⁰⁰

Këmbëngulja e Fan Nolit për njohjen e qeverisë kishte të bënte më shumë me konceptin e tij si diplomat. Sipas tij e ardhmja e një qeverie ishte e lidhur më shumë me qëndrimin e Fuqive të Mëdha të kohës se sa vetëm me çështjen e legjitimitetit të saj. Duke u përqendruar shumë në këtë aspekt, ai la pas dorë veprimet brenda shtetit siç ishin zhvillimi i zgjedhjeve dhe realizimi i programit të qeverisë, shmangia e të cilave u bë faktor ndikues në rrëzimin e qeverisë së tij.

⁷⁹⁸ Po aty, fq. 409

⁷⁹⁹ Greqia, Jugosllavia dhe nevojë, *Politika*, viti III, Vlore, e enjte 31 korrik 1924, fq.1

⁸⁰⁰ Muin Çami, *Shqipëria në rrjedhat e historisë 1912-1924*, Tiranë, 2007, fq. 354

FORTIFIKIME NË MALËSI TË ZHEGOCIT

Phd. Faik Sahiti

Pozicioni gjeostrategjik

Studimet në terren dhe materiali i mbledhur, tregojnë se në aspektin e fortifikimeve, vendi ynë, jo vetëm nuk qëndron mbrapa vendeve të tjera, por ai paraqitet me tiparet e veta të veçanta, që krahas përpunimit krijues të ndikimeve të jashtme, dha kontributin e vet në thesarin e përbashkët të arkitekturës evropiane. Duke u mbështetur në mbetjet faktike – arkeologjike, fortifikimet nuk janë parë të izoluara, vetëm si ndërtime me karakter mbrojtës, por ato janë refleks

për kushtet ekonomike, shoqërore e politike, të formacioneve të ndryshme të shoqërisë në vendin tonë.

Malësia e Zhegocit, shikuar nga aspekti gjeologjik, ka prejardhje vullkanike dhe shquhet me trajta konike të rrumbullaksuara. Përbërja e tyre gjeologjike cilësohet me shkëmbinj magmatikë, të pasur me minerale argjendi, plumbi, zinku, etj. Shfrytëzimi i tyre në këtë anë është i njohur qysh nga Dardanët, kurse aktivitete më intensive xehetare shënohen gjatë antikitetit, vazhdojnë gjatë Mesjetës dhe në kohën e re. Për shkak të pasurisë dhe aktivitetit xehesor, këto male, historikisht njihen me eksploatimin e mineraleve dhe me kalimin e rrugëve me interes, që bashkonin në mënyrë horizontale dy magjistralet, atë Nish – Lezhë me rrugën tjetër Nish - Shkup. Struktura relievore e këtij rajoni është rezultat i karakteristikave fiziografike, të cilat kanë ndikuar në vazhdimësi që këto vise të kësaj malësie të jenë frekuentuar nga banorët që nga periudha parahistorike. Në të ka fushgropa dhe lugjina lumenjesh, terrene dhe vise të valëzuara kodrinore, zona malore me lartësi mesatare dhe të larta, siç është rasti me majen e Plitkoviqit (1071 m).

Megjithëse nuk kemi dëshmi të shkruara, materialet nga terreni, mbetjet e shkrirjes së xeheve, etj, dëshmojnë për pasuri jashtëzakonisht të madhe të këtyre viseve, të cilat kanë qenë parakushte për një jetë dinamike të banorëve dardanë në këto zona. Gjurmët e shumta arkeologjike, gjetje rasti si dhe themele të shumta banimi, janë dëshmi se këto vise në vazhdimësi ishin burim i pashtershëm për ngritjen e kapaciteteve ekonomike në Dardani, në të gjitha fazat e zhvillimit historik. Gjetjet e relikteve të shumta në vendbanimet e kësaj zone, janë dëshmi për jetë të dendur sidomos nga antikiteti e mesjeta, me një vazhdimësi të pashkëputur deri në ditët tona. Me një shtrirje të tillë kohore, kuptohet se rajoni kishte vazhdimësi banimi, andaj gjatë tërë antikitetit të hershëm, mesjetës dhe më vonë, kemi akumulim të vlerave të mirëfillta kulturore, të cilat, pos dëshmisë për vijimësi banimi të etnikumit të njëjtë, Iliro-Dardanëve, deri në ditët e sotme, në gjirin e tyre ruajnë si dëshmi vlera trashëguese të cilat pasqyrojnë nivelin e gjithëmbarshtëm ekonomik dhe kulturor nga e kaluara.

Malësia e Zhegotit, ka një numër të konsiderueshëm të monumenteve me vlera të mëdha kulturore, si të banimit, fortifikime, ashtu edhe monumente me karakter shoqëror e ekonomik.

Se ky lokalitet malor banohej në vazhdimësi, dëshmohet edhe nga vendbanime shumë të hershme, të cilat sigurisht ishin bërthama të forta dhe me kapacitete të sigurta ekonomike, për ngritjen, zgjerimin dhe përparimin ekonomik në tërë territorin e Dardanisë. Prej këtyre lokaliteteve veçohen Suka e Poneshit, kulina në Gadish, gradishta e madhe dhe gradishta e vogël në Sllakoc të Poshtëm, Gradina në Kishnapolë (Shpal), gradina dhe kulina në Zhegot, kulina në Plitkoviq, etj.

Suka e Poneshit


Prej fortifikimeve të lartpërmendura duhet veçuar ndërtimi masovik i fortifikuar në



Sukë të Poneshit. Kështjella shtrihet në pjesën veriperëndimore të fshatit, në një hapësirë të ngritur kodrinore, me lartësi mbidetare 800 m. Fortifikata zë një pozitë gjeostrategjike shumë interesante. Muret rrethuese i janë përshtatur hapësirës së pjerrët kodrinore. Ndonëse nuk është bërë ndonjë hulumtim arkeologjik, në bazë të analogjisë së materialit ndërtimor, duket se kemi të bëjmë me ndërtime tipike dardane të kështjellave. Megjithëse pohimet nuk janë të bazuara në rezultate të hulumtimeve arkeologjike, të cilat janë më se të domosdoshme, si në rastin e mureve rrethuese në pjesën jugore, perëndimore, juglindore, ashtu si edhe në kullën kryesore, nuk vërehet material lidhës.



Muret janë pjesërisht të dukshme në pjesën jugore, lindore dhe veriperëndimore. Në pjesën veriperëndimore dhe verilindore, janë të dukshme gjurmët e kthinave. Marrë në tërësi, materiali ndërtimor – guri, i cili haset në madhësi të ndryshme, ishte i lehtë për përpunim dhe duket qartë se është sjellë nga kodrina e afërt, që ndodhet në pjesën veriperëndimore – pikërisht nga vendi ku ishte hyrja në kështjellë, më saktë nga Kodra e kishës. Forma e ndërtimit të fortifikimit duket mjaft interesante – një rreth i çrregullt, të cilin si duket e devijon detyrimisht, për shkak të konfiguracionit të terrenit, muri rrethues, i cili në pjesën lindore zgjatet dhe krijon një poligon mbrojtës së bashku me një kullë vrojtuese. Kështjella me siguri kishte edhe disa vrojore, mirëpo është dëmtuar seriozisht nga gërmimet klandestine.



Muret në pjesët e dukshme përbëhen nga gurë të vendosur njëri mbi tjetrin, pa ndonjë material lidhës dhe trashësia e tyre shkon nga 1.80 – 2 m. Nga ky lokalitet, janë të dukshme dhjetra fortifikime të rajonit, siç janë fortifikimet në Malësi të Zhegocit, Novobërdë, viset e afërta të fortifikuara, Prilepi, Prizreni si dhe fortifikimet në rajonin burimor të Moravës, përkatësisht në viset e Malit të zi të Shkupit – Karadakut. Në saje të materialit të dukshëm arkeologjik, fragmenteve të qeramikës, gjegjësisht në saje të analogjisë së materialit, kemi të bëjmë me një fortifikim të antikitetit, i cili me sa duket përdoret edhe në antikitetin e vonë, përkatësisht në mesjetën e hershme. Kur këtyre pasazheve u shtohet edhe vlera xehetare e këtyre viseve, fortifikata ishte nyje me vlerë të madhe në mbrojtjen e zonave të pasura në Malësi të Zhegocit.

Kalaja e Zhegocit

Shtrihet në kodrinën e Zhegocit të Ulët, me lartësi mbidetare rreth 1000 m, më saktë, ajo shtrihet në verilindje të majes së Plitkoviqit. Kështjella është e dëmtuar në masë të shkajshme. Nga mbetjet e mureve në pjesën lindore, perëndimore dhe jugperëndimore, duket se materiali ndërtimor përbëhej nga gurë me madhësi të ndryshme, pa ndonjë material lidhës. Në bazë të vështrimeve në terren dhe gjetjeve arkeologjike të rastit, mund të konstatohet se fjala është për një fortifikim të vjetër dardan.

Pozicioni i rëndësishëm gjeostrategjik është element me rëndësi për të ardhur te konkluzioni se fortifikata ishte nyje strategjike për rajonin në fjalë – Malësinë e Zhegocit. Ajo ishte e vendosur në qendër të rivierave e galerive të xeheroreve dhe shërbente si vëzhgimore për tërë rajonin, luginën, deri në viset e rrafshita të Lypjanit dhe Gadimes. Duhet të pohohet lirshëm se kjo fortifikatë, së bashku me dhjetra fortifikata tjera në këtë malësi, ishin të ndërlidhura me njëra-tjetrën dhe shërbenin jo vetëm për strehimin e banorëve të zonave në fjalë, por edhe si mburojë për rrafshin e Kosovës.

Fortifikata përbënte një hallkë me rëndësi mburoje, së bashku me fortifikimet tjera të vargmaleve të Verbiçës e sidomos me fortifikatën e cila nga banorët quhet “Kodra e kishës”.

Në saje të përcjelljes së trakteve të mureve, duket se kështjella kishte formë elipse të zgjatur, ashtu siç ishte konfiguracioni i terrenit. Është e natyrshme që në monument ka gjurmë edhe të periudhave të mëvonshme, të antikitetit të vonë dhe të mesjetës. Mirëpo, gërmimet klandestine, dëmtimet e mureve dhe bimësia e dendur janë shkatarrë të mosidentifikimit të saktë të vrojtoreve dhe pjesëve të tjera shoqëruese të monumentit. Megjithatë, duket se në pjesën jugore, juglindore dhe



veriperëndimore të murit të dytë rrethues ndodhen bazamentet e tri vrojtoreve, që, në bazë të konfiguracionit të terrenit, shërbenin si vëzhgimore për dy luginat; luginën prej

Verbicës deri në Gadime dhe luginën tjetër Gadish – Kishnapole – Lypjan. Pjesa kryesore mbulohet nga drurë me dendësi të madhe dhe rrënoja, mirëpo duket se kthinat ishin të vendosura në një zonë mjaft të gjerë të pikës më të lartë në monument.

Fortifikimet tjera në malësi të Zhegocit

Pos lokaliteteve të pasura me vlera të mëdha për trashëgiminë e paluajtshe, ky rajon është i njohur edhe për eksponate të lëvizshme dhe për vlera të tjera të trashëgimisë natyrore. Lokalitetet e vjetra të këtij rajoni, siç mësohet edhe nga toponimet e ruajtura, gradina dhe afër saj kulina, që gjithashtu gjenden mbi Zhegocin e Ulët, ndërmyet Zhegocit të Epërm dhe bjeshkëve të Plitkoviqit, e tërë hapësira malore, përbëhet nga një zinxhirë i pa shkëputur i fortifikimeve. Megjithëse gjurmët e këtyre fortifikimeve ekzistojnë, nuk mund të përkufizohen qartë traktet e mureve dhe hapësira e plotë e sipërfaqeve që zinin këto fortifikime. Nga vëzhgimet në terren, është e kuptueshme se vija e fortifikimeve fillonte në Zhegocin e Ulët dhe mandej, në formë gjysëm-rrethi të zgjatur, shtritej deri në kulinën e Plitkoviqit. Kur fortifikimeve në fjalë u shtohen edhe ato të Verbicës së Zhegocit – tre sosh, mund të konstatojmë se një mbrojtje e tillë kishte rolin e shumfishtë. Së pari, bënte sigurimin e vendbanimeve të luginës deri në Lypjan dhe së dyti mbronte galeritë dhe minierat e shumta të zonës.

Sipas traditës dhe dëshmimeve të themeleve të ndërtimeve të vjetra nga terreni, Zhegocit është vendbanim i lashtë. Në vendin e quajtur “Kroni i Sofisë”, janë gjetur themelet edhe mbeturina të tjera të një qyeteti antik. Ndonëse sot nuk i kemi gjurmët (ruhen në nëntokën e Zhegocit) me hulumtime të pjesshme arkeologjike, ndoshta do të vërtetohej plotësisht pohimi i të moshuarve të këtij fshati se “macja kishte ecur mbi çatitë e shtëpive, mbi tri kilometra, pa zbritur fare në tokë”. Megjithëse janë të mbuluar nga rrënojat dhe nuk kishim mundësinë e përkufizimit dhe të paraqitjes së skicimeve, fortifikimet simotra të zonës; Loparë –Kropodinë - Blinajë – Plitkoviq, kanë dëshmi grumbujt e gurëve të përpunuar e në raste të rralla kemi të ruajtur edhe trakte muri. Këto të dhëna janë pohime serioze, të cilat duhet të dëshmohen me hulumtime arkeologjike.

Është interesante të bëjmë një përshkrim të shkurtër të fortifikimit në vendin e quajtur kulina në Plitkoviq. Ajo zë një pozitë strategjike dhe ndërlidh zonën me fortifikimet tjera që vijojnë nga kalaja në fshatin Vrellë, gradina në Kishnapolë (Shpal) si dhe fortifikata në Gadish. Pos begatave me xehe, faktor tjetër i përqëndrimit të banorëve në zonë ishin edhe kullosat në prapavi, gjegjësisht në pjesën verilindore të fortifikatës. Nga mbetjet e trakteve të murit, fortifikata duket se ishte e punuar nga gurë me madhësi të ndryshme të cilët janë siguruar nga afërsia. Edhe në këtë fortifikatë, ashtu si në shumicën e fortifikimeve të zonës, mbetjet e mureve janë rrafshuar me sipërfaqe, ndërsa në traktet e dukshme të mureve lartësia e tyre nuk kalon më tepër se 40 cm. Nga ky lokalitet janë të dukshme vend - fortifikatat: Novobërda, Vrella, Gadishi, Sllakovci, Kulina e madhe dhe kulina e vogël në Vrapqiq, Shpali, Veletini te Janjeva, si dhe fortifikime në viset e Karadakut.

Në vendbanimin tjetër të tipit kodrinor-malor, Verbicë e Zhegocit, sikurse edhe në vendbanimet e tjera të malësisë, kemi eksplotimin e xeheve që nga periudha e sundimit romake, andaj edhe në këtë pjesë ekzistojnë dëshmi për monumente fortifikuese. Ndër monumentet e tilla veçojmë, mbetjet e pjesshme të trakteve të mureve të fortifikatave në

lagjen Smajlaj, Spahiaj dhe fortifikatën tjetër në vendin e ashtuquajtur “Kodra e kishës”. Sa i përket fortifikatave të para, është e pamundur të bëhet ndonjë pohim i qëndrueshëm për formën e mureve apo përmasat e tyre. Materiali ndërtimor – gurët janë bartur për ndërtime të shtëpive në fshat. Gjurmët ndërtimore janë të zbehta, vendndodhjet e monumenteve (sidomos në lagjen Spahiaj) janë mbuluar nga bimësia dhe ato pak gjurmë të dukshme, nuk mjaftojnë për të nxjerrë pohime, pa hulumtime të mirëfillta arkeologjike.

Me interes të veçantë paraqitet fortifikata në Kodrën e madhe, respektivisht në “Kodrën e kishës”. Ky vend është pika e bashkimit të luginës së Zhegocit me luginën tjetër të fshatit Verbicë e Zhegocit. E tërë kodrina në sipërfaqe prej rreth 5 hektarësh, duke filluar që nga pika më e ulët e bashkimit të lumenjve të vegjël, lumit të Verbicës dhe të Zhegocit e deri në pikën më të lartë (lartësia mbidetare kodrina e parë 852 m dhe pjesa më e lartë e kodrinës tjetër me lartësi mbidetare 901 m), janë pothuajse tërësisht me themele. Megjithëse kemi të bëjmë kryesisht me rrënoja të mureve, prapë se prapë duket se fortifikata i është përshtatur kodrinës. Kemi të bëjmë me një fortifikim të antikitetit, sigurisht me shtresime banimi që nga periudha parahistorike dhe me vazhdimësi banimi edhe gjatë mesjetës. Fortifikata ka hyrjen nga pjesa juglindore (ende ekzistojnë gjurmët e kalldrëmit), ndërsa traktet e mureve të para rrethuese, janë ende të dukshme. Pjesa kryesore e fortifikimit është dëmtuar seriozisht nga gërmuesit klandestinë dhe është e pamundur pa hulumtime arkeologjike, të nxirret ndonjë konkluzion për formën e monumentit, vijimësinë e banimit në të apo evidentimin e qartë të mureve dhe vrojtoreve.

Fortifikata në fshatin Vrellë

Fortifikimi shtrihet në pjesën jugore të fshatit Vrellë, në një pozicion tejet të rëndësishëm gjeostrategjik. Shtrihet në zona të xeheroreve dhe gjithashtu shërbente si pararoje e vendbanimeve të rrafshëta të Gadimes dhe Lypjanit. Ajo ishte e vendosur në një kodrinë shkëmbore, me lartësi mbidetare prej 773 m. Muret e sajë të punuara me gurë të madhësive mesatare janë të kombinuara me tulla dhe llaç gëlqereje dhe janë të dukshme nga ana jugperëndimore dhe veriore dhe atë në murin e dytë rrethues, sepse muri i parë, meqë ishte në pozicion më të ulët pothuajse është zhdukur. Gurët janë marrë për ndërtim të shtëpive të fshatit.

Ndërtimi i fortifikatës i është përshtatur konfiguracionit të terrenit, andaj siç duket, nga ana veriperëndimore ndodh një plato e rrafshët, e cila kishte qasje më të lehtë me monumentin. Besohet se edhe hyrja duhet të ishte nga kjo anë. Në bazë të vëzhgimeve në terren, ndonëse nuk kemi argumente të mjaftueshme, duket se në murin e dytë rrethues, kemi të paktën tri kulla vrojtuese në pjesët lindore, jugperëndimore dhe veriperëndimore. Sa i përket pjesës kryesore, dukjes së saj, mund vetëm të supozohet. Në përgjigje të saj janë bërë gërmime të shumta klandestine të cilat kanë shkaktuar dëmtime serioze të monumentit. Në murin e ruajtur nga ana veriore, me gjatësi prej 3 m, është vërejtur se për material lidhës është përdorur llaçi i gëlqeres. Nga kjo fortifikatë ishin të dukshme vend-fortifikimet, në Shpal (Kishnapolë) nga ana lindore, në Plitkoviq nga ana verilindore, ndërsa nga ana veriperëndimore shtrihet fortifikata e Veletinit, mbi Janjevë.

Konkluzion

Trashëgimia kulturore e zonës, pozicioni gjeostrategjik dhe itineraret e antikitetit dhe të periudhave tjera vijuese, së bashku me pasuritë minerare, e bëjnë këtë areal si një qendër, apo më saktë, arterie me rëndësi jetike për ngritjen dhe zhvillimin e Dardanisë. Në këtë studim jepet një përvijim i originalitetit krijues, i vetive unike krijuese në trevat ilire-dardane, duke u bazuar në prezantimin e rezultateve përnjohëse të terrenit dhe në të dhënat e kufizuara të shkrimeve (për arealin në fjalë) për këtë kategori monumentesh. Survejimet në terren, përcaktimi dhe dokumentimi i gjurmëve të tilla ndërtimore, mundësojnë së paku krijimin e një evidence për vendndodhjen e monumenteve fortifikuese në këtë malësi.

Studimi i fortifikimeve dhe përshkrimi i disa vendbanimeve dhe minierave përreth tyre, që janë të përshkruara tërthorazi në literaturën e sotme, ku mund të veçojmë sistemin e organizuar fortifikues: Ponesh – Gadish – Shpal – Sllakovc – Vrellë – Plitkoviq – Blinaj – Kropodinë – Zhegoc - Verbicë, etj, historikisht kishte një rëndësi specifike në ndërlidhjet e aspekteve ekonomike me zonat tjera ilire-dardane. Gjithashtu kalimi i rrugëve sekondare që lidhnin në vijë horizontale dy magjistralet e antikitetit dhe mesjetës, me njëra tjetrën, shton edhe më tepër vlerën gjeo-strategjike të arealit. Ajo që është më me rëndësi, Malësia e Zhegocit, së bashku me luginën e Moravës dhe Galabit, zënë vend parësor në ngritjen dhe zhvillimin e qytetërimit ilir-dardan.

Megjithëse është përpjekja e parë në këtë drejtim, bëhet një hap i vogël përpara në boshllëkun e madh të punëve kërkimore shkencore, që do të duhet të ndërmereshin urgjentisht, me qëllim shpëtimi të monumenteve. Trajtesa sjell përpjekjen e parë që bëhet në aspektin e fortifikimeve, në këtë malësi, që natyrisht shënon fillimin e një pune shkencore që do të shërbejë si udhërrëfyes për gjurmimet e ardhshme arkeologjike.

DIPLOMACIA NDËRKOMBËTARE DHE KOSOVA 1990-1999

Ma. Ferit Idrizi

Hyrje

Kosova si një çështje e pazgjidhur e Ballkanit, pothuajse ishte ndër sfidat më e rëndë për diplomacinë ndërkombëtare dhe botën e zhvilluar demokratike në fundshekullin e njëzet. Ajo përbënte atë që shpesh quhej nga diplomatët si "Nyje e Ballkanit", pa zgjidhjen e së cilës Ballkani jo vetëm që nuk do të qetësohej, por do të mbetej fuqi baroti me rrezik të përhershëm të shpërthimit dhe përhapjes. Këtë gjë diplomacia ndërkombëtare e kishte kuptuar me kohë, por e zvarriti duke e anashkaluar në të gjitha konferencat ndërkombëtare që u mbajtën nga vitet 1991-1995 për republikat e Jugosllavisë. Ky anashkalim zgjati derisa vet shqiptarët e zgjedhën rrugën e çlirimit të vendit, e cila më pas gjeti mbështetje jo vetëm diplomatike, por edhe ushtarake.

Kosova në konferencat ndërkombëtare-Konferenca e Hagës

Rruga paqësore të cilën shqiptarët e Kosovës e kishin zgjedhur për të arritur synimet e tyre për liri dhe pavarësi, nuk gjeti përkrahje nga faktorët ndërkombëtar, edhe pse ishte pëlqyer si një formë shumë e mirë edhe nga bota demokratike. Konferenca e Hagës e cila i filloi punimet në shtator të vitit 1991 nën patronatin e BE-së dhe drejtimin e Lordit Kerington(Carrington), ishte një përpjekje e cila filloi për ta mbajtur gjallë Jugosllavinë dhe përfundoi me shqyrtimin e mundësive për ta shpërbërë atë⁸⁰¹ qysh në fillim të kësaj konference, çështja e Kosovës doli të jetë pengesë kur u ngrit nga ministri i jashtëm slloven Dimitrije Rupel, derisa në njërin prej komisioneve po diskutohej çështja e pakicave serbe në Kroaci. Aty ministri slloven propozoi zgjidhje të njëjtë edhe për shqiptarët, e ky doli të jetë fundi i miqësisë sllovene-serbe.⁸⁰² Konferenca e Hagës e zhvilloi punën në dy komisione: Komisioni i Badinterit dhe Komisioni për Suksedim. Me vendim të Komisionit të Badinterit, Kosova mbeti pjesë e Serbisë dhe e Jugosllavisë së mbetur nga ndarjet e njëpasnjëshme të republikave, vullneti politik i të cilave u njoh ndërkombëtarisht.⁸⁰³ Zgjidhja e çështjeve etnike ishte hartuar në një dokument i cili u quajt "Dokumenti i Keringtonit" i cili në fakt ishte dokument i Konferencës së Hagës me titull: "Elementet e Marrëveshjes për Zgjidhjen Globale të Krizës jugosllave." Sipas këtij dokumenti çështjet etnike përkufizoheshin në dy terma: Grupe etnike dhe grupe kombëtare⁸⁰⁴. Për statusin e grupeve kombëtare në Jugosllavi Dokumenti i Keringtonit aplikoi zgjidhje të dyfishtë, duke i avancuar grupet që jetojnë në shumicë në një territor dhe duke ua njohur atyre një formë më të avancuar të statusit i quajtur "statusi special." Ky status ofronte me pak të drejta për shqiptarët se sa gëzonin me Kushtetutën e Vitit

⁸⁰¹ Judah, Tim., Kosova luftë dhe hakmarrje fq. 104

⁸⁰² Po aty, fq. 105

⁸⁰³ Buja, Ramë., Kosova në krizën jugosllave..., fq. 115

⁸⁰⁴ Grupet etnike ishin grupe pakicë të një territor, ndërsa grupet kombëtare ishin grupe shumicë në një territor.

1974, por edhe si i tillë ishte refuzuar nga serbët, të cilët në shenjë reagimi e kishin bojkotuar Konferencën e Hagës.⁸⁰⁵ Konferenca e Hagës ishte tregues i qartë se si dështohet lehtë kur çështjet nuk trajtohen drejt.

Kosova në Konferencën e Londrës dhe Konferencën e Gjenevës

Pas dështimit të Konferencës së Hagës, kjo konferencë paraqet anashkalimin tjetër të Kosovës kur me 17 gusht 1992, Lordi Kerington (Carrington), kryetar i kësaj konference, i shkruan një leter Ibrahim Rugovës. “Në qoftë se keni në plan të ndodheni në Londër në kohën e konferencës” i shkruante ai, atëherë do të ishte e mundur që të bënte disa takime, por nuk do të ishte e mundur për arsye praktike dhe arsye të tjera që t’i mundësohet delegacionit tuaj hyrja në sallën e konferencës.” Megjithatë, Lordi Kerington premtoi që mund të përgatisë një “sallë dëgjimi” për kosovarët në një dhomë të vogël anësore me lidhje të drejtëpërdrejtë me video.” Në këtë mënyrë, ne po bëjmë përpjekje energjike për të siguruar që pikëpamjet e shqiptarëve të Kosovës të dëgjohen.”⁸⁰⁶ Në qoftë se ju jeni të interesuar të merrni pjesë mbi këto baza, do t’ju isha mirënjohës nëse kontaktoni sekretariatit... me hollësitë për delegacionin që propozoni dhe akomodimin në Londër.”⁸⁰⁶ Konferenca e Londrës krijoi një grup të posaçëm për Kosovën (Kosovo Special Group), që kryesohej nga ambasadori Gert Ahrens (Geert Ahrens) i Gjermanisë. Sipas fjalëve të Mark Wellerit (Marc Weller), një jurist i së drejtës ndërkombëtare në Universitetin e Kembrijit, grupi “vendosi shpejt e shpejt që t’i anashkalonte çështjet e vështira të statusit dhe në vend të tyre u përpoq të përqendrohej në çështjet praktike të jetës në atë territor. Çështja e arsimit u zgjodh si një nga fushat ku përparimi dukej i mundur.”⁸⁰⁷ Konferenca e Londrës, së bashku me të edhe grupi për Kosovën kanë vazhduar punën në suazat e OKB-së, përkatësisht të Konferencës Paqësore të Gjenevës për Ish-Jugosllavinë (1992-1995), ku çështja e Kosovës është provuar të zgjidhet sipas konceptit të çështjes parciale, dhe duke lënë për fund bisedimet për statusin final. Përpjekjet negociatore të Konferencës së Gjenevës të cilat arritën të fokusohen vetëm në çështjen e arsimit, përfunduan pa rezultate.

Konferenca e Dejtonit dhe Kosova

Pritjet e gjata të shqiptarëve të Kosovës, se më në fund Konferenca e Dejtonit do t’i japë fund krizës në Jugosllavi dhe do ta zgjidhë edhe çështjen e Kosovës, sollën një zhgënjim të thellë ndër shqiptarët. Këtij zhgënjimi i ishte përgjigjur në vitin 1996 Rudolph Perina, shef i misionit diplomatik të SHBA-ve në Beograd në një mbledhje të Lidhjes Demokratike të Kosovës të mbajtur me dyer të mbyllura, kur ai pyetet “Pse në Dejton nuk u hap çështja jonë, çështja e Kosovës”? Perrina do të jetë i qartë dhe i drejtëpërdrejtë “Në Dejton janë ftuar ata që kanë luftuar. Dejtoni është një marrëveshje e paqes, e arritur midis palëve të inkuadruara në luftërat në Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë.”⁸⁰⁸ Krejt çka u bë në Dejton për Kosovën, ndryshe nga OKB-ja, Shtetet e

⁸⁰⁵ Po aty, fq. 116

⁸⁰⁶ Judah, T., Kosova luftë dhe hakmarrje..., fq. 123

⁸⁰⁷ Po aty, fq. 124

⁸⁰⁸ Shala, Blerim., Vitet e Kosovës 1998-1999..., fq. 26

Bashkuara të Amerikës bllokuan rikthimin e Jugosllavisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe në Bankën Botërore duke cituar çështjen e Kosovës si një arsye për ruajtjen e tij, që më vonë u njoh me emrin “Muri i Jashtëm” i Sanksioneve⁸⁰⁹ Ndërsa “Muri i Jashtëm” për shumicën e kosovarëve mbetej sanksion më tepër teorik pa ndonjë ndikim të dukshëm në aspiratat e tyre, njohja e Jugosllavisë nga Bashkimi Evropian pas Konferencës së Dejtonit, sigurisht që ndikoi shumë. Ajo që njohën Shtetet e Bashkimit Evropian ishte Republika Federale e Jugosllavisë “RFJ” e krijuar më 1992, që përbëhej nga Serbia dhe Mali i Zi, dhe sigurisht edhe Kosova.⁸¹⁰

Diplomacia intensive ndërkombëtare dhe Kosova

Duke e parë paaftësinë e zgjidhjes politike të krizës në Kosovë, radha i mbeti zgjidhjes ushtarake e cila kishte filluar përgatitjet pas vitit 1990 për formimin e UÇK-së si një formacion i armatosur për çlirimin e Kosovës. Këto përgatitje u kurorëzuan në vitin 1997, kur UÇK-ja doli publikisht në skenë dhe filloi luftën çlirimtare në Kosovë. Dalja e UÇK-së në skenë bëri që të krijohen raporte të reja në Kosovë dhe rajon, që problemi i Kosovës të dalë në skenë me tërë kompleksitetin e saj.⁸¹¹ Dalja e UÇK-së, shënon edhe fillimin e luftës në Kosovë dhe angazhimin e fuqishëm të diplomacisë ndërkombëtare. Menjëherë më 23 shkurt 1998 Robert Gelbard i dërguar i posaçëm i SHBA-ve në rajon vizitoi Prishtinën, ku ndër të tjera tha: “Dhuna që po shohim e që po shtohet nga dita në ditë, është jashtëzakonisht e rrezikshme”. Po ashtu, ai kritikoi dhunën “e shpallur zyrtarisht” nga policia serbe, dhe pastaj sulmoi UÇK-në. “Ne i dënojmë me forcë veprimet terroriste në Kosovë. UÇK-ja është pa dyshim një grup terrorist”.⁸¹² Ky cilësim goditi rëndë UÇK-në, ndërsa i dha dritën jeshile Beogradit që të intensifikojë sulmet kundër shqiptarëve të Kosovës në emër të ndjekjes dhe shpërbërjes së UÇK-së. Kështu, më 28 shkurt 1998 në fshatrat Qirez dhe Likoshan të Drenicës në shenjë hakmarrjeje për 4 milicë të vrarë, pushteti serb vrau dhe masakroi 27 shqiptarë.⁸¹³ Menjëherë pas kësaj masakre, Robin Kuk shkoi në Beograd në emër të Bashkimit Evropian për të kërkuar nga Millosheviçi që t’u ofronte kosovarëve ndonjë alternativë tjetër përveç dhunës.⁸¹⁴ Derisa Robin Kuk po bisedonte me Millosheviqin, në Kosovë ndodhi masakra tjetër që e tronditi botën demokratike. Më 5 mars, Prekazi i Ulët i Drenicës ishte përfshirë në flakët e artilerisë së rëndë të forcave ushtarake-policore, që la të vrarë 58 veta përfshirë 13 gra dhe 10 fëmijë nën moshën 16 vjeçare.⁸¹⁵ Menjëherë me 6 mars Prishtinën e vizitoi një delegacion i ambasadorëve të grupit të Kontaktit, ndërsa me 9 mars, në Londër u thirr takim urgjent i Grupit të Kontaktit ku u kërkuar tërheqja e forcave speciale policore serbe nga Kosova, por nuk u përkrah ideja për pavarësi të Kosovës. Më 10 mars u kthye prap në Prishtinën ambasadori amerikan Robert Gelbard, tani me një qasje krejt tjetër. Ai ishte diplomati i parë që i shprehu ngushëllime familjes Jashari të Prekazit.⁸¹⁶ Gjatë kësaj kohe, arkitekti i Dejtonit Richard Hollbruk derisa po ndodhej në Berlin, mori një faks nga Ibrahim Rugova i cili kërkonte nga Hollbruku të

⁸⁰⁹ Po ary, fq. 160

⁸¹⁰ Po ary.

⁸¹¹ Bajrami, Arsim., E drejta e Kosovës në tranzicion..., fq. 69

⁸¹² Judah, T., Kosova luftë dhe hakmarrje..., fq. 174

⁸¹³ Po ary, fq. 176

⁸¹⁴ Po ary, fq. 177

⁸¹⁵ Po ary, fq. 176

⁸¹⁶ Shala, B., vitet e Kosovës 1998-1999..., fq. 38

bëhej ndërmjetës për Kosovën "Pa parakushte." Po ashtu, një faks nga Rugova e kishte marrë edhe sekretarja amerikane e shtetit Medllin Ollbrajt, së cilës i kërkohej ndërhyrja e Hollbrukut si ndërmjetës. Kjo kërkesë si duket nuk i pëlqeu aspak zonjës Ollbrajt, sepse sipas një burimi të lartë diplomatik: "Medllin Ollbrajt donte t'i mbante vetë frerët dhe nuk donte që Hollbruku të futej prapë në lojë. Ajo donte që ky të ishte Dejtoni i saj," ndersa Gelbardin të ishte njeriu i saj. Ndërkohë Këshilli i Sigurisë Kombëtare i SHBA-ve që këshillon presidentin për punët e jashtme dhe çështjet e sigurisë nuk po merrte vesh se çfarë po ndodhte. Kështu, Hollbrukun e angazhuan vetëm në maj kur Strob Talbot zëvendëssekretar i shtetit dhe Sendi Berger këshilltari i presidentit për çështjet e sigurisë kombëtare ia kishin mbushur më në fund mendjen Medllin Ollbrajtit, se Shteteve të Bashkuara u duhej një njeri si Hollbruku që të udhëhiqte operacionet e tyre diplomatike.⁸¹⁷ Kjo po bëhej edhe më urgjente sepse në mars të vitit 1998 Organizata e Sigurisë dhe e Bashkëpunimit në Evropë (OSBE) dhe Bashkimi Evropian, kishin caktuar Filipe Gonzalesin, ish-kryeministër spanjoll si të dërguarin e tyre të posaçëm për Kosovën. Grupi i kontaktit gjithashtu i kishte kërkuar atij që të takonte Millosheviçin, por Milosheviqi nuk pranoi atë.⁸¹⁸

Përpjekjet diplomatike për fillimin e negociatave Kosovë-Serbi

Me qëllim të fillimit të negociatave me Serbinë për t'i dhënë fund krizës, diplomacia amerikane përmes ambasadorit Gelbard inicioi dhe ndihmoi themelimin e grupit negociator të Kosovës G-15.⁸¹⁹ Takimi i parë i G-15 u mbajt të mërkurën me 25 mars një ditë pasi kishte shpërthyer lufta në Dukagjin. Në takim munguan Bujar Bukoshi, i cili vazhdonte të ishte Kryeministër i Qeverisë së Kosovës në ekzil, dhe Adem Demaçi që ishte prononcuar kundër pjesëmarrjes në këtë grup, duke e quajtur këtë iniciativë "Mashtrimi i ri i dr.Rugovës".⁸²⁰ Derisa në diplomacitë përendimore thellohet kriza rreth asaj se çka duhet bërë me Kosovën, Serbia i tha jo negociatave me Kosovën të ndërmjetësuar ndërkombëtarisht, përmes referendumit të 23 prillit. Atë ditë Jergeny Primakovit ministër i jashtëm i Rusisë kishte pasur një bisedë të nxehtë me Millosheviçin, kur ishte munduar ta bindë atë që të pranonte misionin e Filipe Gonsalesit.⁸²¹ Në anën tjetër edhe Italia dëshironte të tregonte ndikimin e vet diplomatik, kur më 25 prill në Prishtinë qëndroi sekretari i përgjithshëm në Ministrinë e Jashtme Italiane Umberto Vattani. Qëllimi i kësaj vizite ishte përgatitja e takimit të Grupit të Kontaktit, i treti me radhë që ishte caktuar të mbahej më 29 prill në Romë.⁸²² Grupi i Kontaktit ishte mbledhur më 29 prill në Romë në nivel të drejtorëve, ku siç duket, sekretarja amerikane e shtetit Medllin Ollbrajt ishte e pakënaqur me punën e këtij grupi.⁸²³ Në anën tjetër me 10 maj arriti në Prishtinë arkitekti i Konferencës së Dejtonit Riqard Hollbruk, bashkë me Robert Gelbard, Kristofer Hill dhe Riqard Mills. Një ditë më parë ky ekip ishte takuar në Beograd me Slllobodan Millosheviçin dhe takimi kishte zgjatur 4 orë.⁸²⁴ Takimi në mes të delegacionit amerikan dhe grupit 15-të u mbajt në

⁸¹⁷ Judah, T., Kosova luftë dhe hakmarrje..., fq. 182

⁸¹⁸ Po aty.

⁸¹⁹ Po aty, fq. 43

⁸²⁰ Po aty, fq. 44

⁸²¹ Po aty, fq. 46

⁸²² Po aty, fq. 49

⁸²³ Po aty, fq. 50

⁸²⁴ Po aty, fq. 55

selinë e LDK-së. Hollbruk në këtë takim tha se në Kosovë ka ardhur me autorizimin e presidentit Bill Clinton dhe të zonjës Medllin Ollbrajt dhe se këtu përfaqëson SHBA-të e jo Grupin e Kontaktit. Ardhja e Hollbrukut në Prishtinë u cilësua edhe si heqje dorë e perëndimit nga Filipe Gonsales si ndërmjetës për Kosovën, dhe si angazhim i SHBA-ve përmes Hollbrukut në krizën e Kosovës. Ndërsa lajmi i mëngjesit i datës 13 maj befasoi pa masë opinionin kosovar, kur u dëgjua se të premtën me 15 maj, Rugova do të takohet në Beograd me Slllobodan Millosheviçin. Mirpo, nga deklarata publike e Gelbardit dhe e Hollbrukut kuptohet fare lehtë që ky takim është rezultat i ndërmjetësimit të diplomacisë amerikane.⁸²⁵ Pas takimit të Beogradit, po ashtu me insistimin amerikan u mbajt takimi i parë dhe i fundit shqiptaro-serb. Takimi u mbajt në selinë e LDK-së në Prishtinë.⁸²⁶ Pas këtyre takimeve të pasuksesshme delegacioni i Kosovës në përbërje dr.Ibrahim Rugova, Bujar Bukoshi, Fehmi Agani dhe Veton Surroi do të udhëtojnë për në Washington, ku më 29 maj në shtëpinë e Bardhë do t'i presë presidenti amerikan Bill Clinton. Në këtë takim morën pjesë edhe Medllin Ollbrajt, sekretare e shtetit dhe Strob Talbot zëdhënësi i saj. Fjala e presidentit Clinton e thënë publikisht pas këtij takimi, se "Nuk do të lejohet Bosnja e dytë në Kosovë" kishte peshën më të madhe të mundshme politike.⁸²⁷ Në anën tjetër derisa Këshilli i Ministrave të Unionit Evropian ishte mbledhur në Bruksel më 8 qershor për të diskutuar për Kosovën, Kristofer Hill kishte shkuar të vizitojë regjionin e Dukagjinit, por nuk arriti në Gillogjan për shak të luftimeve që bëheshin.⁸²⁸ Edhe Aleanca e NATO-s, më 11 qershor mbajti takimin e nivelit të lartë të shteteve anëtare ku paralajmëroi mbajtjen e një ushtrimi ushtarak të aviacionit të NATO-s të quajtur "Skifteri i Vendosur." Ky ushtrim mbi qiellin e Maqedonisë dhe të Shqipërisë do të mbahej me 15 qershor.⁸²⁹ Gjatë kësaj kohe Millosheviçi kishte udhëtuar në Moskë për t'u takuar me kryetarin e Federatës Ruse Boris Jelcinin. Rezultati i takimit Millosheviç-Jelcin do të jetë një marrëveshje me të cilën Millosheviç kinse i plotësonte kërkesat e Grupit të Kontaktit dhe të Bashkësisë Ndërkombëtare.⁸³⁰ Në anën tjetër Richard Hollbruku u takua me pjestarë të UÇK-së në fshatin Junik të Deqanit në një odë të këtij fashati ai u takua me Hajdin Abazin i njohur si Lum Haxhiu, e një ditë më pas ai udhëtoi në Beograd, ku takohet me presidentin e Serbisë Slllobodan Millosheviç. Dy ditë pas takimit të Hollbrukut me luftëtarët e UÇK-së në Junik, diplomati tjetër amerikan, ambasadori Gelbard, me 26 qershor takoi në Zvicër Bardhyl Mahmutin dhe Ramadan Avdiun, të dy përfaqësues politikë të UÇK-së. Përmes këtyre takimeve Washingtoni dëshironte të kuptonte se ku janë prijësit e UÇK-së, të cilët vazhdonin të mbeteshin të panjohur për opinionin kombëtar dhe ndërkombëtar.⁸³¹ Gjatë kësaj kohe, Hill kishte arritur në pajtim që mandatar i qeverisë së re të jetë Mehmet Hajrizi. Hill pastaj kishte biseduar edhe me Dr. Rugovën, i cili pastaj e kishte thirrur Mehmet Hajrzin për t'ia komunikuar lajmin e mandatarit të qeverisë. Për të siguruar mandatin Mehmet Hajrizi duhej të siguronte edhe përkrahjen e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, por edhe kjo iniciativë kishte dështuar.⁸³² Në ditët kur pritej përgjigjja e Shtabit të

⁸²⁵ Po ary, fq. 61-62

⁸²⁶ Po ary, fq. 69

⁸²⁷ Po ary, fq. 73

⁸²⁸ Po ary, fq. 77-79

⁸²⁹ Po ary, fq. 82

⁸³⁰ Po ary, fq. 83

⁸³¹ Shala, B., Vitet e Kosovës 1998-1999..., fq. 101

⁸³² Po ary, fq. 118

Përgjithshëm të UÇK-së rreth mandatarit të qeverisë, edhe Bujar Bukoshi nuk e fshehu mllefin e vet për këtë procesë.⁸³³ Gjatë kësaj kohe derisa ofensivat serbe kishin dobësuar pozitat e UÇK-së, diplomacia ndërkombëtare i kthehet prapë Rugovës si partnerë. Kështu, Brajn Donjëlli ambasador i Britanisë së Madhe në Beograd, me 8 gusht do t'ia japë vetëm Ibrahim Rugovës projektin e Grupit të Kontaktit për zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Një ditë më parë në Beograd, Donelli ia kishte dhënë pakon politike të Grupit të Kontaktit Milan Milutinoviçit, kryetar i Serbisë, dhe Nikolla Shahinoviçit, zëdhënës kryeministër i RFJ-së, por pala jugosllave e kishte refuzuar propozimin e Grupit të Kontaktit.⁸³⁴ Siç duket, edhe Hill kishte hequr dorë nga formimi i qeverisë dhe ia kishte adresuar të gjitha përgjegjësitë Rugovës që ai vetë ta themelojë grupin e ri negociator. Të enjtën, me 13 gusht, Ibrahim Rugova në prani të ambasadorit Hill dhe të ambasadorëve të shteteve anëtare të Grupit të Kontaktit shpalli grupin e ri negociator.⁸³⁵ Para se të lexonte Rugova emrat e negociatorëve të ri shqiptarë, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së përmes një komunikate publike shpalli përfaqësuesit e tij politikë.⁸³⁶

Marrëveshja për armëpushim

Pamjet e masakrës në familjen Deliaj të Abrisë së Epërme të Drenicës paralajmëruan një katastrofë humanitare në Kosovë, ndërsa Këshilli i Sigurimit të OKB-së me 23 shtator miratoi Rezolutën 1199, përmes së cilës kërkohet ndalja e menjëhershme e luftimeve, fillimin e negociatave, tërheqjen e njësisve policore serbe, dhe bashkëpunimin e të dy palëve me Tribunalin e Hagës.⁸³⁷ Në mbështetje të Rezolutës 1199 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së doli edhe Grupi i Kontaktit në mbledhjen e mbajtur në Londër në fillim të tetorit. Ndërsa më 5 tetor, Riqard Hollbruk arriti në Beograd për ta bindur Millosheviçin për një armëpushim, kurse më 6 tetor, Hollbruk arriti në Prishtinë bashkë me Kristofer Hill dhe Tina Kajdanovin, ku dhe u takua me Ibrahim Rugovën dhe bashkëpunëtorët e tij. Hollbruk kërkoi që të ndikohet tek Adem Demaçi për një armëpushim nga ana e UÇK-së.⁸³⁸ Dy ditë më pas të enjten më 8 tetor, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, përmes deklaratës politike nr. 12 vendosi të pranonte obligimet që dalin nga rezoluta 1199 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, gjegjësisht shpalli vetëpërmbajtjen në aktivitetin ushtarak prej ditës së nesërme, e premtë 9 tetor.⁸³⁹ Në mbrëmjen e 12 tetorit, Këshilli i Paktit NATO vendosi për aktivizimin e intervenimit ushtarak mbi caqet ushtarake në RFJ, nëse Sllobodan Millosheviç brenda 96 orëve nuk zotohet për plotësimin e kërkesave që dalin nga Rezoluta 1199 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ndërsa të martën më 13 tetor pas bisedave të reja me Hollbrukun, Millosheviçi shpalli përmes televizionit shtetëror serb se është arritur marrëveshja dhe është ruajtur paqja. Në këtë vendim të Millosheviçit kishte pasur ndikim edhe Moska zyrtare, e cila përmes kanaleve të ndryshme kishte porositur Millosheviçin: “Lësho pe, pranoje ofertën, nuk i ke punët mirë”.⁸⁴⁰ Nga ana tjetër, përfaqësuesit e Paktit NATO do të nënshkruajnë marrëveshjen me zyrtarët e ushtrisë jugosllave sipas së cilës, në Kosovë do

⁸³³ Po aty, fq. 122-125

⁸³⁴ Po aty, fq. 125

⁸³⁵ Po aty.

⁸³⁶ Po aty.

⁸³⁷ Po aty, fq. 141

⁸³⁸ Po aty, fq. 147-148

⁸³⁹ Po aty, fq. 152

⁸⁴⁰ Po aty, fq. 156

të mbeten 18.500 ushtarë dhe policë serbë. Po ashtu, kryesuesi i radhës i OSBE-së, ministri i jashtëm i Polonisë, Bronislaw Geremek do të firmosë marrëveshjen me homologun e tij jugosllav Zhivorad Jankoviç për vendosjen e 2 mijë verifikuesve të OSBE-së në Kosovë, ndërsa shef i këtij misioni ishte caktuar diplomati amerikan William Walker.⁸⁴¹ Pas arritjes së armëpushimit diplomacia amerikane ishte përpjekur edhe disa herë për të iniciuar negociatat, kështu më 6 nëntor ambasadori Hill u takua në Dragobil të Malishevës me udhëheqësit e UÇK-së; Hashim Thaqi, Jakup Krasniqi dhe Ramë Buja. Hill do t'i japë treshes politike të UÇK-së edhe draftin më të ri të marrëveshjes kalimtare që mbante datën e 1 nëntorit.⁸⁴² Draftin e një nëntorit e kishte hedhur poshtë pala serbe dhe nuk e kishte pranuar pala shqiptare. Në këtë draft Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së vërente mungesën e definimit të së drejtës për mbajtjen e referendumit në skadim të periudhës kalimtare 3 vjeçare. Gjatë gjithë periudhës së armëpushimit pati incidente të herë pas herëshme në mes të UÇK-së dhe forcave serbe, por luftimet e 15 janarit përreth fshatit Reçak të Shtimes, rezultuan me hyrjen e forcave policore, ushtarake dhe paraushtarake serbe te popullata civile, të cilët masakruan 51 shqiptarë të fshatit Reçak.⁸⁴³ Të nesërmen, në vend të ngjarjes, arriti William Walker, i cili menjëherë akuzoi autoritetet jugosllave si përgjegjëse. Për këtë masakër Medllin Ollbrajt u informua përmes lajmeve të hershme të radio-orës në orën 4:30 të mëngjesit. E zemëruar jashtë mase nga ajo masakër, ajo mori në telefon Sendi Bergerin dhe i tha: "Pranvera ka ardhur herët në Kosovë."⁸⁴⁴ Autoritetet e Beogradit akuzuan UÇK-në se ajo kishte sajuar një skenë masakre të rreme dhe urdhëroi Wolkerin të largohej nga Kosova. Pas një trysnie të jashtëzakonshme që Beogradit i bëri diplomacia ndërkombëtare, ata më vonë e pezulluan këtë vendim. Në anën tjetër, kryetarja e Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve për ish-Jugosllavinë Luis Arbur, bëri përpjekje që të shkonte në Reçak, por pasi nuk i dhanë vizë autoritetet serbe atë e kthyen në kufi.⁸⁴⁵ Reçaku e lëvizi fuqishëm diplomacinë ndërkombëtare, kështu, në Washington, Paris dhe Londër, diplomatët filluan një varg konsultimesh. Ndërsa, Medllin Ollbrajt filloi shpejt të ndërtonte konsensusin për idenë e saj se diplomacia e ardhshme duhet të mbështetej nga kërcënimi i forcës. Në anën tjetër edhe udhëheqësit britanikë dhe francezë ishin në një mendje me Ollbrajtin, dhe pas konsultimeve me ministrin e jashtëm rus Ivanov, lindi plani i ri ku serbët dhe shqiptarët do të thirren për të biseduar për paqen në një kështjellë rreth 45 kilometra në juglindje të Parisit, në qytetin e quajtur Rambuje.⁸⁴⁶ Trysnia e madhe e diplomacisë ndërkombëtare bëri që edhe palet t'i formojnë ekipet negociuese. Kështu Kuvendi i Serbisë, më 2 shkurt pa diskutim të madh vendosi të dërgonte delegacionin në Konferencën e Rambujesë. Delegacioni serb kishte një përbërje të nivelit të ulët edhe shumë etnike. Në këtë delegacion ishin futur edhe dy shqiptarë "të ndershëm" (term ky i inauguruar nga vetë regjimi serb në vitet e 80-ta, kur u parapërgatit heqja e autonomisë politike të Kosovës), një boshnjak, një goran, dy turq, një rom, madje edhe një "egjiptas", zbulim tjetër i regjimit serb. Megjithatë ishin edhe katër veta që drejtonin delegacionin serb: Ratko Markoviçi, zëvendës kryeministër serb, Vladimir

⁸⁴¹ Po aty, fq. 158-159

⁸⁴² Po aty, fq.165

⁸⁴³ Shala, B., Vitet e Kosovës 1998-1999..., fq. 202

⁸⁴⁴ Judah, T., Kosova luftë dhe hakmarrje..., fq. 240

⁸⁴⁵ Po aty.

⁸⁴⁶ Po aty, fq.241

Shtanbuku, zyrtar i lartë i grupacionit JUL të Maria Markoviçit, gruaja e Sllobodan Millosheviçit, Nikola Shahinoviçi, dhe Vlladan Kuteshiçi, zëvendës kryeministra të RFJ, që të katërt ishin miq të familjes Millosheviç-Markoviç.⁸⁴⁷ Delegacionin e Kosovës e përbënin: përfaqësuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të përbër nga: Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Ramë Buja, Azem Syla dhe Xhavit Haliti; Lidhjen Demokratike të Kosovës nga Ibrahim Rugova, Fehmi Agani, Edita Tahiri, Bujar Bukoshi dhe Idriz Ajeti; Lëvizjen e Bashkuar Demokratike nga Rexhep Qosja, Hidajet Hyseni, Bajram Kosumi dhe Mehmet Hajrizi; si dhe nga të Pavarurit Blerim Shala dhe Veton Surroi.⁸⁴⁸ Delegacioni kosovar duhej të arrinte në Francë më 5 shkurt 1999 për të filluar konferencën me 6 shkurt. Por kjo nuk qe e mundur, për shkak të pengesave që pushteti serb i bëri delegacionit të UÇK-së. Pikërisht në prag të nisjes për në konferencë, Serbia kishte lëshuar për ta flet-arrest.⁸⁴⁹ Në orën 12:00 të datës 6 shkurtë, nën përcjelljen e shumë njerëzve, me makina të blinduara të KDOM(misioni amerikan) udhëtuan për në Aeroportin e Prishtinës tre përfaqësuesit e UÇK-së; Azem Syla, Jakup Krasniqi dhe Ramë Buja, ndërsa dy anëtarët e tjerë, Hashim Thaçi dhe Xhavit Haliti do të udhëtojnë nga Tirana. Në orën 13:25 minuta makinat hyjnë në pistën e aeroportit, të rrethuara me kordone ushtarësh dhe policësh serbë, në mesin e të cilëve edhe kryepolici Llonçar. Pjesëtarët e delegacionit të UÇK-së ishin marrë vesh me shefin e misionit amerikan, që për shkaqe sigurie të mbanin armë të lehta sigurie.⁸⁵⁰ Nga Aeroporti i Prishtinës, delegacioni i UÇK-së fluroi për plot tri orë, për të mbërritur në Paris në orën 16:37 minuta.⁸⁵¹

Konferenca e Rambujesë për Kosovën

Konferenca e Rambujesë ishte e para e rangut ndërkombëtarë për të trajtuar çështjen e Kosovës. Për shkak të rrethanave të luftës delegacioni i Kosovës udhëtoj ndaras për në Rambuje. Derisa në sallën e kështjellës së Rambujesë pritej vetëm delegacioni nga Kosova, i cili kishte arritur me vonesë. Kryesuesit e konferencës qëndronin në sallë bashkë me delegacionin serb dhe përfaqësuesit e të gjitha shteteve të Grupit të Kontaktit, bashkë-kryesuesit e konferencës; ministrin e punëve të jashtme të Francës, Hyber Vedrin, dhe homologun e tij britanik Robin Kuk, si edhe tre ndërmjetësit: ambasadorin Kristofer Hill(SHBA), Volgfabg Petriç(BE), dhe Boris Majorski(Rusi.). Menjëherë pas arritjes së delegacionit kosovar, në sallë hyri presidenti i Francës Zhak Shirak prisnin.⁸⁵² Presidenti Shirak iu bëri palëve në armiqësi një thirrje të pamohueshme fisnike dhe prekëse. Ai e krahasoi armiqësinë shqiptaro-serbe me antagonizmin franko-gjerman, që kishte shkaktuar tri luftëra të mëdha midis viteve 1870-1945.”⁸⁵³ Pas këtij fjalimi shumë humanë dhe paqedashës të presidentit Shirak, edhe sekretari britanik i shtetit Robin Kuk, mbajti një fjalim duke sjellë para pjesëmarrësve një histori luftërash anglo-franceze, ku tani këto dy vende janë mike.⁸⁵⁴ Nögciatorët mbështeteshin nga një ekip ekspertësh të Grupit të Kontaktit që kryesohej

⁸⁴⁷ Aty, fq. 219.

⁸⁴⁸ Buja, R., Kosova në krizën jugosllave..., fq. 263

⁸⁴⁹ Po aty, fq. 264

⁸⁵⁰ Po aty, fq. 264

⁸⁵¹ Po aty.

⁸⁵² Po aty.

⁸⁵³ Judah, T., Kosova luftë dhe hakmarrje..., fq. 249

⁸⁵⁴ Po aty.

nga Xhim O'Brajën i Departamentit të Shtetit, ai kishte luajtur një rol kyç në formulimin e marrëveshjes së Dejtonit. Për befasi, serbët bënë një kthesë të papritshme duke kërkuar bisedime të drejtpërdrejta me palën shqiptare, me njerëzit për të cilët vetëm pak orë më parë kishin thënë se duhet të ishin në burg. Shqiptarët nuk e pranuan këtë, duke argumentuar se duhet të fillojnë me përgatitjen e përgjigjeve ndaj tekstit të propozuar të Rambujesë e, pas kësaj, ndoshta mund të takoheshin më vonë.⁸⁵⁵ Në mëngjesin e ditës së dytë të konferencës, më 7 shkurt 1999, delegacioni i Kosovës hyri në sallën e punimeve që ishte caktuar nga nikoqirët dhe organizatorët. Në sallë ishin të pranishëm edhe tre ndërmjetësit ndërkombëtarë; Hill, Petriç e Majorski, të cilët elaboruan draftet e Kushtetutës së Kosovës dhe marrëveshjes së përkohshme për zgjidhjen e problemit të Kosovës. Me që materialet ishin vetëm në gjuhën angleze, delegacioni i Kosovës kërkoi nga ndërmjetësit që puna rreth shqyrtimit të materialeve të fillojë nga dita e nesërme.⁸⁵⁶ Në fillim delegacioni zgjodhi kryesinë prej tre anëtarësh, të përbërë nga Hashim Thaçi, Rexhep Qosja dhe Ibrahim Rugova. Më pas, delegacioni me shumicë votash i barti përgjegjësitë të trashja e kryesisë që ata vetë ta zgjedhin kryesuesinë e delegacionit, ku kryesia vendosi që delegacionin e Kosovës për negociatë në këtë konferencë ta udhëheqë Hashim Thaçi, kryeshf i Drejtorisë Politike të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.⁸⁵⁷ Nga ekspertët ndërkombëtarë që e ndihmuan delegacionin ishin; Ambasadori Morton Abramovic; eksperti amerikan për çështje ndërkombëtare, Pol Uilliams dhe eksperti britanik për të drejtën ndërkombëtare, Mark Weler. Delegacioni i Kosovës pas shqyrtimit të Projektmarrëveshjes në mënyrë globale dhe veç e veç, në përputhje me platformën e vet artikuloi qëndrimet, kërkesat dhe vërejtjet e tij. Lidhur me Kornizën e Marrëveshjes, Delegacioni i Kosovës u përqendrua parimisht në dy çështje kryesore: Së pari, e drejta për vetëvendosje e popullit të Kosovës të përfshihet në kuadër të parimeve të marrëveshjes kalimtare, dhe së dyti që karakteri kalimtar i marrëveshjes të vlejë për të gjitha elementet e marrëveshjes.⁸⁵⁸ Pas shumë ditësh negociatë intensive dhe aspak të lehta, Grupi i Kontaktit, papritmas më 18 shkurt parashitroi draftin e ri para palëve negociuese. Në këtë draft jo vetëm që nuk ishin marrë për bazë kërkesat e shqiptarëve, por në të, në mënyrë të njëanshme ishin bërë ndryshime substanciale në favor të palës serbe. Ndryshimet më drastike dhe më të papranueshme kishin të bënin me çështjet e "sovrانيتetit të RFJ-së në Kosovë" dhe të "themelimit të institucionit të dhomës së dytë" në Kuvendin e Kosovës.⁸⁵⁹ Pas konsultimeve të delegacionit shqiptar, u morë vendim që Grupi Politik të takohet me juristët e Grupit të Kontaktit, të cilëve u printe Jim O'Brein. Qëndrimi duhet të ishte i prerë; ky draft është i papranueshëm për delegacionin e Kosovës.⁸⁶⁰

Ky draft kishte krijuar një rrëmujë të vërtetë në rrjedhën e negociatave, gjërat kishin shkuar aq larg sa që serbët dhe ruset kishin krijuar bindje se shqiptarët do ta braktisin konferencën, dhe një gjë e tillë iu shkante shumë për shtati. Por qëndrimi këmbëngulës i delegacionit të Kosovës, bëri që dy ditët e ardhshme, më 19 dhe 20 shkurt, drafti të përmirësohet në shumë pika në favor të shqiptarëve. Nga ana tjetër kryesuesi i

⁸⁵⁵ Po aty, fq. 250

⁸⁵⁶ Buja, R., Kosova në krizën jugosllave..., fq. 268-269

⁸⁵⁷ Po aty, fq. 270

⁸⁵⁸ Tahiri, E., Konferenca e Rambujesë..., fq.59

⁸⁵⁹ Po aty, fq. 69

⁸⁶⁰ Shala, B., Vitet e Kosovës 1998-1999..., fq. 256

delegacionit, Hashim Thaçi, nën organizimin e diplomacisë amerikane kishte udhëtuar për Lubjanë të Sllovenisë për t'u konsultuar me Adem Demaçin rreth draftit të ofruar nga Grupi i kontaktit.⁸⁶¹ Ndërsa konferenca ishte në një pikë kritike, sekretarja amerikane e shtetit ishte e vendosur që ajo të mos dështojë duke e shtyrë vazhdimin e konferencës deri më 23 shkurt. Kjo ndodhi kur kryesia e delegacionit shqiptar u takua me ministrat e jashtëm të Grupit të Kontaktit, ku përmes një letre dhënë ministrave të jashtëm, parimisht kishin pranuar marrëveshjen e propozuar me disa vërejtje të cilat pritej të merreshin në konsideratë nga juristët e Grupit të Kontaktit. Delegacionin e Kosovës e pyetën se a pranohet pjesa politike dhe pjesa ushtarake e marrëveshjes. Pjesa politike tashmë ishte e pranueshme, sikur të shtohet fjala referendum në formulimin final. Pjesa ushtarake ishte e panegocieshme, por delegacioni i Kosovës nuk mund të pajtohej me çmilitarizimin e plotë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.⁸⁶² Ndërsa rreth këtyre ngjarjeve Wolfgang Petritch shkruan: "Për kosovarët referendumi për pavarësi dhe çmilitarizimi i UÇK-së ishin dy çështje që nuk viheshin në diskutim. Për Republikën Federative të Jugosllavisë/Serbinë një forcë ushtarake nën drejtimin e NATO - s nuk mund të pranohet në asnjë rrethanë në territorin e saj. Për t'i dalë përpara dështimit të konferencës duhej gjetur sa më shpejt një rrugëdalje. Kjo mund të arrihej vetëm duke e shtuar trysninë mbi të dyja delegacionet dhe duke intensifikuar bisedimet."⁸⁶³ Rrëmuja rreth pranimit të marrëveshjes, çdo çast po bëhej edhe me dramatike. Ishin angazhuar shumë aktorë, të cilët dëshironin që konferenca të mos dështojë. Ishte përgjegjësi e madhe edhe për delegacionin shqiptar. Në ndërkohë ministria e jashtëm e Shqipërisë e konfirmonte nisjen e ministrit të jashtëm, Paskal Milo, në Rambuje. Atë pasdite në favor të marrëveshjes kishte mbërritur edhe një letër e shkrimtarit shqiptar Ismail Kadare, një telefonatë nga kryeministri i Shqipërisë, Pandeli Majko, dhe një letër nga Presidenti i Shqipërisë, Rexhep Mejdani. Të gjithë në favor të nënshkrimit të marrëveshjes.⁸⁶⁴ Tashmë, pothuaj, të gjithë ishin gati të nënshkruanin, veç Hashim Thaçit.⁸⁶⁵ Në mëngjesin e 23 shkurtit, delegacioneve iu dorëzua versioni i fundit i marrëveshjes së përkohshme për paqe dhe vetë- qeverisjen e Kosovës. Bashkë me këtë tekst ishte edhe një shkresë përcjellëse, në të cilën kërkohej nga delegacionet të bënin të ditur qëndrimin e tyre më së largu deri në orën 13:00, kur ishte edhe përcaktuar mbyllja e konferencës.⁸⁶⁶ Në këtë fazë të zhvillimit të konferencës, tërë udhëheqjen e procesit e kishte marrë në duar sekretarja amerikane e shtetit, Medllin Ollbrajt. Ndërmjetësit Hill dhe Petriç po ashtu ishin shumë aktivë, ndërsa përfaqësuesi rus Majorski kishte kohë që nuk dukej më para delegacionit kosovar. Derisa po afrohej koha për përgjigjen, në sallën e punës ku ishin të gjithë anëtarët e delegacionit, hyri Xhim O'brajan, njëri nga ekipi i ekspertëve amerikan për t'ua komunikuar lajmin se konferenca dukej të përfundonte dhe se çështja e nënshkrimit të marrëveshjes do të shtyhej për 2 javë.⁸⁶⁷ Pas kthimit të delegacionit kosovar në Kosovë, Hashim Thaçi shkoi nëpër të gjitha zonat nën kontrollin e UÇK-së ku ai zbuloi se, jo vetëm që shumica e kosovarëve e donin marrëveshjen, por, edhe se "grushti i shtetit" i Demaçit nuk kishte qenë aq i

⁸⁶¹ Po aty, fq. 258-259

⁸⁶² Po aty, fq. 266-267

⁸⁶³ Wolfgang Petritch, "Procesi i Rambouillet" (Fejton në Koha Ditore, 4-17 mars 2002).

⁸⁶⁴ Shala, B., Vitet e Kosovës 1998-1999..., fq 276-277

⁸⁶⁵ Judah, T., Kosova luftë dhe hakmarrje..., fq. 263.

⁸⁶⁶ Buja, R., Kosova në krizën jugosllave..., fq. 321

⁸⁶⁷ Po aty, fq. 322

rëndësishëm sa kishin lënë të kuptonte ai.⁸⁶⁸ Pas konsultimeve me popullatën dhe zonat ushtarake në Kosovë, delegacioni i Kovës nisej për në Paris me disponim pozitiv të të gjitha shtresave dhe strukturave ushtarake dhe politike, për t'i thënë *po* Marrëveshjes së Përkohshme Për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë. Nisja u bë pasditen e 13 marsit nga Aeroporti i Prishtinës me një aeroplan ushtarak, kësaj radhe udhëtonte edhe kryesuesi i delegacionit Hashim Thaçi.⁸⁶⁹ Tani bisedimet do të mbaheshin në Qendrën Ndërkombëtare të Konferencave në bulevardin "Klüber". Kur negociatorët hapën seancën e parë të bisedimeve, Hashim Thaçi, në emër të delegacionit të Kosovës, shpalli se ishin të gatshëm të nënshkruajnë marrëveshjen. Negociatorët kërkuan nga Thaçi që të priste para se të firmoste, me që negociatorët po i vazhdonin përpjekjet për ta bindur palën serbe që të nënshkruajë edhe ajo marrëveshjen.⁸⁷⁰ Në fjalën e tij Kristofer Hill, kumbueshëm potencoi se tash e tutje fati i Kosovës është i lidhur me Amerikën. Hill kishte premtuar këtë pozicion të SHBA-së qysh në Rambuje dhe tani vetëm i përmbahej premtimit të dhënë. Po ashtu edhe Petriç premtoi ndihmën politike, ekonomike dhe humanitare të Unionit Evropian për Kosovën. Më në fund edhe përfaqësuesi rus Majorski nuk mundi t'i ikë një prononcimi duke thënë: "Ju e dini që ne kemi qenë miq dhe do të mbetemi miq."⁸⁷¹ Po në të njëjtën ditë, në mëngjesin e së hënës, më 15 mars, Hashim Thaçi iu kishte drejtuar me një letër bashkëkryesuesve të Konferencës për Kosovën, ministrave të jashtëm të Francës dhe të Britanisë së Madhe, Hubert Vedrinë dhe Robin Kuk në të cilën informonte për vendimin e Delegacionit të Kosovës që Marrëveshja e Rambujelit do të pranohet dhe do të nënshkruhet. Të njëjtën letër një ditë më parë, Hashim Thaçi ia kishte dërguar sekretares amerikane të shtetit, Medllin Ollbrajt.⁸⁷² Në anën tjetër delegacioni serb ua dha negociatorëve një variant të ri të marrëveshjes së Rambujesë, në të cilin rreth gjysma e tekstit ishte hequr dhe në vend të saj ishte hartuar një listë dëshirash serbe; fjala *paqe* ishte fshirë, dhe po kështu ishte fshirë edhe çdo përmbajtje e fjalës *Kosovë* duke u zëvendësuar me fjalën "Kosmet." Edhe negociatori rus Boris Majorski mbeti pa mend nga habia.⁸⁷³ Të enjten, në pasditen e 18 marsit, u nënshkrua marrëveshja nga përfaqësuesit e Kosovës dhe dy ndërmjetësit ndërkombëtarë, ambasadorit Christopher Hill dhe Wolfgang Petrisch. Boris Majorski ndërmjetësi i tretë i cili kishte mandatin e Federates Ruse, nuk do ta firmoste marrëveshjen me që Serbia përfundimisht e refuzoi atë.⁸⁷⁴ Nga Parisi, Delegacioni i Kosovës u kthye përmes Aeroportit të Rinasit në Tiranë, për t'i lënë aty pjesëtarët e UÇK-së të cilët më pas do të futeshin në Kosovë përmes Maleve të Pashtrikut. Pjesa tjetër e delegacionit vazhdoi rrugën për në Shkup.⁸⁷⁵ Dështimi i bisedimeve u morë vesh shpejt. Hollbruk e shpalli këtë dështim në Bruksel, në një takim me gazetaret, bashkë me Havier Solanën, sekretar i Paktit NATO. Në përfundim të negociatave të kota kur Hollbruk ishte përshëndetur me Millosheviçin, ia kishte lënë adresën e tij të përkohshme, disaditore në Ambasaden Amerikane në Budapest, po që se ky do të ndërronte mendjen pasi të kenë rënë bombat e para të Paktit NATO. Në anën tjetër

⁸⁶⁸ Juda, T., Kosova luftë dhe hakmarrje..., fq. 267

⁸⁶⁹ Buja, R., Kosova në krizën jugosllave..., fq.237.

⁸⁷⁰ Judah, T., Kosova luftë dhe hakmarrje..., fq. 269

⁸⁷¹ Shala, B., Vitet e Kosovës 1998-1999..., fq. 318

⁸⁷² Po aty, fq. 316-317

⁸⁷³ Judah, T., Kosova luftë dhe hakmarrje..., fq. 270

⁸⁷⁴ Shala, B., Vitet e Kosovës 1998-1999..., fq. 325

⁸⁷⁵ Buja, R., Kosova në krizën jugosllave..., fq. 331

qeveria e RFJ-së kishte shpallur gjendje lufte dhe tani gjithçka ishte e qartë, pritej vetëm bomba e parë e Paktit NATO, një tomahokë me gjasë që Kosova të hyjë në fazën e fundit të zgjidhjes.⁸⁷⁶ Në mbrëmjen e 24 Marsit të vitit 1999 NATO-ja filloi sulmet e para ajrore kundër caqeve ushtarake dhe pikave të tjera strategjike që shfrytëzonte armata serbe për spastrimin etnik të Kosovës. Urdhri për sulme ajrore mbi caqet ushtarake serbe u dha nga Sekretari Gjeneral i NATO-s i, Javier Solana, i cili iu drejtua publikut me këto fjalë: “Ka ardhur koha për veprim”. Pak minuta pas fillimit të sulmeve ajrore të NATO-s kundër caqeve ushtarake serbe, Presidenti i SHBA-ve, Bill Clinton para reporterëve të Shtëpisë së Bardhë deklaroi se: “Ne dhe aleatët tanë të NATO-se kemi marrë këtë veprim pas përpjekjeve të njëpasnjëshme për të arritur një zgjidhje paqësore për krizën në Kosovë.” Gjithashtu, ai theksoi se sulmet ajrore kane tri objektiva kryesore: Të demonstrojnë forcën e NATO-së, të ndalojnë Beogradin nga ushtrimi i dhunës mbi popullatën shqiptare në Kosovë dhe t’i neutralizojnë kapacitetet ushtarake të Jugosllavisë që të pamundësojë sulmet ushtarake serbe mbi popullatën shqiptare të Kosovës.”⁸⁷⁷ Ndërsa Presidenti francez Zhak Shirak në fjalimin e tij theksoi se: “Jam i bindur se populli francez do ta kuptojë se ne ishim të detyruar të veprojmë. Para kësaj kokëfortësie të pakuptueshme nga Presidenti Milosheviç, aleatët unanimisht u pajtuan që të ndërmarrin sulme ajrore pasi që nuk kishin zgjidhje tjetër për ta ndaluar tragjedinë e cila rrezikon stabilitetin në Ballkan dhe më gjerë.” Presidenti Rus Boris Jelcin këto sulme i quajti si: “Agresion i hapur kundër Jugosllavisë dhe vazhdoi së thëni se kombi i tij ka të drejtë që të ndërmarrë masa adekuate duke përfshirë edhe ato ushtarake në mënyrë që të sigurojë veten e saj dhe Evropën.”⁸⁷⁸

Përfundimi i Luftës në Kosovë

Pas 78 ditë luftimesh midis forcave të NATO-s dhe UÇK-së, në njërën anë dhe të forcave serbe në anën tjetër, Serbia ndërpreu rezistencën ushtarake, dhe në Kumanovë pa pjesëmarrjen e UÇK-së u nënshkrua Marrëveshja ushtarake-teknike midis forcave të NATO-s dhe Forcave ushtarake të Serbisë. Nënshkrimi i marrëveshjes tekniko-ushtarake midis ushtrisë Jugosllave dhe NATO-s, të cilën e përfaqësonte gjenerali Mike Jacson, shënoi fundin e bombardimeve ajrore të NATO-s dhe pranimin e kushteve që ajo i parashtrij Serbisë për njohje të kapitullimit dhe për tërheqjen e forcave të saja nga territori i Kosovës.⁸⁷⁹ Më 9 qershor 1999, pas më shumë se 100 orë bisedime, nënshkruhet kjo marrëveshje. Nënshkrimi bëhet në mes Majk Xhekson komandant i KFOR-it, dhe Svetozar Marjanoviç nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Jugosllave dhe Obrad Stevanoviç (Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë). Rezoluta 1244 është miratuar nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së në mbledhjen e tij të 4011-të, me 10 qershor të vitit 1999. Në fillim të tekstit të rezolutës përcaktohet baza juridike e nxjerrjes dhe qëllimet e saj.⁸⁸⁰ Në aspektin juridik, Rezoluta paraqet akt konstitutiv të

⁸⁷⁶ Shala, B., Vitet e Kosovës 1998-1999..., fq. 344

⁸⁷⁷ CNN, Strike on Yugoslavia, March 24, 1999, Web posted at: 3:29 p.m. EST (2029 GMT), në web faqen:

<http://www.cnn.com/WORLD/europe/9903/24/kosovo.strikes/>

⁸⁷⁸ Po aty.

⁸⁷⁹ Bajrami, A., Drejta e Kosovës në Transicion..., fq. 79

⁸⁸⁰ Bajrami, A., E drejta e Kosovës në tranzicion..., fq. 80

vendosjes së Kosovës nën administrimin e OKB-së, duke vendosur një prezencë civile dhe ushtarake ndërkombëtare. Miratimi i kësaj Rezolutive i dha fund gjenocidit serb ndaj Kosovës dhe ndërpreu gjenocidin shtetëror serb, i cili synonte spastrimin etnik të Kosovës. Administrimi ndërkombëtar në Kosovë i përcaktuar në Rezolutën 1244, ishte i karakterit të përkohshëm dhe synonte krijimin e kushteve të përshtatshme demokratike për zgjidhjen e statusit final të Kosovës.⁸⁸¹

Përfundim

Diplomacia ndërkombëtare edhe pse e kishte anashkaluar çështjen e Kosovës nëpër konferencat ndërkombëtare që u mbajtën për t'i dhënë fund krizes jugosllave, pjesë e së cilës ishte edhe Kosova, ishte e vetëdijshme se një ditë duhet të merret me këtë çështje. Çështja e Kosovës ishte problemi më i ndjeshëm dhe më sfidues për diplomacinë ndërkombëtare. Këtë kompleksitet e bëri edhe më të vështirë qëndrimi i ndryshëm i diplomacisë evropiane e cila për shkak të ndikimit rus nuk ishte e gatshme të ballafaqohet me të. Ishte diplomacia amerikane ajo që që e futi në rrugë të zgjidhjes çështjen e shqiptarve të Kosovës, ashtu siç i dha zgjidhje çështjeve të tjera në Jugosllavi.

Recenzentë:
Prof.Dr. Fehmi Pushkolli
Prof.Dr.Paskal Milo

⁸⁸¹ Po aty, fq. 82

KONTRADIKTAT E NAKO SPIRUT ME POLITIKËN JUGOSLLAVE PËR EKONOMINË E SHQIPËRISË

Ma. Ilir Sallata

PhD Candidate

Shkolla "Bajram Curri" Durrës

il_ir@hotmail.com

Durrës, Albania

ABSTRAKT

Si një nga personalitetet më të rëndësishme të shtetit shqiptar të pas Luftës së Dytë Botërore, në fillim, Nako Spiru e shikonte udhëheqjen jugosllave me syzet e romantikës së komunistëve të ndershëm të asaj kohe. Mirëpo sa u ndesh me realitetin e hidhur, ai iu kundërvu çdo aspekti negativ të politikës jugosllave dhe mbrojti interesat e vendit. Duke qenë në krye të ekonomisë Nako Spiru po kuptonte që marrëdhëniet ekonomike mes dy vendeve, nuk po rezultonin frytdhënëse për Shqipërinë. Marrëveshjet shqiptaro-jugosllave synonin që Shqipëria të vihej nën kontrollin e plotë ekonomik e politik të Jugosllavisë. Në këto rrethana Nako Spiru, i kërkonte qeverisë jugosllave që të respektonte marrëveshjet e nënshkuara, të paktën ashtu siç ishin. Duke analizuar mirë tendencat jugosllave ai filloi rrugën e kundërshtimit të politikës kolonizuese, duke pasur përballë një vijë të fortë projugosllave. Sa më shumë Nako Spiru kërkonte të zbatoheshin drejt marrëveshjet dhe të konsolidohej ekonomia shqiptare, aq më shumë udhëheqja jugosllave do t'i kundërvihej atij. Udhëheqja e PKJ akuzonte drejtpërdrejtë PKSHP që i kishte lënë dorë të lirë Nako Spirut që të kristalizonte vijën e dytë në PKSHP. Në qendër të të gjitha akuzave jugosllave vihej Nako Spiru, i cili cilësohej si armik dhe antijugosllav. Fjale kyçe: Nako Spiru Minister i Ekonomisë, marrëveshje ekonomike, Konventa Ekonomike akuzat jugosllave.

Në fillim Nako Spiru e shikonte udhëheqjen jugosllave me syzet e romantikës së komunistëve të ndershëm të asaj kohe dhe mendonte se dhe ata ishin të tillë, kundërshtarë të shovinizmit serb dhe do ta ndihmonin vllazërisht Shqipërinë e re, që kishte nevojë si për mbrojtjen e pavarësisë dhe për zhvillimin e ekonomisë. Mirëpo sa u ndesh me realitetin e hidhur, ai iu kundërvu çdo aspekti negativ të politikës jugosllave dhe mbrojti interesat e vendit.⁸⁸²

Në janar të vitit 1945, sapo u kthye nga vizita e parë në Beograd Nako Spiru shprehej se Partia Komuniste Jugosllave kishte merita të mëdha në luftën antifashiste, por kjo u kishte ngritur mendjen dhe për më tepër mund të bëhej e rrezikshme tendenca e tyre, për t'u imponuar hegjemoninë vendeve ballkanike dhe vendeve të tjera të lindjes në një Konfederatë Ballkanike.

⁸⁸² L. Belishova "Dritë mbi enigmën Nako Spiru" Gazeta *Zëri i Rinisë*, 28 dhjetor 1991, f.2

Milovan Gjilas, një nga bashkëpunëtorët e Titos, shprehet qartë kur thotë se: “Nako Spiru i cili drejtonte ekonominë e shtetit shqiptar që i pari që u rebelua hapur kundër Jugosllavisë. Idetë e tij u pritën negativisht në Jugosllavi, por dhe në udhëheqjen komuniste shqiptare”.⁸⁸³

Sigurimi jugosllav përdori të gjitha format e mjetet e mundëshme dhe shfrytëzoi të gjitha vështirësitë, që haste qeveria shqiptare në vitet e para të pasçlirimit, duke shtrirë rrjetin agjenturor në të gjithë sektorët.⁸⁸⁴

Duke qenë në krye të ekonomisë Nako Spiru po kuptonte që marrëdhëniet ekonomike mes dy vendeve, nuk po rezultonin frytdhënëse për Shqipërinë. Tendosija e këtyre marrëdhënieve filloi të qartësohej në fillim të vitit 1947, kur jugosllavët kërkonin bashkërendimin e planeve ekonomike. Por Nako Spiru rezistoi duke mos avancuar me nënshkrime të tjera traktatesh që i kërkoreshin nga pala jugosllave, duke u përqendruar në ato traktate që ishin firmosur.⁸⁸⁵

Kur u kthye nga Beogradi, pasi kishte firmosur marrëveshjen në nëntor 1946, Nako tha: “E! A thotë populli shqiptar se e shita Shqipërinë si Eqerem Libohova?”. Kjo tregonte se sa i shqetësuar ishte ai për firmosjen e këtyre marrëveshjeve.⁸⁸⁶

Nako Spiru e kuptoi qartë se zbatimi i marrëveshjeve do t'i jepte fund idealeve kombëtare e demokratike të shpallura gjatë luftës, por edhe vetë pavarësisë së Shqipërisë.⁸⁸⁷ Ai u shqetësua se, pavarësisht nga rrethanat dhe ndryshimi në kohë, marrëveshjet ekonomike të vitit 1946 me Jugosllavinë nuk patën ndonjë ndryshim thelbësor me marrëveshjet që ishin nënshkruar përpara luftës ndërmjet Shqipërisë e Italisë.⁸⁸⁸

Marrëveshjet shqiptaro-jugosllave synonin që Shqipëria të vihej nën kontrollin e plotë ekonomik e politik të Jugosllavisë. Gjatë realizimit të marrëveshjeve, Beogradi krijonte lloj-lloj pengesash e vështirësishë që rëndonin mbi ekonominë shqiptare. Në këto rrethana Nako Spiru, i kërkonte qeverisë jugosllave që të respektonte marrëveshjet e nënshkruara, të paktën ashtu siç ishin. Mirëpo kërkesat e Nakos krijonin bezdi në udhëheqjen jugosllave, pasi ato binin ndesh me planet e saj për bashkimin sa më të shpejtë të Shqipërisë me Jugosllavinë.⁸⁸⁹

Në një letër që Nako i dërgonte Enver Hoxhës nga Beogradi në korrik 1947, i shprehte habi pasi Savo Zllatiç i kishte thënë, që Jugosllavia me Bullgarinë do të bënin një shtet të vetëm, e kjo do të ndodhte dhe me Shqipërinë. Nako ishte i indinjuar se nuk kishte informacion për një gjë të tillë.⁸⁹⁰

Ai kurrë nuk pranoi ta kthejë Shqipërinë në një provincë të varur të Jugosllavisë. I mbështetur dhe nga Mehmet Shehu, i sapokthyer nga BS, iu kundërvu hapur synimeve të Jugosllavisë.⁸⁹¹ Duke analizuar mirë tendencat jugosllave ai filloi rrugën e kundërshtimit të politikës kolonizuese, duke pasur përballë një vijë të fortë projugosllave.

⁸⁸³ Milovan Gjilas, *Fytyra e totalitarizmit*, Tiranë: sh.b Fan Noli, 2006, f.86

⁸⁸⁴ Thimo Bare, *Shërbimi Sekret Shqiptar*, Tiranë: A.Dingu, 2009, f.121

⁸⁸⁵ Georges Herman Hodos, *Inskeniemet*, Tiranë: Amfion&Zeti, 2000, f.26

⁸⁸⁶ Todi Lubonja, *Nën peshën e dhunës*, Tiranë: Mësonjëtorja, Tiranë, 1998, f.223

⁸⁸⁷ Lefter Nasi, *Aspekte nga jeta dhe veprimtaria e Nako Spiritur në vitet 1943-1947*, Studime Historike, Tiranë: 1998, Nr. 1,2, f.211

⁸⁸⁸ Po aty

⁸⁸⁹ *Historia e Popullit Shqiptar*, Grup autorësh, v 4, Tiranë; Toena, 2008, f.196

⁸⁹⁰ Ndreçi Plasari, Luan Mallezi, *Marrëdhëniet Shqiptaro-Jugosllave 1945-1948*, Tiranë, DPA, Eurorilindja, f.119

⁸⁹¹ Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë shek.XX*, Tiranë: Ideart, 2004, f.328

Gjatë bisedave që zhvilloi me Çuvahinin, Nako Spiru i ka shprehur hapur synimet e jugosllavëve, që donin ta kthenin ekonominë shqiptare në një pjesë të ekonomisë jugosllave dhe të pengonin ndihmat nga BS. Jugosllavët kishin udhëzuar që të mbyllej fabrika e shkrirjes së bakrit në Rubik, të mos ndërtohej kombinati i tekstileve në Tiranë me ndihmën e BS. Ata kërkonin që 2/3 e naftës bruto në vend të eksportohej në Jugosllavi, e kjo do të rrezikonte mbylljen e uzinës së përpunimit të naftës në Kuçovë.⁸⁹²

Sa më shumë Nako Spiru kërkonte të zbatoheshin drejt marrëveshjet dhe të konsolidohej ekonomia shqiptare, aq më shumë udhëheqja jugosllave do t'i kundërvihej atij.

Në fund të qershorit 1947 Beogradi akuzonte udhëheqjen e PKSHE se, kishte ndryshuar qëndrimin ndaj Jugosllavisë dhe kishte lejuar krijimin e një vije antijugosllave, duke çuar marrëdhëniet midis dy vendeve në nivelin më të ulët. Byroja Politike e KQ të PKSHE e hodhi poshtë këtë akuzë, duke e konsideruar të papabazë.⁸⁹³

Tek Nako Spiru Tito gjeti fajtorin. Sipas tij ishte Nako Spiru që ndiqte politikën e largimit të Shqipërisë nga Jugosllavia.⁸⁹⁴ Udhëheqja e PKJ akuzonte drejtpërdrejtë PKSHE që i kishte lënë dorë të lirë Nako Spirit që të kristalizonte vijën e dytë në PKSHE. Në qendër të të gjitha akuzave jugosllave vihej Nako Spiru.⁸⁹⁵

Në fillim të nëntorit 1947 Beogradi i bëri kritikën e dytë Tiranës. Sipas tyre Nako Spiru kishte dyshime për çështjen e kredive dhe kishte hedhur tezën që detyrimet e Jugosllavisë nuk ishin ngritur në baza konstruktive.⁸⁹⁶

Udhëheqja jugosllave akuzonte për zvarritjen e zbatimit të Konventës Ekonomike dhe protokolleve të saj, për trajtimin jovëllazëror të specialistëve jugosllavë, për pengesa artificiale për zbatimin e planit të bashkimit të dy ushtrive, etj.

Nako Spiru u akuzua se kishte kundërshtuar çmimet e përcaktuara prej jugosllavëve për eksportet shqiptare, se kishte kërkuar që çmimet e eksporteve të mbështeteshin e të bazoheshin në çmimet ndërkombëtare, se kishte këmbëngulur që çmimet e eksporteve shqiptare në drejtim të Jugosllavisë të përcaktoheshin me dollarë dhe jo me dinarin jugosllav.⁸⁹⁷

Gjithashtu Nako, nga i dërguari jugosllav Savo Zllatiç, u akuzua se kishte dashur të veçonte një pjesë të bitumit e naftës shqiptare për t'i eksportuar në Bashkimin Sovjetik dhe një pjesë të prodhimit të bitumit për asfaltimin e rrugëve të Shqipërisë.⁸⁹⁸

Për të gjitha këto gishti ngrihej kundër Nako Spirit, i cili cilësohej si armik dhe antijugosllav.

Përpjekje të shumta u bënë për të paraqitur Nakon edhe si ambicioz dhe arrivist i pandreqshëm. Për këtë qëllim u shfrytëzua çdo qëndrim dhe mendim i shfaqur prej tij. Kundërshtimi i Nakos për kandidaturat e propozuara nga Koçi Xoxe për zgjerimin e radhëve në Byronë Politike dhe për zëvendësimin e tyre me elementë të tjerë, u paraqitën si përpjekje për të forcuar pozitat e tij në këtë forum.⁸⁹⁹

⁸⁹² D.S.Çuvahin, *Shërbimi im diplomatik në Shqipëri*, Tiranë: Almera, 2008, f.44

⁸⁹³ *Historia e Popullit Shqiptar*, v 4, vepër e cituar, f.197

⁸⁹⁴ N. Smirnova, *Historia e Shqipërisë shek XX*, vepër e cituar, f. 328

⁸⁹⁵ N. Plasari, L. Malltezi, *Marrëdhëniet Shqiptaro-Jugosllave 1945-1948*, vepër e cituar, f.7

⁸⁹⁶ Po aty, f.120

⁸⁹⁷ L. Nasi, "Aspekte nga jeta dhe veprimtaria e Nako Spirit në vitet 1943-1947", vepër e cituar, f.211

⁸⁹⁸ Po aty

⁸⁹⁹ Po aty

Nako u akuzua pa të drejtë se ai prirej për postet më të larta në parti. Në të vërtetë kapaciteti intelektual i Nakos mund t'ia mundësonte një gjë të tillë, por karakteri i tij dhe mentaliteti i një komunisti idealist kurrësesi nuk do ta shtynin për një luftë për pushtet.⁹⁰⁰

Reçesentë:
Prof.Dr. Fatmira Rama,
Prof.Dr. Petrika Thëngjilli,

900 Kujtime verbale dhënë autorit nga L. Belishova, datë 28 maj 2011

TIPOLOGJIA E QYTETIT ANTIK ONHEZMI

Klodian Gjoni

e-mail: klodgjoni@yahoo.com

Hyrje

Objekti i këtij studimi është tipologjia e qytetit antik të Onhezmit, i njohur si një ndër limanet kryesore të Kaonisë, duke u përcaktuar kështu tek tipet e qyteteve skelë. Onhezmi shfaqet për herë të parë në burimet e shkruara në shek. I para Kr. tek Straboni (Straboni VII,5,1) në librin “Gjeografika” e Dionisi i Halikarnasit (Dionisi e Halikarna sit. II, 51,1) e dy shekuj më pas tek Ptolemeu (Ptolemeu III, 13,2) të cilët e quajnë atë një liman kaon. Straboni thotë: “Pas Panormit ndodhet një tjetër liman që quhet Onhezmi, kundrejt të cilit ndodhet Korkyra. Pas Onhezmit janë Poseidi e Butrinti”. Vlen të përmendet një përcaktim i Ciceronit se “limani që shërbente për të lidhur Foiniken me Korkyrën quhej Onhezmi. Kjo ishte pikë tranzite midis Ilirisë dhe Italisë”. Dhe era juglindore e përshtatshme për këtë lundrim njihej me emrin Onhezmites.⁹⁰¹ Si Straboni dhe Ptolemeu e çojnë si një qendër e banuar qysh gjatë shek. IV para Kr.. Duke u nisur nga të dhënat e tyre dijetarë e udhëtarë të ndryshëm si: Pukëvili⁹⁰², Liku⁹⁰³, Isamberti⁹⁰⁴, që në shekullin e kaluar e kanë zgjidhur drejt problemin e identifikimit të tij me rrënojat që duken sot në qytetin e Sarandës, të ngritur në një nga gjiret e pakta të bregdetit të Jonit në Shqipërinë Jugore.

Zhvillimi historik i qytetit antik të Onhezmit

Gërmimet arkeologjike tregojnë dinamikën e zhvillimit të Onhezmit të pranishme në tri faza të njëpasnjëshme të dalluara qartë. Të gjitha objektet e gjetura dëshmojnë se ato janë në funksion të ekzistencës së qytetit skelë. Megjithëse Onhezmi, futet në grupin e qyteteve skelë, materiali arkeologjik tregon se Onhezmi nuk ka qenë thjesht një port i Foinikes, por dhe qendër e banuar dhe e fortifikuar.

Faza e parë përfshin shek. IV- I p.l. K.

Faza e dytë shek. I para Kr.-shek. IV pas Kr.

Faza e tretë shek. IV-VI pas Kr.

Faza e parë përfaqësohet deri tani vetëm nga disa kapitete e kolona jonike dhe ndonjë monedhë. Ka të ngjarë që Onhezmi në këtë kohë të ketë shërbyer si një skelë e Foinikes që ishte një nga qytetet më të rëndësishme të Epirit.

Në shek. I para Kr. që përkon me fundin e fazës së parë dhe me fillimin e fazës së dytë me situatën e re politike të krijuar pas pushtimit të Ilirisë dhe Epirit nga Roma, vërejmë

901 Cicero Ad Atticum, VII, 2, 1

902 F. Pouqueville, *Travels in Epirus, Albania, Makedonia and Thesaly*, London 1820, f.33.

903 M.W. Leake, *Travels in northeru Grece vol.I*, London 1835, f 10.

904 Dr. E Isambert, *Inteneraire descriptif historique et archeologique de L'Orient*, Paris 1873, f. 849- 850.

një zgjerim të vendbanimit të Onhezmit dhe kthimin në skelë që i shërbente Romës për t'u lidhur me krahinat në shpinë të tij dhe sidomos me Foiniken e rrethinat e tij. Për praninë e një skele të tillë, krahas burimeve të kohës, të përmendura më sipër flasin dhe gjetjet e mjaft amforave në forma të larmishme dhe që paraqesin tipa të njohur për Adriatikun Jugor dhe brigjet e Jonit në shek. I-III pas Kr.⁹⁰⁵ Ndërmjet monumenteve të zbuluara të kësaj kohe të tërheqin vëmendjen mbeturina godinash disakatëshe, të cilat janë vendosur pranë bregut të detit. Muret e tyre janë ndërtuar me teknikën "opus incentrum" si të sterna masive dhe porta e një godine monumentale. Është përdorur teknika me gjashtë breza tullash, ku në ndërtimin e muraturës së gurtë janë harmonizuar bukur teknika të përdorura kryesisht në ndërtimet monumentale të shek. I-III pas Kr.. Dyshemeja e këtyre godinave ka qenë e shtruar me mozaikë shumëngjyrësh. Motivet e përdorura janë një kompozim i ndërlikuar figurash gjeometrike si rrrathë, katrorë, rombe, trekëndësha, spirale ove, meandre etj. të cilat ndërthuren bukur me njëra-tjetrën, motive këto që janë të njohura dhe në qendra të tjera antike të vendit tonë si në Butrint, Apoloni e Dyrrah dhe datohen në shek. II-III pas Kr..⁹⁰⁶ Kësaj kohe i takojnë dhe disa varre të zbuluara në qendër e në perëndim të qytetit të sotëm. Inventari i tyre përbëhet kryesisht nga objekte të vogla të përdorimit të përditshëm si kandila, tasa e kana prej balte dhe lotore prej balte ose prej qelqi, të cilat shpesh janë të shoqëruara me monedha të shek. II-III pas Kr..



Pamje e Kalasë së Onhezmit dhe Sinagogës Bazilikë

Materiali arkeologjik tregon se Onhezmi nuk ka qenë thjesht një port i Foinikes, por dhe qendër e banuar dhe e fortifikuar. Këto më shumë i takojnë shek. I-IV pas Kr.. Në fazën e dytë Onhezmi kishte një shtrirje të gjerë (që prej hotel Butrintit në lindje e deri tek porti i sotëm në perëndim).⁹⁰⁷ Ndërtesat në pjesën më të madhe kanë dysheme të shtruar me mozaik e janë ngritur pranë bregut dhe me sa duket një pjesë e tyre kanë shërbyer si vila ose banesa të shtresave të pasura. Prania e këtyre ndërtimeve dhe e nekropolit, dendësia dhe larmia e objekteve arkeologjike, amforat e gjetura në det dhe monedhat si dhe plazhi i Dionisit të Halikarnasit për "ndërtimin e faltores për nder të Afërditës" tregojnë se Onhezmi në këtë kohë është kthyer në një vendbanim të përhershëm që ka pasur marrëdhënie si me prapatokën e saj, ashtu dhe me Romën dhe ka shërbyer më tepër si një skelë e Foinikes dhe e rrethinave të saj. Kjo ka të bëjë edhe me

⁹⁰⁵Dhimosteu Budina, Harta arkeologjike e Bregdetit Jon dhe e pellgut të Delvinës, Iliria 1/1971, f.28.

⁹⁰⁶L. M. Ugolini, *Albania Antika*, Roma 1927, f.144-146.

⁹⁰⁷Apollon Baçe, *Qyteti antik i Onhezmit*, kumtesa e mbajtur në sesionin II arkeologjik. Sarandë 4 Prill 1979. Ndodhet në *Almanak Saranda*, Tiranë 1982, f. 63-64.

pozitën e favorshme gjeografike dhe gjirin e mbrojtur, që krijonte mundësinë e përdorimit të kësaj skele gjatë gjithë vitit.

Në shek IV pas Kr. që përkon me fillimin e fazës së tretë dhe Onhezmi e ndjen krizën e rendit sklloprovar dhe në përshtatje me situatën e re politike të krijuar, ai filloi të fortifikohej me një mur të fuqishëm rrethues.⁹⁰⁸ Kjo dukuri vërehet në mjaft qytete të provincave ilire dhe epiriote.⁹⁰⁹ Kështjella nuk përfshin gjithë sipërfaqen e mëparshme të vendbanimit, por vetëm qendrën e tij. Ajo është e hapur nga bregu, ka formën e një pesëkëndëshi të çrregullt me sipërfaqe 5 ha dhe gjatësi të murit rrethues 850 m e me lartësi 6,5 m me trashësi 2,40- 2,50 m dhe ngrihet mbi themele të ndërtuara me gurë të mëdhenj e të papunuar. Muratura në përgjithësi është e çrregullt, por vërehet se për çdo 1 m lartësi janë përdorur në të breza nivelimi, të formuar prej gurësh plloçakë.

Hyrja e vetme e zbuluar deri tani ndërpret murin rrethues në anën veriore të kështjellës. Elementi më i rëndësishëm i fortifikimit të kësaj kështjelle janë kullat. Deri tani janë zbuluar 8 prej tyre. Për faktin se vetëm në pjesën veriore, me gjatësi afro 100 m, ndodhen 4 kulla të vendosura në një largësi 26-27m nga njëra-tjetra, në gjatësinë e mbetur të murit rrethues mund të vendosen dhe 12 të tjera. Duke plotësuar kështu numrin e dhënë prej Likut 20. i cili e pa kështjellën në fillim të shek. të kaluar.

Gërmimet e kryera brenda kështjellës na japin mundësi të krijojmë ide më të plotë edhe për ndërtimet në të. Prej tyre përmenden dy banesa të zbuluara në anën perëndimore dhe një në anën lindore. Ato janë me dy a tri kthina katërkëndëshe dhe kanë në përbërjen e tyre secila nga një dhe në një rast dhe dy sterna, sipërfaqja e brendshme e të cilave pas ndërtimit është lyster me suva që në muret anësore përbëhet prej gëlqereje dhe rëre të imët, ndërsa në dysheme, së bashku me to, ka dhe pluhur tulle. Interes të veçantë paraqet në pjesën lindore të kështjellës ndërtimi i një bazilike të madhe. Përmendim prej saj dekorin arkitektonik dhe sidomos mozaikun shumëngjyrësh të dyshemesë. Vlen të theksohet edhe fakti se nën dyshemenë e sipërme të mozaikut është dhe një dysheme tjetër po me mozaik. Ndryshimi i linjës bregdetare ka bërë që i tërë muri i kështjellës të shkatërrohej. Mbi shkëmbinjtë e Bregut ruhen sot rrënojat e një kulle me një hyrje me hark tullash. Një numër kullash katërkëndëshe, poligonale dhe rrethore e përforconin kështjellën nga veriu nga pritëshin dhe sulmet e mundshme.⁹¹⁰

Materiali i pasur arkeologjik si fragmentet e arkitekturës (shtylla dhe kapitule të zbuluara me gjethe akantit ose me pëllumba në skaje mbajtëse dhe pllaka të perdes ndarëse prej mermeri, njëra prej të cilave ka në skaj një monogram me shumë gjasë të Justinianit) dhe qeramika, sidomos tjegullat e zbuluara me motive të ndryshme (vija të valëzuara, kryqe, vila rrushi në relief etj.) së bashku me motivet e pasura të mozaikut (motive gjeometrike, pallojtë, pëllumbat, kafshët dhe shpendët e ndryshëm etj), të kompozuar bukur, duke krijuar skena të ndryshme. Në shek. IV-VI pas Kr. jeta e banorëve të Onhezmit nuk ishte e kufizuar vetëm në hapësirat brenda kështjellës, por dhe jashtë saj, megjithëse jo me atë intensitet. Përmendim kështu sidomos shndërrimin e një monumenti pagan në godinë me karakter kulti, gjë që kjo vërehet si në rishtrimin e pjesës lindore të dyshemesë me mozaik, ku mbizotërojnë motive të njohura si ai i eukaristisë, kryqe, shpendë etj. ashtu dhe në disa lloje arkitektonikë (shtylla dhe mbajtëse

⁹⁰⁸ Kosta Lako, *Kështjella e Onhezmit*, Iliria 1984/2, f. 153-205.

⁹⁰⁹ Skënder Anamali, *Antikiteti i vonë dhe mesjeta e hershme në kërkimet shqiptare*, Iliria X-X 1979-1980, f.7.

⁹¹⁰ Neritan Ceka, *Buthroti*, v. 2002, f. 14.

të perdeve ndarëse prej mermeri). Gjurmë të tjera ndërtimesh të kësaj kohe, megjithëse fragmentare janë konstatuar dhe në disa zona në pjesën lindore të qytetit.

Zbulimi i këtyre banesave dhe sternave tregojnë se në antikitetin e vonë, periudhë që kemi të dhëna më të plota, ka pasur jo vetëm një koncept të qartë urbanistik për ndërtimet në qytet, por edhe për anën funksionale të banesave. Kështu, ato janë të orientuara drejt, kryesisht me fasadë nga jugu dhe në përshtatje me madhësinë e familjes kanë pasur një, dy ose më shumë kthina që komunikonin përmes një korridorit.

Njëkohësisht zbulimi i tyre na jep të dhëna me interes edhe për një aspekt të jetës së qytetit, siç është furnizimi me ujë i banorëve të tij. Në kushtet e mungesës së burimeve natyrore qoftë edhe pranë qytetit, gjë që do të mundësonte ndërtimin e ndonjë ujësjellësi, sigurimi i tij është realizuar me ndërtimin e sternave që grumbullonin ujin e shiut duke ndjekur kështu një traditë të hershme, të pranishme edhe në qytete të tjera të Epirit, si Foinike etj.⁹¹¹ Ka prej tyre si sterna 1, e cila nisur nga planimetria, përmasat dhe teknika e ndërtimit, duhet të ketë qenë publike dhe si e tillë u shërbente disa familjeve. Në ndryshim prej saj sternat e tjera të datuara në antikitetin e vonë, janë konceptuar e ndërtuar si pjesë përbërëse të banesave dhe si të tilla i shërbenin vetëm një familjeje. Materiali arkeologjik i gjetur në to dhe teknika e ndërtimit të mureve tregojnë se këto banesa ishin pronë e qytetarëve të zakonshëm të Ankiatit.⁹¹²

Zbulimi i një grup varresh me konstruksion prej tjegullash masive të shek. IV –V pas Kr., të vendosura në formë çatie, në pjesën veriore të qytetit tregojnë se nekropoli i kësaj periudhe shtrihet në këtë drejtim. Gjatë kësaj periudhe të bien në sy dhe monedhat më të shumtat e shek. V-VI pas Kr. që fillojnë me Arkadin (395-408 pas Kr.) dhe shkojnë deri tek Justiani II me Sofinë (565-578 pas Kr.).

Në shek. V- VI pas l.K Onhezmin e ndeshim në disa akte kishtarë si qendër peshkopale me emrin Anchiuzm. Kështu në mbledhjen e Efesit që u mbajt në vitin 459 është i pranishëm midis të tjerëve edhe Peshkopi Klaud i Anchiuzmit. Gjithashtu letra dërguar papës Ormisda nga peshkopët e Epirit të Vjetër në vitin 516 është firmosur krahas të tjerëve edhe nga peshkopi Kristodor i Anchiuzmit..⁹¹³

Në gjysmën e parë të shek. VI pas K. Onhezmi përmendet nga Hierokli si një nga qytetet kryesore të provincës së Epirit të vjetër duke qenë njëkohësisht dhe qendër peshkopale. Ai e ruan këtë rol të tillë deri nga fundi i shek. VI pas K.. Me këtë periudhë të fundit të lulëzimit të Onhezmit lidhen dhe një numër kishash paleokristiane. Brenda sipërfaqes së kështjellës është zbuluar një bazilikë trenëfshë, e adoptuar brenda një ndërtese të lartë. Naosi i saj është shtruar në shek. VI pas K. me një mozaik shumëngjyrësh me skena të shpërndara në mënyrë të parregullt, ku bien në sy dy kapronj rreth një kantari. Një ndërtim tjetër i kultit të krishterë i shek. V pas K. është gjetur në qendër të Sarandës. Ambienti i vetëm i zbuluar është shtruar me mozaik që dallohet për trajtimin jo shumë të kujdesshëm të motiveve gjeometrike.⁹¹⁴

⁹¹¹ L. M. Ugolini, *Albania Antica II, L'Acropoli di Fenice...*, fq. 110- 112, 123 dhe K. Lako, *Të dhëna për disa banesa...*, Iliria 1993, 1- 2, fq. 252.

⁹¹² K. Lako, *Të dhëna për disa banesa...*, Iliria 1993, 1- 2, f. 252.

⁹¹³ K. Lako, *Kështjella e Onhezmit*, Iliria 2/1984, f. 153.

⁹¹⁴ Neritan Ceka, *Buthroti*, v. 2002, f. 14-15.



Në verën e vitit 1967, gjatë punimeve për hapjen e themeleve të godinës së PTT, punëtorët zbuluan një dysheme ambienti, me mozaik polikron. Me qëllim që mozaiku të shpëtohej, punimet e ndërtimit u ndërprejnë për një kohë. Nga disa gërmime të vogla që u kryen në këtë vend, doli se godina me mozaik shtrihet në të dy krahët e ambientit dhe futet edhe nën themelet e godinës ekzistuese të PTT. Gjatë gërmimeve u mundësua të hapet vetëm një ambient i godinës. Ky ka një gjatësi prej rreth 11 m dhe gjerësi prej 8 m. Nga muret janë ruajtur vetëm ai i anës lindore dhe veriore, ndërsa muret e anës jugore dhe perëndimore janë shkatërruar pothuajse plotësisht. Muret ekzistuese kanë një trashësi prej 0.50 m. Ato janë ndërtuar me gurë të vegjël, të lidhur me llaç të bollshëm. Dyshemeja e kthinës është e mbuluar me mozaik shumëngjyrësh, i cili në pjesën më të madhe nuk është ruajtur mirë. Gurët e mozaikut janë të llojeve dhe ngjyrave të ndryshme. Ata janë të radhitur mbi një shtresë llaçi mjaft të hollë. Motivet e mozaikut janë të shpërndara në mënyrë të rregullt, me qëllim që figurat të shtrihen në të gjithë sipërfaqen. Vizatimi i mozaikut të kthinës formohet prej dy pjesëve kryesore: prej emblemës që ndodhet pothuajse në qendër të dyshemesë, dhe prej motiveve anësore. Pjesa lindore është e shtruar me një mozaik që ndryshon nga ai i anës perëndimore. Në qoshen JL të dhomës brenda një katrori, në një sfond të bardhë paraqitet figura e një zogu, ndoshta e një palloi që pi ujë në një gotë. Figura rrethohet nga një brez i ndarë në kuadrate të vogla, në fushën e të cilave janë vizatuar shpendë të ndryshëm: në pjesën më të madhe ato janë dëmtuar. Ky kuadër mesa duket paraqet simbolin e Eukaristisë. Në veri të figurës së palloit vijnë fusha të mbushura me figura geometrike të ndryshme.

Po ta vërejmë me kujdes mozaikun e dhënë, bie menjëherë në sy ndryshimi që ka pjesa perëndimore nga ajo lindore, si nga pikëpamja e teknikës, ashtu edhe nga paraqitja. Të dy këto pjesë u përkasin dy periudhave të ndryshme të ndërtimit. Pjesa perëndimore e mozaikut, bashkë me emblemën qendrore dhe brezat përreth, i përkasin fillimit të shek. III pas K, ndërsa pjesa tjetër, duke u nisur nga figura e palloit dhe e zogjeve përreth dhe disa fragmente arkitektonike

kishtare, i përket shek. IV- V pas K. Siç duket godina në këtë kohë u kthye në një ndërtesë me karakter kulturi.⁹¹⁵

Sinagoga e Onhezmit Rrënojat e Sinagogës



Në gërmimet arkeologjike janë gjetur rrënojat e kompleksit të Sinagogës në qendër të qytetit të Sarandës, që provojnë ekzistencën e një komuniteti të madh dhe të pasur hebre në Onhezëm në shek. V pas K.. Krahas aktiviteteve fetare, kompleksi ka shërbyer si qendër sociale, shkollë për studim bible, karakteristikë për Sinagogat e asaj periudhe. Me kalimin e kohës

Sinagoga iu nënshtrua disa shtesave dhe përshtatjeve strukturore duke përfshirë këtu edhe kthimin e sallës së lutjeve të stilit bazilikan ndërtuar më vonë në kishë. Mozaiku i Menoras në dyshtemenë e strukturës më të hershme, evidenton kompleksin si Sinagogë nëpërmjet simboleve fetare hebraike. Banjat e mundshme rituale (Mikve) janë përdorur nga komuniteti për larjen përpara Shabbatit (dita e shenjte hebre) përpara ditëve të shenjta si dhe për të përmbushur ligjet hebre të pastërtisë në familje.

Këto të gjitha tregojnë një zhvillim të rëndësishëm ekonomik të qytetit dhe përreth qytetit. Onhezmi nuk ka qenë qytet me një administratë politike e ekonomike të veçantë. Ai nuk është përfshirë në luftra të ndryshme. Historia e njeh si port të rëndësishëm të Foinikes e më tej të romakëve për të lidhur Ilirinë me Italinë dhe si qendër të banuar e të fortifikuar. Veprimtaria e Onhezmit nuk ndalet vetëm në antikitet. Ai ka pasë zhvillim e aktivitet dhe nën juridiksionin e Perandorisë Bizantine. Më 877 qyteti u shkatërrua dhe u plaçkit nga flota e fuqishme e saraçenëve që erdhën nga Afrika e zbarkuan në Onhezëm e Butrint. Në shek XI e më pas Onhezmi përshkruhet si një vend i braktisur. Si përfundim, në bazë të karakterizimit tipologjik të qyteteve shumëformëshe të Epirit, Onhezmi futet në grupin e qyteteve skelë. Janë pasqyruar tri periudha kryesore, nëpër të cilat ka kaluar historia e zhvillimit të këtij qyteti, janë analizuar faktet historike si dhe materialet arkeologjike duke argumentuar se Onhezmi ishte një nga qytete antike skelë më të rëndësishme.

Megjithëse Onhezmi, futet në grupin e qyteteve skelë, materiali arkeologjik tregon se Onhezmi nuk ka qenë thjesht një port i Foinikes, por dhe qendër e banuar dhe e fortifikuar.

BIBLIOGRAFI

A.Baçe, *Qyteti antik i Onhezmit*, kumtesa e mbajtur në sesionin II arkeologjik. Sarandë 4 Prill 1979. Ndodhet në *Almanak Saranda*, Tiranë 1982.

Cicero Ad Atticum, VII, 2, 1

Dh. Budina, Harta arkeologjike e Bregdetit Jon dhe e pellgut të Delvinës, Iliria 1/1971.

E. Isambert, *Inteneraire descriptif historique et archeologique de L'Orient*, Paris 1873.

F. Pouqueville, *Travels in Epirus, Albania, Makedonia and Thesaly*, London 1820.

K. Lako, *Kështjella e Onhezmit*, Iliria 2/1984.

⁹¹⁵ Dhimosten Budina, Harta arkeologjike e Bregdetit Jon dhe e pellgut të Delvinës, Iliria 1/1971, fq. 289.

K. Lako, *Bazilika e Ankiarmit*, Iliria 1991, 1- 2.

K. Lako, *Të dhëna për disa banesa.....*, Iliria 1993, 1- 2.

L. M. Ugolini, *Albania Antika*, Roma 1927.

M.W. Leake, *Travels in mortheru Grece* vol.I, London 1835.

N. Ceka, *Buthroti*, v. 2002.

S. Anamali, *Antikiteti i vonë dhe mesjeta e hershme në kërkimet shqiptare*, Iliria X-X 1979-1980.

PROPAGANDA DHE ÇETAT E ARMATOSURA GREKE NË KOHËN E KRYENGRITJES SË VITIT 1912

Dr. Ledia Dushku

ABSTRAKT: Procesi i helenizimit në vilajetin e Janinës vijoi me intensitet gjatë vitit 1912. Në mbështetje të tij vepruan propaganda dhe çetat e armatosura greke. Ashtu sikurse kishte ndodhur edhe me parë, Lëvizja Kombëtare Shqiptare u ndodh sërish nën trysninë e tyre.

Propaganda: Në kohën e Kryengritjes Shqiptare antiosmane të vitit 1912 propaganda greke mori formë të ndryshme në varësi të forcës dhe përhapjes së saj. Në funksion të propagandës vepruan kisha e shkollat, konsujt e shtypi grek, pa lënë mënjandë edhe mitingjet e protestat. Me anën e tyre u synua të kufizohej përhapja e Kryengritjes Shqiptare, në rajonet e pretenduara nga Greqia.

Veprimtaria e çetave të armatosura: Veprimtaria e çetave të armatosura ishte një nga mjetet që u përdor nga Greqia për arritjen e qëllimeve të saj aneksioniste. Në dallim nga propaganda, veprimtaria e çetave u përdor kryesisht në periudha delikate atëherë kur procesi i helenizimit kërcënohej drejtpërsëdrejti nga veprimet e shqiptarëve. Ndër të tjera, nëpërmjet veprimtarisë së tyre u synua që vilajeti i Janinës të mbahej në një gjendje anarkie latente dhe popullsia aty të mbetej jashtë rrezes së veprimtarisë kombëtare shqiptare dhe sa më afër rrezes së veprimeve greke.

Vendimet e Kongresit të Berlinit të vitit 1880 u konsideruan një rregullim provizor i situatës dhe një pikënisje për zgjidhjen përfundimtare të çështjeve kombëtare në Ballkan. Ndërsa çështja shqiptare nuk zuri vend në vendimet e tij sepse ekzistenca e saj u mohua nga Fuqitë e Mëdha, çështja greke nuk mori zgjidhjen e pretenduar nga Greqia. Në ato kushte, si shqiptarët, ashtu edhe grekët synuan që në të ardhmen të siguronin sa të ishte e mundur përparësi, në dobi të zgjidhjeve përfundimtare të çështjeve kombëtare përkatëse.

Organizmi i një veprimtarie të gjerë vëzhguese e subversive, kryesisht në territoret e poshtme të vilajetit të Janinës, u konsiderua jetësore për politikën greke. Promotorë të kësaj veprimtarie, krahas institucioneve fetare dhe shkollore, u bënë tashmë edhe konsullatat. E vetëdijshme për vështirësitë që do të haste në realizimin e shpejtë të pretendimeve të saj ndaj territoreve të Shqipërisë së Jugut, Greqia i kushtoi vëmendje të veçantë procesit të helenizimit. Me anën e tij, ajo synoi të legjitimonte pretendimet e saj në vilajetin e Janinës, duke i vendosur shqiptarët jugorë nën influencën arsimore, kulturore e politike greke. Ajo krijoi dhe ushqeu të ashtuquajturën çështje të Epirit, të cilën u përpoq ta veçonte nga çështja shqiptare.

Procesi i helenizimit në vilajetin e Janinës vazhdoi me intensitet edhe gjatë vitit 1912. Në mbështetje të tij në vijimësi vepruan propaganda dhe çetat e armatosura greke. Ashtu

sikurse kishte ndodhur edhe me parë, Lëvizja Kombëtare Shqiptare u ndodh sërish nën trysinë e tyre.

Propaganda: Në kohën e Kryengritjes Shqiptare të vitit 1912 propaganda greke mori formë të ndryshme në varësi të forcës dhe përhapjes së saj. Në funksion të propagandës vepruan kisha e shkollat, konsujt e shtypi grek, pa lënë mënjanë edhe mitingjet e protestat. Me anën e tyre u synua të kufizohej përhapja e kryengritjes shqiptare, në rajonet e pretenduara nga Greqia.

Në fazën përgatitore të Kryengritjes, propaganda me anën e shtypit nuk duket se luante rol parësor. Gjuha e shtypit ishte përgjithësisht e qetë, madje në faqet e tij i lihej vend edhe pasqyrimet të miqësisë greko-shqiptare. Në këtë fazë shfaqen aktivë veçanërisht konsujt grekë dhe mitropolitët, deklaratat e të cilëve janë të ashpra si ndaj shqiptarëve, ashtu dhe ndaj Lëvizjes së tyre Kombëtare⁹¹⁶. Me shpërthimin e Kryengritjes, punës së tyre iu bashkëngjiti edhe shtypi. Vendi në fjalëve të buta e zunë sulmet e ashpra kundër shqiptarëve dhe lëvizjes së tyre, të gjitha këto në mbështetje të çështjes greke⁹¹⁷. Këtu veçojmë gazetën "Ipiros" dhe "Jehona e Epirit". Në këtë fazë u aktivizuan edhe sillogjet greke, të cilët organizuan mitingje që kishin si qëllim të pengonin bashkimin e banorëve të krishterë me kryengritjen shqiptare.

Më përhapjen e Kryengritjes tej viseve veriore dhe fuqizimin e saj, rrethet politike greke përshtatën detyrat. Krahas të tjerave, tashmë me anën e propagandës u synua acarimi i marrëdhënieve midis popullsisë myslimane dhe asaj të krishtere, në vilajetin e Janinës. Rrjeti i gjerë i shkollave greke për meshkuj e për femra si edhe institucionet kishtare vazhduan të kryenin me intensitet punën e tyre në dobi të thellimit të këtij hendeku. Popullsia e krishterë u frikësua me të ashtuquajturin rrezik "turko-shqiptar"⁹¹⁸. Në përgjithësi, vjedhjet në fshatrat e krishtere u paraqitën si dhunim që "turko-shqiptarët e dhunshëm" i bënin popullsisë "së qetë" greke. Për të rënduar situatën dhe për ta paraqitur atë si të dëshpëruar shpeshherë u trilluan edhe sulme e grabitje të paqena. Fushata e shpifjeve dhe trillimeve ndaj "turko-shqiptarëve", zuri faqet kryesore të shtypit grek⁹¹⁹.

Pranimi i kërkesave të shqiptarëve nga qeveria osmane u konsiderua nga opinioni publik grek, një kërcënim për helenizmin. Shqetësimi që mbretëronte në rrethet e mësipërme u shpreh në mënyrë pasionante në faqet e shtypit, të cilat u mbushën me sulme kundër pretendimeve "arrogante shqiptare". Tezat e hedhura shkonin në mbështetje të qëndrimit qeveritar grek. Kështu, i mëshohej mendimeve se, shqiptarët nuk kanë pjekurinë e duhur politike për t'u bashkuar dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre; mbas kërkesave të tyre qëndrojnë propagandat e huaja, duke dalluar atë të Austro-Hungarisë⁹²⁰. Përshtypja e parë ndër grekë ishte se ministri i Jashtëm, Berhtold me propozimin e tij për decentralizim, synonte të përkrahte vetëm aspiratat kombëtare të

⁹¹⁶ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi (më tej: F) 1501/3, dosja (më tej: D.) 5, viti (më tej: V) 1912, fl. 9, Relacion i konsullatës italiane të Barit për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Bari, 20 prill 1912.

⁹¹⁷ *Greek lands in history, Epirus, 4000 years of Greek history and civilization*, Editor: M.B. Sakellariou, Ekdorike Athenon S.A. Athens: The Demetrius and Egle Botzaris Foundation, 1997, f. 363.

⁹¹⁸ *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: HHSt.A.PA.A), në Arkivin e Institutit të Historisë (më tej: AIH), Vj. 22-21-2123, Raport i konsullit austriak të Janinës për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Janinë, 9 shtator 1912.

⁹¹⁹ Stefanaq Pollo, "Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë", në: *Mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare (përmbledhje studimesh kushuar 50 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë)*, Tiranë: "Mihal Duri", 1962, f. 75.

⁹²⁰ Gazeta *Ipiros*, dt. 26 gusht 1912, HHSt.A.PA.A. në AIH.

shqiptarëve. Deklaratat në dobi të zbatimit të sistemit decentralizues edhe tek kombësitë e tjera, shiheshin prej artikujshkruesve si një mbulesë që austro-hungarezët i bënin mbështetjes së tyre për shqiptarët⁹²¹. Ky mendim, mbizotërues në popullatën greke, ishte në sinkron me qëndrimet e shprehura qeveritare, në lidhje me rolin e Austro-Hungarisë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Opinioni publik grek deklarohet agresiv ndaj çdo zhvillimi që synonte të zgjaste jetën e Perandorisë, madje herë pas here, qëndrimi i tij manifestonte edhe një ndjenjë pakënaqësie ndaj qeverisë greke⁹²². Në të vërtetë, pa mohuar kontributin e Mbretërisë Dualiste në emancipimin e lëvizjes kulturore e politike shqiptare, është e vështirë ta konsiderojmë këtë lëvizje, krijesë krejt të pastër të politikës austro-hungareze.

Në fillim të shtatorit të vitit 1912, mitingjet dhe telegramet e protestave u aktivizuan sërish. Në mitingjet e organizuara në Athinë, Korfuz e në Vollo, jo vetëm që u kundërshtuan kërkesat e shqiptarëve, por në fjalimet e mbajtura nxitej ndjenja e armiqësisë midis dy popujve fqinjë. Ndërkohë, telegrame proteste kundër kërkesave të shqiptarëve iu dërguan Vezirit të Madh, si nga banorët e vilajetit të Janinës, ashtu edhe nga diaspora greke⁹²³.

Intensiteti i propagandës mori trajta më ekstreme në prag të shpërthimit të Luftës së Parë Ballkanike. Nëpërmjet saj tashmë u synua të bëhej sa më shumë "zhurmë" për mbrojtjen e të ashtuquajturës çështje të Epirit. Dy ishin drejtimet kryesore: Së pari, u vu në lëvizje çështja e ripërcaktimit të kufirit verior të shtetit grek. Së dyti, u punua për ta paraqitur të ndryshuar raportin etnik midis shqiptarëve dhe grekëve në vilajetin e Janinës.

Propaganda mbështeti me forcë qëndrimin se Greqia në asnjë rrethanë nuk duhet të hiqte dorë nga vija kufitare osmano-greke e propozuar në Kongresin e Berlinit. Mbështetur në një interpretim relativ të vendimeve të këtij Kongresi dhe atyre të Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1880⁹²⁴, zyrtarët dhe propaganda greke punuan intensivisht për të bindur opinionin politik e publik evropian se, i ashtuquajturit Epir ishte grek dhe si i tillë duhej të ishte pjesë e Greqisë dhe jo e Shqipërisë. Qarkoret që përcilleshin nga Athina, artikujt e shtypit dhe udhëzimet e mitropolitëve të Janinës dhe të Paramithisë, u bënin thirrje ithtarëve të tyre që të përdornin çdo mjet për të bindur Evropën se territoret e poshtme të vilajetit të Janinës ishin greke⁹²⁵.

Në mbështetje të ripërcaktimit të kufirit u hodhën në qarkullim statistika, që mbështesnin pretendimet greke në vilajetin e Janinës. Vazhdohej të propagandohej se të gjithë shqiptarët ortodoksë ishin grekë, madje edhe në territore ku flitej vetëm shqip. Aktiv u tregua veçanërisht konsulli i përgjithshëm grek në Janinë. Në kuadër të zgjedhjeve parlamentare osmane të vitit 1912, ai me ndihmën e disa mitropolitëve, përgatiti disa statistika për përbërjen e popullsisë së vilajetit të Janinës. Sipas statistikave,

⁹²¹ Gazeta *Jehona e Epirit*, dt. 28 gusht 1912, *HHSSt.A.PA.A.* në *AIH*.

⁹²² *HHSSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 22-18-1801, Raport i konsullit austriak të Janinës për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Janinë, 1 shtator 1912.

⁹²³ Ελευθερία Ι. Νικολαΐδου, Η εθνική αλβανική κίνηση στο Βιλλέαθη του Ιωάννινα και η συμβολή των λεσχών στην ανάπτυξη της 1908-1912, Ιωάννινα: IMIAX, 1984 (Shfytëzuar materiali në: AIH, Eleftheria Nikolaidhu, Lëvizja shqiptare në vilajetin e Janinës dhe kontributet e klubeve në zhvillimin e saj, 1908-1912, Janinë: "IMIAX", 1984, fl. 85).

⁹²⁴ Edith Stickney, *Shqipëria Jugore ose Epiri i Veriut në çështjet evropiane ndërkombëtare, 1912-1923*, Tiranë: "Koha", 1998, f. 27.

⁹²⁵ *HHSSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 22-21-2123, Raport i konsullit austriak të Janinës për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Janinë, 9 shtator 1912.

të publikuara në shtator të po atij viti, numri i përgjithshëm i popullsisë së vilajetit shkonte në rreth 520.000 frymë. Nga këto, rreth 210.000 ishin myslimanë [nënkupto shqiptarë] dhe 300.000 të krishterë [nënkupto grekë]. Të gjithë banorët, që frekuentonin fenë e krishterë ortodokse, konsideroheshin pa përjashtim, grekë. Aty nuk veçoheshin as shqiptarët e krishterë dhe as vllahët⁹²⁶. Në një deklaratë për shtyp, konsulli grek deklaroi se, statistikat e tij ishin të destinuara për botën e jashtme dhe kishin si qëllim ta bindnin atë mbi karakterin grek të Epirit. Nuk munguan edhe deklaratat të tilla si “popullsia e krishterë e kazasë së Skraparit, kishte një kohë të gjatë që ndjente për Greqinë, megjithëse fliste shqip”⁹²⁷. Pohime të njëjta u bënë për shqiptarët e sanxhakut të Gjirokastrës.

Në faqet e shtypit grek, raporti midis popullsisë greke dhe asaj shqiptare u shfaq fluid, pra i ndryshueshëm. Me rritjen e forcës së Kryengritjes shqiptare, ai pësoi ndryshime të mëtejshme në favor të popullsisë greke. Gazeta greke “Messenger de Athènes” në një shkrim të shtatorit të vitit 1912 i konsideroi shqiptarët si “minorite insignificante”, që zinin vetëm 1/6 e popullsisë së përgjithshme të vilajetit të Janinës⁹²⁸.

Rritja e skajshme e propagandës greke me anën e shifrave statistikore ndikoi te shqiptarët. Çështja e raportit të popullsisë në vilajetin e Janinës, mori një rëndësi të veçantë sidomos pas plotësimit të kërkesave të shqiptarëve nga Porta e Lartë dhe angazhimeve osmane në dobi të zbatimit të koncesioneve për kombësitë e tjera të Perandorisë. Ekzagjerimet greke si në përbërjen e popullsisë, ashtu edhe në pretendimet territoriale sollën një kundërpërgjigje me të njëjtën monedhë nga shqiptarët. Pretendimet e tyre u ngritën fuqishëm mbi të gjithë territorin e vilajetit të Janinës.

Në fakt, ishte e vështirë të ndaje me thikë shqiptarët dhe grekët në vilajetin e Janinës. Jetesa e përbashkët në Perandorinë Osmane kishte sjellë përzjerje të fshatrave thjesht shqiptare me fshatra thjesht greke. Sipas studiuesit, Jacob Gould Schurman, në atë kohë profesor në Universitetin e Kornellit në ShBA, “ishte e vështirë të përcaktoje saktë kompleksitetin racor të atij vendi, ku raca lidhej me fenë, ku feja lidhej me numrin e peshkopëve, kishave dhe shkollave, ku peshkopët, kishat dhe shkollat krijoheshin dhe mbaheshin nga një propagandë e drejtuar nga fuqitë e huaja rivale, në të cilin rezultatet e propagandës përcaktoheshin gjerësisht nga paratë dhe nga njerëzit e drejtuar nga Athina, të cilët nga ana e tyre ishin në varësi të tekave dhe manipulimeve të qeverisë së sulltanit në Konstandinopojë”⁹²⁹.

Pikëpamjet e skajshme që shqiptarët dhe grekët kishin në lidhje me raportin e popullsisë në vilajetin e Janinës, sigurisht që nuk kontribuonin në qetësinë e vilajetit dhe në harmoninë e popullsisë së tij. Po ashtu, përpjekjet greke për ta zgjidhur në mënyrë të

⁹²⁶ Statistikat e konsullit grek të Janinës i gjejmë në një shtesë raporti të konsullit të Përgjithshëm të Austro-Hungarisë në vilajetin e Janinës. Raporti mban datën 22 shtator 1912 dhe gjendet në Arkivin e Institutit të Historisë. Krahas statistikave greke për përbërjen e popullsisë së vilajetit të Janinës, raporti paraqet statistikat osmane si dhe një statistikë të përgatitur nga vetë konsulli. Sipas statistikës osmane, popullsia e përgjithshme e vilajetit të Janinës ishte rreth 539.000 frymë. Nga këto 227.000 ishin myslimanë, 292.000 ortodoksë, 14.000 vllah dhe 5.000 izraelitë. Sipas statistikës së përgatitur prej konsullit, popullsia në vilajetin e Janinës ishte rreth 560.000 frymë, pra rreth 20.000 frymë më e lartë se popullsia në statistikën osmane. Nga këto 256.050 ishin myslimanë dhe 237.480 ortodoksë. Konsulli veçon shqiptarët ortodoksë, të cilët kapnin shifrën e rreth 67.000 frymëve. Numri i përgjithshëm i shqiptarëve në vilajet arrinte në rreth 188.050 frymë, kurse ai i grekëve në rreth 187.600 frymë.

⁹²⁷ *HHSt.A.P.A.A* në *AIH*, Vj. 22-21-2120, Raport i konsullit austriak të Janinës për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Janinë, 29 shtator 1912.

⁹²⁸ Gazeta *Messenger de Athines*, 12 shtator 1912 në *HHSt.A.P.A.A* në *AIH*, shih: relacionet e shtatorit 1912.

⁹²⁹ Jacob Gould Schurman, *Luftërat Ballkanike 1912-1913*, Tiranë: “Uegen”, 2006, f. 80.

njëanshme të ashtuquajturin problem epirot nuk i shërbenin afrimit shqiptaro-grek. Ato thellonin hendekun midis tyre.

Veprimtaria e çetave të armatosura: Veprimtaria e çetave të armatosura apo bandave, sikurse cilësohen në dokumentacionin e kohës, ishte një nga mjetet që u përdor nga Greqia për arritjen e qëllimeve të saj aneksioniste. Në dallim nga propaganda, veprimtaria e çetave u përdor kryesisht në periudha delikate atëherë kur procesi i helenizimit kërcënohej drejtpërsëdrejti nga veprimet e shqiptarëve. Nga janari e deri në korrik të vitit 1912, veprimtaria e çetave nuk zinte vend kryesor në reagimin grek. Në krye të listës vazhdonte të qëndronte propaganda. Kjo, sepse rrethet e politikës greke nuk e konsideronin si rrezik real veprimtarinë e çetave shqiptare në vilajetin e Janinës. Ajo konsiderohej si një veprimtari e paorganizuar, sporadike dhe jo politike. Mbështetur në propagandën fetare dhe atë shkollore, Greqia ndiqte në vazhdimësi një politikë konsekuente helenizimi në viset shqiptare, me anën e së cilës, ajo kishte arritur rezultate kryesisht në territoret me popullsi të përzier nga ana gjuhësore. Në situata jo shumë shqetësuese, qeveria greke nuk kishte interes të përdorte forcën ndaj shqiptarëve, në dobi të asaj që ajo e konsideronte “çështje kombëtare greke”. Në vite, ajo kishte treguar se parapëlqente vijimin në heshtje të punës helenizuese, në vend të ndezjes së konflikteve me shqiptarët që nuk i shërbente forcimit të helenizimit⁹³⁰.

Situata ndryshoi në gusht të vitit 1912, kohë kur Porta e Lartë vendosi të merrte në konsideratë kërkesat e shqiptarëve. E vetme, propaganda nuk mund të mbronte interesat greke. Duket se përdorimi i mjeteve të forcës u konsiderua i nevojshëm përderisa çetat greke u aktivizuan. Në atë kohë veprimtaria e tyre mori të njëjtën rëndësi sikurse edhe propaganda.

Kushtet e këqija të sigurisë dhe vështirësitë ekonomike në vilajetin e Janinës gjatë vitit 1912, sillnin një rritje të vetëdijshme të banditizmit. Kjo situatë krijonte një terren të favorshëm për ekzistencën e çetave. Në relacionet e kohës përmendet një veprimtari e gjerë e një sërë çetash si shqiptare, ashtu edhe greke, që kishin kryesisht karakter grabitës. Me fuqizimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe përhapjen e kryengritjes shqiptare në vilajetin e Janinës u bë i pranishëm aktiviteti i çetave politike shqiptare. Dallohej veçanërisht çeta e Çamërisë. E krijuar kundër provokacioneve osmane e greke, ajo i kundërvihej dhunës së dyanshme dhe kishte si qëllim të mbronte popullsinë myslimane shqiptare, veçanërisht nga sulmet e çetave greke. Në verë të vitit 1912, aktiviteti i çetave shqiptare tërhoqi vëmendjen e shtypit grek, ku dallohet gazeta “Ipiros”. Në shkrimet e saj, veprimtarisë së tyre nuk i jepej karakter politik. Çetat konsideroheshin banda kusarësh, që synonin të terrorizonin dhe të grabisnin banorët e krishterë. Edhe vetë ministri Koromilas ankohej lidhur me atë që ai nuk ngurronte ta etiketonte si “terrorizim të fshatrave grekë prej bandave shqiptare”⁹³¹.

Rritja e aktivitetit politik të çetave shqiptare u shoqërua me shtim të aktivitetit të çetave greke, kryesisht në zonat e fshatrave me popullsi shqiptare myslimane. Nëpërmjet veprimtarisë së tyre u synua që vilajeti i Janinës të mbahej në një gjendje anarkie latente; popullsia aty të mbetej jashtë rrezes së veprimtarisë kombëtare shqiptare dhe sa më afër

⁹³⁰ *HHSt.A.PA.A*, në *AIH*, Vj. 22-21-2120, Raport i konsullit austriak të Janinës për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Janinë, 29 shtator 1912.

⁹³¹ *Po aty*, Vj. 22-21-2124, Raport i konsullit grek të Janinës për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Janinë, 9 shtator 1912; *Po aty*, Vj. 22-21-2187, Njoftim i ministrit të Austro-Hungarisë në Athinë për ministrin e Punëve të Jashtme, Athinë, 5 tetor 1912. Mbi takimin me Koromilasin.

rrezes së veprimeve greke; të hakërrehej popullsia e krishtere ndaj asaj myslimane; të terrorizohej popullsia e pambrojtur shqiptare, etj. Në veprimtarinë e tyre çetat bashkëpunuan me institucionet fetare, ku shquhet marrëdhënia e veçantë me mitropolitin e Paramithisë. Konsujt grekë, mitropolitët dhe shtypi e përligjën aktivitetin e çetave greke me mbrojtjen e popullsisë së shtypur e të varfër greke të vilajetit të Janinës, nga sulmet e çetave shqiptare. Aktet kriminale të shqiptarëve, sipas drejtorit të “Banque d’Athenes” Frangolopoulos, ishin rritur aq shumë, sa që kishin detyruar popullsinë greke të vetëmbrohej, duke formuar edhe ajo banda.

Natyrshëm lind pyetja. A kishte dorë qeveria greke në krijimin e këtyre çetave?

Deri në prag të fillimit të Luftës së Parë Ballkanike, në përgjithësi në letërsinë historike greke, ekzistenca e çetave shihet vetëm si reagim spontan i popullsisë vendase⁹³². Në këtë mënyrë, përgjegjësia shtetërore anashkalohet. Por, Athina me kohë ishte kujdesur të nxiste pakënaqësinë e banorëve të krishterë të vilajetit të Janinës. Edhe nëse çetat nuk ishin krijim i drejtpërdrejtë i politikave shtetërore, fakti që një numër i madh hajdutësh të pandëshkuar bëheshin anëtarë të tyre apo lehtësirat që këto çeta siguronin në kalimin e kufirit, flasin për rolin e pushtetarëve grekë në veprimtarinë e tyre. Organizata “Bashkimi Epirotik”, e krijuar në vitin 1906 në Janinë, përdori të gjitha mjetet kundër shqiptarëve, që ishin treguar aktivë në kryengritjet kundërosmane. Në veprimtarinë e saj organizata bashkëpunonte me Drejtorinë A në Ministrinë e Brendshme greke. Veprimtaria e saj sikurse ajo e çetave justifikohet sërish me rrezikun shqiptar, që kërcënonte fshatrat e krishtera veçanërisht në rajonin e Çamërisë⁹³³.

Në prag të shpërthimit të Luftës së Parë Ballkanike karakteri politik i veprimtarisë së çetave greke u deklarua hapur në faqet e shtypit⁹³⁴. Tashmë, veprimtaria e tyre ishte në mbështetje të aksioneve të ndërmarra nga qeveria greke. Në shtypin e kohës, qëndrimi i shqiptarëve kundrejt qeverisjes osmane, që prej vitit 1908 konsiderohej një revolucion latent, i cili kishte arritur suksese vetëm në saje të përdorimit të forcës. Artikujshkruesit këshillonin qeverinë greke të përdorte të njëjtin reagim sikundër kishin vepruar shqiptarët. Qëndrimi “korrekt” që Athina kishte mbajtur ndaj ngjarjeve të brendshme në Perandorinë Osmane, duhej të zëvendësohej me “një aksion më energjik”⁹³⁵. Nëse Greqia nuk kishte forcë ta merrte e para iniciativën për një luftë kundër Perandorisë Osmane, ajo duhej të mbështeste cilindo shtet ballkanik, që mund ta bënte atë, qoftë kjo edhe Bullgaria.

Në prag të shpërthimit të Luftës së Parë Ballkanike, numri i çetave greke, që vepronin në vilajetin e Janinës, u rrit ndjeshëm⁹³⁶. Qëllimi kryesor i tyre ishte të detyronte me anën e forcës popullsinë shqiptare që të mbështeste pretendimet greke. Sjellja ishte e dhunshme, veçanërisht ndaj popullsisë shqiptare, që frekuentonte besimin mysliman⁹³⁷.

⁹³² Për më shumë shih, Greek lands in history, Epirus, 4000...; E. Νικολαΐδου, Η εθνική αλβανική κίνηση στο Βιλλιάτι...

⁹³³ Hajredin Isufi, *Musa Demi dhe qëndresa çame, 1800-1947*, Tiranë: “Dudaj”, 2002, f. 91-98.

⁹³⁴ Gazeta *Ipiros*, shtator 1912, *HHS*.A.PA.A. në *AIH*.

⁹³⁵ Po aty.

⁹³⁶ Greek lands in history, Epirus, 4000 ..., f. 364.

⁹³⁷ *HHS*.A.PA.A. në *AIH*, Vj. 22-21-2114, Raport i konsullit austriak të Janinës për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Janinë, 8 tetor 1912.

RËNDËSIA E LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT

Mirela Lazimi

ABSTRAKT

Lidhja Shqiptare e Prizrenit shënon një epokë të ndritur të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare që identifikohet me luftën e organizuar në fushën politike, ideologjike, diplomatike, arsimore e kulturore të popullit shqiptar. Lidhja e Prizrenit, si organizëm politik gjithshqiptar, udhëhoqi luftën e popullit tonë për autonomi me synim pavarësinë e plotë, si komb i bashkuar në kufijtë etnik të saj.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit ishte e para Lëvizje Çlirimtare me karakter mbarë kombëtar, në të cilën morën pjesë të gjitha krahinat e Shqipërisë etnike, ku u harmonizuan të gjitha forcat e luftës çlirimtare që nga "Kuvendet e Dheut" që mobilizonin luftëtarë në mbrojtje të atdheut deri tek parashtresat politike, misionet diplomatike dhe kryengritjet e armatosura. Në sajë të veprimtarisë intensive që nxiti, organizoi dhe udhëhoqi, Lidhja Shqiptare e Prizrenit mundësoi vendosjen e autoritetit të saj në katër vilajetet përfshirë sanxhaqet, kazatë e nahijet shqiptare.

Kjo lëvizje kombëtare, në jug pati qendrën intelektuale dhe në veri qendrën luftarake. Lëvizja e brendshme e Lidhjes formon një histori të veçantë, së cilës i ka shkruar mjaft koha dhe njerëzit e atij brezi, që kanë marrë pjesë aktive. Lidhja e Prizrenit dhe veprimet e saj u bënë shkak, që midis çështjeve të tjera të Ballkanit, të shtohet dhe çështja shqiptare si një nacionalitet i ri i ngjallur pas 5 shekujsh nga një gjumë i rëndë.

Rëndësia e Lidhjes qëndron tek merita e shndërrimit të përpjekjeve sporadike të patriotëve të veçantë në një "ideologji nacionaliste, që përshpejtoi procesin e fermentimit politik dhe kulturor që do të çonte jo vetëm në krijimin e një shteti të pavarur, por do të ndihmonte që ta sillte çështjen shqiptare në vëmendjen e botës".

Fjalet kyç: Lidhja Shqiptare e Prizrenit, lëvizje kombëtare mbarëshqiptare, organizëm politik gjithëshqiptar.

Gjatë 400 viteve nën perandorinë otomane, u duk sikur shqiptarët e patën humbur, jo vetëm idenë e një shteti shqiptar, por edhe vetëdijen e kombësisë.

Shqiptarët, që i kanë dhënë botës pa kursim nga më të mëdhenjtë ushtarakë, udhëheqës e themelues shtetesh, në truallin e tyre nuk mundën të ngrinin diçka të qëndrueshme, të fortë. Kjo shpjegohet nga faktorët historiko-geografikë që kanë penguar bashkimin dhe forcimin e një bashkësie shqiptare si komb e shtet; që kanë sjellë ndasira fetare, krahinore, interesash; që kanë penguar zhvillimin e një kulture kombëtare të lartë dhe dobësuar besimin në mëkëmbjen e Shqipërisë si shtet më vehte.

Ky është shkaku që shqiptarët, deri në gjysmën e shekullit të XIX-të, paraqiten si një popull pa qëllime dhe pa një ide qëndrore shqiptare.

Lidhja e Prizrenit hodhi idenë e bashkimit shqiptar përmbi ndarjet fetare e krahinore, përmbi aventurat personale. Këtu qëndron rëndësia historike e saj.

Lëvizja kombëtare e gjysmës së dytë të shek. XIX, e udhëhequr nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, lindi nga atdhetarizma e popullsisë së Shqipërisë, duke shënuar një hap cilësor nga pikëpamja e platformës ideologjike, e kërkesave politike dhe e frontit luftarak.

Lidhja e Prizrenit, ishte Lidhja e dytë Kombëtare pas Lidhjes së Lezhës të krijuar nga Skenderbeu më 1444. Por, Lidhja e Prizrenit ishte e para lëvizje çlirimtare me karakter kombëtar dhe që mori masa energjike për mbrojtjen e vendit në të cilën u kombinuan të gjitha format e luftës çlirimtare duke filluar nga protestat që ia dërgoi Kongresit të Berlinit dhe Fuqive të Mëdha, që nga kuvendet popullore deri te parashtrirat politike, që nga misionet diplomatike deri te kryengritjet e armatosura, që ishte mjeti më i sigurtë i shpëtimit kombëtar.

Ajo ishte e para lëvizje masive, e cila synoi të përmbushte programin madhor të Rilindjes Kombëtare Shqiptare – njohjen e kombit shqiptar si një bashkësi e pandarë dhe mbrojtjen e tërësisë territoriale të atdheut.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit ishte e para organizatë kombëtare që krijoi degë të saj në të gjitha krahinat shqiptare dhe e para organizatë atdhetare që përdori, për interesat e lartë të atdheut, krahas pushkës edhe penën. Ajo nuk ishte vetëm një mbledhje udhëheqësish politik, ushtarak; apo një mbledhje idealiste; kjo Lidhje përfaqësonte vullnetin e gjithë popullit shqiptar, kudo në trojet e tij stergjyshore. Për më tepër, Lidhja Shqiptare e Prizrenit ishte e para organizatë, e cila jo vetëm u vesh qysh në fillim me funksione pushtetore, por arriti në fund të fitonte atributet e një qeverie të përkohshme shqiptare, pothuajse krejtësisht të pavarur nga autoriteti i Perandorisë Osmane.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit, veç qëllimit, për të mbrojtur tërësinë e Shqipërisë, kërkoi dhe autonominë e vendit, duke mbledhur katër vilajetet e Shqipërisë në një të vetëm dhe me gjuhën shqipe si gjuhë të qeverisë.

Me Lidhjen e Prizrenit, për herë të parë, në Shqipëri u mendua dhe u punua për tërë Shqipërinë; botës ju dha të kuptojë që Shqipëria s'është vetëm vendi në veri a në jug të Shkumbinit, por në gjithë viset ku flitet shqip.

Lidhja e Prizrenit nuk u bazua dhe as nuk u kufizua në memorandume shtërpe drejtuar Fuqive të Mëdha; por këto memorandume u shoqëruan me një mobilizim të madh e të gjithanshëm të masave të gjera popullore. Lidhja për herë të parë sfidoi prepotencën e Fuqive të Mëdha, agresivitetin e monarkive fqinje dhe arrogancën e Portës së Lartë.

Me qëndresën e armatosur, Lidhja tregoi se trojet shqiptare nuk mund të trajtoheshin si plaçkë tregu për të kënaqur lakmitet e monarkive fqinje; ajo i detyroi Fuqitë e Mëdha jo vetëm të rishikonin tri herë me radhë vendimet, por përmbysi dhe tezat e tyre, sipas të cilave, së pari, mohojë ekzistenca e kombit shqiptar dhe së dyti, i paraqitnin shqiptarët si të paafte për vetqeverisje; kështu, çështja shqiptare hyri në veprimtarinë diplomatike ndërkombëtare si një nga problemet e mprehta që kërkonte zgjidhje në çdo rregullim të ardhshëm të Evropës Juglindore.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit i dha një shtytje të madhe edhe lëvizjes kulturore shqiptare; përparimet e arritura brenda tre viteve të jetës së saj në fushën e mendimit shoqëror, të letërsisë publicistike dhe të krijimtarisë letrare ishin më të mëdha, sesa hapat e kryer gjatë dhjetëvjeçarëve të mëparshëm.

Lidhja e Prizrenit krijoi më në fund një pikë të shëndoshë referimi si me programin e saj politik, ashtu edhe me formën e saj organizative për lëvizjet e mëvonshme çlirimtare të shqiptarëve deri në fitoren e pavarësisë kombëtare, në nëntor të vitit 1912.

Nga ana tjetër, Lidhja e Prizrenit u dha shqiptarëve edhe një varg mësimesh të rëndësishme. Sukseset e saj treguan se autonomia e Shqipërisë ishte një synim i realizueshëm, por shtypja e saj tregoi se fitorja përfundimtare e autonomisë kalonte nëpër rrugë të vështira dhe se duheshin përpjekje të tjera vigane për arritjen e saj. Historia e Lidhjes tregoi se pengesa kryesore për krijimin e shtetit kombëtar shqiptar nuk vinte vetëm nga Perandoria Osmane, por edhe nga faktori ndërkombëtar. Shqiptarët u bindën se luftën çlirimtare duhej ta zhvillonin duke u mbështetur në radhë të parë në forcat e tyre njerëzore e materiale dhe se duhej të punonin njëkohësisht për të siguruar përkrahjen e Fuqive të Mëdha, sidomos të atyre që kishin filluar të anonin nga zgjidhja e drejtë e çështjes kombëtare shqiptare. Lidhja provoi gjithashtu se brenda vendit Lëvizja Kombëtare Shqiptare mbështetjen politike, morale, materiale e luftarake duhej ta kërkonte te shtresat e gjera të popullit dhe te bashkimi i të gjitha forcave shoqërore e politike të kombit shqiptar, pa dallim feje, krahine e përkatësie shoqërore. Veprimtaria e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit tregoi, më në fund, rëndësinë e madhe që kishte për betejat e ardhshme çlirimtare edukimi i popullit shqiptar me ndërgjegjen kombëtare nëpërmjet shkollës shqipe, të letërsisë shqiptare dhe të publicistikës patriotike.

Rëndësia e Lidhjes qëndron tek merita e shndërrimit të përpjekjeve sporadike të patriotëve të vecantë në një "ideologji nacionaliste, që përshpejtoi procesin e fermentimit politik dhe kulturor që do të conte jo vetëm në krijimin e një shteti të pavarur, por do të ndihmonte që ta sillte cështjen shqiptare në vëmendjen e botës".

Lidhja Shqiptare e Prizrenit u shtyp pasi i arriti qëllimet e programit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, materialisht ajo u shtyp nga dhuna ushtarake dhe terrori policor i Perandorisë Osmane. Në të vërtetë Lidhja Shqiptare e Prizrenit u shuajt edhe nga konspiracioni ndërkombëtar që organizuan kundër saj Fuqitë e Mëdha. Lidhja Shqiptare e Prizrenit i dha kombit shqiptar një varg mësimesh të rëndësishme për vazhdimin e më vonshëm të lëvizjes çlirimtare të shqiptarëve dhe programin e saj politik deri në fitoren e pavarësisë kombëtare më 28. nëntor. 1912.

Për karakterin e Lidhjes janë mbajtur tre qëndrime:

Qëndrimi i parë përfaqësohet nga historiografia shkencore, e cila e vlerëson Lidhjen e Prizrenit si një organizatë patriotike, të themeluar nga shqiptarët për të mbrojtur interesat kombëtare të Shqipërisë.

Qëndrimi i dytë, denigruese, lindi në truallin politik të armiqve të çështjes shqiptare. Sipas tyre Lidhja Shqiptare e Prizrenit ishte një organizatë fetare islamike, se atë e themeloi Porta e Lartë dhe se qëllimi i saj ishte të mbronte territoret e Perandorisë Osmane në Gadishullin Ballkanik për të shmangur dëbimin e saj nga kontinenti evropian.

Qëndrimi i tretë, i moderuar, zinte një pozitë të ndërmjetme. Ajo lindi në opinionin publik botëror, madje tërhoqi edhe disa personalitete zyrtare evropiane, të cilëve nuk iu duk bindëse teza absurde që mohlonte shqiptarësinë e Lidhjes Shqiptare".

Sidoqoftë, Lidhja e Prizrenit i kompaktësoi shqiptarët dhe ndikoi në formimin e kombit shqiptar mbi një koncept të historisë, gjuhës, kulturës, prejardhjes së përbashkët. Ky është rezultati më i madh që ka arritur Lidhja e Prizrenit.

EMIGRACIONI I HERSHËM SHQIPTAR NË SHBA DHE AKTIVITETI I TYRE NË DOBI TË ÇËSHITJES KOMBËTARE (FUNDI I SHEK. XIX DERI NË 1918)

Mirela Nofulla

Shqiptarët deri në fund të shek.XVIII-të, emigronin kryesisht në Stamboll, në fillim të shek. XIX-të, gjeografia e emigrimeve shqiptare u zgjerua me Rumaninë, Egjiptin, dhe vendet ballkanike, ndërsa në fund të tij edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.⁹³⁸

Shqiptari i parë, mbërriti në Amerikë më 1876, por ai shpejt largohet për t'u vendosur në Argjentinë.⁹³⁹ Historia e emigracionit shqiptar në Amerikë fillon 8 vite më pas dhe lidhet me emrin e Kolë Kristoforit nga fshati Katund i Korçës. Pas gjashtë vitesh qëndrimi në Amerikë, Kristofori kthehet në vendlindje, i mirëveshur me para dhe me shumë rrëfime joshëse për botën e re, të cilat nxitën 16 bashkëfshatarë të tij të shkonin bashkë më të në Amerikë më 1892.⁹⁴⁰

Këta emigrantë, që hapën rrugën e mërgimit në Amerikë, populli i zonës së Korçës i ka memorizuar në një këngë të thurrur në fillim të shek. XX-të. Në vargjet e saj thuhet:

“Kush hapi Ameriqinë / ...Korçari me Katundllinë...”⁹⁴¹

Emigrantët nga fshati Katund i Korçës, të cilët formuan bërthamën e disaporës shqiptare në Amerikë, u pasuan nga një valë e madhe emigrantësh nga Jugu i Shqipërisë, sidomos pas vitit 1900.⁹⁴² Në fillim ata u vendosën në Boston (Boston), Nju-Jork (New York), Sent-Lui (St Louis), më pas ata u përhapën dhe në territore të tjera të ShBA-së, deri në brigjet e Paqësorit.⁹⁴³ Numri i emigrantëve shqiptarë të vendosur në territoret e Amerikës sipas statistikave zyrtare amerikane të vitit 1910, kapte shifrën 625-së.⁹⁴⁴ Por sipas studiuesve shqiptarë⁹⁴⁵ është e vështirë të provohet nga statistikat zyrtare të kohës numri i saktë i emigrantëve shqiptarë në Amerikë në dy dekadat e para të shek.XX, pasi shqiptarët duke qënë shtetas të Perandorisë Osmane shkonin në Amerikë me pasaporta të këtij shteti, ndërsa një pjesë e tyre shkonin dhe me pasaporta greke për shkak të përkatësisë fetare dhe të politikës helenizuese që ndiqte qeveria greke në viset jugore, të

⁹³⁸ Historia e popullit shqiptar, Vëll. II, Tiranë: Toena, 2003, f.69-70.

⁹³⁹ Valentina Duka, *Çështje të historisë bashkëkohore të shqiptarëve*, Tiranë: SHBLU, 2008, f.10, Vehbi Bajrami, *Shqiptarët e Amerikës*, Nju Jork, 2003, f.57.

⁹⁴⁰ Valentina Duka, *Çështje të historisë bashkëkohore të shqiptarëve*, Tiranë: SHBLU, 2008, f.10, Vehbi Bajrami, *Shqiptarët e Amerikës*, Nju Jork, 2003, f.58, Leonard Demi, *Shqipëria dhe diplomacia amerikane*, Tiranë: Guttenberg, 2009, f.9.

⁹⁴¹ Vehbi Bajrami, *Shqiptarët e Amerikës*, Nju Jork, 2003, f.58.

⁹⁴² Valentina Duka, *Çështje të historisë bashkëkohore të shqiptarëve*, Tiranë: SHBLU, 2008, f.10, Vehbi Bajrami, *Shqiptarët e Amerikës*, Nju Jork, 2003, f.58.

⁹⁴³ Historia e popullit shqiptar, Vëll. II, Tiranë: Toena, 2003, f.70.

⁹⁴⁴ Valentina Duka, *Çështje të historisë bashkëkohore të shqiptarëve*, Tiranë: SHBLU, 2008, f.12.

⁹⁴⁵ Valentina Duka, *Çështje të historisë bashkëkohore të shqiptarëve*, Tiranë: SHBLU, 2008, f.11, Vehbi Bajrami, *Shqiptarët e Amerikës*, Nju Jork, 2003, f.58, Beqir Meta, *Federata Panshqiptare "Vatra"*, Tiranë: Globus, 2002, f.13.

cilat i kishte pushtuar gjatë luftrave ballkanike. Gjithashtu shqiptarët shkonin dhe me pasaporta të vendeve të tjera ballkanike, ku kishin emigruar më herët dhe nga ku riemigruan për në Amerikë. Këndvështrimi bindës i studiuesve shqiptarë çon në përfundimin logjik se numri i emigrantëve shqiptarë në statistikat zyrtare amerikane është më i vogël se ç'ishte numri real i tyre.

Por, emigrimi në Amerikë në këtë periudhë nuk ishte vetëm fenomen shqiptar. Një valë e madhe njerëzish nga e gjithë Evropa, emigronte në Amerikë. Ndërmjet viteve 1880 dhe 1910, në brigjet e Amerikës mbërritën 18 milion emigrantë.⁹⁴⁶ Në emigrimin e madh të evropianeve në Amerikë ndikoi rritja e jetëgjatësisë dhe e numrit të popullsisë në Evropë si pasojë e përmirësimit të cilësisë së jetesës nga zhvillimet teknologjike dhe shkencore në kuadrin e Revolucionit të Dytë Industrial⁹⁴⁷ të gjysmës së dytë të shek. XIX.

Nga ana tjetër teknologjia e re i dha shtytje ndërtimit të anijeve të shpejta transoqeanike, që e "zvogëluan" distancën e Amerikës me Evropën. Kompanitë e mëdha të anijeve dërgonin agjentët e tyre edhe në Shqipëri ashtu sikurse dhe në vendet e tjera për të njoftuar kohën e udhëtimit për në Amerikë dhe për të tërhequr sa më shumë udhëtarë. Agjentët e kompanive kishin pjesën e tyre të ndikimit në emigrimin e shqiptarëve në Amerikë.

Por shkaku i emigrimit të shqiptarëve drejt "botës së re" ishte gjendja e vështirë ekonomike si në fshat ashtu dhe në qytet. Në fshat përballimi i jetesës vështirësohej nga një sërë faktorësh si: rritja e vazhdueshme e taksave, veprimi i ligjeve të ekonomisë së tregut dhe fajdeja. Fshatarët për t'i bërë ballë varfërimit të vazhdueshëm detyroheshin të shisnin dhe tokën.

Por edhe qyteti nuk paraqiste ndonjë tablo më të mirë ekonomike, pasi taksat dhe vërshimi i mallrave të huaja pengonin zhvillimin e ekonominë vendase. Si rrjedhojë fabrikat punonin me një kapacitet të vogël punëtorësh, ndërsa punishtet zeytare shkuan drejt rrënimit gjë kjo që rriste papunësinë dhe e bënte të vështirë përballimin e jetesës në vend.

Shkaku politik ishte një tjetër shtysë e fortë që i detyroi shqiptarët të largoheshin nga Atdheu. Veçanërisht pas viteve 1904-1905, 1909-1912, vite të karakterizuara me tensione të forta politike të krijuara nga ngjarjet që sollën shpalljen e pavarësisë si dhe në 1913-1914, e veçanërisht më 1914, kur Shqipëria e Jugut u pushtua nga grekët.⁹⁴⁸

Emigrimi i shqiptarëve në Amerikë përkoi me nevojën për krahë pune atje. Pas Luftës Civile të viteve 1861-1865,⁹⁴⁹ ku Veriu triumfoi mbi Jugun, zhvillimi ekonomik në Amerikë eci me ritme mjaft të shpejta si pasojë: e heqjes së skllavërisë, konsolidimit të tregut kombëtar, numrit të madh të punëtorëve të pakualifikuar, shfrytëzimit të pasurive natyrore, zbatimit të teknologjisë së re, si dhe shpenzimeve të pakta për ushtrinë dhe

⁹⁴⁶ *Historia e SHteteve të Bashkuara të Amerikës*, Tiranë: Qendra Ndërkombëtare e Kulturës "Arbnori", 2010, f.317.

⁹⁴⁷ Revolucionin i Dytë Industrial solli përdorimin e burimeve të reja për fuqinë energjitike lëvizëse, rritjen e shkallës së mekanizimit të prodhimit, krijimin e industrive të reja dhe shtrirjen e mëtejshme gjeografike të industrializimit.

⁹⁴⁸ Valentina Duka, *Çështje të historisë bashkëkohore të shqiptarëve*, Tiranë: SHBLU, 2008, f.11.

⁹⁴⁹ Veriu përfshinte shtete industriale ndërsa Jugu shtete agrare në plantacionet e të cilave kultivohej pambuku që eksportohej. Ndërkohë Shtetet e Jugut importonin mallra britanike me taksat doganore të ulëta për pasojë ato shiteshin më lirë se mallrat amerikane. Kërkesa e pronarëve të fabrikave të Veriut për vendosjen e taksave të larta doganore për mallrat britanike u kundërshtua nga shtetet e Jugut. Mosmarrëveshjet u rritën edhe për problemin e skllavërisë, Veriu ishte për heqjen ndërsa Jugu për egzistencën e saj. Pas fitores në zgjedhjet presidenciale të 1960, të Abraham Lincolnit (Abraham Lincoln), i cili ishte për heqjen e skllavërisë, 11 shtete të Jugut u shkëputën dhe formuan Konfederatën e Shteteve të Jugut. Sulmi i ushtrisë së Konfederatës së Shteteve të Jugut mbi fortesën Senter në Karolinën e Jugut shënoi fillimin e Luftës Civile, e cila u zhvillua në vitet 1861-1865.

administratën. Në 1883, Amerika zinte vendin e parë në botë për prodhimin e përgjithshëm industrial.⁹⁵⁰ Emigrantët shqiptarë ishin të pakualifikuar dhe filluan punë kryesisht në fabrikat e tekstileve, këpucëve dhe ndërrmarrjet, metalike të cilat nuk kishin shumë nevojë për punëtorë të kualifikuar.⁹⁵¹

Sipas studiuesit Stavro Skëndi, udhëheqësit e Lëvizjes kombëtare filluan ta kthejnë vëmendjen nga kolonia shqiptare, e cila pak nga pak u rrit dhe u bë më e rëndësishmja nga të gjitha ngulimet jashtë vendit.⁹⁵² Terreni demokratik amerikan u mundësoi liri veprimi patriotëve shqiptarë për të përçarur idetë e Lëvizjes Kombëtare edhe në gjirin e diasporës shqiptare në SHBA. Gjithashtu pozitivisht mund të kenë ndikuar edhe kontaktet e emigrantëve shqiptarë me ata evropiano perëndimorë, (kujtojmë se emigrimi i shqiptarëve në Amerikë përkoi me valën e madhe të emigrantëve evropianë),⁹⁵³ të cilët vinin nga vende ku procesi i formimit të shtetit kombëtar kishte hyrë në rrugën e konsolidimit. Kujtojmë se në gjysmën e parë të shek.XIX u konsolidua teoria e nacionalizmit, që mbështeste platformën e kombit unik me shtetin kombëtar.⁹⁵⁴

Që më 1905, atdhetari dhe intelektual i shquar shqiptar, Petro Nini Luarasi kishte arritur të themelonte shoqërinë e parë shqiptare në Amerikë, të quajtur "Mall' i Mëmëdheut".⁹⁵⁵ Emigranti nga fshati Katund i Korcës, Kostandin Demo, në kujtimet e tij të shkruara shprehet se Petron mund ta krahasojmë me Shën Janin pasi ai përgatiti udhën e Lëvizjes Kombëtare për ata që erdhën pas tij.⁹⁵⁶ Pas Petro Ninit në Amerikë shkuan dhe shumë intelektualë dhe atdhetarë të tjerë nga Shqipëria apo kolonitë e tjera shqiptare. Më 1905, arriti në Amerikë Sotir Peci dhe një vit më vonë Fan Noli, të cilët luajtën një rol të rëndësishëm në përhapjen e Lëvizjes Kombëtare në diasporën shqiptare në Amerikë.⁹⁵⁷ Ndërkohë në Amerikë krijohet shoqëri të tjera shqiptare. Në vitin 1906, në Boston krijohet shoqëria "Dashuria", ndërsa në janar të vitit 1907, Fan Noli së bashku me një grup atdhetarësh, formoi shoqërinë "Besa-Besë po në Boston. Një muaj pas formimit të shoqërisë "Besa-Besë në Sent Luis krijohet një tjetër shoqëri shqiptare e pagëzuar me emrin "Lidhja".⁹⁵⁸

Themelimi i kishës kombëtare shqiptare, një vit më pas, ishte një nga arritjet e rëndësishme të diasporës shqiptare në Amerikë. Krijimi i një kishë kombëtare ortodokse ishte një nga objektivat kryesore të patriotëve shqiptarë që nga fundi i shek.XIX. Sami Frashëri në veprën "Shqipëria ç'ka qënë,ç'është dhe ç'do të bëhet", në pjesën ku formuloi detyrat e programit minimum të lëvizjes shqiptare, pas shkëputjes së sigurimit nga qeveria turke të së drejtës për të lëvruar gjuhën shqipe, vuri si pikë të dytë krijimin e kishës kombëtare ortodokse.⁹⁵⁹ Sipas studiuesit Stefanaq Pollo arsyet duhen kërkuar jo

⁹⁵⁰ *Historia 2*, Tiranë, SHBLSH, 2003, f.157.

⁹⁵¹ Valentina Duka, Çështje të historisë bashkëkohore të shqiptarëve, Tiranë: SHBLU, 2008, f.15.

⁹⁵² Stavro Skëndi, Zgjimi Kombëtar, Phoenix, f.151.

⁹⁵³ Shih f.2.

⁹⁵⁴ Llambro Filo, *Historia 2 Libri I mësuesit dhe nxënësit*, Tiranë: SHBLSH, 2001, f.47 : Komb-shteti si nocion përmban dy komponentë: 1-Psikologjiko-kulturor që nënkupton bashkësinë e njerzve të formuar historikisht dhe me gjuhë, tradita, zakone, territor, të përbashkët këtyre tipareve mund t'u shtohet dhe besimi fetar i shumicës të popullsisë. 2-Politiko-juridik që nënkupton sovranitetin e popullit (autoriteti më i lartë i pushtetit i takon popullit) dhe atë kombëtar (shtet i bashkuar kombëtar me të drejtën e tërësisë territoriale, të integritetit, të moscënimit nga vendet ose kombet e tjera).

⁹⁵⁵ Valentina Duka, Çështje të historisë bashkëkohore të shqiptarëve, Tiranë: SHBLU, 2008, f.21.

⁹⁵⁶ Po aty, f.21.

⁹⁵⁷ Po aty, f.23.

⁹⁵⁸ Po aty, f.26-31.

⁹⁵⁹ Koço Bihuku, Kumtesë :Themelimi i Kishës Ortodokse Kombëtare dhe roli i Nolit, botuar në përmbledhjen me kumtesa: 70vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, Tiranë, 1993, f.31-32.

vetëm në dëshirën e ligjshme të ortodoksve për të patur kishën e vet autoqefale të pavarur nga Patriarkana, por edhe sepse në Patriarkanë ushtronin një ndikim të madh fanariotët (pasanikët grekë që banonin në lagjen Fanar të Stambollit). Ata kishin arritur ta sundonin kishën dhe ti impononin asaj një vijë politike në favor të ekspansionizmit të helenizmit. Ajo kishte gjetur mbështetje edhe te politika teokratike e Portës së lartë, që i konsideronte ortodoksët e Ballkanit, grekë.⁹⁶⁰

Në fillim patriotët mendonin që kisha kombëtare të ngrihej në Shqipëri, por e kuptuan se

se kjo ishte e perealizueshme në kushtet e sundimit osman dhe influencës së Fanarit. Përballë një situatë të tillë përpjekjet u përqëndruan në kolonitë shqiptare.

Në qershor të vitit 1907 F.Noli në emër të shoqërisë “Besa-Besë” i dërgoi një letër episkopit Rus në Nju Jork, në të cilën i shkruante nëse “*munt t’u bëjë Shqipëtarëve një prift*”.⁹⁶¹ Ndërkohë episkopi kishte shkuar në Rusi ku do të qëndronte 2-3muaj. Por Noli nuk e humbi durimin. Në letrën dërguar atdhetarit Thanas Tashko, më 16 korrik 1907, ai shkruante: “... *I dhashë karar me veten t’ime të bëhem vetë prift...posa që të vinjë episkopi Rus do shkoj në New York do t’i ngjitem si këpushkë gjer sa të më shenjtërojë*”.⁹⁶²

Pas dy muajsh, më 25 gusht 1907, në Hadsëni vdiq patrioti i ri shqiptar Kristaq Dishnica. Varrimi i i tij u bë pa kryerjen e shërbesave mortore pasi kisha siriane e nxitur nga shovinistët grekë refuzuan t’i kryenin ato.⁹⁶³ Pas kësaj ngjarje diaspora shqiptare në ShBA i shtoi përpjekjet për hapjen e kishës shqiptare, të cilat më 1908, u finalizuan me sukses. Sinodi rus, pasi u bind për vendosmërinë e shqiptarëve për themelimin e kishës kombëtare dhe u sigurua se shqiptarët ishin të gatshëm të mbanin me shpenzimet e tyre priftin dhe kishën, udhëzoi kishën e vet në Amerikë të shuguronte priftin shqiptar. Më 8 mars 1908, Fan Noli u dorëzua prift. Themelimi i kishës kombëtare ortodokse në Amerikë më 1908, ishte një hap drejt themelimit të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare.⁹⁶⁴

Arritja tjetër e rëndësishme e diasporës shqiptare në Amerikë ishte themelimi i Federatës Panshqiptare “Vatra”. Në kushtet e rritjes së numrit të shoqërive shqiptare në Amerikë vetëm bashkimi i tyre do ta ngrinte Lëvizjen Kombëtare në një nivel më të organizuar dhe do ta bënte atë më të dobishme. Idetë për bashkim i gjejmë që në fillim të vitit 1906.⁹⁶⁵ Ajo që filloi t’u bënte jehonë ideve ishte gazeta e parë shqiptare në Amerikë, “Kombi”, e cila nisi të botohej në qershor të vitit 1906, nga intelektual shqiptar Sotir Peci.⁹⁶⁶ U zhvilluan shumë mitingje dhe mbledhje, të cilat përgatitën terrenin për momentin final të bashkimit. 28 prill 1912, është data historike që shënoi bashkimin e diasporës shqiptare të Amerikës nën drejtimin e Federatës Vatra.⁹⁶⁷ Historia e Vatrës që nga krijimi dhe në vazhdim do të jetë histori e Shqipërisë sepse ajo në çdo moment jo vetëm që do të

⁹⁶⁰ Stefanaq Pollo, Kumtesë :Problemi i kishës ortodokse autoqefale shqiptare gjatë Rilindjes, botuar në përmbledhjen me kumtesa : 70vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, Tiranë, 1993, f.21-28.

⁹⁶¹ Shpëtim Sala, *Letra të panjohura të Fan Nolit (1906-1913)*, Shkodër: Botime Françeskane, 2008, f.70.

⁹⁶² Shpëtim Sala, *Letra të panjohura të Fan Nolit (1906-1913)*, Shkodër: Botime Françeskane, 2008, f.70.

⁹⁶³ Koço Bihuku, kumtesë:Themelimi i Kishës Ortodokse Kombëtare dhe roli i Nolit, botuar në përmbledhjen me kumtesa: 70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, Tiranë, 1993, f. 31.

⁹⁶⁴ Po aty,f.31.

⁹⁶⁵ Beqir Meta, *Federata Panshqiptare “Vatra”*, Tiranë: Globus, 2002, f.22.

⁹⁶⁶ Valentina Duka, Çështje të historisë bashkëkohore të shqiptarëve, Tiranë: SHBLU, 2008, f.24-31.

⁹⁶⁷ Beqir Meta, *Federata Panshqiptare “Vatra”*, Tiranë: Globus, 2002, f.26, Valentina Duka, *Çështje të historisë bashkëkohore të shqiptarëve*, Tiranë: SHBLU, 2008, f.71.

përjetojë ngjarjet në Shqipëri, por do të jetë aktive. Ajo: organizoi mitingje të mëdha, iu drejtua me nota proteste Fuqive të mëdha dhe dërgoi përfaqësues të saj në Evropë për të ndërgjegjësuar opinionin evropian për të drejtat e popullit shqiptar. Gjithashtu *Vatra* shprehu mendimin e saj në momentet historike me rëndësi për të ardhmen e Shqipërisë. Në tetor 1912, shtetet ballkanike (Greqia, Serbia, Mali i Zi dhe Bullgaria), i shpallën luftë Perandorisë Osmane. Fillimi i Luftës së Parë Ballkanike, fitoret e shpejta të ushtrive të aleatëve ballkanike mbi atë osmane dhe pushtimi i shumë territoreve shqiptare nga ushtritë e aleatëve ballkanikë nxorrën në pah dobësinë e Perandorisë Osmane dhe kërcënimin e viseve shqiptare nga coptimi. Në këtë situatë kritike për Shqipërinë, *Vatra* e sapo krijuar përpiqet të tërheqë vemendjen e Fuqive të mëdha dhe të SHBA për zgjidhjen e çështjes shqiptare. Më 17 nëntor 1912, ajo organizoi një miting të madh në Boston, ku kërkoi pavarësinë e Shqipërisë gjithashtu ajo u dërgoi telegram Fuqive të Mëdha dhe presidentit amerikan Taft, në të cilin kërkohet njohja e pavarësisë së Shqipërisë në kufinj të saj etnikë.⁹⁶⁸ Kërkesa e *Vatrës* drejtuar Amerikës për mbrojtjen e interesave të kombit shqiptar ishte mjaft e guximshme pasi politika izolacioniste e kohës e largonte Amerikën nga përzjerja me konfliktet evropiane, por njëkohësisht ajo ishte e "goditur" dhe mjaft largpamëse.

Me aktin e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912, shqiptarët i dolën përpara rrezikut të coptimit të vendit nga monarkitë ballkanike. Por vendimi përfundimtar për Shqipërinë do të merrej në tryezën diplomatike që do të mbledhet në fund të Luftës së Parë Ballkanike (është fjala për Konferencën e Ambasadorëve 1913). Nga kontaktet me qarqet diplomatike evropiane dhe praktika e ndjekur në Ballkan, *Vatra* ishte e bindur se me krijimin e shtetit të ri shqiptar, Evropa do ta vendoste atë nën kurorën e një mbreti.⁹⁶⁹ Në telegramin e urimit të *Vatrës* drejtuar Qeverisë së Përkohshme të formuar në Vlorë shkruhej: "*Federata Panshqiptare "Vatra" e Amerikës... i lutet mbledhjes së kombit të mos pranojë kandidaturën e një princi mohamedan. Mos e bëni Shqipërinë një mbretëri orientale... Ideali ynë është një Shqipëri evropiane..Prandaj duam më mirë një mbret nga një derë evropiane, i cili do të sjellë në Shqipëri traditën e Perëndimit.*"⁹⁷⁰ Shpallja e pavarësisë hapte prespektiva për të ardhmen e Shqipërisë. *Vatra* në emër të orientimit evropiano-perëndimor të Shqipërisë, i kërkoi Kuvendit Kombëtar të mospranonte kandidaturën e një princi mohamedan, por atë të një princi evropian. Një ngjarje tjetër që angazhoi "*Vatrën*" ishte Konferenca e Ambasadorëve,⁹⁷¹ e cila u mbledh në Londër më 17 dhjetor 1912, për të diskutuar problemet që dolën nga Lufta e Parë Ballkanike. Përfaqësuesi i *Vatrës*, F.Konica së bashku me përfaqësuesin e Kishës Shqiptare në Amerikë, F. Nolin u dërguan në Evropë, për të qënë më afër Konferencës dhe për të ndërgjegjësuar opinionin evropian për të drejtat e popullit shqiptar.⁹⁷² Gjithashtu *Vatra* organizoi shumë mitingje. Nga mitingu i 27 prillit 1913 në Boston, një nga mitingjet më të fuqishëm të organizuar nga *Vatra*, iu dërgua një notë proteste

⁹⁶⁸ Historia e popullit shqiptar, Vëll. III, Tiranë: Toena, 2007, f.514.

⁹⁶⁹ Beqir Meta, *Federata Panshqiptare "Vatra"*, Tiranë: Globus, 2002, f.91.

⁹⁷⁰ Valentina Duka, Çështje të historisë bashkëkohore të shqiptarëve, Tiranë: SHBLU, 2008, f. 82.

⁹⁷¹ Austro-Hungaria, Gjermania, Italia, Franca dhe Rusia u përfaqësuan nga ambasadorët e tyre në Londër ndërsa Anglia nga ministri i saj i Jashtëm Eduard Grey (Edward Grey).

⁹⁷² Valentina Duka, Çështje të historisë bashkëkohore të shqiptarëve, Tiranë: SHBLU, 2008, f. 86.

Fuqive të mëdha. Kjo notë proteste ishte kundër vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve, ishte firmosur nga 3000 shqiptarë.⁹⁷³

Në zbatim të vendimit të Konferencës së Ambasadorëve të 29 korrikut 1913,⁹⁷⁴ Fuqitë e Mëdha në nëntor të vitit 1913, emëruan gjermanin Vilhelm Vid (Wilhelm Wied) si princ të Shqipërisë. Kjo zgjedhje, e cila përkoi me dëshirën e Vatrës u mirëprit nga ajo. Përfaqësuesit e saj Faik Konica dhe Fan Noli ishin të pranishëm në pritjen që iu bë Vidit në Durrës më 7 mars 1914.⁹⁷⁵ Shpërthimi i kryengritjes së Shqipërisë së Mesme më 17 maj 1914,⁹⁷⁶ tre muaj pas ardhjes së Vidit dhe fillimi i Luftës së Parë Botërore në gusht 1914, krijuan një situatë të disfavorshe për të. I gjendur përballë një situatë të tillë dhe i mbetur pa mbështetjen e fuqive, të cilat e sollën në fronin shqiptar, Vidi më 3 shtator 1914, largohet nga Shqipëria. Vendi i mbetur pa qeverisje qendrore dhe pa kontrollin ndërkombëtar u kthye në një shesh lufte, duke u bërë kështu pre e Luftës së Parë Botërore. Kjo situatë alarmoi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në Amerikë e cila mori impulse të reja dhe bëri të gjitha përpjekjet për të sensibilizuar opinionin dhe qeverinë amerikane për të mbështetur Shqipërinë. F. Noli, në Konferencën e Kombeve të Robëruara të mbajtur në Uashington më tetor të vitit 1916, u bëri thirrje pjesmarrësve që të mbështetnin luftën e popullit shqiptar për kthimin e tokave të coptuara pa të drejtë në vitin 1913, në Konferencën e Ambasadorëve në Londër.⁹⁷⁷

Diaspora shqiptare në ShBA duke qënë pjesë e realitetit amerikan e njihte potencialin e kësaj fuqie, e përthithi e para situatën dhe më shumë se 3000 vullnetarë nga diaspora shqiptare u bënë pjesë e trupave ushtarake amerikane.⁹⁷⁸ Për shqiptarët e Amerikës ky angazhim ishte një shans historik për të shprehur mirënjohjen e tyre për mikpritjen amerikane si dhe për të fituar simpatinë e shtetit dhe opinionit amerikan, të cilën do ta shfrytëzonin në dobi të Shqipërisë. Sigurimin e mbështetjes amerikane ishte i nevojshme dhe i domosdoshme për Atdheun e tyre të vogël dhe pa mbështetje, por shumë të rrezikuar nga lakmia e fqinjëve ballkanikë dhe interesat e Fuqive të Mëdha të Evropës. Më 1918, mbaroi Lufta e Parë Botërore, por jo angazhimi i diasporës shqiptare në Amerikë në dobi të Atdheut. Madje ai do të rritet shumë pasi, Shqipëria vazhdonte të ishte e pushtuar dhe pa qeverisje qendrore. Ndërkohë Traktatit i fshehtë i Londrës i vitit 1915⁹⁷⁹ u dekonspirua nga bolshevikët dhe Konferenca e Paqes⁹⁸⁰ ishte në horizont.

⁹⁷³ Beqir Meta, *Federata Panshqiptare "Vatra"*, Tiranë: Globus, 2002, f.65, Historia e popullit shqiptar, Vëll. III, Tiranë: Toena, 2007, f. 515.

⁹⁷⁴ Më 29 nëntor 1913 Konferenca e Ambasadorëve morin vendimin përfundimtar për statusin e shtetit shqiptar. Me anë të këtij vendimi Shqipëria shpallej principatë autonome, sovraane dhe trashëgimore. Çdo lidhje varësie me Turqinë përjashtohet. Shqipëria shpallej shtet asnjëanës nën garancinë e Fuqive të Mëdha dhe shteti shqiptar vihej nën kontrollin kolektiv të tyre. Në krye të Shqipërisë do të qeveriste një princ i caktuar nga Fuqitë e Mëdha brenda 6 muajve. Qetësia dhe rendi public do të siguroheshin nga një xhandarmëri që do t'u besohej oficerëve të huaj.

⁹⁷⁵ Valentina Duka, Çështje të historisë bashkëkohore të shqiptarëve, Tiranë: SHBLU, 2008, f. 84.

⁹⁷⁶ Kryengritja e Shqipërisë së Mesme shpërtheu më 17 maj 1914. Forca kryesore e saj ishte fshatarësia. Në gjirin e kryengritjes pati disa rryma politike, por mbizotëroi ajo turkomanë. Këshilli I Përgjithshëm I kryengritjes miratoi një program politik, në të cilin kërkohej largimi i princ Vidit, futja e Shqipërisë nën administrimin turk, sjellja e një princi turk, shpallja e turqishtes gjuhë zyrtare, përdorimi e alfabetit turko-arab për gjuhën shqipe, zëvendësimi i flamurit me atë turk dhe zgjedhja e kryemyfitit të Shqipërisë nga Sheh-ul-Islami i Stambollit.

⁹⁷⁷ Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë: Kristalina-KH, 2007, 124.

⁹⁷⁸ Beqir Meta, *Federata Panshqiptare "Vatra"*, Tiranë: Globus, 2002, f. 139.

⁹⁷⁹ *Traktati i fshehtë i Londrës i nënshkruar midis Antantës dhe Italisë më 26 prill 1915*, parashikonte ndarjen e viseve shqiptare midis Italisë, Sërbisë, Greqisë dhe Malit të Zi.

⁹⁸⁰ Kjo Konferencë, e cila kishte për qëllim zgjidhjen e problemeve që solli konflikti botëror mblodhi fuqitë fituese të Bllokut të Antantës në Paris më 18 janar 1919. Rolin kryesor në marrjen e vendimeve e kishte Këshilli i të Katërve që

JETA PARLAMENTARE GJATË VITEVE TË MONARKISË SHQIPTARE (1928-1939)

Prof.As.Dr.Nertila Haxhia Ljarja
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
email:nertila71@gmail.com

Abstrakt

Viti 1928 është viti kur Ahmet Bej Zogu, Presidenti i Republikës së Shqipërisë e shndërroi Republikën në Monarki dhe veten e shpalli Mbreti i Shqiptarëve. Mbreti Zogu i I duhej të krijonte një administratë të re, të pa korruptueshme dhe t'u nguliste zyrtarëve të tij ndjenjën e ndershmërisë dhe efektivitetit, të cilat ishin krejtësisht të huaja për brezin e atëhershëm të shqiptarëve. Atij iu desh gjithashtu që kushtetutën e tij ta zhvendoste në binarët e demokracisë dhe parlamentarizmit. Në fakt, vetë regjimi i tij i shpall këto dy koncepte si shtyllat e regjimit, por që në të vërtetë, ky regjim nuk zotëronte në vitin 1928 akoma as demokraci dhe as parlamentarizëm. Ndryshimi i regjimit nuk solli ndonjë ndryshim dhe përmirësim të madh të jetës parlamentare. Shqipëria nën Mbretëri ruajti shumë ngjashmëri me atë nën Republikë: një autokraci e kamufluar keq që përpiquej të fitonte popullaritet.

Fjalë kyçe: Monarki, fushatë zgjedhore, Asamble Kushtetuese,statut.

Me nënshkrimin e dy marrëveshjeve me Italinë dhe me fuqizimin e pushtetit të Ahmet Zogut gjendja politike në Shqipëri dukej më e qëndrueshme. Ideja për një Shqipëri monarkike, një sistem më tradicional se republika për shqiptarët, ishte hedhur që në vitin 1925 nga disa deputetë, por pavarësisht dëshirës së Ahmet Zogut për të qenë mbret i shqiptarëve, ai e shihte se ishte herët për diçka të tillë. Ahmet Zogu sapo kishte marrë pushtetin nëpërmjet një puçi dhe kundërshtarët e tij politikë ishin akoma aktivë. Edhe Fuqitë e Mëdha nuk do të ishin të gatshme të njihnin monarkinë në atë kohë. Për këtë arsye Ahmet Zogut iu desh një periudhë kalimtare republikane, që të përgatiste situatën e brendshme, nëpërmjet përqendrimit të pushtetit në duart e tij.

Shtypi, qarqet politike dhe zyrtarë filluan një propogantë ku lartësonin figurën e Ahmet Zogut dhe vlerësonin veprimtarinë e tij në shërbim të kombit. Ato arritën deri aty sa sajuan edhe një farë lidhje gjaku të tij me heroin kombëtar shqiptar, Skënderbeun (e vetmja gjë e përbashkët e tyre ishte se vinin nga e njëjta krahinë, nga Mati). I sajuar ishte

përbëhej nga kryeministri i Francës Klemanso, i cili ishte dhe kryetar i Konferencës, kryeministri i Britanisë Lloid Xhorxh, kryeministri i Italisë V. Orlando dhe presidenti i SHBA Uillson.

edhe skenari që në Parlamentin shqiptar vinin letra nga populli i cili nuk e donte formën e qeverisjes së deritanishme që ishte e huaj për traditën shqiptare.⁹⁸¹

Ndërsa për sa i përket qëndrimit të shteteve europiane, rreth këtij ndryshimi, Italia ishte e interesuar për mbretërinë, për të realizuar planet e saj aneksuese ndaj Shqipërisë. Po kështu pas shumë përpjekjeve, Ahmet Zogu arriti të bindte edhe diplomacinë angleze dhe atë europiane në përgjithësi, për ndryshimin e formës së qeverisjes shqiptare në monarki.

Tashmë Ahmet Zogut i kishte mbetur vetëm pregatitja e rrugës ligjore. Pikënisje ishte mesazhi që ai i dërgon më 1 qershor 1928 Dhomës së Deputetëve dhe Senatit, nëpërmjet të cilit i kërkon këtyre dy dhomave të rishikonin Statutin. Argumentet e Ahmet Zogut për nevojën e rishikimit të Statutit kishin të bënin me disa mangësi në lidhje me disa probleme të organizimit shtetëror, si p.sh. ishin lënë në hije institucioni i kryeministrit dhe mungonin referencat për ekzistencën e Këshillit të Shtetit dhe disa organizmave të tjerë të krijuar gjatë ekzistencës së republikës⁹⁸². Pra, ishte e nevojshme një mbledhje e përbashkët e dy dhomave për të bërë ndryshimet e nevojshme në Statut. Ndërkohë shtypi shqiptar kishte filluar të vinte në dukje me të madhe mosvarrëveshjet që ekzistonin mes Senatit dhe Dhomës së Deputetëve në lidhje me Këshillin e Shtetit.⁹⁸³ Mbledhja u zhvillua më 6 qershor dhe në të përveç diskutimeve rreth mangësive u kërkuar një rishikim i tërësishëm i sistemit shtetëror. Në këtë mbledhje u miratua dhe shtesa e Nenit 141: "*Rishikimi i përgjithshëm i Statutit i përket Asamblesë Kushtetuese. Kur vendoset nevoja e rishikimit të përgjithshëm të Statutit, simbas procedurës të caktueme në këtë nen, të dy dhomat quben vetiu të shpërndame dhe dekreteton zgjedhje për Asamblenë Kushtetuese, simbas nenit 47 të Statutit*"⁹⁸⁴. Në mbledhje u vendos zbatimi i menjëhershëm i kësaj shtese, kështu që dy dhomat u vetëshpërndanë dhe të nesërmen Ahmet Zogu shpalli dekretin për zgjedhjen e përfaqësuesve në Asamblenë Kushtetuese.⁹⁸⁵

Zgjedhjet u zhvilluan më 17 gusht 1928. Fushata zgjedhore u zhvillua e qetë, megjithëse zgjedhjet ishin krejtësisht formale, pasi nuk kishte parti rivale dhe kishte vetëm një listë kandidatësh. Asambleja vazhdoi të kishte 57 deputetë, ku secili zgjidhej për çdo 15.000 banorë, si më përpara. Zgjedhjet vazhdonin si më përpara, të bëheshin në dy faza. Në fazën e parë çdo qendër banimi përcaktonte përfaqësuesit për zgjedhjet e fazës së dytë. Disa ditë pas këtyre zgjedhjeve, të zgjedhurit e fazës së parë mbidheshin në Prefekturat e qarqeve për të zgjedhur deputetët që do t'i përfaqësonin në Parlament. Megjithëse sipas ligjit çdo shtetas shqiptar që plotësonte kushtet ligjore mund të kandidohej, praktikisht kjo ishte e përaulizueshme. Pasi që në fazën e përzgjedhjes së

⁹⁸¹ "Ambasadori fuqiplotë britanik raportonte se këto telegrame të panumërta dërgoheshin prej fshatarësh që arrestoheshin e mbareshin në burgjet lokale deri sa të pranonin të vendosnin gishtin mbi peticionet që kërkonin shpalljen e mbretërisë. E njëjta taktikë u përdor edhe për të siguruar pëlqimin e bajraktarëve katolikë të Veriut, të cilëve nuk u pëlqente aspak ideja e një mbreti mysliman. Bajraktarët u ftuan në Shkodër ku u mbajtën disa ditë gati si të burgosur e iu kërkuar të vinin shenjat e gishtit mbi dokumente të padëshifrueshme për ta ku, më pas, doli se ato ishin peticione që kërkonin shpalljen e presidentit mbret." Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*. Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2007, fq.177.

⁹⁸² Afrim Krasniqi, *Sistemet politike në Shqipëri 1912-2008*. Shtëpia Botuese UFO Press, Tiranë, mars 2009, fq.128.

⁹⁸³ Cit. nga Kastriot Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar, 1912-2005*, Shtëpia Botuese 55, Tiranë, 2006, fq.273.

⁹⁸⁴ Kastriot Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar, 1912-2005*, Shtëpia Botuese 55, Tiranë, 2006, fq.273.

⁹⁸⁵ Grup autorësh, *Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri* (Botimi III). Shtypshkronja universitare "Luarasi", Tiranë 2005, fq.374.

dytë, prefektët dhe kryetarët e bashkive kujdeseshin që të zgjidhnin persona të parapëlqyer nga qeveria.

Megjithëse jo në përmasat e partive të vërteta politike të demokracive liberale, gjatë veprimtarisë së parlamentit, do të shfaqen grupe të ndryshme si: "Të Vjetrit" me një pozitë solide dhe "Të Rinjtë", me disa karakteristika të një opozite parlamentare. Grupet brenda parlamentit krijoheshin edhe për interesa të rastit, si p.sh. "republikanët" dhe "monarkistët", grupe që u krijuan në lidhje me qëndrimin ndaj formës së qeverisjes etj. Faktikisht, ashtu si në parlamentin republikan, edhe në atë monarkik, nuk u ndje asnjëherë zëri i asnjë grupi të fuqishëm opozitar, aq më tepër këto parlamente nuk u karakterizuan nga fryma e pluralizmit politik.

Më 25 gusht 1928 në Tiranë u mbledh Asambleja Kushtetuese për të vendosur formën e regjimit dhe u bë ajo që pritej të ndodhte. Drejtues i përkohshëm i saj u zgjodh Pandeli Evangjeli dhe në mbledhjen e datës 27 gusht ai njoftoi për rendin e ditës që kishte të bënte me rishikimin e statutit. Ndërsa në mbledhjen e datës 29 gusht i pari që e mori fjalën ishte deputeti Abdurrahman Dibra, i cili kërkoi që Shqipëri të kthehej në mbretëri me mbret Ahmet Zogun. Shumë deputetë e përkrahën propozimin e tij, kështu që u krijuas një komision i posaçëm për këtë çështje. Më 1 shtator 1928 Asambleja vendosi unanimisht shpalljen e Monarkisë. Fillimisht Asamblea votoi për formën e re të regjimit dhe më pas u kalua në votimin nen për nen të statutit të ri. Sipas Nenit 1 të Statutit Themeltar të Mbretërisë Shqiptare⁹⁸⁶, Shqipëria u shpall "*Mbretëri demokratike, parlamentare dhe e trashëgueshme*", ndërsa Ahmet Zogu "*Mbret i Shqiptarëve*" me emrin Zogu I⁹⁸⁷.

Viti 1928 është viti kur Ahmet Bej Zogu, Presidenti i Republikës së Shqipërisë e shndërroi Republikën në Monarki dhe veten e shpalli Mbreti i Shqiptarëve⁹⁸⁸. Italia ishte shteti i parë që e njohu menjëherë ndryshimin e statusit të Shqipërisë. Traktati i Tiranës me Italinë i garantoj atij, jo vetëm imunitet nga çdo agresion i jashtëm, por edhe mbajtjen e një *status – quo* – je të situatës së brendshme nën drejtimin e tij. Mbreti Zogu I duhej të krijonte një administratë të re, të pa korruptueshme dhe t'u nguliste zyrtarëve të tij ndjenjën e ndershmërisë dhe efektivitetit, të cilat ishin krejtësisht të huaja për brezin e atëhershëm të shqiptarëve. Atij iu desh gjithashtu që kushtetutën e tij ta zhvendoste në binarët e demokracisë dhe parlamentarizmit. Në fakt, vetë regjimi i tij i shpall këto dy koncepte si shtyllat e regjimit, por që në të vërtetë, ky regjim nuk zotëronte në vitin 1928 akoma as demokraci dhe as parlamentarizëm. Deputetët e vitit 1928 ishin të njëjtët që votuan në Asamblenë Kushtetuese në Korrik të 1928 dhe për ndryshimin e formës së regjimit. Ministrat mbetën po ata dhe merita e tyre e vetme ishte ajo e mbështetjes pa rezerva nga ana e tyre e ndryshimit të regjimit nga Republikë në Mbretëri. Për sa i përket Këshillit të Shtetit, i cili zëvendësoi Senatin, mund të thuhet se pushteti i tij ishte mjaft i kufizuar. Si përfundim, ndryshimi i regjimit nuk solli ndonjë ndryshim dhe përmirësim të madh të jetës parlamentare. Shqipëria nën Mbretëri ruajti

⁹⁸⁶ Statuti themeltar i Mbretërisë Shqiptare, Tiranë 1929.

⁹⁸⁷ Arben Puto, *Shqipëria politike, 1912-1939*, Botimet Toena, Tiranë, 2009, fq.448.

⁹⁸⁸ "Pasditën e asaj date të shënuar, mbreti i ri u shoqërua në godinën e parlamentit ..., dhe atje bëri betimin e mëposhtëm ndaj kushtetutës së rishikuar: "Unë, Zogu, Mbret i Shqiptarëve, me rastin e hipjes në fronin e Mbretërisë së Shqipërisë dhe duke marrë në duart e mia pushtetin mbretëror, betohem përpara Zotit të Gjithëfuqishëm të ruaj bashkimin kombëtar, pavarësinë dhe tërësinë territoriale të shtetit. Unë do t'i përmabhem besnikërisht Kushtetutës dhe do të veproj në përputhje me dispozitat e saj dhe të ligjit në fuqi, duke mbajtur gjithmonë para syve të mi vullnetin e popullit. Zoti më ndihmoftë!"

Joseph Swire, Shqipëria. Ngritja e një mbretërie, Dituria, Tiranë, 2005, fq.407.

shumë ngjashmëri me atë nën Republikë: një autokraci e kamufluar keq që përpiquej të fitonte popullaritet. Kohë pas kohe Mbreti u dërgonte Ministrave të tij mesazhe, të cilët përmbanin parime jo fort të qarta në kuptimin se si duhet të drejtonin dhe të qeverisnin ata nëpër dikasteret e tyre. E gjithë kjo tendencë mund të përkthehet si një tendencë për të forcuar centralizimin. Mbreti u tregua më se i vendosur të mbante fort frenat e pushtetit në duart e tij. Nga izolimi i tij në Pallat ai do të kontrollojë vazhdimisht çdo lloj situatë që krijohet.⁹⁸⁹

Sipas studiuesit F.Gjilani “Emërtimi “Mbretin Demokratike Parlamentare” që i u dha shtetit me nenin 1 të këtij statuti, shpreh pa dyshim synimin për ta paraqitur atë si një regjim demokratik. Në të vërtetë, të drejtat dhe kompetencat jashtëzakonisht të gjëra që ky Statut i njihje mbretit, gjithë dispozitat e tij mbi mënyrën e ndërtimit, të veprimtarisë dhe të shpërndarjes së parlamentit, si dhe mungesa e çdo lloj garancie për respektimin e atyre të drejtave fare të pakta të shtetasve, që ai shpallte formalisht, heqin çdo mundësi, edhe në vështrimin thjesht juridiko-formal, për ta karakterizuar mbretërinë e Zogut si një monarki demokratiko-parlamentare”⁹⁹⁰.

Më 1 dhjetor 1928, Asambleja Kushtetuese miratoi Statutin Themeltar të Mbretërisë Shqiptare⁹⁹¹ dhe në të njëjtën ditë u transformua në një Dhomë Deputetësh, parlament, duke modifikuar në këtë mënyrë edhe përgjegjësitë e saj para zgjedhësve. Tashmë parlamenti që do të kishte pushtetin legjislativ, do të funksiononte vetëm me një dhomë. Ahmet Zogu kishte përqendruar në duart e veta të gjithë pushtetin, kështu që Dhoma e Lartë (Senati) nuk ishte e nevojshme, për më tepër do të ishte një pengesë në politikën e tij. Pas miratimit të Statutit Themeltar të Mbretërisë Shqiptare, Parlamenti filloi punimet më 10 dhjetor 1928. Në mbledhjen e parë të sesionit të parë u zgjodh kryesia e re dhe komisionet e përhershme të tij si: i Buxhetit, Ekonomisë Kombëtare, Drejtësisë, Arsimit, Financave, Ushtrisë dhe Xhandarmërisë, Punëve të Brendshme, Punëve të Jashtme dhe e Lutjeve.⁹⁹² Përsa i përket zgjedhjes së anëtarëve të Dhomës së Deputetëve, të cilët zgjidheshin një herë në katër vjet, Statuti i Mbretërisë nuk pati ndryshime të dukshme krahasuar me Statutin e mëparshëm.

Parlamentit shqiptar në vitet e monarkisë (1928-1939) mbeti gjatë gjithë periudhës një organ dytësor, pasiv dhe thjesht një mbulesë e pushtetit absolut të Ahmet Zogut. Veprimtaria e tij në fushën legjislativë karakterizohej nga formaliteti dhe detyrë kryesore ishte miratimi i projektligjeve dhe projektbuxheteve vjetore që hartoheshin nga mbreti. Gjithashtu çdo ligj që miratonte parlamenti nuk hynte në fuqi pa u miratuar nga mbreti, pasi ky i fundit kishte kompetencat të ushtronte *veto* absolute ndaj vendimeve. Në fillim të çdo sesioni parlamentar Mbreti i drejtonte një mesazh parlamentit, i cili lexohej nga kryeministri. Në fund të këtij mesazhi parlamenti duhet të përgatiste përgjigjen për mbretin.

Një nga detyrat më të rëndësishme të parlamentit ishte kontrolli ndaj organeve ekzekutive, që sipas Statutit të Mbretërisë parashikonte: pyetje, interpelancë dhe anketim (Neni 47). Procedura e hartimit të pyetjeve dhe zhvillimit të interpelancës bëhej

⁹⁸⁹ PRO.FO. 371 13560, Annual Report 1928

⁹⁹⁰ Grup autorësh, *Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri* (Botimi III). Shtypshkronja universitare “Luarasi”, Tiranë 2005, fq.374-375.

⁹⁹¹ Për më tepër shih: Kastriot Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar, 1912-2005*, Shtëpia Botuese 55, Tiranë, 2006, fq.279-281

⁹⁹² Cit. nga: Kastriot Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar, 1912-2005*, Shtëpia Botuese 55, Tiranë, 2006, fq.278.

nëpërmjet një rregulloreje të brendshme të parlamentit⁹⁹³. Parlamenti kishte të drejtë të akuzonte ministrat për tradhti të lartë ose krime të tjera që parashikonte ligji për veprimtarinë e ministrave. Me një shumicë prej 3/5 e votave parlamenti i dërgonte ministrat e akuzuar para Gjyqit të Lartë të Shtetit.

Në Statut përcaktoheshin detyrat, përgjegjësitë dhe të drejtat e parlamentit. Tashmë ai do të mblidhej brenda vitit në një kohë më të shkurtër se më përpara, vetëm në një sesion të rregullt për një periudhë 5 mujore, nga 15 tetori deri më 15 mars të vitit në vazhdim. Parlamenti nuk mund të shpërndahej pa miratuar buxhetin e vitit pasardhës. Ky rregull ishte për sesionet e zakonshme, por mbreti mund të thërrasë parlamentin në sesione të jashtëzakonshme. Për çdo sesion zgjidhej kryesia e përbërë nga kryetari, nënkryetari dhe anëtarët e kryesisë. Parlamenti hartonte rregulloren e tij të brendshme ("Rregullorja e Mbrendshme e Parlamentit" e vitit 1931⁹⁹⁴), mblidhjet mbaheshin të hapura dhe miratimi i ligjeve bëhej në parim në mbledhjen e përgjithshme të Parlamentit pastaj shqyrtoheshin nen për nen në tre ditë të ndryshme. Ligjet që nuk miratoheshin nuk mund të rishqyrtoheshin brenda të njëjtit sesion. Sipas rregullores votimi i ligjeve bëhej me votim të hapur (me ngritje dore); me thirrje emrash (kur këtë e kërkonin 10 deputetë); me votim të fshehtë. Si më përpara, në parlamentin republikan, brenda parlamentit puna ishte e ndarë në komisione.

Për sa i përket kritereve të zgjedhjes së deputetëve, Statuti i Monarkisë nuk kishte ndryshime të rëndësishme në krahasim me të më përparshmin. Po kështu pak a shumë të njëjta ishin edhe kufizimet që kishin të bëjnë me angazhimin e tyre në organizma të tjerë zyrtar apo fetar. "*Deputetëve nuk u lejohej të merrnin në përdorim apo pronësi pasuri të paluajtshme të shtetit apo të marrë provizione ushtarake ose punë botore... Ata gëzonin imunitet për mendimet e tyre, ndaj ndjekjeve apo arrestimeve nga organet e drejtësisë.*"⁹⁹⁵

Në kapitullin VIII të Statutit themeltar të Mbretërisë Shqiptare parashikohej procedura për shtesa dhe ndryshime të tij, përveç neneve 1, 2, 6, 50, 51, 52, 70 që nuk lejoheshin të rishikoheshin (Neni 224). Këto kishin të bënin me formën e qeverisjes, me pavarësinë, pandashmërinë dhe patjetërsueshmërinë e territorit të shtetit shqiptar, me pabashkueshmërinë e fronit mbretëror shqiptar me fronin e një tjetër mbretërie etj. Të gjitha rishikimet e Statutit vendoseshin nga parlamenti dhe pastaj sanksionoheshin nga mbreti. Nëse mbreti nuk ishte dakord me ndryshimet duhet t'ia kthente parlamentit brenda 15 ditëve për rishqyrtim. E nëse parlamenti ishte i vendosur në mendimin e tij fillestar atëherë ai automatikisht ishte i shpërndarë. Pra, shihej qartë formaliteti i funksionit të parlamentit edhe në këtë drejtim. Vendimi i parlamentit të ri, në këtë rast, ishte përfundimtar dhe shpallej nga mbreti.

Kur $\frac{3}{4}$ e deputetëve kërkonin rishikimin e përgjithshëm të Statutit, duke përfshirë edhe nenet e që ishin shpallur të pandryshueshëm, parlamenti vetëshpërndahej dhe zhvilloheshin zgjedhje të reja. Parlamenti i ri ose "asambleja e rishikimit", që zgjidhej për këtë qëllim, kishte dyfishin e anëtarëve të Parlamentit të mëparshëm.⁹⁹⁶

⁹⁹³ Për më tepër shih:

Aurela Anastasi, *Institucionet politike dhe e drejta kushtetuese në Shqipëri*. Shtëpia Botuese "Luarasi", Tiranë, 1998, fq.172.

⁹⁹⁴ Aurela Anastasi, *Institucionet politike dhe e drejta kushtetuese në Shqipëri*. Shtëpia Botuese "Luarasi", Tiranë, 1998, fq.173-174.

⁹⁹⁵ Afrim Krasniqi, *Sistemet politike në Shqipëri 1912-2008*. Shtëpia Botuese UFO Press, Tiranë, mars 2009, fq.138.

⁹⁹⁶ Aurela Anastasi, *Institucionet politike dhe e drejta kushtetuese në Shqipëri*. Shtëpia Botuese "Luarasi", Tiranë, 1998, fq.175.

Kuadri institucional njihet përveç Këshillit Ministror edhe dy organe të nivelit të lartë: 1. *Këshillin Kontrollues* që kontrollonte financat dhe përbëhej nga një kryetar dhe dy anëtar (nenet 153-159); 2. *Këshillin e Shtetit* për të cilin në Statutin themeltar të Mbretërisë Shqiptare (nenet 160-168), u hartua një kapitull i posaçëm për funksionimin e Këshillit të Shtetit, institucion ky që ndeshet për herë të parë në historinë e shtetit shqiptar.⁹⁹⁷ “*Këshilli i shtetit ishte organ tekniko-juridik për përgatitjen e akteve normative më të rëndësishme, organ këshillimor juridiko-ekonomik e njëkohësisht një gjykatë e lartë administrative.*”⁹⁹⁸

Këshilli i Shtetit, nuk u krijua deri në fillim të 1929. Ai përbëhej nga 10 anëtarë dhe dy deputetë të emëruar prej Mbretit me propozim nga kryeministri, kryetarit të Dhomës së Deputetëve dhe Ministrin të Drejtësisë, për një periudhë 7 vjeçare dhe kishin imunitet ashtu si deputetët. Kryetari emërohej me dekret të posaçëm shtetëror dhe shkarkohej nga mbreti.

Këshilli Shtetëror ndahej në seksione: në seksionin e drejtësisë, në seksionin e administratës dhe në seksionin e financës, ekonomisë dhe komunikacioneve. Detyrat e tij ishin krejtësisht konsultative:

- (a) Në përgatitjen e kodeve;
- (b) Përgatitjen dhe kontrollin e të gjithë projekt – ligjeve.
- (c) Jepte opinione për koncesionet dhe konventat.
- (d) Kryente detyra të veçanta që i ngarkoheshin nga ligjet speciale të Shtetit.⁹⁹⁹

Seksioni i administratës vepronte si Gjykatë e Lartë administrative që i jepte zgjidhje të prerë çdo konflikti dhe juridiksioni mes ministrive ose institucioneve të tjera të larta shtetërore. Ndërsa seksioni i financës dhe ekonomisë i jepte mendime ministrisë ose qeverisë brenda një afati të caktuar rreth problemeve të fushave përkatëse.

Gjatë gjithë ekzistencës së tij, ky Këshill, kreu një sërë detyrash të rëndësishme: hartoi kode e projektligje, mbledhi të gjithë legjislacionin e Mbretërisë Shqiptare në mënyrë kronologjike, bëri interpretime të ndryshme ligjore etj. “*Në këtë mënyrë Këshilli i Shtetit paraqitet në formën e Gjykatës së sotme Kushtetuese, por edhe të një organi ligjëbërës dhe kodifikues të të gjithë legjislacionit në vend.*”¹⁰⁰⁰

Në gusht (për zgjedhësit e parë) dhe nëntor 1932 (për zgjedhësit e dytë) u zhvilluan zgjedhjet parlamentare. Për çdo kandidat për deputet votuan rreth 500 zgjedhës të dytë. Fushata u zhvillua e ashpër nga disa kandidatë dhe grupe konkurruese në të gjithë vendin. Kryeministri Evangjeli i bëri thirrje popullit që të tregonte vullnetin e vet të lirë, pasi me këto zgjedhje hapej një periudhë e re për popullin shqiptar. Parlamenti i ri filloi punimet më 21 nëntor 1932, ku mbreti mbajti fjalën e hapjes duke folur për gjendejen dhe problemet e përgjithshme të vendit. Ai zhvilloi 4 sesione deri më 28 prill 1936 dhe një sesion plotësues, në periudhën 15 tetor-10 nëntor 1936, me 11 mbledhje.¹⁰⁰¹

Komisionet e përhershme të tij ishin: i Buxhetit, Ekonomisë Kombëtare, Drejtësisë, Arsimit, Financave dhe Llogarive të Parlamentit, Ushtrisë dhe Xhandarmërisë,

⁹⁹⁷ Arben Puto, *Shqipëria politike, 1912-1939*, Botimet Toena, Tiranë, 2009, fq.452.

⁹⁹⁸ Grup autorësh, *Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri* (Botimi III). Shtypshkronja universitare “Luarasi”, Tiranë 2005, fq.380.

⁹⁹⁹ PRO.FO. 371 13560, Annual Report 1928.

¹⁰⁰⁰ Afrim Krasniqi, *Sistemet politike në Shqipëri 1912-2008*. Shtëpia Botuese UFO Press, Tiranë, mars 2009, fq.142.

¹⁰⁰¹ Kastriot Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar, 1912-2005*. Shtëpia Botuese 55, Tiranë, 2006, fq.331-332.

Administratës, Punëve Botore dhe Portë-Telefonave, Punëve të Brendshme, Punëve të Jashtme, Lutjeve e Ankimeve.¹⁰⁰²

Vitet e Mbretërisë zogiste u karakterizuar në vazhdimësi nga një sërë krizash qeveritare dhe parlamentare. Në periudhën e Monarkisë shqiptare nuk kishte parti qeveritare, pasi nuk kishte dhe nuk lejohej ekzistenca e partive. Në zgjedhje nuk merrnin pjesë parti politike, dhe deputetët e Parlamentit zgjidheshin nga lista elektorale e kandidatëve zyrtarë dhe ndonjë kandidat i pavarur. Gjatë viteve 1930, brenda qeverisë dhe parlamentit kishte vetëm dy linja konkurrese, ajo e liberale e grupit të politikanëve të rinj dhe ajo konservatore e politikanëve të vjetër.¹⁰⁰³

Në përgjithësi të gjitha qeveritë edhe pse të krijuara nga mbështetësit e Ahmet Zogut ishin të pasukseshme në qeverisjen e vendit (në disa raste përbërja e qeverive ndikohej edhe nga shtetet e huaja, sidomos nga Italia që ishte e interesuar për interesat e veta). Mes disa qeverive që u ndërruan në këtë periudhë më jetëgjata, që u ka rezistuar më tepër kontradiktave të brendshme politike, ishte ajo me kryeministër Pandeli Vangjeli (mes viteve 1933-1935). Ndërsa qeveria më e njohur dhe më liberalja e demokratikja ishte ajo e kryesuar nga Mehdi Frashëri (21 tetor 1935-9 shtator 1936). Disa nga anëtarët e kësaj qeverie ishin të rinj, intelektualë nga të cilët katër kishin kryer studimet në Gjermani. Kjo qeveri paraqiti një program reformash në administratë, xhandarmëri, premtoi liri shtypi dhe masa të rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror. Por, natyrisht, që kjo qeveri do të ishte në shënjestër të përkrahësve më fanatikë të mbretit. "*Rrëzimi i qeverisë Frashëri më 1936 përbën një rast studimi në marrëdhëniet qeveri-parlament.*"¹⁰⁰⁴ Më 6 nëntor lindi një konflikt politik mes kryeministrit dhe parlamentit. Parlamenti nëpërmjet procedurës teknike kaloi një vendim qeveritar që kundërshtoj nga kryeministri. Për këtë arsye kryeministri kërkoi votëbesimin e parlamentit për të kuptuar se sa mbështetet qeveria e tij nga ky i fundit dhe si rrjedhojë nga mbreti. Qeveria Frashëri u rrëzua pas këtij votimi mosbesimi, ku 36 deputetë votuan kundër, 3 e mbështetën dhe 3 abstenuan. Pas kësaj ngjarjeje, më 7 nëntor u krijua përsëri qeveria e Koço Kotës, që shënoi një rikthim në pushtet të të vjetërve, konservatorëve, mbështetës të mbretit.¹⁰⁰⁵

Zgjedhjet e fundit parlamentare për periudhën e monarkisë përfunduan më 31 janar 1937. Rezultatet ishin pothuajse të njëjta me zgjedhjet parlamentare të mëparshme. Nga këto zgjedhje fitoi dukshëm lista e kandidatëve proqeveritarë. Nuk kishte asnjë mundësi zgjedhjeje pasi mungonin partitë politike, nuk kishte kandidatë të opozitës dhe për të siguruar rezultatin mobilizoj edhe xhandarmëria. Kjo ishte rezultat i politikës së ndjekur nga Zogu që të mos kishte kundërshtime në mënyrën e vet të qeverisjes. Parlamenti filloi punimet më 10 shkurt 1937 me fjalën e Mbretit Zog drejtuar deputetëve rreth situatës së vështirë të krijuar nga kriza dhe kërkoi nga të gjithë shtresat e popullit që të jepnin ndihmën e tyre në çdo sektor të ekonomisë, administratës, kulturës etj. për realizimin e reformave dhe përparimin e vendit. Punimet e këtij parlamenti u bënë në tre sesione.

¹⁰⁰² Bisedime Parlamentare

¹⁰⁰³ Afrim Krasniqi, *Sistemet politike në Shqipëri 1912-2008*. Shtëpia Botuese UFO Press, Tiranë, mars 2009, fq.143-144.

¹⁰⁰⁴ Afrim Krasniqi, *Sistemet politike në Shqipëri 1912-2008*. Shtëpia Botuese UFO Press, Tiranë, mars 2009, fq.148.

¹⁰⁰⁵ Për më tepër shih:

-Afrim Krasniqi, *Sistemet politike në Shqipëri 1912-2008*. Shtëpia Botuese UFO Press, Tiranë, mars 2009, fq.143-149.

- Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*. Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2007, fq.194-197.

POLITIKA ITALIANE NDAJ ÇËSHTJES SHQIPTARE 1897-1912

Niko Ferro

Abstrakt:

Ky dokument synon të analizojë perceptimin e lëvizjeve irredentiste italiane dhe ndikimin që patën ato në rajonin e Ballkanit. Qëndrimin që mbajti Austro-Hungaria përball kërkesave të irredentistëve italian.

Si lindën lëvizjet irredentiste?

Me firmosje të paqes në Vjenë në vitin 1866, dhe paqartësia e marrëveshjeve fillestare të nënshkruara me Prusinë, sollën një situatë në të cilën Italisë iu desh të “mohonte” aspiratat e saj territoriale për Trentinon dhe Histrian. Por mbi të gjitha ajo që nxiti më shumë këto lëvizje ishte fundi i luftës e cila zhgënjeu në një masë të gjerë opinionin publikë italian. Pavarësisht këtyre fakteve qeveria dhe populli italian shpresuan se herët a vonë tokat irredentiste do i bashkoheshin një ditë Italisë qoftë kjo edhe nëpërmjet marrëveshjeve paqësore. Por në përballje të kërcënimit austriak, Italisë iu desh të hiqte dorë nga këto kërkesa, gjë për të cilën ajo ishte e vendosur të luftonte deri në fund. Në këtë periudhë qëndrimi zyrtar i Italisë ishte për ruajtjen e marrëdhënieve të mira me aleatët. Në fakt ky qëndrim i Italisë ndikohej më shumë me situatën e Ballkanit dhe shqetësimin se Austro-Hungaria “pa dëshirën e saj” të tërhiqej nga zhvillimi i ngjarjeve dhe të ndërhynte aty me armë. *Jo-zyrtarishtë* nga ana tjetër Italia në fshehtësi vepronte për të rritur influencën në tokat irredentiste.

Fjalët kyçe: Irredentizmi, Italia, Lidhja Tripalëshe, Austro Hungaria, çështja shqiptare, arbëreshët, grekët etj.

Perceptimi i “irredentizmit italian”

Çfarë është irredentizmi?

Termi irredentizëm tregon dëshirën e një populli për të përfunduar bashkimin e tij kombëtar dhe territorial; përvetësimin e tokave të cilat janë subjekt i një sundimi të huaj, e mbështetur kjo në identitetin etnik ose të një lidhjeje të mëparshme historike.

Fjala “irredentizëm” u përdor për herë të parë në vitin 1877 nga Mateo Imbriani themelues i “*Shoqërisë Pro Italia Irredenta*”, që prej atëherë kjo fjalë është përcaktuese e popullsisë të cilat flasin gjuhën italiane dhe që kishin ngelur nën sundimin e huaj.

Origjina e tij

Viti 1866, shënon fillimin e demonstrimeve të irredentistëve italian e pasuar kjo me protesta, me incidente diplomatike, inate dhe tone nga më të egërit, të cilat vazhduan pa ndërprerje deri në fund të vitit 1914.

Këto lëvizje lindën si pasojë e paqartësisë të marrëveshjeve fillestare të nënshkruara me Prusinë, ku në të cilën Italisë iu desh të “mohonte” aspiratat e saj territoriale për Trentinon dhe Histrian, por mbi të gjitha ajo që nxiti më shumë këto lëvizje ishte fundi i

luftës e cila zhgënjeu në një masë të gjerë opinionin publikë italian. Që nga ajo kohë Austria filloj një seri të gjatë kontestimesh, presionesh diplomatike, si e si për të detyruar qeverinë italiane të mbyste këto lëvizje që sipas saj cenonin integritetin territorial të saj. Në një shkresë zyrtare drejtuar Qeverisë italiane, e cila përmbante në thelb qëndrimin që duhet të mbante Italia, përballë kërkesës së popullsisë italiane që banonin në pjesën lindore të Adriatikut, thuhej:

“Italia duhet të heq dorë dhe të përjashtoj absolutisht kërkesën e saj për aneksime të popullsisë që flasin italisht sepse kjo do të sillte rrjedhimisht në popujt e Perandorisë Austro-Hungareze të drejtën për tu shkëputur dhe se kjo ishte shumë e rrezikshme për mbajtjen e paqes në Evropë”.¹⁰⁰⁶

Me ardhjen e së majtës italiane në pushtet në vitin 1876, marrëdhëniet me Austrinë u përkeqësuan edhe më shumë. Mos besueshmëria ndaj saj u shtua edhe më tepër pikërisht në momentin kur u emërua ambasador në Romë konti Enriko Haymerle. Në momentin e dorëzimit të kredencialeve të Mbreti Italian deklaroi: ‘Italia duhet ta konsideroj të zgjidhur çdo kërkesë [territoriale] me Austro-Hungarinë’. Në fakt kjo deklaratë e ambasadorit duhet të ishte bërë publike por ajo nuk u botua kurrë, ndoshta për shkak të tensionit që mund të krijonte ajo në “lëvizjet irredentiste”. Megjithatë pas këtij episodi gjerat shumë shpejt do ndryshonin, shkak për këtë u bënë konfliktet ballkanike dhe lufta ruso-osmane.

Qeveria Ruse, e cila donte të ndalonte një ndërhyrje të Austrisë, e inkurajoj këtë të fundit të pushtonte Bosnje-Hercegovinën. Por Austria nuk e shikonte me sy të mirë shtimin e popullsisë sllave brenda saj. Ndërkohë më 15 janar të 1877 ajo pranon ftesën ruse. Lajmi i përhapur në kancelarit evropiane të një marrëveshje austro-ruse bëri bujë të madhe si në opinionin publikë ashtu edhe në qeverinë Italiane. Pakënaqësia e shprehur nga Qeveria italiane nuk e la indiferente Qeverinë austro-hungareze, e cila deri në atë moment e konsideronte si të nevojshme mbajtjen e miqësisë me Italinë. Pikërisht kjo nevojshmëri u ndje më shumë kur Rusia fitoj mbi Perandorinë Osmane. Pasi vuri në pikëpyetje planet e saj afatgjate.

Shtimi i influencës sllave në Ballkan, bëri që Austria të fliste me Italinë për kompensime territoriale, por aty nuk u gjet mënyrë e të kuptuarit midis kabinetit *Depretis-Krispi*, e pasuar nga *Drepetis-Nikotera*. Italia, për ‘kompensime territoriale’ nënkuptonte marrjen e Trentinos dhe Isonzos. Si forca e Majtë politike e cila ishte e lidhur ngusht me lëvizjet irredentiste, ashtu dhe e Djathta, nuk donin t’ia dinin apo të merrnin në konsideratë një nismë të tillë. Pas përfundimit të Kongresit të Berlinit dhe fundit jo të këndshëm për Italinë, Deputeti Jaçini shkruante:

‘Nuk mund të mendohej për Tunizinë pasi dihej kundërshtimi francez, por as Trentinon për shkak të Austrisë, e cila mbi të gjitha, pushtoj Bosnjën dhe Hercegovinën, dhe me këtë akt përmbushte detyrimin për mbajtjen e paqes në Evropë’.¹⁰⁰⁷

¹⁰⁰⁶ GAZETTA “LA STAMPA”, *La storia dell’Irredentismo*. Torino 15 dicembre 1932, f. 3

¹⁰⁰⁷ GAZETTA “LA STAMPA”, *La storia dell’Irredentismo*. Torino 15 dhjetor 1932, f. 3

Me ardhjen në pushtet të qeverisë Kairoli dhe me emërimin e kontit Korti në Konsult, filloj një politikë e jashtme shumë e dobët dhe pasive ndaj Austrisë. U arrit deri në atë pikë sa të pohohej se Italia nuk kishte nevojë për asnjë kompensim territorial, dhe se qeveria italiane nuk donte më as Trentinon dhe as Tunizinë madje dhe Libinë apo lokalitete të tjera të Perandorisë osmane përfshirë këtu “Shqipërinë”, por objektivi kryesor i Qeverisë italiane, ishte aneksimin i tokave irredentiste. Pa kaluar shumë kohë pas Kongresit të Berlinit, në vitin 1880 Italia u përball me një tjetër humbje, Tunizia. Pikërisht në këtë periudhë lëvizjet irredentiste morën një hov të mëtejshëm. Kudo shpërthyen demonstrata, në Romë, u protestua përpara ambasadës austriake, ndërsa në Venecia konsullata austriake u grabit nga protestuesit. Kjo ditë përkonte me themelimin “*Shoqatës për Italinë Irredente*”.¹⁰⁰⁸

Futja e Italisë në Lidhjen Tripalëshe nuk i qetësoj shpirtat e irredentistëve, madje idetë e revulucionare u rikthyen përsëri në plan të parë. Një tjetër shkak që nxiti më tej këto lëvizje u bë dhe shtypi që informonte opinionin publik italian i cili tejkaloi çdo kufi për të denoncuar pasivitetin e Qeverisë ndaj Austrisë, duke deklaruar se “*Qeveria italiane kënaqej vetëm me injorimin e të drejtave të tyre*”.¹⁰⁰⁹ Faktet tregojnë se prapa shtypit italian sidomos ai milanez, qëndronte Qeveria franceze e cila njëherazi e subvenciononte edhe me fonde.¹⁰¹⁰ Qëllimi i së cilës ishte prishja e Italisë me aleatët dhe shtimin e presionit ndaj saj. Kjo do e detyronte atë të afrohej përsëri në orbitën e Francës.

Sakaq tokat irredentiste u kthyen përsëri një çështje e nxehtë për politikën italiane në ambientin evropian, që pavarësisht nga hipokrizia dhe rregullimeve të bëra nga politika e kohës, kjo temë nuk u harrua kurrë.

Ajo që vështirësoj më shumë marrëdhëniet midis Austrisë dhe Italisë u bënë trazirat e studentëve të Insbruk – si dhe çështja e vështirë dhe e pa zgjidhur e universitetit italian në Trieste – të cilat e rritën më shumë tensionin e irredentistëve. Dhe për pasojë kjo solli një ringjallje të krenarisë italiane në territoret e Perandorisë Austro-Hungareze. Sakaq një vendim i Qeverisë habsburge, i cili acaroi edhe më shumë gjakrat u bë politika favoruese ndaj banorëve sllave me banim në zonën e Triestes. Megjithatë në atë zonë kishte edhe shumë interesa të tjerë të cilat preknin rolin e Italisë si një Fuqi e Madhe.

Argumenti historik i irredentistëve

Shekuj më parë, Roma u bë kryeqyteti dhe qendra intelektuale e gadishullit italian. Pas Luftës së Parë Punike, ajo u kthye edhe në fuqi detare. Pikërisht në këtë moment kur ajo kërkonte të sundonte si fuqi detare filloj të ndjejë, për shkak të piraterisë ilir, e pasojat e inferioritetit në të cilën ndodhej. [Mund të thuhet se ishte Roma ajo që ndihej e kufizuar në Adriatik për shkak të supremacisë së liburnëve. Ky fis ilir përgjatë shekujve VII-V p. Kr, luajtën një rol kryesor në historinë e Adriatikut. Më saktë ishte Roma ajo që për vetësoj anijet liburne dhe jo e kundërta. Kuptohet qartë se pas termit “pirat” fshiheshin synime me qëllime ekspansioniste të cilat kishin në thelb kontrollin e “tregtisë” në Adriatik, dhe në rast se mund të ketë pasur pirateri, kjo nuk ishte vetëm specialitet i ilirëve në atë kohë por edhe të popujve të tjerë të Mesdheut].

¹⁰⁰⁸ Po aty f, 3

¹⁰⁰⁹ GAZETTA “PIEMONTESE”, *L'irredentismo e la triplice alleanza*. Nr 183, 5 luglio Torino 1883, f, 2

¹⁰¹⁰ DDI. Terza Serie 1896-1907 Vol VIII . Nr 45 L'Ambasciatore a Berlino, Lanza, al Ministro Degli, Tittoni II. Riservato 2315/170. Berlino 3 dicembre 1903 f,39

Ndërkaq Roma, e gjetur në këto rrethana, u detyrua në vitin 226 p. Kr të fuste në punë marinën e saj për të luftuar një luftë kundër ilirëve, e ndjekur kjo edhe nga nëntë beteja të tjera, derisa qeveritarët e saj panë se ajo nuk do kërcënohej më prej tyre. Kjo luftë përfundoi me dobësimin e ilirëve dhe pushtimin përfundimtar të bregut lindor të Adriatikut. Pushtim ky i cili u krye në vitin 78 p. Kr, dhe që përfundoi me marrjen e plotë të prapatokës dhe me formimin e një province të re në vitin 10 m. Kr. të cilës ju dha emri “Dalmacia”.¹⁰¹¹

I njëjti problem iu shfaq republikës së Venecias sapo sigurojë pavarësinë e saj, filloj aktivitetin e saj detarë, aq sa ju desh shumë shpejt të bindej që para se të merrte ndonjë iniciativë për ndonjë zgjerim, sigurimi i saj kërkonte një zgjidhje që të ishte në favor të problemit Adriatik: dhe ja tentativat e dështuara të doxhëve Kandiano II dhe Kandiano III më 932-948, dhe kështu pushtimin përfundimtar të vetë Dalmacisë dhe të ishujve dhe qyteteve kryesore bregdetare të operuar nga Doxhi Orseolo (998- 1000), ku u shpall “Dux Dalmatias”.Përgjatë gjithë ekzistencën së saj Republika e Venecias mbajti lart më shumë se çdo gjë tjetër “ruajtjen e brigjeve dalmate”, ashtu siç tregojnë luftrat e saj shekullore kundër Hungarisë nga (1105-1409), dhe më pas me Perandorinë Osmane (1618-1718).

Edhe Napoleoni njohu me traktatin e Presburgut, (1806) nevojën për të bashkuar Dalmacinë dhe Histrian me Mbretërinë Italice. Mund të themi se Dalmacia ruan prej mese 2000 vjet pa ndërprerje latinizmin më saktë italianizmin, asnjëherë ky i ngatërruar nga askush, madje as dhe nga Qeveria austro-hungareze të paktën deri në vitin 1866. E cila pas kësaj date filloj përpjekjet për zbehur dhe për ti treguar të shkrija karakteristikat e saj etnike, si për Venezian Xhulia ashtu dhe Histrian.¹⁰¹²

Pyetjes se sa italianë jetojnë jashtë kufijve? Silleshin shifra të ndryshme nga të dyja palët. Sipas irredentistëve jashtë Italisë banonin të themi një milion, po bashkë me Maltën dhe Korsikën arrijnë shifrën e një milion e treqind mijë banorë italian. Malta me Gozon mund të jenë rreth njëqind e shtatëdhjetë mijë italianë indigjenë. Në Tiçino jetojnë njëqind e tridhjetë mijë italian, dhe janë lombard. Të qëndrojmë pakëz me italianët të Trentinos, Venecia Xhulias, të Triestes që përfshin Gorician, Histrian, Dalmacinë, që janë italianët e Austrisë ata numërohen rreth shtatëqind mijë banorë. Këta shtatëqind mijë italianë të shpërndarë në një rreze prej 700 km gjysma e tyre jeton në Trentino dhe aty janë kompakt dhe përbëjnë pothuajse shumicën e popullsisë që jeton aty. Pastaj kemi Ladinët të cilët ngatërrohen me gjermanët mund të themi në gjuhën e diplomacisë këtu kemi të bëjmë me një “provincë pothuajse austriake” e destinuar të jetë pjesë e Italisë së re. E thënë më shkoqur të gjitha këto vende të lartpërmendura ku banojnë italianë, duhet të jenë e Italisë, sakaq thuhet që Italia mund ta marrë ato vetën me forcën e armëve. Nëse Austria arrin në Selanik, Italia arrin në Trento.¹⁰¹³

Ndërkohe Austria, për të frenuar përhapjen e gjuhës italiane bëri të gjitha përcapjet për ta zëvendësuar atë me gjuhën gjermane. Natyrisht instrumenti më i vjetër dhe më efikas për pengimin e gjuhës italiane, ishte shërbimi ushtarak. Ky shërbim kryhej vetëm në gjuhën gjermane, si italianët ashtu dhe sllavët ishin të detyruar të mësonin atë. Sakaq Qeveria austriake shpresonte që për një farë kohë “*lëvizjet [irredentiste] italiane*” në

¹⁰¹¹ PSEUD ADRIATICUS ADRIATICUS. Da Trieste a Valona. Il problema Adriatico e i diritti dell'Italia. Editore Alfieri & Laroux. Milano 1918 f, 8

¹⁰¹² Pseud Adriaticus Adriaticus, po aty f, 9

¹⁰¹³ GRAZIADIO ASCOLI. *Gli irredenti*. Nuova Antologia. Terza Serie. Roma 1895 f, 48

territorin e saj të ishin thjesht partiake, dhe që të mos të ndikoheshin nga zhvillimi i ngjarjeve të brendshme dhe të jashtme të Italisë. Sepse pas këtyre lëvizjeve të Austrisë fshihej interesi i saj i vërtet, që është “*sigurimi i daljes në Adriatik*”. Pra ishte thelbësore që këto lëvizje të mbaheshin të izoluara pasi rrezikonin mbijetesën e saj. Austria ndjente që në det dhe në veçanti në Lindje (Ballkan), do ti duhej gjithmonë të ndihmohej nga gjysmë italianët, me pak fjalë duhej frenuar “italianizmi”. Pikërisht për të ruajtur këtë synime, Austria zgjodhi të ndihmonte më shumë elementin sllavë si kundërpeshë ndaj elementit italian.¹⁰¹⁴

Përveç Austrisë duket se edhe vetë Italia mund të kishte probleme me irredentistë të kombësive jo italiane të cilët banonin në Itali. Pikërisht në lidhje me këtë gjuhëtari italian Graziadio Ascoli,¹⁰¹⁵ shtroi këtë pyetje:

Çfarë do bënte Italia nëse grekët dhe shqiptarët e Sicilisë dhe Kalabrisë do kërkonin të drejtat politike ose privilegje që mund të bien ndesh me kushtetutën e Italisë? A ishte ky një krahasim vërtet i çuditshëm i çështjes së irredentizmit ?

Për sa i përket grekëve ata janë një pakicë e vogël.

Po për sa i përket shqiptarëve?

Pavarësisht se ata janë akoma dy gjuhë folës në pjesë më të madhe le të themi bëhen rreth njëqind mijë banorë. Është e vërtet që ushtria e Napolit kishte regjimentin “Real Macedone” o “Illirico”, e cila ishte e njohur për praninë e lartë të shqiptarëve në radhët e saj. Nuk mund as të mohohet që ndonjë arbëresh të ketë ëndërruar “*Shqipërinë e Madhe*” apo të mos pranosh faktin që Garibaldi të mos ketë menduar për ndihmën që mund të jepnin shqiptarët e Kalabrisë e të Molizës kur ëndërronte një zbarkim në Epir. Nuk ka asnjë italianë të mos ketë parë që shqiptarët janë njerëz guximtarë dhe që ndikojnë në ekipin e politikës së Italisë.¹⁰¹⁶ Për këto arsye qeveria italiane u kushtëzua tu njihite disa privilegje.

Si përfundim mbështetur dokumentet e kohës mësojmë se qëndrimi i Qeverisë italiane karakterizohet nga interesa të momentit. Pikërisht në këtë periudhë qëndrimi zyrtar i Italisë ishte për ruajtjen e marrëdhënieve të mira me aleatët. Po sjellim si argument korrespondencën midis Ambasadorit në Berlin Lanza, dhe Ministrin të Jashtëm Titoni, aty thuhet:

“Qeveria Italiane mori të gjitha masat për të përhapur në Vjenë besim se kjo do dijë t’i vendos fre manifestimeve irredentiste që përsëri po tronditin vendin... Qeveria italiane dëshironte të rivendoste në raportet midis Italisë dhe Austro-Hungarisë të njëjtën raporte harmonie dhe besimi që mbretëronin midis Italisë dhe Gjermanisë”.¹⁰¹⁷

Me këtë lëvizje ministri Titoni synonte të zhdukte çdo dyshim apo ndonjë keq interpretim të gjithë elementeve të mundshme madje duke siguruar se nga ana e tij se do merreshin të gjitha masat për të penguar çdo lëvizje të irredentistëve.

Në fakt, ky qëndrim i Italisë ndikohet më shumë me situatën e Ballkanit me shqetësimin se Austro-Hungaria “pa dëshirën e saj” mund të tërhiqej nga zhvillimi i ngjarjeve dhe të ndërhynte aty me armë. Kjo do të thoshte pushtimin e Ballkanit prej saj dhe fundin e ëndrrës së Italisë për t’u shtrirë në të.

¹⁰¹⁴ Graziadio Ascoli, *po aty* f, 50

¹⁰¹⁵ GRAZIADIO ASCOLI. *Po aty* f,36

¹⁰¹⁶ Graziadio Ascoli, *po aty* f, 37

¹⁰¹⁷ DDI. Terza Serie 1896-1907 Vol VIII . Nr 45 L'Ambasciatore a Berlino, Lanza, al Ministro Degli, Tittoni II T. Riservato 2315/170. Berlino 3 dicembre 1903 f,39

Për të evituar një gjë të tillë, Italia nëpërmjet Ministrit të Jashtëm, Titoni riafirmonte politikën e sinqertë drejt Lidhjes Tripalëshe, e cila ishte baza kryesore e politikës së saj në të gjitha shfaqjet. Titoni dëshironte që Austria, Gjermania dhe Italia të binin dakord në çështje të rëndësishme që interesojnë në mbajtjen e paqes në Evropë. Këtë gjë ai e lidhte me këndvështrimin e mbajtjes së *status quo* në gadishullin ballkanik dhe dëshirën që në rast të një aksioni ushtarak të ndërmarrë nga Austro-Hungaria përtej kufijve të saj të paraprihej nga një shkëmbim idesh me Gjermaninë dhe Italinë. Kjo nuk do binte në kontrast me marrëveshjen *austro-ruse*.

Për sa i përket reformave dhe detyrave për ruajtjen e paqes në Ballkan, Italia i ka kushtuar dhe do vazhdoj ti kushtoj vëmendje. Në lidhje me "Shqipërinë" i qëndrojmë paktit të bërë më parë, deklaronte Titoni.¹⁰¹⁸

[Por jo çfarë thuhet në politikë zbatohet me përpikmëri], jo zyrtarisht Qeveria italiane punonte në fshehtësi për të rritur influencën në tokat irredentiste kufitare me Austrinë. Madje ajo nuk kurseu të vinte në punë reparte të tëra ushtarake në shërbim të politikës së saj. "thube se ushtarët italian silleshin si të ishin në shtëpinë e tyre"¹⁰¹⁹ Impenjimin e ushtrisë e kthente atë në një element për shpresat nacionaliste. Por që njëkohësisht ishte një kartë tepër e rrezikshme dhe që binte në sy. Pavarësisht se bota zyrtare italiane e mohonte atë kjo bëhej për të mos qenë të kompromentuar.¹⁰²⁰ Nga këto lëvizje të politikës italiane mund të kuptojmë se rritja e tensionit në marrëdhëniet politike midis Austrisë dhe Italisë, nuk erdhi si rezultat i shfaqjeve irredentiste, por nga politika ekspansioniste e Italisë për tu shtrirë në Ballkan.¹⁰²¹

¹⁰¹⁸ DDI. Terza Serie 1896-1907 Vol VIII . Nr 205 Allegato L'Ambasciatore D'Austria-Ungheria a Roma, Pasetti a Ministro degli Esteri Austro-Ungarico, Goluchowski. febbraio 1903 f,163

¹⁰¹⁹ DDI. Terza Serie 1896-1907 Vol VIII . Nr 610 L'Ambasciatore a Vienna al Ministro degli Esteri Tittoni. R. 1302/597 Vienna 31 agosto 1904 f,501

¹⁰²⁰ DDI. Terza Serie 1896-1907 Vol VIII . Nr 610 L'Ambasciatore a Vienna al Ministro degli Esteri Tittoni. R. 1302/597 Vienna 31 agosto 1904 f,502

¹⁰²¹ DDI. Terza Serie 1896-1907 Vol VIII . Nr 613 Il Ministro a Belgrado, Guccioli, al Ministro degli Esteri Tittoni. Allegato Belgrado 1 settembre 1904 f,504

ZHVILLIMET ARSIMORE NË NËNPREFEKTURËN E PËRMETIT NË VITET 1925-1939

Dr. Nuri Dragoj

Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë TIRANË

Më 6 janar 1925, pak ditë pas rrëzimit të qeverisë së Nolit, ardhur në pushtet në qershorin e vitit 1924, u shpall kabineti i ri qeveritar. Ahmet Zogu, krahas postit të kryeministrit do të mbante dhe atë të ministrit të Brendshëm. Hapi i parë që ai bëri ishte suprimimi i dikasterit të arsimit, me argumentin se shumë nëpunës të atij sektori, gjatë kohës së zhvillimit të Revolucionit të Qershorit 1924, patën lënë punën dhe qenë marrë me politikë. Sipas tij, arsimit kishte ndjekur rrugën e ushtrisë dhe fëmijët mendonin vetëm për kobure, pasi këtë frymë u kishin dhënë arsimtarët.¹⁰²² Qeveria krijoi Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe dha orientimin që nga sektori i arsimit “të përjashtoheshin elementët e dobët” dhe të mbaheshin mësuesit e vërtetë, që jepnin garanci për të përcjellë mesazhin e duhur te brezi i ri.¹⁰²³ Në mars të vitit 1925, në krye të drejtorisë arsimore erdhi Sotir Papparisto, i cili qëndroi rreth 5 muaj.¹⁰²⁴ Përmirësimi i programeve mësimore, hartimi i teksteve të rinj, cilësia në godina dhe bazë materiale, ishin hapa që dhanë ndihmesë të dukshme në rritjen e cilësisë për shkollën.¹⁰²⁵

Kabineti i Ahmet Zogut mbylli shumë shkolla me motivacionin e mungesës së mësuesve dhe cilësinë e dobët të tyre, ndaj vendosi të kryente reforma të thella, ku parashikohej dhe ngritja e disa internateve. Sipas qeverisë, synimi i shkollave të fshatit nuk ishte “të bënin gjithë botën dijetarë, por të luftohej analfabetizmi”.¹⁰²⁶ Problem mbetej dhe sigurimi i personelit mësimor me përgatitjen e duhur, pasi ishin vënë re emërime të papërshtatshme. Inspektorati i arsimit të qarkut të Gjirokastrës, në korrik të vitit 1925, i shkruante Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit se “duhet të dëftehemi të hekurit në vendime dhe jo t’i përulemi njëri-tjetrit, në dëm të interesave të kombit dhe atdheut”.¹⁰²⁷

¹⁰²² Siri Shaplo, *Nga historiku i zhvillimit të arsimit në Shqipëri*, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë 1975, f. 133-139.

¹⁰²³ Po aty.

¹⁰²⁴ Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar, Vëll. I, Tiranë 2003, f. 428.

¹⁰²⁵ Jani Sota, *Zhvillimet arsimore në rrethin e Fierit, 1945-1963*, Tiranë 2012, f. 69.

¹⁰²⁶ Iliaz Gogaj, *Aspekte të arsimit në Shqipëri në vitet 1912-1939*, *Revista pedagogjike*, Nr. 3/1972, f. 130-151.

¹⁰²⁷ AQSH, F. 195, V. 1926, D. 27, f. 123-131. Shkresë e inspektoratit të arsimit të qarkut të Gjirokastrës, Nr. 331, datë 21. 7. 1925, firmosur nga inspektori Jani K. Minga, drejtuar drejtorisë së përgjithshme të arsimit, Tiranë.

Ahmet Zogu deklaronte për gazetën italiane “Corriere dela sera”, se në radhë të parë do të punonte për të përmirësuar kulturën dhe zhvillimin e arsimit shkollor.¹⁰²⁸ Dhe me tw vwrretw u hodhwn hapat e para nw drejtim tw masivizimit tw shkollws. Numri i nxënësve në nënprefekturën e Përmetit, në vitin 1926, ishte rritur 40% në krahasim me vitin 1920. Kjo rritje favorizohej nga reformat arsimore të kryera në atë kohë, por edhe nga prirjet arsimdashëse të përmetarëve, të cilët kishin sakrifikuar për të shkolluar fëmijët e tyre, brenda dhe jashtë vendit. Gjatë atij viti, numri i nxënësve dhe studentëve ka qenë si më poshtë: në universitete 37; në gjimnaz 87; në fillore 970; studionin jashtë* 23 vetë. Funksiononin dy shkolla plotore, ku mësonin 220 djem dhe 87 vajza. Po ashtu ishin në veprim 18 shkolla fillore, në të cilat mësonin 582 djem dhe 122 vajza. Ndërsa numri i nxënësve të detyruar për arsim ishte 1 136.¹⁰²⁹

Në shkallë vendi vazhdonin shkollën 3 për qind e popullsisë, kurse në rrethin e Përmetit kjo shifër ishte 5 për qind. Por megjithë përpjekjet e bëra numri i shkollave nuk ishte i mjaftueshëm. Nga 105 fshatra të nënprefekturës së Përmetit, në vitin 1927, vetëm 20 prej tyre kishin shkolla.¹⁰³⁰ Kjo ngecje u krijua për shkak të rrudhjes së buxhetit për arsimin. Por tabloja kritike e shkollave nuk qe vetëm për Përmetin. Ajo paraqitej problematike në tërë qarkun e Gjirokastrës qw kishte 104 shkolla.¹⁰³¹ Përveç atyre që mësonin në shkollat e prefekturws duhej tw shtoheshin 260 nxënës që studionin jashtë.¹⁰³² Kritike shihej gjendja edhe në shkallë vendi, pasi në bankat e shkollës qenë ulur 26 612 nxënës, kur numri i fëmijëve në moshë shkollore ishte shumë më i madh.¹⁰³³

Raporti i nënprefekturës së Përmetit për ecurinë e arsimit gjatë viteve 1925-1929, vinte në dukje se ishin bërë përparime dhe njerëzit kishin etje për të mësuar. Në të thuhej se duke patur në konsideratë dëshirën e zjarrtë të popullit për të luftuar analfabetizimin, qeveria premtonte tw merrte masa për çeljen e shkollave në katundet Miçan, Koblarë, Stwrnec e Kreshovë të krahinës së Dangëllisë, si dhe në katundet Çorrogunj, Bubës, Zhepovë, të rajonit të Ballabanit. Po ashtu shkolla u hapën në fshatin Fratar të Këlcyrës dhe në Pacomit të Ceries.¹⁰³⁴ Populli i Frashërit kishte vendosur ngritjen e një konvikti, por për mungesa financiare nuk qe mundësuar ndërtimi.¹⁰³⁵

Gazeta “Demokratia” në vitin 1931 bënte kritikë për programin mësimor, i cili gjykohej në nivel më të dobët se ai i vitit 1925. Ministria e Arsimit kishte caktuar një komision, i cili do të merrte mendimin e arsimtarëve në shkolla, për ta përmirësuar më tej atë.

¹⁰²⁸ Hajrullah Koliqi, *Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar*, Prishtinë: “Libri shkollor”, 2002, f. 363.

* Studentët përmetarë që studionin jashtë shtetit, kryesisht kishin preferuar dy vende, Greqinë dhe Italinë.

¹⁰²⁹ Teki Selenica, *Shqipëria në vitin 1927*, Tiranë, 1928, f. 281.

¹⁰³⁰ Përmeti gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, Tiranë 1970, f. 55.

¹⁰³¹ AQSH, F. 195, V. 1931, D. 95, f. 35. Statistika të Ministrisë së Arsimit. Prefektura e Gjirokastrës, nga ku varej edhe nënprefektura e Përmetit, në vitin shkollor 1926-1927 kishte 99 shkolla fillore mashkullore, 4 femërore, një shkollë të mesme mashkullore, gjithsej 104. Personeli mësimdhënës kishte 143 mësues në shkolla mashkullore, 12 në femërore, 155 gjithsej. Në shkolla të mesme 9 mësues meshkuj, totali 164 mësues. AQSH, F. 195 V. 1931 D. 95 f. 35.

¹⁰³² AQSH, F. 195, V. 1925, D. 7, f. 38-46. Jashtë këtij qarku studionin 260 nxënës, prej të cilëve me shpenzimet e veta 234, me bursë qeveritare shqiptare 19, me bursë qeveritare greke 7 vetë.

¹⁰³³ *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi III, Periudha e Pavarësisë 28 nëntor 1912-7 prill 1939, Tiranë: Botimet Toena, 2007, f. 255. Në shkallë vendi, numri i atyre që mësonin në shkolla ishte shumë i vogël, në raport me numrin e popullatës. Kështu, gjatë vitit 1926-1927 funksiononin vetëm 536 shkolla fillore në mbarë vendin. 470 prej tyre ishin vetëm me një klasë. Në to jepnin mësim 830 mësues. Numri i përgjithshëm i nxënësve ishte 26 612, nga të cilët vajzat përbënin 10 për qind, shifër kjo shumë e ulët për popullsinë e kohës.

¹⁰³⁴ AQSH, F. 313, V. 1929, D. 94, f. 1. Raporti i nënprefekturës së Përmetit, Nr. 1739/XI Ex 29, datë 8.2.1930, dërguar prefekturës së Gjirokastrës.

¹⁰³⁵ AQSH, F. 313, V. 1929, D. 94, f. 1.

Rëndësi e dorës së parë duhej t'i kushtohet mënyrës së zbatimit të programeve, ndaj lindte nevoja të krijoheshin shkolla dhe klasa eksperimentale, të cilat të ktheheshin në qendra pelegrinazhi për shkollat e tjera. Por që të arrihej ky objektiv, nevojitej që gjatë verës të hapeshin kurse për mësuesit, vetëm për mënyrën e zbatimit të teorisë dhe praktikës në shkollën aktive.¹⁰³⁶

Në vitet '30 të shekullit të 20-të, në shkollën fillore zhvilloheshin këto lëndë: Njohuri morale e qytetare, gjuhë shqipe (këndim, shkrim e drejtshkrim, diktim, hartim, gramatikë); arithmetikë dhe elemente të gjeometrisë, histori kombëtare, gjeografi; mësim sendesh dhe elemente të shkencave; njohuri mbi higjenën; vizatim dhe bukurshkrim; këngë; punë dore; lojna dhe edukatë fizike.¹⁰³⁷ Vlerësimi me nota bëhej si më poshtë: Shumë mirë 1, mirë 2, kalueshëm 3, dobët 4. Vlerësimi për sjelljen: Shembëllore 1, e urtë 2, e durushme 3, e keqe 4. Për kujdesin e rregullar: e lavdërueshme 1, e pëlqyeshme 2, e mjaftë 3, e paktë 4. Vlerësimi për pastërinë: shembullore 1, e pëlqyeshme 2, e mjaftë 3 dhe e metë 4. Pra siç shihet, nota më e lartë ishte 1 dhe më e keqja 4. Pikërisht këtu jepeshin për kujdesin merreshin në konsideratë në nxjerrjen e rezultatit përfundimtar, ndërsa ai i pastërtisë përfshihej në vlerësimin e sjelljes.¹⁰³⁸

Me gjithë përpjekjet, rritja e numrit të shkollave eci me ritme të ngadalta. Në vitin 1937-1938 u hap shkolla e Kaludhit me mësues Goli Dango, ajo Argovë-Grabovë me mësues Seit Luzatin etj. Nënprefektura e Përmetit, në atë vit mësimor kishte 37 shkolla fillore. Katër prej tyre ishin me 5 klasë, dy në Përmet, një në Këlcyrë dhe një në Frashër, ndërsa të tjerat qenë me 4 klasë. Me përjashtim të Shkollës Femërore të qytetit të Përmetit, gjithë të tjerat ishin të përziera. Në to jepnin mësim 51 arsimtarë, 45 prej të cilëve ishin me shkollë të mesme dhe 6 të padiplomuar. Shkollat ndiqeshin nga 1 100 nxënës.¹⁰³⁹ Pranë shkollës Mashkullore qenë hapur dhe dy klasë foshnjore me 62 fëmijë.¹⁰⁴⁰ Në fund të vitit 1939, kjo nënprefekturë regjistronte 41 shkolla, nga të cilat 3 qytetëse dhe 38 në fshatra.¹⁰⁴¹ Nga 844 nxënës që duhej të kishin shkollat, ishin regjistruar 736, prej të cilëve 344 ishin vajza. Siç shihet numri i nxënësve ka qenë i ulët për shkak të ndikimit të rrethanave të reja që u krijuan nga pushtimi italian. Madje edhe gjatë vitit mësimor qenë larguar nga shkolla 85 nxënës, nga të cilët 42 djem dhe 43 vajza.¹⁰⁴²

Vendndodhja e shkollave në vitin 1939 ishte si më poshtë: Përmet-qytet 3 shkolla, dy plotore dhe një foshnjore; në Këlcyrë 1 shkollë plotore. Shkollat e tjera ndodheshin në fshatrat: Argovë-Grabovë, Badlonjë, Ballaban, Brezhdan, Bubës, Buhal, Bënjë-Mërtinj, Bënjë-Novoselë, Çorrogunj, Draçovë, Frashër, Fratar, Lipë, Hotovë, Kajcë, Kaludh, Katundishtë, Koblarë, Kosinë, Kosovë, Leshicë, Leskaj, Leusë, Limar, Lipivan, Lupçkë,

¹⁰³⁶ Gazeta *Demokratia*, Nr. 292, datë 8 gusht 1931, f. 3. Artikulli: Programi i shkollave fillore dhe baza e përmirësimit të shkollave.

¹⁰³⁷ Fletore Zyrtare Nr. 54, datë 28 shtator 1934, f. 2-22. Dekret ligji për arsimin.

¹⁰³⁸ Po aty.

¹⁰³⁹ S. Adhami, *Përmeti dhe përmetarët në faqet e historisë*, Tiranë: Neraida, 2001, f. 611.

¹⁰⁴⁰ *AQSH*, F. 195, V. 1938, D. 90, f. 360-388. Raport final i inspektoriatit të arsimit të Përmetit, për shkollat e asaj nënprefekturë, për vitin 1937-1938, dërguar Ministrisë së Arsimit, me firmën e inspektorit Beqir Haçi. Shkresa ka Nr. 30, datë 12.7.1938.

¹⁰⁴¹ *AQSH*, F. 195, V. 1940, D. 39, f. 43-47. Pasqyrë statistikore e Ministrisë së Arsimit për shkollat në vitin 1939.

Dokumenti nuk ka datë.

¹⁰⁴² Po aty. Pasqyrë statistikore e Ministrisë së Arsimit për shkollat në vitin 1939. Mungojnë të dhënat për shkollat Argovë dhe Grabovë.

Malëshovë, Miçan, Odriçan, Ogren, Podgoran, Stërmbec, Stërnec, Tolar, Topojan, Vllaho, Psilloterë, Zhepovë, Zhepë.¹⁰⁴³

Fati i shkollës përcaktohej nga godina

Përveç problemit të tërheqjes së sa më shumë fëmijëve në shkolla, pwrzgjedhjes së mësuesve dhe teksteve, një çështje me rëndësi ishte ajo e ndërtesave shkollore. Shteti nuk investonte në ndërtimin e tyre, ndaj fshatarët para se të kërkonin mësues, bënë me dije se “godinën e kemi”. Për t’i dhënë më shumë peshë problemit, herë pas here ata dërgonin përfaqësi të tyre në zyrat e pushtetit lokal. Nënprefektura e Përmetit, në fillim të vitit arsimor 1926-1927, i bënte kërkesë ministrisë së Punëve të Brendshme për mësues në shkollën e përbashkët të fshatrave Pacomit, Velçisht, Kuqar, Alipostivan.¹⁰⁴⁴ Kudo ngriheshin godina të reja. Ndërtimi i shkollës së Koblarës kishte filluar në vitin 1926.¹⁰⁴⁵ Një vit më pas u sigurua një godinë për shkollë nate edhe në Këlcyrë, ndërsa godina e shkollës së Ogrenit përfundoi në vitin 1928. Masa të tilla nuk e zgjidhën konfliktin midis kërkesës së madhe dhe mundësive për arsimim, por vetëm sa e zbutën disi problemin. Inspektori i arsimit në një raport të vitit 1928 nënvizonte se në komunën e Këlcyrës me 33 fshatra, ishin vetëm dy shkolla. Ai pajtohej me propozimet e bëra nga pleqësia e asaj krahine, që të ngriheshin shkolla edhe në fshatrat Katundishtë, Tolar, Fratar, Topojan, Zhepovë, Rodenj e Bubës.¹⁰⁴⁶ Ndaj informonte ministrin që shumica e popullsisë së asaj krahine ndodhej në vështirësi financiare dhe me zor siguronin bukën e ditës”.¹⁰⁴⁷ Edhe nënprefekti ishte i ndërgjegjshëm se banorët e asaj zone nuk do të ishin kurrë në gjendje të siguronin ngritjen e godinave shkollore me të hollat e tyre. Ndërkaq, duke parë kërkesat në rritje për arsimim, në fshatin Frashër dhe në ato rreth tij, komuna donte të ndwrtonte me shpenzimet e veta një internat, ku të strehoheshin nxënësit e fshatrave të krahinës. Çështja u shqyrtua nga një komision, i cili e gjykoji të arsyeshme që internati të ishte në vendlindjen e patriotit Naim Frashëri.¹⁰⁴⁸ Ministria e mori në shqyrtim kërkesën e tyre, por nuk e zbatoi në praktikë, madje nuk miratoi as projektin. Pas një viti, nënprefektura i raportonte prefekturës së Gjirokastrës se vendimi i popullit të Frashërit për ngritjen e internatit, për shkak “të ngushticës financiare tash për tash është lënë pas dore”.¹⁰⁴⁹

Në vitin 1930 shteti hartoi një studim mbi gjendjen e arsimit në shkollë vendi. Ministria e Punëve të Brendshme kërkoi informacion të hollësishëm për të gjitha fshatrat e Përmetit, ku duhej të pasqyrohej numri i nxënësve, kushtet e ndërtesave dhe mundësitë për ngritjen e ndonjë godine të re. Qëllimi ishte që në çdo fshat me popullsi relativisht të madhe të kishte një shkollë, kurse në fshatrat e vogla që ndodheshin pranë njëri-tjetrit, të bëhej regjistrimi në shkolla të përbashkëta. Në bazë të kësaj kërkesë, nënprefektura e Përmetit i dërgonte prefekturës së Gjirokastrës listën e fshatrave që përmbushnin

¹⁰⁴³ Po aty.

¹⁰⁴⁴ AQSH, F. 152/9, V. 1927, D. 1263, f. 32. Kërkesë e nënprefekturës së Përmetit, datë 1. 9. 1926, dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme.

¹⁰⁴⁵ Përmeti gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, Tiranë 1970, f. 56.

¹⁰⁴⁶ Po aty.

¹⁰⁴⁷ AQSH, F. 195, V. 1938, D. 90, f. 267-350. Raport i inspektorit të prefekturës së Gjirokastrës, mbi gjendjen e arsimit në prefekturë, Nr. 9/II, datë 13.7.1938, dërguar Ministrisë së Arsimit.

¹⁰⁴⁸ AQSH, F. 195, V. 1928, D. 389, f. 1. Shkresë e nënprefekturës së Përmetit, Nr. 1698/XV, datë 21. XII. 1927, dërguar Ministrisë së Arsimit, të cilës i kërkon të ndihmojë për ngritjen e internatit në Frashër.

¹⁰⁴⁹ AQSH, F. 313, V. 1929, D. 94, f. 1. Shkresë e nënprefekturës së Përmetit për prefekturën e Gjirokastrës.

kriteret për hapjen e shkollës, me ndërtesa dhe numër nxënësish të mjaftueshëm. Sipas këtij dokumenti, fshatrat që plotësonin kushtet ishin: Zhepova me 50 nxënës; Çorrogunji dhe Balli 50; Bubësi I, Bubësi II, 70; Podgorani, 50; Vinokash dhe Pavar, 40; Psar dhe Mazhan, 35; Selenicë dhe Surropull, 55; Koblarë, 60; Miçan, 60; Kreshovë, 70; Gostivisht, 35 dhe Vitisht me 45 nxënës.¹⁰⁵⁰

Pleqësia e Dëshnicës sqaronte Ministrinë e Arsimit se në 15 fshatra funksiononte vetëm shkolla e Kajcës.¹⁰⁵¹ Bazuar në numrin e nxënësve për çdo fshat shihej e nevojshme të çelëshin edhe 9 shkolla të tjera.¹⁰⁵² Vështirësitë për hapje të shkollave ndiheshin jo vetëm në fshatrat e zonës së Dëshnicës, por edhe në Këlcyrë, që ishte qendër e një krahine të tërë. Komuna u bëri thirrje banorëve të ndihmonin në ngritjen e mjediseve të përshtatshme për mësim, për të cilën thuajse të gjithë u treguan të gatshëm. Me financim të popullit të qytetit dhe punën vullnetare të tyre, mbi godinën e spitalit u hodhën dy kate për shkollë.¹⁰⁵³ Fshatrat për rreth Ballabanit, me gati 6000 frymë, edhe në vitin 1931 vazhdonin të kishin vetëm një shkollë. Mbi 90 % e popullsisë nuk dinte shkrim e këndim, ndaj për të luftuar analfabetizmin, të paktën duhej të hapeshin dy shkolla, një në Zhepovë dhe tjetra në Ballaban, ku fshatarët i kishin ngritur godinat me shpenzimet e tyre. Ata shpresonin se në vjeshtën e ardhshme shteti do t'u dërgonte mësues dhe fëmijët do të uleshin në banka për të mësuar.¹⁰⁵⁴

Gjendjen e vështirë të shkollave në rrethin e Përmetit e pasqyronte dhe raporti i inspektoratit të arsimit për vitin 1931. Sipas tij, fshatrat Qilarisht dhe Rapçkë i dërgonin fëmijët në shkollat e fshatrave të tjera të largëta, ndaj do të ishte mirë që të mundësohej çelja e shkollave edhe në katundet e sipërpërmendura.¹⁰⁵⁵ Zyra e arsimit e rrethit pranonte që në komunën e Dëshnicës puna në sektorin e arsimit kishte ecur ngadalë, pasi nuk ishin hapur shkolla as në fshatra me popullsi të madhe. Nga 15 fshatra të komunës me 4 426 banorë, funksiononte vetëm një shkollë. Populli i Zhepovës e kishte ngritur me shpenzimet e veta godinën, madje e pati pajisur edhe me orenditë e nevojshme, por nuk ishte bërë asgjë për dërgimin e një mësuesi. Po ashtu, në komunën e Frashërit me 21 fshatra gjendeshin vetëm dy shkolla, një në Frashër dhe një në Ogren, të cilat ishin në gjendje të mirë.¹⁰⁵⁶

Kryetarët e komunave dhe pleqësitë vazhdonin të dërgonin shkresa, por përgjigjet nga shteti nuk jepnin shpresë për zgjidhje. Pritja e gjatë për ndihmë nga shteti i lodhi edhe banorët e fshatrave të krahinës së Frashërit, ndaj për të mos lënë fëmijët pa shkollë, ata vendosën të merrnin masa "për ngrehjen e godinave shkollore, si dhe për plotësimin e

¹⁰⁵⁰ AQSH, F. 152/8, V. 1930, D. 773, f. 23-24. Shkresë e nënprefekturës së Përmetit Nr. 4081, datë 3. 2. 1930, mbi shkollat që nevoiten në nënprefekturën e Përmetit, dërguar prefekturës së Gjirokastrës. Shkresë e prefekturës së Gjirokastrës, Nr. 361/I, datë 7.2.1930, dërguar Ministrisë së Arsimit Tiranë, mbi shkollat që nevoiten në rrethin e Përmetit.

¹⁰⁵¹ AQSH, F. 313, Pa vit, D. 673, f. 3. Kërkesë e pleqësisë së krahinës së Dëshnicës, dërguar nënprefekturës së Përmetit, Nr. 2013, datë 29. 3. 1930.

¹⁰⁵² Po aty.

¹⁰⁵³ AQSH, F. 313, V. 1934, D. 275, f. 1. Shkresë e nënprefekturës së Përmetit, Nr. 671, datë 8. 03. 1934, dërguar prefekturës së Gjirokastrës në përgjigje të shkresës Nr. 272, datë 5. 02. 1934.

¹⁰⁵⁴ Gazeta Ora, Nr. 432, Viti II i botimit, e shtunë 25 korrik 1931, f. 4. Lajme nga krahinat. Nevoja e shkollave

¹⁰⁵⁵ AQSH, F. 294, V. 1931, D. 489, f. 11. Në raport theksohet se komuna Qendër Përmet, aty ku ka shkolla janë pajisur me orenditë e duhura, por ka dhe të tjerë katunde me probleme.

¹⁰⁵⁶ AQSH, F. 294, V. 1931, D. 489, f. 12-15. Inspektoria e katundarive në prefekturën e Gjirokastrës, Nr. 176/34, datë 9.1.1931, për arrijet në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe arsimit në nënprefektura dhe komunat e tyre. Shkresa i dërgohet prefekturës së Gjirokastrës.

orendive të tyre".¹⁰⁵⁷ Por herë pas here merrej dhe ndonjë lajm shprese. Ministria ishte pajtuar me kërkesën për hapjen e shkollës në Limar.¹⁰⁵⁸ Shpresë jepej edhe për dëshirën e fshatarëve të Berzhdanit, të cilët kishin kërkuar që për shkollën e tyre të dërgohej një mësues i aftë".¹⁰⁵⁹ Kërkesa e tyre që gjykuar e drejtë edhe nga ministria, e cila u premtonte dërgimin e mësuesit me shkresën Nr. 98, datë 13 janar 1930.¹⁰⁶⁰ Por me gjithw premtimin e bwrw, shkolla e Limarit nuk u hap. Fëmijët shkonin në shkollën e Malëshovës, e cila kishte 40 nxënës të rregullt, 10 prej të cilëve vinin nga fshati Limar. Në muajin dhjetor të vitit 1931, fëmijët e Limarit nuk e vijuan shkollën më tej, pasi në fshatin e tyre që hapur një shkollë private, e cila nuk funksionoi pasi ishte pa leje të ministrisë.¹⁰⁶¹

Shkolla kishin kërkuar edhe në fshatra të tjera, por nuk u ishte dhënë përgjigje. Për t'u përmendur qenë kërkesat e katundeve Borockë dhe Pacomit të komunës Cerie, të cilët ishin shprehur të gatshëm për të ngritur godinën me shpenzimet e tyre.¹⁰⁶² Në komunën e Rrëzës funksiononin dy shkolla, ajo e Vllaho e Psilloterës e çelur atë vit dhe tjetra në katundin Stërmbec. Hapja e tyre shihej si arritje e mirë, ndonëse popullsia e asaj zone shprehej e pakënaqur.¹⁰⁶³ Shkolla e Zhepës deri në atë kohë kishte funksionuar si shkollë private, me mësues famulltarin e kishës. Godina që në gjendje të mirë dhe bashkë me fëmijët e fshatit Draçovë, në shkollë mund të vinin 40 nxënës. Mësues kishte qenë Prokop Bezhani por ai u largua me me shkresën e Ministrisë së Arsimit, Nr. 1364, datë 16.4.1930, pasi pranoi dorëheqjen e tij, ndaj propozohej të dërgohej një mësues, ndërsa At Minai të mbetej zëvendës mësues.¹⁰⁶⁴ Këtë fakt e pohonte dhe raporti arsimor i vitit 1931, në të cilin inspektori nënvizonte se nga komuna e Rrëzës ishin paraqitur dy kërkesa të reja për shkolla në katundet Zhepë dhe Kaludh, të cilat ende nuk ishin miratuar.¹⁰⁶⁵

Ministria i kushtonte më tepër rëndësi cilësisë së godinave shkollore. Specialistët ngulmonin të kuptohej se pa një ndërtesë të mirë, jo vetëm që mësimi nuk zhvillohej si duhej, por dhe fëmijëve u kërcënohej shëndeti. Në mjedise të papërshtatshme, si nxënësve dhe mësuesve u shuhej dëshira për punë. Për gjendjen e keqe të godinave shkollore, ministri i Arsimit tërhiqte vëmendjen e strukturave të pushtetit vendor, për

¹⁰⁵⁷ AQSH, F. 294, V. 1930, D. 419, f. 9. Raport i prefekturës së Gjirokastrës për ecurinë e punëve në prefekturë, pjesa ku flitet për nënprefekturën e Përmetit. Data nuk është e qartë, mund të jetë 14. 09. 1930.

¹⁰⁵⁸ AQSH, F. 313, D. 673, Pa vit, f. 1. Shkresë e nënprefekturës së Përmetit, Nr. 1367, datë 17.4.1930, dërguar prefekturës së Gjirokastrës.

¹⁰⁵⁹ AQSH, F. 313, D. 673, Pa vit, f. 1-4. Inspektoria e Arsimit Përmet, raport mbi ecurinë e shkollave në nënprefekturën e Përmetit. Dokumenti nuk ka datë.

¹⁰⁶⁰ AQSH, F. 313, Pa vit, D. 673, f. 1-9. Fletë të shkëputura nga raporti i inspektorit të arsimit të nënprefekturës së Përmetit, mbi gjendjen e shkolla, numrin e nxënësve, karakteristikat e mësuesve. Ndonëse dokumenti nuk ka datë, në bazë të problemeve të shkollave dhe emërimit të mësuesve në to, duhet të bëhet fjalë për vitin 1932.

¹⁰⁶¹ AQSH, F. 313, Pa vit, D. 673, f. 1-9. Fletë të shkëputura nga raporti i inspektorit të arsimit të nënprefekturës së Përmetit, mbi gjendjen e shkolla, numrin e nxënësve, karakteristikat e mësuesve.

¹⁰⁶² AQSH, F. 294, V. 1931, D. 489, f. 12-15. Inspektoria e katundarive në prefekturën e Gjirokastrës, Nr. 176/34, datë 9.1.1931, për arritjet në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe arsimit në nënprefektura dhe komunat e tyre. Shkresa i dërgohet prefekturës së Gjirokastrës.

¹⁰⁶³ AQSH, F. 294, V. 1931, D. 489, f. 15.

¹⁰⁶⁴ AQSH, F. 313, Pa vit, D. 673, f. 1-9. Fletë të shkëputura nga raporti i inspektorit të arsimit të nënprefekturës së Përmetit, mbi gjendjen e shkolla, numrin e nxënësve, karakteristikat e mësuesve. Mësuesi Prokop Bezhani, me moshë 32 vjeç, i martuar dhe me 2 fëmijë, kishte mbaruar qytetsen greke në Labovë për 7 vjet dhe më pas kreu kurse pedagogjike në Gjirokastrë dhe Labovë, por Ministria e Arsimit me shkresën Nr. 1364, datë 16.4.1930 pranoi dorëheqjen e tij dhe shkolla e Zhepës u mbyll.

¹⁰⁶⁵ AQSH, F. 294, V. 1931, D. 489, f. 15.

indiferencën e treguar ndaj tyre. Sipas tij, ata i linin punët pas dore dhe kujtoheshin në prag të fillimit të vitit shkollor, kur nuk mund të bëhej dot asgjë.¹⁰⁶⁶ Në shkallë nënprefekturë numëroheshin 27 fshatra me shkolla katërklasëshe, ndërsa shkolla me tri klasë kishte në 7 fshatra. Në 27 shkollat e fshatrave me katër klasë mësonin 1 519 nxënës. Prej tyre 538 ose 35 % e numrit të përgjithshëm ishin vajza. Në shtatë shkollat e përziera të fshatrave me tri klasë ishin 300 nxënës, 90 prej të cilëve vajza.¹⁰⁶⁷

Nisur nga vështirësitë financiare për të hapur një numër të madh shkollash, ministria kërkonte nga zyrtarët e pushtetit vendor të përcaktonin se cilat prej shkollave duhej të hapeshin menjëherë. Po ashtu, të dërgonin dhe listwn e godinave shkollore që kishin probleme dhe nevojitej kohë për të plotësuar kushtet. Ata jepnin mendim edhe për rastet kur lindte nevoja për transferimin e shkollave. I tillë ishte vendimi për zhvendosjen e shkollës nga Novosela në Bënjë, ndonjëse pleqësia nuk pajtohej me një veprim të tillë.¹⁰⁶⁸ Prefektura i kërkonte shpjegime Ministrisë së Arsimit, përse duhej të hidhej ky hap, kur mbeteshin fëmijët e një fshati pa shkollë.¹⁰⁶⁹ Me gjithë debatet e zhvilluara, zyrtarët e dikasterit të arsimit këmbëngulnin në përparësinë që kishte cilësia e godinës, pa të cilën nuk mund të arrihej përparim në arsim. Ata kishin vërejtur se godina e shkollës së katundit Bënjë ishte në gjendje më të mirë dhe mësimi mund të bëhej në kushte normale.¹⁰⁷⁰

Problematika në shkollat pesëklasëshe dhe kwrkesat e intelektualwve

Në vitin 1938, ministria kërkoi informacion të saktë mbi gjendjen e shkollave pesëklasëshe të nënprefekturës së Përmetit. Nga një verifikim i bërë rezultonte se godina e shkollës Mashkullore kishte 8 klasa mësimi dhe një dhomë për drejtorin e shkollës. Shkolla konsiderohej në gjendje të mirë dhe klasat ishin me përmasa që mund të mbanin nga 35 deri në 50 nxënës. Shkolla Femërore e Përmetit, që funksiononte nga viti 1917, qe e vjetër dhe antihigjenike. Për orenditë që mungonin, këshilli i shkollës vendosi të bliheshin nga fondi 5% i bashkisë. Më e domosdoshme gjykohej pajisja e dy dhomave të reja me orendi për 100 nxënës.¹⁰⁷¹ Puna erdhi duke u përmirësuar dhe në vitin 1938, shkolla ishte me 6 dhoma, të cilat vlerësoheshin relativisht në gjendje të mirë. Mjedisi i planifikuar për nxënësit e vitit të parë, merrte deri në 60 nxënës, ndërsa klasa e pestë 30 nxënës.¹⁰⁷²

¹⁰⁶⁶ AQSH, F. 152/8, V. 1930, D. 773, f. 28. Shkresë e ministrit të Arsimit, A. Dibra, Nr. 725, datë 30. I. 1930, dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme.

¹⁰⁶⁷ AQSH, F. 195, V. 1938, D. 90, f. 361-388. Raport vjetor mbi shkollat e inspektorisë së arsimit në Përmet, për vitin shkollor 1937-1938.

¹⁰⁶⁸ AQSH, F. 152/8, V. 1930, D. 773, f. 98. Shkresë e nënprefektit të Përmetit, Nevruz Taçi, Nr. 310/II, datë 15. II. 1930, dërguar prefekturës së Gjirokastrës. Në të sqaroheshin kërkesat e pleqësisë së fshatrave të tjera për problemin arsimor, ku vihej në dukje, se ankesë për shkollë kanë bërë edhe pleqësia e katundeve Novoselë dhe Tremisht, pasi Ministria e Arsimit kishte vendosur ta transferonte atë në Bënjë. Pleqësia këmbëngulte, që ajo të vijonte në Novoselë, për të mos i lenë pa mësim djemtë e Tremishtit.

¹⁰⁶⁹ AQSH, F. 152/8, V. 1930, D. 773, f. 100. Shkresë e ministrit të Arsimit, Hilë Mosi, Nr. 674/III, datë 31. III. 1930, dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme.

¹⁰⁷⁰ Po aty, f. 100. Shkresë e ministrit të Arsimit, Hilë Mosi, Nr. 674/III, datë 31. III. 1930, dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme.

¹⁰⁷¹ AQSH, F. 195, V. 1931, D. 27, f. 177. Pasqyrë përmbledhëse mbi shkollat në qarkun e Përmetit për vitin mësimor 1930-1931, datë 7. 07.1931.

¹⁰⁷² AQSH, F. 195, V. 1938, D. 90, f. 361-388. Raport vjetor mbi shkollat, e inspektorisë së arsimit të Përmetit, për vitin shkollor 1937-1938.

Shkolla 5 klasëshe përbëhej nga tri klasë, që përfshinin periudhën e ulët të mësim, dhe dy klasë pas tyre, që ishin shkalla më e lartë e shkollës. Lëndët zhvilloheshin sipas atij programi mësimor: Njohuri morale e qytetare; gjuhë shqipe (këndim, shkrim, drejtshkrim, hartim, gramatikë); aritmetikë dhe elemente të gjeometrisë; histori kombëtare, gjeografi; mësimë sendesh dhe elemente të shkencave; njohuri mbi higjenën; vizatim, bukurshkrim; këngë; punë dore; lojra dhe edukatë fizike.¹⁰⁷³ Në shkollën e vajzave, në klasën e tretë futeshin punët me gjelperë, si dhe ekonomia shtëpiake, ndërsa në shkollat e fshatrave bënte pjesë, si lëndë shtesë, mësimi për punët bujqësore.¹⁰⁷⁴ Në shkollën Femërore vajzat msonin punë dore, qepje dhe qëndisje, mënyrën se si mund të prisnin rroba, procese ku to mjaft të vlefshme për to, pasi nesër do të ishin mëma dhe gra nikoqire.¹⁰⁷⁵

Gjatë vitit mësimor 1937-1938, pesëklasëshe ishin shkolla Mashkullore e Femërore në Përmet, shkolla e Këlcyrës dhe ajo e Frashërit. Propozohej të hapej një klasë e pestë edhe në Malëshovë. Sipas inspektorit të arsimit ajo mund të ndiqej nga fëmijët e fshatrave Leskaj dhe Limar, të cilët qenë rreth 3 km larg. Banorët e atij fshati kishin përgatitur dhe mjedisin ku do të zhvillohej mësimi i klasës së pestë.¹⁰⁷⁶ Shkollat pesëklasëshe të nënprefekturës kishin 653 nxënës, nga të cilët 226 ose 36 % të tyre ishin vajza. Më konkretisht: shkolla Mashkullore kishte 297 nxënës, një pjesë e të cilëve vinin nga fshatrat në afërsi të qytetit të Përmetit. Madje për klasën e pestë vinin edhe nga fshatra më të largëta.¹⁰⁷⁷ Në shkollën Femërore ishin 185 vajza. Krahas vajzave të qytetit, shkollën e ndiqnin edhe vajza nga fshatrat Kutal, Leusë, Lipë dhe Qilarisht.¹⁰⁷⁸ Për t'u përmendur janë dhe shkolla e Këlcyrës me 99 nxënës, prej të cilëve 25 vajza dhe ajo e Frashërit ku nga 72 nxënës të regjistruar, 16 ishin vajza. Në vitet 1925-1940 janë pajisur me dëftesë lirim 397 nxënës, 75 për qind e të cilëve qenë femijë të besimit të krishterë.¹⁰⁷⁹

Intelektualët e Përmetit shfaqeshin të paknaqur me ecurinë e arsimit. Dy shkollat e qytetit deri në vitin 1929 ishin 6 klasëshe. Madje në klasat e pesta dhe të gjashta bëhej edhe mësimi i gjuhës frënge. Por pas atij viti, klasa e gjashtë u mbyll dhe shkollat mbetën sërish me 5 klasë. Megjithatë Ministria e Arsimit kishte deklaruar hapjen e tri klasëve qytetëse mbi shkollën fillore, një projekt i tillë në Përmet nuk u zbatua asnjëherë. Paria e qytetit kërkonte vazhdimisht të rriteshin klasat në shkollë pasi plotorja pesëklasëshe ishte e pamjaftueshme. Në funksion të këtij qëllimi, në vitin 1930 do të ngrihej një komision i kryesuar nga Agathokli Xhitomi dhe Sabri Muhtari. Ata i kërkonin qeverisë që shkollës plotore të Përmetit t'i shtonin "edhe dy klasë më të epëra".¹⁰⁸⁰ Sipas

¹⁰⁷³ Dekret-ligja organike e arsimit. Propozim i Kryeministrit Nr. 1315, datë 10.9.1934, dekretuar nga mbreti më 26 shtator 1934. Në: Fletorja Zyrtare Nr. 54, datë 28 shtator 1934, f. 8.

¹⁰⁷⁴ Po aty.

¹⁰⁷⁵ Gazeta Vatra, Nr. 50, datë 23 korrik 1933, f. 5. Rubrika: Vatra nëpër krahina. Përsëri për Përmetin (prej korrespondentit tonë shëtitës).

¹⁰⁷⁶ AQSH, F. 195, V. 1938, D. 90, f. 379. Raport vjetor mbi shkollat e inspektorisë së arsimit në Përmet, për vitin shkollor 1937-1938. Shënim: Për të dhëna më të hollësishme shih shtojcën në fund të librit.

¹⁰⁷⁷ AQSH, F. 195, V. 1938, D. 90, f. 361. Raport vjetor mbi shkollat e inspektorisë së arsimit në Përmet, për vitin shkollor 1937-1938.

¹⁰⁷⁸ Po aty, f. 362.

¹⁰⁷⁹ AQSH, F. 313, V. 1925, D. 609, f. 3-31. Evidencë e nxënësve që kanë marrë dëftesën e lirim në shkollën Plotore të qytetit të Përmetit.

¹⁰⁸⁰ Gazeta Shqiptare, Nr. 201, Bari 24 gusht 1930, f. 2. Artikulli "Nga Përmeti, me nëntitull "Shkolla 7-klasëshe".

komisionit, kjo ishte e domosdoshme, sepse po të bëhej shkolla qytetëse 7-klasëshe, fëmijët që mësonin “mund të hanin një kafshatë bukë si njerëz”.¹⁰⁸¹

Kërkesa e tyre ishte simbolike, pasi organizimi i shkollës me 7 klasë, si për djem dhe për vajza, kërkonte të shtohet në organikë vetëm një mësues dhe një mësuese.¹⁰⁸² Ministri i Arsimit Hil Mosi e kishte parë me vend lutjen e Përmetit. Në mbështetje të kësaj kërkesë, kryetari i bashkisë Themistokli Malo, pasi u këshillua me drejtuesit e shkollës, vendosi të financonte 600 lireta italiane “për blerjen e shumë sendeve didaktike, fizike dhe gjeografike”.¹⁰⁸³ Në një qytet ku mësonin 500 nxënës nuk do të ishte e tepërt të miratohej kjo kërkesë, pasi ishin qindra djem e vajza që rrinin nëpër shtëpi e shëtisin rrugëve, në një kohë që edhe gjatë pushtimeve të huaja Përmeti kishte patur shkolla 7-8 rendëshe.¹⁰⁸⁴ “Gazeta e Korçës” i drejtohej ministrisë të merrte parasysht kërkesën për çeljen e një shkolle 7-8 rendshe në Përmet, madje edhe shkolla e Këlcyrës me mbi 150 nxënës ishte e nevojshme të bëhej të paktën me 6 klasë, sepse Këlcyra ishte qendra e një krahine. Në shkollën e saj vinin nxënës edhe prej fshatrave të qarkut.¹⁰⁸⁵

¹⁰⁸¹ Po aty.

¹⁰⁸² *Gazeta e Korçës*, Nr. 1067, Korçë 28 gusht 1930, f. 4.

¹⁰⁸³ *Gazeta Shqiptare*, Nr. 303, Bari 21 dhjetor 1930, f. 1. Artikulli: “Korrespondenca e veçantë nga krahinat”. Nëntitulli: “Nga Përmeti. Veprimet e bashkisë”.

¹⁰⁸⁴ *Gazeta e Korçës* Nr. 1074, datë 23 qershor 1933, f. 1- 4.

¹⁰⁸⁵ *Po aty*, Nr. 1841, 15 dhjetor 1933, f. 2.

ORGANIZATA E TRAKTATIT TË ATLANTIKUT TË VERIUT; ROLI I ALEANCËS NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT DHE PËRHAPJES TË ARMËVE TË DËMTIMIT NË MASË

Orest Radhima

Abstract

Upon the conclusion of the cold war in the year 1989, which last symbol was the Berlin Wall, it was set forth the question: from now on what function the NATO organization would have, knowing that its creation and function during all the time had been based only over its opponent, *Warsaw Treaty*, which ceased functioning upon the wall drop. A lot of people thought, that upon the conclusion of the cold war and upon the communisms dropping, in analog mode would stop its existence NATO too. This thing did not happen, because the north alliance would have a completely different role and duty in the newly created situation. Now much more important duties were born to the alliance for being afforded, one of them was the war against the terrorism and the spread of the mass destruction weapons. During the years after the wall's dropping it has been seen an intensification of the military arsenal and that nuclear by some Asiatic and Arabian countries, whose dream was they had nuclear weapons in their arsenal too.

As it's known, up to the end of the cold war, there were only a fix number of countries of either of Soviet camp or that American which possessed atomic weapons. The dream of the Arabian-Asiatic countries for supplying themselves with atomic weapons, was not seen with a good eye by the world, by UNO, even more it was seen like a threat, because these countries are not as much as necessary conscious concerning the security, due to they were governed by extremist, dictatorial, monarchic governments, inherited with no point of democracy life at all, and which are precedents to the international arena. Just the same the war against the terrorism is a sufficient big wound, which last time has had in growing up inclination over the whole world. These things have made NATO be organized in such a way as to afford the new challenges the currently world has.

Abstrakt

Me mbarimin e luftës së ftohtë në vitin 1989 ku dhe simboli i saj i fundit ishte muri i Berlinit u shtrua pyetja që: tani e tutje organizata e NATO-s çfarë funksioni do të kishte, sepse krijimi dhe funksionimi i saj gjatë kësaj periudhe ishte bazuar vetëm në kundërshtarin e saj ; Traktatin e Varshavës, i cili pushoi së ekzistuari me rënien e murit. Por shumë veta mendonin që me mbarimin e luftës së ftohtë dhe me rënien e

komunizmit në mënyrë analoge duhet të pushonte së ekzistuari edhe NATO. Kjo gjë nuk ndodhi sepse gjatë kësaj periudhe aleanca e veriut do të kishte një rol dhe detyrë krejt të ndryshme në situatën e re të krijuar. Tani për aleancën dolën detyra shumë më të rëndësishme për t'u përballur, një nga këto ishte dhe lufta ndaj terrorizmit dhe përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë. Në vitet pas rënies së murrit është vënë re një intensifikim i arsenalit ushtarak dhe atij bërthamor nga disa shtete azjatike dhe arabe, të cilat ëndërronin që në arsenalin e tyre të kishin edhe ato armë atomike.

Siç dihet, deri në fund të luftës së ftohtë kishte vetëm një numër të caktuar shtetesh si nga kampi sovjetik edhe nga ai amerikan që dispononin armët atomike. Ëndrra e shteteve arabo-azjatike pët t'u paisur ma armë atomike nuk u pa me sy të mirë nga bota, OKB-ja bile e shikoi si një kërcënim sepse këto vënde nuk janë aq të ndërgjegjshme nga ana e sigurisë sepse qeverisen nga qeveri ekstremiste, diktatoriale, monarkike të trashëgueshme pa as një pikë jete demokracie dhe janë precedent për arenën ndërkombëtare. Po kështu dhe lufta kundër terrorizmit është një plagë goxha e madhe, e cila kohët e fundit ka një tendecë në rritje në të gjithë botën. Këto kanë bërë që NATO të organizohet në mënyrë të tillë që ti bëjë ballë këtyre sfidave të reja që ka tani bota.

Roli i aleancës në luftën kundër terrorizmit dhe përhapjes së armëve të dëmtimit në masë.

Një nga sfidat e reja të rëndësishme që po përballlet tani NATO është edhe lufta kundër terrorizmit ndërkombëtar dhe armëve të shkatërrimit në masë, kjo sfidë e re mori një drejtim shumë më të organizuar mbas sulmeve terroriste të 11 shtatorit të vitit 2001. Siç dihet kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës u përdorën avionët e linjave të shërbimit civil si armë të shkatërrimit në masë; ky veprim na ka bërë të kuptojmë mënyrën se si është ndryshuar konteksti i sigurisë pas mbarimit të Luftës së Ftohtë dhe shfaqja e formave të reja, të cilat rrezikojnë shoqërinë civile bashkohore.

Në përgjigje të kësaj situatë të re të krijuar, aleatët kanë thirrur për herë të parë artikullin 5 të Traktatit të Ushingtonit që ndërton mekanizmin e mbrojtjes kolektive të NATO-së, për t'u dhënë një mbështetje politike dhe praktike Shteteve të Bashkuara të Amerikës në përgjigjen e tyre kundër sulmeve terroriste, për të bërë të mundur përmisimin e kapaciteteve të Aleancës në përballimin e kërcënimeve terroriste ndërkombëtare. Sigurisht që evenimentet e 11 shtatorit të vitit 2001, kanë shkaktuar një goditje të rëndë për Aleancën, por NATO kishte shumë vite që kishte filluar të adaptonte pikërisht mentalitetin operues për të përballur këtë kontekst të ri të sigurisë ndërkombëtare. "Në vitin 1999, aleatët kishin aprovuar dokumentin që përmblihte sfidat, që NATO duhet të përballojë, duke përcaktuar edhe mënyrën se si duhet ta bëjë një gjë të tillë. Ky dokument e konsideronte terrorizmin si një kërcënim serioz përse i përket periudhës pas Luftës së Ftohtë"¹⁰⁸⁶. Pra, sipas situatës së re të krijuar në botë, kërcënim serjoz për vëndet anëtare të NATO-s nuk janë vetëm shtetet e mëdha që kanë interesa influence dhe shfrytëzime të kundërta me Aleancën, por edhe vëndet që konsiderohen të (dobëta), që kanë vështirësi që të integrohen në sistemin ndërkombëtar. Këto vënde të vogla që në shumicën e rasteve kanë sisteme tranzitore ose demokraci të reja në formë dhe provojë, mund të shndërrohen në 'Shtete të Falimentuara'. Këto shtete duke qënë se ndodhen në fazë tranzitore, ose me rregjime të reja dhe të paqëndrueshme

¹⁰⁸⁶ http://www.nato.int/docu/review/2009/Organized_crime/Terrorism_relation_organized/ndex.htm

demokratike, organizatat e fuqishme terroriste kanë më shumë hapësira dhe mundësi që me shuma të mëdha parash të korruptojnë udhëheqësit e këtyre vëndeve të dobëta dhe të vogla duke i kthyer në shtete satelite në shërbim të objektivave dhe interesave të tyre terroriste. Prandaj, jo rastësisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës po ju kushtojnë një rol dhe vëmëndje të veçantë shteteve të kësaj natyre. Megjithatë ashtu siç e ka treguar historiku i saj, NATO është në gjëndje që të përballojë me sukses sfidat e reja, sepse afron mjete efikase ushtarake dhe politike të kordinuara mirë, afron një kornizë multilaterale që legjitimon dhe forcon zgjedhjet e aleatëve duke garantuar sigurinë e tyre mbi bazën e ndërhyrjeve dhe kordinimeve reciproke me qëllimin e vetëm për të siguruar dhe garantuar sigurinë kolektive. “Me këto sfida të reja që po shfaqen, NATO në një proces transformimi ushtarak është në një proces dinamik të cilit nuk i parashikohet fundi”¹⁰⁸⁷.

Trasformimi ushtarak sjell pësosjen në paisje dhe teknologji, po ashtu sjell pësosjen tek ushtarakët, si dhe tek strukturat dhe parimet që udhëheqin dislokimin e forcave dhe drejtimin e operacioneve ushtarake. Transformim do të thotë evoluim, do të thotë futje e institucioneve të rinj për të plotësuar detyra të tilla si paqeruajtja, menaxhimi i krizave, lufta kundër terrorizmit, parandalimi i armëve të dëmtimit në masë. Transformim do të thotë, ti përgjigjesh me një shkallë më të gjërë reziqesh. Por ky proces transformimi nuk duket se do të jetë aq i lehtë. Prioritetet në transformimin e forcës po ndryshojnë çdo ditë. Probleme të kufizimeve të buxhetit nuk janë vetëm për vëndet e varfëra por edhe për vëndet e pasura. Nuk janë jashtë këtyre problemeve as edhe SHBA dhe Europa të cilat gjithashtu po përballen me mungesën të fondeve të mjaftueshme për modernizimin e forcës.

Ngjarjet e 11 shtatorit në Amerikë, përvoja e operacioneve në Afganistan, eksperiencia e Irakut, reziku i prodhimit e përdorimit të armëve bërthamore nga Koreja e Veriut, Irani apo grupet terroriste kanë bërë që t’u jepet prioritet i njëjtë si luftës urbane, ashtu dhe lëvizjeve kryegritëse, si luftë kundër terrorizmit ashtu dhe mbrojtjes së vëndit. Kjo ka bërë gjithashtu që të bashkëpunohet më shumë ndërmjet agjensive të ndryshme, duke krijuar komponente civile që mundë të kryejnë detyra të sigurisë kombëtare si dhe duke u caktuar ushtarakëve role në ndërtimin e vëndit, të ruajtjes së paqes dhe operacioneve të stabilitetit. Lufta e Irakut ka treguar p.sh. se inteligjenca, vëzhgimi dhe zbulimi kanë një rëndësi shumë më të madhe sesa të kesh avionët më të avancuar teknologjikë. Kjo luftë ka treguar që edhe platforma e armatimit ekzistues mund të adaptohet për misionet e reja. Kjo mundë të thuhet si për tanket e mjetet e blinduara, ashtu edhe për helikopterët dhe mjetet e vetë drejtuara të cilat mundë të përdoren me sukses qoftë në qëndrat e banuara ashtu dhe në luftën kundër terrorizmit. Vetë SHBA-ja si vëndi që ishte në shënjestrën e terrorizmit që në fund u finalizua me goditjet e dy kullave binjake në New York, dëmet njerzore, matriale, ekonomike e njësjërë sektorësh qenë me përmasa të pa para ndonjëher në kohët moderne. Kjo bëri që të vihej në pikpyetje sistemi i sigurisë në vëndin më të fuqishëm të botës dhe i cili me ndima te shumë llojshme jashtë kufive të vetë kishte luftuar terrorizmin ekstremis fundamentalist. Megjithatë ishte hera e parë që në kohët moderne u panë këto lloj sulmesh të papara ndonjëherë si në SHBA e më gjërë, kjo tregoi që tani e tutje duhet bërë një riorganizim i thellë dhe të dilnin në pah kush nga mekanizmat nuk ka efektin e duhur.

¹⁰⁸⁷ S.Cami, *Drejt Natos*, Tiranë, Vatra, 2004, f.201

Por kur SHBA-ja me kualicionin anti-terror në konfliktet në Irak dhe Afganistan u vunë në pah aftësitë dhe eksperiencia njerzore e njësive civile-ushtarake dhe kapaciteteve që bazohen në luftra urbane, kjo një e re në ushtrit që deri më parë kishin bërë luftra frontale sipas koventave në fuqi ku pala tjetër ka uniformën përkatëse etj.

Lufta kundër terrorizmit, paqëruatja dhe ndërtimi i paqes, ndërtimi i vëndit dhe stabilitetit i tij, janë fusha që kërkojnë aftësi dhe provojë njerëzore ku njerzit luajnë rolin madhor. Forcat speciale, policia ushtarake, ekspertët e inteligjencës, njësitë mbështetëse, janë shëmbuj të aftësive transformuese që kërkojnë, më shumë se sa sistemet e teknologjisë së lartë. Po kështu, përgjigja brënda vëndit në rast emergjencash civile apo kundër sulmeve terroriste kërkon gjithashtu forca të përgjigjes emergjente. Edhe këtu kapacitetet civile mund të jenë po aq të rëndësishme sa edhe ato ushtarake, pra edhe aty nevojitet transformimi në kuptimin e plotë të fjalës. Për ekspertët e luftës kundër terrorizmit, ata të sigurisë së teknologjisë së informacionit, të mbrojtjes së infrastrukturës kritike, paisjet dhe ekspertët e specjализuar të mjekësisë, reaguesit e menjëhershëm ndaj emergjencave (zjarrfikësit) janë po aq të rëndësishëm për sigurinë kombëtare sa edhe forcat ushtarake. Nevojat e prodhimit dhe përdorimit të armëve jo vrasëse janë duke ardhur gjithnjë e më shumë për diskutim në axhendën transformuese të aleancës.

Samiti i NATO-s që është mbajtur në Pragë, ka bërë ato që thamë më lart dhe të pranojë antarë të rinj. A leanca ushtarake pritet t'i bëjë publike planet për forcën e re të ndërhyrjes së shpejtë, e cila do të luftonte terrorizmin dhe do të përbëhej prej 20 mijë ushtarësh. Por Evropa tanimë e ka filluar procesin e krijimit të forcave të saj të ndërhyrjes së shpejtë. Nuk është e qartë nëse këto forca do të jenë bashkëpunuese me njëra tjetrën. NATO-ja ka gjasa që do ta shfrytëzojë në samitet e ardhëshme për të bërë një rishqytim të përgjithshëm të misionit, me shpresë që transformimin e aleancës mbrojtëse t'a orjentojë drejt luftimit të terrorizmit. "Në samitin e Pragës gjithëashtu, qeveritë e vëndeve të NATO-s miratuan zbatimin e pesë nismave mbrojtëse të Aleancës kundër armëve të dëmtimit në masë".¹⁰⁸⁸ Pjesë kyçe e transformimit është krijimi e një force për ndërhyrje të shpejtë, e cila do tu, përgjigje kërcënimeve gjithandej, madje edhe jashtë kontinentit evropian. Ndryshimet do të ishin kthesa më radikale që nga formimi i NATO-s në vitin 1949, por duhet theksuar që bota e këtij shekulli nuk është ajo e shekullit të kalur dhe sfidat dhe metodat e sigurisë janë bërë gjithënjë e më të vëmëndëshme ndaj këtyre risive të reja.

Problem madhor që duhet theksuar po ashtu është se nga shpërbërja e ish-republikave Sovjetike një pjesë e mirë e stoqeve ushtarake të trashëguara ishin dhe armët konvecionale, kimike, biologjike, bërthamore të cilat u ngelën tërë këtyre republikave si në kaukaz, evropën juglindore, si dhe vënde simpantizante të Bashkimit Sovjetik. Por me ndryshimet demokratike dhe panvarsisë së këtyre shteteve, lidert e tyre nuk qenë aq të përgatitura për këto ndryshime rënjësore dhe për terroristët u panë si shtete të falimentuara dhe mund të penetrohej lehtë ti komandoje e ti shfrytëzoje stokun e tyre të armëve të rezikëshme. Kjo gjë për demokracitë e konsoliduara evropiane dhe amerikane ishte mjaft kërcënuese dhe duhet të menaxhohej me mjaft kujdes për ta patur nën kontroll. Vëndet më problematike përgjithësisht shikoheshin në ish-republikat B.S të cilat ishin reth Detit të Zi e deri në Kazakistan, edhe për faktin se edhe për vetë B.S

¹⁰⁸⁸ Manuali i Natos-s, Brussel 2006, f.182

luftrat në Afganistan, Oseti, Gjorgji, Çeçeni etj. Luftrat e vazhdueshme për pushtet, për klane dhe fise për të drejtuar këto republika dhe përfundonin o me vendosjen e diktaturave ose shteteve fondamentaliste ekstremiste me pikpamje fetare.

Sulmet terroriste ndaj Amerikës dhe ndryshimi i madh në luftën ndaj tij

Më 11 shtator 2001 në New York të SHBA-së u bë sulmi i parë terrorist ndaj kullave binjake dhe gjysmë ore më pas ndaj kullës së dytë ku u përdorën dy avion të rrëmbyer të linjave lokale brënda Amerikës, të cilët u përdorën si armë të shkatërrimit në masë dhe mburojë njerzore për të bërë sulmin. Në sy të gjithë botës së qytetruar u pa se si u shëmbën dy kullat me një interval të vogël kohor, brënda tyre u zunë me mijra punonjës dhe njerëz të skuadrave të shpëtimit. Po ashtu një tjetër avion i rrëmbyer përplasat me pentagonin duke shëmbur një pjesë të tij ku dhe këtu pati viktima të shumtë në radhët e stafit ushtarak, ndërsa një tjetër u hodh në erë në ajër nga avionët e ushtrisë para se të arrinte në objektivin kamikaz. E reja që doli në pah ishte që tani terroristët nuk ndërmernin më veprime dhe akte jashtë kufijve të vëndit më të fuqishëm të botës, por brënda tij dhe aleatëve të tij që dukeshin si të pa prekshëm dhe të pa arritshëm.

Kështu për NATO-n ishte prekur aleati i saj më i rëndësishëm dhe kjo bënte një precedent edhe për aleatët e tjerë biles në një nga dispozitat kur u themelua NATO është edhe një nga pikat kyçe të traktatit ku thuhet : Në qoftëse një pjestar i aleancës së veriut sulmohet atëhere janë sulmuar indirekt edhe pjestarët e tjerë dhe këta të fundit duhet ti vinë në ndihmë. Kështu si në SHBA edhe evropianët e panë me vëmëndje të madhe ecurinë se si do shkonin ngjarjet dhe riorganizimin e pritshëm me direktivat e reja. Shtabi i përgjithëshëm në Bruksel u mblodh dhe u pronocua : “Ata janë të mendimit sa për të luftuar terrorizmin është e nevojshme një përpjekje gjithëpërfshirëse që do të bashkonte veprimet politike, ekonomike, diplomatike, ushtarake si dhe masat shtrënguese ligjore”¹⁰⁸⁹.

Kështu më 4 tetor 2001, me kërkesën e SHBA-së, vëndet aleate të NATO-s ranë dakort për marrjen e tetë masave që do të sillnin zgjerimin e mundësive përzgjedhëse, të përshtatëshme për fushatën kundër terrorizmit. Në këto tetë masa përfshiheshin :

1-Zgjerimi i shkëmbimit të të dhënave të zbulimit.

2-Ndihmesa ndaj shteteve që kërcënohen si pasojë e mbështetjes së përpjekjeve të kualicionit.

3-Forcimi i sigurisë për Shtetet e Bashkuara dhe për objektet e tjera të aleatëve nëpër territoret e tyre.

4-Rezerva plotësuese për mjetet e përzgjedhura të aleatëve që nevojiten për të mbështetur operacionet kundërterroriste.

5-Të drejta mbulimi ajror për aeroplanët e Shteteve të Bashkuara dhe të vëndeve të tjera aleate, për fluturime luftarake lidhur me operacionet kundër terrorizmit.

6-E drejta e hyrjes në porte dhe aerodrome.

7-Përhapja e forcave detare të NATO-s në Mesdheun Lindor.

Kështu që masat e marra në kohë shumë të shpejt bënë që autoritet të kalonin në gjëndje të jashtë-zakonshme, për të krijuar besimin komplet të humbur gjat sulmeve. Edhe mbrapa shtatorit muaji pasardhës e deri në dhjetor në SHBA kishte një psikozë frike se sulmet mund të përsëriteshin dhe mund të ishin dhe të tipeve; vendosja e

¹⁰⁸⁹ Po aty, f.18

bombave në kafene ose në vënde të tjera ku ka shumë njerëz, ndoshta përsëriteshin raste të rrëmbimit të avionve të tjerë, etj. Kjo krijoi një gjëndje pasigurie dhe ankthi të vazhdueshëm për të gjithë popullësinë megjithëse e keqja tragjike kishte kaluar por mesazhet kërcënuese që vinin ishin : “ Ne nuk largohemi, ne do t’ju bëjmë fatkeq deri sa ju të na kushtoni vëmëndje”¹⁰⁹⁰.

Administrata Bush me shpejtësi kaloi disa ligje që binin ndesh me të drejtat e njeriut dhe privatsinë e individit pou miratuar nga kongresi edhe për faktin që flitej që duhet të kishte akoma celula aktive brënda SHBA-së dhe ato ishin gati të godisnin nga momenti në moment. U bënë dhe shumë ndryshime në ligjin e emigracionit po ashtu u vunë re masa shumë shtrënguese kryesisht për shtetas nga lindja e mesme që kërkonin te jetonin në Amerikë.

Përfundime

1. NATO me mbarimin e luftës së ftohtë jo vetëm që nuk pushoi së ekzistuari por u rrit u forcua e konsolidua në të rejat që solli koha.
2. NATO nga dita në ditë po prefeksionohet ushtarakisht si në arsenalin luftarak dhe në atë njerëzor, në mënyrë që ti përshtatet evenimenteve të reja që paraqiten në të gjithë globin në luftën që po zhvillohet kundër terrorizmit dhe taktikave të tij.
3. NATO është një organizatë politiko-ushtarake, ombrellë për shumë vënde e popuj që luftojnë për liri dhe demokraci kundër regjimeve totalitare dhe atyre që ëndërrojnë të kenë në duart e tyre armët e dëmtimit në masë, apo që u imponohen vëndeve të lira me doktrina politiko-fetare.
4. Ngjarjet terroriste 2001 angazhuan NATO-n më shumë se kurrë ndaj luftës kundër terrorizmit duke dalë hapur në misionet e reja si në Afganistan e më gjërë.
5. Në përfundim konkludojmë se, nëqoftëse NATO kërkon të arrijë të përballojë sfidat që paraqet mjedisi i sotëm i sigurisë, ajo duhet të angazhohet dhe të ushtrohet për një transformim më të gjërë se sa është konceptuar dhe po konceptohet ende. Ky koncept i një transformimi më të gjërë nuk i bën të pavleshme planet e sotme mbi transformimin ushtarak.

¹⁰⁹⁰ Joshua S. Goldstein, *Mardbënie Ndërkombëtare*, Soros 2001, f.232

FORTIFIKIME NË SHALË TË BAJGORËS

Phd. Pajazit Hajzeri

Kështjella e Boletinit

Fshati Boletin shtrihet 5 km në veri të Mitrovicës. Është vendbanim i tipit të shpërndar i ndar në tri lagje.

Në lokaliteti e quajtur Boletini i Vjetër, gjenden gërmadhat e një kështjelle të vjetër. Gërmadhat e kështjellës gjenden tek vendi i quajtur *Kërsbi i Vodicës*, në koordinatat gjeografike 42°55'59.2"N 20°51'04.8"E. Lokaliteti në fjalë, ishte një kështjellë, e cila kishte për synim mbrojtjen e luginës së Ibrit. Kështjella nuk komunikonte drejtpërdrejt me kështjellën e Zveqanit, mirëpo, pika më e lartë në anën lindore Sokolica (918 m.), komunikonte me të dy kështjellat, të Boletinit dhe të Zveqanit.

Gërmadhat e kësaj fortifikate gjenden rreth 2.5 - 3 km larg nga Kullat e Isa Boletinit në drejtim të perëndimit. Kjo kështjell komunikonte mirë me luginën e Ibrit dhe ishte pararojë e rrugës që lidhte Municipiumin DD me burimet e xeheroreve që gjenden në këtë trevë.¹⁰⁹¹

Në gërmadhat e kësaj kështjelle janë gjetur gjurmët e murit verior i cili ende është dëshmi e ndërtimit, që përbëhet nga gurë i lidhur me llaç gëlqereje. Nga kjo kuptojmë se kështjella i takon periudhës Iliro-romake. Në gërmadhat janë gjetur edhe pjesë të qeramikë, përveç qeramikës ka edhe material tjetër që është përdorur për ndërtimin e mureve si tulla. Materiali ndërtimor është vendor, pasi që Boletini njihet për materialin e gurit shumë cilësor i cili përdoret për ndërtimin e gurëve të mullirit, dhe ndërtimin e monumenteve të ndryshme për banim.

Fortifikata në fjalë, sipas të gjitha gjasave shërben edhe gjatë mesjetës për nevojat e raguzanëve, të cilët ishin të pranishëm në qytetin e Trepçës, dhe kështjella ju shërbente si konsullat¹⁰⁹² e cila i përcillte punët e tregëtis dhe karvanet me minerale nga miniera e Trepçës për në Novi Pazar e Raguzë.

¹⁰⁹¹ Treva në fjalë është ka xeherore përveç në Trepçë, në Cerajë, Vllahi, Ziaçë, Magjerë, Melenicë, Vidishiq, Mazhiq e fshatra të tjera ku edhe sot e kësaj dite gjenden mbeturina të zgjyrit të xehes, ku bëhej shkrirja dhe përpunimi i xehes.

¹⁰⁹² Kështjella e Boletinit në popull njihet me variante të ndryshme, si: Kështjellë, Gjytet, Konzullata raguzane, fshati i vjetër etj.



Pjesë muri në kështjellën e Boletinit




Qeramikë e gjetur në Kështjellën e Boletinit

Nga kështjella përveç grykës së Ibrit kontrollohej edhe një pjesë e madhe e territorit të Shalës së Bajgorës duke përfshirë fashatrat, Boletin, Zhazhë, Vllahi, Rahovë, Vidimriq, Rudar, Grabovc, Vallq, Bugariq (Serbovc), Zherevnicë, me të cilat komunikonte drejt për drejt.

Aleksandër Deroko përmend një kështjellë me emrin (Kllopotnik), që do të thotë "Kështjella e Mbyllur" e cila ndodhet rreth 11 km larg nga qyteti i Mitrovicës,¹⁰⁹³ mirëpo nuk e sqaron vend-ndodhjen e saj, ku mendoj se afërsisht me largësinë nga Mitrovica ndodhen gërmadhat e kështjellës së Boletinit të cilat ruhen në një lokacion të mbyllur, në majë të një bregoreje të mbrojtur nga të katër anët nga natyra.

Shkallë, Kështjella e Boletinit



Kështjella e Potokut,
Vesekofc-Shalë e
Bajgorës

Kështjella e
Potokut, Vesekofc -
Shalë e Bajgorës gjendet
në koordinatat
gjeografike
42°55'47.2"N
-
21°04'32.5"E, në një
zonë të thellë malore në

mesë Kaqanollit dhe Bradashit, fshat në Llap. Kjo kështjellë ishte pararojë e rrugës

¹⁰⁹³ A. Deroko, Srednjekovi, op. cit. p. 170.

Trepçë - Llap e cila shfrytëzohej për tregëtinë e xehes së xeheroreve nga miniera e Trepçës.

Kështjella e Potokut gjendet në një lartësi mbidetare prej 1170 m, dhe ka një pozitë shumë të mirë gjeografike duke përcjellur rrugën nga Mitrovica në Prishtinë e Llap dhe nga Mitrovica për në Llap. Kështjella e Potokut nga të katër anët është e mbrojtur nga natyra, mbrojtja nuk është shëkëmbore, por nga pjerrtësia shumë e madhe. Kështjella komunikonte përmes dy rrugëve që të shpënin në të, dhe dy portave hyrëse. Njëra hyrje në kështjellë ishte nga lindja nëpërmes një rruge që vinte pran murit rrethues qysh prej veriut i sillej kështjellës përreth, ndërsa hyrje tjetër ishte nga perëndimi dhe komunikonte me lumin e Kaqanollit. Kështjella është ilire, pasi që teknika e ndërtimit të mureve ishte guri i pa latuar, pra i pa gdhendur dhe ndërtimi i tij ishte pa material lidhës (i thatë). Rrethoja e murit të kështjellës ishte e pa ndërprer në një territor të jashtzakonshëm me një pozitë imponante ku përfshinte një hapsirë prej 3.5 ha. Pika më e lartë në kështjellë ishte pika veriore ku relievi shkonte gradualisht duke rënë në drejtim të jugut. Kështjella ka shtrirje meridionale, kulla kryesore mbrojtëse ishte në veri ku ruheshin rrënojat e mureve 4 deri 5 metra, por tërësisht të mbuluar nga vegjetacioni. Ngjitur me kullën veriore ndodhej edhe objekti i kultit me përmasa shumë të mëdha edhe me pa mundësi të matjes së përmasave për shkak të vegjetacionit, ky objekt kulti në popull njihet si Kisha e Kështjellës.

Nuk vëreheshin kulla mbrojtëse të tjera për gjatë gjithë muri, përpos që muri ishte i ndërtuar në rrethin më të lartë në malit konik të ngritur nga lugina e lumit të Kaqanollit si pika më e ulët e relievit në afërsi të kështjellës. Kështjella komunikonte me lumin edhe përmes një dalje sekrete në formë kanali. Një legjende për këtë dalje sekrete në popull flitej se nga kështjella nëpër atë dalje për çdo ditë, kanë dalur shotat kanë shkuar në lum dhe janë kthyer në mbramje pa i vrejtur askush. Për shkak të vegjetacionit dhe mungesës së gërmimeve arkeologjike ishte e pamundur të vëreheshin të gjitha detajet e hyrje - daljeve, aq më tepër atyre daljeve sekrete.

Prania e mureve ishte e përhapur gjithandej nëpër brendinë e kështjellës, ku kishte gjurmë të ndërtesave të tjera. Përveç materialit ndërtimor gurit, në kishën e kështjellës ishte i pranishëm edhe material lidhës llaç gëlqereje, ndërsa tulla dhe qeramika ishin të pranishme por në sasi shumë të vogël. Kryesisht edhe tulla gjendej në veri dhe lindje, pjesë nga ishin të përhapura rrënojat e kishës.

Kështjella si mburoj të parë kishte në pjesën fundore të kësaj kodre konike një mburoj nga ledhe dheu, e cila shkonte diku rreth dy deri tri metra e lart pjesa e jashtme, ndërsa pjesa e brendshme kishte një hapësirë rreth dy metra dhe shërbente për rrugë. Ngjitja për në kështjellë ishte tejet e vështirë për shkak të pjerrësisë së terrenit.

Një pozitë shumë e mirë gjeografike, një komunikim me gjithë Rrafshin e Kosovës, Ultësirën e Llapit, viset e Shalës së Bajgorës të pasura me miniera dhe minerale, një sipërfaqe shumë të madhe në brendi të kështjellës, një objekti kulti aq madhështor sa ishte kisha e kështjellës, të lë përshtypjen se aty ishte seli e ndonjërit nga mbretërit e Mbretërisë Dardane.

Kjo lidhet edhe me faktin dhe legjendat e përciellura ndër breza, se kjo kështjellë ishte shumë e pasur dhe ruante në rrënojat e saj në pasuri shumë të madhe në ari.

Kështjella është në pronësi të Riza Kajtaz Tërnkollit, në parcel kadastrale të Komunës së Vushtrris, të cilën e mbikqyrë i biri pas vdekjes së pronarit, Hamdi Riza Kajtazi. Si rezultat i moskujdesit për këtë Kështjellë përveç rrënimin nga koha dhe

vjetërsia, rrënimet i kishte ndihmuar edhe faktori njeri, duke marr gurët për ndërtimin e shtëpive dhe murosjen e puseve (bunarëve) për uji.

Në pjesën veri lindore të Kështjellës ndodhej një bregore e përmasave mesatare e cila të linte përshtypjen e një kodërvarri (një tume), e cila ishte mu rrëzë kështjellës. Me këtë rastë ju bëjë thirrje të gjitha strukturave shtetërore që meren me këtë fushë studimi, ta kthejnë vëmendjen nga kjo kështjellë dhe të fillohet me gërmimet arkeologjike për të zbardhur të vërtetën e të kaluarës së lashtë ilire në këto treva.

Gjurmë të tullave dhe harasanit në Kështjellën e Potokut
Mur ne brendi të Kështjellës



QËNDRIMI I SHQIPËRISË NË KONFERENCËN I BALLKANIKE TË MINISTRAVE TË PUNËVE TË JASHTME BEOGRAD, 26-28 SHKURT 1988 (NË DRITËN E BURIMEVE ARKIVORE DIPLOMATIKE SHQIPTARE)

Prof. Asoc. Dr. Pranvera Dibra Teli

Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore vendet e Ballkanit, rajon i përshkruar në mënyrë konstante në konotacionin negativ, si një sferë gjeopolitike problematike, si zonë permanente konflikti,¹⁰⁹⁴ hynë në një periudhë ndryshimesh e zhvillimesh të rëndësishme si në planin e brendëshëm, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Për shkak të pozicionit të tij gjeostrategjik në kufijtë periferikë të blloqeve të mëdha politike e ushtarake me orientime të ndryshme politike dhe nën ndikimin e tyre, rajoni u kthye në një tregues të ekujlibrimit të madh gjeopolitik, që pasqyronte çdo tendencë konflikti ose bashkëpunimi në marrëdhëniet ndërkombëtare të kohës. Pas mesit të viteve '80-të, kur zhvillimet ndërkombëtare po ç'tensiononin marrëdhëniet midis blloqeve, për rajonin krijoheshin hapësira bashkëpunimi. Kjo rrethanë e kombinuar me zhvillimet e brendshme të shteteve ballkanike, të cilat po çonin drejt krizës së sistemit, aktivizoi dukshëm procesin e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit ballkanik. Arritja më e rëndësishme për përmirësimin e atmosferës së nderë në rajon ishte takimi i parë i te gjithë Ministrave të Jashtëm të vendeve të Ballkanit me 26-28 shkurt 1988 në Beograd. Vendet ballkanike nuk trashigonin asnjë eksperiencë historike në këtë drejtim. Për herë të parë në këtë takim merr pjesë edhe Shqipëria me një delegacion të drejtuar nga Ministri i Punëve të Jashtme Reiz Malile, duke e kthyer atë në një takim historik.

Pas vdekjes së Hoxhës dhe zhvillimit të krizës së brendëshme ekonomike, pasojë e sistemit dhe izolimit ndërkombëtar të Shqipërisë, në presionin edhe të zhvillimeve në Moskë dhe qëndrimeve të reja të Mihail Gorbaçov, Alia përpiqet të bëjë hapjet e para drejt bashkëpunimit rajonal dhe më gjërë. Shqipëria nuk kishte marrë pjesë deri tani në takimet e mirëfillta politike në nivel rajonal, dhe nuk kishte mbështetur propozimet për mbledhje të nivelit të lartë të vendeve ballkanike, propozuar nga qeveria greke apo ajo rumune. Qeveria shqiptare i ishte përmbajtur vazhdimisht pikëpamjes se në kushtet kur ekzistonin probleme të rëndësishme në marrëdhëniet midis disa vendeve në rajon, rruga më e mirë ishte ajo e bashkëpunimit dypalësh për zgjidhjen e problemeve.¹⁰⁹⁵

¹⁰⁹⁴ Bashkim Rama, Ballkani pas rënies së murit të Berlinit, Tiranë 2013, fq.9.

¹⁰⁹⁵ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej – AMPJ), V.1988.D.1286, Fl.32, Informacion i Drejtorisë së Tretë lidhur me aktivitetet ballkanike, prill 1988.

Sekretari Federativ për Punët e Jashtme të Jugosllavisë Raif Dizdarevic që në fund të prillit 1987 e kishte bërë publike në mediat jugosllave idenë se kishte ardhur koha për një takim të Ministrave të Jashtëm të vendeve ballkanike, për të nxitur dialogun, mirëkuptimin, dhe bashkëpunimin ballkanik, si pjesë e procesit të përgjithshëm të bashkëpunimit evropian, e se kështu mund të ndihmohej detanta që kishte filluar midis lindjes e perendimit. Në fakt në kohën që kjo ide bëhej publike nga qeveria jugosllave, Jugosllavia po paraqitej përherë e më tepër jo si faktor mirëkuptimi dhe bashkëpunimi në Ballkan, por si “grindaveci” i Ballkanit, si një shtet që ndikonte negativisht për sigurimin e stabilitetin në rajon. Për krahun federalist të udhëheqjes jugosllave kjo tendencë po shihej përherë e më me shqetësim, shqetësim që lidhej sidomos me sigurimin në të ardhmen të ndihmave ekonomike, pasi Jugosllavia po humbiste besimin e partnerëve të saj, sidomos atyre perendimorë. Thirrja e kësaj Konference ishte një rast i mirë për qeverinë jugosllave për të demonstruar se Jugosllavia ishte akoma në gjendje të luante një rol në fushën ndërkombëtare, në mos në shkallë botërore, të paktën në atë rajonale në Ballkan.

Menjëherë pas bërjes publike të kësaj iniciative, reagimet nga qeveritë e vendeve ballkanike ishin pozitive, në mbështetje të organizimit të këtij takimi historik për politikën ballkanike, si një mundësi që ballkanasit të merrnin vetë në dorë sigurinë e tyre e të shkeputeshin nga varësia e shteteve të mëdha dhe blloqeve politiko-ushtarake.¹⁰⁹⁶ Interesi rritej për qëndrimin që do të mbante qeveria shqiptare.¹⁰⁹⁷

Dizdarevic kreu takime individuale me të gjithë ambasadorët e shteteve ballkanike të akredituar në Beograd. Në këto takime ai u dorëzoi ambasadorëve edhe letrat përkatëse për ministrat e tyre të jashtëm lidhur me organizimin e takimit të ministrave të jashtëm të vendeve të Ballkanit. I fundit ambasador që takoi, ishte ambasadori shqiptar, Z. Kujtim Hysenaj. Takimi u zhvillua me 27 maj 1987, ora 17.30. Në këtë takim, Dizdarevic dorëzoi letrën për Ministrin e Punëve të Jashtëm Reis Malile, duke e konsideruar nga ana e Jugosllavisë këtë akt si fillimi zyrtar i iniciativës për mbledhjen e ministrave të jashtëm të vendeve të Ballkanit.¹⁰⁹⁸ Ministria e Punëve të Jashtëm e Shqipërisë ishte vënë më herët në dijeni për këtë iniciativë nëpërmjet ambasadorit jugosllav në Tiranë Pribiçeviç. Në takimin me Ambasadorin Hysenaj, Dizdareviç u shpreh se përmirësimi i klimës politike në Ballkan ngushtonte hapësirën për veprimin e Fuqive të Mëdha dhe të blloqeve ushtarake në rajon, reduktonte presionet dhe kushtet e tyre për dominim dhe u jepte mundësi ballkanasve që të angazhoheshin vete për sigurimin e tyre.

Tezë tjetër e shprehur në takim nga pala jugosllave, ishte argumenti që mbledhja të mos kishte rend dite, që palët të mos detyroheshin të prononcoheshin për çështje të caktuara, as të hartoheshin dokumente që detyronin palët të prononcoheshin, por diskutimi të ishte fleksibël dhe të prekeshin ato fusha ku palët mund të bashkëpunonin dhe ku ekzistonin interesa reciproke. Kjo për shkak të pjesëmarrjes së shteteve ballkanike në blloqe të ndryshme ushtarake, dhe një klime jo krejt të shëndoshë që ekzistonte midis tyre. Vendet e rajonit kishin rënë dakort që për të lehtësuar pjesëmarrjen e Shqipërisë, si bazë juridike ndërkombëtare për takimin theksi vihej tek parimet e OKB-së dhe jo tek

¹⁰⁹⁶ AMPJ, V.1988, D.1288, Fl.5,8,9, Informacion i Drejtorise III për reagimet e vendeve të Ballkanit ndaj propozimit jugosllav, 9.6.1987.

¹⁰⁹⁷ AMPJ, V.1988, D.1288, Po aty Fl.10-11.

¹⁰⁹⁸ AMPJ, V.1988, D.1287, Fl.6, Informacion i Ambasadës së RSH në Beograd për MPJ Tiranë, 29.5.1987.

Karta e Helsinkit ku Shqipëria nuk ishte palë.¹⁰⁹⁹ Në letrën që Dizdareviç dorëzoi për Ministrin Malile, shpreheshin idetë që ai artikuloi në takimin me ambasadorin Hysenaj.¹¹⁰⁰

Qeveria shqiptare u rezervua të jepte pëlqimin që në fillim ndaj kësaj nisme me synimin që të njihet më mirë qëllimet jugosllave dhe qëndrimet e vërteta të vendeve të tjera ballkanike. Fakti që kjo inisiativë shfaqej në një situatë kur midis vendeve të Ballkanit viheshin re fërkime deri në kriza të rënda, aq më shumë në raportet e Jugosllavisë me fqinjët e saj lidhur me pakicat kombëtare, diplomacia shqiptare e shikonte këtë inisiativë më shumë sesa për vetë Ballkanin, si mjet për ngritjen e imazhit ndërkombëtar të Jugosllavisë në kushtet e krizës së rëndë ekonomike, politike e sociale, dhe për vënien në dukje të rolit të rëndësishëm që mund të luante Jugosllavia pas Titos. Meqenëse po humbiste rolin në drejtimin e "Lëvizjes së të Paangazhuarve", Jugosllavia kërkonte të fitonte pikë në realizimin e ëndrrës së saj të vjetër për rolin drejtues në Ballkan, dhe këtë ja jepte fakti që një mbledhje e tillë ishte e para për gjithë periudhën pas WWII, ndërkohë që për zonat e tjera gjeografike kjo kishte ndodhur më shpejt. Mungesën e rendit të ditës, qeveria shqiptare e quante pjesë e propogandës së këtij takimi pa një bosht të caktuar.

Meqenëse asnjë qeveri ballkanike nuk e kishte hedhur zyrtarisht poshtë këtë ide, por e kishin mbështetur me rezerva, edhe Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë propozon që kjo ide të mos hidhej poshtë zyrtarisht, por të ndiqeshin reagimet e të tjerëve dhe të dy aleancave ushtarake. Qëndrimi i qeverisë shqiptare iu bë i njohur diplomatëve të huaj si një qëndrim pro takimit, por më parë duhej krijuar klima e mirëbesimit midis fqinjëve, e cila aktualisht sipas qeverisë shqiptare nuk ekzistonte. Kjo do të mundësonte që takimi të arrinte në rezultate konkrete për zgjidhjen e problemeve dhe hapjen e bashkëpunimit më të gjërë rajonal.¹¹⁰¹

Pas kësaj analize, Ramiz Alia në Kongresin e 10-të të Bashkimeve Profesionale në qershor 1987 dhe në Plenumin e 4-të të KQ të PPSH me 10 korrik 1987 u shpreh se në parim udhëheqja shqiptare nuk ishte kundër mbledhjeve ndërkombëtare, përfshirë edhe ato ballkanike, por ky propozim dukej me ngarkesa propogandistike, sidomos nga fakti që politika aktuale jugosllave nuk po i shuante, por po i ndizte urat e bashkëpunimit në Ballkan, sidomos në qëndrimin ndaj Shqipërisë. Qeveria shqiptare ishte për zgjidhje nëpërmjet bisedimeve dypalëshe të problemeve që ekzistonin ndërmjet tyre e kjo rrugë do të çonte në krijimin e besimit dhe atmosferës së domosdoshme për të shqyrtuar bashkarisht edhe problemet panballkanike¹¹⁰². Ky qëndrim nuk u komentua pozitivisht nga diplomacia jugosllave, që priste momentin të akuzonte Shqipërinë për politikë vetëizoluese, por për Tiranën zyrtare Alia me këtë deklaratë nuk e kishte hedhur poshtë idenë e takimit, por tregoi rrugën sesi kjo mbledhje ti shërbente vërtet mirëkuptimit, besimit reciprok dhe paqes në rajon.¹¹⁰³

Të gjitha shtetet ballkanike inkurajuan pjesëmarrjen e Shqipërisë në takim.¹¹⁰⁴, por qeveria shqiptare mbante qëndrim prites, ndërkohë që vazhdonte konsultimet me

¹⁰⁹⁹ AMPJ, V.1988, D.1287, Po aty, Fl.8-10

¹¹⁰⁰ AMPJ, V.1988, D.1287, Fl.21-23, Letra e Dizdareviç për Reis Malile, 29.5.1987.

¹¹⁰¹ AMPJ, V.1988, D.1287, Informacion i MPJ për qeverinë shqiptare, 13.6.1987

¹¹⁰² AMPJ, V.1988, D.1289, Fl.11, Historik i shkurtër i përgatitjes së mbledhjes ballkanike të MPJ.

¹¹⁰³ AMPJ, V.1988, D.1288, Fl.48-49, Analizë përmbledhëse e MPJ për takimin.

¹¹⁰⁴ AMPJ, V.1988, D.1987, Fl.43-45, Informacion për evolucionin e qëndrimeve të shteteve ballkanike për takimin e MPJ-ve., 10.8.1987.

vendet e tjera mbi përmbajtjen e kësaj mbledhjeje dhe rrugët më të përshtatshme që mund ta bënin atë të dobishme. U zhvillua një veprimtari e dendur diplomatike nëpërmjet kontakteve bilaterale për ti dhënë mbledhjes një platformë e objekt të pranueshëm nga të gjithë. Pritej edhe takimi i ministrave të jashtëm në OKB.

Konsultimet kryesore u bene në New York në takimet që zhvilloi Malile me të gjithë ministrat e jashtëm të rajonit gjatë sesionit të OKB-së. Qëndrimi i përgjithshëm I diplomateve nga rajoni ishte që mbledhja të kishte një rend dite të studiuar mirë, dhe të mos përfundonte me resolutë, por me një komunikatë për shtyp.¹¹⁰⁵ U propozuan datat 15 janar ose 15 shkurt 1988 për zhvillimin e saj. Në këtë frymë u përgatit edhe përgjigjia e letrës për Dizdarevic me 15 tetor 1987, e firmosur nga Zv.Ministri i Jashtëm Sokrat Plaka.

Pasi shprehej mendimi pozitiv për të marrë pjesë në mbledhjen e iniciuar, kushti i vendosur ishte përcaktimi i rendit të ditës për takimin që pjesëmarrësit në mbledhje të mos viheshin para vështirësive të ndryshme të papritura. Qeveria shqiptare kërkonte që të përgatitej atmosfera e besimit dhe mirëkuptimit para mbledhjes, që të garantonte suksesin e saj. Plaka ia dorëzoi letrën me 16 tetor ambasadorit jugosllav në Tiranë Novak Pribiçević. Me 17 tetor qëndrimi i Shqipërisë u be publik në gazetën kryesore Zëri i Popullit.¹¹⁰⁶

Sipas ambasadorit Hysenaj, qarqet diplomatike në Beograd e më gjërë, e pritën mire përgjigjen pozitive nga ana e Shqipërisë dhe e quajtën pjesëmarrjen e saj në takim si shumë të rëndësishme nga pikpamja diplomatike që ky takim të mos ishte i cunguar.¹¹⁰⁷

Qeveria jugosllave e shtypi jugosllav filluan të kufizonin dukshëm propogandën kundër Shqipërisë. Ndaj Kosovës u pakësuan disi arbitraritetet banale dhe vihej re një reduktim i veprimtarisë për të forcuar psikozën antishqiptare. Diplomatët e vendeve perendimore mbështetën qëndrimin e Shqipërisë, por shpreheshin skeptik për ndonjë hap pozitiv nga ky takim.¹¹⁰⁸

Në fund të dhjetorit 1987 ambasadori shqiptar Hysenaj u takua përsëri me autoritetet jugosllave dhe ripërsëriti qëndrimin e qeverisë shqiptare të shprehur qartë në përgjigjen e Zv.Ministrit të Punëve të Jashtme. Përsa i takon çështjes së pakicave, pala jugosllave kërkoi që në këtë takim të mos ngriheshin këto çështje, që përbënin një problem kyç në Ballkan, sepse do të dështonte takimi. Ky takim, në projektin e palës jugosllave, nuk do të ishte një konferencë ndërkombëtare për të marrë vendime, por një takim për shkëmbim mendimesh. Ai do të mbyllej me një njoftim në shtyp, për tekstin e të cilit do të bihej dakort midis palëve.¹¹⁰⁹

Me 28 dhjetor 1987 në Ministrinë e Punëve të Jashtme mbërriti përgjigjia zyrtare nga Ministri i Jashtëm jugosllav Dizdarevic, i cili konfirmonte marrjen e përgjigjes nga pala shqiptare mbi pjesëmarrjen e Shqipërisë në takimin e ministrave të jashtëm të vendeve ballkanike. Në këtë letër Dizdarevic bën edhe ftesën zyrtare për Shqipërinë për të marrë pjesë në këtë mbledhje. Pala jugosllave njoftonte zyrtarisht se ashtu siç kishte propozuar pala shqiptare, ishte arritur në një rend dite fleksibël, produkt i konsultimeve dypalëshe

¹¹⁰⁵ AMPJ, V.1988, D.1287, Fl.50-53, Qëndrimi i shteteve të Ballkanit për inisiativën jugosllave, gjatë takimeve në OKB., 10.10.1987.

¹¹⁰⁶ AMPJ, V.1988, D.1287, Fl.70-75, Informacion i Drejtorisë së III në MPJ, tetor 1987.

¹¹⁰⁷ AMPJ, V.1988, D.1288, Fl.12, Informacion i Ambasadës shqiptare në Beograd për MPJ, 25.11.1987.

¹¹⁰⁸ AMPJ, V.1988, D.1288, po aty, Fl.19-20.

¹¹⁰⁹ AMPJ, V.1988, D.1286, po aty Fl.12-13

me ministrinë e jashtme të vendeve ballkanike. Propozohet që rendi i ditës i mbledhjes së ministrave të jashtëm të ishte “ Shkëmbim mendimesh lidhur me idetë, rrugët e mundësitë për zhvillimin e bashkëpunimit shumëpalësh në Ballkan në të gjitha fushat ku interesat e vendeve ballkanike perputhen dhe ku nevojat janë të përbashkëta”. Qëllimi i saj ishte krijimi i një klime pozitive për të çuar më tej bashkëpunimin ndërballkanik. Mbledhja do të zhvillohej me 24-26 shkurt 1988..¹¹¹⁰

Diplomacia shqiptare zhvilloi takime me përfaqesues të të gjitha qeverive të rajonit për tu njohur aq sa mundej me qëndrimet e secilit, jo vetëm që ajo të mos gjindej para të papriturave në takim, por edhe dhe për të ndërtuar një qëndrimin sa më realist në këtë takim.¹¹¹¹

Para nisjes për në Beograd, Ministri i Punëve të Jashtme, Reis Malile, raportoi në Byronë Politike me 19 shkurt 1988 për të gjitha qëndrimet që do mbaheshin në takimin ndërballkanik. Argumentat e paraqitur theksonin faktin që përsa kohë kishte një tendencë zbutjeje të marrëdhënies SHBA-Bashkimi Sovjetik, të përfitonte edhe Ballkani. Sipas malile, ndoshta në Ballkan nuk ishte e mundur të bëhej një hap i dukshëm e i qëndrueshëm për të përmirësuar situatën problematike, por një zbutje e vogël tensioni, ndoshta tranzitore mund të ndodhte dhe Shqipëria ishte e interesuar për një zhvillim të tillë.¹¹¹² Mospjesëmarrja e Shqipërisë në mbledhje, do e ngarkonte Shqipërinë me përgjegjësinë e dështimit të mbledhjes dhe qeveria jugosllave do të kishte duar të lira për të vazhduar goditjet ndaj shqiptarëve në Kosovë. Ishte një rast që politika e jashtme shqiptare të fliste. Pala shqiptare synonte që nëpërmjet tezave që do të paraqiteshin, politika jugosllave të vihej në vështirësi për politikën antishqiptare që ndiqte, të krijoheshin kushte për të frenuar masat shkombëtarizuese në Kosovë e të hapeshin shtigje për vendosjen e lidhjeve Shqipëri-Kosovë. Pjesëmarrja në takim do të shfrytëzohej për forcimin akoma më tej të pozitave ndërkombëtare të shtetit shqiptar,¹¹¹³ Duke shfrytëzuar pozicionin e Shqipërisë jashtë blloqeve, në këtë takim ajo mund të kthehej në faktor normalizimi dhe qëndrueshmërie të marrëdhënies në rajon.

Me 23 shkurt Ministri Malile me një pesë të delegacionit mbërriti në Beograd . Delegacioni shqiptar u prit në mënyrë krejt korrekte, në ndonjë rast edhe me kujdesje të veçanta. Gjatë takimit në aeroport me Sekretarin e ri Federativ për Punët e Jashtme Loncar ai u shpreh se Shqipëria dëshironte suksesin e mbledhjes. Pala shqiptare nuk do të hapte në mbledhje problemin e Kosovës, siç ishte rënë dakort në parim me delegacionet e tjera, por do të prekte në parim problemin e mprehtë të minoriteteve kombëtare e rrugët për të zgjidhur problemet e tyre. Malile i kujtoi Loncar se mbledhja nuk mundte e nuk duhej të kërkonte të merreshin vendime, por vetëm mund të bënte rekomandime e në Komunikatën e përbashkët të pranoheshin vetëm ato rekomandime për të cilat delegacionet kishin një mendim të përbashkët.¹¹¹⁴ Pala jugosllave ra dakort me këtë qëndrim. Në darkën e asaj dite ministrat ranë dakort përfundimisht për programin e procedurën e mbledhjes si dhe për formimin e një komisioni që do të merrej

¹¹¹⁰ AMPJ, V.1988, D.1287, Fl.94-100, Letra e Dizdareviç dhe komentet e MPJ-se për të, 28-31 dhjetor 1987.

¹¹¹¹ AMPJ, V.1988, D.1287, Fl.103-106, Informacione të Drejtorisë së III në MPJ për takimet me diplomatët e rajonit.28.1.1988.

¹¹¹² AMPJ, V.1988, D.1294, Fl.67, Raport i Maliles në Byronë Politike, 19.2.1988.

¹¹¹³ AMPJ, V.1988, D.1294, Fl.70, Raport i Maliles në Byronë Politike, 19.2.1988.

¹¹¹⁴ AMPJ, V.1988, D.1288, Fl.55, Analize e MPJ për takimin e 24-26 shkurt 1988.

me hartimin përfundimtar të Komunikatës së përbashkët, për të cilën një projekt të parë do ta paraqiste pala jugosllave.

Mbledhja u hap me 24 shkurt. Delegacionet u vendosën në sallën e konferencës sipas rendit alfabetik. Pas fjalës përshëndetëse të Presidentit të presidencës jugosllave Llazar Mojsovit, e mori fjalën Ministri i Jashtëm shqiptar Reis Malile. Fjalimi u ndoq me interes të madh nga të gjithë të pranishmit dhe nga mbi 400 gazetarë që ndodheshin në sallë nga Europa dhe jashtë saj. Në pushimin e séancës, Malile u urua nga Loncar për fjalimin shumë konstruktiv. Më pas ate e uruan Ministri i jashtëm grek, turk, bullgar e rumun. Interesimi i gazetarve për intervista ishte shumë i madh.¹¹¹⁵ Qëndrimet kryesore të qeverisë shqiptare të shprehura në fjalim ishin:

1-Rikonfirmohet teza se zhvillimet në Ballkan nuk ishin të shkëputura nga ato në Evropë e m tej.

2-Marrëdhëniet dypalëshe ishin bazë e bashkëpunimit shumëpalësh. Mirëkuptimi dhe bashkëpunimi ballkanik nuk mund të ecnin përpara pa përmirësuar e ndrequr marrëdhëniet dypalëshe.

3-Shqipëria ishte kundër pakteve ushtarake që ndanin Ballkanin, kundër çdo ndërhyrjeje të huaj, si dhe për largimin e supërfuqive nga rajoni, largimin e armëve dhe bazave të tyre ushtarake e Ballkani tu përkiste ballkanasve.

4-Politika e fqinjësisë së mirë si një politikë konsekuente e Shqipërisë dhe jo konjunkturiale. Malile shprehu qartë qëndrimin e qeverisë shqiptare se asnjë e keqe nuk do ti vinte ndonjë vendi fqinj nga territori shqiptar, e se populli shqiptar nuk do të lejonte askënd që përmes territorit të tij të cënonte lirinë, pavarësinë e sovranitetin e shteteve fqinje. Malie u bëri thirrje ministrave të jashtëm të rajonit që edhe ata të merrnin një zotim të tillë solemn. Nga pala shqiptare u theksua dëshira për stabilitet në të gjitha vendet e Ballkanit, respektimi i pavarësisë në të gjitha vendet, marrëdhënie të qëndrueshme, duke respektuar pavarësinë dhe sistemin shoqëror të secilit vend, duke e konsideruar këtë çështje të brendëshme të tij.¹¹¹⁶

5-Vend me rëndësi zuri çështja e respektimit të minoriteteve kombëtare, që ato të sherbenin si ura miqësie midis vendeve. “Tensione ka-u shpreh Malile- jo kur respektohen të drejtat e tyre, por kur shkelen ato. Nuk është koha e kolonizimeve, shtypjes së minoriteteve të drejtat e të cilëve njihen nga Karta e OKB-së. Ngushtësia nacionale në kushtet e një integrimi ekonomik e kulturor midis vendeve, është jo vetëm anakronike, por edhe e dëmshme. RPSSH asnjëherë nuk ka shtruar çështjen që problemi i minoriteteve të zgjidhej duke ndryshuar kufijtë e duke ndërhyrë në punët e brendëshme të njëri-tjetrit. Ne njohim të drejtën e çdo vendi që ti zgjidhë problemet në përputhje me kushtetutën e tij, por jo diskriminimin, shtypjen e çkombëtarizimin. Të ngresh zërin kur ndodhin këto nuk është as ndërhyrje, as pretendim territorial, as përpjekje për destabilizim.”¹¹¹⁷ Kundër kësaj deklarate nuk doli askush. Ministri i Jashtëm rumun nuk ishte dakort që kjo çështje të përfshihej në komunikatë. Sipas tij vendet e tjera nuk kishin të drejtë të merrreshin me trajtimin e minoriteteve në një vend të caktuar, pasi ishte çështje e këtij të fundit. Meqenëse kjo u shkonte për shtat disa pjesëmarrësve, në komunikatë u tha vetëm “u shpreh mendimi” dhe jo “ministrat e jashtëm konsiderojnë se minoritetet...” etj.

¹¹¹⁵ AMPJ, V.1988, D.1288, Po aty fl.57.

¹¹¹⁶ AMPJ, V.1988, D.1294, Fl.96, Fjalimi i Reis Malile .

¹¹¹⁷ AMPJ, V.1988, D.1294, Fl.102, Fjalimi I Reis malile ne Konferencë.

6-U bënë propozime për bashkëpunime shumëpalëshe në fusha konkrete: zhvillimi i tregëtisë kufitare, heqja e pengesave doganore, transporti i të gjitha llojeve, shfrytëzimi i ujrave të përbashkëta, shkëmbimet në fushat e ekologjisë, kulturës, shkencës, sportit. Pala shqiptare theksoi faktin se afërsia gjeografike përbënte një avantazh të madh për bashkëpunim midis vendeve të Ballkanit dhe tradita nuk mungonte, pavarësisht se pas Luftës II Botërore ngjarjet kishin marrë një drejtim që nuk i përshtatej interesave të vërteta të popujve ballkanikë, kjo për shkak të aleancave të ndryshme që u lidhën, të ndërhyrjeve e presioneve të jashtme të cilat dëmtojnë këto keto lidhje ndërballkanike. Për këto bashkëpunime, sipas palës shqiptare, duhej të ekzistonte atmosfera e përshtatshme politike.

7-Në kushtet e Ballkanit alternativa shqiptare ishte riaktivizimi i Komiteteve të Mirëkuptimit Ballkanik ku të merrnin pjesë parlamentarë, shkenctarë, gazetarë, përfaqësues të organizatave të masave etj.¹¹¹⁸ Veprimtaria e komiteteve ishte e dobishme për qeveritë ballkanike, jo vetëm se do të zbulonte drejtimet që çonin drejt bashkëpunimit të gjithëanshëm, por edhe do të përgatiste terrenin për zgjerimin e rritjen e këtij bashkëpunimi.¹¹¹⁹

8-Duke i qëndruar diplomacisë dypalëshe, si më të efektshmen në zgjidhjen e problemeve ballkanike, pala shqiptare nuk ishte dakort me institucionalizimin e takimeve të ministrave të jashtëm apo për takimin ballkanik të udhëheqësve të shteteve apo qeverive në mbledje të nivelit të lartë (propozimi grek), sepse takimet e shpeshta zbehin realitetin dypalësh dhe nuk ishin reale.¹¹²⁰

Debate të forta u vunë re në mbledhjen e grupit të redaktimit të Komunikatës përfundimtare të Konferencës. Mbledhja zgjati 12 orë nga ora 16.00 e ditës 25 shkurt deri në orën 4.00 të datës 26 shkurt. Nga pala shqiptare morën pjesë në këtë debat diplomatët Muhamet Kapllani, Vladimir Prela dhe Petraq Pojani. Në grupin e redaktimit dolën në sipërfaqe në një mënyrë ose në një tjetër, pikëpamjet e kontraditave midis vendeve ballkanike për çështje të rëndësishme politike në marrëdhëniet midis tyre, për marrëdhëniet ndërballkanike si dhe për konceptimin e shkallës së bashkëpunimit shumëpalësh në rajon. Diplomatat shqiptarë arritën që nepërmjet negociatave të gjata të vendosnin disa nga qëndrimet e tyre në komunikatën përfundimtare.¹¹²¹

Pjesëmarrja e Shqipërisë në Konferencën e parë të Ministrave të Jashtëm të Ballkanit në Beograd (24-26 shkurt), nga shumë analistë të huaj u quajt "hapje e politikës së jashtme shqiptare". Kjo u hodh poshtë nga qeveria shqiptare e cila e konsideronte politikën e saj të jashtme krejt të tjerëve, dhe nuk merrte pjesë në blloqe. Përkundrazi, pjesëmarrja në Konferencë u konsiderua nga qeveria shqiptare si konkretizim i politikës së fqinjësisë së mirë, dëshirës dhe interesit të vendit që situata në Ballkan të ishte e qetë, një rast i mirë për të demonstruar parimet e politikës së jashtme shqiptare. Kontributi që dha delegacioni shqiptar në këtë takim, u konsiderua nga qeveria shqiptare një sukses i madh i diplomacisë shqiptare.¹¹²²

¹¹¹⁸ AMPJ, V.1988, D.1294, Fl.73, Diskutimi ne Byrone Politike.

¹¹¹⁹ AMPJ, V.1988, D.1294, Fl.106, Fjalimi I Reis Maliles ne Konference.

¹¹²⁰ AMPJ, V.1988, D.1298, Fl.79, Raport i Drejtorise se vendeve te rajonit per takimin e MPJ-ve, 3.3.1988.

¹¹²¹ AMPJ, V.1988, D.1298, Raport i MPJ për mbledhjen e MPJ në Beograd, 24-26 shkurt 1988, dt.5.3.1988

¹¹²² AMPJ, V.1988, D.1286, Fl.37-40, Informacion për pjesëmarrjen e vendit tone në veprimtaritë ndërballkanike gjatë v.1988.

Pas Konferencës së shkurtit 1988, qeveria shqiptare e përcaktoi politikën e fqinjësisë së mirë si një nga orientimet themelore të politikës së saj të jashtme. Për qeverinë shqiptare, roli aktiv në Ballkan, angazhimi në mirekuptimin ballkanik dhe uljen e tensionit do krijonte kushte më të favorshme për Kosovën dhe popullsinë shqiptare në Jugosllavi dhe mundësi më të mëdha kontakti me të. Kjo do i shërbente edhe planit ekonomik për të rritur shkëmbimet tregëtare, të cilat lehtësosheshin nga afërsia gjeografike dhe nga struktura ekonomike e vendeve të Ballkanit.¹¹²³ Në kushtet e krizës së brendshme që po thellohej në Jugosllavi, një politikë e jashtme shqiptare më aktive në Ballkan dhe rritja e peshës së saj në rajon, do të ndikonte në rritjen e respektit dhe interesimit të shteteve të tjera të Evropës Perendimore për Shqipërinë dhe rolin e saj në Ballkan, mjaft e rëndësishme kjo për kushtet e brendshme dhe të jashtme të shtetit shqiptar në fundin e viteve '80-të.

¹¹²³ AMPJ, V.1988, D.1288, Analizë e MPJ mbi zhvillimet në Ballkan pas Konferencës, 5.12.1988.

VËSHTRIM HISTORIK-ETNOLOGJIK I KRAHINËS SË TOMORRICËS, SHQIPËRI

Prof. Asc. Dr Qamil Lirëza

Universiteti "A.Xhuvani" Elbasan

Departamenti Histori-Gjeografi

Abstrakt

Në këtë artikull bëhet një vlerësim shkencor nga pikëpamja historike dhe etnologjike kësaj krahine, duke u bazuar në dokumente historike: Shpjegimin e varianteve të ndryshme të etimologjisë së emrit, periudhat më të hershme të popullimit, periudhën e shpalljes së pavarësisë, luftën nacional-çlirimtare, deri në ditët e sotme. Në fillim të këtij artikulli analizohet natyra e kësaj krahine; pozita gjeografike, ndërtimin gjeologjik, relievi. Në vazhdim i bëhet një analizë popullimit të kësaj krahine, sipas periudhave të ndryshme historike, duke filluar që nga antikiteti, mesjeta, pavarësia, lufta nacional-çlirimtare, periudha e socializmit, ndryshimet demokratike të vitit 1992, deri në ditët e sotme. Më tej jepen argumente nga identiteti kulturor i krahinës si; tradita, besimi, mënyra e jetesës, folklori, mikpritja, veshjet etj. Në fund jepen konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse.

Fjalë kyçe. Tomorrica, etimologji, identitet kulturor, histori,

Natyra dhe etimologjia e emrit

Tomorrica është një krahinë gjeografike etnografike, që shtrihet ndërmjet vargmaleve të Tomorrit, Qafës së Gjarprit, Guritë Prerë dhe Koshnicës. Ajo përshkohet nga një lumë, që formohet nga prurjet e përrenjve, nga fshati Gjogovicë deri sa bashkohet me lumin Devoll në fshatin Shëmrizë të rrethit të Gramshit, i emërtuar lumi i Tomorricës. Kjo krahinë kufizohet; në lindje me fshatrat e Korçës, në veri me fshatrat e Gramshit dhe në veriperëndim me ato të rrethit të Beratit dhe në jug e jugperëndim me fshatrat e Skraparit. Ndodhet në dy rrethe, pjesa jugore në rrethin e Skraparit, (Tomorrica e Skraparit) kurse ajo veriore në atë të Gramshit, (Tomorrica e Gramshit). Sipërfaqja e përgjithshme është 266.7 km². Sipas studiuësve (kolektiv autorësh 2000) është njësi gjeografike lidhëse midis Krahinës malore Qendrore dhe asaj Jugore.

Krahinë në periudha të ndryshme historike ka pasur dhe madhësi të ndryshme. Në një libër për "Prefekturat shqiptare" e botuar në vitin 1920, thuhet se: "Nënprefektura e Skraparit përfshin, krahinën e Tomorricës dhe krahinën e Vlushës"(Muzeu historik i Skraparit, 2012).

Tomorrica sot përfshin gjithsej 45 fshatra, nga të cilat; 15 janë në rrethin e Gramshit, kurse 30 të tjerë janë të përfshirë në rrethin e Skraparit. Nga pikëpamja hipsometrike

shtrihet në lartësinë nga 250 metra, në pjesën e poshtmen afërsi të fshatit Shëmrizë, rrethi Gramsh, deri në 2714 metra mbi në nivelin e detit, mali i Tomorrit. Sipas natyrës së shkëmbinjve (gëlqerorë dhe terrigjenë), banorët e njohin me emrat Tomorricë e bardhë (pjesa perëndimore) dhe Tomorricë e zezë, (pjesa lindore). Pozicioni i saj gjeografik, bën që të jetë larg rrugëve kryesore kombëtare. Më pranë ka rrugën rurale Gramsh-Moglicë-Maliq drejtë qytetit të Korçës. Sipas studiuesve arkeologë nëpër këtë krahinë ka kaluar dhe një degëzim i rrugës së vjetër "Egnatia", ndoshta në antikitetin e vonë, ajo ka kaluar nga Berati, në Dardhë rrëzë Tomorrit dhe më tej në drejtim të Tomorricës.

Sipas historianëve të vjetër, nga Tomure ka rrjedhur fjala Tomuriase, që tregon krahinën e malit Tomorr, **që nuk është gjë tjetër, veçse krahina e Tomorricës (rrethina e malit Tomor).**

Vetë emri Tomor si emër pellazgjik mund të kuptohet me ilirishten dhe do të thotë, mal i të mirave, "do duam, dëshirojmë" dhe e gjejmë në formën më të plotë në shqip në emrin Desaret (Llaqi dhe Miha Jano, Gazeta Kritika, shtator 2001, dorëshkrim).

Për të shpjeguar origjinën e emrit të krahinës, përmendim shpjegimin e dhënë nga Apiani, kur ai duke u përpjekur të shpjegojë origjinën e emrit ilir shkruan: "Këtë emër ky vend, siç thonë, e ka nga iliri, i biri i Polifenit. Bijtë e tij kanë qenë Eneleu, Autari, Dardani, Medi, Taulanti dhe Perrebi, ndërsa vajzat e tij ishin Partha, Daortha, Dasara etj, nga ku kanë rrjedhur dhe emrat e fiseve më të mëdha ilire (Burimi Muzeu historik Skrapar 2013).

Etimologjia e emrit Tomorr dhe e krahinës është thjesht shqip edhe pse ka shumë mendime të ndryshme, por që të gjitha janë të pranueshme për vet mitologjinë e pasur që ekziston për të.

Nga autorët e Antikitetit e përmend për herë të parë emrin e Tomorrit Toponimin(Tomarosose Tamari a Tmari) na e sjell Straboni (63 para Krishtit dhe 20 mbas Krishtit), por e përmend edhe me emrin Talar. Plini i vjeter (23-79 pas Krishtit) e quan Tmarus ose Tomarus, si mal pranë Dodonës (Artikull Llaqi dhe Mihal Jano, gazeta Kritika, shtator 2001). Për emrin e Tomorrit dhe të krahinës së tij, anglezi Martin Leak, nuk jep ndonjë etimologji të saktë, por vetëm një koment që ka diçka të rëndësishme për ne, që tashmë kërkojmë të vërtetën e historisë së emrit. Është e lehtë të kuptohet se ashtu si emrat e maleve dhe të lumenjve në përgjithësi, Tomorr e Tomorricë, janë fjalë karakteristike që i përkiste gjuhës së hershme të Epirit dhe që për këtë arsye, emri Tomor, shumë shpejt u pagëzua me emrin Fron i Nga ky vlerësim logjik i hedhur nga Martin Leak, për emrin e malit Tomorr, mendojmë se përputhet me llogjikën e argumentet e parashtruara edhe më lartë në trajtimin historik e gjuhësor të emërtimeve.. (shtator 2001 nga Llaqi dhe Mihal Jano Gazeta Kritika)

Koloneli anglez Ëiliam (1777-1860). Në udhëtimin e tij në shtator 1805 ai shkruan për Tomorricën: "Zbritëm nga Dushari dhe mbërritëm në Komeno Lithari, ose siç i thonë në gjuhën shqipe Guri i Prerë. Ky është një shkëmb i vogël që ngrihet mbi kreshtën e një vargu kodrash, të cilat ndajnë shtratin e lumit Kelidon nga ai degëzimi tjetër kryesor i lumit Devoll, që rridhte përgjatë faqes lindore të malit Tomorr. Më tej ai shkruan . Tek Guri i Prerë përreth këtij shkëmbi ishte ngritur një kështjellë...një rrethinë me mure të hollë në formë katërkëndëshe, përreth shkëmbit, në qendër të të cilit ngrihej një kullë e vogël e vetme në fortesë". (Artikull shtator 2001 nga Llaqi dhe Mihal Jano).

Për emrin e Tomorrit dhe të krahinës së tij, anglezi Martin Leak, nuk jep ndonjë etimologji të saktë, por vetëm një koment që ka diçka të rëndësishme për ne, që tashmë kërkojmë të vërtetën e historisë së emrit. Është e lehtë të kuptohet se ashtu si emrat e maleve dhe të lumenjve në përgjithësi, Tomorr e Tomorricë, janë fjalë karakteristike që i përkiste gjuhës së hershme të Epirit dhe që për këtë arsye, emri Tomor, shumë shpejt u pagëzua me emrin Fron i Perëndive, Fransoi Pucell historian dhe gjuhëtar, në vitin 1806, kur kaluar në këtë krahinë ka shkruar për Tomorrin dhe rrethinat e tij Tomorricën. Në fillim të viteve 1900 shkruante: “Në pjesën më të lartë të Tomorrit, gjendet edhe sot një “ murane” vend i shenjtë kristian që quhet Ali Baba ose baba Ali, shkruan Antonio Baldaci dhe se kazaja e Tomorricës, kishte 12-14 mijë banorë”.

Krahina gjatë periudhave të ndryshme historike

Studiuesit shqiptarë kanë dalë në përfundimin se jeta njerëzore këtu ka filluar në mijëvjeçarin X-të para lindjes së Krishtit. Ndoshta ato janë të pakta, por megjithatë nga studjuesit arkeologë janë ndërmarrë disa ekspedita, me ndihmën dhe të Institutit të Arkeologjisë, Tiranë. Kështu gjetjet prehistorike në këtë krahinë, flasin për një periudhë të hershme të popullimit, gjatë epokës së Mezolitit dhe Neolitit të Hershëm.

Në krahinën e Tomorricës eksplorimet dhe gërmimet e pakta arkeologjike kanë dokumentuar edhe vendbanimet e fortifikuar si p.sh qyteza antike në fshatin Tërrovë. Janë të pranishme dhe ish-vendbanime qytetare të tipit kala, si p.sh rrënojat e Kalasë së Gradecit në këtë krahinë. Arkeologët e kanë datuar në shekujt VII-VI-të para lindjes së Krishtit. Këto tip vendbanime u ruajtën edhe më vonë në formën e traditës në Tomorricë e më gjerë.

Nga të dhënat e deri tanishme rezulton se në trevat e Skraparit dhe të Tomorricës janë vërejtur gjurmë të ekzistencës së jetës qytetare qysh në kohët më të lashta. Kryesore është se kjo jetë nuk është ndërprerë, thuhet asnjëherë për të arritur e plotë deri në ditët tona.

Deri më sot, janë zbuluar mbi 20 qendra banimi me vlera të mëdha për studimin e kulturës ilire të kësaj treve dhe më gjerë. Fondi i këtyre të dhënave arkeologjike i ka ndihmuar studiuesit për popullimin e hershëm të kësaj krahine

Disa nga kalatë në historinë e trevës së Tomorricës janë: Kalaja e Lavdarit, Bregut të Koronit, Bargullasit, Prishtës, Vidhanit, Gradecit.

Sipas studiuesve arkeologë nëpër këtë krahinë ka kaluar dhe një degëzim i rrugës së vjetër “Egnatia”, po sipas tyre ndoshta në antikitetin e vonë, një rrugë ka kaluar nga Berati, në Dardhë rrëzë Tomorrit dhe më tej në drejtim të Tomorricës.

Studiuesit shqiptarë kanë dalë në përfundimin se jeta njerëzore këtu ka filluar në mijëvjeçarin X-të para lindjes së Krishtit. Ndoshta ato janë të pakta, por megjithatë nga studjuesit arkeologë janë ndërmarrë disa ekspedita, me ndihmën dhe të Institutit të Arkeologjisë, Tiranë. Kështu gjetjet prehistorike në këtë krahinë, flasin për një periudhë të hershme të popullimit, gjatë epokës së Mezolitit dhe Neolitit të Hershëm.

Në krahinën e Tomorricës eksplorimet dhe gërmimet e pakta arkeologjike kanë dokumentuar edhe vendbanimet e fortifikuar si p.sh qyteza antike në fshatin Tërrovë. Janë të pranishme dhe ish-vendbanime qytetare të tipit kala, si p.sh rrënojat e Kalasë së Gradecit në këtë krahinë. Arkeologët e kanë datuar në shekujt VII-VI-të para lindjes së Krishtit. Këto tip vendbanime u ruajtën edhe më vonë në formën e traditës në

Tomorricë e më gjerë. Nga të dhënat e deri tanishme rezulton se në trevat e Skraparit dhe të Tomorricës janë vërejtur gjurmë të ekzistencës së jetës qytetare qysh në kohët më të lashta. Kryesore është se kjo jetë nuk është ndërprerë, thuhet asnjëherë për të arritur e plotë deri në ditët tona.

Deri më sot, janë zbuluar mbi 20 qendra banimi me vlera të mëdha për studimin e kulturës ilire të kësaj treve dhe më gjerë. Fondi i këtyre të dhënave arkeologjike i ka ndihmuar studiuesit për popullimin e hershëm të kësaj krahine

Disa nga kalatë në historinë e trevës së Tomorricës janë: Kalaja e Lavdarit, Bregut të Koronit, Bargullasit, Prishtës, Vidhanit, Gradecit.

Sipas studiuesve arkeologë nëpër këtë krahinë ka kaluar dhe një degëzim i rrugës së vjetër "Egnatia", po sipas tyre ndoshta në antikitetin e vonë, një rrugë ka kaluar nga Berati, në Dardhë rrëzë Tomorrit dhe më tej në drejtim të Tomorricës

Gjatë pushtimit të turqve osmanë në periudhën e Mesjetës, në dy dhjetë vjeçarët e parë të shekullit të XV-të, edhe kjo krahinë ishte nën këtë pushtim ashtu sikurse për të gjithë Shqipërinë, pati pasoja mjaft të rënda edhe për popullsinë e kësaj krahine. Në dokumentet turke të kohës të publikuar nga studiuesit shqiptarë krahina e Tomorricës shënohet me emërtimin mevkufi ose fshat i braktisur. Kjo nuk ka të bëjë me braktisjen, largimin e popullsisë, por me mos pagimin e detyrimeve ndaj administratës osmane. Emigracioni si një plagë e rëndë shoqërore gjatë kësaj periudhe ka qenë i përhapur në këtë krahinë.

Nga mesi i shekullit XV si në gjithë trojet shqiptare edhe krahina e Skraparit dhe e Tomorricës, nuk kishte një administrim dhe organizim të mirëfilltë shtetëror.

Ne dokumentet e asaj kohe, banorët e Skraparit e të Tomorricës në vitet 1431, besonin në religjionin ortodoks, të lënë prej Bizantit dhe më herët, prej pushtuesve sllavë, dukuri që do të evidentohet edhe një shekull më vonë Lidhur me baraz vlefshmërinë krahasuese të monedhës osmane të asaj periudhe historike, të emërtuar akçe, me lekun tonë të sotëm, sipas disa specialistëve të kësaj fushe, përfaqje më të madhe ka që të jetë 600 akçe baras me 1000 lekë. Termi grua e ve, vejushe, përdoret për ato familje që nuk kanë patur burra, d.m.th shtëpi që nuk llogariteshin për ushtarë (Burimi Shkruar nga Fatjon Kaloci Trashëgimi 2010).

Popullsia e Tomorricës pas vdekjes së Skënderbeut, ka pasur emigrime, largime edhe drejt Italisë së Jugut. Duket se numri ka qenë jo i vogël, pasi atje u ruajtën emrat e fshatrave të origjinës si; Zhepë, Gjerbës. Sipas dokumenteve një largim tjetër masiv i kësaj popullate ka qenë në shekullin e XIX drejtë Myzeqesë. Nga mesi I shekullit XV

Nga gojëdhëna të ndryshme popullore ky pushtim është refuzuar. Shkrimtari i njohur i poemës "Garda Krutane" Kolë Jakova e përshkruan figurën e Ajolin Muzakës, si bashkëluftëtar i Skënderbeut, që ra heroikisht në betejën e Torvjollit, më 1444. Ky fakt dëshmohej dhe nga këngët folklorike në zonën e Tomorricës. Sipas gojëdhënave të ndryshme heroi ynë kombëtar Skënderbeu, pas humbjes që pësoi në Berat, nga pushtuesit turq në vitin 1455, mendohet se ka kaluar dhe në Sulovë e Tomorricë. Po sipas gojëdhënave në fshatin Shëmbërdhjenj, ai ka pushur bashkë me ushtrinë e tij. Ndaj edhe sot ky fshat njihet me emrin Skënderbegas.

Nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX edhe për këtë krahinë lufta shumëshekullore e rilindësve për çështjen kombëtare, fitimin e pavarësisë, filloi të japë frytet e veta. Filluan të krijohen çeta atdhetare, krahas asaj të Lace Backës në vitin (1900), u krijua në Tomorricë, çeta e Servet Zaloshnjës (1906).

Këto çeta bashkëpunonin me çetën e Bajo Topollit dhe Mihal Gramenos, ku hyri në lidhje me to dhe patrioti Baba Meleq Shëmbërdhenji. Ky klerik krahas problemeve fetare, preokupohej shumë për çështjen e atdheut dhe të popullit. Teqenë e shndërroi në qendër takimesh dhe strehë për patriotët që luftonin për liri.

Në 1910 niset për në Rumani për të tërhequr libra dhe abetare shqipe që do t'u shërbenin shkollave shqipe, jo vetëm në Skrapar e Tomorricë por në të gjithë Shqipërinë.

Në kryengritjen e përgjithshme të vitit 1912 kundër Turqisë, shumë luftëtarë nga kjo krahinë me në krye Xhile Liçin, Asllan Shahinin, Baba Meleq Shëmbërdhenjin etj, kanë dhënë kontribut të rëndësishëm. Këta patriotë kanë qënë përfaqësues të Gramshit e Tomorricës, në Kuvendin e Vlorës, më 28 nëntor 1912. Sipas dokumenteve të kohës, në pamundësi për të marrë pjesë në këtë kuvend ata shkruan këtë telegram nga Berati : “ Shkëlqesisë së Tij, Ismail Qemal Beut. Vlorë. Sado që kemi tri ditë që kemi ardhur këtu, nga shkak i dimrit nuk mujtëm me ardhë aty. Lutemi pranoi përfaqësimin e krahinave tona. Në qoftë nevoja për ne, lajmëroni”. Përfaqësuesit; Asllan Shahini dhe Seit Shëmbërdhenj.

Në territorin e kësaj krahine, në periudhën 1915-1918 u vendosën ushtritë e fuqive të Italisë, Austro-Hungarisë dhe Francës,. Në kushtet dhe momentet që erdhën këto trupa ushtarake, për popullin e kësaj krahine ato ishin shpëtimtare pas masakrave që kishin parë me sytë e tyre, të kryera nga andartet greke. Çetat e Skraparit dhe të Tomorricës, të cilat kishin mbajtur peshën në luftën kundër forcave greke u ingranuan në ushtritë e huaja sipas zonave respektive. Patriotët si Ali Koprencka, Mustafa Spathara, Avni Kapinova, Riza Kodheli, Ali Farmaqi, Servet Zaloshnja, Baba Meleq Shëmbërdhenji etj, pavarësisht nga synimet apo kontradiktat që kishin mes tyre fuqitë e huaja, bashkëpunimin me to e shikonin si një mundësi në të ardhmen për zgjidhjen e çështjes kombëtare e ruajtjen e tërësisë tokësore. (Klodiana Bufi gazeta Zeri Yt. 04. 12. 2005).

Përfundimi i Luftës së Parë Botërore u shoqërua me ngjarje që, jo vetëm krijuan pengesa për veprimtarinë normale të shtetit të ri shqiptar, por vunë në pikëpyetje dhe qënjen e tij. Në këto rrethana edhe nga kjo krahinë, patrioti Hysen Zaloshnja, krijoi në vitin 1919, në Zaloshnje të Tomorricës “ Komitetin për Shpëtim Kombëtar”. Po kështu forca vullnetare nga kjo krahinë janë dërguar në Lushnje, për mbarvajtjen e punimeve të Kongresit të Lushnjes, në janar të vitit 1920.

Gjatë periudhës së sundimit të Mbretit Zog (1925 – 1939) kjo krahinë ka qënë pjesë e nënprefekturës së Skraparit . Sipas statistikave të vitit 1926 e gjithë nënprefektura numëronte 93 fshatra, me 14 100 banorë gjithsej. Një moment me rëndësi për këtë krahinë përbën dhe Lufta Nacional – Çlirimtare . Një ndikim të madh në mobilizimin e popullatës kundër pushtuesëve dhanë figura intelektuale dhe nacionaliste, të tilla si Mestan Ujaniku, Hysen Zaloshnja, Abas Ermenji etj. Kështu në 14 mars 1942 u krijua çeta partizane nga më të vjetrat në të gjithë vendin, quhet çeta plakë, me në krye Mestan Ujanikun.

Gjatë Luftës antifashiste në muajin gusht të vitit 1942, fashistët italianë dërguan në drejtim të Tomorricës një detashment 63 milicës nën drejtimin e Xhafer Balit, me qëllim asgësimin çetës partizane të Tomorricës. Milicët bënë masakra, plaçkitje, grabitje të shtëpive të banorëve. Në të gëdhirë të 31 gushtit 1942 çeta partizane nën komandën e Mestan Ujanikut dhe Gjin Markut, rrethoi milicët dhe kërkoi dorëzimin e tyre. Deri në rreshtimin e saj në strukturat e tjera partizane “Çetën Plakë” kishte 110 partizanë, të cilët

65 nga Skrapari dhe Tomorrca dhe 45 nga rrethet Korçë, Përmet, Berat dhe Mallakastër. Pas krijimit të saj "Çeta Plakë" filloi të veprojë në luftë kundër okupatorit, ajo pa humbur kohë hartoi planin për sulm. Veçojmë sulmin për çlirimin e Çorovodës më 5 shtator 1942.

Në memorien e popullit do të mbeten të paharruar emrat e heronjve dhe dëshmorëve të dalë nga kjo çetë si: Ramiz Aranitasi, Hajri Shpatanji, Veri Zaloshnja, Përparim, Zaloshnja, Tahir Grepcka, Syrja Grabocka, Mustafa Radovicka, Tefik Lapani etj. Në këtë krahinë janë zhvilluar shumë beteja gjatë periudhës së Luftës Nacional - Çlirimtare si: ato të zhvilluara në Qafën e Gjarprit, që ndodhet në kufirin ndarës midis krahinës së Tomoricës dhe asaj të Oparit të rrethit të Korçës. Gjatë Operacionit të Qershorit të vitit 1944, është konsideruar si pika më e rëndësishme strategjike e luftimeve midis forcave të Nacional - Çlirimtares me ato naziste.

Pas çlirimit të vendit nga nazi-fashistët, kjo krahinë pësoi ndryshime të rëndësishme. Gjatë periudhës 1945 - 1990 si rrjedhojë i politikave ekonomike të shtetit komunist, pati ndryshime në jetën sociale të kësaj krahine. Në ndryshimet që ndodhën pas luftës, rëndësi pati të madhe për këtë krahinë pati zhdukja e disa plagëve të vjetra të trashëguara nga e kaluara. Gjatë kësaj periudhe ka pasur një zhvillim të mirë të arsimit dhe kulturës. Në të gjitha qendrat e ish kooperativave bujqësore ka pasur shkolla 8 - vjeçare dhe në disa prej tyre shkolla të mesme, me profil bujqësor.

Nga kjo krahinë kanë dalë mjaftë intelektualë të zotë në fusha të ndryshme si mjeku kardiokirurg mjaftë i njohur Ajli Alushani, nga fshati Gjerbës. Ka qenë dhe ministër i Shëndetësisë, përpara viteve "90. Po kështu kanë dalë pedagogë, gazetarë, inxhinierë etj, mjaftë të spikatur në fushat e tyre. Si rrjedhojë e politikave të organizimit territorial e atyre sociale të shtetit komunist gjatë kësaj periudhe, pati një rritje të konsiderueshme të numrit të popullsisë. Sipas statistikave popullsia e vitit 1992 ishte trefishuar në krahasim me vitin 1945.

Pas vitit 1992 si pasojë e ndryshimeve në sistemin politik dhe për shkak të lëvizjes së lirë të popullatës u rrit shumë lëvizja mekanike e kësaj popullate, në kërkim të një jetë më të mirë. Nga viti 1994 deri më sot, fenomeni i largimeve si brenda dhe jashtë vendit është një problem tepër i madh. Kjo ka çuar në abandonim të shumë fshatrave deri në braktisje të plotë, procesi vazhdon ende. Migrimi i brendshëm më shumë është drejtë qyteteve të Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit. Kurse ai i jashtëm në shtetet Greqi, Itali etj. Kjo lëvizje e tillë mekanike, që ka çuar më largime masive të banorëve të fshatrave të ndryshëm, ka sjellë problem të mëdha dhe në mjedisin natyror. Në këtë krahinë ngado të sheh syri territore të degraduara, pasojë kjo e keq shfrytëzimit të tokës dhe dëmtimit të bimësisë.

Tomorrca në vite e shekuj është dalluar jo vetëm si popull punëtor e bujar, atdhedashës e patriot, por edhe si një popull i besimit të fesë bektashiane, që u kanë bërë jehonë shenjtorëve që ranë në fushën e Qerbelasë, siç ishin Abazi dhe Aliu, të cilëve populli i Tomoricës u ka kënduar dhe u këndon këngën:

Janë dy vëllezër

Rrinë larg e larg

O yll i bukur me bajrak

Njëri në Tomorr

Tjetri në Berat..... etj.

Mali i Tomorrit këtë emër ka pasur qysh në zanafillë dhe këtë emër do të ketë për jetë të jetëve. Ai është baza e historisë së vjetër dhe e asaj të resë, është simboli i bashkimit kombëtar pa dallim feje dhe krahine. Ai mirëpret këdo. Ai bekon këdo që mendon drejt. Ai ndëshkon me rrufenë dhe stoçenin e tij, këdo që mendon dhe vepron mbrapsht. Njerëz të mirë kudo qofshi, ejani dhe bëhuni adhurimtarë të bukurisë pagane! Paçi bekimin e Baba Tomorrit! Ashtu qoftë.

Populli i Tomorricës për të përjetësuar jetën dhe veprën e këtyre shenjtorëve të mëdhenj të gjithësisë, të cilët ranë në fushën e betejës për t'i ndriçuar rrugën dhe jetën pasardhësve dhe njerëzimit ka ndërtuar edhe dy faktore në kreshtat e malit të Tomorrit. Një në malin e Kulmakut dhe tjetrën në Çukën Tomorrit. Çdo vit nga data 21deri 24 të gusht bëhet pelegrinazh, nga mijëra njerëz të moshave të ndryshme. Ata vijnë nga Dumreja dhe Sulova, nga Gora e Pogradecit dhe Opari i Korçës, nga nahija e Beratit dhe Dangëllia e Përmetit, nga Mallakastra, Vlora e Kruja .

Në Tomorricë janë ndërtuar disa teqe: Teqeja e Kulmakut e Dervish Iliazit, në Tomor, Tyrbe e Abaz Aliut në Çukë të Tomorit. Teqe në Brerimës (dimërore) e baba Xhaferit, në fshatin Gjerbës. Teqe e Kuçit, tashmë është rrënojë. Teqe e fshatit Çërricë edhe kjo e rrënuar. Teqe e Strafickës e Baba Meleqit. Teqja e Shëmbërdhenjtit e Baba Meleq Shëmbërdhenjit (Staravecka).

Për ndërtimin e këtyre vendeve të shenjta, përveç Kryegjyshitës Botërore Bektashiane me seli në Tiranë, një kontribut të veçantë ka dhënë edhe populli i Tomorricës, i cili ju përkushtua në të gjitha kohërat besimit fetar të sektit bektashian. Kontribut të madh kanë dhënë Dervish Iljazi për ndërtimin e teqesë Kulmak, Baba Tahiri për ndërtimin e teqesë të Kuçit, Pajo Dervishit në Çërricë, Bedri Carkanji në Brerim të Gjerbësit.

Populli i Tomorricës duke vlerësuar kontributin e madh të këtyre njerëzve që iu përkushtuan me të gjitha forcat mendore e fizike besimit fetar bektashian, i këndon Dervish Iljazit: *Korriku njëzet e tetë, Dervish Iljazi i vërtetë. Në Kulmak ngriti teqetë. Teqeja në rrëzë Tomorrit. Ndrin si yll në mes të qiellit... Ose siç këndohet kënga tjetër: Mu në fushë të Qerbelasë . Lluftojnë djemtë e Zyrihasë. Lluftojnë djemtë e Zyrihasë. Për njerëzimin që do vij pas. ... Nuk mund të mos përmendësh teqenë e Shëmbërdhenjtit me në krye Baba Meleq Shëmbërdhenjin (Staravecka). Duhet thënë se klerikët bektashinj kanë dhënë një kontribut të madh jo vetëm fetar por edhe patriotik, në përhapjen e gjuhës shqipe, në zgjimin e ndjenjës kombëtare dhe në organizimin e luftës për liri dhe pavarësi.*

Baba Meleqi me krijimtarinë e tij zgjonte krenarinë kombëtare dhe frymën patriotike. Teqja e tij ishte bazë e çetave të luftëtarëve të lirisë, ku bashkëpunonte me luftëtarët si Xhile Liçi, Asllan Shahini, Qemal Panariti etj. Klerikët bektashinj të Tomorricës kanë mbajtur lidhje me patriotë të Rilindjes dhe Pamvarësisë të tillë si: Kristo Luarasi, Bajo dhe Çerçiz Topulli, Hilë Mosi, Ismail Qemali, Papa Kristo Negovani etj (Burimi Petrit Basha, Tomorri përballë nesh). Duke marrë parasysh kushtet klimaterike tokësore për prodhimet bujqësore e blegtorale ajo vazhdimisht është quajtur "Myzeqeja e Skraparit". Tomorrica është dalluar dhe dallohet në të gjitha kohërat për cilësitë veçanta si mikpritja, bujaria dhe virtyte të tjera. Ajo dallohet për kultivimin dhe zhvillimin e zakoneve dhe traditave më të mira të Skraparit dhe Gramshit. Populli i ka thurur edhe këngë luginës së Tomorricës, ku ndërmjet të tjerash i thotë: *"Moj luginë e Tomorricës, midis Tomorrit dhe Koshnicës. Je luginë e bukur shumë, përmes të ndan një lumë. Ndaj ti je*

faqebardhë, në Kulmak çeta e parë..... më tej kënga vazhdon: Nga Kërpicë në Dëvri, ti je shkruar në histori” etj

Profesor Dhimitër Shuteriqi, tek Vepra letrare nr 4 shkruan: Hidhni sytë andej nga Tomorri, e do të shohësh të xixëllojnë yjet dhe dritat në qiell. Se rrojnë edhe andej njerëz të mirë, në kaq e kaq fshtra, rrëzë atij mali të bukur, në Sulovë, në Tomorricë e gjetiu.

Identitet kulturore të krahinës

Tomorrica është e punës, e dijes, e luftës, e zakoneve dhe e traditave më të mira, kjo është krahina e njerëzve të thjeshtë, bujarë e mikpritëse dhe krenarë për gjithçka që kanë trashëguar në shekuj. Kjo krahinë ofron një pasuri shumë të madhe në fushën e etnokulturës. Nga pikëpamja etnologjike shtrihet në krahinën e Toskërisë, por duke qenë pranë krahinave të Myzeqesë dhe Labërisë, në të ka dhe ndikime ndërkrahinore. Popullsia e kësaj krahine dallohet për një numër të madh identitetesh kulturore, që përfshijnë fushat e ndryshme. Vihen re në mënyrën e jetesës, të veshjes, gatimit, të jetës shpirtërore, të besimit fetar. Si kostum popullor tipik ka qenë fustanellë dhe këpucë me xhufka, si dhe përdorimi i gjerë i shajakut. Në fshatin Kërpicë shekuj më parë në pamundësi për të siguruar rrobat e shtrojës apo dhe veshjet, me lirin që e kultivonte vet dhe leshin nga bagëtitë, këto rroba i përpunonin me fuqinë e ujit, që njihen me emrin Dërstila e Taban. Sipas banorëve të zonës kanë qenë rreth 15 dërstila, të vendosura në të dy krahët e burimit dhe mbi 8 tabanë.

Në fushën e krijimtarisë folklorike në këtë krahinë gjen tradita të pasura. Si burim frymëzimi kanë shërbyer ceremonitë dhe festat e ndryshme. Këngët dhe vallet janë tepër karakteristike. Sipas tipeve të tyre mund të ndahen në këngë të kurbetit, e tillë është ajo e “Artistit të Popullit” Demir Zyko, nga fshati Gjerbës, e titulluar “ Mbeçë more shokë mbeçë” Studiuësit e folklorit e kanë quajtur këtë këngë si perlë e muzikës popullore shqipëtare. Tipe të tjera janë; këngë e valle dasmash, këngë për malin e Tomorrit, për Klerikët Bektashinj, për trimat e rënë në luftë etj.

Krahina shquhet dhe për botën e pasur shpirtërore. Trimëria, besimi, humanizmi, respekti i ndërsjellët janë cilësi që i karakterizojnë këta banorë. Mikpritja është një traditë tepër e vyer e kësaj krahine, kjo është pjesë përbërëse e bujarisë dhe të edukatës që kanë këta banorë. Si elementë më të rëndësishëm zakonorë janë; gatimet karakteristike të zonës, rakia dhe dollia,

Ashtu si e ka në traditë e gjithë krahina e Skraparit edhe në Tomorricë prodhimi i rakisë është shumë shekullor. Kjo lidhet me kushte e favorshme klimatike, në kultivimin e hardhisë, përgjatë luginës së Tomorricës. Ka qenë dhe është një zakon: Një shishe a një pagure raki është një nga dhuratat më të gjetura nga i zoti i shtëpisë për mikun, kur e përcjell. Dhe skena është pak a shumë e njëjtë, disi ceremoniale. Para se ta fuste në xhep, ai e tundte edhe një herë paguren dhe, me një ndjenjë të dallueshme krenarie në fytyrë thoshte: “Merre, e ke ballkazani, shiko sa e ka syrin! Zakonisht ajo nuk pihet çdo ditë, më shumë në ditë festash dhe gëzime familjare. Por duhet thënë se tradita e ka të pihet me karar dhe lezeti i saj është dollia. Tradita e ka dashur që drejtuesit e muhabetit, i zoti i shtëpisë dhe mikun, mundoheshin që të gjithë pjesëmarrësit të pinin me masë dhe të mos deheshin (Z.Hoxha Gazeta Telegraf . Tradite 20011).

Problemet aktuale që bëjnë pjesë në këtë krahinë janë disa. Pas rënies së sistemit socialist dhe nga kalimi i ekonomisë nga ekonomi socialiste në ekonomi tregu, ekonomia

pati mjaftë dëmtime. Por e meta më e madhe është se ajo edhe në kohën e kolektivizimit nuk pati ndonjë rritje, madje mund të themi që pati një stanjacion në disa raste edhe hapa mbropa, deri në atë pikë sa fshati blinte në qytet produkte blegtorale, si bulmet e mish, perime e produkte të tjera që mbilleshin në fshat. Me kolektivizimin numri i bagëtive ra, si rrjedhojë edhe rendimenti i tyre pavarësisht se u bë një përpjekje për përmirësim racor.

Ndryshimet demokratike patën ndikim të madh në këtë krahinë, ku mbi të gjitha u realizua lëvizja e lirë e këtyre banorëve. Për të siguruar një jetesë më të mirë një pjesë e mirë e kësaj popullate është larguar si brenda dhe jashtë vendit. Në vitin 1991 në këtë krahinë është zbatuar ligji me Nr. 7501, për ndarjen e tokës, miratuar nga parlamenti pluralist i asaj kohe. Pavarësisht këtij procesi, tokat filluan të mos punoheshin në shumicën e rasteve, për shkak të mungesës së mekanikës etj. Këto toka në shumicën e rasteve janë në shpatet e pjerrët të kodrave, ku erozioni ka bërë kërdrinë, duke i kthyer ato në toka të degraduara. Për këtë fenomen flitet më tepër tek monumentet natyrore.

Ja si e shohin realitetin e sotëm të jetës së fshatrave të Tomorricës emigrantët që janë larguar nga kjo trevë shumë herët. Më poshtë po japim përshtypjet e një emigranti që ka kaluar në disa fshatra të Tomorricës, pasi ka kaluar nga Guri i Prerë hyn në fshatrat e Tomorricës, ndërmjet të tjerash thotë: "U përqafova me të gjithë dhe u largova për në krahun e Tomorricës, që i takojnë rrethit të Skraparit. Fshati i parë që ndesha ishte Gurrazezi. Aty nuk gjeta fare njerëz, por vetëm braktisje dhe heshtje. Vazhdova më tutje dhe i mora me radhë" (Gazeta Shqip, artikull 2013).

Kjo është një pasqyrë e vërtetë e kësaj krahine, ku ka vetëm largime të popullatës, me shpresë se këta banorë do ti rikthehen krahinës së tyre, pse jo dhe të investojnë në të, kjo lidhet me resurset e shumta natyrore që ka zona, që nga Ujaniku, deri në Kërpicë dhe nga Gjogovica deri në Nartë.

Konkluzione

Gjatë trajtimit të kësaj kumtese jemi përqendruar në disa momente të rëndësishme, të historisë së kësaj krahine që nga antikiteti deri në ditët e sotme. Fillimisht janë dhënë disa vlerësime për natyrën dhe kufizimet e kësaj krahine me zonat e tjera përreth, Shpjegohet nga ana etimologjike emri Tomorr dhe Tomorricë duke ju referuar historianeve të vjetër si Strabonit; Apianit, dhe personalitetet të tjera në fushën e diplomacisë, historisë etj. Një analizë shkencore i bëhet dhe qëndresës së kësaj popullate ndaj pushtueseve të huaj, që nga shek VIII-IX, deri në shpalljen e pavarësisë në 28 nëntor 1912. Vend të rëndësishëm zë lufta nacional-çlirimtare e popullit të kësaj krahinë për liri dhe çlirim kombëtar. Në fund vlerësohen ndryshimet demokratike të ndodhura edhe në këtë krahinë, pas vitit 1992, deri në ditët e sotme, pasqyrohen dhe identitetet kulturore të kësaj krahine.

Reçensues:

Prof. Dr. Skënder Sala - Universiti Tiranë.

VEÇORITË E REVOLUCIONIT GREK DHE SHQIPTARËT

Rezart Mezani

Çdo perandori në periudhën e rënies u përball me sfida të ndryshme. Shteti Osman, si sfidë të vet pati nacionalizmin, që u bë shkak i copëtimit dhe rënies së këtij shteti multi etnik. Revolucioni Grek përbën lëvizjen e parë që solli krijimin e nje shteti te ri në Ballkan.

Deri në Revolucionin Francez, në shtrirje ndërkombëtare, tek perandorit multi etnike nuk është vënë re asnjë lëvizje që që të jetë e mbështjellë me botkuptim nationalist. Mendimi nationalist që po zhvillohej në Evropë, në fillim të shk. 19 filloi të ndjehej edhe midis elementëve të ndryshëm që jetonin në territorin ku Shteti Osman kishte shtrirje të sundimit të vet¹¹²⁴. Zhvillimet politike në Evropë dhe politika që u ndoq sidomos mbi elementët e krishterë që jetonin në Shtetin Osman në lidhje me politikën ekspansioniste të këtyre shteteve, u bënë një faktor i rëndësishëm në zhvillimin e mendimit nationalist dhe të hapave që do të hidheshin në rrugën që të çonte drejtë pavarësisë. Nga shtetet që i nxitën më shumë shoqëritë e krishtera të Ballkanit kundër Shtetit Osman ishin Rusia dhe Franca¹¹²⁵. Në luftën për Pavarësi të popullsisë së Mores, përshkak se në opinionin publik të Evropës kishte gjetur pranim mendimi që ekzistenca kulturore e Evropës mbështetej mbi civilizimin antik helen/grek, për të dhënë mbështetje u mblodhën ndihma financiare, madje u dërguan në Gadishullin e Mores grupe vullnetarësh me qëllim që të mbështesnin revolucionin. Ky mendim që popullsinë e Mores ishte pasardhës i popullit të lashtë helen/grek, bëri që lëvizja Greke, në krahasim me lëvizjet e tjera nacionaliste që po zhvilloheshin në Ballkan, të gjente më shumë pranim dhe përkrahje nga Shtetet Evropiane¹¹²⁶.

Lëvizja Greke që filloi më 1821, fillimet e veta i pati në Gadishullin e Mores dhe shumë shpejt u përhap në rajon. Administrata Osmane duke e menduar si një kryengritje të zakonshme për shkaqe ekonomike apo për keq trajtime nga nënpunësit vendore, reagoi duke dërguar forca ushtarake për ti dhënë fund kesaj revolte. Ndërhyrja e Fuqive të Mëdha Evropiane i dha një dimension tjetër kesaj lëvizjeje. "Projekti Grek" si

¹¹²⁴ Lewis, *Modern Türkiye'nin Doğuşu*, çev. Prof. Dr. Metin Kırıralı, TTK. Yay. Ankara 1988, f. 129 - 130

¹¹²⁵ Mezani, s. 21-26

¹¹²⁶ Seyitdanlioğlu, *Yunan İhtilali ve II Mahmud'un Politikaları*,

<http://yordam.manas.kg/ekitap/pdf/Manasdergi/sbd/sbd12/sbd-12-06.pdf>; İhsanoğlu, f. 85; Piriñçi, "Yunan Ulusal Kimliğin Oluşumu Sürecinde İçsel ve Dışsal Parametrelerin Analizi", *Ankara Üniversitesi Dil ve Tarih - Coğrafya Fakültesi Dergisi*, Cilt. 46, Sayı 1, 2006, f. 55.

marrëveshje midis Fuqive Evropiane, për herë të parë u arrit në marrëveshjen që Kateriana II bëri me Josephin II (1783). Në thelbin e këtij projekti qëndronte ringritja e shtetit Bizantin mbasi të rrëzohej shteti Osman. Në këtë marrëveshje të dy shtetet u morrën vesh në coptimin dhe ndarjen e territoreve të shtetit Osman dhe mbas marrjes së Stambollit do të formohej përsëri shteti Bizantin¹¹²⁷.

Fillimet e Lëvizjes Nacionale Greke do t'i gjejmë jashtë territorit ku shtrihet sot Shteti Grek. Në fillimet e shk. 19, ekzistenca e një klase të zhvilluar tregtarësh dhe intelektualësh që përfaqësonin mendimin e identitetit grek, u bë një faktor i rëndësishëm në zhvillimin dhe vazhdimisinë e Lëvizjes Nacionale dhe të Pavarësisë Greke¹¹²⁸. Ndërsa faktorin kryesor që kjo lëvizje të arrinte sukses, e përbënte mbështetja dhe ndihmat ushtarake, politike dhe ekonomike që dhanë shtetet Evropiane¹¹²⁹. Më 1829, mbas luftës midis Rusisë dhe Shtetit Osman, që përfundoi me humbjen e osmanllinjve, në Edirne u firmos një marrëveshje, sipas së cilës Shteti Osman pranoi formimin e një shteti autonom Grek. Me këtë marrëveshje Shteti i Ri Grek, megjithese nuk i kishte të përcaktuar sakt kufijt, fitoi statusin ligjor të ekzistencës si njësi më vete dhe më 3 Shkurt 1830 në Londër, me firmosjen e protokollit në mbledhjen që u bë midis Anglisë, Rusisë dhe Francës, arriti shkëputjen nga Shteti Osman. Etapa tjetër ishte t'i paraqiteshin përfundimet e kësaj mbledhje Shtetit Osman dhe të diskutohej mbi detajet teknike të shtetit të ri të pavarur¹¹³⁰.

Pjesëmarrja e shqiptarëve në Revolucionin Grek kërkon ti kushtohet një vemendje e veçant dhe zë një vend të rëndësishëm në shtrirjen e kësaj lëvizjeje në rajon. Në shek. 19, shqiptarët që jetonin në Ballkan i përkisnin fesë së krishterë dhe islame. Shqiptarët ortodoks gjendeshin më shumë në pjesën jugore, në Jug të Shqipërisë së sotme dhe në përgjithësi në Greqi, madje edhe në ishujt e Egjeut¹¹³¹.

Në kryengritjen e Mores, Odisa Andruco, Karaiskaki, Varnacioti, Athanas Dhiako, Gura, Griva, Gardhicioti, Vangel Zapa, Bakola, dhe shumë persona nga familja Boçari e Cavela vinin nga rradhët e ushtrisë së Ali Pashë Tepelenës. Në krye të kësaj lëvizjeje gjendeshin Aleksandër Mavrakordatos, Marko Boçari, Theodoros Kolokotroni, Mavromihalis dhe Patriku i Balyabadrës Germanos. Nga 100 liderët që bënë emër në këtë kryengritje, 90 prej tyre janë me origjinë shqiptare. psh. Marko Boçari, Kolokotroni dhe Mavromihali janë shqiptarë. Në shoqatën "Lidhja Shqiptare e Athinës" e formuar në vitin 1897, janë rregjistruar fëmijët e shumë prej liderve të Revolucionit të 1821't¹¹³².

Nga grupet shoqërore që morrën pjesë në kryengritjen e Moresë dhe luajtën një rol të rëndësishëm, njëri janë grupet e Kleftëve të krishterë që ishin largë autoritetit qëndror, në zona malore dhe tjetri njësit Armatolli që mbështesnin administratën Osmane kundrejt kleftëve¹¹³³. Kola që ka kryer një kërkim mbi elementin shqiptarë në përzierjen kulturore dhe biologjike të grekërve, kundrejt historianit Kordati që mbron mendimin

¹¹²⁷ Günay, Necla "Filik-i Eteria Cemiyeti", Gazi Üniv. Kırşehir Eğitim Fak. Dergisi, Cilt 6, Sayı 1, (2005), f. 269

¹¹²⁸ Nikos Svoronos, Çağdaş Hellen Tarihine Bakış, Çev. Panayot Abacı, Belge Yayınları, İstanbul 1988, s. 27

¹¹²⁹ Ortaylı, "Osmanlı İmparatorluğunda Milliyetçilik", XIII. Türk Tarih Kongresi, V. II, TTK., Ankara 1999, f. 2; Seyitdanhoğlu, f. *Yunan İhtilali ve II Mahmud'un Politikaları*,

<http://yordam.manas.kg/ekitap/pdf/Manasdergi/sbd/sbd12/sbd-12-06.pdf>

¹¹³⁰ George Finlay, *History of the Greek Revolution*, V. II. f. 220 - 222; Erdal Çetintaş, Doğu Akdeniz Politikaları Çerçevesinde Avrupalı Devletlerin Yunan İşyanına Desteği, ergiler.ankara.edu.tr/dergiler/19/1132/13300.pdf

¹¹³¹ Kola, *Arvanitet dhe Prejardhja Greke, Borimet TOENA, Tirane 2008* f. 127 - 200; Halim Çavuşoğlu,

Yunanistan'da Arnavutlar, <http://www.makturk.com/modules.php?name=Neës&file=article&sid=584>

¹¹³² Fuat, *Balkanlarda İlk Dram, Babiali Kültür Yay. İstanbul 2009* f. 32; Kola, f. 361;

¹¹³³ George Finlay, *History of the Greek Revolution*, V. I. f. 22-29

që kleftë ka edhe turqë edhe shqiptarë, por në përgjithësi janë grek, mbron mendimin që kleftët janë shqiptarë. Ai që është Kleft mund të bëhet edhe Armatoll. Ai që është Armatoll kishte detyrën të siguronte rendin në zonën ku ishte emëruar nga administrata qendrore¹¹³⁴.

Organizata që udhëhoqi kryengritjen e Moresë dhe që luajti rol të rëndësishëm në drejtimin e politikave me përmbajtje helenizmin në rajon, padyshim është Organizata Filik-i Eteria. Qëllimi i Organizatës Filik-i Eteria që u themelua sipas rregullave të formimit dhe të veprimit të organizatave masonike, nga ana e tre tregtarëve (dy Rum: Skufas, Emmanuel Ksanthos dhe një bulgar: Almas Çakalof) në vitin 1814 në qytetin Odesa dhe nën mbrojtjen/kujdesin e Ruisisë, në fjalë ishte të përhapte arsimin tek nënshtetasit e krishterë brenda kufijve të shtetit Osman. Në fakt synimi ishte të formonte përsëri Perandorinë Bizante të varur nga Patriakana Ortodokse¹¹³⁵.

Organizata hapi shumë filiale në tokat Osmane e sidomos në qendra (qytete), arriti të shumëfishonte anëtarët e ve brenda një kohe shumë të shkurtër. Nëntë përqind e organizatës përbëhej nga Kleftët¹¹³⁶. Anëtarët si Andruco, Kacioni dhe Mitromara ishin nga anëtarët e rëndësishëm të organizatës, ishin me prejardhje shqiptare¹¹³⁷.

Veçorit e Kryengritjes së Moresë

Për ta studjuar brenda një vlerësimi më të mirë qëndrimin e shqiptarëve kundrejt Kryengritjes së Moresë, nevojitet të shqyrtohen veçorit e kësaj kryengritje.

Shoqërit që jetonin në territorin e Shtetit Osman nuk klasifikoheshin nga ana etnike, por sipas sistemit Millet, i cili ishte një klasifikim mbi botkuptimin fetar: Myslim dhe Gayrimyslim (jo mysliman). Katolikët emërtoheshin Latin, kurse Ortodoksët emërtoheshin Rum dhe ky klasifikim kishte të bënte me qendrën nga e cila varej kisha përkatëse¹¹³⁸. Institucioni më i lartë i fesë së krishtere Ortodokse është Patriakana e Stambollit, e cila emërtohet Patriakana Rume e Fenerit (Fener Rum Patrikhanesi)*. Nga shoqërit që jetonin brenda kufijve të sovranitetit Osman, në pozitën më të mirë ishin Ortodoksët-Rum. Mbas marrjes së Stambollit, në mbështetje të fermanit që nxorri Mehmeti II, nga rregullat që u vendosën kundrejt popullsisë jo-myslimane, Kisha Ortodokse Rume fitoi një pozitë autonome. Ortodoksët që jetonin në Shtetin Osman, pamvarësisht nocionit etnik, sipas statusit ligjor u lidhën tek Patriakana Ortodokse Rume e Stambollit.

Ekzistenca e Patrikanes Ortodokse brenda Shtetit Osman me një status autonom, bëri të lindte mendimi i vazhdimësisë dhe i ringjalljes përsëri të Shtetit Bizantin. Kryengritja e Moresë për shkak se mbështetej tek krijimi i një Shteti Ortodoks nën mendimin e ringjalljes të Shtetit Bizantin, tregoi një zhvillim të mbështjellur me fenë Ortodokse. Për këtë arsye në luftën për pavarësi, për shkak se u mbajt një perceptim i *Fesë dhe Shtetit* dhe kjo luftë u zhvillua nën ombrellën e fesë, shqiptarët me përkatësi fetare ortodoks morrën pjesë dhe luajtën një rol të rëndësishëm në këtë kryengritje. Për të njëjtën arsye edhe

¹¹³⁴ Kola, [Arvanitet dhe Prejardhja Greke, Botimet TOENA, Tirane 2008](#) f. 224 - 225

¹¹³⁵ George Finlay, [History of the Greek Revolution](#), V. I, f. 121-122

¹¹³⁶ Günay, "Filik-i Eteria Cemiyeti", Gazi Üniv. Kırşehir Eğitim Fak. Dergisi, Cilt 6, Sayı 1, (2005), f. 274 - 275

¹¹³⁷ Kola, [Arvanitet dhe Prejardhja Greke, Botimet TOENA, Tirane 2008](#) f. 223

¹¹³⁸ Ortaçlı, "Osmanlı İmparatorluğu'nda Millet Sistemi", [Genel Türk Tarihi, V.6, Yeni Türkiye Yayınları, Ankara 2002](#).

* Patriku i Moskës, Patriku i Egjiptit, Patriku i Antakjes dhe i Kodusit janë një shkallë më poshtë kundrejt Patrikanës së Stambollit.

bulgarët e shikonin veten brenda botës helene dhe në Kryengritjen e Moresë morrën pjesë duke formuar një njësi të konsiderueshme¹¹³⁹.

Në Arkivin Osman në Stamboll (Başbakanlık Osmanlı Arşivi), në lidhje me Kryengritjen e Moresë, e cila çoi në formimin e Shtetit të Greqisë, për një periudhë 10 vjeçare (1820 - 1830) duke përdorur termin "Rum" dhe "Yunan" (Yunan - Grek), gjenden 790 dokumenta. Prej të cilave 745 kanë të përdorur termin "Rum". Këtu do të gjejmë, "Rum isyanı", "Rum ihtilali" (Kryengritja Rume, Revolucioni Rum). Kurse në 45 dokumentet ku është përdorur termi Yunan (grek) do të vëmë re se kjo është përdorur e shoqëruar me fjalën "Devlet" (Shtet), ç'ka tregon shtetin e ri të formuar në More.

Termi "Rum" i përdorur tek osmanët apo edhe tek arabët ka kuptimin "Romak" dhe ky ndryshim lidhet me anën gjuhësore. Kurse "Rumeli" ka kuptimin "Vendi i Rumëve (Romakëve)" dhe në literaturën Osmane ky term është përdorur për të treguar tokat e Shtetit Osman në Ballkan. Në të njëjtin kuptim termi "Diyar-ı Rum" (Tokat Romake) është përdorur për të treguar shtrirjen gjeografike të shtetit të Romës së Lindjes dhe si njësi gjeografike tregohej Anadollu¹¹⁴⁰. Në literaturën Islame Roma e Lindjes/Bizanti identifikohet me termin "rum". Një nga mendimtarët islam që ka jetuar në Konya quhet Mevlana Celaleddin Rûmi. Fjala Rûmi që është përdorur në emrin e tij ka të bëjë me veçorin e vendit ku ai ka jetuar dhe kjo është veçori identifikuese. Edhe Hacı Bayram Veli (1339-1429) është quajtur Şeyhur-Rûm¹¹⁴¹.

Fatih Sulltan Mehmedi me pushtimin e Stambollit i dha fund edhe Perandorisë Romake të Lindjes. Termi Bizans nuk është përdorur nga ky shtet apo nënshtetasit e tij. Ata vet identifikoheshin si "romak"¹¹⁴². Megjithëse iu dha fund Shtetit Romak, termi *rum* vazhdoi të përdorej për të identifikuar një kultur teritoriale. Perceptimi *rum* gjeti vend tek osmanllinjte dhe veten e shikonin si trashëgimtarë të Romës¹¹⁴³. Duke e parë në këtë këndvështrim termi *rum* nuk ka përkatësi etnike, barazimi i perceptimit *rum* me grek është shumë larg realitetit të kohës dhe pranimi i një perceptimi të tillë do të na çonte në përfundime të gabuara.

Në shek. 19 në Ballkan ekzistonte një botkuptim Helen i mbështjellë me besimin Ortodoks-Rum. "Identiteti Rum-Ortodoks, ishte një identitet i vendosur mbi themelet helene dhe e kapërcente atë. Të gjithë të krishterët Ortodoks, pa e përvetësuar shumë si histori dhe etnicitet helenizmin, e përvetësuan gjuhën helene si gjuhë të Ungjillit ku mësohej feja e krishterë, të liturgjisë dhe të filozofisë së akides të krishtërimit. Helenizmi dhe Greqishtja ishte përshkrimi i Krishtërimit Ortodoks. Të gjithë (të arsimuar apo jo) besonin që greqizimi dhe greqishtja ishin rrënja e përbashkët dhe gjuha e përbashkët kulturore"¹¹⁴⁴. Gjuha greke përshkak se ishte gjuha e Patriakanës Ortodokse Rume, përdorej nga kishat Ortodokse që gjendeshin në Ballkan.

¹¹³⁹ Ortaylı, "Osmanlı İmparatorluğu'nda Millet Sistemi", f. 3; Seyitdanhoğlu, *Yunan İhtilali ve II Mahmud'un Politikaları*, <http://yordam.manas.kg/ekitap/pdf/Manasdergi/sbd/sbd12/sbd-12-06.pdf>; Beqir Haçi, *Epiri dhe Prendimet absurde Greke, Koha, Shtepia Botuse Koha, nr. 37, Korrik 2000* f. 20.

¹¹⁴⁰ Sali Özbaran, *Bir Osmanlı Kimliği*, 14.-17. Yüzyıllarda Rûm/Rûmi Aidiyet ve İmgeleri, Kitap yayınevi, İstanbul 2013, f. 42

¹¹⁴¹ Özbaran, *Bir Osmanlı Kimliği*, f. 52 - 57; Fuat Bayramoğlu, *Hacı Bayram-ı Veli: Yaşam, Soy, Vakfı*, V.I, 1983, f.37

¹¹⁴² İlber Ortaylı, *Osmanlı Sarayında Hayat, Yitik Hazine Yay.* İzmir 2008, f. 21

¹¹⁴³ Özbaran, *Bir Osmanlı Kimliği*, f. 44-47.

¹¹⁴⁴ Ortaylı, "Osmanlı İmparatorluğunda Milliyetçilik", XIII. Türk Tarih Kongresi, V. II, TTK., Ankara 1999 f. 3

ELBASANI NË ZONËN E PUSHTIMIT AUSTRO-HUNGAREZ, GJATË VITEVE TË LUFTËS SË PARË BOTËRORE

Prof.As.Dr. Rudina Mita, Msc. Elvis Dhono

Universiteti "Aleksandër Xhuvani"
Elbasan

Abstrakti

Lufta e Parë Botërore dhe largimi i Princ Vidit më 3 shtator 1914 nga Shqipëria e ndërlikuan gjendjen politike në vend. Shqipëria u shndërrua në shesh luftimesh midis dy blloqeve kundërshtarë, dhe u nda në zona pushtimi.

Situata në Shqipëri nën regjimin e pushtimit paraqitej e vështirë dhe e nderë. Kjo dukej qartazi dhe në proklamatat (dy) e hartuara nga Cetinja më 28 janar 1926, të firmosura nga Prenk Bibdoda, Feizi Alizoti, Seid Pasha, Lugi Gurakuqi dhe Aqif pashë Elbasani. Këta personalitete të internuar në Malin e Zi prej malajzezeve, pas uzurpimit nga ana e tyre të Shkodrës ndër të tjera shpreheshin se: " Nuk asht nevoja me ju sjellë ndër ment të gjitha të ligate mjerimet, që ka hequn kombi ynë në këti trië vjetët e fundit nën zgjedhën barbare t`anmiqve t`anë, të cilët, jo vetëm që na vran vllazënit, na rrëmbyen pasuniët e shkretënuen viset t`ona, por u përpoqën me mënyrat ma t`egra e të panjerzishme t`a shuejnë fare fisin t`onë nga faqjae dheut....".¹¹⁴⁵

Qyteti i Elbasanit nga fundi i janarit 1916 ishte zonë e pushtimit Bullgar, të cilët zbarkuan në Elbasan para austro-hungarezëve. Një fakt i tillë evidentohet edhe nga proces-verbali i nënshkruar nga përfaqësuesit elbasanas si Lef Nosi, Kasem Sejдини, Filip Papajani dhe Emin Matraxhiu dhe përfaqësues bullgar ku përmendim Kapiten Serafimoff, Toger Kristoff, dhe nëntogerët Skordeff e Kasaroff. Përmbajtja e këtij proces-verbali ishte: "Sot më 29 kallënduer 1916 ora 4.30 pas mesdite fuqia priëse e Ushtriës Bullgare të të 23-tit regjiment infanterie hyni në qytetin Elbasan (Shqipnië), i cili ish stolisë me flamurë kombëtarë Bullgarë e Shqiptarë. Ushtria menjherë muer masat për me mbajtë qetësin e rregullin mbrenda në qytet. Prandaj u ba ku proces-verbal e u ndëshkrue më nj`anë prej përfaqësuesvet të qytetit....., e më tjetërt anë prej kapidanit, komandantit të kompaniës së 3-të të të 23-tit regjiment infanterije, prej togërit Kristoff, komandantit të të 5-tës batterië artilerie mali, të të 8-tit regjiment edhe prej nëdntogerëve....., oficerëvet të të 23-tit regjiment infanterie".¹¹⁴⁶

¹¹⁴⁵ Instituti i Historisë, Lef Nosi, Dokumente Historike 1912-1918, Tiranë 2007, faqe 245.

¹¹⁴⁶ Instituti i Historisë, Lef Nosi, Dokumente Historike 1912-1918, Tiranë 2007, faqe 246.

Në filim të vitit 1916, pikërisht në janar 1916, ushtria austro-hungareze nisi marshimin e saj drejt Shqipërisë së Veriut, hyri në Shkodër më 23 janar 1916 duke avancuar edhe drejt Tiranës, Durrësit dhe Shqipërisë së Mesme.

Ardhja e tyre u vlerësua dhe u prit mirë nga Lëvizja Kombëtare Shqiptare duke shpresuar e besuar se Austro-Hungaria, e cila para luftës kishte përkrahur rregjimin e Vidit, do ta përkrahte atë edhe gjatë luftës dhe për t'u treguar fuqive ndërluftuese se në Shqipëri ishte rregjimi i Vidit. Synini i një ardhje e një avancimi të tillë sipas austro-hungarezëve ishte çlirimi i Shqipërisë nga forcat pushtuese serbe dhe malazeze, ndërsa sipas shqiptarëve shpresat e tyre për lirinë dhe ruajtjen e atdheut mund të përligjeshin vetëm tek austro-hungarezët. Në proklamaten e përmendur më lart kjo dukej qartë: "E përnderueshmja monarkië Austro-Ungare me një fuqie t'pamasë, diftoj deri m'sod sa fitime lufrash kundra këtyne anmiqve për me projektë (mbrojtë) t'drejtat e veta e s'u kursye ma nap rue edhe t'drejtat t'ona për gjallnimin e përparimin t'kombit t'onë. Vëllazën shqiptarë! Ndër këto ditë t'pa harruëme qi ushtrinat Austro-Ungare me një trimëni t'pa masë, sa fitesa lufrash diftuenë kundra atyne anmiqve t'cillt janë kenë, e janë edhe anmiqt t'onë, kështu sod t'anë shqyphtarët t'bashkuem m'nji mende e zemër pa ndryshim fejet, e kan me detyrë me e pritur ushtrin Austro-Ungare, si rojtës e librues, e do t'detyrohena për ndimë t'këtij bamirsit për xhvillim ashtu edhe për t'kenunit t'ardhes t'onë".¹¹⁴⁷

Shpresa e ringjalljes së regjimit të Vidit pas ardhjes së austro-hungarezëve, do të ishte dhe motivi kryesor i një aktivizimi të forcave shqiptare. Ahmet Zogu komandant i fuqive kombëtare njoftontë nga Kavaja, më 14 shkurt 1916 se: "Sot ngritëm Flamurin Kombëtar në pallat të Mbretit tonë në Durrës dhe po kthehem në Shijak. Nesër do të nisemi drejt për në Elbasan.....", dhe pas katër ditësh Kryetari i Bashkisë së Elbasanit Xhaferr Ilmi Dardha i dërgonte Kryesisë së Bashkisë Tiranë telegramin si vijon: "Për nderim të së martës që vjen asht dita e lumët që Madhnia e Tija Mbreti ynë i lavdueshëm Wilhelmi i Parë nderoi fatbardhësoi Fronin Mbretnuer, u formue këtu një komision për me bamë ceremoniet e zakonshme e me ndriçue e stolisë qytetit dhe po bahen veprimet e duhuna. Pas këtyne ceremonive do t'i paraqiten urime Madhniës Tija me anë të të Naltës Ministrië të Punëve të Mbrendshme. Lutemi kini mirësiën me bamë edhe aty veprimet e duhuna."¹¹⁴⁸

Në rend të ditës në ato moment për shqiptarët dhe veçanërisht për forcat nacionaliste kombëtare ishte mbledhja e një Kongresi kombëtar në Elbasan. Për këtë qëllim një komision i mbledhur më 18 shkurt 1916 në Elbasan, me nismën e Aqif Pashës e të Ahmet Zogut dhe i përbërë nga Ahmet Zogu, Qemal bej Elbasani, Ahmet Haxhisinani, Ymer Stringa, Shefqet Daiu, Sava Papajani, Simon Shuteriqi, Thanas Floqi e Lef Nosi vendosi:

Të mbahej një Kongres më 2 prill allafrenga në Elbasan për të biseduar gjendjen politike dhe masat që duheshim marrë për forcimin e shtetit shqiptar,

Komisioni do t'i propozonte Aqif Pashës, ministrit të Brendshëm, të thërriste edhe ministrat e tjerë, për të nisur e vazhduar punën qeveria e Vidit.¹¹⁴⁹

Kryetari i komisionit të Kongresit, Ahmet Zogu, ftoi më 2 mars bashkitë e qyteteve të zonës austro-hungareze e bullgare të pushtimit, dhe u dërgoi telegrame kryesive të

¹¹⁴⁷ Instituti i Historisë, Lef Nosi, Dokumente Historike 1912-1918, Tiranë 2007, faqe 244.

¹¹⁴⁸ Instituti i Historisë, Lef Nosi, Dokumente Historike 1912-1918, Tiranë 2007, faqe 247-248.

¹¹⁴⁹ Lef Nosi, "Dokumente historike për t'i shërbyer Historisë sonë Kombëtare", viti I, gusht 1946, Nr. 6, faqe 184-185.

katundarive të Beratit, Skraparit, Ballshit, Fierit, Lushnjës, Kavajës, Durrësit, Peqinit, Shijakut, Tiranës, Krujës, Lezhës, Shkodrës, Matit, Dibres dhe Starovës që të dërgonin përfaqësues në Kongres. Ahmet Zogu lajmëroi nga Elbasani edhe Nexhip Dragën (Mitrovicë), Bajram Currin (Gjakovë), Hasan Prishtinën (Prishtinë) dhe Mehmet pashë Derhallën (Tetovë). Ai ftoi gjithashtu kolonitë shqiptare të Bukureshtit, Sofjes e Lozanës të dërgonin edhe ato nga dy delegatë.¹¹⁵⁰ Ja teksti i telegramit “ Marrim nderin me ju lajmëruar se u vendos që të mbledhet këtu në këtë qytet më 16 mars 1916 një Kongres Kombëtar, për me bisedue për punët e Shqipënisë. Lutemi dërgoni dy delegatë të cilët të kenë me vete dhe shkresën e përfaqësimit. Elbasan, 3 mars 1916. Nënshkruar nga kryetari i Komisionit inisiator të Kongresit Ahmet Zogu”¹¹⁵¹

Ahmet Zogu në një letër dërguar August Kral-it, pasi e njoftonte se më 18 mars 1916 ishte vendosur të mbahej Kongresi kombëtar, theksonte se: “Shpresa që kemi mbështetur tek Zotëria e juaj na dha guxim dhe vendosëm që të bëhet më 18 mars (2 prill allafrenga) këtu një Kongres Kombëtar, me anën e të cilit të silllet bashkimi e vllazëria ndërmjet fiseve shqiptare dhe të mendohet ç’ duhet bërë që Atdheu ynë paskëtaj të marri udhën e përparimit e të dijë të gëzojë lirinë që po i japin sot armët e ushtrisë së perandorisë austro-hungareze nga e cila presim zgjerimin e kufijve sipas principit të kombësisë”.¹¹⁵²

Por përpjekjet e atdhetarëve për thirrjen e një kongresi në Elbasan për të shqyrtuar masat e ndryshme politike për rivendosjen e shtetit shqiptar, të njohur nga Fuqitë e Mëdha, nuk u kurorëzuan me sukses pasi në kushtet e Luftës së Parë Botërore, autoritetet austro-hungareze nuk ishin të interesuara për regjimin e Vidit dhe shtetin e pavarur shqiptar. Toger Von Zivtkovski, nënkonsull i Austrisë në Elbasan i shkruante më 12 mars Komandës së korpusit XIX se “Rrahja e mendimeve mbi administratën e ardhshme është e rrezikshme”. Por dhe ndalimi i kongresit, vazhdonte ai, do të shkaktonte zemërim sepse delegatët ishin rrugës dhe do të shfrytëzohej prej kundërshtarëve tanë kundër nesh, eventualisht edhe prej bullgarëve.¹¹⁵³

Nga sa u tha më lart, Kongresi u ndalua jo nga kolera, por nga detyrat politike që synonte të zgjidhte, për të cilat Austro-Hungaria nuk kishte interesa në atë kohë.

Një ndër patriotët e trevës së Elbasanit por edhe një ndër kontribusit e mëdhenj të çështjes shqiptare në rang vendi, Aqif pashë Elbasani, në këto rrethana të reja të krijuara dhe nën autoritetin e një ish ministri të qeverisë së fundit të Turhan Pashës në regjimin e Princ Vidit, i bënte thirrje edhe ish ministrave të tjerë të ktheheshin në detyrë, një ndër objektivat kjo të mbledhjes që do të rregullonte punët e atdheut. Ai nën këtë autoritet emëroi prefekttë, nënprefektë dhe kryetarë komunash në të gjitha zonat e pushtimit austro-hungarez. Aqifi vuri të gjitha forcat për organizimin e administratës shtetërore vidiste.

Kongresi do të shqyrtonte “mënyrën se si do të qeverisej Shqipëria, do t’i shfaqte Mbretit W.Wied dëshirën që ai të vinte sa më shpejt në Shqipëri dhe do të tregonte një mirënjohje për fuqitë që njohën të drejtën e ngritjes së flamurit kombëtar”¹¹⁵⁴.

¹¹⁵⁰ Po aty, faqe 184.

¹¹⁵¹ Shqyqyri Demiri, Histori e shkurtër e trevës së Elbasanit, Tiranë 2006, faqe 128.

¹¹⁵² Kastriot Dervishi, vepër e cituar faqe 73

¹¹⁵³ Arkivi i Institutit të Historisë (Arkivi i Vjenës), më poshtë A.I.H. dokument 26-6-634, datë 12 mars 1916.

¹¹⁵⁴ Kastriot Dervishi, vepër e cituar faqe 73

Komandanti i forcave ushtarake austro-hungareze në Elbasan njoftoi Bashkinë e Elbasanit se në kohë lufte, veprimtari të tilla edhe në Austro-Hungari ishin të ndaluara. Pas këtij njoftimi Aqif pashë Elbasani me cilësinë e ish Ministrit të Punëve të Brendshme njoftoi prefekturat se largohet nga detyra sepse për "shkak të veprimeve ushtarake të qeverisurisë e Shqipërisë do të bëhet përkohshëmish prej Ushtrisë së Mbretërisë së madhe të Austro-Hungarisë.¹¹⁵⁵

Në një notë rezervate të 18 prillit Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneral Kolonel Baron Von Konrad përshkruante arsyet justifikuese të vendosjes së administratës ushtarake. Sipas kësaj note, del se Ministria e Jashtme austro-hungareze ishte për krijimin e një Shqipërie autonome, kurse Kryekomanda ishte kundër. Qëndrimin e vet ajo e justifikonte me faktin se Shqipëria ishte e pushtuar nga ushtritë austro-hungareze, bullgare, italiane e greke. As italianët, as grekët, as bullgarët,- thuhej aty,- nuk heqin dorë vullnetarisht nga ato që kanë pushtuar në Shqipëri. Veçanërisht bullgarët, nëqoftëse do t`u lejonte disa gjendja ushtarake praën Selanikut, "me siguri do të okupojnë edhe toka të tjera në Shqipëri (kishin pushtuar zonën midis Prizrenit e Prishtinës dhe atë në lindje e juglindje të Elbasanit-autorët), për të fituar daljen në Adriatik që ata aspirojnë".¹¹⁵⁶ Për këto arsye Italia, Greqia e Bullgaria nuk do të lejonin kurrë krijimin e Shqipërisë autonome, për më tepër,-thuhet në notën rezervate,-do të bashkëpunonin për synimet e tyre. Zgjidhja e çështjes shqiptare, në formën e një Shqipërie autonome, nuk do të ishte e mundur të arrihej pa një luftë të re, dhe një luftë të re për Shqipërinë, ne, nuk mund t`a shpërthejmë.¹¹⁵⁷

Përveç sa u tha më lart, Kryekomanda shpresonte që, me ndihmën e bullgarëve, të luftoheshin italianët.

Shefi i Shtabit justifikohet edhe me disa pretekse, jo bindëse se gjoja populli shqiptar ishte i përçarë në krahina e fise që luftonin njëri tjetrin, se shqiptarët ishin dembelë dhe shiteshin menjëherë për monedha tingëlluese. Në këto kushte, theksohet në notë,- Shqipëria autonome nën protektoratin austro-hungarez, do të përbente një rrezik për Monarkinë e Habsburgëve dhe e vetmaja rrugë është aneksimi i tokave të Shqipërisë Veriore e të Mesme, të okupuara nga forcat ushtarake austro-hungareze.¹¹⁵⁸

Kryekomanda e ushtrisë, -vazhdon Kral, -vendosi që tokat në Veri të Shkumbinit të konsideroheshin si "toka të administratës sonë", kurse në Jug të Shkumbinit "si tokat e influencës sonë".¹¹⁵⁹ Për të siguruar influencën austro-hungareze në Jug të Shkumbinit, iu propozua Aqif Pashës të ishte Shefi i qeverisë në ato krahina, por ai nuk pranoi.¹¹⁶⁰ Pasi ai ishte për administratë shqiptare dhe jo për administratë ushtarake.

Në këto rrethana, Aqif Pasha, që kishte shpresuar shumë se Austro-Hungaria do të përkrahte regjimin e Vidit dhe kishte punuar me të gjitha forcat për ngritjen e administratës shtetërore Vidiste, dha dorëheqjen.

Austro-hungarezët e kthyen Tiranën në një qendër ushtarake administrative, dhe Elbasanin e kthyen nga një Prefekturë në një nënprefekturë. "Pasi asht nevoja që të gjithë Ndënprefekturat, të lidhen drejt për drejt me komandën e Tiranës dhe Prefekturat

¹¹⁵⁵ Instituti i Historisë, Lef Nosi, Dokumente Historike 1912-1918, Tiranë 2007, faqe 254-255.

¹¹⁵⁶ A.I.H (Arkivi i Vjenës), dok. 26-7-724, datë 18 prill 1916.

¹¹⁵⁷ Po aty.

¹¹⁵⁸ Po aty.

¹¹⁵⁹ A.I.H (Arkivi i Vjenës), dok. 26-19-1906, Relacioni i Kralit, Shkodër datë 18 maj 1916.

¹¹⁶⁰ Po aty.

titullohen Ndënprefektura, tyke qenë i lidhun drejt për së drejti me kryekomandën..... me të vërtetë se kjo firmë qeverrimi asht e përkohshme..... nga nevoja e veprimeve ushtarake, nuk cënon aspak qëllimin e mirë të sajë për shpëtimin e Atdheut tonë e dashuniën që ka mbi ne.....”¹¹⁶¹

Sahatin e Qytetit të Elbasanit e kthyen në kampanë për dhënien e alarmit. Shumë shqiptarë u ingranuan në rradhët e ushtrisë austro-hungareze. Edhe nga Elbasani kishte të tillë. Kur austro-hungarezët kryenin gërmime arkeologjike në Apolloni (Pojan të Fierit), me qëllim gjetjen e objekteve me vlerë dhe dërgimin e tyre në Austro-Hungari, Abaz Taushani në postin e oficerit shqiptar Brenda armatës, dha alarmin për sensibilizim të opinionit lidhur menjë akt të tillë. Austriakët e dënuan për spiunash dhe e pushkatuan.¹¹⁶² Në një relacion të 16 gushtit 1916, Konsulli Kral njoftonte ministrin e Jashtëm, baronin Burian mbi pushkatimin e tre oficerëve shqiptarë. Kundërshtimi i batalioneve të grupit të shqiptarëve të Ahmet bej Matit e veçanërisht i dy batalioneve nga Mati, - shkruante ai, -i “atribuohet ndikimit të oficerëve shqiptarë”.¹¹⁶³ Një farë faji, - vazhdonte ai, - i takon edhe qëndrimit jo energjik të Ahmet Zogut, por kundër tij dhe oficerëve të batalionit të I dhe III nuk u zbulua ndonjë material i mjaftueshëm.¹¹⁶⁴ Të akuzuar për krim kundër ushtrisë austro-hungareze dhe për “lidhje” me italianët, u dënuan me vdekje dhe u ekzekutuan më 4 qershor 1916 kapiten Kamber Ali Berati dhe togerët Bexhet Riza Manastiri dhe Abaz Bej Elbasani (Taushani). Më 15 qershor, po për akuza të tilla pushkatohet në Tiranë edhe toger Mahmut Shefik, komandant kompanie.¹¹⁶⁵

Në vitin 1916 u organizua një mbledhje e fshehtë në shtëpinë e Aqif pashë Elbasanit me pjesmarrjen e Themistokli Gërmenjit e Salih Butkës, ku qëllimi kryesor ishte organizimi i luftës kundër vorio-epiriotëve në zonën e Korçës e okupuar prej Francezëve. Pjesmarrja e elbasanasve në këto luftime ishte e pashmangshme, të cilët qëndruan aty deri në çlirimin e Korçës nga grekët nga Komanda franceze, dhe me vendosjen e administratës civile me drejtor policie Themistokli Gërmenjin.¹¹⁶⁶

Më 23 janar 1917, komanda e korpusit XIX me anë të një proklamate drejtuar popullit shqiptar, shpallte autonominë kulturore të Shqipërisë, derisa të krijoheshin kushtet për vetëadministrim.

Në fillim të vitit 1918, në Elbasan e në zonën e pushtimit, u gjallërua lëvizja për një Shqipëri të pavarur etnike dhe për rivendosjen e regjimit të Vidit. Nxites i kësaj lëvizje të fuqishme u bë njoftimi në gazetën “Noje Fraja Press”, rreth botimit të Rizoffit, përfaqësues i Bullgarisë në Berlin. Në këtë botim shpreheshin synimet e Bullgarisë për aneksimin e trojeve shqiptare dhe sigurimin e një daljeje në Adriatik.¹¹⁶⁷ Në lidhje me këtë qytetarët e Elbasanit i dërguan një Momerandum proteste Korpskomandës së XIX në Shkodër kundër planeve aneksioniste bullgare dhe parashikuan të organizonin një manifestim politik në Elbasan, por autoritetet në zonën e pushtimit nuk i lejuan.¹¹⁶⁸

¹¹⁶¹ Instituti i Historisë, Lef Nosi, Dokumente Historike 1912-1918, Tiranë 2007, faqe 255.

¹¹⁶² Shqyqyri Demiri, Histori e shkurtër e trevës së Elbasanit, Tiranë 2006, faqe 129.

¹¹⁶³ A.I.H., dok. 26-15-1573, datë 18 gusht e 9 shtator 1916.

¹¹⁶⁴ Po aty.

¹¹⁶⁵ Po aty.

¹¹⁶⁶ Shqyqyri Demiri, Histori e shkurtër e trevës së Elbasanit, Tiranë 2006, faqe 128.

¹¹⁶⁷ Po aty, dok. 28-4-499, 14 mars 1918, Komanda e Qarkut Tiranës, Tiranë 17.2.1918.

¹¹⁶⁸ Po aty.

Lëvizja e protestave u shëndrua, në Elbasan dhe në krahina të tjera në një lëvizje për rivendosjen e regjimit të Vidit.

“Në Elbasan e në Fier,...dhe në peticionet kolektive të bashkive të lokaliteteve më të rëndësishëm, u fut kontrabandë formulimi i legjitimitetit të mbretërisë së Vilhelmit të I-rë”.¹¹⁶⁹ Agjitacioni kryesor për Fon Vidin, vazhonte konsulli Kral, nisej prej parisë së Elbasanit, pikërisht prej ish Ministrit Aqif Pashës, i cili parën komandantit të grupit 1/XIX në Elbasan; feldmareshallit Fon Gerhauser “ka gjetur çuditërisht një ndihmë të jashtëzakonshme”,¹¹⁷⁰ jo vetëm për ambicjet e tij personale, por edhe ato politike. Organet e tjera,... “dëshirojnë rikrijimin e Shqipërisë krejtësisht të pavarur nën mbretin e tyrë të mëparshëm”¹¹⁷¹ Konsulli Kral kërkonte nga Ministria e Jashtme t`i jepte direktiva korpskomandës për qëndrimet që duhej të mbante ndaj diskutimeve e gjuhës politike që duhej të përdornin shqiptarët.¹¹⁷² Konsulli Kral kërkonte të kufizonte kërkesat politike të Shqiptarëve. Dëshira e shqiptarëve për rivendosjen e shtetit të pavarur shqiptar dhe bashkimin e krahinave etnike, ishte një aspiratë e përgjithshme kombëtare e patriotëve dhe intelektualëve shqiptarë dhe jo ambicje e interesa personale të Aqif Elbasanit, nëpunësve dhe oficerëve shqiptarë, sikurse orvatej të justifikohesh konsulli Kral.

Nga sa u tha më lart, del qartë se, kërkesa e patriotëve dhe e elbasanasve për rivendosjen e regjimit të Vidit, ishte për faktin se ai personifikonte shtetin e mbretërinë shqiptare, të njohur e të garantuar para lufte nga Fuqitë e Mëdha. Kjo ishte arsyeja që, në Elbasan ishte vendosur të kremtohej 7 marsi i vitit 1918, gjë që nuk u lejua.

Njoftimi sekret të 17 marsit 1918, nga majori Hass vinte në dijeni komandën e korpusit XIX, tek vizita që kajmekani (nënprefekti, -autorët), kryetari i bashkisë Tajar bej Malezi, Dr. Ryzhdi Beu e të tjerë, i kishin bërë Aqif Pashës. Kajmekani kishte informuar se Aqif Elbasanin s: “Ju jeni shkaktari i vetëm që prej austriakëve u ndalua festa e Vidit. Ju e keni tradhëtuar çështjen”.¹¹⁷³ Në qoftë se ne detyrohemi të festojmë së bashku festën e imperatorit dhe përvjetorin e dytë të hyrjes së trupave austro-hungareze në Shqipëri, -i kishte thënë Aqifi,-përse të mos lejoheshim edhe ne të kremtonim 7 marsin festën e Vidit. Në këtë mënyrë,-kishte vazhduar ai,-austriakët kanë thyer zemrat e shqiptarëve dhe kanë humbur gjithë simpatinë tonë. Për të na dhënë një sadsifaksion, kishte vazhduar Aqif Pasha, duhet të lejohemi të festojmë ditëlindjen e princit Fon Vid më 26 mars.¹¹⁷⁴

Shpresat që kishin pasur patriotët shqiptarw se perandoria dualiste do të mbështeste Shtetin Shqiptar nën princ Vidin, u venitën. Duke dyshur se ajo mund të përkrahte pretendimet bullgare, ai i kishte rekomanduar kajmekanit: “Në qoftë se princ Vidi nuk i jepet Shqipërisë, atëhere mund të vijë në konsideratë një princ turk”.¹¹⁷⁵ Kështu kishte informuar kajmekani autoritetet ushtarake austro-hungareze. Ndofta Aqifi është shprehur për një princ turk për t`i prerë rrugën sjelljes në krye të shtetit shqiptar të bullgarit Basri Beu, të cilin e kishin bërë sundimtar të trojeve shqiptare të pushtuara nga ushtria bullgare. Sidoqoftë, propozimi për një princ turk vërtetonte edhe një herë se, bëhej

¹¹⁶⁹ A.I.H. (A.Vj.) dok. 28-32, Shkodër 1 mars 1918.

¹¹⁷⁰ Po aty.

¹¹⁷¹ Po aty.

¹¹⁷² Po aty.

¹¹⁷³ Po aty, dok. 28-44, shtojca e raportit 25.03.1918.

¹¹⁷⁴ A.I.H. (A.Vj.) dok. 28-44, shtojca e raportit 25.03.1918.

¹¹⁷⁵ Po aty.

fjalë, jo për personin e Vedit, por për një symbol që personifikonte shtetin shqiptar e pavarësinë e tij.

Në fund të relacionit të tij, Kral insistonte të frenohej lëvizja Vidiste në Shqipëri, dhe rekomandonte të mos përmendej ai vetë dhe hollësitat konfidenciale të raportit të tij.¹¹⁷⁶

Mardhëniet politike midis shqiptareve dhe austro-hungarezëve në Shqipëri vazhduan të ishin të ndëra, derisa në shtator të vitit 1918 trupat austro-hungareze filluan tërheqjen nga Shqipëria. Vendin e tyre e zunë në muajin tetor 1918 forcat ushtarake italiane, franceze, greke e serbe.

¹¹⁷⁶ По аты.

MINORITETET NË FOKUS TË KOMISIONIT HETIMOR TË ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA

Dr. Sonila Boçi

Instituti i Historisë, QSA

Tiranë

Vera e vitit 1946 ishte shumë e nxehtë për marrëdhëniet ndërmjet shteteve të Ballkanit Perëndimor. Pas fitores së Popullorëve në Greqi në zgjedhjet e 31 majit 1946, marrëdhëniet e Greqisë me fqinjët veriorë: Shqipërinë, Jugosllavinë dhe Bullgarinë u përkeqësuan. Në fillim të korrikut një mori akuzash dhe kundër akuzash të ndërsjella u shkëmbyen ndërmjet qeverisë shqiptare dhe asaj greke për provokacione në zonën ndërkufitare¹¹⁷⁷.

Shpejt situata e acaruar mes dy shteteve fqinje nuk do të ishte një çështje rajonale, por do të merrte karakter ndërkombëtar. Më 24 gusht 1946, ministri i Jashtëm i Republikës Socialiste Sovjetike të Ukrainës, Dimitri Zakharoviç Manuilski, paraqiti para Këshillit të Sigurimit disa akuza kundrejt qeverisë greke. Ai e akuzoi atë se po mbante një qëndrim armiqësor ndaj fqinjëve të saj veriorë. Në mënyrë më specifike Manuilski fajësoi qeverinë greke për provokimet e saj në territorin shqiptar, për pretendimet se ekziston gjendja e luftës mes Shqipërisë dhe Greqisë, për persekutime të minoriteteve nga qeveria greke, si dhe për propagandën e shfrenuar monarkiste për pretendimet territoriale¹¹⁷⁸. Memorandumi ukrainas nuk harronte gjithashtu të fajësonte për gjendjen e krijuar, praninë e trupave britanike në Greqi.

Këto akuza të Ukrainës, të cilat, sigurisht, mbështeteshin nga Bashkimi Sovjetik, shkaktuan shqetësim të SHBA-ja dhe Britania e Madhe. Në sesionin e datës 28 gusht 1946, delegati i Vendeve të Ulëta mbështeti mocionin e Mbretërisë së Bashkuar për të mos i diskutuar akuzat ukrainase në këtë seancë, por t'i shtynte për seancat e mëvonshme¹¹⁷⁹. Çështja e akuzave ukrainase u diskutua gjerësisht në kancelaritë e ndryshme ndërkombëtare. Më 5 shtator 1946, Sekretari i Shtetit në detyrë, Acheson,

¹¹⁷⁷ Për akuzat shqiptare mbi provokacionet greke në kufi shih: *Bashkimi*, 12 korrik 1946; ndërsa për akuzat greke shih: Foreign Relations of the United States Diplomatic Papers (më tej: FRUS), edited by United States Department of State, Washington: United States Government Printing Office, 1967, 1946, vol. VII, 179, Procesverbal bisede i zhvilluar mes zyrtarëve të Departamentit të Çështjeve të Lindjes së Afërme dhe të ngarkuarit grek në SHBA, Gouras, 8 korrik 1946.

¹¹⁷⁸ FRUS, 1946, Vol. VII, f. 194, shënime të redaksisë.

¹¹⁷⁹ Për më tepër shih: *Po aty*, f. 196, Departamenti amerikan i Shtetit dhe Foreign Office nuk dëshironin që akuza të tilla të merreshin në shqyrtim përpara zhvillimit të plebishitit për formën e regjimit, të parashikuar për në 1 shtator 1946. Për këtë arsye, ata kërkuan që para se Këshilli i Sigurimit të vendoste, ai duhet të kishte mundësi të dëgjonte palët e interesuara.

instruktonte përfaqësuesin e SHBA-së në OKB, Herschel V. Johnson t'i konsideronte akuzat ukrainase veçse si një pjesë të së vërtetës. Ai vinte në dukje se qeveria greke gjithashtu pretendonte se shqiptarët po kryejnë provokacione në kufirin greko-shqiptar¹¹⁸⁰.

Në instruksionet amerikane i kushtohet rëndësi jo e vogël akuzës së delegatit ukrainas për keqtrajtimin e minoriteteve nga qeveria greke. Sipas qeverisë amerikane akuzat të tilla kërkonin më tepër ndriçim, pasi përsëri të dyja shtetet akuzojnë njëri-tjetrin. "Është i njohur, - i shkruante Sekretari amerikan në detyrë, Acheson, përfaqësuesit të SHBA, Johnson, - pretendimi shqiptar se 25000 shqiptarë u dëbuan nga Greqia. Nga ana tjetër, Shqipëria është akuzuar për persekutim të minoritetit grek"¹¹⁸¹. Departamenti amerikan i Shtetit shprehej se ishte pothuajse e pamundur të kishte një pamje të plotë dhe të qartë të kësaj çështjeje të diskutueshme. Trajtimet që u bëheshin minoriteteve kombëtare nga shtetet në të cilat jetonin konsideroheshin si çështje të juridiksionit të brendshëm të shtetit. Megjithatë, Departamenti i Shtetit ishte i ndërgjegjshëm se, "disa praktika që lidhen me minoritetet kombëtare si dëbimi i dhunshëm mund të kenë implikime ndër-kombëtare që lidhen me OKB-në"¹¹⁸².

Më 7 shtator 1946, SHBA-ja paraqiti një qëndrim më të prerë ndaj akuzave të Ukrainës. Ndërsa ishte e mendimit se qeveria shqiptare duhej të thërritej për të paraqitur para Këshillit të Sigurimit këndvështrimin e saj si palë në diskutim, ajo shpалosi bindjen e saj se nuk ishte Greqia shkaktarja e gjendjes së krijuar në Ballkan¹¹⁸³. Incidentet kufitare dhe persekutimi i minoriteteve ishin, sipas qeverisë amerikane, "simptoma të përgjithshme të gjendjes në Ballkan"¹¹⁸⁴. Megjithatë, SHBA-ja u shpreh e shqetësuar për pasojat që mund të shkaktonin çështjet e minoriteteve kombëtare për paqen ndërkombëtare. Çështjet e minoriteteve në Ballkan e kishin treguar dhe në të kaluarën se mund të shkaktonin fërkime serioze ndërmjet shteteve¹¹⁸⁵. Por, Departamenti amerikan i Shtetit nuk mendonte se "fërkimet e deritanishme do të rrezikonin paqen ndërkombëtare"¹¹⁸⁶. Në situatën e krijuar, ishte e mjaftueshme krijimi i një komisioni apo nënkomisioni, i cili të shqyrtonte ankimet e secilës nga palët e interesuara në New York¹¹⁸⁷.

Më 9 shtator 1946 u zhvillua një seancë e Këshillit të Sigurimit ku u thirrën për t'u dëgjuar përfaqësuesit e qeverive greke dhe shqiptare. Në emër të qeverisë greke foli përfaqësuesi i saj, Vassili Dendramis, ndërsa për qeverinë shqiptare, Tuk Jakova. Ky i fundit akuzoi qeverinë greke për provokacionet e shumta kufitare. Ai u shpreh se i kishte vënë në dispozicion komisionit dy lista të gjata provokacionesh në kufirin shqiptar, ndërkohë që një listë tjetër sapo i kishte mbërritur nga qeveria e tij. "Fshatarët shqiptarë pranë kufirit, - shtoi ai, - janë shqetësuar nga shkaku i viktimave që kanë pasur gjatë këtyre provokacioneve dhe jeta, nderi dhe pasuria e tyre ndodhen në rrezik"¹¹⁸⁸. Duke mbështetur akuzën e ministrit të Jashtëm ukrainas për persekutim të minoriteteve nga

¹¹⁸⁰ Po aty, f. 198, Sekretari i Shtetit në detyrë, Acheson për përfaqësuesin e SHBA-së në OKB, Johnson, 5 shtator 1946.

¹¹⁸¹ Po aty.

¹¹⁸² Po aty.

¹¹⁸³ Po aty, f. 203, Sekretari i Shtetit në detyrë, Acheson për përfaqësuesin e SHBA-së në OKB, Johnson, 7 shtator 1946.

¹¹⁸⁴ Po aty.

¹¹⁸⁵ Po aty.

¹¹⁸⁶ Po aty.

¹¹⁸⁷ Po aty.

¹¹⁸⁸ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ), Viti (më tej: V). 1946, Dosja (Më tej: D.) 58, Fleta (më tej: fl.) 121-123, Fjala e Tuk Jakovës para Këshillit të Sigurimit të OKB-së, 9 shtator 1946.

qeveria greke, diskutimi i Tuk Jakovës u përqendrua në gjendjen e minoritetit shqiptar në Greqi. Ai kundërshtoi pretendimin e Dendramisit, sipas të cilit, minoriteti çam kishte bërë krime ndaj popullsisë greke gjatë periudhës së pushtimit italian dhe largimi i tij ishte si pasojë e këtyre krimeve. Tuk Jakova parashtrroi një ekspozë të gjatë të krimeve greke ndaj popullsisë çame, ai tregoi për vështirësitë dhe mungesat e shumta me të cilat përballlej kjo popullsi në Shqipëri, si dhe fajësoi qeverinë greke që nuk po merrte asnjë masë për kthimin e tyre¹¹⁸⁹. Përfaqësuesi shqiptar akuzoi Athinën zyrtare për pretendimet e saj territoriale ndaj Shqipërisë së Jugut, “djepin e patriotizmit shqiptar”¹¹⁹⁰. Ai përsëriti me tone të ashpra qëndrimin e qeverisë shqiptare se në territorin e shtetit shqiptar nuk ka asnjë pëllëmbë tokë të huaj dhe se “kushdo që do të guxojë të kalojë piramidat e kufirit, atje do të derdhet gjak”¹¹⁹¹. Në përfundim të fjalës së tij, përfaqësuesi shqiptar i kërkoi Këshillit të Sigurimit të ndërhynte pranë qeverisë greke për të pushuar provokacionet në kufirin shqiptaro-grek¹¹⁹².

Në lidhje me çështjen e incidenteve kufitare dhe të trajtimit të minoriteteve anëtarët e Këshillit të Sigurimit kishin mjaft divergjenca. Përfaqësuesi i Francës, Parodi, propozonte një komision hetimi, i cili të mblidhte faktet në terren. Ndërsa për përfaqësuesin e Vendeve të Ulëra, Këshilli duhet të mjaftohej me tërheqjen e vëmendjes palëve, si dhe t'u kërkonte Fuqive të Mëdha të bëheshin moderatorë të situatës¹¹⁹³. Ndërkohë që Britania e Madhe, e cila ishte prekur drejtpërdrejt nga akuzat e përfaqësuesit ukrainas, se prania e trupave britanike në Greqi po rrezikonte paqen ndërkombëtare, ishte e interesuar që Këshilli t'i rrëzonte tërësisht akuzat. Më 12 shtator 1946, në telegramin e Departamentit amerikan të Shtetit për përfaqësuesin e SHBA-së në OKB, Johnson, shkruhej se përfaqësuesit e Shqipërisë dhe të Greqisë, nuk kishin ofruar prova me vlerë për incidentet kufitare, kështu që akuzat ukrainase nuk duhet të merreshin më në konsideratë nga Këshilli i Sigurimit¹¹⁹⁴. Megjithatë, SHBA-ja konsideronte se gjendja në këtë pjesë të Ballkanit nuk ishte e qetë. Për këtë arsye, Departamenti i Shtetit e instruktonte përfaqësuesin e tij të mbështeste, nëse propozohej një gjë e tillë, krijimin e një nënkomiteti për të hetuar më tej këtë çështje. Detyra e këtij nënkomiteti do të ishte të pyeste dhe të merrte nga qeveritë informacione të tjera në lidhje me fërkimet përgjatë kufijve midis Greqisë nga njëra anë dhe Shqipërisë, Jugosllavisë dhe Bullgarisë nga ana tjetër¹¹⁹⁵.

Më 18 shtator 1946, përfaqësuesi i SHBA-së e shpalli këtë qëndrim të qeverisë së tij para Këshillit të Sigurimit. Në seancën e 20 shtatorit 1946, ai propozoi krijimin e një komisioni prej tre vetash, të cilët të kryenin misionin e mbledhjes së fakteve për të gjitha incidentet kufitare në të gjithë gjatësinë e kufirit grek me fqinjët veriorë të saj. Ky

¹¹⁸⁹ Po aty.

¹¹⁹⁰ Po aty.

¹¹⁹¹ Po aty.

¹¹⁹² Po aty.

¹¹⁹³ FRUS, 1946, Vol. VII, f. 216-218, Procesverbal i bisedës nga drejtori i Zyrës së Çështjeve Politike Speciale, Hiss, 13 shtator 1946.

¹¹⁹⁴ Po aty, f. 214, Sekretari i Shtetit në detyrë për përfaqësuesin e SHBA-së në OKB, Johnson, 12 shtator 1946.

¹¹⁹⁵ Po aty.

propozim i SHBA-së u hodh poshtë për shkak të vetos sovjetike¹¹⁹⁶. Qeveria sovjetike nuk dëshironte që hetimi të përfshinte dhe kufirin jugosllavo-grek dhe bullgaro-grek¹¹⁹⁷. Mungesa e një Komisioni Hetimor nuk e pengoi qeverinë greke të bënte kundërpërgjigjen e saj. Gjatë muajve tetor-dhjetor të vitit 1946, Greqia e përdori OKB-në si tribunë për të akuzuar shtetin shqiptar për keqtrajtim të minoritetit grek. Qeveria greke filloi të dërgonte informacione gati periodike, në të cilët akuzonte qeverinë shqiptare se kishte filluar një valë të re burgosjesh, internimesh dhe persekutimesh të minoritetit grek. Kështu, në një letër të paraqitur nga përfaqësuesi i qeverisë greke, Dendramisi, për Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së, Turgve Li, njoftonte se gjatë 15-ditëshit të parë të tetorit 1946, Athanatos Vis, nga Leskoviku, u dënua me vdekje nga gjyqi ushtarak i Korçës dhe është në burg në pritje të ekzekutimit. Jani Fundi u arrestua në rajonin e Sarandës dhe Paul Kaculi, Sofokli Kondis, Antoni Tasi dhe Nikolla Kosmo në rajonin e Gjirokastrës. Sipas së njëjtës informatë, një dyzinë me helenë të Epirit të Veriut, emrat e të cilëve nuk janë bërë të njohur, janë arrestuar dhe burgosur në Gjirokastrë¹¹⁹⁸. Në fund të nëntorit, në një tjetër komunikim mes përfaqësuesit grek në OKB dhe Sekretarit amerikan të Shtetit, njoftohej për ekzekutimin e Kristo Gjinit, Thanas Pandos, Sotir Shqevit, Aristotel Likarpadesis, Efthimi Gokas, Kostandin Evangjelis. Sipas letrës së qeverisë greke, këto ekzekutime bënë pjesë në përpjekjet sistematike të qeverisë shqiptare mbi bazën e një plani, parashikuar për të eliminuar “popullatën e pastër helene të Epirit të Veriut”¹¹⁹⁹.

Është e vërtetë që gjatë vitit 1946 qeveria shqiptare, e dominuar nga komunistët, filloi ta manifestonte hapur natyrën e saj të vërtetë me përpjekjet për të vendosur regjimin komunist dhe të ashtuquajturën “diktaturë të proletariatit”. Në të gjithë vendin, nga jugu në veri, filluan të përndiqeshin të gjithë ata që kishin kundërshtuar regjimin, në mënyrë të hapur apo të heshtur, si: tregtarë, industrialistë apo individë të familjeve të mëdha. Po kështu filloi një “gjueti shtrigash” ndaj klerikëve katolikë. Nga ky kuadër i përgjithshëm nuk mund të bënte përjashtim as popullsia e Shqipërisë së Jugut, madje as minoriteti grek. Edhe në gjirin e popullsisë greke pati arrestime dhe internime. Një pjesë e emrave, të përfshira në memorandumet greke, gjenden dhe në dosjet gjyqësore të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Pavarësisht nga kjo, mund të thuhet me bindje se informacionet e qeverisë greke japin një version të shtrembëruar të së vërtetës. Së pari, ajo konsideron minoritarë grekë të internuar dhe të arrestuar edhe shqiptarët ortodoksë të Shqipërisë së Jugut që kishin pësuar një fat të tillë. Në vazhden e njësimi të qëllimshëm të fesë me kombësinë, në raportet greke përfshiheshin shqiptarët ortodoksë të krahinave të Jugut, si: Leskoviku, Erseka, Përmeti, Korça etj. Sa për ta ilustruar këtë mund të përmendim informacionin e datës 29 nëntor 1946, në të cilin flitej për arrestimin dhe burgimin e 33 familje “greke” të Korçës, midis të cilëve përmendeshin dhe emrat e juristit Vasil Kondis (mbi 70 vjeç),

¹¹⁹⁶ *Po aty*, f. 221, shënimet e redaksisë.

¹¹⁹⁷ Për akuzat dhe kundërakuzat greke dhe jugosllave mbi kufirin jugosllav-grek shih: *Resurgent Irredentist: Documents on Skopje "Macedonian" Nationalist Aspirations (1934-1992)*, edited by Basil Kondis, Kyriakos Kentrotis, Spyridon Sftas, Yiannis D. Stefanidis, Thessaloniki: Institute of Balkan Studies, 1993; si dhe *Greek Terror in Aegean Macedonia, Threat to War Peace and Security*, (përmbledhje dokumentesh), published by Macedonian American People's League of USA, Michigan: 1950.

¹¹⁹⁸ *AMPJ*, V. 1946, D. 128/5, fl. 103. Letër e ambasadorit grek Dendramisi për Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së, pa datë.

¹¹⁹⁹ *Po aty*, fl. 105. Letër e ambasadorit grek, Dendramisi, për Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së, 26 nëntor 1946.

Petro Kotokos, vëllait të ish-peshkopit të Gjirokastrës, Pandelejmon Kotokos¹²⁰⁰. *Së dyti*, e lidhur ngushtë me të parën, numri i dhënë nga qeveria greke është i ekzagjeruar. Statistikat e dhëna nga qeveria greke pretendojnë se vetëm në muajin janar të vitit 1946 janë internuar 394 minoritarë dhe burgosur 130 të tjerë¹²⁰¹. Ndërkohë, sipas statistikave të Ministrisë së Brendshme të kohës, gjatë gjithë vitit 1946 janë arrestuar si agjentë grekë në gjithë Shqipërinë 78 persona¹²⁰². *Së treti*, motivacionet që jep qeveria greke, pra atë të persekutimit për shkak të përkatësisë etnike janë të shtrembëruara. Qeveria komuniste shqiptare ishte në procesin e vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri. Ashtu si në të gjitha vendet e tjera me qeveri komuniste në Evropën Lindore, një nga shtyllat e politikës në lidhje me kombësitë ishte farkëtimi i bashkim-vëllazërimit mes popullsisë shqiptare dhe minoriteteve. Nga hulumtimi i deritanishëm i arkivave të KQ të PKSH-së nuk kam mundur të gjej asnjë dokument që të na çojë të mendojmë se qeveria e Enver Hoxhës ka pasur ndonjë linjë politike për të ndryshuar strukturën etnike të rajonit ku jetonte minoriteti grek. Nga ana tjetër, nëse bëjmë një krahasim mes numrit të shqiptarëve të arrestuar apo internuar gjatë viteve 1945-1946 nga qeveria e E. Hoxhës, mund të themi se, edhe në raport dhe me peshën specifike të popullsisë, numri i shqiptarëve të arrestuar është disa herë më i madh. Çështja e trajtimit të ashpër në burgjet komuniste dhe për dënimet tejet ekstreme të dhëna nga gjykatat ushtarake gjatë viteve 1945-1946 dhe për personat civilë, të cilat, fatkeqësisht, i vuajti dhe një pjesë e minoritetit grek apo çështja se si këto arrestime u perceptuan në minoritetin grek, janë jashtë objektit të këtij prezantimi. Qeveria greke i përdorte këto akuza si kundërpeshë për akuzat e bëra më parë nga qeveria shqiptare, si dhe akuzën që kishte përsëritur përfaqësuesi i Ukrainës në lidhje me persekutimin dhe largim e dhunshëm të minoritetit shqiptar nga nacionalistët grekë.

Në të njëjtën kohë, situata politike në Greqi po shkonte duke u përkeqësuar gjithnjë e më shumë. Pas plebishitit të shtatorit 1946, dhe, veçanërisht pas kthimit të mbretit Jorgo II, më 28 të po atij muaji, tensionimi i situatës së brendshme politike në Greqi erdhi duke u përshkallëzuar. Në tetor të vitit 1946 u krijua Ushtria Demokratike Greke, si krahu i armatosur i PKG-së. Lufta civile do të shndërrohej në një provë force jo vetëm midis qeverisë dhe PKG-së brenda në Greqi, por edhe mes Bllokut Perëndimor dhe atij Lindor¹²⁰³.

Ndonëse gjatë vitit 1946 Bashkimi Sovjetik nuk e mbështeti hapur të majtën greke¹²⁰⁴, Niko Zahariadhis kishte arritur, që në shkurt të vitit 1946, të merrte premtimin për ndihmë nga Jugosllavia, Bullgaria, Shqipëria dhe Çekosllovakia¹²⁰⁵. Gjatë muajve tetor-dhjetor u ndje një rritje e tensionit dhe në marrëdhëniet e Shqipërisë me Greqinë. Në tetor 1946, kryetari i Misionit Amerikan, Jakobs njoftonte qeverinë e tij se kishte

¹²⁰⁰ *Po aty*, V. 1946, D. 87, fl. 10, Telegram i nënsekretarit të përgjithshëm të OKB-së drejtuar delegacionit shqiptar në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut.

¹²⁰¹ *AMPJ*, V. 1946, D. 27, fl. 13-21, Të dhëna e qeverisë greke dërguar qeverisë britanike në lidhje me gjendjen e minoritetit grek në Shqipëri.

¹²⁰² Arkivi i Ministrisë së Brendshme (më tej: *AMB*), Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, Dega I, V. 1965, D. 384, fl. 10.

¹²⁰³ Në lidhje me fillimet e Luftës së Ftohtë, shih: John Lewis Gaddis, *We now know: Rethinking Cold War History*, New York: Oxford University Press, 1997.

¹²⁰⁴ Arnold A. Offner, *Another such victory: President Truman and the Cold War 1945-1953*, California: Stanford University Press, 2002, f. 195.

¹²⁰⁵ Thanasis D. Sfikas, *The British Labour Government and the Greek Civil War: the Imperialism of "Non-intervention"*, Ryburn Publishing, 1994, f. 106.

grumbullime forcash ushtarake shqiptare dhe se opinioni i përgjithshëm në Shqipëri perceptonte se ishin shumë afër një lufte me Greqinë¹²⁰⁶. Nga ana tjetër, në një takim të Sekretarit të Shtetit, Burns, me kreun e delegacionit grek, Dragumis, në Konferencën e Paqes në Paris, ky i fundit kishte përmendur se “popullsia rurale në Greqinë e Veriut ishte kaq e bindur se do të pushtohej nga Shqipëria, sa fermerët po linin fushat, ndërkohë që duhet të përgatiteshin për mbjelljet dhe po gjenin strehë në qytete”¹²⁰⁷. Përfaqësuesit perëndimorë në shtetet ballkanike ishin të ndarë mbi shkaqet e kësaj gjendjeje në Ballkan. Për përfaqësuesit amerikanë në Shqipëri, situata ishte shkaktuar nga agresiviteti me të cilin Greqia kishte parashtruar gjatë gjithë vitit 1946, pretendimet e saj territoriale ndaj territorit shtetëror shqiptar¹²⁰⁸. Ndërsa ambasadori amerikan në Greqi, Lincoln MacVeagh mendonte se “politika greke që pas çlirimit kishte synuar të shmangte konfliktet me fqinjët veriorë”. Sipas ambasadorit të SHBA-së në Greqi, nuk ishin pretendimet territoriale greke shkak për gjendjen e krijuar, por propaganda jugosllave për aneksimin e Maqedonisë Perëndimore, si dhe mbështetja nga të tre fqinjët veriorë të gueriljeve komuniste në zonën e pretenduar¹²⁰⁹.

Më 3 dhjetor 1946, qeveria greke me anë të përfaqësuesit të saj, Athanasios Agnidis, i kërkoi Këshillit të Sigurimit të ndërhynte ndaj fqinjëve veriorë të saj: Bullgarisë, Jugosllavisë dhe Shqipërisë, të cilët krijonin incidente kufitare dhe ndihmonin gueriljet greke¹²¹⁰. Në 19 dhjetor 1946, Këshilli i Sigurimit votoi unanimisht krijimin e një Komisioni Hetimor të përbërë prej 11 anëtarësh, të cilët kishin për detyrë të mblidhnin fakte mbi shkaqet e situatës së tensionuar në kufijtë veriorë të Greqisë. Ky Komision do të jepte rekomandime në lidhje me: incidentet kufitare, trajtimin e minoriteteve, shtrembërimet tendencioze të fakteve në radio dhe në shtyp, aktivitetet me karakter ushtarak dhe policor të shteteve të huaja në katër vendet në fjalë¹²¹¹.

Pas dy muajve punë për mbledhjen e dëshmive në Greqi e Shqipëri, në mars 1947, Komisioni Hetimor u vendos në Gjenevë ku do të shkruante raportin përfundimtar për faktet e mbledhura në terren, si dhe do të hartonte rekomandimet përkatëse. Ndërkohë, u vendos që nënkomisione të veçanta të Komisionit të vazhdonin punën në terren për të furnizuar komisionin me fakte të reja të freskëta. Në procesin e gjatë të hartimit të raportit u diskutua ndër të tjera dhe për çështjen e minoriteteve. Duhet sqaruar me këtë

¹²⁰⁶ FRUS, 1946, Vol. VII, f. 222, Kryetar i Misionit të SHBA-së në Shqipëri, Xhejkobs për Sekretarin e Shtetit, 21 shtator 1946.

¹²⁰⁷ *Po aty*, f. 228, shënim i redaksisë.

¹²⁰⁸ *Po aty*, f. 229, Kryetar i misionit të SHBA-së në Shqipëri, Jacobs për Sekretarin e Shtetit, 5 tetor 1946.

¹²⁰⁹ Gjatë verës 1946 udhëheqja jugosllave organizoi një fushatë të zjarrit rreth keqtrajtimin të minoritetit sllav në Greqi. Për më tepër në lidhje me akuzat jugosllave për keqtrajtim të minoritetit maqedonas në Greqi shih: *Greek terror in Aegean Macedonia* Në kontekstin e sloganit të njohur të Kominternit “Maqedonia për maqedonasit”, Titoja kishte arritur në mesin e vitit 1946 të siguronte premtimin e Gjergj Dimitrovit për autonomi kulturore për minoritetin maqedonas të rajonit të Pirinit në Bullgari. Në gusht 1946, ai arriti të merrte miratimin e udhëheqjes bullgare për bashkimin e Maqedonisë, si pjesë përbërëse e Federatës jugosllave. Pas kësaj në shtypin jugosllav filloi një fushatë e egër me pretendime edhe për Maqedoninë Perëndimore apo të Egjeut. Ajo në disa raste kishte kërkuar bashkimin e Maqedonisë së Egjeut me Republikën Federative Socialiste të Maqedonisë. Në këtë kontekst, duket se Titoja kishte një arsye më shumë për t'u dhënë ndihmë gueriljeve greke, si një mënyrë për të ruajtur influencën jugosllave te popullsia sllavofolëse e Maqedonisë Perëndimore në Greqi. Për më tepër mbi këndvështrimin grek për ndërhyrjen jugosllave në rajonin ku banonte minoriteti sllavofolës në Greqi shih: *Resurgent irredentist* ...

¹²¹⁰ Th. D. Sfikas, *The British Labour Government and the Greek Civil War* ..., f. 123; Beqir Meta, *Tensioni greko-shqiptar 1939-1949*, Tiranë: “GEER”, 2000, f. 555.

¹²¹¹ FRUS, 1947, vol. V, 818, Përfaqësuesi amerikan në Komisionin Hetimor, Mark Etrixhe për sekretarin e Shtetit, 8 shkurt 1947.

rast se qendra e diskutimit ishte trajtimi i minoriteteve nga shteti grek. Mendimi i përgjithshëm i komisionit ishte se Greqia i ka keqtrajtuar minoritetet e saj¹²¹², si ato sllavofolëse, ashtu dhe shqiptare (çame). Në lidhje me minoritetin shqiptar komisioni paraqiti në konkluzione vetëm mendimin e qeverisë greke, sipas së cilës faktet që kishin sjellë për keqtrajtim të minoritetit shqiptar ishin para se administrata greke të kontrollonte zonën dhe se shumë anëtarë të këtij minoriteti kishin bashkëpunuar me pushtuesit¹²¹³. Për shtetet e Bllokut Perëndimor, të cilët kërkonin me çdo kusht të favorizonin Greqinë, një zgjidhje e mundshme ishte shkëmbimi i minoriteteve sllavofolëse, por dhe të tjera nën përgjegjësinë e Këshillit të Sigurimit¹²¹⁴. Ideja e shkëmbimit të popullsisë po gjente gjithnjë e më shumë mbështetës në shtypin liberal grek.

Në disa artikuj të shtypit grek gjatë marsit të vitit 1947 minoritetet konsideroheshin si shkak i tensionit mes katër shteteve ballkanike. "Të propozojmë zgjidhje definitive të problemeve të minoriteteve, i cili helmon marrëdhëniet midis katër shteteve ballkanike. Të gjithë ata që nuk dëshirojnë të rrojnë në Greqi, ata që e ndiejnë veten si minoritarë të shtypur, të deklarojnë se nga të tri vendet fqinje cilën preferojnë të jetojnë ata më mirë dhe të emigrojnë atje lirisht dhe me qetësi dhe me përkrahjen e UNO-s. E njëjta gjë të bëhet dhe për helenizmin [kupto: grekët], që ka shpëtuar në regjimet autoritare fqinje"¹²¹⁵. Ndërkohë, zyrtarisht, asnjë nga shtetet ballkanike nuk ishte treguar entuziaste për një ide të tillë.

Raporti i Komisionit Hetimor u nënshkrua më 23 maj 1947 dhe iu paraqit Këshillit të Sigurimit të OKB-së katër ditë më vonë. Delegati i BS-së dhe ai i Polonisë nuk pranuan konkluzionet e komisionit, ndërsa ai i Francës absteno. Komisioni Hetimor arriti në përfundimin se problemet e minoriteteve në vetvete nuk krijojnë tension në marrëdhëniet mes katër shteteve, pasi ky ishte një fenomen i vjetër në Ballkan. Sipas raportit të Komisionit Hetimor, tensioni në marrëdhëniet mes katër shteteve shkaktohej nga: ndihma që në një masë të madhe Jugosllavia dhe, më pak Shqipëria dhe Bullgaria, u jepnin guerilëve grekë¹²¹⁶; lëvizja jugosllave dhe bullgare për të shkëputur Maqedoninë dhe Thrakën Perëndimore nga Greqia si dhe nga pretendimet territoriale të Athinës. Konkluzionet dhe puna në përgjithësi e Komisionit Hetimor të OKB-së, ashtu siç pritej, nuk arritën të ulin tensionin mes Greqisë nga njëra anë dhe fqinjëve të saj veriorë nga ana tjetër. Viti 1947 shënoi zyrtarisht fillimin e Luftës së Ftohtë dhe Greqia u përfshi e para në luftën për sfera influence midis dy superfuqive. Siç e tregoi dhe raporti apo puna e Komisionit Hetimor, në këtë arenë të madhe lufte, minoritetet ishin për politikën e madhe ndërkombëtare pika uji në oqean.

Si përfundim, krijimi i Komisionit Hetimor i OKB-së ishte shprehje e përplasjeve të Blloqeve rivale në Luftën e Ftohtë, secila në përpjekje për të mbështetur satelitët e tyre. Ky Komision kishte për detyrë të hetonte situatën ndërkufitare mes Greqisë dhe Shqipërisë, por, ashtu siç dhe e kishin parashikuar disa nga anëtarët e Këshillit të

¹²¹² B. Meta, Tensioni greko-shqiptar..., f. 541.

¹²¹³ FRUS, V. 1947, Vol. V, p. 858.

¹²¹⁴ Po aty, f. 823-824, Sekretari i Shtetit, Marshall për përfaqësuesin amerikan në Komisionin Hetimor, Mark Etridge, 28 shkurt 1947.

¹²¹⁵ AMPJ, V. 1947, D. 156/5, fl. 35, Artikulli i gazetës "Elefteria" të Athinës me nr. 728-729 me titull "Pozita", 21 shkurt 1947.

¹²¹⁶ FRUS, V. 1947, Vol. V, p. 850, Konkluzionet e Komisionit Hetimor, të paraqitura nga Mark Etridge për sekretarin e Shtetit, 12 maj 1947.

Sigurimit të OKB, as pritej dhe as arriti të krijojë një klimë të përshtatshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes dy vendeve. Madje ai nuk arriti të artikulonte edhe rekomandime të zbatueshme për zgjidhjen e çështjes së minoriteteve në përgjithësi dhe as atij shqiptar në Greqi, në veçanti.

SHPALLJA E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË SIPAS SHTYPIT SHQIPTAR TË KOHËS

Shpend AVDIU
Instituti Albanologjik-Prishtinë

Përmbajtje e shkurtër:

Gazetat shqiptare kanë trajtuar të gjitha rrethanat në të cilat është shpallur Pavarësia e shtetit shqiptar. Në këtë punim jam fokusuar në një pjesë të ngjarjeve kryesore që e karakterizuan vitin dramatik për kombin dhe shtetin shqiptar përgjatë vitit 1912, ngjarje këto që kanë zënë vend në shtypin shqiptar që botohej kryesisht në diasporë para Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Përveç shtypit shqiptar, në këtë punim është marrë për bazë edhe shtypi i vendeve të tjera si dhe studime të ndryshme lidhur me temën bosht.

Fjalët kyç: 28 Nëntori 1912, Gazeta "Atdheu", Ismail Qemali, Aleanca Ballkanike.

Fig.1.Gazeta "Koha" e cila botohej në Korçë, e datës 19 gusht 1912,e cila raportonte për marrëveshjen shqiptaro-osmane.



Raportimi i shtypit për Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë

Vjeshta e vitit 1912 shqiptarët i gjeti mëse të raskapitur nga lufta katër vjeçare me Perandorinë Osmane,

nën pesionin a vazhdueshem të shteteve ballkanike të përkratur fuqimisht nga Rusia, por edhe nga fuqitë e tjera evropiane, me armiqësi të thella me xhon-turqit, pa miq në skenën ndërkombëtare dhe me ndasi të konsiderueshme në mes vete. Pas marrëveshjes shqiptaro-osmane, shtetet fqinje nën ndikimin e Rusisë, u ngutën të fillonin Luftën e

Parë Ballkanike në mënyrë që të pengoheshin zhvillimet drejt pavarësisë së shtetit shqiptar. Me këtë marrëveshje ndërmjet shqiptarëve dhe Perandorisë Osmane, shqiptarët fitonin autonominë dhe një varg të drejtash si p.sh: shqiptarët do ta kryenin shërbimin ushtarak në Shqipëri, shqiptarëve u lejohej të mbanin armë dhe pika më rëndësishme ishte pika e shtatë ku shqiptarëve u lejohej të hapnin shkolla ku të duan dhe të financoheshin nga shqiptarët.¹²¹⁷



Fig.2. Gezeta “Atdheu” që botohej në Kostancë të Rumanisë,raportonte mbi shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë.

Me Luftën e Parë Ballkanike shtetet fqinje nuk kishin synim largimin e osmanëve nga Ballkani, por ndarjen e tokave shqiptare dhe daljen e Serbisë në Detin Adriatik, në portin e Durrësit dhe Shën Gjinit, marrjen e Shkodres nga malazezët dhe vendosjen e kufirit grek në Shkumbin. Prandaj, kur shikohet ky kompleks i situatës në të cilën u gjenden shqiptarët në atë kohë, në atë vorbull tragjike të atyre elementeve që u theksuan më sipër dhe të situatave të tjera, është për t’u habitur se si arritën të shpëtojnë si komb dhe të formojnë një shtet, sado që ishte i rrudhur dhe i cunguar.

Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912, kishte ndodhur pas një mori zhvillimesh politike dhe ushtarake në Ballkan. Gjatë vitit 1912, shqiptarët, po shkonin në atë drejtim që në një të afërme jo të largët ta formonin shtetin e tyre të pavarur. Pas këtyre zhvillimeve, Aleanca Ballkanike i kishte shpallur luftë Perandorisë Osmane dhe shqiptarët nuk kishin alternativë tjetër, pos ta shpallnin pavarësinë një orë e më parë.¹²¹⁸ Për shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, shtypi shqiptar ka pak të dhëna lidhur më rrethanat në të cilën u shpall pavarësia. Shtypi i diasporës shqiptare që dilte në Rumani,

¹²¹⁷“Koha”, Korçë, 19 gusht 1912

¹²¹⁸ Grup autorësh, *Historia e Popullit Shqiptar, II*, ASHSH, Prishtinë, 1969, f. 348-349; shih edhe Lef Nosi, “Dokumente Historike – 1912- 1918”, Tiranë, 2007, f. 99.

SHBA dhe në Bullgari raportoi për Ditën e Shpalljes së Pavarësisë. Gazeta "Atdheu" që dilte në Rumani e përshkruan kështu këtë ngjarje: " Më 14 të vjeshtës së tretë në orën 4 u proklamua Liri e Shqipërisë, prej popullit shqiptar dhe prej delegatëve që kishin ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë si dhe nga kolonitë shqiptare që vepronin në diasporë. Në mes të një entuziazmi të pakufi, u zbrit flamuri i Turqisë edhe u ngrit flamuri i Shqipërisë. Një qeveri provizore u formua edhe prej shqiptarëve, duke zgjedhur si kryetar të Qeverisë të shkëlqyerin z. Ismail Kemail Beun, i cili e rrëfeu veten se është një shqiptar i ndershëm.¹²¹⁹

Një meritë e shtypit shqiptar të kësaj kohe është se në faqet e veta transmetonte shtypin e huaj për ngjarjet në Shqipëri.

Nga shtypi i huaj për Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë e para kishte raportuar gazeta "Daily Telegraph", që dilte në Londër, pastaj gazetat italiane dhe ato të vendeve të tjera të Evropës.¹²²⁰ Agjencia italiane e lajmeve "Stefani" e datës 16, vjeshtë e III-të, raportonte nga Vlora që më 28 nëntor shqiptarët u mblodhën në Vlorë dhe shpallën pavarësinë. Kjo gazetë shkruante se në Kuvendin e Vlorës morën pjesë delegatë nga të gjitha pjesët e Shqipërisë, dhe përfaqësues nga të tri fetet që i kanë shqiptarët.¹²²¹ Ndërsa gazeta tjetër italiane "Korriere d'Italia" raportonte prej Vlore se shqiptarët shpallën pavarësinë e tyre dhe Shqipëria do të jetë nën protektoratin e Austrisë dhe të Italisë.¹²²² Për shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë shkruante dhe gazeta londineze "Daily Telegraph" e cila raportonte nga Durrësi se në të gjitha qytetet e mëdha të Shqipërisë u deklarua Pavarësia e Shqipërisë.¹²²³

Ndërsa gazeta boshnjake "Sarajevski list" raportonte për telegramin që Ismail Qemali i kishte dërguar kontit Bechold dhe shkruante kështu: "Asamble popullore, që sot u mblodh në Vlorë e që përbëhet nga përfaqësuesit e të gjitha krahinave shqiptare, pa dallim feje, në këtë çast shpalli pavarësinë politike të Shqipërisë dhe emëroi qeverinë e përkohshme me porosi që t'i mbrojë të drejtat dhe ekzistencën e popullit shqiptar të cilat armata serbe po i kërcënon me shfarosje dhe ta çlirojnë atdheun të cilin e kanë vërshuar ushtritë ballkanike.¹²²⁴

Qeveria e Ismail Qemalit i kishte dërguar telegram edhe qeverise turke, në të cilën thuhej se shqiptarët deri në fund ishin shtetas lojal të Perandorisë Osmane dhe tani kur ushtritë ballkanike kanë vërshuar vendin, janë të detyruar të veprojnë pavarësisht për ta mbrojtur vendin, dhe i sqaronte qeverisë turke se shqiptarët me këtë nuk dëshirojnë t'i sjellin dëme Turqisë, dhe se i vetmi qëllim ishte ta mbrojë vendin e vet. Ai kërkonte nga qeveria turke që ta ndihmojë në këtë rrugë.¹²²⁵

Gazeta turke "Ikdam" botoi një deklaratë të shqiptarëve të cilët deklarorin: "Kombi shqiptar do t'i mbrojë të drejtat e veta nga Preveza në Shkodër dhe nga Prizreni gjer në Manastir". Gazeta shkruante se shqiptarët janë të gatshëm të marrin pjesë në Konferencën e Londrës e cila do të mbahet për çështjen e Ballkanit.¹²²⁶

¹²¹⁹ "Atdheu", Kostancë, 22 Vjeshtë e III-ë 1912. Gazeta "Atdheu" e datës 5 dhjetor 1912 (22 Vjeshtë e III-ë 1912) Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë e raportonte më 27 nëntor 1912.

¹²²⁰ H. Sillajxhiq, Shpallja e Pavarësisë në shtypin e Bosnë-Hercegovinës, *Gjurmime Albanologjike*, VII/1977, f. 224.

¹²²¹ Po aty; shih edhe "Liri e Shqipërisë", Sofje, 20 Vjeshtë e III-ë 1912.

¹²²² "Atdheu", Kostancë, 22 Vjeshtë e III-ë 1912.

¹²²³ Po aty; shih edhe "Liri e Shqipërisë", Sofje, 20 Vjeshtë e III-ë 1912.

¹²²⁴ H. Sillajxhiq, *Shpallja e Pavarësisë në shtypin e Bosne*. vep. e përm., f. 224.

¹²²⁵ Po aty.

¹²²⁶ "Atdheu", Kostancë, 22 Vjeshtë e III-ë 1912.

Ismail Qemali, në “Kujtimet” e tij në këtë mënyrë e përshkruan Ditën e Pavarësisë: “Qyteti im i lindjes ishte i ndezur i tëri nga flaka e patriotizmit dhe kudo populli na përshëndeste me gaz dhe hare. Brenda pak kohe u gjenda në mes të tetëdhjetë e tre delegatëve, mysliman, e të krishterë, të ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë, nga ato të pushtuarat ose jo prej ushtrive ndërluftuese. Kuvendi u hap menjëherë. Në sesionin e tij të parë- 15-28 nëntor 1912 ai votoi njëzëri për shpalljen e pavarësisë.”¹²²⁷

Ndërsa, Eqrem bej Vlora në kujtimet e tij e përshkruan kështu ditën e shpalljes së pavarësisë :” Në mbrëmjen e 27 nëntorit 1912, kur Ismail Qemal bej Vlora , me karvanin e tij të konakëve, mbërriti në Vlorë dhe u vendos në selamllëkun e konakut të Vlorajve, ku dhe kishte lindur 68 vjet më parë , u bë një mbledhje , në të cilën u vendos që të nesërmen të shpallej Pavarësia e Shqipërisë. Mjerisht, që në këtë mbledhje të parë spikati mungesa e çdo rregulli siç kishim parashikuar edhe ia kishim pasur frikën ne, im atë dhe unë... dhe kështu , në mbledhjen parapërgatitore, të mbajtur më 28 nëntor, u tubuan me nxitim 40 burra nga krahina të ndryshme të Shqipërisë. Në ditët që pasuan erdhën edhe delegatë të tjerë nga jugu dhe lindja e Shqipërisë”.¹²²⁸

Në ditën e dytë Kuvendi i Vlorës u dërgoi Fuqive të Mëdha dhe fqinjëve ballkanik letra që ta njohin Shqipërinë shtet të pavarur.¹²²⁹

Më 2 dhjetor, Konsulli i Austrisë dhe ai i Italisë e siguruan Ismail Qemalin që shtetet e tyre edhe në përputhje me interesat e tyre “kanë për ta njohur Pavarësinë e Shqipërisë dhe për këtë qëllim kanë për të dhënë ndihmën e tyre”.¹²³⁰

Në dhjetor të viti 1912, Vlora ishte bllokuar nga flota greke, por Austria edhe Italia ishin të gatshme të intervenonin kundër bllokadës greke.¹²³¹ Konferenca e Ambasadorëve në Londër e cila u zhvillua kah fundi i dhjetorit e parandaloi një sulm të mundshëm të Austro-Hungarisë në Ballkan. Në këtë periudhë politika shqiptare ishte shumë aktive, duke u munduar që Fuqive të Mëdha të kohës t’u shpjegonin qëllimet e veta dhe në të njëjtën kohë të ngjallnin simpatinë në opinionin evropian.¹²³²

Gazeta “Atdheu” për pushtimin e tokave shqiptare në kohën kur po Shpallej Pavarësia e Shqipërisë shkruante: “Mos u dëshpëroni, që serbët pushtuan Kosovën, Durrësin dhe Elbasanin. Është e ditur se në Shqipëri nuk ka as komb serb e as komb bullgar përveç kombit shqiptar”. Shtypi raportonte se shpresa e shqiptarëve ishte te Evropa dhe veçanërisht të Austro-Hungaria pasi që Shqipëria ishte pushtura nga Aleanca Ballkanike. Po e njëjta gazetë shkruante:” Italia, Gjermania dhe Turqia në emër të civilizimit dhe të historisë edhe në emër të kombësisë e në emër të proklamatës të luftës të shteteve të Ballkanit “Ballkani për Ballkanasit” sot ata lypët ta njohin Shqipërinë.”¹²³³ Shpallja e pavarësisë e vitit 1912 ishte një akt thelbësor për popullin shqiptar me një rëndësi të madhe për ekzistencën e shtetit dhe Kombit Shqiptar.¹²³⁴ U bë një shtet shqiptar që sado i brishtë dhe në shumicën e kohës jo funksional, arriti ta ruajë qenien

¹²²⁷ I.Qemali, *Kujtime*, Tiranë,2009, f. 417.

¹²²⁸ E. Vlora, *Kujtime*, Tiranë, 2010, f. 307.

¹²²⁹ “Atdheu”, Kostancë, 22 Vjeshtë’ e III-ë 1912.

¹²³⁰ Po aty.

¹²³¹ “Atdheu”, Kostancë, 22 Vjeshtë’ e III-ë 1912.

¹²³² H. Sillajxhiq, *Shpallja e Pavarësisë në shtypin e Bosne..vep. e përm.*, f. 225.

¹²³³ “Atdheu”, Kostancë, 22 Vjeshtë’ e III-ë 1912.

¹²³⁴ N. Ciachir, Roli i Brëiles në Rilindjen Kombëtare Shqiptre(1829-1912), *Vjetari*, Prishtinë, 1979,f. 58.

kombëtare, jo vetëm brenda kufijve të shtetit të vet, por edhe në viset e okupuara, si: Kosovë, Maqedoni e pak a shumë edhe në Malin e Zi.

Eqrem bej Vlora , i cili ishte dhe vetë ishte protagonist i këtyre ngjarjeve kështu i përshkruan këto zhvillime” Mund mbase te më pyesni kush dështoi? Por un nuk mund të fajësoj në mënyrë të veçantë, e sa ta për ligj plotësisht ndokënd dhe thënë thjesht “të gjithë” pa përjashtim! Vetëm populli, populli i thjeshtë , e plotësoi detyrën e vet duke paguar taksa deri në groshin e fundit, duke mbajtur qetësin dhe rendin (gjë që nuk e kishte bërë deri atëherë) dhe, atje ku qe nevoja duke bërë edhe sakrifica. Shumë shpesh gjatë kësaj kohe kujtova me mall përvojën time të korrikut në Shkup.¹²³⁵

Recensentë:

Prof.dr. Lush Culaj - Instituti Albanologjik - Prishtinë
Dr. Nuridin Ahmeti - Instituti Albanologjik –Prishtinë

¹²³⁵ E. Vlora, *Kujtime...vep. e përm.*, f. 308.

SHPALLJA E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË 28 NËNTOR 1912

Zile Hasmeta

Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë

Gjendja e Shqipërisë gjatë fundit të vitit 1912 ishte shumë e vështirë pasi territoret shqiptare ishin kthyer në një arenë lufte ndërmjet fuqive ballkanike dhe perandorisë Osmane. Lufta ballkanike nxori në pah dobësinë e Perandorisë Osmane dhe fundi saj i bindi patriotët shqiptarët se kishte ardhur koha të mëvehtësohen e të formojnë shtetin e tyre. Patrioti shqiptar Ismail Qemali duke parë situatën e rëndë në të cilën ndodheshin trojet shqiptare dhe rrezikun që u kanoseshin atyre kryesisht nga fqinjët, kishte nisur bisedimet me fuqitë europiane dhe qeverinë turke për njohjen e kombësisë dhe të gjuhës Shqipe. Gjatë bisedimeve me qeverinë turke Ismail Qemali u përpoq të binde Stambollin se Shqiptarët janë shpëtimi i Turqisë, duke e argumentuar këtë me tensionin që ishte krijuar midis Perandorisë Osmane dhe vendeve Ballkanike, por që Shqiptarët të mbështesin Perandorinë Osmane duhet që ajo të njohë autonominë e Shqipërisë dhe të drejtat tyre kombëtare, Kërkesë të cilën perandoria Osmane nuk e mori parasysh.¹²³⁶

Para se të kthehej në Shqipëri për të kryer aktin e shpalljes së pavarësisë Ismail Qemali ndërmori një udhëtim nëpër kancelaritë europiane për të kërkuar mbështetje dhe për ti njohur ata me çështjen Shqiptare. Mbështetja e parë Ismail Qemalit i erdhi nga Austro-Hungaria e cila nuk ishte e interesuar për fuqizimin e Serbisë dhe për daljen e saj në det sepse kjo binte ndesh me interesat e saj. Mbështetje çështjes Shqiptare i dha edhe Italia e cila synonte të finalizonte planet e saj për përfshirjen e Shqipërisë nën ndikimin e saj me qëllim " mbylljen e detit adriatik për ta shndërruar atë në "një liqen të brënshtëm Italian"¹²³⁷.

Në të njëjtën kohë, patriotët shqiptarë brënda vëndit po bënin të pamundurën për të ngritur çështjen shqiptare tek fuqitë e mëdha, në tetor 1912 i dorëzuan përfaqësuesve diplomatike të fuqive të mëdha në Stamboll një "thirrje të popullit Shqiptar"¹²³⁸ në të cilën shprehej protesta e tyre kundër planeve të fqinjëve që flisnin qartë për copëtimin e Shqipërisë. Një ditë para nisjes për në shqipëri Ismail Qemali deklaroi se "menjëherë pas mbërritjes së tij në Shqipëri do të shpallej pavarësia dhe do të zgjidhej qeveria e përkoshme"¹²³⁹.

¹²³⁶Dh. Kotimi-Xh.Struga-F.Veizi-m.SHuteriqi-K.Dedi, *Qeveria e përkoshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj*, (Tiranë,"MIHAL DURI"), 1979, 5-6

¹²³⁷ Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit të XX*, (Tiranë,"Ideart" 2004), 56

¹²³⁸ Po aty 57

¹²³⁹ Po aty 58

Për sa i përket mendimeve se ku do të mbledhesh kuvendi kombëtar fillimisht u mendua që të mbledhesh në Durrës por bregdeti ishte i bllokuar nga flota Greke dhe zbarkimi i karvanit do të duhej të bëhej me barka të vogla. Lajmi rreth një urdhëri që kishte ardhur për arrestimin e Ismail Qemalit e detyroi karvanin e pavarësisë që të largohej nga Durrësi në drejtim të Vlorës. Sigurimi i përkrahjes nga disa fuqi europiane, përparimi aleatëve ballkanike si rezultat i të cilave Perandoria Osmane po dëbohej nga ballkani, si dhe shkëputja e cdo lidhje territoriale mes Shqipërisë dhe Stambollit bënë që Ismail Qemali me shokët e tij të arrinin në përfundimin se e vetmja zgjidhje e drejtë e çështjes shqiptare në kushtet e reja të krijuara nga luftatrat ballkanike ishte jo më kërkesa për autonomi territoriale-administrative por Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë. Pasi siguroi mbështetjen e jashtme, në mbrëmjen e 27 nëntorit Ismail Qemali arriti në Vlorë dhe në rrethana të detyruara akoma pa arritur të gjithë përfaqësuesit nga të gjithë krahinat shqiptare ai së bashku me patriotët e tjerë të mbledhur, në datën e shënuar të 28 nëntorit në orën 14 :00 çelin punimet e Kuvëndit të Vlorës.¹²⁴⁰

Në kuvendin Kombëtar të Vlorës morën pjesë 37 delegatë nga 63 që ishin të ftuar dhe kjo për arsye të pengesave si të infrastrukturës ashtu edhe gjendjes në të cilën ndodhej shqipëria, pasi ajo ishte pushtuar në zona të ndryshme nga ushtritë fqinje. Pasi u bë hapja e kuvendit kombëtar Z. Ismail Qemali mori fjalën e u tregoi delegatëve se qëllimi i thirrjes së kuvëndit ishte të përipiqen së bashku e të marrin masat e nevojshme për të shpëtuar Shqipërinë nga rreziku i madh ku ndodhet sot.¹²⁴¹

Në fjalimin e tij Ismail Qemali ndër të tjera tha: " Shqiptarët ndonëse besnikë kurdoherë të mbreteria Osmane nuk e kanë harruar kurrë as gjuhën as kombësinë e tyre e prova më mirë janë perpjekjet dhe kryengritjet e tyre që bënë herë për herë e sidomos në këto katër vjetet e mbrapme për ti ruajtur te drejtat dhe zakonet e veta.. Qeveria Otomane nuk e vështroi kurrë interesin e saj dhe nuk e deshi kurrë t'ua shpërblejë me të mirë shqiptarëve shërbimet e mëdha që i bënë. Në këto kohët e fundit rrefeu ndopak dëshirën që të merrej vesh me kombin tonë, por prapë nuk vuri të gjithë vullnetin e mirë e nuk mori të gjitha masat e nevojshme për të paqësuar dhe për të kënaqur shqiptarët. Në këtë kohë dhe sipër krisi lufta me katër mbretëritë e ballkanit, të cilat kërkonin përmirësime e të drejtave për vëllezërit e tyre të një kombi dhe të një bese. Më vonë e harruan qëllimin e parë, e meqë lufta u vajti mbarë u muarnë vesh për copëtimin e ndarjen e mbretërisë e pra edhe të shqipërisë. Shqiptarët të cilët kishin marrë pjesë në luftë me shumë si ushtarë, si të zotët e vendit për të shpëtuar vehten e tyre, kur e panë se ushtria e Turqisë u mund e se mbreteria nuk mund të qëndronte më vrapuan të merrnin masat që koha kërkonte.¹²⁴² Me këtë qëllim Z. e tij Ismail Qemali Beu u nis nga Stambolli e pasi që u mor vesh edhe me shqiptarët e Bukureshtit, u nis e vajti për në Vjenë, ku nisi marrëveshjet e tija me ato. Mbretëri të mëdha që kanë interesa më të gjalla në punët e ballkanit, pasi që nuk mbetej më as ndonjë shpresë për të shpëtuar Shqipërinë me armë, e vetmja udhë shpëtimi ishte ndarja e shqipërisë nga Turqia. Këtë mendim e këtë qëllim e vuri përpara Z. Ismail Qemal Beu mendim e qëllim që u pranua me simpati nga dy qeveritë e mëdha nga Austria e nga Italia.....¹²⁴³

¹²⁴⁰ Valentina Duka, Historia e Shqipërisë 1912-2000, Tiranë

¹²⁴¹ Dh. Kotimi-Xh. Struga-F. Veizi-m. SHuteriqi-K. Dedi, *Qeveria e përkoshme....*, 72

¹²⁴² Po aty, 8

¹²⁴³ Po aty, 12

Të gjithë delegatët me një zë i pëlqyen fjalët e Z.Ismail Qemalit dhe vendosën që:

"Shqipëria të bëhet që sot mëvehte, e lirë, e pamvarur, nën një qeveri të përkoshme".¹²⁴⁴ Kuvëndi kombëtar i Vlorës shpalli pavarësinë e Shqipërisë. Me anë të këtij akti formalisht të rëndësishëm elita politike shqiptare synonte të realizonte një gjendje faktike për të mos lejuar që depërtimi i ushtrive të vëndeve ballkanike aleate me preteksin e luftës kundër osmanëve të pushtonin territore të reja në tokat Shqiptare. Po atë ditë Ismail Qemali nga ballkoni i shtëpisë së Vlorajve ngriti flamurin Shqiptar që ishte një shqiponjë me dy krerë me sfond të kuq. Më 29 nëntor kuvendi kombëtar i Vlorës caktoi Ismail Qemalin kryeministrin e parë dhe i dha atributin e formimit të qeverisë së përkoshme. Në projektin që Ismail Qemali i paraqiti kuvendit të Vlorës për përbërjen e qeverisë së tij ai kishte pasur parasysh faktin së qeveria e tij, si qeveri e parë shqiptare të përbëhej nga njerëz me reputacion në vend, që kishin mbështetjen e Fuqivë të Mëdha europiane, por edhe të Stambollit, lidhjet pesëshkullore me të cilin ishin ende të pashkëputura.¹²⁴⁵ Më 4 dhjetor 1912 u miratua nga kuvëndi i Vlorës përbërja e qeverisë së parë shqiptare.

Shpallja e pavarësisë ishte një akt me rëndësi jetikë për popullin shqiptar ajo nga njëra anë mbylli një epokë të tërë luftrash e përpjekjesh shekullore për të hequr qafe zgjedhën e huaj dhe për të ruajtur tërësinë territoriale të atdheut dhe për të formuar shtetin e lirë kombëtar shqiptar duke kurorëzuar veprën e rilindjes dhe nga ana tjetër hapi një epokë të re luftrash e përpjekjesh shekullore për të mbrojtur pavarësinë e fituar nga rreziqet e jashtme dhe të brendshme, për të siguruar bashkimin kombëtar të gjymtuar rëndë dhe për të vendosur rendin demokratik¹²⁴⁶. Qeveria e emëruar nga kuvendi i Vlorës qëndroi në detyrë deri më 22 janar 1913. Pasi u miratimit të saj kuvendi zgjodhi edhe pleqësinë, një institucion i përbërë nga 18 veta me në krye Vehbi Dibrën i cili do të luan të rolin e legjislativit si dhe do të shërbente si organ këshillimor i qeverisë.

Pas shpalljes së pavarësisë, krijimit të qeverisë, detyra e parë e Ismail Qemalit ishte njoftimi i Fuqive të Mëdha dhe i Portës së Lartë për themelimin e shtetit të ri dhe u paraqiti kërkesën për njohjen e këtij shteti, ai u kërkoi atyre " që ta njihnin këtë ndryshim në jetën politike të kombit shqiptar"¹²⁴⁷

Akti i shpalljes së pavarësisë do të pasohej nga thirrja e konferencës së ambasadorëve në Londër më 17 dhjetor 1912. Ajo u thirr më marrëveshje midis 6 fuqive të mëdha. Kjo ishte një konferencë diplomatike e nivelit të lartë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve në nivel ambasadorësh dhe i kryesuar për më tepër nga një ministër i jashtëm, ai i Britanisë së Madhe Eduart Grey. Çështja më e rëndësishme që u diskutua ishte çështja e pavarësisë së Shqipërisë e cila u bë "molla e sherrit" e fuqive imperialiste dhe e klientelës së tyre ballkanike. Konferenca e ambasadorëve ishte një formë e ndeshjes së interesave kontradiktore të cilat sheshoheshin sipas raportit të forcave dhe ndërmjet lëshimeve reciproke¹²⁴⁸ Në trajtimin e çështjes Shqiptare u dallua pozicionimi i fuqive veç e veç secila në interes të saj. Çështja shqiptare u trajtua në tri pjesë:

¹²⁴⁴ Po aty, 15

¹²⁴⁵ Valentina, Duka, *Historia...*, 23

¹²⁴⁶ Po aty, 24

¹²⁴⁷ Dh. Kotimi-Xh.Struga-F.Veizi-m.SHuteriqi-K.Dedi, *Qeveria e përkoshme...*, fq 8

¹²⁴⁸ Arben Puto, *Çështja Shqiptare në aktet ndërkombetare të periudhës së imperializmit, (Përmbledhje dokumentash vëll II)*, (Tiranë, "8 NËNTORI"), 12

- 1-Statusi i Shqipërisë
- 2-Çështja e kufinjve
- 3-Organizimi i shtetit Shqiptar

1-Statusi i Shqipërisë

Problemi i statusit të Shqipërisë është çështja e parë që u trajtua në konferencë dhe e vetmja çështje për të cilën është mbërritur që aty një marrëveshje. Gjashtë fuqitë e mëdha vendosën të njhnin "parimin e autonomisë Shqiptare"¹²⁴⁹ kështu pranohej më në fund vërtet ideja e krijimit të një shteti shqiptar por ky shtet do të vendosej në një formë të varësisë juridike ndërkombëtare dhe konkretisht do të varej nga Turqia në marrëdhëniet e politikës së jashtme. Por kjo formulë është ekuivoke përdorisë autonoma konceptohej në një trajtë alternative: "nën sovranitetin ose suzeranitetin e sulltanit"¹²⁵⁰ por me përmbajtjen e autonomisë shqiptare që në fillim u vunë re dy pikëpamje të ndryshme:

1-Rusia cariste pavarësisht se pranonte në parim autonominë e Shqipërisë ngulte këmbë për krijimin jo të një shteti shqiptar por të një "province autonome" nën autoritetin e Portës së Lartë prania e së cilës do të shprehej jo vetëm me një guvernator të caktuar nga sulltani por edhe me mbajtjen aty të forcave ushtarake turke. Prapa kësaj skeme fshihej qëllimi i vjetër i Rusisë e cila mendonte se me rënien e Turqisë, kjo krahinë autonome të copëtohej ndërmjet vendeve fqinje¹²⁵¹

2-Austro-Hungaria dhe Italia shpreheshin për një shtet autonom nën sovranitetin e sulltanit dhe nën garancinë ekskluzive të gjashtë Fuqive të Mëdha.

Qeveria e Vlorës me atributet e një qeverie shqiptare pavarësisht se zëri i saj nuk u lejua të dëgjohej dërgoi në Londër një delegacion të përfaqësuar nga : Mehmet Konica, Filip Noga, Rasim Dino të cilët ishin aktivë të shquar të lëvizjes kombëtare shqiptare në emigracion. Arsyeja e perzgjedhjes së tyre lidhet me faktin se ata ishin me banim jashtë dhe kishin mundësi për të shkuar në Londër të papenguar nga bllokada navale greke e bregdetit Shqiptar.¹²⁵² Në janar të vitit 1913 delegacioni i qeverisë së Vlorës i paraqiti konferencës së Ambasadorëve një memorandum ku parashtronte kërkesat territoriale të banuar nga shqiptarët në ballkan si dhe rajone që ishin etnografikisht të diskutueshme, ndoshta për të pasur hapësira kompromisi në pazaret e konferencës. Gjithashtu për të ngritur zërin në mbrotje të çështjes Shqiptare në Londër, në emër të diasporës Shqiptare të Amerikës shkoi edhe Faik Konica si dhe Fan Noli, ky i fundit erdhi në emër të kishës autoqefale të themeluar në Amerikë. Këto të dy përpara se të shkonin në Londër u mblodhën në Trieste nga 1-8 mars 1913 ku hartuan një memorandum drejtuar konferencës së Ambasadorëve ku shpreheshin për krijimin e shtetit Shqiptar që do të përfshinte territoret e të katër vilajeteve të kohës së sundimit Osman dhe për qeverisjen e Shqipërisë prej një princi europian. Delegacioni i kryesuar nga kryeministri Ismail Qemali mbërriti 3 muaj me vonësë nga fundi i marsit 1913¹²⁵³. Në përgjithësi fuqitë e Mëdha nuk e njohën qeverinë e Vlorës si përfaqësuese të ligjshme të kombit shqiptar por edhe lidhur me këtë çështje pati qëndrime të ndryshme : Austro-Hungaria dhe Italia

¹²⁴⁹ Po aty, 19

¹²⁵⁰ Po aty

¹²⁵¹ Po aty, 20

¹²⁵² Valentina Duka, *Historia.....*, 27

¹²⁵³ Valentina Duka, *Historia.....* 28

mendonin se qeveria e Vlorës mund të shërbente si një bërthamë për organizimin e shtetit Shqiptar ndërsa Rusia, Franca dhe Anglia ishin në kundërshtim me këtë fakt.¹²⁵⁴ Pas shumë diskutimesh më 29 korrik 1913 konferenca e ambasadorëve vendosi për statusin e Shqipërisë i cili ishte: *"Shqipëria bëhet Principatë Autonome, Sovrane dhe të Trashiguar sipas rregullave të fëmijës së parë, nën garancinë e gjashtë fuqive të mëdha. Princi do të caktohet nga gjashë fuqitë."*¹²⁵⁵

3-Çështja e Kufinjëve

Një ndër problemet që u diskutua gjatë konferencës së ambasadorëve dhe që shkaktoi diskutime të mëdha në lidhje me Shqipërinë ishte çështja e kufinjëve. Vendet ballkanike si fituese të luftës ballkanike kërkonin që të përfitonin sa më shumë territore. Greqia kërkonte viset shqiptare në jug të Shqipërisë të banuara nga shqiptarët, Serbia kërkonte të aneksonte Kosovën dhe viset shqiptare që ndodheshin në Maqedoni, Mali i Zi kërkonte të merrte Shkodrën dhe të shtrihej deri në Mat.

Qeveria e Vlorës i paraqiti ndërmjet një harte që ia ekspozoi konferencës së ambasadorëve në përmbajtje të së cilës ishte njohja e pavarësisë së Shqipërisë me kufijntë e saj enike.¹²⁵⁶ Mosmarrëveshje të mëdha pati ndërmjet Austro-Hungarisë dhe Italisë mbrojtëse të çështjes shqiptare dhe Rusisë mbrojtëse e çështjes sllave. Konferenca e ambasadorëve ngarkoi këto dy shtete që të hartonin projektin mbi hartën e shqipërisë politike, u hartuan dy projekte, Austro-Hungarez dhe Rus.

1-Projekti i Austro –Hungarisë nuk bazohej plotësisht në parimin etnik. Sipas këtij projekti vija kufitare kalonte përgjatë lumit të Bunës duke ndjekur drejtimin e vjetër të kufirit Turqi-Mali i Zi, pastaj kalonte në trajtën e një gjysmërrethi në jug të Guxisë dhe Plavës duke përfshirë brënda kufinjëve shqiptare Pejën, Gjakovën dhe Prizrenin, në verilindje dhe lindje qyteti i Dibrës dhe Liqeni i Ohrit, futeshin brënda tokave shqiptare, në jug dhe juglindje Korca dhe Janina i mbeteshin shqipërisë duke ndjekur rrjedhën e lumit Kalamas në jug të Korfuzit.¹²⁵⁷ Projekti Austro-Hungarez kundërshtohej nga Rusia, Franca dhe aleatët ballkanik.

2 -Projekti Rus brënda shtetit shqiptar përfshinte vetëm Shqipërinë e mesme.

Pazarllëqet për kufijntë e shtetit shqiptar në Konferencën e Ambasadorëve ndahen në dy faza:

Faza 1- Diskutimi i caktimit të kufinjëve veriore, kjo fazë përfundoi më 22 mars 1913. Një nga pikat më të nxehta të kësaj faze ishte Shkodra e cila pas shumë debatesh iu la Shqipërisë por për këtë u sakrifkua Kosova dhe territoret e tjera shqiptare në lindje të Shqipërisë etnike duke përfshirë dhe Gjakovën.¹²⁵⁸

Faza 2- Diskutimi i caktimit të kufinjëve jugorë, më 19 mars 1913 ambasadori Italian dhe Austro-Hungarez i paraqitën Konferencës së Ambasadorëve projektin e përbashkët për kufijntë jugore të shqipërisë. Sipas këtij projekti Janina dhe një sipërfaqe e konsiderueshme jugore i kalonte Greqisë ndërsa Korça dhe Gjirokastra i mbeteshin Shqipërisë. Kjo nuk u pranua nga Greqia e cila kërkonte aneksimin e Gjirokastrës dhe Korçës. Këto dy rajone ishin edhe *"molla e sherrit"* ndërmjet fuqive europiane. Pas shumë

¹²⁵⁴ Po aty, 29

¹²⁵⁵ Po aty

¹²⁵⁶ Po aty, 32

¹²⁵⁷ Po aty, 33

¹²⁵⁸ Po aty, 35

diskutimesh më 11 gusht u përcaktuan kufijntë jugore të Shqipërisë; Austro-hungaria hoqi dorë nga Janina por kërkoi që Korça, Përmeti dhe Gjirokastra, si dhe territoret deri në rrjedhjen e lumit Kalamas ti mbeteshin Shqipërisë. Qeveria Greke nuk e pranoi këtë vendim, në këto rrethana Konferenca e Londrës bëri përsëri disa lëshime në favor të Greqisë duke vendosur që skaji jugor i Shqipërisë të ishte kepi i Stillos dhe jo lumi Kalamas, gjithashtu ajo vendosi që Korça ti mbetej Shqipërisë, ndërsa Gjirokastra të vazhdonte të mbetej me status të papërcaktuar.¹²⁵⁹

3-Organizimi i shtetit Shqiptar

Pas vendosjes së statusit të Shqipërisë, status që e shkëputi Shqipërinë nga Perandoria Osmane më 1912, hapi i dytë që ndërmoren Fuqitë e Mëdha kishte të bënte me organizimin e shtetit Shqiptar. Për organizimin e saj u morën si qeveria e Vlorës dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha. Çështja e organizimit të shtetit shqiptar u kthye në një problem të forumeve ndërkombëtare të nivelit të lartë. U përvijuan dy vija, dy parime në veprën e organizimit të shtetit të ri Shqiptar:

a-parimi kombëtar

b-Parimi ndërkombëtar

Këto dy vija vepruan paralelisht në të njëjtën kohë derisa u ndodhën ballë për ballë. Në aspektin e parimit kombëtar kuvendi i Vlorës shtroi jo vetëm në parim por edhe në praktikë organizimin e Shqipërisë si shtet më vetë. Kuvendi kombëtar nuk u kufizua vetëm me aktin e shpalljes së pavarësisë por do të pasohej nga vepra konkrete e hedhjes së themeleve të shtetit të ri.¹²⁶⁰ Kështu kuvendi formoi edhe qeverinë e parë kombëtare të kryesuar nga Ismail Qemali, në të njëjtën kohë vendimi i kuvendit përmban edhe një formulë të përgjithshme mbi ngritjen dhe funksionimin e administratës së re. Qeveria e re do të ishte një qeverie e përkoshme që do të vepronte nën kontrollin e një "pleqësie" dhe do të drejtonte vendin deri në përcaktimin përfundimtar të rendit kushtetues të shtetit të ri. Qeveria e Përkoshme iu përvesh punës jo vetëm për ngritjen e hallkave të rëndësishme të aparatit shtetëror por ishte për vendosjen e lidhjeve të pushtetit me krahinat e vendit pasi për sa pëket pikëpamjes së efektivitetit të pushtetit të saj Qeveria e Vlorës veprroi në një zonë tepër të ngushtë në trekëndëshin Vlorë-Berat-Lushnje. Pavarësisht vështirësive të mëdha Qeveria e Vlorës arriti disa rezultate të rëndësishme në ngritjen e një administrate shtetërore qoftë edhe në trajtën embrionale. U ngritën disa forca të rendit publik dhe u morën disa masa për krijimin dhe ngritjen e një ushtrie kombëtare.¹²⁶¹ U vunë gurët e parë për vendosjen e një sistemi gjygjësor sipas modeleve evropiane. U caktua gjuha shqipe si gjuhë zyrtare dhe u vendos hapja e shkollave shqipe prej shtatorit 1913. Në planet e saj të para ishte përpunimi i një kushtetute të plotë dhe definitive, arsyeja kryesore kishte të bënte me ndërhyrjen e fuqive të mëdha në organizimin e brendshëm të shtetit Shqiptar.

Në aspektin ndërkombëtar çështja e organizimit të brendshëm të Shqipërisë ishte në qëndër të vëmendjes të konferencës së ambasadorëve, bënte fjalë "edhe për një mbret nga familja mbretërore evropiane" dhe për shumë ndihma nga jashtë.¹²⁶² Fuqitë imperialiste u munduan t'ia ngushtonin sa më shumë sferën e veprimit elementit vendas në organizimin e brendshëm të Shqipërisë. Konferenca e Londrës e shqyrtoi çështjen

¹²⁵⁹ Po aty, 36

¹²⁶⁰ Arben Puto, Çështja Shqiptare..., 41

¹²⁶¹ Po aty, 42

¹²⁶² Po aty, 45

shqiptare në të gjitha elementët e saj. Që në mbledhjen e saj të parë më 17 dhjetor 1912 konferenca e përcaktoi pozitën e saj në një kuptim negativ kundrejt elementit vendas. Konferenca e Ambasadorëve Londrës i dha që në krye veprës së krijimit të shtetit shqiptar një karakter thellësisht ndërkombëtar.¹²⁶³

Ajo u lëshoi një "mandat" dy fuqive Austro-Hungarisë dhe Italisë duke njohur me këtë tërthorazi "interesat e tyre të posaçme" në Shqipëri-mandatin për të hartuar një projekt të parë të organizimit "të shtetit autonom Shqiptar". Ky projekt nuk bënte fjalë fare për elementin vendas as edhe për tërheqjen e tij në organizimin e shtetit të ri. Rezoluta e adoptuar me atë rast kufizohej më këto fjalë "*Qeveria Austro-Hungareze dhe ajo italiane ftohen që të shprehin pikëpamjet e tyre të përgjithshme mbi organizimin e ardhshëm të kësaj autonomie*".¹²⁶⁴ Projekti i përbashkët i dy fuqive evropiane iu paraqit konferencës më 8 maj, në pjesën kushtuar organizimit të brëshëm të shtetit shqiptar projekti parashikonte krijimin e dy organeve ndërkombëtare:

Komisioni I - do të kishte për detyrë të propozonte një regjim gjygjësor "të frymëzuar në parimet e adoptuara në përcaktimin e regjimit gjygjësor të vendosur në Egjipt" c'ka do të thoshte krijimin e gjykatave mikse me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të fuqive.

Komisioni II -Mendohej si një organ ndihmës i komisionit i krijuar prej tij për ti besuar organizimin dhe kontrollin e administratës civile dhe finaciare të shqipërisë "madje rregjimi i kontrollit do të vepronte për 10 vjet dhe " në rast nevojë edhe më gjatë", edhe qetësia dhe rendi publik do të siguroheshin nga një xhandarmëri e organizuar ndërkombëtarisht.¹²⁶⁵

Kuadrin e këtij regjimi në thelb ndërkombëtar e plotësonte princi i cili po ashtu do të emërohej nga Fuqitë e Mëdha me propozimin e Austro-Hungarisë dhe Italisë. Përballë këtij predominimi të qartë të parimit ndërkombëtar, prania e elementit vendas ishte krejt i zbehtë. Në projekt propozohej që shqiptarët t'u lihej mundësia që të shprethenin dëshirat e tyre, por edhe kjo për aq sa nuk do të vinte në kundërshtim me "fuqitë e mëdha". Në këto kushte pjesëmarrja e një përfaqësuesi të qeverisë Shqiptare përkrah përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha në komisionin dhe komitetin e përmendur reduktohej në një formalitet të thjeshtë. Nga gjithë kjo del qartë koncepti mbi organizimin e Shqipërisë, thelbi i tij është vendosja e një regjimi ndërkombëtar të plotë dhe pa afat për Shqipërinë. Organizimi i shtetit shqiptar i ndërrmarrë nga konferenca e ambasadorëve shënon shkallën më të lartë të "ndërkombëtarizimit" të punëve të brenshme të një shteti të vogël para luftës së parë botërore. Ajo që merrte përsipër Konferenca e Ambasadorëve ishte një operacion kompleks për ngritjen në plan konstitucional të një aparati të tërë shtetëror nga poshtë deri lart. Vendimi i 29 korrikut 1913 mbi organizimin e brenshëm të shqipërisë nxirrte në pah mbizotërimin e shteteve të Antantës ndërsa vepra e kryer deri atëherë nga qeveria e Vlorës nuk merrej parasysh.¹²⁶⁶

Kuvendi i Vlorës e shpalli pavarësinë në emër të të gjithë shqiptarëve, të të gjitha trevave shqiptare, që dërguan përfaqësuesit e tyre në të. Ai e trajtoi Shqipërinë një e të pandarë. Edhe qeveria shqiptare e Ismail Qemalit doli në rrafshin ndërkombëtar si

¹²⁶³ Po aty, 48

¹²⁶⁴ Po aty, 49

¹²⁶⁵ Po aty, 50

¹²⁶⁶ Po aty, 54

përfaqësuese e gjithë popullsisë shqiptare dhe e të gjitha tokave shqiptare, edhe pse një pjesë e madhe e tyre ishte e pushtuar nga ushtritë e shteteve ballkanike. Edhe deklaratat e notat e protestës, që kjo qeveri u dërgoi shteteve ballkanike e komandave të tyre ushtarake, në të cilat kërkoi largimin e menjëhershëm të forcave të huaja ushtarake nga trojet e pushtuara shqiptare dhe kthimin e tyre Shqipërisë, u bënë në emër të Asamblesë Kombëtare që përfaqësonte të gjitha trojet e banuara nga shqiptarët. Për ta siguruar një fitore të tillë popullit shqiptar iu desh të bënte një luftë të gjatë kundër sundimtarëve osmanë dhe synimeve grabiqare të fuqive të huaja.

Një varg rrethanash të brendshme e të jashtme kanë bërë që këto lëvizje të mos arrinin dot objektivin. Por në çdo etapë ato kanë vënë në provë forcat materiale e morale të popullit shqiptar, kanë pasuruar përvojën e traditat e tij luftarake dhe kanë krijuar premisat për zhvillimin e mëtejshëm të luftës. Në shek. XIX e në fillim të shek. XX kjo luftë u zhvillua mbi baza të reja shoqërore e politike dhe mori karakter të ndërgjegjshëm kombëtar. Në Gadishullin Ballkanik Shqipëria, sikurse Maqedonia, ishte vendi që u çlirua i fundit nga sundimi i sulltanëve osmanë, në një kohë kur popujt e tjerë fqinjë kishin, kush më shumë e kush më pak, dhjetëra vjet që bënin jetë shtetërore të pavarur. Kjo vonesë u shkaktua nga faktorë ekonomikë, shoqërorë e politikë, të brendshëm e të jashtëm, që vepruan ndërsjelltas mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare dhe përcaktuan ritmet e zhvillimit të saj.

Prapambetja ekonomike e shoqërore e vendit ishte padyshim një faktor që vonoi rritjen e forcave organizuese e drejtuese të lëvizjes kombëtare e si pasojë e vështirësoi dhe e vonoi Shpalljen e Pavarësisë. Megjithatë, edhe pse Shqipëria ishte një vend i vogël e mbi të rëndonte zgjedha e një perandorie të madhe, një faktor themelor që e vonoi për dhjetëra vjet pavarësinë shqiptare ishte ai i jashtëm. Populli shqiptar ka qenë gjatë gjithë lëvizjes për çlirimin kombëtar i vetëm, pa ndihmën e jashtme e pa aleatë. Për më tepër, shtetet ballkanike fqinje, të cilat të parat patën siguruar pavarësinë, luftuan me të gjitha mjetet, duke filluar nga presionet diplomatike e duke mbaruar edhe me ndërhyrje të armatosura, kundër Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, e cila për nga qëllimet e saj ishte në kundërshtim me planet e tyre të skllavërimit ekonomik e politik dhe të copëtimit të Shqipërisë.

Fuqitë e Mëdha, të cilat, gjatë gjithë shek XIX patën përkrahur popujt e krishterë të Ballkanit (Serbët, Grekët, Rumunët e Bullgarët) të formonin shtetet e tyre të pavarura, për një kohë të gjatë, mbajtën një qëndrim mospërfillës ndaj çështjes shqiptare. Në këto kushte, lufta për pavarësinë e Shqipërisë nuk mund të mbështetej veçse në forcat e popullit shqiptar dhe mund t'ia arrinte qëllimit vetëm kur të krijohet një konjunkturë e favorshme ndërkombëtare, kur kontradiktat ndërmjet Fuqive të Mëdha mund të shfrytëzoheshin me sukses për realizimin e saj. Pavarësia e Shqipërisë u shpall në kushte të tilla ndërkombëtare.¹²⁶⁷

Udhëheqësit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, në fazën e fundit të saj, ditën të shfrytëzonin me mjeshtëri koniunkturën politike që u krijua me shpërthimin e Luftës së Parë Ballkanike, kur në çështjen shqiptare u ndeshën me forcë interesat e kundërt të Fuqive të Mëdha. Është meritë e këtyre atdhetarëve largpamës dhe në mënyrë të veçantë, e atdhetarit dhe e diplomatit të shquar Ismail Qemali, që duke u mbështetur në luftën e popullit shqiptar brenda vendit, zgjodhën drejt çastin e përshtatshëm për të kaluar nga

¹²⁶⁷ Valentina Duka, *Historia.....* 47

platforma e deriatëhershme politike e lëvizjes për autonominë në atë të pavarësisë, dhe kjo u realizua pikërisht më 28 nëntor 1912, kur Osmanët po dëboheshin nga Ballkani, kur Fuqitë e Mëdha vendosën të hiqnin dorë nga ruajtja e status quo-së në Ballkan dhe kur planet e aleatëve ballkanikë për ta zhdukur Shqipërinë, të përkrahura edhe nga fuqitë e Antantës, u kundërshtuan nga fuqitë e Lidhjes Tripalëshe

SEMANTIZMI ELIPTIK (“LUM LUMI”, A. PODRIMJA)

Msc. Fitor Ollomani

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë

Departamenti i Gjuhësisë

Në trajtesën tonë do të vëzhgojmë, interpretojmë semantizmin në strukturat eliptike në ligjërimin poetik të A. Podrimjes në disa drejtime:

1. Vështrim teorik mbi strukturat eliptike marrëdhënia konvencionale e leksemave.
2. Vëzhgimi dhe interpretimi i shfaqjes së plotë semantike të fjalës në raporte eliptike të strukturave ligjëruese, parë nga këndvështrimi i drejtimeve të ndryshme gjuhësore.
3. Interpretimi i sintetizmit eliptik në realizimin e plotshmërisë së fjalës gjatë ligjërimin (poetik), orjentimi drejt polisintetizmit dhe krijimit të simbolikës.
4. Vëzhgimi dhe interpretimi i strukturave minimale të lëvizjeve kuptimore në ligjërimin poetik të A. Podrimjes, si të strukturave sipërfaqësore ashtu edhe të strukturave të thella në kushtet e sintetizmit eliptik.
5. Interpretimi i lëvizjeve kuptimore të hirearkisë kuptimore të leksemave të ndryshme në struktura minimale të rrjedhës ligjërimit poetike, pa përjashtuar edhe strukturat më të mëdha në nivel fjalie si një mundësi jo vetëm e gjuhës shqipe.

Metoda kërkimore: Hulumtim teorik mbi strukturat minimale eliptike, ku ndodh lëvizja kuptimore, analizë e lëvizjeve kuptimore në struktura minimale, por edhe në struktura më të mëdha, interpretimi i të dhënave bazuar në teoritë semantiko poetike.

Rëndësia e punimit: Punimi ka një rëndësi të veçantë në evidentimi e strukturave ku vetëdija gjuhësore e shqipëfolësve fillon e krijon devijanca semantike të leksemave si shenja konvencionale në kushte eliptizmi, natyrisht drejt pasurimit semantik. Njohja e eliptizmit si një mundësi e zgjerimit të mundësive interpretimi dhe mundësisë për të shkuar drejt simbolikës.

Ejalët çelës: strukturë minimale eliptike, strukturë e thellë, sipërfaqësore, sintagmë arbitrare në aspektin e gjatësisë, nominacion primar, semantikë poetike, polisintetizmi.

Eliptizmi si dukuri poetike i takon rrafshit të sintagmës dhe më tej, rrafshit të fjalisë. Eliptizmi ka lidhje me mungesën formale dhe kuptimore gjatë ligjërimin dhe gjenerimit të strukturave sintaksore. Por jo gjithnjë, eliptizmi nënkupton mungesën e kuptimit, sepse në shumë raste “kuptimi” është një prani e munguar e formës; natyrisht mungesë e formës

deri në një masë të pranueshmërisë së mungesës. Sipas John Lyons fjalitë ose janë kuptimplota ose me kuptime të cinguar (të pakuptimta), natyrisht fjalitë janë kuptimplota kur ata me të vërtetë kanë të përcaktuar mirë vlerën që mbartin¹¹⁶¹. Përcaktimi i plotshmërisë së kuptimit të një fjalie duhet kërkuar jo vetëm në natyrën leksikore të leksemave që formojnë strukturat sintaksore të fjalive (vargjeve), por edhe të konektorëve që ka struktura e tyre. Dallimi në ligjërimin poetic duhet kërkuar në ekzistencën ose jo të konektorëve (parafjalëve, lidhzave, formave paradigmatiche të leksemave) dhe vlerave të vërteta (të plota) dhe rrethanave të vërteta të përdorimit të strukturave ligjëruese¹¹⁶², por pa e barazuar me shprehjen si pjesë të ligjërimit.

Strukturat ligjëruese të gramatikës, herë janë të pranueshme si të tilla në realizimin e kuptimisë së plotë dhe herë duken si të papranueshme duke na krijuar idenë e një mungese formale, rrjedhimisht edhe të mungesës semantike. Nga ana tjetër përputhshmëria gramatikore mund të jetë në masën më të madhe të realizimit të saj, por mardhëniet semantike të leksemave në strukturën ligjëruese nuk janë të pranueshme kjo për shumë arsye të ndryshme, *qofshin kontekstuale sociale (krahinore), qofshin në mungesë të metalinguistikës ose psikologjisë gjuhësore të individit*¹¹⁶³. Kur flitet për eliptizmin semantic, nuk mund të flitet për eliptizmin semantik të shprehjes, pasi ajo del e realizuar në tërsinë e saj shprehëse. Vështrimi ynë është i përqendruar në eliptizmin semantik të fjalisë (strukturës së saj, natyrisht strukturës semantiko – sintaksore). Lyons në përpjekjet e tij për të shpjeguar kuptimshmërinë dhe pakuptimshmërinë e fjalisë mendon se fjalia në radhë të parë është e përcaktuar nga formimi i mirë gramatikor. Por nga ana tjetër nuk është, gjithnjë, kusht formimi i mirë gramatikor, ndaj ekzistojnë edhe fjali agaramtikore. Fjalitë ndoshta mund të jenë kuptimplota (kur janë të formuara mirë semantikisht) ose jokuptimplota (kur janë semantikisht jo mirë të formuara). Shprehja në ndryshim nga fjalia mund të jetë gramatikore ose jo gramatikore. Shumë shprehje, që janë prodhuar në rrethana normale të përditshmërisë janë jogramatikore, po të respektohet norma gramatikore e ligjërimit (shprehisë) të përditshëm, kjo na sjellë vështërsi të interpretimit në situatë kur ato prodhohen (ndodhen).¹¹⁶⁴

Ekzistojnë disa shprehje ku papranueshmëria është plotësisht e përcaktuar nga rregullat (material) gramatikore me shumë (më qartë) se nga parimet semantike të shprehjes. Po kjo nuk do të thotë së shprehja është tërësisht e përcaktueshme nga tërësia gramatikore e formimit të pjesëve përbërëse të saj (fjalitë).

Dallimi mes fjalisë dhe shprehjes është esencial në studimet semantike të ligjërimit poetic, pasi poezia është një shprehje unitare e cila ka strukturën gramatikore “të rregullt” ose jo të rregullt. Natyrisht shprehje e prodhuar në kushte të ndryshme socio – psiko – kulturore, si e tillë ajo shfaqet e pranueshme ose jo ose e pranueshme pjesërisht. Pranimi ose jo si sistem referimi herë ka pasur formën gramatikale, herë kuptimshmërinë e plotë. Si formë e veçantë e shprehjes poezia shfaqet si pranueshmëri herë e plotë herë jo e plotë, por asnjëherë nga të gjithë folësit e gjuhës në të cilën ligjërohet. Një gjendje e tillë ligjëruese është e kushtëzuar jo nga mosnjohja e tërsisë leksikore të përdorur në realizimin e shprehjes, por për shkak të kontekstualizmit duke e bërë një pamundësi interpretimi në

¹¹⁶¹ John Lyons, *Linguistic Semantics, an introduction*, Cambridge, University Press, 1995, f.131

¹¹⁶² Po aty, f. 131.

¹¹⁶³ Po aty, f. 133

¹¹⁶⁴ Po aty, f. 135

kushtet e njohjes normale. Thënë ndryshe, kontekstualizimi i ligjërimit ka bërë që të kemi shprehjen e zgjatjes kuptimore të më tejshme krahasuar me ligjërimit normal, literal duke shprehur nuanca kuptimore ku sipas njohjes tradicionale dhe retorike kjo shprehje është pjesë e parimeve metaforike, metonimike dhe të sinekdokës. Nga ana tjetër shprehja e nuancave kuptimore sipas parimeve të tropeve është realizuar sipas gramatikalitetit normative fillestar në të cilin kanë marrë jetë strukturat e tropeve kuptimore. Por çfarë ndodh me struktura sintaksore të fjalive që nuk u përshtaten rregullave normative gramatikore dhe që nuk janë pjesë e strukturave prototipale të tropeve? Pranimi i këtyre strukturave duhet parë si një lloj i veçantë të formës sintaksore, duke përfshirë varësinë kontekstuale dhe format eliptike të tyre. Lyons për këto struktura mendon se është e rëndësishme të bëhet dallimi mes tufave të formave jogramtikore nga njëra anë (duke përfshirë fjalitë të varura kontekstualisht dhe formave eliptike) dhe nga ana tjetër të “dërdëllitjeve” jogramtikore¹¹⁶⁵.

Në këtë dallim duhet të kemi parasysh marrëdhënien mes strukturave të thella dhe strukturave sipërfaqësore, marrëdhënie mes tufave (fijeve) të formës e përfshirë në komponentët e të dy seteve (strukturave sipërfaqësore dhe të thella).

Në këtë pikë, Chomsky mendon se procesi i të kuptuarit mund të shpjegohet pjesërisht në bazë të nocionit të nivelit gjuhësor, në veçanti për të kuptuar një fjali është e nevojshme të njihen fjalitë bërthamë prej të cilave ka prejardhjen¹¹⁶⁶. Kjo pikëpamje i jep jetë mendimit se niveli i shfaqjes sipërfaqësore nuk qenka determinues në tërësi të kuptimit të fjalisë, por marrëdhënia semantike (pa përjashtuar edhe atë formale) e hershme duhet parë me një rëndësi të veçantë në krijimin e kontureve të plota të kuptimit. Konturimi i tërësisë kuptimore, sidomos në ligjërimit poetic, nuk mund të realizohet bazuar në parimin e dallimit formal dhe kuptimor si parim bazë, pasi forma dhe përmbajtja e njëjse ligjëruese janë në varësi të saj që Chomsky e quan “reagime të gjuhës”¹¹⁶⁷

Në analizën e strukturave eliptike me rëndësi të veçantë paraqitet përfytyrimi intuitivë të të krijuarit kuptim. Në rastet kur përfytyrimi intuitivë nuk është i sigurtë në udhëheqjen e krijimit të kuptimit (të përfytyrimit semantic të pranueshëm), ku ekzistojnë një sërë kriteresh që na bëjnë të vendosim që një shprehje aktuale ose potenciale semantike është formuar mirë ose është formuar jo mirë. Në studimin e strukturave eliptike nuk duhet anashkalluar parimi i korigjueshmërisë së strukturave për të na dhënë një ide të qartë të pranueshmërisë semantike dhe gramatikore të një fjalie. Parimi i korigjueshmërisë nuk është vetëm në aspektin formal, të tufave lidhëse mes një forme dhe një forme tjetër të fjalëve në aspektin linear dhe gramatikor, por ky parim duhet parë edhe në aspektin e korigjimit semantic, nëse një fjali është e ndërtuar “gabim” semantike dhe deri në çfarë niveli është e korigjueshme semantike duke parë kushtet semantike të korigjimit. Kjo nuk do të thotë se ky parim është i zbatueshëm në të gjitha llojet e fjalive të ndërtuara jo mirë semantike, ndaj ato mund të mbeten edhe të pakorigjueshme.

Në ligjërimit poetic është me shumë rëndësi shqyrtimi i parimit të verifikimit të principeve ligjëruese, parim i cili ka lidhje të drejtpërdrejt me lexuesin, sipas Ayer, faktikisht një fjali është e rëndësishme për një person të dhënë, nëse dhe vetëm nëse ai është në gjendje të njoh qëllimin e propozuar (të dhënë) të shprehjes përmes kësaj fjalie (

¹¹⁶⁵ Po aty, f. 137

¹¹⁶⁶ Noam Chomsky, *Strukturat sintaksore*, Dituria, Tiranë, 2011, f.113

¹¹⁶⁷ Po aty, f. 121

Ayer 1946: 35). Nga ana tjetër Lyons mendon se ky parim nuk është determinues total i kuptimit¹¹⁶⁸.

Në shekullin XX neogramtikanët dhe neostrukturalistët mendonin se qëllimi i komunikimit është shumë i rëndësishëm në dekodifikimin e mesazhit poetik, madje lexuesi është pjesë e shkrimit me mundësitë interpretative të tekstit poetik. Bazuar në këtë parim kemi edhe ndarjen e lexuesve të jashtëm (explicit) dhe të brendshëm (implicit). Eliptizmi si formë e veçantë ligjërimore. Në strukturimin semantic të njësive sintaksore eliptike, Lyons propozon që të kemi parasysh lidhjet sintagmatike dhe paradigmatiche të pjesëve përbërëse të këtyre strukturave duke nisur nga niveli më i vogël duke përfunduar në nivelin më të lartë. Këto marrëdhënie duhen para si pjesë e sistemit të gjuhës dhe ligjërimin,¹¹⁶⁹ pavarësisht ndarjes që u bëjnë strukturalistët duke filluar nga Humboldt, Leibniz, Saussure, Chomsky etj.

Në marrëdhëniet sintagmatike dhe paradigmatiche, pavarësisht nivelit të sintagmave, është e rëndësishme të shikohet parimi i përzgjedhjes dhe kombinimit të njësive të këtyre lidhjeve. Tërësia e një lidhje paradigmatiche mund të ndodhet në një pozicion që është tipikisht i ndryshëm nga një tërësi tjetër lidhesh paradigmatiche që ndodhet në një pozicion tjetër, duke patur parasysh se një njësi leksikore mund të ketë rezultate të ndryshme në marrëdhënie sintagmatike të ndryshme. Ky parim i lidhjeve sintagmatike kushtëzon marrëdhënien semantike mes fjalëve në prezencë ose në mungesë. Për të patur një ide me të qartë mbi semantizmin e një structure ligjëruese, Chomsky propozon për të kundëruar me përparësi strukturat sintaksore të cilën këto fjali (struktura) janë përdorur zakonisht¹¹⁷⁰.

Strukturat eliptike jo vetëm që u nënshtrohen parimeve semantike të sintetizmit, por ato janë produkt i tyre. Sintetizmi eliptik është i kushtëzuar nga sintetizmi semantik dhe parimi i tij e aq më tepër kur ky parim në thelb të tij ka vërtetësinë e kushtëzuar. Pohimi është sintetik, kur vërtetësia është e kushtëzuar, - si fakt empiric, i cili mund të ishte edhe ndryshe.¹¹⁷¹

Përkundër pohimit analitik, ku vërtetësia jo vetëm që është e domosdoshme, por ajo është e garantuar nga kuptimi i elementeve konstitues dhe nga rregullar sintaksore të gjuhës. Nga ana tjetër mjegullnaja e vërtetësisë semantike të pohimit të shpie drejt mjegullnajës të krijimit të shumësisë interpretative, rrugë e cila përfundon në krijimin e konstruktve të semantikës simbolike jo vetëm të strukturave të lekesemave të veçanta, por edhe të strukturave të ndryshme ligjëruese. Në analizën e strukturave të tilla është me rëndësi të merret parasysh koncepti i kontekstit të kufizuar (Lyons), i cili jo vetëm shërbën për një dekodifikim të vështirë të strukturës semantike, por bëhet shkak për një marrëdhënie të shumësisë interpretative me strukturën e mirfilltë semantike, të sintagmës, të fjalisë ose të shprehjes.

Poezia e Podrimjes shaqet si unikalitet në strukturat semantiko – sintaksore të eliptizmit. Aq sa është konsideruar *poezi e thukët, madje tepër e thukët*, jo vetëm se është *metaforiko-simbolike, por edhe se është eliptike, mungesore*. Në të mungon, gjithmonë, diçka: *emra, folje,*

¹¹⁶⁸ Po aty, f. 141

¹¹⁶⁹ John Lyons, *Semantics (Volume I)*, Cambridge University Press, 1977, f 240 – 241.

¹¹⁷⁰ Noam Chomsky, *Strukturat sintaksore*, Dituria, Tiranë, 2011, f. 125

¹¹⁷¹ John Lyons, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Dituria, Tiranë, 2007, f. 409.

*dnajfolje, përmera të llojeve të ndryshme (vetorë, lidhorë, dëftorë të pacaktuarë), lidhëza, pjesëza, parafjalë, madje rrokje dhe tinguj fjalësh.*¹¹⁷²

Studimi i eliptizmit semantik në poezinë e Podrimjes do të jetë i orientuar në aspektin semantik, plotësimit të mungesës së pranishme, ose më saktë të reflektimit të gjuhës në mungesë. Do të përqipemi të hedhim dritë mbi strukturat, eliptike, poetike të Podrimjes duke u mbështetur në parimet e një semantike jo vetëm strukturale, por edhe të vetëdijes dhe psikologjisë së autorit dhe lexuesit, thënë ndryshe të vetëdijes dhe psikologjisë së shqipfolësve.

Në këtë mënyrë eliptizmi poetik i Podrimjes nuk është vetëm gjuhësor, por ai është mungesë e mendimit të shkruar ose prani e madhe e mendimit të pashkruar. Vëllimi poetik Lum Lumi, është një mozaik i eliptizmit të Podrimjes.

Poezia e Podrimjes është një mundësi e artë për të parë marrëdhëniet mes shprehjes dhe semantizmit eliptik në nivelet më të ulta të shprehjes, në nivelin e fjalisë (vargut), apo të sintagmës. Poezia “Këlthitje” është një panoramë e ndryshimit të mungesës së shprehje dhe pranisë në nivelet më të ulta të ligjërit.

*Edhe pak e Bregu s’do të duket/ Krejt njësoj/ Kohën tam as apo jo/ Edhe pak e Mallkimi e arrin Vala*¹¹⁷³

E gjithë poezia është ndërtuar mbi bazën e marrëdhënies mes katër elementeve leksikore, kun ë marrëdhëniet e tyre sintagmatike dhe paradigmatiche kanë kaluar në nivelin simbolik. Bregu, Koha, Mallkimi dhe Vala, krijojnë kuartetin karbonik të semantikës. Marrëdhënia e tyre është e kushtëzuar nga mos zëvendësimi paradigmatic i njëri – tjetrit duke u dhënë mundësi të jenë sa të vetëm simbolikisht, aq edhe potencë e pranisë simbolike të mungesës së gjymtyrës së dytë të sintagmave potenciale si: Bregu i lumit/liqenit/detit/oqeanit, po ashtu edhe leksema valë mund të hyjë në këtë marrëdhënie komplekse Vale e lumit/liqenit/detit/oqeanit. Këto dy leksema edhe pse me potencë zëvendësimi, natyrisht edhe këtu parimi i korrigjimit semantic është shumë i mundshëm, duke e bërë vargun e parë dhe vargun e fundit thellësisht të pranueshme në aspektin gramatikal, ato mbeten vargje hipotetike në pranimin e tyre semantik sepse marrëdhëniet e tyre sintagmatike janë jo shumë të qëndrueshme për shkak të mungesës formale dhe të shumëpranisë semantike. Në këtë mënyrë këto dy leksema bartin peshën e mëkatit të simbolit, janë Bregu dhe Vala që i kundërvihen njëri – tjetrit, janë simbole të konceptualizuara bazuar në antitetizmin e dëshirave. Në dëshirimin e një Bregu shpëtues në ikje nga Vala rrëmbyese, por edhe Vala shfaqet si shpëtim nga Mallkimi, i cili është mbret mbi Bregun ndërsa Vala me rrëmbimin e saj i shpëton mallkimit. E gjithë poezia shfaqet si një strukturë konceptuale në mungesë dhe një strukturë formale në prani sipas rregullave të sintaksës normative ligjërimore.

Kuarteti Bregu – Vala – Mallkimi – Koha është ndërtuar mbi bazën e hirearkisë filozofike – konceptuale, koha mbetet mbi mallkimin, valën dhe bregun. Kjo marrëdhënie e shndërron këtë poezi të nominacionit simbolik dhe të një simbolike ku parimi i njohurisë mbi qëllimin e shprehjes nuk mund të jetë i pranishëm në plotshëminë e tij. Nga ana tjetër parimi i thelbit semantik shfaqet i realizuar kontekstualisht jo tek të gjithë lexuesit.

¹¹⁷² Bashkim Kuçuku, *Parathënie e vëllimit poetik “Litari i ankthit” (poezi të zgjedhura)*, Toena, Tiranë, 2002, f.21

¹¹⁷³ Ali Podrimja, *Lum Lumi*, Koha, Prishtinë, 2012, f. 23

E gjithë poezia shfaqet si pohim sintetik mbi pushtetin e kohës, mallkimin dhe dëshirën për t'i shpëtuar qoftë në breg në paqe shpirtërore, ose në trandjen e lëvizjes së valëve.

Kjo situatë ligjërimore i jep status quo të një poezie nominative, gjëndje jo pak e pranishme në tërë krijimitarinë e Podrimjes, sa që shumë studiues mendojnë se poezia e tij është poezi e emrit me një artikulum të fortë.

Në poezinë e Podrimjes fjala artikulohet me një sforco të brendshme majft të madhe të Unit lirik dhe duke u përqendruar në asociacione, të cilat ndërlidhen mes tyre me një lloj fragmentariteti, që më së shumti është eliptizëm. Tërë poezia e Podrimjes është poezi e emrit, pra e gjëndjes dhe e hapësirës, pasi ekjuvalenca mes të trija elementeve është e drejtpërdejtë¹¹⁷⁴.

Në tërë poezinë e Podrimjes emri zë një vend të veçantë në krijimin e strukturave ligjëruese. Emri shfaqet si mundësi ekzistence semantike jo vetëm si nominacion unikal dhe individual, por gjithnjë përfshirë në një strukturë më të gjërë të shprehjes poetike. Nëse emri interpretohet si unikalitet dhe individualitet ai nuk bëhet bartës i semantikzimit poetik, por vetëm një nomenklaturë nominuese pa asociacione poetike, aq më tepër në struktura eliptike. Në jo pak poezi të Podrimjes lexuesi mund të hamendësojë për situata të tilla, gjithnjë duke mos arritur të dekodifikojë strukturën poetike, për shkak të mosnjohjes së qëllimit të shprehjes, dhe si i tillë tërësia nominale shfaqet jo mirëfunktionalizuar në këtë konstrukt dekodifikues. Një shumësi poezish, që në nominimet e tyre shfaqen me problemin e moszbatimit të parimit të qëllimit të njohur, ku mund të përmendim: *Myshku, emri, Uji i madh, Monstrumi, Dumvenio, Shushatje, Parisi, vendlindja, Besa, Gjarpri, bukuria, Dashuria, fjalët, Dashuria, Frika, Harrimi, Populli, Armenia, Shthurje, Drejtpeshimi, Çështje, Trajtat, origjina*. Moszbatimi i këtij parimi është vetëm në pamje të parë, pasi emërtimet e tyre jo kalojnë në nivelin e emërtimeve simbolike duke shfaqur në mënyrë të dukshme një çorjentim të qëllimit të parë dhe duke shfaqur shumësinë interpretative të nominimeve.

Interesante shfaqen emërtimet dyshe me një marrëdhënie sa arbitrare dhe të pamotivuar semantikisht aq edhe simbolike duke shndërruar në simbole – shenja në marrëdhëniet me tërësinë e shprehjes së poezisë. Poezi të tilla si *Myshku, emri; Parisi, vendlindja; Gjarpri, bukuria; Trajtat, origjina, Dashuria, fjalët* marrëdhënia mes tyre është sa pjesë e një sintagme aq edhe sintagma eliptike më vetë. Është me rëndësi të theksohet se marrëdhënia mes tyre vjen e bëhet më e fortë dhe shumë e qëndrueshme bazuar në tërësinë e shprehjes poetike. Në poezinë *Myshku, emër* një nominim i bazuar në strukturat inverse me një tendencë të eliptizmit formal marrëdhënia e tyre është e përcaktuar përmes foljes grimcoj-në përmes këtij konstrukti: *Në Bregun tim nuk dukesh/ as valë e lumit tim/ nuk të lagë më/ Sorrat të dergjura/ grimcojnë/ ëndrrën/ dhe myshku emrin në gurë*.¹¹⁷⁵

Në vargjet e para leksemat nominuese janë në marrëdhënie formale, natyrisht edhe semantike, ndërsa dy vargjet e parafundit janë ndërtuar mbi bazën e strukturës së sintagmës në mungesë dhe në prezencë potenciale duke u shndërruar në vargje të veprimit dhe të gjëndjes. Natyrisht, struktura e sintagmës dhe struktura transformuese duket se përmbajnë mjetet më kryesore sintaksore që përdoren në gjuhë për të organizuar përmbajtjen¹¹⁷⁶.

¹¹⁷⁴ Bavjola Shatro , *Fjala dhe ontologjia në poezinë bashkëkohore (Realiteti poetik i Martin Camajt, Azem Shkrelit, Ali Podrimjes dhe Agron Tufës)*, Botimet Dita 2000, Tiranë, 2012, f. 197

¹¹⁷⁵ Ali Podrimja, *Lum Lumi, Koha, Prishtinë*, 2012, f. 24

¹¹⁷⁶ Noam Chomsky, *Strukturat sintaksore*, Dituria, Tiranë, 2011, f. 123

Në këtë mënyrë janë krijuar vargjet e poezisë së mësipërme, duke theksuar faktin se prania në mungesë e elementeve formale, duke i bërë vargjet me një mundësi të madhe të lidhjeve paradigmatiche, por me një strukturë sintaksore statike të ligjëritimit na përforcon idenë se strukturat e thella mund të shfaqen edhe si sipërfaqëore vetëm me një ndryshim me strukturat sipërfaqësore të përfunduara në tërësi, sepse mundësitë e marrëdhënieve paradigmatiche, rrjedhimisht edhe sintagmatike janë në pafundësi duke shprehur pafundësinë e marrëdhënieve sematike nga njëra anë. Nga ana tjetër struktura të tilla shfaqen si të kalcifikuara për shkak të raporteve kontekstuale dhe përzgjedhjes paradigmatiche duke i shndërruar në simbole, pasi simbolet janë ata që bëjnë lidhjen e të kundërtave mes njëra – tjetrës, shprehin të pathënën, sepse përmbajtja e tyre i tejkalon kufijtë e arsyes¹¹⁷⁷

Simbolet shfaqen si individualitete, ku gjithsecili prej tyre ka një pikënisje në llojin e tij, ose krijohen kontekste, të cilat janë në gjendje të ndërtojnë struktura semantiko – simbolike. Në poezinë e mësipërme, marrëdhënia simbolike krijohet nga raportet mes leksemës sorrë – a/t me leksemat ëndërr – a/t dhe sintagma e emrave myshku dhe emri, këto të fundit shndërrohen në leksema simbole kontekstuale dhe për më tepër marrëdhënia e tyre shfaqet e tillë.

Struktura eliptike e vargjeve të mësipërme, natyrisht, dhe leksema simbole si sorrat, endrra, guri në bartjen e tyre semantike shfaqen elementete të mitikës kombëtare gurri dhe të mitikës së popujve të ndryshme. Ndërsa në poezitë “Gjarpri, Bukuria” dhe “Besë” raporti i mitikes kombëtare dhe të mitit me origjinë të lashtësisë kur vetëdija kombëtare nuk ishte e qartë në popuj shfaqet si element simbiotikë në simbolikën që mbart. Simboli i gjarprit ravijëzohet si i gjithëpranishëm në historinë e njerëzimit, si pjesë e kohës së individit në ndërgjegjen e tij, pavarësisht marrëdhënies që ka krijuar me atë, ku Podrimja e shfaq si qenie mbrojtëse të kohës, të individit të pozicionuar në kohë. Si simbol të tillë e gjejmë në simbolikën e lashtësisë ilire, por jo vetëm. Nga ana tjetër simboli i besës del tepër kombëtar, simbol i dallimit dhe unikalitetit të shoqërisë – komb të Podrimjes. Uni liri jep besën, më të shtrenjtën për të se do të jetë në bregun tjetër gjallë ose vdekur. Struktura ideomatike “gjallë ose vdekur” e kontekstualizon më shumë këtë natyrë të simbolikës së besës, kjo edhe përmes eliptizmit të saj formal dhe pranisë së semantike. Marrëdhënia e tyre shfaqet si mistikë e semantikës në tërësi, ku në fushat kuptimore të këtyre miteve vendosen e sprovohen ide dhe pikëpamjet e përjetimet e ndryshme imagjorative

poetike dhe shtrohen kërkesa që ato të rikupimësohen në përgjithësi, të marrin sa më shumë vlerësi të ideve poetike¹¹⁷⁸.

Nga ana tjetër, eliptizmi formal i këtyre vargjeve në strukturat sipërfaqësore krijon idenë e një konvencionalizmi primar në një strukturë sintaksore normale kryefjalë + kallëzues + kundrinë ndërsa vargu i fundit është homogjen në strukturë me tërësinë e vargjeve pararendës, me ndryshimin e mungesës së kallëzuesit në aspektin formal, por me një prezencë të kallëzuesit si poetencial në marrëdhënie me vargun *grimcojnë*. Marrëdhënia formale mes leksemave shfaqet me tendencë në krijimin e strukturave simbolike, sidomos në vargun përmbyllës së poezisë, me tre simbolet e qënësishë së individit (myshku, emri dhe guri) në një triptik të bashkëjetesës së njeriut në tokë si myshku një emër mbi gurë të

¹¹⁷⁷ Basri Çaqpriqi. *Simboli dhe rivalët e tij*, Kosova Pen Centre, Prishtinë, 2005, f. 19

¹¹⁷⁸ Ibrahim Rugova, *Kritika*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Alfa Print, 2007, f. 334

përhershmerisë. Në shumë poezi të Podrimjes gjejmë një enumeracion klimaks të eliptizmit duke përfunduar në vargje monoleksikore të tipit ose monosintagmatike: *Vetëm ora e thyer mbet dhe syri im çel'*/ *Buzë Ujit të Madh/ Dhe Diellit/ Në zenith*¹¹⁷⁹; *Dhe shoh rënien/ por fundin askund/ Ai det*¹¹⁸⁰; *Dhe të duartrokasit/ kur ti humb/ Lumi*¹¹⁸¹; *Do të ngjitem lart/ vetminë do e mund/ me fyell*¹¹⁸²; *Tek mbyllej në pikë të zezë/ universi*¹¹⁸³

Në strukturimin formal dhe semantik të këtyre vargjeve eliptike janë funksionalizuar një sërë dukurish stilistike dhe të tropeve kuptimore. Një peshë të madhe zë personifikimi i disa dukurive të ndryshme si: *Uji, Dielli, Deti, Lumi (Lum*¹¹⁸⁴). Jo me pak, mbartin forcën poetike edhe tropet kuptimore si metaforat: *orë e thyer, vetminë do e mund me fyell*.

Një nyje e veçantë të semantizmit eliptik përbën edhe eliptizmi korelativ, që është shumë e pranishëm në poezinë e Podrimjes. Në shumë poezi të tij kemi mungesë të mjeteve lidhëze qofshin lidhëzat, qofshin mjetet formale, por në rastet e tilla është treguar një kujdes i veçantë në praninë e mjeteve korelative sintetike. Mungesa e mjeteve lidhëse krijon një efekt disi të veçantë në perceptimin semantik të marrëdhënies mes formës dhe përmbajtjes të njësisë leksikore. Në poezinë “Shushatje” njësitë leksikore vijnë njëra pas tjetrës si breshëri fjalësh: *Kush e di për të satën herë lexoja Shokun Zylo/ Kuti konservash gazeta të verdha të grisuar erëra këpucësh erëra çorapësh/ smogu të dhera mizash të cofte lëvozhga frutash/ lajme taze/ lajme bajate*.¹¹⁸⁵

Mungesa e mjeteve korelative analitike është një potencë semantike të korelacionit sintetik, njësitë semantiko – sintaksore krijojnë një marrëdhënie të veçantë, kjo sidomos në perceptimin e njësisë leksikore me përafri semantike të pranëvendosura me kujdes nga uni poetik. Prania potenciale e korelacionit sintetik – formal rrit intensitetin e perceptimit të njësisë semantike të aktualizuara me qëllime të veçanta të kumtit poetik.

Në këto sturkuktura poetike strukturat sipërfaqësore të shqipes nuk janë respektuar në maksimum, madje si bazë e tyre kanë shërbyer strukturat e thella, ku njësitë sintaksore janë ndërtuar mbi bazën e parimit elemntet e strukturës së thellë në fjali kanë kuptim¹¹⁸⁶, natyrisht, bazuar edhe në parimin e pranueshmërisë dhe papranueshmërisë gramatikore dhe semantike.

E gjithë struktura është ndërtuar mbi bazën e parimit të pranueshmërisë semantike, në radhë të parë, por duke mos anashkaluar edhe parimin e pranueshmërisë formale, gramatikore. Pranueshmëria gramatikore (sintaksore, morfologjike) ka zbritur në nivelin e njësisë minimale të lëvizjes kuptimore, pra të sintagmës. Njësitë sintagmatike janë të pranueshme në masën më të lartë sintaksikisht, por edhe semantikisht, pavarësisht marrëdhënies mes pjesëve përbërëse. Kjo të krijon përshtypjen se poezia e eliptizmit është poezi e sintagmës, pasi vetëm duke zbritur në nivelin e saj mund të krijohet dabaza kuptimore e vargjeve. Poezia “Shushatje”, përsëri, shërben si një model i vargut eliptiko – sintagmatik, në të cilin mungesa dhe prezenca e konektorëve, qofshin analitik apo sintetik,

¹¹⁷⁹ Ali Podrimja, *Lum Lumi*, Koha, Prishtinë, 2012, f. 26

¹¹⁸⁰ Po aty, f. 27

¹¹⁸¹ Po aty, f. 41

¹¹⁸² Po aty, f.130

¹¹⁸³ Po aty, f.138

¹¹⁸⁴ Lumi shfaqet si nominim dual, si hidronim dhe si emërtim i qënieve njerëzore. Në këtë poezi portretizohet portreti i pjesës shpirtërore të unit lirik, pra të trashgimitarit fatqeq të tij.

¹¹⁸⁵ Ali Podrimja, “Lum Lumi”, Koha, Prishtinë, 2012, f. 53

¹¹⁸⁶ John Lynos, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Dituria, Tiranë, 2001, f. 389

është dëshmi e qartë e semantizmit sintetik të eliptizmit; përmes të cilit ndjesitë emocionet përcillen në formën e një shprehjeje të formës dhe strukturës, kun ë të vërtetë kemi një strukturë thellësisht logjike dhe e bazuar mbi semantizmin si parimin bazë.

*Fjalë ëndrra kopnin thonjë qyrrat thika myshku harresa*¹¹⁸⁷

Në pamje te parë vargu i mësipërm të krijon idenë e një grumbulli fjalësh pa lidhje mes njëra – tjetrës, por në të vërtetë ato kanë një marrëdhënie të fortë mes tyre. Ato janë shprehëse e emocioneve dhe ndjesive të unit lirik, nga njëra anë dhe nga ana tjetër janë dëshmi e strukturës sintaksore që buron nga një gjendje e rënduar psikologjike të unit lirik që kërkon mëshirë tek harresa pas myshkut, thikave, qyrrave, thonjëve, ëndrrave dhe fjalëve. Dy leksemat e skajeve të vargut lidhen semantikisht në funksionet që bartin jo në formën harmonike, por si formë antitetike kontekstuale. Fjalët nuk mund të sjellin harresë, përveçse kujtesës, po ashtu ëndrrat nuk shërbejnë për të harruar, madje për të kujtuar. Të gjithë leksemat janë funksionalizuar në dëshirën për harresë dhe pamundësinë e harresës.

Përfundime:

Marrëdhënia sintagmatike e bazuar në strukturat e thella dhe duke anashkaluar strukturat sipërfaqësore krijon përshtypjen e një nominacioni linear pa marrëdhënie semantike mes pjesëve përbërëse të strukturave sintagmatike ose më tepër.

Strukturat eliptike në ligjërimin poetik duhen parë në disa këndvështrime gjithnjë nisur nga parimet përkatëse, që nga parimi i gramatikalitetit dhe agramatikaliteti, pranueshmërisë dhe jopranueshmërisë së njësisive të tilla, parimit të korigjueshmërisë ose jo; po ashtu edhe parimit të strukturave të thella dhe strukturave sipërfaqësore, parimit të qëllimit të dhënies së informacionit.

Bazuar në parimet e sipërpërmendura është bërë e mundur që të bëhet një dallim mes shprehjes dhe fjalisë si në aspektin strukturor ashtu edhe në aspektin semantik, natyrisht duke u mbështetur në nivelin e strukturës së fjalisë.

Strukturat poetike sintetike dhe eliptike janë prototipet e strukturave të tropeve kuptimore, natyrisht duke iu referuar modeleve fillestare të ekzistencës së tyre.

Poezia e Podrimjes shfaqet si një formë e veçantë e eliptizmit poetik në nivel të sintagmës dhe vargut ndërsa si shprehje shfaqet sintetike dhe e plotë, pavarësisht mungesës dhe pranisë së formës dhe kuptimit.

Ajo është dëshmitare se strukturat eliptike janë fillesa e një nominacioni me tendencë simbolike duke mos përjashtuar edhe nivelet e para të një hermetizmi poetik, pasi niveli simbolik mbetet kontekstual në shumë raste.

Poezia eliptike shfaqet si poezi e sintagmës sintetike të shprehjes së forcës së gjuhës poetike bazuar në harmonizimin e strukturave të thella të ligjërimin.

Recenzentë të punimit
Prof. Dr. Valter Memisha
Prof. Dr. Mimoza Gjokutaj

Literaturë:

1. Chomsky, Noam, *Strukturat sinatsore*, Dituria, Tiranë, 2011
2. Çaqpriqi, Basri, *Simboli dhe rivalët e tij*, Kosova Pen Centre, Prishtinë, 2005
3. Hamiti, Sabri, *Vepra letrare nr.6 (Kritika letrare)*, "Faik Konica", Prishtinë, 2002

¹¹⁸⁷ Ali Podrimja, *Lum Lumi*, Koha, Prishtinë, 2012, f. 55

4. Lyons, John, *Linguistic Semantics, an introduction*, Cambridge, University Press, 1995
5. Lyons, John, *Semantics (Volume I)*, Cambridge University Press, 1977
6. Lyons, John, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Dituria, Tiranë, 2007
7. Kuçuku, Bashkim *Parathënie e vëllimit poetik "Litari i anktit" (poezi të zgjedhura)*, Toena, Tiranë, 2002
8. Podrimja, Ali, *Lum Lumi*, Koha, Prishtinë, 2012
9. Rugova, Ibrahim, *Kritika*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Alfa Print, Prishtinë, 2007
10. Shatro, Shatro, *Fjala dhe ontologjia në poezinë bashkëkohore (Realiteti poetik i Martin Camajt, Azem Shkreli, Ali Podrimjes dhe Agron Tufës)*, Botimet Dita 2000, Tiranë, 2012.

DRAMAT E ANTON PASHKUT (TRAGJEDI MODERNE)

Halil Dervishaj

Hyrje

Titulli “Dramat e Anton Pashkut (Tragjedi moderne)” shenjon objektin që kemi përzgjedhur për studim; pjesa e parë, “Dramat e Anton Pashkut”, shenjon gjininë letrare, dhe pjesa e dytë, “Tragjedi moderne”, zhanrin brenda gjinisë letrare.

Anton Pashku ka shkruar dy drama (tragjedi): “Sinkopa” e botuar në vitin 1969, edhe pse për herë të parë shihet e botuar në revistën “Jeta e re”, në vitin 1968 dhe “Gof”, e botuar më 1976.

Më pas, që të dy këto drama, do të dalin në një vëllim të përbashkët, në vitin 1982, nën shenjuesin “Tragjedi moderne”.

Në aspektin formal, botimi i dramave Pashkut, së bashku, nën titullin “Tragjedi moderne”, të jep të kuptosh se zhanri është i përcaktuar, por gjatë leximit vëren se, krahasuar me dramën tradicionale, përcaktimi me lehtësi i zhanrit është një çështje relative. Bile edhe nëse në “Gof” ky element përcaktohet më lehtë, në “Sinkopa” ndodhë ndryshe, sepse në pjesën e parë të saj kemi një tekst që nga “drama zbritet në monodramë, nga dialogu në monolog, nga dramatikja në dramatizim”¹¹⁸⁸.

Zhanri i tragjedisë, pos konfliktit që ka në mes, ka edhe tragjikën, pra pësimin. Te Pashku, pësimi del si një shenjues universal, duke reflektuar gjendje të caktuara, pushtimin në “Gof”, ndërsa në dramën tjetër, në “Sinkopa”, rrënimin e lirisë dhe pësimi shihet si një simbolikë që përfshin gjithë tekstin dramatik pastaj. Andaj, në këtë mënyrë, i gjithë teksti zhvillohet në nivel të idesë.

Duke qenë se këto drama janë studiuar kryesisht si të ndara, pasi që ato edhe u botuan si të tilla së pari, sepse ato kanë autonominë e vet, por ato janë studiuar edhe së bashku në këndvështrime të tjera, mua më pëlqeu që analizën time ta nis pikërisht nga varianti i botuar së bashku (1982), për të parë përmbysjet që ndodhin edhe në këtë strukturim të ri. Andaj, kësaj here, dramat e Pashkut dua t’i lexoj bashkë, si faqet e një flete dhe analizën time do ta filloj nga kategoria, pra gjinia letrare dhe zhanri brenda saj, niveli strukturor, kompozicional, kodi tematik dhe deri te niveli i ideve.

Zhanri

Forma letrare i hapë rrugë edhe leximit të ideve, sepse përcaktimi i formës letrare, në radhë të parë ndërlidhet me elementet e veçanta që kanë format e ndryshme letrare,

¹¹⁸⁸ Anton Pashku, *Tragjedi moderne*, Rilindja, Prishtinë, 1986, f. 7.

elemente që pavarësisht se nuk kanë kufij të prerë mes tyre, megjithatë, e dallojnë gjininë poetike, narrative dhe dramatike. Brenda gjinisë letrare, pastaj qëndojnë zhanret letrare. Në teoritë e sotme letrare, zhanret letrare shihen si çështje historike dhe kufiri në mes të këtyre zhanreve është i kalueshëm. Huazime të elementeve nga gjini e zhanre të ndryshme; atëherë, elementet mikse të formave narrative e dramatike janë të dallueshme edhe në “Gof”, por edhe në “Sinkopa”. Ky është dallimi i parë e që e bën Pashkun të veçantë.

Pos strukturës së veçantë që ka vepra dramatike, ajo ka të veçantë edhe elementin gjuhësor. Në vend të narracionit, vepra dramatike ka monologun e dialogun; ligjeratën e drejtë. Por ky element përmbyses në dramën e Pashkut, sepse elementet narrative janë të pranishme brenda tyre. Përzierja e elementeve të tilla është shenjë që dëshmon njohjen e zhanrit para se ai të përmbyses.

LULASHI

.....

1. *kur Iksi... tue përdorun ndonji mjet kontër kafshës ... e trondit këtë në mënyrë që vetiu rrëzohet për toke e gjallë, e mandej mbi këtë kafshë aplikohet therrja... a asht e lejueshme ngranëja e mishit të sajë?*

Dër Bë Shpati dë vë: asht e lejueshme.

2. *nga mënyra e therrjes së kafshëve ... cila asht ma e pëlqyeshme nga sa përshkruajmë këtu:*

a) *Ajo që aplikohet me tronditjen e kafshës me një vegël që pro vo kon rrëximim e sajë për toke të gjallë, apo b) ajo që pa aspak tronditje rrëzohet për toke me të gjitha ndjenjat pa e cenua me asnjë send?*

*Dër ... Së shpejti ... Bë Shpati ... dë vë: asht ma e pëlqyeshme therrja si u shënue në paragrafin A ... Ultima moda ... Së shpejti ... Kobobobo ... Bobo ... Kokobobo ...*¹¹⁸⁹

Në gjithë tekstin dramatik, Lulani dhe Lulua bëjnë dialog, Lulashi monolog të dialogëzuar (monolog të dialogëzuar në kuptimin e asaj që teksti i afrohet prozës), personazhi flet nga Uni i tij edhe për të tjerët, dhe si tip rrëfimi qëndron afër prozës. Në këtë mënyrë, monologu i Lulashit nuk komunikon drejtpërdrejtë me dialogët e Luluas dhe Lulanit, por po të shihet teksti i plotë, monologu i tij është esencial në shtjellimin e idesë.

Megjithatë, derisa monologu dhe dialogët janë element përbërës në “Gof”, në “Sinkopa”, në pjesën e parë të saj kemi zbritje nga dialogu në monolog dhe nuk vërejmë veprim dramatik.

XHEXHEU

Alo, Shpresë, alo!... Shpresë! (Qet kambën mbi kambë.) Alo, ëhë. Alo! Ëhë, athue ku do të jetë Shpresa ime? (Shtrihet në shtrat) Alo, alo! ... Shpresë, ëhë, alo!

¹¹⁸⁹ Anton Pashku, vep. e cit., f. 51.

(Mugë. Ka dritë vetëm në dritaren e Femnës dhe të Mashkullit. Femna largohet prej dritares. Mashkulli rrëxon shikimin e vet në rrugë. Herë mbas here, dëgjohej mjaullima e një mace).¹¹⁹⁰

Derisa në dramën e parë, monologu i Lulashit, brenda strukturimit të tillë përmban elementin narrativ në mes dhe si i tillë, brenda monologut pyet e pergjigjet, në "Sinkopa", monologu ruan farën e vet dhe dialogun vetëm sa mund ta konstruktojmë nga ajo që dëgjojmë të flasë Xhexheu.

Dialogu vetëm sa mund të nënkuptohet, por jo edhe të dëgjohej. Në të dy këto drama mungon veprimi dramatik, element përbërës i gjinisë dramatike. Teksti është me ngarkesa emocionale shprehëse dhe ka dramatikën brenda vet tij. Ky është elementi i dytë që Pashkun e bën të veçantë. Pra, përmbysja e parë ndodhë me strukturën e jashtme (formën) dhe e dyta me zhanrin.

Vënien e këtyre dramave nën titullin "Tragjedi moderne", Mensur Raifi e merr si përshkrim dhe assesi si vlerësim. "Ndërkaq, secila përpjekje për ta përcaktuar a definuar zhanrin e një teksti bashkëkohor modern apo avangard bart në vete, përveç këtyre cilësimeve, edhe po aq përshkrime, por kurrsesi jo vlerësime"¹¹⁹¹. Edhe kur këto tragjedi i quan drama të individit, thotë se edhe ky është përshkrim dhe jo definim i zhanrit. Megjithatë, shikuar nga ana formale, parateksti, didaskalitë dhe shenjuesit e tjerë tekstorë, "Sinkopa" ka elemente që të cilësohet e farës dramatike, por në mënyrë të kundërt me dramën e traditës. Ndërsa në "Gof", pos elementit narrativ në raste të caktuara, ajo ruan farën e gjinisë dramatike, me shenjuesit e saj tekstorë, formalë e kompozicionalë, por gjithashtu, duke e përmbysur rregullin tradicional të kësaj gjinie.

Struktura

Të gjithë studiuesit që kanë studiuar dramën e Pashkut, që në fillim theksojnë përmbysjen strukturore të tyre dhe kjo nuk është ndonjë gjë e re.

Derisa drama "Gof" ka strukturë: *Një epilog, Mbas një epilogu, Para një prologu, Një prolog*; "Sinkopa" ka strukturë: *Mbarimi i fillimit të Sinkopës, Fillimi i mbarimit të Sinkopës*.

Përmbysja e tillë strukturore nuk do të mund të ndodhte pa u pasë njohur mirë së pari struktura tradicionale e dramës si e tillë.

Përmbysja tjetër ndodhë në botimin e vitit 1982, kur këto drama botohen së bashku, nën titullin "Tragjedi moderne". Rrjedha origjinare e shkrimit përmbysset. Edhe pse "Sinkopa" ishte shkruar e para, këtu renditet e dyta dhe "Gof" që ishte botuar e dyta, këtu renditet e para. Atëherë, struktura e këtij vëllimi të përbashkët nën shenjuesin "Tragjedi moderne", e vitit 1982 duket: "Gof" e para dhe pastaj "Sinkopa".

Në nivel ideje ndër lidhet me kodin tematik, sepse "Gof" për temë ka kohën e Luftës së II Botërore dhe "Sinkopa" kohën e pas luftës.

Por, ndoshta edhe më shumë se kaq, sepse në këtë strukturim të ri, vërehet edhe një përmbysje tjetër, ajo gjuhësore. Meqë "Sinkopa" ishte botuar para unisimit të gjuhës standarde, ajo ishte e shkruar në dialektin gegë, "Gof" ishte shkruar në standard dhe pas saj, por këtu, kjo strukturë prap përmbysset.

¹¹⁹⁰ Po aty, f. 106.

¹¹⁹¹ Mensur Raifi, *Mozaik letrar I*, Dukagjini, Pejë, 1998, f. 92.

“Teksti i *Gof-it* është tekst kryesisht i shkruar më parë, i bartur këtu nga publikimet dhe gazetat e ndryshme, ndërsa përpjekja krijuese e autorit gjakon të bëjë të mundshëm barazimin e *gjuhës së folur* me *gjuhën e shkruar*.”¹¹⁹²

Studiuesi Kujtim M Shala, Pashkun e sheh të frymëzuar nga autorët gegë të viteve tridhjetë të shekullit të kaluar, konkretisht Koliqit, duke e argumentuar këtë edhe me personazhin e “huazuar” (Lulashin) nga ai dhe dashurinë për mënyrën e shkrimit të tij. Edhe pse tekstet e Koliqit dhe të Pashkut janë tekste të kategorive të ndryhme “s’është vetëm punë *narrativiteti intertekstual*. Është punë malli të Antonit për Ernestin, për letërsinë e tij”¹¹⁹³. Kjo është shenjë dashurie e malli për Koliqin. Në këtë aspekt, mbase standardi i ri nuk e ka kënaqur Pashkun dhe si i tillë mund të ketë reflektuar në këtë përmbysje strukturore të vitit 1982. Ndoshta! “(...) mospajtimi me kodifikimin e normës letrare, ndaj të cilës ushtron refleks pasiv nuk reagon parimisht, mirëpo vetëm shfrytëzon hapësirën që lejohej institucionalisht se për letërsinë s’është e thënë të vlejë domosdo kodifikimi i *gjuhës letrare të unisuar*”¹¹⁹⁴.

Përmbysja strukturore e dramave të Pashkut, qoftë kur u botuan veç e veç, qoftë së bashku, është shenjë moderniteti, njohje e konvencës dhe njohje e mirë e zhanrit tradicional ndër ne dhe në letërsitë përendimore, atëherë shenjë moderniteti te ne. Përmbysja e tillë i hap rrugë leximit të dramave të Pashkut, sepse vetë ai theksonte se së pari projektonte fundin e veprës dhe pastaj fundit ia përshtaste fillimin. Kjo është veçantia tjetër e Pashkut.

Kodi tematik

Para se të kalohet në kodin tematik, theksojmë tipin e shkrimit krejt të figurshëm si esencë e çelës për hyrje në interpretim.

Hyrja në brendi të tekstit të parë dramatik, “Gof”, të çon para së gjithash te çështja nacionale. Mbështetja në *faction*, në historinë kombëtare, në tradhtinë, çon deri te pushtimi. Pastaj, këtë Pashku e universalizon dhe rikontekstualizon, duke e sjellë në vepër letrare, duke i dhënë një dimension të ri dhe ngjyrim të ri artistik, duke e kombinuar me *fiction*.

E në “Sinkopa”, thyerja e iluzioneve të lirisë, për shkak të sistemit socio-politik, ka çuar në vetëmbyllje, në humbje të ndjenjës njerëzore. Derisa e para ndërlihet me shakun e pasojën e gjendjes kaotike, pushtimit, si rezultat i tradhëtisë, në të dytën, thyhen këto iluzione dhe individit dhe shoqëria pësojnë për shkak të sistemit represiv që instalohet si diktaturë, qoftë e shpallur ose jo.

Në “Gof” pushtuesi del i figuruar, si shpend i zi, andaj korb dhe pos që në tekstin hyrës theksohet viti i pushtimit, tutje i gjithë teksti është i figuruar.

Shihen e dëgjohen

LULASHI

LULANI

LULUA

¹¹⁹² Anton Pashku, *Tragjedi moderne*, Rilindja, Prishtinë, 1986, f. 11.

¹¹⁹³ Kujtim M. Shala, *Vox-i i Anton Pashkut*, Buzuku, Prishtinë, 2002, f. 75.

¹¹⁹⁴ Rexhep Murtez Shala, *Ex libris - moderna pashkiane*, Papyrus, Prishtinë, 2006, f. 22.

Dhe një shpend, një zë, shumë zëra dhe ulurima e ujve, përzier me hukamat e heqamës që pat shpërthyer në prillin e njëmijentëqindetridhjetentë.¹¹⁹⁵

Personazhet (Lulashi, Lulani e Lulua) janë nisur për ta pushtuar Majën e Naltë dhe gjatë rrugës kanë dështuar. Lulashi ka pësuar (dramatikja nënkuptohet si e ndodhur) dhe tutje nuk do të ketë dramatikë, pos dramatizim në mes të këtyre personazheve, për të gjetur zgjidhje në gjendjen që janë, për ta ndihmuar Lulashin e pësuar. Veprimi mungon. Kjo gjendje mbizotëron deri në fund. Ne nuk dimë nëse Lulashi ka mbijetuar apo jo, por në fund kemi rrjedhën e ujit në lugun e mullirit, si shenjë për vazhdimin e jetës, apo këngë për bukën, siç thotë Sabri Hamiti.

Në Sinkopë:

Personat

XHEXHEU

GJEGJEU

FEMNA

MASHKULLI

KITARISTI

Role aspak interesante luejnë edhe një TELEFON dhe një THIKË gati plotësisht e ndryshkët. Autori nuk di kush i krijoi këto dy role dhe si u futën në shtjellën e dramës së tij; asht e tepërt me thanë se nuk i pëlqejnë, por tash nuk mundet as me i shlye, sepse tanima asht shumë, shumë vonë. Kaq, sa u përket roleve. E sa i përket vetë dramës, mund të thuhet mezi vetëm kaq: kjo copë drame, nis e sos, zhvillohet sall në banesën e Xhexheut, ku muret e të gjitha mobiljet janë krejtësisht të bardha. Por, ju gaboni rrast nëse do të përfundoni se kjo dramë zhvillohet edhe gjetiu. E ke gabim i juaj do të jetë komplet edhe me të vërtetë katastrofal, për të mos thanë fatal, nëse në mbarim do të ju duket se paska ndodhë diçka e tmerrshme në dhomën krejtësisht të bardhë të Xhexheut të gjorë edhe sidomos në dritaren e majtë. Njëmend, vritet femna, por çrandësi mund të ketë kjo Femën dhe vdekja e saj, kur në mbarim – fatlumnisht apo, ndoshta, mjerisht – gjaku i saj nuk shihet askund. Çdo gja, çdo gja, ama bash çdo gja mbetet e bardhë, plotësisht e bardhë.¹¹⁹⁶

Ky paratekst shenjon pikat kryesore, çelës, nga ku fillon leximi i veprës, apo shfaqja kur ajo luhet në skenë. Ngjarja ndodhë në një vend, në dhomën e Xhexheut, si miniaturë e realitetit, si refuzim e mospajtim, por edhe fshehje e realitetit dhe ky realitet shfaqet në dhomën përballë tij, në të cilën shihen vetëm imazhet, sepse nuk dëgjohen zërat e Femnes e Kitaristit. Aty ka edhe dramatikë. Ka edhe vdekje. Por ajo tentohet të fshihet. Shkohet deri në nivel simboli. Njëmend, vritet femna, por çrandësi mund të ketë kjo Femën dhe vdekja e saj, kur në mbarim – fatlumnisht apo, ndoshta, mjerisht – gjaku i saj nuk shihet askund. Çdo gja, çdo gja, ama bash çdo gja mbetet e bardhë, plotësisht e bardhë.

¹¹⁹⁵ Anton Pashku, *Tragjedi moderne*, Rilindja, Prishtinë, 1986, f. 34.

¹¹⁹⁶ Po aty, f. 99.

Xhexheu është oponenca e realitetit dhe ai nuk pajtohet me të. Megjithatë ai nuk mund ta ndryshojë atë.

Krijimi i Subjektit karshi sistemit represiv duket i pamundshëm. Në anën tjetër, drama më e madhe ndodhë në prapaskenë, që del e barasvlershme me realitetin, ku pavarësisht mundësisë që realiteti i dhembshëm të fshihet, ndodhë e kundërta. Shtresat e një personaliteti dhe ëndrrat e tij, dalin në mënyrë mjeshtërore tek vetë Xhexheu. Koha e kryer, e tashme dhe e ardhme janë ekuivalente me Lumninë, Shpresën dhe Lumtuninë. Ndërsa Gjegjeu mund të shihet si alter ego i Xhexheut. Si e tillë edhe këtu drama më e madhe ndodhë brenda vetë shtresave të personalitetit. Sinkopa, kuptimi i së cilës shenjon mungesën e një rrokjeje ose tingulli, këtu shenjon një mungesë në strukturën e veprës dramatike e në aspektin e përgjithshëm dhe shenjon një mungesë shpirtërore, por edhe mungesë lirie. Në fund, dalja e Xhexheut në kërkim të Lumtunisë hap një alternativë, por tekstin e lë të hapur.

Përmbyllje

1. Te “Gof” vërejtëm të gjithë shenjuesit formalë të gjinisë dramatike, duke filluar që nga parateksti dhe teksti shoqëruar në fund e deri te didaskalitë që janë të farës dramatike. Megjithatë, kemi reduktim të madh të situatës dramatike dhe personazhet më shumë dramatizojnë ide në mes vete se sa veprojnë. Dramatikja si e tillë nuk kalon në konflikt të hapur. Ka edhe monologët e dialogët si përbërës kryesorë të gjinisë dramatike. Duke qenë se i shmanget strukturës tradicionale, drama “Gof” është antidramë në kuptimin e përmbysjes strukturore.

Monologu i Lulashit përbën esencën e tekstit dramatik. Monologu i tillë komunikon me dialogët e Lulanit e Luluas në plan të idesë.

Dramatizimi në mes të personazheve të tij, është një nga alternativat e shkakut e pasojës që kanë çuar në dështimin e pushtimit të Majës së Naltë. Maja e Naltë del e barasvlershme me Lirinë. Andaj, mbërritja në Majën e Naltë, njëherësh është mbërritja në liri. Pashku këtu vë në pah binomin individ/liri, në dobi të të parit, sepse, individ i është ai që i prin lirisë sipas tij. Megjithëse, në fund nuk dimë nëse personazhet e Pashkut kanë mbijetuar apo jo, kemi rrjedhën e ujit në lugun e mullirit, si një shenjë e vazhdimit të jetës. Pashku e do vazhdimin e jetës, e do lirinë.

2. Aty ku fillon të lulëzojë jeta në dramën “Gof”, tutje, do të fillojë zhgënjimi në “Sinkopa”. Megjithëse kjo dramë, së pari vë në dyshim kategorinë, për shkak se në gjithë pjesën e parë të saj kemi një zbritje nga dialogu në monolog, rrjedhimisht nga drama në monodramë, kjo ka kompleksivitetin e vet, sepse ka edhe prapaskenën, figurativisht një dramë tjetër që ndodhë jashtë skenës. Në plan të idesë, thyerja e iluzioneve të lirisë, ka çuar në vetëmbyllje, në humbje të ndjenjës njerëzore, del përfundimi i Pashkut.

3. Anton Pashkun e bën modern tipi i shkrimit i veçantë, stili gjuhësor, kompozicioni, struktura formale. Artikulimi i të gjithë këtyre përbërësve brenda tërësisë së veprës së tij dramatike e bën prijës të modernitetit tek ne. Leximi i dramave të tij mund të bëhet edhe i shkëputur (ato lexohen edhe veçmas), por parë kompleksivitetin dhe dëshirën për një lexim tjetër, ato mund të lexohen edhe në sistem, bile jo në relacion më kohën se kur u shkruan, por ashtu siç dalin në vëllimin e përbashkët “Tragjedi moderne”.

Veprat dramatike të Anton Pashkut, “Gof” e “Sinkopa”, vazhdojnë të qëndrojnë si vepra me vlerë të veçantë në letërsinë shqipe, si nismëtare të modernitetit dhe komunikimi me

to as sot nuk ka pushuar. Këto drama lënë hapësirë për qasje të ndryshme, në nivele të ndryshme dhe nuk mund të shteren.

Recensentë:
Prof. asoc. dr. Kujtim M. Shala
Prof. asoc. dr. Vehbi Miftari

KONTRAVERSI I KULTIT TË DETIT NË KRAHINËN E BREGUT TË JONIT

Dr. Irena Gjoni

Kontraversi i Kultit të detit është objekti i këtij studimi. Shumë i përhapur në krahinën e Bregut të Jonit, Kulti i Detit është i pranishëm me të dy anët e tij të kundërta: jetëdhënës dhe jetëmarrës. Si jetëdhënës del në sigurimin e ekzistencës jetësore me anë të peshkimit a të tregtisë me vendet e tjera. Si jetëmarrës ka shërbyer si burim prej nga kanë ardhur ushtritë pushtuese, piratët e ndryshëm, apo tërbimi i tij gjatë lundrimit me kohë të keqe. Për t'i përmbushur të mirat që sillte deti dhe për t'i rezistuar të këqijave që vinin nga ai, sipas perceptimit të njeriut primordial ishte e nevojshme të bëheshin blatime e flijime, të ngriheshin kulte. Në këtë studim është synuar të argumentohet ekzistenca e Detit me funksionin e dyfishtë: edhe si hyjni, edhe si altar ku adhurohej e lutej. Për këto arsye është dashur që protoshqiptarët ta njihnin dhe ta kenë ngritur kultin e hyjnisë së detit, i cili në një formë të regjuar na del i personalizuar në besimin në shenjterinë e shën Spiridhonit. Kontraversi i Kultit të Detit, ka përcaktuar edhe mënyrën e jetesës praktike dhe shpirtërore të banorëve afër tij.

1. Dy pamje kontrastuese të detit

Krahina e Bregdetit ka qenë e lidhur pazgjidhshmërisht me detin. Me të ka të ndërthurur pjesën më të madhe të jetës, të ekonomisë, të lidhjeve me botën. Nëpërmjet tij Bregdeti ka qenë i lidhur me botën e huaj (me Korfuzin, Venedikun, me Napolin, Peloponezin). Në sytë e bregdetasve të lashtë, ashtu si dhe të grekëve e romakëve të lashtë, koncepti fillestar mbi detin ishte pamja e dyanshme e tij. Simonidhi e përshkruan kështu: "Shumë herë qëndron i palëvizur, të keq nuk bën, përveç gëzimit për marinarët. Në verë shumë herë i papërmbajtshëm, përplas valët me furi".¹¹⁹⁷

Për anën negative të tij mund të lexojmë *Ligjet* e Platonit. Duhej vendosur për një zonë fantastike në Kretë. Diskutimi rrotullohej rreth vendit ku duhej të ndërtohej qyteti. Duhej të gjendej afër detit. Por kjo, sipas njerit nga diskutuesit, do të kishte rezultate të këqija, sepse "afërsia me detin do të mbushë tokën me tregtarë dhe shitës të vegjël që fitojnë para dhe lindin në shpirt zakone të paqëndrueshme, të këqija dhe i bën qytetarët të pabesueshëm dhe armiqtësorë".¹¹⁹⁸

Këtë kontradiksion të detit e shpreh qartë A. Papeleka: "Marrëdhëniet e himariotëve (nënkupto bregasit – shën. im – I.Gj.) kanë qenë komplekse, madje kontradiktore. Nga njëra anë deti është një element i jashtëzakonshëm, i stërfuqishëm dhe i madhërishtëm i natyrës, si një hapësirë e pakufishme për bëma dhe aventura, si një mundësi për të siguruar fitime të mëdha përmes tregtisë, peshkimit, piraterisë; nga ana tjetër ai ka qenë një botë e panjohur, vendbanimi i qenieve të llahtarshme, apo vdekjeprurëse, shkaktari i furtunave shkatërrimtare, rruga nga kanë ardhur nëpër shekuj ushtri pushtuese dhe

¹¹⁹⁷ N. Psilakis, *Κρητική Μυθολογία*, Ηρακλειο 1996, f. 67.

¹¹⁹⁸ N. Psilakis, *Κρητική Μυθολογία*, Ηρακλειο 1996, f. 67.

piratë.¹¹⁹⁹ Madje, tri arsytet e fundit thuhet se janë bërë shkak që disa fshatra të Bregdetit të tërhiqen nga buza e detit, më në lartësi e thellësi. Megjithatë, nga ana tjetër, deti mund të paraqitet si një burim i çmuar jetese nëpërmjet peshkimit dhe tregtisë. Bregdetarët janë njohur si detarë të mirë e të zotë, pa përjashtuar piraterinë e qeparotasve e të himariotëve. Aq të lidhur kanë qenë me detin, sa thonë se në Piqeras kishte aq varka, sa kishte dhe burra, prandaj shpesh i thonë “Fshati i varkarëve”. Kjo ka bërë që tek banorët e kësaj treve shumë kuptime mitike dhe rite të kishin të bënin me detin. Elementët e paganizmit, të lidhura me të (detin) mbijetuan edhe pas krishtërimit, por përgjithësisht të pasuruara me detaje kristiane.

2. Hyjnizimi i detit

Kultin e detit e hasim tek ballkanasit dhe te mbarë indoevropianët. Në të gjithë këta popuj ai shfaqet me një fuqi të mistershme, herë jetëdhënëse e herë të frikshme. Kudo flitet për thellësi të mistershme, të panjohur e tepër të fuqishme. Ky konceptim i hershëm natyrisht që lidhet me nivelin e njohjes së një realiteti veprues tepër energjik.

Deti përfaqësohet nga vetëm një Zot, i cili megjithëse nuk është forca e vetme që vepron në ujërat e tij, kishte një fuqi më të lartë se të gjitha fuqitë e tjera, nga Posejdoni. Gjendja e tij ishte herë e qetë, herë e butë, herë e trazuar dhe herë e pakontrollueshme. Ai është perëndia e detit dhe e kuajve – shprehet Homeri. Njihet nga furka me tre dhëmbë, armë me të cilën edhe sot peshkatarët kapin peshqit më të mëdhenj.¹²⁰⁰ Figura e Posejdonit, perëndisë së detit, derdhur në vjeggën e një ene bronxi, datuar në shek. IV p. K., është gjetur në Kastane (Himarë) të Bregdetit kaon.¹²⁰¹

Atributet e Posejdonit i kishte edhe Redoni ilir, Neptuni latin e hyjnesha Tetis.¹²⁰² Një numër Zotash më të vogla si: Glauku, Nereu, Proteu dhe Tritoni ndanin një njohje të përbashkët, profecinë. Zecharia Sitchin e paraqet Posejdonin jo vetëm sundimtar të deteve, por, sipas tij, ai zotëronte edhe artin e metalurgjisë e të skulpturës, si dhe ishte magjistar dhe falltar i fuqishëm.¹²⁰³ Përmes ekzistencës së këtij atributi të fundit, mund të gjykohet se ndër kohëra, me dëshirën njerëzore për të kuptuar të sotmen e imagjinuar, të ardhmen, fuqia e mistershme e detit mund të jetë interpretuar si simbol i misterit të thellë e të pazbuluar të së ardhmes.

Megjithëse nuk i quanin banorë të tij, fuqi në det ushtronin gjithashtu edhe Dioskurët (djemtë e Zeusit), pra Kastori dhe Polluksi.¹²⁰⁴ Njihen si mbrojtës të marinarëve .

Duke qënë banorë të bregut të detit Jon, pranë këtij areali mitologjik, afërsie, marrëdhënieje, mendojmë se edhe kaonët do të kenë pasur emërtesë të një hyjnie deti në trajtë ikone të antropomorfizuar. Në fakt kjo ngelet vetëm një hipotezë, sepse asgjëkundi nuk ekziston një emërtim konkret për hyjninë tonë të detit, as në tekstet e shkruara, as në burimet gojore. Por hipoteza e ekzistencës së kësaj hyjnie deti bëhet më e besueshme për shkak se në konceptin etnologjik popullor shqiptar deti ka qenë dhe vijon të mbetet një forcë tejet e madhe, të cilit banorët e Bregut të Jonit i falen e i blatojnë.

¹¹⁹⁹ Anton Papeka, *Himara në shekuj*, Tiranë 2004, f. 439.

¹²⁰⁰ Gerold Dommernuth – Gudrich, *Mitet*, Tiranë 2006, f. 226.

¹²⁰¹ Jano Koçi, *Himara – Kaonia*, Tiranë 2006, f. 30.

¹²⁰² Tetis (apo Tetida) ishte një nga hyjneshat e para që sipas legjendës i kishte dhënë jetë çdo gjëje që ekzistonte. Tetia përfaqësonte detin Mesdhe. Në shumë shkrime paraqitet si personifikim i detit.

¹²⁰³ Zecharia Sitchin, *Toka dhe njeriu, përmbytja e madhe*, Helgas's sekrets, Tiranë 2010, f. 69.

¹²⁰⁴ Guus Houtzager, *Ελληνική Μυθολογία*, Athinë 2004, f. 192.

Gjiri i Jonit, siç e ka vënë re edhe dijetari Hamond, ka qenë “rezistenca e Klas Kolpos dhe Kronios Pontos”, pra një lloj Olimpi detar, bota fillestare e ekzistencës mitologjike, e protohyjnine të mëdhenj të cilët i rrëzoi Zeusi. Në gjirin jonian duhet të dallojmë djepin më të vjetër mitologjik të kozmogonisë, të pashkëputur nga bota e detarëve të fiseve rreth tij dhe paraardhësve.¹²⁰⁵

Mendojmë se ndër kohëra do të ketë pasur një emërtesë konkrete edhe këtu në Breg për hyjninë e detit: 1. Sepse të tilla ekzistojnë në të gjitha hapësirat kufitare me Kaoninë, kështu që nuk kishte pse të bënte përjashtim ky vend. 2. Sepse deti, në vetvete, në Bregdet është konsideruar si hyjni dhe gjithmonë i janë adresuar lutje. Madje këtu deti shfaqet me një funksion të dyfishtë: edhe si hyjni, edhe si altar ku adhurohej e lutej. 3. Sepse Detit i është blatur (sipas të dhënave gojore) si në periudhat pagane, ashtu edhe në ato kristiane. Në periudhat pagane e më vonë flijonin njerëz, kryesisht fëmijë për të shpëtuar nga e keqja. Më vonë flijimi u zëvendësua nga qenie njerëzore, në ato shtazore, më vonë ushqimore. Një formë më e vonë blatimi ishte edhe nderzja e qiririt në det.¹²⁰⁶ 4. Ekzistencën e hyjnisë së detit në Kaoni e vërteton tërthorazi edhe një figurë mitologjike që quhet “Nëna e detit”, konceptimi popullor i së cilës paraqet ngjashmëri me perëndeshën e deteve oqeanëve, Tetis. Të “Përralla e djalit dhe e Kuçedrës”, thuhet: “Duke u kthyer për në shtëpi, me gëzim të madh për fitoren e madhe që pat, na ra në det dhe “Nëna e Detit” e hëngri”.¹²⁰⁷ 5. Ka shumë të ngjarë që në Bregdet pasardhësi më i vonë i hyjnisë së antropomorfizuar, si edhe në festat e tjera kalendarike, të jetë zëvendësuar nga shën Spiridhoni. Kjo është fare e natyrshme po të kemi parasysh se prej shekujsh banorët e kësaj treve janë ndodhur nën ndikimin e religjionit të krishterë të rritit ortodoks greko-bizantin.¹²⁰⁸

3. Ritet kushtuar kultit të detit

Pavarësisht që nuk kemi një emër të saktë të hyjnisë së detit në zonën e Bregdetit ekzistenca e kësaj hyjnie nuk është mohuar asnjëherë. Po kaq i sigurt është ruajtur edhe funksioni i tij themelor si mbrojtës i lundërtarëve. Jo pa qëllim në konceptimin popullor ky është atributi i tij kryesor. Lundërtarët, apo detarët ishin më në kontakt me detin. Ata ishin më të rrezikuar prej tij dhe ishin personat që i luteshin më shumë, bashkë me familjarët e tyre. Këtu shfaqet më i pranishëm edhe gërshetimi i elementit pagan me atë kristian.

Detarët, përpara çdo lëvizjeje, çdo daljeje në det, i luteshin detit: “Të lutemi i madhi Det, ndihna të na vejë lundrimi mbarë!”, “Të lutemi Baba Det, mos të ketë tallaz në det!”, “Zoti Det, i plotfuqishëm që na jep jetë e shpirt”. Po me kaq pathos i luteshin edhe Shën Spiridhoni të kasës dhe e shoqëronin me bërjen e kryqit. Ndërsa të afërmit e tyre luteshin: “O Shën Spiridhon, na i shpëto! Të venë shëndoshë e të kthehen shëndoshë!”¹²⁰⁹ Kur ishin në det në rrezik, detarët bregdetarë i drejtoheshin njëri – tjetrit: “Bëni kriq, kriqi ju ndihet”. Shpesh këtë ritual e shoqëronin me hedhjen e kryqit në det.¹²¹⁰ Hedhja e kryqit për të lehtësuar tallazet vdekjeprurëse është një mbivendosje kulturore. Konvergimin e simbolikës së kulteve pagane me simbolikën e kulteve kristiane e vemë re

¹²⁰⁵ Moikom Zeqo, *Motive arkeologjike*, Sh. B. “8 Nëntori”, Tiranë 1986, f. 147.

¹²⁰⁶ Arkivi vetjak i familjes Gjoni. Minella Gjoni, *Mite dhe rite të Bregut të Poshtëm*, Dorëshkrim 1988.

¹²⁰⁷ S. Th. Frashëri, *Folklori shqiptar*, Tiranë 1936, f. 245.

¹²⁰⁸ Anton Papeleka, *Deti dhe ulliri në traditën gojore të Bregut: Himara në shekuj*, Tiranë 2004, f. 442.

¹²⁰⁹ Arkivi vetjak i familjes Gjoni. Mblodhi Irena Gjoni nga Spiro Nasti 82 vjeç, Lukovë 2003.

¹²¹⁰ Arkivi vetjak i familjes Gjoni. Mblodhi Irena Gjoni nga Spiro Nasti 82 vjeç, Lukovë 2003.

jo vetëm në këtë rast, por edhe në shumë raste të tjera. Kur u vonoheshin njerëzit në detin me tallaz, gratë dilnin karshi Korfuzit, bënin kryq dhe luteshin: “Shpëtoma burrën e djalën, o Shën Spiridhon i kasës!” Dhe si shpërblim për shenjtërinë e tyre, Shën Spiridhonin, që i “ndihthe” (ndihmonte- dialektore –shën. im) dhe s’i braktiste kurrë, bregdetasit tradicionalisht më 12 dhjetor të çdo viti ua hipnin karaveve e shkonin në Manastirin e Shën Spiridhonit në Korfuz. E çanin detin më 12 dhjetor edhe në furtunë, vetëm e vetëm për të arritur tek fryma e shenjtë e Shën Spiridhonit. Kënga thotë: “O karav¹²¹¹ me derte shumë,/ Ku të zu ajo furtunë, Apo e bën maksus,¹²¹² / Të na nxjerrësh n’Othonus¹²¹³ / O ndë nisi në Korfuz?/ O kanal Korfu me shkumë, /Natën njomë e ti më shumë,/ Ule pak atë furtunë,/ Se na prishe shumë punë/ për Spiridhon do vete u’(unë).”¹²¹⁴

Faleshin e luteshin në kishën e Korfuzit duke qëndruar tërë natën jashtë, ndonëse në kohë shumë të ftohtë, në dhjetor. Besohej se shën Spiridhoni natën ngjallej e ditën futej në kasë, duke lënë këpucët jashtë kase, ndonëse zakonisht netët e tjera qëndronte buzë detit. Ndër dhuratat më të preferuara që njerëzit çonin te Shën Spiridhoni ishin këpucët.

Natën e shën Spiridhonit burra, gra e fëmijë që nuk shkonin dot në Korfuz, mblidheshin në sheshet e kishave e bënin një zjarr të madh. Djemtë i kapërcenin zjarret e shenjtë për të komunikuar me forcat e mbinatyrshme. Në këto zjarre piqnin kurbanët që kishin therur për Shën Spiridhonin.¹²¹⁵

Për të njëjtin moment, A. Papeleka përshkruan: “Natën e Shën Spiridhonit, djemtë mblidheshin grupe – grupe, ndiznin zjarre në rrugët e fshatit dhe një zjarr të madh në një kodrinë. Këtë të kremte banorët e krahinës hanin mish. Duke u nisur nga skenari i këtij riti, ku është i pranishëm edhe kulti i zjarrit, mund të them se duhet të ketë pasur ndonjë altar të thjeshtë në natyrë. Djemtë i kapërcenin zjarret për të komunikuar me forcat e mbinatyrshme e për t’u pajisur me cilësi të jashtëzakonshme. Ashtu si në kontekste të tjera, mishi që hahej natën e Shën Spiridhonit, ka qenë mbijetesë e flisë së qëmotshme që i bëhej hyjnisë së detit.”¹²¹⁶

Kaq i lidhur ka qenë shpirti i këtyre njerëzve me detin, sa kur ndodhte ndonjë fatkeqësi në krahinë, jo vetëm i luteshin detit, por flijonin dhe njerëz, kryesisht fëmijë, për të shpëtuar nga e keqja. Më vonë flijimi u zëvendësua nga qenie njerëzore me ato shtazore. Tregojnë në fshatin Nivicë Bubar: “Në stanin e një familjeje kishte rënë një sëmundje e rëndë, sa çdo ditë u ngordhnin 7-8 krerë bagëti. Thirrën meshtarin e fshatit. Ai iu lut detit në Grykën e Kakomesë. Të gjitha bagëtitë i spërkatën e i lanë me ujin e detit, si shpëtimtari i vetëm i fatkeqësisë. Flijuan 12 desh në det, duke vënë përpara Ungjillin e Manastirit të Kakomesë. Si për çudi, ngordhja u ndërpre. Të gjithë ia dedikuan këtë mirësi “Baba Detit”, “Zoti Det”, “Të madhit Det”.¹²¹⁷ Riti i flijimit, si njëri nga ritet më të vjeta të njerëzimit, shfaqet me një tipologji krejt të veçantë në Bregdet: ai nuk bëhet as në kala, as në kishë e as në urë (vendet tipike të hiperlandit ballkanik), por në det.

Kulti i detit është i lidhur edhe me kultin e blegtorisë e bollëkut në të. Kjo duket te vargjet e mëposhtme që këndohen në Nivicë – Bubar, stanet e të cilëve ishin karshi detit: “*Deti*

¹²¹¹ Anije.

¹²¹² Enkas, me qëllim

¹²¹³ Një nga ishujt e vegjël të Korfuzit përballë Himarës.

¹²¹⁴ Fane Veizi, *Bregu i detit në këngë*, Tiranë 1998, f. 106.

¹²¹⁵ Arkivi vetjak i familjes Gjoni. Mblodhi Irena Gjoni nga Dhespo Xhani 83 vjeç, Piqeras 1999.

¹²¹⁶ Anton Papeleka, *Himara në shekuj*, Tiranë 2004, f. 443.

¹²¹⁷ Mitro Papadhima, *Nga jetesa, zakonet dhe luftrat e niviciotëve*, Tiranë 2004, f. 82.

me ujë./ dubeku me qumësht./ Deti me valë./ dubeku me gjalpë./ Deti me hopa./ dubeku me topa.” Plakat e shtëpisë kur tundnin për herë të parë dubekun me qumështin e vitit, ktheheshin me fytyrë nga deti dhe thoshnin me zë të ulët vargjet e mësipërm. Pranë dubekut varnin një pasqyrë, një lëmshe leshi dhe një gur. Shtrohej bari i njomë poshtë dubekut dhe thuheshin vargjet: “Si deti në verë./ Si pasqira ndriftë./ Si lëmshe u mbështjellë./ Si guri u forcoftë./ Si lulja lulëzoftë./ si bari na bleroftë.” Në këtë mënyrë besohej se prodhimi blegtoral i atij viti do të ishte i mbarë.

4. Riti i prerjes së Sifonit

Për këto rite kemi të dhëna vetëm nga arkivi gojor, nga një dorëshkrim i Minella Gjonit Mite e rite në Bregdetin e Poshtëm dhe nga një material më specifik të studiuësit Anton Pappleka, të botuar tek *Himara në shekuj*. Ndër këta rite më interesantin kemi konsideruar ritin për prerjen e sifonit. Prandaj e pamë të arsyeshme që të japim një përmbledhje të këtij riti duke e analizuar.

Stihia është figurë mitike, karakteristike e Bregdetit të Jonit. Përfytyrohej si demon femër. Në besimin popullor shfaqet si një kuçedër me krahë, që nxjerr flakë nga goja dhe që ruan thesaret e fshehura nën dhe. Stihia, si demon femër, na paraqitet edhe te balada e Kostandinut dhe e Dhoqinës, e cila ruhet e pastërt në Vuno e Kudhës. Këtë e vërteton dhe profesor Eqrem Çabej në kujtimet e tij, kur tregon se këtë këngë ia kishte rrëfyer në origjinal një shoku i tij bashkëstudent nga Vunoi i Bregdetit në Vjenë të Austrisë: “*Ditën e Pashkës në drekë./ Seç u ther një ka në fshat./ Vajta e mora një okë mish./ Dhe e hodha në kusi./ Me vrap dolla në avlli./ Të marr një kërcu të zi./ Të më shfaqet një stih/, Kërcen brenda në kusi./ M’i helmoi djemtë e mi./ Nëntë djem e nëntë nuse./ Të nënta me djep në duar./ Nëntë djepe ç’ m’i përmbise./ Nëntë konake ç’ m’i zhurite...*”¹²¹⁸

Fjala stih, aq e përdorur në Bregdetin e Jonit, ka gjetur vend edhe tek kjo këngë baladë. Ekzistojnë disa rite për prerjen e sifonit. “Një ndër dukuritë meteorologjike më tipike dhe më mbresëlënëse të trevës së Bregdetit, ka qenë sifoni. Ai në kuptimin popullor është i shtrirë nga retë deri në det, thithte ujë nga deti, përpinte anijet, shkulte ullinjte. Sifoni zbriste nga reja lart, derisa futej në det. Populli mendon se kaq fuqi ka sifoni, sa nxjerr ullirin nga toka në Palasë dhe e shpie në Vuno. Po ta prisnin, nuk bënte dëm. Njerëzit nuk e dëshironin stihinë, por kur vinte ishën të detyruar ta përballonin. Bënin çdo lutje e veprim për ta ndaluar këtë fuqi të pallogaritur meteorologjike. Prerja e sifonit bëhej si nga ata që jetonin në tokë, ashtu edhe nga lundëtarët në det. Kryenin këtë rit: njerëzit merrnin një urë të ndezur dhe e hidhnin në oborr, duke belbëzuar gati si me vete. Atë e realizonin në formë dialogu. I pari thoshte: “Ç’pret aty?”. Tjetri i përgjigjej: “Pres sifonin”. Ky dialog përsëritej tri herë. Përdorimi i urës së zjarrit shpreh epërsinë e botës qiellore mbi botët e tjera, epërsinë e hyjnisë së Diellit mbi atë të Detit.

Në një trajtë tjetër që paraqet përparimin teknik të shoqërisë njerëzore, ura e zjarrit është zëvendësuar me armë zjarri. Kur vinte sifoni në drejtim të anijes e gjuanin me armë. Që të bënte kohë e mirë, qëllonin me armë në sy të resë që t’i pëlciste syri e të hapej koha.

Sipas Andrea Varfit (poet nga Qeparoi), për të prerë sifonin përdorej një brez i zi, i gjatë dhe i hollë. Kur e këputnin në mes këtë brez, pritej sifoni. Diku përdorej një tërkuzë e madhe e bardhë dhe, me të dalë sifoni, thoshin: “O burra, ta presim se do të na marrë!” Merrnin një kërcu, një tërkuzë të bardhë liri, të cilën e vendosnin mbi të dhe e mbanin nga skajet dy fëmijë. E ëma e fëmijëve thoshte: “Siç të pres unë tia, o tërkuzë, kështu u preftë

¹²¹⁸ Arsen Kabuci, *Kudhësi në këngë*, Tiranë 2002, f. 68.

sifoni!" Këto fjalë i përsëriste tri herë, pastaj gruaja qëllonte me sëpatë. Duhej që tërkuza të këputej me një të rënë të sëpatës. Po që se nuk pritej tërkuza me një të rënë, duhej të përsëritej tërë riti. Kjo tregonte se sifoni duhet të ishte shumë i fuqishëm. Ndodhte që sifoni pritej pa i bërë këto veprime. Atëherë thoshin: "Dikush e ka prerë". Sifoni këputej në mes, hollohej e ikte larg.

Veç tërkuzës, një mjet magjik i fuqishëm ishte thika me dorezë të zezë. Doreza duhej të ishte prej briri dhie, cjapi ose sorkadheje. Atë e mbante përpara në anije Karaviqeli (nostromi, drejtuesi i anijes), i cili shikonte nga vinte shtrëngata. Tehu i thikës mbështillej me lëkurë gjarpri e lule trëndeline. Trëndelina përdorej që të binte bunaca. Koncepti mbi forcën magjike të trëndelinës ndoshta buron në mendimin se ajo simbolizon motin e mirë kur i çelinulet. Ndikimet e krishterimit ishin më të dukshme te një trajtë tjetër e këtij riti, ku thika me dorezë të zezë, ngulej në mes të pendë allfës. Kur njeriu që e kryente këtë rit, ndodhej në shtëpi, ai dilte në dritare. Pendë allfa kishte këtë tekst:

"Më përpara ishte fjala/ fjala për perëndi/ dhe perëndia – fjala". Në trajtën më të thjeshtëzuar, këtij riti i ka mbetur vetëm teksti namatisës. Kur ndodheshin në det, për të prerë sifonin, lundëtarët thoshin: "Shpëtona, o zot nga një stuhi e madhe!" Me të thënë këto fjalë, sifoni këputej në mes".¹²¹⁹

Nga sa u tha më sipër, del në pah se ky është një rit me origjinë pagane. Shtresat e tjera kulturore kristiane janë mbivendosje të një kohe më të vonshme. Gjithë këto rite të ndjekura nga banorët e Bregut tregojnë për raportin e natyrshëm me detin, në breg të të cilit jetojnë dhe nga i cili kanë siguruar një pjesë shumë të madhe të të mirave materiale për jetesë. Njëherazi raportet e paqta me detin u janë dashur si nevojë mbijetese, pasi jetojnë në brigjet e tij. Deti ka shërbyer si mundësi kalimi nëpër vende të tjera të botës e shumë funksione të tjera utilitare jetësore.

Si përfundim, kulti i detit në Bregdetin Jonian ka një shtrirje shumë të madhe dhe është ndër kultet më të përhapura dhe më të pasura me rite dhe kanë një rëndësi shumë të madhe për mitologjinë shqiptare në përgjithësi. u përpoqem të dëshmojmë për ekzistimin e kultit të hyjnisë së tij në natyrë të hapët. Midis argumenteve që flasin në dobi të kësaj hipoteze janë edhe: (1) ekzistimi i emërimit të hyjnisë së tij te fqinjët; (2) funksioni i dyfishtë mitik i detit (si hyjni dhe si altar); (3) flijimet i bëhen (fillimisht në njerëz, pastaj në kafshë dhe në fund në ushqime); (4) përpjekja për personalizimin në kontekst të hyjnine të tjera mitike të arealit mitik bregdetar, si Baba Deti, Nëna Deti; (5) ngritja në kult e kishës së Shën Spiridhonit në Korfuz dhe vizita në të më 12 dhjetor.

Të gjitha këto shkojnë në dobi të tezës për ekzistimin e hyjnisë kontraverse shqiptare të detit, shumë të pranishëm në këtë zonë dhe në zonat e tjera shqiptare, i cili duhet të jetë një qenie e antropomorfizuar, që dallohet prej vendkulteve të tjera (si të krabinave të tjera shqiptare, ashtu dhe të popujve të tjerë) që bëhej në natyrë të hapur.

Recensentë

Prof. Dr Zeqirja Neziri

zeqirjaneziri@yahoo.com

Prof. Dr. Miaser Dibra

Drejtoreshë e Institutit Antropologjik

QSA Shqipëri

¹²¹⁹ Anton Papeleka, "Himara në shekuj", Tiranë 2004, f. 449.

BIBLIOGRAFIA

1. A.Papleka, *"Himara në shekuj"*, Tiranë 2004.
2. Kabuci, *Kudhësi në këngë*, Tiranë 2002.
3. F. Veizi, *Bregu i detit në këngë*, Tiranë 1998.
4. G. Dommernuth – Gudrich, *Mitet*, Tiranë 2006.
5. Houtzager, *Ελληνική Μυθολογία*, Athinë 2004.
6. J. Koçi, *Himara – Kaonia*, Tiranë 2006.
7. M. Zeqo, *Motive arkeologjike*, Sh. B. "8 Nëntori", Tiranë 1986.
8. Psilakis, *Κρητική Μυθολογία*, Ηρακλείο 1996.
9. S. Th. Frashëri, *Folklori shqiptar*, Tiranë 1936.
10. Z. Sitchin, *Toka dhe njeriu, përmytja e madhe*, Helgas's sekrets, Tiranë 2010.

DUKURI LEKSIKO-SEMANTIKE NË VEPRËN E MARTIN CAMAJT

Ma. Majlinda Bushaj

Martin Camaj është një nga shkrimtarët më të mëdhenj të letërsisë shqiptare i cili shquhet për kërkim e krijim gjuhësor, duke u dalluar për vlerat e prurjet e shumta. Ai zhvilloi veprimtari krijuese të shumanshme, si albanolog, si gjuhëtar e studiues i historisë së shkrimeve dhe letrave, si ligjërues i dijeve albanologjike, si poet e prozator. "I pajisur me një kulturë e formim filologjik Martin Camaj dha një shembull të shkëlqyer të bashkimit të punës së shkrimtarit e poetit krijues me atë të dijetarit të gjuhës.¹²²⁰ Camaj e studioi mekanizmin e gjuhës në planin diakronik dhe sinkronik. Studimet e tij në fushën e gjuhës së sotme dhe asaj historike, e ndihmojnë autorin në përzgjedhjen e leksikut të veprës së vet letrare. Vepra e Camajt sjell leksik nga thellësitë e shekujve e nga shek. XX, nga mjedisi mbarëshqiptar e nga ai arbëresh.

Vepra e tij dallohet për pasurinë e madhe leksikore e cila nuk është bërë objekt i ndonjë studimi të veçantë¹²²¹. Gjuha e tij është vetë shqipja, me të gjithë bukuritë, mundësitë e aftësitë shprehëse të pafundme. Camaj e mori brumin gjuhësor të vendlindjes, e përdori mjeshhtërisht, e pasuroi me fjalë e shprehje, e pasuroi me nuanca kuptimore dhe e risemantizoi një pjesë të madhe të leksikut. Objekt i këtij studimi është prurja e vlerave të fjalës në korpusin krijues të tij.

Leksiku i veprës së tij mund të kundrohet në disa prerje. Camaj shquhet për njohjen e thellë të pasurisë leksikore e semantike të shqipes dhe ai jo vetëm e përdori fjalën shqipe zotësisht, por edhe ripërtëriu pasurinë e madhe që jetonte në vereperendim të vendit. Ndaj fjalori i veprës së tij përbëhet nga dy grupe të mëdha njësisish: Nga leksiku i gjuhës amtare dhe nga leksiku i krijuar nga vetë Camaj. Brenda fjalësit gjejmë fjalë të ringjallura nga autorët e vjetër, fjalë mbarëshqiptare, fjalë krahinore. Të rëndësishme paraqiten kuptimet e reja që janë të shumta. Natyra e veçantë dhe specifike, buron nga gjuha e

¹²²⁰ Kolec Topalli, Albanologu i shquar Martin Camaj në 85-vjetorin e lindjes, Studime filologjike, 3-4, 2010.

¹²²¹ Veçojmë këtu: Valter Memisha, *Martin Camaj dhe leksiku i munguar*, kumtesë në Konferencën Ndërkombëtare për Martin Camajn, Tiranë, 24 shtator 2010, botuar në *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011; T. Osmani, *Çështje të leksikut dhe të fjalëformimit në faqet e një reviste*, në *Gjuha dhe shkrimtari*, Shkodër, 2001; D. Luka, *Ndihmesa e Fishtës, Koliqit dhe Camajt për pasurimin e leksikut të gjuhës letrare shqipe*, "Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare" XXII/I, Prishtinë, 2004. D. Luka, *Martin Camaj-Mjeshtër i fjalës shqipe*, kumtesë në Konferencën shkencore "Martin Camaj në kulturën shqiptare", mbajtur në Tiranë me rastin e 85 vjetorit të lindjes, nga Qendra e Studimeve Albanologjike (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë), më 24 shtator 2010, botuar në *Studime gjuhësore XIII*, Shkodër, 2011.

përdorur prej tij. Gjuha poetike, e poezisë, por edhe e prozës dhe studimeve gjuhësore dhe letrare është gegërishtja letrare.

Një fushë konceptore leksiko-semantike e konceptuar me shumë nënfusha e mikrofusha, e formojnë fjalët me kuptim të drejtpërdrejtë, me kuptimin konkret, të cilat sjellin përmes ndërtimit mjeshtëror artistik, shtëpinë, kopshtin, fushën malin, grykat, lumin, përroin, gjithë mjedisin nga poeti vjen, mjedisin mbarëshqiptar.

I. Leksiku i të folmes së Dukagjinit

Vepra e Camajt konsiderohet si “ dëshmi e e gjallë e njohjes së thellë të thesarit popullor dhe punës së tij të pareshtur në lëmin e gjuhës.”¹²²² Shkrimtari gjendet tërësisht në kurthin e kujtimeve të fëmijërisë e të rinisë dhe të atij atdheu shpirtëror që mori me vete, për të mos e parë më kurrë. Lumi i madh Drini, katundet e ngritura në shkëmbinjtë pranë theqafjeve të tij, janë emra orientues në tërë prozën e tij. Kështu, majet e thepisura, krojet, lugina e lumit, shkurret apo lisat që bëhen pjesë e veprës së Camajt. Në vepër toponimet janë të shumta dhe mbizotërojnë ato të Dukagjinit si: familja e **Pukajve** (Shkundullima, f.7); **Gurra** (Shkundullima, f. 8); **Fundinë** (Shkundullima, f. 9); **Maja e Çilkokut** (Shkundullima, f. 11); shkambi i **Çilkokut** (Shkundullima, f. 42); **lumin e Vilës** (Shkundullima, f.11); **katundi i Vilës** (Shkundullima, f. 11); **Kroni i Vjetër** (Shkundullima, f.86); **Shkorreti** (Shkundullima, f. 114); **Përroin i Thatë** (Shkundullima, f.114); **Përtejçafës** (Shkundullima, f.128); **Përroin të Mbyllë** (Shkundullima, f. 237); **Shtëpinë e Pemëve të thata** (Karpa, f. 19); **Ara e Keqe** (Rrathë, f. 133); **Kapërcelli** (Rrathë, f. 190); **Suka e Poshtme** (Rrathë, f. 91); **Cukal** (Dranja, f. 7); **Qeta e Berishës** (Dranja, f.12); lumi i **Kirit** (Dranja, f.13) **rrafshi i Dukagjinit** (Dranja, f. 24); **Malin e Shejtë** (Dranja, f.44); **Trush** (Dranja, f.48); **kodrat e Rrencit** (Dranja, f.51); **Përroi i paemën** (Dranja, f.53); **Ndërsana** (Djella, Vepra I, f.107); **Udha e Breshkave** (Dranja, f. 56); **Ara e Keqe** (Rrathë, f. 133); **Kodra e Hardhisë** (Martin Camaj, Djella, Vepra I, f. 133); **Curri i Kingjave** (Karpa, f. 87); **Guri i Korbit** (Karpa, f. 114); **Sharra** (Karpa, f. 52); etj.

Edhe kur ngjarjet vendosen formalisht në mjedise të tjera, si ato të novelës “Shkundullima” në të cilën personazhet dhe dhe subjekti vendosen në një fshat arbëresh, prapëseprapë nën njerëzit e mjediset, që autori përshkruan zbulohen malësia dhe malësori. Në gojën e personazheve autori vë fjalë të vjetra të krahinës, por të përdorura me një saktësi të habitshme e me një kuptim që nuk lë shteg për dyshime a dyzime. Këto fjalë shërbejnë për të kontrolluar fjalorët që në mjaft raste nuk e japin kuptimin e saktë. Khs. Shqimth “zbokth”(Fjalor 2006, f.1047) me shqimth “pragu i derës; një gur i gjatë, sa gjerësia e derës, por edhe një copë trau, që vendoset në hyrje të derës”: *I tha se hymja në qendër do të zvarritej e çka ashtë ma keq vështirë se do të vendosej ndokush t'i shkelë në shqimth të derës një i koboja si Voni pse asnjë familje si kush nuk paska vajzë për të.* (Karpa, f. 21).

Në veprën e tij ndeshim mjaft fjalë e shprehje të rralla të vendlindjes së tij Dukagjinit nga të cilat mund të vëmë në dukje: **biçak** “thikë e vogël”; **cik** “hirrë që lëshon kosi ose djathi i njomë”; **galuc** “galiç, me gjunjë të përkulur e duke u mbështetur mbi themra, në bisht”;

¹²²² Kolec Topalli, *Vepra e Martin Camajt në aspektin gjuhësor, Martin Camaj. Tradita dhe bashkëkohësia, Shkodër, 1994, f. 86.*

kajat “kasolle e vjetër”; **katua** “bodrum, pjesa e shtëpisë ku mbahet bagëti”; **lëpizë** “sergjen anëve të murit, dy dërrasa të vendosura pingul (nga gjerësia) me njëra tjetrën, njëra prej të cilave më e gjerë, që vendoset në lartësinë e trupit të njeriut në një rënë anë të murit ose të zdathut (pjesës prej dërrase që zëvendëson murin) ku fshatari vendoste enët e guzhinës, por edhe gjëra të tjera”; **ndulkun (të)** “të pjekur”; **plajtë(e)** “e sheshtë”; **shmirjak** “shok bjeshke ndër kullosa; ato që dalin bashkë në të njëjtin vend për të kullotur bagëtinë”; **rangët** “punët ose shërbimi i grues mbrendë, në shtëpi; punë në përgjithësi”; **tëlyen** “gjalpë”; **shtalp** “i njomë, i papjekun”; **vrrri** “kullotë në vende të ngrohta, vend dimnimi”; **lëpozë** “një lloj trine që në shtëpitë fshatare zë vendin e tavanit”; **cekë** “me vendosë”; **curak** “lakuriq”; **hajm** “i thatë”; **blegë** “bareshë”; **lëndurun** “i plagosur”; **lëmekun** “e këputun”; **kizë** “thikë e madhe në formë drapri”; **lugajë** “luginë e madhe”; **pagjë** “paqe”; **palare** “dërrasë e lëmuar ku hollojnë petët”; **plojë** “një llojë vathi bagëtish”; **rogë** “lëndinë mes pyllit”; **buzanë** “pjesë e dalë në qoshen e faqes së shtëpisë”; **cakël** “sende të vogla, gjithsesi pa ndonjë vlerë të madhe”; **cohë** “veshje”; **djegë** “dëshirë e zjarrrë”; **kashetë** “arkëz”; **i këllatun** “i mbërthyer”; **lukth** “stomak”; **ndragë** “me u fëlliqun”; **ndinollë** “shtyllë mbajtëse”; **shokë** “brez”; **taroç** “mëzat”; **tejzë** “gjalme”; **zdatk** “mur i hollë me dërrasa që ndan më dysh një odë”; **çuklajë** “grumbull kodrash”; **cik** “hirrë që lëshon kosi ose djathi i njomë; **hajat** “kati i parë i shtëpive të vjetra, i cili lihej bosh dhe shërbente për të mbledhur e mbajtur sende të ndryshme që i nevojiteshin shtëpisë; ahër, haur” **nusak** “dhëndërr”; **gjalmise** “lidhëse”; **i ajhtë** “i hequr, i dobët”; **i cokatun** “i mangut nga mendja”; **gunë** “pelerinë e trashë leshi me kapuç që hidhet krahëve në dimër”; **kithi** “tërthorazi”; **muranë** “grumbull gurësh, rënoje”; **picak** “lakuriq”; **rizë** “lloj peshqiri që e vendosnin gratë në kokë në rast zie”; **shputë** “çorap i shkurtër nga syri i këmbës e poshtë”; **shekë** “enë e drunjtë për djathë”; **strugë** “batanije që hidhet krahëve ose shtrohet për të ndenjur”; **kaçinë, kallcë, shkandull, dangë, zgurë, sendgja, shqitëz, gërlac, gopç, neth, terramot, rrëfanzë, shqekë, krekcare, strukshëm, mis, ngatërr, nergut, zhaurime, syzoj, zbruj, spetull, thrap, i lëbyrët, lëpushtër, kaploj, e lëkuqme, i thukët, etj.** Këto fjalë e shumë të tjera Camaj i mori nga e folmja e Dukagjinit, duke e mbajtur të gjallë kontaktin me vendin e tij, me gjuhën e vendlindjes.

II. Leksiku i të folmes veriperendimore me funksion stilistik.

Vlera të qenësishme bart fjalë në veprën e tij kur ajo kalon nga rrafshi i drejtpërdrejtë emërtues, në atë të figurshëm. Përjetimet tashmë zëvendësohen nga abstraksioni, zhdërvjelltësia, variacioni, shumëfishimi i lidhjeve sintagmatike e i asosacioneve. Duke ndjekur traditën e paraardhësve Camaj ka një qëndrim aktiv ndaj leksikut u vesh fjalëve vlera të reja shprehëse dhe na jep me dorë të mbarë e të sigurtë në krijimin e mjaft fjalëve. Valter Memisha vë në dukje se “...në prozën e Camajt, ndër të tjera merr jetë jo vetëm fjalë shqipe e ajo gegë, por edhe shumë fjalë të reja, të krijuara prej tij sipas gjedheve të shqipes që përbëjnë një pasurim horizontal të fjalorit mbarëkombëtar.”¹²²³

Camaj u jep kuptime të reja, shpeshherë edhe të figurshme fjalëve të rralla duke i bërë të përdorshme edhe për gjuhën shqipe. Me interes paraqitet ndjekja e fjalëve me kuptime të dyta, në disa sintagma të veçanta: Fjalën **çengel** e ndeshim në Fjalor 2006, f. 151 me kuptimin “grep hekuri për të varur a për të kapur diçka; kanxhë gremç,” te Camaj fjalë merr kuptim të ri “i fortë, i fuqishëm” p.sh. *Duert e tija çengela i ndiente si me qenë të ngrimë në krahë.* (Djella, f.70).

¹²²³ Valter Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011 f.102.

Fjala **kreckë** ka kuptimin “dru i vendeve të ngrohta, i ngjashëm me panjën” *Tue u përshkue nëpër strofullin e dhelpnave i kujtohej se ishte mbajtë për degë të një krecke, shej i pa fare vlere sepse krejt buzat e Drinit në atë rrethinë ishin të veshuna në lisa kreckash që lishin marrë me u ngjethë njena pas tjetrës përlyeshëm.* (Karpa, f. 156). Camaj përdor edhe **kreckare** “e hijshme, krenare” *Shiko tha ky me vete, si ec tue herë në një krah, herë në tjetrin me lëvizje aspak kreckare, pa ia vu se ku po i bie kamba ashtu si i ka hije një vajze të pakeq që ende se di se ka një korp për martesë.* (Karpa, f. 20.)

Lema (fjala) **ndeshtrashe** nuk pasqyrohet në fjalorin e vitit 1980, atë e ndeshim të shpjeguar nga T. Osmani me të njëjtin kuptim si e ka përdorur Camaj “ndodhi a ngjarje e paparashikuar në jetë.¹²²⁴ Kuptimi i figurshëm i kësaj lekseme është rreziqe, peripeci, vuajtje, ndodhi të jetës. P.sh. *Frymor i ndërmjemë mes sisorëve e atyne që pjellin vezë, di të ngrehet rrëshqanë e të çohet më të katrat për t’iu shmangë ndeshtrashes së zezë.* (Dranja, f.31). Fjala **kulaç** “bukë e ngjeshur, zakonisht e rrumbullakët, e zënë pa tharm, që piqet në saç, në shpuzë a furrë”. Te Camaj fjala merr kuptim të figurshëm “me trup të mbështjellë rrumbullak; *Grumbull, kruspull*”. Ishte mbledhur rreth vetes gati për të sulmuar. *Uli konopin teposhtë i cili u suell kular para derës së strofullit tue trajtue një kulaç gjarpni...* (Karpa, f.121).

Fjalën **arneni** (sh. arnej-të) e ndeshim në Fjalorin 1980 me kuptimin lloj pishe, Camaj jep trajtën e saktë **arnyell**, këtu fjala është përdorur në kuptimin e veçantisë, pa arnej të tjerë pranë, pa njëzëz të tjerë nga vëllezërit apo nga fisi. E.g. *Kola, fjalëmbare e i kuptueshëm, don me thanë, prorre gati për t’u bindë e pranue çdo pikëpamje të huej e cila s’i sillte atij dam, e quente Nikën arnyell i vetmuem mes ashtës, pa arnej të tjerë pranë.* (Shkundullima, f. 23).

Fjalën **të kokërrueme** e ndeshim në Fjalorin 2006, f. 473 me kuptimin “e bëj një lëndë kokrra kokrra” te Camaj e përdorur për shtëpi që janë larg njëra tjetrës. E.g. *Edhe në shekullin e kaluem, si sot e kësaj dite, thashethanat nuk kishin qenë të çrranjosura prej gojës së gjindjes të këtyne viseve me lagje e shtëpi të kokërrueme brinjash e luginash sit ë kishite qenë secila sosh dikur farë e hjedhun prej një grushti e ma vonë të ishin rritë të mëdha aq sa ishin.* (Shkundullima, f. 13).

Këto kuptime të reja për leksikografinë janë mjaft të rëndësishme dhe në veprën e Camajt janë të shumta: *Kjo djegë, thoshin ata, me shndërrue kulm e themel dhenë nuk ishte diktue në asnjë mërgimtar vendës që vinte me kalue një javë apo një muej në katundin e vjetër.* (Shkundullima, f. 80); *Punët e mbara nuk duhet me i ditë ashtu për majesh, por donë gdhendë në tru.* (Shkundullima, f. 49); *Por gjithë këto rrethana nuk e lirojnë breshkën prej zanit të keq si parasite, e për ma tepër dritë-shkurtë dhe e lanun mbas dore gjithesë.* (Dranja, f. 9). *Mbasi të jesh vrojtë mirë, peshoje në mendën e në zemrën tande, a të duket fare e natyrshme me e përppjekë shtatin e picakët për parzmin tim!.* (Shkundullima, f. 147); *Nika tue folë për të shoqen, i shkokërronte fjalët shijueshëm.* (Shkundullima, f.25); *Si vajzë që rritej shpejt, dhe shpejt që don me i qit fat vetes e me dalë nuse, ajo më lëshoi një shikim të shkrihtë.* (Dranja, f. 30); *Shtegtarët e Ripës së Mesme e të Epër ishin përngut e theknin hapin për të dalë në krye të vargut për të mbërritë pa çelë drita në shtëpi që e kishin ma larg.* (Rrathë, f. 83), etj. Këto kuptime të dyta, herë të drejtëpërdrejta e herë të figurshme, të përdorura

¹²²⁴ Tomor Osmani, *Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor II*, Shkodër, 2007, f.113.

me vend e me shumë finesë, pasurojnë vargun e bashkë me të edhe gjuhën shqipe, duke sjellë një ndihmesë të dukshme në këtë drejtim.

III. Leksiku historik.

Leksiku i veprës së tij mund të gjurmohet edhe në rrafshin historik pasi dihet se gjuha e autorëve qëndron shumë afër gjuhës së popullit në atë kohë. Çabej shkruan: “Me rëndësi të veçantë për gjeografinë dialektore janë në këtë mes disa përkime që vihen re ndërmjet gegërishtes veriore e përmendoreve të vjetra të shkrimit të saj”¹²²⁵

Nuk po flasim për pasurinë e madhe leksikore të veprave të autorëve të vjetër dhe të gjuhës së sotme në përgjithësi, sepse ato kanë një shtresë të përbashkët. Këtu vihen në dukje ajo pjesë e leksikut që paraqet interes të posaçëm gjuhësor nga trajta dhe nga kuptimi, për natyrën dhe përdorimin e saj të kufizuar në fjalorët e shqipes, ndërsa në rrafshin e gjuhës letrare, njihet pak ose nuk njihet fare, ndërkohë që njohja e saj do të ishte me vlerë në më shumë se një vështrim.

Camaj ringjall e fut në përdorim ndonjë fjalë nga autorët e vjetër të shqipes si p.sh. i **parilemë** “Ndonëse i **parilemë**, gjyshe e kish lanë me gojë që Katallani mos të emnohej kurrë kryetar i Karpës; edhe sikur ai të ishte caktue i parë në Qytezë, katallani s’do kishte dalë as në derë pa pyetë të motrën.” (Karpa, f. 79). Kjo fjalë është marrë nga Buzuku i *parilenë*, lat. *primogenitus*, me të njëjtin kuptim; **parzëm** “gjoks, krahor” p.sh. *Ishte ajo një lloj ngrohtësie që vjen mbas dimnit, e lehtë nxemje që niset prej prushit të vorfës nëpër shputët e leshta, lagë e ndragë në borë e akull, e depërton deri tek kamba e mardhun dhe ngadalë me qindresë i ngjitet korpit dhe zen vend në parzëm.* (Shkundullima, f. 119). Ndeshet te Buzuku në shumë “...mbë **parmëzatë** e ndër dy krahët”(XXV, 2b); “tue i dëlirunë **parmëzatë**” (XXIV, 2b). Kjo fjalë edhe pse është pasqyruar në FGJSSH (parzëm) është e rrallë në përdorimin e përditshëm¹²²⁶; **fogacë**, Buzuku “e ta hanë me bukë **fogace** e me sanëp që anshtë i fortë” (Meshari II, f.221, LVIII/1)¹²²⁷.

Autorët e vjetër e kanë fjalën **kurt**-ja “hajat, tremë”, p.sh. *tek kurtja e të parit; ndër kurt të t parët priftënet* (Buzuku, LXIV, 2a, LXIII, 2b); *e bane me shtimë ndër gropë o kurtë të luanjët, ishte aty kurti i popullit* (Bogdani, III, IX,6,II, III, 13). Tek Camaj ndeshim: *Dhandri i Karpës s’i dinte shteg vetes para riprodhimit të së kaluemes në Kurtin e Pemëve të thata* (Karpa, f. 26). **i përvutë** -fjalë nga Bogdani¹²²⁸ e ndeshim te Camaj .. e sjellja e **përvujtë** e ndeja e tij e tij në shkamb... (Lirika, f. 12). etj.

IV. Leksiku vetjak i Camajt.

Martin Camaj krijoi mjaft fjalë, disa u bënë pronë e fjalorit aktiv të gjuhës shqipe, disa jo. Ai u mbështet kryesisht në modelet e gjuhës popullore dhe shfrytëzoi ato elemente, që janë prodhimtare në gjuhën e sotme. Nga këto krijime mbizotërojnë fjalët e prejardhura me parashtesa, prapashtesa. Si p.sh. **pambërritshëm** (i) “që nuk mbërrihet, që nuk arrihet dot”; **papashëm** (i) “që nuk shihet që është i padukshëm”; **përbotun** (i) “i ndotur me bot” (Bot-ë-a “një lloj dheu me ngjyrë të kafe që përdoret për ndërtimin e qypave prej

¹²²⁵E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes* I, 1982, f.49.

¹²²⁶ Shih. Fran Luli, *Fjalë të rralla që hasen qysh tek autorët e vjetër*, Gjuha jonë, 1/1991, f.71-77.

¹²²⁷ Shih. D. Luka, *Vëzhgime, kërkime dhe studime në lëmin e gjuhës shqipe*, Studime gjuhësore XV, Shkodër, 2013 f. 69 v.

¹²²⁸ Shih, Ina Arapi, *Tipat strukturorë të mbiemrave në veprën “Çeta e profetëve” të Pjetër Bogdanit*, SF 1/1990 f.41-56.

balte). Këtë fjalë Camaj e krijon në analogji me fjalën **përbaltem** të cilën e ndeshim edhe në *Fjalorin* 1980 me kuptimin “bëhem me baltë ndotem, fëlliqem”; p.sh. *Tue u ulë te kasolla, u ndalën te uji i lagësniës dhe ia dliirën gojën e duert që të mos e shihite e ama, Lena, ashtu të përbotun.* (Shkundullima, f.67); **përngeshëm (i)** “që ka punë, pak që ka nge”; **përnjësue (me)** “barazoj” *Dhe përnjisobem me gurt e rrenojeve/të harrueme...* (Lirika, f.32); **përdhimituen(i)** “i ngushtëlluan”; **përfrigueshëm** “që është tepër i frikshëm; i frikshëm në shkallën sipërore”; **përlëvdoj** “e lavdëroj tepër”; **përmaje** “plot”; **përtrollazi** “përtokë”, etj. Fjalët kompozita zënë një vend të rëndësishëm në këtë leksik me fjalët përcaktuese me strukturat emër+emër, emër+mbiemër, emër+pjesore etj: **bakëqij**, **mbushmendje**, **mrekullbamëse**, **largushtues**, **gjithçkafja**, **kripëbardhë**, **keqvojtun**, **kryekërcyem**, **buzëshpërvjelun**, **gojëleshuem**, etj. Fjalën **lukshtjerrë**, që do të thotë grua që nuk lind; që është me luk të shtjerrë; me luk të shqyer” e ndërton në mënyrë të përkryer si kompozitë ekzocentrike me vlerë pronësore brenda strukturës së gjuhës shqipe, duke dhënë një fjalë të re që nuk e ka fjalori i 1980. P.sh. **luk-shtjerrë** *Duhet ta marri vesh malësia, kishte thanë në vete Lena, se unë nuk jam luk-shtjerrë si Zanat, unë jam dikush tjetër.* (Shkundullima, f.28). Kjo fjalë krahasohet me bahuverhit indoevropiane¹²²⁹. Mbiemri /i/ **prishakandun** ndërtohet mbi bazën e **mirakande** të cilën megjithëse gegizëm e pastër, e ka pranuar edhe *Fjalori* i vitit 1980. Si fjalë vetjake të Camajt mund të rendisim a to fjalë që nuk i kanë fjalorët e gjuhës por egziston mundësia që ndonjëra prej tyre të gjallojë në gjuhën e popullit, ose të paraardhësve si: **malemal** *Simbas tregimit të Nikës, nganjëherë, lumi i Vilës ishte i rritun malemal.* (Shkundullima, f..50). Këtë fjalë Luka e vështron si krijim të Camajt malemal “që është shtrirë nga njëri mal tek tjetri; që është i ngritur nga njëri mal tek tjetri” nga mal e mal.¹²³⁰; **lëkurëremët** “ai që e ka lëkurën me ngjyrë të murrme”, etj.

Si prirje të prozës së Camajt në romanet e fundit vihet në dukje dukuria e sintetizimit leksikor. Në shumicën e përftesave të këtij autori vërehet prirja për të kaluar nga forma analitike në forma sintetike. Formimet me **-shëm** dalin edhe si mbiemra edhe si ndajfolje. “*Ato janë nga më të goditurat dhe me vlera të gjithanshme: shënuesë shprehëse etj..duke treguar dhe një herë veçantinë e gegërishtes në këtë tip fjalë formimi.*”¹²³¹ Ndeshim shumë njësi leksikore me prapashitesën **-shëm**, që në veprat e tij kanë përdorim të dendur: **Shkoqitshëm**, **zhgrehshëm**, **përngeshëm**, **ngathshëm**, **kërratshëm**, **këndellshëm**, **bastardhueshëm** etj. Kjo përfshin jo vetëm formimet e reja të tij, por edhe ato që gjuha i njej prej kohësh duke krijuar mjete fjalëformuese më shprehëse, si **ngulshëm**, **këmbëngulshëm**, **rrokshëm** etj.

Ashtu si krijues i madh edhe Camaj kur shkruan, krahas synimeve të veta mirëfilli letrare, ka gjithnjë edhe mëtimet gjuhësore, të cilat shfaqen jo vetëm në punën gjuhëpasuruese e gjuhëpastruese, po edhe në përzgjedhjen apo parapëlqimin që shfaq ai ndaj kategorive të ndryshme të fjalëve apo mjeteve fjalëformuese.

Në veprat e Camajt ndeshim një sasi mjaft të konsiderueshme fjalësh, të cilat ai i përdor për të mënjeluar fjalët e huaja përkatëse. Mjaft prej krijimeve gjuhësore mund të përdoren me sukses krahas mjaft sinonimeve, fjalë të huazuara, me prirje për t’i nxjerrë ato jashtë përdorimit. Gjithashtu Camaj se për ruajtjen e pastërtisë së gjuhës krahas krijimeve të tij

¹²²⁹Shih.D. Luka, Studime gjuhësore XIII, Shkodër, 2011, f.186.

¹²³⁰Po aty, f. 196.

¹²³¹Valter Memisha, Studime për fjalën shqipe, Tiranë, 2011, f. 111.

që janë kryesisht semantike, përdor fjalë të shqipes së përbashkët ose të leksikut dialektor e krahinor, fjalë të krijuara nga shkrimtarë të mëparshëm etj. Kështu, **ngallënjehem** përdoret në vend të **entuziazmohem**: *Për njerëzit që ngadhënjehen nga flija njerëzore, në anë tjetër, gjàja mà e panatyrshme në jetë është vetëvrasja.* (Djella, f. 138); emri **barnatar** përdoret në vend të farmacist; p.sh. *Voni, për shembull, ishte barnatar, zeje ma e çmueshme se ajo e mjekut!*(Karpa, f.5); **syzë** në vend të **sirtar**: *Dora e tij biluri ose shtrat marimange u suell si gaforre nëpër një turrë letrash të përzieme në syzën e tryezës dhe nxori një fletë ku lexohej kjo poezi që zë vendin e parë në një varg vjershash të mia që due me t'i lexue sonte e me të tregue si ato dolën në dritë:* (Djella, f. 33); ndajfolja **deshtas**, si fjalë shqipe nga rrënjë foljore përdoret në vend të huazimeve enkas, kastile, e postafat; *Por ky doli i terun, arrë (kur e hoq mantelin!) shëndosh e mirë dhe shkeli në dheun e Karpës ku e priste një jetë e vështirë sa që shpesh ma vonë do t'i shkojë mendja se do kishte ba ma mirë sikur deshtas të ishte mbytë në lumë.* (Karpa, f. 7); **erëtim në** vend të aromë: *Në shtëpinë e lashtë e të lëshueme/erëtim ngjyre rraqesh të përmykuna* (Poesie, f.128); **tytësi** "vend i zbrazët që vjen si gyp, grykë, zgavër" në vend të **boshllëk**: *Fjalët shterpa kumbonin fort bukur në tytësinë e hapësinës rreth pishinës.* (Karpa, f.50);

Huazimin e vjetër nga turqishtja *tamam* Camaj e zëvendëson pothuajse në të gjitha romanet e tij me fjalën **shì** të dialektit të veriut. P.sh. *Tue dalë në punë katundësit, ata ma të vjetrit, këqyrnin në brijën e malit: secili dinte se kur reja ulet e mbulon timba e curra, shi aty në gjysmën e brijës, si hi i hedhun me grusht prej së naltit, jo atë ditë, por të nesërmen do të binte shi.*(Shkundullima, f. 113); **Shì** te kambët e përmendores... (Poesie, f.72); **rrokaqiej** në vend të grataçiel: *Në nadie rá dielli e zbeu/faqet e rrokaqiellëve.* (Gedichte, f. 40); **qafzëzë** në vend të **jakë**: *Ia ka ngjitë thojtë në fyt dhe kam pa si Cubit i plasi giaku për qafzës të këmishës.* (Djella, f.131); **bujtë** në vend të akomodim: p.sh. *Mbas çka u tha, kjo borë ende nuk e paska ngulë kambën në tokë andaj ashtë si ai miku i largët që përhubet dikund një natë e të nesërmen ulet teposhtë brijave e bie në lumë ...po due me thanë bora.* (Shkundullima, f.161); **i njëmendë** në vend të **real**: *Deshi me thanë edhe se ai fliste mbi vetje të njimendta.* (Rrathë, f. 160); **mallëngjyeshëm** në vend të emocionalisht: *Ashtë një lloj majë undyre dhe sytë në të lëvizin shlrshëm dhe shkëlqejnë hijshëm e mallëngjyeshëm si me qenë të mbushun me ndiesi bujare.* (Djella, f. 93); fjalën **katastrof/ë-a**, ai e zëvendëson me fjalën e bukur shqipe të dialektit geg **zezon/ë/a**: *Shkundullima paska dalë prej detit e qenkej për udhë me ardhë e me ba zezonën në njerëz e sende.*(Shkundullima, f.116); **njinjishëm** në vend të identik: *Vëreja këtij guri çukëzat e njinjishëm ku kanë ra me të njëjtën forë qinda e mija maje kepush!* (Rrathë, f. 93); **ndëgjojse** në vend të **receptor** (doreza e telefonit): *Këtu në park përballë, në ora tetë e gjysmë!"Urdhnoi Përgjegjësi e uli ndëgjojësen e telefonit pa përshëndetje.*(Rrathë, f.52); **mbërrelë** në vend të **çadrër**: *Ai në të vënte mbërrelën dhe shkopin me shkrojla të gdhenduna me brisk prej ndoj bariu me dorë të sigurtë mjeshtri të përngeshëm.* (Rrathë, f. 9); **tejzat** në vend të kordat; etj.

Vepra e M. Camajt është shprehja më e fuqishme e vlerave gjuhësore të shqipes, e mundësive të pakufizuara shprehëse e pasurisë, e gjallërisë dhe e forcës së magjishme të fjalës. Në vepër pas çdo fjale e shprehjeje ndihet pena e një mjeshtri të fjalës që e kërkon e zgjedh me mprehtësi të rrallë, me një vlerësim njëherësh shkencor e letrar të lëndës gjuhësore.

Bibliografi e shfrytëzuar

- E. Çabej, *Për pastërtinë e gjuhës*, në "Gjuha jonë"1, 1981, f.36-47.
- D. Luka, *Studime gjuhësore VIII*, Shkodër, 2003.
- D. Luka, *Studime gjuhësore XIII*, Shkodër, 2011.
- D. Luka, *Studime gjuhësore XIV*, Shkodër, 2012.
- *Dialektologjia e gjuhës shqipe*, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, Tiranë, 1971-2005.
- *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë 1954.
- *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 1980.
- *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 2002.
- *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.
- F. Luli, *Fjalë të rralla që hasen qysh tek autorët e vjetër*, Gjuha jonë 1/1991, f. 71-77.
- *Martin Camaj- Tradita dhe bashkohësia*, Shkodër, 1994.
- *Martin Camaj për kulturën shqiptare-Shkrimtari dhe albanologu*, Studime shqiptare 17, Shkodër, 2011.
- N. Gazulli, *Fjalori i Gazullit*, Tiranë, 2010.
- T. Osmani, *Çështje të leksikut dhe të fjalëformimit në faqet e një reviste*, në Gjuha dhe shkrimtari, Shkodër, 2001.
- T. Osmani, *Martin Camaj dhe vepra e tij gjuhësore*, Gjuha Jonë, 1-2 /2000, f. 107-113.
- V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011.

Letërsi e vjelë:

1. Martin Camaj, *Rrathë*, Munchen, 1978.
2. Martin Camaj, *Karpa*, Roma, 1987.
3. Martin Camaj, *Shkundullima* (Proza) Roma, 1981.
4. Martin Camaj, *Dranja madrigale, mbi fatin e një frymori të papërsosun*, Roma, 1981.
5. Martin Camaj, *Djella, Vepra I*, Onufri, Tiranë, 2010.
6. Martin Camaj, *Gedichte* München: Kyrill &Method Verlag, 1991.
7. Martin Camaj, *Lirika mes dy motive*, Munchen, 1967, f.87.
8. Martin Camaj, *Poezi 1953-1967*, Roma, 1981.

Summary

Martin Camaj is one of the greatest writers of Albanian literature. He is known as albanologist, linguist and scholar of the history of writings and letters, poet and narrator, one of the best known specialists of Albanian studies in the second half of the twentieth century. The object of this study is to bring the values of the word in his creative corpus. A conceptual - semantic lexicon field, composed are the words with the direct sense of Dukagjin, that lead through masterful artistic construction: home, garden, field, mountain, streams, brook, all environment from where the poet comes, the environment of all Albanian. Inherent values are carried in the word of his composition when it comes by direct denominator, in that of figurative. Camaj gives new meanings, rare words often figuratively, making usable for the Albanian language. A prominent component of the work of Camaj is the purity of the Albanian language. He fought foreign word strikingly. In works of Camaj we find a fairly substantial amount of words, which he uses to avoid foreign relevant words. The work of M. Camaj is the most powerful expression of the values of the Albanian language, of expressive limitless possibilities of the vitality and strength of magic word. In his work behind every word and expression is felt the pen of a master of the word that requires the word, selects with rare insight with a scientific and literary language evaluation.

Recensentë
Prof. dr. Valter Memisha
Prof. dr. David Luka

DASHURIA SI ELEMENT KODIFIKUES NË POEMËN “KËNGËT E MILOSAOS”

Marjela Progni-Peci

Universiteti i Prishtinës

Fakulteti i Filologjisë

Jeronim de Rada është njëri nga autorët më të rëndësishëm të romantizmit shqiptar. Megjithëse veprimtarinë e tij jetësore e zhvilloi jashtë truallit shqiptar, në njërin nga kolonitë më të mëdha të shqiptarëve në Itali, e gjithë kjo veprimtari iu kushtua tërësisht çështjes shqiptare, shqiptarëve e Shqipërisë. Pavarësisht se veprimtaria e tij ndahej në shkrime letrare artistike, historike, shkencore, publicistike, teorike-estetike, politike-patriotike etj, ato që zënë një vend mjaft të rëndësishëm në krijimtarinë e tij janë shkrimet letraro-artistike, veçanërisht poemat e tij.

Siç e shohim, në qendër të poemave të De Radës, përveç të tjerash, qëndrojnë fakte të ndryshme të marra nga historia e popullit shqiptar, letërsia popullore dhe mite të ndryshme që lidhen po me këtë histori. Autori përmes këtyre poemave mundohet të na paraqesë më shumë se historinë e krijimit të një identiteti, ai paraqet zhvillimin dhe vendosmërinë për mbajtjen e identitetit të cilin ai aq shumë e trumbeton. Poemat e tij si të marra një e nga një, po ashtu edhe nëse i shohim të tëra së bashku do të vërejmë se paraqesin një histori për një vend të caktuar siç është Shqipëria dhe një grup personazhesh-heronjsh me anë të të cilëve na jepet përshkrimi i një momenti të veçantë i civilizimit njerëzor, i përfaqësuar nga një grup i pashembullt njerëzish, të cilët e organizojnë jetën e tyre. Dhe çka është më e rëndësishmja, që e bën veprën e tij të dallohet për nga struktura, kryesisht epike, është mënyra se si paraqiten faktet historike, ato kulturore dhe bota shpirtërore, të cilat së bashku japin botën e kolektivitetit për të cilin bëhet fjalë jo vetëm në subjektin e veprës, por edhe në realitetin objektiv e subjektiv të vendit ku kryesisht zhvillohen ngjarjet, të Shqipërisë.

De Rada, kryesisht, sjell në veprat e tij jo vetëm fate personazhesh, qëllimi që ka është të tregojë historinë e kombit të tij dhe këtë në një periudhë të caktuar, pra periudhën e Skënderbeut, gjithmonë duke pasur parasysh se do të ndërfaqes në veprat e tij edhe mjaft elemente fikzionale të cilat shpeshherë nuk kanë lidhje me historinë. Por fatet e kolektivitetit përcaktohen nga zgjedhjet individuale, duke na paraqitur, në këtë mënyrë, hibridizimin mes dy temave të mëdha romantike, asaj të dashurisë ndaj atdheut dhe asaj erotike. Duke pasur parasysh se poezia erotike është e pranishme, pothuajse, në veprimtarinë e secilit poet edhe Jeronim de Rada nuk bën përjashtim. Ai jo vetëm që ka krijuar traditë, por e ka pasuruar e zhvilluar më tutje poezinë shqipe, duke elaboruar brenda saj edhe kodet erotike. Motivi erotik te poemat e De Radës del herë më i theksuar

e herë më i mënjanuar dhe nëse e shohim me kujdes nuk është kultivuar si poezi e veçantë, por shfaqet si topikë e këtij rrafshi poetik, të fuqishëm e me bukuri të rrallë artistike.

Edhe pse duket sikur janë elementet epike që dominojnë në veprat e tij, duke u nisur që nga përzgjedhja e personazheve, e cila bëhet në mënyrë të tillë që të dominojnë ato të larta, karakteristikë kjo e epikës, apo lidhja e fateve të këtyre personazheve kryesisht me fatet e atdheut, etj. Megjithatë, jo të gjitha ato dominojnë në mënyrë të njëjtë. P.sh. te poema “Këngët e Milosaos” shihet që dominimi i epikës është më i dobët se në të gjitha poemat e tjera. Përgjithësisht në këtë poemë dominon kodi erotik, i dhënë përmes frymës lirike, personale e subjektive. Megjithatë si ide e përgjithshme shihet që edhe epika ka vendin e saj. Në poemë narratori rrëfen në mënyrë të tillë, sa s’mund ta mbajë veten larg ngjarjeve. Përdorimi i disa trajtave të shkurtra që përdor në rrëfim e sipër e bën atë personal pavarësisht se pozicioni prej të cilit ka zgjedhur t’i tregojë ngjarjet është ai objektiv në rolin e dëshmitarit të papërzier e të paanë ndaj rrjedhës së ngjarjeve e personazheve.

“Ish e diela menatë

E i biri i zonjës madhe

Ngjitej tek e bukura

të *mi* lypë një pikë ujë

se ish djegur etit”¹²³².

Kodet erotike te vepra e tij e parë “Këngët e Milosaos”, ndërtohen përmes dhënies së lirizmit në dy rrafshje; përmes temës që dominon, por edhe nëpërmjet ligjëritimit e mjeteve të tjera letrare.

Lirizmi që transmetohet përmes vargjeve, jepet si ndjenjë e subjektit lirik, si *unë* në marrëdhënie me ndjenjat e tij dashurore, me pengesat, me detyrimet që i takojnë etj. Duke qenë se ngjarjet rrëfohen nga veta e parë, distanca në kohë nga rrëfimi i ngjarjeve nuk ekziston dhe nga ana tjetër lexuesi mund të integrohet menjëherë brenda pozitës së unit poetik. Përmes një lirizmi të hollë, personazhet e rrëfejnë botën e tyre të brendshme, përmes vetës së parë, kjo botë paraqitet subjektive dhe e ngarkuar me emocione e drithërime shpirtërore, përmes të cilave paraqitet gjendja e tyre, qoftë e gëzuar e ankthshme apo e trishtuar.

Fenomenet dhe elementet e natyrës luajnë një rol të madh sa i përket lirizmit të De Radës. Shpeshherë, disa motive të natyrës, shumë prej tyre të huazuara edhe nga letërsia popullore, bëhen shkas për krijimin e situatave e ngjarjeve vërtetë të bukura. Natyra zgjon te subjektet lirike ndjenja, të cilat paralelizohen me natyrën që i rrethon. “Teksti lirik i subjektivizuar deri në skaj, erotika me shenjat shqiptare; dashuria si ndjenjë e triumfit dhe e humbjes, më në fund si formë themelore e shfaqjes së individualitetit, ndjenjë që rritet edhe në mungesë; imagjinata si fushë më e përshtatshme, e pakufizuar, e ëndrrës së dashurisë, shpërthimi i saj individual si kacafytje me konvencën kolektive; dhe në fund gjuha e habitshme dhe zbuluese e diskursit të saj, për të mbaruar në një dhembje, siç përfundon rëndom ndjenja e fuqishme personale përballë triumfalizmit të kalkulluar dhe të afishuar kolektiv; këto janë shenjat karakteristike të *Milosaos*”.¹²³³

¹²³² De Rada, *Vepra I*, Rilindja, Prishtinë 1980, f. 85.

¹²³³ Sabri Hamiti, *Letërsia filibliblike dhe Letërsia romantike*, *Vep. letrare* 7, Faik Konica, Prishtinë 2002, f. 158.

Tekstet që përcillen si ligjërim i personazheve janë edhe ato që paraqesin kulminacione lirike të këtyre kodeve erotike të zbatuara përmes vargjeve, p. sh. Vjershat e të bijës së Kollogresë;

“Nga m’erdh te kurmi gjith’ ky gëzim?
Si e pafaj unë zhvishem te shtrati
e zgjohem e hareshme se u zgjova,
si ajo që gdhihet me një fat të bardhë”.¹²³⁴

ose vargjet që këndohen nga Milosao;

“Krahërorin e dërsitur
ajo e fshin me mandil,
e skuqur se po ma shohin.
Ajo vashë zakon bukur
nuk leu ndër të mëndafshita;
porse mua, kur zbardh dita,

në një kasolle të lënë
e të hapur ernave,
prej ku duken, nëpër të,
brinja e bardhë, malet, lumi,
fort ma kënda ta kem pranë
vajzën që më mori zemrën;
ajo mua më ka hije”.¹²³⁵

Përveç elementeve lirike, në ndërtimin dhe funksionalizimin e kodeve erotike në veprën “Këngët e Milosaos” luajnë edhe një sërë elementesh dramatike. P.sh. shihet se një dukuri e shpeshhtë në poemat e De Radës janë dialogët. Këta dialogë, në shumë raste, kanë statusin e dialogëve që përdoren në gjininë e dramës. Si të tillë dialogët e personazheve, kryesisht atyre kryesore, bie fjala, ato të Rinës, Milosaos, kryejnë funksione që shkojnë përtej bashkëbisedimit. Shpeshherë roli i rrëfimtari, i cili ka funksionin kryesor të kallëzimit, tregimit të ngjarjeve mënjanohet dhe ky rol i kalon personazhit, i cili përmes dialogimit me tjetrin apo me veten (monologut), paraqesin jo vetëm ndjenjat e tyre, por edhe ngjarje, situata e veprime, të ndodhura e parashikime për të ndodhurat e ardhshme etj. Këta dialogë shpeshherë i shërbejnë dramatizimit të situatës duke çuar në zhvillimin e ngjarjeve të reja, hapjen e një kapitulli të ri zhvillimesh. E njëjta gjë ndodh edhe me dialogët me vetveten ku hapen, le t’i quajmë, konflikte të cilat sjellin peripeci të reja në poemë. Kjo shihet p.sh. te Milosao i cili bashkëbisedon me erën, bashkëbisedim i cili hap konflikt midis dashnorëve, çka sjell dramatizimin e brendshëm të personazheve, pra të ndjenjave të tyre. Një tjetër tipar dramatik në poemat e tij janë edhe këngët, vjershat e kryepersonazheve, përmes të cilave përcillen gjendjet e tyre dhe artikulimi i ndjenjave të tyre të brendshme në forma nga më të ndryshmet, këtu paraqitet shpeshherë edhe dramatizimi më i skajshëm i botës subjektive të personazheve. Këto vjersha nuk kanë funksion kallëzimi dhe nuk luajnë rol në zhvillimin e ngjarjeve edhe si njësi të shkruara

¹²³⁴ De Rada, *Vepra I*, Rilindja, Prishtinë 1980, f. 87.

¹²³⁵ Po aty, f. 95.

qëndrojnë të ndara dhe nuk numërohen si kapituj/këngë, por thjeshtë vendosen mes tyre dhe qëndrojnë si njësi të ndara.

Të ngjashme me këto vjersha janë edhe këngët kolektive që këndohen nga shoqet ose shokët e kryepersonazheve, apo nga kolektivitete të mbledhura në raste të caktuara, shpeshherë edhe vetë personazhet këndojnë bashkë me ta. Këto këngë mund të quhen këngë të korit të cilat pasqyrojnë jo më gjendjen e brendshme individuale të personazheve, por një gjendje të përgjithësuar, e cila mund të nënkuptohet edhe si gjendje individuale, duke ndërfaqur këtu jo vetëm ndjenjat që lidhen me dashurinë, por edhe obligimet, detyrat që ata duhet t'i zbatojnë, kori këshillon, bekon, e i shtyn personazhet drejt veprimeve të reja. Kori paraqet një ndërdije kolektive e cila përmes këngëve zë vendin e saj edhe në tekstet e De Radës.

Recensentë

Prof.Dr. Nuhi Rexhepi
Prof.Dr. Liman Matoshi

ROMANI KRONIKË NË GUR I ISMAIL KADARESË (KUFIJTË E RRËFIMIT)

Muhamet Peci

Universiteti i Prishtinës
Fakulteti i Edukimit

Tash e disa kohë, shumë kohë, madje më mirë të thuhet gjysmë shekulli i plotë është bërë ku flitet e stërflitet për Ismail Kadarenë. Për Kadarenë, është folur shumë, në fakt, është shkruar shumë, ndoshta, po e përsëris ndoshta, sepse nuk kam bërë ndonjëfarë matjeje të saktë, por nga perceptimi mund të thuhet se ai, (Kadare) është shkrimtari në mos më i studiuar, ndër më të studiuarit e letërsisë sonë. Pa dyshim që ndër shkrimtarët e pas Luftës së Dytë Botërore zë vendin qendror.

Për Kadarenë jemi mësuar të dëgjojmë e të lexojmë gjithfarë lloj mbiemrash a epitetesh le të themi më mirë. Për veprat e tij, sidomos romanin si zhanrin kryesor të tij tashmë është shkruar edhe përtej kësaj pjesës sonë kulturore. Përkthimi i veprave të tij në gjuhë të ndryshme të botës ka bërë që ky autor dhe vepra e tij të lakohet e komentohet nga mënyrat më të ndryshmet, nganjëherë edhe më të çuditshmet. Disa prej atyre që e kanë lexuar janë marrë me lëndën e parë nëse mund të themi, pra veprën e tij, e disa të tjerë kanë kaluar kufijtë e vërtetë të studimit të letërsisë dhe i janë hedhur vështrimi fenomenit Kadare. Megjithatë, nuk duhet harruar se edhe për studimet shqiptare, apo lexuesin shqiptar, por edhe për atë të huaj që siç e dimë nuk është i paktë, Ismail Kadare është shkrimtari më i njohur shqiptar dhe kontributi i tij për letërsinë është mjaft i madh dhe tashmë i afirmuar dhe i pamohueshëm. Vlera e veprimtarisë së tij artistiko-letrare në letërsinë shqipe është shumë e madhe dhe ka luajtur një rol të pazëvendësueshëm në zhvillimin e saj, por nga ana tjetër këto vlera i kanë dëshmuar dimensionet e tyre edhe jashtë kufijve shqiptarë, duke prezantuar talentin e jashtëzakonshëm të autorit, vepra e tij rrumbullakohet duke marrë vlera universale.

Vlera universale e veprave të Ismail Kadaresë, pa dyshim që lidhet shumë me disa nga romanet e tij tashmë shumë herë të botuara e ribotuara në shumë gjuhë të botës. Bashkë me romanin Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Kështjella, Pallati i ëndrrave, Prilli e thyer, Dosja H, Koncert në fund të dimrit e të tjera vepra të Kadaresë, vlen të thuhet se pjesë e pandashme e kësaj liste vlerash është edhe romani Kronikë në gur, i botuar në Tiranë të fillim të viteve të '70. Kronikë në gur është cilësuar si vepër e cila shquhet për mjeshtërinë e veçantë të rrëfimit.

Vepra përbëhet nga tri lloje të teksteve: tekstet pa tituj, të cilët paravihen pothuajse para çdo kapitulli dhe që do t'i emërojmë si paratekste, tekste të cilat titullohen nga vetë autori si kronika dhe teksti bazë i rrëfimit i cili përbëhet nga 18 kapituj. Pavarësisht se tekstet janë të lidhura me njëra-tjetrën, mund të thuhet se dy tekstet e para mund të qëndrojnë edhe si digresione, sepse edhe nëse eliminohen tërësisht, përsëri nuk do të rrezikonin statusin e tekstit bazë, që si i tillë përbën romanin në tërësi.

Duket sikur parateksti i parë që hap edhe romanin rrëfëhet nga perspektiva e vetës së tretë. Këtë e mbështet struktura e tekstit e cila ndërtohet prej këndvështrimit të narratorit impersonal, gjithëdija e tij sa i përket, jo vetëm rrëfimit të ngjarjes, por edhe paraqitjes së mendimeve, pikëpamjeve, përshtypjeve e me radhë. "Rrëfimi në vetën e tretë, sikur e largon, sikur e distancon në një mënyrë- sikur indiferentizon".¹²³⁶ Pastaj, në paragrafin e parafundit kjo strukturë ballafaqohet me një strukturë tërësisht të re, e cila vë në dukje një rrëfim të dhënë nga veta e dytë njëjës, ku nga një pozicion i jashtëm dhe i ftohtë i narratorit, shihet kthimi i një disponimi bashkëbisedues dhe përfshirës kundrejt lexuesit "veta e dytë sikur i asgjëson tërë ato mekanizma mbrojtëse të individit. Ajo sikur krijon iluzionin e furishëm njëkohësisht edhe të afrimit, po edhe të krijon iluzionin e tjetrit dhe iluzionin e distancimit të vetvetes. Kështu çlirimi i sensibilitetit të "mbrojtur" ka gjasë të arrihet më shpejt dhe më tërësisht" dhe në fund duke analizuar kontekstin, paraqitet edhe fjalja e fundit, e cila, pavarësisht se si strukturë, madje edhe si ndërtim gjuhësor paraqet krejtësisht të kundërtën, megjithatë, si diskurs aludon një narrator të vetës së parë, pjesëmarrës dhe personazh të ngjarjeve, me të cilin në fakt hap edhe kreun e parë të këtij romani. Paratekstet e tjera kryesisht karakterizohen me nga një zë narrativ, i cili zakonisht rrëfen nga veta e parë dhe identifikohet me fëmijën narrator të ngjarjeve, ose në vetën e tretë, i cili identifikohet me dëshmitarin e gjithëdijshëm. Këto tekste karakteristike themelore kanë ngjashmërinë e madhe me njëra - tjetrën, pra si tekstet e rrëfyera nga veta e parë si ato nga veta e tretë për nga mënyra e rrëfimit, ndërtimit ligjërimor, etj. të vetmin ndryshim kanë identifikimin e narratorit në një pikë të caktuar, sepse mënyra se si përshkruhet një ngjarje, se si paraqitet një gjendje, apo arsyetohen veprimet nuk ka ndryshim. Por identifikimi i narratorit, pavarësisht asaj që përmendëm pak më lart, i ndan këto tekstë sipas staturave të ndryshme. Aty ku narratori identifikohet në vetën e parë, teksti merr status subjektiv- personal, ndërsa ku narratori identifikohet në vetën e tretë njëjës, merr status objektiv-impersonal, pra dëshmitar i paanë ngjarjesh. Edhe parateksti i fundit, ashtu si i pari, ndryshon nga të tjerët dhe është më i veçantë sa i përket mënyrës së rrëfimit. Parateksti i fundit hapet me një dialog, i cili rrëfëhet nga perspektiva të një narratori kolektiv. Kjo trajtë e të rrëfyerit është shumë e rrallë dhe kërkon mjeshtëri në përdorim, por Kadare arrin ta realizojë me mjaft sukses. Siç e përmendëm më lart, pjesë e këtij romani janë edhe disa pjesë tekstore të titulluara kronika. Sipas teoricienëve të letërsisë "teksti narrativ mjaft shpesh përmban pjesë që nuk mund të quhen narracion. Ato synojnë të japin ndonjë element plotësues të asaj që përmban narracionin i mirëfilltë. Teksti i tillë rregullisht paraqitet në alternim me tekstin e narracionit të bërë nga narratori. Në përgjithësi teksti jo narrativ është një tekst komentues që shpreh një pikëpamje, është ideologjik dhe nuk lidhet me zhvillimin e ngjarjes në situatën e tekstit narrativ, po jep një imazh të idesë që zhvillohet atje".¹²³⁷

¹²³⁶ Ali Aliu, *Rrjedhëve të letërsisë*, Rilindja, Prishtinë 1977, f. 173-174.

¹²³⁷ Zejnullah Rrahmani, *Leximi dhe shkrimi*, Faik Konica, Prishtinë 2003, f. 75.

Duket sikur këto kronika i përshtaten pikërisht këtij profili apo statusi të tekstit, por nga ana tjetër dalin nga ky status kur vëmë në pyetje autorësinë e rrëfimitarit. Siç edhe kuptohet nga informacionet që na jepen në këto tekste, kemi të bëjmë me pjesë të përmbledhura nga gazeta ditore, ku informacioni relevant përmbledhet kryesisht te ngjarjet historike të ndodhura në Evropë dhe Shqipëri, kryesisht në qytetin ku ndodhin ngjarjet. Me anë të paraqitjes së këtyre ngjarjeve, jepet kalimi i kohës në vepër që nga fillimi i luftës deri te përfundimi i saj, por me anë të mënyrës se si paraqiten dhe përmbledhen ngjarjet në kronika shenjëzohet autori që i përmbledh këto ngjarje e si rrjedhojë narratori. Duket qartë që gazeta është e kontrolluar nga aleatë të gjermanëve, natyrisht këtë na e thonë tërthorazi tekstet e kronikave, ku paraqitet retorika justifikuese e Hitlerit për luftën, fitoret e gjermanëve, ndjekja e terroristëve, apo përndjekja e atyre që i ndihmojnë, pra bashkëpunëtorëve, gjithashtu mënyra se si tregohet pushtimi i qytetit herë nga greket e përsëri nga italianët e tjerë, të gjitha këto të përmbledhura në mënyrë të pamenduar e të thëna aq thjeshtë e me naivitet të papërshkrueshëm, indikojnë vetëm te një person, te fëmija narrator, ai që e identifikon veten kudo në tekst si pjesëmarrës i ngjarjeve, këtu identifikohet në bazë të asaj që shpreh duke paraqitur edhe logjikën e tij të mendimit fëmijëror e jo të thellë. Gjetje kjo e përkryer e autorit, me anë të së cilës i jep mundësi lexuesit që nga këto kronika të nxjerrë ide krejt të kundërta nga ato që manifestohen.

Recensentë
Prof Dr. Liman Matoshi
Prof.Dr. Rifat Ismajli

BASHKËKOHËSIMI I ZHVILLIMIT LETRAR SHQIPTAR DHE ATIJ EVROPIAN

Prof. dr. Hamit Xhaferi

Universiteti i Evropës Juglindore – Tetovë, Maqedoni
Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit
Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe

Në këtë studim bëhet fjalë për praninë e ideve, temave, shqyrtimeve dhe ndjeshmërive të poezisë dhe prozës së letërsisë shqipe gjatë periudhës 1944 - 1990 me bashkëkohëzimin e poezisë dhe prozës moderne evropiane. Letërsia shqipe pothuajse brenda një gjysmë shekulli (1944-1990) ka njohur arritje dhe zhvillim të plotë të saj, duke u përforcuar dhe afirmuar si një letërsi me vlera të nivelit evropian. Poezia shqiptare kurdoherë është pasqyruar me një ritëm intenziv për të theksuar vërtetësinë e artit dhe individualitetin, duke arritur vendin e saj që i përket brenda hapësirës fisnike të vjershërimit të këngës frymëzuese lirike të popujve dhe kulturave evropiane. Jehona e thirrjes poetike të saj duke u bashkëngjitur me frymëzimet lirike të popujve tjerë u ka lënë lexuesve vazhdimisht mbresën e pjesës së lirizmit të zemrës, ku treten në mënyrë mahnitëse zërat poetike shqiptare me ato evropiane¹²³⁸. Andaj, vjershëtarët shqiptar kanë dëshmuar se kanë pasur një afërsi të thellë shpirtërore me poetët dhe poezinë evropiane, pasi poezitë shprehin mesazhe të fuqishme, që përshkojnë të tëra fushat e jetës, me filozofinë e ndjesive dhe perceptimit të realitetit objektiv. Poezia bashkëkohore shqipe gradualisht po zë një ndër vendet më të shquara në rajon, duke i ndjerë ngjyrat e ngrrohta të ambientit evropian. Njëkohësisht shpreh edhe një qëndrim poetik me tipare dhe vlera të thella që nxit poezinë universale. Në këtë mënyrë ajo e shpreh edhe botëkuptimin shqiptar me primatin e vlerave poetike të një civilizimi. Kemi bindjen se kështu gradualisht po zgjerohet jo vetëm në Ballkan, por edhe në Evropë, me impulset e shpirtit dhe fatet e poezisë shqiptare në tërësi. Nëse duam të zbulojmë sekretin se çka e krijoi këtë rrezatim të poezisë shqiptare, e kemi vështirë të përgjigjemi me një qëndrim, ose me disa fjalë, sepse kemi të bëjmë me një fenomen poetik dhe artistik që duhet të studiohet. Mendimi i parë i yni do të ishte, nxitja e madhe që erdhi qysh nga çlirimi kombëtar, ku na u duk sikur u hap diç e fuqishme, thuase kënduan shpirtërat e kohërave që hetuan fshehtësitë e poezisë, që s'kishin lirinë e fjalës gjatë diktaturës komuniste. Liria bëri të mundshme përnjëherë të zbulohen prirjet e hetuara të një populli të ndarë jashtë shtetit kombëtar, i cili, nëpërmjet të poetëve dha shprehjen më të lartë të mendimeve dhe ndjenjave të tij. Çudia e poezisë dhe prozës shqiptare qëndron ndoshta në planin indoevropian e më gjerë, që flet qartazi se pa lirinë kombëtare nuk ka vrull krijues, së paku jo në përmasa kreative të frymës dhe fjalës së një populli të ndarë. Me lirinë kombëtare erdhi edhe fuqia kreative e fjalës së lirë, qoftë në poezi apo në prozë. Ka mendime se fuqia e poezisë dhe prozës shqiptare del nga freskia e

¹²³⁸ Smaqi Laura, Lasgushi dhe simbolistët evropianë, Letërsia si e tillë, Tiranë, 1996, f. 337

një gjuhë letrare të përdorur. Madje, është e pranishme ndjenja se poezia dhe proza shqipe ushqehet nga gjuha, nga mediumi i gjuhës shqipe, që është e pasur dhe kumbuese, duke krijuar forma ritmike të vetme dhe origjinale. Me këtë, duam të themi se kjo është gjuhë magjike, e ruajtur me ndërthurje të lashta të fjalëve, prej të cilave merr fuqinë forma dhe gjuha e poezisë apo prozës. Madje, mund të flitet për veprimin me të folur të gjallë të popullit dhe strukturat moderne të poezisë, që të habit me ekspresionin magjik. Por ajo që të gjithë i fascinon janë motivet frymëzuese dhe stili magjik, që vijnë nga linjat gjenetike të folklorit të pasur shqiptar.

Studiuesi N. Jorgaqi në studimin e tij “Vështrim mbi letërsinë shqipe” do të thotë se: poezia shqiptare, e cila kish një traditë të ndritur, u begatua mëtej me vlera të reja artistike dhe me personalitete përmasash dhe aftësishë krijuese të mëdha që janë dalluar me tiparet e tyre autentike, në pjesën e dytë të këtij qindvjeçari. Në rrafshin letrar në Shqipëri, Fishta ishte poeti prijës që do të mbart një nivel cilësor më të lartë, të cilin vendet më të zhvilluara të Evropës e patën arritur që nga pjesa e dytë e shekullit nëntëmbëdhjetë¹²³⁹. Janë interesante poezitë e Fishtës ku bëhet fjalë për një sintezë të rëndësishme midis karakterit të thellë nacional dhe vlerave poetike që mund të krahasohen me ato që krijohen në poezinë moderne evropiane. Kahjen e modernitetit, domethënë rrugën drejt Evropës e përqafuan gjithashtu edhe dy vjershëtarët e brezit tjetër, Migjeni dhe Lasgush Poradeci, pra dy poetët që dolën jashtë rrethanave të njohura letrare, duke u veçuar me traditën e letërsisë sonë dhe përmes saj e radhitën kulturën letrare shqiptare me Evropën bashkëkohore. Duke e kultivuar poezinë, këtë seli të shpirtit që të impresionon nga prirja kah idealja dhe ëndrra, me impulset e shpresës dhe lirisë, në mënyrë mahnitëse është zbuluar poezia moderne shqipe në Evropë. Migjeni i hapi rrugën letërsisë moderne, ndërsa Lasgush Poradeci, një ndër personalitetet kryesore të letrave shqipe, në krijimet e të cilit pikëpamjet dhe synimet përëndimore kanë lënë mbresa të pashlyeshme, duke qenë krijues eklektik i kohës dhe një paradoks në letërsinë e Evropës juglindore. Duke vënë në pah atë çka është shoqërore dhe e njëllotë përmes krijimtarisë poetike të tij dhe asaj të simbolistëve evropianë, ku në të njëjtën kohë, Lasgush Poradeci është krijues dhe poet evropian. Ashtu si Bodleri, njëri nga pararendësit e simbolizmit dhe babai shpirtëror i tij, i cili zë në poezinë franceze një vend të ngjashëm me atë të Lasgushit në poezinë shqipe. Krijimtaria e Lasgushit ka qenë sa hutuese që të lë me gojën hapur, po aq magjepsë për kohën në të cilën krijoi, prandaj me të drejtë mund të cilësohet si nismëtar i një epoke të re në letërsinë tonë. Duke e zbuluar dhe duke e vërejtur vlerën poetike të Lasgushit, ku përveç llojllojshmërisë dhe vitalitetit ai ka ndërje edhe diç më të thellë, atë që jeton në poezinë e tij: e përgjithshmeja njerëzore dhe jashtëkohore. Individualiteti i theksuar dhe shenjtëzimi që i bën poezisë, dëshira e zjarrtë për të provuar gjithë llojet e risive, e afrojnë Lasgushin përfundimisht me simbolistët evropianë. Përafritë në mes poezisë lasgushiane dhe asaj të simbolistëve, e vendosin Lasgushin me dinjitet përkrah një grupi poetësh të shquar evropianë që arritën të krijojnë poezi¹²⁴⁰. Poezia e Lasgushit mundi këtë ta arrij për mrekulli, duke arritur deri te rrymimet moderne, përmes stilit të këngëtimit dhe krijimit, që edhe sot ajo konsiderohet projeksioni më i lartë shpirtëror krijues. Kontaktet e tij me truallin e vjetër të kulturës dhe qytetërimit evropian dhe vullin e ri të poezisë dhe

¹²³⁹ Elsie Robert, *Rruga e modernitetit dhe koha e artë e letërsisë shqiptare*, Kultura shqiptare e viteve '30, Përpjekja, e përtremuajshme kulturore, Tiranë, 1995

¹²⁴⁰ Smaqi Laura, *Lasgushi dhe simbolistët evropianë*, Letërsia si e tillë, Tiranë, 1996, f. 340

të poetëve shqiptar. Kjo është poezi evropiane dhe njëkohësisht poezi autentike vetjake, e cila shkel në problematikën e përgjithshme njerëzore.

Megjithatë, duhet theksuar se kjo rrugë mbeti e hapur brenda një kohe tepër të shkurtër¹²⁴¹. Prandaj, ky ishte një hap jashtëzakonisht i rëndësishëm, për arsye se krijuesit shqiptar, ashtu si gjithë shqiptarët u ballafaquan me konsolidimin e vonuar të Shqipërisë si vend ballkanik dhe me zhvillimin e saj të ngadalshëm politik dhe kulturor. Krijuesit tanë të viteve tridhjetë duke u mahnitur nga shtetet e zhvilluara evropiane, përmes krijimit të poezisë së madhe dhe origjinale shqipe, ata do të orvaten ta zbulojnë rolin e Shqipërisë në Evropë. Zatën, ky agens krijues i këtij lulëzimi të bukur dhe të hovshëm që do arrijë nivelin e poezive të zhvilluara moderne, do të bëhet temë kryesore në shtypin letrar të kohës. Një masë e madhe intelektualësh të cilët kishin qenë jashtë vendit dhe ishin ballafaquar me realitetin në disa nga vendet e zhvilluara evropiane, duke ardhur nga vendi të cilin, mbi bazën e thënies së njohur, "e don Zoti, meqë u ndryshua fare pak që nga koha e krijimit të botës", ata mbetën të tërhequr në vete, njëkohësisht edhe të çorientuar e të tmerruar nga rrethanat dhe situata në të cilën ndodhej Shqipëria. Fjala Evropë perëndimore në Shqipëri kishte një kuptim pothuajse disi të pakuptueshëm, duke qenë se shteti perëndimor më afër Shqipërisë ishte Italia fashiste e Musolinit. Nuk e teprojmë kur themi se jeta intelektuale dhe kulturore shqiptare kishte arritur një kulm nga gjysma e viteve tridhjetë deri në pjesën e parë të viteve dyzet. Pas një periudhe kohore të gjatë, ky ishte fillimi i pranisë së një letërsie bashkëkohore moderne me cilësi në Shqipëri. Tërësia historike e poezisë sonë e shekullit XIX, arriti disa kulme që i rezistuan kohës dhe vazhdoj të jetë e tilla edhe sot, siç janë De Rada, Naimi, Serembe etj., të cilët e inkuadruan tërë shekullin e vet poetik në rrjedhat moderne evropiane dhe universale¹²⁴². Pra, filluan të shqyrtohen ndërvarësitë e mendimeve teorike dhe imagjinata poetike, të cilat kanë qenë të lëna shpesh pas dore. Me këtë rast do të përballen drejtpërsëdrejti idetë më me ndikim, të cilat në fushën e teorisë bashkëkohore letrare dhe kulturore gjatë tridhjetë viteve të fundit janë formësuar përmes koncepteve dhe reflektimeve të ndryshme të autorit, lexuesit, letërsisë, zhanërit, realitetit, politikës, etikës, ideologjisë, subjektit, identitetit, tekstualitetit, vlerës dhe botërave poetike të shkrimtarëve më me ndikim të cilët kanë botuar gjatë këtyre viteve, siç janë: I. Kadare, D. Agolli, F. Arapi, Xh. Spahiu, A. Podrimja, V. Zhiti, A. Shkreli, D. Mehmeti, E. Basha, F. Reshpa, M. Ahmeti, B. Londo, N. Lako, K. Petriri, M. Zeqo, Zef Skiro Di Maxhio etj. Me depërtimin e disa prej këtyre krijuesve dhe veprave të tyre në Evropë dhe më gjerë, tanimë nëpërmjet antologjive, filluan të zgjojnë kërshëri të madhe dhe interes krijues për ide dhe trajta origjinale. Kjo antologji e poezisë së sotme shqipe duhet të pranohet edhe si tregues e çmueshëm në orientimin topografik të Evropës poetike. Tanimë po e spikat magjiken e poezisë shqipe me stil të lartë dhe me ambicje më moderne, sepse në format moderne ndjehet frymëzimi nga tradita popullore në një vertikale të bukur. Kemi bindjen se këtu është shprehur vlera dhe simbioza e madhe midis magjikes dhe poezisë me fjalën moderne që sot dallohet si stil poetik. Në pjesën më të madhe të poezisë shqipe, poetët e kësaj gjenerate do të paraqesin akordin e hyrjes në poezinë e shekullit XX. Në poezinë bashkëkohore shqipe lirika moderne që e hapur, ndërsa komunikimi i poetit me lexuesin ishte i lehtë. Për nga timbri lirik, karakterizohet në mesin e poezive të pasura evropiane, sepse në lirikën shqiptare

¹²⁴¹ Elsie Robert, *Rruga e modernitetit dhe koha e artë e letërsisë shqiptare*, Kultura shqiptare e viteve 30, Përpjekja, e përtremuajshme kulturore, Tiranë, 1995

¹²⁴² Aliu Ali *Antologji e poezisë shqipe (Gjysmëshekulli i artë)*, Klubi letrar 94 – Tetovë, 2000, f. 339

jeton një traditë e vjetër dhe poetët shqiptar kanë ditur kurdoher ta shfrytëzojnë në mënyrë artistike folklorin tonë të pasur. Fuqia e fjalës së bukur artistike ngjyrorej me domethëniet dhe kuptimet e ndryshme. Në veprat e tyre forcohej paralajmërimi dhe sugjestionin poetik, ku imazhi ka shumë domethënie, sepse përmes tij zhvillohej metafora. Karakterizimi i hapësirës kulturore shqiptare gjatë viteve shtatëdhjeta shfaqet me amzën e fuqishme ideologjike, me gërshetimet dhe thurjet e poetikës agolliane. Gjuha poetike e Kadaresë dhe Agollit pasurohej me lëndë leksikore, ku shfrytëzohen të gjitha anët e shprehjes gjuhësore. Në poezinë e F. Arapit, Xh. Spahiut dhe A. Podrimjes zbulohet natyra me ndryshueshmërinë e saj. Tek V. Zhiti në lirikën e dashurisë futet intensiteti dramatik, në të cilën flasin jo vetëm fjalët. Gjithashtu ky poet reagon në mënyrë sensitive ndaj kundërthënieve të kohës, duke kërkuar rrugëdalje nga ndjenja e vetmisë, përmes krijimit të vizionit dhe harmonisë së re. Poeti A. Shkreli, kthehet nga motivet e vendlindjes dhe kërkon bashkimin e qenies njerëzore shqiptare që reflekton një optimizëm të qetësuar. Në kuptimin kreativ kultura poetike shqiptare është bashkuar me kulturën e lartë shpirtërore të poezisë. Kjo tregon se poezia moderne shqiptare nuk është lule pa rrënjë. Nga kjo lidhje më vonë është zhvilluar një proces i gjatë, që ushqehet nga tradita dhe kultura evropiane. Në këtë mënyrë nga njëra anë do të rrjetëzohet tradita e poezisë shqiptare me poezinë evropiane, duke treguar në cilën masë poezia bashkëkohore shqipe është e aftë të përgjigjet në çështjet më të ndërlikuara të kohës sonë, pavarësisht nëse kjo është e hapur në hapësirën e letërsisë ose të kulturës, apo në kuptimin më të gjerë të fjalës, siç janë etika, politika, shkenca dhe feja. Në anën tjetër, do fillojnë të hulumtohen varësitë teorike narrative poetike dhe prozaike që kanë të bëjnë me tropizimin halucinacional lirik dhe pjesëmarrjen e përgjithshme të vibrimit të kërcëllimës poetike në ato përmbajtje simbolike që na mësojnë kuptueshmërinë, rregullin dhe disiplinën letrare dhe artistike. Këto analiza në vete nënkuptojnë kalimin e përhershëm të kufijve të largët dhe nganjëherë strategjik, veçanërisht përmes kundërvënies filozofike, teorike ose gjuhës poetike, apo poetikave evropiane në përgjithësi. Megjithatë treguesi më i mirë i zhvillimit të plotë të letërsisë sonë është rrjedha e begatshme e prozës dhe zhvillimi i gjerë i saj¹²⁴³. Prandaj me të drejtë N. Jorgaqi në shqyrtimin e tij “Vështrim mbi letërsinë shqipe” heton se synimet e këtyra arritën shprehjen e vërtetë të tyre, në mënyrë konkrete përmes tregimit, që fitoi cilësi të reja estetike në shkrimet poetike dhe prozaike tek një varg autorësh si Dh.S. Shuteriqi, Sh. Musaraj, N. Prifti, F. Ballanca, Z. Çela, E. Kadare etj. Për këtë arsye, lartësitë më të mëdha që arriti letërsia jonë në këta vite s’do mend se janë në fushën e prozës, përkatësisht romanit. Këtu nuk bëhet fjalë për rrethin e gjithanshëm dhe të lirshëm të krijuesve që u morën me këtë gjini letrare, apo për numrin e madh të romaneve të botuara, kundrejt krijimit të disa veprave romaneske me nivel të lartë ideoartistik. Dihet mirëfilli se hapësira kulturore shqiptare e viteve shtatëdhjeta është karakterizuar me matricën e fuqishme ideologjike dhe me gërshetimet apo thurjet e poetikës së re agolliane që kërkonte shpëtim me anë të artit. Ky poet arriti t’i shprehte mendimet e tij më komplekse, të frymëzuara mes të tjerash nga veprat me poezi “Udhëtoj i menduar” dhe “Pelegri i vonuar”. Një moment i rëndësishëm në letërsinë tonë në këto vite është pa dyshim paraqitja në skenën letrare e disa krijuesve tanë të njohur, të cilët bënë bujë në fushën e romanit, si bie fjala D. Agolli, J. Xoxa, S. Spasse, A. Abdihoxha, F. Gjata etj. Me praninë e tyre në skenën letrare shqiptare si dhe me konceptin personal të

¹²⁴³ Jorgaqi Nasho, “Vështrim mbi letërsinë shqipe”, Tiranë, 2007

shkrimit letrar, poetët dhe prozatorët bashkëkohor shqiptarë kanë krijuar rrjetin letrar, në brendinë e të cilëve përshkruajnë vështrimet personale të funksionimit të tekstit letrar të cilët në planin e përgjithshëm kanë përfundimet e njëjta, që pastaj të shpërthejnë brenda shkrimeve një nga një, duke u përcaktuar secili në hapësirën e vet. Letërsia shqiptare kësaj do të fillojë të shfaqet me dinjitet dhe me lartësinë e cilësinë e duhur përballë opinionit evropian, duke dëshmuar në qarqet letrare evropiane si një argument i shkëlqyer. Në këtë fushë dallon talenti i madh i Ismail Kadaresë, romanet e të cilit paraqesin një enciklopedi të jetës dhe të historisë së popullit tonë. Njëherazi këto vepra paraqesin në mënyrë të qartë vlera letrare dhe artistike të jashtëzakonshme në letërsinë tonë. Me këtë autor, të përkthyer në dhjetëra gjuhë të botës, letërsia shqiptare është prezantuar me dinjitet dhe me tërësinë e vlerave të saj ndaj opinionit të huaj. Janë interesante dhe eksperimentet letrare që u bënë në këtë kohë për të krijuar korelacione me rrjedhat dhe fenomenet që zhvilloheshin në letërsinë evropiane, veçanërisht me simbolizmin dhe neorealizmin etj.

Pothuajse brenda një gjysmë shekulli, poezia dhe proza shqipe është pasqyruar tërësisht duke e ndryshuar vetveten dhe gjithnjë e më tepër duke u ndërlidhur me rrjedhat e zhvillimit evropian. Kjo pasqyrë e vetëreflektuar, edhe pse është dashur të jetë vetëm një pasqyrim besnik i realitetit, tregon qartë se letërsia shqiptare gjithmonë ka qenë e ndikuar nga ajo evropiane, por edhe reflektimi ngandonjëherë ka ditur të jetë më i mprehtë nga vetë objekti i saj, duke qenë më e plotë në diskursin racionalizues me papërkthyeshmërinë e bujshme të praktikës poetike evropiane. Në çdo rast, klima e përgjithshme e autorëve me referencë bashkëkohore, do i mëshoj sa më shumë demokratizimit të kushteve dhe mënyrës së të krijuarit dhe menduarit në korpusin e tërësisht të poezisë dhe prozës bashkëkohore shqipe, duke sjellur para lexuesve shqiptar dhe atyre evropian pothuajse një sasi dhe cilësi të pakrahasueshme krijimesh të ndryshme historiko-letrare dhe teoriko-letrare, qofshin në prozë apo poezi

Bashkëkohësimi i zhvillimit letrar shqiptar dhe atij evropian

Literatura

Elsie Robert, *Ruga e modernitetit dhe koha e artë e letërsisë shqiptare*, Kultura shqiptare e viteve 30, Përpjekja, e përtremuajshme kulturore, Tiranë, 1995.

Jorgaqi Nasho "Vështrim mbi letërsinë shqipe", Tiranë, 2007.

Lasgush Poradeci, *Vdekja e Nositit*, Rilindja, Prishtinë, 1978.

Smaqi Laura, *Lasgushi dhe simbolistët evropianë*, Letërsia si e tillë, Tiranë, 1996.

Reçenzentë:

1. Prof. dr. Bardhosh GAÇE

Universiteti i Vlorës Ismail Qemali – Vlorë, Shqipëri

2. Prof.dr. Emin KABASHI

Instituti Albanologjik – Dega Letërsi, Prishtinë, Kosovë

VEÇORI TË PËRGJITHSHME TË GJUHËS E STILIT NË VEPRËN E GJERGJ FISHTËS

Gladiola Durmishi (Elezi)

Departament of Albanian language and literature
University of Vlora "Ismail Qemali"
Address: district "Isa Boletini", "Sadik Zotaj" street
Albania
email: gladiola.elezi@yahoo.it

Abstrakt

Gjergj Fishta në veprën e tij letrare ka përmbushur funksionalisht një **organizim gjuhësor** gjithëpërfshirës në të gjitha njësitë dhe nivelet gjuhësore. Vepra letrare e Fishtës shihet si në pikëpamje stilistike në të gjitha nivelet e gjuhës: **nivelin fonetik, fonologjik, gramatikor, morfologjik e sintaksor**, si dhe atë **leksikor, semantik e frazeologjik**. Kjo është konceptuar sipas nënndarjeve: fonetikë e shprehjes gjuhësore (**fonostilistikë**), morfologji e shprehjes gjuhësore (**morfostilistikë**), sintaksë e shprehjes gjuhësore (**sintaksostilistikë**) dhe semantikë e shprehjes gjuhësore (**semantostilistikë e leksikostilistikë**).

Analiza e mjeteve **gjuhësore-stilistike, figurative-stilistike, stilistiko-metrike e stilistiko-fonike** dëshmon se gjuha e këtij shkrimtari përdallon një stil të veçantë shkrimi, tejet vetjak, gjuhë e cila ka qëndrueshmëri eptuese të gjedheve fonemore, morfologjike, leksikore e sintaktike. Fishta përdori si gjuhë shkrimore shqipen e gegërishtes veriperëndimore bazuar mbi shkodranishten me veçori të mbarë **gegërishtes** dhe përmes saj dëshmoi realisht se ishte një ndër përpunuesit më të zellshëm të saj, zbulues i vlerave gjuhësore të gjalla por të mbetura mënjandë të fjetura të montuara nga **gjuha librore**, një visar ky i jashtëzakonshëm që Fishta ia riktheu gjuhës së përbashkët shqipe.

Stilistika morfologjike e Fishtës shfrytëzon me mjaft efikasitet efektin stilistik të kategorive kryesore **leksiko-gramtikore** dhe përpos kësaj ai harmonizon format e ndryshme gramatikore të cilat ai i shndërron në mjete poetike të strukturave letrare. Vihet re pashkëputshmëria dhe ritmi i rregullt i strukturave poetike, përfundimi informativ i tekstit, tejngopja dhe tejkonsumimi i njësive gjuhësore, mbizotërimi i fjalive emërore etj.

Si përfundim, Fishta ka një **stil** të veçantë, të përdalluar qartë, shprehur kjo përmes përdorimeve të njësive, mjeteve gjuhësore në një mënyrë stilistike tërësisht vetjake, e cila është përfutur qëllimisht në të gjitha nivelet e gjuhës (fonologjik e fonetik, morfologjik e fjalëformues, sintaksor e tekstori dhe leksikor e semantik).

Fjalët kyç, janë ato të bolduara

Abstract

George Fisher in his literary work has met an organization functionally **inclusive language** in all units and linguistic levels. Fishta literary seen as stylistic standpoint at all levels of language: it **phonetic**, **phonological**, **grammatical**, **morphological** and **syntactic**, and the **lexical**, **semantic** and **phraseological**. It was conceived by subdivisions: **phonetics** and linguistic expression ((**phonostylistic**), morphology and expression language (**morphostylistic**), linguistic expression syntax (**syntaxostylistic**) and semantics of linguistic expression (**semanticostylistic** of **lexicostylistic**)

Analysis of **linguistic - stylistic tools**, **Visual - stylistic**, **stilistico – metric**, **stilistico - phonic** indicates that the language of this writer distinguishes a unique writing style, very personal, language which has durability eptuese fonemore cattle, morphological, lexical and syntactic. Fisher used as the Gheg Albanian language text based on shkodranishten northwest with distinguished features and through its **Gheg** testified that indeed was one of the most diligent processors to its discoverer linguistic values of remaining alive but dormant assembled aside from, **language book** a depository that this extraordinary Fisher sent him back to common language Albanian.

Stylistics morphological Fishta quite effectively exploits the stylistic effect of **lexicon - gramtikore** main categories and in addition he harmonizes various forms gramatikore which means he transforms into poetic literary structures. Unbroken noticed and regular rhythm poetic structures, completion informative text, staggers and consumed linguistic units, the prevalence of nominal sentences etc.

Finally, Fisher has a particular **style**, the **përdalluar** clearly expressed through the uses of units, vehicles stylistic language in a totally personal way, which is deliberately obtained at all levels of language (phonological and phonetic, morphological and formative, Syntax the textual and lexical and semantic).

Metodologjia

Metodat që janë përdorur në këtë punim janë të larmishme si:

metoda e analizës dhe sintezës: kryesisht është përdorur për caktimin temës, vjeljen materialit teorik, caktimin bibliografisë, ku janë shfrytëzuar një sërë librash me autorë të ndryshëm.

metoda statistikore ose metanaliza për nxjerrjen e rezultateve statistikore të fjalëve në studim, me ndihmën e programit kompjuterik EXEL 2007.

Për arritjen e përfundimeve kemi shfrytëzuar një literaturë mjaft të gjerë, që përfshin si studime monografike ashtu edhe studime filologjike me autorë të ndryshëm.

Objekti i këtij studimi është shqyrtimi i tekstit poetik të Fishtës në tërësinë e vet shtresore, në shtresat ndërtimore dhe kuptimore. Një tekst poetik përbëhet prej strukturave të ndryshme ndërtimore, duke filluar nga fjala, vargu, strofa figurat, tipat e ligjërimit, idetë poetike etj., e të gjitha këto shtresa ofrojnë mundësi të mëdha studimore të tekstit poetik. Së pari, do të vështrohet struktura e ligjërimit, pastaj struktura e stilit duke përfshirë vargun, strofën, si dhe motivet e poezisë. Analiza e mjeteve gjuhësore-stilistike, figurative-stilistike, stilistiko-metrike e stilistiko-fonetike dëshmon se gjuha e këtij shkrimtari dallon një stil të veçantë shkrimi, tejet vetjak, gjuhë e cila ka qëndrueshmëri eptuese të gjedheve fonemore, morfologjike, leksikore e sintaktike.

Një analizë e tillë e strukturave të veprave do të jetë baza më e mirë për gjykimin e përgjithshëm dhe sintetizues dhe për vlerësimin e lirikës së Fishtës. Kjo do të thotë se deri në njëfarë mase do t'i përmbahemi demontimit të veprës letrare në struktura dhe njësi të vogla dhe pasi ato të jenë studiuar si të tilla, në montimin e saj të ri dhe në zbatimin e rregullave dhe të kufijve të ndërtimit të kuptimit të veprës. I konceptuar në këtë mënyrë, ky studim do të jetë sfidë për studimet e Fishtës, të cilat, në pjesën më të madhe janë ndërtuar mbi një metodë të përmbysur: është vlerësuar vepra pa u njohur sa duhet në brendinë e vet. Shqyrtimi studimor i veprave të Fishtës, përveç njohjes së vlerave të vet poezisë, mund të ndihmojë shumë fuqimisht edhe në pozicionimin e Fishtës në rrjedhën e letërsisë. Kjo vazhdon sot e tutje të jetë një çështje e hapur, ndërsa vetëm **"Lahuta e Malcis"**, padyshim kryevepra e Fishtës dhe kryevepra epike shqiptare, nuk mund ta pozicionojë Fishtën në këtë apo atë shkollë a drejtim letrar, në këtë apo atë lëvizje letrare, në këtë apo në atë vend në historinë e letërsisë shqipe. Dy vepra të tjera të njohura të Fishtës përmendim gjithashtu **"Mrizi i Zanave"** dhe **"Vallja e Parrizit"** ku ndihet dora e autorit në radhitjen e poezive sipas një qëllimi të caktuar poetik. Lexuesi i sotëm thjesht nuk ka idenë si duket poezia e pastër e Fishtës apo poezia e vërtetë e tij, edhe pse ai mund ta ketë në dorë librin e veprave përkatëse. Poezia perceptohet para së gjithash si fizikum, materie, shkronjë a varg e strofë, e vetëm pastaj si ide, mesazh apo si figurë.

Sa ishte vetë gjallë, ishte shumë i njohur për satirën dhe sarkazmën, për talljet dhe ironinë që bënte mbi kurriz të të gjithëve, por edhe të vetin, ose më mirë, mbi kurriz të shqiptarëve, të cilët në kohën e tij e përjetonin trazicionin politik, moral, social, etik e kombëtar, si shoqëri që po kalonte nga një gjendje robërie osmane në një shtet dhe në një shoqëri të lirë, një shoqëri në kërkim të identitetit të ri. Poeti, prozatori, publicisti, përkthyesi, njeriu euridit, Gjergj Fishta ishte dhe mbetet një ndër personalitetet e rralla që përjetuan lavdërimet dhe mohimet më të skajshme. Fishta ka arritur më shumë se tjetërkush në letërsinë e kohës që shprehjen letrare, në gjuhën dhe në stilin, në mprehtësinë e fjalës, në intensitetin e brendshëm të strukturës artistike të sjellë shpirtin e gjallë të njeriut shqiptar përmes gjuhës, përmes fjalës së tij

Gjuha

Fishta është mjeshtër i gjuhës. Këtë e dëshmojmë në shumë rrafshe të shqyrtimit që është bërë. Ai e mbizotëron mjeshtërisht gjuhën dhe ia nënshton për mrekulli synimeve të veta. Kjo e bën Fishtën poet të madh. Autori nuk krijon ide të mëdha poetike, as nuk krijon ide të reja poetike, nuk krijon drama të veprimit apo drama të personazheve të tij. Ai arrin që, me fuqinë shprehëse të fjalëve të krijojë imazhin e ferrit e të parajsës. Lirika e tij karakterizohet me depërtimin e thellë të fjalës në idenë poetike, pra me një përputhje të fortë në mes të fjalës e tingëllimit të saj dhe idesë poetike. Fishta ngadhënjën me gjuhën, me fjalët, me figurat, me shprehshmërinë e fortë të gjuhës, me shumë kuptueshmërinë e fjalëve.

-Fraza shqipe e Fishtës është tharm i brumit shqip dhe është e marrë nga një krahinë malore shqiptare, Zadrime, një krahinë e ruajtur maksimalisht prej ndikimeve të huaja gjuhësore. Fraza shqipe në këtë krahinë duhet të bartë në vete filozofinë e vjetër të ligjërimit shqip dhe natyrën e atij ligjërimit. Prandaj në këtë gjuhë ka me shumicë thirrje, mallkime, urime, pasthirrma. Sabri Hamiti, pasi ndanë dy koncepte themelore të ligjërimit në poezinë e Fishtës, Urimin dhe Mallkimin, thotë se që të dyja, si struktura të komunikimit burojnë nga letërsia gojore. Duhet të theksohet edhe një çështje: fraza shqipe e Fishtës nuk dallon për asnjë grimë nga epika në lirikë. Kjo do të thotë se Fishta e

ka mbizotëruar aq mirë frazën shqipe saqë edhe ligjet e gjinive letrare ua nënshtron ligjeve të frazës shqipe. E kjo nuk ndodh aspak edhe me marrëdhëniet fjala shqipe-metrika.

-Karakteri i ligjërimit hetohet fund e krye në poezinë e Fishtës. Stili i tij është i krijuar sipas nevojave politike, morale, shoqërore, etj., të autorit për të komunikuar me auditorin dhe e kundërta. Poezinë e vet Fishta ja drejton auditorit, shqiptarëve, me të cilin ai komunikon. Kjo shihet më së miri në faktin se poezia e Fishtës është e lidhur ngushtë me ngjarjen e kohës, me çastin. Poezia e tij lirike është si një lloj dialogu latent në mes të poetit dhe lexuesit. Ligjërimi i tij është domosdoshmërisht retorik, me trajtë thirrjeje e vlerësimi, moralizues e didaktik. Fishta i jep karakterin komunikues, ligjërimit e vet e bën të hapur, fjalinë dhe fjalën e vet e bën të kuptueshme dhe prej lexuesit më të thjeshtë, ndërsa idetë e veta poetike i bën të tejpushme. E tërë kjo i krijon atij mundësinë e komunikimit me publikun që është personazhi kryesor, të cilit i drejtohen të gjitha mesazhet e autorit të vërtetë, pra Fishtës.

-Parimi i kundërshtisë si strukturë ligjërimit vjen nga sfera morale e filozofike e Fishtës: kundërshtia në mes të mirës dhe të keqes, në mes të trimërisë, burrërisë, besës e virtytit, në njërin anë dhe, vesit ndrydhjes, tradhtisë, lajkës, në anën tjetër; në mes të ekzistues dhe asaj që do të duhej të ekzistonte a që e mëton autori etj. Në sferën morale e filozofike, këto kundërshti e krijojnë shëmbëllimin e dëshiruar nga poeti, ndërsa si strukturë tekstore e poetike, të shpeshtën e herëve krijojnë efekt të madh. P.sh.: tek poezia *Surgite, mortuil*, ku paraqitet indiferenca e shqiptarëve përballë kërcënimit real për zhbërjen e botës së tyre:

Imazhi i parë:

*Shqyptarë, a ndiet? Europa, mrrutë e ndyt,-
Shkerdhye me errej t'Parisit e t'Londonit,
E bani gjyq, qi t'nipat e Kastriotit
Shkjevjet t'Ballkanit urë t'u rrijn mbas sotit.*

Imazhi i dytë:

*Shka bajn Shqyptarët?...Han fiq e kastraveca:
E pijnë mastikë, e qesin petlla n'uej;*

Ndërtimi kundërshtues i strukturës ligjërimitore në këto vargje është i dyfishtë: së pari kundërshtohet imazhi i zhbërjes me imazhin e mosveprimit të shqiptarëve; së dyti kundërshtohet domosdoja e veprimit dhe fakti i mosveprimit të shqiptarëve. Ndërtim i tillë struktural i tekstit është pothuajse parim krijues i Fishtës. Te Fishta krijimi i ligjërimit mbi parimin e kundërshtisë së strukturave shprehëse, rezulton me një tekst poetik energjik e të shpejtë, me një shprehshmëri dinamike, e cila vjen duke i rritur vlerat kundërshtuese të së mirës dhe të së keqes.¹²⁴⁴

-Teksti poetik si dialog jepet mes poetit dhe publikut. Aktori i dytë i dialogut, shoqëria, është pasive, ai vetëm dëgjon, edhe atëherë kur vepron sillet sipas porosisë së poetit, nëse nuk vepron sipas porosisë së poetit, poeti e mallkon, e shanë dhe e përbuzë. Ndërsa aktori i parë është strumbullari i tërë imazhit. Ai vepron, flet, krijon, krahason, përgjason, luan me fjalët. Dialogu, forma bisedore e ligjërimit në mes dy vetash, e cila në thelb është filozofia e ligjërimit në këngët e epikës popullore, e mbizotëron çdo strukturë tjetër të ligjërimit.

¹²⁴⁴ Fishta, *Piksime estetike mbi artin e fjalës*, Shpresa, Prishtinë, 2003, f. 20.

-**Stërzgjatja e tekstit poetik** vërehet më së shumti në epikën e Fishtës "Lahuta e Malcis", ku ka pjesë të stërzgjatura e të cilat i rrezikojnë idetë themelore poetike të autorit dhe e humbin rrëfimin në digresione dhe në stërhollime të panevojshme. Kjo mungesë e ndjenjës së duhur për masën nuk mund të merret në asnjë mënyrë si parim krijues i poetit, sikurse në rastin e supozuar të diskontinuitetit të qëllimshëm epik, sepse në çdo rast dhe në çdo formë vetëm e dëmton veprën. Te Fishta stërzgjatja e tekstit poetik është pasojë e mospunës së madhe të Fishtës në vargjet dhe në veprat e shkruara. E vërteta duhet të jetë ashtu: natyrisht që Fishta kishte ndjenjën e masës, sepse nuk mund të shkruante vepra të mira pa e pasur këtë ndjenjë, por ai nuk e kishte vullnetin ose kohën për t'i përpunuar sa duhet veprat e veta, prandaj vende vende e lë tekstin e vet poetik të stërzgatur, e cila kjo stërzgjatje shndërrohet në degjenerim të artit të vërtetë të tij.

Ligjërimi dhe llojet e tij

Fishta, më shumë se asnjë poet tjetër shqiptar, ka në tekstin e vet poetik llojshmëri tipash ligjërimi. Ai i thyen kufijtë e ligjërimit tradicional dhe krijoi disa tipa të ligjërimit:

-**Ligjërimi thirrur (eksklamativ)**: Në pjesën më të madhe të poezisë së vet, sidomos në ato patriotike, Fishta e vazhdon traditën rilindëse të ligjërimit thirrur. Kur shkruan vargun, ai ka parasysh auditorin dhe i drejtohet atij drejtpërdrejt: *Shqiptarë, a ndiet? Me këtë thirrje e fillon ai poezinë Sugrite, mortui!...*, për të vazhduar në komunikimin e drejtpërdrejt.¹²⁴⁵

*Ktu, ktu Shqyptarë!... A ndiet? Ku u kam...ku jeni
Mo'leni, burra!... M'armë!... Mbaroi Kosova!...
Ah! M'kambë, bre burra! m'kambë! Shka jeni shehun
Nder furka t'gravet...*

Përdorimi i fjalëve të shkurtra, thirrjeve, përdorimi i fjalëve thujse të këputura përgjysmë, përdorimi i tri pikave, si zëvendësimi i asaj që s'ka kohë e as rëndësi të thuhet, krejt ky orkestrim pra, e krijon edhe më shumë dramaticitetin e çastit dhe shpejtësinë e veprimit. Ligjërimi thirrur, që komunikon drejtpërdrejt me auditorin, është ligjërimit pa nuanca. Ai është ose pohues, ose mohues. Vargu i Fishtës ka një ngarkesë emocionale, ashtu sikurse edhe poezia e romantikëve shqiptarë. Ky tip ligjërimit krijohet me anë të thirrjeve, pasthirmave thirrrore, me format e ligjërimit dialogues, me anë të apostrofit, personifikimit, përmes nxitjes etj. Ky ligjërimit mbizotëron në poezitë e Fishtës sepse poezia e tij është e angazhuar në proceset shoqërore e politike.

-**Ligjërimi sipëror (himmizues)**: Fishta himnizon atdheun, gjeografinë e tij, tërësinë e tij fizike. Ai himnizon shpirtin e atdheut, vlerat dhe simbolet morale, historike e kombëtare të tij: gjuhën, lirinë, flamurin, shqiptarin, luftën e shqiptarit për liri etj. Por, në të dy rastet himnizimi i atdheut te Fishta nuk është vetëm një përmallim, për të ngritur ndjenjat e shqiptarëve, ai është një besim dhe vetëdije:

*T'falem, Shqypni, ti i shpirtit t'em dishiri!
I lum njëmend jam un n'gji t'and tue rrune,
Tue gzue t'pamt t'and tue t'hjekë atë aj t'kullue...*

-**Ligjërimit predikues**: Derisa poezia e Fishtës komunikon drejtpërdrejt me publikun, lexuesi i saj nuk është një, në kuptimin një lexues, por është shumësi, në kuptimin shumë

¹²⁴⁵ E. Çabej, *Studime gjuhësore VI*, Rilindja, Prishtinë, 1977, f. 17.

lexues të përnjëhershëm, është publiku. Fishta nuk thotë *shqiptar a ndjeve*, po *Shqyphtarë a ndiet*. Ky përcaktim i Fishtës për shumësin ka të bëjë me karakterin predikues të ligjërimit të tij. Ai është predikues. Ai mban predikime poetike. Në tërë poezinë e tij ai ka një qëllim imanent: ta bindë lexuesin në atë që thotë. Kjo është pak e çuditshme për një poet të madh dhe kjo do një analizë më të thellë. Ka shumë mënyra e trajta të predikimit dhe të bindjes së të tjerëve ndaj një ideje a pikëpamje, cilado qofshin ato pikëpamje. Në gjuhën poetike të Fishtës ky tip ligjërimi mbizotëron: ai shfaqet në hyrje të poezive, në mes dhe në fund të tyre; mund të shfaqet në disa vargje të një poezie, po mund të shfaqet disa herë brenda një poezie. Zgjidhja e çështjes se pse Fishta, si poet i madh që ishte, imponohet në tërë poezinë e tij me ligjërimit predikues, është e rëndësishme jo vetëm për poezinë e tij apo për letërsinë në përgjithësi, por edhe për vetë karakterin njerëzor të Fishtës. Fishta nuk ka predikuar idetë e veta, por ai e krijon tipin predikues të ligjërimit për vetë ligjërimitin, sepse ai tip ligjërimit është a priori më i imponueshëm.¹²⁴⁶

-Ligjërimit bisedor: Ky tip ligjërimit krijohet:

- me përdorimin e shumtë të shprehjeve me pjesëzat *po* dhe *jo* (*po, jo...; jo, po...; jo, jo...; po, po...;*);

- me përdorimin e shpeshtë të nyjës *të*, e cila del gati si gjithmonë si *t'*

- me përdorimin e madh të pjesëzës së përcjellores *tue*, psh: *Tue gyue t'pamt tand*

- me ligjërimitin shkaksor, p.sh.: *Prandaj, për peng miqsijet... Prandaj arsyje...*

Këto struktura bisedore nuk arrijnë ta mbajnë fuqinë e vargut dhe fuqinë e ideve poetike të vargjeve e të strofave. Arti zbret nga madhështia e fjalës së vet dhe bëhet një lloj gjuhe:

Jo, po: a s'desht djalli Shqypni?

Jo, po: a s'dasht hasmi Shqyphtarë?

Qe, pra, sod po ka Shqypni;

Qe, pra, sod po ka Shqyphtarë.

-Ligjërimit vajtues (dëshpërues): Vaji i Fishtës është këngë, po në të cilën me gjuhë të ashpër e të hidhur, me intensifikimin e përdorimit të thirrjeve, pasthirmave, frazave thirrëse, frazave urdhëruese, frazave mallkuese, frazave përbuzëse e fyese, frazave dëshpëruese deri në një mohim të plotë të gjithçkaje, poeti krijon një tip ligjërimit vajtues, mjaft prezent në letërsinë popullore të Veriut:

E mbas sotit Shqyphtarët n'gjuhë t'huej do t'flasin:

Egiaksvet t'vet do t'bajn kta t'u ngjatët jeta?

Hajnat lapera zotni do t'i thërrasin,

E t'pa rodit do t'i apin pagë e t'dheta;

Me armë shqyptare, n'za gjithmonë e n'namë,

Sogje Shqypitari shkjaout do t'rrij sod m'kamë.

Ah vaj! Ah kob! A ka ma zi n'ketë jetë?

A ka si i bahet kuj ma tepër dhunë?...

(Surgite, mortui!)

Këto vargje janë këngë vaji të Fishtës. Kështu janë edhe poezitë *Nji gjamë desprimit!...*, 28 *Nanduer* 1913 etj. Ky vajtimit nuk është elegji as në kuptimin teorik të këtij lloji poetik, po as në kuptimin tradicional shqiptar. Fishta nuk vajton në kuptimin elegjiak: vaji i tij është më tepër mlllef, kërcënim, urrejtje ndaj të keqes; është nxitje dhe kurajo për të tjerët që të

¹²⁴⁶ Sala, Kujtim M., *Shënimet e Fishtës*, AJKD, Prishtinë, 2002, f. 25.

përballohen me të keqen; dhe vetëm në fund është nganjëherë dëshpërim ndaj të keqes apo ndaj shqiptarëve që e pranojnë të keqen, e ky dëshpërim nganjëherë e arrin kulminacionin, duke kaluar në mohim.¹²⁴⁷ Po edhe kur dëshpërohet e mohon Fishta nuk dorëzohet, ligjërimi i tij përsëri është ai i luftëtarit.

-Ligjërimi vlerësues: Ky ligjërim krijohet kryesisht mbi krahasimin. Krahasimi, si figurë, ka lidhje shkakore me vlerësimin. Nëse dy gjëra krahasohen mes vetish, si pasojë krijojnë edhe marrëdhënie vlerësuese. Marrim si shembull poezinë *Atdheu*:

*Por një fushë ma e blerët nuk shtrohet,
por një mal ma bukur s' rri,
ma i kulluet një lumë s' dikohet,
moj Shqypni, pors i ke ti.
N'ty ma i bukur lulzon Prielli,
janë ma t' kandshme stië e mot;
n'ty bylbyli pa le dielli
k'ndon ma amel t' Madhit Zot.*

Si shihet edhe nga këto vargje, aty ku ka ligjërim vlerësues ka edhe nota epike të ligjërimin. Bashkë edhe me disa prej tipave të tjera të ligjërimin, edhe ky ligjërim i jep notë epike lirikës së Fishtës. Aty ku nuk ka ligjërim vlerësues shpërthen më shumë lirizmi i Fishtës.¹²⁴⁸

-Ligjërimi mallkues: Mallkimi, qoftë si frazë, qoftë si strukturë ndërtimore e ligjërimin rri pranë ligjërimin vajtues dhe atij vlerësues. Ky ligjërim ndërtohet përmes shprehjeve mallkuese si një mendësi mohuese ndaj të keqes dhe jo si një nënshtrim dhe dorëzim para të keqes absolute.

Ligjërimi mallkues është i pranishëm gati në gjithë lirikën e Fishtës dhe bashkëfunksionon me të gjithë tipat e ligjërimin. Kur mallkon, Fishta nuk është politikan, madje as patriot tradicional. Kur mallkon ai është njeri, humanist, besimtar i Zotit, i cili nuk e pranon të keqen. Te Fishta mallkimi është fuqi e gjuhës për të shprehur shkallën e lartë të së keqes.

*Mallkue kjoftë hera, n't' cillen shkau pik 's' parit
Vuni kambën dhunuese m' tokë t' Shqypnarit,
E mallkue kjoftë Europa! Ate e vraftë Zoti,
E e shoftë me fise, popuj e qytete;
(Nji gjamë desprimit!...)*

-Ligjërimi didaktik (moralizues): Vetë nocioni i këtij ligjërimi e përcakton efektin e tij, duke e lidhur, me asocionim, me katedrën, me klasën shkollore, në të cilën përballë njëri-tjetrit qëndrojnë mësuesi dhe nxënësi, ai që mëson dhe ligjëron, pra pedagogu dhe ata që dëgjojnë, mësojnë dhe kuptojnë, e që edhe mund të pyesin ndonjëherë, por gjithnjë në favor të nxënies së dijes dhe të të kuptuarit. Psh:

*Prandej, pra, n'e doni fisin,
Mali, bregu edhe Malcija*

¹²⁴⁷ Sala, Kujtim M., *Shënimet e Fishtës*, AJKD, Prishtinë, 2002, f. 27.

¹²⁴⁸ Po aty, f 30.

Prej njaj goje sod t'brohrisin:

Me gjuhë t'veten rrhoftë Shqypnija!

Ligjërimi didaktik shndërrohet shpesh në argument logjik të idesë poetike, apo të bindjeve e botëkuptimeve politike të poetit. Poeti fillimisht thotë idenë apo idetë e veta politike, duke i himnizuar ato; poezinë e përfundon me lidhëzat pra, prandaj etj., pas të cilave rendit thirrjen e vet që dëgjuesi t'i bindet idesë së fillimthënë.

-Ligjërimi ironizues: Jo vetëm në poezinë satirike, në të cilën Fishta fund e krye është ironik e sarkastik, si në strukturat ndërtimore ashtu edhe në ato kuptimore, po edhe në poezitë e tjera lirike ai ndërton ligjërimin ironizues. Edhe te poezitë himnizuese, edhe te ato vajtuese, ai krijon një si sfond ironizues të poezisë dhe mbi atë sfond ironizues ai krijon ligjërimin e vet poetik. Ligjërimi ironizues nuk shprehet si ironi e drejtpërdrejtë, si te poezia satirike, po si prapavijë e ligjërimin fishtjan.

Fjalësi dhe dialekti

Përdorimi i madh i fjalëve nëndialektore në veprën e Fishtës është hetuar qysh herët. Fishta shkroi me gjuhën e folur në Gropën e Shkodrës dhe me gjuhën e këngëve satirike qytetare shkodrane, me gjithë veçoritë nëndialektore e dialektore. Fjalësi nëndialektor nuk është faktori numër një që krijon vështirësi të leximit, ai paraqet një vështirësi serioze të leximit të veprës së tij, po nuk është as i vetmi e as më kryesori, si është thënë nga studiuesit.¹²⁴⁹ Fishta e pasuroi fjalësin e vet në një krahinë të izoluar malësorësh shqiptarë. Kjo krahinë i dha atij shumë fjalë të cilat nuk përdorëshin në anët e tjera shqiptare, por ishin shqipe ose me përdorim të lashtë në shqip. Me këtë fjalës ai jo vetëm që rriti fondin e fjalëve në përdorim, por dhe i dha një ngjyrë antike shqipes dhe hapi mundësi, që ato fjalë të vjetra të hyjnë në fondin e fjalësit shqip në përgjithësi. Përfundimisht, përdorimi i këtyre fjalëve në veprën e vet, nuk e zbeh atë vepër, përkundrazi e pasuron me diçka që u mungon shkrimtarëve të tjerë. Pra, ky nuk është gabimi i Fishtës e as e metë e tij.

Gjuha përbëhet nga tërësia e vet, pra edhe nga fjalësi i një krahine, sidomos nëse ajo krahinë njihet për ruajtjen e pastër të gjuhës. Fishta është ndër të rrallë artistë shqiptarë të fjalës që ka një fond shumë të pasur të fjalësit të vet. Shumësia e fjalësit, përdorimi i sinonimeve të shumta etj., i ndihmuan mjaft atij në krijimin e figuracionit të pasur poetik. Natyrisht, prej Fishtës nuk mund të merren të gjitha fjalët, sepse ai përdor edhe sinonime më të dobëta për fjalët ekzistuese, ose krijon fjalë të panevojshme dhe jofunksionale, ose lokalizma për fjalët ekzistuese e që kanë shtrirje në gjithë hapësirën gjuhësore shqiptare. P.sh.: për varreza, në poezinë *Ditën e të shuemvet* Fishta përdor fjalën *rrmajt*, e cila përdoret në Shkodër vetëm për të shënuar se ku janë varrezat e Shkodrës, po jo edhe për varrezat në përgjithësi. Prirja e Fishtës për fjalësin lokalist theksohet edhe në përdorimin e nocioneve *shekulli*, *rrethi* i *shekullit* dhe *rruzullimi*, të cilat shprehin gjithësinë.

Humbja e zanoreve ose bashkëtingëlloreve

Nganjëherë, edhe pse i matur saktësisht, vargu i Fishtës del i dëmtuar rëndë në shqiptim. Këtu nuk është fjala për vendin dhe rolin e theksit të cezurës, por për një fenomen tjetër

¹²⁴⁹ Dykro-Todorov, *Fjalori enciklopedik i shkencave të ligjërimin*, Rilindja, Prishtinë, 1984, f. 11.

që mund të quhet thyerje e natyrës së gjuhës shqipe.¹²⁵⁰ Kjo thyerje e natyrës së gjuhës shfaqet në eliminimin e zanoreve, dy e më tepër radhazi, në favor të ekuilibrit të rrokjeve, pra, të matjes së vargut:

Nëpër goll **t'kthellueshme t'hapët** Empirit (*Mbi vorr t'A.Anton M.Zannonit*, vargu 47)

T'ttanë shej' i madhnijes. (*Ngadhnyja e kryqit*, vargu 8)

E Ruzalemit u **shkmbye** (*Guravet të Jordanit*)

M'tkthielltat kala (*Guravet të Jordanit*)

...rod **thknd**illit (*Jerina...*,f. 203)

Nd'i t'dekun (ndonjë të vdekur) (emancipacioni i Kombit..., vargu 125)

Prirja e tillë fonologjike e Fishtës nuk është e rrallë: ndjehet në tërë poezinë e tij, diku më pak e diku më shumë e theksuar, por dëmtimi i natyrës së gjuhës është më serioz kur shmangen dy a tri fonema në të njëjtën fjalë. Në vargjet e tilla mbisundojnë bashkëtingëlloret, ndërsa zanoret tërhiqen, duke shkaktuar një shurdhim të vargut dhe gjuhës. Leximi i natyrshëm i këtyre vargjeve është pothuajse i pamundshëm, prandaj kjo edhe mund të shquhet si thyerje e natyrës së gjuhës shqipe.

Stili

-Epizmi në veprat e Fishtës:

Aq sa është folur për lirizmin e Fishtës në "Lahutën e Malcis' ", ndoshta edhe më shumë mund të flitet për epizmin në "Mrizin e Zanavet" dhe në "Vallen e Parrizit". Vetë ligjërimi i tij i paraprin rrëfimit epik më shumë sesa të shprehurit lirik. Këtu nuk është fjala në kuptimin plotë të lirikës dhe epikës si gjini letrare klasike, por për tipin e përgjithshëm ligjërues epik dhe lirik. Në këtë kuptim, në shumicën dërmuese të poezisë së Fishtës gjen vargje të llojit lirik të të rrëfyerit, si:

*Asht natë, e rreh veri,
termales s'rrëmbyeshme,
njaj rave së thyeshme
kush njetet, i mjeri?*

(*Meshari i Malcis'*)

-**Pyetja epike:** Ashtu sikurse në epikën popullore shqipe, edhe në gjithë epikën popullore të popujve të Ballkanit, në të cilat përdoret me të madhe pyetja epike, si një prej figurave që krijon gjallëri dhe dramacitet në rrëfim, edhe Fishta e përdor në lirikën e vet, në të njëjtën mënyrë e në të njëjtën strukturë dhe me të njëjtin efekt.¹²⁵¹ P.sh.:

*Shka kanë ra, thue, mbramë do valle,
qi atje larg, kah Nazareti,
kanë jebue n'për male e zalle?
E pse qiella, toka e deti
disi n'gaz sot janë stolisun,
për të cillën Shkrola flet?*

¹²⁵⁰ Dykro-Todorov, *Fjalori enciklopedik i shkencave të ligjërimit*, Rilindja, Prishtinë, 1984, f. 41.

¹²⁵¹ Vinca, Agim, *Kurs i teorive letrare*, Prishtinë, 2002, f. 5.

(Të lemtë e Zojës)

-Toposet sintaksore epike: Edhe në lirikë, sikurse në epikën e vet Fishtës përdor mjaft topose sintaksore, të bartura nga epika popullore. Ato janë formula të thjeshta frazore, të brumosura gjatë shekujve dhe të bartura nga brezi në brez si topose. Të tilla janë: *Qi kah bijte ai shkelte deka; Qi flakue (këndue, vajtue, dekë...) kanë...; Mo' leni burra!*, etj. Të këtij tipi janë edhe format e mallkimeve apo të thirrmeve etj. Këto topose, mallkime e thirrma nuk krijojnë strukturë epike por ato krijojnë imazhin e rrëfimit epik, krijojnë imazhin e dialogut dhe të veprimit.¹²⁵²

-Figuracioni i zgjeruar epik: Kjo është forma më e pranishme e epizmit në lirikën e Fishtës, një lloj digresioni në figurë, një figurë e zgjeruar që gati se krijon tablo epike, një figurë e bukur e krijuar me rrafsh kuptimesh të ndryshme, të kohëve dhe hapësirave të ndryshme, po që të gjitha bashkërisht krijojnë një imazh poetik dhe një ide poetike. P.sh.:

*I kuj do t'jet njai vorr, mbi t'cillin mvaret
Kunorë lulesh e blerët e qi madhnueshëm
Zotnon mbi fang t'mjeruem, porsi shatorja
E njaj Tyrani zemer-gur, cilli,
Mbi shegj Persijet pa kujdes pësttetun...*

Që të shihet më mirë gjerësia dhe digresioni i kësaj figure, po e ndajmë në pjesët përbërse:

1. rrëfimtari (*Uni, autori*)
2. vorri i stolitur me kunora lulesh të blerta, i një të riu të panjohur shqiptar
3. fang-i mjeruam (*tokë djerrë*)
4. shatori pers
5. tirani zemer-gur pers që rri mbi shegj (*qilim*)
6. tirani bën jetë hedoniste (*kandje t'prujtna*)
7. ushtari besnik vritet për lirinë e atdheut (*Persisë*)
8. mënyra se si vdes ky ushtar
9. varri i harruar i luftëtarit shqiptar (*në vijim të poezisë*)

Në këtë figurë ka krahasim pas krahasimi dhe metaforë pas metafore, ndërsa kuptimi poetik bartet që nga vargu i parë e deri te i fundit pa shkëputje. Kjo figurë krijon disa imazhe, apo edhe disa tablo, krejt të ndryshme apo edhe të kundërta në mes vete, por me një qëllim: krahaso kurorat e një varri të rregulluem për mrekulli me diçka që krijon imazh të keq, të dhunshëm e të përzier me krim. Vazhdimi i poezisë me imazhin e varrit tjetër, atë të heroit shqiptar, e qartëson edhe më tepër pse Fishta ka krijuar këtë imazh të keq që në hyrje të poezisë.

Ndërtimi i tekstit poetik

Tekstin poetik Fishta e ndërton në formën e një vize të drejtë. Kjo strukturë ndërtimore nuk ka rënie e ngritje, nuk ka fillim, kulminacion dhe rënie të intensitetit të ideve poetike apo të ritmit a figuracionit. Fishta nuk ka një rregull për ndërtimin strukturor të tekstit poetik. Në lirikën e Fishtës ka dramaticitet në shumicën e poezive të tij. Dramaticiteti në lirikën e tij krijohet me intensitetin e fuqisë së fjalës, me bymehen e saj apo tkurrjen e saj, po jo me idenë poetike dhe në ndërtimin e saj strukturor. Struktura e poezisë fillon me

¹²⁵² Po aty, f. 13.

fjalën në varg. Emërtimi dhe matja e vargut me këmbë është më tepër çështje e teorisë së letërsisë, çështje e inercionit tradicional sesa çështje e praktikave poetike në letërsinë shqipe. Në natyrën e gjuhës shqipe është rrokja dhe theksi, e jo këmba, njësia më e vogël matëse e cila krijon një kumbim apo i jep cilësi fjalës poetike, pavarësisht nga ndërtimi.¹²⁵³

Përfundime

- Fishta i ka sjellë gjuhës shqipe shumë fjalë të vjetra, të cilat mund të përdoren bukur në gjuhën e sotme shqipe. Ai është njëri prej poetëve shqiptarë që ka një fond shumë të madh të fjalëve në fjalorin e vet poetik.
- Ai përdor nganjëherë fjalë dhe forma shprehjesh nëndialektore pa nevojë dhe kështu e vështirëson komunikimin e lirikës së vet me lexuesin. Kjo vështirësi nuk ka të bëjë me dallimin kohor në mes të poetit dhe lexuesit të sotëm, e nuk ka të bëjë as me ndryshimet që kanë pasur në gjuhën shqipe me krijimin e gjuhës letrare. Kjo vështirësi komunikimi ka të bëjë parësisht me metrin e Fishtës: për shkak të matjes metrike të vargut të vet, Fishta krijon një efekt poetik që mund të quhet shurdhim i fjalës.
- Ajo që e veçon Fishtën nga poetët e tjerë dhe, njëkohësisht, e bashkon me poetët e mëdhenj shqiptarë, është të kuptuarit e gjuhës si art: Fishta është artist i gjuhës; gjuha e tij është më shprehëse dhe më e fuqishme në shprehje se te shumica e poetëve të tjerë shqiptarë.
- Në strukturën ligjërimore të Fishtës nuk ka një kufij të prerë në mes të të rrëfyerit epik dhe të të shprehurit lirik. Ai është lirik në epikë, po është epik në lirikë, ashtu sikur në shumë drama të tij nuk mund të tërhiqet një vijë e prerë në mes të të folurit dramatik dhe atij lirik apo epik.

Gjuha e tij e bukur, e fuqishme, shprehëse, kuptimplotë, në plotësinë e metrikës klasike nganjëherë rënkon si e plagosur, shurdhohet dhe krijon fenomenin e quajtur thyerje e natyrës së gjuhës shqipe.

- Fishta është më shprehë dhe më poet në tetërrokëshin tradicional shqiptar sesa në vargjet e tjera të përshtatura nga italishtja, edhe pse ato vargje, për shkak të prozës relative të theksave ritmikë, ofrojnë më shumë mundësi për llojshmëri të ritmeve.
- Pas shprehshmërisë së gjuhës fuqia lirike e Fishtës është përqendruar në krijimin mjeshhtëror të figurës. Figura e tij dallon për të mirë lirikën shqipe, për shkak të ndërtimit shumështrësor dhe përbërjes prej shumë elementeve, herë-herë të kundërta me njëra-tjetrën, po që si tërësi rrumbullakojnë idenë poetike të figurës. Kjo është figura e shtresëzuar e Fishtës. Nganjëherë, kjo figurë shndërrohet në një tablo të tërë poetike dhe në rastet më të shpeshta, këto tablo janë pjesët më të arrira të lirikës së Fishtës.
- Fishta nuk është vetëm sintetizues i traditës, por ai është edhe modern. Ai bën pjesë në grupin e poetëve shqiptarë të fillim shekullit XX që thyen traditën romantike të të shkruarit të poezisë. Vendi i tij në rrjedhën e letërsisë shqipe dhe në historinë e kësaj letërsie nuk mund të lidhet me emrin e një shkolle apo të një drejtimi letrar, cilido qoftë ai: romantik, klasikist apo neoklasikist. Demitizimi i

¹²⁵³ Hoxha, Hysni, *Struktura e vargut shqip*, Rilindja, Prishtinë, 1973, f. 28.

figurës dhe i veprës së tij është vetëm njëri prej parakushteve për të parë ato vlera të Fishtës së vërtetë.

BIBLIOGRAFI

1. Çabej, E., *Studime gjuhësore V*, Rilindja, Prishtinë, 1977.
2. Çabej, E., *Studime gjuhësore VI*, Rilindja, Prishtinë, 1975.
3. Dykro-Todorov, *Fjalori enciklopedik i shkencave të ligjërimit*, Rilindja, Prishtinë, 1984.
4. Fishta, Gj., *Vepra*, katër vëllime, Rilindja, Prishtinë, 1997
5. Fishta, Gj., *Vallja e Parrizit*, Kuvendi Françeskan, Gjakovë, 1995.
6. Fishta, *Piksimi estetikë mbi artin e fjalës*, Shpresa, Prishtinë, 2003.
7. Hoxha, H., *Struktura e vargut shqip*, Rilindja, Prishtinë, 1973.
8. Jaku, P., *Fjalori fishtjan*, Kuvendi, Lezhë, 2000.
9. Jaku, P., *Vlerat letrare në Lahutën e Malcis të Gjergj Fishtës*, Kuvendi, Lezhë, 2000.
10. Kabashi, E., *Gjergj Fishta, "Mrizi i Zanave"*, 1942, në *Jeta e re*, nr.11-12, 1990.
11. Kola, P., "Lirikat fetare të Atë Fishtës", parathënie në Gjergj Fishta, *Vallja e Parrizit*, KF, Gjakovë, 1995.
12. *-Lahuta e Malcis'*
13. *-Lirika* (1. Mrizi i Zanavet, 2. Vallja e Parrizit)
14. Sala, K.M., *Shënimet e Fishtës*, AJKD, Prishtinë, 2002.
15. Shuteriqi, Dh., *Metrika shqipe*, Prishtinë, 1968.
16. Vinca, A., *Kurs i teorive letrare*, Prishtinë, 2002.
17. Welek-Woren, *Teoria e letërsisë*, Rilindja, Prishtinë, 1982.

Recensues:
Prof.dr Gjovalin Shkurtaç,
Prof. dr Asllan Hamiti

GJURMIME NË HISTORINË E SHTYPIT SHQIPTAR DERI NË VITIN 1990

Can. Dr. Naile Demiri,

Kolegji UBT, Prishtinë &

Prof. Dr. Hamit Boriçi,

Universiteti i Tiranës, Shqipëri

Gazetaria shqiptare në Kosovë është relativisht e lashtë. Rrënjët e saj duhen kërkuar në fillim të viteve '70 të shekullit XIX, përceptuar e si histori e shtypit mbi Shqipërinë e atyre kohëve, kur u botua gazeta "Prizren".¹²⁵⁴ Me këtë të përjavshmenis kohështrirja e parëhistorisë së gazetarisë në Kosovë, që, në këtë studim - sprovë, e kemi konceptuar dhe emërtuar:

1. Parahistori

(Shtypi mbi Shqipërinë e viteve 1871-1888)

Tëpërjavshmet "Prizren" (1871-1874) e "Kosova" (1877-1888) dhe vjetari i Vilajetit të Kosovës ("Salname-i Vilayjet-i Kosova" janë botimet e para të shtypit në Kosovë.

Çfarë përfaqësonin këto të përkohshme?

Gazeta "Prizren" (1871-1874) ishte botim i administratës së vilajetit Prizren. Publikonte kronika dhe lajme nga jeta politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, arsimore, fetare, etj., por edhe artikuj të natyrës administrative, urdhëresa, akte zyrtare, dekrete, vendime ligjore e udhëzime. Numri i parë doli me 2/15 gusht dhe vijoi deri më 1874.

Gazeta e dytë, "Kosova" qarkulloi pa ndërprerje, nga viti 1887 deri në javën e parë të shtatorit 1888 në Prishtinë, dhe më pas, në Shkup, ku u transferua qendra e vilajetit.

Vjetari i Vilajetit të Kosovës titullohej: "Salname-i Vilayjet-i Kosova". Doli gjatë viteve 1878-1888. Vjetarët ishin "ditarë" të ngjarjeve; përmbanin informacion të gjërë bashkëkohës; pasqyronin shkrime për punët e administratës shtetërore; sillnin të dhëna për nëpunësit me emra e funksione, për gjyqet e gjykatat, për komisionin arsimor, shkollat e mësuesit, për të gjithë jetën në vilajete.

Bibliografi Palok Daka është i pari që vlerësoi natyrën shqiptare të këtyre tri të përkohshmeve, duke i përfshirë në "Bibliografi retrospektive e shtypitshqiptar e mbi Shqipërinë e viteve 1848-1944".¹²⁵⁵ Sadri Ramabaja arsyeton: "Pavarësisht se kush i botonte, çfarë orientimi kishin e kë përfaqësonin, këto tre botime përmbajnë të regjistruara gjëndjen, punët e bëmat e shqiptarëve, historinë e Shqipërisë të atyre viteve. Është kjo arsyeja kryesore që, në mënyrë të bazuar e të logjikshme, këto organe shtypi i

¹²⁵⁴Të dhëna relativisht të pasura sjellin: revista "Gjurmime albanologjike", Prishtinë, 1968, nr. 1, f. 171-183; dhe Dr. Emin Pllana –Perandoria osmane në fund të shek.XIX – "Vjetar I Arkivit të Kosovës, II-III, Prishtinë1970.

¹²⁵⁵Revista "Studime historike", T. 1971, nr.3, f. 144-145).

përkasin historisë së gazetarisë shqiptare dhe mbi Shqipërinë e asaj kohe".¹²⁵⁶Ndërsa studiuesi Sherafedin Hoxha shpreh mendimin, se viti 1871, kur nisi udhën e botimit gazeta "Prizren", "merret edhe si koha kur filluan t'i vihen themelet e para gazetarisë në Kosovë.¹²⁵⁷

Vlera kombëtare e tre botimeve të Kosovës rritet, po të marrim parasysh, se që nga vitet 1883 ato janë bashkëkohës me revistën "Fiamuri i Arbërit" të De Radës, që botohej në Kalabri (1883-1887); me revistën didaktiko-pedagogjike, kulturore e letrare në gjuhën shqipe "Drita"- "Dituria" të Stambollit (1884-1885); me të përmuajshmen "Arbri i Ri" të Palermos (1887); me gazetën "Drita"- "Lumina" të Bukureshtit (1887) dhe me fletoren e Bukureshtit "Shqipëtar"/"Albanezul" (1888-1903).

Argumentat:

Së pari, gazetat "Prizren", "Kosova" dhe Vjetari i Vilajtit të Kosovës, janë të parat organe të shtypit në këtë trevë etnike shqiptare, ku banonte dhe banon rreth 90 përqind e popullsisë shqiptare autoktone.¹²⁵⁸Në protestën e 24 majit 1878 të qytetarëve të Prizrenit kundër Traktatit të Shën Stefanit thuhet: "në vendin tonë, nëntë të dhjetat e popullsisë janë myslimanë shqiptarë dhe vetëm një e dhjeta përfaqësohet nga bashkatdhetarët tanë të krishterë, të gjithë të besimit katolik ose grek (ortodoks-H.B.)¹²⁵⁹

Së dyti, të tre këta periodikë i drejtoreshin audiencës shqiptare edhe pse në gjuhë të huaj. Ata kishin objekt pasqyrimi jetën e problemet e shqiptarëve dhe të Shqipërisë në gjysmën e parë të viteve '60 të shekullit XIX.

Së treti, problematika e tematika, si dy komponentët kryesorë të përmbajtjes në gazetari e publicistikë, kishin karakter shqiptar.

Së katërti, ato u shtrinë në kohë në një periudhë kur vetëdija kombëtare shqiptare ishte në rritje, kur përpjekjet për lëvizjet, kryengritjet e armatosura arritën kulmin me Lidhjen e Prizrenit (1878-1881).

Së pesti, sadoqë autoritet e vilajetit kishin vendosur censurën zyrtare, prapëseprap, nën ndikimin e "personelit" shqiptar apo me origjinë shqiptare, drejtëpërsëdrejti apo tërthorazi, në faqet e gazetës "Prizren" regjishtroheshin ngjarje dhe zhvillime politike, ekonomike, kulturore e shoqërore, që dëshmojnë për etninë dhe autoktoninë e kombësisë shqiptare, që ruante traditat dhe zakonet e të parëve, të gjyshstërgjyshëve të tyre.¹²⁶⁰Opinionit përgjithshëm shoqëror e, më tepër, veprimtaria aktive e forcave kombëtare, që mishërohej në përpjekjet e lëvizjet e mëdha politike, kulturore e shoqërore, kanë ushtruar ndikim të ndjeshëm në redaksitë e organeve të shtypit dhe drejtuesit e tyre. Shfaqja ose lindja e të parave organe të shtypit në Kosovë, gazetat "Prizren" e "Kosova", si dhe "Salname-të", ashtu si përmbajtja e tërë veprimtaria e tyre, mund të kuptohen dhe interpretohen drejtë, vetëm duke u nisur nga rrethanat e faktorët e brendshëm e të jashtëm dhe zhvillimet historiko-shoqërore në Kosovë.

2. Fletorja "Bashkimi i Kombit" pararendëse e shtypit shqiptar në Kosovë

¹²⁵⁶ Dr. Sadri Ramabaja - Të parat organe të shtypit shqiptar në Kosovë - Temë diplome -, Tiranë, f. 8, dorëshkrim.

¹²⁵⁷ Sherafedin Hoxha - Shtypi i kombeve dhe i kombësive të Kosovës, Prishtinë 1987, f. 173.

¹²⁵⁸ Dr. Qazim Lleshi- Qytetet e Kosovës-, studim monografik, Prishtinë, f. 251

¹²⁵⁹ Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1872-1912- Botim i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë - Tiranë.

¹²⁶⁰ Hamit Boriçi, Mark Marku - Historia e Shtypit Shqiptar - 1-, T. 2007, f. 97)

Në disa shkrime për zanafillen e historisë së gazetarisë shqiptare në Kosovë është konsideruar gazeta "Shkupi".¹²⁶¹ Nga një rivështrim i organeve të shtypit shqiptar të hershëm në trevat tona etnike, delse pararendëse e gazetarisë shqiptare në Kosovë ishte e përdyjavshmja "Bashkimi i Kombit".

Përpara se të sjellim argumentet për këtë tezë, kujtojmë se Porta e Lartë e Stambollit nuk lejoi botime në gjuhën shqipe në të trevat shqiptare. Përfundim të bënin vend të komunitet ortodokse e katolike shqiptare. Prandaj, në kohën kur perandoria osmane rrethohej nga presioni ndërkombëtar¹²⁶² për njohjen e disa të drejtave për kombësitë krishtere..., u bënë disa lëshime.¹²⁶³ Ndërsa kur Xhonturqit erdhën në pushtet shqiptarët fituan të drejtën e botimit e gazetave në gjuhën amtare. Dhe rradhas u themeluan, njëra pas tjetrës, disa të përkoshme në gjuhën shqipe. Manastiri u bë qendra e shtypit shqiptar. Manastiri përfshihej në Vilajetin e Kosovës asokohe me qendër në Shkup.¹²⁶⁴ Aty u botuan: e përdyjavshmja "Bashkimi i kombit" (1909-1910), Kalendari "Aferdita" (1909), "Lahut'e Malsis" (1910-1911) dhe "Drita" (1911-1912); ndërsa e përjavshmja "Shkupi". (1911-1912) në qytetin e Shkupit, qendër e Vilajetit të Kosovës. Asokohe "Tokat shqiptare u ndanë në 4 vilajete: i Shkodrës, i Janinës, i Manastirit dhe i Kosovës".¹²⁶⁵ Në ato vilajete "popullsia mbizotëruese ishte shqiptare, por kishte në viset periferike dhe pakica malazeze,, serbe, maqedonase e greke".¹²⁶⁶ Për çlirimin e "katër vilajeteve shqiptare duke ngritur popullin shqiptar në një kryengritje të përgjithshme" dhe "krijimin e formacionit shtetëror" kombëtar u vendos në janar të vitit 1912 në Kuvendin e Taksimit, mbledhje e fshehtë e një grupi personalitetesh politike shqiptare në Stamboll.¹²⁶⁷ Për zbatimin e atij vendimi, Hasan Prishtina organizoi dhe udhëhoqi kryengritjen e përgjithshme shqiptare¹²⁶⁸ që në korrik gusht 1912 "...çoi në çlirimin e qyteteve kryesore të Kosovës dhe kryeqendren e saj, Shkupin...".¹²⁶⁹ Këta faktorë politikë dhe ushtarakë i hapen rugë gazetarisë shqiptare në Manastir e Shkup.

Pse "Bashkimi i kombit" është pararendëse e gazetarisë shqiptare në Kosovë dhe jo gazeta "Shkupi", siç është njohur deri tani ?

¹²⁶¹ Profesor Pirraku, Veprimtaria letrare e gazetës "Shkupi", revista "Fjala", Prishtinë, 1979; Sherafedin Hoxha, Shtypi i kombeve dhe i kombësive të Kosovës (1871-1983), Prishtinë 1987, f.67-68; Hamit Boriçi-Mark Marku, Histori e shtypit shqiptar -1, T.2007, f.11; Sabile Keçmezi-Basha, Shtypi legal shqiptar në Kosovë (1945-1999), Prishtinë, 2009, f.32

¹²⁶² Marrëveshja anglo-ruse për reformat e reja në Maqedoni e qershorit – Fjalori Enciklopedik Shqiptar, botim i Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1985, f. 586

¹²⁶³ Ismail Eren- "Shtypshkronja e Vilajetit të Kosovës në Prishtinë",-revista "Gjurmime albanologjike", Prishtinë, 1968, f. 181

¹²⁶⁴ Shënim: Hyacinthe Hewcquard, konsull frances në Shkodër në dhjetvjeçarin '50 të shekullit XIX, Manastirin e quante si pjesë e gegërisë së Shqipërisë, Hekard shkruante "Shqipëria e Epërme përfshinë një pjesë të madhe të pashallekut të Prizrenit, të Manastirit dhe pashallekun e Shkodrës. Shih - Hyacinthe Hewcquard – "Historia dhe përshkrimi i Shqipërisë së Epërme ose i Gegërisë" 1885, përkthyer në shqip dhe botuar në Tiranë më 2008, f. 25. Po aty, Hekard shtonte: "Shqiptarët kanë jetuar në Shqipëri qysh prej kohëve më të lashta".

¹²⁶⁵ Fjalori Enciklopedik Shqiptar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë. 2009, f. 2886

¹²⁶⁶ Fjalori Enciklopedik Shqiptar i Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë, t. 1985, f.560

¹²⁶⁷ Sabri Maxhuni-Novosella, Kuvendi i Taksimit dhe lufta çlirimtare shqiptare 1912-1998/1999, f. 87

¹²⁶⁸ Fjalori Enciklopedik Shqiptar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, t. 2009, f.1372

¹²⁶⁹ Fjalori Enciklopedik Shqiptar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2009, f. 2560 .

Së pari, numri i parë i të së përdyjavshmes “Bashkimi i Kombit” doli në qarkullim më 10 shtator 1909, ndërsa e përjavshmja “Shkupi” dy vjet më vonë, më 29 gusht 1911.

Së dyti, “Bashkimi i kombit” botohet në gjuhën shqipe,¹²⁷⁰ ndërsa gazeta “Shkupi” dilte në dy gjuhë, “shqip e turqisht”.¹²⁷¹

Së treti, “Bashkimi i kombit” në programin me moto “Mbron të drejtat kombiare”, shpjegon se “...do të jetë fletë e kombit dhe e popullit shqiptar, e interesave të tij në çdo pikëpamje...do të punojë duke patur udhëheqës e nom Konstitucjen, e cila kërkon mbrohtësinë e lumturinë e Perandorisë osmane edhe të çdo kombi e neriu që gjëndet ndë të, pa vënë re komb, gjuhë e fe...”,¹²⁷² ndërsa punoi me moton “Pruen interes e kombit”, por fletorja “në të parë “gunën” e ka gjysëm shqiptare e gjysëm turke. Pamja shqiptare shfaqet në misionin e saj illuminist e diturak, për gjuhën e letërsinë shqipe;pamja tuke shprehet në premtimin se redaksia do të punojë “me shpirt e trup të pandamun nga mbretëria tone e lumtun” me të cilën “mbi 500 vjet që rojmë, të mirën e të keqen e kemi nda dhe do ta ndajmë sot e tutje më mirë”.¹²⁷³ E përjavshmja “Shkupi luajti rol të rëndësishëm për propagandimin e idealeve kombëtare shqiptare dhe ndërgjegjësimin e opinionit publik për qënien dhe të drejtat e Shqipërisë. “Gazeta “Shkupi” mbart e përçon idetë e problemet më të qenësishme të kohës në ato treva.”Kurt hemi Kosova,- shkruan “Shkupi,- marrim vesh, jo vetëm çka përfshinë fushën e Kosovës, por krejt Vilajetin e Shkupit, qi asht pjesa e Shqypenisë ma e bukura, por edhe ma e vjefshmja krahinë e Turkes n’Europë, si për tregti, ashtu edhe për kah politika’.¹²⁷⁴

3. Vitet 1913-1938 – periudhë “e bardhë”!

Kosova ishte njësi geografike, pjesë e Shqipërisë, me tërë shtrirjen e saj gjatë pushtimit osman deri më 1912, si dhe gjatë sundimit të mbretërisë së karagjorgjeviçëve, ka qenë region i ndaluar për gjuhën e shkruar shqipe. Ashtu si në pesë shekujt robëri, nën zgjedhën osmane, edhe nën sundimin tridhjetëvjeçar të mbretërisë jugosllave, “shqiptarët jo vetëm nuk guxonin të botonin asgjë në gjuhën e tyre, por as të zhvillonin format elementare të arsimit në gjuhën amtare”.¹²⁷⁵ Dhe nëse qarkullonte ndonjë gazetë në gjuhën shqipe “botohej ose ilegalisht në truallin e Kosovës, ose dilte jashtë territoreve të banuara me shqiptarë”.¹²⁷⁶ Kjo gjëndje u shtri gjatë viteve 1913-1941.

Me krijimin e shtetit artificial jugosllav, nën Mbretërinë e karagjorgjeviçëve, llava sllave e pansllaviste përfshiu të gjitha trevat etnike shqiptare: në Kosovë, në Mal të Zi dhe në Mqedoninë e sotme. Fuqitë e Mëdha i lanë dorë të lirë shovinizmit serbomadhpër çkombëtarizminin e sllaviziminin e shqiptarëve etnikë.Brënda 23 vjetëve 250.000 shqiptarë u dëbuan me dhunë.Shumica e tyre mërgoi në Turqi. Në emër të së ashtuquaturës “Reformë agrare” iu grabitën shqiptarëve 200.000 ha tokë, ku u instaluan 14.000 familje kolonësh sllavë me rreth 60.000 pjestarë.

¹²⁷⁰ Palok Daka, burim i cituar, f. 193

¹²⁷¹ - po aty, f. 200

¹²⁷² Hamit Boriçi-Mark Marku – Historia e Shtypit Shqiptar 1, T. 2007, f. 111

¹²⁷³ Gazeta “Shkupi”, 29 gusht 1911

¹²⁷⁴ Gazeta “Shkupi”, nr. 7, 15 tetor 1911

¹²⁷⁵ Sherafedin Hoxha - Shtypi i kombeve dhe kombësive të Kosovës (1871-1883), Prishtinë, 1987, f. 5

¹²⁷⁶ Sabile Keçmezi-Basha, Shtypi legal shqiptar në Kosovë (1945-1999), Prishtinë, 2009, f.31

Në ato vite "lindin" e "vdesin" gazeta e revista serbe e turke, si "Vardar", "Kosovo", "Kosovski bozhuri", "Kosovske novine", "Juzhna tribuna", "Osvitzh", "Juzhna zvezda", "Zbor za Kosovo", etj. Për shtyp shqiptar as që bëhëj fjalë.

Kësisoj periudha prej një çereshekulli (1913-1939) mbetet e bardhë në historinë e gazetarisë shqiptare në Kosovë. Problemet e kohës dhe përjetimet e shqiptarëve të Kosovës u ngriten dhe u trajtuan në median e shkruar jashtë Kosovës, në Shqipëri dhe në diasporë, sidomos në Rumani e Bullgari, ku u aktivizuan edhe një varg publicistësh kosovarë. Gjatë viteve njëzet duken firmat e para të gazetarëve kosovarë, që shkruajnë në gazetatat e revistat shqiptare dhe të huaja; ata që më vonë do t'i jepnin shtysë gazetarisë shqiptare në trevat e tyre atnore.

4. Fillet e gazetarisë së re shqiptare

Prizreni është vatra e gazetarisë së re shqiptare. Në këtë qytet, në muajt e parë të zaptimit fashist të Shqipërisë, në shtator 1939 u botua revista "Hylli", organ i nxënësve shqiptarë të Seminarit Katolik. Revista u shndërrua në një vatër kombëtare rreth të cilës u mblodhën fillestarë në lëmin e poezisë, të letërsisë artistike dhe të publicistikës.

E përkohshmja hyri shpejt në jetën shqiptare. Ajo u shndërrua në një vatër kombëtare rreth të cilës u mblodhën fillestarë në lëmin e poezisë, të letërsisë artistike dhe të publicistikës. E përkohshmja e Prizrenit hyri shpejt në jetën shqiptare. Në faqet e saj publikoheshin krijime, vjersha, skica, vizatime letrare e tregime të debutantëve të pasionuar edhe të gjimnazistëve jo seminaristë. Tematika ishte shqiptare dhe me karakter shoqëror. Autorët e ri bënë përpjekje që, në krijimet e tyre, të gërshetojnë subjektet fetare me ata shoqërore, duke ngritur e trajtuar problemet më shqetësuese të kombit shqiptar. Të 15 numrat e kësaj reviste, që qarkulluan gjatë viteve 1939-1941, ndikuan shumë në jetën letrare, kulturore e shoqërore; në ngritjen e vetëdijes kombëtare të rinisë prizrenase dhe më tej. Nismëtari, organizatori dhe botuesi i saj, Mark Krasniqi, do të shkruante më vonë: "drita e "Hyllit" xixëlloi në natën e errët të historisë së kulturës sonë".¹²⁷⁷

Fletorja "Kosova" e ngre në një shkallë të lartë cilësore gazetarinë shqiptare të kohës. Numri i parë i saj doli në qarkullim më 27 prill 1941. E përjavshmjai përmbajt programit të Komitetit "Kosova", organ i së cilës ishte. Motoja e saj, "Kosova patundësisht vendos m'u bashkue me Shqipni", pasqyrohej në vargjet e Vaso Pashës, që rënditën në krye të faqes së parë: "/Prej Tivari në Prevezë/,/Gjithku lshon dilli vapë e rreze/,/Asht toka jonë/,/Kush mos t'na preki/,/Se vdesim të tanë/".¹²⁷⁸

U botua me 4,6,8 e 12 faqe, në gjuhën shqipe, pjesërisht edhe italisht. Vijoi deri në nëntor 1944 me 59 numra. Përveç publicistit Bedri Pejani, që ishte edhe kryetar i Komitetit "Kosova", u afruan në faqet e kësaj gazete mjaft pena, intelektualë të rinj, si Jah Salih Elezaj, Petër Elezi me një varg shkrimesh për gjuhën shqipe, Zekerija Rexha, Dr. Rexhep Krasniqi, Profesor Filip Fishta, Niman Ferizi, Prenkë Gruda, Ibrahim Lutfi, Tonin Ndoca, etj. Ndër fletorarët profesionistë përmendim Mazar Sopotin e Petrit Petritin. Ky i fundit, siç shkruan gazeta, ishte një "reporter, ardhë posaçërisht prej Tiranë".¹²⁷⁹ Vëmendje u kushtohet shkrimeve e dokumenteve për etnitetin shqiptar të Kosovës.

20 marsi i vitit 1944 shënon një tjetër datë të rëndësishme për shtypin shqiptar në Kosovë, botimin e numrit të parë të gazetës "Lidhja e Prizrenit", organ i intelektualëve të rinj të

¹²⁷⁷ Profesor dr. Mark Krasniqi- "Hylli"- revistë shqiptare në Jugosllavinë e vjetër-, Revista "Jeta e re", Prishtinë, 1953, nr. 5, f.330

¹²⁷⁸ Gazeta "Kosova", Tiranë, nr. 8, dt. 8 qershor 1941

¹²⁷⁹ Gazeta "Kosova", Tiranë, nr. 22, dt. 23 shkurt 1942

Lidhjes II të Prizrenit. Në programin e saj prej 6 pikash theksohej se ajo kishte për mision propagandimin e përqëndrimin e gjitha energjiëve të kombit në një drejtim të vetëm: M'e mbajtë të lirë e t'padhunueshme tokën e Kosovës dhe me e mbrojtë nga çdo rrezik që mund t'i kërcënohet sod apo nesër" dhe "M'e predikue bashkimin e vllaznimitin e të gjithë shqiptarëve kudo që të jetojnë dhe çfarëdo tendence që të kenë".¹²⁸⁰ Në të 44 numrat e saj, fletorja "Lidhja e Prizrenit" i bëri jehonë mendësisë se "Shqipnia pamvarësinë e vet dhe sidomos Kosova lirinë e vet e ka fitue në saje t'ushtrisë gjermane të Adolf Hitlerit".¹²⁸¹ E përjavshmja drejtohej nga Tahir Zajmi. Në të bashkëpunonin intelektualë kosovarë të kohës, si Bedri Pejani, Ibrahim Fehmiu, Selman Riza, Shevqet Veliu, etj. E organizuar me rubrika fletorja pasqyronte problemet më themelore që lidheshin me historinë, traditat dhe qenien kombëtare të Kosovës.

Në Tetovë, që përfshihej në regionin e Kosovës, më 5 tetor 1944 duk dhe u zhduk me dy numrta "Zani i Sharrit", fletore me 6 faqe. Ajo e nisi jetën e shkurtër si e përjavshme politike, shoqërore e letrare, me lajme në gjuhën shqipe.

Gjatë viteve 1942-1944 në Kosovë mori jetë edhe shtypi ilegal antifashist nacionalçlirimtar. Ai përfaqësohej nga e përkohshmja "Lirija", që dilte në gjuhën shqipe dhe nga 2 simotrat e saj dygjuhëshe, shqip e serbokroatisht: "Zani"- "Gllas" dhe "Lirija"- "Slloboda". Profesor Ali Hadri njoftonte se në Prishtinë nga fundi i vitit 1942 doli edhe një gazetë antifashiste me emrin "Kroz borbu".¹²⁸²

5. Një sistem bashkëkohës i shtypit shqiptar

Periudha e pasluftës II Botërore përfaqëson shkallën më të lartë të ecurisë dhe të zhvillimit të shtypit tonë kombëtar në Kosovë. Që nga 12 shkurti i vitit 1945 kur doli në qarkullim fletorja "Rilindja", shkallë-shkallë, në Kosovë me kryeqendër Prishtinën, u krijua një sistem i plotë i shtypit shqiptar që, me gazeta e revista të veçanta ose me grupime të tyre, rrokte tërë sferat e jetës e të veprimtarisë politike, shoqërore, kulturore, letrare, artistike, ekonomike, juridike, shkencore, sportive, etj.

Tërësia e mjeteve të informimit e të komunikimit publik, media e shkruar dhe ajo elektronike, u zhvillua në disa faza. Praktika sugjeron si kohështrirje të parë gjysmën e dytë të viteve '40. Ajo zë fill më 5 shkurt 1945 me themelimin e radiopërhapjes së parë dhe shtrihet deri më 7 gusht 1990, kur policia dhe ushtria serbe sulmuan të përditshmen "Rilindja" të Prishtinës; faza e dytë përshkom dhjetëvjetshin e fundit deri më 23 mars 1999, kur trupat speciale terroriste të Beogradit ndërrmorën kryqëzatën e egër e barbare, genocidin kulturor ndaj institucioneve të medias shqiptare në Kosovë.

Gjatë fazës së parë, që nga pragvera e 1945-ës e deri në gjysmën e parë të vitit 1990, dolën e qarkulluan në të gjitha trevat e Kosovës 86 gazeta e revista informative, letrare, kulturore e shoqërore; 12 të përkohshme të profileve të ndryshme, tematike e problemore; si edhe 6 radiostacione lokale në varësi të Radio-Televizionit të Prishtinës. Në sistemin informativo-botues "Rilindja" me ndikim efektiv në gazetarinë shqiptare në Kosovë, përfshihej edhe Ndërmarrja e Përbërë "Rilindja" në kuadër të së cilës operonin 7 njësi e organizma teknike, teknologjike, ekonomike, tregtare, etj., me rreth 2.000 punëtorë: Ndërmarrja e Gazetës "Rilindja", ku botohej e përditshmja kryesore e Prishtinës; Ndërmarrja e Revistave Kulturore, Shoqërore, Arsimore e Shkencore; Ndërmarrja Botuese e Librit "Rilindja"; Shtypshkronja; Ndërmarrja Tregtare Import-Eksport;

¹²⁸⁰ Gazeta "Lidhja e Prizrenit", Prishtinë, 20 mars 1944, f. 1

¹²⁸¹ - po aty, 26 mars 1944, f. 1

¹²⁸² Prof. dr. Ali Hadri - Revista "Përpara", Prishtinë, 1972, nr.9, f.871

Ndërmarrja e Shitjes dhe e Reklamave; dhe, së fundi, Entik i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore.¹²⁸³

Pas daljes në dritë të gazetës "Rilindja" më 12 shkurt 1945, deri në fund të dhjetëvjetëshit '40, numri i të përkohshmeve në gjuhën shqipe është i kufizuar. Në dy vitet e parë të pasluftës u hodhën themelet e shtypit të përgjithshëm informativ, por edhe të atij të profiluar tematik e problemor, sipas konceptit sllavo-socialist për klasat e shtresat shoqërore të popullsisë në Jugosllavi. Në këtë kuadër nisen botimin tre organe shtypi në gjuhën shqipe: gazeta "Puna" (1945) me pretendimin si përfaqësuese e mendimit të klases punëtore të Kosovë-Metohisë; "Zëri i rinisë shqiptare" (1945-1999), revista jetëgjatë e Lidhjes së Rinisë Socialiste të KSA të Kosovës, më pas me titullin e reduktuar, "Zëri i rinisë"; dhe e përmuajshmeja "Pionieri" (1946), letrare e kulturore për fëmijë, shkollarë të rëndeve të para. Të kësaj natyre ishin edhe të përkohshmet "Ndërtuesi", "Bujku i ri" dhe "Agimi", që qarkulluan më 1949, me një interval kohor trevjeçar prej të parave. Me revistën "Jeta e Re", të po atij viti, i hapet shtegu medias me orientim letrar, kulturor e shoqëror. Si organ i Lidhjes së Shoqërive Kulturore-Arsimore për Kosovë e Metohi, luajti rol të rëndësishëm për gjallërimin e jetës intelektuale, të veprimtarisë së tyre në lëmë të letërsisë, të publicistikës, të kulturës dhe të historisë kombëtare.

Për gati dy dhjetëvjeçar media shqiptare, peng i politikës së Beogradit, ecën zvarrë, kufizuar në numër e ritmikë botimi. U jepet përparësi disa revistave dygjuhëshe, shqip e serbokritisht, si "Glasnik Muzeja Kosovo/Buletin i Muzeut të Kosovës", "E Drejta/Pravo" dhe "Kosova/Kosovo", botim i Entit të Historisë së Kosovës. Me përpjekjet këmbëngulëse të qarqeve pedagogjike e shkencore shqiptare u siguria leja e botimit të revistës "Gjurmime Albanologjike", themeluar më 1962 nga Katedra e Albanologjisë e Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës; dhe, më tej, e të përjavshmes "Fjala" (1968), organ i Lidhjes së Shkrimtarëve, të Artistëve dhe të Arkivave të Kosovës, e cila, shndërruar në një vatër, veçmas për rrethet e gjera krijuese letrare e studimore, e ngriti traditën shumëvjeçare të revistës "Jeta e Re" në një shkallë të re, më të lartë cilësisht. U deshën disa vjet që "Gjurmimet albanologjike" të çelnin brazdat e shkencës kombëtare, (numri 2 qarkulloi më 1965, pas një heshtjeje trevjeçare) duke dritësuar rrugën e studimeve gjuhësore, historike, etnografike, folklorike, etj, me aq përkushtim, posaçërisht që prej 1968-tës, kur kjo revistë dinjitoze përligjet si organ i Institutit Albanologjik të Prishtinës.

Rritje progresive njih shtypi shqiptar në vitet 1968-1973, që mund të përcaktohen si rilindje e dytë e tij. Me 18 të përkohshmet, që nisin udhë në këtë pesëvjeçar, përvijohen tiparet e një sistemi të medias bashkëkohëse me karakter kombëtar. Shquhen, mes të tjerave, e përmuajshmeja "Bota e re" (1968-1975), organ i Lidhjes së Rinisë Socialiste të Studentëve të Universitetit të Kosovës, tribunë e një falange të ardhshme shkrimtarësh, publicistësh e shkencëtarësh; e përdyjavshmeja "Shkëndia" (1971-1976) në faqet e së cilës u ngritën dhe trajtuan problemet më qenësore, arsimore, pedagogjike dhe shoqërore të Kosovës; revista "Kosovarja" (1972), organ i Konferencës Krahinore për aktivitetin shoqëror të grave të Kosovës; "Ekonomia" (1973), revistë për çështje të teorisë dhe të praktikës ekonomike, botim i Institutit të Hulumtimeve Ekonomike e Shoqërore, etj. Qarqet autoritare të publicistikës shqiptare të Kosovës shfrytëzuan situatat e krijuara në Jugosllavinë dhe në Kosovën e viteve 1974-1981, duke i hapur medias horizonte perspektive

¹²⁸³ Asllan Fazliu, "Rilindja, monografi, Prishtinë 1985

me dimensione të gjera kombëtare. Arritja më e shënuar është themelimi i Televizionit të Prishtinës, i cili i dha shtysë përmbajtjes kombëtare, gazetarisë dhe publicistikës me shtrirje tej caqeve të trevave të Kosovës. Ky institucion i medias elektronike gjatë 15 vjetëve u fuqizua vijimisht. Me bazën teknike dhe me aftësitë profesionale të forcave të saj krijuese u bë mbizotërues në jetën politike, kulturore, letrare e shoqërore të shikuesve të Kosovës. Përcillte 11 orë programe televizive të një cilësie bashkëkohëse. Ndërsa Radio-Prishtina në të tre kanalet e saj transmetonte 43 orë program. Në këtë rrafsh vlerësohet edhe Ndërmarrja Gazetare-Botuese "Rilindja", e cila, në rrjedhën e kohës, u shndërrua në një bazë të fuqishme tipografike për periodikun dhe për librat: për letërsinë, për kulturën, për shkencën dhe, në përgjithsi, për jetën shqiptare.

Kësaj periudhe i përkasin 27 gazeta e revista të reja, si e përmuajshmja "Bujku" (1978); "Dituria" (1974), revistë e studentëve të Kosovës; "Drita" organ i komunitetit katolik shqiptar, që vijoi të dilte në Ferizaj; "Studia humanistica" (1974), botim i Fakultetit Filozofik, shqip e serbokroatisht; "Libri shkollor" (1975), buletin i Entit të Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore; "Sporti" (1976) në gjuhën shqipe; "Horizontet e Historisë" (1977); "Kërkime gjeografike" (1979-1983); "Përpjekja" (1979-1981); "Lyra" (1981-1983), fletë e shoqatës së kompozitorëve të Kosovës; etj. Kësisoj në fund të viteve shtatëdhjetë u kristalizua sistemi i plotë i shtypit shqiptar në Kosovë.¹²⁸⁴

6. Kryqëzatë e genocid ndaj medias shqiptare

Tatëpjeta, regresi i medias shqiptare, të shkruar dhe elektronike, nis nga gjysma e dytë e vitit 1981.¹²⁸⁵ Në rrethanat e krijuara nga ridimensionimi i lëvizjes për të drejtat legjitime kombëtare të shqiptarëve në Kosovën etnike; regjimi serb, tashmë hapur e me agresivitet, ushtron trysni ndaj shtypit shqiptar. Një varg gazetash e revistash detyrohen ta ndërpresin botimin. Organet kryesore të shtypit qëndror, gjatë stisjes së procesit të diferencimit politik e ideologjik edhe në gjirin e gazetarisë shqiptare, u përballën me vështirësi të shumëllojshme, denigruese e frenuese.

Në javën e parë të pranverës, arradhat e ushtrisë, të policisë dhe të forcave paramilitare serbe, me ferman të Millosheviçit në dorë, ndërmorën kryqëzatën - gjenocid kundër Kosovës shqiptare. Sinjali ogurzi u dha më 23 mars 1999, kur trupat speciale terrosite të Beogradit sulmuan institucionet e medias shqiptare në Kosovë. Paramilitarët serbë, pasi vranë nëpunësin e shërbimit të së përditshmes "Koha ditore", vodhën e shkatërruan gjithçka gjëndeje në godinën e saj dhe i vunë zjarrin. "Të njëjtin fat pësuan edhe ato pak organe të mediave që operonin me vështirësi në Kosovë"¹²⁸⁶

Kulmi arrin më 5 korrik 1990, kur policia serbe pushtoi godinën e radiotelevizionit shqiptar të Prishtinës; dëboi me dhunë 1300 punonjës, gazetarë, regjizorë, dramaturgë, kameramanë, montatorë, etj. Me urdhër të Beogradit u sekuestrua teknika e gjithçka ishte krijuar me djersën e punën e shqiptarëve të Kosovës: 40.000 m² truall, 15 komplete telekamerash, studiot moderne, përfshirë 2 transmetuesit radiotelevizivë në Golesh e Cvilen, si dhe 6 radiostacionet lokale (në Gjilan, në Mitrovicë, në Prizren, në Gjakovë dhe në Ferizaj). Gjithashtu u bllokuan dhe u grabitën xhirrollogaritë e Radio-Televizionit në

¹²⁸⁴ Eduard Dujaka, Vitet e Rilindjes, Prishtinë, 2013, f.

¹²⁸⁵ Zeqir Bekolli – Historia e bllokimit të gazetës "Rilindja", - Forumi Shqiptar, 31.08.2006

¹²⁸⁶ Genc Tirana-Mediat nën makinën e rëndë të luftës-, gazeta "Shekulli", Tiranë, 1999, 3 maj, f. 7

Bankën e Prishtinës. Në të njëjtën ditë e orë, reparte të policisë dhe të ushtrisë, ardhur enkas në Prishtinë, sulmuan edhe Ndërmarrjen Gazetare-Botuese "Rilindja". Mbas disa ditësh kjo kryqëzatë ushtarake u "përligj" me vendimin e Kuvendit të Serbisë të datës 23.07. 1990, për masa të dhunshme ndaj organeve të medias së shtypur dhe elektronike shqiptare në tërë shtrirjen e saj.¹²⁸⁷ Kryqëzata mesjetare serbe ndaj medias u përmbyll me 7 gusht 1990 me sulmin ndaj të përditshmes "Rilindja" të Prishtinës, duke shkelur traktate e nome ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut.

Recensentë
Prof. Aso. Dr. Fatmir Tartale
Prof. Dr. Sabile Keçmezi- Basha

¹²⁸⁷ Frrok Kristaj – RILINDJA – Abetare e gazetarisë-, Prishtinë, 2009

LEXUESI INTERPRETUES PËRBALLË VEPRËS SË ZHITIT

Neim Zhuri

Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan

Në krye të faqes së parë të romanit "Funerali i pafundmë", aty ku mund të ishte prologu, ose në mos, të paktën një epigraf, autori shkruan:

altoreliev
i një metafore
me bronz të munguar

Nuk kemi të bëjmë me një epigraf, që ti si lexues i vëmendshëm do dëshiroje të ishte, sepse do të të jepte mundësinë e një leximi prapakthyes dhe do e kishe më të lehtë të shkoqisje domethënien e tekstit, dhe gjallërisht të merrje pjesë në përpilimin e kuptimit të tij. Apriori do të duhet të merresh me një tekst, interpretimi i të cilit kërkon zberthim aluzionesh dhe atje ku duhet të ishte jo domosdoshmërisht një prolog, në të vërtetë është "një fletë e grisur nga fundi për tu lexuar në fillim". Kjo fletë "e grisur nga fundi..." nuk shënjon veçse mirazhin tragjik të një tufe ikanakësh drejt absurdit. Nuk thuhet nga vinin, pse bujtën në këtë "fushë të tërë" dhe ku shkonin? Në këtë fletë "të grisur" nuk ka asnjë kumt, asnjë pohim. Ndërkaq ka nisur "udhëtimi i zi" dhe vjen ndërkohë edhe pohimi i parë: "të ikësh larg... sa më tepër këmbë aq më pak lodhje... kokët janë të rrezikshme. Të menduarit ndryshe gjithmonë prish punë..."¹²⁸⁸

Dhe ti që ke marrë përsipër të bësh lexuesin interpretues ndihesh një cast i entuziasmuar mbas këtij pohimi, mendon se ke gjetur fillin që do të shturë lëmshin e kësaj loje të imagjinatës. Sapo e ke vendosur një lidhje mes tekstit dhe autorit. Shumë vite burg për shkak se pat menduar ndryshe "rrugëtimin e bën më të lehtë mendimi i njejte, i vetëm, i përbashkët"¹²⁸⁹ Ky tërthoritet ligjërimi në rastin e aluzionit të përcaktuar kërkon njohje, pse jo dhe erudicion të lexuesit, për të çkoduar tekstin. Ndiheh në të njëjtin siklet që do të ndihesh po të të kërkonin të interpretoje "Kumtin Perandorak" të "Kështjella" e Kafkës. Kumtari që e merr kumtin nga perandori, i cili dergjet në shtratin e vdekjes, nisat për ta çuar atë tek ata që bëjnë hije nën diellin perandorak. Sakaq, perandori ka vdekur dhe atij i duhet të çajë muret pengues që krijojnë grupet e spektatorëve të cilët janë mbledhur për vdekjen e tij. Atij i duhet të hapë rrugën, por mizëria shtrihet shumë larg, numri i njerëzve nuk ka të mbaruar... ai akoma është në dhomat e brendshme të pallatit, nuk dihet nëse do të dalë ndonjëher prej tyre, por edhe sikur, më tej vijon një pallat tjetër, pastaj një tjetër... gjithandej porta, shkallë, oborre. Askush nuk ja hap rrugën dhe ai do të çonte një kumt, kumtin e një njeriu të vdekur... pas tij shtrihet kryeqyteti i perandorisë.

¹²⁸⁸ Visar Zhiti, Funerali i pafundmë, shtepia botuese OMSCA, Tiranë, 2003, fq.11

¹²⁸⁹ Po aty, fq.11

Nuk do të ishte korrekte, nëse e njeh sadopak stilin e Kafkës, ta reduktoje atë çka parashtrohet te “Kështjella” në një kuptim të veçantë, ai ta përjashton vetë çdo mundësi të një interpretimi të tillë pasi thelbin e artit të tij e përbën dykuptimësia.

Ndërsa ty, që ke marrë përsipër të jesh lexues interpretues i “Funeralit...”, dhe që të duhet ti nënshtrohesh kodit simbolik të veprës, edhe pse ke sigurinë që vepra nuk mund të protestojë kundër kuptimit që i jep ti, madje siç vëren Roland Bart “ajo as mund ta shpallë si autentik këtë kuptim” (R.Bart, Aventura semiologjike), sapo të është tronditur besimi se e kishe gjetur fillin që do të ndihmonte për ta shthurur lëmshin. Marrëdhëniet e autorit me shtetin diktatorial, kjo metaforë ironike i është dashur autorit për të përqeshur dhe groteskuar botën komuniste. Por, sapo nis të shfletosh disa faqe, kupton se do të ishte fyese për autorin, por edhe për veprën, ta reduktoje vetëm në kaq kuptimin e saj, si një veper kundër diktaturës komuniste.

Duke ndjekur udhën e “funeralit” autori të jep shkas për interpretime të tjera “një ballë jetim u rrudh. Vetullat e trasha sikur kërcyen nga një fytyrë tjetër, u afruan për tu bërë një vetull e gjatë si krah korbi mbi dy sy krejt të tjerë që skishin ç’shihnin. Ditë qorre. Shteti dhe varrimi. Po i vdekuri ku bën pjesë, apo është i gjithëkundshëm si vdekja? Po ky varrim është shtetëror. Semos shteti është varrmihës? Eh, më mirë ciklop se je më i fortë. Po më dhëmbin kockat e nofullave. S’duhet të bluaj fjalë më shumë nga ç’lejohej. Do të bjerë shi. Kam reumatizëm në mendime. A do të pushojmë gjëkund? Kafka ime pikon brenda...”¹²⁹⁰

Duket si një marrëdhënie qenësore që njeriu ka vendosur me shtetin e tij shumë herët, ndoshta që nga koha e perandorive dhe që vazhdon deri te demokracitë që presin të rriten, por që të gjitha janë regjime që e kanë të pranishme indoktrinimin dhe totalitaritetin. Heroi i “Funeralit...” na “dëshmon” se ka qënë i pranishëm në çdo varrim, jo vetëm brenda vendit, por edhe në morte të mëdha të personaliteteve të klasit të parë. Ka preferuar veçanërisht varrimin e tiranëve. Le të themi që varrimi i Çezarit nuk i pat pëlqyer dhe aq, për të mos thënë fare. Ajo që e pat emocionuar ishte salla në senat ku i patën ngulur thikën. “u ula atje, në shkallët e gurta, veshur me dru dhe doja të rijetoja thikat në brinjët e Çezarit. Sapo kisha veshur shpirtin e tij si një pelerinë dhe në çastin kur filluan të më dhimbnin plagët e tij, e duart i kisha mbushur me gjakun e ndjenjave të mia, erdhën rojet e bashkise së Romës dhe më nxoren.”¹²⁹¹

Funeralisti i Zhitit ka bindjen, se njeriu më i mirë se kudo është në funeral, mbase ngaqë ndihet njëllor si i vdekuri “dhe i vdekuri është më i urtë se urtësia dhe i papërbalueshëm, më filozof se filozofët”¹²⁹²

Mendimi për ta përqasur romanin “Funerali...” me një veper kundër diktaturës komuniste, nuk vlen, pasi funeralisti (metanarratori), pohon se parapëlqen jo vetëm mortet e personaliteteve të klasit të parë, por veçanërisht ato të diktatorëve. Ajo që të bën të mendosh për një qasje të tillë është marrëdhënia e autorit me shtetin diktatorial. “Një nga novitetet më gjeniale, që kanë mundur të bëjnë komunistët, është pikërisht rinovimi i sistemit ndëshkimor... me fjalë të tjera gjithë gjeniale e komunistëve ishte rikthimi i skëterrës në jetën bashkëkohore”¹²⁹³

¹²⁹⁰ Visar Zhiti, Funerali i pafundmë, shtepia botuese OMSCA, Tiranë, 2003, fq.42-43

¹²⁹¹ Po aty, fq.49-50

¹²⁹² Po aty, fq.46

¹²⁹³ Ismail Kadare, Dialog me Alain Bosque, Vepra XX, Onufri, Tiranë, 2009, fq.502

V. Zhiti ishte një nga ata që brenda asaj skëterre të madhe, po vuan një tjetër skëterrë, që në tipologjinë e prozës së tij është bërë e njohur tashmë si *burgologji*. Ai i ndjeu më afër se çdokush *novitetet gjeniale* të komunizmit. Në rastin e funeralit, lexuesit i duhet të mbledhë apriori copëza të rrëfimit për të zbuluar dhe ndërtuar një domethënie. I duhet të marrë përsipër një zbrëthim aluzionesh, që në më të shumtën e rasteve e fshehin kuptimin por jo synimin e shkrimit. Duke shfletuar romanin, vjen një cast, që të duket se je bërë edhe ti pjesë e këtij “funerali” që nuk ka as fillim as fund. Ajo që ndjen të të shoqërojë është ritmi i të rrëfyerit, i narratorit funeralist, një zë që të ngjet me një melodi që se ke dëgjuar kurrë por që të mbetet në mendje për shumë kohë edhe pasi je shkëputur nga leximi. Funeralisti “merr pjesë” në varrimin e Enver Hoxhës dhe i duhet të pohojë se qe përballur me një madhështi të rreme. Aty kish parë që grave ju ndalohej me “dekret” të bënin buzët me të kuq, madje nuk duhej të bënin as dashuri në ditët e zisë. Dënosheshe po të buzëqeshje, ndërsa po të qeshje përballeshe me dënime shumë më të rënda.

Ndërkohë që vdekja e Mao Ce Dunit përshkruhet si një gjuhëzim grotesk i një populli të tërë, i cili qan në një shesh të stërmadh të mbushur, jo me flamuj, por me tullumbace. Është një liste e gjatë diktatorësh dhe personalitetesh në të cilat funeralisti ka qënë pjesëmarrës por madhështia e varrimit që theu një ligj të botës është varrimi i Nënë Terezës. Mbi arkmortin e saj u gjuhëzuan gjithë sundimtarët e botës, ndërsa ajo , plaka fisnike e dobët kockë e lëkurë dontë të buzëqeshnin të vdekurit.

Letërsitë bashkëkohore shpesh i referohen teprisë së librave të trashëguara nga një fond kulturor ndër shekuj duke veçuar veprën më të afërt me të në kohë. Kjo krijon ndjesinë e tejngopjes por dhe domosdoshmërinë e kërkimit të risisë “*e cila nuk kalon më nëpërmjet një procesi mbledhës, por një fond mbi të cilin çdo vepër përpiqet të shkëputet, e frymëzuar nga një merak risie, aq të thellë saqë historia letrare, do ta ëndërronte veten në modernitet si një revolucion i përhershëm*”¹²⁹⁴

Parë në këtë kontekst “Funerali...” i Zhinit përbën në mënyrë të padiskutueshme një risi. Për nga lloji i diskursit është rrëfim që mbështet mbi një erudicion që synon të vendosë të vërtetën, por që ushqehet mbi imagjinaren. Metafora “funeral” të çon drejt kuptimesh ekzistenciale. Përgjatë gjithë tekstit, gjerat që nuk të ndahen asnjë çast janë ankthi dhe vdekja. Të trokasin në kujtesë ndërkaq etërit e ekzistencializmit, Jaspersi, Hajdeggeri dhe Sartri, por dhe ata që me shumë fije të padukshme ishin jashtëzakonisht të lidhur me ekzistencializmin, Niçe e Dostojevski por dhe Rilke, Kafka e Kamy.

Sipas Valter Kaufman, ekzistencializmi nuk është filozofi por thjesht emërtim për një numër revoltash kundër filozofisë tradicionale. “*është ndjeshmëria e pa kohë e cila mund të dallohet aty këtu në të kaluarën, po vetëm në kohën tonë, kjo ndjeshmëri është rritur deri në protest të organizuar dhe në një shqetësim të shprehur*.”¹²⁹⁵

Përmasa ekzistenciale është konstatuar nga studjuesit e Zhinit edhe në poezinë e tij që sipas studjuesit A. Aliu “*e çfarëdo prejardhjeje qoftë, e çfarëdo objekti frymëzimi dhe shqetësimi, në të gjitha rrethanat e ngjizjes dhe zënies, të kthen te burimi, te kuptimësia e të ekzistuarit*”¹²⁹⁶

Por poezia e Zhinit i ka të gjitha tiparet që Du Bellay do dëshironte që ti kishte poezia e vërtetë, në gjuhën e tij apo në të gjitha gjuhët e botës. “*Ta dish lexues, që poeti i vërtetë që*

¹²⁹⁴ Nathalie Piegay-Gros, Poetika e intertekstualitetit, “Parnas”, Prishtinë, 2011, fq. 238-239

¹²⁹⁵ Valter Kaufman, Ekzistencializmi nga Dostojevsi te Sartri, Plejad, Tiranë 2011, fq. 10

¹²⁹⁶ A. Aliu, Kronikë letrare, Logos, 2003, fq. 74

*unë kërktoj në gjuhën tonë, do të jetë ai që do të më bëjë të nxehem, të qetësohem, të gëzohem, të vuaj, të dashuroj, të urrej, të admiroj, të habitem shkurt ai do të mbajë frerën e ndjenjave të mia duke më kthyer lart e poshtë sipas dëshirës së tij”*¹²⁹⁷

Të folurit lirik mjeshtror që i dha sukses të padiskutueshëm si poet, ka depërtuar natyrshëm edhe në prozën e Zhitit, aq sa kur lexon romanin, të duket se je para një poeme të stërgjatë, të fragmentarizuar, pa kurrfarë fabule dhe skeme kompozicionale. E megjithatë vepra është gjithmonë brenda kufijve zhanëror të romanit, por të një romani ndryshe, jo thjesht për shkak të gjuhës lirike të përdorur por dhe për shkak të hapësirave për të shpalosur një paralele me realitetin, përmes një ngjizjeje imagjinare, që shkon deri në kufijtë e përmasës apokaliptike dhe që groteskon me absurdin e botës. Një stil rrëfimi i ngjashëm me atë të Xhoisit, në trajtën e një rrjedhe që e orienton lexuesin drejt portave të pandriçuar mirë të subkoshencës. Duke ndjekur rrugën e protagonistit të funeralit e kupton se je duke ecur së bashku me të drejt një shteg dalje që nuk ekziston, je duke ecur për në askund, një askund i ngjashëm të Jozef K të Kafkës, i cili rri përpara derës së Portës së Ligjeve dhe prët me ditë, me vitë për të hyrë brenda.

Çasti i ngjizjes së veprës duhet kërkuar tek metafora e funksionimit të kujtesës, ndryshe objekti metaforik është një lloj palimpsesti i trurit njerëzor. Siç ka pohuar më shumë se njëhërë, një pjesë e mirë e poezive të Zhitit, veçanërisht poezitë ekzistenciale, u shkruajtën në një qeli të errët e të lagësht, ku mungonte edhe drita edhe lapsi edhe letra u “shkruajtën” dhe u ruajtën gjatë në muret e kujtesës së poetit. “*Sado pa lidhje të jetë një ekzistencë, thotë Bodler, njësia njerëzore nuk është e turbulluar dhe nëse do të mund ti zgjonim njëkohësisht të gjitha jehonat e kujtesës ato do formonin një koncert të këndshëm ose të dhimbshëm, por logjik dhe pa shkëputje*”¹²⁹⁸

Në rastin e Zhitit do të përftonim një koncert tragjikisht të dhimbshëm. Si lexues, jam i prirur të besoj, se “Funerali” është ngjizur në njësinë e kujtesës, brenda qelisë së zezë, i populluar në fillim nga banorët e qelive. Me “u ngjiz” nënkuptoj romanin sepse funerali si i tillë ka ekzistuar, ai është i pafundmë edhe në kohë edhe në numër. Funerali nuk ka identitet, sepse nuk ka identitet as i vdekuri në arkmort. Ky ankth parak që shoqëron gjithë romanin, ka lindur pikërisht atje, në skutat e errëta të asaj qelie të lagur, si shumica e motiveve ekzistenciale të krijimeve të autorit, pastaj është ushqyer nga erudicioni i shumë librave të Xhoisit, Kafkës, Borgesit, Kamysë.

Mundimi i Sizifit për ta ringritur sërish gurin e rëndë në fund të malit, është një torturë që nuk mbaron kurrë dhe që e bën mitin tragjik. Mendoni ç’torturë do të ishte sikur ai të shpresonte se një ditë do t’ia arrinte qëllimit? Por Sizifi është i qartë në fatkeqësinë e tij dhe fati i tij është absurd, por dhe një fat që përballohet me anë të përbuzjes. I gjithë thelbi i mitit mund të përmbledhet me pak fjalë; njeriu absurd kur mediton përvuajtjen e tij, bën të heshtin të gjithë idhujt. Funeralisti në një farë kuptimi ngjet me Sizifin, përpjekja e përhershme e Sizifit drejt majave, është e mjaftueshme për të mbushur zemrën e tij, sikurse përpjekja e vazhdueshme e funeralistit për të mbërritur në krye të funeralit, atje ku të bie rradha për ta mbajtur një çast mbi supe arkmortin është dëshira finale për të përmbushur misionin e tij.

Në të ashtuquajturin epilog të veprës, ku ka rënë maska e narratorit, funerali shpallet antifuneral dhe sakaq, të vijnë në mendje sekuencat e “faqes së grisur nga fundi për tu

¹²⁹⁷ Du Bellay, Lavde ndaj imitimit, cituar në Poetika e intertekstualitetit, “Parnas”, Prishtinë, 2011, fq. 208

¹²⁹⁸ Baudlaier, Les Paradis artificiels, në Poetika e intertekstualitetit, “Parnas”, Prishtinë, 2011, fq. 208

lexuar në fillim”, korruptimi i frikshëm mortar ka marrë fund, por pafundësia e pamjeve të tmerrshme duket se sdo të mbarojë kurrë.

*Një helicopter fluturonte ulët, gati rrafsh me fushëtirën. Shiheshin qartë pas dritareve të tij njerëz që xhironin hullinë e madhe të asaj heqje zvarrë, aq të çmendur dhe tërësisht absurde, fotografonin këpucët e hedhura, gjurmë pa kuptim dhe këmbët e vetmuara, të pashkulura dot nga toka... skelete njerëzish... herë pas here ata largonin aparatet nga sytë, sa për të fshirë lotët.*¹²⁹⁹

Recensentë:
Prof.dr. Adem Jakllari
Prof.as.dr. Elvira Lumi.

¹²⁹⁹ Visar Zhiti, Funerali i pafundmë, shtepia botuese OMSCA, Tiranë, 2003, fq.8

PROBLEME LIDHUR ME TERMIN E STRUKTURËS SË PËRBËRËSIT SINTAKSOR (SINTAGMËS)

Sonila Sejdini (Çela)

Tema:

Sintagma është një kategori sintaksore në rrafshin formal-gramatikor dhe një njësi ndërtimore e fjalisë dhe si e tillë ngërthen shumë çështje problemore dhe të diskutueshme. Në gjuhësinë strukturaliste angleze e amerikane përbërësi sintaksor certifikohet me termin¹³⁰⁰ frazë (phrase), në gjuhësinë italiane, franceze e gjermane përdoret termi sintagmë dhe grup fjalësh. Po të shqyrtojmë gjuhësinë angleze, konkretisht teorinë gjenerativiste do të vemë re, që kemi disa përcaktime të ndryshme, herë përdoret termi sintagmë, herë përdoret termi frazë. E diskutueshme paraqitet përzgjedhja e termit më të përshtatshëm (sintagmë, grup fjalësh apo frazë), a i plotëson të gjitha parametrat gjuhësorë përzgjedhja e njërit term për një koncept teorik aq shumë të nevojshëm?

Probleme të tilla janë bërë objekt studimi dhe analize nga gjuhëtarë të huaj dhe shqiptarë. Kujtojmë që në tekstet tona gjuhësore ndeshet një multipërdorim i këtyre termave, madje vitet e fundit është quajtur edhe përbërës sintaksor sipas këndvështrimit strukturalist¹³⁰¹. Sipas gjuhëtarit Mehmet Çeliku këtyre termave (sintagmë, frazë dhe grup fjalësh) i përshtatet në gjuhën shqipe termi përbërës sintaksor (shkurt përbërës)¹³⁰², të cilin ai e quan si një njësi të veçantë sintaksore (me vlera kuptimore, strukturore-gramatikore dhe fonetiko-intonacionore) që realizon teorinë e lidhjeve të fjalëve emërtuese në fjalinë e thjeshtë dhe të lidhjeve të sifjalive në fjalitë e përbëra (periudha). Çeliku këtë term e ka marrë dhe e ka përshtatur nga termi strukturalist constituent, term të cilin e përdor gjuhësia angleze strukturaliste për "komponent", ndërsa Çeliku e përdor vetëm për përbërës sintaksor, që do të thotë përbërës i fjalisë. Çeliku njihet fjalinë me strukturë: PE + PF dhe fjalitë me strukturë PE ose me strukturë PF.

Së treti nuk njihet përbërësin parafjalor dhe zbaton lidhjet e përbërësve sintaksor në klasifikimin e periudhave.

Sipas analizave dhe studimeve të para dhe të vlerësuara në optikën e mendimit gjuhësor modern mendoj, se nocioni sintagmë rezulton të jetë universal dhe praktik për analizat sintaksore. Argumentet që na çojnë në këtë qëndrim mbështeten në faktin se po të nisemi nga gjuhësia angleze e amerikane, madje edhe italiane termi "frazë" nden probleme a përshtjellime për fjalinë në gjuhën shqipe, sepse me këtë term zakonisht njihet edhe një grup fjalësh (pra parakupton ekzistencën e dy a më shumë fjalëve, duke përjashtuar madje rastet e shprehjes së saj edhe me një fjalë të vetme) dhe vetiu nuk mund të përdoret një term në dy përdorime a nocionetë ndryshme të gjuhës¹³⁰³. Termi grup fjalësh nuk mund të

I Marianne Celce-Murcia, Diane Larsen-Freeman "The grammar book", Boston 1999, faqe 237.

II Mehmet Çeliku "Sintaksë e gjuhës shqipe", Tiranë 2012, faqe 51.

III Shih po aty, Mehmet Çeliku "Sintaksë e gjuhës shqipe", Tiranë 2012, faqe 51.

IV Maurizio Dardano dhe Pietro Trifone "La nuova grammatica della lingua italiana", Bologna 1997, faqe 110.

përdoret, sepse është një njësi e gjërë dhe e larmishme, prandaj termi sintagmë i përshtatet më së miri analizave sintaksore të fjalive të thjeshta dhe atyre të përbëra. Me këtë nocion mund të përkufizojmë edhe ¹³⁰⁴ një fjalë të vetme (single words.ang), pra "sintagma të thjeshta"¹³⁰⁵ të përbëra nga një fjalë emërtuese.

Kjo njësi është e përbërë nga fjalë leksikore emërtuese dhe së dyti ka aftësi të zgjerohet në mënyrë të vetëdijshme nga folësit e një gjuhe të caktuar. Termi sintagmë është shumë i vlefshëm për ¹³⁰⁶ analizën logjike sepse lejon të vendosen në të njëjtin nivel elementët e vetëm ose binarë që kanë të njëjtin funksion nga këndvështrimi analitik sintaksor.

Marrim në analizë dy fjali të thjeshta:

(1) Tenori i famshëm po këndon një romancë.

(2) Tenori i famshëm i Operas këndon një romancë shumë të bukur.

Është e qartë se në të dyja këto fjali sintagma emërore tenori ka të njëjtin funksion (kryefjalë) si edhe sintagma e përbërë tenori i famshëm i Operas, ashtu sikurse sintagma foljore këndon ka të njëjtin funksion (kallëzues) sikurse sintagma foljore e përbërë këndon një romancë shumë të bukur. Këtu kemi formulën tipike (subjekt + predikat).

Sipas gjuhëtarëve italianë Trifone dhe Dardano ka dy tipologji sintagmash: sintagma emërore dhe sintagma foljore. Sintagma e parë emërore (tenori i famshëm) është e përbërë nga një një emër i shoqëruar nga një apo më shumë caktuesorë¹³⁰⁷ (nyje, mbiemra, kundrinorë); e dyta sintagma foljore (këndon një romancë) konsiston nga një folje e ndjekur nga elementë të tjerë. Sintagma e parë, e cila është e zërthyeshme (ang. complex constituent), (tenori i famshëm) e ka të domosdoshëm mbiemrin shoqëruar dhe quhet caktuesor me kuptim të ngushtë në gjuhën shqipe. Në fjalinë e dytë sintagma e zërthyeshme (tenori i famshëm i Operas) fjalët që shoqërojnë sintagmën tenori janë të panevojshme dhe quhen caktuesorë me kuptim të gjërë.

Sintagma emërore

Sintagma foljore

Tenori i famshëm

këndon një romancë

Tenori i famshëm i Operas

këndon një romancë shumë të bukur

Përveç sintagmave emërore dhe foljore, ekzistojnë edhe disa tipe të tjera sintagmash, si sintagma parafjalore, e cila ndërtohet nga një parafjalë dhe nga një emër (ose nga një sintagmë emërore), dhe sintagma mbiemërore, e cila është e ndërtuar nga një mbiemër i shoqëruar me elementë të tjerë.

Në fjalinë: Tenori i famshëm i Operas këndon një romancë shumë të bukur.

V Lesley Jeffries "The structure of modern english" London, faqe 102.

VI M. Çeliku "Sintaksa e gjuhës shqipe", Tiranë 2012, faqe 56.

VII Analizë logjike quhet identifikimi i kategorive sintaksore të prezantuara në fjalinë e thjeshtë, të cilët mund të jenë kryefjala, kallëzuesi, kundrinori, përcaktori. Maurizio Dardano, Pietro Trifone "La nuova grammatica della lingua italiana", Bologna, faqe 119.

VIII Termi "caktuesorë" përdoret në këtë kuptim në veprën e M. Çelikut: "Sintaksë e gjuhës shqipe" Tiranë 2012, faqe 69. Me këtë term njihen trajtat e shkurtra të përemrave vetorë kur ndodhen pranë foljeve kalimtare, p.sh: *Mua vjen keq për nënën. Mua me vjen keq për nënën. (Ky është një ndërtim jogramatikor, prandaj është e domosdoshme prania e trajtës së shkurtër, në këtë mënyrë ajo formon një njësi së bashku me foljen duke u sjellë si caktuesor i saj. Së dyti këtu përfshihen nyjet e pashquara që përdoren përpara emrave, duke shërbyer si caktuesorë të domosdoshëm të pashquarsisë së emrave (një djalë).

il célèbre tenore dell'Opera canta una romanza molto bella .(it)

Le célèbre tenor de l'Opera chante une chanson tres belle. (fr)

arrijmë të identifikojmë si një sintagmë parafjalore (dell'Opera,kjo ndodh në gjuhën italiane pasi në gjuhën shqipe lidhja mes rasës dhe emrit jepet me nje i/e) dhe një sintagmë mbiemërore shumë të bukur.

Duket qartë që një sintagmë mund të shoqërohet me sintagma të tjera për të dhënë një informacion të plotë.Sintagma emërore il célèbre tenore dell'Opera (tenori i famshëm i Operas) është formuar nga një sintagmë emërore (il célèbre tenore) dhe nga një sintagmë parafjalore (dell'Opera).Sintagma foljore këndon një romancë shumë të bukur është formuar nga folja (këndon)dhe nga një sintagmë emërore (una romanza molto bella),sintagma emërore në vetvete është formuar nga një sintagmë emërore (një romancë) dhe një sintagmë mbiemërore (shumë të bukur).Kemi individualizuar të gjitha sintagmat që ndërtojnë frazën :tenori i famshëm këndon një romancë shumë të bukur;secila prej këtyre sintagmave është formuar nga elementë të tjerë: për shembull : sintagma mbiemërore (shumë e bukur) është formuar nga një ndajfolje (shumë) dhe nga një mbiemër (e bukur);sintagma emërore një romancë është formuar nga një nje (një) dhe nga një emër (romancë).

Procesi i identifikimit që kemi bërë për çdo sintagmë ,nga i cili kemi zbritur nga fjalia te sintagmat dhe nga sintagmat tek elementët e vetëm,quhet ANALIZË E PËRBËRËSVE TË AFËRT(it.analisi in constituenti immediati).Me një analizë të tillë e ndajmë frazën në dy pjesë : një sintagmë emërore dhe një sintagmë foljore (këto dy pjesë janë përbërës imediatë të frazës); secila prej këtyre dy pjesëve të frazës ndahet në dy përbërës të tjerë ,e kështu në vazhdim derisa mbërrihet tek elementet e thjeshtë,fjala. Analiza e përbërësve imediatë paraqitet grafikisht me një diagramë në formë peme.

Simbolet e përdorura janë marrë nga terminologjia angleze.

F=fraza,SN=sintagma emërore,SV=sintagma foljore,N=emri,V=folja,Art=nyja.¹³⁰⁸

Nga ky diagram kuptojmë që edhe në gjuhë të tjera,përveç anglishtes,edhe në italisht dhe frengjisht struktura e fjalisë mund të paraqitet me formulën: PE(Z) + PF(Z)

1.Fjalia tenori këndon një romancë është formuar nga një sintagmë emërore (tenori) dhe nga një sintagmë foljore (këndon një romancë);tenori dhe këndon një romancë janë përbërësit imediatë të fjalisë.

2.Sintagma emërore il tenore është formuar nga nyja (il) dhe nga emri(tenore);il dhe tenore janë përbërësit imediatë të sintagmës emërore (il tenore).

3.Sintagma foljore këndon një romancë formohet nga folja(këndon) dhe nga emri (një romancë);një dhe romancë janë përbërësit imediatë të sintagmës emërore(një romancë).

Mund të bëjmë një sintezë të gjithë asaj që parashtruam më lart: çdo fjali është e përbërë nga sintagma;këto të fundit nga ana e tyre mund të përbëhen nga fjalë.Nëse përshkruhet dhe paraqitetet në një mënyrë të tillë sipa ligjërimit, struktura e dytë e gjenerativizmit do t'i bashkërendisë elementët nga njëri –tjetri : niveli i fjalisë është më i lartë se ai i sintagmës;niveli i sintagmës është më i lartë se ai i fjalës.Sintagma rezulton kështu si një njësi gjuhësore e nivelit të mesëm.

Redaktor shkencor

¹³⁰⁸ Diagrami nuk eshte botuar per shkak se gjate procesimit kishte humbur forme

AFIRMIMI I ARSIMIT DHE KULTURËS SHQIPTARE NË NJË VEPËR TË RËNDËSISHME

(“SHEJZAT”, NUMËR JUBILAR PËRKUJTIMOR KUSHTUE PROF. ERNEST KOLIQIT; ROMË, 1975 ME 384 FAQE)

Dr. Teuta Vinca- Kafexholli

1. Në vend të hyrjes

Shkrimtari, studiuesi, përkthyesi, bilinguisti, poliglotti, arsimuesi, poeti, prozatori Ernest Koliqi ka lindur në Shkodër më 1903. Rruga jetësore e tij shoqërohet me vështirësi të mëdha për shkak të rrethanave të kohës. Nga shënimet biografike të tij veçojmë disa konstatime siç janë:

Mësimet e para i ndoqi në [Kolegjin Saverian të Jezuitëve](#). I ati, Shani e dërgon për të studiuar në Itali kur ishte 15 vjeç. Studion në Kolegjin Jezuit Arici në Breshia. Në gazetën “Noi giovani” (“Ne të rinjtë”), të cilën e themelon vetë me disa bashkënxënës, boton poezitë e tij të para në italisht. Përveç italishtes shkrimet e tij janë edhe gjermanisht, anglisht, arabisht, greqisht. Pra ai spikatet jo vetëm si bilinguist (dygjuhësor) por edhe si poliglott d.m.th njohës i shumë gjuhëve. Për te me të drejtë është pohuar kështu: “Bashkëpunon dhe shkruan në rivistat e fletoret ma me randësi “Hylli i Dritës”, Leka, Gazeta Shqipëtare, Illyria, Përpjekja Shqiptare, Minerva, Besa, Koha jonë, Jeta katolike, Lajmtari i të mërguemit etj.” (Shif “Shejzat” nr. Jubilar, f.17).

Veprimtaria letrare dhe shkencore e E. Koliqit është shumë e gjerë. Ja disa nga veprat e tij:

1. Më 1921, kur i kishte vetëm 18 vjet, fiton konkursin e Ministrisë për për “hymën kombëtar” nga juria e përbërë: Gjergj Fishta, Fan Noli, Mid-hat Frashëri e Luigj Gurakuqi. (Shih “Shejzat”, f.14);
2. Më 1923, bashkë me Anton Harapin e Nush Topallin, themelon “Ora e maleve”;
3. “Kushtrimi i Skanderbeut”, poemth dramatik më 1924;
4. Në Zara “Hija e maleve”, 1928;
5. “Poetët e mëdhenj të Italisë”, 1932 (me parathënie të At Gj. Fishtës);
6. “Gjurmët e stinëve”, poezi, 1933;
7. “Tregtar flamujsh”, 1935;
8. Studimi për tezë doktorature “Epika popullore shqiptare”, me vlerësim nga N. Jokli e M. Lamberci, 1937;
9. Më 1939 si ministër arsimit boton “Visaret e kombit” deri më XIV vëllime;
10. “Shihja e bukës mbrume”, 1960;
11. “Darsma shqiptare” e Ali Asllanit, italisht, 1961;
12. “Antologji e lirikës shqipe” (me lirikat më të mira të shqiptarëve në përgjithësi), 1963;

13. "Pasqyra e Narçizit", 1963, me shatë proza poetike të autorit;
14. "Symfonia e shqypeve", Romë 1970 (anglisht e përkthen Anesti Andrea) etj.

2. Arsimi

Në numrin jubilar të "Shejzave" dua të veçoj e të theksoj një mendim të dr. Vasil D. Allarupit në Nju Jork me rastin e përkujtimit të Ernest Koliqit. Ky studiues tekstualisht thotë kështu: "Fletorizma i tregojti udhën e bukur dhe në fletorizme të çkëlqyer e mbylli jetën. Sikur të mos na kishte lënë kurgjë tjetër, po vetëm *Shejzat*, kjo tribunë e kulturës shqiptare në mërgim do t' ishte më se e mjaftë që t' ia pavdeksonte emrin. Në të ay na le një trashëgim nga më të pasurit për brezat të cilët do të gjejnë këshillat e Mësuesit të madh edhe një udhë për të ndjekur me nder e krenari" ("Nr. Jubilar i "Shejzave" f. 332.).

Ndërsa doktori i nderuar V. Allarupi ia njuh meritën e madhe për *Shejzat*, unë me dëshirë e kënaqësi do të theksoj një studiues tjetër të Ernest Koliqit, bashkëkohësi i njohur i tij dhe bashkëveprimtari i dalluar dr. Rexhep Krasniqi bashkë me të famshmin Luigi Gurakuqin "I cili qe mentori dhe frymëzuesi kryesor i interesimit të Koliqit për Kosovë". (Po aty, f.327). Ta ritheksojmë edhe një herë çka thotë R. Krasniqi kur flet për kontributin e Koliqit për arsimin kombëtar në Kosovë: "...Në vjeshtën e 1941 u hapën për të parën herë shkollat shqipe dhe i pari gjimnaz i plotë në Prishtinë. Drejtor i këtij gjimnazi u emëru nga Koliqi dr. Krasniqi, por me funksionin e drejtorit. Kjo veprimtari vendimtare e Koliqit ka qenë fatlume për Shqipninë e për Kosovën se, sot shohim një përtrimje të shumëngjyrshme të kulturës në Kosovë. E kjo ndodhi sepse që në rini Koliqi u influencue për Kosovën nga Gurakuqi që kishte si miq Bajram Currin, e kryetarë tjerë revolucionarë e politike të Kosovës, që Koliqi i njofti që në hapat e para të veprimtarisë së tij letrare e politike". (Po aty, f. 327.)

Mendoj se hapja e shkollave shqipe në trojet shqiptare nga Struga, Dibra, Kërçova, Gostivari, Tetova, rrethi i Shkupit, gati gjithë Kosova me Ulqin, Plavë e Guci, është vërtet një hap i madh historik për voglushët e 1941-shit. Është shkolla e parë e institucionalizuar apo thënë ndryshe shkolla zyrtare me program dhe libra në gjuhën shqipe. Këto troje asnjëherë më parë nuk kanë pas shkolla të tilla zyrtare. Pra është një akt historik i paparë deri atëhere, sidomos për trojet shqiptare këndej kufirit politik të shtetit shqiptar. Prandaj ata voglushët e '41-tës para një kohe festuan 50 vjetorin e atij akti historik.

Çështjet me vlerë historike dhe kombëtare duhet të theksohen dhe të ritheksohen në gjeneratat arsimore qofshin ato fillore, të mesme apo universitare. Kështu "*Shejzat*" bëhet dhe mbetet një dokument i patejkalueshëm për historinë e arsimit shqiptar. Le ta dëshmojmë këtë duke shfletuar faqet e kësaj reviste jubilarë.

Kështu Ernest Koliqi me vetëdije të plotë dhe me ndërgjegje të zgjuar zbatoi idealet e Rilindasve tonë. Ajo farë e mbjellur e arsimit shqiptar vazhdon të jap frute nëpër brezni si meritë dhe nismë nga Prof. dr. Ernest Koliqi.

Të flasësh pra për E. Koliqin ashtu edhe për disa shkrimtarë të rrallë e të mëdhenj, na duhen shumë studime, përkushtime, analiza qoftë nga penda e tij, qoftë nga shkrimtarët e

tjerë shqiptarë apo të huaj. Na duhet shfletuar “Shejzat” e plot 18 viteve, pra me qindra e mijëra faqesh hulumtime. Na duhen thellime nëpër pyll fusnotash sqaruese. Na duhen thellime në kontekste shkrimesh qofshin letrare a shkencore.

Meqë gjindemi në Javën e Shkencës në Kosovë, dua të theksoj aktin historik e hapjes së shkollave të vitit 1941 e fjalët apo shkrimet që kanë bërë për këtë akt të madh historik qoftë nga Dr. Krasniqi qoftë nga të tjerët.

Përveç çështjes së shkollave do të ndalemi kalimthi te disa poezi si ajo “Lutja e dëshprueme”, që ka 13 strofa me vargje 16 rrokëshe, me disiplina poetike, rima të alternuara edhe të përkthyer anglisht nga Prof. Zef Nekaj, profesor i katedrës së arsimit në Universitetin e Kalifornisë. Thuhet, gjithashtu se një prof. i quajtur Valet Loban, për elegjinë e Koliqit pohon se është një elegji, poemë e mrekullueshme. Është kjo një përshtypje pas leximit anglisht të kësaj poeme që e kemi në “Shejzat”, numër jubilar, f.21.

Te “Shejzat” ka shumë shkrime të llojeve dhe gjinive të ndryshme si: ese, histori të arsimit shqiptar, poezi, vështrime shkencore e me shumë rezyme të thukta në gjuhë shqipe dhe botërore. Autorët janë emra të njohur e të shumtë. Janë rreth 70 autorë me shkrime e analiza të dokumentuara e me nivel të duhur shkencor e artistik. Ndër autorët që janë të pranishëm me shkrime po veçojmë: Italo Fortini, Martin Camaj, Rexhep Krasniqi, Emanuele Giordano, Hamdi Oruçi, Petar Bartl, Anton Logoreci, Nermin Falaçi, Gjon Sinishta, Halim Begeja, Tahir Kolgjini, Tahir Zajmi, Nijazi Sulçoglu, Miftar Spahija, Ago Agaj, Vasil Allarupi, Prenk Gruda, Hasan Kaleshi, Klaus Lange, Kosov Rexha- Bala etj. Veçanërisht bëhet fjalë për aktin arsimor, historik të paparë të hapjes së shkollave shqipe në trevat shqiptare që nga Struga, Dibra, Gostivari, Tetova, Ferizaji e gjithë Kosova 1941-1944, bashkë me Ulqin, Plavë e Guci etj. Këtë vepër përkujtimore e përgatitën njohës të krijimtarisë e veprimtarisë së Prof. Ernest Koliqit siç janë: Peter Bartl, Martin Camaj, Zef V. Nekaj, Hamdi H. Oruçi, Gjon Sinishta e Petro Vuçani.

Nuk mund të ndahemi nga ky botim vëllimor me këto 384 faqe, me shkronja të imëta, pa veçe disa mendime të Ernest Koliqit apo mendime për te, që janë jo veç të thella por kanë edhe stil me gjuhë poetike...

“Arbereshët nuk mund t’ a harrojmë kurrë këtë burrë që u interesue shumë për ta. Në mërgim si ata, larg nga shtëpie ku kish lerë, ku kish kaluar vitet e para bashkë me prindërit dhe vëllezërit, ai shpirtërisht ka qenë shumë afër arbëreshëve, pse Ai kish përshtypjen se i njëjti fat kish përcjellur arbëreshët në Ilali para 500 vjetësh dhe Atë në shekullin” XX (f.32...).

Prandaj është kuptimplotë vargu i poezisë kushtuar arbëreshëve” “Mirë se erdhe n’ truall t’ Frasnitës” (f. 31).

Gjithashtu janë sa sugjестive, reale dhe sinjifikative faqet 41, 59, 61, 96, 149, 180 që saktësisht na dokumentojnë çështjen madhore për hapjen e shkollave shqipe në trevat shqiptare. Ja ç’ thuhet për to konkretisht: “Prova ma bindshme që rrajët e shqiptarizmit... nuk thahen por jesin mugulluese, na e japin shqiptarët në Jugosllavi. Populli i Kosovës... mbas së dytës luftë të përbotshme, diji e muji me u naltësue në kulturë e krijoi Parnazin arbnuer...” (Po aty, f.41). Po në këtë numër në faqen 59 thuhet: “Me vend e pat zgjedhur Prof. Karl Gurakuqi, dritë pastë, titullin e librit komentues me rasën e dhjetëvjetorit të parë të revistës “Nëpër vullajt e Shejzavet”, të cilën e botoi në Romë më 1969. Titulli vetë e përshkruen përmbajtjen e kopshtit (landës) së *Shejzavet*... vullaj të njoma e të freskëta që tue u rritë, lulëzojnë dhe në verën e lirisë japin frytet e bukura e të shijshme për të mirën e njerëzimit”(f.59).

Gjithashtu edhe për arsimin, shkollat në revistën “Shejzat” lexojmë: “Po merita ma e madhja e këtij dikasteri të arsimit ka qenë hapja e shkollave shqipe për të parën herë ndër krahinat e ndryshme kosovare. Vetë kosovarët e pohojnë se kjo nismë e fillimit të shkollës shqipe në Kosovë... është një lindje e vërtetë historike” (f.61).

“Aty kah medisi i prillit 1941, lash Bashkinë e Kukësit dhe shkova si kryetar i Bashkisë në Prizren... Në Prizren dhe rrethinë janë grumbullue arsimatët shqiptarë. Midis tyre ndodhet dhe Fafil Hoxha. Ky është ma i shkathtë e ma i zjarrtë se të tanë të tjerët...”. Kështu flet e shkruan Tahir Kolgjini në faqe 96 të “Shejzat”.

“... Me keqardhje të madhe mora vesh vdekjen e Prof. Koliqit, të cilin do ta kujtojmë na kosovarët, me nderim pse asht flaka e zemrave tona dhe frymëzuesi i punës së madhe të përhapjes së arsimit dhe të gjuhës shqipe” (Reis Ali Hoxha, po aty, f.149).

Dr. Rexhep Krasniqi shkruan: “Kur u emnuesh Drejtues i shkollës shqipe në Prishtinë, prof. Koliqi (Ministër arsimit) shquejti tri pika me randësi: 1) Ministria e arsimit ven bujarisht në dispozicion mjete financiare për shkollën dhe internatin si dhe ushqim dhe veshmbathje për studentat bursistë; 2) Mësimi i gjuhës shqipe do të ketë prioritetin mbi të gjitha lëndët me nga dy orë të përditshme në të gjitha klasat... 3) Studentat e kësaj shkolle nuk do të kishin nevojë të marrin pjesë në organizimin e rinisë fashiste, siç ishte gjendja në Shqipërinë e vjetër” (Po aty.f. 180).

Po kështu flet edhe njeriu me pseudonimin “KOSOVARI” në faqe 64.

Vetë Koliqi shprehet: “Besojmë në punën e shqiptarëve të vëllazënuem e në lumnin që ka për të sjellë kombit parmenda e bulkut, veli i detarit, penda e dijetarit, kulma e farkatarit, muza e poetit, spata e druvarit, mësimi i fetarit, kur këto të lëvizin e të kumbojnë tue veprue “n`emnat e ngjitur e të pandam të Perëndisë të Shqipnisë” (f.178).

Nuk mund ta lë anash edhe një mendim e iniciativë të Ernest Koliqit: “Kah mbarimi i vitit shkolluar 1940 erdhi në Elbasan dhe në Shkollë Normale mbajti një fjalim të shkurtë por me këshilla që kërkonte koha e kushtet shqiptare edhe gjendja botnore, tue na porositë dashuninë për Shqipërinë e zellin për mësim. Ne të klasave të nalta na porositi të shkojshim në Tiranë, në Ministri të Arsimit te sekretari i Tij, Sterio Spase, për me marrë udhëzime e ndihma përkatëse për me mbledh prej popullit folklorin anekand atdheut. (Po aty f.241)... Më duket detyrë njerëzore me theksue se kurr nuk më ka folë për partina as për animin e Tij partiak, veç gjithmonë ndriçonte për çështje të ndryshme gjuhe e për probleme shqiptare... prandaj ngarkimet që ja bën Tirana janë akuza të padrejta e të teprueme” (Po aty f.242). Kështu flet Prenk Gruda. Ai “shpreson” se mohimi i Fishtës, Konicës, Koliqit me shokë nuk ka me zgjat shumë. Dhe ja erdhi koha që këta shkrimtarë e 55 personalitete të tjera që i thekson Lec Shllaku nuk mbeten të mohuar. Ata hynë dhe e pasuruan edhe letërsinë shqiptare (Po aty f. 218).

Me këso shënimesh e sugjerimesh mbushen faqet e revistës “Shejzat” që do të duhej të zgjerohemi në një punim të veçantë, sepse i kërkon koha dhe e vërteta historike. Mjafton këtu të cekim veç emrat edhe të disa personalitetëve që kanë dhënë mendime në faqet e “Shejzave” të E. Koliqit. Ja Fishta me njëzet e më shumë rreshta. Ja Emanuel Jordani i Frasnitës së Arbëreshëve të Italisë, Hamdi Oruçi, Xhyzepe Valentini, Nijazi Sulçoglu, Ago Agaj, Tahir Zajmi, Lec Shllaku, Adem Hodo etj. etj. Në ato faqe është edhe

testamenti i Ernest Koliqit (f.118) për dëshirën e tij për t' u preh në Shkodër, e shumë e shumë çështje të tjera për gjuhë, letërsi, arsim e shkencës.

3. Përfundim

Në 384 faqet e numrit jubilar “Shejzat” (1957-1975), pra 18 vjet pa ndërprerë, ka shkrime të llojeve e gjinive të ndryshme.

Autorët janë emra të njohur të periudhës midis dy luftave botërore dhe pas tyre. Disa nga ata janë të anatemuar nga pushteti i viteve 1945-1990, kryesisht për shkaqe ideologjike duke varfëruar kulturën shqiptare. Të tillët janë: Mit-hat Frashëri, At Gjergj Fishta, F. Konica, M. Camaj, E. Koliqi etj.

Gjuha e shkrimeve është me sintaksë të natyrshme e të bukur shqipe, me leksik të rrallë, me fjalë që duhet përfshirë në gjuhën e njësuar të 1972-tës. Mbizotëron një letrarishte geqe me një shkodranishte të bukur e kumbuese. Në faqet e revistës ka edhe shkrime në letrarishten toske, shumë të afërt e të pasur me gjuhën e njësuar të 1972-tës, pra të Kongresit të Drejtshkrimit të Shqipes. Një fjalor i bazuar në shkrimet e Ernest Koliqit, të Fishtës e të tjerëve si ata, do të ishte i mirëseardhur për pasurimin dhe zbukurimin e godinës së ngritur të gjuhës standarde të vitit 1972...

Mendojmë, në fund, që MASHT-i të marrë përsipër detyrën e përkthimeve të punimeve të pranishme në faqet e revistës “Shejzat”, punime nga shume studiues të njohur që janë botuar në gjuhët gjermane, italishte, frengjishte e anglishte. Kështu do të mundësohet edhe ana njohëse edhe do të shijohet kultura në gjuhën tonë amtare e me standard të gjuhës së njësuar të Kongresit të 1972-tës.

LITERATURA:

Koliqi, Ernest, “Shejzat” (Le pleiadi), Romë, 1957-1975.

Akademiae Shkencave të Shqipërisë, *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, Tiranë, 2008.

Instituti Albanologjik, *Albanologji II*, Prishtinë, 2012.

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë, *Kumtesat nga “Java e Shkencës 2012*, Prishtinë, 2012.

Recensentë:
Prof.dr. Mirlinda Krifca-Beqiri
Prof.dr. Enver Mehmeti

POEZIA INTIME E KADARESË, E FRYMËZUAR NGA MOSKA

Prof.dr.Vebi Bexheti,
UEJL-Tetovë

Shkrimtari që me kohë i kaloi caqet e letërsisë kombëtare , duke u bërë i njohur edhe për lexuesin e një pjese të madhe të globit , Ismail Kadare, në letërsinë shqipe , përveç veprimtarisë së gjatë në prozë, ku edhe u afirmua aq shumë në përmasë botërore, mbeti edhe sot ndër poetët më të mëdhenj të kësaj letërsie.Poezia, dashuria e parë e tij , edhe pse shumë herët e filloi edhe veprimtarinë në prozë, mbeti e freskët dhe me tërë shkëlqimin e saj.Ajo , që në fillimet e veta , apo më mirë të themi nga përmbledhja **Shekulli im** , botuar më 1961, na erdhi me tërë risitë që mund t'i sillte një letërsi moderne .Ardhja e Ismail Kadesë, bashkë me poezinë e tij të re e shënoi epokën e ndryshimit në rrugën e letërsisë shqipe , të ngulfatur nga ideologjia e rreptë e të ashtuquajturit Realizëm socialist . Vetëm shkrimtarë të mëdhenj si Kadare , i mbijetuan këto sfida të kohës.Letërsia konvencionale e ngulfatur me këtë folklorizëm socialist që e kishte detyrim edhe ferrin ta paraqiste si parajsë, me ardhjen e Kadesë , përmes rebelimit gjuhësor dhe tematik , për ta penguar këtë traditë të zhvillimit të një letërsie sipas shijes së „oborrit, , do të gjejë shtigje të reja me prirje rinovuse, në aspektin tematik dhe gjuhësor.Që në fillimet e këtij angazhimi krijues, edhe pse tendenca e ndryshimit të kursit nga rutina dhe skematizmi socialist , thuajse ishte i padurueshëm, Kadare ne kritikant e para për „devijim,, të rrugës së trasuar nga shkrimtarët pararendës, u godit ende pa u afirmua mirë si shkrimtar, që në fazën fillestare .Duke qenë pjesë edhe e debateve që atë botë zhvilloheshin lidhur me frymën e re që po depërton në letërsi , ai në një artikull , përveç tjerash pat shkruar: „Unë mendoj se në kohën tonë nuk është bërë tek ne asnjë shpikje forme .Te ne përmbajtja ka sjellë gjendjen e disa mënyrave të reja.¹³⁰⁹ Qëndrimet e këtilla të Kadesë për risitë që po depërtonin në letërsinë e asaj periudhe përkraheshin edhe nga studijues të huaj që Kadarenë e cilësonin si „Zërin e ndryshimeve të një Shqipërie më të mirë,, . Ky shkrimtar që u balafaqua me goditjet të më të ndryshmet që në fillimet e krijimtarisë , nuk e pati lehtë , sepse të vazhdohej të krijosh në atë trysni politike në rrethana të një shteti jo normal, siç ishte ai i diktaturës, do të thotë të sakrifkosh vetëdëshëm për pasojat.

Meqë veprimtarinë krijuese në prozë dhe poezi, Kadare e filloi paralelisht , edhe risitë në letërsi i solli përmes këtyre zhanreve. Ai u konsideruar i dëmshëm për sistemin edhe atëherë kur shkruante edhe një poezi të vetme.E këtillë ishte poezia **Vjeshhtë tiranase**, që përherë të parë u botua më 1957, në gazetën „Zëri i rinisë,, . E vetmja strofë

¹³⁰⁹ I.Kadare, Asgje tragjike, asnjë traditë sështë mohuar në "Drita", 23 korrik, 1961

pesë vargjëshe e poezisë , fillon dhe mbaron me vargun: *“Pa formë është qielli, si tru idioti”*. Ky varg jo i zakonshëm për poezinë e atyre viteve , përshkrimin e qiellit të një toke socialiste siç ishte Shqipëria e paraqet pa formë dhe e krahason me trurin e idiotit .Kjo poezi ku përshkruhet pamja e një dite të mërzitshme të qullur me shiun karakteristik kadarean, do ishte e zakonshme pa vargun problematik ,që përveç zymtësisë së kryeqytetit, e degradon atë edhe në nivelin e intelgjencës së një idioti.Kjo përballje , e para e Kadaresë me parimet dhe metodat e Realizmit socialist ishte edhe sinjal kërcënues i autoriteteve shtetërore për këtë letërsi dhe autorin e saj.Kjo poezi e vlerësuar si problematike që disi u përvodh nga sytë e autoriteteve kur u botua në gazetë , për herë të parë në një libër u botua e përkthyer në rusisht , në vëllimin **Lirika**. Me këtë rast ky imazh i turbullt i qiellit mbi Tiranë iu duk i pazakonshëm edhe autorit të parathënies së librit, David Sojmollov, i cili konstatoi se poeti i ri shqiptar , Ismail Kadare , është i ndikuar nga letërsia moderne perëndimore.¹³¹⁰

Në këtë rast, temë trajtimi e kemi vetëm pjesën intime të poezisë së tij , të frymëzuar nga qëndrimi në Moskë , kur po specializonte letërsinë , prandaj do përqendrohemi te ky cikël poezish, disa nga të cilat u botuan për herë të parë në vëllimin numër shtatë të veprave të Kadaresë në vitin 2008. Qëndrimi i Kadaresë në Moskë për qëllime studimesh nuk e shkëputi poetin e ri nga krijimtaria që e kishte filluar në Shqipëri, përkundrazi ai këtu gjeti terren më të përshtatshëm për ta vazhduar rrugën e poezisë .Poezia që lindi në këtë qytet të madh të një vendi të huaj ,por shumë të afërt në kuptimin ideologjik me atdheun tij ,Shqipërinë e diktaurës ,si duket, frymonte më lirshëm.Realiteti artistik individual , karakteristikë për Kadarenë edhe në këto kushte të reja të një ambienti të huaj, mbetën po thuaj të njëjtat.

Preokupimi me urabanen , zymtësinë klimatike në ndërtimin e imazheve , imagjinata e tij racionale pa u lëshuar në pafundësi dhe rebelimi gjuhësor e tematik , edhe në këtë poezi të lindur nga frymëzime të përjetimeve të thella të dashurive me disa të dashura , mbetet Kadareane, ashtu si dhe poezitë e lindura më vonë .Tema e dashurisë që aq shumë u trajtua në poezinë shqipe , e që nuk mungon në poezinë e Kadaresë , në këtë tip poezish të krijuara larg atdheut të autorit ,na vjen pak si më ndryshe , më e natyrshme dhe e trajtuar pa ndonjë drojë se mund të çënojë ndonjëfarë morali të ndërtuar mbi një shoqëri diktatoriale siç ishte ajo e Shqipërisë së kohës.Letërsia ruse , përkundër faktit se deri në vitet e gjashtëdhjeta kishte kaluar kohë te gjatë nën diktaturën komuniste , i kishte përballuar sfidat ideologjike dhe konvencionalitetin si tendencë për ta pasur nën kontroll të rreptë edhe letërsinë, me gjithë koston aq të madhe që u kushtoi shumë shkrimtarëve disidentë rusë. Kjo atmosferë më e relaksuar krijuese që dallonte nga ajo e Shqipërisë sikur i dha krahe Kadaresë që këto përjetime nga një jetë e shfrenuar e një të riu beqar, t'i paraqes edhe përmes vargut poetik. Poezi dashurie ai shkruajti dhe do shkruajë edhe në Shqipëri , por për dallim nga ato që u frymëzuan nga Moska ,ato vijnë përmes vargjeve më të kujdesshme, gjithsesi pa e dëmtuar fuqinë e ndjenjës mes dy të dashuruarve. Nëse në poezinë **Mall**, tani ndër më të njohurat e Kadaresë , dy të dashurit edhe pse jetojnë në një qytet të vogël , krahasuar me Moskën , shihen aq rrallë , gjithsesi nga droja e syve të botës dhe thashethemet për këtë dashuri, nëse do kurorëzohet me martesë apo jo, në poezinë **Edhe kur kujtesa** , ku me aq lirizëm i këndohet ndarjes që patjetër duhet të vijë , ndarja e dy të dashuruarve nuk paraqet diçka të jashtëzakonshme: *“Ndarja erdhi ,/Po iki*

¹³¹⁰ I.Kadare, Vepra 7, Tiranë 2008 (shih te Sabit Bejko) në parathënie , faq 11

larg prej teje ./ Asgjë e jashtëzakonshme". Poeti në këtë poezi që ia kushton të dashurës ruse Tanja Vilenskajës, megjithatë e shpreh dashurinë e sinqertë , pavarësisht epilogut të saj që mbaron me ndarje, ndoshta në këtë rast pa fajin e tyre, kur dihet se kjo ndarje ndodh në kohën e shkëputjes së marrëdhënieve mes dy shteteve të një kampi të përbashkët socialist .Plaga e ndarjes , sipas vargjeve të fundit të kësaj poezie , si duket , do mbetet e pashërueshme për poetin edhe atëherë kur ajo do jetë në krahët e dikuj tjetër: "Veç ndonjë natë /Gishtat e dikjut do pleksen në flokët e tu/Me të largëtit gishtat e mi,me mijëra kilometra të gjatë". Me këto vargje, si duket mbyllet vetëm poezia por jo edhe dashuria që do jetojë përjetësisht në kujtesë .Vështirë se pas humbjes së një dashurie do mbijetonin vargjet e këtilla , në një vend siç ishte Shqipëria. Ndoshta në emër të një edukimi të familjes socialiste, këto vargje do konsideroheshin si prekje në moralin e huaj, pavarësisht se janë vetëm vargje poezie e asgjë më tepër .Kjo poezi dashurie dhe shumë të tjera që e ndërtojnë artin poetik të Kadaresë, janë edhe një dëshmi se poeti nuk erdhi i vetëm në letërsi por me bagash të ri që përcaktonte profilin tjetërfare të krijuesit , bashkë me konceptet e reja për mënyrën e të jetuarit dhe të dashurisë brenda saj, pa e cënuar e kushtëzuar atë , pa e bërë pjesë të konventave dhe skemave të përgatitura nga lartë. Kadare nuk erdhi në letërsi vetëm për të shtuar një shkrimtar më tepër , por me misionin që të sjellë elemente , veçori dhe tendencat e reja në këtë letërsi.

Një poezi tjetër e ngjashme më këtë , që poashtu trajton momente të ndarjes së dhembshme , është edhe ajo me titull **Do të vijë koha** . Në këto vargje tanimë nuk përmendet emri i një të dashure. Me këtë rast autori sikur është i vetëdijshëm se do vijë koha e ndarjes me vajzën nga veriu .Strofa e parë e poezisë nuk le përshtypje se bëhet fjalë për ndonjë dashuri të fuqishme .Vargjet: "Do të harroj unë vajzën nga veriu./Do të harosh ti të huajin nga Ballkani i largët" , sikur rrëfejnë për ndonjë dashuri të rastit, mes një vaje vendase dhe një djali të huaj , që me aq lehtësi do e harrojnë njëri tjetrin. Metafora shumë e njohur poetike e „valës,, dhe „shkëmbit,, , megjithatë e arrin fektin e nivelit artistik e gjuhësor .Edhe pse ky krahasim nuk përkon plotësisht me realitetin e një ndarjeje pa fajin e dy të dashuruarve .Vala, që vazhdimisht gërryen shkëmbin duke kërkuar brigje të tjera të kaltra sikur e deformon sinqeritetin e një dashurie për dhembjen e ndarjes dhe për vuajtjen njësoj të të dyve , për këtë ndarje.

Shumë nga këto poezi të Kadaresë që erdhën me tendencë të futjes së letërsisë shqipe me një fazë të re, nuk e panë asnjëherë dritën e botimit deri në vitin 2008. Poezi të këtilla që fati u buzëqeshi aq vonë, janë edhe :,**Taksitë e mesnatës** , **Stoli në kopshtin e institutit Gorki** , **Ndarja në stacion** dhe **Zhana B**. Të gjitha këto poezi që e trajtojnë temën e dashurisë dhe si duket fundin e saj , janë krijuar në një atmosferë të zymtë klimatike .Ashtu si shumë vepra të tij që ishin krijuar në kushte të këtilla, madje edhe të atyre që u shkruajtën në Shqipëri , në një vend bregdetar ballkanik me shumë ditë me diell, edhe këto poezi me vargje të lagura nga shiu i qiellit verior gri që i freskonte të puthurat dhe lagte stolin para institutit, "Gorki", karakterizohen me prirjen e autorit për të krijuar në këto kushte .Edhe në këto katër poezi të shkurtëra të mjedisit urban me taksi ,udhëkryqe, semaforë, lokomotiva e binarë hekurudhash , përsëri ndarje. Në poezinë **Zhana B** me gjithësej dy stofë me nga katër vargje, autori si me fuqinë magjike përmes harmonizimit të fjalëve dhe zërit poetik e përshkruan ndarjen e tij nga e dashura me emrin Zhana. Edhe pse këto ishin çastet e fundit para ndarjes, ai ndjehet më i lumturi pranë ruses biondinë: "Këto flokë biondë/Mbi qafën time derdhur./Cili i lumtur/Të tillë ar ka përkëdhelur".

Në kuadër të ciklit me poezi dashurie që dritën e botimit nuk e pa gjatë kohë, është edhe poema **Llora**, që u shkrua poashtu gjatë viteve të studimeve në Moskë, e që vjen me titullin e emrit të një të dashure, që shpesh herë del edhe me emrin karakteristik rus Lorisa. Përveç raporteve dashunore, poeti këtu bën edhe përshkrimin e çarjeve të marrëdhënieve shqiptaro-ruse. Kjo poemë nuk u botua në përmbledhjen poetike "Shekulli im", pikërisht për shkak të karakterit intim dhe përshkrimit të ngjarjes politike mes Shqipërisë dhe Rusisë, si një dramë, në rradhë të parë njerëzore. Kjo poemë, e mbetur gati 30 vjetë pa u botuar, ka qenë në të vërtetë zanafilla e romanit "Muzgu i perëndive të stepës". Poema për herë të parë u botua në librin "Ftesë në studio"¹³¹¹ Edhe në këtë poemë bie në sy gjuha specifike e një niveli të lartë e të pastër artistik e Ismail Kadaresë. Reflektimi i mendimit të gjithanshëm poetik që përcakton edhe ritmin e jetës, bashk me shijen për të, në raport edhe me dashurinë dhe pasojat në rast ndarjeje, e karakterizojnë këtë poemë, tanimë shumë të njohur, që mund të llogaritet edhe përfaqësuesja kryesore e këtij cikli të poezisë intime, që lindi aq lehtë, si reflektim i ndjenjës së fuqishme të dashurisë, por që priti aq shumë kohë për tu botuar, si pasojë e "teprimit" në përjetimet intime dhe të "nostalgjisë" për ndërprerjen e marrëdhënieve të dy shteteve. Gjuha poetike e poemës, e specializuar edhe për këtë kategori poezish, ku krahas fjalës "dashuri" përmendet edhe ajo "ndarje", i bën vargjet të kuptueshme edhe pse janë shprehje e një vetëdije të lartë artistike. Bulevardet, kafenetë plot dritë, semaforët, stacionet e metrove, avionët, rrugët e qullura me asfaltin e lagur, edhe në këtë poemë bëhen figurat poetike që e ndërtojnë ambientin urban të këtij qyteti, siç ishte Moska, që bashkë me emrin **Llora** dhe dashurinë e ndërprerë, sillen vërdallë në kujtimet e poetit. Ashtu siç ky poet nuk shembëllen me të tjerë, e që në letërsi u dallua me zërin autokton individual, ai dallohet edhe për nga ndërtimi i figurës dhe rrezatimet e saj me thellësinë dhe gjerësinë e ndjenjave. E gjithë kjo dashuri që rritet vazhdimisht, edhe në momente kur ndarja kishte ndodhur dhe ashtu të ndarë, të largët e të vetmuar e kujtonin njëri tjetrin, tanimë udhëtonte përmes reve e mjegullave, me që letrat kishin ikur si zogj e adresat kishin humbur: "*Zor se në jetë do takohemi./ Adresat humbën,/ S'ka letra./ Ti mjegullat, / Unë retë/ Do t'i dërgojmë/ njëri tjetrit/ Gjersa edhe vetë /Të mjegullohem*". Siç vërehet, kjo formë e re e vargut, me plot figura e metafora të reja, e mbajnë në jetë këtë dashuri të viktimizuar nga prishja e marrëdhënive diplomatiketë dy shteteve: "*Ambasadat u mbyllën./ Pasaportat, / Vizat/ Ranë në zi*".

Togëfjalëshat si: *valixhe të mbushura me pritje, mall bojë hiri, shiu godet me shqelma qelqeve, nofullat e zemrës*, dhe shumë tjera të ngjashme si këto, dëshmojnë edhe një herë për praninë aq të madhe të figurave me thellësi kuptimore e ndjeshmëri të fuqishme lirike, duke mos i përfillur aq format ritmike. Fuqia dhe pesha e shumë metaforave, vetëm sa e forcojnë këtë dashuri që gjithmonë e ka afër ndarjen, këtë "fjalë goje" aq të rëndë: "*Por ndarja është e rëndë, shpirtin ta qit./ Të ndërtosh një ndarje për të qenë/ Është më e zorshme se të ngreshë një piramidë*".

Këtyre dashurive që u bënë pjesë e një numri të madh poezishë të Kadaresë, dhe ndarjeve që erdhën pas secilës nga to, sikur nuk u mjafton kjo jetë e kjo tokë. Ato janë si yjet, ato kanë nevojë për hapësira më të mëdha: "*Kërkojnë hapësira të mëdha, e po aq mund./ Por jetë e njëriut s'është galaktikë/ Që të nxjerë kaq yje e katastrofa e mund*". Ndarja që në këtë cikël bëhet pjesë e pandashme e poezisë është e rëndë për poetin aq sa edhe

¹³¹¹ I. Kadare, Vepra 7, Tiranë, 2008, f.369

kujtesa për të . Dashuria,ndarja ,kujtesa e harresa për to, që në këto vargje nuk kanë kuptim pa njëra tjetrën , kanë nevojë për një kohë të pakufizuar, jashta kornizave jetësore :”Në jetën e ngushtë koha vërtetë s’mbafton /Për dashuri,/ Për ndarje,/Harresë”.

Këto ishin vetëm disa poezi me motive dashurie të Kadaresë, që përmes prirjeve të forta krijuese të tij e njohëm artin e madh poetik, e përmes këtij arti, edhe pjesët e jetës intime të shkrimtarit gjatë ditëve më të lumtura rinore kur gjendej për studime në Moskë

Literatura:

1. Kadare, Vepra 7, Tiranë 2008
2. I. Kadare, Kristal, Tiranë 2004
3. Shaban Sinani, Letërsia në totalitarizëm dhe “Dossier K” Tiranë 2012
4. Ali Aliu, Don Kishoti shqiptar, Tiranë 2012

Recensentët
Prof.dr Emin Kabashi
Prof. dr. Hamit Xhaferi

NJË VËSHTRIM I SHKURTËR PËR VALENCËN DHE ROLET TEMATIKE TË FOLJES

Xhafer Beqiraj

Në gjuhësinë bashkëkohore, teoria e valencës është njëra nga teoritë themelore shumë e rëndësishme, e cila është përdorur për herë të parë në gjuhësi nga studiuesi frëng Tenieri ((Tensier 1893-1954) në veprën *Elementet e sintaksës strukturale* (Elements de Syntaxe structurale, 1959; vepër e botuar pas vdekjes së tij). Këtë koncept, Tenieri e huazoi nga fjalori teknik i kimisë, duke u nisur nga formula e ujit H₂O që tregon se valenca e atomit të oksigjenit është e dyfishtë krahasuar me valencën e hidrogjenit. Që do të thotë se për të formuar një molekulë uji domosdo duhen dy atome oksigjen dhe një atom hidrogjen (për ndryshe nuk do të kemi përfitim të ujit). Ky koncept i përdorur me kuptim metaforik nga Tenieri gjeti zbatim edhe në gjuhësi. Kështu, për të ndërtuar një fjali gramatikore të saktë, b.f. me foljen *ngjaj*, është e domosdoshme që të plotësohet valenca e foljes, dmth. kjo folje kërkon dy argumente (sipas Tenierit aktant), të cilëve ajo u shkarkon rolet tematike (teoria theta), p.sh.: *Agimi i ngjan babait të vet*. Te kjo fjali kemi dy argumente: një argument në funksion të kryefjalës¹³¹² (subjektit) dhe një argument të shprehur me sintagmë emërore në rasën dhanore në funksion të kundrinorit të zhdrejtë. Në të kundërtën, fjalia e mësipërme nuk do të jetë gramatikore, si p.sh.: **Agimi ngjan*. Kjo fjali është jogramatikore, sepse mbetet pa u plotësuar valenca e foljes me një sintagmë emërore në funksion të kundrinorit të zhdrejtë. Nga kjo analizë vihet në dukje se folja "ngjaj" është folje dyvalente. Sipas teorisë së valencës, foljet e shqipes dhe të gjuhëve të tjera klasifikohen në folje zerovalente, njëvalente, dyvalente, trivalente¹³¹³, si p.sh.:

- 1) foljet zerovalente: **bubullon, vetëtinë, gjëmon** etj.
- 2) foljet njëvalente: **eci, fle, rri, teshtij, mjaullin, pëllet, leh, ulërinë**, etj.
- 3) foljet dyvalente: **ngjaj, përngjaj, pëlqej, vështroj, shikoj, shkruaj, vizatoj, studioj, lëroj** etj.
- 4) foljet trivalente: **dhuroj, jap, fal, them, përkthej, sjell, bie, përgatit, krahasoj** etj.

1) Në klasën e foljeve zerovalente hyjnë foljet që dalin pa argumente, si p.sh.: *bubullon, vetëtin gjëmon* etj. Quhen folje zerovalente, sepse këto folje nuk marrin fare argumente dhe si të tilla nuk kanë aftësi të caktojnë as role tematike (teoria theta). Në

¹³¹² Në shqipe kryefjala mund edhe të mos jetë e shprehur fonetikisht, por ajo nënkuptohet. Ky parameter e bën të ndryshojë shqipja në krahasim me gjermanishten, anglishten etj., sepse te këto të fundit, kryefjala duhet domosdo të shprehet fonetikisht, për ndryshe fjalia është jogramatikore, p.sh. **regnet (es regnet), *raining (it's raining)*.

¹³¹³ Shih: Josif Mita, *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë, 2005, f. 62.

gramatikën tradicionale të shqipes, këto folje quhen *pavetore*, kurse në gramatikën gjenerative kjo klasë foljesh quhet *zerovalente*. Foljet e sipërpërmendura, në të vërtetë, nuk janë pa vetë që të quhen *pavetore*. Ato dalin gjithmonë në vetën e tretë, që dmth. se kanë vetë, prandaj do të ishte shumë më mirë që këto folje të quhen *zerovalente*.

2) Foljet *njëvalente* janë ato folje, të cilat kërkojnë vetëm një argument për të plotësuar valencën e tyre. Folje të tilla, siç u tha më lart, janë: *fle, rri, teshtij, eci* etj., të cilat kërkojnë një argument në funksion të kryefjalës (argument i jashtëm), kurse çdo sintagmë tjetër e shtuar del si përbërës fakultativ, dmth. shtesë (adjunkt - plotës) që sjell një të dhënë të re, por është jo e domosdoshme për ta bërë ose jo një fjali gramatikore. Ja disa shembuj për foljet njëvalente:

a) shq. *Agimi fle.* gjerm. *Karl schläft.* ang. *David sleep.*

Por kësaj fjalie mund t'i shtojmë edhe ndonjë shtesë fakultative, p.sh.: *Agimi fle në dhomën e gjumit*. Sintagma parafjalore (SP) *ënë dhomën e gjumit* është përbërës fakultativ, dmth. mosprania e saj nuk e bën fjalinë jogramatikore. Mirëpo adjunkti (plotësi) mund të jetë i domosdoshëm, atëherë kur folje të caktuara kërkojnë që të plotësohen domosdo prej tyre, p.sh.:

b) *Agroni banon ë?*] *Daniel wohnt ë?*] *I dwell ë?*] (ku?)

c) *Unë shkoj ë?*] *Ich gehe ë?*] *I go ë?*] (ku?)

3) Foljet *dyvalente* janë ato folje të cilat për të plotësuar valencën e tyre kërkojnë dy argumente mbi të cilat i shkarkojnë rolet tematike (apo semantike) dhe kështu të ngopin valencën e vet. Folje të tilla janë: *ngjaj, përngjaj, vështroj, shkruaj* etj., Ja disa shembuj për këtë klasë foljesh krahasuar edhe në gjermanishte dhe anglishte:

a) *Vjollca shikon filmin.* *Oto sieht den Film* *John watches the movie.*

b) *Shkruaj një poezi* *Ich schreibe eine Poesie* *I write a poetry.*

Te shembujt e mësipërm, folja *shikoj* dhe *shkruaj* janë *dyvalente*, sepse domosdo kërkojnë dy argumente për të shkarkuar rolet tematike dhe kështu të plotësojnë valencën e tyre. Sikundërqë duket, folja *shikoj* (sehen, to watch) dhe *shkruaj* (schreibe, write) kërkojnë një sintagmë emërore në funksion të kryefjalës (argument i jashtëm) dhe një sintagmë emërore (argument i brendshëm) në rasën kallëzore në funksion të kundrinorit të drejtë. Pra në përputhje me funksionet që kryejnë në fjali, sipas R. Memushajt, argumentet kanë role tematike, si *veprues* (agent), *pësues* (experiercer), *përfitues* (beneficiary) *temë* (pacient) ¹³¹⁴ varësisht nga kuptimi leksiko-gramatikor i kallëzuesit, i cili çdo argumenti i cakton një funksion semantik (ose ndryshe rol tematik). Në qoftë se fjalia *Vjollca shikon filmin* zgjerohet me përbërës të tjerë (ose, nëse mungon njëri nga argumentet obligative) do të kemi thyerje të parimit të projektimit, p.sh.:

a) *Vjollca shikon filmin në kinema.*

b) **Vjollca shikon filmin Petritit.*

c) **Vjollca shikon filmit.*

¹³¹⁴ Shih: Rami Memushaj, *Gjuhësia gjenerative*, SHBLU, Tiranë, 2008, f. 167.

Sintagma parafjalore te shembulli (a) *ënë kinema*] është plotës (adjunkt) që sjell një të dhënë të re, por është përbërës fakultativ, e cili nuk lidhet me rolet tematike të foljes, sepse valencën e foljes *shikoj* e plotësojnë argumentet e shprehura me sintagma emërore (SE): *ëVjollca*] dhe *ëfilmin*] (njëri argument i jashtëm, kurse tjetri argument i brendshëm). Në shembullin (b), sintagma emërore e Petritit] në funksion të kundrinorit të zhdrejtë nuk përputhet në rrjetin tematik dhe me valencën e foljes "shikoj", prandaj fjalia del jogramatikore. Në rastin e dhënë, folja "shikoj" kërkon t'i shkarkojë rolet semantike mbi një sintagmë emërore në funksion të kryefjalës dhe një rol tematik tjetër mbi sintagmën emërore (në rasën kallëzore) në funksion të kundrinorit të drejtë. Mirëpo kjo folje nuk ka mundësi t'i caktojë rol tematik një sintagme emërore në shembullin e dhënë (në rasën dhanore)¹³¹⁵. Për këtë çështje, Rami Memushaj thotë: "Elementet të cilave u caktohen role semantike nga një folje, për t'i marrë këto role, duhet të ndodhen në pozicionin e duhur sintaksor, të cilat quhen *pozicione theta*. P.sh., folja *fle* duhet të ketë një gjymtyrë në pozicionin e kryefjalës që t'i caktojë rolin e vepruesit; por kjo folje nuk ka rol pësuesi për të caktuar" (Gjuhësia generative, 2008: 167).

Në gramatikën e gjermanishtes, kjo çështje del e zgjidhur mjaft mirë. Në këtë gramatikë foljet klasifikohen në disa grupe, duke u mbështetur në atë se mbi cilat sintagma ato i shkarkojnë rolet tematike për të plotësuar valencën e vet (mbi një sintagmë në rasën emërore, kallëzore, dhanore apo njëherazi mbi dy sintagma kallëzore-dhanore etj.). Kjo vë në dukje edhe një fakt tjetër: argumentohet se folja është rasë caktuese dhe kategoria e rasës së emrit është tipar i paiterpretueshëm (shih R.M., Gjuhësia generative, 2006). Në vijim po i sjellim disa shembuj sipas valencës nga gramatika e gjermanishtes, si p.sh.:

a) **folje + plotësor**¹³¹⁶ **emëror (verb + Nominalergänzung):** *sein werden, heißen*, p.sh.:

Das ist Rolf Schneider - "Ky është Rolf Shnajder"

Er ist Student - "Ai është student"

Sie heißt Karin - "Ajo quhet Karin"

Sie ist nett - Ajo është e këndshme";

b) **folje + plotësor në kallëzore (Verb + Akkusativergänzung):** *abholen, ansehen, anziehen, bauen, bekommen, bemerken, besuchen, bringen, einladen, erkennen, essen* etj., p.sh.:

Sie sucht **einen Stuhl** - "Ajo kërkon një karrige",

Sie sucht **den Verkäufer** - "Ajo kërkon shitësin",

c) **folje + plotësor në dhanore (Verb + Dativergänzung):** *fehlen, folgen, gefallen, helfen, passen, schmecken, stehen, zuhören, zuschauen* etj., p.sh.:

¹³¹⁵ Në gramatikën e gjermanishtes, folja *sehen* (shikoj) konsiderohet folje që merr plotësor në rasën kallëzore (Akkusativergänzung).

¹³¹⁶ Plotësor = argument.

Das Buch gehört **mir** - "Libri më përket **mua**"¹³¹⁷.

Siç shihet, ky klasifikimi në gjermanishte dëshmon se folja i cakton rasë sintagmës emërore dhe ndarja e tyre bëhet sipas parimit të roleve tematike dhe shkarkimi i këtyre roleve bëhet mbi sintagmat emërore (në rasën emërore, kallëzore, dhanore etj.). Nga shembujt e mësipërm shihet se foljet b.f. **folje + plotësor në kallëzore** (Verb + Akkusativergänzung) u caktojnë role tematike (dhe rasë) emrave në rasën kallëzore (dhe emërore - argument i jashtëm). Në qoftë se në vend të argumentit (plotësorit) të rasës kallëzore vendosim një argument në rasën dhanore, do të kemi, sipas teorisë së sintagmës, një projektim jogramatikore, prandaj këto folje nuk kanë mundësi të shkarkojnë rolin tematik mbi një sintagmë (SE) në rasën dhanore, sepse sintagma duhet të jetë në pozicionin sintaksor theta, si p.sh.:

*_{SE} _EAna]] _{SF} _F sucht _{SE} _{N_y} einem _E Stuhl]]]]]]]]]]¹³¹⁸ (krh. *Ana kërkon një karrigeje.)

Folja *suchen* kërkon të shkarkojë rolin semantik (të brendshëm) mbi një sintagmë emërore (në kallëzore), mirëpo në vend të saj del një sintagmë emërore në rasën dhanore. Në këtë rast fjalia është jogramatikore, sepse thyhen parimet e valencës, roleve tematike dhe të caktimit të rasës. I sollëm këta shembuj nga gjermanishtja për të parë zbatimin e kësaj teorie dhe adekuacinë përshkruese dhe shpjeguese që jep valenca si teori universale në linguistikë, por fare pak e rrahur në shqipe.

4) Një klasë më vete përbëjnë foljet trivalente, të cilat domosdo kërkojnë tri argumente për të shkarkuar rolet tematike. Folje të tilla janë: *dhuroj, jap, fal, them* etj. Këto folje kërkojnë, siç u tha, tri argumente (varësisht nga valenca e foljes): një në funksion të vepruesit (kryefjalës), një në funksion të përfituesit (kundrinorit të zhdrejtë) dhe një tjetër në funksion të pësuesit (kundrinorit të drejtë) a temës. Çdo shtesë tjetër, përveç tri argumenteve, del fakultative. Në vijim po i japim disa shembuj:

- a) *Petriti i dhuroi shokut të tij një libër.*
- b) *Hans gab seinem Freund einen Buch.*
- c) *He gave his friend a book.*

Siç shihet, folja *dhuroj* (geben, to give) domosdo kërkon tri argumente për të shkarkuar rolet tematike, kurse mungesa e njërit nga argumentet e bën fjalinë jogramatikore, sepse një rol tematik mbetet pa u shkarkuar mbi një argument (sintagmë), p.sh.: **Petriti i dhuroi një libër ëshokut të tij*] del jogramatikore, sikurse edhe **Petriti i dhuroi shokut të tij ënjë libër*]. Të dy fjalitë janë jogramatikore, ngaqë folja kërkon të shkarkojë tri role tematike, ndërsa mungesa e një argumenti bën që një rol tematik të mungojë në plotësimin e valencës së foljes dhe në shkarkimin e roleve semantike. Kurse, në anën tjetër, një argument nuk mund të marrë dy role semantike (theta). Për këtë Çomski thotë:

- Çdo argument duhet t'i caktohet një rol tematik dhe vetëm një.
- Çdo rol tematik duhet t'i caktohet një argumenti dhe vetëm një argumenti.

ëChomsky: 1981].

¹³¹⁷ H. Aufderstraße, J. Müller, Th. Storz, *Delfin*, Max Hueber Verlag, Ismaning - Deutschland, 2002, f. &51.

¹³¹⁸ Përbërësit e drejtpërdrejtë të fjalisë (EPT) sipas kllapave të etiketuara.

Siç duket, një trajtim i mbështetur në teorinë e valencës jep një përshkrim të saktë, të qartë si në sintaksë, ashtu edhe në morfologji dhe semantikë etj. Përveç që teoria e valencës qartëson dhe argumenton bindshëm se cilët janë plotësorët e foljes (argumentet), valenca jep një përshkrim të saktë edhe për adjunktët (plotësit) e foljes, p.sh.:

a) *Teuta shkoi në mal me të vëllanë*¹³¹⁹ - *Teuta shkoi në mal*

b) *Ismajli ishte i një mendjeje me të jatën*.¹³²⁰ - *Ismajli ishte i një mendjeje me të jatën*.

Sipas Gramatikës universitare (vëll. 2, 2002), sintagmat parafjalore [eme të vëllanë] dhe [eme të jatën] konsiderohen kundrinorë të zhdrejtë me parafjalë. Sipas teorisë së valencës, foljet *shkoj* dhe *jam* janë njëvalente, të cilat marrin vetëm një argument në funksion të kryefjalës (argument i jashtëm), kurse çdo sintagmë (emërore a parafjalore) tjetër e shtuar mund të dalë në funksion të plotësit (cirkostant/adjunkt), por assesi në funksion të argumentit. Folja *shkoj* dhe *jam* dhe folje të tjera si këto janë folje intransitive. Këto folje marrin edhe kallëzuesor të shprehur me një emër, mbiemër, përemër, sintagmë etj. në funksion të kallëzuesorit (predikativit). Në gramatikën gjermane DUDEN thuhet se foljet *vij*, *shkoj*, *jam*, *qëndroj* etj. (kommen, gehen, sein, bleiben, stehen etj.) janë folje njëvalente intransitive (einwertig intransitiv)¹³²¹. Prandaj te shembujt e mësipërm (a) dhe (b), sintagmat parafjalore [eme të vëllanë] dhe [eme të jatën] nuk janë kundrinorë (argumente), por shtesa (adjunktë, plotës). Te disa folje edhe plotësit dalin të domosdoshëm kur nuk ndihmon konteksti, sepse një gjë të tillë kërkon valenca sintaksore dhe semantike e tyre, p.sh.:

a) **Teuta shkoi*¹³²² [ë?] [ë + në mal] [ë ± me të vëllanë],

b) **Ismajli ishte*¹³²³ [ë?] [ë i një mendjeje ± me të jatën]¹³²⁴.

Në qoftë se sintagmat parafjalore [ënë mal], [eme të vëllanë], [ëi një mendjeje (SE)], [eme të jatën] do të ishin argumente, atëherë ato do të dilnin përbërës të domosdoshëm (obligatory). Mirëpo këta përbërës të fjalisë edhe po munguan, fjalia mbetet përsëri gramatikore, po aq sa ishte më parë, p.sh.:

Teuta shkoi në mal

¹³¹⁹ ASHSH, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Vëll. 2, Tiranë, 2002, f. 262.

¹³²⁰ Vep. e cit., po aty, f. 262.

¹³²¹ DUDEN, *Die Grammatik*, Duden Verlag, Mannheim, Wien, Zürich, 2009, f. 424-425.

¹³²² Si në gjermanishte e po kështu edhe në shqipe, folja *shkoj* (gehen) është intransitive. Për mendimin tonë, sintagma parafjalore [me të vëllanë] është në funksion të kallëzuesorit (PK). Në *Gramatikën univeristare* thuhet: "foljet që tregojnë lëvizje: *kthej*, *dal*, *iki*, *shkoj*, *vij*, *zbres* etj." (vëll. 2, 2002: 243) marrin përcaktorë kallëzuesorë të shprehur me emër me dhe pa parafjalë. Sipas mendimit tonë, kjo përbën në luhatje, një paqartësi në definimin e çështjes se SP duhet konsideruar si kundrinor të zhdrejtë me parafjalë apo përcaktor kallëzuesor (a përcaktor).

¹³²³ Folja *jam* është njëvalente, sepse merr një argument të jashtëm dhe valenca e kësaj foljeje kërkon të plotësohet edhe nga plotës (adjunktë). E njëjta dukuri shpërfaqet edhe në gjermanishte (krh. **sein** + **1 Ergänzung**, DUDEN, 2009: 361). Nga kjo rrjedh se folja *jam* nuk ka mundësi të marrë argumente të mbrendshme (kallëzore a dhanore).

¹³²⁴ Sintagma parafjalore [me të jatën] është argument i emrit [i një mendjeje], por jo i foljes. Prandaj edhe mund të mungojë, sepse është plotësor fakultativ i emrit, por mungesa e sintagmës [i një mendjeje] sjell ndryshime kuptimore në fjali, p.sh. *Ismajli ishte me të jatën* krh. *Ismajli ishte i një mendjeje*.

Ismajli ishte i një mendjeje (\pm me të jatin),
Ismajli ishte me të jatin (\pm i një mendjeje)¹³²⁵.

Në vijim sjellim shembullin *Mollët m'i ka ënda shumë* (ma ka ënda / më pëlqejnë)¹³²⁶ dhe shtrojmë pyetjen: pse kjo fjali nuk merr kryefjalë? Në qoftë se nisemi nga tradita, themi se kemi të bëjmë me folje pavetore, por përgjigjja nuk është eksplicite, sepse të thuash se është pavetore, del se përgjigjja është e pasaktë, ngase ka vetë (veta e tretë). Sipas teorisë së valencës dhe roleve semantike, kjo folje ka aftësi të marrë dy argumente: një argument të shprehur me sintagmë emërore në funksion të kundrinorit të drejtë (argument i brendshëm) dhe një argument (po ashtu të brendshëm) në rasën dhanore të shprehur me trajtën e shkurtër të përemrit vetor *ëunë* (*mua më*) + (*ato i*)). Çka do të thotë se kjo folje nuk ka mundësi të marrë një sintagmë emërore (argument të jashtëm), në funksion të kryefjalës, sepse valenca semantike dhe sintaksore¹³²⁷ nuk e lejon që folja të shkarkojë një rol semantik mbi një sintagmë emërore në funksion të kryefjalës. Qoftë në strukturën sipërfaqësore, qoftë në e strukturën e thellë të projektimit të kësaj fjalie, kjo folje nuk ka mundësi të marrë një argument të jashtëm (subjekt).

Dekadat e fundit, disa studiues shqiptarë sollën zhvillimet e reja nga gjuhësia bashkëkohore perëndimore, qoftë me anë të përkthimeve, qoftë me anë të studimeve të tyre të mbështetura në teoritë e linguitikës bashkëkohore (gjenerativizmit e teorive të tjera të kohës). Me punën e tyre të pakundshoq, ndër ne, hapën një hulli dhe trasuan rrugën për gjuhëtarët e rinj që t'i qasen edhe këta trajtimeve gjuhësore të mbështetura në teori të linguitikës bashkëkohore. Kjo është nismë e mbarë që shqipja të lëvrohet sipas teorive të reja linguitike dhe t'u jepet përgjigje eksplicite mjaft problemeve gjuhësore që gjuhësia tradicionale nuk ka arritur t'i shpjegojë në mënyrë të qartë dhe të saktë.

Literatura

- ASHSH, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Vëll. 2, Tiranë, 2002.
 ASHSH, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë 2006.
 DUDEN, *Die Grammatik*, Duden Verlag, Mannheim, Wien Zürich, 2009.
 Chomsky, Noam, *Syntactic structures*, Mouton de Gruyter, Berlin, 2002 (First ed. publ. 1957).
 Dhima, Thoma, *Çështje, të sintaksës së gjuhës shqipe*, Infbotues, Tiranë, 2013.
 Fillmore, J. Charles, *A VALENCY DICTIONARY OF ENGLISH*, , International Journal of Lexicography Advance Access published October 8, 2008, f.10; doi:10.1093/ijl/ecn037.
 Graffi, Giorgio, *Sintaksa*, Dituria, Tiranë, 2003.
 Koleci, Flora, *Frazat relative të shqipes parë në këndvështrimin gjenerativist*, Tiranë, 2013.
 Memushaj, Rami, *Gjuhësia gjenerative*, SHBLU, Tiranë, 2008.
 Memushaj, Rami, *Hyrje në gjuhësi*, Toena, Tiranë, 2006.
 Mita, Josif, *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë, 2005

Recensentë:
 Prof. dr. Ragip Mulaku
 Prof. dr. Abdullah Zymberi

¹³²⁵ Për këtë çështe shih: G. Graffi, *Sintaksa*, Dituria, Tiranë, 2003, f. 72-75.

¹³²⁶ ASHSH, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 256, 456.

¹³²⁷ Charles J. Fillmore, *A VALENCY DICTIONARY OF ENGLISH*, International Journal of Lexicography Advance Access published October 8, 2008, f.10; doi:10.1093/ijl/ecn037.

PËRMBAJTJA

| | |
|--|-----|
| ETIKA NË SHKENCË, Salvatore Bushati | 11 |
| INDIKATORËT NDËRKOMBËTARË TË MATSHMËRISË SË VEPRIMTARISË KËRKIMORE – SHKENCORE, Murteza Osdautaj | 17 |
| INTERNETI DHE GJUHA E TË RINJËVE (KULLERAVE) Afërdita Abdullahi | 27 |
| DALLIMET EVENTUALE DHE NGJASHMËRITË FUNKSIONALE MIDIS MË SE TË KRYERËS DHE TË KRYERËS SË TEJSHKUAR, Agnesa Hasimja..... | 31 |
| RRETH PËRDORIMIT TË FORMAVE TË PASHTJELLUARA NË SHKRIMET E HERSHME TË ARSHI PIPËS, Aimir Osmani | 35 |
| PËRDORIMI I FJALËVE TË HUAJA NË LIGJËRIMIN E SOTËM TË FOLUR E TË SHKRUAR, Alma Tirana | 41 |
| VEÇORI TË LIGJËRIMIT TË KADARESË NË ROMANIN “KRONIKË NË GUR, Aseda Behari | 47 |
| PRIRJA E DEFONOLOGJIZIMIT TË ZANOREVE HUNDORË NË TË FOLMET E GEGËRISHTES, Asllan Hamiti | 55 |
| TOPONOMIA DHE MIKROTOPONOMIA E REKËS SË EPËRME, Avzi Mustafa | 61 |
| HAJDAR SALIHU - STUDIUES I PËRKUSHTUAR I POEZISË SHQIPE ME ALFABET ARAB, Besim Muhadri | 71 |
| REFLEKSET MODERNISTE NË ARTIN PAMOR NË KOSOVË, Agnesa Muharremi | 77 |
| ÇËSHTJA E FORMIMIT TË GJUHËS LETRARE NË REVISTËN “ALBANIA” TË FAIK KONICËS, Besmira Palushaj | 83 |
| KONCEPTI I SË FSHEHTËS NË VEPRËN “ËNDËRRIME” TË NAIM FRASHËRIT, Blerina Harizaj | 89 |
| FJALORI ITALISHT-GREQISHT-SHQIP I THIMI MITKOS, VLERAT DHE KARAKTERISTIKAT E TIJ NË PËRQASJE ME FJALORIN E KOSTANDIN KRISTOFORIDHIT, Doriana Tuxhari | 95 |
| GJUHA SHQIPE NË TEKSTET TONA SHKOLLORE, Gentiana Shahini, Fadil Latifi | 101 |
| BOTA E BRENDSHME E P. MARKOS PËRMES FIGURACIONIT GJUHËSOR E STILISTIK, Greta Jani | 109 |
| DY KODIKË EKUFONETIKË TË SHEK. XI NË ARKIVIN QËNDROR TË SHTETIT SHQIPTAR, Holta Sina | 117 |
| MBIJETESA SHUMËSHEKULLORE E ARBËRESHËVE NË VATRAT E GJUHËS DHE TË LETËRSISË, Hysni Ndreu | 125 |
| NOTACIONI I RI MUZIKOR SI SPROVË PËR PEDAGOGJINË PIANISTIKE (MODEL SET NJOHURISH PËR QASJE PEDAGOGJIKE), Indira Çipa | 131 |
| ERNEST KOLIQUI DHE VENDI I TIJ NË STUDIMET LETRARE SHQIPTARE PAS VITEVE `90, Irma Sokoli (Bilali) | 139 |

| | |
|--|---------|
| MUZEU HISTORIK ETNOGRAFIK NË VUSHTRRI TEMPULL I KOMUNIKIMIT QYTETAR ME TRASHËGIMINË KULTURORE, Jehona Hajrullahu | 147 |
| PROFILI KRIJUES I PETRIT PALUSHIT, Kosovare Krasniqi | 153 |
| E FOLMJA MALËSORE NË MAL TË ZI NËN DRITËN E SHQYRTIMEVE SOCIOLINGUISTIKE, Marjan Lulgjuraj | 159 |
| VEPRIMTARIA E POETËVE TË SOTËM ARBËRESHË NË KUSHTET E DYKULTURËSISË DHE DYGJUHËSISË, Kristo Kolçi, Denis Himçi, Meli Shopi | 165 |
| LETËRSIA GOJORE SI INTERTEKST NË POEZITË E NAIM FRASHËRIT, Msc. Meral Shehabi-Veseli | 173 |
| ASPEKTET POZITIVE DHE NEGATIVE TË SHUMËGJUHËSISË , Mustafa Ibrahim | 182 |
| FRAZELOGJIA NË TREVËN E GJAKOVËS, Naim Berisha | 185 |
| HENRIK IBSEN PËRMES KONFLIKTIT PA RRUGËDALJE TEK "HEDDA GABLER" Rregjina Gokaj..... | 189 |
| MODERNITËTI I NDËRPRERË NË POEZINË E VITEVE '70: MOIKOM ZEQQO, Sali Bytyçi |195 |
| RRETH DISA PIKËTAKIMEVE MIDIS SHQIPES DHE RUMANISHTES, Sejdi M. Gashi | 201 |
| ROLI I PËREMRRIT PRONOR VETVETOR I, E VET NË TË FOLMET BILINGUALE, Senad Neziri | 209 |
| FEJESAT E NDALUARA NË VENDIN TONË, Shkëlçesë Kurtaj | 219 |
| RRUGËTIMI DREJT PARISIT, VATRËS SË KULTURËS, Valbona Gashi-Berisha | 225 |
| SISTEMI I NJOHJES PAMORE TË FJALËS, Zamira Shkreli | 233 |
| FJALËT E HUAJA NË GJUHË SHQIPE PËRMES TERMINOLOGJISË SË INFORMATIKËS, Abdurrahim Maxhuni | 239 |
| VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI PËREMRRAT E PACAKTUARA TË PËRNGJITURA TEK "MESHARI" I GJON BUZUKUT, Aida Bado-Beqiri | 243 |
| VËSHTRIM STILISTIKOR MBI POETIKËN E CAMAJT, Aida Uruçi | 251 |
| PËRDORIMI I VARIANTEVE GJUHËSORE NË TELEVISIONIN "KLAN KOSOVA", Albulena Alidema & Majlinda Emini | 259 |
| TIPIZIMI I PERSONAZHIT KRYESOR TE ROMANI "PALLATI I ËNDRRAVE" I ISMAIL KADARESE, Alta Haluci. | 265 |
| ORGANIZIMI FAMILJAR DIKUR, FAMILJA BASHKËKOHORE, Angjelina Hamza | 271 |
| DREJTSHKRIMI I FJALËVE DHE I EMRAVE ME PREJARDHJE TË HUAJ NË SHQIPEN MODERNE, Anisa Çuni | 277 |
| VEÇORI LEKSIKORE TË FJALORËVE DIALEKTORË-KRAHINORË (BARDHI, GAZULLI E BENEDIKT DEMA), Anisa Kosteri | 285 |
| STRUKTURAT KUSHTORE NË POEZINË "NËSE" TË R. KIPLINGUT, Ardita Berisha | 293 |

- KOSTUMET POPULLORE TË JUGUT TË SHQIPËRISË NË VEPRAT E PIKTORËVE E SKULPTORËVE SHQIPTARË, Arjan Zurbo 299
- POSTULATET TEORIKO-SHKENCORE TË SHKATHHTESISE SE PERKTHIMIT DHE INTEPRETIMIT, Arjan Zurbo 307
- EMËRTIMET TOGFJALËSHORE NGA ANA E FORMËS SË BRENDSHME NË SHQIPE NË PËRQASJE ME GJEGJËSET BARAZVLERËSE NË ANGLISHTE DHE RUSISHTE, Dervish Alimi, 315
- IMAGOLOGJIA, KRIJIMI I IMAZHIT DHE MIRAZHIT PËRMES SHKRIMIT LETRAR, Edelaajda Cenaj- Çepa 323
- TRONDITJA E MITIT TË BESËS TEK VEPRAT E KADARESË: "KUSH E SOLLI DORUNTINËN", "PRILLI I THYER" DHE "URA ME TRI HARQE" , Edlira Çerkezi 327
- SHKRIMET KRITIKE TË REXHEP QOSES, METODA KRAHASUESE DHE GJURMË TË INETERTEKSTUALITETIT, Edlira Gugu 333
- VËZHGIME MBI VLERAT SEMANTIKORE TË FOLJEVE MODALE NË GJUHËN SHQIPE DHE ATË ITALIANE, Entela Mustafaraj 339
- KONVEKSIONI DHE NDJESHMËRIA SKENIKE, Erald Bakalli 349
- REFLEKTIME TË LETËRSISË QËLLIMORE NË LETËRSINË SHQIPE ME SHKRIM ORIENTAL, Ermira Alia 353
- SHKENCAT HISTORIKE**
- NJË VËSHTRIM KRITIK MBI BAZAT KUSHTETUESE TË SHKATHTESISE SHQIPTAR - ILUMINITETI I TYRE DHE REALITETI SHQIPTAR NË VITET 1920-1924, Albana Mema 369
- ÇËSHTJA E KOSOVËS NË POLITIKËN SHQIPTARE NË FUND TË SHEKULLIT XX, Alida Avdullari 377
- GJASHTË MUAJ PRINC I SHQIPTARËVE - TË METAT NË QEVERISJE DHE KËRCËNIMET, Alma Prendi 398
- QËNDRIMI POLITIK I SHQIPËRISË DHE PENGESAT E NDESHURA NË KONFERENCËN E PARË DHE TË DYTË BALLKANIKE, Anduana Shahini (Kertalli) 399
- QËNDRIMI I POLITIKËS BRITANIKE NDAJ SHQIPËRISË NË VITET 1939 – 1942, Armand Sheqi 421
- KRYENGRITJA E KOSOVËS E VITIT 1910 – PARAPRIJËSE E SHPALLJES SË PAVARËSISË SË SHQIPËRISË, Avni Rexha 405
- TRASHËGIMIA MONUMENTALE NË DEÇAN, Bekim Vishaj.....411
- QËNDRIMI I AUSTRO-HUNGARISË NDAJ ÇËSHTJES SHQIPTARE GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE, Blerim Haziri 417
- DIMENSIONI EVROPIAN I MËSIMDHËNIES SË HISTORISË NE SHKOLLË NGA RIPRODHIMI NË INTERPRETIM TË FAKTEVE DHE TË NGJARJEVE HISTORIKE, Desara Karaj 423
- SFIDAT NË ADAPTIMIN DHE IMPLEMENTIMIN E POLITIKAVE EVROPIANE NË SISTEMIN POSTKOMUNIST SHQIPTAR, Dritan Palnikaj 431
- PRONËSIA NË MYZEQE SIPAS REFORMËS AGRARE 1945 – 1990, Elona Gjelaj 437

RRETHANAT DHE FAKTORËT QË FAVORIZUAN KTHIMIN E AHMET ZOGUT NË PUSHTET SIPAS HISTORIOGRAFISË SË HUAJ, Elona Kazazi
441

GJETJE MONEDHASH NË ANAMORAVË, Elvira Reçica 447

PERSEKUTIMI I INTELEKTUALËVE NGA PKSH, Enis Kelmendi 453

VEPRIMTARIA E FAN NOLIT NË MBROJTJE TË ÇËSHTJES SHQIPTARE NË VITET E PARA TË PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE, Erjon Dervishi
459

VËSHTRIM MBI VEPRIMTARINË E SHOQËRIVE TË PARA FEMËRORE NË SHQIPËRI NË VITET 1912-1924, Esilda Luku 465

QENDRIMI I FUQIVE TË MËDHA NDAJ REVOLUCIONIT TË QERSHORIT TË VITIT 1924 NË SHQIPËRI, Estela Palnikaj (Hoxha) 473

FORTIFIKIME NË MALËSI TË ZHEGOCIT, Faik Sahiti 579

DIPLOMACIA NDËRKOMBËTARE DHE KOSOVA 1990-1999, Ferit Idrizi
487

KONTRADIKTAT E NAKO SPIRUT ME POLITIKËN JUGOSLLAVE PËR EKONOMINË E SHQIPËRISË, Ilir Sallata 501

TIPOLOGJIA E QYTËTIT ANTIK ONHEZMI, Klodian Gjoni..... 505

PROPAGANDA DHE ÇETAT E ARMATOSURA GREKE NË KOHËN E KRYENGRITJES SË VITIT 1912, Ledia Dushku.....513

RËNDËSIA E LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT, Mirela Lazimi.....519

EMIGRACIONI I HERSHËM SHQIPTAR NË SHBA DHE AKTIVITETI I TYRE NË DOBI TË ÇËSHTJES KOMBËTARE (FUNDI I SHEK. XIX DERI NË 1918), Mirela Nofulla 523

JETA PARLAMENTARE GJATË VITEVE TË MONARKISË SHQIPTARE (1928-1939), Nertila Haxhia Ljarja 529

POLITIKA ITALIANE NDAJ ÇËSHTJES SHQIPTARE 1897-1912, Niko Ferro
537

ZHVILLIMET ARSIMORE NË NËNPREFEKTURËN E PËRMETIT NË VITET 1925-1939, Nuri Dragoj 543

ORGANIZATA E TRAKTATIT TË ATLANTIKUT TË VERIUT; ROLI I ALEANCËS NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT DHE PËRHAPJES TË ARMËVE TË DËMTIMIT NË MASË, Orest Radhima 553

FORTIFIKIME NË SHALË TË BAJGORËS, Pajazit Hajzeri 559

QËNDRIMI I SHQIPËRISË NË KONFERENCËN I BALLKANIKE TË MINISTRAVE TË PUNËVE TË JASHTME BEOGRAD, 26-28 SHKURT 1988 (NË DRITËN E BURIMEVE ARKIVORE DIPLOMATIKE SHQIPTARE), Pranvera Dibra Teli 565

VËSHTRIM HISTORIK-ETNOLOGJIK I KRAHINËS SË TOMORRICËS, SHQIPËRI, Qamil Lirëza 573

VEÇORITË E REVOLUCIONIT GREK DHE SHQIPTARËT, Rezart Mezani
683

ELBASANI NË ZONËN E PUSHTIMIT AUSTRO-HUNGAREZ, GJATË VITEVE TË LUFTËS SË PARË BOTËRORE, Rudina Mita, Elvis Dhono...687

MINORITETET NË FOKUS TË KOMISIONIT HETIMOR TË ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA, Sonila Boçi 695
 SHPALLJA E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË SIPAS SHTYPIT SHQIPTAR TË KOHËS Shpend AVDIU 603
 SHPALLJA E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË 28 NËNTOR 1912 , Zile Hasmeta 609
 SEMANTIZMI ELIPTIK ("LUM LUMI", A. PODRIMJA), Msc. Fitor Ollomani..... 619
 DRAMAT E ANTON PASHKUT (TRAGJEDI MODERNE), Halil Dervishaj 629
 KONTRAVERSI I KULTIT TË DETIT NË KRAHINËN E BREGUT TË JONIT, Dr. Irena Gjoni 637
 DUKURI LEKSIKO-SEMANTIKE NË VEPRËN E MARTIN CAMAJT, Ma. Majlinda Bushaj 645
 DASHURIA SI ELEMENT KODIFIKUES NË POEMËN "KËNGËT E MILOSAOS", Marjela Progni-Peci 653
 ROMANI KRONIKË NË GUR I ISMAIL KADARESË (KUFIJTË E RRËFIMIT) Muhamet Peci 657
 BASHKËKOHËSIMI I ZHVILLIMIT LETRAR SHQIPTAR DHE ATIJ EVROPIAN, Prof. dr. Hamit Xhaferi 661
 VEÇORI TË PËRGJITHSHME TË GJUHËS E STILIT NË VEPRËN E GJERGJ FISHTËS, Gladiola Durmishi (Elezi) 667
 GJURMIME NË HISTORINË E SHTYPIT SHQIPTAR DERI NË VITIN 1990, Naile Demiri & Prof. Dr. Hamit Boriçi 679
 LEXUESI INTERPRETUES PËRBALLË VEPRËS SË ZHITIT, Neim Zhuri 689
 PROBLEME LIDHUR ME TERMIN E STRUKTURËS SË PËRBËRËSIT SINTAKSOR (SINTAGMËS), Sonila Sejdini (Çela) 695
 AFIRMIMI I ARSIMIT DHE KULTURËS SHQIPTARE NË NJË VEPËR TË RËNDËSISHME, Dr. Teuta Vinca- Kafexholli 699
 POEZIA INTIME E KADARESË, E FRYMËZUAR NGA MOSKA, Prof.dr.Vebi Bexheti 705
 NJË VËSHTRIM I SHKURTËR PËR VALENCËN DHE ROLET TEMATIKE TË FOLJES, Xhafer Beqiraj 711
 PËRMBAJTJA 717

Radaktor
Murteza Osdautaj

Ndihmuan:
Ukë Osmanaj
Ardiana Shabaj
Sebahate Jupolli
Yllza Mehmeti

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

008(=18)”2014”(061)
811.18-26
94(=18)

Kumtesat / Redaktor Murteza Osdautaj.- Prishtinë :
Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë,
2015. - libra ; 24 cm.

[Libri] I. - Shkencat gjuhësore, kulturore dhe historike.
– 723 f. : ilustr.

Parathënia / Arsim Bajrami f. : 5-6

ISBN 978-9951-16-087-2
ISBN 978-9951-16-088-2